Ellen G. White

KONFLIKTI I MADH

Me Udhëzues Studimi

Titulli në origjinal:
"The GREAT CONTROVERSY between Christ and Satan"
© The Ellen G. White® Estate, Inc.
www.whiteestate.org

Ky libër është pjesë e serisë "Connecting with Jesus"
www.connectingwithjesus.org

Botues: Kisha Adventiste® në Shqipëri - ALM
Albanian Mission of Seventh-day Adventists®
P.O. Box 2937, Tirana, Albania

Përkthyen: Bruna Hoxholli, Migena Tane
Redaktoi: Kornelia Gjata
Ndihmuan: Andi Lile, Julian Kastrati
U kujdesën: Leo N. España, Mario Šijan & Gentian Thomollari
Përgjegjës për botimin: Julian Kastrati, ALM Publishing Service

web: www.adventist.al
e-mail: office@adventist.al
Për më shumë info: www.eksplorojeten.al

Ellen G. White

KONFLIKTI I MADH

Me Udhëzues Studimi

Përmbajtja

Parathënie nga Botuesit 7

Hyrje 9

1. Shkatërrimi i Jeruzalemit 15
2. Persekutimi në Shekujt e Parë 30
3. Një Epokë Errësire Shpirtërore 38
4. Valdezët 47
5. John Wycliffe 60
6. Huss dhe Jerome 73
7. Ndarja e Luterit nga Roma 89
8. Luteri Përpara Dietës 107
9. Reformatori Zvicerian 125
10. Progresi i Reformës në Gjermani 135
11. Protestat e Princave 144
12. Reformimi Francez 155
13. Hollanda dhe Skandinavia 175
14. Reformatorët e Mëvonshëm Anglezë 182
15. Bibla dhe Revolucioni Francez 197
16. Etërit Pelegrin 214
17. Lajmëtarët e Mëngjesit 222
18. Një Reformator Amerikan 234
19. Drita Përmes Errësirës 251
20. Një Zgjim i Madh Besimi 260
21. Një Paralajmërim i Refuzuar 274
22. Profecia e Përmbushur 286
23. Çfarë është Shenjtërorja? 299

24. Në Vendin më të Shenjtë 309
25. Ligji i Pandryshueshëm i Perëndisë 316
26. Një Punë Reformash 329
27. Rigjallërimet Moderne 337
28. Duke u Përballur me Ngjarjet Jetësore 350
29. Origjina e së Keqes 360
30. Armiqësi Midis Njeriut dhe Satanit 370
31. Agjensitë e Frymërave të Liga 375
32. Kurthet e Satanit 381
33. Mashtrimi i Parë i Madh 391
34. A Mund të na Flasin të Vdekurit? 405
35. Kërcënimi i Lirisë së Ndërgjegjes 414
36. Konflikti i Pashmangshëm 429
37. Shkrimet si Mburojë 438
38. Paralajmërimi i Fundit 446
39. Koha e Trazirave 454
40. Njerëzit e Perëndisë të Çliruar 470
41. Shkretimi i Tokës 483
42. Konflikti Merr Fund 490

Parathënie nga Botuesit

Ky libër, të dashur lexues, nuk është botuar për të na treguar se ekziston mëkati, vuajtjet dhe mjerimi në këtë botë. Këtë gjë e dimë mjaft mirë. Ky libër nuk është botuar as për të na thënë se ekziston një konflikt i papajtueshëm ndërmjet errësirës dhe dritës, mëkatit dhe drejtësisë, të gabuarës dhe të drejtës, vdekjes dhe jetës. Thellë në zemër e dimë edhe këtë, madje dhe që jemi pjesëmarrës dhe aktorë në këtë konflikt.

Por herë pas here, shumëkujt i vjen një endje të dijë më shumë për Konfliktin e Madh. Si filloi ky konflikt? Apo mos ndoshta ka ekzistuar gjithnjë këtu? Cilët elementë luajnë rol në aspektin e ndërlikuar të këtij konflikti? Çfarë raporti kam unë me të? Cila është përgjegjësia ime? Çfarë do të thotë për mua fakti që kam ardhur në këtë botë jo prej zgjedhjes sime? A është kjo mirë apo keq për mua?

Cilat janë parimet themelore të përfshira këtu? Për sa kohë do të vazhdojë ky konflikt? Cili do të jetë fundi i tij? A do të fundoset kjo botë, sikurse thonë disa shkencëtarë, në thellësitë e një nate të përjetshme te akullt e pa diell? Apo ka një të ardhme më të mirë?

Pyetja na përafrohet edhe më shumë: Si mundet, që konflikti në zemrën time, lufta ndërmjet egoizmit dhe dashurisë, të vendoset përfundimisht me fitoren e së mirës? Çfarë thotë Bibla për këtë gjë? Çfarë na mëson Perëndia në lidhje me këtë pyetje kaq të rëndësishme me pasoja të përjetshme?

Lexues të dashur, është qëllimi i këtij libri që të ndihmojë shpirtrat e trazuar në zgjidhjen e duhur për të gjitha këto probleme. Ky libër është shkruar nga dikush që e ka provuar dhe e ka vërtetuar që Perëndia është i mirë dhe që ka mësuar nga kuvendimi me Perëndinë dhe nga studimi i Fjalës së Tij, që të fshehtat e Perëndisë u zbulohen atyre që i druhen Atij dhe se Ai do t'u shfaqë atyre besëlidhjen e Tij.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë parimet e këtij krye-konflikti i cili përfshin jetën e krejt universit, autori na e ka paraqitur atë në formë mësimesh madhështore që vijnë nga njëzetë shekujt e fundit të historisë së planetit tonë.

Ky libër hapet me skenat e dhimbshme përmbyllëse nga historia e Jeruzalemit, qytetit të të zgjedhurve të Perëndisë, pas refuzimit që i bëri Jezu Krishtit, Njeriut të Kalvarit, që erdhi për të shpëtuar, duke filluar që andej e më tej përgjatë rrugës së gjatë të kombeve, na përcjell për tek përndjekjet që iu bënë besimtarëve përgjatë shekujve të parë; apostazia e madhe që pllakosi më vonë kishën e Tij; zgjimi

mbarëbotëror i kombeve gjatë periudhës së Reformacionit, gjatë së cilës shfaqen dukshëm disa nga parimet themelore të konfliktit; leksioni i hidhur prej refuzimit të parimeve të drejta nga Franca; rigjallërimi dhe promovimi i Shkrimeve të shenjta dhe influenca e tyre jetë-shpëtuese; rizgjimi i besimit në ditët e fundit; shfaqja e burimit të ndritshëm të fjalës të Perëndisë me zbulesat e tij të mrekullueshme të dritës dhe njohurive që na mundësojnë përballjen më trillimet e errësirës.

Kështu, na shfaqet ky konflikt i vazhdueshëm dhe i pashmangshëm, me gjithë parimet jetësore që ai përfshin, ndaj të cilave askush nuk mund të qëndrojë asnjëanës.

Në fund na tregohet për fitoren e përjetshme dhe të lavdishme të së mirës mbi të keqen, të gëzimit mbi trishtimin, të shpresës mbi dëshpërimin, të lavdisë mbi turpin, të jetës mbi vdekjen dhe të dashurisë së durueshme të përjetshme mbi urrejtjen hakmarrëse.

Duke filluar që me edicionin e parë në 1888, e duke vazhduar me një edicion të rishikuar nga vetë autorja në 1911, kjo vepër e shquar ka arritur një qarkullim të jashtëzakonshëm mbarëbotëror nëpërmjet shumë edicioneve e përkthimeve në dhjetëra gjuhë të ndryshme. Lexuesi do të kuptojë që autorja shkruan në mënyrë të sinqertë dhe energjike, duke nxjerrë në pah gabimet dhe duke propozuar në të njëjtën kohë edhe zgjidhjet, mbështetur gjithnjë në Fjalën e pagabueshme të Perëndisë. Ndonëse dekadat e fundit kanë hasur ndryshime e lëkundje në botën shoqërore-fetare, skema kryesore dhe projeksionet e së ardhmes të prezantuara në këtë libër janë në fakt më koherente se kurrë dhe vërtetë të bëjnë për vete.

Edicionet e mëparshme të këtij libri kanë sjellë shumë shpirtra tek Bariu i vërtetë; është lutja e botuesve që ky botim të mund të jetë edhe më i frytshëm plot me mirësi përjetësie!

Botuesit.

Hyrje

Para se të hynte mëkati, Adami gëzonte akses të plotë me Krijuesin e tij, por që nga momenti kur njeriu u nda nga Perëndia për shkak të shkeljes, raca njerëzore u privua nga ky privilegj i madh. Megjithatë, falë planit të shpëtimit, u hap një rrugë përmes së cilës banorët e tokës mund të kishin ende një lidhje me qiellin. Perëndia ka komunikuar me njerëzit përmes Frymës së Shenjtë dhe drita hyjnore i është dhënë botës nëpërmjet zbulesave që Ai u ka dhënë shërbëtorëve të Tij. "Njerëzit e shenjtë të Perëndisë folën të shtyrë nga Fryma e Shenjtë" (*2 Pjetrit 1:21)*.

Gjatë njëzetepesë shekujve të parë të historisë njerëzore, nuk ekzistonte asnjë zbulesë e shkruar. Ajo çka ishte mësuar mbi Zotin, komunikohej gojarisht dhe kështu transmetohej nga baballarët tek bijtë, brez pas brezi. Përgatitjet për Fjalën e shkruar filluan të realizoheshin gjatë periudhës së Moisiut. Kështu pra, zbulesat e frymëzuara u trupëzuan në një libër të frymëzuar. Kjo veprimtari vazhdoi përgjatë një periudhe të konsiderueshme prej gjashtëmbëdhjetë shekujsh — që nga Moisiu, historiani i zanafillës dhe i ligjit, e deri tek Gjoni, regjistruesi i të vërtetave më sublime të ungjillit.

Bibla tregon qartë se autori i vërtetë i saj është Zoti Perëndi, ndonëse u shkrua nga dora njerëzore, dhe në stile të ndryshme e të shkruarit të librave të saj, duke na treguar edhe karakteristikat unike të shkruesve të saj të ndryshëm. Të vërtetat e zbuluara në Bibël janë të gjitha "të frymëzuara nga Perëndia" (*2 Timoteut 3:16*), ndonëse ato janë të shprehura me fjalë njerëzore. I pakufishmi Perëndi përmes Frymës së Tij të Shenjtë ka hedhur dritë në mendjet dhe zemrat e shërbëtorëve të Tij. Ai u ka shfaqur ëndërra, vegime, simbole dhe figura; dhe ata të cilët i morën këto të vërteta, i shkruan më pas në gjuhë njerëzore.

Dhjetë Urdhërimet u shpallën personalisht nga Zoti dhe u shkruan nga vetë dora e Tij. Ato janë një kompozim hyjnor, jo njerëzor. Por Bibla, me të vërtetat e dhëna nga Zori Perëndi, të shprehura në gjuhën njerëzore, na paraqesin një bashkim të hyjnores me njerëzoren. Ky lloj bashkimi u shfaq në natyrën e Krishtit, i cili ishte njëkohësisht Biri i Perëndisë dhe Biri i njeriut. Pra ashtu sikurse është e vërtetë për Krishtin, është e vërtetë edhe për Biblën, që "Fjala u bë mish dhe jetoi mes nesh" (*Gjoni 1:14)*.

Shkruar në periudha kohore të ndryshme, nga njerëz të cilët ndryshonin nga njëri-tjetri përsa i përket nivelit, pozicionit apo aftësive intelektuale e dhuntive

shpirtërore, librat e Biblës paraqesin një kontrast të gjërë në stil si dhe një gjithanshmëri në natyrën e tematikave që trajtohen. Mënyra të ndryshme të të shprehurit janë përdorur nga shkrimtarë të ndryshëm; shpesh, e njejta e vërtetë përçohet me intensitet të ndryshëm në varësi të shkrimtarit. Dhe duke qenë se shkrimtarë të ndryshëm flasin për një tematikë të caktuar, por të parë nga këndvështrime të ndryshme, disa lexuesve të pakujdesshëm dhe sipërfaqësorë mund t'u jetë dhënë përshtypja sikur ekzistojnë papajtueshmëri apo kontradikta, por, nga ana tjetër, lexuesit e kthjellët dhe të mprehtë arrijnë të dallojnë harmoninë e plotë të shkrimeve biblike.

Siç paraqitet nga individë të ndryshëm, e vërteta na jepet e parë nga aspekte të ndryshme. Një shkrimtari, për shembull, i lë më tepër mbresë një pjesë e caktuar e temës; ai kap ato pjesë që harmonizohen me përjetimin apo me aftësinë e tij të perceptimit dhe vlerësimit; dikush tjetër mbresohet nga një tjetër pjesë; dhe secili prej tyre, nën drejtimin e Frymës së Shenjtë, prezanton atë që ka lënë më shumë mbresa në mendjen e tij — një aspekt të ndryshëm të së vërtetës, por e gjitha e harmonizuar në përsosmëri. Të vërtetat në këtë mënyrë bashkohen për të formuar një tërësi të përsosur, e përshtatur kjo për të plotësuar nevojat e njeriut në të gjitha rrethanat dhe përvojat jetësore.

Zoti Perëndi ka parapëlqyer të komunikojë të vërtetën e Tij përmes kanaleve njerëzore, dhe Ai vetë, me anë të Frymës së Shenjtë, trajnoi njerëzit dhe i aftësoi ata për ta kryer këtë detyrë. Ai i udhëhoqi mendjet e tyre duke u treguar se çfarë të zgjidhnin për të folur dhe për të shkruar. Ndonëse iu besua mjeteve tokësore, thesari mbetet gjithsesi nga Qielli. Vërtetë, dëshmia u përçua nëpërmjet shprehjes së papërsosur të gjuhës njerëzore, por megjithatë ajo është dëshmia e Perëndisë; dhe besimtarët e bindur të Perëndisë shikojnë në të lavdinë e fuqisë hyjnore, plot me hir e të vërtetë.

Në fjalën e Tij, Perëndia i ka dhënë njeriut njohurinë e nevojshme për shpëtim. Shkrimet e Shenjta duhet të pranohen si zbulesa të pagabueshme dhe autoritative të vullnetit të Tij. Ato janë standarti i karakterit, shfaqëset e doktrinave dhe prova e eksperiencës. "I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë" (*2 Timoteut 3:16-17)*.

Megjithatë, fakti që Zoti Perëndi u ka zbuluar vullnetin e Tij njerëzve përmes fjalës së Tij, nuk e ka bërë të panevojshme praninë e vazhdueshme dhe udhërrëfimin e Frymës së Shenjtë. Përkundrazi, Fryma na u premtua nga Shpëtimtari ynë, për të përhapur fjalën tek shërbëtorët e Tij, për të ndriçuar dhe për të zbatuar mësimet e Tij. Dhe përderisa ishte Fryma e Perëndisë që e frymëzoi Biblën, është absolutisht e pamundur që mësimet e Frymës të jenë në kundërshtim me ato të fjalës së shkruar.

Fryma nuk u dhurua dhe as nuk mund të jepet kurrë si zëvendësues i Biblës; sepse Shkrimet në mënyrë të qartë na thonë që fjala e Perëndisë është standarti nga i

cili duhen vënë në provë të gjitha mësimet e përjetimet. Apostulli Gjon thotë: "Mos i besoni çdo fryme, por i vini në provë frymërat për të ditur nëse janë nga Perëndia, sepse shumë profetë të rremë kanë dalë në botë" (*1 Gjonit 4:1)*. Dhe Isaia na thotë, "Përmbahuni ligjit dhe dëshmisë! Në rast se një popull nuk flet në këtë mënyrë, kjo do të thotë se ai nuk ka dritë" (*Isaia 8:20)*.

Një padrejtësi e madhe është bërë ndaj punës së Frymës së Shenjtë nga gabimet e atyre të cilët, duke pretenduar se janë ndriçuar nga Fryma, deklarojnë së nuk kanë më nevojë për udhëheqjen e fjalës së Perëndisë. Ata udhëhiqen nga ndjesitë apo përjetimet, të cilat i konsiderojnë si zëri i Perëndisë në shpirt. Por fryma që i kontrollon ata nuk është Fryma e Zotit. Ndjekja e këtyre emocionalizmave, duke neglizhuar kështu Biblën, mund të çojë vetëm në çoroditje, mashtrim dhe shkatërrim. Këto gjëra shërbejnë vetëm për avancimin e planeve të të ligut. Përderisa puna e Frymës së Shenjtë është e një rëndësie jetësore për kishën e Krishtit, një nga mënyrat tinzare të Satanit është që nëpërmjet gabimeve të ekstremistëve dhe fanatikëve, të shkaktohet përbuzje për punën e Frymës si dhe të provokohet një neglizhencë tek njerëzit e Perëndisë ndaj këtij burimi fuqie, të cilin Zoti vetë na e ka dhuruar.

Në harmoni me fjalën e Perëndisë, Fryma e Tij duhej të vazhdonte punën e vet përgjatë periudhës kohore të shpalljes së ungjillit. Gjatë kohës në të cilën u dhanë Shkrimet e Dhjatës së Vjetër dhe Dhjatës së Re, Fryma e Shenjtë nuk pushoi së komunikuari dritë në mendjet e individëve, përfshi dhe zbulesay që u materializuan në Kanonin e Shenjtë (procesin e përcaktimit të 66 librave përfundimtarë që përbëjnë Biblën). Bibla është një shembull që na tregon sesi nëpërmjet Frymës së Shenjtë, njerëzimi ka marrë paralajmërime, qortime, këshilla dhe udhëzime në çështje që nuk lidhen me mënyrën e dhënies së Shkrimeve. Referenca të tilla janë bërë nga profetë të epokave të ndryshme, ligjërimet e të cilëve nuk janë regjistruar. Në mënyrë të ngjashme, pas përfundimit të kanonizimit të Shkrimeve, Fryma e Shenjtë përsëri do të vazhdonte punën e vet, duke ndriçuar, paralajmëruar dhe ngushëlluar fëmijët e Perëndisë.

Jezusi u premtoi dishepujve të Tij: "Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t`ju mësojë çdo gjë dhe do t`ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë". "Kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, Ai do t`ju prijë në çdo të vërtetë: … dhe do t`ju tregojë gjërat që do vijnë" (*Gjoni 14:26; 16:13)*. Shkrimet qartësisht na mësojnë se këto premtime, nuk ishin të kufizuara vetëm për kohërat apostolike por edhe përgjatë të gjitha epokave të kishës së Krishtit. Shpëtimtari i siguron ndjekësit e Tij, "Unë jam me ju deri në mbarim të botës" (*Mateu 28:20*). Kurse Pali deklaron se dhuntitë dhe shfaqjet e Frymës ndodhnin brenda kishës "për përsosjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, te një njeri i përsosur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit" (*Efesianëve 4:12-13)*.

Për besimtarët në Efes, apostulli u lut, "që Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdisë, t`ju japë juve Frymën e diturisë dhe të zbulesës, në njohurinë e tij, dhe t`u ndriçojë sytë e mendjes suaj, që të dini cila është shpresa e thirrjes së tij dhe cilat janë pasuritë e lavdisë së trashëgimisë së tij në shenjtorët, dhe cila është madhështia e jashtëzakonshme e fuqisë së tij ndaj nesh, që besojmë sipas veprimit të forcës së fuqisë së tij" (*Efesianëve 1:17-19)*. Shërbesa e Frymës hyjnore në ndriçimin e të kuptuarit dhe hapjes së mendjes për gjërat e thella të fjalës së Shenjtë të Perëndisë, ishte bekimi që Pali kërkonte për kishën efesiane.

Pas shfaqjes së mrekullueshme të Frymës së Shenjtë në Ditën e Rrëshajave, Pjetri nxiti njerëzit të pendoheshin dhe të pagëzoheshin në emrin e Krishtit, për shlyerjen e mëkateve të tyre; dhe tha: "Ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë sepse premtimi është për ju dhe për bijtë tuaj dhe për gjithë ata që janë larg, për ata që Zoti, Perëndia ynë, do t`i thërrasë" (*Veprat e Apostujve 2:38-39)*.

Në lidhje direkte me skenën e ditës së madhe të Perëndisë, Zoti përmes profetit Joel na ka premtuar një derdhje të posaçme të Frymës së Tij (*Joeli 2:28*). Profecia u përmbush pjesërisht në derdhjen e Frymës në Ditën e Rrëshajave; por do të përmbushet plotësisht në shfaqjen e hirit hyjnor që do të kujdeset për mbylljen e shërbesës së shpërndarjes së ungjillit.

Konflikti i Madh ndërmjet të mirës dhe të keqes do të rritet në intensitet në momentet e fundit të historisë tokësore. Në të gjitha epokat, zemërimi i Satanit është derdhur kundër kishës së Krishtit; dhe Perëndia ka derdhur hirin dhe Frymën e Tij mbi njerëzit për t'i forcuar ata që t'i rezistojnë fuqisë së të ligut. Kur apostuj-ve të Krishtit u duhej të shpërndanin ungjillin e Tij nëpër botë dhe ta ruanin atë për kohërat e ardhshme, ata u ndriçuan me dhurimin e Frymës. Por ndërsa kisha i afrohet çlirimit të saj përfundimtar, Satani do të punojë më fuqishëm. Ai zbret "duke pasur zemërim të madh, duke ditur se ka pak kohë" (*Zbulesa 12:12)*. Ai do të punojë "me çudira, shenja dhe mrrekullira të rreme" (*2 Thesalonikasve 2:9)*. Për më se 6000 vjet, ajo mendje mjeshtërore që njëherë e një kohë kishte qenë më e larta mes engjëjve të Perëndisë, ka qenë tërësisht e angazhuar në punën e shkatërrimit dhe mashtrimit. Dhe gjithë thellësitë e aftësive satanike të fituara me dinakëri, e gjithë ligësia e shkaktuar përgjatë këtyre luftërave të epokave, do të përballet me njerëzit e Perëndisë në konfliktin përfundimtar. Dhe në këtë kohë plot rrezik, ndjekësit e Krishtit do të duhet t'i shpallin botës lajmin e ardhjes së dytë të Zotit; dhe njerëzit duhet të përgatiten të qëndrojnë përballë Tij në ardhjen e Tij, "të papërlyer dhe të paqortueshëm" (*2 Pjetrit 3:14)*. Në këtë kohë dhurata e posaçme e hirit hyjnor dhe fuqisë së Tij nuk është më pak e nevojshme se ç'ishte në kohërat apostolike.

Nëpërmjet ndriçimit nga Fryma e Shenjtë, skenat e konfliktit të gjatë ndërmjet të mirës dhe të keqes i janë shfaqur autores së këtij libri. Herë pas here mua më është lejuar të shoh ngjarjet, në epoka të ndryshme, të konfliktit të madh mes Krishtit,

Princit të jetës, Autorit të shpëtimit tonë dhe Satanit, princit të së keqes, autorit të mëkatit, shkelësit të parë të ligjit të shenjtë të Perëndisë. Armiqësia e Satanit ndaj Krishtit është shfaqur kundrejt ndjekësve të Tij. E njëjta urrejtje ndaj parimeve të ligjeve të Perëndisë, e njëjta taktikë mashtrimi, përmes së cilës e gabuara paraqitet sikur të ishte e vërtetë, nga e cila ligjet njerëzore zëvendësojnë ato të Perëndisë dhe njerëzit drejtohen për të adhuruar krijesën në vend të Krijuesit, mund të evidentohet gjatë gjithë historisë së shkuar. Përpjekjet e Satanit për të hedhur baltë mbi karakterin e Perëndisë, me synimin që njerëzimi të ketë një konceptim të gabuar për Zotin Krijues dhe, për rrjedhojë, ta mendojnë Zotin me frikë e urrejtje dhe jo me dashuri (siç është në të vërtetë); përpjekjet djallëzore për ta anashkaluar ligjin hyjnor, duke i drejtuar njerëzit që të mendojnë se janë të çliruar nga kërkesat e tij; si dhe përndjekja e atyre që guxojnë t'i rezistojnë mashtrimeve të tij, janë ushtruar në vazhdimësi përgjatë epokave. Ato mund të evidentohen qartësisht në historinë e patriarkëve, profetëve dhe apostujve, martirëve e reformatorëve.

Në konfliktin e madh përfundimtar, Satani do të përdorë të njëjtën praktikë pune, do të shfaqë të njejtën frymë dhe do të punojë për të njejtin fund sikurse edhe përgjatë epokave të shkuara. Ajo që ka ndodhur më parë do të ndodhë sërish, vetëm se beteja që po troket do të jetë tmerrësisht më intensive, aq sa bota nuk e ka parë ndonjëherë më parë. Mashtrimet e Satanit do të jenë më të rafinuara, sulmet e tij më të vendosura. Nëse do të kishte mundësi, ai do të mashtronte edhe më të zgjedhurit (*Marku 13:22*).

Ashtu si Fryma e Perëndisë më ka hapur mendjen ndaj të vërtetave të mëdha të fjalës së Tij dhe skenave të së shkuarës e të së ardhmes, unë jam ftuar për t'ua bërë të ditur të tjerëve–të hulumtoj historinë e konfliktit në të shkuarën dhe veçanërisht të hedh dritë në betejën e së ardhmes që po afron shumë shpejt. Në përmbushjen e këtij objektivi, jam përpjekur të zgjedh dhe përmbledh së bashku ngjarjet e historisë së kishës në një mënyrë të tillë që të shpalos të vërtetat e sprovave që ka kaluar bota në kohëra të ndryshme, të cilat e kanë nxitur zemërimin e Satanit dhe armiqësinë e një kishe të dhënë pas botës dhe që janë ruajtur në dëshminë e atyre që "nuk e deshën veten e tyre deri në vdekje."

Në këto shkrime mund të shohim paralajmërimet e konfliktit përpara nesh. Në lidhje me këtë, me dritën e fjalës së Perëndisë dhe ndriçimi e Frymës së Tij, ne mund të shohim qartësisht mënyrat që përdor i ligu dhe rreziqet që duhet të shmangin ata, që të mund të gjenden "pa faj" përpara Zotit kur Ai të vijë.

Ngjarjet e mëdha që kanë shënuar progres në reformën e epokave të shkuara janë çështje të historisë, të mirëpranuara në tërësi nga bota protestante; ato janë fakte të cilat askush nuk mund t'i mohojë. Këtë histori unë e kam paraqitur shkurtimisht, në përputhje me qëllimin e këtij libri dhe konçiziteti që duhet të analizohet, faktet që janë paketuar në një hapësirë të vogël të cilat konsistojnë edhe me një

kuptim të drejtë të zbatimit të tyre. Në disa raste, kur një historian ka grupuar disa ngjarje bashkë, aq sa ka qenë e mundur, në një mënyrë të përmbledhur të temës, ose ka përmbledhur detaje në një mënyrë të përshtatshme, fjalët e tij janë cituar; por në disa raste specifike nuk u është cituar emri, për shkak se nuk ka qenë qëllimi të citohet shkrimtari si autoritet, por për shkak se fjalimet e tij japin një prezantim të fuqishëm të temës. Në tregimin e përvojave jetësore dhe pikëpamjeve të atyre që po çojnë përpara punën e reformës në kohën tonë, një përdorim i ngjashëm është bërë edhe me botimet e tyre.

Nuk është synimi i këtij libri të japë të vërteta të reja në lidhje me betejat e kohërave të shkuara sesa është sjellja e fakteve dhe parimeve që kanë ndikim në ngjarjet që do të ndodhin. Megjithatë, parë si pjesë e konfliktit ndërmjet forcës së dritës dhe errësirës, të gjitha këto ngjarje të së shkuarës duket që japin një domethënie të re; dhe nëpërmjet tyre hidhet një dritë mbi të ardhmen, duke ndriçuar rrugën e atyre, të cilët sikurse dhe reformatorët e kohërave të shkuara, do të thirren të dëshmojnë "për fjalën e Perëndisë dhe për dëshminë e Jezus Krishtit", qoftë edhe në rast sakrifikimi të të mirave tokësore.

Të shpalosen skenat e konfliktit të madh ndërmjet të vërtetës dhe gënjeshtrës; të demaskohen dinakëritë e Satanit si dhe të evidentohen mjetet me anë të të cilave mund t'i rezistojmë atij me sukses; të prezantohet një zgjidhje e kënaqshme e problemit të madh të së keqes, duke hedhur kaq shumë dritë mbi origjinën dhe natyrën e mëkatit derisa të manifestohen plotësisht drejtësia dhe dashamirësia e Perëndisë në tërësinë e raportit që Ai ka me krijesat e Tij; dhe të tregohet natyra e shenjtë dhe e pandryshueshme e ligjit të Tij – ky është pikërisht objektivi i këtij libri. Që, përmes influencës së librit, njerëzit të mund të çlirohen nga fuqia e errësirës dhe të bëhen "pjesëmarrës të trashëgimisë së shenjtorëve në dritë", për lavdi të Atij që na deshi dhe dha jetën e Tij për ne – kjo është lutja e sinqertë e autores!

Ellen G. White

1.

Shkatërrimi i Jeruzalemit

"Oh, sikur ti, pikërisht ti, të njihje të paktën në ditën tënde ato, që janë të nevojshme për paqen tënde! Por tani ato janë të fshehura për sytë e tu. Sepse përmbi ty do të vijnë ditë, kur armiqtë e tu do të të qarkojnë me ledh, do të të rrethojnë dhe do të të zënë nga të gjitha anët. Dhe do të të rrëzojnë përtokë ty dhe bijte e tu në ty dhe nuk do të të lënë në ty gur mbi gur, sepse ti nuk e ke njohur kohën kur je vizituar". *(Luka 19:42-44)*

Nga maja e malit të Ullinjve Jezusi vështronte Jeruzalemin. E bukur dhe e shndritshme nga paqja ishte skena, që hapej përpara vështrimit të Tij. Ishte koha e Pashkëve dhe fëmijët e Izraelit kishin ardhur nga të katër anët për të festuar këtë festë të madhe kombëtare. Pallatet madhështore dhe muret e larta të qytetit ngriheshin mes lulishteve, vreshtave, maleve të pyllëzuar dhe të ngjyrosur nga tendat e shtegëtarëve, mbi sfondin e kodrave në formë taracash. Vajza e Sionit dukej sikur fliste me krenari: "Unë rri mbi fron si mbretëreshë dhe nuk do të njohë kurrë trishtim". Ajo ndjehej po aq e bukur dhe e sigurt për dashamirësinë qiellore, sa ç'kishte qenë edhe kohë më parë, kur psalmisti këndonte: "I bukur për nga lartësia e tij, gëzimi i gjithë dheut është mali i Sionit...qyteti i Mbretit të Madh". *(Psalmi 48:2)*.

Përballë dukeshin qartë ndërtesat madhështore të tempullit. Rrezet e diellit në perëndim ndriçonin muret e mermerta dhe i jepnin shkëlqim të ri arit të portës dhe kullës.

"Bukuria e përsosur" ishte krenaria e popullit çifut. Cili izraelit mund t'i afrohej një pamjeje të tillë pa provuar një ndjenjë drithëruese gëzimi dhe admirimi? Por, Jezusin e kishin pushtuar mendime të tjera. "Kur po afrohej, Ai e pa qytetin dhe qau për të". *(Luka 19:41)*.

Në mes të haresë së madhe për nder të hyrjes së Tij triumfuese, ndërsa tundeshin degë palmash dhe thirrjet "Hosana" rizgjonin jehonën e kodrave dhe miliona zëra e quanin "Mbret", Shpëtimtari i botës u pushtua nga një ndjenjë e thellë trishtimi.

Ai, Biri i Perëndisë, Premtimi i Izraelit, që me fuqinë e Tij kishte fituar mbi vdekjen dhe u kishte falur liri robërve të saj, qante. Nuk bëhej fjalë për një dhembje kalimtare, por për një ankth të thellë e të pafrenueshëm.

Megjithëse e dinte se ku do ta shpinte rruga, që kishte nisur Ai nuk derdhte lot për veten. Përpara Tij shtrihej Gjetsemani, skena e agonisë që e priste. Madje edhe porta e qingjave gjendej afër; porta nëpërmjet së cilës kishin kaluar në shekuj viktimat që i nënshtroheshin aktit të flijimit dhe Ai e dinte mirë se ajo portë do të hapej edhe për Të kur të shkonte "si një qengj në thertore" *(Isaja 53:7)*.

Pak më tutje ndodhej Kalvari, udha e kryqëzimit. Mbi rrugën, që e priste shpejt do të binte nje errësirë e padepërtueshme, ndërsa shpirti i Tij do të kthehej në fli për mëkatin. Megjithatë nuk ishte vizioni i skenave të tilla, që hodhi një hije trishtimi në atë orë gëzimi. Nuk ishte as paralajmërimi i ankthit të Tij mbinjerëzor, që ia errësonte shpirtin vetëmohues. Ai qante për banorët e Jeruzalemit - qante verbërinë dhe kokëfortësinë e të gjithë atyre, të cilët kishte ardhur t'i bekonte dhe t'i shpëtonte. Përpara syve të Jezusit u shfaqen ato mijëra vjet historie të dashamirësisë së veçantë dhe kujdesit atëror të Perëndisë ndaj popullit të zgjedhur. Aty pranë ishte Mali i Morias, ku biri i premtuar(Isaku) ishte shtrirë pa fjalë mbi altar - një emblemë kjo e flijimit të Birit të Perëndisë. Aty iu konfirmuan edhe njëherë babait të besimtarëve(Abrahamit) besëlidhja e besimit dhe premtimi i lavdishëm i ardhjes së Mesisë *(Zanafilla 22:9; 16-18)*. Pak më tutje flakët e flijimit, që u ngritën nga lëmi i Ornanit drejt qiellit e bënë engjëllin e vrasjes ta rifusë shpatën në mill *(1 Kronikave 21)* - një simbol i saktë dhe i vërtetë i ndërmjetësimit të Shpëtimtarit në dobi të fajtorëve. Zoti e kishte nderuar Jeruzalemin më shumë se çdo vend tjetër. Zoti "e kishte zgjedhur Sionin" dhe "e kishte dashur atë për banesë të Tij" *(Psalmi 132:13)*. Atje profetët në shekuj kishin dhënë mesazhe paralajmërimi. Atje priftërinjtë kishin lëkundur temjanicat e tyre, ndërsa retë e temjanit dhe lutjet e adhuruesve ishin ngjitur në qiell deri tek Perëndia. Atje ishin therrur çdo ditë qingja tokësorë, që simbolizonin gjakun e Qingjit të Perëndisë. Atje ishte ngritur shkalla mistike, që lidhte qiellin me tokën *(Zanafilla 28:12; Gjoni 1:51)*. - ajo shkallë, mbi të cilën ngjiteshin dhe zbrisnin engjëjt e Perëndisë, shkalla, që i hapi botës rrugën drejt lavdisë më të madhe. Në qoftë se Izraeli si komb nuk do të kishte prishur marrëveshjen me Qiellin, do të kishte jetuar në përjetësi si qyteti i zgjedhur nga Zoti *(Jeremia 17:21-25)*. Por historia e këtij populli të zgjedhur është një rrugë rëniesh dhe rebelimesh. Izraelitët nuk iu dorëzuan mirësisë së qiellit, abuzuan me privilegjet dhe i hodhën poshtë mundësitë, që iu afruan.

Megjithëse Izraeli "i kishte përqeshur lajmëtarët e Perëndisë, i kishte përbuzur fjalët e Tij dhe i kishte keqtrajtuar profetët, *(2 Kronikave 36:16)* Ai kishte vazhduar të tregohej "Zot i mëshirshëm e i dhembshur, i ngadalshëm në zemërim, i pasur në mirësi dhe në besnikëri" *(Eksodi 34:6)*, pavarësisht nga mohimet e vazhdueshme.

Mëshira e Tij nuk kishte rreshtur. Me një dashuri akoma më të madhe se ajo e babait për birin, Perëndia "u dërgoi atyre paralajmërime me anë të lajmëtarëve të Tij, sepse donte ta shpëtonte popullin e Tij dhe banesën e Tij" *(2 Kronikave 36:15)*. Kur ankesat, këshillat dhe qortimet s'qenë asgjë tjetër veçse një vrimë në ujë, Ai nuk hezitoi të jepte Dhuratën më të shtrenjtë të qiellit, Dhuratën, që përfshinte në vetvete qiellin vetë. Vetë Biri i Perëndisë kishte ardhur të këshillonte qytetin e pabindur. Ishte Krishti Ai, që e kishte nxjerrë Izraelin si një hardhi hyjnore jashtë Egjyptit *(Psalmi 80:9)*. Ishte Krishti Ai, që mbolli vreshtën e Izraelit "në një kodër pjellore". Ishte kujdesi i Tij, që iu bë gardh mbrojtës. Ishin shërbëtorët e Tij ata, që u dërguan ta plehëronin. "Çfarë mund t'i kisha bërë vreshtit tim, - tha Ai - që nuk ia kam bërë?" *(Isaja 5:1-4)*. Ndërsa pritej që vreshti të prodhonte rrush, ai prodhoi gjemba. Megjithatë Zoti, duke ushqyer shpresën e qëndrueshme për frute erdhi vetë në vreshtin e Tij dhe u orvat ta shpëtonte nga shkatërrimi. Ai prashiti tokën përreth, e shartoi vreshtin dhe me përpjekje të parreshtura bëri të pamundur për ta mbajtur në jetë vreshtën, që e kishte mbjellë me duart e Veta.

Zoti i dritës dhe i lavdisë qëndroi për 3 vjet mes popullit të Tij. Ai "e përshkoi vendin, duke bërë mirë e duke shëruar të gjithë ata, që ishin të pushtuar nga djalli", duke u dhënë shpresë zemërthyerve, duke shpallur çlirimin e të burgosurve, kthimin e të parit të verbërve, kthimin e të ecurit të çalëve, pastrimin e lebrozëve, kthimin e dëgjimit të shurdhërve, ringjalljen e të vdekurve dhe duke u predikuar tëvarfërve *ungjillin (Veprat e Apostujve 10:38)*; *(Luka 4;18)*; *(Mateu 11:5)*.Thirrja e hirshme: "Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar e të rënduar dhe unë do t'ju jap çlodhje" iu drejtua të githë njerëzve pa përjashtim.

Megjithëse u shpërblye me urrejtje dhe mosmirënjohje *(Psalmi 109:5)* Ai me mirësi dhe dashuri vazhdoi i patrembur misionin e Tij mëshirëplotë. Kurrë nuk i zbrapsi ata, që kërkonin hirin e tij. Shtegtar pa fole, duke pasur si trashëgim vetëm përbuzjen dhe varfërinë, Ai jetoi për të përmbushur nevojat e njerëzve dhe për t'ua lehtësuar shqetësimet, duke i nxitur ata ta pranonin dhuratën e jetës. Dallgët e hirësisë me t'u zbrapsur nga zemrat e pabindura ktheheshin sërisht me një shprehje akoma më të qëndrueshme dashurie dhe keqardhjeje. Por Izraeli ishte larguar nga Miku i tij më i mirë, nga Ndihma e tij e vetme. Thirrjet e Tij të dashurisë u përbuzën, këshillat e Tij u shkelën me këmbë dhe paralajmërimet e Tij u hodhën poshtë.

Orës së shpresës dhe faljes po i vinte fundi, kupa e zemërimit të pashprehur të Perëndisë ishte pothuajse plot. Retë, që ishin dendësuar gjatë periudhës së gjatë të mosbesimit e rebelimit ishin në pikën e shpërthimit mbi një komb fajtor, ndërsa Ai që mund t'i shpëtonte u tall, u përqesh, u mohua dhe do të kryqëzohej pa humbur kohë. Me t'u mbërthyer Jezusi mbi kryqin mbi Kalvar, do t'u vinte fundi edhe ditëve të Izraelit si komb i zgjedhur dhe i bekuar i Perëndisë. Humbja madje edhe e

një njeriu të vetëm është një fatkeqësi, që ka të bëjë me fitimet e pasuritë botërore, por, ndërsa Krishti hodhi vështrimin mbi Jeruzalem, përpara syve të Tij u shpalos fati i një qyteti të tërë, fati i një kombi të tërë - i atij kombi dhe atij qyteti, që dikur kishin qënë të zgjedhurit e Perëndisë, thesaret e Tij të veçantë.

Profetët kishin qarë për apostazinë e Izraelit dhe për rrënimet e tmerrshme, që do të provokonin mëkatet e Tij. Jeremia dëshironte që sytë e tij të ishin burim lotësh për të qarë ditë e natë të vrarët e bijës së popullit të tij dhe tufën e qingjave të Perëndisë, që do të shkonte drejt robërisë *(Jeremia 9:1;13:17)*. Sa i madh ka qënë atëherë trishtimi i atij, që me vështrimin e Tij profetik depërtonte jo vite, por shekuj!Ai shihte engjëllin shfarosës, që me shpatë të zhveshur sulmonte qytetin e lashtë, që për shumë kohë kishte qënë vendbanimi i të Madhërishmit.nga maja e malit të ullinjve vendi, i cili më vonë do të pushtohej nga Titusi dhe ushtria e tij, shikimi i Tij drejtohej tek lëndinat dhe harqet e shenjta dhe përgjatë një perspektive të frikshme Ai shihte me lot në sy muret e rrethuara nga ushtritë armike. Dëgjonte ritmin e hapit ushtarak të legjioneve në marshim drejt frontit të luftimit dhe thirrjet e fëmijëve, që brenda qytetit të rrethuar u kërkonin bukë nënave. Ai shquante shtëpitë e bukura të qytetit, pallatet dhe kështjellat e tij - pre e flakëve, që do të linin më pas vetëm një grumbull gërmadhash të tymosura.

Duke hedhur vështrimin në shekuj, Krishti pa popullin e besëlidhjes të shpërndarë në të katër anët si mbeturinat e një anijeje të mbytur në brigjet e një plazhi të shkretuar. Në fatkeqësinë që do të binte mbi fëmijët e Izraelit Ai vuri re vetëm gllënkën e parë të kupës së hidhur të zemërimit, që gjatë gjykimit të fundit atyre do t'u duhej ta pinin me fund. Mëshira hyjnore dhe dashuria shlyese u shpreh në fjalët: "Jeruzalem, Jeruzalem, që i vret profetët e i vret me gurë ata, që të janë dërguar! Sa herë kam dashur t'i mbledh bijtë e tu ashtu si i mbledh klloçka zogjtë e vet nën krahë, por ju nuk deshët! Oh sikur ti, kombi i zgjedhur mbi të tjerët ta kishe njohur kohën e lajmërimeve dhe gjërave, që i përkasin paqes tënde! Unë e zbrapsa engjëllin gjykues, të ftova për pendim, por pa asnjë dobi. Ti nuk ke mohuar e përçmuar vetëm shërbëtorët e lajmëtarët, por edhe të shenjtin e Izraelit, Shpëtimtarin tënd. Vetëm ti je përgjegjës i shkatërrimit tënd. "Ju nuk doni që të vini tek Unë që të keni jetën" *(Mateu 23:37)*; *(Gjoni 5:40)*

Krishti shihte në Jeruzalem një simbol të botës së ngurtësuar në pabesi dhe rebelim, një botë, që po nxitonte drejt gjykimit të Perëndisë. Pesha e dhimbjes për njerëzimin e rrënuar, që i rëndonte mbi shpirt, e bëri të qante me kuje. Ai vuri re gjurmët e mëkatit në mjerimin, lotët dhe gjakun njerëzor, zemra e Tij u mbush me një mëshirë të pashtershme për të vuajturit e kësaj bote dhe dëshironte me gjithë shpirt t'i ndihmonte. Por madje as dora e Tij e lavdishme nuk mund ta zbrapste baticën e mallkimit njerëzor, sepse ata, që do ta kërkonin të Vetmin Burim ndihme do të ishin të paktë. Ai ishte gati që t'ia jepte shpirtin e Tij vdekjes për të fituar shpëtimin e tyre, por ata, që do të shkonin me Të për të "marrë jetën" ishin të pakët.

I madhërishmi i qiellit i përlotur? Biri i Zotit ishte i turbulluar në shpirt dhe i kredhur në ankth. Kjo skenë e çuditi qiellin. Kjo skenë na tregon ndotjen tepër të madhe të mëkatit, na tregon se sa detyrë e vështirë është madje edhe për Fuqinë Pafund që t'i çlirojë fajtorët nga pasojat e shkeljes së Ligjit të Perëndisë. Jezusi duke hedhur vështrimin në kohëra deri tek brezi i fundit, pa botën të intriguar në një mashtrim të ngjashëm me atë, që e kishte çuar Jeruzalemin në rrënim të plotë. Mëkati i madh i çifutëve ishte mospranimi i Krishtit, mëkati më i madh i botës Kristiane do të ishte mospranimi i ligjit të Perëndisë, që përbën bazën e qeverisjes së Tij si në qiell edhe në tokë. Ligjet e Zotit do të përbuzeshin e do të shkeleshin me këmbë. Miliona njerëz skllevër të mëkatit, shërbëtorë të Satanit, të dënuar për të vuajtur vdekjen e dytë nuk do të pranonin t'i dëgjonin fjalët e së vërtetës. Çfarë verbimi i tmerrshëm! Çfarë budallallëku i madh!

Dy ditë para Pashkëve pasi ishte larguar nga tempulli për të fundit herë dhe pasi kishte denoncuar hipokrizinë e udhëheqësve çifutë, Krishti mblodhi dishepujt e Tij në Malin e Ullinjve dhe u ul me ta mbi të tatëpjetën e gjelbëruar që dominonte qytetin. Ai vështroi edhe një herë muret, pallatet dhe kështjellat e Jeruzalemit. Ai pa edhe një herë tempullin që me shkëlqimin e tij i ngjante një kurore bukurie që hijeshonte malin e shenjtë.

Një mijë vjet më parë, psalmisti e kishte lartësuar dashamirësinë e Perëndisë ndaj Izraelit, duke e kthyer tempullin e tij në vendbanimin e Vet. "Tabernakulli i Tij është në Salem dhe Ai banon në Sion". Ai "zgjodhi fisin e Judës, malin e Sionit, që Ai e do dhe ndërtoi shenjtoren e Tij, ashtu si vendet shumë të larta *(Psalmi 76:2; 78; 68;69)*. Tempulli i parë u ndërtua gjatë periudhës së lulëzimit Izraelit. Mbreti David grumbulloi shumë materiale me vlerë, ndërsa projekti i ndërtimit mbante vulën hyjnore. *(1Kronikave 28:12,19)*. Ishte Solomoni, më i urti ndër mbretërit izraelitë, ai që e përfundoi këtë punë. Tempulli ishte ndërtesa më e bukur në faqe të dheut. Megjithatë Perëndia, nëpërmjet profetit Hagai, në lidhje me tempullin e dytë kishte thënë: "Lavdia e këtij tempulli të fundit do të jetë më e madhe nga ajo e të mëparshmit" "Dëshira e të gjithë kombeve do të vijë dhe Unë do ta mbush këtë tempull me lavdi - thotë Zoti i ushtrive" *(Hagai 2:9,7)*.

Pas shkatërrimit për shkak të Nabukadnezarit tempulli u rindërtua rreth 500 vjet para lindjes së Krishtit, nga një popull, që pas një robërie të gjatë, kthehej praktikisht në një vend të shkretë e të izoluar. Në mes të popullit kishte njerëz të moshuar, të cilët, duke qënë se e kishin njohur më parë lavdinë e tempullit të Solomonit, qanë kur u hodhën themelet e ndërtesës së re, që mendohej se ishte më pak e lavdishme se e para. Profeti e ka përshkruar bukur ndjenjën e trishtimit të atyre ditëve, kur shkruan: "Cili prej jush ka mbetur nga ata, që e kanë parë këtë tempull në lavdinë e tij të mëparshme? Dhe si po e shikoni tani? Në krahasim me atë, a nuk është kjo asgjë para syve tuaj?" *(Hagai 2:3)*; *(Esdra 3:12)*. Atëherë u dha premtimi se lavdia e shtëpisë së re do të ishte më e madhe se e së parës.

Por tempulli i dytë nuk mund të krahasohej me madhështine e të parit dhe në të ishte e vështirë të gjeje shenja të pranisë hyjnore, që ishin tipike të të parit. Përkushtimi i tij nuk u shoqërua nga një shfaqje e fuqisë mbinatyrore dhe mbi shenjtoren e sapondërtuar nuk u shfaq asnjë re lavdie. Nga qielli nuk zbriti zjarr për të djegur flinë e vendosur mbi altar. Pajtuesi nuk ndodhej në mes kerubineve në vendin shumë të shenjtë, arka, pajtuesi dhe pllakat e dëshmisë nuk ishin më brenda tempullit. Nga qielli nuk u dëgjua asnjë zë që t'i tregonte priftit vullnetin e Jehovait.

Çifutët ishin përndjekur më kot, për shekuj me radhë, që të kuptonin se në ç'mënyrë do të përmbushej premtimi i dhënë nga Perëndia, nëpërmjet Hagait. Krenaria dhe mosbesimi ua kishin mbyllur sytë përpara kuptimit të vërtetë të fjalëve profetike. Tempulli i dytë nuk u nderua nga reja e lavdisë së Perëndisë, por nga prania e gjallë e Atij, në të cilin jetonte fizikisht tërësia e Perëndisë - nga prania e Zotit vet shfaqur në mish. Kur Nazaretasi shëroi dhe u mësoi njerëzve në rrethinat e shenjta, tempulli me fjalë të tjera, pati nderin të kishte: "Dëshirën e kohërave" brenda tij. Tempulli i dytë ia kalonte për nga lavdia të parit vetëm sepse Jezusi ishte i pranishëm në të. Por Izraeli e flaku tej Dhuratën e paçmueshme qiellore. Me t'u larguar Mësuesi i përulur përmes portave të tij të arta, tempulli humbi përgjithmonë lavdinë e vet. Kështu u përmbushën fjalët e Shpëtimtarit: "Ja, shtëpia juaj po ju lihet e shkretë" *(Mateu 23:38)*.

Dishepujt mbetën të befasuar e të çuditur kur dëgjuan parashikimin e Krishtit rreth shkatërrimit të tempullit dhe dëshironin të njihnin më mirë kuptimin e fjalëve të Tij. Shkëlqimi i tij ishte fryt i punës, aftësive arkitektoriale dhe derdhjes së pasurive pafund për 40 vjet rresht. Herodi i Madh përdori për ndërtimin e tij pasuritë romake edhe thesaret çifute, pa përmendur dhuratat bujare të perandorit. Blloqe të ngjeshur mermeri të bardhë me përmasa të mëdha ishin dërguar posaçërisht nga Roma për të formuar një pjesë të strukturës së tij të madhërishme dhe dishepujt patën parasysh pikërisht këto blloqe masive kur i tërhoqën vëmendjen Mësuesit me fjalët: "Mësues, shih ç'gurë e ç'ndërtesa!" *(Marku 13:1)*

Këtyre fjalëve Jezusi iu përgjigj solemnisht: "Në të vërtetë po ju them se këtu nuk do të mbetet asnjë gur mbi gur, që nuk do të rrënohet" *(Mateu 24:2)*

Dishepujt e lidhën shkatërrimin e Jeruzalemit me ardhjen personale të Krishtit, i veshur me një lavdi të përkohshme, për t'u ulur mbi fronin e perandorisë më të madhe botërore, për të dënuar çifutët e pabindur e për ta flakur tej zgjedhën romake. Zoti u kishte thënë se do të vinte përsëri. Prandaj me të dëgjuar për rrënimin e Jeruzalemit mendjet e tyre u rikthyen tek ardhja e Tij e dytë dhe ashtu siç ishin të mbledhur në Malin e Ullinjve ata e pyetën Shpëtimtarin: "Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra dhe cila do të jetë shenja e ardhjes Tënde dhe e mbarimit të botës?" *(Versa 3)*.

E ardhmja iu fsheh si akt mëshire dishepujve. Sikur t'i kishin kuptuar atëherë plotësisht dy të vërtetat e frikshme - vuajtjet, vdekjen e Shpëtimtarit si dhe shkatër-

rimin e qytetit dhe tempullit - ata do t"i kishte pushtuar tmerri. Por Krishti u paraqiti atyre një kuadër të ngjarjeve më të rëndësishme, që do të ndodhin përpara fundit të kohërave. Fjalët e Tij në atë moment nuk u kuptuan plotësisht, por domethënia e tyre do të zbulohej kur populli i Tij të kishte nevojë për udhërrëfim. Kjo profeci kishte dy kuptime: ndërsa nga njëra anë parashikonte shkatërrimin e Jeruzalemit, nga ana tjetër skiconte tmerret e ditëve të fundit.

Jezusi u tregoi dishepujve, që dëgjonin me vëmendje për dënimet, që do të bëheshin mbi Izraelin femohues dhe veçanërisht për hakmarrjen shlyerëse, që do ta kishte zanafillën tek mohimi dhe kryqëzimi i Mesisë. Shenja të pagabueshme do t'i paraprinin kësaj pike kulmore. Ora e tmerrshme do të vinte papritur e pa pandehur.

Shpëtimtari i paralajmëroi pasuesit e Tij "Kur të shihni pra, neverinë e shkretimit, që është parathënë nga profeti Daniel, që ka zënë vend në vendin e shenjtë (kush lexon le ta kuptojë), atëherë ata që janë në Jude, le të ikin në male." *(Mateu 24:15,16)*; *(Luka 21: 20,21)*. Kur flamujt idhujtare të Romës të vendoseshin në vendin e shenjtë dhe jashtë mureve të Jeruzalemit, pasuesit e Krishtit duhej të gjenin shpëtim në arratisje. Me të parë shenjat paralajmeruese ata, që duhej të largoheshin nuk duhet të vononin. Si në Jude, edhe në Jeruzalem, të gjithë njerëzit duhej t'i bindeshin sinjalit për mërgim pa fjalë. Kush do të gjendej rastësisht mbi çatinë e shtëpisë, nuk duhej të hynte brenda saj, madje as për të marrë gjërat më me vlerë. Kush gjendej duke punuar në fusha apo në vreshta nuk duhet të humbiste kohë duke u kthyer në shtëpi për të marrë rrobat e trasha, që ka lënë atje ndërsa djersitej nga nxehtësia e diellit. Ata nuk duhet të ngurrojnë as edhe një minutë, përndryshe do të shkatërohen me të tjerët.

Gjatë mbretërimit të Herodit, Jeruzalemi jo vetëm që ishte zbukuruar shumë por, ndërtimi i kullave, mureve dhe fortesave e kishin përforcuar akoma më shumë pozicionin e tij të fuqishëm strategjik, duke e bërë qytetin praktikisht të papushtueshëm. Ai, që në një kohë të tillë kishte guximin të parashikonte publikisht shkatërrimin e tij, do të quhej padyshim ashtu siç u quajt Noeja në kohën e tij - një alarmist i çmendur. Por Krishti pati thënë: "Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e Mia nuk do të kalojnë". *(Mateu 24:35)*. Falë mëkateve të tij, Jeruzalemit i kanosej dënimi dhe mosbesimi kokëfortë i banorëve të tij e vulosi fatin e këtij qyteti.

Zoti nëpërmjet profetit Mikea deklaroi: "Tani dëgjoni këtë, o krerë të shtëpisë së Jakobit dhe qeveritarë të shtëpisë së Izraelit, që urreni drejtësinë dhe shtrembëroni çdo gjë, që është e ndershme, që ndërtoni Sionin me gjak dhe Jeruzalemin me paudhësi. Krerët e tij gjykojnë për një dhuratë, priftërinjtë e tij japin mësim për një pagesë, profetët e tij kryejnë shortari për para, megjithatë mbështeten te Zoti dhe thonë: "A nuk është vallë Zoti midis nesh? Nuk do na bjerë në krye asnjë fatkeqësi". *(Mikea 3:9-11)*

Këto fjalë përshkruanin saktësisht banorët e shthurur dhe egoistë të Jeruzalemit, të cilët, megjithëse pretendonin se i "respektonin" rreptësisht normat e ligjit të Perëndisë, i shkelnin me këmbë të gjitha parimet e tij. Ata e urrenin Krishtin, sepse pastërtia dhe shenjtëria e Tij i nxirrnin plotësisht në pah mëkatet e tyre dhe jo vetëm kaq, por e akuzonin Atë si fajtor për të gjitha shqetësimet, që përjetonin si rrjedhim i mëkateve të tyre. Edhe pse e dinin mirë që Ai ishte pa mëkat ata deklaruan, se vdekja e Tij ishte e nevojshme për shpëtimin e kombit. "Po ta lëmë Atë të vazhdojë kështu të gjithë do të besojnë në Të - thanë udhëheqësit çifutë - dhe do të vijnë romakët e do ta shkatërrojnë vendin dhe kombin tonë." *(Gjoni 11:48)*. Po të flijohej Krishti ndoshta ata do të ktheheshin përsëri në një komb të fortë e të bashkuar. Kështu ata u bashkuan me vendimin e kryepriftit të tyre, që është më mirë të vdesë një njeri i vetëm sesa të zhduket një komb i tërë.

Kështu udhëheqësit çifutë e ndërtuan "Sionin me gjak dhe Jeruzalemin me paudhësi." *(Mikea 3;10)*. Ndërsa nga njëra anë kryqëzonin Shpëtimtarin e tyre, sepse Ai nuk ia miratonte mëkatet, nga ana tjetër ata vazhdonin të vetëquheshin "populli i zgjedhur i Perëndisë" dhe pretendonin që Zoti t'i çlironte nga armiqtë. "prandaj, - vazhdon profeti, - për shkakun tuaj Sioni do të lërohet si arë, Jeruzalemi do të bëhet një grumbull rrënimesh dhe Mali i Tempullit një lartësi e pyllëzuar." *(Versa 12)*

Zoti e vonoi dënimin e Tij për qytetin dhe për kombin 40 vjet, duke filluar nga momenti në të cilin Jezusi shqiptoi profecinë mbi Jeruzalemin. I mahnitshëm ishte durimi i Perëndisë ndaj atyre, që ia mohuan ungjillin e ia vranë Birin e Tij. Parabola e pemës shterp paraqiste sjelljen e Zotit kundrejt popullit çifut. Urdhëri u dha: "Preje; pse të zërë kot tokën?" *(Luka 13:7)*, por mëshira hyjnore ia zgjati jetën edhe pak. Shumë çifutë nuk dinin asgjë për karakterin dhe punën e Krishtit. Fëmijët nuk kishin pasur mundësinë që të shihnin dritën, që prindërit e tyre e kishin përbuzur. Zoti dëshironte që drita, nëpërmjet apostujve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, të shkëlqente mbi ta, kështu atyre do t'u jepej mundësia që të shihnin përmbushjen e profecive, që lidheshin jo vetëm me lindjen dhe jetën e Jezusit, por edhe me vdekjen edhe ringjalljen e Tij. Fëmijët nuk do të dënoheshin për shkak të baballarëve, por nëse do të njihnin dritën e dhënë prindërve të tyre dhe mohonin dritën e dhuruar vet atyre, ata do të merrnin pjesë në mëkatet e prindërve dhe do t'i vinin kapakun kupës së paudhësisë.

Durimi i gjatë i Perëndise ndaj Jeruzalemit vërteton edhe një herë mosbindjen dhe kokëfortësinë e tyre. Plot urrejtje dhe të pamëshirshëm ndaj dishepujve të Jezusit ata e flakën tej ofertën e fundit të mëshirës. Atëherë Perëndia hoqi dorë nga mbrojtja e tyre dhe i la rrugë të lirë Satanit dhe engjëjve të tij dhe kombi e pa veten nën sundimin e udhëheqësit, që kishte zgjedhur vetë. Fëmijët e Jeruzalemit e kishin përbuzur hirësinë e Krishtit, që i aftësonte ata t'i nënshtronin impulset e tyre keq-

dashëse, duke i lënë atyre dorë të lirë veprimi. Satani nxiti pasionet më të egra e më të ulta shpirtërore. Njerëzit humbën aftësinë e të gjykuarit; ata vepronin të shtyrë nga inati i verbër. Mizeria e tyre kishte vetëm një emër: "satanike". Në gji të familjes e të shoqërisë, mes klasave të larta e të ulëta njerëzore mbizotëronin dyshimi, zilia, urrejtja, kontradiktat, rebelimi dhe vrasja. Nuk kishte askund siguri. Miqtë dhe të afërmit tradhëtonin njëri - tjetrin. Prindërit vrisnin fëmijët e tyre dhe fëmijët prindërit. Sundimtarët e kombit humbën vetkontrollin dhe pasionet shtazarake i kthyen ata në tiranë. Çifutët pranuan dëshmi të rreme dhe e dënuan në bazë të tyre Birin e Perëndisë, ndërsa tani akuzat e gënjeshtërta po ua vinin jetën në rrezik. Me veprimet e tyre kishin kohë që thonin: "Largojeni nga sytë tona të Shenjtin e Izraelit!" *(Isaja 30:11)* Dëshira e tyre tani u përmbush, s'kishin më frikë nga Perëndia. Satani ishte kreu i kombit dhe në kurthin e tij kishin rënë si autoritetet më të larta civile ashtu edhe ato fetare.

Kryetarët e grupeve të kundërta ndonjëhere bashkoheshin për t'i torturuar viktimat e mjera, por shpesh luftonin kundër njëri - tjetrit, duke bërë kërdinë. Madje as mjediset e shenjta të tempullit nuk mund ta frenonin egërsinë e tyre. Adhuruesit goditeshin përpara altarit dhe shenjtoren e fëlliqnin kufomat e të vrarëve. Megjithatë, mendjemëdhenj deri në verbëri e blasfemues deri në poshtërsi, autorët e kësaj vepre djallëzore deklaronin publikisht se as nuk u shkonte ndër mendje se mund të shkatërrohej Jeruzalemi, sepse ishte qyteti i Zotit Vet. Për ta përforcuar qytetin e tyre ata paguan profetë të rremë, që ndërsa legjionet romake rrethonin tempullin, këta të deklaronin se populli duhej të priste tani liri nga Perëndia. Së fundi, turmat e njerëzve i mbante gjallë "besimi" se i Madhërishmi do të ndërhynte për t'u dhënë fitore mbi armiqtë, por Izraeli e kishte përbuzur fuqinë qiellore e tani gjendej i pambrojtur. Jeruzalemi i mjerë! Dërrmuar nga mosmarrëveshjet e brendshme, dëshmitar i gjakut të fëmijëve të vrarë, nga banorët e vet dhe i ushtrive armike, që i rrafshuan fortesat e tij dhe ia masakruan luftëtarët.

Të gjitha paralajmërimet, që bëri Jezusi u përmbushën deri në germën e fundit. Çifutët e vuajtën mbi kurriz të vërtetën e fjalëve të Tij: "Me masën me të cilën ju masni, do t'iu masin të tjerët." (Mateu 7:2)

Shenjat dhe mrekullitë u shfaqën si paralajmërim i fatkeqësive dhe shkretimeve. Në mes të natës një dritë e çuditshme ndriçonte tempullin dhe altarin. Nën retë e perëndimit dukeshin si të pikturuara karrot dhe ushtarët e radhitur për beteja. Priftërinjtë, që gjatë natës shërbenin në tempull, i tmerronin disa zëra misteriozë, toka dridhej dhe nga të katër anët dëgjoheshin zëra, që thërrisnin: "Le të largohemi nga këtu!" Porta e madhe lindore, që ishte kaq e rëndë sa mezi e mbyllnin 20 burra të fuqishëm dhe, që ishte e siguruar nga shufra të rënda hekuri të fiksuara në gurin e dyshemesë, u hap në mesnatë pa veprimin e duarve të askujt.[1]

[1] (Milman, "The History of the Jews", libri 3).

Një burrë përshkoi rrugët e Jeruzalemit 7 vjet me rradhë, duke deklaruar të këqiat që do të përjetonte qyteti. Ditë e natë ai këndonte këtë këngë vaji: "Një zë nga veriu! Një zë nga jugu! Një zë nga çdo anë! Një zë kundër Jeruzalemit! Një zë kundër tempullit! Një zë kundër nuseve dhe dhëndurëve! Një zë kundër popullit!"[2]. Ky njeri i çuditshëm u arrestua dhe u burgos, por nuk nxorri fjalë nga goja. Fyerjeve iu përgjigj vetëm me fjalët: "Mjerë, mjerë ti o Jeruzalem! Mjerë banorët e tu!" Thirrja e tij nuk u dëgjua më vetëm kur ai vdiq brenda rrethimit, që ai vetë e kishte profetizuar.

As edhe një i krishter i vetëm nuk vdiq gjatë shkatërrimit të Jeruzalemit. Jezusi i kishte paralajmëruar dishepujt e tij dhe të gjithë ata, që u besonin fjalëve të Tij vëzhguan për të shquar shenjën e premtuar. "Kur të shihni Jeruzalemin të rrethuar nga ushtritë - tha Jezusi - ta dini se shkretimi është afër. Atëherë ata, që janë në Jude të ikin në male dhe ata, që janë në qytet të largohen dhe ata, që janë në fushë të mos hyjnë në të". *(Luka 21:20,21)*. Pas rrethimit që i bënë romakët qytetit nën drejtimin e Cestius-it, pikërisht atëherë kur gjithçka dukej e favorshme për goditjen përfundimtare, ata papritur e ndërprenë rrethimin. Kur gjenerali romak tërhoqi pa asnjë arsye bindëse forcat e tij, të rrethuarit pasi kishin rezistuar për një farë kohë pa sukses, ishin gati që të dorëzoheshin. Por ishte Zoti i mëshirshëm po i drejtonte ngjarjet në të mirë të njerëzve të Tij.

Të krishterëve në pritje iu dha shenjën e premtuar në mënyrë që ata, në rast se u pëlqente, t'i bindeshin lajmërimit të Shpëtimtarit të tyre. Gjërat rodhën në një mënyrë të tillë që, as romakët dhe as çifutët nuk e ndaluan arratisjen e të krishterëve. Çifutët u hodhën në ndjekje të forcave të Cestjus-it në tërheqje dhe ndërsa palët kundërshtare po përlesheshin egërsisht Kristianët mundën të largohen nga qyteti. Në atë kohë edhe fshatrat ishin boshatisur nga armiqtë, të cilët do të ishin orvatur ta pengonin arratisjen e tyre. Gjatë kohës së rrethimit çifutët u mblodhën në Jeruzalem për të marrë pjesë në festën e Rëshajave dhe kjo u dha mundësi të krishterëve të largoheshin pa asnjë pengesë. Pa vonesë ata u arratisën në një vend të sigurt- në qytetin e Pellas, në Perea, përtej Jordanit.

Forcat çifute në ndjekje të Cestjus-it dhe ushtrisë së tij e sulmuan me aq vrull kalorësinë romake sa pothuajse e shkatërruan plotësisht. Romakët u zbrapsën me vështirësi të mëdha. Çifutët u larguan pothuajse pa asnjë humbje dhe u rikthyen në Jeruzalem triumfues, duke mbajtur në duar trofetë e fitores. Megjithatë ky sukses i përkohshëm nuk u bëri dobi. Ai i frymëzoi ata me një frymë rezistence kokëforte ndaj romakëve, që i solli shpejt fundin qytetit të pabindur.

Kur u rivendos rrethimi nga Titusi fatkeqësitë, që ranë mbi Jeruzalem ishin nga më të tmerrshmet. Qyteti ra në kohën e Pashkëve kur miliona çifutë ishin mbledhur për të festuar brenda mureve te tij. Depot e ushqimeve, që po të ishin

[2] Ibid

përdorur me kujdes do t'u mjaftonin banorëve për vite me rradhë, ishin shkatërruar falë xhelozisë dhe hakmarrjes së grupeve ndërluftuese dhe njerëzit përjetuan kështu tmerrin e zisë së bukës. Një sasi e vogël bereqeti shitej për një talent[3]. Kaq e rëndë ishte zija e bukës sa që njerëzit brenin lëkurën e rripave, sandaleve madje edhe veshjen e jashtme të mburojave. Gjatë natës shumë njerëz dilnin fshehurazi nga qyteti dhe mblidhnin barërat e egra, që rriteshin jashtë mureve, edhe pse disa prej tyre kapeshin dhe vriteshin në mënyrë të tmerrshme ndërsa të tjerëve, që kthe-heshin shëndoshë e mirë u rrëmbehej nga duart"ushqimi", që e kishin mbledhur me aq rrezik. Njerëzit, që ishin në fuqi ushtronin tortutat nga më çnjerëzoret për ta detyruar popullin të dorëzonte edhe ato dy thërrime buke, që kishte mundur të fshihte. Jo rrallë këto mizori kryheshin nga njerëz të ushqyer mirë, që thjesht dëshironin të grumbullonin një sasi ushqimesh rezervë për të ardhmen.

Mijëra njerëz vdiqën nga uria apo sëmundjet epidemike. Dukej sikur dashurisë i kishte humbur nami dhe nishani. Burrat vidhnin gratë e tyre dhe gratë burrat e tyre. Aty-këtu shiheshin fëmijë, që ua rrëmbenin bukën nga goja prindërve të tyre të moshuar. Pyetja që bëri profeti: "A mundet një grua të harrojë foshnjën e gjirit?" - gjeti përgjigje brenda mureve të atij qyteti: "Duart e grave të mëshirshme kanë pjekur vetë fëmijët e tyre, të cilët u kanë shërbyer si ushqim në shkatërrimin e bijës së popullit tim".*(Isaja 49:15)*; *(Vajtimet 4:10)*. Kështu u përmbush edhe një herë profecia e katërmbëdhjetë shekujve më parë: "Gruaja më zemërbutë dhe delikate midis jush, që për delikatesën dhe elegancën e saj nuk do të kishte guxuar të vendoste tabanin e këmbës në tokë, do të ketë një zemër keqbërëse ndaj burrit, që pushon mbi gjirin e saj, ndaj djalit dhe vajzës së saj...ndaj fëmijëve që lind, sepse ajo do t'i hajë fshehurazi, për shkak se çdo gjë mungon gjatë rrethimit dhe për shkak të mjerimit të madh që do të pësosh nga armiqtë e tu në të gjitha qytetet e tua". *(Ligji i Përtërirë 28:56,57)*.

Udhëheqësit romakë u përpoqën t'i terrorizonin çifutët për t'i detyruar kështu të dorëzoheshin. Të burgosurit, që i rezistonin arrestimit rriheshin për vdekje, torturoheshin dhe kryqëzoheshin në murin e qytetit. Qindra persekutime të tilla numëroheshin çdo ditë dhe një mizori e tillë vazhdoi aq gjatë sa mbi kodrinën e Jehoshapatit dhe në Kalvar kishte aq shumë kryqe, saqë nuk kishte vend për të kaluar. Përmbushej kështu, në një mënyrë të tmerrshme, pohimi i shqiptuar nga njerëzit përpara fronit gjykues të Pilatit: "le të bjerë gjaku i Tij mbi ne dhe mbi fëmijët tanë!" *(Mateu 27:25)*

Titusi do t'i kishte dhënë fund me gëzim një skene të tillë të frikshme, duke e shpëtuar deri-diku Jeruzalemin nga fati i tij i hidhur. Atë e tmerroi pamja e kufomave të të vdekurve, të shtrirë kapicë në lëndina. Nga lartësia e Malit të Ullinjve, ai vështroi tempullin dhe dha urdhër që të mos prekej asnjë gur i tij. Përpara se të

[3] Talent- lloj paraje me vlerë të konsiderueshme

fillonte sulmin kundër kësaj fortese ai u bëri thirrje udhëheqësve çifutë që të mos ta detyronin ta ndotte me gjak atë vend të shenjtë. Në qoftë se ata do të dilnin prej tij për të luftuar në një vend tjetër asnjë romak nuk do të ushtronte dhunë ndaj shenjtërisë së tempullit. Vetë Josifus u bëri çifutëve thirrje që të dorëzoheshin, duke shpëtuar kështu jetën e tyre, qytetin dhe vendin e adhurimit. Në përgjigje të këtyre fjalëve ai mori mallkime të hidhura. Shigjetat u drejtuan drejt tij, drejt ndërmjetësit të fundit njerëzor, që po u lutej me lot në sy. Çifutët kishin flakur tej kështillat e Birit të Perëndisë dhe çdo tratativë tjetër s'bënte asgjë tjetër, vetëm rriste vendosmërinë e tyre për t'i bërë ballë deri në fund sfidës. Përpjekjet e Titusit për të shpëtuar tempullin ishin të kota: "Dikush më i madh se ai kishte deklaruar se s'do të mbetej gur mbi gur në atë ndërtesë".

Kokëfortësia e verbër e udhëheqësve çifute dhe krimet e tmerrshme që u kryen brenda qytetit të rrethuar, nxitën zemërimin e romakëve dhe së fundi Titusi vendosi ta merrte tempullin me forcë. Sidoqoftë ai vendosi që mundësisht t'i shpëtonte shkatërrimit. Por urdhërat e tij nuk u respektuan. Me të rënë nata, ai u tërhoq në tendën e tij për të pushuar, ndërsa çifutët duke dalë papritmas nga tempulli, sulmuan ushtarët që ishin jashtë. Gjatë luftimit një ushtar hodhi një urë zjarri të ndezur nëpërmjet një të çare të skelës dhe menjëherë dhomat e veshura me dru kedri të shtëpisë së shenjtë i gllabëruan flakët. Titusi nxitoi për në vendin e ngjarjes i shoqëruar nga komandantët dhe legjionarët e tij dhe u dha urdhër ushtarëve që ta fiknin zjarrin. Por askush nuk ua vuri veshin fjalëve të tij. Ushtarët të tërbuar hynë me ura zjarri në duar në dhomat e tempullit dhe i vranë me shpatë të gjithë ata që kishin ardhur të gjenin strehë në to. Gjaku rridhte nëpër shkallët e tempullit rrëke-rrëke. Mijëra e mijëra çifutë vdiqën. Mbi rrapëllimën e betejës dëgjoheshin zëra që thërrisnin: "Ichabad!" - lavdia u largua.

"Titusi nuk mundi t'i vinte fre inatit të ushtarëve. Ai hyri i shoqëruar nga oficerët, në brendësi të tempullit dhe shtangu nga shkëlqimi i saj. Meqë flakët nuk e kishin përpirë akoma vendin e shenjtë, ai tentoi për të fundit herë që ta shpëtonte, duke i ftuar ushtarët qe t'i jepnin fund betejës. Centurioni Liberalis u përpoq t'i detyronte ushtarët të bindeshin, i ndihmuar edhe nga oficerë të tjerë, por gjithçka ishte e kotë, sepse edhe ndjenja e respektit ndaj perandorit u fashit përpara tërbimit armiqësor kundër çifutëve, përpara zallahisë së betejës dhe përpara etjes për grabitje. Ushtarët panë përreth tyre vetëm objekte të lara në ar që dukej akoma më rrezatues falë afshit të flakëve dhe menduan që në shenjtore gjendeshin thesare të paçmuara. Një ushtar, të cilin nuk e pa askush, hodhi një pishtar të ndezur mes menteshave të prishura të një porte dhe në moment e gjithë ndërtesa u përfshi nga flakët. Tymi verbues dhe zjarri i detyruan oficerët të zbrapsen e kështu tempulli i madhërishëm iu la në dorë fatit.

"Në qoftë se ishte për romakët një spektakël i frikshëm ky - po çifutët çfarë mendonin? Maja e kodrës që dominonte qytetin lëshonte flakë si gryka e një vull-

kani. Ndërtesat sheshoheshin njëra pas tjetrës me një zhurmë të frikshme dhe dukej sikur gëlltiteshin nga një greminë përvëluese. Çatitë prej cedri u ngjanin gjuhëve të zjarrit, majat e ndërtesave shkëlqenin si një shirit drite i kuq, kullat lëshonin dredha të gjata tymi dhe flakë. Kodrat rrethuese të qytetit lëshonin një dritë verbuese, ndërsa grupe njerëzish që u ngjanin ca pikave të zeza shihnin me ankth se si shkatërrimi vazhdonte: muret dhe pjesët më të larta të qytetit gumëzhinin nga njerëzit, disa të zbehur nga agonia e dëshpërimit, të tjerët të gjallë nga etja e hakmarjes. Thirrjet e ushtarëve romakë që vraponin sa andej këndej dhe britmat e atyre që po kalleshin në zjarr, bashkoheshin me zhurmën e shpërthimit dhe me oshëtimën gjëmuese të trarëve të mëdhenj që binin. Jehonat e maleve rikthenin e përsërisnin thirrjet e njerëzve nga larg, muret kumbonin nga rënkimet dhe të qarat. Njerëzit që po vdisnin nga uria mblidhnin forcat e fundit për të lëshuar një thirrje ankthi dhe shkretimi.

"Masakrat që ndodhnin brenda ishin akoma më të tmershme se spetakli i jashtëm. Burra dhe gra, pleq dhe të rinj, kryengritës dhe priftërinj, të gjithë ata që luftonin dhe të gjithë ata që luteshin për mëshirë vriteshin në këtë kërdi të përgjakshme. Meqënëse numri i të vrarëve ishte shumë më i madh se ai i vrasësve, ushtarëve romake u duhej të shkelnin mbi grumbujt e kufomave për t'i dhënë fund kësaj "detyre shfarosjeje."[4]

Menjëherë pas shkatërrimit të tempullit i gjithë qyteti ra në duart e romakëve. Udhëheqësit çifutë i braktisën kështjellat e tjera të papushtuara dhe Titusi i gjeti ato të shkreta. Ai hodhi vështrimin mbi to dhe deklaroi se ishte Zoti Ai që ia kishte dorëzuar këto fortesa,sepse asnjë armik sado i fuqishëm të ishte nuk do të kishte mundur t'i shtinte në dorë.

Qyteti dhe tempulli u rrafshuan dhe toka mbi të cilën ngrihej dikur shtëpia e shenjtë "u lërua si një fushë" *(Jeremia 26:18)*. Në rrethimin dhe masakrën që pasuan humbën jetën më shumë se një milion njerëz. Ata që mbetën gjallë u burgosën, u shitën si skllevër, u çuan në Romë si trofe lufte, iu dhanë si ushqim bishave nëpër amfiteatre apo u shpërndanë si shtegtarë varfanjakë pa shtëpi e pa strehë, nëpër botë.

Çifutët ia kishin nxjerrë sytë vetes me duart e tyre, ata e kishin mbushur deri në buzë kupën e hakmarrjes. Shkatërrimi mbarëkombëtar që ra mbi ta dhe fatkeqësitë që i ndoqën hap pas hapi gjatë shpërndarjes së tyre nëpër botë, s'ishin asgjë tjetër veçse korrjet e "të lashtave", që i patën mbjellë me duart e tyre. Profeti thotë: "Ti je shkatërruar o Izrael, sepse ke rënë poshtë për shkak të paudhësisë sate" *(Osea 13:9, 14:1)*

Vuajtjet e Izraelit shpesh janë paraqitur si dënime të një dekreti qiellor. Kështu përpiqet gënjeshtari i madh të fshehë punën e duarve të tij. Por e vërteta është

[4] Milman. "The History of The Jews" libri 16.

ndryshe: duke e flakur tej me përbuzje dashurinë dhe mëshirën hyjnore, çifutët e "detyruan" Perëndinë që të zbrapsej e të mos i mbronte më. Kështu djalli pati mundësi të bënte çfarë të donte me ta. Mizoritë shtazarake që çuan në shkatërrimin e Jeruzalemit janë shfaqje të hapura të fuqisë hakmarrëse të Satanit ndaj të gjithë atyre që vihen nën kontrollin e tij.

Ne nuk arrijmë të kuptojmë se sa mirënjohës duhet t'i jemi Krishtit për paqen dhe mbrojtjen që gëzojmë. Eshtë fuqia e Perëndisë ajo që e ndalon njerëzimin të kalojë plotësisht në duart e Satanit. Të pabindurit e mosmirënjohësit duhet ta falenderojnë Perëndinë për mëshirën dhe durimin e Tij, sepse fuqia e Tij është e vetmja që mund t'i verë fre keqdashjes dhe mizorisë së armikut të madh. Por kur njerëzit e kalojnë kufirin e durimit hyjnor, kjo pengesë largohet. Zoti nuk i del përpara mëkatarit si ekzekutues i dënimit me vdekje që sjell shkelja e ligjit, por Ai i lë vetëm ata që e mohojnë mëshirën e Tij në mënyrë që të korrin atë që kanë mbjellë me duart e tyre. Çdo rreze drite e flakur tej, çdo lajmërim i përbuzur apo i harruar, çdo pasion çoroditës, çdo shkelje e ligjit të Perëndisë është një farë që do të japë pashmangshmërisht frytin e saj. Fryma e Perëndisë kur përbuzet gjithnjë e më shumë çdo ditë, tërhiqet nga mëkatari dhe ky i fundit gjendet nën kontrollin e plotë të pasioneve keqdashëse shpirtërore dhe i pambrojtur kundrejt dinakërisë dhe armiqësisë së Satanit. Shkatërrimi i Jeruzalemit është një paralajmërim i frikshëm dhe solemn për të gjithë ata që qeshin me thirrjet e hirit hyjnor e nuk i pranojnë ftesat mëshirëplote të Zotit. Kurrë nuk është dhënë një provë më e qartë e urrejtjes së Perëndisë ndaj mëkatit dhe i dënimit të pashmangshëm që do të bjerë mbi fajtorin.

Profecia e Shpëtimtarit që ka të bëjë me ndëshkimin e Jeruzalemit, do të ketë një përmbushje të dytë, për të cilën ai shkretim i tmerrshëm është vetëm një imagjinatë e zbehtë. Fati i qytetit të zgjedhur na tregon qartë ndëshkimin e një bote që nuk e ka pranuar mëshirën e Zotit dhe e ka shkelur me këmbë ligjin e Tij. Sa tragjike janë të dhënat e mjerimit njerëzor për të cilat toka, në kursin e gjatë të shekujve të kriminalitetit është dëshmitare vetë. Zemra dridhet e mendja errësohet përpara një konstatimi të tillë. Rrjedhimet e mohimit të autoritetit qiellor kanë qënë të tmerrshme. Megjithatë profecitë e së ardhmes na zbulojnë një pamje akoma më të errët. Historitë e së shkuarës - vargu i gjatë i revoltave, konflikteve dhe revolucioneve ku "manteli i çdo luftëtari do të rrëkëllehet në gjak" *(Isaja 9:4)*. - nuk janë asgjë të krahasuara me ditën në të cilën Fryma e Perëndisë do të zbrapset nga i ligu dhe nuk do t'u vërë më fre shpërthimeve të pasioneve dhe zemërimit satanik. Atëherë bota do t'i shohë si kurrë më parë pasojat e sundimit satanik.

Por në atë ditë, siç ndodhi edhe gjatë shkatërrimit të Jeruzalemit, populli i Perëndisë "kushdo që është shënuar ndër të gjallët" do të shpëtoje. *(Isaja 4:3)*. Krishti ka premtuar se herën e dytë do të vijë të marrë me vete të gjithë besnikët e Tij. "Të gjitha kombet e dheut do të mbajnë zi dhe do ta shohin Birin e njeriut,

duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe lavdi të madhe. Ai do të dërgojë engjëjt e Tij me tinguj të fuqishëm borie dhe ata do t'i mbledhin të zgjedhurit e Tij nga të katër anët, nga çdo skaj i qiellit tek tjetri." *(Mateu 24;30,31)*. Ndërsa të gjithë ata që nuk i janë bindur Ungjillit do të konsumohen nga fryma e gojës së Tij dhe do të shkatërrohen nga shkëlqimi i ardhjes së tij *(2 Selanikasve 2;8)*. Ashtu si ne Izraelin e lashtë, të pabesët do të vetëshkatërrohen dhe do të rrëzohen për shkak të paudhësisë së tyre. Në vazhdim të një jete mëkatare ata janë në një mosmarrëveshje të tillë me Perëndinë dhe karakteri i tyre ka degraduar kaq shumë saqë shfaqja e lavdisë së tij përbën për ta një zjarr përvëlues.

Njerëzit duhet të tregohen të kujdesshëm që të mos i hedhin poshtë mësimet që dalin nga fjalët e Krishtit. Ashtu si i paralajmëroi dikur dishepujt e Tij për shkatërrimin e Jeruzalemit, duke u dhënë atyre një shenjë të shkretimit të ardhshëm në mënyrë që ata të largoheshin, ashtu ai e ka paralajmëruar edhe botën për ditën e shkatërrimit përfundimtar, duke na dhënë shenja të afrimit të saj në mënyrë që të gjithë t'i largohemi mallkimit të fundit. Jezusi deklaroi: "do të ketë shenja ne diell, në hënë dhe në yje dhe mbi tokë ankth popujsh" *(Luka 21:25)*; *(Mateu 24;29)*; *(Marku 13;24-26)*; *(Zbulesa 6;12-17)*. Të gjithë ata që do t'i vënë re këto shenja të ardhjes së Tij, do ta dinë që Ai "është pranë, pikërisht tek dera" *(Mateu 24;33)*. "Rrini zgjuar pra..." janë fjalët e Tij paralajmëruese. Kush e dëgjon lajmërimin nuk do të lihet në errësirë dhe ajo ditë nuk do ta gjejë të papërgatitur. Ndërsa për atë që nuk qëndron zgjuar "dita e Zotit do të vijë si një vjedhës nate" *(1 Selanikasve 5:2-5)*.

Sot bota nuk është e gatshme për t'i besuar mesazhit të ditëve të fundit, ashti si çifutët që nuk ishin gati për ta pranuar paralajmërimin e Shpëtimtarit në lidhje me Jeruzalemin. Por kur të vijë, dita e Zotit do t'i befasojë të pabesët. Ndërsa jeta vazhdon kursin e saj të zakonshëm, ndërsa njerëzit janë të dhënë kokë e këmbë pas kënaqësive, tregtisë, etjes për fitim, ndërsa udhëheqësit fetarë lëvdojnë progresin dhe përparimin mbarëbotëror, ndërsa njerëzit i josh siguria e rreme -atëherë si hajduti që vjedh në mesnatë shtëpitë e pambrojtura, një shkatërrim i befasishëm do të bjerë mbi të pabesët dhe moskokëçarësit dhe "ata nuk do të shpëtojnë" *(versa 3)*

1. Përse e lejoi Jezusi, qytetin e tij të dashur, Jeruzalemin, që të shkatërrohej nga Romakët?

2. Çfarë premtimesh u dha Jezusi njerëzve të Tij që jetonin nëJeruzalem? Çfarë i urdhëroi ai atyre? Si ju ndihmon Perëndia kur jeni në kohë trazirash?

3. Si jua përforcon juve besimin tek Perëndia ky kapitull, duke marrë parasysh ngjarjet e panjohura profetike të ditëve të fundit?

2.

Persekutimi në Shekujt e Parë

Kur Jezusi u tregoi dishepujve të Tij mbi fatin e Jeruzalemit dhe u foli për ngjarjet që lidheshin me ardhjen e Tij të dytë, Ai parashikoi gjithashtu edhe përvojën që do të përjetonte populli i Tij që nga momenti i largimit të Tij drejt qiellit deri në momentin e rikthimit të Tij të lavdishëm që do të shënonte edhe çlirimin e tyre. Nga maja e Malit të Ullinjve, Shpëtimtari pa uraganin që do të përfshinte kishën apostolike dhe duke depërtuar më thellë me sy në të ardhmen, Ai vuri re stuhitë e tërbuara dhe shkatëruese që do të godisnin pasuesit e Tij në rrjedhën e shekujve të errësirës dhe persekutimit. Me pak fjalë kuptimplote Ai parashikoi se me çfarë metri do ta masnin sundimtarët e botës kishën e Perëndisë. Mateu 24:9,21,22. Ndjekësve të Krishtit do t'u duhej të përshkonin të njëjtën udhë poshtërimi, qortimi dhe vuajtjesh që dikur e shkeli edhe Mësuesi i tyre. Armiqësia me të cilën u trajtua Shpëtimtari i botës do të manifestohej edhe kundër të gjithë atyre që do t'i besonin emrit të Tij.

Historia e kishës së parë dëshmon për vërtetsinë e fjalëve të Çlirimtarit. Fuqitë tokësore dhe ato të ferrit e provuan fatin kundër Krishtit të mishëruar në figurën e ndjekësve të Tij. Paganizmi e dinte mirë që po të triumfonte ungjilli, tempujt dhe altarët e tij do të rrafshoheshin, prandaj mblodhi forcat për ta shkatërruar Kristianizmin. Zjarret e persekutimit u ndezën. Të Krishterëve iu grabitën gjithçka që kishin dhe u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Ata duruan një luftë të madhe vuajtjesh."Hebrenjtë 10:32 Ata hoqën përleshje dhe goditje, madje edhe pranga e burgime." Hebrenjtë 11:36

Të panumërt ishin ata që vulosën me gjak dëshminë e tyre. Fisnikët dhe skllevërit, të pasurit dhe të varfërit, të diturit dhe të padituri, të gjithë u masakruan pa mëshirë. Këto persekutime që filluan me Neronin pak a shumë në kohën e martirizimit të apostullit Pal, vazhduan me egërsi të madhe për shekuj me rradhë. Të Krishterët u akuzuan pa të drejtë për krime nga më të tmerrshmet dhe u quajtën

shkaktarë të fatkeqsive të mëdha si: zitë e bukës, sëmundjet epidemike dhe tërmetet. Me t'u bërë objekt i urrejtjes dhe mosbesimit popullor ata përgjoheshin edhe nga informatorë që ishin të etur për fitim. Ata dënoheshin si rebelë të perandorisë, si armiq të fesë dhe si "mortajë" e shoqërisë. Të panumërt ishin ata që iu hodhën si ushqim i gjallë egërsirave apo u dogjën në amfiteatër. Disa u kryqëzuan, ndërsa të tjerët u veshën me lëkurë kafshësh dhe u hodhën në arena ku u shqyen nga qen të uritur. Shpesh martirizimi i tyre përbënte pjesën më argëtuese të festave publike. Një numër i madh njerëzish mblidhej për t'u kënaqur nga këto spektakle dhe përshëndesnin me duartrokitje e të qeshura agoninë e tyre vdekjeprurëse.

Kudo që kërkonin strehë, të Krishterët ndiqeshin këmba - këmbës si kafshë grabitqare. Ata ishin të detyruar të fshiheshin në vende të shkreta e të veçuara: "Nevojtarë, të pikëlluar e të keqtrajtuar (bota nuk ishte e denjë për ta), u sollën nëpër shkretëtira e nëpër male, nëpër shpella dhe nëpër guva të dheut." Versat 37,38 Katakombat u ofronin miliona njerëzve strehë. Galeri të gjata u gërmuan nën tokë përmes shkëmbinjve, nën kodrat rrethuese të Romës; ky rrjet korridoresh të errëta dhe të ngatërruara zgjatej për km e km të tëra përtej mureve të qytetit. Në vend-strehime të tilla nëntokësore, ndjekësit e Krishtit varrosnin miqtë e tyre të vdekur e në rast rreziku e dyshimesh gjenin në to një mbrojtje. Kur Jetëdhënësi do të zgjojë ata, luftëtarët e betejës së drejtë, shumë prej martirëve të Krishtit do të dalin nga ato galeri nëntokësore. Nën persekutimin më të ashpër, këta dëshmitarë të Zotit nuk e njollosën besimin e tyre. Megjithëse nuk gëzonin asnjë rehati, larg dritës së diellit dhe të detyruar të jetonin në thellësinë e errët por miqësore të tokës, nuk u ankuan asnjëherë. Me fjalë besimi, durimi dhe shprese ata inkurajonin njëri - tjetrin për t'i bërë ballë vështirësive dhe problemeve. Humbja e çdo të mire tokësore nuk i detyroi ata që të hiqnin dorë nga besimi tek Krishti. Provat dhe përndjekjet ishin hapa që i afronin ata drejt çlodhjes dhe shpërblimit.

Ashtu si shërbëtorët e hershëm të Perëndisë, shumë prej tyre u torturuan,se pse nuk pranuan çlirimin për të fituar një ringjallje më të mirë." Versa 35. Atyre u kujtoheshin fjalët e Mësuesit se të persekutuarit për hir të Krishtit duhet të ngazëllenin sepse shpërblimi i tyre në qiell do të ishte shumë i madh. Edhe profetët ishin përndjekur para tyre prandaj ata gëzoheshin që ishin quajtur të denjë për të vuajtur për të vërtetën dhe nga mesi i flakëve shpesh ngriheshin këngë lavdërimi. Duke hedhur vështrimin drejt qiellit me besim, ata shihnin me sytë e mendjes Jezusin dhe ëngjëjt e Tij që duke u përkulur me interes të madh nga fortesat qiellore dukej sikur e miratonin qëndrueshmërinë e tyre. Nga froni i Perëndisë dëgjohej një zë që thoshte: "Ji besnik deri në vdekje e Unë do të të jap kurorën e jetës." Zbulesa 2:10

Të kota ishin përpjekjet e Satanit për ta shkatërruar me dhunë kishën e Krishtit. Kontradikta e madhe, gjatë të cilës dishepujt e Krishtit humbën jetën e tyre, nuk përfundoi kur këta flamurtarë besnikë ranë në vendin e tyre të luftimit. Nëpërmjet

humbjes, ata fituan. Punëtorët e Perëndisë u masakruan, por puna vazhdoi pandërprerje. Ungjilli vazhdoi të predikohej dhe numri i përkrahësve të tij u rrit gjithnjë e më shumë. Ai depërtoi deri në ato zona që ishin të pakapërcyeshme madje edhe për shqiponjat e Romës.

Një i krishterë, duke iu kundërvënë sundimtarëve paganë që po thellonin persekutimet çdo ditë e më shumë, tha: "Ju mund të na vrisni, të na torturoni e të na dënoni... Padrejtësia juaj dëshmon pro pafajsisë sonë... Mizoria juaj nuk vlen për asgjë." Në të vërtetë ajo ishte një ftesë e ethshme për t'i shtyrë të tjerët drejt bindjeve kristiane. "Sa më shumë të na korrni, aq më shumë do të rritet numri ynë! Gjaku i të Krishterëve është farë." Sertullian Apologjia, paragrafi 50

Me mijëra njerëz u burgosën e u vranë, por vendet e tyre i zunë shpejt të tjerë. Ata që martirizoheshin për besimin e tyre, tregonin siguri tek Krishti dhe dilnin fitimtarë. Ata bënë një luftë të drejtë dhe me ardhjen e Jezusit do të merrnin si shpërblim një kurorë lavdie. Vuajtjet që duruan ata, lidhën të Krishterët më shumë me njëri - tjetrin dhe me Shpëtimtarin e tyre. Shembulli që dhanë ata me jetën e tyre dhe dëshmia që vulosën me vdekjen e tyre ishin një vërtetim i pamohueshëm i së vërtetës dhe ushtarët e Satanit filluan të dezertojnë nga shërbimi ndaj tij për t'u bashkuar nën flamurin e Krishtit.

Prandaj Satani i detajoi më poshtërsisht planet e tij të luftës kundër qeverisjes së Perëndisë duke e ngritur flamurin e tij në kishën Kristiane. Nëqoftëse pasuesit e Krishtit do të mashtroheshin e do të bënin sipas kokës së tyre pa pyetur për Zotin, atëherë fuqia, qëndrueshmëria dhe forca do t'i linin e ata do të ktheheshin në viktima të lehta. Kundërshtari i madh u përpoq që të fitonte me dinakëri, aty ku nuk kishte mundur të triumfonte me forcë. Persekutimi përfundoi dhe vendin e tij e zunë joshjet e rrezikshme drejt lulëzimit të përkohshëm dhe nderit të botës. Idhujtarët filluan të pranonin një pjesë të besimit Kristian ndërsa hidhnin poshtë të vërtetat e tjera kryesore. Ata deklaronin se e pranonin Jezusin si Bir të Perëndisë dhe besonin në vdekjen dhe ringjalljen e Tij, por nuk e pranonin mëkatin dhe nuk ndjenin nevojën për t'u penduar e as dëshirën për të ndryshuar. Me disa lëshime nga ana e tyre, ata propozuan që edhe të krishterët të lëshonin akoma edhe më pe dhe të gjithë të bashkoheshin mbi platformën e besimit tek Krishti.

Tani kishës i kanosej një rrezik i madh. Burgu, torturat, zjarri dhe shpata nuk ishin asgjë përpara këtij rreziku. Disa nga të krishterët mbetën besnikë, duke deklaruar se nuk mund të arrinin kompromise të këtij lloji. Por të tjerët ishin gati që të dorëzoheshin e të ndryshonin disa elemente të besimit të tyre, duke u bashkuar me ata që kishin pranuar tashmë një pjesë të Kristianizmit e duke theksuar se kjo ishte një mënyrë e mirë për t'i nxitur ata të bënin kthesën e plotë. Ajo ishte një periudhë e vështirë ankthndjellëse për ndjekësit e vërtetë të Krishtit. Nën petkun e të ashtuquajturit "Kristianizëm", Satani po depërtonte në brendësi të kishës, duke e cënuar besimin e tyre e duke ua larguar mendjet nga e vërteta.

Së fundi, pjesa më e madhe e të krishterëve iu dorëzuan lëshimeve dhe kështu u formua bashkimi Kristianizëm - Paganizëm. Edhe pse adhuruesit e idhujve thërrisnin me të madhe se ishin shndërruar shpirtërisht dhe u bashkuan me kishën, në të vërtetë ata vazhduan të jepeshin pas idhujtarisë duke e ndryshuar subjektin e adhurimit të tyre tek imazhet e Jezusit, Marisë dhe ëngjëjve. Sharmi i hidhur me t'u hedhur në kishë, e vazhdoi veprimtarinë e tij shkatërruese. Doktrina të rreme, rite supersticioze dhe ceremoni pagane u ndërthurën me besimin dhe adhurimin e vërtetë. Meqënëse pasuesit e Krishtit u bashkuan me idhujtarët, besimi u korruptua dhe si rrjedhim kisha humbi pastërtinë e saj. Megjithatë nuk munguan edhe ata që nuk u gënjyen nga këto mashtrime dhe mbetën besnikë ndaj Autorit të së vërtetës dhe adhurimit të Perëndisë dhe vetëm Atij.

Ata që mbajnë emrin të Krishterë ndahen në dy grupe. Ndërsa njëri grup studion jetën e Shpëtimtarit dhe përpiqet me zell t'i përmirësojë të metat e veta për t'iu afruar sa më shumë Modelit, tjetri shmang qëllimisht të vërtetat e qarta dhe praktike vetëm e vetëm sepse i nxjerrin në shesh gabimet e tij. Edhe në kohën e lulëzimit të saj, kisha nuk ka qënë kurrë një tërësi elementesh të vërtetë, të pastër e të sinqertë. Shpëtimtari na mësoi se ata që gjejnë me ndërgjegje kënaqësi në mëkat, nuk duhet të pranohen në kishë; megjithatë Ai vetë u shoqërua me njerëz me karakter të dobët dhe u fali atyre të mirat e mësimeve dhe shembullit të Vet, në mënyrë që edhe ata të kishin një mundësi për t'i parë gabimet e tyre e për t'u përmirësuar. Mes dymbëdhjetë dishepujve ndodhej një tradhëtar. Juda nuk u pranua falë të metave të tij, por ato nuk iu morën shumë parasysh. Ai iu shtua dishepujve në mënyrë që përmes udhëzimeve dhe shembullit të Jezusit të kuptonte se ç'do të thoshte karakter Kristian, të shquante gabimet e tij, të pendohej, e me anë të ndihmës hyjnore ta pastronte shpirtin e duke iu bindur së vërtetës. Por Juda nuk eci në rrugën e dritës që shkëlqeu mbi të. Duke u zhytur gjithnjë e më thellë në mëkat, ai ua hapi derën tundimeve satanike. Pikat e tij të dobëta të karakterit u fuqizuan. Mendja e tij kontrollohej nga fuqitë e errësirës, inatosej kur i viheshin në dukje gabimet e kështu arriti deri atje sa kreu krimin e tmerrshëm të tradhëtisë ndaj Mësuesit të tij. Në të njëjtën mënyrë, të gjithë ata që e mbajnë gjallë mëkatin nën petkun e perëndishmërisë, i urrejnë të tjerët që ua prishin qetësinë duke ua vënë në dukje rrugën e gabuar që kanë nisur. Ata, ashtu si Juda, me të ardhur rasti i volitshëm do t'i tradhëtojnë ata, që i kanë qortuar për të mirën e tyre.

Apostujt kishin të bënin në kishë me njerëz që ndërsa nga njëra anë hiqeshin ëngjëllorë, nga ana tjetër fshehtazi i përkushtoheshin paudhësive. Anania dhe Safira luajtën rolin e mashtruesit kur pretenduan se do t'i kushtonin një flijim të pacënuar Perëndisë, ndërsa mbajtën një pjesë të parave për vete. Shpirti i së vërtetës u zbuloi apostujve karakterin e vërtetë të këtyre mashtruesve dhe ndërhyrja hyjnore e pastroi kishën nga kjo njollë e shëmtuar. Ky veprim i qartë i Shpirtit të Krishtit në gjirin e bashkësisë i tmerroi hipokritët dhe keqdashësit. Ata nuk mund të shoqëroheshin

me të tjerët, që me sjelljen dhe besimin e tyre, ishin përfaqësues të vërtetë të Krishtit; kur pasuesit e Tij u ballafaquan me prova të vështira e persekutime, vetëm ata që ishin gati të hiqnin dorë nga gjithcka për hir të së vërtetës, u bënë dishepuj të Shpëtimtarit. Kështu, kisha mbeti deri diku e pastër gjatë periudhës së persekutimit. Por me mbarimin e tij, kishës iu shtuan "besimtarë" të rinj që nuk ishin aq të sinqertë dhe të përkushtuar sa të parët dhe Satanit iu hap rruga për të zënë një qoshe vend.

Ashtu si nuk ka unitet midis Princit të dritës dhe princit të errësirës, ashtu nuk mund të ketë unitet mes ndjekësve të tyre. Kur të Krishterët ranë dakort që të bashkoheshin me gjysëm Kristianët - paganë, ata i hynë një shtegu që i largonte gjithnjë e më shumë nga e vërteta. Fakti që ia kishte dalë mbanë në mashtrimin e një numri kaq të madh pasuesish, e ngazëllente Satanin. Më pas ai i vuri ata nën kontrollin e tij të plotë dhe i nxiti që të persekutonin të tjerët që vazhdonin t'i qëndronin besnikë Perëndisë. Askush nuk dinte ta kundërshtonte besimin kristian më mirë se ata që dikur kishin qënë mbrojtësit e tij dhe ishin këta të Krishterë femohuesë që së bashku me miqtë e tyre gjysmë paganë, u vunë në ballë të luftës kundër doktrinave më të rëndësishme të Krishtit.

Kjo kërkonte një përpjekje të vazhdueshme nga ana e atyre që dëshironin të qëndronin besnikë dhe të mos jepeshin përpara mashtrimeve dhe gënjeshtrave "të veshura me petka priftërore" brenda kishës. Bibla nuk pranohej më si standart besimi. Doktrinës së lirë fetare iu vu emri "herezi" dhe përkrahësit e saj shiheshin me sy të keq e përçmoheshin.

Pas një lufte të gjatë e të ashpër, të paktët që kishin mbetur besnik, vendsën të shkëputeshin nga kisha në qoftë se ajo nuk do të hiqte dorë nga idhujtaria dhe mashtrimi. Ato vunë re se një shkëputje e tillë ishte e pashmangshme në rast se dëshironin t'i bindeshin fjalës së Perëndisë. Ata nuk guxonin që të pranonin gabime aq të mëdha sa do t'u rrezikonte jetën atyre dhe besimin fëmijëve e nipërve të tyre. Për të siguruar paqe dhe bashkim ata ishin të gatshëm që të bënin lëshime që përputheshin me besnikërinë ndaj Perëndisë; por megjithatë ata parapëlqenin ruajtjen e parimeve mbi paqen e rreme. Në qoftë se uniteti mund të arrihej vetëm duke rrezikuar të vërtetën dhe drejtësinë, atëherë le të kishte mosmarrëveshje e madje edhe luftë.

Do të kishte qënë mirë për kishën dhe për botën që parimet që ushqenin këta shpirtra të papërkulur, të kishin vazhduar të hidhnin rrënjë edhe në zemrat e njerëzve të tjerë të mëvonshëm të Perëndisë. Egziston një moskokëcarje alarmuese për sa u përket doktrinave që përbëjnë shtyllën e besimit Kristian.

Po përhapet gjithnjë e më shumë ideja që në fund të fundit, ato nuk janë të një rëndësie jetësore. Kjo shkarje i shkon për shtat agjentëve të Satanit, kështu që teori të rreme dhe ide vdekjeprurëse që u kushtuan jetën besnikëve ndër kohëra,

po përqafohen me dashamirësi nga mijëra njerëz që pretendojnë të jenë pasues të Krishtit.

Të Krishterët e parë përbënin me të vërtetë një popull të veçantë. Sjellja e tyre shembullore dhe besimi e tyre i palëkundur ishte një qortim i heshtur, por i vazhdueshëm që nuk i linte të qetë mëkatarët. Megjithëse të pakët në numër, të varfër, pa tituj e grada, kudo ku bëheshin të njohura doktrinat dhe karakteri i tyre, të pabesët i pushtonte paniku dhe tmerri. Prandaj u bënë objekt i urrejtjes së të pabesëve, ashtu sic u bë Abeli objekt urrejtjeje i të vëllait, Kainit. Për të njëjtën arsye që e shtyu Kainin të vriste Abelin, edhe ata që i bënë bisht thirrjeve të Shpirtit të Shenjtë i dënuan me vdekje njerëzit besnikë të Perëndisë. Edhe cifutët e mohuan dhe e kryqëzuan Shpëtimtarin për të njëjtën arsye - sepse ishte pastërtia dhe shenjtëria e karakterit të Tij që ua nxorri në shesh egoizmin dhe korrupsionin. Që nga koha e Jezusit e më tej, dishepujt e Tij kanë ngjallur gjithmonë urrejtjen dhe kundërshtimin e atyre që duan dhe e ndjekin rrugën e mëkatit.

Si mund të quhet atëherë ungjilli mesazh paqeje? Kur profeti Isaja predikoi lindjen e Mesisë, ai i bashkangjiti Atij titullin "Princ i paqes." Kur ëngjëjt i lajmëruan barinjtë për lindjen e Krishtit, ata kënduan nëpër fushat e Betlehemit: "Lavdi Perëndisë në qiell dhe paqe mbi tokë njerëzve mbi të cilët qëndron mirëdashja e Tij!" Luka 2:14. Duket sikur këto deklarata profetike nuk përputhen plotësisht me fjalët e Jezusit: "Nuk erdha të sjell paqen por shpatën." Mateu 10;34. Nëqoftëse kuptohen drejt, këto thënie harmonizohen me njëra -tjetrën. Ungjilli është mesazh paqeje. Kristianizmi është një sistem, që me t'u pranuar e me t'iu bindur, përhap paqe, harmoni dhe lumturi në mbarë botën. Feja e Krishtit bashkon si vëllezër e motra të gjithë ata që i pranojnë mësimet e saj. Vetë misioni i Krishtit ishte pajtimi i njerëzve me Perëndinë e me njëri - tjetrin. Por pjesa më e madhe e banorëve të tokës janë nën kontrollin e Satanit, armikut të betuar të Krishtit. Ungjilli hap përpara tyre parime jetësore që ndryshojnë tërësisht nga zakonet e dëshirat e tyre dhe ata rebelojnë kundër tij. Ata e urrejnë pastërtinë që ua zbulon dhe ua dënon mëkatet e tyre "të dashura" dhe i persekutojnë dhe i vrasin të gjithë ata që i nxisin të pendohen. Pikërisht kjo është arsyeja që ungjilli quhet shpatë.

Mëshira misterioze që e lejon të drejtin të drejtin të vuajë e të persekutohet nga i pabesi, ka qënë gjithmonë motiv çoroditjeje të madhe për njerëz besimpak. Madje disa kanë hequr dorë nga besimi vetëm e vetëm sepse Zoti lejon që keqbërësit të gëzojnë mirëqënie e shëndet, ndërsa mirëdashësit shpesh janë të pikëlluar e vuajnë nga fuqia mizore e të parëve.

Lind pyetja: si shpjegohet që Perëndia që është i drejtë, i mëshirshëm dhe i plotfuqishëm, lejon një padrejtësi e shtypje kaq të madhe? Kjo është një pyetje që ne nuk mund t'i japim përgjigje. Zoti na ka dhënë prova të mjaftueshme dashurie dhe ne nuk kemi si ta vëmë në dyshim mirësinë e Tij vetëm sepse nuk arrijmë t'i

kuptojmë plotësisht veprat e mënyrat e Tij të veprimit. Shpëtimtari, gjatë kohës së provës e persekutimit, u tha: "Kujtoni fjalët që iu thashë: Shërbëtori nuk është më i madh se i zoti. Nëse më kanë përndjekur Mua, do t'iu përndjekin edhe ju." Gjoni 15:20. Asnjë nga ndjekësit e Jezusit nuk do të vuajë më shumë se Ai vetë nga mizoria e njerëzve pashpirt. Të gjithë ata që durojnë tortura e martirizohen nuk bëjnë asgjë tjetër, veçse ecin në gjurmët e të dashurit Bir të Perëndisë.

"Zoti nuk vonon plotësimin e premtimit." 2 Pjetrit 3:9. Ai as nuk i harron e as nuk i lë pas dore fëmijët e Tij; por lejon që të pabesët ta zbulojnë vetë karakterin e tyre në mënyrë që cilido që dëshiron të kryejë vullnetin e Tij të mos mashtrohet më prej tyre. Të drejtët shpesh futen në "furrën e vuajtjeve" që të pastrohen; që shembulli i tyre të mund të mund të bindë të tjerët për vërtetsinë e besimit dhe mirësisë dhe që qëndrimi i tyre i papërkulur të jetë dënim për të pabesët e të paudhët.

Perëndia i lejon femohuesit që të jetojnë në mirëqënie e ta shfaqin haptazi armiqësinë ndaj Tij, që kur të jetë mbushur kupa e paudhësive të tyre, të mund të shohin në shkatërrimin e tyre të plotë, një shfaqje të drejtësisë dhe mëshirës së Tij. Dita e hakmarrjes së Tij po afron, kur të gjithë ata që e kanë shkelur me këmbë ligjin dhe e kanë shtypur popullin e Tij, do të marrin kompensimin e drejtë për veprat e tyre; kur çdo akt mizorie dhe padrejtësie ushtruar mbi besnikët e Perëndisë do të trajtohet si të ishte kryer mbi Vetë Jezusin.

Megjithatë shtrohet një çështje tjetër më e rëndësishme që duhet të tërheqë vëmendjen e kishave të tjera sot. Apostulli Pal deklaron se "të gjithë ata që jetojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus, do të përndiqen." 2 Timoteut 3:12. Përse atëherë duket sikur persekutimi është fashitur? E vetmja arsye është që kisha i është përshtatur standartit botëror e nuk nxit më kundërshtime. Rryma fetare e ditëve tona nuk është e pastër dhe e shenjtë siç ishte besimi Kristian në kohën e Krishtitdhe apostujve. Kristianizmi është kaq popullor sot vetëm sepse ka përqafuar frymën e kompromisit me mëkatin, sepse sheh me mospërfillje të vërtetat e mëdha të fjalës së Perëndisë e sepse mirësia njerëzore është zbehur në të. Me t'u rizgjuar besimi dhe fuqia e kishës së hershme, fryma e persekutimit dhe zjarret e përndjekjes do të fillojnë të gjallërohen sërisht.

1. Çfarë perceptimi ju sjell në mendje të qenurit "një popull i veçantë"?

2. Tek Hebrenjtë 11:36, 37, lexuesi kujtohet për nevojën e përballimit të vuajtjeve të mëdha. Përse është vuajtja shpesh herë pjesë e jetës së Krishterë?

3. Përse disa të Krishterë vuajnë më shumë se të tjerët?

4. Kur Satani nuk arriti dot të shkatërronte kishën përmes persekutimeve, ai i tundoi besimtarët që të adoptonin praktika mëkatare nga besimet pagane. Çfarë hapash specifikë mund të ndërmerrni ju që do tju mbanin larg adoptimit të mënyrave që përdor bota?

3.

Një Epokë Errësire Shpirtërore

Apostulli Pal në letrën e tij të dytë drejtuar Selanikasve parashikon apostazinë e madhe, që do të jetë fryt i vendosjes së pushtetit të papatit. Ai deklaron se dita e Krishtit nuk do të vijë "pa ardhur më parë rënia dhe pa u shfaqur njeriu i mëkatit, i biri i humbjes, kundërshtari, ai që lartëson veten mbi cdo gjë që quhet Perëndi ose objekt adhurimi, aq sa të shkojë e të rrijë në tempullin e Perëndisë si Perëndi, duke e paraqitur veten se është Perëndi." Për më tepër, apostulli i paralajmëron vëllezërit e tij se "misteri i paudhësisë në fakt tashmë është në veprim." *(2 Selanikasve 2:3,4,7)*. Që në atë kohë, ai pa duke u zvarritur drejt kishës disa gabime që do t'i përgatisnin rrugën zhvillimit të papatit.

Dalëngadalë, në fillim në mënyrë të fshehtë e të heshtur, pastaj gjithnjë e më hapur, "misteri i paudhësisë" me t'u fuqizuar e me të vënë nën kontroll mendjet njerëzore, e vazhdoi pa u ndalur detyrën e tij mashtruese e blasfemuese. Në mënyrë pothuajse të paperceptueshme, zakonet pagane depërtuan në brendësi të kishës. Persekutimet e egra që duroi kisha nën veprimin e paganizmit, për një farë kohe, i vunë cak frymës dhe njëtrajtshmërisë. Por me të përfunduar periudha e persekutimeve dhe me të hyrë në oborret dhe pallatet mbretërore, Kristianizmi hoqi dorë nga thjeshtësia, që karakterizonte Krishtin dhe apostujt e Tij, për të përqafuar madhështinë dhe krenarinë e priftërinjve dhe sundimtarëve paganë, në vend të urdhëresave të Perëndisë u përkrahën teoritë dhe traditat njerëzore. I ashtuquajturi "shndërrim shpirtëror" i Kostandinit të Madh në fillim të shekullit të katërt, ngjalli një gëzim të madh dhe bota e veshur me një petk drejtësie, hyri në kishë. Korrupsioni përparoi me shpejtësi. Paganizmi, edhe pse dukej sikur po fashitej në fakt po lulëzonte. Fryma e tij e vuri nën kontroll kishën. Doktrinat, ceremonitë dhe bestytnitë pagane u bënë pjesë e besimit dhe adhurimit të atyre, që hiqeshin si pasues të Krishtit.

Ky kompromis mes paganizmit dhe Kristianizmit rezultoi në zhvillimin "e njeriut të mëkatit", që përmendet në profeci si kundërshtar dhe armik i Perëndisë. Ai

sistem gjigantesk besimi të rremë është një kryevepër e fuqisë së Satanit - një lapidar i përpjekjeve të tij për t'u ulur mbi fron e për ta sunduar botën sipas vullnetit të tij.

Dikur Satani u përpoq të binte në kompromis me Jezusin. Ai iu afrua Birit të Perëndisë në shkretëtirën e tundimit e, duke i treguar të gjitha mbretëritë e botës dhe lavdinë e tyre, i premtoi se të gjitha ato do të ishin të Tijat në rast se Ai do ta pranonte pushtetin suprem të princit të errësirës. Krishti e përçmoi tunduesin mendjemadh, duke e detyruar të largohej. Megjithatë Satani është më i suksesshëm kur ua parashtron njerëzve këto "gënjeshtra të bukura." Në mënyrë që të fitonte respektin dhe të mirat tokësore, kisha u detyrua që të kërkonte mbështetjen e njerëzve të mëdhenj dhe, duke hedhur poshtë kështu Krishtin, ajo iu dorëzua aleances me përfaqësuesin satanik - peshkopin e Romës.

Një nga doktrinat kryesore të Romanizmit është ajo e njohjes së papës si kreu i kishës mbarëbotërore të Krishtit; i veshur ky me autoritet të padiskutueshëm mbi peshkopët dhe pastorët e tjerë të të gjithë botës. Për më tepër, papës i janë dhënë të gjithë titujt e Hyjnisë. Ai është quajtur "Papa - Zoti, Perëndi" dhe është shpallur si i pagabueshëm. Atij i takon nderimi i të gjithë njerëzve. I njëjti pretendim i shpallur nga Satani në shkretëtirën e tundimit, shpallet edhe nga ai përmes Kishës së Romës dhe me mijëra njerëz janë gati që ta nderojnë.

Por ata që e respektojnë e nderojnë Perëndinë i bëjnë ballë këtyre pretendimeve absurde me vetmohim ashtu siç i përballoi edhe Krishti tundimet e armikut dinak, duke i thënë: "Adhuro Zotin, Perëndinë tënd dhe shërbei vetëm Atij." *(Luka 4:8).* As edhe një varg i vetëm në fjalën e Perëndisë nuk thotë se Perëndia ka caktuar një njeri që ky të jetë kreu i kishës. Doktrina e mbizotërimit të papës bie ndesh me mësimet e Shkrimeve të Shenjta. Papa mund të ketë fuqi mbi kishën e Krishtit vetëm në qoftë se e rrëmben këtë "të drejtë" me dhunë.

Përkrahësit e Kishës së Romës vazhdojnë t'i akuzojnë Protestantët për herezi dhe ndarje të ndërgjegjshme nga kisha e vërtetë. Në të vërtetë këto akuza u shkojnë për shtat atyre sepse janë ata që e ulën flamurin e Krishtit dhe u larguan nga "besimi që iu transmetua shenjtorëve njëherë e përgjithmonë." *(Juda 3)*

Satani e dinte mirë se Shkrimet e Shenjta do t'i aftësonin njerëzit t'ua çirrnin maskën mashtrimeve dhe t'i bënin ballë fuqisë së tij. Madje edhe Shpëtimtari i theu sulmet e tij me anë të Fjalës. Pas çdo sulmi, Krishti përdori mburojën e së vërtetës së përjetshme, duke thënë "Eshtë shkruar". Çdo sugjerim të kundërshtarit Ai e hodhi poshtë, falë fuqisë dhe meçurisë së fjalës. Në mënyrë që t'i mbante nën zgjedhën e tij njerëzit e të vendoste autoritetin e uzurpatorit romak, Satani duhet t'i linte njerëzit të paditur ndaj Shkrimeve të Shenjta.

Bibla lartëson Perëndinë e u jep njerëzve vendin e tyre, prandaj të vërtetat e saj të mëdha duheshin fshehur e shtypur. Kisha e Romës përdori pikërisht këtë llogjikë. Për shekuj me radhë përhapja e Biblës u ndalua. Njerëzve nuk u lejohej leximi apo

mbajtja e saj në shtëpi dhe kjo gjë u jepte mundësi priftërinjve dhe prelatëve të paskrupuj që t'i interpretonin mësimet e saj në përputhje me pretendimet e tyre boshe. Kështu, papa u njoh, pothuajse në të gjithë botën si zëvendës i Perëndisë në tokë, i veshur me autoritet si mbi kishën ashtu edhe mbi shtetin.

Me t'u mënjanuar busulla e drejtësisë, Satani filloi të vepronte sipas vullnetit të tij. Profecia pati deklaruar se papati "do të mendonte të ndryshonte kohërat dhe ligjet" *(Danieli 7:25)* dhe një gjë e tillë nuk vonoi që të ndodhte. Për t'u afruar paganëve të shndërruar në të Krishterë, një zëvendësim të adhurimit të idhujve dhe për të nxitur pranimin e Kristianizmit në një shkallë të gjerë, në adhurimin Kristian hyri gradualisht respektimi dhe nderimi i imazheve dhe relikave. Ky sistem idhujtarie përfundimisht u miratua edhe nga dekreti i këshillit të përgjithshëm. Për të vazhduar punën e saj minuese, Roma pati guximin të hiqte nga ligji i Perëndisë urdhëresën e dytë, që ndalon adhurimin e idhujve dhe të ndante urdhëresën e dhjetë në dysh për të ruajtur të pandryshuar numrin e urdhëresave.

Fryma e lëshimeve ndaj paganizmit, i hapi rrugën një mospërfilljeje akoma më të madhe të autoritetit qiellor. Satani, duke punuar përmes udhëheqësve të papërkushtuar të kishës e shkeli me këmbë edhe urdhëresën e katërt dhe e shfuqizoi Sabatin e hershëm, ditën që e kishte bekuar e shenjtëruar vetë Perëndia *(Zanafilla 2:2,3)* për ta zëvendësuar me festën, që paganët e quanin " e nderueshmja ditë e diellit." Fillimisht ky ndryshim nuk u bë haptazi. Gjatë shekujve të parë, Sabati mbahej nga të gjithë të Krishterët. Ata e nderonin me besim Perëndinë e, duke besuar se ligji i Tij ishte i pandryshueshëm, ata e ruajtën me zell të madh karakterin e shenjtë të urdhëresave të këtij ligji. Por Satani, duke vepruar me zgjuarsi të madhe nëpërmjet agjentëve të tij, mundi të vinte në jetë qëllimin e tij. Në mënyrë që vëmendja e njerëzve të përqëndrohej tek e diela, ajo u quajt ditë feste për nder të ringjalljes së Krishtit. Në atë ditë filloi kremtimi i disa shërbesave fetare e megjithatë ajo trajtohej si ditë argëtimi, ndërsa Sabati vazhdonte të respektohej si ditë e shenjtë.

Për t'i përgatitur rrugën punës që kishte ndërmend të kryente, Satani i kishte shtyrë çifutët para ardhjes së Jezusit, që ta ngarkonin Sabatin me rite aq rigoroze sa respektimi i tij të ishte barrë e jo kënaqësi. Kështu, duke përfituar nga drita e rreme që qarkonte atë, ai hodhi idenë se Sabati ishte thjesht një rit çifut. Ndërsa të Krishterët në përgjithësi vazhduan ta shihnin të dielën me syrin e një dite të gëzueshme feste, ai i nxiti ata që ta kthenin Sabatin, si shenjë urrejtjeje ndaj Judaizmit, në një ditë agjërimi, trishtimi dhe mërzitjeje.

Në fillim të shekullit të katërt, perandori Konstandin nxori një dekret, që e bënte të dielën një festë publike në mbarë Perandorinë Romake. Dita e dielë respektohej nga nënshtetasit e tij paganë e nderohej edhe nga të Krishterët; politika e perandorit ishte bashkimi i interesave kontradiktore të paganizmit dhe Kristianizmit. Ai u nxit që ta bënte një të tillë nga peshkopët e kishës që të frymëzuar nga

ambicia dhe etja për pushtet, menduan që në rast se e njëjta ditë respektohej si nga paganët, ashtu edhe nga të Krishterët, kjo do t'i shtynte paganët ta pranonin njëzëri Kristianizmin dhe kisha kështu do të fitonte një pushtet e një lavdi më të madhe. Megjithatë, shumë të Krishterë - besnikë të Perëndisë, edhe pse u shtynë që ta konsideronin të dielën deri - diku si të shenjtë, vazhduan ta mbanin Sabatin, në bindje ndaj urdhëresës së katërt, si ditën e shenjtë të Zotit.

Kryemashtruesi nuk e kishte përfunduar ende punën e tij. Ai kishte vendosur ta grumbullonte gjithë botën Kristiane nën flamurin e tij dhe ta ushtronte pushtetin e tij përmes zëdhënësit të tij, kryepriftit krenar, i cili pretendonte se ishte përfaqësues i Krishtit. Ai ia arriti qëllimit të vet, duke përdorur paganë gjysmë - besimtarë, prelatë ambiciozë dhe priftërinj fitimdashës. Herë pas here, mblidheshin personalitete të kishës nga e gjithë bota për të diskutuar "problemet e mëdha." Në pothuajse çdo mbledhje, Sabati - krijuar nga Vetë Perëndia, shtyhej pak më poshtë, ndërsa e diela ngrihej pak më lart. Kështu festa pagane filloi të nderohej si urdhëresë hyjnore, ndërsa Sabati Biblik u quajt "relikt çifut" dhe përkrahësit e saj u quajtën "mashtrues".

Femohuesi i madh ia doli mbanë dhe u lartësua mbi gjithçka që quhet perëndi ose objekt adhurimi. *(2 Selanikasve 2:4).* Ai guxoi të ndryshonte të vetmen urdhëresë, që e drejton mbarë njerëzimin tek Zoti i vërtetë që jeton. Urdhëresa e katërt e zbulon Perëndinë si Krijues të qiellit dhe të tokës, duke e veçuar nga perënditë e rreme. Dita e shtatë u shenjtërua si ditë pushimi për njerëzit në përkujtim të punës krijuese. Qëllimi i kësaj urdhërese ishte që ta mbante Perëndinë të gjallë në mendjet e njerëzve si burim i të qënit dhe objekti i vetëm i nderimit dhe adhurimit. Satani mundohet që t'i largojë njerëzit nga aleanca me Perendinë dhe nga bindja ndaj ligjit të Tij, prandaj ai i përqëndron forcat e tij kundër asaj urdhërese, që e cilëson Perëndinë si Krijues. Sot Protestantët janë të mendimit se ringjallja e Krishtit të dielën e ka kthyer këtë ditë në Sabatin Kristian. Por atyre u mungon prova Biblike. As Krishti e as apostujt e Tij nuk e veshën me lavde të tilla këtë ditë. Respektimi i së dielës si një ceremoni Kristiane e ka zanafillën tek "misteri i paudhësive" *(2 Selanikasve 2:7)* që e kishte filluar veprimtarinë e vet që në kohën e Palit. Kur dhe ku e "adoptoi" Perëndia këtë fëmi të papatit? Çfarë arsye bindëse mund të jepet në mbështetje të një ndryshimi që Shkrimet e Shenjta nuk e meritojnë?

Papati u vendos plotësisht në shekullin e gjashtë. Qëndra e tij ndodhej në qytetin perandorak dhe peshkopi i Romës u vetquajt kreu i kishës mbarëbotërore. Vendin e paganizmit e zuri papati. Dragoi i kishte dhënë bishës "fuqinë e vet, fronin e vet dhe autoritet të madh." *(Zbulesa 13:2).* Pikërisht në atë kohë filloi periudha 1260 vjeçare e shtypjes së papatit, që parashikohet në profecitë e Danielit dhe Zbulesës. *(Danieli 7:25; Zbulesa 13:5-7)* Të Krishterët u detyruan të zgjidhnin: ose të hiqnin dorë nga besnikëria dhe të pranonin ceremonitë dhe adhurimin e

papatit, ose ta kalonin jetën të mbyllur në qeli ose të vdisnin mbi turrën e druve, mbi trekëmbësha apo në gijotinë. Kështu u përmbushën fjalët e Jezusit: "Dhe ju madje do t'iu tradhëtojnë edhe prindërit, edhe vëllezërit, edhe farefisi dhe miqtë, dhe disa prej jush do t'i vrasin. Dhe të gjithë do t'iu urrejnë për shkak të emrit Tim." *(Luka 21:16,17).* Persekutimi i përfshiu të gjithë të Krishterët e vërtetë në një valë të paparë tërbimi dhe bota mori pamjen e një fushe të stërmadhe luftimi. Për qindra vjet kisha e Krishtit gjeti strehë në vendet e shkreta e të errëta. Profeti tha: "Gruaja iku në shkretëtirë, ku kishte një vend të përgatitur nga Perëndia, që të ushqehej atje një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë ditë." *(Zbulesa 12:6)*

Ngritja në pushtet e Kishës së Romës shënon fillimin e Mesjetës. Me rritjen e pushtetit të saj, thellohej edhe më errësira. Besimi kaloi nga Krishti apo nga themeli i vërtetë tek papa i Romës. Në vend që t'ia besonin Birit të Perëndisë faljen e mëkateve dhe shpëtimin e përjetshëm, njerëzit i drejtoheshin papës, priftërinjve dhe prelatëve, që caktoheshin dhe visheshin me autoritet prej tij. Atyre u ishte thënë që papa ishte ndërmjetësi i tyre tokësor dhe askush nuk mund t'i afrohej Perëndisë përveç tij; e për më tepër, ai ishte për ta në vend të Zotit e duhej respektuar. Një shmangie sado e vogël nga udhëzimet e tij përbënte një arsye të mjaftueshme për dënimet më të ashpra fizike e shpirtërore. Kështu, mendjet e njerëzve e harruan Perëndinë për t'u përqëndruar tek njerëz mëkatarë e mizorë; e për më tepër... sa keq! Ato u përqëndruan tek vetë princi i errësirës, që ushtronte pushtetin e tij përmes tyre. Mëkati u fsheh prapa një veshjeje të shuguruar. Kur Shkrimet e Shenjta flaken tej dhe njeriu fillon ta quajë veten të plotfuqishëm, mbetja është vetëm mashtrim, padrejtësi dhe paudhësi. Lartësimi i ligjeve dhe traditave njerëzore nxori në pah korrupsionin, që rezulton nga shkelja e Ligjit të Perëndisë.

Ato ishin ditë të vështira për kishën e Krishtit. Shumë të pakët ishin ata që ngrinin flamurin e së vërtetës. Edhe pse pati gjithmonë dëshmitarë të së vërtetës, pati momente kur dukej sikur gabimet dhe bestytnitë do të triumfonin dhe besimi i vërtetë do të zhdukej nga faqja e dheut. Ungjilli ishte lënë pas dore, ndërsa format fetare shumëfishoheshin dhe njerëzit ishin ngarkuar me detyrime të rënda.

Ata u mësuan, që jo vetëm ta shihnin papën si ndërmjetësin e tyre, por edhe që t'i besonin veprave të mira si shlyerje për mëkatin. Shtegtimet e gjata, aktet e ndëshkimit, adhurimi i relikeve, ngritja e kishave, faltoreve dhe altarëve, derdhja e shumave të mëdha lekësh në kishë - këto dhe gjëra të tjera të ngjashme me to bëheshin për të zbutur zemërimin e Perëndisë apo për të siguruar dashamirësinë e Tij, sikur Ai t'i ngjante njeriut që egërsohet nga kotësitë e mund të merret me të mira, me dhurata e akte pendimi.

Pavarësisht nga përhapja dhe mbizotërimi i veseve mes udhëheqësve të Kishës Romake, ndikimi i saj rritej gjithnjë e më shumë. Aty nga fundi i shekullit të tetë, përkrahësit e papatit dolën me idenë që peshkopët e Romës kishin pasur të njëjtën

fuqi shpirtërore edhe në shekujt e parë të ekzistencës së kishës. Në mënyrë që ky pretendim të dukej deri - diku i vërtetë duheshin gjetur prova e aty, i gatshëm ishte babai i gënjeshtrave. Murgjit gjetën disa shkrime "të hershme". U zbuluan dekrete mbledhjesh të fshehta që askush nuk i kishte dëgjuar ndonjëherë dhe këto dekrete "vërtetonin" epërsinë mbarëbotërore të papës që nga kohërat e lashta. Kisha, që e kishte mohuar me kohë të vërtetën, i pranoi verbërisht këto mashtrime.

Ndërtuesit e pakët besnikë, që vazhdonin të qëndronin në themele të shëndosha *(1 Korintasve 3: 10,11)* u çoroditën dhe u frenuan nga skorjet e doktrinave të rreme, që e penguan punën. Si ndërtuesit e murit të Jeruzalemit gjatë kohës së Nehemisë, edhe disa prej tyre qenë gati të thoshin: "Forcat e mbartësve të peshave u pakësuan dhe gërmadhat janë aq të shumta, sa nuk do të arrijmë të ndërtojmë muret." *(Nehemia 4:10).* Të dërrmuar nga lufta e vazhdueshme kunder persekutimit, mashtrimit, paudhësisë dhe çdo pengese tjetër që u vinte Satani në rrugën e përparimit, disa prej tyre edhe pse kishin qënë ndërtues besnikë u dekurajuan; dhe për hir të paqes, sigurisë, pronës dhe vetë jetës, ata iu larguan themelit të së vërtetës. Të tjerët, të patrembur nga kundërshtimi i armiqve të tyre, deklaruan: "Mos kini frikë nga ata: kujtoni Zotin e madh e të tmerrshëm" *(Versa 14);* e kështu ata vazhduan punën, secili me shpatën e vet ngjeshur brezit. *(Efesianët 6:17)*

Gjatë gjithë kohërave armiqtë e Perëndisë i ka frymëzuar e njëjta frymë urrejtjeje dhe kundërshtimi, ndërsa shërbëtorëve të Tij iu është kërkuar e njëjta vigjilencë dhe besnikëri. Fjalët që u tha Krishti dishepujve të parë, u drejtohen edhe pasuesve të Tij të ditëve të fundit: "Këtë që po ju them juve, ua them të gjithëve: Rrini zgjuar!" *(Marku 13:37)*

Errësira bëhej gjithnjë e më e dëndur. Adhurimi i imazheve merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha. Para tyre ndizeshin qirinj dhe vetë lutjet u drejtoheshin atyre. Mbizotëruan zakone nga më absurdet e supersticiozet. Mendjet njerëzore u vunë plotësisht nën kontrollin e supersticioneve, saqë arsyeja e humbi fillin. Ndërsa vetë priftërinjtë dhe peshkopët ishin të dhënë pas kënaqësive, epshit dhe korrupsionit, njerëzit e tjere që i mbanin ata si "shembuj" zhyteshin gjithnjë e më shumë në padije dhe vese.

Një hap tjetër në rrugën e hamendjeve të papatit u hodh në shekullin e njëmbëdhjetë, kur papa Gregori VII shpalli përsosmërinë e Kishës së Romës. Mes pretendimeve të tjera absurde, u veçua një, që deklaronte që kisha nuk kishte gabuar kurrë e sipas Shkrimeve të Shenjta, nuk kishte për të gabuar ndonjëherë as në të ardhmen. Por Shkrimet e Shenjta nuk e mbështesnin një deklaratë të tillë. Kryeprifti kryelartë pretendonte gjithashtu se kishte të drejtë të shkarkonte perandorët e deklaronte se asnjë vendim i marrë prej tij nuk mund të shfuqizohej nga ndonjë tjetër, por ai gëzonte fuqi të plotë për të anulluar vendimet e të tjerëve.

Një shembull domethënës i karakterit tiranik të këtij "avokati mbrojtës" të pagabueshmërisë, është edhe trajtimi që i rezervoi ai perandorit gjerman Henri IV. Ky mbret, me akuzën e mospërfilljes ndaj autoritetit të papës, u shkarkua nga detyra dhe u shpronësua. I tmerruar nga kërcënimet dhe braktisja e princërve të tij që u inkurajuan që të rebelonin kundër tij nga vendimi i papatit, Henrit i duhej të pajtohej me Romën. I shoqëruar nga gruaja e tij dhe një shërbëtor besnik, ai kaloi Alpet në mes të dimrit për t'u gjunjëzuar përpara papës. Kur arriti tek kështjella ku qëndronte Gregori, atë e çuan të vetëm në oborrin e brendshëm, ku iu desh të priste mes acarit të dimrit, këmbëzbathur, me kokë të zbuluar e i veshur me thes, lejen e papës për ta takuar. Pasi agjëroi dhe rrëfeu tri ditë rresht, papa e fali. Ai u fal por me kusht, që të priste miratimin e papës përpara se të merrte përsëri titujt, që i takonin e të ushtronte autoritetin mbretëror. Pas kësaj, Gregori i ngazëllyer nga ky triumf, mburrej, duke deklaruar se ishte detyra e tij që t'ua ulte krenarinë mbretërve.

Sa domethënës është ndryshimi mes kryelartësisë së pakufishme të kësaj pape dhe përuljes e mirësisë së Krishtit, që lutet në dyert e zemrës që ato të hapen e Ai të sjellë falas falje dhe paqe e që dikur u tha dishepujve të Tij: "Kushdo prej jush që do të dojë të jetë i pari, qoftë skllavi juaj." *(Mateu 20:27)*

Rrjedha e shekujve nxori në dritë gabime gjithnjë e më të mëdha të doktrinave të Romës. Filozofia pagane e ka tërhequr vëmendjen e kishës dhe ka pasur ndikimin e vet mbi të edhe përpara vendosjes së papatit dhe përhapjes së mësimeve të tij. Shumë njerëz edhe pse vetëquheshin të Krishterë, vazhdonin t'u përmbaheshin teorive të filozofisë së tyre pagane dhe jo vetëm që e vazhdonin vetë studimin e saj, por i nxisnin edhe të tjerët të bënin të njëjtën gjë, duke deklaruar se kjo ishte një mënyrë ndikimi mes paganëve. Kështu në besimin Kristian hynë shumë gabime. Një nga më të shquarit mes tyre është ai i besimit në pavdekshmërinë natyrore dhe ndërgjegjen gjatë vdekjes. Kjo doktrinë shërbeu si themel mbi të cilën Roma ndërtoi përrallën e shenjtorëve dhe adhurimit të Virgjëreshës Mari. Këtu e ka zanafillën gjithashtu herezia e dënimit të përjetshëm, që kishte kohë që i përkiste besimit të Romës.

Më pas, rruga iu hap një shpikjeje tjetër të paganizmit, që Roma i vuri emrin Purgator dhe e përdori për t'u kallur datën turmave supersticioze e besimtare. Falë kësaj herezie u shpall ekzistenca e imagjinuar e një vendi të mundimshëm, ku shpirtrat që nuk e meritonin dënimin e përjetshëm, do të dënoheshin pjesërisht për mëkatet e tyre dhe do të pranoheshin në parajsë me t'u pastruar nga paudhësitë.

Në mënyrë që të përfitonte akoma edhe më shumë nga frika dhe të metat e përkrahësve të saj, Roma përdori një trillim tjetër. Doktrina e zemërbutësisë ia afroi këtë mundësi. Të gjithë atyre, që do të merrnin pjesë në luftrat e papës për të zgjeruar territoret e sundimit të tij, për të dënuar armiqtë e tij apo për të zhdukur ata që guxonin ta mohonin epërsinë e tij, iu premtua fshirja e mëkateve të së shkuarës,

të momentit e të së ardhmes dhe çlirimi nga dhembjet dhe dënimet që sjellin ato. Njerëzve u thuhej që ata mund t'i shpëtonin mëkatit dhe t'i çlironin miqtë e tyre të vdekur nga flakët përvëluese, përmes pagimit të shumave të mëdha kishës. Duke përdorur rrugë të tilla fitimi, Roma mbushi arkat dhe u siguroi atyre, që pretendonin të ishin përfaqësues të Atij që s'pati as një vend për të vënë kokën, madhështi, luks dhe rehati.

Urdhëresës Biblike të Darkës së fundit të Zotit, ia zuri vendin flijimi idhulltar i meshës. Priftërinjtë e kishës së Romës pretendonin, se falë mërmëritjeve të tyre të pakuptimta, mund ta shndërronin bukën dhe verën e thjeshtë "në trupin dhe gjakun e vërtetë të Krishtit."[1] Ata pretendojnë me një mendjemadhësi të marrë, se kanë fuqi të krijojnë Zotin, Krijuesin e gjithçkaje. Të Krishterëve iu kërkohej që t'ia përkushtonin besimin e tyre kësaj herezie të tmerrshme, që e sfidonte Qiellin. Me mijëra njerëz, që nuk pranuan ta bënin një gjë të tillë u dogjën të gjallë.

Në shekullin e trembëdhjetë u krijua makina më e tmerrshme e papatit - Inkuizicioni. Princi i errësirës veproi përmes udhëheqësve të hierarkisë romake. Në dhomat e tyre të errëta, Satani dhe ëngjëjt e tij i vunë nën kontrollin e tyre mendjet e njerëzve të ligj, ndërsa diku aty ndodhej i paparë një ëngjëll i Perëndisë, që mbante shënim dekretet e tyre të tmerrshme dhe shkruante rrjedhën e ngjarjeve, që ishin tepër të llahtarshme për syrin njerëzor.

Babilonia e madhe u deh me gjakun e të shenjtëve. Miliona trupa të torturuar martirësh i bënë thirrje Perëndisë që të hakmerrej kundër kësaj fuqie femohuese. Papati u kthye në despot të botës. Mbretër e perandorë përuleshin përpara dekreteve të papës së Romës. Dukej sikur fati i njerëzimit, që lidhej me përjetësinë, varej prej tij. Doktrinat e Romës u pranuan si të vërteta e të pakundërshtueshme, ritet e saj u kryen me respekt dhe shërbesat e saj u mbajtën rregullisht për qindra vjet me radhë. Kleri i saj nderohej e financohej bujarisht. Që nga ajo kohë, kisha nuk ka gëzuar dinjitet, madhështi apo fuqi më të madhe.

Por "mesdita e papatit u bë mesnata e botës."[2] Jo vetëm populli, por edhe priftërinjtë ishin të paditur në lidhje me Shkrimet e Shenjta. Si Farisenjtë e hershëm, udhëheqësit e papatit e urrenin dritën, që ua nxirrte në shesh mëkatet. Me të flakur tej ligjin e Perëndisë - atyre iu dha mundësia të ushtronin një pushtet të pakufizuar dhe të praktikonin zakonet e mbrapshta pa ngurruar. Mbizotëruan mashtrimi, kopracia dhe korrupsioni. Njerëzve nuk u trembej syri përpara asnjë krimi, që do të mund t'u siguronte atyre pozitë dhe pasuri. Pallatet e papëve dhe prelatëve ishin skena të shthurjeve më të ulëta. Disa prej kryepriftërinjve më të pushtetshëm ishin autorë krimesh kaq të neveritshme saqë disa udhëheqës sekularë, duke i gjykuar si përbindësha, kërkuan shkarkimin e tyre. Për shekuj me radhë Evropa nuk hodhi

---

[1] Kardinal Wiseman, "The real Presence of the Body and Blood of Our Lord Jesus Christ in the Blessed Eucharist, Proved from Sripture", lek 8, sek 3, parag. 26

[2] J.A Wylie, "The History of Protestanism" l 1, k 4

asnjë hap të ri në fushën e arsimit, artit apo qytetërimit. Dukej sikur Kristianizmin e kishte pllakosur një paralizë morale dhe intelektuale.

Gjendja në të cilën ndodhej bota nën zgjedhën romake paraqet një përmbushje të detajuar e të frikshme të fjalëve të profetit Osea: "Populli im vdes për mungesë njohurish. Duke qënë se ti ke harruar njohjen, edhe unë do të refuzoj... duke parë se ke harruar ligjin e Perëndisë Tënd, edhe unë do t'i harroj fëmijët e tu." "Nuk ka në fakt as sinqeritet, as mëshirë dhe as njohje të Perëndisë në vend. Nuk bëhet tjetër përveç shpërbetimeve, gënjeshtrave, vrasjeve, vjedhjeve, shkeljeve të kurorës, shkeljeve të çdo kufizimi dhe derdhet gjak mbi gjak." *(Osea 4:6,1,2)*. Ja, këto janë rezultatet e braktisjes së fjalës së Perëndisë!

1. Cili ishte shkaku i "errësirës shpirtërore" pas shekullit të tretë?

2. Tek 2 Selanikasve 2:7, Pali shkruan për "misterin e paudhësisë". Kujt po i referohet ai?

3. Satani ndonjëherë përdor forcën e dhunshme dhe disa herë të tjera, ai influencon ndryshime të ngadalshme që të çojnë tek e keqja. Cilat janë metodat e Perëndisë që bëjnë ndryshime të qëndrueshme drejt së mirës?

4. Përse e sulmon në veçanti Sabatin djalli?

4.

Valdezët

Edhe mes errësirës që dukej sikur kishte mbuluar tokën gjatë periudhës së gjatë të mbizotërimit të papatit, drita e së vërtetës nuk u shua plotësisht.Gjatë gjithë kohërave nuk kanë munguar dëshmitarët e Perëndisë - njerëz që besonin se Krishti ishte i vetmi ndërmjetës midis Zotit dhe jeriut, që e nderonin Biblën si udhërrëfyesen e vetme në jetë dhe e mbanin të shenjtë Sabatin e vërtetë. Megjithatë bota asnjëherë nuk do ta kuptojë plotësisht se sa borxhlie u është këtyre njerëzve. Ata u quajtën heretikë, qëllimet e tyre u kritikuan, karakteri i tyre u përbalt dhe shkrimet e tyre u ndaluan, u keqinterpretuan dhe u zhdukën. Megjithatë ata nuk u përkulën dhe e ruajtën të pastër besimin e tyre në shekuj për t'ia lënë trashëgim të pacënuar e të shenjtë brezave të ardhshëm.

Historia e popullit të Perëndisë gjatë periudhës së errësirës që pllakosi botën falë pushtetit suprem të Romës, është gdhendur në qiell, por pak shenja të saj gjenden në dokumentet njerëzore. Gjurmët e ekzistencës së tyre gjenden vetëm në akuzat e perseku- torëve të tyre. Politika e Romës konsistonte në zhdukjen e çdo gjurme pakënaqësie ndaj doktrinave apo dekreteve të saj. Ajo u përpoq të shkatërronte çdo gjë, person apo shkrim, që paraqiste shenja herezie. Shprehjet e dyshimit apo kundershtimit ndaj autoritetit të dogmave romake, ishin të mjaftueshne për të vënë në rrezik jetën e të varfërve dhe të pasurve, e të pushtetshmë- ve dhe të zakonshmëve. Roma u orvat që të zhdukte gjithashtu çdo shenjë të mizorisë së saj ndaj këtyre "rebelëve". Këshillat e papatit, me anë të dekreteve të tyre, urdhëruan djegien e të gjithë librave që përmbanin të dhëna të tilla. Meqënëse përpara shpikjes së shtypshkronjës së parë librat ishin të pakët dhe ishte e vështirë ruajtja e tyre dhe kjo ua lehtësonte autorite- teve të Romës detyrën tyre.

Asnjë kishë që ndodhej brenda sferës së juridiksionit romak, nuk e gëzoi lirinë e ndërgjegjes për një kohë të gjatë. Me të vendosur pushtetin e tij, papati nxitoi për të zgjatur duart e për t'i shkatërruar të gjithë ata që nuk pranuan ta njihnin zgjedhën e saj. Kështu, njëra pas tjetrës, kishat iu dorëzuan sundimit të tij.

Në Britaninë e Madhe, Kristianizmi primitiv i hodhi shumë shpejt rrënjët e tij. Britanët në shekujt e parë, u njohën me një un- gjill të pacënuar nga femohueshmëria romake. Kishat e para angle ze morën nga Roma një dhuratë të vetme: persekutime nga perando- rët paganë, persekutime që u zgjeruan deri në brigjet e largëta. Shumë të Krishterë, duke u larguar nga persekutimi në Angli, gje-tën strehë në Skoci; e nga këtu e vërteta depërtoi në Irlandë ku u prit me gëzim të madh.

Paganizmi mbizotëroi në vend, kur saksonët pushtuan Britaninë. Pushtuesit e quanin për turp të merrnin mësime nga skllevërit e tyre e kështu të Krishterëve iu desh të strehoheshin në male e në moçale të shkreta. Megjithëse drita u fsheh për një farë kohe, ajo shkëlqeu përsëri. Në Skoci, një shekull më vonë, ajo shkëlqeu me një vezullim verbues që u ndie edhe në vendet fqinje. Nga Irlanda erdhi Kolumba i zellshëm dhe bashkëpunëtorët e tij që duke i mbledhur besimtarët e shpërndarë në ishullin Iona, e kthy- en këtë të fundit në qëndrën e punës së tyre misionare. Mes këty- re misionarëve ndodhej edhe një mbrojtës i Sabatit Biblik dhe kjo e vërtetë depërtoi dhe u përqafua edhe nga të tjerët. Në Iona u ngrit një shkollë, misionarët që dolën nga bankat e saj shkuano vetëm në Skoci e Angli, por edhe në Gjermani, Zvicër e Itali.

Por Roma ia kishte ngulur sytë Britanisë dhe vendosi që ta zinte edhe atë në kurthin e saj. Në shekullin e gjashtë misionarët e saj i hynë punës për t'i kthyer në të Krishterë saksonët paganë. Duke u mirë pritur nga barbarët krenarë, këta misionerë mundën të bindnin me mijëra prej tyre që ta pranonin besimin ro-mak. Ndërsa puna ecte përpara, udhëheqësve romakë dhe të bindurve të tyre iu desh të ballafaqoheshin me të Krishterët e vërtetë. Ndryshimi midis këtyre palëve ishte mbreslënës. Të dytët ishin të thjeshtë, kokëulur, përkrahës të karakterit, doktrinave dhe zakoneve Biblike, ndërsa të parët lartësonin supersticionin, arro gancën dhe madhështinë e papatit. Lajmëtarët e Romës i ftuan këto kisha që të njihnin pushtetin e pakufizueshëm të papës. Britanët iu përgjigjën me urtësi këtyre ftesave duke theksuar se ata dëshironin t'i donin të gjithë njerëzit papërjashtim, por papën nuk e kishte caktuar kush si kreu i kishës dhe ata ishin gati ta respektonin atë ashtu siç nderonin çdo pasues të Krishtit. Për-pjekje të vazhdueshme u bënë për të siguruar aleancën e tyre me Romën, por të Krishterët kokëulur, të çuditr nga krenaria që tregonin këta lajmëtarë, u përgjigjën me vendosmëri se ata nuk njihnin asnjë Zot tjetër mbi Krishtin. Pikërisht atëherë u zbulua fryma e vërtetë e papatit. Udhëheqësi romak tha: "Në qoftë se nuk i mirë prisni vëllezërit që ju sjellin paqe, do t'iu vijnë armiqtë që do t'iu sjellin luftë. Në qoftë se nuk do të bashkoheni me ne për t'iu treguar saksonëve rrugën e jetës, ata do t'iu falin goditjen e vdekjes. -J.H. Merle D'Aubigne,"History of the Reformation of the Sixteenth Century" libri 17 kap 2. Këto nuk ishin kërcënime boshe. Kundër tyre u përdorën intriga dhe mashtrime kaq të mëdha saqë këta dëshmitarë të besimit Biblik ose u shkatërruan, ose u detyruan t'i nënshtro- heshin autoritetit romak.

Në vendet përtej juridiksionit të Romës, kanë ekzistuar për shekuj me rradhë grupe të Krishterësh, që kanë mbetur tërësisht të pastër ndaj korrupsionit të papatit. Edhe ata ishin të rre- thuar nga paganizmi dhe me kalimin e kohës u prekën deri- diku nga gabimet e tij; por megjithatë vazhdonin ta respektonin Biblën si rregullin e vetëm të besimit dhe t'i vinin në praktikë shumë nga të vërtetat e saj. Këta të Krishterë besonin në karakterin e përjetshëm të ligjit të Perëndisë dhe e mbanin të shenjtë Sabatin e urdhëresës së katërt. Kisha, që e ruanin këtë besim dhe e respektonin këtë mënyrë veprimi, ekzistonin në Afrikën Qëndrore dhe mes armenëve të Azisë.

Mes atyre që i bënë ballë me guxim fuqisë së romës, një vend nde- ri mbajnë Valdezët. Korupsioni dhe gënjeshtrat e Papatit ndeshën rezistencën më të madhe pikërisht në atë vend ku ndodhej froni dhe selia e tij. Kishat e Piemontit e ruajtën pavarësinë e tyre për shekuj me rradhë; por, më së fundi, erdhi koha kur Roma kërkoi me këmbëngulje dorëzimin e tyre. Pas betejash të pasuksesshme kundër tiranisë së saj, udhëheqësit e këtyre kishave u detyruan ta njihnin pushtetin e pakufishëm të asaj fuqie që dukej sikur kishte vënë nën themrën e saj pothuajse gjithë botën. Sidoqoftë, pati disa prej tyre që nuk pranuan t'i dorëzoheshin autoritetit të papës apo prelatëve të tij. Ata ishin të vendosur që ta ruanin besnikërinë ndaj Perëndisë dhe thjeshtësinë e pastërtinë e besimit që kishin përqafuar. Kështu filloi përçarja. Ata që i përkisnin besimit të pacënuar u larguan: disa braktisën Alpet e vendlindjes për ta ngritur flamurin e së vërtetës në vende të tjera; të tjerët gjetën strehë nëpër shpella apo guva të maleve ku gëzonin liri të plotë për ta adhuruar Perëndinë. Besimi që për shekuj me rradhë u kultivua dhe u mësua nga të Krishterët Valdezëndryshonte plotësisht nga doktrinat e rreme që kishte përqafuar Roma. Besimi i tyre fetar kishte si themel fjalën e shkruar të Perëndisë, sistemin e vërtetë të Kristianizmit. Këta fshatarë kokëulur, në strehinat e tyre të errëta, të ndara prej botës dhe të dhëna pas punës së përditshme mes tufave të bagëtive e vresh- tave, nuk arritën vetë tek njohja e së vërtetës që binte në kundërshtim me dogmat dhe herezitë e kishës femohuese. Besimi i tyre nuk ishte një besim i një tipi të ri. Këtë besim fetar ata e kishin marrë në trashëgim nga baballarët e tyre. Ata i gëzonte ky besim i kishës apostolike -"besimi që u qe transmetuar shenjtorëve njëherë e përgjithmonë." - Juda 3. "Kisha në shkre-tëtirë" dhe jo hierarkia kryelartë që ishte ulur mbi fronin e kryeqytetit të botës, ishte kisha e vërtetë e Krishtit, depozita e thesareve të së vërtetës që Perëndia ia besoi popullit të Tij për t'ia shpërndarë botës.

Urrejtja e kishës së Romës për Sabatin Biblik ishte një nga shkaqet kryesore që çuan në ndarjen e saj nga kisha e vërtetë. Fuqia e papatit, siç parashikohet edhe në profeci, e shkeli me këmbë të vërtetën. Ligji i Perëndisë u mbulua me pluhur, ndërsa u ngritën lart traditat dhe zakonet njerëzore. Kishat që u gjendën nën sundimin e Romës, shumë shpejt u detyruan ta nderojnë të dielën si ditë të shenjtë. Në mes të gabimeve në rritje e su- persticioneve shumë njerëz, madje edhe nga populli i vërtetë

i Perëndisë u çoroditën kaq shumë saqë, ndërsa e mbanin të shenjtë të shtunën, i shmangeshin punës dhe gjatë të dielës. Por as kjo nuk i kënaqte udhëheqësit e Romës. Ata dëshironin që jo vetëm të shenjtërohej e diela, por edhe të dhunohej e shtuna dhe i qortuan ashpër të gjithë ata që guxonin ta respektonin atë. Vetëm duke iu larguar fuqisë së Romës njerëzit mund t'i bindeshin në paqe urdhëresave të ligjit të Perëndisë.

Valdezët ishin të parët në Evropë që i përkthyen Shkrimet e Shenjta. Qindra vjet përpara Reformacionit, ata kishin një dorë- shkrim të Biblës në gjuhën e tyre. E vërteta e pashtrembëruar që ruanin ata, i ktheu në objekt urrejtjeje dhe persekutimi. Ata deklaruan se Kisha e Romës ishte Babilonia femohuese e Zbulesës dhe nuk iu dorëzuan asaj edhe pse një gjë e tillë e vinte në rrezik jetën e tyre. Ndërsa disa prej tyre, nën ndikimin e përndjekjeve të gjta, dalë nga dalëi braktisën parimet kryesore, të tjerët vazhduan ta ruanin të vërtetën të pacënuar. Përmes she-kujve të errësirës dhe apostazisë këta Valdezë e mohuan sundimin romak, e hodhën poshtë adhurimin e imazheve si idhujtari dhe e mbajtën të shenjtë Sabatin e vërtetë. Ata u kapën fort pas besimit të tyre edhe pse iu desh të përballonin furtuna të ashpra kundërshtimi. Edhe pse të sulmuar nga trupat savojase dhe të përvëluar nga turrat e druve romake, ata mbetën besnikë të papër- kulur të fjalës së Perëndisë dhe vazhduan ta nderojnë Atë.

Prapa ledheve të këtyre maleve të madhërishëm që në çdo kohë kanë qënë vendstrehim i të persekutuarve dhe të shtypurve - Valdezët gjetën shpëtim. Këtu, drita e së vërtetës vazhdoi të ndriçonte mes errësirës së Mesjetës. Këtu, dëshmitarët e së vërtetës, ruaj- tën me mijëra vjet, besimin e parë.

Perëndia kishte përgatitur për popullin e Tij një shenjtore me një madhështi të paparë që u shkonte për shtat të vërtetave të mëdha që u kishte besuar. Për këta mërgimtarë besnikë malet për- bënin një emblemë të pathyeshme të drejtësisë së Jehovait. Ata u tregonin fëmijëve të tyre majat mbizotëruese që spikatnin ma-dhërisht kundrejt qiellit dhe u flisnin atyre për Atë që as nuk ndryshon e as nuk kthehet, fjalët e të Cilit do të jetojnë për- jetësisht si kodrat e patundura. Zoti i kishte vendosur në vendet e tyre malet dhe u kishte falur forcë atyre e askush, përveç Fuqisë së Pafund, nuk mund t'i lëvizte vendit ato. Në të njëjtën mënyrë Perëndia kishte caktuar ligjin e Tij, që përbën themelin e qeverisjes së Tij në qiell e në tokë. Dora e njeriut mund të shtrihet e ta shkatërrojë jetën e një njeriu tjetër, por ajo dorë ashtu si nuk mund t'i shkatërrojë nga themelet malet e t'i hedhë në det, ashtu as nuk mund të ndryshojë urdhëresat e ligjit të Jehovait apo të fshijë premtimet që Ai ua ka rezervuar atyre që kryejnë vullnetin e Tij. Në besimin e tyre ndaj ligjit të Tij, shërbëtorët e Zotit duhet të jenë të patundur si kodrat që nuk mund të lëvizin.

Malet që ndahen nga luginat ishin një dëshmi e vazhdueshme e fu-qisë krijuese të Perëndisë, përveç sigurisë së pagabueshme të kujdesit të Tij. Këta shtegtarë më-

suan t'i duan simbolet e hesh-tura të pranisë së Jehovait. Ata nuk ankoheshin për ashpërsinë e fatit të tyre; kurrë nuk ndjeheshin të baktisur edhe në mes vetmisë malore. Ata e falënderonin Perëndinë që u kishte siguruar një strehë larg zemërimit dhe mizorisë njerëzore dhe i gëzoheshin lirisë së adhurimit. Shpesh fuqia e maleve u siguronte atyre një mbrojtje të sigurt nga ndjekjet e armiqve. Nga majat e larta të maleve, ata i këndonin Perëndisë himne lëvdimi dhe ushtritë e Ro-mës nuk mund ta heshtnin këngën e tyre të zjarrtë.

Mëshira e këtyre pasuesve të Krishtit ishte e pastër, e thjeshtë dhe e përulur. Për ta parimet e së vërtetës kishin vlerë më të madhe se shtëpitë, tokat, miqtë, të afërmit e madje edhe se vetë jeta vetë. Në zemrat e fëmijëve farërat e këtyre parimeve hidhe-shin që në vegjëli. Që në fëmijëri, të rinjve u flitej për Shkrimet e Shenjta dhe u mësohej t'i trajtonin si të shenjta ur-dhëresat e ligjit të Perëndisë. Kopjet e Biblës ishin të pakta, prandaj fjalët e saj të çmuara mësoheshin përmendësh. Të shumtë ishin ata që qenë në gjendje të përsërisnin pasazhe të tëra të Dhjatës së Re e të Vjetër. Mendimet për Perëndinë i shoqëronin skenat e mrekullueshme të natyrës dhe bekimet e jetës së përdit- shme. Fëmijët e vegjël mësuan t'i jenë mirë njohës Zotit, si burim i vetëm i çdo të mire e begatie.

Prindërit e dashur e të dhembshur, i donin shumë fëmijët e tyre e prandaj i mësuan ata të heqin dorë nga plotësimi i kënaqësive vetjake. Ata i priste një jetë provash e vështirësish... e ndo-shta edhe një vdekje martirësh. Që në fëmijëri ata u edukuan që t'u bënin ballë vështirësive, të ushtronin vetëkontroll e të vepronin e të mendonin drejt. Që në moshë të re, ata u mësuan të ishin përgjegjës për veprimet e tyre, të kishin kujdes kur flisnin e ta kuptonin rëndësinë e heshtjes. Një fjalë e pamatur, që mund të binte në veshin e armikut, do të vinte në rrezik jo vetëm jetën e folësit, por edhe atë të vëllezërve të tij; sepse armiqtë e të vërtetës i ndiqnin ata që guxonin ta mbronin lirinë e besimit, siç ndjekin ujqërit e uritur prenë e tyre.

Valdezët sakrifikuan begatinë e vërtetë të kësaj bote për hir të së vërtetës dhe u duhej të punonin me durim për të siguruar bukën e gojës. Çdo pëllëmbë tokë e punueshme mes maleve shfrytëzohej me kujdes; lëndinat dhe faqet e kodrave, edhe pse jo shumë pjellore, punoheshin e prodhonin. Kursimi dhe vetëmohimi përbënin një pjesë të rëndësishme të edukatës që fëmijët e merrnin si një vlerë të trashëguar. Atyre iu tha se Perëndia dëshiron që jeta të jetë e disiplinuar dhe plotësimi i çdo nevoje të përditshme arrihet nëpërmjet punës personale, kujdesit, largpamësisë dhe besimit. Një ecuri e tillë, është e vërtetë, që duket e lodhshme dhe rraskapitëse, por është e plotë, ajo përbën shkollën që ka ngritur Perëndia për t'iu përgjigjur gjendjes së mjerueshme në të cilën ndodhet njeriu dhe për ta stërvitur e zhvilluar atë. Të rinjtë mësoheshin të ishin gati për punë e sakrifica, por nuk li- hej mënjanë as veprimtaria mendore. Atyre u mësohej se çdo dhunti i takonte Perëndisë e të gjitha duheshin zhvilluar për t'i shërbyer Atij.

Kisha Valdeze, me pastërtinë dhe thjeshtësinë e saj, i ngjante kishësapostolike. Duke hedhur poshtë sundimin e papës dhe prelatëve romakë, ata njihnin vetëm autoritetin e Biblës si të pagabueshëm e suprem. Pastorët e tyre, ndryshe nga priftërinjtë kryelartë të Romës, ndiqnin shembullin e Mësuesit të tyre" që nuk erdhi që t'i shërbenin të tjerët, por t'u shërbente atyre."

Ata e ushqyen tufën e perëndisë në kullotat e gjelbra dhe burimet plot jetë të fjalës së Tij të shenjtë. Larg monumenteve të krenarisë dhe madhështisë njerëzore, ata mblidheshin, jo në kisha apo katedrale madhështore, por nën hijen e maleve apo në kohë rreziku në guva shkëmbore, për të dëgjuar nga goja e shërbëtorëve të Krishtit fjalët e së vërtetës. Pastorët predikonin jo vetëm Ungjillin, por vizitonin të sëmurët, mësonin fëmijët, qortonin ata që gabonin, përpiqeshin të shuanin grindjet e të vendosnin harmoninë e dashurinë vëllazërore. Në kohë paqeje ata ushqeheshin me të ardhurat e mbledhura nga dhuratat e njerëzve; por ashtu si Pali - ndërtuesi i tendave - edhe ata mësuan një profesion apo zanat për të siguruar të ardhura në rast nevoje.

Pastorët ishin mësuesit e të rinjve. ndërsa u kushtohej vëmendje e veçantë kulturës së përgjithshme, Bibla mbetej lënda kryesore. Ungjijtë e Mateut dhe të Gjonit, si dhe pjesa më e madhe e Letrave të Apostujve mësoheshin përmendësh. Ata merreshin edhe me kopjimin e Shkrimeve të Shenjta. Disa ishin dorëshkrime të të gjithë Biblës, të tjerat të pjesshme; disa prej të cilave ishin pasuruar me shpjegime të thjeshta të tekstit, shkruar nga ata që ishin në gjendje ta bënin një gjë të tillë. Shpërndaheshin kështu thesaret e së vërtetës që ata që donin të lartësoheshin mbi vetë Perëndinë, i kishin fshehur për një farë kohe.

Me një punë këmbëngulëse e të palodhur, ndonjëherë në guvat e errëta e të thella të tokës me ndihmën e një qiriu u kopjuan varg pas vargu e kapitull pas kapitulli Shkrimet e Shenjta. Kështu, puna vazhdoi duke e shfaqur vullnetin e Perëndisë si ar i kulluar. Vetëm ata që ishin marrë me atë punë, e dinin se ari ishte akoma më rrezatues, më i kulluar e më i qartë falë provave që kishte kaluar. Engjëjt e qiellit fluturonin përreth këtyre shërbëtorëve besnikë.

Satani i kishte nxitur priftërinjtë dhe prelatët romakë që ta varrosnin fjalën e së vërtetës nën plehrat e gabimit, herezisë dhe supersticionit; por ajo kishte mbetur mrekullisht e pacënuar përmes shekujve të gjatë të errësirës. Nuk mbante vulën e njeriut por gjurmën e Perëndisë. Njerëzit nuk kanë rreshtur së nxiri kuptimin e qartë dhe të thjeshtë të Shkrimeve të Shenjta duke i bërë ato të bien ndesh me vetveten; por të ngjashme me varkën që lundronte mbi valët e tërbuara, fjala e Perëndisë mundi t'i sfidojë furtunat që e kërcënonin me shkatërrim. Ashtu si minierat mbajnë të fshehura në brendësi të tyre damarë ari dhe argjendi, për gjetjen e të cilëve duhet gërrmuar thellë, ashtu edhe Shkrimet e Shenjta për,bajnë në vetvete thesaret e së vërtetës që i zbulohen vetëm atij që i kërkon me zell, me dëshirë e me

lutje. Perëndia e skicoi Biblën si libër - model për mbarë njerëzimin në fëmijëri, rini e burrëri vepër studimi në shekuj. Ai ia dha Fjalën njeriut që të zbulonte në të Vetveten. Zbulimi i çdo të vërtete të re është një shprehje e re e karakterit të Autorit të saj.Studimi i Shkrimeve të Shenjta është një plan hyjnor për ta afruar njeriun me Krijuesin e tij e për ta qartësuar vullnetin e Tij përpara syve njerëzor. Eshtë mënyra e komunikimit mes njeriut dhe Perëndisë.

Valdezët megjithëse e quanin respektin ndaj Perëndisë si fillimin e mençurisë, ata e dinin mirë se edhe kontakti me botën, dijet mbi njerëzit dhe jetën e tyre aktive luanin një rol të rëndësishëm në zgjerimin e ideve dhe në zhvillimin e aftësive të të ekzistuarit. Nga shkollat e malit, të rinjtë dërgoheshin ne institucionet arsimore të Francës e Italisë, ku përpara tyre hapej një fushë e re studimi, mendimi dhe vëzhgimi, shumë më e gjerë se ajo e Alpeve të tyre. Të rinjtë i dilnin kështu përpara tundimeve, dëshmonin të metat e shoqërisë dhe ballafaqoheshin me agjentët më të aftë të Satanit, që i nxisnin ata drejt herezive më të ulëta e mashtrimeve më të rrezikshme. Por edukata, me të cilën ishin brumosur që në fëmijëri, ishte e një natyre të tillë që i aftësonte ata t'i bënin ballë gjithçkaje.

Në shkollat ku shkuan, ata nuk mund t'i besonin askujt. Veshjet e tyre ishin qepur në mënyrë të tillë, që të fshihnin brenda tyre thesaret më të çmuara - dorëshkrimet e Biblës. Këto fryte muajsh dhe vitesh pune ata i mbanin me vete dhe u flisnin, sa herë që mund të vepronin kështu pa ngjallur dyshim, të gjithë atyre që dukeshin të gatshëm për t'ia hapur zemrën së vërtetës. Të rinjve valdezë u ishte besuar ky mision që kur ishin në prehër të nënës; ata e kuptuan mirë detyrën e tyre dhe e përmbushën atë me besnikëri. Nga këto qëndra arsimimi dolën shumë të Krishterë të vërtetë e shpesh parimet e besimit Biblik depërtonin në mbarë shkollën, por udhëheqësit romakë nuk mundën kurrë, edhe pse gjurmuan me kujdes, ta zbulonin të ashtuquajturin "burim here- zie."

Fryma e Krishtit është frymë misioni. Hovi i parë i një zemre të rinovuar është ai i prezantimit të të tjerëve me Shpëtimtarin. Kjo ishte fryma që karakterizonte të Krishterët valdezë. Ata e ndjenin se perëndia kërkonte prej tyre më shumë se thjesht ruajtje të së vërtetës së pacënuar në kishat e tyre. Ata ndjenin se mbanin mbi supe përgjegjsinë për t'u falur dritë të gjithë atyre që ishin në errësirë; ata u përpoqën, me ndihmën e Fuqisë së Perëndisë, t'i thyenin prangat e robërisë romake. Pastorët valdezë përgatiteshin fillimisht si misionarë; secilit i kërkohej që të fitonte, para së gjithash, një përvojë të mjaftueshme evangjelistike. Çdo kandidat duhet të shërbente 3 vjet në një kamp misionar, përpara se të fillonte drejtimin e një kishe lokale. Një shërbim i tillë, që kërkonte vetmohim dhe vetësakrifikim, ishte një parantezë e përshtashme për jetën e një pastori, gjatë një periudhe të tillë vështirësish të mëdha. Të rinjtë që i hynin kësaj rruge të vështirë, nuk prisnin një të ardhme fitimesh apo lavdish tokësore, por një jetë të vështirë e të mundimshme që ndoshta do të

përfundonte në martirizim. Misionarët punonin dy e nga dy, ashtu siç i nisi edhe Jezusi dishepujt e Tij. Çdo i ri shoqërohej nga një burrë i pjekur e me përvojë, për ta udhëhequr e këshilluar të parin, përgjegjësia për përparimin e të cilit binte mbi supet e të dytit fjala e të cilit duhej respektuar. Këta bashkëpunëtorë nuk qëndronin gjithmonë bashkë, por takoheshin shpesh herë për t'u lutur, për t'u këshilluar e për ta inkurajuar njëri - tjetrin përgjatë rugës së besimit.

Zbulimi i qëllimit të tyre mund të thoshte shpartallim të sigurt; prandaj ata e fshihnin me kujdes karakterin e vërtetë të punës së tyre. Çdo misionar njihte një zanat apo ushtronte një profesion të dytë dhe e vazhdonte punën e tij nën maskën e një veprimtarie me karakter sekular. Zakonisht, ata zgjidhnin atë të tregtarit shëtitës. "Mbanin me vete mëndafsh, bizhuteri dhe artikuj të tjerë që ish-te e vështirë t'i gjeje në atë periudhë problematike. Ata prite-shin mirë si tregtarë në ato vende ku nuk do t'i kishin afruar si misionarë." - Wylie, libri 1, k 7. Gjatë gjithë kohës zemrat e tyre komunikonin me Perëndinë e Ai u jepte mençurinë që ata "të shëtisnin" thesare më të çmuara se ari dhe bizhuteritë. Ata mbanin fshehurazi kopje të plota apo të pjesshme të iblës; e me t'iu dhënë rasti ata e tërhiqnin vëmendjen e myshterive tek dorë-shkrimet. Shpesh në zemrën e dikujt zgjohej dëshira për ta lexuar fjalën e Perëndisë dhe në raste të tilla ata i falnin me gëzim kopjet e dorëshkrimeve të Biblës.

Puna e këtyre mosionarëve filloi në fushat e lëndinat pranë ma-leve ku jetonin, por me kalimin e kohës u shtri përtej këtyre ku-fijve. Ata depërtuan në qytete të mëdha e udhëtuan në vende të largëta si Mësuesi i tyre dikur, me këmbë të zbathura e rroba të shqyera. Hodhën kudo farën e çmuar. Në rrugën e tyre u ngritën kisha dhe gjaku i martirëve vulosi të vërtetën. Dita e madhe e Zotit do të nxjerrë në pah një korrje të mbarë shpirtrash mble-dhur falë punës së këtyre shërbëtorëve besnikë. Fjala e Perëndisë po hapte qetësisht e fshehtësisht një rrugë të re mes Kristianiz-mit që përfundonte në shtëpitë dhe zemrat e njerëzve.

Për valdezët Shkrimet e Shenjta nuk ishin thjesht shënime mbi marrëdhëniet e Perëndisë me njerëzit apo një zbulim i përgje-gjësive dhe detyrave të kohës, por edhe një parashtrim i rrezi-qeve dhe lavdisë të së ardhmes. Ata besonin se fundi i gjithçkaje ishte i afërt e ndërsa e studionin Biblën me lutje e lot në sy, ata mrekulloheshin nga madhështia e thënieve të saj dhe nga nderi që u ishte besuar, për t'ua zbuluar të tjerëve këto të vërteta që mbartnin shpëtim. Në faqet e shenjta skicohej qartë plani i shpëtimit dhe ata gjetën ngushëllim, shpresë dhe paqe tek besimi ndaj Jezusit. Meqënëse drita ua ndriçoi mendjet e ua gëzoi zem-rat, Ata dëshironin me gjithë zemër që rrezet e saj të depërtonin mes errësirës romake deri tek ata që kishin humbur në të.

Ata shihnin se si një numër i madh njerëzish nën udhëheqjen e pa-pës dhe priftërinjve, përpiqeshin më kot që të fitonin falje në-përmjet mundimeve të trupit

për të larë mëkatet e shpirtit. Atyre u ishte thënë që t'u besonin veprave të mira se ato sjellin shpë-tim, prandaj ata e përqëndronin vëmendjen tek vetja e tyre duke menduar për gjendjen e mjeruar në të cilën ndodheshin, dhe për zemërimin e Perëndisë, e as mundimet fizike, e as mundimet shpir-tërore nuk u sillnin paqe. Në këtë mënyrë, shumë njerëz të ndër-gjegjshëm e gjenin veten në rrjetën e doktrinave të Romës. Me mi-jëra njerëz i braktisën miqtë dhe të afërmit e tyre dhe u mbyllën nëpër manastire, ku kaluan një jetë të tërë. Me mijëra të tjerë u përpoqën ta qetësonin ndërgjegjen e tyre me anë të agjërimeve të shpeshta, trishtimeve të rënda, qëndrimeve me orë të zgjatura zbathur në ftohtësinë e natës, shtegtimeve të shumta, akteve fy-ese të pendimit e torturave çnjerëzore. Të shtypur nga një ndje-një e tillë mëkati e të pushtuar nga frika e zemërimit hakmarrës të Perëndisë, shumë prej tyre vuanin kështu për një kohë të gjatë derisa i linin forcat e përfundonin në errësirën e varrit pa ma-rrë me vete asnjë rreze drite apo shprese.

Valdezët dëshironin t'u jepnin bukë këtyre shpirtrave të uritur, t'u ofronin atyre premtimet e Perëndisë si mesazhe paqeje e t'u tregonin për Krishtin që ishte shpresa e tyre e vetme e shpëti-mit. Ata deklaruan se doktrina e veprave të mira si shlyerje të shkeljeve të ligjit të Perëndisë ishte një gënjeshtër kokë e këm-bë. Të mbështetësh në vlerën e meritave e mertave njerëzore do të thotë të hedhësh baltë mbi dashurinë e pafund të Krishtit. Jezusi vdiq si flijim për njeriun sepse raca mëkatare nuk mund të bëjë asgjë për t'u pajtuar me forcat e veta me Perëndinë. Me-ritat e një Shpëtimtari të kryqëzuar e të ringjallur janë theme-let e besimit Kristian. Varësia e shpirtit ndaj Krishtit është aq e vërtetë dhe lidhja e njeriut me të aq e ngushtë sa ajo e një gjymtyre me trupin apo e një sythi me hardhinë.

Mësimet e papës e të priftërinjve i kishin bërë njerëzit ta ski-conin karakterin e Perëndisë e të Krishtit si të ashpër, të ftoh-të e të pamëshirshëm. Shpëtimtari paraqitej si i zhveshur tërë-sisht nga ndjenja e simpatisë dhe keq ardhjes për njeriun mëkatar saqë pa ndërmjetësimin e priftërinjve dhe shenjtorëve nuk mund të arrihej asgjë. Ata, mendjet e të cilëve ishin ndriçuar nga fjala e Perëndisë, mezi pritnin t'i drejtonin këta shpirtra të humbur tek Shpëtimtari i tyre i dhemshur e i dashur që i priste me krahë hapur e që i ftonte të vinin tek Ai me gjithë barrën e mëkatit, shqetësimeve dhe lodhjes. Ata mezi pritnin t'i sheshonin barrierat që kishte ngritur Satani përpara syve të njerëzve që ata të mos i shihnin premtimet e të mos i drejtoheshin vetë Atij duke ia rrëfyer mëkatet dhe duke marrë falje e paqe prej Tij.

Misionari Valdez ua zbuloi këto të vërteta të paçmuara të Ungji-llit mendjeve të etura njerëzore. Shpesh ai përdorte pjesë të Shkrimeve të Shenjta. Gëzimi i tij më i madh ishte shpresa që i ofronte shpirtit të turbulluar e të çorientuar që shihte përpara syve të mendjes vetëm një Zot hakmarrës e të zellshëm për të ush-truar drejtësi. Me buzë të dridhura e me lot në sy, i ulur në gjunjë, ai i fliste vëllait të tij mbi premtimet e çmuara që për-bëjnë shpresën e vetme të mëkatarit. Kështu, drita

e së vërtetës depërtoi në shumë mendje të errëta duke i larguar prej tyre retë e trishtimit derisa Dielli i Drejtësisë, me rrezet e tij shëru-ese, e ngrohte zemrën. Shpesh ndodhte që disa pjesë të caktuara të Shkrimit të Shenjtë lexoheshin e rilexoheshin sepse dëgjuesi dukej sikur donte të sigurohej plotësisht që veshët nuk e kishin tradhëtuar. Në mënyrë të veçantë përsëriteshin tekste si: "Gjaku i Jezu Krishtit, Birit të Tij, na pastron nga çdo mëkat." - 1 Gjonit 1:7. "Ashtu si Moisiu e ngriti lart gjarprin në shkretë-tirë, kështu duhet të ngrihet lart Biri i njeriut, që kushdo që beson në Të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme." - Gjoni 3:14,15.

Shumë njerëz filluan të mos bien më në grackën e gabimeve të Ro-mës. Ata e kuptuan që ndërmjetsimi i njerëzve apo engjëjve në do-bi të mëkatarit është i kotë. Ndërsa drita e vërtetë filloi të lindi brenda zemrave të tyre, ata thërritën me gëzim: "Krishti është prifti ynë; gjaku i Tij është flija jonë; rrëfimi ynë i takon altarit të Tij." Ata iu dorëzuan plotësisht meritave të Jezusit, duke përsëritur fjalët: "Pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij." - Hebrenjtë 11:6. "Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhë-në njerëzve dhe me anë të së cilit duhet të shpëtohemi." - Vep-rat e Apostujve 4:12.

Për disa nga këto shpirtra të tronditura prej furtunës, ishte pak e vështirë të kuptohej dashuria e pakufishme e Shpëtimtarit. Leh-tësimi që u sillte kjo siguri ishte kaq i madh dhe drita e saj kaq verbuese, saqë u dukej sikur ndodheshin në qiell. Duart e ty-re ishin kapur fort pas dorës së Krishtit, këmbët e tyre ishin vendosur mbi Shkëmbin e Kohërave. Frika e vdekjes ishte zhdukur dhe ata ishin gati t'i bënin ballë burgut dhe turrës së druve, në qoftë se një gjë e tillë do t'i jepte lavdi emrit të Shpëtim-tarit të tyre.

Në vende të fshehta, fjala e Perëndisë i lexohej qoftë një njeriu të vetëm, qoftë një grupi të vogël njerëzish që po kërkonin dritë dhe liri. Shpesh, netë të tëra kaloheshin në një mënyrë të tillë. Çudia dhe admirimi i dëgjuesve shpesh ishte kaq i madh sa ata e ndërprisnin lajmëtarin e të vërtetës për t'i dhënë mundësi e kohë mendjes për ta kuptuar lajmin e mirë të shpëtimit. Shpesh dëgjo-heshin pyetje të tilla: "Me të vërtetë do ta pranojë Zoti ofertën time? A do të më buzëqeshi vallë? A thua të më falë mua?" Më pas u lexohej kjo përgjigje: "Ejani tek unë, o ju të gjithë të mun-duar e të rënduar, dhe unë do t'ju jap çlodhje." -Mateu 11:28.

Besimi e përqafonte premtimin dhe dëgjohej përgjigja e gëzuar: "S'ka më shtegtime të gjata; mjaft më me relika; unë mund të shkoj tek Jezusi kështu siç jam: mëkatar e i papastër dhe Ai nuk do ta mbylli veshin përpara lutjes së një të penduari: "Mëkatet të janë falur. Të miat, edhe të miat mund të falen!"

Zemra mbushej me gëzim dhe himnet e këngët e lëvdimit e ngrinin lart emrin e shenjtë të Jezusit. Këta njerëz të lumtur ktheheshin në vendet e tyre për ta përhapur dritën e për t'u folur të tje-rëve për përvojën e tyre të re; për t'u thënë se e kishin gjetur Rrugën e vërtetë. Fjalët e Shkrimeve të Shenjta, me të hyrë në zemrat e atyre

që kaq shumë e donin të vërtetën, merrnin një fuqi të re e solemne. Ishte zëri i Perëndisë që i binte ata që ia vi-nin veshin.

Lajmëtari i së vërtetës vazhdonte rrugën e tij; por butësia, sinqeriteti, zelli dhe vullneti i tij nuk kalonin pa u vënë re. Në shumicën e rasteve dëgjuesit nuk e pyesnin nga vinte e ku shkonte. Ata fillimisht ishin çuditur kaq shumë e më pas gëzuar kaq shumë, sa nuk kishin pasur kohë t'i bënin pyetje, por kur e kishin ftuar në shtëpitë e tyre, ai kishte thënë se do shkonte në kërkim të deleve të humbura. A mos vallë ishte një engjëll i dërguar nga qielli? - pyesnin ata.

Në shumë raste, lajmëtari i së vërtetës nuk dukej më. Ndoshta kishte shkuar në vende të tjera, ndoshta po i shtynte ditët në një çeli të errët apo ndoshta kockat e tij preheshin pikërisht aty ku kishte dëshmuar për të vërtetën. Por fjalët e tij nuk mund të veniteshin. Ato punonin brenda zemrave të njerëzve; frytet e tyre do të vihen re vetëm në ditën e gjykimit.

Misionarët valdezë po cënonin mbretërinë e Satanit dhe fuqitë e errësirës e mprehën vigjilencën. Princi i së keqes vëzhgonte çdo përpjekje për ta çuar përpara të vërtetën dhe ngjallte frikë në zemrat e agjentëve të tij. Udhëheqësit romakë shihnin në veprim-tarinë e këtyre njerëzve një rrezik serioz për çështjen e tyre. Në qoftë se drita e së vërtetës do të ndriçonte pa u penguar, ajo do t'i kishte shpërndarë retë e dendura të gabimit që u qëndronin mbi koka njerëzve do t'i kishte përqëndruar mendjet e tyre tek Perëndia duke e shkatërruar plotësisht epërsinë e Romës.

Vetë ekzistenca e këtyre njerëzve, që e ruanin të pastër besimin e kishës apostolike, ishte një dëshmi e vazhdueshme kundër apos-tazisë romake dhe si rrjedhim nxiste urrejtje dhe persekutim. Fakti që ata nuk pranonin t'i braktisnin Shkrimet e Shenjta ishte në vetvete një ofendim i pushtetit të tij që papati nuk mund ta duronte. Ai vendosi t'i zhdukte ata nga faqja e dheut. Kështu, filluan kryqëzatat më të tmershme kundër popullit të Perëndisë në shtëpitë e tyre nëpër male. Inkuizitorët ranë në gjurmët e tyre dhe skena e të pafajshmit Abel që ra pre e Kainit u përsërit me qindra herë.

Herë pas here tokat e tyre pjellore u shkretuan dhe shtëpitë dhe kishat e tyre u rrafshuan. Aty ku njëherë e njëkohë lulëzonin fushat dhe banesat e njerëzve të pafajshëm e punëtorë, nuk mbeti gjë tjetër veçse rrënojave. Ashtu si bisha e egër që tërbohet më shumë nga era e gjakut, ashtu edhe tërbimi i persekutorëve arriti kulmin nga vuajtjet e viktimave të tyre. Shumë nga këta dëshmi-tarë të besimit të kulluar ndiqeshin hap pas hapi nga malet, për-gjatë luginave dhe detyroheshin të fshiheshin në pyje të dendur.

Karakteri moral i këtij grupi njerëzish ishte i pastër. Madje edhe armiqtë e tyre e pranonin se ata ishin të qetë, të zellshëm e paqedashës. "Mëkati" i tyre i madh ishte se ata nuk dëshi-ronin ta adhuronin Perëndinë sipas vullnetit të papës. Për këtë "krim" ata mbajtën mbi supe të gjitha egërsitë, fyerjet dhe torturat e shpikura nga njerëzit apo demonët.

Kur Roma vendosi ta zhdukte nga rrënjët "sektin e urryer" papa nxorri një dekret ku i cilësonte ata si heretikë dhe i dënonte me vdekje. Valdezët nuk akuzoheshin për pandershmëri apo për shthurje; por thuhej që me pamjen e tyre të mëshirshme e të paq-shme, ata po mashtronin "delet e tufës së vërtetë." Për këtë arsye, papa urdhëroi që "ky sekt i urryer keqbërësish" në qoftë se nuk "pranonin të dorëzoheshin, të shtypeshin si gjarpërinj helmuesë." - Wylie, libri 6, kap. 1. A mendonte ky personazh mendjemadh se një ditë do të ballafaqohej me fjalët e tij? Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi të vegjël, - tha Jezusi, - këtë ma bëtë mua. - Mateu 25: 40.

Dekreti u bënte thirrje gjithë anëtarëve të kishës që të bashko-heshin në kryqëzatë kundër heretikë. Si nxitje për të marrë pjesë në këtë akt mizor ai (dekreti) "i shkarkonte nga çdo dënim kish-tar: të përgjithshëm apo të veçantë dhe i çlironte nga përgjegj-sia e çdo betimi të bërë të gjithë ata që do të bashkoheshin me kryqëzatën; u jepte të drejtën e çdo pronësie të paligjshme dhe u premtonte faljen e të gjitha mëkateve atyre që do të vrisnin qoftë edhe një prej këtyre heretikëve. Anullonte çdo kontratë të lidhur me Valdezët, urdhëronte të afërmit e tyre që t'i braktis-nin, ndalonte dhënien e çfarëdo lloj ndihme atyre dhe i nxiste të tjerët t'i shtinin në dorë pronat e tyre." - Wylie, libri 16, kap. 1. Ky dokument tregon qartë se çfarë dore fshihej prapa ske-nave. Nga prapa dëgjohet ulërima e dragoit dhe jo zëri i Krish-tit.

Udhëheqësit e papatit nuk donin ta ndryshonin karakterin e tyre sipas ligjit të Perëndisë, por "krijuan" një standart që t'u shkonte për shtat atyre dhe vendosën t'i detyrojnë të gjithë të tjerët të ndryshonin sipas tij se ky ishte vullneti i Romës. Si rrjedhim ndodhën tragjeditë më të mëdha. Priftërinjtë dhe papët e korruptuar dhe blasfemuesë po kryenin punën që ua kishte besuar Satani. Natyra e tyre mëkatare nuk mund ta pranonte mëshirën. E njëjta frymë që kryqëzoi Krishtin dhe theri apostujt, që nxiti Neron e etur për gjak kundër besimtarëve të kohës së tij, po vepronte përsëri për t'i zhdukur nga faqja e dheut të dashurit e Pe-rëndisë.

Për shekuj me rradhë, persekutimi nëri kërdinë në rradhët e popu-llit besnik të Perëndisë, që e përballoi atë me një durim dhe qëndrueshmëri që e nderonte Shpëtimtarin e tyre. Pa marrë para-sysh kryqëzatat dhe masakrat çnjerëzore që kishin si qëllim zhdu-kjen e tyre, Valdezët vazhduan të dërgojnë misionarë për ta për-hapur të vërtetën e çmuar. Ata ndiqeshin hap pas hapi e shumë humbën jetën; por gjaku i tyre vaditi farën e hedhur e ajo s'pu-shoi së dhëni fryta. Kështu, Valdezët ngritën lartë pishtarët e së vërtetës së Perëndisë shekuj përpara lindjes së Luterit. Të shpërndarë në të katër anët, ata mbollën farën e Reformacionit që filloi në kohën e Wycliff- it, u zhvillua dhe u përhap në ko-hën e Luterit ndihmën e atyre që janë gati të durojnë gjithçka për "fjalën e Perëndisë e për dëshminë e Jezu Krishtit." - Zbulesa 1:9.

1. Disa grupe të hershme të Krishtera e mbanin Sabatin e ditës së shtatë. Përse Sabati ka qenë një shenjë kaq e rëndësishme për kishën e vërtetë gjatë epokave?

2. Ne i admirojmë vlerat e trashëguara brez pas brezi nga Valdezët. Si mund të ndërtojmë ne të njejtat vlera tek fëmijët tanë në kulturën e sotme?

3. Valdezët u përballën me vështirësi të mëdha në sigurimin dhe ndarjen e Fjalës. Konsideroni se si lehtësia e aksesit ndaj Biblës na ka bërë ne sot ta marrim atë si për të mirëqenë.

4. Çfarë i motivoj misionarët Valdezë që të shkonin nëpër botë me pasion dhe përkushtim të thellë?

5.

John Wycliffe

Përpara Reformacionit, pati periudha gjatë të cilave numri i kopjeve të Biblës ishte shumë i pakët, por Perëndia nuk lejoi zhdukjen e plotë të fjalës së Tij. Të vërtetat e saj nuk do të mbeteshin të fshehura përgjithmonë. Ai mund të shkatërronte zinxhirët që e qarkonin fjalën e tij me po atë lehtësi që mund të hapte dyert e burgjeve dhe kangjellat e hekurta që mbanin të burgosur shërbëtorët e tij. Në vende të ndryshme të Evropës, Fryma e Shenjtë nxiti shumë njerëz që ta kërkonin të vërtetën, si të ishte një thesar i fshehur. Të udhëhequr drejt Shkrimeve të Shenjta, ata filluan t'i studionin ato varg pas vargu me një interes të madh. Ata ishin gati ta pranonin dritën pa marrë parasysh rrjedhimet e saj. Megjithëse nuk e kuptuan gjithçka plotësisht, atyre iu dha mundësia që të zbulonin të vërteta, të varrosura prej kohësh. Si lajmëtarë nga qielli ata shkonin nga vendi në vend, duke thyer prangat e gabimeve dhe supersticioneve dhe duke u bërë thirrje të gjithë të skllavëruarve që të ngriheshin në këmbë e të fitonin lirinë.

Me përjashtim të versionit në gjuhën e Valdezëve, fjala e Perëndisë ishte kufizuar për shekuj me rradhë vetëm në gjuhët më të njohura të botës, por kishte ardhur koha që Shkrimet e Shenjta të përktheheshin e t'u flisnin njerëzve të kombeve të ndryshme në gjuhën e tyre amëtare. Bota e kishte lënë pas mesnatën. Orët e natës po kalonin e në shumë vende po shfaqeshin shejat e para të agimit.

Në Angli, në shekullin e XIV, ndriçoi "Ylli i mëngjesit të Reformacionit." John Wycliffe ishte lajmëtari i reformës jo vetëm në Angli, por në mbarë vendet e Krishtera. Protesta e madhe kundër Romës, që iu besua atij, nuk mundi të shuhej më. Ajo protestë shërbeu si shkëndijë e luftës që rezultoi në emancipimin e individëve, kishave dhe kombeve.

Wycliffe mori një edukim të shëndoshë dhe respekti ndaj Perëndisë ishte pikënisja e aftësive të tij. Në kolegj u shqua për mëshirën e tij të flaktë, si dhe për talentet e tij të shumëanëshme. Duke qënë i etur për dije, ai u përpoq që të njihej me

çdo fushë arsimimi. Ai studjoi në mënyrë të veçantë filozofinë skolastike, normat kishëtare dhe ligjet civile, veçanërisht të vendit të tij. Në punët e tij të mëvonshme, ai u ndikua mjaft nga arsimimi i tij. Një njohje e thellë e filozofisë spekulative të kohës së tij, i dha atij mundësi të nxirrte në pah gabimet e saj; dhe falë studimit të ligjeve kombëtare e kishëtare, ai qe në gjendje që të udhëhiqte betejën e madhe për liri fetare e civile. Ai, jo vetëm që dinte t'i përdorte mirë armët që i ofronte Fjala e Perëndisë, por e njihte edhe disiplinën intelektuale të institucioneve arsimore dhe i kuptonte mirë taktikat që përdornin "të arsimuarit". Si miqtë, edhe armiqtë e tij e respektonin për fuqinë e gjenialitetit dhe tërësinë e njohurive të tij. Përkrahësit e tij vunë re me kënaqësi që kampioni i tyre shquhej mes mendjeve të ndritura të kombit, armiqtë e tij nuk mund ta përçmonin reformën duke hedhur baltë - siç ndodh zakonisht - mbi padijen dhe dobësitë e udhëheqësit të saj.

Edhe pse nxënës në bankat e shkollës, ai filloi studimin e Shkrimeve të Shenjta. Gjatë asaj kohe, kur Bibla ekzistonte vetëm në gjuhët e vjetra, vetëm të arsimuarit mund të shkonin tek burimi i së vërtetës; rruga drejt të cilit ishte e mbyllur për të padituri. Po përgatitej kështu shtegu i punës së ardhme të Wycliffit si reformator. Njerëz të ditur, duke e studjuar fjalën e Perëndisë, kishin zbuluar në të të vërtetën e hirit të Tij falas. Ata e kishin përhapur nëpërmjet mësimeve të tyre, këtë të vërtetë të madhe dhe i kishin udhëhequr të tjerët drejt Shkrimeve të Shenjta.

Kur vëmendja e tij u përqëndrua tek Shkrimet e Shenjta, Wycliffi filloi t'i shqyrtjë ato me të njëjtin zell që kishte përdorur gjatë studimit të lëndëve të ndryshme shkollore. Deri në atë kohë, ai ndjente një boshllëk të madh që nuk mund t'ia mbushnin as studimet personale e as mësimet e Kishës. Ai gjeti në fjalën e Perëndisë atë që e kishte kërkuar më kot për vite me rradhë.

Aty, ai vuri re planin e shpëtimit dhe kuptoi se Krishti është avokati i vetëm mbrojtës i njeriut. Ai iu përkushtua shërbimit ndaj Krishtit, i vendosur për të shpallur të vërtetat që zbuloi.

Ashtu si Reformatorët e tjerë pas tij, Wycliffi, në fillim të punës së tij, nuk arriti ta parashikonte se ku do ta çonte ajo. Ai, fillimisht, nuk e kundërshtoi me ndërgjegje Romën; por përkushtimi ndaj së vërtetës detyrimisht, e çoi atë në mosmarrëveshje me gënjeshtrën. Sa më qartë dilnin në pah gabimet e papatit, aq më me zell zbulonte ai mësimet e Biblës. Ai vuri re se Roma e kishte hedhur poshtë fjalën e perëndisë, për të lartësuar traditat njerëzore; ai e akuzoi klerin për këtë braktisje të Shkrimeve të Shenjta e kërkoi me vendosmëri që Bibla t'u jepej njerëzve e që autoriteti i saj të risundonte në kishë. Ai ishte një mësues i aftë e i zellshëm, një predikues elokuent dhe i vinte në jetë të vërtetat që u shpallte të tjerëve. Ai fitoi besimin dhe simpatinë e të tjerëve falë njohurive të tij mbi Shkrimet e Shenjta, arsyetimit të tij të mprehtë, pastërtisë së jetës dhe guximit e ndershmërisë së panjollosur. Shumë njerëz ishin të pakënaqur nga besimi i tyre i mëparshëm sepse vunë re se në Kishën

e Romës mbizotëronte padrejtësia dhe i përqafuan me gëzim të vërtetat që nxorri në dritë Wycliff, por udhëheqësit e papatit u tërbuan kur kuptuan se ky Reformator po siguronte një autoritet më të madh se ata vetë.

Wycliffi kishte aftësinë që t'i shquante gabimet dhe i sulmoi pa frikë shumë nga abuzimet e "shenjtëruara" nga autoriteti romak. Kur ishte kapelan i mbretit ai kundërshtoi pagesën e detyrimeve që i kërkonte papa monarkut anglez dhe theksoi se i ashtuquajturi autoritet i papatit mbi sundimtarët sekular binte ndesh si me arsyen njerëzore, ashtu edhe me zbulesën hyjnore. Kërkesat e papës kishin nxitur një zemërim të madh dhe mësimet e Wycliffit ushtronin një ndikim të madh mbi përfaqësuesit e kombit anglez. Mbreti dhe fisnikët nuk pranuan të paguanin detyrimet dhe e hodhën poshtë pretendimin e papës për një autoritet të përkohshëm. Kështu, zgjedha romake në Angli pësoi një goditje të rëndë.

Reformatori luftoi për një kohë të gjatë edhe kundër një të keqe tjetër të madhe; kundër urdhrit të murgjërve të ndërmjetëm. Këta murgjër sikur "e pushtuan" Anglinë, duke i shkaktuar madhështisë dhe përparimit të kombit dëme të mëdha. Industria, arsimi dhe vlerat morale ranë nën ndikimin e tyre të rrezikshëm. Jeta prej lypësi e dembeli e murgjërve, jo vetëm që rëndonte mbi shpatullat e popullit, por edhe ia ulte vlerat punës së ndershme. Të rinjtë u demoralizuan e u korruptuan. Për shkak të shembullit të murgjërve, shumë të rinj zgjodhën jetën e manastireve dhe e bënë këtë gjë, jo vetëm pa miratimin e prindërve, por edhe pa dijeninë e tyre, duke mos i marrë aspak parasysh porositë e tyre. Një nga etërit e parë të Kishës së Romës, duke theksuar se jeta e manastireve ishte më e rëndësishme se dashuria dhe detyrat birnore, tha: "Edhe në qoftë se babai do të shtrihet përpara portës duke qarë e vajtuar; edhe në qoftë se nëna jote do të tregonte trupin që të solli në jetë dhe gjirin që të ushqeu, shkeli me këmbë e kalo mbi trupin e tyre duke ecur përpara drejt Krishtit." Nëpërmjet kësaj "tiranie çnjerëzore" - siç e quajti më pas Luteri, - "ku shfaqej më shumë ujku e tirani, se njeriu apo i Krishteri," fëmijët u nxitën kundër prindërve. -Barnas Sears "The Life of Luther", fq.70,69. Kështu, udhëheqësit e papatit, si Farisenjtë e dikurshëm, me anë të traditave të tyre e anulluan këtë urdhëresë të Perëndisë.(urdhëresa e pestë). Vatrat familjare u shkretuan dhe prindërit humbën përgjithmonë fëmijët e tyre.

Edhe studentët u mashtruan nga deklaratat "e bukura" të murgjërve dhe u bënë pjesë e urdhrave të tyre. Më pas, shumë prej tyre u penduan për një vendim të tillë sepse e vunë re se e kishin shkatërruar me duart e veta jetën e tyre dhe u kishin shkaktuar hidhërim prindërve; por me të rënë në kurth, ishte e pamundur që të çliroheshe prej tij. Shumë prindër, të frikësuar nga ndikimi i murgjërve, nuk pranuan t'i dërgojnë fëmijët në universitet. Në qendrat kryesore të arsimimit, u vu re një rënie e dukshme në numrin e studentëve. Shkollat filluan të mbylleshin dhe padija filloi, dalëngadalë, të mbizotëronte përsëri.

Papa u kishte dhënë këtyre murgjëve të drejtën për të dëgjuar rrëfime dhe për t'i falur "mëkatarët". Kjo u kthye në burim të këqijash të shumta. Murgjit, të dhënë pas fitimeve, ishin të gatshëm t'i falnin të gjithë kriminelët që u drejtoheshin atyre dhe kështu u rrit në masë numri i veseve më të ulëta. Të sëmurët e të varfërit liheshin në mëshirë të fatit, ndërsa dhuratat që mund të shërbenin si ushqim për ta, u shkonin murgjëve, që me anën e kërcënimeve të tyre mblidhnin lëmoshat e popullit dhe nuk ngurronin të akuzonin për pabesi të gjithë ata që nuk "dhuronin" me bujari. Ndërsa nga njëra anë ankoheshin për varfëri, nga ana tjetër pasuria e murgjërve rritej nga dita në ditë dhe zyrat e tryezat e tyre të mrekullueshme e vinin më në pah varfërinë në rritje të kombit. Ndërsa e kalonin kohën në luks e kënaqësi, ata ua "besonin" punën e tyre njerëzve të paditur që dinin të tregonin përralla e legjenda fantastike e të zbavitnin njerëzit duke i kthyer ata plotësisht në skllevër të murgjërve. Kështu, këta të fundit vazhdonin të ushtronin ndikimin e tyre mbi turmat supersticioze, duke i bërë ata të besojnë se detyra fetare përbëhej nga: njohja e sundimit të papës; adhurimi i shenjtorëve dhe dhuratat e murgjërve. Këto ishin të mjaftueshme "për të blerë" një vend në qiell.

Njerëz të ditur e të zotë ishin përpjekur më kot që t'i reformonin këta urdhëra murgjësh; por Wycliffi falë largpamësisë së tij, e goditi të keqen që nga rrënjët duke deklaruar se sistemi vetë ishte i kalbëzuar e duhej shkulur. U zgjuan kështu debate dhe hetime. Njerëzit, duke parë murgjët që silleshin vërdallë duke tundur temjanët e "faljeve të papës", filluan të dyshonin mbi mundësinë e sigurimit të faljes nëpërmjet pagesës dhe të mendonin se ndoshta ishte më mirë që kjo falje t'i kërkohej vetë Perëndisë e jo papës së Romës. Të shumtë ishin ata që i shqetësonte grykësia e murgjërve, etja e të cilëve dukej sikur nuk shuhej kurrë. "Priftërinjtë dhe murgjët e Romës, - thoshin ata, - po na zhdukin si kancer. Zoti na shpëtoftë, ndryshe populli do të shuhet." - D'Aubigne, libri 17, kap 7. Për të maskuar kopracinë e tyre, këta murgjër - lypës pretendonin se po ndiqnin shembllin e Jezusit dhe deklaronin me të madhe se Shpëtimtari dhe dishepujt e Tij e mbanin frymën gjallë nga bamirësia e njerëzve. Kjo gjë e dëmtoi kauzën e tyre, sepse i nxiti shumë njerëz që ta kërkonin të vërtetën në Bibël - një rezultat ky i papëlqyeshëm për Romën. Mendjet e njerëzve u përqëndruan tek Burimi i së vërtetës, që Roma përpiqej ta mbante të fshehur.

Wycliffi filloi të shkruante e të botonte broshura kundër murgjërve, pa dashur sidoqoftë që të hynte në mosmarrëveshje me ta, por që ta tërhiqte vëmendjen e njerëzve tek mësimet e Biblës e tek Autori i saj. Ai deklaroi se as papa dhe as priftërinjtë e tjerë nuk kanë të drejtë të falin apo të shkishërojnë dhe se një njeri mund të shkishërohet vetëm atëherë kur me veprimet e tij ka ngjallur zemërimin e Perëndisë. Kjo ishte mënyra më e suksesshme për të rrëzuar strukturën gjiganteske të kësaj fuqie shpirtërore shekullore ndërtuar nga papa, që kishte shërbyer si kurth shpirtrash dhe trupash për miliona njerëz.

Wycliffi u ngrit përsëri në mbrojtje të të drejtave të fronit britanik kundër ndërhyrjeve të Romës. I emëruar si ambasador i mbretit ai kaloi në Hollandë dy vjet të jetës së tij, nga njëra mbledhje në tjetrën me përfaqësuesit e papës. Këtu iu dha mundësia që të ballafaqohej me klerikë nga Italia, Franca dhe Spanja dhe të shikonte prapa skenave, duke mësuar kështu fakte, që po të kishte qëndruar në Angli, do të mbeteshin të errëta për të. Në të vërtetë, kuptoi shumë gjëra që e ndihmuan në veprimtarinë e tij të mëvonshme. Këta përfaqësues të selisë romake, i zbuluan atij karakterin dhe qëllimet e vërteta të kësaj hierarkie të madhe. Duke u rikthyer në Angli, ai ripërtëriu më me forcë e zell mësimet e tij të mëparshme, duke pohuar se lakmia, krenaria dhe mashtrimi ishin perënditë e Romës.

Duke folur për papën e bashkëpunëtorët e tij, ai shkruan kështu në njërën nga broshurat e tij: "Ata u rrëmbyen të varfërve frytin e djersës së tyre dhe tërhoqën nga thesari mbretëror miliona monedha ari, nën preteksin e riteve fetare e ceremonive shpirtërore; që nuk është asgjë tjetër, veçse një herezi e dënueshme dhe përkrahje e heshtur nga ana e botës së krishterë - e vetë kësaj herezie. Sigurisht, edhe nëqoftë se perandori ynë do të kishte një mal me monedha floriri e askush - me përjashtim të tagrambledhësit fetar - nuk do të mund ta prekte, me kalimin e kohës edhe mali do të ishte sheshuar, sepse ai merr nga ne të holla duke na lënë prapa mallkimet e Perëndisë për këto zhvatje"- John Leurs, "History of life and Sufferings of J.Wycliff." fq37

Me t'u kthyer në Angli, mbreti e caktoi Wycliffin rektor të Lutterworthit. Kjo tregonte se sovrani ishte i kënaqur nga fjalët e tij të hapura. Ndikimi i Wycliffit u vu re jo vetëm në orientimin e besimit të kombit, por edhe në përcaktimin e veprimtarisë qeveritare.

Vetëtimat e papatit nuk vonuan të shpërthenin mbi të. Tre dekrete u përhapën në Angli - e para në universitet, e dyta tek mbreti dhe t treta tek prelatët,- që urdhëronin marrjen e masave të menjëhershme dhe të rrepta për t'ia mbyllur gojën mësuesit heretik.(Augustus Neander, "General History of the Christian Religion and Church", periudha 6, sek 2, pt 1, parag 8). Megjithatë, peshkopët e kishin ulur Wycliffin në bankën e të akuzuarve përpara këtyre dekreteve. Por Wycliffin e shoqëruan dy nga princët më të fuqishëm të mbretërisë dhe turmat e njerëzve, që e kishin rrethuar ndërtesën dhe që hynë edhe brenda saj, i tmerruan kaq shumë gjykatësit sa ata e pezulluan seancën për një farë kohe e ai u kthye shëndoshë e mirë në shtëpi. Më pas, Eduardi i III - të, që prelatët duke përfituar nga mosha e tij e thyer, po përpiqeshin ta nxisnin kundër reformatorit, vdiq dhe vendin e tij mbi fron e zuri një përkrahës i flaktë i Wycliffit.

Por dekretet e papatit, me t'u shpallur në Angli, kërkonin arrestimin dhe burgosjen e këtij heretiku. Masa të tilla paraprinin trekëmbëshin. Dukej sikur herët a vonë Wycliffi do të kthehej në pre të hakmarrjes romake, por Ai që dikur i deklaroi

Abrahamit: "Mos ki frikë... Unë jam mburoja jote." Zanaflla 15:1 i shtriu përsëri duart për ta mbrojtur shërbëtorin e Vet. Vdekja i erdhi jo reformatorit, por papës që kishte vulosur dekretin e shkatërrimit të tij. Gregory XI vdiq dhe kishëtarët e mbledhur për të gjykuar Wycliffin, u shpërndanë.

Mençuria qiellore vazhdoi të udhëhiqte rrjedhën e ngjarjeve që t'i jepte mundësi Reformacionit të përparonte. Vdekja e Gregoryt u pasua nga zgjedha e dy papëve rivalë. Dy fuqi të kundërta, çdo njëra prej të cilave "besonte" se ishte e pagabueshme, bënin thirrje për bindje. Çdo njëra prej tyre i nxiste përkrahësit e saj që ta ndihmonin në luftë kundër tjetrës, duke i përforcuar këto kërkesa me mallkime të tmerrshme drejtuar kundërshtarëve e me premtime shpërblimi qiellor drejtuar besimtarëve. Një konkurencë e tillë e dobësoi dukshëm fuqinë e papatit. Dy fraksionet rivale u morën me njëra - tjetrën për një kohë të gjatë dhe Wycliffi u la i qetë. Mallkimet dhe kundërpaditë kalonin nga njëra papë tek tjetri dhe mbështetja e pretendimeve të tyre absurde u la me lumenj gjaku. Në kishë mbizotëruan krimet dhe skandalet. Ndërkohë Reformatori, në qetësinë dhe sigurinë e kishës së tij të vogël në Lutterworth, punonte me zell që t'i largonte njerëzit nga papët e pakënaqur, për t'i afruar me Jezusin, Princin e Paqes.

Kjo përçarje, me korrupsionin dhe çoroditjen që mbarti me vete, duke i dhënë mundësi njerëzve që të shikonin karakterin e vërtetë të papatit, i hapi rrugën Reformacionit. Në një broshurë me titull "Mbi përçarjen e papëve" Wycliffi u bënte thirrje lexuesve që të kuptonin se papët po thoshin të vërtetën kur e akuzonin njëri- tjetrin si antikrisht. "Zoti, - shkruante ai, -nuk mund të lejonte më që djalli të mbretëronte vetëm brenda një prifti të tillë, por.... e përçau në dy, në mënyrë që njerëzit, në emër të Krishtit, të fitonin ndaj të dyve më me lehtësi." - R.Vauhgan, "Life and Opinions of John de Wycliffe", vëll 2, fq 6.

Wycliffi, si edhe Mësuesi i tij, ua predikonte ungjillin të varfërve. Duke mos u kënaqur vetëm nga përhapja e dritës brenda shtëpive të varfra të famullisë së tij në Lutterworth, por vendosi ta çonte atë në të katër anët e Anglisë. Në mënyrë që ta realizonte një qëllim të tillë, ai organizoi një grup predikuesish - njerëz të thjeshtë e të devotshëm, që donin të vërtetën dhe dëshironin me shpirt që ta përhapnin atë. Këta njerëz shkuan kudo: jepnin mësim në qëndrat e pazareve, në rrugët e gjera të qyteteve të mëdha, por edhe në rrugicat e fshatrave. Vizitonin pleqtë, të sëmurët e të varfërit dhe u shpallnin atyre lajmin e mirë të hirit të Perëndisë.

Studentët e dëgjuan fjalën e Perëndisë nëpër sallat e leksioneve nga profesori i teologjisë Wycliff. Ai ua parashtronte studentëve të vërtetën me kaq besim, saqë ata i dhanë titullin "doktor i ungjillit." Megjithatë, vepra më e madhe e jetës së tij mbetet përkthimi i Shkrimeve të Shenjta në anglisht. Në veprën e tij "On the Truth and Meaning of Scriptures" (Mbi të vërtetën dhe kuptimin e Shkrimit të Shenjtë,) ai shprehu qëllimin që kishte për ta përkthyer Biblën, në mënyrë që çdo njeri të mund t'i lexonte veprat e mrekullueshme të Perëndisë në gjuhën amtare.

Por veprimtaria e tij u ndërpre papritmas. Edhe pse pa i mbushur të gjashtëdhjetat, puna dhe studimi i pandërprerë, si dhe sulmet e vazhdueshme të armiqve të tij, ndikuan negativisht mbi shëndetin e tij dhe ai u sëmur rëndë. Ky lajm i gëzoi shumë murgjët. Ata menduan se tani ai do të pendohej për të keqen që i kishte bërë kishës dhe nxituan në dhomën e tij "të vdekjes" u mblodhën përfaqësues të të katër urdhërave fetarë të shoqëruar nga katër zyrtarë civilë. "Vdekjen e ke tek pragu i derës - i thanë ata - Pendohu për gabimet e tua merri prapsh, në praninë tonë, të gjitha ato që ke thënë kundër nesh." Reformatori dëgjoi në heshtje; pastaj i kërkoi infermieres që ta ndihmonte të rrnte ulur në shtrat dhe duke i parë me ngulm ata që po prisnin pohimin e tij, tha me zë të lartë: "Unë nuk do të vdes, por do të jetoj për të shpallur përsëri veprat e liga të murgjëve!" -D'Aubigne, libri 17, kap 7. Murgjët u larguan nga dhoma me bisht në shalë.

Fjalët e Wycliffit u bënë realitet. Ai jetoi për t'u falur bashkatdhetarëve të tij armën më të fuqishme kundër Romës - për t'u dhënë atyre Biblën që është agjenti qiellor që i çliron, ndriçon dhe inkurajon njerëzit. Deri në përfundimin e kësaj pune, atij iu desh që të kalonte shumë pengesa. Wycliffit i rëndonin mbi supe vite të vështira dhe e dinte se dhe pak i kishte mbetur; ai e dinte se kundërshtimet do ta ndiqnin hap pas hapi, por i inkurajuar nga premtimet e fjalës së Perëndisë, ai i hyri punës me vendosmëri. I pajisur me fuqi të mëdha intelektuale dhe me një përvojë të gjatë, ai ishte përgatitur me kujdes nga Perëndia, për të kryer kryeveprën e tij. Ndërsa botën e Krishterë e kishte përfshirë furtuna, në strehën e tij në Lutterworth, pa e dëgjuar zallamahinë që vinte nga jashtë, ai iu përkushtua kësaj detyre të veçantë.

Më së fundi puna u krye - përkthimi i parë i Biblës në anglisht. Fjala e Perëndisë mori jetë në sytë e anglezëve. Tashmë Reformatori nuk i trembej as burgut dhe as trekëmbëshit sepse kishte vënë në duart e një kombi dritën që nuk do të mund të shuhej kurrë. Duke u dhuruar Biblën bashkëatdhetarëve të tij, ai kishte bërë më shumë për të thyer prangat e padijes dhe gabimit, më shumë për të çliruar e përparuar vendin e tij se nga fitoret e arritura në fushat e betejave.

Në atë kohë shtypshkronja nuk ishte shpikur akoma dhe kopjet e Biblës mund të shumëfishoheshin vetëm nëpërmjet një pune të ngadalshme e të lodhshme. Interesimi për këtë libër ishte kaq i madh, sa shumë njerëz i hynë vullnetarisht punës për ta kopjuar atë, por ata e kishin të vështirë t'u përgjigjeshin kërkesave gjithnjë në rritje. Blerësit më të pasur kërkonin një kopje të plotë të Biblës. Të tjerët blinin kopje të pjesëshme. Në shumë raste, bashkoheshin dy - tre familje për të blerë një kopje. Kështu, Bibla e Wycliffit shumë shpejt, u përhap në shtëpitë angleze.

Thirrja që iu drejtua arsyes njerëzore, i zgjoi ata nga nënshtrimi pasiv ndaj dogmave të papatit. Kështu, Wycliffi parashtroi doktrinat themelore të Protestanizmit - shpëtimi nëpërmjet besimit tek Krishti dhe pagabueshmërinë e Shkrimeve

të Shenjta. Predikuesit - bashkëpunëtorë të tij e shpërndanë Biblën së bashku me shkrimet e Reformatorit. Puna e tyre pati një sukses të tillë të madh saqë besimi i ri u pranua nga pothuajse gjysma e popullsisë angleze.

Shfaqja në skenë e Shkrimeve të Shenjta i shqetësoi autoritetet kishëtare. Tani, atyre u duhej të ballafaqoheshin me një forcë shumë më të madhe se Wycliffi - një forcë që do t'ua shkatërronte përfundimisht armët. Gjatë asaj kohe në Angli, nuk ekzistonte asnjë ligj që ta ndalonte Biblën sepse ajo nuk ishte botuar asnjëherë në gjuhën amtare. Ligje të tilla u fuqizuan dhe u miratuan më pas. Ndërkohë, pa marrë parasysh përpjekjet e klerit, për një farë kohe u krijua mundësia e përhapjes së fjalës së Perëndisë.

Udhëheqësit e papatit filluan përsëri të komplotonin për t'ia mbyllur gojën Reformatorit. Atë e kishin thirrur tri herë në gjyq pa sukses. Në fillim një sinod peshkopësh i quajti shkrimet e tij heretike, e më pas, me ndihmën e mbretit të ri, Richard III që e përkrahte papatin, doli një dekret mbretëror që i kanoste me burgim të gjithë ata që i pranonin doktrinat e mallkuara.

Wycliffi i bëri në fillim thirrje sinodit e më pas Parlamentit; pa iu trembur syri ai e paditi hierarkinë romake përpara këshillit kombëtar dhe kërkoi një reformë të abuzimeve të mëdha të kryera nga kisha. Ai foli, me një fuqi të madhe bindëse, për korrupsionin dhe padrejtësitë e selisë së papatit. Miqtë dhe përkrahësit e Wycliffit u detyruan të dorëzoheshin dhe mendohej se edhe Reformatori, i thyer në moshë, i vetëm dhe i braktisur, do të përulej përpara autoritetit të përbashkët të kurorës dhe skeptrit. Por përkrahësit e papatit e kuptuan shpejt se ai kishte dalë fitimtar. Parlamenti, i prekur nga thirrjet e Wycliffit, e anulloi dekretin e parë dhe Reformatori fitoi lirinë.

Ai u ul në bankën e të akuzuarve për të tretën herë përpara trupit gjykues kishëtar më të lartë të mbretërisë. Këtu "herezia"do të trajtohej siç e meritonte. Këtu, më së fundi Roma do të triumfonte dhe punës së Reformatorit do t'i vihej kapaku. Kështu mendonin papistët... Në qoftë se do të arrihej qëllimi i tyre, Wycliffi do të detyrohej t'i shkelte me këmbë doktrinat e tij apo do të largohej nga salla e gjyqit për të përfunduar mbi turrën e druve.

Por Wycliffi nuk u zbraps, ai nuk u përkul. Pa iu dridhur qerpiku ai i mbrojti deri në fund mësimet e tij, duke i hedhur poshtë akuzat e persekutorëve. Pa marrë parasysh jetën dhe pozitën e tij ai kaloi nga i akuzuar në akuzues, duke i peshuar mashtrimet dhe filozofitë e dëgjuesve të tij mbi peshoren e së vërtetës së përjetshme. Në sallën e gjyqit u ndje prania e Shpirtit të Shenjtë. Të pranishmit, të hutuar nga fuqia e Perëndisë, dukeshin si të gozhduar në vendet e tyre. Fjalët e Reformatorit depërtonin në zemra si shigjeta nga harku i Zotit. Ai u ngarkoi mbi kurriz gjykuesve akuzën për herezi. Pse, - pyeti ai, - guxoni t'i përhapni gabimet tuaja? Për hir të fitimit apo sepse doni të bëni tregti me hirin e Perëndisë?

Kë mendoni se po kundërshtoni? - tha ai në fund. - Një burrë plak në buzë të varrit? Jo! Ju po bini ndesh me të Vërtetën - e Vërteta është më e fortë se ju dhe do t'ju vërë përfund."- Wylie, libri 2, kap 3. Me këto fjalë ai u largua nga asambleja dhe asnjë nga kundërshtarët e tij nuk u orvat që ta pengonte.

Detyra e Wycliffit pothuajse ishte realizuar; flamuri i së vërtetës që ai kishte mbajtur lart për një kohë të gjatë, do t'i kalonte dikujt tjetër; por ai dëshmoi edhe njëherë për ungjillin. E vërteta duhej shpallur nga kështjella e mbretërisë së gabimit. Wycliffi doli përpara trupit gjykues në Romë, nga ku ishte derdhur shumë gjak shenjtorësh. Ai i njihte mirë rreziqet që i kërcënoheshin e megjithatë do t'i ishte përgjigjur "ftesës" nëqoftë se nuk do të ishte paralizuar. Paraliza ia bëri të pamundur udhëtimin, por edhe pse në Romë nuk do të dëgjohej zëri i tij, ai mund të fliste me anë të një letre dhe kështu bëri. Nga famullia e tij Reformatori i dërgoi papës një letër, që pavarësisht nga toni miqësor dhe fryma kristiane, ishte një qortim i hapur ndaj madhështisë dhe krenarisë së autoriteteve të papatit.

"Në të vërtetë unë jam i kënaqur, - shkruan ai, - që të dëshmoj e t'i deklaroj çdo njeriu besimin tim veçanërisht kur një gjë të tillë e bëj me peshkopin e Romës. Meqënëse unë besoj se feja ime është e saktë dhe e drejtë, mendoj se edhe ai (papa) do ta miratojë atë, ose në rast të kundërt, do t'a korrigjojë.

Pikë së pari, unë mendoj se ungjilli i Krishtit është boshti i ligjit të Perëndisë.... Besoj që peshkopi i Romës, si përfaqësues i Krishtit në tokë, duhet të jetë më shumë i interesuar dhe i dhënë se të gjithë njerëzit e tjerë, ndaj ligjit të ungjillit. Madhështia mes dishepujve të Krishtit nuk ishte e lidhur me dinjitetin apo nderin tokësor, por me ndjekjen e afërt dhe të saktë të shembullit të jetës e zakoneve të Krishtit.... Krishti, gjatë kohës së mërgimit të Tij mbi tokë, ishte më i varfëri ndër të varfrit dhe hoqi dorë nga sundimi e nderet tokësore....

"Asnjë besimtar nuk duhet të ndjekë as papën dhe as ndonjë nga klerikët e tij të shejtë, por vetëm Zotin tonë Jezu Krisht, sepse Pjetri dhe bijtë e Zebedeusit, ndryshe nga shembulli i Krishtit, u dhanë pas ndereve tokësore e bënë gabim. Ne nuk duhet t'u shkojmë pas gabimeve të tyre "Papa duhet t'ia lërë në duar sundimin dhe pushtetin e përkohshëm fuqive sekulare duke mësuar e drejtuar në këtë rrugë edhe klerin e tij sepse kështu veproi Krishti; kështu vepruan apostujt e Tij. Megjithatë, në qoftë se kam gabuar në njërën nga këto pika do t'i nënshtrohem me përulësi qortimit e në qoftë se është e nevojshme edhe vdekjes. Në qoftë se do të mund të punoja sipas vullnetit tim apo të veproja me kokën time, padyshim do të paraqitesha përpara peshkopit të Romës, por Zoti më ka hapur një rrugë tjetër e më ka mësuar që t'i bindem më mirë Perëndisë se sa njerëzve."

Në mbyllje të letrës, ai shkruan: "Le t'i lutemi së bashku Zotit që Ai të punojë brenda zemrës së Papës Urban VI, që ai së bashku me klerikët e tij të ndjekin shembullin e jetës dhe zakoneve të Zotit tonë Jezu Krisht dhe t'i mësojnë njerëzit me

drejtësi që edhe këta nga ana e tyre të bëjnë të njëjtën gjë." - John Fosce "Acts and Monuments", vëll 3, fq. 49,50.

Kështu Wycliffi i paraqiti papës dhe kardinalëve të tij butësinë dhe përulësinë e Krishtit, duke nxjerrë në pah jo vetëm përpara tyre, por përpara mbarë Kristianizmit, ndryshimin midis tyre dhe Mësuesit, përfaqësuesit e të Cilit ata "pretendonin" se ishin.

Wycliffi ishte i bindur se jeta e tij do të ishte çmimi i besnikërisë së tij. Mbreti, papa dhe peshkopët ishin bashkuar për ta rrënuar; sipas parashikimeve vetëmj pak muaj e ndanin nga trekëmbëshi. Por guximi nuk e la kurrë. "Përse flisni për kërkimin e kurorës së martirizimit? - tha ai - Predikojeni ungjillin e Krishtit edhe tek prelatët e tjerë dhe martirizimi nuk do të mungojë. Çfarë?! Duhet të jetoj në heshtje?.... Kurrë! Le të më godasë shpata, jam gati ta pres." - D'Aubigne, libri 17, kap.8.

Por kujdesi i Perëndisë vazhdoi ta mbronte shërbëtorin e Tij. Njeriu, që gjatë gjithë jetës së tij e kishte mbrojtur me guxim të vërtetën pa marë parasysh rreziqet, nuk do të binte pre e urrejtjes së armiqve të tij. Wycliff- nuk u përpoq kurrë që të vetëmbrohej, por Zoti ishte mbrojtësi i tij më i mirë; e kur armiqtë ishin të sigurt se e kishin zënë në grackë, dora e Perëndisë e çonte në jë vend ku ata nuk mund ta gjenin. Ndërsa po kremtonte në kishën e tij në Lutterworth shërbesën e komunionit, ai ra në tokë i goditur nga një atak paralitik dhe pas pak kohësh vdiq.

Perëndia ia kishte besuar Wycliffit këtë detyrë. Ai kishte vendosur në gojën e tij fjalët e së vërtetës dhe kishte ngritur një mur mbrojtës përreth tij në mënyrë që këto fjalë t'i dëgjonin njerëzit. Jeta e tij u zgjat dhe puna e tij u mbrojt derisa u hodhën themelet e Reformacionit.

Wycliffi doli nga errësira e mesjetës. Përpara tij, nuk kishte ekzistuar askush tjetër që të hidhte farën. I thirrur si Gjon Pagëzori, për të kryer një mision të veçantë, ai ishte lajmëtari i një epoke të re. Megjithatë në sistemin e së vërtetave që paraqiti ai, vihej re një bashkrendim dhe tërësi, që u ruajt edhe nga Reformatorët, që e pasuan atë edhe pas qindra vjetësh. Themeli ishte kaq i gjerë dhe i thellë dhe struktura kaq e fortë dhe e sigurt, sa të tjerëve që vazhduan më pas tij, nuk iu desh ta rindërtonin.

Lëvizja e madhe që inkurajoi Wycliffi dhe që çliroi ndërgjegjen dhe intelektin duke i zgjidhur kombet nga anija në mbytje e Romës, e kishte zanafillën në Bibël. Ai ishte burimi i atij lumi bekimi, që uji i jetës, ka zgjedhur përmes kohërave që nga shekulli XIV-të. Wycliffi i pranoi Shkrimet e Shenjta si zbulesë e frymëzuar e vullnetit të Perëndisë, si një rregull i mjaftueshëm besimi dhe praktike. Ai ishte mësuar ta shikonte Kishën e Romës si një autoritet hyjnor e të pagabueshëm dhe t'i pranonte me respekt të thellë mësimet dhe zakonet e mijëra vjetëve; por ai u ktheu kurrizin të gjitha këtyre, për t'u vënë veshin fjalëve të Shenjta të Perëndisë. Ai i nxiti

edhe njerëzit e tjerë që ta njihnin këtë autoritet. Ai deklaroi se, në vend të fjalëve të kishës thënë me gojën e papës, i vetmi autoritet i vërtetë ishte zëri i Perëndisë që dëgjohej përmes fjalës së Tij. Ai u mësoi të tjerëve jo vetëm që Bibla është një zbulim i përsosur i vullnetit të Perëndisë dhe që Fryma e Shenjtë është përkthyesi i saj i vetëm, por edhe që çdo njeri, falë studimit të saj, duhet ta kuptojë për vete detyrën e tij. Kështu ai i përqëndroi mendjet e njerëzve nga papa dhe Kisha e Romës, tek fjala e Perëndisë.

Wycliffi ishte një nga Reformatorët më të shquar. Për nga forca e intelektit, qartësia e mendimit, besnikëria ndaj së vërtetës dhe guximi për ta mbrojtur atë, të paktë ishin ata që u barazuan me të. Pastërtia e karakterit, zelli i zjarrtë për të studiuar e punuar, ndershmëria e pacënueshme, besimi dhe dashuria Kristiane ishin veçoritë dalluese të Reformatorit të parë. Ai shkëlqeu si pishtar mes errësirës intelektuale dhe korrupsionit moral të kohës së tij.

Karakteri i Wycliffit është një dëshmi e qartë e fuqisë transformuese dhe edukuese të Frymës së Shenjtë. Ishte Bibla ajo që bëri njeriun që ishte. Përpjekjet për të kuptuar të vërtetat e mëdha i gjallërojnë e freskojnë aftësitë mendore, e zgjerojnë mendimin dhe e pasurojnë gjykimin. Studimi i Biblës i fisnikëron mendimet, ndjenjat dhe aspiratat si asnjë lloj tjetër studimi. Ai ngjall qëndrueshmëri mendimi, durim, guxim dhe papërkulshmëri; ai e përpunon karakterin dhe e shejtëron shpir tin. Një studim i zellshëm dhe i përulur i Shkrimeve të Shenjta, duke e lidhur mendjen e studjuesit me mendjen e pafundme, do t'i jepte botës intelekt më të fortë e më aktiv dhe me parime më fisnike se studimi i filozofisë njerëzore. "Zbulimi i fjalëve të Tua, - thotë psalmisti, - ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë." - Psalmi 119:130.

Doktrinat e përqafuara nga Wyclifi vazhduan të përhapeshin për një farë kohe të gjatë; pasuesit e tij, që njihen me emrin Wycliffianë dhe Lollardë, përshkuan jo vetëm Anglinë, por u shpërndanë edhe në vende të tjera duke marrë me vete njohurinë e ungjillit. Tani që udhëheqësi i tyre nuk ishte më mes tyre, predikuesit punonin me zell akoma më të madh dhe me mijëra njerëz vinin për t'i dëgjuar mësimet e tyre. Mes besimtarëve të rinj kishte fisnikë e madje edhe gruaja e mbretit ishte një prej tyre. Në shumë vende u vu re një ndryshim i dukshëm në sjelljen e njerëzve dhe simbolet idhujtare të Romës filluan të hiqeshin nga kishat. Por, shumë shpejt, stuhia e pamëshirshme e persekutimit shpërtheu mbi ata që guxuan ta pranojnë Biblën si udhërrëfyese në jetë. Mbretërit anglezë, të etur për të forcuar pushtetin e tyre me përkrahjen e Romës, nuk ngurruan t'i flijonin Reformatorët. Për herë të parë në historinë e Anglisë u dekretua dënimi me vdekje për dishepujt e ungjillit. Martirët pasonin martirë. Avokatët mbrojtës të së vërtetës, të dëbuar e të torturuar, mund ta ngrinin zërin e tyre vetëm ndaj Perëndisë së ushtrive. Edhe pse i ndiqnin si armiq të kishës e tradhëtarë të mbretërisë, ata vazhdonin të predikonin

fshehtazi duke u strehuar në shtëpitë modeste të të varfërve e madje edhe në shpella e guva të shkreta.

Megjithë tërbimin e valës së persekutimeve, vazhdoi të ekzistojë shekuj me radhë një protestë e qetë, e zellshme dhe e flaktë kundër korrupsionit të besimit fetar. Të Krishterët e asaj kohe gëzonin një njohje të pjeshsme të së vërtetës, por ata kishin mësuar ta donin e t'i bindeshin fjalës së Perëndisë dhe vuajtën në heshtje për hir të saj. Si dishepujt e parë, shumë prej tyre sakrifikuan edhe të mirat tokësore për shkak të kauzës së Krishtit. Ata, që ishin lejuar të banonin në shtëpitë e tyre, i strehonin me gëzim vëllezërit e persekutuar e kur edhe ata vetë dëboheshin, e pranonin pa fjalë fatin e mërgimtarit. Eshtë e vërtetë që, me mijëra prej tyre, të tmerruar nga tërbimi i persekutorëve e blenë lirinë e tyre në kurriz të besimit dhe dolën nga burgjet të veshur me thes për ta shprehur publikisht tërheqjen e tyre; por edhe numri i atyre - mes të cilëve kishte fisnikë dhe skllevër - që i qëndruan besnikë të vërtetës në qelitë e errëta, në "kullat e Lallardëve" dhe në mes torturave dhe flakëve, duke u gëzuar që ishin llogaritur të denjë për të "marrë pjesë në vuajtjet e Tij", nuk ishte i vogël.

Papistët nuk kishin mundur ta detyronin Wycliffin, sa ishte gjallë, që të vepronte sipas vullnetit të tyre dhe urrejtja e tyre nuk mund të zbutej ndërsa trupi i Reformatorit pushonte qetësisht në varr. Më shumë se 40 vjet pas vdekjes së tij, me anë të një dekreti të Këshillit të Konstancës, u urdhërua zhvarrosja dhe djegia publike e eshtrave t ë tij. Hiri u hodh në një përrua aty pranë. "Ai përrua, - thotë një shkrimtar i kohës, - e përcolli hirin e eshtrave të tij në Avon, Avoni në Severn, Severni në det dhe deti në oqean. Kështu hiri i eshtrave të Wycliffit është një emblemë e doktrinës së tij, që tani është përhapur në, mbarë botën." - T.Fuller,"Church History of Britain" libri 4, sek 25, par 54. Armiqtë e tij nuk arritën ta kuptonin domethënien e aktit të tyre keqdashës.

Falë shkrimeve të Wycliffit, John Huss nga Bohemia, u detyrua t'i braktiste gabimet e shumta të Romës për t'i hyrë rrugës së reformës. Kështu, në këto dy vende që ndodhen kaq larg njëri- tjetrit, u hodh fara e së vërtetës. Nga Bohemia kjo vepër u përhap në vende të tjera. Mendjet e njerëzve po drejoheshin tek Fjala e harruar prej kohësh e Perëndisë. Një dorë hyjnore po i përgatiste rrugën Reformacionit të Madh.

1. Cilat ishin ndikimet providenciale të Perëndisë në jetën e Wycliffe që bënë të mundur që ai të sillte vëmendjen tek e vërteta e Shkrimeve?

2. Shumë nga predikimet e Wycliffe kishin si temë kryesore abuzimet sociale të kohës së tij, duke u përqëndruar tek çështje si: fuqia, autoriteti shpirtëror dhe paraja. Gjeni

ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet ambjentit moral të kohës së tij me atë të kohës sonë. Në cilat mënyra na flasin Shkrimet rreth degradimit moral të shoqërive bashkëkohore ashtu siç ishte edhe në ditët e Wycliffe?

3. Përse,përkthimi i Biblës në gjuhën angleze ishte puna më e madhe e arritur nga Wycliffe?

6.

Huss dhe Jerome

Fara e ungjillit u mboll në Bohemi që në shekullin e nëntë. Bibla tashmë ishte përkthyer dhe adhurimi zhvillohej në gjuhën amtare. Por me rritjen e pushtetit të papës, u errësua fjala e Perëndisë. Gregory VII, që kishte vendosur ta përbalte krenarinë e mbretërve, ishte po aq i zellshëm për të kthyer në sklevër popujt dhe pa humbur kohë, ai nënshkroi një dekret që ndalonte adhurimin publik në gjuhën bohemiane. Papa deklaroi "se të Plotfuqishmit i pëlqente adhurimi në gjuhë të panjohur dhe se shumë të këqija dhe herezi kishin ardhur si rrjedhim i shkeljes së këtij rregulli" - Wylie, libri 3, kap 1. Kështu Roma vendosi të shuante dritën e fjalës së Perëndisë e t'i braktiste njerëzit në mes të errësirës. Por Qielli kishte përgatitur rrugë të tjera për ta ruajtur kishën. Shumë Valdezë dhe Albigensë, të dëbuar nga shtëpitë në Itali dhe Francë nga tërbimi i persekutimit, erdhën në Bohemi. Megjithëse nuk guxonin të predikonin haptazi, ata punuan me zell të madh në fshehtësi. Kështu besimi i vërtetë mbijetoi nga shekulli në shekull.

Përpara Hussit, në Bohemi ka pasur njerëz të tjerë që janë ngritur haptazi kundër korrupsionit të kishës dhe pandershmërisë së popullit. Veprimtaria e tyre ngjalli një interesim të përgjithshëm. Lindi frika në selitë e hierarkisë dhe filloi persekutimi i dishepujve të ungjillit. Ushtarët i ndiqnin ata këmba - këmbës ndërsa shkonin për të adhuruar në pyje e male dhe shumë prej tyre u vranë. Pas një farë kohe, u miratua dekreti që urdhëronte djegien e të gjithë atyre që largoheshin nga adhurimi romak. Të Krishterët, duke vdekur, shihnin me sytë e mendjes triumfin e kauzës së tyre. Njëri prej atyre "që besonin se shpëtimi gjendet vetëm tek besimi tek Shpëtimtari i kryqëzuar" përpara se të vdiste tha: "Tërbimi i armiqve të së vërtetës tani ka epërsi të mahe; por nuk do të vazhdojë kështu përgjithmonë; nga gjiri i popullit do të ngrihet një njeri, pa shpatë dhe paautoritet, ndaj të cilit nuk do të mund të triumfojnë." - Ibid, libri 3 kap 1. Koha e Luterit ishte ende larg; por po afrohej shfaqja e dikujt; dëshmia e të cilit kundër Romës do t'i trondiste kombet.

Hussi rridhte nga shtresat e ulëta të shoqërisë dhe mbeti jetim nga babai që në moshë të njomë. Nëna e tij e zellshme, që i quante arsimimin dhe respektin ndaj Perëndisë, pasuritë më të çmuesh me, u përpoq t'ia siguronte edhe të birit këtë trashëgimi. Hussi studjoi fillimisht në shkollën e fshatit e më pas i vazhdoi studimet me një bursë bamirësie, në universitetin e Pragës. Gjatë udhëtimit të tij për në Pragë e shoqëroi e ëma; e ve dhe e varfër, ajo nuk kishte as pasuri e as dhurata tokësore për të birin, por ndërsa arritën pranë qytetit ajo u gjunjëzua pranë të riut jetim dhe i kërkoi Atit qiellor ta bekonte. Ajo nënë atëherë nuk e dinte se si do të ishte përgjigjja e asaj lutjeje.

Në universitet, Hussi u shqua për punën e tij të palodhur dhe përparimin e shpejtë, ndërsa falë jetës së tij të ndershme dhe sjelljes së tij së hijshme fitoi respektin e të tjerëve. Ai ishte një përkrahës i sinqertë i Kishës së Romës dhe një kërkues i zellshëm i bekimeve shpirtërore që "dhuronte"ajo. Me rastin e një jubileu, ai shkoi të rrëfehej dhe pasi dhuroi monedhat e fundit të "fondit"të tij të pakët, u bashkua me proçesionin që të fitonte faljen e premtuar. Me të mbaruar studimet universitare, u bë prift dhe duke i ngjitur shkallët e karrierës njëra pas tjetrës, hyri në shërbim të mbretit. Më pas ai u bë profesor dhe rektor i universitetit ku ishte diplomuar. Brenda një kohe të shkurtër, studenti me bursë, u bë krenaria e kombit dhe emri i tij u bë i njohur në mbarë Evropën.

Por Hussi e filloi punën reformuese në një fushë tjetër. Disa vjet pas shugurimit të tij si prift, ai u caktua predikues i kishës së vogël të Betlehemit. Themeluesi i kësaj kishe kishte theksuar si një çështje të rëndësisë së veçantë, predikimin e Shkrimeve të Shenjta në gjuhën e popullit. Pavarësisht nga kundërshtimi i Romës në këtë pikë, kjo praktikë nuk ishte zhdukur plotësisht në Bohemi. Por ekzistonte ama një padije e madhe në lidhje me Biblën dhe mes klasave të ndryshme shoqërore viheshin re vese nga më të ulëtat. Hussi i dënoi me forcë këto të këqija duke theksuar se vetëm fjala e Perëndisë mund të rivendoste parimet e së vërtetës dhe pastërtisë që mungonin.

Një qytetar i Pragës, Jeromi, që më pas u bë mik i ngushtë i Hussit, kishte sjellë me vete nga Anglia shkrimet e Wycliffit. Mbretëresha e Anglisë, që ishte një përkrahëse e zjarrtë e mësimeve të Wycliffit, ishte një princeshë Bohemiane dhe për shkak të ndikimit të saj, veprat e Reformatorit u përhapën edhe në vendlindjen e saj. Hussi i lexoi me një interesim të madh këto vepra; ai ishte i mendimit se autori i tyre ishte një i Krishterë i sinqertë dhe kjo e nxiti t'i mirëpriste reformat që nxirrte në pah ai. Me vetëdije apo pa vetëdije, Hussi i hyri kështu një rruge që do ta largonte nga Roma.

Pikërisht në këtë kohë, në Pragë erdhën nga Anglia dy njerëz të arsimuar, që me ta pranuar dritën, kishin ardhur ta përhapnin atë në këtë vend të largët. Duke qënë se e sulmuan haptazi papën, autoritetet nxituan t'ua mbyllnin gojën; por meqënëse ishin të vendosur për t'ia arritur qëllimit të tyre, përdorën mënyra të tjera. Duke

qënë edhe artistë, ata filluan ta vinin në punë talentin e tyre. Ata pikturuan dy skica në një vend afër qëndrës. Njëra paraqiste hyrjen e Jezusit në Jeruzalem "zemërbutë, ulur mbi një gomar" (Mateu 21:5), i pasuar nga dishepujt e Tij me veshje të shqyera e këmbëzbathur. Tjetra paraqiste një proçesion - të prirë nga papa i veshur me rrobat e tij madhështore dhe kurorën tricepëshe, iulur mbi një kalë të stolisur, i shoqëruar nga kardinalë, prelatë dhe trumpeta.

Ato përbënin një shërbesë tërhiqte vëmendjen e të gjithë njerëzve. Me mijëra njerëz vinin për të parë pikturat. Të gjithë e kuptonin mirë moralin e skicave dhe shumë prej tyre çuditeshin nga ndryshimi mes zemërbutësisë dhe përuljes së Krishtit, Mësuesit, dhe krenarisë dhe arrogancës së papës, të ashtuquajturit "shërbëtor" i tij. Në Pragë pati një çrregullim të madh dhe pas një farë kohe atyre iu desh të largoheshin. Por mësimi që dhanë ata nuk harrohej. Pikturat lanë një mbresë të madhe në mendjen e Hussit dhe e shtynë atë që ta studjonte Biblën dhe Shkrimet e Wycliffit më me kujdes. Edhe pse nuk ishte akoma gati për t'i pranuar të gjitha reformat që nënvizonte Wycliffi, ai vuri re karakterin e vërtetë të papatit dhe filloi t'i dënonte me zell më të madh krenarinë, ambicjen dhe korrupsionin e kësaj hierarkie

Nga Bohemia drita kaloi në Gjermani, sepse çrregulimet në Universitetin e Pragës bënë të largoheshin me qindra studentë gjermanë. Shumë prej tyre kishin fituar me ndihmën e Hussit, njohuritë e para mbi Biblën dhe me t'u kthyer në vendlindje, ata filluan përhapjen e ungjillit. Lajme të veprimtarisë që zhvillohej në Pragë arritën deri në Romë dhe Hussin e lajmëruan të paraqitej përpara papës. Të bindej do të thoshte vdekje e sigurtë. Mbreti dhe mbretëresha e Bohemisë, profesorët e universitetit, fisnikët, zyrtarët e qeverisë i dërguan një kërkesë papës që ta lejonte Hussin të qëndronte në Pragë dhe të paraqitej në Romë në personin e një delegati. Në vend që t'i përgjigjej pozitivisht kësaj kërkese, papa ngulmoi në dënimin e Hussit dhe e "shkishëroi" qytetin e Pragës.

Gjatë asaj kohe, shqiptimi i një dënimi të tillë, ngjallte shqetësim dhe alarm. Ai (dënimi) shoqërohej nga ceremoni që i tmerronin njerëzit që e shihnin papën si përfaqësues të vetë Perëndisë, që mbante në dorë çelësat e parajsës dhe ferrit dhe që kishte të drejtën t'i gjykonte ata. Besoj që portat e parajsës mbylleshin për atë zonë që shkishërohej dhe derisa papa ta anullnte dënimin, të vdekurit mbeteshin jashtë shkëlqimit të atij vendi përrallor. Si shenjë e kësaj fatkeqësie të madhe, ndërpriteshin të gjitha veprimtaritë e asaj zone. Kishat mbylleshin. Martesat festoheshin në oborret e kishave. Të vdekurve u mohohej e drejta për tu varrosur me ceremonitë përkatëse në varreza, prandaj varroseshin përkohësisht nëpër fusha e hendeqe. Kështu, duke përdorur mjete e mënyra të ndryshme, Roma përpiqej të vinte nën kontroll ndërgjegjen njerëzore.

Praga ishte mjaft e çorientuar. Një grup i madh njerëzish e quanin Hussin shkakun e vetëm të fatkeqësive të tyre dhe kërkonin që ai t'i dorëzohej hakmarrjes romake. Për ta qetësuar disi furtunën, Reformatori u kthye për një farë kohe në

fshatin e tij të lindjes. Duke u shkruar miqve në Pragë, ai thoshte: "Jam larguar nga mesi juaj vetëm për të ndjekur urdhëresat dhe shembullin e Jezu Krishtit, për të mos u dhënë mundësi keqdashësve të mendojnë se po dënohen përjetësisht dhe për të mos i trishtuar e munduar të zellshmit. U largova gjithashtu që të mos u jap mundësi priftërinjve të pabesë t'ua fshehin për një kohë të gjatë Fjalën e Perëndisë, sepse nuk dua që ju ta mohoni të vërtetën hyjnore për të cilën, me ndihmën e Perëndisë, jam gati të vdes." - Bonnechose,"The Reformers before the Reformation" vëll 1, fq 87. Hussi nuk hoqi dorë nga puna e tij, por udhëtoi në fshatrat përreth duke u predikuar turmave të etura për dije. Kështu, papa me masat që mori, jo vetëm nuk e shtypi ungjillin, por ndikoi në përhapjen e tij. "Ne në fakt nuk kemi asnjë forcë kundër të vërtetës por pro të vërtetës." 2 Korintasve 13:8.

Mendja e Hussit, në këtë periudhë të karrierës së tij, dukej sikur ishte kthyer në skenën e një konflikti të dhimbshëm. Megjithëse kisha po përpiqej ta shkelte me këmbë, ai nuk kishte hequr dorë nga autoriteti i saj. Për të, Kisha e Romës vazhdonte të ishte nusja e Krishtit dhe papa vazhdonte të mbetej përfaqësues dhe mëkëmbës i Perëndisë. Hussi po sulmonte abuzimin e autoritetit dhe jo parimin në vetvete. Kjo shkaktoi një kontradiktë të tmerrshme mes bindjeve të intelektit dhe thirrjeve të ndërgjegjes. Në qoftë se ky autoritet ishte, siç besonte ai, i drejtë dhe i pagabueshëm, si shpjegohej që ai pirej drejt mosbindjes ndaj tij? Ai e kuptoi se të bindej do të thoshte të mëkatonte. Pse bindja ndaj një kishe të pagabueshme çonte në një rezultat të tillë? Ky ishte problemi që ai nuk e zgjidhte dot, ky përbënte dyshimin që e mundonte çdo ditë. E vetmja zgjidhje e përafërt që i shkonte ndër mend ishte, që si në kohën e Shpëtimtarit, priftërinjtë e kishës ishin bërë të ligj dhe po e përdornin autoritetin e tyre të ligjshëm për qëllime të paligjshme. Kjo e bëri atë të arrinte në konkluzionin se urdhëresat Biblike të kuptuara drejt janë të vetmet rregulla të ndërgjegjes, apo me fjalë të tjera, se Zoti duke folur në Bibël dhe jo në kisha duke folur nëpërmjet priftërinjve, është udhërrëfyesi i vetëm i pagabueshëm" Wylie, libri 3, kap. 2.

Me t'u rivendosur në Pragë qetësia, Hussi u rikthye në kishën e tij të vogël të Betlehemit për të vazhduar me një zell dhe guxim më të madh predikimin e fjalës së Perëndisë. Armiqtë e tij ishin aktivë e të fuqishëm, por mbretëresha dhe shumë fisnikë ishin miqtë e tij dhe pjesa më e madhe e njerëzve e përkrahnin. Duke ballafaquar mësimet e tij të drejta e fisnike dhe jetën e tij të shenjtë me dogmat degraduese që predikonin papistët dhe me kopracinë dhe çthurjen e tyre, shumë njerëz e kishin për nder të ishin në anën e tij.

Deri atëherë Hussi kishte qënë i vetëm; por tani punës së reformës i hyri edhe Jeromi, që gjatë qëndrimit të tij në Angli kishte pranuar mësimet e Wycliffit. Më pas, ata qëndruan gjithmonë bashkë e madje as vdekja nuk i ndau. Jeromi shquhej për mendjemprehtësi gjeniu, elokuencë dhe dije - veçori këto që fitojnë stimën pop-

ullore - ndërsa përsa u përket aftësive që çojnë në forcë karakteri, Hussi mbante vendin e parë. Pjekuria e tij shpesh i vinte fre shpirtit të papërmbajtur të Jeromit, i cili me thjeshtësi të sinqertë e vlerësonte Hussin dhe u nënshtrohej me bindje këshillave të tij. Reforma, falë përpjekjeve të tyre të përbashkëta, u përhap me shpejtësi.

Perëndia lejoi dritën të ndriçonte mendjet e këtyre njerëzve të zgjedhur, duke u zbuluar atyre mjaft gabime të Romës; por ata nuk mundën të kapnin çdo rreze të kësaj drite për t'ia përcjellë botës. Nëpërmjet këtyre shërbëtorëve të përulur, Zoti po i udhëhiqte njerëzit jashtë cakut të errët që kishte vendosur Roma; por vështirësitë që do t'u dilnin përpara ishin të shumta dhe Ai vazhdoi kështu, hap pas hapi, t'i nxiste të ecnin përpara me aq shpejtësi sa kishin forca. Ata nuk ishin të përgatitur për ta pranuar të gjithë të vërtetën menjëherë. Drita e diellit të mesditës do të ishte, për këta njerëz që kishin jetuar për një kohë të gjatë në errësirë, verbuese dhe do t'i trembte. Prandaj Ai ua zbuloi udhëheqësve rreze pas rrezeje dhe këta të fundit ua përcollën njerëzve po ashtu: rreze pas rrezeje. Nga shekulli në shekull, në skenën e historisë dolën njerëz të tjerë besnikë që vazhduan rrugën e nisur duke i nxitur njerëzit akoma më shumë drejt reformës.

Përçarja në kishë vazhdonte si më parë: 3 papët luftonin për pushtet dhe vendet e Krishtere përjetuan si rrjedhim, gjakderdhje dhe konflikte të vazhdueshme. Duke mos u kënaqur vetëm me dënime dhe mallkime reciproke, ata iu drejtuan armëve. Secili prej tyre filloi blerjen e armëve dhe grumbullimin e ushtarëve.

Natyrisht, të gjitha këto kërkonin shpenzime të mëdha dhe lekët u nxorrën nga shitja e dhuratave, titujve dhe bekimeve të kishës. Edhe priftërinjtë e thjeshtë - duke ndjekur shembullin e eprorëve të tyre - filluan të shisnin gjërat me vlerë të kishave e të manastireve e t'i sulmonin rivalët e tyre për të forcuar "pushtetin lokal." Hussi u ngrit hapur, me një guxim të madh, kundër padrejtësive që bëheshin në emër të fesë; edhe njerëzit filluan t'i akuzonin haptazi udhëheqësit romakë si shkaku i vetëm i fatkeqësive që po përjetonte bota e Krishtere.

Praga rrezikohej përsëri nga konflikti i përgjakshëm. Si në kohët e lashta, shërbëtorit të Perëndisë iu tha: "Ti je pikërisht ai që e bën rrëmujë Izraelin." 1 Mbretërve 18:17. Qyteti u shkishërua përsëri dhe Hussi shkoi sërisht në fshatin e tij të lindjes.

Dëshmisë, që ai e kishte mbrojtur me besim të madh nga kisha e tij e vogël, i kishte ardhur fundi. Përpara se të jepte jetën si dëshmitar i së vërtetës, ai i foli botës mbarë nga një podium shumë më i lartë.

Për të shëruar plagët e shumta të Evropës, perandori Sigismund urdhëroi Gjonin XXIII që ishte njëri nga papët rivalë, të thërriste në Kostancë një këshill të përgjithshëm. Papës Gjon nuk i pëlqente ideja e një mbledhjeje të tillë sepse i trembej shqyrtimit të politikës dhe karakterit të tij - edhe pse ky shqyrtim do të bëhej nga klerikë e prelatë, morali i të cilëve linte shumë për të dëshiruar - por sidoqoftë, ai nuk guxonte ta bënte dy fjalën e Sigismundit.

Objektivat kryesore të këtij këshilli ishin dy: shkulja nga rrënjët e herezisë dhe dhënia fund e përçarjes në kishë. Kështu, këshilli ftoi si dy antipapët, ashtu edhe propagandorin e reformës së re, John Huss. Të parët, duke mos dashur që të rrezikoheshin, nuk u paraqitën vetë por dërguan delegë përpara këshillit. Papa Gjon, megjithëse ishte drejtuesi i mbledhjes, nuk u paraqit me qejf sepse kishte frikë se mos perandori kërkonte shkarkimin e tij dhe i kërkonte llogari për padrejtësi dhe krimet që kishte kryer për padrejtësitë dhe krimet që kishte kryer për të arritur kurorën tricepëshe të papës. Megjithatë hyrja e tij në qytetin e Kostancës ishte madhështore: ai shoqërohej nga një numër i madh klerikësh të rangjeve të larta dhe shumë lajmëtarë me trumpeta. Kleri, personalitetet më të larta dhe banorët e qytetit i dolën përpara për t'i uruar mirseardhjen. Turma i shkonte përpara dhe veshjet e kushtueshme të kardinalëve dhe aristokratëve, i jepnin proçesionit një shkëlqim të veçantë.

Ndërkohë Kostancës po i afrohej një udhëtar tjetër. Hussi ishte më se i ndërgjegjshëm për rreziqet që i kanoseshin. Ai u nda me miqtë e tij a thua s'do t'i takonte më kurrë dhe e nisi udhëtimin me parandjenjën se po shkonte drejt trekëmbëshit. Megjithëse kishte një lejekalimi të nënshkruar nga mbreti i Bohemisë dhe iu dërgua edhe një e dytë nga perandori Sigismund, ai bëri gjithë përgatitjet e duhura për t'i dalë përpara një vdekjeje të mundshme.

Në një letër që u dërgoi miqve të tij në Pragë ai shkruante: "Vëllezër të dashur.... po nisem me një lejekalim nga mbreti për të takuar armiqtë e mi të shumtë vdekjeprurës.... Besimi im qendron i patundur tek Perëndia i plotfuqishëm dhe tek Shpëtimtari im; jam i sigurt se Ai do t'i dëgjojë lutjet tuaja të zjarrta dhe do të më falë maturinë dhe mençurinë e Tij në mënyrë që unë t'iu bëj ballë atyre; se do të më dërgoje Shpirtin e Tij të Shenjtë për të më fuqizuar në të vërtetën e Tij në mënyrë që t'i përballoj me guxim tundimet, burgimin apo, në qoftë se është e nevojshme, edhe vdekjen mizore. Jezu Krishti vuajti për të dashurit e Tij; a duhet të çuditemi atëherë që Ai na ka lënë shembullin e Tij që edhe ne të durojmë pa fjalë gjithçka për shpëtimin tonë? Ai është Perëndi e ne jemi krijesat e Tij; Ai është Zoti e ne jemi shërbëtorët e Tij; Ai është Sovrani i botës e ne jemi qënie të dobëta -e megjithatë Ai vuajti! Atëherë pse nuk u dashka që të vuajmë edhe ne kur e dimë mirë se vuajtja është në vetvete pastrim? Të dashurit e mi, në qoftë se vdekja ime do të shërbejë për lëvdimin e emrit të Tij, lutuni që ajo të vijë sa më shpejt dhe që Zoti të më ndihmojë t'u bëjë ballë fatkeqësive me durim. Po... në qoftë se është më mirë që të kthehem përsëri mes jush, le t'i lutemi Zotit që të kthehem i panjollosur - që të mos i heq asnjë shkronjë të vetme të vërtetës së ungjillit, në mënyrë që t'u lë vëllezërve të mi nje shembull të pastër frymëzimi. Ndoshta Praga nuk do ta shikojë më kurrë fytyrën time; por në qoftë vullneti i Zotit që unë të kthehem sërisht mes jush, të dimë të ecim përpara me zemër të fortë drejt njohjes dhe dashurisë ndaj ligjit të Tij." Bonnechose, vëll 1, fq.147,148.

Në një letër tjetër drejtuar një prifti që ishte kthyer në dishepull të ungjillit, Hussi fliste me përulje për gabimet e veta, duke u vetëakuzuar "që kishte gjetur kënaqësi në veshjet dhe mantelët e shtrenjtë dhe në kalimin e orëve të tëra në punë të kota." Më pas shtonte: "Mendja jote u pushtoftë nga lavdia e Perëndisë dhe shpëtimi i njerëzve dhe jo nga pronat e të mirat tokësore! Kujdesu më shumë për zbukurimet e shpirtit tënd sesa të shtëpisë tënde dhe merru më mirë me ndërtimin tënd shpirtëror. Tregohu i thjeshtë dhe i përulur me të varfërit e mos e harxho pasurinë tënde nëpër festa. Në qoftë se nuk do të vazhdosh të ndryshosh dhe të pastrohesh nga gjërat pa vlerë, kam frikë se do të pendohesh si unë. Ti i njeh doktrinat e mia sepse të kam mësuar që në fëmijëri prandaj nuk po të shkruaj më gjatë. Megjithatë të lutem për lavdi të Zotit tonë, që të mos më imitosh në kotësitë që më ke parë të bie." Në pjesën e përparme të zarfit ai shtoi: "Të lutem të mos e hapësh letrën përpara se të bindesh për vdekjen time." Ibid, vëll 1, fq. 148, 149.

Gjatë udhëtimit të tij, Hussi pa kudo shenjat e përhapjes së doktrinave të tij dhe vuri re se kauza e tij ishte mirëpritur nga populli. Njerëzit grumbulloheshin për ta parë dhe në disa qytete, vetë magjistratët e shoqëronin nëpër rrugë.

Me të arritur në Kostancë, Hussi fitoi liri të plotë sepse lejekalimit të nënshkruar nga perandori iu bashkangjit një garanci personale për mbrojtje nga papa. Por megjithatë, për një farë kohe, pa marrë parasysh këto deklarata, Reformatori u arrestua dhe u burgos me urdhër nga papa dhe nga kardinalët. Më pas ai u transferua në një kështjellë në lumin Ren ku u mbajt si i burgosur, por edhe papa, pa iu gëzuar mirë kësaj pabesie, përfundoi pa një, pa dy në të njëjtin burg. (Ibid, vëll 1, fq. 247.) I gjykuar nga këshilli, Gjoni i XXIII u deklarua fajtor për krime të ulëta si: vrasje, tradhëti bashkëshortore dhe shitblerje, pa përmendur "mëkatet që s'ia vlente të përmendeshin" aq të ndyra ishin. Kështu këshilli vendosi ta shkarkonte nga kjo detyrë dhe e dënoi me burgim. Edhe dy rivalët e tjerë u shkarkuan dhe vendin e tyre e zuri një papë i ri.

Megjithëse papa ishte quajtur fajtor për krime shumë më të mëdha se ato që kishte përmendur Hussi dhe për të cilat ai kishte bërë thirrje për reformë, këshilli që e dënoi peshkopin e Romës, u hodh edhe kundër Reformatorit. Burgimi i tij ngjalli një pakënaqësi të madhe në Bohemi. Aristokratë të fuqishëm protestuan ashpër pranë këtij këshilli kundër kësaj padrejtësie. Perandori, që nuk i pëlqente t'i shkelej lejekalimi me vulën e tij, u mundua ta ndalonte gjyqin kundër tij. Por armiqtë e Reformatorit ishin keqdashës dhe të vendosur. Ata i bënë thirrje pregjykimeve, frikës dhe zellit të perandorit ndaj kishës. Ata shfrytëzuan argumente të vjetra për të provuar se "besimi nuk duhej mbajtur me heretikë apo me njerëz që dyshohen për herezi edhe pse ata mund të jenë të pajisur me lejekalimi nga perandori apo nga mbretërit." Jacquet Lenfant,"History of the Counsil of Constance", vëll 1, fq. 516. Kështu, ata ia arritën qëllimit.

I dobësuar nga sëmundja dhe burgimi,- lagështia dhe ajri i ndotur i qelisë i shkaktuan ethe që desh i kushtuan jetën, - Hussi doli më në fund përpara anëtarëve të këshillit. I lidhur me zinxhirë ai qëndroi përpara perandorit që dikur kishte vendosur ta mbronte duke i dhënë besën e tij. Gjatë gjuqit të tij, që zgjati për një kohë të gjatë, ai e mbrojti me vendosmëri të vërtetën dhe protestoi haptazi, përpara autoriteteve të kishës dhe të shtetit, kundër korrupsionit të kësaj hierarkie. Kur iu kërkua të zgjidhte mes braktisjes së doktrinave të tij dhe vdekjes, ai zgjodhi fatin e martirit.

Hirësia e Perëndisë e ndihmoi dhe gjatë javëve përpara marrjes së vendimit përfundimtar, shpirtin e tij e pushtoi paqja qiellore"Po e shkruaj këtë letër,- i thoshte një miku të tij,- nga burgu, me duar të lidhura me pranga, në pritje të vendimit me vdekje që do të jepet nesër.... Kur, me ndihmën e Jezu Krishtit, do të takohemi përsëri në paqen e jetës së ardhshme, do të kuptosh se sa mëshirë ka pasur Zoti për mua dhe se si më ka mbrojtur në mes të tundimeve dhe provave."- Bonnechose, vëll 2, fq. 67.

Në errësirën e burgut, ai pa triumfin e besimit të vërtetë. Në ëndërr ai pa kishën e tij të vogël në Pragë ku kishte predikuar ungjillin, si dhe papën dhe peshkopët e tij që po fshihnin pikturat e Krishtit që ai vetë i kishte pikturuar në mure. "Ky vizion e shqetësoi;por natën tjetër ai pa në ëndërr shumë piktorë që po merreshin me rikrijimin e këtyre imazheve, me ngjyra më të çelura e me një numër më të madh. Me të mbaruar punën piktorët, që i rrethonte një turmë e madhe njerëzish, thanë: "Le të vinë tani papët dhe peshkopët; ata nuk do të mund t'i fshijnë më këto piktura!" Duke i lidhur ëndrrat me njëra - tjetrën, Reformatori tha: "Jam më se i sigurtë se imazhi i Krishtit nuk do të shuhet kurrë. Ata kanë dashur ta shkatërrojnë por ai do të ripikturohet në zemrat e të gjithëve nga piktorë më të mirë se unë." - D'Aubigne, libri 1, kap. 6.

Hussi u paraqit përpara këshillit për herë të fundit. Asambleja ishte e madhe në numër dhe "e ndritur" - aty ishte perandori, princët e perandorisë, deputetët mbretërorë, kardinalët, peshkopët, priftërinjtë dhe një turmë e madhe spektatorësh. Nga të katër anët e botës së Krishtere kishin ardhur njerëz, që donin të shihnin me sytë e tyre, flijimin e parë të betejës së gjatë që do të sillte liri ndërgjegjeje.

I ngritur në këmbë, në pritje të vendimit përfundimtar, Hussi deklaroi se mbronte çdo doktrinë të tijën dhe duke ia ngulur sytë monarkut që e kishte shkelur paturp besën e dhënë, tha: "Vendosa me vullnetin tim të lirë, që të paraqitesha përpara këtij këshilli sepse perandori, që është i pranishëm këtu, më premtoi publikisht mbrojtjen e tij." - Bonnechose, vëll 2, fq. 84. Sigismundo u skuq, kur vështrimi i të gjithëve u përqëndrua tek ai.

Me t'u shpallur vendimi, filloi "ceremonia" e poshtërimit. Peshkopët e veshen të burgosurin me rroba priftërore e ndërsa e vishnin, ai tha: "Zotin tonë Jezu Krishtin e veshën me një rrobë të bardhë, si shenjë poshtërimi, kur e çuan nga Herodi tek

Pilati." - Ibid, vëll 2, fq. 86. Kur iu bë thirrje përsëri për t'u tërhequr, duke iu drejtuar turmës së njerëzve, ai tha: "Po si mund ta hedh vështrimin drejt qiellit pastaj? Si mund t'i shikoj në sy këta mijëra njerëz, të cilëve u kam predikuar ungjillin e kulluar? Jo, unë e vlerësoj shpëtimin e tyre më shumë se këtë trup të mjerë që është dënuar me vdekje." Veshjet iu hoqën njëra pas tjetrës ndërsa çdo peshkop e mallkonte duke luajtur kështu një "rol" të rëndësishëm në këtë ceremoni. Më së fundi i vendosën në kokë një kapelë në formën e një skeptri piramik ku ishin shkruar fjala "kryeheretik" në pjesën e përparme. "Me shumë gëzim do ta mbaj këtë kurorë turpi për Ty o Jezus, - tha Hussi, - sepse Ti mbajte për mua një kurorë gjembash."

Mbasi u "rregullua" në këtë mënyrë, prelatët thanë: "Shpirtin tënd tani ia përkushtojmë djallit." "Ndërsa unë, - tha Hussi duke i ngritur sytë drejt qiellit, - ta lë shpirtin tim në duar Ty o Zoti Jezus, sepse Ti më ke çliruar."- Wylie, libri 3, kap.7

Ai iu kalua më pas autoriteteve sekulare që e çuan në vendin e ekzekutimit. Një varg i gjatë i shkonte pas - qindra ushtarë të armatosur, priftërinj e prelatë të veshur bukur e banorë të Konstancës. Kur u lidh tek turra e druve dhe gjithçka u bë gati për të ndezur zjarrin, martirit iu dha mundësia e fundit për të shpëtuar duke pohuar gabimet e tij. "Çfarë gabimesh - tha Hussi,- duhet të pranoj? Unë nuk ndjehem aspak fajtor. Thërres Zotin si dëshmitar se gjithçka që kam shkruar e predikuar e kam bërë vetëm për t'i shpëtuar shpirtrat njerëzorë nga mëkati dhe zhdukja e prandaj, me shumë gëzim, e vërtetoj me gjakun tim të vërtetën për të cilën kam shkruar e predikuar." - Ibid, libri 3, kap.7. Me të marrë zjarr shkarpat përreth tij, ai filloi të këndonte: "Jezus, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua!" dhe vazhdoi kështu derisa nuk iu dëgjua më zëri.

Armiqtë shtangën përballë qëndrimit dhe durimit të tij heroik. Një përkrahës i zjarrtë i papatit, duke përshkruar martirizimin e Hussit dhe Jeromit që vdiq më pas, tha: "Të dy ishin më se të ndërgjegjshëm se po iu afrohej ora e fundit. U përgatitën për të shkuar drejt zjarrit sikur po shkonin në dasëm. Nuk shqiptuan asnjë fjalë pakënaqësie e dhembjeje. Me t'u ndezur zjarri, ata filluan të këndonin himne dhe dukej sikur as flakët përvëluese nuk mund t'i ndalonin këngët e tyre." - Ibid, libri 3, kap. 7

Kur trupi i Hussit u dogj plotësisht nga flakët, hiri së bashku me dheun poshtë tij, u mblodhën dhe u hodhën në lumin Ren, duke nisur kështu udhëtimin drejt oqeanit. Persekutorët e tij më kot mendonin se i kishin shkulur nga rrënjët të vërtetat që predikonte ai. Atyre as nuk u shkonte në mendje se hiri i hedhur në det atë ditë, do të bëhej farë e do të shpërndahej në të katër anët e tokës; në vende, deri atëherë të panjohura ajo do të lidhte fryte të bollshme si dëshmi e së vërtetës. Zëri që u dëgjua në sallën e gjyqit në Konstancë, do të përcillej si jehonë nga brezi në brez. Hussi nuk jetonte më, por të vërtetës për të cilat dha jetën, nuk mund të zhdukeshin. Shëmbulli i besimit dhe qëndrueshmërisë së tij do të inkurajonte me mijëra njerëz që t'u bënin ballë torturave dhe vdekjes për hir të së vërtetës. Ekzeku-

timi i tij i tregoi edhe njëherë botës mbarë mizorinë e paparë të Romës. Armiqtë e së vërtetës, edhe pse pa vetëdije, e kishin çuar më përpara kauzën që po përpiqeshin ta shkatërronin.

Megjithatë, një turrë tjetër drush do të në Konstancë. Gjaku i një dëshmitari tjetër do të vuloste të vërtetën. Kur i uroi udhëtim të mbarë Hussit, kur ky po nisej për t'u paraqitur përpara këshillit, Jeromi e kështilloi të tregohej i fortë e i guximshëm, duke i premtuar se, në qoftë se do t'i ndodhte ndonjë e keqe, nuk do të ngurronte ta ndihmonte. Me të dëgjuar për burgimin e Reformatorit, dishepulli besnik u bë agti për të mbajtur fjalën e dhënë. Pa lejekalimi ai u nis me dikë tjetër për në Konstancë. Me të arritur atje, ai e kuptoi se duke ardhur në Konstancë nuk kishte bërë asgjë tjetër, veçse kishte vënë në rrezik veten e tij sepse Hussin nuk e ndihmonte dot. Ai u largua nga qyteti, por e arrestuan gjatë udhëtimit për në shtëpi dhe e kthyen mbrapsht të shoqëruar me ushtarë dhe të lidhur me pranga. Kur u paraqit perpara këshillit, përpjekjet e tij për t'iu përgjigjur akuzave që i bëheshin, u mbytën nga thirrjet: "Në zjarr bashkë me të! Në zjarr!" - Bonnechose, vëll 1, fq. 234. Atë e flakën në qeli, të lidhur duar e këmbë, ku i jepnin vetëm bukë e ujë. Pas disa muajsh burg, trajtimi mizor që iu bë, la gjurmë në shëndetin e tij dhe ai u sëmur për vdekje. Armiqtë e tij, duke pasur frikë se mund t'u shpëtonte nga duart, e trajtuan pak më mirë. Ai vazhdoi të qëndronte në burg për një vit.

Rezultati i vdekjes së Hussit nuk kishte qënë ai që mendonin papistët. Shkelja e lejekalimit të tij kishte ngjallur një zemërim të madh dhe kështilli vendosi të ndiqte një rrugë të mesme; në vend që ta dënonte me djegie Jeromin, ata vendosën ta detyronin të tërhiqej. Ai u thirr përpara trupit gjykues dhe u detyrua të zgjidhte mes braktisjes së doktrinave të tij dhe vdekjes mbi turrën e druve. Vdekja, në fillim të burgimit të tij, do të kishte qënë një çlirim përpara vuajtjeve të tmerrshme që duroi; por tani, i dobësuar nga sëmundja, nga tmerret e burgut, nga ankthi dhe pritja e gjatë, larg miqve të tij dhe i dekurajuar nga vdekja e Hussit, ai pranoi t'i nënshtrohet kështillit. Ai u shfaq si përkrahës i besimit Katolik dhe i quajti të drejta veprimet që kishte marrë kështilli ndaj Wyciffit dhe Hussit, duke pranuar sidoqoftë "të vërtetat e shenjta" që kishin predikuar ata.

Nëpërmjet kësaj thënieje ai u përpoq që ta fashiste zërin e ndërgje gjes e t'i shpëtonte dënimit. Por në qetësinë e qelisë ai e kuptoi më qartë se ç'kishte bërë. Ai kujtoi guximin dhe besnikërinë e Hussit dhe i krahasoi këto me poshtërsinë e vet. Mendja i shkoi tek Mësuesi hyjnor, të cilit ishte betuar t'i shërbente; i Cili kishte duruar për hirin e tij vdekjen mbi kryq. Përpara dorëzimit e kishte ngushëlluar dashamirësia dhe simpatia e Perëndisë; por tani shpirtin ia brenin dyshimet dhe keqardhja. Ai e dinte se paqja me Romën nuk sigurohej vetëm me një mohim të vetëm. Ai i kishte hyrë një rruge që do ta çonte në apostazi të plotë. Më së fundi vendosi: nuk do ta mohonte Zotin e tij për t'i shpëtuar një periudhe të shkurtër vuajtjesh.

Nuk kaloi shumë kohë dhe atij iu kërkua që të paraqitej sërisht përpara këshillit. Gjykatësit nuk ishin të kënaqur nga dorëzimi i tij. Etja e tyre për gjak, e ndezur nga vdekja e Hussit, mund të shuhej vetëm me viktima të reja. Jeromi e tërhoqi deklaratën e tij të parë dhe kërkoi që t'i jepej mundësia e fundit për t'u mbrojtur. Prelatët, duke iu trembur fjalëve të tij, ngulën këmbë që ai ose t'i pranonte ose t'i hidhte poshtë akuzat që i bëheshin

Jeromi protestoi kundër kësaj padrejtësie dhe mizorie: "Më mbajtët të mbyllur për treqind e dyzet ditë në një qeli të frikshme, - tha ai, - në mes të papastërtisë, lagështirës, erës së qelbur dhe mungesës së pothuajse gjithçkaje. Më pas më thirrët para jush dhe ndërsa u vinit veshin fjalëve të armiqve të mi, nuk pranuat të më dëgjonit.... Në qoftë se me të vërtetë jeni njerëz të mençur dhe drita e botës, kini kujdes të mos mëkatoni ndaj drejtësisë. Sa për mua, unë jam një qënie e dobët njerëzore; jeta ime ka pak rëndësi dhe kur ju bëj thirrje që të mos merrni një vendim të padrejtë, flas më shumë në të mirën tuaj se sa timen." - Ibid, vëll. 2, fq.146, 147.

Më së fundi, kërkesa e tij u mor parasysh. në prani të gjykatësve, Jeromi u ul në gjunjë dhe u lut që Shpirti i Shenjtë të kontrollonte mendimet dhe fjalët e tij, në mënyrë që të mos thoshte asgjë që binte ndesh me të vërtetën apo nuk përfaqësonte denjësisht Mësuesin e tij. Me të, atë ditë, u përmbush premtimi që u bëri Jezusi dishepujve të parë: "Do t'ju çojnë përpara guvernatorëve dhe përpara mbretërve për shkakun tim.... Por, kur t'ju dorëzojnë në duart e tyre, mos u shqetësoni se çfarë dhe si do të flisni, sepse nuk do të jeni ju që do të flisni, por Fryma e Atit tuaj që do të flasë në ju." - Mateu 10:18-20.

Fjalët e Jeromit i habitën dhe i mahnitën edhe vetë armiqtë e tij. Për një vit të tërë, ai ishte varrosur për së gjalli në një qeli burgu, pa parë e pa lexuar, duke vuajtur fizikisht dhe mendërisht e megjithatë, ai i parashtroi argumentet që solli me një qartësi dhe forcë të tillë të madhe, si të kishte studjuar për një vit rresht ditë e natë. Ai e tërhoqi vëmendjen e dëgjuesve në listën e gjatë të shenjtorëve që ishin dënuar nga gjykatës të padrejtë. Nga çdo brez kanë dalë njerëz, që megjithëse përpiqeshin t'i lartësonin bashkëkohësit e tyre, përçmoheshin e dëboheshin. Vetëm më vonë njerëzit e kuptuan se ata meritonin të nderoheshin. Vetë Krishti u dënua si keqbërës nga një gjykatës i padrejtë.

Gjatë tërheqjes së tij, Jeromi kishte pranuar drejtësinë e vendimit që e dënonte Hussin me vdekje, tani ai theksoi se ishte penduar dhe dëshmoi për pafajësinë dhe shenjtërinë e martirit: "E kisha shok fëmijërie, - tha ai. - Ishte një njeri i përsosur, ishenjtë dhe i drejtë; ai u dënua edhe pse ishte i pafajshëm.... Edhe unë jam gati të vdes: nuk do të zbrapsem përpara torturave që më kanë përgatitur armiqtë e mi dhe dëshmitarët e rremë, që do t'i japin një ditë llogari për të gjitha padrejtësitë e tyre, Perëndisë së madh që askush nuk mund ta mashtrojë." - Bonnechose, vëll.2, fq. 151.

I penduar për sjelljen e tij, Jeromi vazhdoi: "Nga të gjithë mëkatet që kam kryer në rini, asnjëri nuk më rëndon më shumë në shpirt dhe nuk më vret më shumë në ndërgjegje sa ai që kreva në këtë vend fatal, kur miratova dënimet e Wycliffit dhe martirit të shenjtë John Huss, mësuesit dhe mikut tim. Po! Deklaroj me tmerr dhe e pohoj me gjithë shpirt se kam gabuar, kam gabuar shumë, kur nga frika e vdekjes, ikam dënuar doktrinat e tyre. Prandaj lutem.... O Zot i plotfuqishëm, m'i fal mëkatet e mia dhe veçanërisht më fal këtë mëkat që është më i urryeri nga të gjithë." Duke treguar me gisht, gjykatësit e tij, ai tha me vendosmëri: "Ju i dënuat Wycliffin dhe John Hussin, jo sepse kishin flakur tej doktrinat e kishës, por sepse guxuan të protestonin kundër skandaleve që mbanin vulën e klerit - kundër krenarisë, madhështisë dhe të gjitha veseve të tjera të prelatëve dhe priftërinjve. Unë deklaroj dhe i mbështes të gjitha gjërat që kanëtheksuar ata e që janë të pamohueshme."

Diskutimi i tij u ndërpre. Prelatët, duke u dridhur nga inati, thirrën: "A ka më nevojë për prova të tjera? Ne kemi përpara syve heretikun më të tërbuar!"I patrembur nga furtuna, Jeromi u përgjigj: "Mendoni se kam frikë nga vdekja? Më mbyllët për një vit në një burg më të tmerrshëm se vetë vdekja; më keni trajtuar më mizorisht se një turk, çifut apo pagan dhe u treta si qiri, megjithatë nuk ankohem, se ankesat ta dobësojnë shpirtin e ta mundojnë zemrën, por çuditem kur shoh barbaritetin me të cilin trajtoni një të Krishterë." - Ibid, vëll. 2 fq. 151- 153

Stuhia e inatit shpërtheu sërisht dhe Jeromi u çua në burg. Megjithatë, mes atij grupi njerëzish, pati nga ata që u mahnitën nga fjalët e tij aq shumë saqë donin t'i shpëtonin jetën.

Autoritete të kishës shkuan ta takonin e ta detyronin t'i dorëzohej këshillit. Atij iu premtuan si shpërblim gjëra nga më joshëset, në rast se do të hiqte dorë nga lufta kundër Romës. Por ashtu siç nuk u dha Mësuesi kur iu premtua lavdia e kësaj bote, edhe Jeromi qëndroi i papërkulur.

"Provomëni se po gaboj duke përdorur Shkrimet e Shenjta, - tha ai, - dhe unë do të dorëzohem.""Shkrimet e Shenjta! - thirri njëri nga kundërshtarët e tij. - A mos duhet të gjykohet gjithçka sipas tyre? Kush mund t'i kuptojë ato në qoftë se kisha nuk i ka interpretuar akoma?"

"A mos vallë duhet t'u besojmë traditave njerëzore më shumë se ungjillit të Shpëtimtarit? - u përgjigj Jeromi. - Pali nuk u bëri thirrje njerëzve, të cilëve u shkruajti, që të udhëhiqeshin nga traditat e njerëzve, por përkundrazi që të hetonin Shkrimet e Shenjta."

Përgjigja që mori ishte kjo: "Heretik! Mëvjen keq që t'u luta për një kohë kaq të gjatë. Tani e kuptoj që ti frymëzohesh nga djalli." - Wylie, libri 3, kap. 10.

Pa kaluar shumë kohë, ai u dënua me vdekje. Atë e çuan në të njëjtin vend ku humbi jetën Hussi. Ai këndoi gjatë gjithë rrugës ndërsa fytyra i shkëlqente nga gëzimi dhe paqja. Sytë e tij shikonin ngultazi Krishtin dhe vdekja kishte hum-

bur fuqitë e saj përpara tij. Kur ekzekutori që do t'u vinte zjarrin druve, idoli nga mbrapa, martiri i tha: "Veru zjarrin druve përpara syve të mi! Sikur t'i trembesha vdekjes nuk do të isha këtu."

Fjalët e fundit që tha, ndërsa zjarri bubuloi, ishin fjalë lutjeje: "Zot, i dashur At i plotfuqishëm, - thirri ai, - ki mëshirë për mua dhe m'i fal mëkatet e mia sepse Ti e di që unë e kam dashur gjithmonë të vërtetën Tënde." - Bonnechose, vëll 2,fq.168.

Zëri i tij nuk u dëgjua më, por buzët e tij vazhduan të lëviznin. Kur zjarri e dogji kokë e këmbë, hiri i eshtrave të martirit bashkë me dheun ku ndodheshin, u mblodhën dhe si ato të Hussit, u hodhën në lumin Ren.

Kështu u zhdukën pishtarmbajtësit e Perëndisë, por drita e së vërtetave që shpallën ata - drita e shembullit të tyre heroik - nuk mund të shuhej sepse i ngjante diellit, që sado që njerëzit të përpiqen t'i ndryshojnë drejtimin, do të lindë për të treguar agimin e një drite të re.

Ekzekutimi i Hussit kishte ngjallur zemërim dhe tmerr në Bohemi. I gjithë kombi ishte i mendimit se ai kishte rënë pre e keqdashjes së priftërinjve dhe tradhëtisë së perandorit. Njerëzit besonin se ai kishte qënë një mësues besnik i së vërtetës dhe faji për vdekjen e tij binte mbi anëtarët e këshillit. Doktrinat e tij ngjallnin një interes shumë më të madh se mëparë. Shkrimet e Wycliffit u dogjën për shkak të një dekreti të miratuar nga papati; por një pjesë e tyre i shpëtoi shkatërrimit dhe pikërisht këto kopje dolën nga vendet ku ishin fshehur dhe u studjuan së bashku me Biblën apo me pjesë të veçanta të saj - sipas mundësisë së njerëzve për t'i gjetur ato - dhe kjo bëri shumë njerëz që ta pranonin besimin e reformuar.

Vrasësit e Hussit nuk qëndruan duke soditur duarkryq triumfin e kauzës së tij. Papa dhe perandori bashkuan forcat për t'i bërë varrin kësaj lëvizjeje dhe ushtritë e Sigismundit marshuan drejt Bohemisë.

Nga gjiri i popullit doli një udhëheqës, Ziska, që fill pas fillimit të luftës u verbua e megjithatë mbeti një nga gjeneralët më të zotë të kohës së tij, u bë kreu drejtues i Bohemianëve. Duke i besuar ndihmës së Perëndisë dhe drejtësisë së kauzës së tyre ky popull i bëri ballë ushtrive më të fuqishme të asaj kohe. Perandori, duke mbledhur ushtarë të rinj, e pushtoi disa herë Boheminë, por po aq herë u zbraps me turp. Hussitët (përkrahësit e Hussit) nuk i trembeshin vdekjes dhe asgjë nuk mund ta përballonte vrullin e tyre. Pas pak vjetësh, Ziska trim vdiq dhe vendin e tij e zuri Procopiusi që ishte një gjeneral po aq i guximshëm dhe i zoti.

Armiqtë e Bohemianëve, kur dëgjuan që gjenerali i verbër vdiq, menduan se kishte ardhur çasti i volitshëm për të rifituar gjithçka që kishin humbur. Papa organizoi një kryqëzatë kundër Hussitëve dhe forca të shumta sulmuan Boheminë, por ata u tërhoqën me bisht ndër shalë. Një kryqëzatë e dytë pasoi të parën. Municione, të holla dhe njerëz "u volën" nga vendet evropiane që ndodheshin nën sundimin e papatit. Turma të panumërta ushtarësh u rekrutuan nën flamurin e papës, të bindur

për fundin e tmerrshëm të heretikëve Hussianë. Ushtria e stërmadhe hyri në Bohemi. Populli ishte gati për t'i pritur. Ushtritë marshuan në drejtim të njëratjetrës derisa arritën në një vend ku vetëm një lumë i ndante. "Ushtritë e papës kishin epërsi në numër, por në vend që ta kapërcenin lumin e t'i jepnin fund betejës me Hussitët që kishin ardhur nga larg për t'i shkatërruar, mbetën në vend duke vëzhguar në heshtje luftëtarët." Wylie, libri 3, kap.17. Papritur, ata i pushtoi një frikë e tmerrshme dhe pa pësuar asnjë humbje, ajo forcë e madhe u shpërbë dhe u shpërnda kuturu si të ishte sulmuar nga një fuqi e padukshme. Ushtria Hussite, që u vu në ndjekje të tyre, vrau shumë ushtarë dhe mblodhi shumë plaçkë lufte, kështu që lufta, në vend që ta varfëronte Boheminë, e pasuroi atë.

Pas disa vitesh, papa i ri organizoi një kryqëzatë të tretë. Ashtu si më parë, vendet Katolike evropiane shërbyen si burim njerëzish dhe të hollash. Të mëdha ishin premtimet që iu bënë të gjithë atyre që do t'i hynin kësaj rruge të rrezikshme. Çdo luftëtari në kryqëzatë iu premtua falja e çdo mëkati, sado i rëndë të ishte ai. Të gjithë që do të vriteshin në luftë do të shpërbleheshin bujarisht në qiell, ndërsa të tjerët që do të mbeteshin gjallë do të merrnin pjesën që u takonte nga plaçka e luftës. U organizua përsëri një ushtri tepër e madhe, që duke kaluar kufirin, hyri në Bohemi. Forcat Hussite filluan të tërhiqeshin, duke i drejtuar pushtuesit të marshonin gjithnjë e më në brendësi të vendit e duke i bërë ata të mendonin se tashmë fitorja ishte e tyre. Më së fundi, ushtria e Procopiusit ndaloi dhe filloi të përparonte drejt armikut. Papistët, me të vënë re gabimin që kishin bërë, ngritën kampet e tyre në pritje të rrjedhës së ngjarjeve. Sapo dëgjuan zhurmën e afrimit të Hussitëve, ende pa i parë ata, ushtarët i pushtoi përsëri paniku. Princët, gjeneralët dhe ushtarët e thjeshtë, duke hedhur armët, u larguan me të katra në drejtime të ndryshme. Më kot u përpoq t'i mblidhte përfaqësuesi i papatit, që ishte njëkohësisht edhe udhëheqësi i kryqëzatës, forcat e trembura e të çorientuara. Pavarësisht nga përpjekjet e tij, vala e "refugjatëve" e mori edhe atë me vete. Fitorja ishte e plotë dhe në duart e fitimtarëve ra përsëri një plaçkë e majme lufte.

Për të dytën herë, një ushtri e madhe e dërguar nga vendet më të fuqishme evropiane, e përbërë nga njerëz trima e luftëtarë të stërvitur mirë e të armatosur rëndë, u largua me bisht në shalë përballë mbrojtësve të një vendi të vogël e të pafuqishëm. Ai ishte një manifestim i fuqisë hyjnore. Pushtuesit i pushtonte një tmerr mbinatyror. Ai që i mbyti ushtritë e Faraonit në Detin e Kuq, që i bëri të zbrapseshin ushtritë e mideasve përpara Gideonit dhe treqind bashkëluftëtarëve të tij, që brenda një nate i shfarosi forcat e Asirisë, e kishte shtrirë dorën e Tij përsëri për ta asgjësuar armikun. "I ka zënë një frikë e madhe, aty ku nuk kishte arsye për frikë, sepse Perëndia i ka shpërndarë eshtrat e atyre që ngrihen kundër teje. Ti i mbulove me turp sepse Perëndia i ka hedhur poshtë." - Psalmet 53:5.

Udhëheqësit e papatit, kur e kuptuan se nuk mund të fitonin me forcë, përdorën diplomacinë. Kështu u arrit në një kompromis, që ndërsa dukej sikur u jepte

bohemianëve liri besimi dhe ndërgjegjeje, në të vërtetë i vendoste ata nën thundrën e Romës. Bohemianët kishin theksuar katër pika të rëndësishme si kushte për traktatin e paqes me Romën: të drejtën e të gjithë kishës për të ngrënë bukën dhe për të pirë verën gjatë shërbesës së komunionit dhe kryerjen e adhurimit fetar në gjuhën amtare; përjashtimin e klerit nga të gjitha postet apo pozitat qeveritare dhe në raste shkeljesh apo krimesh, juridiksioni i gjyqit civil të ishte i njëjtë si për laikët, ashtu edhe për autoritetet kishëtare. Më së fundi autoritetet e Romës "ranë dakort që t'i pranonin të katër kërkesat e Hussitëve, por me kusht, që e drejta për t'i shpjeguar ato, domethënë për të përcaktuar rëndësinë e tyre, i takonte këshillit - pra papës dhe perandorit." Wylie, libri 3 kap 18. Mbi bazë të kësaj deklarate u lidh një marrëveshje dhe Roma me shtirje dhe amshtrim fitoi atë ç'ka nuk kishte mundur të fitonte me luftë, sepse duke i interpretuar sipas dëshirës së saj kërkesat e Hussitëve, ajo, ashtu siç kishte vepruar edhe me Biblën, mund ta shtrembëronte kuptimin e tyre për të arritur qëllimet e saj.

Një numër i madh Bohemianësh, duke e kuptuar se kjo marrëveshje vinte në rrezik lirinë e tyre, nuk u pajtuan me të. Lindën kështu grupimet dhe përçarjet që çuan në gjakderdhje mes vetë popullit. Në këtë luftë humbi jetën edhe Procopiusi trim dhe së bashku me të i erdhi fundi edhe lirisë bohemiane.

Sigismundi, tradhëtari i Hussit dhe Jeromit, tani u ul mbi fronin e Bohemisë dhe pa marrë parasysh zotimin që kishte bërë për t'i mbrojtur të drejtat e Bohemianëve, i hapi dyert papatit. Por ai përfitoi fare pak nga servilizmi i tij ndaj Romës. Jeta e tij këta njëzet vjetët e fundit, ishte kthyer në një fushë beteje dhe rreziqesh. Ushtritë dhe pasuria e tij ishin rrënuar nga lufta e gjatë dhe e pafrytshme dhe pasi mbretëroi për një vit, ai vdiq, duke e lënë mbretërinë në prag të luftës civile dhe duke u lënë brezave të ardhshëm si trashëgim një emër të përbaltur me turp.

Trazirat, mosmarrëveshjet dhe gjakderdhja vazhduan. Ushtritë e huaja e pushtuan përsëri Boheminë, që po e gërryenin nga brenda edhe përçarjet dhe grupimet e shumta. Ata që vazhduan t'i qëndronin besnikë ungjillit ranë pre e një persekutimi të përgjakshëm.

Ndërsa miqtë e tyre, duke hyrë në kontakt me Romën, u infektuan nga gabimet e saj, ai grusht besnikësh të besimit të parë formuan një kishë të veçantë që i vunë emrin "Vëllezërit e bashkuar." Një akt i tillë ngjalli pakënaqësinë e të gjithëve. Megjithatë qëndrueshmëria e tyre nuk u lëkund. Të detyruar për të gjetur strhë në pyje e guva, ata vazhdonin të mblidheshin për të lexuar fjalën e Perëndisë dhe për ta adhuruar Atë.

Ata mësuan nga lajmëtarët që dërguan në vende të ndryshme, se andejkëtej "kishte rrëfyes të tjerë të së vërtetës që si ata ishin kthyer në qytetet e tyre në objekt të persekutimit dhe se mes Alpeve ekzistonte një kishë e vjetër që bazohej tek Shkrimet e Shenjta dhe që protestonte kundër korrupsionit idhujtar të Romës." Wylie,

libri 3, kap. 19. Ky lajm u prit me gëzim të madh dhe ata filluan korrespondencën me të Krishterët Valdezë.

Të patundur ndaj besimit të tyre tek ungjilli, Bohemianët i kaluan netët e gjata e të errëta të persekutimit me sytë ngulur në horizont duke pritur agimin e ditës së re. "Fati i bëri të përjetonin kohë të vështira.... por atyre iu kujtoheshin fjalët e Hussit dhe Jeromit që thoshin se dita do të lindë ndoshta pas një shekulli. Këto fjalë ishin për Hussitët si fjalët e Jozefit drejtuar fiseve në robëri të Izraelit: "Unë do të vdes, por Perëndia nuk do t'iu harrojë e do t'iu nxjerrë jashtë." - Ibid, libri 3, kap 19. "Fundi i shekullit të pesëmbëdhjetë shënoi një rritje të ngadalshme, por të sigurtë në numër të kishave të Vëllezërve. Edhe pse shpesh viheshin në shënjestër, ata gëzuan deridiku një liri të pakufizuar. Në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë kishte pothuaj dyqind kisha të tilla në Bohemi dhe Moravi." - Ezra Hall Gillet, "Life and Times of John Huss", vëll 2, fq.570

"Kështu rezultoi teprica, që duke i shpëtuar tërbimit shkatërrues të zjarrit dhe shpatës, pa me sytë e saj agimin e asaj dite, që ishte parashikuar dikur nga Hussi." - Wylie, libri 3, kap 19.

1. Në Pragë, ekzistonte një pikturë murale e punuar nga dy burra anglezë që vinin në contrast Jezusin dhe Papën. Çfarë kishte aty në atë pikturë që ndikoi aq shumë tek Huss duke influencuar në shërbesën e Tij të ardhshme?

2. Çfarë po bënte Hussi që tërhoqi vëmendjen e papatit të Romës? Përse ishin kërcënuese veprimet e tij për papatin?

3. Vini në kontrast karakteret e Huss dhe Jerome. Çfarë mund të mësojmë nga bashkëpunimi i tyre? Përse Huss nuk pranoi të hiqte dorë nga "gabimet" e tij? Si mund të ishte në gjendje ai të këndonte ndërkohë që po digjej në shtyllën e drurit? Jerome u përfshi në këshill, por më pas ai ndërroi mendje. Cili autoritet po i drejtohej ai?

4. Huss dhe Jerome ishin të talentuar, predikues efektiv të ungjillit të Krishtit. Për shkak të kësaj, jetët e tyre përfunduan shpejt. Edhe pse vdiqën shpejt, e vërteta që ata predikuan jetoi në Bohemi dhe u shpërnda nëpër botë. Çfarë na mëson kjo gjë në lidhje me fuqinë e të vërtetës që gjendet në Shkrime? Shih 2 Pjetrit 1:12-21.

7.

Ndarja e Luterit nga Roma

Martin Luteri është figura më e shquar mes gjithë atyre njerëzve, që u thirrën për ta udhëhequr kishën nga errësira e papatit, në dritën e besimit të kulluar. I zellshëm, i zjarrtë e i devotshëm, duke mos respektuar asgjë tjetër përpara Perëndisë dhe duke i quajtur Shkrimet e Shenjta themelin e vetëm të besimit, Luteri ishte njeriu që i duhej më shumë kohës së tij; Zoti e përdori atë për të kryer një punë të madhe në reformacionin e kishës dhe në ndriçimin e botës mbarë.

Ashtu si lajmëtarët e parë të Ungjillit, edhe Luteri rridhte nga një familje e varfër. Fëmijërinë e kaloi në një shtëpi të thjeshtë fshatare në Gjermani. Babai i tij, duke punuar si minator, e ndihmoi të arsimohej me të ardhurat e tij të pakta. Familja e tij donte që ai të bëhej gjykatës, por Perëndia i propozoi punën e ndërtuesit të tempullit të madh, që po ngrihej ngadalë nga shekulli në shekull. Vështirësitë, sakrificat dhe disiplina e rreptë përbënin programin mësimor që Mençuria Pafund përdori për ta përgatitur Luterin për misionin më të rëndësishëm të jetës së tij.

Babai i Luterit ishte një njeri me mendje pjellore, me karakter të fortë, i ndershëm dhe energjik. Ai i qëndronte besnik detyrimeve të tij pa marrë parasysh rrjedhimet që mbartnin në vetvete ato. Arsyetimi i tij i shëndoshë e kishte bërë t'i shikonte me përçmim manastiret dhe u zemërua shumë kur Luteri, pa lejen e tij, hyri në një të tillë. Babë e bir u pajtuan vetëm pas dy vjetësh e madje edhe atëherë, ai kishte mbetur i të njëjtit mendim.

Prindërit e Luterit bënë çmos për edukimin e fëmijëve të tyre. Ata u përpoqën t'u jepnin atyre njohuri të mjaftueshme për Zotin dhe t'i edukonin me virtytet e vërteta Kristiane. Shpesh herë ati lutej me zë të lartë në prani të të birit, që fëmija e tij të kujtonte emrin e Zotit sa të kishte jetë e të ndihmonte në përhapjen e së vërtetës. Ata bënë ç'është e mundur që t'i përgatisnin fëmijët e tyre për një jetë të devotshme e të dobishme. Duke pasur një karakter të fortë ndodhte jo rrallë që të tregoheshin tepër të ashpër, por vetë Reformatori, edhe pse i ndërgjegjshëm për disa gabime të tyre, më shumë e miratonte se sa e qortonte disiplinën e tyre.

Në shkollën fillore e trajtuan me ashpërsi dhe dhunë. Varfëria e familjes së tij ishte aq e madhe, saqë atij i duhej për të siguruar bukën e gojës të këndonte derë më derë gjatë rrugës nga shtëpia në shkollë, që ndodhej në një qytet tjetër, dhe shpesh vuante nga uria. Atë e trembnin idetë fetare supersticioze, që mbizotëronin në atë kohë. Shpesh gjatë natës ai brengosej e dridhej kur mendonte për të ardhmen e errët dhe për Perëndinë - gjykatës të ashpër e të pamëshirshëm; për këtë tiran mizor që s'është asgjë tjetër veçse një At i dashur qiellor.

Megjithatë, pa i marrë parasysh këto fakte dekurajuese, Luteri ecte përpara, gjithmonë përpara, drejt një ideali të lartë madhështie morale dhe intelektuale, që e tërhiqte si magnet. Etja e tij për dije dhe mendja e tij praktike dhe aktive e shtynë të dëshironte konkreten dhe të dobishmen e jo boshen dhe sipërfaqësoren.

Kur në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare filloi studimet në Universitetin e Erfurit, gjendja e tij ishte më e favorshme dhe perspektivat e tij më të qarta se më parë. Prindërit e tij, falë punës dhe ekonomisë familjare të kursyer, ishin në gjendje tani që ta ndihmonin më shumë. Nga ana tjetër, shoqëria e zgjedhur e ndihmoi që deri - diku t'i harronte efektet negative të edukimit të tij të mëparshëm. Ai i hyri studimit të veprave të autorëve më të mirë, duke i ruajtur si thesare mendimet e tyre më të rëndësishme dhe duke mësuar prej mençurisë së tyre. Që në moshë të re, pavarësisht nga disiplina e rreptë e mësuesve të tij të parë, ai kishte dhënë prova inteligjence dhe tani, falë disa ndikimeve pozitive, mendja e tij u zhvillua akoma më me shpejtësi. Kujtesa e

tij e pagabueshme, imagjinata e gjallë, gjykimi i shëndoshë dhe përpjekjet e zellshme, e bënë atë të dallohej mes shokëve të tij të shkollës. Disiplina intelektuale poqi gjykimin e tij dhe ngjalli tek ai një mprehtësi perceptimi të admirueshme që e përgatitën atë, që në moshë të re, për t'i bërë ballë koflikteve të jetës.

Respekti ndaj Perëndisë kishte hedhur rrënjë me kohë në zemrën e Luterit, duke i falur atij qëndrueshmëri mendimi dhe përulshmëri përpara Tij. Ai ishte më se i ndërgjegjshëm se kishte nevojë për ndihmën hyjnore dhe nuk harronte kurrë ta fillonte ditën duke iu lutur Zotit për udhëheqje dhe mbështetje. "Të lutesh mirë, - thoshte shpesh, - vlen sa gjysma e studimit." - [1].

Një ditë, ndërsa po kërkonte mes librave të bibliotekës universitare, Luteri gjeti një Bibël latine. Ai nuk kishte parë kurrë një libër të tillë, madje as nuk kishte dëgjuar ndonjëherë për ekzistencën e tij. Ai kishte dëgjuar pasazhe nga Ungjijtë dhe Letrat, që u lexoheshin njerëzve gjatë adhurimeve publike dhe mendonte se ato përbënin Biblën. Tani, për herë të parë, ai kishte në dorë fjalën e plotë të Perëndisë. I frikësuar dhe i mahnitur, ai shfletoi faqet e shenjta dhe në mënyrë të ethshme, me zemrën që i rrihte fort lexonte fjalët e jetës, duke ndaluar aty - këtu për të thënë: "Oh sikur Zoti të ma jepte edhe mua një libër të tillë!"[2]. Engjëjt qiellorë i qëndronin

[1] D'Aubigne, libri 2, kap. 2.

[2] Ibid, libri 2, kap. 2.

pranë dhe rrezet e dritës, që zbrisnin nga froni i Perëndisë i zbulonin atij thesaret e së vërtetës. Ai gjithmonë kishte pasur frikë se mos e ofendonte Zotin, por tani ai ishte më se i bindur për gjendjen e tij të mjerë si mëkatar që ishte.

Dëshira e madhe dhe e ethshme për t'u çliruar nga mëkati dhe për të gjetur paqe me perëndinë e shtyu atë që t'i hynte jetës së manastirit. Këtu iu kërkua që të kryente punë nga më të ulëtat dhe të lypte derë më derë. Ai ishte në një moshë, kur respekti dhe vlerësimi i të tjerëve, ka më shumë vlerë se gjithçka tjetër dhe këto detyra kaq poshtëruese i lëndonin jo pak ndjenjat e tij njerëzore, por ai i duronte të gjitha këto duke besuar se ishin të nevojshme për të shlyer mëkatet e tij.

Pas kryerjes së detyrave të përditshme, çdo moment të lirë ia kushtonte studimit, duke kaluar shpesh netë të tëra pa gjumë dhe duke u ankuar për kohën e humbur kot gjatë ngrënies së atij ushqimi të pakët. Studimi i fjalës së Perëndisë e kënaqte shpirtin e tij mbi çdo gjë tjetër. Ai kishte gjetur një Bibël të lidhur me zinxhirë në murin e konviktit dhe shpesh shkonte tek ai vend. Me rritjen e bindjes se ai ishte një mëkatar i mjerë e asgjë tjetër, ai u përpoq akoma dhe më shumë që të fitonte falje dhe paqe nëpërmjet veprave të mira. Bënte një jetë të ndershme, duke u përpjekur që me agjërime, netë pa gjumë e keqtrajtime ndaj trupit, ta mposhte natyrën e tij mëkatare që jeta e murgut nuk kishte mundur ta ndryshonte. Ai nuk i shmangej asnjë sakrifice që mund ta ndihmonte të fitonte atë pastërti dhe drejtësi, që do t'i jepnin atij mundësi të qëndronte përpara Perëndisë. "Isha me të vërtetë një murg i zellshëm, - thoshte ai më pas, - dhe i respektoja rregullat e urdhërit ku bëja pjesë rreptësisht. Në qoftë se ndonjë murg do të mundte të shkonte në qiell falë veprave të tij, unë padyshim do të kisha pasur atë nder.... Në qoftë se do të kisha vazhduar edhe më gjatë, mundimet e mia do të më kishin çuar në varr."[3] Si rrjedhim i kësaj disipline çnjerëzore ai u dobësua dhe vuajti nga një sëmundje, që shoqërohej me marrje fryme e gjendje të fikti, pasojat e të cilës i ndjeu gjatë gjithë jetës. Megjithë përpjekjet e shumta, shpirti nuk i gjeti paqe. Më së fundi kaloi në një gjendje dëshpërimi.

Kur Luterit iu duk se kishte humbur çdo shpresë, Perëndia i dërgoi një ndihmës dhe një mik. Staupitzi i devotshëm e ndihmoi Luterin që ta kuptonte fjalën e Perëndisë dhe e nxiti që të hiqte dorë nga vuajtjet personale dhe të mos mendonte për dënimin e përjetshëm që mbart në vetvete shkelja e ligjit të Zotit, por të përqëndrohej tek Jezusi, tek ky Shpëtimtar që fal mëkatet. "Në vend që të vetëtorturohesh për shkak të mëkateve të tua, hidhu në krahët e Çliruesit, besoji Atij, drejtësisë së jetës së Tij dhe shlyerjes që sjell vdekja e Tij.... Dëgjoje Birin e Perëndisë! Ai u bë njeri që të të jepte ty sigurinë e dashamirësisë qiellore. Duaje Atë, sepse Ai të deshi i pari."[4] Kështu foli ky lajmëtar i mëshirës. Fjalët e tij lanë gjurmë të thellë në mendjen e Luterit. Pas shumë përpjekjesh të gjata, ai më së fundi e gjeti të vërtetën dhe ndjeu paqe në shpirtin e e tij të trazuar.

[3] Ibid, libri 2, kap. 3.

[4] Ibid, libri 2, kap. 4.

Luteri u shugurua prift dhe u caktua në detyrën e profesorit në Universitetin e Wittenbergut. Këtu ai i hyri studimeve të Shkrimeve të Shenjta në gjuhët origjinale. Filloi të japë leksione mbi Biblën dhe dëgjuesit e emocionuar mësuan për Psalmet, Ungjijtë dhe Letrat. Staupitzi, miku dhe eprori i tij, e nxiti që të hipte në podium e të predikonte fjalën e Perëndisë. Luteri hezitoi, sepse nuk e quante veten të denjë për t'u folur njerëzve në vend të Krishtit. Vetëm pas shumë përpjekjesh nga ana e mikut të tij, ai pranoi ta bënte një gjë të tillë. Tashmë ai ishte i përgatitur në lidhje me Shkrimet e Shenjta dhe hiri i vetë Perëndisë e ndihmoi. Elokuenca e tij i bëri për vete dëgjuesit, fuqia dhe qartësia me të cilat e parashtronte të vërtetën i bindën ata dhe zelli i tij i preku zemrat e tyre.

Luteri vazhdonte të ishte në atë kohë një bir i denjë i Kishës së Romës dhe as që nuk i shkonte ndër mend se mund të ishte ndryshe. Vullneti i Perëndisë e çoi të vizitonte Romën. Ai e filloi udhëtimin e tij në këmbë, duke ndaluar për të kaluar natën, në manastiret e ndryshme përgjatë rrugës. Në një manastir në Itali, ai u çudit nga pasuria, madhështia dhe luksi që i panë sytë. Duke gëzuar rendin princëror, murgjët jetonin në banesa të mrekullueshme, visheshin me rroba nga më të shtrenjtat dhe uleshin përpara një tryeze madhështore. Me dhimbje të madhe, Luteri krahasoi këtë skenë me vetëmohimin që kishte përballuar në jetë. Filloi të çoroditej.

Më së fundi, pa në largësi qytetin e shtatë kodrave. Me një emocion të thellë u gjunjëzua dhe tha: "Romë e shenjtë të përshëndes!"[5] Ai hyri në qytet, vizitoi kishat, dëgjoi përrallat e mrekullueshme, që tregonin priftërinjtë dhe murgjit dhe i ndoqi të gjitha ritet e duhura. Kudo syri i kapi skena që e çuditën dhe e befasuan. Ai vuri re se, midis të gjitha klasave të klerit, ekzistonte padrejtësia. Dëgjoi të dilnin nga goja e prelatëve shaka të papërshtatshme dhe u tmerrua nga ndyrësia, që nuk mungonte as gjatë meshës. Nga takimet që pati me murgj dhe njerëz të thjeshtë, kuptoi se çthurja dhe orgjitë mbizotëronin kudo. Duke shkuar atje ku duhej të shkonte, - në vendin e "shenjtërimit", - ai gjeti ndyrësi. "Askush nuk mund ta imagjinojë, - shkruan ai, - se çfarë mëkatesh dhe veprimesh të padenja kryhen në Romë, duhet t'i shikosh me sytë e tu e t'i dëgjosh me veshët e tu që t'i besosh. Mund të thuhet vetëm kaq:

"Në qoftë se ekziston ferri, Roma është ndërtuar mbi të. Ajo është një vullkan nga ku do të shpërthejnë të gjitha llojet e më-kateve."[6]

Me anë të një dekreti të ri, papa u kishte premtuar falje të gjithë atyre që do të zbrisnin me gjunjë "shkallën e Pilatit", nga e cila thuhej se kishte zbritur edhe Shpëtimtari ynë kur u largua nga salla e gjyqit dhe që kishte ardhur mrekullisht nga Jeruzalemi në Romë. Një ditë Luteri po ngjiste me devotshmëri këto shkallë, kur, papritur, një zë si bubullimë i tha: "I drejti do të jetojë me anë të besimit." - Romakët 1:17. Ai u ngrit në këmbë dhe u largua me nxitim nga ai vend i turpëruar dhe i tmerruar. Ai tekst mbeti i paharruar në zemrën e tij. Që nga ai moment, ai e

[5] Ibid, libri 2, kap. 6.

[6] Ibid, libri 2, kap. 6.

kuptoi akoma edhe më shumë kotësinë e besimit në veprat njerëzore për shpëtim dhe domosdoshmërinë e një besimi të vazhdueshëm në meritat e Krishtit. Sytë e tij u hapën, për të mos u mbyllur kurrë, përpara mashtrimeve të papatit. Me t'u larguar nga Roma, ai ishte larguar prej saj edhe me zemër dhe që nga ai moment ndarja u thellua gjithnjë e më shumë derisa ai i preu plotësisht lidhjet me kishën e papës.

Pas largimit të tij nga Roma, Universiteti i Wittenbergut e nderoi atë me titullin "Doktor i shenjtërisë." Tani, ai ishte i lirë t'u përkushtohej plotësisht Shkrimeve të tij të dashura. Ai ishte betuar solemnisht që do ta studionte me kujdes fjalën e Perëndisë dhe do të predikonte besnikërisht jo thëniet dhe doktrinat e papës, por mësimet e saj. Ai nuk ishte më një profesor apo murg i thjeshtë, por lajmëtari i autorizuar i Biblës. Ai ishte thirrur si bari për të ushqyer tufën e Perëndisë, që kishte etje dhe uri për të vërtetën. Deklaroi me forcë që të Krishterët nuk duhet të pranojnë asnjë doktrinë tjetër, përveç atyre që bazohen tek autoriteti i Shkrimeve të Shenjta. Ky pohim e godiste haptazi epërsinë e papatit nga themelet. Ai përbënte parimin jetik të Reformacionit.

Luteri vuri re rrezikun që sillte lartësimi i teorive njerëzore mbi fjalën e Perëndisë. Ai e sulmoi pa frikë pabesinë spekulative të kishëtarëve dhe e kundërshtoi filozofinë dhe teologjinë që i kishin skllavëruar njerëzit për një kohë të gjatë. Ai i quajti këto studime, jo vetëm pa vlerë, por edhe të rrezikshme dhe u përpoq t'i largonte mendjet e dëgjuesve të tij nga filozofët e teologët, për t'i drejtuar tek profetët e apostujt.

Mesazhi, që u përcolli ai turmave, që e dëgjonin me vëmendje çdo fjalë që dilte nga goja e tij, ishte i çmuar. Askush nuk kishte dëgjuar më parë mësime të tilla. Lajmi i mirë i dashurisë së Shpëtimtarit, siguria e paqes dhe faljes përmes gjakut të Tij shlyerës, i ngazëllenin zemrat dhe u ngjallnin atyre shpresën e pavdekshme. Në Wittenberg u ndez një dritë, rrezet e së cilës do të depërtonin deri në skajet më të largëta të botës dhe do të shkëlqenin më shumë në ditën e fundit.

Por drita dhe errësira nuk mund të bashkekzistojnë. Mes të vërtetës dhe gabimit ekziston një konflikt i përhershëm. Ngritja dhe mbrojtja e njërës, do të thotë, rënie dhe humbje e tjetrës. Vetë Shpëtimtari ynë deklaroi: "Nuk erdha të sjell paqen, por shpatën." *(Mateu 10:34)*. Pak vjet pas fillimit të Reformacionit, Luteri tha: "Perëndia nuk më udhëheq, por më shtyn përpara. Ai më frymëzon. Unë nuk jam zot i vetvetes. Do të dëshiroja të jetoj i qetë; por më hedhin mes konfliktesh dhe trazirash."[7]. Tashmë ai do të nxitej drejt një beteje të vërtetë.

Kisha romake kishte bërë tregti me hirin e Perëndisë. Tryezat e tregtarëve *(Mateu 21:12)* ishin vendosur përbri altarëve të saj dhe kudo dëgjoheshin thirrjet e shitësve dhe blerësve. Nën pretekstin e ngritjeve të fondeve për ndërtimin e Kishës së Shën Pjetrit në Romë, u shitën, me autorizimin e papës edhe faljet për mëkatet e ndryshme. Princi i krimit do të ndërtonte një tempull për adhurimin e Perëndisë

[7] D'Aubigne, libri 5, kap. 2.

- guri i qoshes i së cilit ishte blerë me të ardhura të mbledhura me padrejtësi. Por pikërisht, rrugët dhe mjetet që u përdorën për lartësimin e Romës, u kthyen në një goditje vdekjeprurëse për fuqinë dhe madhështinë e saj. Kjo i dha shkak lindjes së armikut më të vendosur e më të suksesshëm të papatit dhe çoi në betejën që e drodhi fronin e papës dhe e vuri në rrezik kurorën tricepëshe të tij.

Fetzeli, - zyrtari që u caktua për të drejtuar shitjen e faljeve në Gjermani, - ishte dënuar vazhdimisht për krime nga më të ulëtat kundër shoqërisë dhe kundër ligjit të Perëndisë; por duke i bërë bisht dënimit të këtyre krimeve, u ftua për të çuar më përpara projektet mercenare e të paskrupullta të papës. Me paturpësinë më të madhe, ai përsëriti gënjeshtrat më të ulëta dhe përrallat më të mrekullueshme për të mashtruar një popull të paditur e superstticioz. Sikur ta kishin studiuar fjalën e Perëndisë ata nuk do të ishin mashtruar aspak, por udhëheqësit e papatit, në mënyrë që t'i mbanin nën kontroll e të forconin pushtetin dhe pasurinë e tyre, e kishin kyçur Biblën kush e di se ku.[8]

Ndërsa Fetzeli hyri në qytet, një lajmëtar përpara tij thërriste: "Hiri i Perëndisë dhe i Atit të shenjtë është në portat tuaja."[9] Dhe njerëzit e mirëpritën gënjeshtarin blasfemues sikur Zoti Vetë të kishte zbritur nga qielli për ta. Tregtia e urryer do të zhvillohej në kishë dhe Fetzeli, duke u ngjitur në podium i paraqiti "faljet" si dhuratat më të çmuara të Perëndisë. Ai deklaroi që nëpërmjet çertifikatave të tij të faljes, blerësit do t'i faleshin të gjitha mëkatet që do të dëshironte të kryente dhe madje një gjë e tillë do të bëhej "pa pasur nevojë për t'u penduar."[10] Për më tepër, ai i siguroi dëgjuesit se faljet kishin aftësi të shpëtonin jo vetëm të gjallët, por edhe të vdekurit dhe sapo monedhat të hidheshin në arkë, shpirti për të cilin blihej falja, i shpëtonte purgatoritdhe nisej drejt parajsës.[11]

Kur Simon magjistari u tregua i gatshëm për t'u blerë apostujve fuqinë për të kryer mrekulli, Pjetri i tha: "Le të humbasë paraja jote dhe ti bashkë me të, sepse ti mendove se mund të blesh me para dhuratën e Perëndisë." *(Veprat e Apostujve 8:20)*. Por turmat e paditura e pritën me entuziazëm ofertën e Fetzelit. Arka u mbush me ar e argjend. Shpëtimi, që mund të blihej me lekë ishte më i lehtë se shpëtimi i vërtetë që kërkon pendim, besim dhe përpjekje të zellshme për t'i bërë ballë e për ta mundur mëkatin.

Doktrina e faljeve në Kishën e Romës u sulmua nga njerëz të shquar e të ditur dhe u hodh poshtë nga një numër i madh njerëzish, që nuk mund t'i besonin këtyre pretendimeve që binin plotësisht ndesh si me arsyen, ashtu edhe me Fjalën. Asnjë prelat nuk guxoi që ta ngrinte zërin kundër kësaj tregtie të pacipë, por mendjet e

---

[8] të shihet John C.L.Gieseler, "A Compendium of Ecclesiatical History", per 4, sek 1, parag 5

[9] D'Aubigne, libri 3, kap. 1.

[10] Ibid, libri 3, kap. 1.

[11] të shihet K.R.Hagenbach, "History of the Reformation" vëll 1, fq. 96.

njerëzve filluan të turbullohen e të shqetësohen dhe shumë prej tyre filluan të pyesin veten... vallë a do të përdorë Zoti ndonjë mjet për pastrimin e kishës?

Luterin, edhe pse vazhdonte të ishte një papist i zellshëm, e tmerruan paturpësitë blasfemuese të tregtarëve të faljeve. Shumë nga anëtarët e kishës së tij kishin blerë çertifikata faljesh dhe ata filluan t'i drejtohen pastorit të tyre, duke rrëfyer mëkatet dhe duke pritur fshirjen e tyre, jo sepse ishin penduar e dëshironin të ndryshonin, por sepse kishin "faljen" e blerë. Luteri nuk pranoi t'i falte dhe i paralajmëroi se në qoftë se nuk pendoheshin e nuk fillonin një jetë të re, ata do të zhdukeshin falë këtyre mëkateve të tyre. Të çoroditur, ata shkuan tek Fetzeli për t'u ankuar për priftin që nuk i kishte marrë parasysh çertifikatat e tij dhe disa kërkuan me këmbëngulje që t'u ktheheshin të hollat. Famulltari u inatos. Ai filloi të mallkonte dhe urdhëroi ndezjen e zjarreve në sheshet publike, duke deklaruar "se papa kërkonte djegien e tij."[12]

Luteri tani i hyri me vendosmëri punës së tij si kampion i së vërtetës. Zëri i tij shpalli që nga podiumi, një paralajmërim solemn dhe të rëndësishëm. Ai u përshkroi njerëzve karakterin fyes të mëkatit dhe u mësoi atyre që ishte e pamundur për njeriun, që me anë të veprave të tij, ta pakësonte fajin apo ta shmangte dënimin. Vetëm pendesa drejtuar Perëndisë dhe besimi tek Jezu Krishti mund ta shpëtojnë mëkatarin. Hiri i Krishtit nuk mund të blihet; është një dhuratë falas. Ai i këshilloi njerëzit që të mos blinin falje, por t'i hidhnin sytë me besim tek Shpëtimtari i kryqëzuar. Ai u tregoi njerëzve përvojën e tij të dhimbshme personale, kur përpiqej më kot ta siguronte shpëtimin me anë të vuajtjeve dhe poshtërimit dhe se si duke hequr dorë nga përpjekjet e pavlefshme dhe duke i besuar Krishtit, kishte gjetur paqen dhe gëzimin e vërtetë.

Ndërsa Fetzeli vazhdoi me tregtinë dhe mashtrimet e veta, Luteri vendosi të protestonte më me vrull kunder këtyre abuzimeve. Rasti i erdhi shpejt. Kisha e kështjellës së Wittenbergut kishte shumë relike të çmuara, të cilat ekspozoheshin në raste festash dhe, të gjithë atyre, që vizitonin kishën dhe rrëfeheshin në këto ditë të caktuara u jepej shlyerja e plotë e mëkateve. Kështu, këtu vinin me mijëra e mijëra njerëz në ditë të tilla. Një nga festat më të rëndësishme - festivali i Gjithë Shenjtorëve - ishte në prag të derës. Një ditë më parë, Luteri, duke u bashkuar me turmat e njerëzve, që kishin filluar udhëtimin e tyre drejt kishës, ngjiti në derën e saj një afishe që përmbante 95 teza kundër doktrinës së faljes. Ai deklaronte në të se ishte gati t'i mbronte këto teza kundër atyre, që mund t'i sulmonin, të nesërmen në universitet.

Tezat e tij ngjallën një interesim shumë të madh. Ato u lexuan, u rilexuan dhe u përsëritën në të katër anët. Në universitet dhe në qendër të qytetit u krijua një gjendje e nderë. Këto teza theksonin se papës apo ndonjë njeriu tjetër, nuk i ishte

[12] D'Aubigne, libri 3, kap. 4.

dhënë kurrë e drejta për të falur mëkatet apo për të flakur tej dënimin e tyre. I gjithë ky sistem ishte bosh, - një forcë për të mbledhur të holla, duke luajtur me supersticionin dhe frikën e njerëzve, -një sajim i Satanit për të shkatërruar të gjithë ata që do t'u besonin pretendimeve të tij të rreme. Theksohej gjithashtu se ungjilli i Krishtit është thesari më i çmuar i kishës dhe se hiri i Perëndisë, që zbulohet në të, i jepet falas të gjithë atyre që e kërkojnë atë përmes pendimit dhe besimit.

Tezat e Luterit ftonin për diskutim, por askush nuk guxoi ta pranonte sfidën. Kërkesat dhe pyetjet e tij u bënë të njohura brenda pak ditësh në gjithë Gjermaninë dhe u përcollën, brenda pak javëve, në të katër anët e botës së krishterë. Shumë katolikë të devotshëm, që e kishin vënë re dhe ishin shqetësuar nga paudhësia, që po mbizotëronte në kishë, por që nuk dinin se çfarë të bënin për t'i prerë rrugën asaj, i lexuan me gëzim të madh këto kërkesa, duke njohur në to shkrimin e Perëndisë. Ata e kuptuan se Zoti kishte shtrirë dorën e Tij për ta ndalur valën përmbytëse të korrupsionit, që vinte nga selia romake. Princët dhe magjistratët gëzoheshin në fshehtësi që po i vihej pritë fuqisë arrogante, e cila u kishte mohuar të drejtën për të kundërshtuar vendimet e saj.

Por turmat e njerëzve supersticiozë e mëkatarë u tmerruan nga tronditja e sistemit të gënjeshtrave që ua kishte qetësuar "shqetësimet." Kishëtarët dinakë, të ndërprerë në mes të vepprimtarisë së tyre kriminale dhe të lënë pa fitime, u tërbuan e nxituan t'i mbronin pretendimet e tyre. Reformatori u ballafaqua me akuzues nga më të rrezikshmit. Disa e akuzuan se po vepronte me nxitim e kuturu; të tjerët e dënuan për fodullëk, duke theksuar se nuk po udhëhiqej nga Zoti, por nga mendjemadhësia dhe krenaria. "Të gjithë e dinë, - u përgjigj ai, - se gjithmonë ai që mbron një ide të re akuzohet për mendjemadhësi dhe nxit polemika.... Pse u kryqëzua Krishti dhe u vranë martirët? Sepse dukeshin si mbartës kryelartë të mençurisë së kohës dhe sepse parashtruan ide të reja pa u këshilluar më parë me mbrojtësit e ideve të vjetra.

Më pas, ai deklaroi: "Çfarëdo gjëje që kam nisur, do ta mbaroj, jo për shkak të maturisë së njerëzve, por me anë të këshillës së Perëndisë. Në qoftë se kjo punë buron nga Zoti, kush do të mund ta ndalojë? E në qoftë se nuk buron prej Tij, kush do të mund ta çojë përpara? Jo vullneti im, as i tyre, as yni, por vullneti yt, o At i shenjtë, që je në qiell."[13]

Mëgjithëse Luteri ishte frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë për ta filluar këtë punë, ai nuk do të gjente fushë me lule përpara. Qortimet e armiqve të tij, keqinterpretimet ndaj karakterit të tij, ranë mbi të si rrebesh; dhe ndikimi i tyre u ndje deridiku

Luteri mendonte se udhëheqësit e popullit, si në kishë, edhe në shkolla, do të bashkoheshin me gëzim me të përpara reformën. Fjalët inkurajuese, nga ana e njerëzve të rëndësishëm, e kishin mbushur me gëzim dhe i kishin dhënë shpresë. Ai

[13] Ibid, libri 3,kap. 1.

kishte parashikuar që më parë, agimin e një dite më të mirë për kishën. Por inkurajimi ia kishte lënë vendin qortimit dhe mallkimit. Shumë autoritete, si shtetërore, ashtu edhe fetare, ishin të bindur për vërtetësinë e tezave të tij; por ata e kuptuan shpejt se pranimi i këtyre të vërtetave do të shoqërohej me ndryshime të mëdha. Përparimi dhe reformimi i njerëzve do të thoshte dobësim i autoritetit të Romës, bllokim i rrymave që mbushnin arkën e saj të thesarit dhe humbje e ekstravagancës dhe luksit të udhëheqësve të saj. Për më tepër, t'u mësoje njerëzve të mendonin e të vepronin si qënie të ndërgjegjshme, duke e parë Krishtin si shpëtimin e tyre të vetëm, do të çonte në rrëzimin e fronit të papës, që nga ana e vet, do t'i vinte shkelmin autoritetit të tyre. Për këtë arsye, ata flakën tej njohjen e Perëndisë dhe e hodhën poshtë Krishtin dhe të vërtetën e Tij, duke kundërshtuar njeriun që kishte dërguar Ai për t'ua ndriçuar mendjet.

Luteri, duke menduar për veten - një njeri që e kundërshtonin fuqitë më të mëdha të botës, - dridhej. Ndonjëherë dyshonte a kishte qënë me të vërtetë Zoti Ai, që e kishte udhëhequr të ngrihej kundër autoritetit të kishës? "Kush isha unë, - shkruan ai, - që munda të kundërshtoj madhështinë e papës, para të cilit... mbretërit dhe bota mbarë dridhet?... Asnjë nuk mund ta kuptojë se sa vuajti zemra ime gjatë atyre dy vjetëve të para dhe në çfarë mjerimi, apo dëshpërimi më mirë të them, kisha rënë."[14] Por ai nuk u dekurajua plotësisht. Kur mbështetja njerëzore e braktisi, ai hodhi vështrimin drejt qiellit dhe mësoi të mbështetej plotësisht në krahun e plotfuqishëm.

Një përkrahësi të Reformacionit, Luteri i shkroi kështu: "Ne nuk mund t'i kuptojmë Shkrimet e Shenjta, as vetëm duke studiuar dhe as vetëm falë inteligjencës sonë. Detyra jote e parë është që të fillosh të lutesh. Lutju Zotit, që me mëshirën e Tij, të të japë aftësinë për të kuptuar fjalën e Tij. Ashtu siç ka thënë edhe Ai vetë: "Të gjithë do të mësohen nga Perëndia", nuk ka asnjë interpretues të fjalës së Perëndisë përveç Autorit të saj. Mos shpreso tek puna jote apo tek arsyetimi yt; besoji vetëm Perëndisë dhe ndikimit të Shpirtit të Tij. Ki besim tek fjalët e një njeriu që flet nga përvoja e tij."[15] Ky është një mësim me rëndësi jetësore për të gjithë ata, që mendojnë se Perëndia i ka thirrur për t'i zbuluar botës të vërtetat solemne të kësaj kohe. Këto të vërteta do të ngjallnin armiqësinë e Satanit dhe njerëzve të tjerë, të cilëve u pëlqejnë përrallat që tregon ai. Gjatë luftës me fuqitë e së keqes, duhet diçka që ia kalon forcës së intelektit dhe mençurisë njerëzore.

Kur armiqtë përmendin zakonet, traditat apo të ashtuquajturat "pohime" rreth autoritetit të papës, Luteri u përmendte Biblën dhe vetëm Biblën. Ajo përfshinte argumente që ata nuk mund t'i hidhnin poshtë; prandaj skllevërit e fondamentalizmit dhe supersticionit e sulmuan për ta vrarë ashtu si çifutët kërkuan gjakun e Krishtit. "Ai është heretik! - thërrisnin përkrahësit fanatikë të Romës. - Eshtë një tradhti e

[14] Ibid, libri 3, kap. 6.
[15] Ibid, libri 3, kap. 7.

madhe ndaj kishës qoftë edhe një orë më shumë jetë e këtij heretiku te tmerrshëm. Le të ngrihet trekëmbëshi për të!"[16] Por Luteri nuk ra pre e tërbimit të tyre. Perëndia i kishte besuar një detyrë të rëndësishme dhe engjëjt qiellorë e mbronin ditë e natë. Sidoqoftë, shumë njerëz, që e pranuan dritën e çmuar të Luterit, u vunë në qendër të shënjestrës së Satanit dhe përballuan me stoicizëm, torturat e madje edhe vdekjen, për hir të së vërtetës.

Mësimet e Luterit tërhoqën vëmendjen e njerëzve të ditur në mbarë Gjermaninë. Shërbesat dhe shkrimet e tij çliruan rreze drite, që zgjuan dhe ndriçuan mijëra njerëz. Një besim i gjallë po i zinte vendin formalizmit pa jetë, që kishte pushtuar kishën për një kohë të gjatë. Njerëzit po humbisnin besimin në bestytnitë e papatit çdo ditë e më shumë. po binin edhe barrierat e paragjykimeve. Fjala e Perëndisë, me të cilën Luteri ballafaqonte çdo doktrinë dhe çdo pretendim, i ngjante një shpate me dy presa, që depërtonte thellë në zemrat e njerëzve. Kudo po lindte një dëshirë e madhe për përparimin shpirtëror. Askund nuk ishte vënë re më parë një etje kaq e madhe për drejtësi. Shikimi i njerëzve, që për një kohë kaq të gjatë ishte përqëndruar tek ritet njerëzore dhe tek ndërmjetësit tokësorë, tani po drejtohej tek pendesa dhe tek besimi në Krishtin e kryqëzuar.

Ky interesim në rritje i tmerroi akoma edhe më shumë autoritetet romake. Luteri mori një ftesë për t'u paraqitur në Romë i akuzuar për herezi. Miqtë e tij u trembën shumë nga kjo kërkesë. Ata e njihnin mirë rrezikun që i kanosej atij në qytetin e korruptuar, që pothuajse ishte dehur me gjakun e martirëve të Jezusit. Ata protestuan dhe e hodhën poshtë kërkesën që ai të shkonte në Romë dhe kërkuan gjykimin e tij në Gjermani.

Kjo kërkesë më së fundi u pranua dhe papa dërgoi një delegat të tij që të merrej me shqyrtimin e çështjes. Sipas porosive të dhëna nga papa, delegatit iu theksua, se Luteri ishte shpallur që më parë heretik. Kështu, delegatit iu ngarkua detyra që "ta proçesonte e ta detyronte të dorëzohej pa vonuar." Në qoftë se ai nuk do të tërhiqej dhe delegati nuk do të mundte ta bindte apo ta detyronte të hiqte dorë, atëherë atij i ishte dhënë e drejta "që ta nxinte emrin e tij kudo në Gjermani; si dhe të dëbonte, mallkonte dhe shkishëronte të gjithë ata që do ta përkrahnin."[17] Përveç kësaj, papa, në mënyrë që ta shkulte nga rrënjët këtë herezi të rrezikshme, e urdhëroi delegatin që t'i shkishëronte të gjithë me përjashtim të perandorit, pavarësisht nga pozita shtetërore apo kishëtare që kishin, të cilët nuk do të ndihmonin në kapjen e Luterit. Më pas ata do t'i nënshtroheheshin hakmarrjes së Romës.

Kështu u shfaq edhe një herë shpirti i vërtetë i papatit. Nga rreshti i parë deri në rreshtin e fundit të këtij dokumenti nuk vihet re as gjurma më e vogël e parimeve Kristiane apo drejtësisë elementare. Luteri ndodhej shumë larg Romës; ai nuk kishte pasur mundësi që të shpjegohej apo të mbronte vetveten dhe madje përpara

[16] Ibid, libri 3, kap. 9.
[17] Ibid, libri 4, kap. 2.

se të shqyrtohej çështja e tij, ai ishte quajtur heretik dhe në të njëjtin çast ishte akuzuar, gjykuar e dënuar. E gjitha kjo... nga i vetëquajturi "at hyjnor" që ishte i vetmi autoritet i pagabueshëm dhe suprem i kishës dhe shtetit!

Pikërisht në këtë kohë, kur Luteri kishte më shumë nevojë për mirëkuptimin dhe këshillën e një miku, Perëndia dërgoi Melanchtonin në Wittenberg. I ri, modest dhe i sjellshëm, i pajisur me një gjykim të shëndoshë, njohuri të thella, gojëtari të mprehtë dhe pastërti karakteri, Melanchtoni dinte të fitonte admirimin dhe respektin e njerëzve kudo që shkonte. Pasuria e talenteve që kishte ishte jo më pak e rëndësishme se mirësia që e karakterizonte. Shumë shpejt ai u bë një dishepull i zjarrtë i ungjillit, si dhe miku dhe mbështetësi më i besuar dhe i vlefshëm i Luterit, sepse mirësia, kujdesi dhe saktësia e tij e plotësonin kuadrin e veçorive të admirueshme të Luterit. Puna e tyre e përbashkët e forcoi Reformacionin dhe e inkurajoi Luterin.

Augsburgu u caktua si vendi ku do të zhvillohej gjyqi dhe Reformatori filloi udhëtimin e tij në këmbë për të shkuar atje. Miqtë e tij i kishte pushtuar një frikë e madhe. Në të vërtetë, shumë njerëz e kishin kërcënuar se do ta kapnin e do ta vrisnin rrugës dhe prandaj shokët iu lutën që të mos rrezikohej më kot. Ata madje i sugjeruan që të largohej për një farë kohe nga Wittenbergu dhe të strehohej mes miqve të ngushtë, që do ta mbronin me gëzim. Megjithatë ai nuk donte të largohej nga posti ku e kishte caktuar Perëndia, prandaj vazhdoi ta ruante të pacënuar të vërtetën, pa i marrë parasysh stuhitë, që po i silleshin rrotull. Ai thoshte: "Unë i ngjaj Jeremisë, jam një njeri i sulmit dhe ballafaqimit dhe sa më shumë shtohen kërcënimet e tyre, aq më shumë gëzohem unë... Tashmë ata e kanë shkatërruar emrin tim të mirë dhe nderin tim. Nuk më ka mbetur gjë tjetër veçse trupi im i dobët. Le ta marrin! Jetën time nuk mund ta shkurtojnë më shumë se disa orë; po përsa i përket shpirtit tim... atë nuk ma marrin dot. Ai që dëshiron t'i shpalli botës fjalën e Krishtit, duhet ta presë vdekjen nga momenti në moment."[18]

Lajmi i ardhjes së Luterit në Augsburg e gëzoi shumë delegatin romak. Heretiku "turbullues", që po tërhiqte çdo ditë e më shumë vëmendjen e botës mbarë, dukej sikur tani ishte nën thundrën e Romës dhe delegati ishte i vendosur ta mbërthente aty. Reformatori nuk kishte kërkuar ndonjë leje kalimi. Miqtë e tij iu lutën që të mos paraqitej përpara gjykatësit pa një të tillë dhe ata vetë filluan punën për të marrë një leje nga perandori. Delegati synonte ta detyronte Luterin të tërhiqej ose në rast të kundër të shkonte në Romë, ku padyshim e priste fati i Hussit dhe Jeromit. Prandaj, nëpërmjet agjentëve të tij, ai bëri çmos që Luteri të paraqitej, duke i besuar mëshirës së tij, pa këtë dokument. Por Reformatori nuk pranoi ta bënte një gjë të tillë. Ai u paraqit përpara ambasadorit të papës vetëm kur mori lejekalimin, që i siguronte mbrojtjen e perandorit.

[18] Ibid, libri 4, kap. 4.

Autoritetet romake, për hir të diplomacisë, kishin vendosur ta shtinin në dorë Luterin me butësi. Delegati, gjatë takimeve që pati me të, u tregua shumë i përzemërt, por i kërkoi Luterit që t'i dorëzohej pa fjalë autoritetit të kishës dhe të pranonte çdo pikë pa bërë pyetje e pa debatuar. Ai nuk e kishte vlerësuar si duhej karakterin e këtij njeriu që kishte përballë. Në përgjigjen e tij, Luteri shprehu respektin e tij për kishën, dëshirën për të ndjekur të vërtetën dhe gadishmërinë për t'iu përgjigjur të gjitha vërejtjeve mbi mësimet e tij dhe për t'ia nënshtruar doktrinat e tij vendimit të njerëzve të ditur; por në të njëjtën kohë ai protestoi kundër kërkesës së kardinalit që e ftonte të tërhiqej pa provuar "gabimet" e tij.

Përgjigjja e vetme që mori ishte: "Tërhiqu! Tërhiqu!". Reformatori tregoi se qëndrimi i tij mbrohej nga dëshmia e Shkrimeve të Shenjta dhe deklaroi me bindje se nuk mund të hiqte dorë nga e vërteta. Delegati, duke mos mundur të hidhte poshtë argumentet e tij, e sulmoi me një valë qortimesh, sarkazmash dhe lajkash, të ndërprera këto nga citime të traditave dhe thënie të Etërve dhe, duke mos i lënë kohë Reformatorit të fliste. Luteri, duke parë që bashkëbisedimi ishte i kotë, kërkoi leje që ta paraqiste përgjigjen e tij me shkrim. Kjo leje iu dha me gjysëm zëri.

"Duke vepruar kështu, - i shkruante ai një miku të tij, - kush shtypet ka një të mirë të dyfishtë: së pari, ajo që është shkruar mund t'i nënshtrohet gjykimit të të tjerëve dhe së dyti, paraqet një mundësi më të madhe për t'i ngjallur frikë apo vepruar mbi ndërgjegjen e një tirani arrogant dhe fjalëshumë, që në rast të kundërt, do të inkurajohej nga elokuenca e vet."[19]

Në takimin tjetër, Luteri paraqiti një përmbledhje të qartë, të shkurtër e të saktë të pikëpamjeve të tij, mbështetur këto edhe nga mjaft citime Biblike. Pasi e lexoi me zë të lartë këtë dokument, ai ia kaloi atë kardinalit, që e flaku tutje me përçmim, duke e quajtur atë një broçkull fjalësh dhe citimesh pakuptim. Luteri, i ngritur në këmbë, u ballafaqua me prelatin mendjemadh në një fushë që ai e njihte mirë - traditat dhe mësimet e kishës - dhe i hodhi poshtë të gjitha pohimet e tij.

Kur prelati e kuptoi se arsyetimi i Luterit ishte i pathyeshëm humbi vetëkontrollin dhe thirri si i tërbuar: "Tërhiqu ose përndryshe do të të dërgoj në Romë përpara gjykatësve që do të shqyrtojnë çështjen tënde. Unë do të të shkishëroj ty, të gjithë përkrahësit e tu dhe të gjithë ata që do të përpiqen të të ngjajnë, duke ju flakur njëherë e mirë nga kisha." Përfundimisht me një zë të egër e fodull, ai deklaroi: "Tërhiqu ose mos u kthe më."[20]

Reformatori, i shoqëruar nga miqtë e tij, u largua duke lënë të kuptohej qartë se nuk kishte ndërmend të tërhiqej. Kardinali nuk priste një kundërveprim të tillë. Atë e kishte gënjyer mendja se do ta detyronte me forcë Luterin të dorëzohej. Tani, vetëm me bashkëpunëtorët e tij, ai i vështroi të gjithë me radhë, i zhgënjyer dhe i mërzitur nga përfundimi i papëlqyer i planit të tij.

---

[19] Martyn, "The Life and Times of Luther", fq.271- 272.

[20] D'Aubigne, edicioni i Londrës, libri 4, kap. 8.

Përpjekjet e Luterit në këtë rast nuk mbetën pa u shpërblyer. Të pranishmit e shumtë patën mundësi të krahasonin dy protagonistët dhe ta gjykonin personalisht frymën që manifestonte secili prej tyre, duke vlerësuar fuqinë dhe vërtetësinë e pozitave përkatëse. Çfarë ndryshimi! Reformatori, i thjeshtë, i përulur, qëndroi i papërkulur në anën e Perëndisë, duke mbrojtur të vërtetën; përfaqësuesi i papës, krenar, mendjemadh dhe i paarsyeshëm edhe pse nuk kishte në dorë asnjë argument Biblik, thërriste i vetëkënaqur: "Tërhiqu, ose përndryshe, do të përfundosh në Romë ku do të dënohesh!"

Pa marrë parasysh lejekalimin e tij, papistët po komplotonin arrestimin dhe burgimin e tij. Miqtë e tij iu lutën që të kthehej pa vonesë në Wittenberg, pasi qëndrimi i tij i zgjatur në atë vend ishte i panevojshëm dhe i rrezikshëm. Kështu, ai u largua nga Augsburgu para lindjes së diellit, i hipur mbi kalë dhe i shoqëruar vetëm nga një udhërrëfyes, që ia kishte gjetur magjistrati. Ai nisi udhëtimin përmes rrugicave të errëta e të shkreta të qytetit, i pushtuar nga parandjenja të këqija. Armiqtë vigjilentë dhe mizorë, po komplotonin zhdukjen e tij. A do t'u shpëtonte vallë kurtheve të ngritura rreth tij? Ishin momente ankthi dhe lutjesh të ethshme. Arriti pranë një porte të vogël në murin e qytetit. Ajo ishte lënë hapur për të dhe ai, së bashku me shoqëruesin e vet, kaluan pa pengesa. Me të dalë jashtë, ata nxituan të largoheshin dhe kur delegati dëgjoi për ikjen e tij, ai ishte tepër larg persekutorëve të tij. Satani dhe misionarët e tij u mundën. Njeriu, që ata menduan se e kishin në dorë, ishte larguar, siç i shpëton zogu kurthit të skifterit.

Lajmi i largimit të Luterit e inatosi dhe e çuditi gjykatësin. Ai priste që ta nderonin për mençurinë dhe vendosmërinë me të cilën e kishte trajtuar këtë prishës të kishës, por mbeti i zhgënjyer. Ai e shprehu zemërimin e tij në një letër drejtuar Frederikut, përfaqësuesit të Saksonisë, duke e kritikuar ashpër Luterin dhe duke i kërkuar Frederikut që ta dërgonte Reformatorin në Romë ose ta dëbonte nga Saksonia.

Luteri, nga ana e tij, kërkoi që delegati ose papa t'i tregonin në Bibël gabimet e tij dhe u betua solemnisht se do të hiqte dorë nga doktrinat e tij, në qoftë se ato binin ndesh me fjalën e Perëndisë. Më pas, ai i shprehu Zotit mirënjohjen e tij që Ai e kishte quajtur të denjë për të vuajtur për një kauzë kaq të shenjtë.

Përfaqësuesi sakson nuk dinte shumë për doktrinat e reformuara, por çiltërsia, forca dhe qartësia e fjalëve të Luterit e prekën atë dhe Frederiku vendosi ta mbronte Reformatorin derisa të provoheshin gabimet e tij. Në përgjigje të kërkesës së delegatit, ai shkroi: "Duhet të jeni i kënaqur meqë Doktor Martini është paraqitur përpara jush në Augsburg. Ne nuk na shkonte në mendje që ju do të përpiqeshit ta detyronit të tërhiqej pa e bindur se ishte i gabuar. Asnjë nga njerëzit e ditur të principatës sime nuk më ka njoftuar se doktrinat e Martinit janë të pabesa, antikristiane dhe heretike." Kështu princi nuk pranoi ta dërgonte Luterin në Romë apo ta dëbonte nga shtetet e tij."[21]

[21] D'Aubigne, libri 4, kap. 10.

Princi kishte vënë re një shthurje të përgjithshme të moralit shoqëror dhe e kishte kuptuar domosdoshmërinë e reformës. Nuk do të kishte nevojë për marrje masash të kushtueshme e të koklavitura për ndalimin e krimit, në rast se njerëzit do t'i njihnin e do t'u bindeshin urdhëresave të Perëndisë dhe zërit të ndërgjegjes së ndriçuar. Ai e kuptoi që Luteri po punonte për arritjen e këtij qëllimi dhe në fshehtësi gëzohej që në kishë po ndjehej një erë e re.

Ai vuri re gjithashtu se si profesor universiteti Luteri ishte më se i suksesshëm. Vetëm një vit kishte kaluar që nga dita kur Luteri ngjiti tezat e tij mbi portën e kishës së kështjellës dhe numri i shtegtarëve që vizitonin kishën për festivalin e Gjithë Shenjtorëve, kishte rënë shumë. Roma po zhvishej nga adhuruesit dhe dhuratat e tyre, por vendin e tyre e zuri një grup tjetër njerëzish, që shkonin në Wittenberg jo si shtegëtarë për të adhuruar relika, por si studentë, për të mbushur auditorët e universitetit. Shkrimet e Luterit kishin ngjallur kudo një interesim të madh mbi Shkrimet e Shenjta dhe studentë, jo vetëm nga Gjermania, por edhe nga vende të tjera, mbushën bankat e universitetit. Të rinjtë, që shkelnin për herë të parë në Wittenberg, "ngrinin duart drejt qiellit dhe e lëvdonin Perëndinë që e kishte shpërndarë nga ai qytet, si nga Sioni në të shkuarën, dritën që duhej përcjellë edhe në vendet më të largëta."[22]

Gjatë kësaj periudhe Luteri nuk ishte bindur akoma plotësisht për gabimet e Kishës së Romës, por ndërsa krahasonte Shkrimet e Shenjta me dekretetet dhe vendimet e papatit, ai çuditej gjithnjë e më shumë. "Po lexoj, - shkruante ai, - dekretet e papëve... dhe nuk e kuptoj nëse papa është antikrishti vetë apo apostulli i tij, kaq shumë e keqpërfaqësojnë dhe e kryqëzojnë Krishtin ato."[23] Megjithatë, në këtë pikë, Luteri vazhdonte të ishte përkrahës i Kishës Romake dhe as që mendonte se mund të shkëputej prej saj.

Shkrimet dhe doktrinat e Reformatorit po përhapeshin në të gjitha vendet e Krishtera. Puna filloi në Zvicër dhe Hollandë. Kopjet e veprave të tij depërtuan deri në Francë dhe Spanjë. Mësimet e tij anglezët i pritën si fjalë jete. E vërteta kishte kaluar gjithashtu edhe kufirin e Belgjikës dhe Italisë. Me mijëra njerëz u zgjuan nga dremitja vdekjeprurëse drejt gëzimit dhe shpresës jetëdhënëse të besimit.

Roma shqetësohej gjithnjë e më shumë nga sulmet e Luterit dhe disa nga kundërshtarët fanatikë të tij, - mes të cilëve edhe profesorë e doktorë te universiteteve Katolikë, - deklaruan se atij që do ta vriste murgun rebel, do t'i faleshin mëkatet pa përjashtim. Një ditë, një njeri i panjohur me një revole të fshehur nën mantel, iu afrua Reformatorit dhe e pyeti pse lëvizte vetëm. "Jam në duart e Zotit. - u përgjigj Luteri - Ai është forca dhe mburoja ime. Ç'mund të më bëjnë njerëzit?"[24] Me të dëgjuar këto fjalë, njeriu i panjohur u zverdh dhe iku me të katra sikur të kishte parë engjëjt e qiellit.

---

[22] Ibid, libri 4, kap. 10.

[23] Ibid, libri 5, kap. 1.

[24] Ibid, libri 6, kap. 2.

Roma synonte ta shkatërronte Luterin, por atë e mbronte Perëndia. Doktrinat e tij jehuan kudo - "në kasolle dhe konvikte... në kështjellat e fisnikëve, në universitete dhe në pallatet mbretërore"; dhe njerëz fisnikë nga çdo vend u ngritën në mbrojtje të tij."[25]

Pikërisht në këtë kohë, duke lexuar veprat e Hussit, Luteri zbuloi se e vërteta e madhe e shfajësimit me anën e besimit që ai vetë po përpiqej ta mbronte e ta predikonte, ishte pranuar më parë nga Reformatori Bohemian: "Ne që të gjithë, - tha Luteri, -Pali, Augustini dhe unë kemi qënë Hussitë pa e ditur!" "Sigurisht që Zoti do t'ia kujtojë botës, - vazhdoi ai, - se kjo e vërtetë është predikuar dhe djegur një shekull më parë."[26]

Duke folur për papën, në një thirrje drejtuar perandorit dhe aristokracisë gjermane në emër të reformacionit Kristian, Luteri shkruante: "Eshtë e tmerrshme që të shikosh një njeri, që vetëquhet "zëdhënës i Krishtit", të kapardiset me nje madhështi që nuk krahasohet me atë të asnjë perandori. A i ngjan ky njeri Jezusit të varfër apo Pjetrit të përulur? Thonë që ai është Zot i botës! Por Krishti, mëkëmbësi i të Cilit ai mburret se është, ka thënë: "Mbretëria ime nuk i takon kësaj bote." A është e mundur që sundimi i një mëkëmbësi ta kalojë atë të eprorit të tij?"[27]

Përsa u përket universiteteve, ai shkruante: "Kam frikë se, në qoftë se universitetet nuk përpiqen me zell për t'i shpjeguar Shkrimet e Shenjta e për t'i gdhendur ato në zemrat e të rinjve, ata do të kthehen në porta ferri. Ju këshilloj të mos i dërgoni fëmijët tuaj atje ku Shkrimi nuk zë vendin kryesor. Çdo institucion, që nuk ka bazë fjalën e Perëndisë, herët a vonë do të korruptohet."[28]

Kjo thirrje u përhap me shpejtësi në Gjermani dhe pati një ndikim të madh mbi njerëzit. I gjithë vendi u trondit dhe me mijëra njerëz u vunë nën flamurin e reformës. Kundërshtarët e Luterit, të etur për hakmarrje, e nxitën papën që të ndërmerrte masa më të rrepta kundër tij. U mor vendim që të dënoheshin doktrinat e tij. Reformatorit dhe përkrahësve të tij iu dhanë gjashtëdhjetë ditë që të tërhiqeshin dhe në qoftë se brenda kësaj kohe nuk e bënin një gjë të tillë, do të shkishëroheshin të gjithë.

Reformacioni po përjetonte një krizë të thellë. Për shekuj me radhë dënimi romak i shkishërimit i kishte tmerruar mbretërit e fuqishëm dhe kishte sjellë mallkim dhe fatkeqësi mbi perandoritë.Ata që merrnin këtë dënim shiheshin me frikë dhe tmerr; miqtë e tyre prisnin çdo lloj lidhje me ta, trajtoheshin si kriminelë e ndiqeshin këmbakëmbës derisa vriteshin mizorisht. Luteri e njihte mirë furtunën që po përgatitej për ta përfshirë; por ai nuk u përkul, duke i besuar Krishtit si mbështetja dhe mburoja e tij. Me guxim dhe besim martiri, ai shkroi: "Nuk e di

[25] Ibid, libri 6, kap. 2.
[26] Wylie, libri 6, kap. 1.
[27] D'Aubigne, libri 6, kap. 3.
[28] Ibid, libri 6, kap. 3.

se çfarë do të ndodhë, por një gjë e tillë nuk më shqetëson... Le të fryjë era nga të dojë. Frikë nuk kam, sepse as edhe një gjethe e vetme nuk bie po nuk qe vullneti i Atit... Po për ne sa shumë kujdeset Ai! Është e lehtë të vdesësh për Fjalën duke qënë se Fjala u bë mish dhe vdiq Vetë për ne. Në qoftë se vdesim me Të edhe do të jetojmë me të dhe, duke duruar vuajtjet që më parë i duroi Ai për ne, ne do të jemi ku është Ai dhe do të qëndrojmë me të përgjithmonë."[29]

Kur Luterit i ra në dorë dokumenti i nënshkruar nga papa, ai tha: "E përçmoj dhe e sulmoj, sepse është i padrejtë dhe i rremë ... Ky dokument dënon vetë Krishtin... Gëzohem që më duhet të vuajë për kauzën më fisnike. Tashmë ndiej në zemër një çlirim të madh, sepse më në fund e kuptova se papa është antikristi dhe që është ulur mbi fronin e Satanit."[30]

Megjithatë mandati i Romës nuk kaloi pa u ndjerë. Burgu, torturat dhe shpata ishin armë të fuqishme për të siguruar bindje. Njerëzit e dobët dhe supersticiozë u drodhën përpara dekretit të papës; megjithëse shumica e popullsisë e përkrahte Luterin, ata mendonin se jeta ishte shumë më e shtrenjtë se kauza reformuese. Dukej sikur punës së Reformatorit po i vinte fundi.

Megjithatë Luteri nuk kishte frikë. Roma po përdorte kundër tij gjithë arsenalin e saj dhe bota mbarë po priste vdekjen ose dorëzimin e tij. Me guxim të pashoq, ai ia përplasi në fytyrë asaj (Romës) dënimin, që kishte dalë nga goja e autoriteteve romake dhe shpalli publikisht vendimin e tij për ta braktisur kishën përgjithmonë. Në prani të një turme të madhe studentësh, profesorësh dhe qytetarësh të të gjitha shtresave shoqërore, dogji dekretin e papatit, ligjet tradicionale, urdhëresat e papës dhe disa shkrime të tjera, që e mbronin autoritetin e tij. "Armiqtë e mi, - tha ai, - duke djegur librat e mia, i kanë turbulluar mendjet e njerëzve dhe e kanë dëmtuar kauzën e së vërtetës; për këtë arsye po ua djeg edhe unë librat atyre. Beteja solemne sapo ka filluar. Deri tani vetëm kam luajtur me papën. E fillova këtë punë në emër të Perëndisë dhe ajo do të vazhdojë, edhe pa mua, në sajë të fuqisë së Tij."[31]

Akuzave të armiqve, të cilët vinin në lojë dobësinë e kauzës së tij, Luteri iu përgjigj: "Kush është ai që e di me siguri që Perëndia nuk më ka zgjedhur dhe thirrur mua e duke mos iu trembur kësaj, përçmon Zotin Vetë, duke më përçmuar mua? Moisiu ishte vetëm kur u largua nga Egjipti, Elija ishte vetëm në kohën e mbretit Ahab; Isaja ishte vetëm në Jeruzalem; Ezekieli ishte vetëm në Babiloni ... Zoti kurrë nuk ka zgjedhur si profet as kryepriftin dhe as ndonjë personazh të njohur. Zakonisht Ai zgjidhte njerëz të thjeshtë dhe të përulur si bariu Amos. Gjatë gjithë kohërave, shenjtorëve u është dashur të qortojnë të fuqishmit, mbretërit, princët, priftërinjtë dhe njerëzit e mençur, duke vënë në rrezik jetën e tyre.... Nuk po them se jam profet, thjesht po them pikërisht se jam vetëm dhe ata janë shumë,

[29] Ibid, edicioni i tretë i Londrës; 1840, libri 6, kap. 9.
[30] D'Aubigne, libri 6, kap. 9.
[31] Ibid, libri 6, kap. 10.

duhet të kenë frikë. Jam i sigurt për diçka: fjala e Perëndisë është me mua dhe jo me ta."[32]

Megjithatë, Luteri vendosi që të ndahej përfundimisht me kishën vetëm pas një konflikti të gjatë me vetveten. Pikërisht gjatë kësaj periudhe të vështirë ai shkroi: "Çdo ditë e më shumë e kupton se sa e vështirë është që të heqësh dorë nga zakonet, që të janë ngulitur në mendje që në fëmijëri. Sa shumë kam vuajtur, - edhe pse Shkrimet e Shenjta ishin me mua, - për ta bindur veten që duhej të merrja guximin për t'u ngritur i vetëm kundër papës e për ta shpallur atë si antikrisht! Sa e madhe ka qënë dhimbja që kam ndier në zemër! Sa herë i kam bërë vetes ato pyetje që m'i drejtojnë shpesh papistët: "Vetëm ti je i zgjuar? A mund të gabojnë gjithë të tjerët? Çfarë do të ndodhë në qoftë se ti je i gabuar dhe përfshin në këtë gabim shumë shpirtra që më pas do të dënohen përjetësisht? Kështu, luftova për një kohë të gjatë me veten dhe me Satanin derisa Krishti, me fjalën e tij të pagabuar, ma forcoi zemrën kundër këtyre dyshimeve."[33]

Papa e kishte kërcënuar Luterin me shkishërim në rast se nuk do të tërhiqej dhe kërcënimi tani u bë realitet. U miratua një dekret i ri, që deklaronte shkëputjen përfundimtare të Reformatorit nga Kisha e Romës, që e quante atë të paditur nga Qielli dhe që i përfshinte të gjithë ata që do t'i pranonin doktrinat e tij, në këtë dënim. Kishte filluar me të vërtetë beteja e madhe.

Të gjithë ata, të cilët Perëndia i përdor për të shpallur të vërteta të rëndësishme për kohën kur jetojnë, do të kenë si fat, kundërshtimin. Ekzistonte një e vërtetë, që i përkiste kohës së Luterit - një e vërtetë e një rëndësie të veçantë; ekziston një e vërtetë, që i përket kishës së ditëve tona. Ai që bën gjithçka sipas vullnetit të Tij, ka pasur mirësinë t'i vendosë njerëzit në rrethana të larmishme dhe t'u besojë atyre detyra të rëndësishme për kohën, në të cilën jetonin dhe për kushtet, në të cilat ndodheshin. Në qoftë se ata do ta vlerësonin dritën që do t'u jepej, rreze të reja të së vërtetës do te hapeshin përpara tyre. Por, pjesa më e madhe e njerëzve vazhdojnë ta hedhin poshtë të vërtetën, duke u ngjarë papistëve, të cilët e kundërshtuan ashpër Luterin. Vazhdon të ekzistojë e njëjta prirje për të pranuar teoritë dhe traditat njerëzore në vend të fjalës së Perëndisë. Të gjithë ata që paraqesin të vërtetën në ditët tona, nuk duhet të mendojnë se do të priten me entuziazëm më të madh nga ç'u pritën reformatorët e parë. Kontradikta e madhe midis Krishtit dhe Satanit, do të intensifikohet në ditët e fundit të historisë botërore.

Jezusi u tha dishepujve të tij: "Po të ishit nga bota, bota do t'i donte të vetët; por sepse nuk jeni nga bota, por Unë iu kam zgjedhur nga bota, prandaj bota do t'ju urrejë. Kujtoni fjalët që iu thashë: "Shërbëtori nuk është më i madh se i zoti." Nëse më kanë përndjekur Mua, do t'ju përndjekin edhe ju; nëse kanë zbatuar fjalën Time, do të zbatojnë dhe tuajën." *(Gjoni 15:19, 20)*. Nga ana tjetër, Zoti deklaroi

[32] Ibid, libri 6, kap. 10.

[33] Martyn, fq. 372, 373.

qartë: "Mjerë ju, kur të gjithë njerëzit do të flasin mirë për ju, sepse në të njëjtën mënyrë vepruan etërit e tyre me profetët e rremë." *(Luka 6:26)*. Fryma, që mbizotëron në botë sot nuk përputhet me frymën e Krishtit ashtu siç nuk përputhej edhe në të shkuarën dhe ata që e predikojnë fjalën e Perëndisë, pa i shtuar asnjë pikë e pa i shtuar asnje gërmë, do të priten me atë armiqësi që u vu re që atëherë. Format e kundërshtimit të së vërtetës mund të ndryshojnë; armiqësia mund të jetë më e fshehur, sepse është më dinake, por i njëjti antagonizëm do të vazhdojë të ekzistojë e do të manifestohet ndjeshëm në fund të kohës.

1. Listoni karakteristikat intelektuale dhe shpirtërore të të riut Luter, që e bënë atë një lider të patundur parimor.

2. Duke zbritur "Shkallët e Pilatit" në Romë, Luteri dëgjoi fjalët tek Romakët 1:17. Si reagoni në jetën tuaj kur dëgjoni këto fjalë?

3. Me cilin personazh të Dhjatës së Re e barazon Ellen White Tetzelin? Pse?

4. Kisha e sulmoi, e përqeshi dhe e persekutoi Luterin bashkë me ndjekësit e tij, deri në pikën e shkishërimit dhe vdekjes. Si iu përgjigj Luteri? Si mund të ndiqni shembullin e tij në mbrojtje të "të vërtetës aktuale"?

8.

Luteri Përpara Dietës

Mbi fronin e Gjermanisë u ul një perandor i ri, Karli V dhe delegatët e Romës nxituan ta përgëzonin e ta joshnin që ai të përdorte fuqinë e tij kundër Reformacionit. Nga ana tjetër, i zgjedhuri i Saksonisë, të cilit Karli i ishte borxhli për pozitën e re që gëzonte, iu lut atij që të mos merrte asnjë masë kundër Luterit pa e dëgjuar më parë. Kështu, perandori u çorodit pa ditur si të vepronte. Papistët mund t'i kënaqte vetëm një dekret perandorak që kërkonte dënimin me vdekje të Luterit. I zgjedhuri i Saksonisë kishte deklaruar me vendosmëri se "as madhëria e tij perandori dhe as ndonjë personalitet tjetër nuk kishte provuar se shkrimet e tij ishin të gabuara"; prandaj ai kërkonte që "doktor Luteri të pajisej me një lejekalim për t'u paraqitur përpara një trupi gjykues të ditur, të devotshëm e të paanshëm." - D'Aubigne, libri 6, kap.11.

Vëmendja e të dyja palëve ishte përqëndruar tashmë në mbledhjen e përfaqsuesve të shteteve gjermane, që do të mbahej në Worms, menjëherë pas ngjitjes në fron të Karlit. Ky këshill kombëtar do të shqyrtonte probleme dhe çështje me rëndësi politike; për herë të parë princët e Gjermanisë do të mblidheshin së bashku me perandorin e tyre të ri në një asamble legjislative. Nga të katër anët e vendit erdhën në Worms personalitetet më të shquara të kishës dhe të shtetit. Zotërinj sekularë, nga familje të nderuara dhe të fuqishme, krenarë për të drejtat e trashëguara që gëzonin; klerikë të ndërgjegjshëm për pozitën dhe pushtetin e madh që kishin në duar; oborrtarë fisnikë të shoqëruar nga rojet e tyre personale dhe ambasadorë të vendeve të afërta e të largëta - të gjithë ishin mbledhur atje. Megjithatë, interesin më të madh të asaj asambleje të përzgjedhur e ngjalli çështja e Reformatorit Sakson.

Karli i kishte sugjeruar më parë të zgjedhurit të Saksonisë që të vinte i shoqëruar nga Luteri, të cilit i siguronte mbrojtjen e tij dhe i premtonte një diskutim të lirë të çështjeve që e shqetësonin me njerëz të po të njëjtit rang. Luteri mezi po priste që të dilte përpara perandorit. Shëndeti i tij gjatë asaj kohe ishte shumë i paqëndrueshëm,

prandaj ai i shkroi të zgjedhurit të Saksonisë: "Në qoftë se nuk mund të shkoj në Worms shëndoshë e mirë, do të shkoj duke u hequr zvarrë - sëmurë siç jam, sepse nuk kam asnjë dyshim se kërkesa e perandorit është një thirrje nga Perëndia. Në rast se dëshirojnë të më bindin me dhunë, -gjë që është më se e mundshme (se nuk po më urdhërojnë të dal përpara tyre, për të më këshilluar urtë e butë), - ia lë gjithçka në dorë Zotit. Ai, që ruajti të paprekur të tre burrat në furrën e përvëluar, vazhdon të jetojë e të mbretërojë. Në qoftë se nuk do më shpëtojë, kjo do të thotë se jeta ime nuk ka shumë rëndësi. Le ta mbrojmë ungjillin nga talljet e të pabesëve dhe le të derdhim gjakun tonë për triumfin e tij! Nuk më takon mua të vendosë nëse jeta apo vdekja ime do të ndihmojnë më shumë në shpëtimin e njerëzimit.... Nga unë mund të pritet gjithçka përveç nënshtrimit dhe tërheqjes. Nuk kam për t'u nënshtruar e aq më pak kam për t'u tërhequr." - Ibid, libri 7. kap. 1.

Me t'u përhapur lajmi në Worms që Luteri do të paraqitej përpara Diet - ës*, të gjithë njerëzit u çuditën dhe u emocionuan. Aleandri, delegati i papatit që ishte ngarkuar me shqyrtimin e kësaj çeshtjeje u alarmua dhe u inatos. Ai e kuptoi se rezultati i një tratative të tillë do të ishte shkatërrues për Romën. Të merrje në shqyrtim një çështje, që papa e kishte vulosur me dënim me vdekje, do të thoshte përbuzje e autoritetit të kryepriftit sovran. Për më tepër, ai kishte frikë se argumentet e fuqishme dhe elokuente të këtij njeriu do t'i largonte princët nga kauza e papës. Prandaj ai e kundërshtoi me forcë paraqitjen e Luterit në Worms. Pikërisht në këtë kohë u shpall publikisht edhe dekreti i shkishërimit të Luterit; dhe ky dokument së bashku me deklaratat e delegatit papist, e bënë perandorin që të dorëzohej. Ai i shkroi të zgjedhurit të Saksonisë se në rast se Luteri nuk do të tërhiqej, duhet të qëndronte në Wittenberg.

I pakënaqur nga kjo fitore e pjesshme, Aleandri bëri ç'kishte në dorë dhe përdori gjithë mençurinë e tij për të arritur qëllimin e dënimit të Luterit. Me një këmbëngulje të padenjë për një kauzë të tillë, ai tërhoqi vëmendjen e princëve, prelatëve dhe anëtarëve të tjerë të asamblesë mbi këtë çështje duke e akuzuar Reformatorin për "rebelim, pabesi dhe blasfemi. "Por vrulli dhe pasioni që manifestoi delegati e zbuluan qartë frymën që e motivonte. "Ai nxitet më shumë nga urrejtja dhe hakmarrja, - thanë të gjithë, - sesa nga zelli dhe mëshira." - Ibid, libri 7, kap. 1.

Me zell të dyfishuar, Aleandri i kujtoi perandorit domosdoshmërinë e zbatimit të urdhrave të papatit. Por sipas ligjeve të Gjermanisë një gjë e tillë nuk mund të bëhej pa miratimin e princëve; së fundi Karli iu nënshtrua presioneve të delegatit dhe e autorizoi atë t'ia paraqiste këtë çështje këshillit. "Kjo ishte një ditë e madhe për priftin. Asambleja ishte e rëndësishme; kauza akoma dhe më e rëndësishme. Aleandri do të përfaqësonte Romën...Nënën dhe zonjën e të gjithave kishave." Atij i duhej të hakmerrej për mbizotërimin e Pjetrit përpara asmblesë së përfaqsuesve të shumicës së vendeve kristiane. "Aleandri ishte një gojëtar i talentuar dhe u paraqit

në lartësinë e situatës. Ishte vullneti i Perëndisë që Roma të përfaqësohej në prani të gjykatësve të nderuar përpara se të dënohej, nga një prej oratorëve të saj më të aftë." - Wylie, libri 6, kap. 4. Dashamirësit e Reformatorit e pritën me frikë e shqetësim fjalimin e Aleandrit. I zgjedhuri i Saksonisë nuk ishte i pranishëm, por ai kishte caktuar disa nga këshilltarët e tij që të mbanin shënim diskutimin e priftit.

Aleandri u bë gati që ta shkelte me këmbë të vërtetën duke përdorur forcën e madhe të arsimimit dhe elokuencës së tij. Akuzë pas akuze, ai e përshkroi Luterin si armik të betuar të kishës dhe të shtetit, të të vdekurve e të të gjallëve, të klerit dhe të laikëve, të këshillave dhe të Kristianëve të thjeshtë. "Gabimet e Luterit janë kaq të shumta, - tha ai - sa do të shfajësonin djegien e njëqind mijë heretikëve së bashku."

Në mbyllje të fjalimit të tij, ai u përpoq që të hidhte baltë mbi përkrahësit e besimit të reformuar, duke u shprehur: "Çfarë na qënkan gjithë këta Luterianë? Një grup pedagogësh të pacipë, priftërinjsh të korruptuar, murgjish të shthurur, avokatësh të paditur, fisnikësh të rrënuar që janë bashkuar me njerëzit e thjeshtë, të cilët i kanë keqtrajtuar dhe gënjyer. Sa më epërsi ka bashkësia Katolike në numër, fuqi dhe dije? Ky dekret i njëzëshëm i kësaj asambleje do të ndriçojë njerëzit e thjeshtë, do të paralajmëroj mendjelehtët, do t'i bindi të lëkundurit dhe do t'i forcojë të dobtit." - D'Aubigne, libri 7, kap. 3.

Këto armë janë përdorur në shekuj për të sulmuar avokatët mbrojtës të së vërtetës. Të njëjtat argumente drejtohen edhe sot e kësaj dite kundër atyre që guxojnë të paraqisin, në kundërshtim me gabimet mbizotëruese mësimet e qarta dhe të drejtpërdrejta të fjalës së Perëndisë. "Kush na qënkan këta predikuesë të doktrinave të reja?" - thërrasin ata që jepen pas "besimit" popullor. - Ata janë të paditur, të pakët në numër e të varfër. Megjithatë, kanë fytyrë e pretendojnë se kanë me vete të vërtetën e janë populli i zgjedhur i Perëndisë. Ata janë injorantë e të mashtruar. Sa më epërsi ka në numër e në fuqi kisha jonë? Sa njerëz të ditur e të pushtetshëm kemi mes nesh? Sa më shumë popullaritet gëzojmë?" Këto janë argumente që e bindin botën; por ato vazhdojnë të mbeten po aq boshe sot sa ishin në kohën e Reformacionit.

Reformacioni, ndryshe nga ajo që mendojnë disa, nuk përfundoi me Luterin. Ai do të vazhdojë deri në ditët e fundit të historisë botërore. Luteri, duke reflektuar dritën e marrë nga Perëndia, kreu një detyrë të rëndësishme; megjithatë ai nuk arriti të merrte të gjithë dritën që do t'i jepej botës. Që nga koha e tij e deri në ditët tona, Shkrimet e Shenjta kanë çliruar rreze të reja dhe të vërteta të mëdha kanë dalë nga errësira nën ndikimin e dritës së tyre.

Fjalimi i delegatit la gjurmë në mendjet dhe zemrat e anëtarëve të Dietës. Luteri nuk ishte i pranishëm, që me të vërtetat bindëse dhe të qarta të fjalës së Perëndisë, t'ia ulte hundën kampionit të papatit. Nuk u bë asnjë përpjekje për ta mbrojtur Reformatorin dhe dukej qartë tendenca e përgjithshme për të dënuar jo vetëm atë

dhe doktrinat e tij, por edhe për ta shkulur nga rrënjët këtë herezi. Roma kishte shfrytëzuar mundësinë më të volitshme për të mbrojtur kauzën e saj. Ajo kishte thënë ç' kishte dashur në këtë deklaratë hakmarrjeje. Megjithatë e ashtuquajtura "fitore" ishte sinjali i parë i humbjes. Që nga ai moment, lufta e hapur, do ta nxirrte akoma më në pah ndryshimin midis të vërtetës dhe gabimit dhe Roma do ta humbiste sigurinë e mëparshme

Ndërsa pjesa më e madhe e anëtarëve të Dietës nuk do të kishin ngurruar t'ia dorëzonin Luterin hakmarrjes së Romës, shumë prej tyre e kishin vënë re dhe e dënonin shthurjen që mbizotëronte në kishë dhe dëshironin t'u jepej fund abuzimeve që mbante mbi kurriz populli gjerman falë korrupsionit dhe grykësisë së kësaj hierarkie. Delegati e kishte përshkruar sundimin e papës me ngjyra të ndezura. Zoti frymëzoi një anëtar të Diet- ës që ta paraqiste haptazi tiraninë e papatit. Me vendosmëri të madhe, Duka George i Saksonisë u ngrit në mes të asaj asambleje dhe saktësoi mashtrimet, gënjeshtrat dhe frytet e punës së selisë së shenjtë. Në fund të fjalimit të tij, ai tha: "Këto janë disa nga abuzimet që e tregojnë me gisht Romën. Ata nuk e njohin më kuptimin e fjalës "turp" dhe qëllimi i tyre i vetëm është ... paraja, paraja, paraja... kështu predikuesit që duhet t'u mësojnë njerëzve të vërtetën, nxjerrin nga goja vetëm gënjeshtra dhe jo vetëm që nuk qortohen, por edhe shpërblehen sepse sa më të mëdha gënjeshtrat, aq edhe më i madh fitimi. Nga një burim i tillë i ndyrë rrjedh vetëm ujë i qelbur. Shthurja ia shtrin dorën kopracisë... Mjerë ne! Skandali që ka shkaktuar kleri i ka shtyrë shumë shpirtra drejt dënimit të përjetshëm. Eshtë e nevojshme një reformë e përgjithshme!" - Ibid, libri 7, kap. 4.

As vetë Luteri nuk do të kishte mundur t'ua çirrte maskën më mirë abuzimeve të papatit; dhe fakti që folësi ishte një kundërshtar i vendosur i Reformatorit i dha forcë më të madhe fjalëve të tij.

Sikur sytë e asamblesë të ishin të hapur, ata do të kishin parë mes tyre engjëj qiellorë që duke e çarë errësirën e gabimit, hidhnin rreze drite dhe i hapnin dyert e zemrave dhe të mendjeve për të mirëpritur të vërtetën. Fuqia e Perëndisë së të vërtetës dhe mençurisë kishte nën kontroll madje edhe kundërshtarët e Reformacionit duke i hapur rrugën kështu punës së madhe që duhej kryer. Martin Luteri nuk ishte i pranishëm, por ajo asamble kishte dëgjuar zërin e Dikujt që ishte shumë më i madh se ai. Diet i zgjodhi një komitet, të cilit iu ngarkua detyra e përgatitjes së një liste të të gjitha shtypjeve të papatit që i rëndonin mbi shpatulla popullit gjerman. Kjo listë, e përbërë nga njëqind e një pika, iu paraqit perandorit së bashku me kërkesën që ai të merrte masa të menjëhershme për ndalimin e këtyre abuzimeve. "Sa shumë humbje shpirtrash, - shkruanin hartuesit e peticionit, - sa shumë grabitje, sa shumë zhvatje si pasojë e skandaleve që rrethojnë kreun shpirtëror të Kristianizmit! Eshtë detyra jonë që të ndalojmë shkatërrimin dhe poshtërimin e popullit që përfaqësojmë. Për këtë arsye lutemi me përulje, por edhe me ngulm

që të jepet urdhër për një reformë të përgjithshme dhe të vihet në jetë realizimi i saj." - Ibid, libri 7, kap. 4.

Këshilli kërkoi që Reformatori të paraqitej pa vonesë. Pa marrë parasush lutjet, protestat dhe kërcënimet e Aleandrit, perandori ra dakort që luteri të thirrej përpara Diet- ës. Me ftesën u bashkangjit një lejekalim që i siguronte atij një kthim pa pengesa. Në Wittenberg të rejat i solli një lajmëtar, që ishte ngarkuar ta shoqëronte Reformatorin në Worms.

Miqtë e Luterit u shqetësuan dhe u frikësuan. Të vetëdijshëm për paragjykimet dhe armiqësinë që ekzistonte kundër tij, ata kishin frikë që as lejekalimi nuk do t'i shërbente për gjë dhe iu lutën që të mos rrezikohej më kot. Ai iu përgjigj: "Papistët nuk dëshirojnë vajtjen time në Worms, por dënimin dhe vdekjen time. S'karëndësi. Mos u lutni për mua, por për fjalën e Perëndisë... Krishti do të më japë Shpirtin e Tij që të dal fitimtar ndaj pastorëve të gabimit. Unë i kam përbuzur gjatë gjithë jetës sime dhe do të triumfoj me vdekjen time. Ata në Worms po komplotojnë tërheqjen time dhe unë do të tërhiqem sepse, në fillim, thoja se papa është mëkëmbës i Krishtit, kurse tani do të deklaroj se është kundërshtari i Zotit tonë dhe apostull i djallit." - Ibid, libri 7 kap. 6.

Luteri nuk do ta ndërmerrte këtë udhëtim të rrezikshëm vetëm. Përveç lajmëtarit perandorak, atë vendosën ta shoqëronin edhe tre nga miqtë e tij më besnik. Edhe Melanchtoni donte me gjithë shpirt të bashkohej me ta. Zemra e tij ishte e lidhur fort me atë të Luterit dhe ai ishte betuar ta ndiqte Luterin po të lindte nevoja, në burg e në varr. Lutjet e tij nuk u morën parasysh. Sikur të vdiste Luteri, shpresa e vetme e Reformacionit mbetej bashkëpunëtori i tij i ri. Ndërsa u nda me Melanchtonin, Reformatori tha: "Në qoftë se nuk kthehem dhe armiqtë e mi më dënojnë me vdekje, vazhdo t'i mësosh njerëzit dhe të qëndrosh i patundur në mbrojtje të së vërtetës. Puno në vendin tim... Në rast se ti mbijeton, vdekja ime nuk do të ketë shumë rëndësi." - Ibid, libri 7, kap. 7. Studentët dhe qytetarët që ishin mbledhur për t'i uruar udhë të mbarë, u prekën thellë. Një turmë e madhe njerëzish, zemrat e të cilëve e kishin pranuar ungjillin, përshëndetën me lot në sy. Kështu, Reformatori dhe bashkëudhëtarët e tij u larguan nga Wittenbergu.

Gjatë udhëtimit ata vunë re se njerëzit i kishin pushtuar parandjenja të këqija. Në disa qytete, kalimi i tyre nuk ngjalli as emocionin më të vogël. Kur qëndruan në një qytet të vogël për të kaluar natën, një prift - mik shprehu frikën e tij duke i treguar Luterit portretin e një reformatori italian që kishte rënë si martir. Të nesërmen ata dëgjuan se shkrimet e Luterit në Worms ishin quajtur të gabuara. Lajmëtarët po shpallnin kudo vendimin perandorak duke u bërë thirrje njerëzve që t'ua dorëzonin magjistratëve librat e ndaluar. Shoqëruesi i tij, duke mos i besuar më lejekalimit dhe duke menduar se çështja e tij tashmë ishte goditur rëndë, e pyeti nëse dëshironte të kthehej. Ai iu përgjigj: "Edhe pse më ndalojnë në çdo qytet, do të vazhdoj." - Ibid, libri 7, kap. 7.

Në Erfurt, Luteri u prit me nderim. I rrethuar nga turma admiruesish, ai përshkoi rrugët që vite më parë i kishte shkelur ngarkuar me thesin e fratit lypës. Ai shkoi tek qelia e tij në konvikt dhe mendja i shkoi tek betejat e gjata që i ishte dashur të përballonte për t'i falur Gjermanisë dritën që i kishte ndriçuar shpirtin. Murgu që dikur u kthye në tallje të konviktit mbarë, tani hipi mbi podiun, - një gjë e tillë nuk i lejohej por lajmëtari bëri një lëshim - dhe predikoi.

Grumbullit të njerëzve ai iu drejtua me fjalët e Krishtit: "Paqja qoftë me ju! Filozofë, mjekë dhe shkrimtarë janë përpjekur t'i tregojnë njerëzimit mënyrën se si mund të fitohet jeta e përjetshme, por nuk ia kanë dalë mbanë. Do t'ua tregoj unë... Perëndia ka ngritur një njeri nga varri, Zotin Jezu Krisht, në mënyrë që Ai ta shkatërrojë vdekjen, ta çrrënjosë mëkatin dhe t'i mbyllë portat e ferrit. Kjo është puna e shpëtimit... Krishti ka fituar! Ky është lajmi i gëzuar dhe ne shpëtohemi jo nga veprat tona, por nga vepra e Tij... Zoti ynë Jezu Krishti tha: "Paqja qoftë me ju; shihni duart e mia!" Ai po thoshte: "Shiko, o njeri! Jam Unë dhe vetëm Unë që të laj nga mëkati dhe të blen. Tani keni paqe! - tha Zoti."

Ai vazhdoi të predikonte duke theksuar se besimi i vërtetë, shfaqet me anë të një jete të shenjtë. "Duke qënë se Perëndia na ka shpëtuar, le të veprojmë drejt që veprat tona të pranohen me gëzim prej Tij. Je i pasur? Eshtë mirë që të ardhurat e tua të shërbejnë edhe për të mirën e të tjerëve. Je i varfër? Qoftë puna jote e pranueshme për të pasurin! Në qoftë se puna jote të vlen vetëm ty, atëherë shërbimi që pretendon t'i ofrosh Perëndisë është i gënjeshtërt." - Ibid, libri 7, kap. 7.

Njerëzit dëgjonin me gojë hapur. Shpirtrat e uritur po shijonin bukën e jetës. Krishti në sytë e tyre ishte ngritur mbi papën, mbi delegatët, mbi perandorët dhe mbi mbretërit. Luteri as nuk e përmendi pozitën e tij të vështirë. Ai nuk u përpoq që të kthehej në objekt mendimi dhe keqardhje. Duke soditur Krishtin, ai e kishte harruar vetveten. Ai u fsheh pas Njeriut të Kalvarit, duke u orvatur që ta prezantonte Jezusin si Shpëtimtarin e mëkatarëve.

Ndërsa Reformatori vazhdonte udhëtimin e tij, vinte re rritjen e interesit të njerëzve. Gjithnjë e më shpesh turmat që e rrethonin e dëgjonin me dashamirësi dhe e paralajmëronin për qëllimin keqdashës së papistëve. "Do të të djegin, - i thanë disa, - e do të bëjnë shkrumb e hi siç vepruan me John Hussin. "Luteri përgjigjej: "Edhe sikur të ndiznin një zjarr të madh, flakët e të cilit të arrinin qiellin, nga Wittenbergu në Worms, unë do të kaloja mes tij në emër të Zotit dhe do të paraqitesha atje; do të hyja mes kthetrave të kësaj bishe dhe do t'ia thyeja dhëmbët duke treguar për Zotin Jezu Krisht." - Ibid, libri 7, kap.7

Lajmi i mbërritjes së tij në Worms ngjalli një shqetësim të madh. Miqtë frikësoheshin për jetën e tij; armiqtë frikësoheshin për fatin e kauzës së tyre. Përpjekje të mëdha u bënë që ta bindnin të mos hynte në qytet. Papistët me lëkurë deleje, e nxitën të kërkonte strehë në kështjellën e një fisniku, ku të gjitha problemeve do t'u jepej zgjidhje në mënyrë shoqërore. Miqtë u përpoqën ta frikësonin duke i përshk-

ruar rreziqet që e kanosnin. Përpjekjet e tyre nuk dhanë rezultat. Luteri, i vedosur, deklaroi: "Edhe sikur në Worms të ketë aq shumë demonë sa tjegullat mbi çati, unë do të shkoj atje." - Ibid, libri 7, kap. 7.

Me të arritur në portat e qytetit, i doli përpara një turmë e madhe njerëzish për t'i uruar mirëseardhjen. Një grumbullim kaq i madh nuk ishte mbledhur as për perandorin vetë. Shqetësimi ishte i madh. Nga mesi i turmës u dëgjua një këngë vaji si paralajmërim për fatin që e priste. "Perëndia do të jetë mbrojtja ime. tha ai ndërsa po zbriste nga karroca.

Papistëve nuk u kishte shkuar në mendje se ai do të vinte në Worms dhe ardhja e tij i tmerroi. Perandori mblodhi menjëherë këshilltarët e tij që të vendosnin se çfarë rruge do të ndiqnin. Një nga peshkopët, përkrahës i zellshëm i papës, deklaroi: "Jemi konsultuar edhe më parë për këtë çështje. Hiqe qafe, madhëri, kë-të njeri! A nuk e dënoi Sigismundi, John Hussin me djegie? Ne nuk kemi pse ta respektojmë lejekalimin e një heretiku. Jo, -tha perandori, - ne duhet ta mbajmë premtimin që dhamë." - Ibid, libri 7, kap.8. U vendos që Reformatorit t'i jepej e drejta e fjalës.

Të gjithë banorët e qytetit mezi prisnin ta shihnin këtë njeri të shquar dhe një turmë e madhe njerëzish priste vazhdimisht pranë vendit ku banonte ai. Luteri sapo kishte kaluar një sëmundje të rëndë dhe ishte i lodhur nga udhëtimi dyjavor. Ai duhej të përgatitej për ngjarjet e së nesërmes dhe kishte nevojë për qetësi e pushim, por dëshira për ta takuar ishte kaq e madhe, saqë vetëm pas dy orësh nga mbërritja e tij, fisnikë, oborrtarë, priftërinj, qytetarë u mblodhën në vend. Mes tyre, kishte shumë nga fisnikët që i kishin kërkuar me vendosmëri perandorit një reformë të përgjithshme kishëtare dhe që, - sipas fjalëve të Luterit, - "ishin çliruar nga ungjilli im." - Martyn, fq.393.

Për t'u takuar me murgun trim nuk erdhën vetëm miq, por edhe armiq; por ai i priti të gjithë me qetësi, duke u dhënë përgjigje të matura dhe dinjitoze. Durimi i tij ishte i qëndrueshëm dhe i guximshëm. Fytyra e tij e zbehtë dhe e imët, vijosur nga gjurmët e punës dhe sëmundjes, ruante një shprehje të gëzueshme. Solemniteti dhe saktësia e fjalëve të tij, i falnin atij një fuqi, të cilës nuk i bënin dot ballë as armiqtë e tij. Si miqtë dhe armiqtë u mahnitën. Disa ishin më se të bindur se ai ndihmohej nga një forcë hyjnore; të tjerët, si farisenjtë me Krishtin thonin: "Eshtë i pushtuar nga djalli."

Të nesërmen Luteri u paraqit përpara Diet- ës. Një roje perandorake e shoqëroi atë deri në sallën e pritjes; megjithatë ai e pati të vështirë të arrinte deri atje. Vdo rrugë ishte mbushur me njerëz që mezi prisnin ta shihnin me sytë e tyre murgun që kishte guxuar ta kundërshtonte autoritetin e papës.

Ndërsa po hynte në sallën e gjyqit, një gjeneral i vjetër, një hero betejash të lavdishme, i tha atij me butësi: "I shkreti murg, i shkreti murg! Ti do të përballosh tani një betejë shumë më fisnike se unë ose ndonjëri prej kapitenëve të mi. Por në qoftë se kauza jote është e drejtë dhe ti je i sigurtë për këtë, ec përpara në emër të

Zotit dhe mos ki frikë nga asgjë. Perëndia nuk do të harrojë." - D'Aubigne, libri 7, kap. 8.

Luteri qëndroi përpara kështillit. Perandori ishte ulur mbi fron. Përreth tij ndodheshin personazhet më të shquara të perandorisë. Asnjë njeri tjetër nuk ishte paraqitur ndonjëherë përpara një asambleje më të nderuar se kjo e mbledhur tani për Martin Luterin, që do t'i duhej të jepte llogari për besimin e tij. "Një pamje e tillë ishte në vetvete një fitore mbi papatin. Papa e kishte dënuar këtë njeri dhe ai, tani, qëndronte përpara një trupi gjykues që me këtë veprim po lartësohej mbi vetë papën. Papa e kishte mallkuar dhe veçuar nga pjesa tjetër e shoqërisë njerëzore; e megjithatë atij i bëhej njëftesë e respektueshme dhe thirrej përpara asamblesë më fisnike të botës. Papa e kishte dënuar me heshtje të përjetshme, ndërsa ai po bëhej gati të fliste përpara mijëra dëgjuesve të vëmendshëm që ishin mbledhur nga të katër anët e botës së Krishterë. Luteri u kthye në shkëndijë të një zjarri të fuqishëm revolucionar. Roma tashmë po zbriste nga froni i saj dhe shkaku i këtij poshtërimi ishte zëri i një murgu të thjeshtë." - Ibid, libri 7, kap. 8.

Para asaj asambleje të fuqishme dhe fisnike, Reformatori që vinte nga një familje e thjeshtë, dukej i mahnitur dhe i hutuar. Disa nga princat, duke e kuptuar që ai ishte i emocionuar, iu afruan dhe njëri prej tyre pëshpëriti: "Mos kij frikë nga ata që vrasin trupin, por që nuk mund të vrasin shpirtin. "Një tjetër tha: "Kur t'ju çojnë përpara guvernatorëve dhe përpara mbretërve për shkakun Tim, Fryma e Atit do të flasë në ju. "Kështu, njerëzit e fuqishëm të botës i kujtuan fjalët e Krishtit, shërbëtorit të Tij në ketë orë prove.

Luterin e ulën përpara fronit të perandorit. Në sallë nuk pipëtinte askush. Më pas, një zyrtar perandorak u ngrit në këmbë dhe duke treguar me gisht një grumbull me veprat e Luterit, i kërkoi Reformatorit që t'u përgjigjej dy pyetjeve - a i pranonte këto shkrime si të tijat dhe a pranonte t'i tërhiqte opinionet që kishte shprehur në to. Me t'u lexuar titujt e librave, Luteri u përgjigj se veprat ishin shkruar prej tij. "Përsa i përket pyetjes së dytë, - tha ai, - meqë është një pyetje që ka të bëjë me besimin dhe shpëtimin e shpirtrave dhe ku përfshihet edhe fjala e Perëndisë që është thesari më i çmuar si në qiell dhe mbi dhe, duhet të mendohem mirë përpara se t'i përgjigjem. Mund të pranoj më pak nga ç'më kërkojnë rrethanat ose më shumë nga është e vërtetë, duke mëkatuar kështu ndaj kësaj thënie të Krishtit: "Kushdo që do te më mohojë përpara njerëzve, edhe unë do ta mohoj përpara Atit tim që është në qiej." - Mateu 10:33. Kjo është arsyeja që unë i lutem madhërisë së tij perandorit, që të më japë kohë që të përgjigjem pa e cënuar fjalën e Perëndisë." -D'Aubigne, libri 7, kap.8.

Kjo kërkesë ishte një veprim i mençur i Luterit. Rruga që ndoqi e bindi asamblenë se ai nuk vepronte i nxitur nga pasioni apo impulsi i momentit. Një qetësi dhe vetkontroll i tillë, që nuk pritej nga njeri i vendosur dhe i drejtpërdrejtë si ai, i

dha një nuancë të re fuqisë së tij dhe më pas e aftësoi atë të përgjigjej me një urtësi, pjekuri, vendosmëri dhe me një dinjitet të tillë që i çuditi, i zhgënjeu dhe i vuri në lojë kundërshtarët e tij mendjemëdhenj.

"O Zot i plotfuqishëm dhe i përjetshëm, - u lut ai, - sa e tmerrshme është kjo botë! Shiko se si ka hapur gojën për të më gëlltitur dhe unë kam kaq besim tek Ti... Në qoftë se do t'i besoj forcës së kësaj bote, mori fund gjithçka... Ka ardhur ora ime e fundit, dënimi im është vendosur... O Zot, më ndihmo ta përballoj mençurinë e botës. Bëje këtë... Vetëm Ti,... sepse kjo nuk është puna ime, por Jotja. Unë nuk mund të bëj asgjë për të zbrapsur të mëdhenjtë e botës... Kauza të përket Ty... dhe është një kauzë e drejtë dhe e përjetshme. O Zot, më ndihmo! O Zot besnik dhe i qëndrueshëm vetëm Ty të besoj. Gjithçka që vjen nga njeriu është e paqëndrueshme; gjithçka që vjen nga njeriu dështon... Ti më ke zgjedhur për këtë punë... Qëndromë pranë për hir të të dashurit Tënd Jezu Krisht, që është mbrojtja, shpata dhe kështjella ime." - Ibid, libri 7, kap. 8.

Me vullnetin e Tij Zoti e kishte bërë Luterin të ndërgjegjshëm për rrezikun që i kanosej, në mënyrë që ai të mos kishte besim tek forcat e veta e të nxitohej kuturu. Nuk ishte aspak frika e vuajtjeve personale, torturave dhe vdekjes që e tmerronte. Tani ai po ballafaqohej me këtë periudhë kritike dhe ndjehej jo plotësisht i aftë për t'i bërë ballë. Për shkak të dobësisë së tij, kauza e së vërtetës mund të dëmtohej. Ai iu lut Zotit jo për siguri personale, por për triumfin e ungjillit. Konflikti dhe ankthi që ndjente në shpirt i ngjanin vuajtjeve të Izraelit në atë natë të shqetësuar pranë atij përroi pa jetë. Ashtu si Izraeli edhe ai doli fitimtar me Perëndinë. Kur gjithçka dukej pa shpresë, ai e përqëndroi besimin e tij tek Krishti, Çliruesi i fuqishëm. Ai mori forcë nga siguria se nuk do të paraqitej i vetëm përpara atij këshilli. Paqja iu rikthye në shpirt dhe ai u gëzua që po i besohej nderi i madh që t'ua hapte sundimtarëve të kombeve, fjalën e Perëndisë.

Me mendje të drejtuar tek Zoti, Luteri u përgatit për betejën që e priste. Ai përcaktoi planin e përgjigjeve të tij, shqyrtoi pasazhe të veprave të tij dhe nxirri nga Shkrimet e Shenjta prova të shumta në mbështetje të tezave të veta. Më pas, duke e vënë dorën e majtë mbi Volumin e Shenjtë që ishte hapur përpara tij, ai ngriti dorën e djathtë drejt qiellit dhe u betua "t'i qëndronte besnik ungjillit dhe ta shprehte haptazi besimin e tij edhe sikur t'i duhej ta vuloste me gjak dëshminë e tij." - Ibid, libri 7, kap. 8.

Kur u paraqit sërisht përpara Diet- ës, në fytyrën e tij nuk dalloheshin gjurmë frikë apo hutimi. I qetë dhe paqësor, por edhe i guximshëm dhe fisnik, ai qëndronte mes njerëzve të mëdhenj të botës, si dëshmitar i Perëndisë. Zyrtari perandorak e pyeti sërisht nëse kishte vendosur të hiqte dorë nga doktrinat e tij. Luteri u përgjigj me zë të ulët dhe të qetë, pa u udhëhequr nga hakmarrja apo pasioni. Sjellja e tij ishte e respektueshme dhe shprehte një besim dhe gëzim që e çuditi asamblenë.

"Perandor i nderuar, princë të shquar, zotërinj të respektueshëm - tha Luteri. - Paraqitem përpara jush sot duke e çuar në vend urdhrin që m'u dha dje dhe në emër të Zotit i lutem madhërisë suaj dhe fisnikëve të tjerë të pranishëm që të më dëgjojnë me dashamirësi ndërsa do të mbroj një kauzë që mendoj se është e drejtë dhe e vërtetë. Në rast se, falë padijes sime, do t'i shkel zakonet dhe ritet e oborrit mbretëror, ju lutem që të më falni, sepse nuk jam rritu në pallat luksoze, por në vetminë e një manastiri." - Ibid, libri 7, kap. 8.

Më pas, ai pohoi se veprat e tij nuk ishin të të njëjtit karakter. Në disa prej tyre ai kishte folur për besimin dhe veprat e mira dhe madje edhe armiqtë e tij deklaronin se ato ishin mjaft të dobishme. Të flakje tej libra të tillë, do të thoshte të dënoje të vërteta që i pranonin të dyja palët. Pjesa tjetër e shkrimeve të tij kishte në qëndër korrupsionin dhe abuzimet e papatit. Të mohoje këto vepra do të thoshte të forcoje tiraninë e Romës dhe t'i hapje rrugën pabesive akoma dhe më të mëdha. Në librat e grupit të tretë ai kishte sulmuar individë që u kishin dalë në mbrojtje të këqijave që viheshin re në botë. Në lidhje me këto libra ai pohoi haptazi se ishte treguar ca më i ashpër. Ai nuk pretendonte se ishte pa asnjë faj; por as këta libra nuk mund t'i hidhte poshtë sepse një gjë e tillë do t'i inkurajonte armiqtë e së vërtetës dhe ata nuk do të nguronin ta trajtonin akoma më mizorisht popullin e Perëndisë.

"Megjithatë unë jam thjesht një qënie njerëzore dhe jo Perëndi. - vazhdoi ai - Prandaj do ta mbroj vetveten ashtu siç u mbrojt edhe Krishti. "Në qoftë se kam folur keq, dëshmoni për këtë të keqe... Falë mëshirës së Perëndisë, unë ju lutem ju, perandor i nderuar, ju princë të respektueshëm dhe njerëzve të çdo rangu e shtrese shoqërore, të më provojnë se jam i gabuar. Me t'u bindur për këtë, do të heq dorë nga çdo gabim dhe do të jem i pari që do t'i marr librat e mi e do t'i hedh në zjarr.

Shpresoj që fjalët që kam thënë deri tani tregojnë qartë se i kam peshuar dhe vlerësuar mirë rreziqet që më kanosen; por nuk jam aspak i trishtuar, por i gëzuar që ungjilli sot, si në kohën e apostujve, bëhet shkak shqetësimi dhe kundërshtimi. Ky është karakteri; ky është fati i fjalës së Zotit. "Nuk erdha të sjell paqe, por shpatë, - tha Jezusi. Zoti është i mrekullueshëm dhe i tmerrshëm kur këshillon, prandaj mendohuni mirë sepse duke synuar të shmangni diskutimet nuk do të merrni nëpër këmbë fjalën e Perëndisë, por do të përjetoni një zhgënjim të frikshëm dhe rreziqesh të panumërta, rrënimesh të mëdha dhe shkatërrim të përjetshëm... Unë mund të citoj shumë shembuj nga Shkrimet e Perëndisë. Mund të flas për Faraonët, për mbretërit e Babilonisë dhe te Izraelit, veprat e të cilëve çuan në shkatërrimin e tyre pikërisht atëherë kur kërkuan këshillë nga kuvendet më të njohura të botës, për të forcuar sundimin e tyre." - Ibid, libri 7, kap.8

Luteri foli fillimisht në gjermanisht; tani atij iu kërkua të përsëriste gjithçka që tha në latinisht. Megjithëse i lodhur nga fjalimi i parë, ai e pranoi këtë kërkesë, dhe përsëriti gjithçka me të njëjtën energji dhe qartësi të fillimit. Perëndia ndërhyri

përsëri. Mendjet e shumë princëve ishin verbuar kaq shumë nga gabimet dhe superstcioni, saqë ata nuk arritën ta kuptonin forcën e arsyetimit të Luterit gjatë fjalimit të parë; por përsëritja i dha atyre mundësi t'i perceptonin më qartë çështjet në diskutim.

Ata, që i mbyllën me kokëfortësi sytë përpara të vërtetës dhe vendosën të mos i bindeshin asaj, u tërbuan nga forca e fjalëve të Luterit. Kur ai i dha fund fjalimit të tij, zëdhënësi i Diet- ës tha me ashpërsi: "Nuk i ke dhënë përgjigje pyetjes që t'u bë... Kërkojmë një përgjigje të saktë dhe të shkurtër. Do të tërhiqesh apo jo?

Reformatori u përgjigj: "Meqënëse madhëria juaj e respektuar dhe autoritetet e larta kërkojnë prej meje një përgjigje të saktë, të thjeshtë dhe të shkurtër, unë do t'ua bëj qejfin. Përgjigjja ime është kjo: nuk mund t'ia nënshtroj besimin tim as papës dhe as këshillave sepse është e qartë si drita e diellit se ato kanë gabuar dhe kanë rënë ndesh me njëri- tjetrin. Në qoftë se nuk bindem nga dëshima e Shkrimeve të Shenjta ose nga arsyetimi më i shëndoshë, në qoftë se nuk bindem, nëpërmjet pasazheve që sapo citova, se gaboj, në qoftë se ndërgjegja ime nuk përputhet me fjalën e Perëndisë, unë as mund të tërhiqem dhe as nuk do ta bëj një gjë të tillë, sepse nuk është mirë që një i Krishterë të flas kundër ndërgjegjes së tij. Ky është vendimi im. Nuk mund të veproj ndryshe. Zoti më ndihmoftë! Amen." - Ibid, libri 7, kap.8

Kështu, ai njeri i drejtë, i kishte ngulur këmbët fort mbi themelin e sigurt të fjalës së Perëndisë. Drita qiellore ia ndriçonte fytyrën. Madhështia dhe pastërtia e karakterit, paqja dhe gëzimi shpirtëror dolën në dritë të plotë, ndërsa ai dëshmonte kundër fuqisë së gabimit dhe pro atij besimi që del fitimtar mbi botën.

Për disa çaste e gjithë asambleja mbeti e shtangur nga habia. Kur Luteri ishte paraqitur për herë të parë përpara këshillit ai kishte folur me zë te ulët dhe kishte mbajtur një qëndrim të respektueshëm, pothuajse të nënshtruar. Papistët kishin menduar se kjo ishte provë e mungesës së guximit nga ana e tij. Ata e quajtën kërkesën për shtyrje, "preludë" të tërheqjes së tij. Karli vetë, duke vënë re me përçmim pamjen e vuajtur të murgut, veshjen e tij modeste dhe thjeshtësinë e fjalimit të tij, kishte thënë: "Për mendimin tim ky murg nuk do të bëhet kurrë heretik." Guximi dhe qëndrueshmëria që shfaqi ai tani, si dhe fuqia dhe qartësia e arsyetimit të tij, i çuditi të gjithë të pranishmit. Perandori, i mahnitur, thirri: "Ky murg flet me gjithë zemër dhe me guxim të paparë." Shumë princë gjermanë e panë me gëzim e krenari këtë përfaqsues të denjë të kombit të tyre.

Përkrahësit e Romës u ngrysën në fytyrë, kauza e tyre po shqyrtohej nga një këndi ri vështrimi. Ata u përpoqën të mos dorëzoheshin, duke mos iu drejtuar Shkrimeve të Shenjta, por duke kërcënuar, sepse kërcënimet janë argumentet e vetme "bindëse" të Romës. Zëdhënësi i Diet- ës tha: "Në qoftë se nuk heq dorë, perandori dhe përfaqësuesit e shteteve të perandorisë do të mblidhen për të diskutuar mbi masat që do të merren kundër një heretiku të pandreqshëm."

Miqtë e Luterit, që e kishin dëgjuar me gëzim mbrojtjen e tij, u tmerruan nga këto fjalë; por vetë Reformatori tha qetësisht: "Më ndihmoftë Zoti se nuk mund te heq dorë nga asgjë." - Ibid, libri 7, kap. 8.

Atij iu dha urdher që të largohej nga salla gjyqësore ndërsa princët do të konsultoheshin me njëri- tjetrin. Gjithkush e kuptoi se pika kulmore kishte ardhur. Këmbëngulja e Luterit për të mos u gjunjëzuar mund ta ndryshonte rrënjësisht historinë shekullore të kishës. U vendos që t'i ofrohej atij një mundësi tjetër pendimi. Ai u shoqërua përpara asamblesë për herë të fundit. U pyet sërisht nëse ishte i gatshëm t'i braktiste doktrinat e tij. "Përveç përgjigjes që dhashë, - tha ai- unë s'kam asgjë tjetër për të shtuar." Dukej qartë se as premtimet dhe as kërcënimet, nuk mund ta bënin atë t'i nënshtrohej mandatit të Romës.

Udhëheqësit e papatit u tërbuan me murgun që guxoi të përçmonte autoritetin e tyre, para të cilit ishin trembur princë dhe mbretër. Ata mezi prisnin ta shprehnin zemërimin e tyre duke "luajtur" mizorisht me jetën e tij, por Luteri, edhe pse e dinte që i kanosej një rrezik i madh, i kishte folur të gjithëve me dinjitet dhe qetësi prej të Krishteri të mirë. Fjalët e tij ishin të thjeshta, të matura dhe të qarta. Ai e kishte harruar vetveten dhe ata që e rrethonin, duke e përqëndruar vëmendjen vetëm tek Ai që është shumë më i madh se papa, prelatet, mbretërit apo perandorët. Krishti kishte folur, përmes dëshmisë së Luterit, me një fuqi dhe madhështi aq të madhe saqë për një farë kohe ishin çuditur dhe mahnitur jo vetëm miqtë por edhe armiqtë. Në atë sallë ishte i pranishëm Shpirti i Perëndisë që i preku zemrat e sundimtarëve perandorakë. Shumë princë e pranuan me guxim drejtësinë e kauzës së Luterit drmë të thellë. Mes tyre pati edhe nga ata që nuk i shprehën bindjet e tyre që në atë moment, por që pas një studimi të hollësishëm të Shkrimeve te Shenjta, u kthyen më pas, në përkrahës të patrembur të Reformacionit.

I zgjedhuri i Saksonisë, Frederiku, që e kishte pritur me ankth paraqitjen e luterit në Worms, e dëgjoi i emocionuar fjalimin e tij. I gëzuar dhe krenar, ai vuri re guximin, qëndrueshmërinë dhe vetëkontrollin e doktorit dhe vendosi ta mbronte më me forcë kauzën e tij. Ai krahasoi palët kontradiktore dhe kuptoi që mençuria e papës, mbretërve dhe prelatëve nuk vlente fare përpara fuqisë së të vërtetës. Papati pësoi një disfatë që do të linte gjurmë në të gjithë brezat e në të gjithë kohërat.

Me të kuptuar efektin që pati fjalimi i Luterit, delegati pati frikë më shumë se kurrë për sigurinë e pushtetit romak dhe vendosi ta sulmonte Reformatorin me të gjitha mundësitë që kishte. Duke përdorur gojëtarinë dhe diplomacinë, për të cilat shquhej, ai i parashtroi perandorit rreziqet e miqësisë dhe përkrahjes së selisë së fuqishme romake për hir të një murgu të rëndomtë.

Fjalët e tij patën ndikimin e tyre. Të nesërmen e përgjigjes së Luterit, Karli i paraqiti Diet- ës një mesazh, ku theksonte vendosmërinë e tij për ta vazhduar politikën e mbrojtjes dhe ruajtjes së fesë Katolike në vend, që e kishin përqafuar

më parë edhe paraardhësit e tij. Meqënëse Luteri nuk kishte pranuar të hiqte dorë nga gabimet e tij, kundër atij vetë dhe heretikëve të tjerë që e përkrahnin, duheshin ndërmarrë masat më të ashpra. "Një murg i vetëm i çmendur është ngritur kundër Kristianiznit. Të përqafoj një marrëzi të tillë do të thotë të vë në rrezik mbretëritë e mia, miqtë e mi, trupin tim, gjakun tim, shpirtin tim e madje edhe jetën time. E ndaloj Luterin që të shkaktojë çrregullime dhe trazira në popull. Në rast të kundërt, do të proçedoj kundër tij dhe përkrahësve të tij duke i shkishëruar dhe duke marrë të gjitha masat e duhura për shkatërrimin e plotë të këtyre heretikëve. U bëj thirrje përfaqsuesve të shteteve gjermane që të sillen si të Krishterë besnikë." - Ibid, libri 7, kap. 9. Megjithatë, perandori deklaroi se lejekalimi i Luterit duhej respektuar dhe ai duhej të kthehej në shtëpi shëndoshë e mirë përpara fillimit të proçesit kundër tij.

Anëtarët e Diet- ës mbronin, në lidhje me këtë çështje, dy mendime të kundërta. Përfaqësuesit dhe delegatët e Romës kërkuan sërisht anullimin e lejekalimit të reformatorit. "Hiri i tij, ashtu si i John Hussit përpara një shekulli, - thanë ata, - duhet të përfundojnë në lumin Ren." - Ibid, libri 7, kap. 9. Por princët gjermanë, edhe pse vetë ishin përkrahës të papës dhe armiq të betuar të Luterit, protestuan kundër një shkeljeje të tillë besimi dhe kundër një njolle të tillë të madhe mbi nderin e kombit. Ata kujtuan fatkeqësitë që patën pasuar vdekjen e Hussit dhe deklaruan se nuk guxonin të bëheshin shkak i përsëritjes së këtyre të këqijave mbi Gjermaninë dhe mbi perandorin e tyre të ri.

Duke iu përgjigjur këtij propozimi të ulët, vetë Karli tha: "Edhe në qoftë se nderi dhe besa do të zhdukeshin nga faqja e dheut, gjithmonë duhet të vazhdonin të gjenin strehë në zemrat e princëve." - Ibid, libri 7, kap. 9. Armiqtë më të vendosur të Luterit vazhduan ta nxisnin atë që të vepronte me Reformatorin ashtu siç kishte vepruar Sigismundi me Hussin - t'ia linte atë në dorë kishës; por, duke kujtuar skenën kur Hussi duke treguar me gisht prangat e tij, e quajti mbretin besëshkelës përpara asamblesë, Karli i V deklaroi: "Nuk dua të skuqem si Sigismundi" - Lenfant vëll. 1, fq. 422.

Megjithatë Karli i kishte hedhur poshtë me vetëdije të vërtetat që parashtroi Luteri. "Unë jam më se i vendosur të ndjek shembullin e paraardhësve të - shkruante perandori. - D'Aubigne, libri 7, kap. 9. Ai kishte vendosur të ndiqte rrugën e zakonit, edhe pse ajo e largonte nga shtegu i drejtësisë dhe së vërtetës. Ai do ta mbronte papatin, si dhe mizorinë dhe korrupsionin e tij sepse kështu kishin vepruar edhe stërgjyshërit e vet. Duke marrë këtë vendim, ai refuzoi të pranonte dritën që etërit e tij nuk kishin mundur ta shihnin dhe as të hidhte një hap të tillë të rëndësishëm që ata nuk e kishin hedhur.

Edhe në ditët tona ka shumë njerëz që kapen fort pas zakoneve dhe traditave të trashëguara. Kur Zoti u fal atyre rreze të reja drite ata nuk i pranojnë ato vetëm sepse baballarët e tyre, duke mos e pasur këtë mundësi, nuk i kanë pranuar ato. Ne

nuk jetojmë si etërit tanë, rrjedhimisht përgjegjësitë tona ndryshojnë nga të tyret. Në qoftë se nisemi nga shembulli i baballarëve tanë, pa e studjuar personalisht Biblën duke kuptuar kështu se cila është detyra jonë, nuk do të fitojmë miratimin e Perëndisë. Përgjegjësia jonë është më e madhe se ajo e paraardhësve tanë. Ne jemi përgjegjës jo vetëm për dritën që e pranuan ata e na e lanë trashëgim në shekuj, por edhe për rrezet e reja që na zbulohen në fjalën e Perëndisë.

Duke folur për çifutët jobesimtarë, Jezusi tha: "Po të mos kisha ardhur e të mos u kisha falur atyre, nuk do të kishin faj, por tani ata nuk kanë asnjë shfajësim për mëkatin e tyre." - Gjoni 15:22. Ishte e njëjta fuqi hyjnore ajo që u foli princëve dhe perandorit të Gjermanisë me gojën e Luterit. Ndërsa drita u çlirua madhërisht nga fjala e Perëndisë, Shpirti i Tij punoi për herë të fundit në zemrat e shumë anëtarëve të asaj asambleje. Ashtu si Pilati, shekuj më parë, i hapi rrugë krenarisë dhe popullaritetit duke ia mbyllur portën e zemrës në fytyrë Shpëtimtarit të botës; ashtu si Feliksi frikacak iu lut lajmëtarit të së vërtetës: "Për tani, shko dhe kur të kem rast, do të dërgoj të të thërrasin.", ashtu si Gripa krenar që tha: "Për pak dhe po ma mbush mendjen të bëhem i Krishterë." (Veprat e Apostujve 24: 25:26:28), duke i kthyer kurrizin mesazhit qiellor, - edhe Karli i V, duke u dhënë pas krenarisë dhe politikës botërore, vendosi ta mohonte dritën e së vërtetës.

Thashethemet për masat që do të merreshin kundër Luterit u përhapën me shpejtësi, duke ngjallur një shqetësim të madh në mbarë qytetin. Reformatori kishte shumë miq, që duke njohur mizorinë e madhe të Romës ndaj të gjithë atyre që guxonin t'ua çirrnin maskën gabimeve të saj, vendosën të bënin çmos që ai të mos binte pre e saj. Qindra aristokratë u betuan se do ta mbronin me jetën e tyre. Të shumtë ishin ata që e quajtën mesazhin perandorak një nënshtrim të ulët ndaj fuqisë kontrolluese të Romës. Në dyert e shtëpive dhe në vendet publike u ngjitën pllakata pro dhe kundër Luterit. Në njërën prej tyre ishin shkruar vetëm fjalët domethënëse të njeriut të mençur: "Mjerë ti o vend, mbreti i të cilit është një fëmi." - Predikuesi 10:16. Entuziazmi popullor në mbështetje të Luterit në mbarë Gjermaninë, e bindi si perandorin edhe Diet- ën se çdo padrejtësi që mund t'i bëhej atij do ta vinte në rrezik paqen e perandorisë dhe stabilitetin e fronit.

Ndërkohë Frederiku i Saksonisë mbajti një qëndrim të studjuar mirë, ndërsa i fshihte me kujdes ndjenjat e tij të vërteta ndaj Reformatorit, ai vëzhgonte vazhdimisht lëvizjet e tij dhe të armiqve të tij. Megjithatë pati shumë njerëz që nuk u përpoqën ta fshihnin simpatinë e tyre për Luterin. Ai vizitohej nga princë, kontë, baronë dhe personalitete të tjera të shquara; si fetare dhe laikë. Në dhomën e vogël të doktorit, - shkruan Spalatini, -nuk mund të rrinin të gjithë vizitorët që paraqiteshin në çdo orë të ditës." - Martyn, vëll 1, fq.404. Njerëzit e shikonin si të ishte më shumë se një qënie njerëzore. Madje edhe ata që nuk u besonin doktrinave të tij, e admironin ndershmërinë dhe guximin e këtij njeriu që ishte gati t'i bënte ballë vdekjes vetëm për të mos cënuar ndërgjegjen.

Përpjekje të shumta u bënë për ta bindur Luterin që të hynte në kompromis me Romën. Fisnikë dhe princë e paralajmëruan se po të vazhdonte të këmbëngulte në drejtësinë e gjykimit të tij mbi atë të kishës dhe të këshillit, do të dëbohej nga perandoria dhe do të humbiste të drejtën për t'u mbrojtur. Kësaj thirrjeje Luteri iu përgjigj: "Ungjilli i Krishtit nuk mund të predikohet pa rrezik... Atëherë pse duhet të më ndajë frika ndaj rrezikut nga Zoti dhe nga fjala e Tij, e vetmja gjë që është e vërtetë? Jo! Më mirë të jap trupin, gjakun dhe jetën time." - D'Aubigne, libri 7, kap. 10.

Kur iu bë thirrje për t'iu nënshtruar përsëri gjykimit të perandorit sepse vetëm kështu mund të jetonte i qetë, ai tha: "Jam shumë dakort që perandori, princët dhe madje edhe i Krishteri më i thjeshtë, t'i shqyrtojnë e t'i gjykojnë veprat e mia, por me një kusht: që ata të marrin si rregull bazë të hetimeve të tyre fjalën e Perëndisë. Detyra e vetme e njerëzve është bindja ndaj saj. Mos u mundoni ta cënoni ndërgjegjen time sepse është e lidhur pazgjidhshmërisht me Shkrimet e Shenjta." Ibid, libri 7, kap. 10.

Një thirrjeje tjetër, ai iu përgjigj kështu: "Jam gati ta dorëzoj lejekalimin. Ia lë në duar perandorit jetën dhe veten time, por jo fjalën e Perëndisë - atë kurrë!" - Ibid, libri 7, kap. 10. Ai theksoi gadishmërinë e tij për t'iu nënshtruar vendimit të këshillit kombëtar me kusht që ky këshill, të vendoste në përputhje me Shkrimet e Shenjta. "Për sa i përket fjalës së Perëndisë dhe besimit, - shtoi ai, - çdo i Krishterë është një gjykatës i mirë sa papa dhe një milion këshilla." - Martyn, vëll 1 fq. 410. Si miqtë, edhe armiqtë u bindën më në fund se përpjekjet e mëtejshme për ripajtim do të ishin të kota.

Sikur Reformatori të kishte lëshuar pe në një pikë të vetme, Satani dhe përkrahësit e tij do të kishin dalë fitimtarë, por qëndrueshmëria e tij e patundur ishte një rrugë për emancipimin e kishës dhe një fillim i një epokë të re. Ndikimi i këtij njeriu, që i vetëm guxoi të mendonte e të vepronte ndryshe nga e zakonshmja në çështje fetare, u ndje në historinë kishëtare dhe botërore jo vetëm të kohës së tij, por gjatë gjithë kohërave. Qëndrueshmëria dhe besnikëria e tij do t'u jepte forcë të gjithë atyre, që në ditët e fundit, do të përjetonin një eksperiencë të ngjashme. Fuqia dhe madhështia e Perëndisë triumfoi mbi këshillat njerëzor dhe mbi mençurinë djallëzore të Satanit.

Perandori e urdhëroi Luterin që të kthehej në shtëpi dhe ai e dinte mirë se një urdhër i tillë do të pasohej nga dënimi i tij i shpejtë. Rrugën e tij po e errësonin gjithnjë e më shumë re kërcënuese; por ndërsa po largohej nga Wormsi zemra e tij ishte mbushur me gëzim dhe paqe. "Vetë djalli, - tha ai, - u mundua ta mbrojë kështjellën e papës, por Krishti hapi një të çarë të madhe dhe Satani u detyrua të pranojë se Zoti është më i fuqishëm se ai." - D'Aubigne, libri 7, kap. 11.

Pas largimit të tij, Luteri, duke mos dashur që qëndrueshmëria e tij të interpretohej për rebelim, i shkroi sërisht perandorit: "Zoti, që heton zemrat, më është

dëshmitar që unë jam më se i gatshëm që t'i bindem madhërisë suaj me nder ose pa nder, në jetë e deri në vdekje, pa asnjë përjashtim përveç asaj që paraqitet në Fjalën e Perëndisë, që është buka jetëdhënëse për njeriun. Besnikëria ime ndaj jush në lidhje me gjërat e kësaj jete, nuk do të lëkundet sepse fitimi apo humbja në këtë jetë nuk ka të bëjë me shpëtimin, por kur vihen në lojë interesat e përjetshme, Zoti dëshiron që njeriu të mos i nënshtrohet njeriut. Nënshtrimi në çështje shpirtërore është një adhurim në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe duhet t'i drejtohet vetëm Krijuesit." - Ibid, libri 7, kap. 11.

Gjatë udhëtimit për në shtëpi, Luteri u prit më me ngrohtësi sesa gjatë udhëtimit të parë. Klerikët fisnikë e mirëpritën murgun e shkishëruar dhe sundimtarët civilë e nderuan njeriun të cilin perandori e kishte mohuar. Atij iu lutën që të predikonte dhe pa marrë parasysh urdhërin perandorak që ia ndalonte një gjë të tillë, ai u ngjit sërisht në podium. "Nuk jam angazhuar kurrë në groposjen e fjalës së Perëndisë, - tha ai, - dhe asnjëherë nuk do ta bëj një gjë të tillë." - Martyn, vëll 1, fq. 420.

Me t'u larguar ai nga Wormsi, papistët, pa humbur kohë, ia mbushën mendjen perandorit që të nxirrte një vendim kundër tij. Në këtë dekret Luteri përshkruhej si "Satani vetë në formë njerëzore, i veshur me fratin e një murgu." - D'Aubigne, libri 7, kap. 11. U dha urdhëri që me t'u zhvleftësuar lejekalimi i tij, të merreshin masa për t'i vënë fre punës së tij. Të gjithëve iu ndalua që ta strehonin, ta ushqenin apo ta ndihmonin privatisht apo publikisht, me fjalë apo me vepra. Ai duhej kapur e dorëzuar pranë autoriteteve përkatëse. Edhe përkrahësit e tij duheshin burgosur e u duhej konfiskuar gjithçka që kishin. Shkrimet e tij duheshin shkatërruar dhe të gjithë ata që do të guxonin të vepronin ndryshe, do të përfshiheshin në dënimet e shpallura nga ky dekret. I zgjedhuri i Saksonisë dhe princët - miq të Luterit u larguan nga Wormsi menjëherë pas largimit të tij kështu që dekreti i perandorit u miratua nga Diet- a. Papistët u gëzuan. Ata e quanin të vulosur punën e Reformacionit.

Perëndia kishte parasjikuar një rrugë shpëtimi për shërbëtorin e tij në këto çaste rreziku. Një sy vigjilent i kishte ndjekur lëvizjet e Luterit dhe një zemër e sinqertë dhe fisnike kishte vendosur ta ndihmonte. Dukej qartë se Romën do ta kënaqte vetëm vdekja e tij; vetëm duke u fshehur mund t'i shpëtonte ai dhëmbëve të luanit. Zoti i dha mençurinë e duhur Frederikut të Saksonisë dhe ky hartoi një plan për shpëtimin e Reformatorit. Falë bashkëpunimit me miq, u arrit qëllimi i Frederikut dhe Luteri u fsheh me sukses pa lënë gjurmë. Gjatë udhëtimit të tij për në shtëpi, ai u "rrëmbye", u nda nga shoqëruesit e tij dhe përmes pyllit u dërgua në kështjellën e Wartburgut që ndodhej në një vend të shkretë mes maleve. Si rrëmbimi i tij, ashtu dhe fshehja e tij ishin kaq të mistershme, sa edhe vetë Frederiku nuk dinte për një kohë të gjatë se ku strehohej ai. Padija i shërbente një qëllimi; për aq kohë

sa i zgjedhuri i Saksonisë nuk dinte gjë, edhe nuk mund të tregonte gjë. Ai e dinte që Reformatori ishte shëndoshë e mirë dhe kjo e kënaqte.

Kaluan pranvera, vera, vjeshta, erdhi dimri dhe Luteri vazhdonte të mbetej "në burg". Aleandri dhe përkrahësit e tij ngazëlloheshin sa herë që drita e ungjillit dukej sikur po fikej. Por Reformatori po e mbushte llampën nga ushqyesi i së vërtetës dhe drita e saj po bëhej gati për të dhënë më shumë ngrohtësi.

Për një farë kohe, Luteri iu gëzua sigurisë miqësore te Watburgut, larg zallahisë dhe tymit të betejës. Megjithatë, nuk mund të vazhdonte të gjente kënaqësi në heshtje dhe vetmi. I mësuar me një jetë aktive konfliktesh të mprehta, ai nuk mund të qëndronte gjatë pa bërë asgjë. Gjatë atyre ditëve vetmie, ai mendoi për gjendjen në të cilën ndodhej kisha dhe thirri i dëshpëruar: "Obobo! Nuk gjendet asnjë njeri, që në këto ditë të fundit të zemërimit të Tij, të qëndrojë si mur përpara Zotit e ta shpëtojë Izraelin!" - Ibid, libri 9, kap. 2. Ai mendoi përsëri për vetveten dhe pati frikë se mos e quanin frikacak ngaqë ishte tërhequr nga beteja. Më pas, filloi të vetëqortohej për përtaci e plogështi ndërkohë që çdo ditë punonte më shumë se zakonisht. Pena e tij nuk rreshti kurrë së shkruari. Ndërsa armiqtë e tij ia bënin qejfin vetes duke menduar se ia kishin mbyllur gojën, ata çuditeshin nga provat e një pas njëshme të veprimtarise së tij. Një numër i madh traktesh, shkruar nga dora e tij, qarkullonin në mbarë Gjermaninë. Ai u bëri gjithashtu një shërbim të madh bashkëatdhetarëve të tij duke përkthyer Dhiatën e Re në gjermanisht. Nga Patmosi i tij shkëmbor ai vazhdoi për një vit të shpallte ungjillin dhe t'i qortonte të metat dhe gabimet e kohës së tij.

Zoti e kishte veçuar Luterin nga jeta publike jo vetëm për t'i shpëtuar zemërimit të armiqve të tij apo për t'i ofruar atij një periudhë qetësie pas një veprimtarie kaq të ngjeshur, por për të arritur rezultate akoma dhe më të rëndësishme. Vetmia e vendstrehimit të tij malor nuk cënohej nga mbështetja apo lëvdimi njerëzor. Kështu, ai i shpëtoi krenarisë dhe vetëbesimit që mbart në vetvete suksesi. Falë vuajtjeve dhe përçmimit, ai u përgatit që të ecte i sigurt mbi majat marramendëse ku u gjend papritmas.

Ndërsa njerëzit i gëzoheshin lirisë që u fal e vërteta, ata janë të prirur të lartësojnë shërbëtorët që ka përdorur Perëndia për të thyer prangat e gabimit dhe superstticionit. Satani përpiqet t'i largojë mendimet dhe ndjenjat e njerëzve nga Zoti, tek veglat njerëzore; ai i bën njerëzit që të nderojnë instrumentin dhe ta harrojnë Dorën që i drejton të gjitha ngjarjet. Shpesh, udhëheqësit fetarë që nderohen dhe lëvdohen nga të tjerët, e harrojnë varësinë e tyre ndaj Perëndisë dhe fillojnë t'u besojnë forcave të tyre. Rrjedhimisht ata përpiqen t'i vënë nën kontroll mendjet dhe ndërgjegjet e njerëzve, që janë të prirur të udhëhiqen prej tyre, në vend që t'i drejtohen fjalës së Perëndisë. Reforma shpesh pengohet nga një frymë e tillë vetëkënaqësie që vihet re tek mbështetësit e saj. Zoti e mbrojti Reformacionin nga një rrezik i tillë. Ai dëshi-

ronte që kjo vepër të mbante vulën e Perëndisë dhe jo gjurmën e njeriut. Vështrimi i njerëzve ishte përqëndruar tek Luteri si zbulues i së vërtetës; ai u largua prej tyre që sytë e të gjithëve të drejtoheshin tek Autori i përjetshëm i së vërtetës.

1. Më ç'mënyrë ishte prezantimi i Luterit në këshillin e "Diet Wormsit" një prezantim revolucionar për të?

2. Shprehja e Luterit, "Unë qëndroj këtu, nuk mund të bëj tjetër gjë; Zoti më ndihmoftë. Amen,"është ndoshta një nga fjalitë më të mëdha të rregjistruara në historinë njerëzore. Konsideroni një eksperiencë ku ju jeni ngritur për të vërtetën. Cili ishte rezultati?

3. Luteri reflektonte dritën që Perëndia e lejoi të shkëlqente mbi të, por deri në fund të kohërave do të vazhdojë të shkëlqejë dritë e re. Si duhet të sillemi dhe si duhet ta përdorim "dritën e re"?

9.

Reformatori Zvicerian

Plani hyjnor që u vu re në formimin e kishës së parë, vazhdoi të luante rol të rëndësishëm edhe në reformimin e kësaj kishe. Mësue esi qiellor nuk i përfilli njerëzit e mëdhenj, të pasur e të pushtetshëm të botës që ishin mësuar të lëvdoheshin e të nderoheshin si udhëheqës të popujve. Ata ishin kaq krenar dhe mendjemëdhenj për shkak të epërsisë së tyre, saqë nuk do të mundnin të bëheshin një me bashkëkohësit e tyre dhe nuk do të mund të bashkëpunonin me Njeriun e përulur të Nazaretit. Thirrja: "Ndiqmëni dhe unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish." - Mateu 4:19, iu drejtua peshkatarëve të paditur të Galilesë. Këta dishepuj ishin të përulur e të duruar. Sa më pak të ishin ndikuar nga mësimet e rreme të kohës së tyre, aq më me sukses mund t'i stërviste Jezusi ata në shërbim të Tij. Kështu ndodhi edhe gjatë ditëve të Reformacionit. Reformatorët kryesorë ishin njerëz të thjeshtë - njerëz që kishin qëndruar larg ndikimit të krenarisë së postit, shthurjes dhe politikës sipërfaqësore të priftërinjve. Perëndia përdor mjete të thjeshta për të arritu rezultate të mëdha. Vetëm kështu, lavdia nuk do t'u jepet njerëzve, por Atij që punon me anë të tyre për të kryer vullnetin e Tij.

Pak javë pas lindjes së Luterit në kabinën e një minatori në Saksoni; mes Alpeve, në kasollen e një bariu, u dëgjuan të qarat e para të Ulrik Zwinglit. Rrethanat ku kaloi fëmijërinë dhe arsimimi i tij që mori në rini e përgatitën Zwinglin për misionin e tij të së ardhmes. Skenat e madhështisë, bukurisë dhe sublimitetit të natyrës ndikuan në lindjen, që në moshë të njomë, brenda zemrës së tij të një ndjenje admirimi për madhështinë dhe fuqinë

e Perëndisë. Historia e veprave dhe fitoreve të mëdha të arritura mbi këto male, ndezi aspiratat e tij djaloshare. Ulur mbi prehërin e gjyshes ai dëgjoi ato histori të pakta e të çmuara Biblike që ajo i kishte pastruar me kujdes nga pluhuri i legjendave dhe traditave të kishës. Me interes të madh, ai dëgjoi veprat e mëdha të patriarkëve dhe profetëve, të barinjve që ndërsa ruanin tufat e tyre mbi kodrat e Palestinës folën me ëngjëjt që u treguan atyre mbi Foshnjën e Betlehemit dhe Njeriun e Kalvarit.

Ashtu si babai i Luterit, edhe ai i Zwinglit dëshironte që i biri të arsimohej dhe kështu, djali u largua nga lëndinat e tij që në moshë të re. Mendja e tij u zhvillua shumë shpejt dhe lindi problemi i gjetjes së mësuesve të aftë për ta udhëzuar më tej. Në moshën trembëdhjetë vjeçare ai shkoi në Bern, që në atë kohë ishte qendra kryesore arsimore në Zvicër. Sidoqoftë këtu u ndesh një rrezik i madh që kërcënonte të dëmtonte të ardhmen e tij premtuese. Murgjit u përpoqën që ta joshnin atë drejt jetës së manastirit. Në atë kohë murgjit domenikanë dhe françeskanë ishin rivalë në luftën për të fituar simpatinë popullore. Ata u përpoqën ta siguronin një gjë të tillë me anë të zbukurimeve të kishave përkatëse, madhështisë së ceremonive kishëtare, relikave të njohura dhe imazheve çudibërëse.

Domenikanasit e Bernit e kuptuan që po ta kishin me vete këtë të ri të talentuar, do të siguronin bashkë me të fitime të shumta dhe nder të madh. Rinia e tij, aftësia natyrore për të folur e për të shkruar, gjenialiteti i tij si muzikant dhe poet do t'i tërhiqnin më shumë njerëzit, duke e zgjeruar rrezen e ndikimit të këtij urdhri murgjësh, sesa e gjithë madhështia dhe krenaria e tyre të marra sëbashku. Ata u përpoqën ta bindnin Zwinglin me ane të mashtrimeve dhe lajkave që të bashkohej me ta. Luteri, ndërsa ishte akoma student, u varros në një çeli konvikti dhe bota as nuk do të kishte dëgjuar kurrë për të sikur të mos e kishte çliruar Zoti me vullnetin e Tij të lirë. Zwingli nuk u lejua që të përjetonte të njëjtin rrezik. Planet e murgjërve ranë jo rastësisht në vesh të të atit. Ai nuk synonte që i biri të binte pre e jetës pavlerë dhe të lodhshme të murgut, prandaj, duke parë që e ardhmja e tij rrezikohej, e këshilloi të birin të kthehej në shtëpi pa vonesë.

Ky urdhër u zbatua; por i riu nuk mund të kënaqej në luginat e gjelbra për një kohë të gjatë dhe kështu rifilloi studimet e tij në Basel. Pikërisht këtu, e dëgjoi Zwingli për herë të parë lajmin e mirë të hirit falas të Perëndisë. Wittembach, një mësues i gjuhëve antike, ndërsa studjonte greqishten dhe hebraishten e vjetër, i kishte lexuar Shkrimet e Shenjta dhe falë punës së tij, drita ndriçoi dhe mendjet e studentëve. Ai deklaroi se ekzistonte një e vërtetë më e hershme dhe shumë herë më e vlefshme se teoritë e profesorëve dhe filozofëve. Kjo e vërtetë e lashtë ishte se vdekja e Krishtit është shpagimi i vetëm i një mëkatari.Për Zwinglin këto fjalë ishin si rrezet e para të dritës që paraprijnë agimin.

Shumë shpejt Zwinglit iu bë thirrje që t'i hynte punës, të cilës ai do t'i kushtonte jetën. Një kishë e vogël mes Alpeve, jo shumë larg vendlindjes së tij, u kthye në misionin e tij të parë. Me t'u shuguruar si prift, ai iu përkushtua me gjithë shpirt kërkimit të së vërtetës hyjnore sepse ai ishte më se i ndërgjegjshëm, - thotë një reformator - mik i tij, - se duhet ta dinte se kujt i ishte besuar tufa e Krishtit." - Wylie, libri 8, kap. 5. Sa më shumë që i studjonte Shkrimet e Shenjta, aq më qartë e kuptonte dallimin midis të vërtetave të tyre dhe herezive të Romës. Ai iu nënshtrua Biblës, si të vetmit rregull të plotë e të pagabueshëm. Ai kuptoi se ajo duhet

të interpretonte vetveten. Ai nuk guxonte ta shpjegonte Biblën për të mbështetur një doktrinë apo teori njerëzore, por e quante si detyrë të rëndësishme njohjen e mësimeve të saj të qarta e të drejtpërdrejta. Ai u përpoq ta kuptonte tërësisht dhe saktësisht domethënien e Shkrimeve të Shenjta dhe për këtë kërkoi ndihmën e Shpirtit të Shenjtë, i Cili, deklaronte ai, do të punonte me të gjithë ata që i drejtoheshin me sinqeritet dhe me lutje.

"Shkrimet e Shenjta, - thoshte Zwingli, - vijnë nga Perëndia dhe jo nga njeriu dhe vetëm ky Zot, që errësirën, do të bëjë të kuptosh se Ai është Autori i fjalimit. Fjala e Zotit... nuk mund të gabojë; është e shndritshme; përsërit vetveten; zbulon vetveten; e ndriçon shpirtin me dritën e shpëtimit dhe hirit; e ngushëllon atë me dijen e Perëndisë, e përul në mënyrë që ai (shpirti) ta harrojë vetveten e të përqafojë Zotin." Zwingli e kishte provuar vetë të vërtetën e këtyre fjalëve. Duke folur për përvojën e tij gjatë asaj kohe, ai shkruante më pas: "Kur... iu përkushtova kokë e këmbë studimit të Shkrimeve të Shenjta, filozofia dhe teologjia (skolastike) do të m'i çorientonin mendimet. Më së fundi arriti deri në atë pikë sa mendova: "Hiq dorë nga gënjeshtrat dhe mësoje se ç'është Perëndia nga fjala e Tij e thjeshtë." Më pas i kërkova Zotit dritë dhe Shkrimet e Shenjta u bënë akoma dhe më të qarta për mua." - Ibid, libri 8, kap. 6.

Zwingli predikoi një doktrinë që nuk e mori nga Luteri. Ishte doktrina e Krishtit. "Në qoftë se Luteri predikon mbi Krishtin, - tha Reformatori Zvicerian, - ai bën atë që po bëj edhe unë. Ai ka sjellë tek Krishti më shumë njerëz se unë, por kjo nuk ka rëndësi. Unë njoh vetëm vetëm emrin e Krishtit, i Cili është i vetmi Komandant i imi, ushtar i të cilit jam. Luteri nuk më ka shkruar asnjë fjalë të vetme dhe as unë nuk i kam shkruar kurrë. Pse?... Në mënyrë që të shihet se sa në unitet është Shpirti i Perëndisë me vetveten, përderisa ne të dy, edhe pse nuk jemi takuar kurrë, predikojmë të njëjtën doktrinë të Krishtit si të ishin një." - D'Aubigne, libri 8, kap. 9.

Në vitin 1516, Zwingli u ftua që të predikonte në konviktin e Einsiedelnit. Pikërisht këtu, ai u ndesh ballë për ballë me korrupsionet e Romës dhe ushtroi ndikimin e një Reformatori që do të njihej përtej. Alpeve të vendit të tij. Një nga relikat më të çmuara të Einsisdelnit ishte ikona e Virgjëreshës, për të cilën thuhej, se kishte fuqi çudibërëse. Mbi portën e konviktit shkruhej: "Këtu mund të fitohet një falje e plotë e mëkateve." -Ibid, libri 8, kap. 5. Shtegtarët i drejtoheshin imazhit të Virgjëreshës në çdo kohë të vitit; por në ditën e festivalit të përvitshëm të përkushtimit të saj vinin me mijëra njerëz jo vetëm nga të katër anët e Zvicrës, por edhe nga Franca dhe Gjermania. Zwingli, i trishtuar shumë nga një skenë e tillë, vendosi që ta shfrytëzonte këtë mundësi për t'u shpallur këtyre skllevërve të supersticionit, liri përmes ungjillit.

Mos mendoni, - tha ai, - se Perëndia është më i pranishëm në këtë tempull sesa në ndonjë pjesë tjetër të krijimit të Tij. Nuk ka rëndësi se ku banoni, Zoti është

aty dhe iu dëgjon... A ka mundësi që veprat tuaja të padobishme, shtegtimet e gjata, dhuratat, imazhet, thirrja e Virgjëreshës apo shenjtorëve t'iu sigurojnë hirin e Perëndisë?... Çfarë u jep vlerë fjalëve tona që i përdorim gjatë lutjeve? Çfarë rëndësie ka një mantel me kapuç, një kokë e punuar bukur, një veshje e gjatë dhe marramendëse apo sandalet me rripa ari?... Zoti peshon zemrën dhe zemrat tona janë larg Tij. "Krishti, - tha ai, - që u ofrua njëherë në kryq, është flijimi dhe viktima dhe i ka shlyer të gjitha mëkatet e besimtarëve përjetësisht." - Ibid, libri 8, kap.5.

Shumë dëgjuesve nuk u pëlqyen këto mësime. Ishte një zhgënjim i madh për ta fakti që udhëtimin e lodhshëm e kishin ndërmarrë më kot. Ata nuk mund ta kuptonin faljen falas që u ofronte Krishti. Ata ishin të kënaqur nga rruga e vjetër drejt parajsës që u kishte projektuar Roma. Ata dridheshin dhe çoroditeshin nga mendimi se do t'u duhej të kërkonin diçka më të mirë. Ishte më e lehtë t'ua lije shpëtimin në duar priftërinjve dhe papës se sa të kërkoje pastërti shpirtërore.

Megjithatë, një grup tjetër njerëzish e pritën me gëzim lajmin e shpëtimit përmes Krishtit. Ceremonitë "e shpikura" nga Roma nuk i sillnin më paqe shpirtit dhe ata e pranuan me besim gjakun e Shpëtimtarit si pajtim. Këta njerëz u kthyen nëpër shtëpitë e tyre për t'u zbuluar të tjerëve dritën që kishin marrë me vete.

E vërteta udhëtoi kështu nga fshati në fshat dhe nga qyteti në qytet dhe numri i shtegtarëve drejt ikonës së Virgjëreshës u pakësua. Dhuratat nuk ishin më edhe aq të shumta dhe rrjedhimisht rroga e Zwinglit që nxirrej prej tyre u pakësua. Por, ndërsa shihte sesi fanatizmi dhe supersticioni goditeshin për vdekje, ai gëzohej.

Autoritetet kishëtare nuk ishin të verbër përpara punës që po kryente Zwingli, por, për momentin, ata vendosën të mos ndërhynin. Duke vazhduar të shpresonin se ai do ta përqafonte një ditë kauzën e tyre, ata u përpoqën ta bënin për vete me lajka; ndërkohë që e vërteta po hidhte rrënjë në zemrat e njerëzve.

Puna në Einsiedeln e kishte përgatitur Zwinglin për një fushë më të gjerë veprimi që po e priste pa humbur kohë. Pas tre vjet pune në këtë qytet, atij iu besua detyra e predikuesit në katedralen e Zyrihut. Në atë kohë ky ishte qyteti më i rëndësishëm i konfederatës zviceriane dhe ndikimi që ushtroi ai këtu u ndje në të katër anët e vendit. Klerikët që e ftuan të punonte në Zyrih nuk i kishin edhe aq për zemër rinovimet dhe ata fillimisht e udhëzuan dhe i përshkruan detyrat që e prisnin.

"Do të bësh ç'është e mundur, - i thanë ata, - për të mbledhur të gjitha të ardhurat e kapelanit pa përjashtuar as edhe një qindarkë. Do t'i nxisësh besimtarët, si nga podiumi, ashtu edhe nga dhoma e rrëfimit, që t'i paguajnë të dhjetat rregullisht dhe që ta tregojnë dashurinë e tyre ndaj kishës me anë të dhuratave. Do të tregohesh i zellshëm në shtimin e fitimeve që vijnë nga të sëmurët, nga meshat dhe përgjithësisht nga çdo shërbesë fetare."

"Edhe drejtimi i ceremonive fetare, predikimi dhe kujdesi për tufën shpirtërore, - shtuan këshilluesit e tij, - janë detyra të kapelanit. Megjithatë për kryerjen e tyre

ti mund të caktosh një zëvendësues, veërisht për sferën e predikimit. Ceremonitë e veçanta mund t'i lihen nën drejtim vetëm personave të shuguruar, zëvendësimi është i palejueshëm në rastin e njerëzve të tjerë." - Ibid, libri 8, kap. 6.

Zwingli i dëgjoi me vëmendje këto këshilla dhe pasi shprehu mirënjohjen e tij për nderin që i ishte bërë duke iu besuar një detyrë kaq e rëndësishme, vazhdoi të shpjegonte rrugën që mendonte të ndiqte. "Njerëzve u është fshehur për një kohë të gjatë jeta e Krishtit. - tha ai. - Do të predikoj mbi të gjithë ungjillin e Shën Mateut... duke pirë vetëm nga burimi i Shkrimeve të Shenjta, duke prekur fundin e tyre, duke e krahasuar një pasazh me tjetrin dhe duke u përpjekur t'i kuptoj ato falë krahasimeve dhe lutjeve të ethshme. Unë do t'ia përkushtoj shërbimin tim lavdisë së Perëndisë, lëvdimit të Birit të Tij të vetëm, shpëtimit të vërtetë të shpirtrave dhe ngritjes së tyre drejt besimit të kulluar." - Ibid, libri 8, kap. 6. Edhe pse shumë nga klerikët nuk e miratuan planin e tij dhe u përpoqën ta bindnin të hiqte dorë, Zwingli qëndroi i papërkulur. Ai theksoi se nuk do të përdorte ndonjë metodë të re, por do të ndiqte metodën e vjetër të kishës në kohërat e shkuara.

Të vërtetat që predikonte ai kishin ngjallur tashmë një interes të madh dhe turma të tëra njerëzish mblidheshin për ta dëgjuar atë. Mes dëgjuesve kishte shumë njerëz që kishin kishin kohë pa marrë pjesë në shërbesa fetare. Detyra e tij si predikues filloi me leximin dhe shpjegimin e jetës, mësimeve dhe vdekjes së Krishtit, siç përshkruhen në Ungjijt. Këtu, ashtu si në Einsiedelm, ai e mbrojti fjalën e Perëndisë si autoritetin e vetëm të pagabueshëm dhe e paraqiti vdekjen e Krishtit si të vetmin flijim të plotë. "Unë dua t'iu drejtoj, - tha ai, - tek Krishti që është burimi i vërtetë i shpëtimit." - Ibid, libri 8, kap. 6. Predikuesin e qortonin njerëz të klasave të ndryshme, nga qeveritarët dhe profesorët deri tek artizanët dhe fshatarët. Ata i dëgjonin me etje fjalët e tij. Ai nuk shpalli vetëm dhuratën falas të shpëtimit, por edhe i qortoi ashpër të këqijat dhe korrupsionin e kohës së tij. Shumë njerëz largoheshin nga katedralja duke e lëvduar Perëndinë. "Ky njeri, - thoshin ata, - predikon të vërtetën. Ai do të jetë Moisiu ynë, që do të na udhëheqë jashtë kësaj errësire egjiptiane." - Ibid, libri 8, kap. 6.

Megjithëse, fillimisht, veprimtaria e tij u prit me entuziazëm, pas një farë kohe ai u ndesh me kundërshtimet e para. Murgjët vendosën ta pengojnë punën e tij dhe t'i dënojnë mësimet që mbronte. Shumë prej tyre e sulmuan me kurthe dhe qortime; të tjerët me kërcënime dhe pabesi. Por Zwingli i duroi të gjitha këto duke thënë "Në qoftë se duam t'i bëjmë për vete të këqinjtë drejt Jezu Krishtit, duhet t'i mbyllim sytë përpara shumë gjërave." - Ibid, libri 8, kap. 6.

Pikërisht në këtë kohë, punën e reformës e çoi më përpara një njeri tjetër. Një përkrahës i reformës në Basel kërkoi që një mik i tij Luterian të vinte në Zyrih sepse shitja e veprave të Luterit mund të ndihmonte në përhapjen e dritës. "Sigurohu, - i shkruante ai Zwinglit, - që ky njeri zotëron aftësi dhe kujdes të mjaftueshëm,

e nëse kjo është e vërtetë, le të shkojë ai nga qyteti në qytet, nga fshati në fshat e madje nga shtëpia në shtëpi. për të përhapur mes zviceranëve veprat e Luterit e në mënyrë të veçantë, versionin e Lutjes së Zotit shkruar për laikët. Sa më shumë të njihen këto shkrime, aq më shumë blerës do të ketë." - Ibid, libri 8, kap. 6. Kështu dritës iu hap rruga.

Në momentin kur Perëndia bëhet gati për të thyer prangat e padijes dhe superstucionit, Satani punon akoma edhe më shumë për t'i lënë njerëzit në errësirë dhe për t'i vidhosur më fort hekurat që i mbajnë lidhur. Ndërsa në vende të ndryshme po ngriheshin heronj që ishin gati t'u flisnin njerëzve për faljen dhe shfajësimin përmes gjakut të Krishtit, Roma i hapi si kurrë më parë, në mbarë botën e krishterë, vendshitjet e faljeve për para.

Çdo mëkat kishte çmimin e vet dhe njerëzve u ofroheshin liçensa për çdo lloj krimi përderisa thesari i kishës rritej nga dita në ditë. Kështu përparuan të dyja lëvizjet - njëra që ofronte falje për mëkatin për para, tjetra, falje përmes Krishtit, - Roma, duke e shlyer mëkatin me liçensë dhe duke futur fitimin në xhep dhe Reformatorët, duke e dënuar mëkatin dhe duke treguar me gisht Krishtin, si të vetmin çlirimtar dhe shpagues.

Në Gjermani shitja e faljeve iu besua murgjërve Domenikanë dhe u drejtua nga krimineli Fetzel. Në Zvicër kjo tregti iu la në duar Françeskanëve dhe u kontrollua nga Samsoni, një murg italian. Samsoni ishte shquar për shërbimet që i kishte bërë kishës, duke grumbulluar shuma të mëdha nga Gjermania dhe Zvicra për të mbushur arkat e papatit. Tani ai e përshkroi kryq e tërthor Zvicrën, duke bërë për vete me mijëra njerëz, duke u rrëmbyer fshatarëve të varfër fitimet e tyre të mjerueshme dhe duke u kënaqur nga dhuratat e majme të të pasurve. Megjithatë, edhe pse ndikimi i reformës nuk mund ta ndalonte këtë tregti, ai u ndje deri- diku Zwingli ishte akoma në Einsiedeln kur Samsoni, pasi hyri në Zvicër, arriti me gjithë pasuesit e tij në një qytet fqinj. Me t'u njohur me misionin e tij, Reformatori u nis menjëherë për ta kundërshtuar. Rivalët nuk u takuan por suksesi i Zwinglit në zbulimin e pretendimeve absurde të murgut ishte kaq i madh, saqë Samsoni u detyrua të largohej nga ai vend.

Në Zyrih, Zwingli predikoi me zell kundër tregtarëve të faljeve dhe kur samsoni iu afrua qytetit, atij i doli përpara një lajmëtar nga këshilli që e paralajmëroi të mos hynte në Zyrih. Më së fundi ai hyri duke përdorur një hile të vjetër, por u dëbua pa shitur as edhe një falje. Më pas ai u largua nga Zvicra.

Shfaqja e murtajës apo vdekjes së zezë në zvicër në vitin 1519, idha një shtytje të madhe reformës. Me t'u gjendur ballë për ballë me shkatërruesin, shumë njerëz filluan ta kuptojnë se sa pavlerë dhe të kota ishin faljet që kishin blerë dhe dëshironin me gjithë shpirt të kishin një themel më të sigurt besimi. Në Zyrih, Zwingli ishte në një gjendje kaq të rëndë sa çdo shpresë shërimi u shua dhe u përhap kudo

fjala se ai kishte vdekur. Në atë orë prove guximi dhe shpresa e tij nuk u dobësuan. Ai e shikonte me besim kryqin në Kalvar, duke i besuar shpagimit të mjftueshëm të çdo mëkati. Kur i shpëtoi vdekjes, ai filloi të predikonte me një zell akoma më të madh dhe fjalët e tij kishin një fuqi të mahnitshme. Njerëzit e pritën me gëzim pastorin e tyre të dashur që dukej sikur ishte kthyer nga buza e varrit. Ata vetë ishin kujdesur për të sëmurët dhe kishin varrosur të vdekurit dhe e kuptonin si kurrë më parë, vlerën e ungjillit.

Edhe Zwingli kishte arritur në një konceptim më të qartë të të vërtetave të tij dhe e kishte përjetuar plotësisht fuqinë e tij rinovuese. Ai trajtoi kryesisht dështimin e njeriut dhe planin e shpëtimit. "Me Adamin, - thoshte ai, - ne kemi vdekur të gjithë e jemi fundosur në korrupsion dhe dënim." - Wylie, libri 8, kap. 9. "Krishti... ka blerë për ne një çlirim të përjetshëm...

Pasioni i Tij është... një flijim i përjetshëm që nuk e humb kurrë efektin shërues; ai vë në vend drejtësinë hyjnore në emër të të gjithë atyre që u mbështetën në të me një besim të fortë e të qëndrueshëm." Megjithatë, ai e theksoi disa herë që njeriu, falë hirit të Krishtit, nuk është i lirë që të vazhdojë të mëkatojë. "Atje ku ka besim tek Perëndia, ndodhet Perëndia Vetë; dhe kudo ku ndodhet Perëndia, lind një zell i brendshëm për të kryer vepra të mira." - D'Aubigne, libri 8, kap. 9.

Interesimi për të dëgjuar predikimin e Zwinglit ishte aq i madh, sa katedralja mbushej plot me turma njerëzish. Pak nga pak, - sipas aftësive të tyre - ai u zbulonte dëgjuesve të tij të vërtetën. Ai ishte i kujdesshëm që të mos përmendte që në fillim çështje që do t'i çudisnin ata apo ngjallnin paragjykime në mendjet e tyre. Detyra e tij ishte që t'i bënte ata për vete me mësimet e Krishtit, t'ua zbuste zemrat me dashurinë e Tij dhe t'ua shpaloste përpara syve shembullin e Tij; dhe ndërsa ata do të pranonin parimet kryesore të ungjillit, besimet dhe praktikat e tyre supersticioze do të shuheshin dalëngadalë.

Reformacioni po përparonte hap pas hapi në Zyrih. Të alarmuar, armiqtë e tij u ngritën për ta kundërshtuar. Një vit më parë, murgu i Wittenbergut, i kishte thënë "jo" papës dhe perandorit në Worms dhe tani dukej sikur edhe në Zyrih papati po ndeshte në qëndresë. Zwingli u sulmua disa herë. Në vendet e kontrolluara nga papati herë pas here, ngriheshin turra drush për dishepujt e ungjillit, por kjo nuk mjaftonte; mësuesit të herezisë i duhej mbyllur goja. Për këtë arsye, peshkopi i Konstancës dërgoi tre delegatë në Këshillin e Zyrihut për ta akuzuar Zwinglin si njeri që u mësonte të tjerëve ta shkelnin ligjin e kishës duke rrezikuar kështu paqen dhe qetësinë sociale. Ai deklaroi se po të flakej tej autoriteti i kishës, do të mbizotëronte anarkia mbarëbotërore. Zwingli u përgjigj se gjatë këtyre katër vjetëve ai kishte predikuar ungjillin në Zyrih, "që ishte qyteti më i qetë dhe i paqshëm i konfederatës." "A nuk është Kristianizmi, - tha ai, - mbrojtësi më i mirë i sigurisë së përgjithshme?" - Wylie, libri 8, kap. 11.

Delegatët i paralajmëruan këshilltarët që ta mbronin kishën, jashtë të cilës, deklaruan ata, nuk ka shpëtim. Zwingli u përgjigj: "Mos u çorodisni nga kjo akuzë. Themeli i kishës është i njëjti Shkëmb, i njëjti Krisht që i fali Pjetrit emrin e tij sepse ai u tregoi të tjerëve për Të me besim. Çdo njeri, i çfarëdolloj kombi, që i beson me gjithë zemër Zotit Jezu Krisht, pranohet nga Perëndia. Ky është kisha jashtë të cilës nuk ka shpëtim. - D'Aubigne, edicioni i Londrës, libri 8, kap. 11. Si rrjedhim i kësaj konference, njëri nga delegatët e pranoi besimin e reformuar.

Këshilli nuk pranoi të merrte masa kundër Zwinglit dhe Roma u përgatit për një sulm të ri - Reformatori, kur dëgjoi për komplotet e armiqve të tij, tha: "Le të vijnë. Nuk kam frikë prej tyre ashtu si shkëmbi i patundur nuk u trembet valëve që e godasin parreshtur." - Wylie, libri 8, kap. 11. Përpjekjet e klerikëve vetëm sa e çuan përpara kauzën që po përpiqeshin të shkatërronin. E vërteta vazhdoi të përhapej. Në Gjermani përkrahësit e saj të dekurajuar nga zhdukja e Luterit, morën zemër sërisht kur panë përparimin e ungjillit në Zvicër.

Me t'u vendosur Reformacioni në Zyrih, frytet e tij u vunë re qartë në lulëzimin e harmonisë dhe rregullit dhe në pakësimin e krimeve. "Paqja banon në qytetin tonë, - shkruante Zwingli. - S'ka më grindje, zili dhe mosmarrëveshje. Nga mund të vijë tjetër një bashkim i tillë përveçse nga Zoti dhe nga doktrina jonë që na i mbush zemrat me paqe dhe mëshirë? - Ibid, libri 8, kap. 15.

Fitoret e arritura nga Reformatori i shtynë përkrahësit e Romës drejt përpjekjeve më të vendosura për shkatërrimin e tij. Duke vënë re se nga persekutimi i punës së Luterit në Gjermani nuk kishte rezultuar pothuajse asgjë, ata vendosën t'i bënin ballë reformës me armët e saj. Ata do të organizonin një ballafaqim me Zwinglin dhe duke i marrë në dorë vetë gjërat, do ta siguronin fitoren jo vetëm duke e zgjedhur vetë vendin e diskutimit, por edhe duke i caktuar vetë gjykatësit e kësaj çështjeje. Dhe me ta futur Zwinglin në kurth, ata nuk do ta linin t'u shpëtonte më. Me t'iu mbyllur goja udhëheqësit, lëvizja do të shtypej me lehtësi. Megjithatë, një qëllim i tillë u fsheh me kujdes.

U vendos që ballafaqimi të bëhej në Baden, por Zwingli nuk ishte i pranishëm. Këshilli i Zyrihut, duke dyshuar për planet e papistëve dhe i paralajmëruar nga turrat e ndezura të druve në vendet e tjera për predikuesit e ungjillit, nuk lejoi pastorin zvicerian t'i dilte përpara këtij rreziku. Në Zyrih ai ishte gati të takonte të gjithë delegatët e Romës; por të shkonte në Baden, ku ishte derdhur edhe më parë gjak martirësh, do të thoshte të shkonte drejt vdekjes së sigurt. Oecolampadiusi dhe Halleri u zgjodhën si përfaqësues të Reformatorëve, ndërsa doktor Ecku i famshëm, i shoqëruar nga një grup i madh njerëzish të ditur dhe prelatësh, ishte kampioni i Romës.

Edhe pse vetë Zwingli nuk ishte i pranishëm në konferencë, ndikimi i tij u ndje. Sekratarët u zgjodhën nga vetë papistët dhe të tjerëve u ndalohej marrja e

shënimeve me vdekje. Pavarësisht nga kjo, Zwinglit i shkonin çdo ditë të dhëna të sakta të gjithçkaje që thuhej në Baden. Një student që ndiqte ballafaqimin shënonte çdo mbrëmje argumentet e ditës. Dy studentë të tjerë merreshin me dërgimin e këtyre letrave, - së bashku me letrat e Oecolampadiusit, - deri në duart e Zwinglit. Reformatori përgjigjej çdo ditë, duke i këshilluar e sugjeruar bashkëpunëtorët e tij. Ai i shkruante letrat natën dhe studentët ktheheshin me to në Baden në mëngjes. Për t'i gënjyer rojet që qëndronin ditë e natë në portat e qytetit, lajmëtarët mbanin shporta me vezë mbi kokë dhe kalonin pa vështirësi.

Kështu Zwingli iu përgjigj sulmeve të kundërshtarëve të tij dinakë aty për aty. "Ai ka punuar - thotë Myconiusi, - me anë të meditimeve, netëve pa gjumë dhe këshillave më shumë se ç'do të kishte bërë duke diskutuar personalisht me armiqtë e tij." -D'Aubigne, libri 11, kap. 13.

Papistët, të krekosur nga parashikimi "i sigurt" i triumfit të tyre, erdhën në Baden me rrobat e tyre më të shtrenjta e me bizhuteri marramendëse. Ata udhëtuan në luks, tryezat e tyre të mbushura me ushqimet më të mira e verërat më të zgjedhura. Gëzimi dhe hareja ua lehtësonin detyrat e tyre kishëtare. Reformatorët ndryshonin shumë nga të parët. Njerëzit i shihnin si një grup lypësish që ishin kaq të zënë me punë sa nuk kishin kohë as për të ngrënë. Qiramarrësi i Oecampadiusit sa herë që shkonte në dhomën e tij, e gjente atë duke studjuar ose duke u lutur dhe i çuditur raportonte që të paktën heretiku ishte "shumë i zellshëm."

Në sallën e konferencës, "Ecku u ngjit me krenari në një podium të dekoruar bukur... ndërsa Oecamlampadiusi i përulur, me veshjen e tij të thjeshtë, u detyrua të ulej mbi një stol druri përballë kundërshtarit të tij mendjemadh." - Ibid, libri 11, kap. 13. Ecku nuk hoqi dorë nga siguria e tij e patundur dhe nga zëri autoritar. Zelli i tij e kishte zanafillën tek shpresa jo vetëm për famë por edhe për ar, sepse mbrojtësi i besimit do të shpërblehej me një shumë të madhe. Kur argumentet e tij më të "shëndosha" u hodhën poshtë, ai iu drejtua kërcënimeve dhe fyerjeve.

Oecamlampadiusi modest dhe i thjeshtë, fillimisht, u emocionua nga ky ballafaqim, por me ta marrë veten deklaroi solemnisht: "Fjala e Perëndisë është i vetmi standart gjykimi që njoh." - Ibid, libri 11, kap. 13. Edhe pse i sjellshëm dhe i qetë, ai u tregua i zoti dhe i papërkulur. Ndërsa delegatët e papatit, duke iu përmbajtur motos së tyre, u hodhën në mbrojtje të autoritetit dhe zakoneve të kishës, Reformatori mbrojti me vetëmohim Shkrimet e Shenjta. "Zakoni, - tha ai, - nuk ka fuqi në Zvicrën tonë në qoftë se nuk i përmbahet kushtetutës; në lidhje me besimin, Bibla është e vetmja kushtetutë." - Ibid, libri 11, kap.13.

Ndryshimi midis dy kundërshtarëve luajti rolin e vet. Arsyetimi i qartë dhe i qetë i Reformatorit, sëbashku me modestinë dhe mirësinë e tij, i bënte për vete mendjet e njerëzve, që i hidhnin poshtë hamendjet e kota dhe të pabaza të Eckut.

Diskutimi vazhdoi për 18 ditë. Në fund të tij, papistët, me besim të madh, pretenduan se fitorja u takonte atyre. Pjesa më e madhe e gjykatësve mbajtën anën e Romës dhe Diet- a e mohoi punën e Reformatorëve, duke vendosur që ata sëbashku me Zwinglin, udhëheqësin e tyre të përjashtoheshin nga kisha. Por frytet e konferencës e treguan qartë se cilët ishin fitimtarët e vërtetë. Ballafaqimi i dha një shtytje përpara kauzës së Protestanizmit dhe nuk kaloi shumë kohë kur Berni dhe Baseli, këto dy qytete të rëndësishëm, e përqafuan me gëzim Reformacionin.

1. Cili mësues e prezantoi Zëinglin me Biblën dhe tek cila "e vërtetë e lashtë" e drejtoi ai?

2. Në pozicionin e tij të parë si prift i një dhioqeze të madhe, "ai i nënshtrohej Biblës, si fjala e Perëndisë, autoriteti i vetem i mjaftueshëm dhe pagabueshëm." Përse është kaq e rëndësishme të marrësh Biblën si autoritetin e vetëm të besimit dhe praktikimit?

3. Në debatin midis Eck dhe përfaqësuesit të Zwinglit, Oecolampadius, Ecku bëri apel për "autoritetin e traditave kishtare", ndërkohe që reformatorët mbështeteshin tek Shkrimet e Shenjta. Cili është vendi që duhet të zerë tradita në zakonet kishtare?

10.

Progresi i Reformës në Gjermani

Zhdukja misterioze e Luterit ngjalli hutim dhe frikë në gjithë Gjermaninë. Kudo dëgjoheshin pyetje rreth tij. U përhapën thashetheme nga më të çuditshmet dhe shumë besonin se Luterin e kishin vrarë. Ankime vinin jo vetëm nga miqtë e tij të devotshëm, por edhe nga mijëra të tjerë, që nuk e kishin përkrahur haptazi Reformën. Shumë njerëz lidhën një betim solemn për t'u hakmarrë ndaj vdekjes së tij.

Udhëheqësit e Kishës Katolike Romake panë me tmerr pikën në të cilën kishte arritur zemërimi kundër tyre. Edhe pse në fillim ata u entuziazmuan nga vdekja imagjinare e Luterit, shumë shpejt ata dëshironin t'i fshiheshin indinjatës mbarëpopullore. Armiqtë e tij nuk kishin qënë kurrë kaq të shqetësuar nga aktet e guximshme që ai kreu, ndërsa ishte midis tyre sa ç'ishin tani me largimin e tij. Të gjithë ata që në zemërim e sipër ishin përpjekur ta shkatërronin Reformatorin e patundur tani ishin frikësuar nga fakti që ai ishte kthyer në një rob të pambrojtur. "E vetmja rrugë shpëtimi për ne" - tha dikush është kjo: "Të ndezim pishtarët dhe ta kërkojmë Luterin në të gjithë botën dhe ta rikthejmë atë tek kombi që po e thërret". Urdhëri i Perandorit u shfuqizua.

Ambasadorët e Papës u indinjuan kur vunë re se ky fakt nuk tërhoqi aq shumë vëmendjen e njerëzve sa fakti i Luterit.

Lajmi që u përhap nga një i burgosur se ai ishte shëndoshë e mirë i qetësoi njerëzit e frikësuar dhe në të njëjtën kohë rriti edhe më shumë entuziazmin e tyre në favor të tij. Shkrimet e tij u lexuan me më shumë etje. Një numër gjithnjë e më i madh njerëzish u bashkuan me kauzën e këtij njeriu heroik, që kishte mbrojtur fjalën e Zotit edhe në rrethana të tilla të rrezikshme. Reforma po forcohej në vazhdimësi. Fara që mbolli Luteri po mbinte kudo. Me mungesën e tij ai zhvilloi një aktivitet, që nuk do ta bënte kurrë me praninë e tij. Aktivistët e tjerë, me largimin e udhëheqësit të tyre të madh, ndjenë përgjegjësinë mbi supet e tyre. Në mënyrë që puna fisnike, që tashmë kishte nisur, të mos pengohej, ata ecën përpara duke bërë gjithçka që kishin në dorë me seriozitet dhe me besim të ri.

Por Satani nuk ishte dembel. Ai tani u orvat ashtu siç ishte orvatur edhe në çdo lëvizje tjetër reformiste - të mashtronte dhe të shkatërronte njerëzit, duke i bindur ata të besonin një gënjeshtër në vend të së vërtetës. Ashtu siç u shfaqën "krishterët" e rremë të shekullit të parë të kishës kristiane, ashtu u shfaqën edhe profetët e rremë të shekullit të 16-të.

Një grup i vogël njerëzish, të ndikuar nga gjallëria e botës fetare imagjinuan se ata vetë ishin njohur me zbulime të veçanta nga Qielli dhe deklaruan se ishin udhëzuar me mënyra hyjnore për ta thelluar më tej Reformën deri në përfundimin e saj. Në të vërtetë ata po shkatërronin punën që Luteri kishte bërë. Ata mohuan parimin themelor që përbënte themelin e Reformës - që fjala e Zotit është rregulla më se e mjaftueshme e besimit dhe praktikës dhe, duke marrë parasysh këtë, ajo është një udhëzues i pagabueshëm që zëvendëson standartin e paqëndrueshëm dhe të pasigurt të ndjenjave dhe të përshtypjeve njerëzore. Duke lënë mënjanë treguesin e vetëm të gabimit dhe fallsifikimit Satanit iu hap rruga për të kontrolluar mendjet e njerëzve sipas dëshirës së tij.

Një nga këta profetë deklaroi se ishte udhëzuar nga engjëlli Gabriel. Një student që u bashkua me ta ndërpreu studimet, duke deklaruar se vetë Zoti ia kishte dhënë atij urtësinë e duhur për të shpjeguar deri në detaje fjalën e Tij. Shumë të tjerë, që i përuleshin fanatizmit, u bashkuan me ta. Veprimet e këtyre njerëzve "të entuziazmuar" krijuan një ngacmim të fuqishëm Predikimet e Luterit kishin ngritur në këmbë shumë njerëz, që ndjenin nevojën e një reforme dhe tani shumë prej këtyre njerëzve të ndershëm u gënjyen nga pretendimet e profetëve të rinj.

Udhëheqësit e lëvizjes vazhduan të vepronin në Witenberg dhe i drejtuan pretendimet e tyre mbi Melanktonin dhe bashkëpunëtorët e tij. Ata deklaronin: "Ne na ka dërguar Zoti të mësojmë njerëzit. Ne kemi biseduar kokë më kokë me Zotin; ne e dimë se çfarë do të ndodhë, me një fjalë ne jemi apostuj dhe profetë dhe i bëjmë thirrje Luterit".- Ibid., b.9;

Reformatorët u çuditën dhe u çorientuan. Ky ishte një element i ri, të cilin ata nuk e kishin hasur kurrë më parë dhe nuk dinin nga t'ia mbanin.Melanktoni tha: "Këta njerëz drejtohen vërtet nga shpirtra të jashtëzakonshëm, por nga ç'lloj shpirtrash?..... Nga njëra anë shihet zhdukja e shpirtit të Zotit dhe nga ana tjetër drejtimi në rrugë të keqe nga shpirti i Satanit".- Ibid., b. 9; K. 7

Rezultati i mësimeve të reja u shfaq shpejt. Njerëzit preferuan mohimin e Biblës ose mënjanimin e saj. Shkollat gjendeshin në rrëmujë të plotë. Studentët braktisën studimet dhe u tërhoqën nga universiteti, duke dalë jashtë kontrollit. Të gjithë ata që hiqeshin si ekspertë në rigjallërimin dhe kontrollin e Reformës nuk bënë gjë tjetër veçse e sollën atë në cakun e rrënimit të plotë. Përkrahësit e Kishës Katolike Romake rifituan besimin e humbur dhe deklaruan triumfues: "Edhe një betejë të fundit dhe gjithçka do të jetë jona" - Ibid., b.9; K. 7

Luteri që qëndronte në Vartburg, kur dëgjoi për gjithçka që kishte ndodhur tha shumë i shqetësuar: "Kam pritur gjithmonë që Satani të na dërgonte një fatkeqësi të tillë".- Ibid., b.9; K. 7. Ai e kuptoi karakterin e vërtetë e "të ashtuquajturve" profetë dhe e vuri re rrezikun që i kanosej kauzës së të vërtetës. Situata që po përjetonte i krijoi atij një shqetësim dhe brengë më të madhe nga kundërshtimi i Papës dhe Perandorit. Të ashtuquajturit miq të Reformës ishin kthyer në armiqtë e tij më të këqinj. E vërteta që i kishte sjellë atij një gëzim dhe ngushëllim kaq të madh, po përdorej për të ndezur grindje dhe për të krijuar konfuzion në kishë.

Ndërsa punonte për Reformën, shpirti i Zotit e kishte çuar Luterin përpara dhe ai kishte kapërcyer vetveten. Nuk kishte për qëllim të zinte pozita të tilla apo të kryente ndryshime kaq radikale. Ai ishte një instrument në duart e Fuqisë së Pafundme.E përsëri ai shqetësohej nga rezultati i punës së tij. Dikur ka thënë: "Sikur ta dija që doktrina ime do të lëndonte dikë -një njeri të vetëm sado i përulur dhe i parëndësishëm të ishte ai - gjë që s'mund të ndodhë, sepse ka të bëjë me vetë Ungjillin, - unë do të preferoja të vdisja dhjetë herë se sa ta mbroja atë".- Ibid.,b.9; K.7.

Tani edhe Vitenbergu, qendra e Reformës, po dorëzohej përballë fuqisë së fanatizmit dhe akteve të paligjshme. Kjo situatë e tmerrshme nuk ishte rezultat i mësimeve të Luterit, por në të gjithë Gjermaninë armiqtë e tij e ngarkonin atë me përgjegjësi. Në kulmin e zemërimit ai ndonjëherë pyeste: "A mund të jetë i tillë fundi i punës për Reformën?". - Ibid.,b.9; K.7

E përsëri zemra e tij prehej në paqe, ndërsa ai fliste me Zotin gjatë lutjeve. "Puna nuk më përket mua, por është jotja" - thoshte ai; "Ti nuk do të lejosh që ajo të korruptohet nga supersticioni dhe fanatizmi". Qëndrimi larg nga konflikti në një fazë të tillë kritike u bë i padurueshëm. Ai vendosi të kthehej në Vitenberg.

Nisi udhëtimin e tij të rrezikshëm pa vonuar, udhëtim i cili ishte i ndaluar me ligj në perandori. Armiqtë ishin gati ta vrisnin, miqve u ndalohej ta ndihmonin ose ta strehonin. Qeveria perandorake po ndërmerrte masat më të rrepta kundër përkrahësve të tij. Por ai vuri re se puna e Ungjillit po rrezikohej dhe kështu në emër të Zotit ai u largua pa frikë që të luftonte për të vërtetën.

Në një letër drejtuar autoriteteve, pasi shpjegonte qëllimin e tij në largimin nga Vartburgu, Luteri shkruante: "Do të desha t'ia bëj të njohur shkëlqesisë suaj se po shkoj në Vitenberg nën një mbrojtje shumë më të sigurt se ajo e princëve dhe autoriteteve. Duke pasur për zemër mbrojtjen tuaj, do të parapëlqeja t'ju mbroja unë ju, sesa të kërkoja mbështetjen e shkëlqesisë suaj. Po ta dija se shkëlqesia juaj mundej ose do të më mbronte as që do të shkoja në Vitenberg. Shpata nuk mund ta çojë përpara këtë kauzë. Vetëm Zoti, pa ndihmën ose bashkëveprimin njerëzor, mund të bëjë gjithçka. Ai që ka besimin më të madh është i vetmi që mund të mbrojë". - Ibid., b.9; K.9

Në një letër të dytë, të cilën e shkroi gjatë rrugës për në Vitenberg, Luteri shtonte: "Jam gati të përballojë pakënaqësinë e Shkëlqesisë suaj dhe zemërimin e gjithë botës mbarë. A nuk janë banorët e Vitenbergut delet e mia? A nuk m'i ka besuar Zoti mua? Dhe a nuk duhet që unë t'i dal përpara vdekjes për hatrin e tyre në qoftë se kjo është e pashmangshme? E përveç kësaj ia kam frikën shpërthimit të një lufte në Gjermani me anë të së cilës Zoti do të dënojë kombin tonë". - Ibid., b.9; K. 7

Ai i hyri punës me kujdes dhe përulje, por edhe me vendosmëri dhe qëndrueshmëri. "Ne duhet" - tha ai "të përmbysim dhe të shkatërrojmë me fjalë atë që është ngritur me dhunë. Unë nuk do të përdor forcën kundër superstitioneve dhe mosbesimit..... Asnjë nuk duhet të detyrohet. Liria është esenca e besimit". - Ibid., b.9; K.8

U dëgjua shumë shpejt në Vitenberg lajmi se Luteri ishte kthyer dhe do të predikonte. U grumbulluan njerëz nga të gjitha drejtimet dhe kisha u mbush plot. Me të dalë në podium, me zgjuarësi dhe mirësi, ai udhëzoi, kështilloi dhe qortoi. Duke u folur disave, që i ishin drejtuar dhunës për të ndaluar masat, ai tha: "Grumbullimet janë diçka e keqe, Zoti është kundër tyre, është mirë të ndalohen dhe unë do të doja që në të gjithë botën mbarë ato të ishin zëvendësuar nga fjala e Ungjillit. Por askush të mos shkëputet prej tyre me forcë. Duhet ta lëmë këtë problem në duart e Zotit. Eshtë fjala e Tij që duhet të veprojë dhe jo ne. Po pse kështu? - do të pyesni ju. Sepse unë nuk i mbaj zemrat e njerëzve në duart e mia ashtu si ena që mban argjilën. Ne kemi të drejtën e fjalës, nuk kemi të drejtën e veprimit. Le të predikojmë, gjithçka tjetër i takon Zotit. A duhet të përdor forcën? Çfarë do të fitoj? Ngërdheshje, formalitet, urdhëresa njerëzore dhe hipokrizi..... Por nuk do të kishte zemër të sinqertë, as besim, as mirësi. Atje ku mungojnë këto të trija gjithçka mungon dhe unë nuk do të jepja asnjë qime floku për një rezultat të tillë..... Zoti bën vetëm me fjalën e tij shumë më tepër se sa mund të bëjmë unë, ju, e gjithë bota me fuqinë tonë të bashkuar. Zoti rrëmben zemrën dhe kur fitohet zemra fitohet gjithçka....." Unë do të predikoj, do të diskutoj dhe do të shkruaj, por nuk do të detyroj askënd, sepse besimi është një akt i vullnetshëm. Ja se çfarë kam bërë.

Nuk u përkula përballë Papës, përballë katolikëve, përballë privilegjeve, por pa dhunë dhe pa trazira. Përdora si pararojë fjalën e Zotit; unë predikova dhe shkrova - kaq bëra. E ndërsa isha duke fjetur..... fjala që predikova goditi katolicizmin roman me aq forcë sa asnjë princ ose perandor nuk e kishte dëmtuar më parë. E pra, unë nuk bëra asgjë, qe fjala ajo që bëri gjithçka. Në qoftë se do t'i bëja thirrje dhunës, e gjithë Gjermania, ndoshta do të ishte zhytur në gjak. Po rezultati cili do të ishte? Shkatërrim dhe shkretim i trupit dhe shpirtit. Prandaj qëndrova urtë dhe lashë vetëm fjalën të përhapej nëpër botë". - Ibid., b.9; K.8

Ditë për ditë gjatë një jave, Luteri vazhdoi t'i predikonte turmave të etura për dije. Fjala e Zotit theu magjinë e ngacmimeve fanatike. Fuqia e Ungjillit i ktheu përsëri në rrugën e së vërtetës të gjithë të gënjyerit.

Luteri nuk donte të ballafaqohej me fanatikët, që me veprimet e tyre kishin sjellë kaq të këqija. Ai i njihte ata si njerëz me gjykim të dobët dhe me pasione të pakontrolluara të cilët ndërsa deklaronin se ishin ndriçuar në mënyrë të veçantë nga Qielli, nuk pranonin as kontradiktën më të thjeshtë dhe madje as qortimin apo këshillën më të përzemërt. Duke u veshur me autoritetin më të lartë, ata kërkonin që të gjithë pa përjashtim të pranonin dhe të njihnin pretendimet e tyre. Por kur ata kërkuan një intervistë me të, ai pranoi t'i takonte. Kështu ai ia doli mbanë në demaskimin e pretendimeve të tyre sa që të gjithë mashtruesit u larguan menjëherë nga Vitenbergu.

Fanatizmi u kontrollua për një farë kohe, por ai shpërtheu përsëri pas disa vitesh akoma më i dhunshëm dhe me rezultate akoma më të tmerrshme. Duke folur për udhëheqësit e kësaj lëvizjeje Luteri tha: "Shkrimet e Shenjta për ta nuk ekzistonin dhe ata thërrisnin: "Shpirti! Shpirti!" Por pa dyshim unë nuk do t'i ndiqja kurrë deri atje ku i udhëhiqte ky shpirt. Më ruajtë Zoti me mëshirën e Tij nga një kishë, ku përveç të shenjtëve nuk ka tjetër. Unë dëshiroj të qëndroj midis të përulurve, mes të dobtëve dhe mes të sëmurëve, të cilët i dinë dhe i ndiejnë mëkatet e tyre dhe që, duke rënkuar i luten Zotit vazhdimisht që nga thellësia e zemrës që Ai t'u japë ngushëllimin dhe mbështetjen e Tij. - Ibid., b. 10; K. 10.

Tomas Mynzer, fanatiku më aktiv, ishte një njeri me aftësi të mrekullueshme që po të instruktohej drejt, mund të kishte bërë mirë, por ai nuk kishte mësuar parimet themelore të besimit të vërtetë. "Ai digjej nga dëshira që të ndryshonte botën dhe harroi, ashtu si harrojnë të gjithë të entuziazmuarit, që reformimin duhet ta fillonte nga vetvetja. - Ibid., b.9; K.8. Ambicia për post dhe influenca nuk e lejonte të ishte i dytë, madje as i dyti pas Luterit. Ai deklaroi se Reformistët, duke zëvendësuar me autoritetin e Shkrimeve të Shenjta, autoritetin e Papës, thjesht po vendosnin një formë të re papati. Ndërsa për veten e tij pretendonte se ishte ngarkuar nga Lart të paraqiste reformën e vërtetë. "Ai që zotëron një shpirt të tillë" - thoshte Mynzer - "zotëron besimin e vërtetë edhe pse ai nuk i ka parë ndonjëherë Shkrimet e Shenjta gjatë gjithë jetës së tij" - Ibid., b.10; K.10.

Mësuesit fanatikë hoqën dorë nga gjithçka dhe filluan të udhëhiqeshin nga mbresat, duke e konsideruar çdo mendim dhe çdo impuls si zërin e Zotit. Rrjedhimisht ata kaluan në ekstreme. Disa dogjën madje edhe Biblat, duke bërtitur: "Letra vret, por Shpirti jep jetë". Mësimet e Mynzerit i bënin thirrje dëshirës njerëzore për të mrekullueshmen e njëkohësisht përkëdhelnin krenarinë e tyre, duke vendosur faktikisht idetë dhe opinionet njerëzore mbi fjalën e Zotit. Doktrinat e tij u

pranuan nga mijëra njerëz. Ai denoncoi edhe rregullin gjatë adhurimeve publike dhe deklaroi se që t'i bindesh princërve është një përpjekje për t'i shërbyer të dyve edhe Zotit edhe Belialit.

Mendjet e njerëzve, që tashmë kishin filluar të hiqnin qafe zgjedhën e papatit, po humbisnin durimin nga kufizimet e autoritetit civil. Mësimet revolucionare të Mynzerit që mendoheshin si aprovime hyjnore, bënë që ata t'i shmangeshin kontrollit dhe të udhëhiqeshin nga pasione dhe paragjykime. Të gjitha këto ia lanë vendin skenave nga më të tmerrshmet të kryengritjeve e konflikteve dhe fushat e Gjermanisë u lanë me gjak.

Tek shikonte se si rezultatet e fanatizmit i ngarkoheshin Reformacionit, agonia shpirtërore, të cilën Luteri e kishte përjetuar shumë kohë më parë në Erfurt, tani i rëndonte me forcë të dyfishuar. Princërit, përkrahës të Papës, deklaronin - dhe shumë të tjerë ishin të gatshëm ta mbështetnin thënien e tyre se: rebelimi ishte frut i ligjshëm i doktrinave të Luterit. Edhe pse kjo akuzë ishte e pabazuar, ajo përsëri i shkaktonte një mërzitje të thellë Reformatorit. Ai nuk mund ta duronte faktin që kauza e së vërtetës të turpërohej, duke u radhitur në të njëjtin nivel me fanatizmin më të tërbuar. Nga ana tjetër, udhëheqësit e revoltës e urrenin Luterin jo vetëm se ai kishte kundërshtuar doktrinat e tyre dhe i kishte hedhur poshtë pretendimet e tyre si frymëzim hyjnor, por edhe sepse ai i kishte quajtur ata rebelë ndaj autoritetit civil. Si kundërpërgjigje ata e akuzuan Luterin për një pretendues të ulët. Dukej sikur ai kishte mbi shpatulla armiqësinë e të dyja palëve: princërve dhe njerëzve.

Përkrahësit e katolicizmit romak të ngazëllyer pritnin të shihnin me sytë e tyre rënien e shpejtë të Reformacionit; ata fajësuan Luterin edhe për gabimet që ai ishte orvatur me të gjitha forcat t'i ndreqte. Pala tjetër grumbulloi me sukses rreth vetes simpatizantë nga klasa të ndryshme të popullit, duke pretenduar se ishin trajtuar padrejtësisht dhe siç ndodh shpesh me ndjekësit e gabimeve, ata u konsideruan martirë. Kështu, ata që përdorën gjithë energjinë e tyre në kundërshtim me Reformacionin, u mëshiruan dhe u lavdëruan, duke u quajtur viktima të shtypjes dhe të mizorisë. Kjo ishte puna e Satanit, ushtruar nga i njëjti shpirt rebelimi që ishte manifestuar ne qiell.

Satani përpiqet në mënyrë të vazhdueshme t'i mashtrojë njerëzit dhe t'i çojë ata deri atje sa ta quajnë mëkatin drejtësi dhe drejtësinë mëkat. Sa e suksesshme ka qënë puna e tij! Sa shpesh qortimet dhe dënimet bien mbi shërbëtorët besnike të Zotit, sepse ata qëndrojnë të patundur në mbrojtje të së vërtetës! Ata që janë agjentë të Satanit miklohen dhe lëvdohen, madje konsiderohen edhe si martirë, ndërsa të gjithë ata që duhet të respektohen dhe të përkrahen për besnikërinë që tregojnë ndaj Zotit, braktisen nën peshën e dyshimit dhe mosbesimit. (?)

Hirësia e gënjeshtërt, shenjtërimi i rremë janë akoma duke u mashtruar. Ato shfaqin në forma të ndryshme të njëjtin shpirt si në kohën e Luterit, duke i larguar

mendjet njerëzore nga Shkrimet e Shenjta dhe duke i shtyrë ata më shumë drejt rrugës së ndjenjave dhe përshtypjeve të tyre se sa drejt bindjes ndaj Ligjit të Zotit. Ky është një nga mekanizmat më të suksesshëm të Satanit për të errësuar të vërtetën dhe për të njollosur pastërtinë.

Luteri e mbrojti pa frikë Ungjillin nga sulmet që erdhën nga të katër anët. Në çdo konflikt u provua edhe njëherë se fjala e Zotit ishte në vetvete një armë e fuqishme. Me atë fjale ai luftoi kundër autoritetit zaptues të Papës dhe kundër filozofisë racionaliste të të shkolluarve, ndërsa ai vete qëndronte i fortë si shkëmb kundër fanatizmit, që kërkonte të bashkohej në një me Reformacionin.

Secili nga këta elemente të kundërt, në mënyrën e vet, po mënjanonte Shkrimet e Shenjta dhe po lartësonte zgjuarsinë njerëzore si burim të së vërtetës dhe njohurive fetare. Racionalizmi idealizon arsyen dhe e bën këtë kriter të besimit. Romanizmi, duke pretenduar se kryeprifti (Papa) sovran është "frymëzim" i zbritur në tokë përmes linjës së pashkëputur dhe të pandryshuar të apostujve gjatë gjithë kohërave, i jep mundësinë të fshihet nën paprekshmërinë e urdhërit apostolik çdo lloj ekstravagance dhe korrupsioni. Frymëzimi i deklaruar nga Mynzeri dhe shokët e tij e kishte burimin jo më larg se trillet e imagjinatës dhe influenca e tij ishte subversive ndaj autoritetit njerëzor ose hyjnor. Kristianizmi i vërtetë e pranon fjalën e Zotit si të vetmin thesar të së vërtetës së frymëzuar dhe si provë të të gjithë këtij frymëzimi.

Gjatë kthimit të tij nga Vartburgu, Luteri përfundoi përkthimin e Dhiatëssë re (Testamentit të Ri) dhe shumë shpejt pas kësaj, populli gjerman e lexoi Ungjillin në gjuhën e vet. Ky version i përkthyer në gjermanisht u prit me gëzim të madh nga të gjithë ata që donin të vërtetën, por u mohua me përçmim nga të gjithë ata që kishin zgjedhur traditat dhe urdhëresat njerëzore.

Priftërinjtë u alarmuan nga idea se njerëzit e thjeshtë mund të ishin në gjendje të diskutonin me ta rreth parimeve që gjendeshin në fjalën e Zotit dhe patën frikë nga shfaqja e injorancës së tyre. Armët e arsyetimeve njerëzore ishin të pafuqishme përballë shpatës së Shpirtit të Shenjtë. Roma përdori të gjithë autoritetin e saj për të ndaluar përhapjen e Shkrimeve të Shenjta; por dekretet, shkishërimet dhe torturat shkuan kot. Sa më shumë që Roma dënonte dhe ndalonte Biblën aq më shumë rritej padurimi i njerëzve për të njohur mësimet e saj të vërteta. Të gjithë ata që dinin të lexonin ishin të etur ta studionin vetë fjalën e Zotit. Ata e mbanin gjithmonë me vete, e lexonin dhe e rilexonin, duke mos u kënaqur deri sa të arrinin të mësonin përmendësh pjesë të tëra prej saj. Kur pa entuziazmin me të cilin u prit Dhiata e Re, Luteri filloi menjëherë punën për përkthimin e Dhiatës së Vjetër dhe e botoi në pjesë deri sa e përfundoi.

Shkrimet e Luterit u mirëpritën si në qytet dhe në fshat. "Gjithçka që shkruhej nga Luteri dhe miqtë e tij, shpërndahej nga të tjerët. Murgj, të bindur për paligjshmërinë e detyrimeve të ushtruara në manastire, të dëshëruar për të shkëmbyer një

jetë të plogët me një jetë të mundimshme dhe aktive, por të paditur për të shpallur fjalën e Zotit, udhëtonin përmes provincave gjermane, duke vizituar fshatra të vegjël dhe kasolle ku shitnin librat e Luterit dhe miqve të tij. Shumë shpejt Gjermania zieu nga këta bashkëpunëtorë të guximshëm.- Ibid., b.9; K.11.

Këto shkrime studioheshin me interes të madh nga të pasurit dhe nga të varfërit, nga të diturit dhe nga të padiburit. Natën, mësuesit e shkollave të fshatrave ia lexonin me zë të lartë këto shkrime grupeve të mbledhura pranë vatrave. Disa shpirtra të bindur nga e vërteta, duke e pranuar këtë fjalë me gëzim, ia tregonin lajmin e mirë edhe të tjerëve.

Fjalët e Frymëzimit u provuan të vërteta: "Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë". Psalmi:119; 130. Studimi i Shkrimeve të Shenjta kishte sjellë një ndryshim të madh në mendjet dhe zemrat e njerëzve. Sundimi i Papës kishte vendosur mbi ta një zgjedhë të hekurt, që i ndrydhte nën injorancë dhe degradim. Zbatimi supersticioz i formave ishte ruajtur me përpikmëri, por gjatë këtyre riteve nuk kishte pasur kurrë vend për zemrën dhe intelektin njerëzor. Predikimet e Luterit, duke nxjerrë në pah të vërtetat e pamohueshme të Fjalës së Zotit, e më pas, vetë kjo fjalë në duart e njerëzve të thjeshtë, kishin zgjuar fuqitë e tyre të fjetura, jo vetëm duke pastruar e fisnikëruar natyrën shpirtërore, por edhe duke e ushqyer intelektin me energji dhe fuqi të reja.

Kudo shiheshin njerëz të të gjitha klasave me Bibla në duar, duke mbrojtur doktrinat e Reformacionit. Përkrahësit e papatit që ia kishin lënë në dorë priftërinjve dhe murgjëve studimin e Shkrimeve të Shenjta, tani kërkonin që ata të paraprinin duke përgënjeshtruar mësimet e reja. Por padija si ndaj Shkrimeve të Shenjta, ashtu edhe ndaj fuqisë së Zotit, bëri që priftërinjte dhe murgjit të mundeshin tërësisht prej atyre, që dikur i kishin quajtur të paditur dhe heretikë.

" Fatkeqësisht - thotë një shkrimtar katolik - Luteri i kishte bindur ndjekësit e tij që të mos besonin asnjë profeci tjetër përveç Shkrimeve të Shenjta". - D'Aubigne, b.9, K.11.

Turma njerëzish grumbulloheshin për të dëgjuar të vërtetën, të shpallur nga njerëz pa shkollë e madje për të dëgjuar debatet e tyre me teologë të ditur e të gojës. Injoranca e këtyre njerëzve të mëdhenj shfaqej turpshëm sa herë që argumentet e tyre rrëzoheshin lehtë nga mësimet e thjeshta të fjalës së Zotit. Punëtorët, ushtarët, gratë madje dhe fëmijët i njhnin më mirë mësimet e Biblës se sa priftërinjtë dhe doktorët e shkolluar.

Kontrasti mes nxënësve të Ungjillit dhe përkrahësve të supersticionit të Papës manifestohej qartë si në klasat e intelektualëve ashtu edhe mes njerëzve të thjeshtë. Në kundërshtim me kampionët e vjetër të hierarkisë që patën mohuar studimin e gjuhëve të huaja dhe kultivimin e letërsisë..... ishin të rinjtë, të hapur ndaj ndryshimeve, të devotshëm për të studiuar, që rrëmonin mes Shkrimeve të Shenjta dhe që

e njihnin deri në hollësi kryeveprën e lashtësisë. Duke zotëruar një mendje aktive, një shpirt dijedashës dhe një zemër të patrembur, këta të rinj shumë shpejt fituan një njohuri të tillë që askush s'mund ta konkuronte..... Prandaj sa herë që këta të rinj, mbrojtës të Reformacionit, debatonin me doktorët e Romës në asamble, ata i sulmonin këta të fundit me një lehtësi dhe besim të tillë, saqë ata injorantë hezitonin, ziheshin ngushtë dhe meritonin përbuzjen e gjithë njerëzve të tjerë. - Ibid., b.9; K.11.

Kur klerikët romakë vunë re se kongregacionet e tyre po pakësoheshin, ata kërkuan ndihmën e menjëhershme të magjistratëve dhe përdorën gjithçka që kishin në dorë për t'i kthyer përsëri dëgjuesit. Por në mësimet e reja njerëzit kishin gjetur pikërisht atë që plotësonte nevojat e shpirtit të tyre dhe i kishin kthyer kurrizin atyre që i kishin ushqyer për një kohë kaq të gjatë me lëvozhgat boshe të riteve supersticioze dhe traditave njerëzore.

Kur persekutimi drejtohej kundër mësuesve të së vërtetës, ata i kushtonin vëmendje fjalëve të Krishtit: "kur t'iu përndjekin në njërin qytet, ikni në tjetrin!" Mateu 10:23. Drita depërtoi kudo. Të ikurit gjetën gjithkund një derë të hapur e mikpritëse dhe atje ku jetonin ata predikonin për Jezu Krishtin, ndonjëherë në kishë ose në qoftë se iu mohohej ky privilegj, në shtëpi private ose në natyrë. Për ta ishte një tempull i shenjtë çdo vend, ku një grumbull njerëzish dëgjonte lajmin e mirë. E vërteta, e shpallur me kaq siguri dhe me një energji të tillë, përhapej me një forcë të fuqishme.

Më kot autoritetet klerikale dhe civile u përpoqën ta shuanin këtë herezi. Më kot ata përdorën burgimin, torturat, zjarrin dhe shpatën. Mijëra besimtarë e vulosën me gjak besimin e tyre dhe puna vazhdoi. Persekutimi shërbeu thjesht për shpërndarjen e së vërtetës dhe fanatizmi, që Satani u përpoq ta njësonte me këtë të vërtetë, qartësoi akoma më shumë kontrastin mes punës së Satanit dhe punës së Zotit.

1. Cili ishte përshkrimi i Luterit për një kishë të shëndetshme?

2. Përshkruani qasjen jo të dhunshme të Luterit përgjatë ngajrjeve të nxehta të Reformimit.

3. Kur Perëndia fillon një punë të mirë në kishën tuaj, si mund të kundërpërgjigjet Satani nëpërmjet fanatizmit?

4. Psalmi 119:130 thotë: "Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë." Si na ndihmon ky varg të kuptojmë punën e Frymës së Shenjtë në studimin personal të Fjalës së Perëndisë?

11.

Protestat e Princave

Një nga dëshmitë më fisnike të Reformacionit ishte Protesta e princërve të krishterë gjermanë, që u manifestua në Dekretin e Spirës dhe që njihet në histori si Dita e Madhe e Reformacionit (Diet of Spires) të 1529. Guximi, besimi dhe qëndrueshmëria e këtyre njerëzve të Zotit solli si rezultat lirinë e mendimit dhe ndërgjegjes për shekuj me radhë. Protesta e tyre i dha emrin "Protestante" kishës së reformuar. Parimet e saj përbëjnë "Esencën e Protestanizmit".- D'Aubigne, b.13; k.6.

Reformacioni ballafaqohej me ditë të errta dhe kërcënuese. Duke mos iu përmbajtur Dekretit të Wormit që ndalonte mësimin ose besimin e doktrinave të tij dhe që e konsideronte vetë Luterin si të jashtëligjshëm, liria e besimit triumfoi në të gjithë perandorinë. Kujdesi i Zotit kishte mbajtur nën kontroll të gjitha forcat, që kundërshtonin të vërtetën. Mbreti Karli III kishte vendosur ta shkatërronte Reformacionin, por sa herë që ngrinte grushtin për të goditur detyrohej të ndryshonte drejtimin e goditjes. Sa herë që shkatërrimi i menjëhershëm i atyre që kishin guxuar të kundërshtonin Romën dukej i pashmangshëm, në momentin kritik, ushtritë turke shfaqeshin papandehur në kufirin lindor, ose mbreti i Francës apo Papa vetë, xheloz ndaj madhështisë në rritje të perandorit, i shpallnin luftë atij; pra mes konflikteve dhe trazirave të kombeve, Reformacioni forcohej dhe zgjerohej më tej. Më së fundi, monarkët - përkrahës të papatit i zunë frymën feudeve të tyre, që të gjithë këta të bashkoheshin në kauzën kundër Reformatorëve. Dekreti i Spirës në 1526 i kishte dhënë çdo shteti liri të plotë besimi deri në mbledhjen e një këshilli të përgjithshëm, por sapo kishte kaluar rreziku, të cilin e mënjanonte ky lëshim, perandori formuloi një Dekret të dytë të Spirës në 1529, me qëllim që të shkatërronte herezinë. Princërit duhet të nxiteshin, në qoftë se ishte e mundur me mjete paqësore, kundër Reformacionit, por në qoftë se këto përpjekje do të dështonin Mbreti Karl ishte përgatitur për të përdorur shpatën.

Përkrahësit e Papës u ngazëllyen. Ata u shfaqën në Spirë me qindra dhe manifestuan hapur urrejtjen e tyre kundër Reformatorëve dhe kundër atyre që i favorizonin. Melanktoni tha: "Neveritja dhe mallkimi i botës është përqëndruar mbi ne, por Jezu Krishti do të kujdeset për njerëzit e tij të shkretë dhe do t'i shpëtojë ata". - Ibid., b.13; K.5. Princërve evangjelistë iu ndalua në pritje të Dekretit të predikonin Ungjillin, madje edhe në banesat e tyre. Por njerëzit e Spirës ishin të etur për të dëgjuar fjalën e Zotit dhe me mijëra grumbulloheshin në kishën e të zgjedhurit të Saksonisë, për të marrë pjesë në shërbesat që mbaheshin atje, pa pyetur për këtë ndalim.

Kjo e përshpejtoi krizën. Një mesazh perandorak i bënte të ditur Kuvendit se meqënëse vendimi që pranonte lirinë e ndërgjegjes kishte krijuar çrregullime perandori kërkonte anullimin e tij. Ky akt arbitrar ngjalli indinjatë dhe shqetësim mes të krishterëve evangjelistë. Njëri prej tyre tha: "Jezu Krishti ka rënë përsëri në duart e Kajfës dhe të Pilatit". Katolikët romakë u bënë më të ashpër. Një përkrahës i zellshëm i papatit deklaroi:

"Turqit janë më të mirë se Luterianët, sepse turqit e mbajnë kreshmën, ndërsa luterianët e thyejnë atë. Në qoftë se duhet të zgjidhnim mes Shkrimit të Shenjtë të Zotit dhe gabimeve të vjetra të kishës, ne do ta mohonim të parën (Shkrimin e Shenjtë). Melanktoni tha: "Çdo ditë, si një trup i vetëm, Faberi me të tjerët hedhin gurë mbi ne dëshmitarët e lajmit të mirë". -Ibid., b.13; K. 5.

Liria e besimit ishte vendosur me ligj dhe shtetet kristiane vendosën të kundërshtojnë shkeljen e të drejtave të tyre. Luteri, që ishte akoma i dënuar nga dekreti i Wormit nuk lejohej që të merrte pjesë në kuvend, por bashkëpunëtorët e tij dhe princërit, që Zoti i kishte ngritur në këmbë në mbrojtje të kauzës së Tij, në këtë rast urgjence, kishin zënë vendin e Luterit. Fisniku Frederik i Saksonisë ish mbrojtës i Luterit kishte vdekur, por Duka John, vëllai dhe pasardhësi i tij e mirëpriti Reformacionin me gëzim dhe tregoi guxim dhe energji të madhe në zgjidhjen e të gjitha problemeve, që lidheshin me interesat e besimit, duke qënë në të njëjtën kohë paqedashës.

Priftërinjtë kërkuan që të gjitha shtetet, që kishin pranuar Reformacionin t'i nënshtroheshin pa fjalë juridiksionit romak. Nga ana tjetër reformatorët shpallën lirinë që kishin fituar më parë. Ata nuk mund të lejonin që Roma të fitonte përsëri kontrollin mbi ato shtete që e kishin pranuar me aq gëzim fjalën e Zotit.

Së fundi u propozua një kompromis, sipas të cilit në të gjitha ato vende ku Reformacioni nuk ishte vendosur ende, Dekreti i Wormsit do të imponohej me rigorozitet dhe që ..." në të gjitha ato vende, ku njerëzit kishin devijuar prej tij dhe nuk mund të pajtoheshin me të pa rrezikun e një revolte ata të paktën nuk duhet të zhvillonin një reformë të re, nuk duhet të diskutonin mbi çështje të kundërta, nuk duhet të kundërshtonin festimet popullore dhe nuk duhet të lejonin që asnjë katolik romak të përqafonte Protestanizmin. - Ibid., b.13; k.5. Për kënaqësinë e priftërinjve dhe prelatëve të papatit një masë e tillë u miratua nga Kuvendi.

Në qoftë se një dekret i tillë do të zbatohej, "Reformacioni as mund të zgjerohej..... drejt vendeve që nuk e njihnin atë dhe as mund të vendosej mbi themele të shëndosha..... në vendet ku ekzistonte tashmë". -Ibid.,b.13;K.5. Nuk do të kishte liri fjale. Nuk do të lejoheshin diskutimet. Dhe nga miqtë e Reformacionit kërkohej që t'i nënshtroheshin këtyre kufizimeve dhe ndalimeve menjëherë. Dukej sikur shpresat e botës mbarë po shuheshin.

"Rivendosja e hierarkisë romake... pa dyshim do të rikthente gjithë abuzimet e hershme"; dhe do të gjendej me dëshirë një shkak "për të përfunduar shkatërrimin e një pune, që ishte tronditur thellësisht"...nga fanatizmi dhe mosmarrëveshjet. -Ibid.,b.13;K.5.

Ndërsa reformatorët takoheshin për konsultime ata shihnin të hutuar njeri - tjetrin në ankth. Pyetja kalonte nga njëri tek tjetri: "Ç'duhet bërë" Probleme me rëndësi jetike për botën po rrezikoheshin." Do të nënshtrohen udhëheqësit e Reformacionit dhe do ta pranojnë dekretin? Sa lehtë mund të gabonin Reformatorët nën ndikimin e një krizë të tillë, që ishte me të vërtetë e fuqishme. Sa shumë pretekse bindëse dhe arsye të vërteta mund të ishin gjetur për nënshtrim. Princat, përkrahës të Luterit, kishin garantuar ushtrimin e lirë të besimit. Të njëjtën lehtësi kishin të gjithë të tjerët, që kishin përqafuar idetë e rinovuara përpara miratimit të një mase të tillë. A nuk duhet t'i kënaqte kjo? Sa rreziqe do të shmangte nënshtrimi! Në çfarë rreziqesh dhe konfliktesh të panjohura do t'i zhyste kundërshtimi! Kush e dinte se çfarë mundësish do t'u ofronte e ardhmja? Le të përqafojmë paqen, le të rrokim degën e ullirit që po na zgjat Roma dhe le të mbyllim plagët e Gjermanisë. Reformatorët mund ta kishin justifikuar, me argumente të tilla, ndërmarrjen e një rruge, e cila në një kohë të shkurtër, do të rezultonte me zhdukjen e kauzës së tyre.

"Fatmirësisht ata vunë re parimin mbi të cilin ishte bazuar kjo marrëveshje dhe vepruan në besim. Cili ishte ky parim? Ishte e drejta e Romës për të kufizuar ndërgjegjen dhe për të ndaluar besimin e lirë. Po a nuk ishin ata vetë dhe ndjekësit e tyre protestantë që kënaqeshin me lirinë fetare? Po, si favor i kushtëzuar në një marrëveshje, por jo si e drejtë e ligjshme. Parimi i autoritetit udhëhiqte gjithçka tjetër jashtë kësaj marrëveshjeje; për ndërgjegjen s'kishte vend. Roma ishte gjykatësi i pagabueshëm dhe të gjithë duhej t'i bindeshin asaj. Pranimi i propozimit për një marrëveshje të tillë do të konfirmonte idenë se liria e besimit duhej të kufizohej brenda Saksonisë së reformuar, ndërsa për sa i përket të krishterëve dhe shteteve kristiane - hetimi i lirë dhe shfaqja e besimit të reformuar konsideroheshin krime dhe duhet të kontrolloheshin me përdorimin e hurit dhe birucave. A mund ta miratonin ata lokalizimin e lirisë së besimit? A mund të shpallnin botërisht se Reformacioni kishte arritur tek shndërrimi i fundit, kishte zaptuar të fundit zonë veprimi? A mund të pranonin se të gjitha vendet që duronin sundimin e Romës për momentin ishin të destinuara ta duronin dominimin e saj përjetësisht? A mund të

kërkonin Reformatorët pafajësinë për gjakun e atyre qindrave, mijërave njerëzve, që në zbatim të kësaj marrëveshjeje, duhet të vdisnin në vendet e sunduara nga papati? Kjo do të thoshte "tradhti ndaj kauzës së Ungjillit dhe lirive të të krishterëve dhe shteteve kristiane në këtë orë kritike".- ....b.9;K15. Ata preferuan të flijonin gjithçka kishin, shtetet, kurorat dhe jetët e tyre - D' Aubigne, b.13;K.5.

"Të mos e pranojmë këtë vendim, thanë princat. - Shumica nuk ka fuqi kur është fjala për ndërgjegjen". Deputetët deklaruan: "Vendimi i 1526-ës është burimi i vetëm i paqes që gëzon perandoria, anullimi i tij do të sjellë shumë shqetësime dhe ndarje në Gjermani. (Diet) duhet të ruajë këtë liri besimi deri në mbledhjen e këshillit".- Ibid.,b.13;K.5. Mbrojtja e lirisë së ndërgjegjes është detyrë e shtetit dhe ky është kufiri i autoritetit të tij përsa i përket problemeve të fesë. Çdo qeveri, që përpiqet të rregullojë ose të detyrojë respektimin e normave të caktuara fetare, duke përdorur autoritetin e saj civil, flijon vetë parimin për të cilin Kristianët evangjeliste luftuan fisnikërisht.

Përkrahësit e Papës vendosën të zbatonin të ashtuquajturën "kokëfortësi e marrë". Ata filluan përpjekjet për të përçarë përkrahësit e Reformacionit dhe për të frikësuar të gjithë ata që nuk ishin deklaruar hapur në favor të tij. Përfaqësuesit e qyteteve të lira u grumbulluan përpara (Diet) dhe kërkuan të deklarohej nëse ata do t'i pranonin kushtet e këtij propozimi. Ata u lutën për më shumë kohë, por më kot. Kur u vunë në provë, pothuajse edhe një herë gjysma e numrit të tyre mbajtën anën e Reformatorëve. Të gjithë ata që refuzuan të flijonin lirinë e ndërgjegjes dhe të drejtën e gjykimit individual, e dinin mirë se një pozitë e tillë do t'i sillte kritika, dënime dhe persekutime në të ardhmen. Një nga delegatët tha: "Ne ose duhet të mohojmë fjalën e Zotit ose të digjemi". - Ibid.,b.13; K.5.

Mbreti Ferdinand, përfaqësuesi i perandorit në (Diet), vuri re se një vendim i tillë do të shkaktonte përçarje serioze, në qoftë se princat nuk do të detyroheshin ta pranonin dhe ta mbështetnin atë. Prandaj ai u përpoq të përdorte bindjen, duke e ditur fare mirë se përdorimi i forcës do t'i bënte akoma më të vendosur ata njerëz. Ai iu lut princërve që ta pranonin vendimin, duke i siguruar se një akt i tillë do ta kënaqte se tepërmi perandorin". Por këta burra besnikë njihnin një autoritet më të lartë se ai i sundimtarëve tokësorë dhe iu përgjigjën qetësisht: "Ne do t'i bindemi perandorit për gjithçka që do të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe në nderimin e Zotit".- Ibid., b.13; K.5.

Në prani të (Diet) mbreti së fundi deklaroi përpara të zgjedhurve dhe miqve të tij se dekreti "do të përpilohej në formën e një vendimi perandorak", dhe se "e vetmja rrugë për ta ishte t'i nënshtoheshin shumicës". Me të mbaruar së foluri, ai u largua nga asambleja, duke mos i dhënë mundësi Reformatorëve për ta shqyrtuar problemin apo për t'u përgjigjur." Më kot dërguan një delegacion për t'iu lutur mbretit që të kthehej". Protestave të tyre ai iu përgjigj: "kjo punë ka mbaruar; vetëm nënshtrimi ka mbetur".- Ibid., b.13;k.5.

Pala perandorake ishte e bindur se princat kristiane do të mbështetnin idenë se Shkrimet e Shenjta ishin shumë më superiore se doktrinat dhe kërkesat njerëzore dhe ata e dinin se pranimi i këtij parimi do të sillte rrënimin e papatit. Por si mijëra të tjerë përpara tyre, duke vënë re vetëm "gjërat e dukshme", ata u gënjyen nga idea se kauza e perandorit dhe Papës ishte e fuqishme, ndërsa ajo e Reformatorëve e dobët. Reformatorët po të ishin mbështetur vetëm tek ndihma njerëzore, do të ishin me të vërtetë aq të pafuqishëm sa mendonin edhe përkrahësit e Papës. Ata ishin të fuqishëm edhe pse të pakët në numër dhe në grindje me Romën. Ata u drejtuan "nga raporti i (Diet) tek fjala e Zotit, nga perandori Karl tek Jezu Krishti - Mbret i mbretërve dhe Zot mbi Zotët".- Ibid.,b.13;k.6.

Ashtu si Ferdinandi që kishte refuzuar të merrte parasysh bindjet e tyre, ashtu edhe princat vendosën të mos i kushtonin vëmendje mungesës së tij, por ta paraqisnin protestën e tyre përpara Këshillit Kombëtar pa vonesë. Një deklaratë solemne u përpilua dhe u paraqit përpara (Diet).

"Ne protestojmë me anë të këtij dokumenti, përpara Zotit, i cili është i vetmi Krijues, Mbrojtës, Çlirues dhe Shpëtimtar dhe që një ditë do të bëhet Gjykatësi ynë, ashtu si përpara të gjithë njerëzve dhe gjithë krijesave, në emrin tonë dhe në emër të përkrahësve tanë, duke deklaruar se nuk miratojmë dhe nuk jemi dakort me asnjë pikë të vendimit të propozuar, ashtu si nuk pranojmë asgjë që është në kundërshtim me Zotin, me fjalën e Tij të shenjtë, me ndërgjegjen tonë dhe me shpëtimin e shpirtrave tanë". Ne miratojmë zyrtarisht këtë dekret:

1. "Ne shpallim se edhe kur Zoti i Plotëfuqishëm thërret dikë për t'i zbuluar pjesë nga dija e Tij, përsëri ky njeri nuk mund të ketë gjithë njohurinë e Zotit!" Nuk ka asnjë doktrinë të vërtetë, përveç atyre që janë në përputhje me fjalën e Zotit.....Zoti ndalon mësimin e ndonjë doktrine tjetër..... Shkrimet e Shenjta duhet të shpjegohen nga tekste të tjera nga këto shkrime që janë më të qarta.....ky Libër i Shenjtë, i thjeshtë për t'u kuptuar dhe i mjaftueshëm për të shpërndarë errësirën, është më se i nevojshëm për të Krishterët për gjithçka. Ne jemi të vendosur, me hirin e Zotit, t'i ruajmë të pastra dhe të vetme mësimet e kësaj fjale, ashtu siç janë përfshirë në librat biblikë të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re, pa u shtuar asgjë më tepër, që mund të jenë të kundërta me to. Kjo fjalë është e vërteta e vetme; është rregulli i sigurt i të gjitha doktrinave dhe e jetës dhe nuk mund të dështojë ose të na mashtrojë. Ai që ndërton mbi këtë themel do t'u qëndrojë të gjitha fuqive të ferrit, ndërsa të gjitha kotësitë njerëzore që do të përpiqen ta kundërshtojnë atë do të zhvleftësohen përpara syve të Zotit".

"Për këtë arsye ne e flakim tej dhunën që na imponohet". "Në të njëjtën kohë ne presim që Madhëria e tij perandorake të sillet kundrejt nesh si një princ kristian, i cili e do Zotin mbi gjithçka tjetër, dhe ne deklarojmë se jemi të gatshëm të shfaqim dashuri dhe bindje kundrejt atij dhe kundrejt jush, lord fisnik, si detyra jonë legjitime". - Ibid.,b.13;k.6.

(Diet) u impresionua thellësisht. Pjesa më e madhe u çuditën dhe u alarmuan nga qëndrueshmëria e protestantëve. E ardhmja shfaqej para tyre e stuhishme dhe e pasigurt. Mosmarrëveshjet, konfliktet dhe gjakderdhja dukeshin të pashmangshme. Por Reformatorët, të sigurt për drejtësinë e kauzës së tyre, duke u mbështetur mbi krahun e të Gjithëpushtetshmit ishin të mbushur me guxim dhe qëndrueshmëri.

"Parimet e paraqitura në këtë Protestë...përbejnë vetë bazën esenciale të Protestanizmit. Pra, kjo Protestë kundërshton dy lloj abuzimesh njerëzore në çështje fetare: i pari është imponimi i gjykatësve civile dhe i dyti autoriteti arbitrar i kishës. Në vend të këtyre abuzimeve, Protestanizmi nxjerr në pah fuqinë e ndërgjegjes mbi gjykatësin dhe autoritetin e fjalës së Zotit mbi kishën tokësore. Para së gjithash ai mohon fuqinë njerëzore mbi çështjet hyjnore dhe përsërit thënien e profetëve dhe apostujve: "Ne duhet t'i bindemi Zotit e jo njerëzve". Përballë kurorës njerëzore të Karlit V ai ngre lart kurorën mbretërore të Jezu Krishtit. Por ai shkon edhe më tej: parashtron parimin se të gjitha mësimet njerëzore duhet t'i nënshtrohen profecive të Zotit". - Ibid., b.13;k.6.

Protestanët e kishin afirmuar disa herë të drejtën e tyre për t'i shprehur haptazi bindjet e tyre mbi të vërtetën. Ata jo vetëm do t'i lexonin e do t'i bindeshin, por edhe do t'u mësonin të tjerëve atë që përfaqësonte fjala e Zotit, duke u mohuar të drejtën priftërinjve dhe magjistratëve për të ndërhyrë. Protesta e Spirës ishte një dëshmi solemne kundër robërise fetare dhe doli në mbrojtje të së drejtës së njerëzve për ta adhuruar Zotin sipas bindjes së ndërgjegjeve të tyre.

Deklarata u bë. U shkrua në kujtesën e mijërave dhe u regjistrua në librat e qiellit, ku asnjë përpjekje njerëzore nuk mund ta fshinte më. E gjithë Gjermania e pranoi Protestën si shprehje të besimit të saj. Kudo njerëzit vunë re në këtë deklaratë premtimin për një epokë të re e më të mirë. Një nga princat, duke iu drejtuar Protestantëve tha: "Ju mbroftë i Plotëfuqishmi, që ju ka dhënë mirësi për të rrëfyer energjikisht, hapur dhe pa frikë, në qëndrueshmëri kristiane deri kur të vijë ditë e përjetësisë". Ibid.,b.13;k.6. Sikur pas arritjes së një farë suksesi, Reformacioni të kishte fituar kohë për të siguruar simpatinë e botës, ai s'do të ishte besnik as ndaj Zotit, as ndaj vetvetes dhe do të kishte sjellë shkatërrimin e tij të plotë. Përvoja e këtyre Reformatorëve fisnikë është një mësim për të gjithë brezat e mëvonshëm. Mënyra e punës së Satanit kundër vetë Zotit dhe fjalës së Tij nuk ka ndryshuar; ai është po aq kundër Shkrimit të Shenjtë si udhëzues në jetë sa ka qënë edhe në shekullin e 16 - të. Në kohën tonë vihet re një shkëputje e ndjeshme nga doktrinat dhe udhëzimet e tyre dhe ndjehet nevoja e rikthimit tek parimi i Protestantëve - tek Bibla dhe vetëm tek Bibla si rregulli i besimit dhe detyrës. Satani akoma punon me të gjitha mjetet që ka nën kontroll për të zhdukur lirinë e besimit. Ajo fuqi antikristiane, që u mohua nga protestanët e Spirës, po përpiqet me energji të reja të rivendosë epërsinë e humbur. Besnikëria e patundur drejt fjalës së Zotit, që u manifestua gjatë krizës së Reformacionit, është sot e vetmja shpresë reforme.

U shfaqën shenja rreziku për Protestantët; por kishte gjithashtu shenja, që tregonin se dora hyjnore ishte shtrirë në mbrojtje të besnikëve. Pikërisht gjatë kësaj kohe Melanktoni drejtonte me nxitim mes rrugëve të Spirës drejt Rinit shokun e tij Simon Grynaos, duke e shtyrë atë të kapërxente lumin. Ky i fundit, Simoni u çudit nga ky nxitim i madh. "Një burrë plak plot hirësi e solemnitet, i panjohur për mua - tha Melanktoni - m'u shfaq para syve dhe më tha: "Pas pak Ferdinandi do të dërgojë nëpunësit e drejtësisë për të arrestuar Grynaosin".

Atë ditë, Grynaosi ishte skandalizuar nga një shërbesë e mbajtur nga Faberi, një doktor i papatit dhe në mbyllje kishte protestuar kundër mbrojtjes së "disa gabimeve të urryera". Faberi fshehu inatin e tij për t'ia zbrazur mbretit, nga i cili mori urdhërin e arrestit për profesorin këmbëngulës të Haidelbergut. Melanktoni nuk kishte as më të voglin dyshim se Zoti e kishte shpëtuar shokun e tij, duke dërguar një nga engjëjt e Tij të shenjtë për ta paralajmëruar atë.

"Pa lëvizur, ai priti në brigjet e Rinit, derisa ujërat e lumit e ndanë Grynaosin nga persekutuesit e tij." Më së fundi - thirri Melanktoni, kur e pa atë në bregun tjetër - më së fundi ai u shkëput nga kthetrat mizore të të gjithë atyre që kanë etje për gjak të pafajshëm. Kur u kthye në shtëpinë e tij, Melanktonin e informuan se ushtarët që po kërkonin Grynaosin e kishin kontrolluar atë fill e për pe. - Ibid., b.13;k.6.

Reformacioni duhej të nxirrej në pah përballë personave të pushtetshëm në tokë. Mbreti Ferdinand nuk i kishte dëgjuar princat evangjelistë, por atyre iu dha mundësia e prezantimit të kauzës së tyre në prani të perandorit dhe të funksionarëve të lartë shtetërore e kishëtare. Karli V një vit pas Protestës së Spirës, në mënyrë që të qetësonte konfliktet që shqetësonin perandorinë, thirri një (Diet) në Augsburg, të cilin pati si qëllim ta drejtonte vetë. Udhëheqësit protestantë u thirrën në mbledhje.

Rreziqe të mëdha kërcënonin Reformacionin, por përkrahësit e tij ia besuan kauzën e tyre Zotit dhe u zotuan të kapen fort pas Ungjillit. Anëtarët e këshillit u përpoqën që i zgjedhuri i Saksonisë të mos merrte pjesë në (Diet). Thuhej se perandori kërkoi pjesëmarrjen e princave, në mënyrë që t'u ngrinte atyre një kurth. "A nuk do të thotë të rrezikosh gjithçka po të shkosh e të bllokohesh brenda mureve të një qyteti bashkë me një armik të fuqishëm?" Por të tjerët deklaronin fisnikërisht: "Të veprojnë princat me guxim dhe kauza e Zotit do të shpëtojë". "Zoti është besnik, Ai nuk do të na braktisë" - tha Luteri. - Ibid., b.14; k.2.

I zgjedhuri filloi udhëtimin drejt Augsburgut, i shoqëruar nga suita e tij. Të gjithë e dinin rrezikun që e kërcënonte dhe shumë prej tyre shkonin përpara me çehre të prishur e me zemër të shqetësuar. Por Luteri që i shoqëroi deri në Koburg rigjallëroi besimin e tyre, duke kënduar himnin, që u shkrua gjatë atij udhëtimi "Zoti ynë është një kullë e fortë". Shumë parandjenja të këqija u zhdukën, shumë zemra të shqetësuara u lehtësuan nga tingujt e melodisë frymëzuese.

Princat reformatorë kishin vendosur t'i paraqisnin pikëpamjet e tyre në një formë sistematike, me dëshmi nga Shkrimet e Shenjta, përpara (Diet) dhe detyra e përgatitjes së saj u ishte besuar Luterit, Melanktonit dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ky rrëfim u pranua nga Protestantët si parashtrim i besimit të tyre dhe ata u mblodhën që t'i bashkangjisnin emrat e tyre këtij dokumenti të rëndësishëm. Ishte kohë solemne, kohë prove. Reformatorët ishin të kujdesshëm që kauza e tyre të qëndronte jashtë problemeve politike. Ata mendonin se Reformacioni nuk duhet të ushtronte ndikim tjetër, përveç atij që vjen nga fjala e Zotit.

Ndërsa princat kristianë u bënë gati të nënshkruanin Rrëfimin, Melanktoni ndërhyri duke thënë: "Propozimi i gjërave të tilla i përket teologëve dhe misionarëve; le ta ruajmë autoritetin e autoriteteve tokësore për çështje të tjera". "Zoti nuk u lejon - u përgjigj Gjoni i Saksonisë -të më përjashtoni. Unë jam i detyruar të bëj atë që është më e drejtë, pa u shqetësuar aspak për kurorën time mbretërore. Dëshiroj ta pranoj Zotin botërisht. Rroba dhe kapelja ime nuk janë më të çmuara për mua se kryqi i Jezu Krishtit". Pasi foli ai shkroi në letër emrin e tij. Ndërsa një princ tjetër mori penën, ai tha: "jam gati të heq dorë nga gjithçka kam dhe nga jeta ime, nëse nderi i Zotit tim, Jezu Krishtit kërkon një gjë të tillë. Do të preferoja t'i mohoja shtetet e mia dhe elektoratin tim, të braktisja gjithçka të të parëve të mi, sesa të pranoja ndonjë doktrinë tjetër që nuk përfshihet në këtë Rrëfim". - Ibid., b.14;k.6. Të tillë ishin besimi dhe guximi i këtyre njerëzve të Zotit.

Koha e caktuar për t'u paraqitur përpara perandorit erdhi. Karli V i ulur në fron dhe i rrethuar nga të zgjedhurit dhe princat dëgjoi Reformatorët Protestantë. U lexua rrëfimi i besimit të tyre. Në atë asamble perandorake u paraqitën të vërtetat e Ungjillit dhe u vunë në dukje gabimet e kishës së Papës. Me të drejtë ajo ditë u quajt "Dita më e madhe dhe më e rëndësishme e Reformacionit dhe një nga ditët më të lavdishme në historinë e Kristianizmit dhe të mbarë njerëzimit". - Ibid., b.14;k.7.

Vetëm pak vite kishin kaluar që kur murgu i Vitenbergut qëndronte i vetëm në Worms përpara këshillit kombëtar. Tani në vend të tij qëndronin princat më të fuqishëm dhe më fisnikë të perandorisë. Luterit nuk i lejohej pjesëmarrja në Augsburg, por ai ishte i pranishëm me fjalët dhe lutjet e tij. "Jam më se i lumtur - shkruante Luteri - që ia arrita kësaj dite, në të cilën Krishti

1. Rrobë: me push, e purpurt - përdorej nga personat e zgjedhur gjatë shek.XVI.
2. Kapele konike - shenjë e të zgjedhurve.

është lartësuar publikisht nga rrëfyes të tillë të shquar, përballë një asambleje kaq dinjitoze". - Ibid.,b.14;k.7. Kështu u përmbush ajo që shkruhej në Shkrimet e Shenjta: "Përballë mbretërve do të flas.....për ligjet e Tua". Psalmi 119:46.

Në kohën e Palit, Ungjilli për të cilin ai u burgos, u lexua përpara princërve dhe fisnikëve të qytetit perandorak. Në të tilla raste ajo që ishte ndaluar per t'u predikuar nga podiumi, deklarohej nga pallati mbretëror dhe ajo që konsiderohej

si e papërshtatshme edhe për shërbëtorët, dëgjohej me habi nga pronarët dhe lordët e perandorisë. Mbretër dhe njerëz të mëdhenj përbënin auditorin, princa kurore ishin predikuesit dhe e vërteta mbretërore e Zotit përbënte shërbesën. Që nga koha apostolike - thotë një shkrimtar - nuk është kryer kurrë një punë kaq e madhe ose një rrëfim kaq i mrekullueshëm. - D'Aubigne, b.17;k.7.

Gjithçka që thonë Luteranët është e vërtetë, ne s'mund ta mohojmë atë -deklaronte një bishop i papatit. A mund ta refuzoni me arsye të shëndosha Rrëfimin e të zgjedhurit dhe aleatëve të tij? - pyeti një tjetër anëtar i grupit të Doktor Eckut. "Jo" - ishte përgjigjja, sipas shkrimeve të apostujve dhe profetëve. "Po" - sipas atyre të Etërve dhe të këshillit. "E kuptova" - u përgjigj ai që pyeti. "Luteranët, sipas jush, u përmbahen Shkrimeve të Shenjta, kurse ne jemi jashtë tyre". - Ibid., b.14;k.8.

Disa nga princat gjermanë e përkrahën më vonë besimin e reformuar. Vetë perandori deklaroi se të gjitha nenet e Protestantëve ishin të vërteta. Rrëfimi u përkthye në shumë gjuhë të tjera dhe u përhap në të gjithë Evropën dhe është pranuar nga miliona njerëz gjatë brezave të mëvonshëm si shprehje e besimit të tyre.

Shërbëtorët besnikë të Zotit nuk po punonin vetëm. Ndërsa principatat, fuqitë dhe shpirtrat e së keqes po bashkoheshin kundër tyre, Zoti nuk i harroi njerëzit e tij. Sikur t'i kishin pasur sytë e hapur ata do të vinin re të njëjtën dëshmi të qartë të pranise hyjnore dhe ndihmë që dikur i ishte dhënë profetëve të lashtësisë. Kur shërbëtori i tij i tregoi Elishës ushtrinë armike, që duke i rrethuar nuk i kishte lënë asnjë mundësi shpëtimi, profeti u lut: "O Zot hapja sytë shërbëtorit tim që të shohë". 2 Mbretërve 6:17. Dhe ja, malet ishin mbushur me kuaj e karro lufte të zjarrta, ushtria e qiellit ishte vendosur në pozicion për të mbrojtur njeriun e Zotit. Në të njëjtën mënyrë engjëjt mbrojtën pjesëmarrësit e kauzës së Reformacionit.

Një nga parimet e respektuara rreptësisht nga Luteri ishte parimi sipas të cilit nuk do të kërkohej përkrahja e Reformacionit me anë të fuqive tokësore dhe nuk do të bëhej thirrje për të rrokur armët në mbrojtje të tij. Atë e gëzonte fakti se Ungjilli po përhapej me ndihmën e princërve të perandorisë, por kur ata propozuan që të krijonin një lidhje për mbrojtje, ai deklaroi se: "Doktrina e Ungjillit duhet të mbrohet vetëm nga Zoti...Sa më pak ndërhyrje njerëzore të përfitohet në këtë punë aq më e dukshme do të jetë ndërhyrja e Zotit në emër të saj. Sugjerimi i masave të tilla paraprake vinte si atribut i frikës së pabazë dhe mosbesimit mëkatar". D'Aubigne, London ed.,b.10;k.14.

Kur armiq të shumtë e të fuqishëm bashkuan forcat që të rrëzonin këtë besim të reformuar dhe kur mijëra shpata ishin gati të zhvisheshin nga milli, Luteri shkroi: "Satani po shpreh tërbimin e tij; bishopë e priftërinj të pafe po komplotojnë e ne na kërcënon lufta. Nxitini njerëzit të vinë me guxim përpara fronit të Zotit, me anë të besimit e lutjes, në mënyrë që armiqtë tanë, të mundur nga Shpirti i Zotit të ruajnë qetësine e paqen. Lutja është dëshira dhe puna jonë kryesore. Le t'i mësojmë

njerëzit se tani para tyre janë shfaqur shpata dhe zemërimi i Satanit dhe le të luten". - D'Aubigne,b.10;k.14.

E përsëri më vonë, duke iu referuar idesë së një lidhjeje që e kishin në mend princat reformatorë, Luteri deklaroi se e vetmja armë që duhet të përdoret në këtë ndërmarrje është "Shpata e Shpirtit". Ai i shkruante të zgjedhurit të Saksonisë "Ne nuk na lejon ndërgjegjja të aprovojmë këtë aleancë që na propozohet. Ne do të parapëlqenim më mirë të vdisnim dhjetë herë, sesa të shihnim se si kauza e Ungjillit të shkaktonte derdhjen e një pikë të vetme gjaku. Nga ana jonë ne duhet të jemi si ata qingjat, që janë gati për therje. Ne duhet të durojmë kryqin e Krishtit. Hirësia juaj nuk duhet të frikësohet.

Lutjet tona do të bëjnë shumë më tepër se të gjitha lëvdatat e armiqve tanë. Mos i lani duart me gjakun e vëllezërve tuaj. Në qoftë se perandori kërkon paraqitjen tonë në gjyq ne jemi gati të paraqitemi. Ju nuk mund ta mbroni besimin tonë, secili duhet të jetojë pasigurinë dhe rrezikun e vet.- Ibid.,b.14;k.1.

Nga vendi sekret i lutjeve doli fuqia, që tronditi botën gjatë Reformacionit të Madh. Pikërisht atje, me një qetësi të shenjtë, shërbëtorëte Zotit rifituan fuqi, duke u mbështetur tek shkëmbi i premtimeve të Tij. Gjatë përpjekjeve në Augsburg, Luteri nuk kaloi asnjë ditë pa i dedikuar të paktën tri orë lutjes e këto orë veçoheshin nga orët e zgjedhura për studim. Në vetmi, në dhomën e tij atë e kishin dëgjuar teksa i hapte zemrën Zotit me fjalë "adhurimi, frike dhe shprese, ashtu si dikush që flet me mikun e tij".

"E di se Ti je Ati dhe Zoti ynë" - thoshte "dhe se Ti do t'i shpërndash persekutorët e fëmijëve të Tu, sepse Ti vetë je në rrezik bashkë me ne. E gjithë kjo çështje të përket Ty dhe ne kemi marrë pjesë në të falë forcës Tënde. Prandaj mbrona o At!" - Ibid., b.14; k.6.

Ai i shkruante kështu Melanktonit, që ishte dërrmuar nga barra e ankthit dhe frikës: "Hir e paqe në Krisht - po them në Krisht dhe jo në botë. Amin. I urrej me gjithë fuqinë time këto shqetësime të mëdha (ekstreme) që po të konsumojnë. Nëse kauza nuk është e drejtë braktise, por në qoftë se kauza është e drejtë pse nuk duhet të besojmë premtimet e Atij që na urdhëron të flemë pa frikë?... Krishti nuk do të mungojë sa herë punohet për të vërtetën e drejtesine. Ai jeton, Ai mbreteron, e pse duhet te kemi frike?"- Ibid.,b. 14; k.6.

Zoti i dëgjoi lutjet e shërbëtorëve të Tij. Ai u dha hir dhe guxim princërve dhe misionarëve për ta ruajtur të vërtetën kundër sunduesve të errësirës së kësaj bote. Zoti thotë: "Unë vë në malin e Cionit një gur, gur themeli të zgjedhur e të çmuar. Kush i beson atij, nuk do të pësojë humbje". 1 Pjetri, 2:6. Reformatorët protestantë i kishin besuar Krishtit dhe dyert e ferrit nuk mund t'i mposhtnin ata.

---

* etërve - sipas at (prift i kishës katolike).

1. Çfarë kompromisi iu ofrua princave në favor të Reformimit nga Kisha e Romës? Përse e refuzuan princat atë?

2. Shpjegoni konceptin e lirisë së besimit.

3. Çfarë parimesh, që ishin në esencë të "protestave të princave", përcaktonin Protestantizmin? A janë ende relevante ato?

4. Sa të rëndësishme ishin lutjet dhe studimi Biblik në jetën e Luterit dhe të princave? Si u jep njerëzve kurajo për të përballuar sfidat dhe konfliktet e përditshme, marrëdhënia personale me Krishtin?

12.

Reformimi Francez

Protesta e Spirës dhe Rrëfimi i Augsburgut, të cilat vulosën triumfin e Reformacionit në Gjermani, u pasuan nga vite konflikti dhe errësire. Protestanizmi i dobësuar nga përçarja mes përkrahësve të tij dhe i sulmuar nga armiq të fuqishëm dukej se ishte i destinuar të shkatërrohej plotësisht. Me mijëra vetë vulosën dëshmitë e tyre me gjak. Shpërtheu lufta civile, kauza e Protestantëve u tradhëtua nga njëri prej përkrahësve të saj kryesore. Më fisnikët nga princët reformatorë ranë në duart e perandorit dhe u hoqën zvarrë si robër nga qyteti në qytet. Por pikërisht, në kohën e këtij të ashtuquajturi triumf perandori u sulmua deri në humbje. Ai vuri re se si preja i iku nga duart dhe së fundi u detyrua të toleronte doktrinat, shkatërrimi i të cilave kishte qënë ambicia e gjithë jetës së tij. Ai kishte rrezikuar mbretërinë e tij, thesaret e tij dhe vetë jetën e tij për të shuar këtë herezi. Ai pa shkatërrimin e ushtrive të tij nga lufta, shterrimin e thesareve të tij dhe vetë mbretëritë e tij të kërcënuara nga revolta, ndërsa besimi që ai ishte përpjekur më kot ta shtypte, po përhapej më tej. Karli V kishte luftuar kundër fuqisë së gjithpushtetshme. Zoti kishte thënë: "Të bëhet drita", por perandori ishte përpjekur ta ruante të paprishur errësirën. Qëllimet e tij kishin dështuar dhe, para kohe, i dërrmuar nga përpjekjet e gjata, ai dha dorëheqjen nga froni dhe u varros më pas në një manastir.

Ditë të errëta për Reformacionin erdhën edhe në Zvicër ashtu si edhe në Gjermani. Ndërsa ky besim i reformuar u pranua në disa nga pjesët zvicerane, të tjerat akoma rroknin me një këmbëngulje të verbër besimet dhe parimet e Romës. Persekutimi ndaj atyre, që dëshironin të pranonin të vërtetën ndezi luftën civile. Zwingli dhe shumë të tjerë, që ishin bashkuar me të në përkrahje të reformës ranë në fushat e përgjakura të Kappelit. Oekolampadiusi, i kërrusur nën peshën e këtyre fatkeqësive, vdiq pak pas tyre. Roma doli triumfuese dhe në shumë vende dukej sikur do të rifitonte gjithçka që kishte humbur. Por Ai, këshillat e të Cilit janë që nga përjetësia, nuk e harroi as kauzën e Tij dhe as njerëzit e Tij. Dora e Tij do t'u sillte

atyre çlirim. Ai kishte gjetur punëtorë në vende te tjera për ta çuar përpara punën e nisur të reformës.

Në Francë dita kishte filluar të agonte përpara se të dëgjohej emri i Luterit si Reformator. I pari që perceptoi dritën e agimit ishte i moshuari Lefevre, një njeri me njohuri të thella, profesor në Universitetin e Parisit dhe një përkrahës i zellshëm dhe i sinqertë i Papës. Gjatë kërkimeve të tij mbi letërsinë antike, vëmendja e tij u përqëndrua tek Bibla dhe ai ua paraqiti studimin e tij studentëve.

Lefevre ishte një adhurues entuziast i shenjtorëve dhe kishte marrë përsipër përgatitjen e një historie të shenjtorëve dhe martirëve, i mbështetur në legjendat kishtare. Kjo punë kërkonte mundim të madh, por ai kishte përparuar në mënyrë të konsiderueshme. Mendimi se mund të merrte ndihmën e nevojshme nga Bibla e shtyu atë të fillonte studimin e saj për këtë qëllim. E me të vërtetë shenjtorët iu shfaqën para syve, por jo të tillë si ata që figuronin në kalendarin roman. Drita hyjnore depërtoi në thellësitë e mendjes së tij. Ai i ktheu krahët me habi dhe përçmim detyrës që i pati ngarkuar vetes dhe iu dedikua fjalës së Zotit. Të vërtetat e çmuara që zbuloi në të filloi t'ua mësojë shumë shpejt edhe të tjerëve.

Në vitin 1512 përpara se Luteri apo Zwingli të fillonin punën për reformën, Lefevre shkruante: "Zoti është Ai që na jep nëpërmjet besimit drejtësinë, e cila përligj jetën e përjetshme dhe na dhurohet vetëm nga hiri i Perëndisë". - Wylie, b.13,k.1.

Duke trajtuar gjerë e gjatë misteret e çlirimit apo shpëtimit ai thërriste: "Oh, madhështia e pashprehur e këtij shkëmbimi; I pafajshmi dënohet, ndërsa ai që është fajtor largohet i lirë; Bekimi mban mbi supe mallkimin dhe i mallkuari fiton bekimin; Jeta vdes, ndërsa i vdekuri jeton; Lavdia mbështillet me errësirë dhe ai që përveç konfuzionit nuk njihte asgjë tjetër, mbështillet me lavdi."- D'Aubigne, London ed., b.12,k.2.

E ndërsa mësonte se lavdia e shpëtimit i përket vetëm Zotit, ai njëkohësisht deklaronte se njeriut i përkiste detyra e bindjes. "Në qoftë se ti je anëtar i kishës së Krishtit," - thoshte ai, "ti je pjesë e trupit të Tij; në se ti je nga trupi i Tij, ti je mbushur me natyrën hyjnore....Oh,sikur njerëzit vetëm ta kuptonin thelbin e këtij privilegji, sa dlirësisht, padjallëzisht dhe sa shenjtërisht do të jetonin ata dhe sa me përbuzje do ta gjykonin ata lavdinë e kësaj bote,- të krahasuar me lavdinë brenda tyre, lavdi që syri njerëzor nuk mund ta shohë." - Ibid.,b.12,k.2.

Mes studentëve të Lefevresë kishte nga ata që i thithnin me etje fjalët e tij, të cilët shumë kohë pasi zëri i mësuesit nuk ndihej më, do të vazhdonin të shpallnin hapur të vërtetën. I tillë ishte edhe William Farel. Duke qënë bir i një familjeje besimtare, që ishte edukuar të pranonte me besim të patundur mësimet e kishës, ai shumë mirë mund të deklaronte bashkë me apostullin Pal, përsa i përkiste vetes së tij kështu: "Se kam jetuar sipas rrymës më të rreptë të fesë sonë si farise." - Veprat 26:5.

Si katolik i devotshëm, ai digjej nga dëshira e zelli për të shkatërruar të gjithë ata që guxonin të kundërshtonin kishën. "Unë kërcisja dhëmbët si ujk i tërbuar, sa herë dëgjoja ndokënd, që fliste kundër Papës." - thoshte ai më pas, duke iu referuar kësaj periudhe të jetës së tij.- Wylie, b.13,k.2. Ai kishte qënë i palodhur në adhurimin e shenjtorëve, kur së bashku me Lefevrenë i kishte rënë rrotull të gjitha kishave të Parisit, duke adhuruar përpara altarëve dhe duke zbukuruar me dhurata arkat e shenjta. Por respektimi i këtyre rregullave nuk mund të sillte qetësi shpirtërore. Bindja e mëkatit e mbërthente, ndërsa të gjitha aktet e pendimit që ai praktikonte nuk mund ta zbërthenin atë. Tamam si zë nga parajsa, ai dëgjoi fjalët e Reformatorit:

"Shpëtimi vjen nga hiri i Perëndisë." "I pafajshmi u dënua, ndërsa krimineli vepron." "Vetëm kryqi i Krishtit është ai që hap dyert e parajsës dhe mbyll dyert e ferrit."-Ibid.,b.13,k.2.

Fareli e pranoi të vërtetën me gëzim. Ai doli nga robëria e traditës në lirinë e bijve të Zotit me anë të një shndërrimi shpirtëror si ai i Palit. "Në vend të zemrës idhtare të një ujku grykës" - tha ai përsëri, "qetësisht si ajo delja e bindur dhe e pafajshme fitova një zemër, që u shkëput tërësisht nga Papa dhe iu dha Jezus Krishtit." - D'Aubigne, b.12,k.3.

Ndërsa Lefevreja vazhdonte të përhapte këtë dritë mes studentëve të tij,

Fareli, duke treguar për kauzën e Krishtit të njëjtin zell si për atë të Papës, parapriu në deklarimin publik të së vërtetës. Shumë shpejt u bashkua me ta një personalitet kishtar siç ishte peshkopi i Meauksit. Të tjerë mësues, që falë njohurive dhe aftësive të tyre kishin poste të larta, u bashkuan në përhapjen e Ungjillit, i cili fitoi admirues nga të gjitha shtresat, nga shtëpitë e artizanëve dhe fshatarëve dhe deri në pallatin mbretëror. Vetë motra e Francit I, i cili gjatë asaj kohe ishte monarku i kurorës, e pranoi besimin e reformuar. Mbreti vetë dhe nëna mbretëreshë për një farë kohe e favorizuan atë dhe Reformatorët me shpresa të reja mezi prisnin kohën kur Ungjilli do të triumfonte në mbarë Francën.

Por shpresat e tyre nuk u realizuan. Kurthe dhe persekutime ishin ngritur kundër nxënësve të Krishtit. Sidoqoftë ky fakt ishte fshehur nga sytë e tyre me mëshirë. Për një farë kohe mbizotëroi paqja, në mënyrë që ata të fitonin guximin e duhur për të përballuar stuhinë. Dhe Reformacioni përparoi shpejt.

Peshkopi i Meauksit punoi me zell për instruktimin si të klerikëve dhe të njerëzve. Priftërinjtë injorantë dhe imoralë u eliminuan dhe u zëvendësuan brenda mundësive me njerëz të ditur e mëshirëplotë. Peshkopi donte me gjithë shpirt që njerëzit e tij të kishin të drejtën e leximit të fjalës së Zotit për veten e tyre dhe kjo dëshirë shumë shpejt iu plotësua. Lefevreja mori përsipër përkthimin e Dhiatës së Re; e ndërsa Bibla e Luterit në gjermanisht po dilte nga shtypi në Wittenberg, Dhiata e Re në frëngjisht u botua në Meauks. Bishopi nuk kurseu as mundimin as të hollat për qarkullimin e saj në lokalitete dhe shpejt fshatarët e Meauksit kishin në duar Shkrimet e Shenjta. Ashtu si udhëtarët e djegur nga etja presin me gëzim

të madh një rrjedhë uji ashtu edhe ata shpirtra njerëzore pranuan mesazhin e qiellit. Argatët në fusha, artizanët në punishte lehtësoheshin nga mundimi i punës së përditshme, duke folur për të vërtetat e çmuara të Biblës. Në mbrëmje në vend që t'i drejtoheshin lokaleve e verës ata mblidheshin në shtëpitë e njëri - tjetrit për të lexuar fjalën e Zotit, për t'iu lutur e për ta lavdëruar Atë së bashku. Në këto bashkësi u shfaq një ndryshim rrënjësor. Në jetët e tyre u vu re ajo fuqi e reformuar dhe e lartngritur e hirit hyjnor, sepse ata i përkisnin klasës më të paditur, më të përulur e më punëtorë të shoqërisë, ata i përkisnin fshatarësisë. Të përulur, të dashur e të shenjtë ata qëndronin dëshmitarë të asaj që Ungjilli do të përmbushë për të gjithë ata që e pranojnë sinqerisht.

Drita që u ndez në Meauks i përhapi rrezet e saj larg. Numri i të shndërruarve rritej nga dita në ditë. Për një farë kohe tërbimi i hierarkisëu kontrollua nga mbreti, i cili përçmonte fanatizmin e errët të murgjve, por më së fundi mbizotëruan udhëheqësit përkrahës të papës. Tani litari u shtrëngua. Peshkopi i Meauksit i detyruar të zgjidhte mes zjarrit dhe dorëheqjes pranoi rrugën më të lehtë. Por pavarësisht nga dështimi, tufa e tij qëndroi e patundur. Shumë dëshmuan për të vërtetën edhe mes flakëve. Nëpërmjet guximit dhe besnikërisë së tyre në kohë rreziku, këta kristianë të përulur i folën mijëra të tjerëve që gjatë kohës së paqes nuk i kishin dëgjuar kurrë dëshmitë e tyre.

Jo vetëm të varfërit dhe të përulurit guxonin mes vuajtjeve dhe përçmimit të dëshmonin për Krishtin. Në sallat e kështjellave të lordëve dhe në pallat kishte shpirtra mbretërorë, të cilët e vlerësonin këtë të vërtetë mbi pasurinë, mbi postin, madje edhe mbi jetën e tyre. Armatura mbretërore fshihte një shpirt më të butë e më të papërkulur se rroba dhe shkopi i bishopit. Louis de Berquin rridhte nga një familje fisnike. Fisnik i guximshëm dhe .. i rafinuar dhe me moral të pacënuar, ai i ishte dedikuar studimit. Një shkrimtar thotë: "Ai ishte një ndjekës i bindur i ligjeve të papatit dhe një dëgjues i zellshëm i meshave dhe shërbesave fetare,... dhe ai i kurorëzoi të gjitha virtytet e tjera, duke ushqyer një neveritje të veçantë për Luteranizmin. Po si shumë të tjerë ai u drejtua me maturi në Bibël dhe u mahnit kur në të gjeti "Doktrinat e Luterit dhe jo ato të Romës" - Wylie, b. 13; k.9 Që tani e tutje ai iu dedikua tërësisht kauzës së Ungjillit.

"Më i dituri i të gjithë fisnikëve francezë", gjenialiteti dhe elokuenca e tij, guximi i tij i admirueshëm, zelli i tij heroik dhe influenca e tij në oborrin mbretëror - sepse ai ishte i favorizuari i mbretit - bëri që shumë veta ta konsideronin si të destinuar për të qënë Reformatori i vendit të tij.

Beza tha: "Berquin do të ishte bërë Luteri i dytë, po të kishte gjetur tek Fransi i parë një të zgjedhur të dytë" "Ai është më keq se Luteri" -thërrisnin përkrahësit e papatit. - Ibid., b.13; k.9

Pjesa dërrmuese kishin frikë se ai ishte me të vërtetë i tillë, sidomos romanët e Francës. Ata e burgosën atë si heretik, por ai u lirua përsëri nga mbreti. Beteja

vazhdoi për vite me radhë. Fransi i lëkundur mes Romës dhe Reformacionit herë pas here i linte dorë të lirë ose nënshtronte zellin e tërbuar të murgjve. Autoritetet e papatit e burgosën Berquinin 3 herë, por ai u lirua nga monarku, i cili duke respektuar gjenialitetin dhe fisnikërinë e karakterit të tij refuzonte flijimin e tij ndaj keqdashjes së hierarkisë.

Berquinin e paralajmëruan vazhdimisht për rrezikun që e kërcënonte në Francë dhe e nxitën të ndiqte hapat e atyre që kishin gjetur siguri në mërgim. Erasmusi i ndrojtur dhe egoist, i cili pavarësisht nga shkëlqimi i edukimit të tij, nuk arriti ta kuptojë atë madhështi morale që e bën jetën dhe nderin të volitshme për të vërtetën, i shkruante Berquinit: "Kërko që të të dëgjojnë si ambasador në ndonjë vend të huaj. Ti e njeh Beden, ai është një përbindësh me njëqind kokë dhe po derdh vrer në çdo anë. Armiqtë e tu janë me mijëra, një mizëri. Edhe sikur kauza jote të ishte më e mirë se ajo e Jezus Krishtit, ata nuk do të linin të largoheshe, por do të të shkatërronin mizorisht. Mos i beso shumë mbrojtjes së mbretit. Sido që të ndodhë, mos më kompromento me çështje teologjike." - Ibid., b.13;k.9

Ndërsa rreziku shtohej, zelli i Berquinit forcohej më shumë. Larg nga pranimi i këshilles politike e egoiste të Erasmusit, ai vendosi të ndërmarrë masa akoma më të forta. Ai jo vetëm do të qëndronte në mbrojtje të së vërtetës, por edhe do të sulmonte gabimin. Akuzën për herezi, të cilën përkrahësit e Papës po përpiqeshin ta mbërthenin mbi të, ai do ta kthente mbi ta.

Oponentët më aktivë dhe më të papëlqyer për të ishin doktorët dhe murgjët e ditur të degës teologjike të Universitetit të njohur të Parisit, një nga qëndrat më të larta kishtare si për qytetin ashtu edhe për kombin. Nga shkrimet e këtyre doktorëve, Berquini nxorri dymbëdhjetë sugjerime, të cilat ai i deklaroi publikisht si "kundër Biblës dhe heretikë" dhe ai u paraqit përpara mbretit për të vepruar si gjykatës në këtë kontradiktë.

Monarku, duke mos dashur që të krahasojë fuqinë dhe saktësinë e kampionëve të kundërt dhe i gëzuar nga mundësia që iu dha për të gjunjëzuar krenarinë e këtyre murgjve mendjemëdhenj, i kërkoi përkrahësve të Romës të mbronin kauzën e tyre në Bibël.

Ata e dinin mirë se kjo armë nuk do t'u sillte ndonjë dobi të madhe. Burgimi, tortura dhe druri ishin armët që ata dinin t'i përdornin shumë më mirë. Tani rolet ishin ndryshuar dhe ata vunë re se ishin gati për të rënë në gropën që ata kishin shpresuar të hidhnin Berquinin. Ata filluan të kërkoninpërreth me habi, një rrugë shpëtimi.

"Pikërisht në këtë kohë një imazh i Virgjëreshës, në një cep rruge, u shkatërrua." Qyteti u emocionua. Turma njerëzish u mblodhën në atë vend, duke u ankuar dhe të indinjuar. Edhe mbreti u prek thellësisht. Ja pra ku ishte një avantazh, nga i cili mund të përfitonin murgjit dhe ata e shfrytëzuan atë me shpejtësi.

"Këto janë frutet e doktrinave të Berquinit - thërrisnin ata. -Gjithçka bëhet për të shkatërruar fenë, ligjet dhe vetë fronin mbretëror - nga ky konspiracion Luterian" - Ibid., b.13;k.9

Berquini u arrestua përsëri. Mbreti u tërhoq nga Parisi dhe murgjit u lanë të lirë të plotësonin vullnetin e tyre. Reformatori u gjykua dhe u dënua me vdekje dhe përpara se Fransi të ndërhynte për ta shpëtuar, dënimi u krye në të njëjtën ditë që u mor. Në mesditë Berquini u dërgua në vendin e vdekjes. Një turmë e madhe njerëzish ishte grumbulluar aty për ta parë me sytë e tyre këtë ngjarje. Kishte shumë prej tyre, që vunë re me habi dhe dyshim se viktima ishte zgjedhur nga një prej familjeve fisnike më të mira dhe më të guximshme franceze. Çudi, indinjatë, përçmim dhe urrejtje e thellë lexohej në fytyrat e inatosura të turmës, që rritej vazhdimisht, por në një fytyrë nuk kishte asnjë hije dyshimi. Mendimet e martirit ishin larg skenës së kësaj trazire; ai ndjente vetëm praninë e Zotit të tij.

Karrocën fatkeqe mbi të cilën ai udhëtonte, fytyrat e vrenjtura të persekutorëve të tij, vdekjen e tmerrshme drejt së cilës po shkonte - nuk i merrte parasysh. Ai që jetonte, vdiq dhe është i gjallë përgjithmonë, Ai që ka çelësat e vdekjes dhe ferrit, qëndronte pranë tij. Shprehja e fytyrës së Berquinit shkëlqente nga drita e paqes qiellore. Ai ishte veshur me një petk tërheqës me "një mantel kadifeje, me një xhakete atllasi e damasku dhe çorape të arta" - D'Aubigne, Historia e Reformacionit në Evropë në kohën e Kalvinit, b.2; k.16. Ai tashmë do t'i dëshmonte besimin e tij Mbretit të mbretërve përpara Universit - dëshmitar dhe s'kishte shenjë pakënaqësie, që të errësonte gëzimin e tij.

Ndërsa procesioni zhvendosej ngadalë në rrugët e mbushura me njerëz, ata vinin re me habi paqen e paturbulluar, triumfin gëzimplotë të pamjes dhe qëndrueshmërisë së tij. Ata thoshin: "Ai është tamam si dikush, që ulet në tempull dhe mediton për gjëra të shenjta" - Wylie, b.13; k.9

Në prag të vdekjes (në hu), Berquini u përpoq t'u drejtohej njerëzve me disa fjalë, por murgjit të frikësuar nga rezultati që këto fjalë do të kishin, filluan të bërtisnin dhe ushtarët filluan të përplasnin armët e tyre, kështu që zhurma e tyre e mbyti zërin e martirit. Pra në vitin 1523 autoriteti më i lartë letrar dhe kishtar i Parisit të kulturuar "i dha vegjëlisë së vitit 1793 shembullin e ulët, duke mbytur fjalët e fundit të një të dënuari me vdekje, mbi podiumin e ekzekutimit" - Ibid., b.13; k.9

Berquini u var në litar dhe më pas flakët përfshinë trupin e tij. Lajmi i vdekjes së tij shkaktoi dhimbje mes miqve të Reformacionit në të gjithë Francën. Por shembulli i tij nuk humbi. "Edhe ne jemi të gatshëm, - thanë dëshmitarët e të vërtetës, - që ta presim vdekjen me gëzim, me sy të fiksuar tek jeta e re që do të vijë." - D'Aubigne, Historia e Reformacionit në Evropë në kohën e Kalvinit, b.2; k.16

Gjatë persekutimit në Meauks, mësuesve të besimit të reformuar nuk iu njoh e drejta për të predikuar e kështu ata u larguan në drejtime të tjera. Lefevre, pas

një farë kohe, u nis për në Gjermani. Fareli u rikthye në qytetin e tij të lindjes në Francën Lindore, me qëllim që të përhapte dritën në vendin e fëmijërisë së tij. Tashmë kishin mbërritur lajme mbi gjithçka që po ndodhte në Meauks dhe e vërteta, të cilën ai e kishte përhapur me zell e pa frikë, po dëgjohej. Autoritetet, shumë shpejt, u ngriten në këmbë që t'ia mbyllnin gojën dhe e dëbuan nga qyteti.

Edhe pse ai nuk mund të punonte më publikisht, ai përsëri udhëtonte përmes fushave dhe fshatrave, duke dhënë mësim në shtëpi private dhe në livadhe të veçuara, duke pasur për strehë pyjet dhe shpellat e gurta, të cilat gjatë fëmijërisë së tij kishin qënë vendqëndrimet e tij. Zoti po e përgatiste për prova më të mëdha. "Brengat, persekutimet dhe makinacionet e Satanit, për të cilat më kishin paralajmëruar, nuk munguan - tha ai. Ato janë madje shumë më të ashpra dhe unë s'mund t'i duroj vetë, por Zoti është Ati im. Ai më ka dhënë dhe do të më japë gjithmonë fuqinë që më duhet." - D'Aubigne, Historia e Reformacionit e shek.16-te, b.12; k.9

Si gjatë ditëve apostolike, persekutimi "ndihmoi për përhapjen e lajmit të mirë." - Filipianet 1:12. Të larguar nga Parisi dhe Meauksi, "Ata që kishin ikur, e përhapën gjithkund lajmin e mirë për Jezusin" - Veprat 8:4. Kështu drita gjeti shtegun drejt pjesës më të madhe të provincave të largëta franceze.

Zoti po përgatiste punëtorë për të përhapur më tej kauzën e Tij. Në një nga shkollat e Parisit ishte një i ri i mençur dhe i qetë, që tashmë kishte dhënë prova të një mendjeje të fuqishme dhe pjellore dhe njihej si për jetën e tij pa gabime ashtu edhe për energji intelektuale e devocion fetar. Gjenialiteti dhe impenjimi i tij e bënë atë shumë shpejt të ishte krenaria e kolegjit dhe u parashikua me besim të patundur se John Calvin do të bëhej një nga mbrojtësit më të zotë e më të nderuar të kishës. Por një rreze nga drita hyjnore penetroi edhe muret e skolasticizmit dhe supersticionit, që e kishin rrethuar Calvinin.

Ai u rrënqeth kur dëgjoi për doktrinat e reja, duke mos dyshuar për asnjë çast se heretikët meritonin të digjeshin. Megjithatë pa dashje ai u gjend ballë për ballë me herezinë dhe u detyrua të provonte fuqinë e teologjisë romake kundër mësimit protestant.

Një i afërm i Calvinit, përkrahës i Reformatorëve, ishte në Paris. Të dy kushërinjtë takoheshin shpesh dhe diskutonin së bashku mbi problemet që shqetësonin kristianizmin. "Fetë, që ekzistojnë në botë janë vetëm dy" -thoshte Olivetan Protestanti. Njëra klasë përfshin të gjitha llojet e fesë, që janë shpikur nga njeriu, në të cilat ai përpiqet të shpëtojë vetveten nëpërmjet ceremonive dhe veprave të mira; tjetra përbën atë fe, që zbulohet në Bibël dhe që e mëson njeriun ta kërkojë shpëtimin vetëm tek hiri i dhënë falas nga Zoti.

"Nuk pranoj asnjë nga doktrinat e tua të reja - thirri Calvini. Si mendon ti se unë kam jetuar gabim gjatë gjithë jetës sime?" - Wylie, b.13; k.7. Por në mendjen e tij ishin zgjuar mendime të reja, që ai s'mund t'i dëbonte pavarësisht nga dëshira

* karrocë që përdorej për të dërguar të burgosurit në gijotinë, gjatë Revolucionit francez.

e tij. Ai i peshonte fjalët e kushëririt të tij sa herë që ishte i vetëm në dhomën e tij. Bindja e mëkatit e mbërtheu, ai e pa veten në praninë e një Gjykatësi të shenjtë e të drejtë, pa ndërmjetës. Ndërmjetësimi i shenjtorëve, veprat e mira, ceremonitë kishtare ishin të pafuqishme për të shlyer mëkatin. Përpara tij nuk kishte asgjë tjetër veç errësirës së zhdukjes së përjetshme. Më kot u përpoqën doktorët e kishës t'ia lehtësonin brengën.

Rrëfimi dhe pendesa nuk kishin rezultat, ato nuk mund ta pajtojnë shpirtin mëkatar me Zotin.

Ndërsa akoma ishte i përfshirë në këto përpjekje të pafrytshme, Calvin rastësisht një ditë po shëtiste në sheshet publike dhe në njërin prej tyre ai pa me sytë e tij djegien e një heretiku. Ai u habit nga shprehja paqësore që prehej mbi fytyrën e martirit. Pavarësisht nga tortura e asaj vdekjeje të llahtarshme dhe nga pesha e dënimit më të tmerrshëm të kishës, ai manifestoi një guxim dhe besim, të cilin studenti i ri, me dhimbje e krahasoi me dëshpërimin dhe errësirën e tij shpirtërore, të cilat ai i përjetonte edhe pse jetonte në bindje të plotë me kishën. Ai e dinte se heretikët e mbështesnin besimin e tyre në Bibël. Ai vendosi ta studionte atë dhe të zbulonte po të mundte sekretin e gëzimit të tyre.

Në Bibël ai gjeti Krishtin. "O Atë - thërriste ai, sakrifica e Tij ka zbutur zemërimin Tënd. Gjaku i Tij ka marrë me vete papastërtitë e mia, kryqi i Tij ka përballuar mallkimin tim, vdekja e Tij ka shlyer mëkatet e mia. Ne kemi shpikur për veten tonë budallallëqe të padobishme. Ti ke vendosur fjalën Tënde përpara meje si pishtar dhe Ti ke prekur zemrën time, në mënyrë që unë të përbuz të gjitha meritat e tjera përveç atyre të Jezusit."- Martyn vol. 3;k.13.

Calvin kishte mësuar për t'u bërë prift. Kur ishte vetëm 12 vjeç ai u emërua në kapelansinë e një kishe të vogël dhe peshkopi i qethi flokët sipas kanunit të kishës. Ai nuk u shenjtërua dhe as nuk i përmbushi detyrat e tij si prift, por ai u bë anëtar i klerit, duke mbajtur titullin e postit të tij dhe duke përfituar nga ky fakt një liri të konsiderueshme veprimi.

Gjatë asaj kohe, duke e kuptuar se nuk mund të bëhej kurrë një prift i vërtetë, ai iu kthye studimit të Ligjit, por përfundimisht hoqi dorë nga ky qëllim dhe vendosi t'ia dedikonte jetën e tij Ungjillit. Por sidoqoftë hezitonte të bëhej mësues publik. Ishte i ndrydhur nga natyra dhe mbi të ushtronte ndikim përgjegjësia e rëndë e postit dhe akoma dëshironte t'i jepej studimit. Por lutjet e vendosura të miqve të tij më së fundi triumfuan.

"Eshtë i mrekullueshëm fakti - tha ai që një njeri, me një origjinë kaq të përulur, mund të lartësohej drejt një dinjiteti të tillë." - Wylie, b.13; k.3.

Ai i hyri punës qetësisht dhe fjalët e tij ishin si vesa, që bie për të freskuar tokën. Ai ishte larguar nga Parisi dhe ndodhej në një qytet provincial nën mbrojtjen e princeshës Margaret, e cila duke e dashur Ungjillin e zgjeroi akoma më shumë

mbrojtjen që u jepte nxënësve të tij. Calvin ishte akoma i ri, i sjellshem dhe pa pretendime. Ai e filloi punën me njerëzit në shtëpitë e tyre. Lexonte Biblën dhe zbulonte të vërtetat e shpëtimit i rrethuar nga anëtarët e familjes. Ata që e dëgjonin mesazhin e shpërndanin atë tek të tjerët e shumë shpejt mësuesi u zhvendos në qytetet dhe fshatrat përreth. Ai i gjeti të hapura dyert e kasolleve dhe zemrat e njerëzve dhe përparoi, duke hedhur themelet e kishave, nga të cilat më vonë do të dilnin dëshmitarë sypatrembur për të vërtetën.

Pas disa muajsh ai u kthye përsëri në Paris. Në rrethin e njerëzve të ditur e të shkolluar ndjehej shqetësim. Studimi i gjuhëve të lashta i kishte çuar këta njerëz drejt Biblës e shumë prej tyre, zemrat e të cilëve nuk ishin prekur nga të vërtetat e saj, diskutonin me zell e madje grindeshin me kampionet e katolicizmit roman. Calvin edhe pse ishte një debatues i zoti në fushën e kontradiktës teologjike kishte marrë mbi vete plotësimin e një misioni më të lartë se ai i këtyre intelektualëve zhurmues. Mendjet njerëzore ishin prekur e tani ishte koha e duhur që e vërteta të zbulohej para tyre. Ndërsa sallat e universiteteve zienin nga zhurma e diskutimeve teologjike, Calvin përparonte nga shtëpia në shtëpi, duke ia zbuluar Biblën njerëzve dhe duke u folur atyre për Krishtin dhe kryqëzimin e Tij.

Me kujdesin e Zotit, Parisit iu dha një ftesë e dytë për të ftuar Ungjillin. Thirrja e Lefevresë dhe Farelit ishte hedhur poshtë, por përsëri të gjitha klasat e kryeqytetit të madh do ta dëgjonin mesazhin edhe një herë. Mbreti i influencuar nga arsye politike nuk e kishte përkrahur Romën plotësisht në luftën kundër Reformacionit. Margaret akoma mbështetej tek shpresa se Protestanizmi do të triumfonte në Francë. Ajo vendosi që besimi i reformuar të predikohej në Paris. Gjatë mungesës së mbretit ajo urdhëroi një misionar protestant që të predikonte në kishat e qytetit. Duke qënë se kjo u ndalua nga autoritetet e papatit, princesha hapi pallatin mbretëror. Një apartament u rregullua në formën e një kishe të vogël dhe u komunikua se çdo ditë do të mbahej një shërbesë në një orë të caktuar dhe njerëzit e të gjitha klasave ftoheshin të merrnin pjesë. Turma njerëzish erdhën në shërbesë. Jo vetëm kisha, por edhe dhomat dhe sallat përreth saj u mbushën plot. Me mijëra njerëz mblidheshin çdo ditë: fisnikë, qeveritarë, gjykatës, tregtarë dhe artizanë.

Mbreti në vend që t'i ndalonte këto grumbullime dha urdhër që të hapeshin dy nga kishat e Parisit. Qyteti nuk kishte qënë kurrë më parë kaq i trazuar nga fjala e Zotit. Shpirti i jetës i dha frymëmarrje njerëzve që nga parajsa. Maturia, pastërtia, rregulli dhe puna zunë vendin e dehjeve, trazirave, dembelllëkut dhe imoralitetit.

Por hierarkia nuk qëndroi pasive. Mbreti vazhdonte të refuzonte për të ndërhyrë në ndalimin e predikimit, kështu që ata iu drejtuan masave popullore. Nuk u kursye asgjë për të ngjallur frikën, paragjykimin dhe fanatizmin e masës injorante dhe superstitioze. Duke u dorëzuar verbërisht përpara mësuesve të rremë, Parisi, ashtu si Jeruzalemi i vjetër nuk e kuptoi kohën e vizitës dhe as gjërat që i përkisnin paqes.

Fjala e Zotit u predikua në kryeqytet për dy vjet rresht, por, ndërsa disa e pranuan, pjesa më e madhe e njerëzve e mohuan atë.

Franci kishte treguar një farë tolerance vetëm që ato t'i shërbente qëllimeve të veta, kështu që përkrahësit e papës e rifituan përsëri epërsinë. Kishat u mbyllën përsëri dhe u ngritën turrat e druve.

Calvin ishte akoma në Paris, duke u përgatitur nëpërmjet studimit, meditimit dhe lutjes për punën e tij të ardhshme në vazhdim të përhapjes së dritës. Sidoqoftë, dyshimi më së fundi ra dhe mbi të. Autoritetet vendosën ta digjnin. Duke u ndjerë i sigurtë në vendin e izuluar ku jetonte, atij nuk i kishte shkuar ndonjëherë ndërmend rreziku, kur miqtë e tij duke nxituar i sollën lajmin se ushtarët ishin nisur për ta arrestuar. Pikërisht në atë moment u dëgjua një e trokitur e fortë tek dera e jashtme. Edhe sekonda nuk duhej humbur. Disa nga shokët e tij vonuan ushtarët tek dera, ndërsa të tjerët ndihmuan Reformatorin të zbriste nga dritarja dhe të largohej me shpejtësi drejt rrethinave të qytetit. Gjeti strehë në kasollen e një punëtori, mik i reformës dhe duke u maskuar nën veshjet e mikut të tij dhe duke mbajtur njëshat në sup, ai filloi sërish udhëtimin e tij.

Duke udhëtuar në drejtimin e Jugut ai gjeti përsëri strehim nën pronësimin e Margaretës. - D'Aubigne, Historia e Reformacionit në Evropë në kohën e Calvinit, b.12; k.30.

Si gjithmonë i zhytur në studim, ai qëndroi këtu për disa muaj nën mbrojtjen e disa miqve të pushtetshëm. Por ai donte me gjithë shpirt evangjelizimin e gjithë Francës, prandaj nuk mund të qëndronte pasiv për një kohë më të gjatë. Sapo stuhia u qetësua disi, ai provoi të punonte në një fushë të re e pikërisht në Pitiern, ku ndodhej një universitet dhe idetë e reja kishin gjetur përkrahje. Njerëz të të gjitha klasave e dëgjonin me gëzim lajmin e mirë. Nuk mund të predikohej publikisht, por Calvin ia hapte fjalët e jetës së përjetshme të gjithë atyre që dëshironin t'i dëgjonin në shtëpinë e kryemagjistratit, në vendbanimet e tij apo ndonjëherë edhe në kopshtin publik.

Pas ca kohësh, ndërsa numri i dëgjuesve rritej, ata menduan se do të ishte më e sigurt mbledhja jashtë qytetit. Një e çarë, në një grykë të thellë e të ngushtë mali, me pemë dhe shkëmbinj përreth, që krijonin një izolim të plotë, u zgjodh si vend takimi. Grupe të vogla largoheshin nga qyteti në drejtime të ndryshme dhe ngjiteshin deri atje. Në këtë vend paqendjellës lexohej me zë të lartë dhe shpjegohej Bibla. Pikërisht këtu u festua për herë të parë nga protestantët francezë Darka e Zotit. Nga kjo kishë e vogël dolën shumë evangjelistë besnikë.

Calvin u rikthye përsëri në Paris. Ai akoma ushqente shpresën se Franca si komb do ta pranonte Reformacionin. Por ai nuk gjeti asnjë mënyrë për të punuar. Të jepje mësime rreth Ungjillit do të thoshte të merrje rrugën për në turrën e druve, prandaj së fundi ai vendosi që të nisej për në Gjermani. Sapo ai u largua nga Franca

shpërtheu një stuhi mbi Protestantët, stuhi, e cila pa dyshim do ta përfshinte edhe atë po të kishte qëndruar dhe do ta çonte drejt rrënimit përfundimtar.

Reformatorët francezë të etur për ta parë vendin e tyre me një hap me Gjermaninë dhe Zvicrën vendosën t'i godisnin fort supersticionet e Romës, goditje, e cila do të ngrinte në këmbë një komb të tërë. Sipas këtij vendimi në të gjithë Francën brenda një nate u vendosën pllakate, që godisnin meshën. Kjo lëvizje e zellshme, por e keqgjykuar në vend që të sillte progresin e reformës solli vetëm rrënimin jo vetëm të propaganduesve të saj, por edhe të të gjithë përkrahësve të besimit të reformuar në mbarë Francën. Kjo i dha përkrahësve të Romës atë që kishin dëshiruar për një kohë kaq të gjatë - një preteks për të kërkuar shkatërrimin përfundimtar të heretikëve, të cilët ishin agjitatorë të rrezikshëm si për stabilitetin e fronit mbretëror ashtu dhe për paqen kombëtare.

Nga një dorë misterioze, që nuk u mor vesh kurrë e kujt ishte, e një shoku të pakujdesshëm apo e një armiku mashtrues, një nga pllakatet u ngjit në derën e mbretit. Supersticionet, që ishin pranuar me nderim të thellë ndër shekuj goditeshin në këtë letër pa kursim. Guximi i pashembullt i vendosjes së këtyre thënieve të ulëta dhe tronditëse pikërisht në praninë mbretërore, zgjoi indinjatën e vetë mbretit.

I çuditur ai qëndroi për një farë kohe pa folur dhe duke u dridhur. Më pas zemërimi i tij u shpreh në fjalët e tmerrshme: "Të kapen pa dallim të gjithë ata që dyshohen për luterizëm. Do t'i shfaros të gjithë." - Ibid, b.4;k.10. Loja filloi. Mbreti vendosi të mbante plotësisht anën e Romës.

Menjëherë u morën masa për arrestimin e çdo përkrahësi të Luterit në qytet. Një artizan i varfër, përkrahës i besimit të reformuar, i cili zakonisht mblidhte besimtarët në grupet e tyre sekrete, u kap dhe pasi e kërcënuan me vdekje të menjëhershme mbi turrën e druve, e urdhëruan t'i çonte të dërguarit e papës në shtëpitë e çdo protestanti në qytet. Fillimisht ai u neverit nga një propozim kaq i ulët, por së fundi, frika nga flakët e zjarrit triumfoi dhe ai pranoi të tradhëtonte vëllezërit e tij. Zbuluesi mbretëror, Morini, bashkë me tradhëtarin, të paraprirë nga një mori njerëzish dhe të rrethuar nga një varg priftërinjsh, murgjish, mbajtësish temjani dhe ushtarësh, qarkuan qetësisht dhe ngadalë rrugët e qytetit. Demonstrimi sa për sy e faqe nderonte "kungatën e shenjtë", ai ishte një akt rishlyerjeje për fyerjen që protestantët i kishin bërë meshës. Por kjo paradë fshihte një qëllim vdekjeprurës. Tradhëtari, me të arritur përpara shtëpisë së ndonjë Luterani, bënte me shenjë, pa shqiptuar asnjë tingull. Procesioni ndalej dhe futej në shtëpi, duke tërhequr zvarrë të lidhur me zinxhirë tërë familjen e më pas turma e tmerrshme bënte përpara në kërkim të viktimave të reja. Ata nukkursyen asnjë shtëpi, të madhe a të vogël, madje ata nuk kursyen as kolegjet e universitetit të Parisit.

.... Morini i futi të dridhurat qytetit mbarë.

.... Terrori mbretëronte kudo. - Ibid, b.4; k.10

Vdekja e viktimave u shoqërua me tortura mizore, u urdhërua veçanërisht që zjarri të mos ndizej shumë, në mënyrë që agonia e tyre të zgjatej e të zgjatej. Por ata vdiqën si fitimtarë. Qëndrueshmëria e tyre nuk u lëkund, paqja e tyre nuk u errësua. Persekutuesit e tyre, të pafuqishëm për ta lëkundur vendosmërinë e tyre të paepur u ndjenë të mundur. "Turrat e druve u shpërndanë në të gjitha lagjet e Parisit dhe djegiet vazhduan për disa ditë rresht, me qëllimin e vetëm të përhapjes së terrorit ndaj herezisë, duke përhapur terrorin e ekzekutimeve.

Sidoqoftë në fund përparësia i takonte përsëri Ungjillit. Parisi qe në gjendje të shihte se çfarë njerëzish mund të krijonin idetë e reja. Nuk kishte fjalë me fuqi më të madhe se turra e martirëve. Gëzimi që u jepte dritë fytyrave të këtyre njerëzve, ndërsa ata drejtoheshin .... për tek vendi i ekzekutimit, heroizmi i tyre, ndërsa ata qëndronin mes flakëve djegëse, falja që ata i bënin padrejtësive, kthyen jo në pak raste zemërimin në keqardhje, urrejtjen në dashuri dhe flisnin me elukuencë, të cilës askush nuk mund t'i rezistonte në emër të Lajmit të Mirë." - Wylie,b.13;k.20.

Priftërinjtë, duke dashur ta mbanin zemëratën popullore në lartësinë e duhur përhapën akuza nga më të tmerrshmet kundër Protestantëve. Ata u akuzuan për komplot në masakrimin e katolikëve, në rrëzimin e qeverisë dhe në vrasjen e mbretit. Por nuk mund të gjendej asnjë gjurmë prove për të mbështetur këto deklarata. Megjithatë këto profeci të mbrapshta do të përmbusheshin në rrethana tërësisht të ndryshme dhe nga shkaqe të një karakteri të kundërt.

Mizoritë, të cilat katolikët ia ngarkuan Protestantëve të pafajshëm, u akumuluan në formë shpagimi dhe sollën në shekujt që pasuan fatkeqësitë, që ishin parashikuar mbi mbretin, mbi qeverinë e tij dhe mbi shtetasit e tij, fatkeqësi, që i sollën tradhëtarët dhe vetë përkrahësit e papës 300 vjet më vonë. Këto fatkeqësi ranë mbi Francën jo nga vendosja, por nga shtypja e Protestanizmit.

Dyshimi, mosbesimi dhe terrori përfshinë të gjitha klasat e shoqërisë. Përveç alarmit mbarëshoqëror u vu re se mësimet luterane kishin hedhur rrënjë të thella në mendjet e njerëzve të nderuar për edukimin, ndikimin dhe karakterin e tyre brilant. Menjëherë u zhdukën personalitete të besuara dhe të nderuara. Artizanë, botues, shkollarë, profesorë universitetesh, autorë e madje dhe oborrtarë humbën pa gjurmë. Me qindra njerëz u larguan nga Parisi, sepse për shumë prej tyre aludohej se kishin përkrahur besimin e reformuar, duke përbërë të ashtuquajturit mërgimtarë nga toka mëmë. Përkrahësit e papës u çuditën kur vunë re tolerimin që u patën bërë heretikët, për të cilët nuk kishin dyshuar kurrë. Zemërimi i tyre u shfry mbi viktimat më të përulura, që ndodheshin nën pushtetin e tyre. Burgjet ishin mbushur plot dhe dukej sikur edhe ajri ishte ndotur nga tymi i turrave që digjeshin, turra që ishin ngritur për rrëfyesit e Ungjillit.

Fransi kishte fituar lavdi si udhëheqës i lëvizjes së madhe për ringjalljen e mësimit, ringjallje, e cila vulosi hapjen e shekullit të 16-të. Ai ishte kënaqur duke

mbledhur në oborrin e tij mbretëror njerëz të ditur nga çdo vend. Reforma kishte gëzuar një farë lirie, falë dashurisë së tij për dije dhe përçmimit të tij për injorancën dhe supersticionin e murgjve. Por ky mbrojtës i dijes, i frymëzuar nga zelli për t'i dhënë fund herezisë, nxori një dekret sipas të cilit ndaloi shtypjen e librave në të gjithë Francën.

Fransi përbën një prej shembujve të shumtë të të dhënave të ndryshme, që dëshmonin se kultura intelektuale nuk është mburojë e sigurt kundër skllavërisë dhe persekutimit fetar.

Franca me anë të një ceremonie solemne dhe publike, tregoi se iu dha me mish e me shpirt shkatërrimit të protestanizmit. Priftërinjtë kërkuan që fyerja që iu bë Qiellit të Lartë, duke dënuar meshën, të shpaguhej me gjak dhe që vetë mbreti në emër të popullit ta aprovonte publikisht këtë punë të tmerrshme.

Ceremoniali i shëmtuar u caktua për në 21 Janar të vitit 1535. Ishin ripërtërirë frika supersticioze dhe urrejtja fanatike e një kombi mbarë. Turma njerëzish u dyndën në rrugët e Parisit edhe nga fshatrat përreth. Një procesion i gjerë dhe hijerëndë priste agimin e ditës së re. "Në shtëpitë, që shtriheshin përgjatë vijës së marshimit ishin varur pëlhura zije dhe aty - këtu ishin ngritur altare. Përpara çdo porte ndodhej një pishtar i ndezur për nder të "Kungatës së Shenjtë". Pa aguar akoma plotësishtprocesioni u zhvendos përpara pallatit të mbretit. "Paraprinin flamurët dhe kryqet e famullive të ndryshme, të ndjekur nga qytetarët, të cilët ecnin në rresht nga dy, duke mbajtur në duar pishtarë." Pasonin Katër Urdhërat Oshënarë*, secili me veshjen e vet karakteristike. Më pas i vinte radha një koleksioni të pasur reliktesh të famshme. Së fundi udhëtonin të hipur mbi kuaj klerikët - feudalë me rrobat e tyre të purpurta dhe të kuqe të ndezura, një petk me të vërtetë i mahnitshëm dhe i ndritshëm.

Peshkopi i Parisit mbante Bukën** e ndorme, me një mbulesë të mrekullueshme hedhur mbi të... i ndjekur nga katër princa të familjes mbretërore....Mbreti ecte pas tyre ... Fransi nuk kishte as kurorë dhe nuk kishte veshur petkun shtetëror atë ditë. Me "kokë të zbuluar, me sytë përdhe dhe me një qiri të ndezur në dorë" u shfaq mbreti i Francës "me pamje të penduar." - Ibid.,b.13;k.21. Ai përkulej me përulje përpara çdo altari jo për të këqijat, që fëlliqnin shpirtin e tij dhe as për gjakun e pafajshëm me të cilin kishte ndotur duart, por për mëkatin e tmerrshëm që kishin kryer shtetasit e tij, duke guxuar të dënonin meshën. Ai ndiqej pas nga mbretëresha dhe nga autoritetet shtetërore, që gjithashtu ishin rreshtuar për dy dhe mbanin pishtarë të ndezur në duar.

Si pjesë e shërbesave të ditës vetë monarku i udhëhoqi zyrtarët e lartë të mbretërisë në sallën e madhe të pallatit të peshkopit. Ai doli para tyre me një pamje të dëshpëruar dhe foli me një elokuencë prekëse, duke u qarë që "krimi, blasfemia

* - murg

** - bukë pa maja, që përdoret gjatë shërbesës së Komunionit

dhe dita e dëshpërimit dhe turpit" kishin rënë mbi kombin mbarë. Ai i bëri thirrje çdo shtetasi besnik për të ndihmuar në shfarosjen e herezisë vdekjeprurëse, e cila kërcënonte deri rrënimin e Francës.

"Messieurs, sa është i vërtetë fakti që unë jam mbreti juaj - tha ai -po aq i vërtetë është fakti që sikur ta dija që një nga gjymtyrët e mia ishte prekur apo infektuar nga ky kalbëzim i neveritshëm, unë do t'ua afroja ta prisnit.... E për më tepër, sikur të shihja një nga fëmijët e mi të njollosur prej tij nuk do ta kurseja.. unë vetë do ta çliroja dhe do ta flijoja për Zotin."

Ai u mbyt në lot dhe e gjithë asambleja qau me të, duke përsëritur të njëjtën gjë: "Ne do të jetojmë dhe do të vdesim për fenë katolike."D'Aubigne, Historia e Reformacionit në Evropë gjatë kohës së Kalvinit,b.4;k.14.

Ishte e tmerrshme historia e kombit, që kishte mohuar dritën e së vërtetës. Hiri "që sjell shpëtim" ishte shfaqur, por Franca, pasi pa fuqinë dhe shenjtërinë e tij, pas mijëra njerëzve që i kishte tërhequr bukuria e tij hyjnore, pas një numri të madh qytetesh e fshatrash, që kishin marrë dritë nga rrezatimi i tij ishte zbrapsur, duke preferuar të zgjidhte më mirë errësirën se dritën. Ata e kishin larguar dhuratën qiellore, që u ishte ofruar. Ata e kishin quajtur të keqen të mirë dhe të mirën të keqe deri sa ishin kthyer në viktima të gatshme të vetëmashtrimit. Megjithëse ata mund të besonin se po i kryenin shërbim Zotit, duke persekutuar njerëzit e Tij, sinqeriteti nuk i bënte të pafajshëm. Ata e kishin mohuar me kokëfortësi dritën, e cila do t'i kishte shpëtuar nga mashtrimi dhe nga njollosja e shpirtrave të tyre me gjak të pafajshëm.

Ata u betuan solemnisht që ta shkatërronin herezinë në katedralen e madhe, vend, në të cilin tre shekuj më vonë kombi, i cili kishte harruar Zotin që jeton, do të kurorëzonte Mbretëreshën e Arsyes. Procesioni u formua përsëri dhe përfaqësuesit e Francës u nisën që të fillonin punën për të cilën kishin dhënë fjalën. "Turra drush ishin ngritur shumë, afër njëra - tjetrës dhe mbi to do të digjeshin të gjallë Kristianët Protestantë. U vendos që një krahu shkarpash t'u vihej zjarri me t'u afruar mbreti dhe që procesioni të ndalonte për ta parë me sy ekzekutimin." - Wylie,b.13;k.21.

Detajet e torturave që duruan këta dëshmitarë të Krishtit janë tepër të mundimshme për t'u rrëfyer, por viktimat nuk u tutën. Ndërsa e nxitnin të hiqte dorë nga besimi i tij, njëri prej tyre iu përgjigj: "Unë besoj vetëm në atë që predikuan dikur profetët dhe apostujt dhe në atë që besuan të gjithë shenjtorët. Feja ime mbështetet tek besimi në Zot, prandaj do t'i rezistojë të gjitha fuqive të ferrit." - D'Aubigne, Historia e Reformacionit në Evropë gjatë kohës së Kalvinit,b.4;k.12.

Aty - këtu procesioni ndalonte në vendet e torturës. Turma u shpërnda dhe oborrtarët bashkë me mbretin me të arritur në pikënisje, në pallatin mbretëror u shkëputën prej tyre, më se të kënaqur me ngjarjet e ditës dhe krenarë që puna e saponisur do të vazhdohej deri në shkatërrimin e plotë të herezisë.

Lajmi i mirë i paqes që Franca e pati mohuar do të nxirrej përsëri mbisipërfaqe dhe përfundimet do të ishin të tmerrshme. Më 21 Janar të vitit 1793, vetëm 258 vjet pas ditës që e hodhi Francën plotësisht në anën e persekutimit të Reformatorëve, një procesion tjetër do të përshkonte rrugët e Parisit, duke mbarsur mbi vete një qëllim krejtësisht të ndryshëm. "Mbreti ishte përsëri figurë kryesore, kishte përsëri trazira dhe britma, u dëgjua përsëri thirrja për viktima të tjera, podiumet e zeza u ngritën përsëri. Dita u mbyll përsëri me ekzekutime të llahtarshme. Luigji i 16-të, duke i rezistuar gardianëve dhe persekutorëve të tij, u soll zvarrë deri tek gijotina dhe atje u mbajt me forcë deri sa u shkëput sëpata dhe koka e tij e këputur u rrotullua mbi podium." - Wylie,b.13;k.21.

Mbreti nuk ishte e vetmja viktimë, afër të njëjtit vend u zhdukën nga gijotina 2800 njerëz gjatë ditëve të përgjakura të Mbretërimit të Terrorit.

Reformacioni kishte shpalosur përpara botës Biblën e hapur, kishte zhvulosur parimet e ligjit të Zotit, duke i drejtuar kërkesat e tij mbi ndërgjegjet njerëzore. Dashuria e Pafundme kishte shfaqur përpara njerëzimit vendimet gjyqësore dhe parimet e qiellit. Zoti kishte thënë: "Ruajini dhe ndiqini...Për këtë ju do të jeni të njohur ndër të gjitha kombet, sepse kur kombet e tjera do të dëgjojnë që ju jetoni sipas këtyre ligjeve, ata do t'ju nderojnë dhe do të thonë: "Sa i mençur dhe i arsyeshëm është ky popull i madh!" - Besëlidhja e Përtërirë 4:4

Franca me të mohuar dhuratën e qiellit mbolli farën e anarkisë dhe shkatërrimit dhe rrjedhojat e pashmangshme të kauzës dhe efektit të saj rezultuan në Revolucionin Francez dhe në Mbretërimin e Terrorit.

Fareli i guximshëm dhe i zellshëm ishte detyruar, shumë kohë më parë se persekutimi të nxitej edhe më nga pllakatet, të largohej nga vendlindja. Ai u vendos në Zvicër, ku nëpërmjet punës së tij përkrahu iniciativën e Zwinglit dhe ndihmoi në arritjen e rezultateve në favor të Reformacionit.

Ai i kaloi vitet e fundit të jetës këtu, por ai vazhdonte të ndikonte ndjeshëm reformën në Francë. Gjatë viteve të para në mërgim, përpjekjet e tij u drejtuan veçanërisht në përhapjen e Lajmit të Mirë në vendin e tij. Ai kaloi një periudhë kohe të konsiderueshme, duke u predikuar fshatarëve afër kufirit, nga ku ai vëzhgonte konfliktin dhe ndihmonte me fjalë inkurajuese dhe këshilla.

Shkrimet e Reformatorëve Gjermanë u përkthyen në frëngjisht me ndihmën edhe të mërgimtarëve të tjerë dhe bashkë me Biblën në gjuhën frënge u shtypën në tirazh të madh.

Këto përkthime u shitën në të gjithë Francën me ndihmën e postierëve malorë. Ato u jepeshin postierëve me çmim të ulët dhe fitimi i punës iu jepte mundësi që ta vazhdonin atë.

Fareli filloi punën e tij në Zvicër në rolin e përulur të një mësuesi shkolle. Duke shkuar shpesh në një famulli të veçuar, ai iu përkushtua edukimit të fëmijëve. Përveç

metodave të zakonshme të mësimdhënies, ai me kujdes u prezantoi atyre të vërtetat e Biblës, duke shpresuar se nëpërmjet fëmijëve do të arrinte deri tek prindërit. Disa besuan, por priftërinjtë me shpatë në dorë deshën ta ndalonin punën e nisur dhe banorët supersticioze të fshatit u ngritën në këmbë kundër tij. S'mund të jetë Ungjilli i Krishtit, predikimi i të cilit sjell vetëm luftë e jo paqe - thoshin priftërinjtë. -Wylie, b.14;k.3.

Si nxënësit (dishepujt) e parë, kur persekutohej në një qytet, ai largohej për tek tjetri. Ai udhëtonte në këmbë nga fshati në fshat, nga qyteti në qytet, duke përballuar urinë, të ftohtin, lodhjen dhe duke e vënë kudo jetën e tij në rrezik. Ai predikonte në vende shit - blerjeje, në kisha e ndonjëherë në podiumet e katedraleve. 5YNdonjëherë në kishë nuk kishte asnjë dëgjues, ndonjëherë shërbesa ndërpritej nga britma e tallje dhe atë e rrëzonin dhunshëm nga podiumi. Disa herë turma e vinte përpara dhe e rrihte për vdekje. Ai akoma përparonte. Edhe pse shpesh zbrapsej, me këmbëngulje të admirueshme ai i kthehej përsëri sulmit, kështu ai vuri re se si njëri pas tjetrit qytete të mëdha e të vogla, që dikur ishin nën kthetrat e papatit, tani po ia hapnin dyert Lajmit të Mirë. Famullia e vogël në të cilën ai vetë kishte punuar, e pranoi besimin e reformuar. Edhe qytetet e Moratit dhe Neuchatelit hoqën dorë nga ritet romane dhe i pastruan kishat e tyre nga imazhet idhujtare.

Fareli kishte dashur me gjithë shpirt të mbillte farën e Protestanizmit edhe në Gjenevë. Sikur të fitohej një qytet i tillë, ai do të bëhej më pasqëndra e Reformacionit francez, zviceran dhe italian. Duke pasur një synim të tillë përpara, ai kishte vazhduar përpjekjet derisa qytetet dhe fshatrat e vogla përreth i kishin përqafuar idetë e reja. Së fundi, bashkë me një shok ai hyri në Gjenevë. Iu lejua predikimi vetëm i dy shërbesave. Priftërinjtë, të cilët më kot ishin përpjekur të siguronin dënimin e tij nga autoritetet civile, e thirrën atë para një këshilli kishtar, në të cilin ata vetë u paraqitën me armë të fshehura poshtë veladonëve të tyre, të vendosur për të vrarë. Jashtë sallës ishte mbledhur një turmë njerëzish të inatosur, me shkopinj e shpata në duar, për ta vrarë Farelin në rast se ai do t'i shpëtonte këshillit. Por prania e magjistratëve dhe e forcave të armatosura e shpëtoi atë. Të nesërmen në mëngjes ai së bashku me shokun e tij doli në anën tjetër të liqenit, në një vend të sigurt. Kështu përfundoi përpjekja e tij e parë për të evangjelizuar në Gjenevë.

Për të kryer një provë të dytë u zgjodh një instrument i një rangu më të ulët, një i ri, me një pamje shumë të përulur, sa trajtohej ftohtë edhe nga vetë miqtë öYe njohur të reformës. Çfarë mund të bënte një njeri i tillë, atje ku Farelin e mohuan? Si mund ta përballonte furtunën, së cilës i ishin shmangur më të fortët e më të guximshmit, një njeri me kaq pak guxim dhe eksperiencë.

"Nuk do të kesh sukses me fuqi dhe forcë njerëzore, por me shpirtin tim! Këtë e them unë Zoti i gjithëfuqishëm!" - Zeharja 4:6. Zoti pati zgjedhur të pafuqishmen e botës për të përballuar të fuqishmen. "Perëndia vepron, siç duket në kundërsh-

tim me "urtësinë e botës" e megjithatë është më i urtë se të gjithë njerëzit. Perëndia tregohet "i dobët" e megjithatë është më i fuqishëm se të gjithë njerëzit." - 1 Korin.1:25,27.

Fromenti e filloi punën si mësues shkolle. Fëmijët përsëritnin në shtëpi të vërtetat që ai ua mësonte në shkollë. Nuk kaloi shumë kohë dhe prindërit erdhën për të dëgjuar shpjegimin e Biblës deri sa klasa u mbush plot me dëgjues të vëmendshëm. Dhiata të Reja dhe broshura u shpërndanë falas dhe ato arritën deri tek ata që nuk patën guxuar t'i dëgjonin haptazi doktrinat e reja. Pas një farë kohe edhe ai u detyrua të largohej, por mësimet e tij mbi të vërtetat ishin ngulitur në mendjet e njerëzve. Reformacioni kishte hedhur rrënjë dhe vazhdoi të forcohej e të zgjerohej. Predikues të ndryshëm u kthyen dhe së fundi adhurimi Protestant u vendos edhe në Gjenevë.

"Qyteti tashmë ishte deklaruar pro Reformacionit, kur Calvin pas një numri të madh ecejakesh dhe peripecish hyri në portat e tij. I kthyer nga vizita e fundit që kishte bërë në vendlindje, ai ishte drejtuar për në Bazel. Duke parë se rruga kryesore ishte bllokuar nga ushtrite e Karlit të V, ai u detyrua të ndiqte rrugën e tërthortë që kalonte nga Gjeneva.

Fareli ndjeu në këtë vizitë dorën e Zotit. Edhe pse QYGjeneva e kishte pranuar besimin e reformuar përsëri duhej punuar akoma shumë. Njerëzit shndërrohen dhe e pranojnë Zotin si individë dhe jo si bashkësi (komunitet), puna për regjenerim bëhet brenda zemrës dhe ndërgjegjes nga Shpirti i Shenjtë dhe jo nga dekretet e këshillave. Ndërsa gjenovezet e kishin flakur tej autoritetin e Romës ata nuk ishin gati të hiqnin dorë nga të këqijat që kishin marrë jetë nën rregullin e tij. Vendosja e parimeve të pastra të Ungjillit dhe përgatitja e njerëzve që të mbanin me dinjitet pozicionin tek i cili po i drejtonte Zoti, nuk ishin detyra të lehta.

Fareli ishte i bindur se Calvini ishte personi i duhur për t'u bashkuar me punën e tij. Ai i kërkoi evangjelistit të ri me ngulm dhe solemnisht në emër të Zotit që të qëndronte dhe të punonte atje. Calvini u tërhoq i alarmuar.

Duke qënë i ndruajtur dhe paqedashës ai dridhej nga kontakti me shpirtin e qëndrueshëm, të pavarur e madje edhe të egër gjenovez.

Shëndeti i dobët dhe jeta e mundimshme bënë që ai të kërkonte të tërhiqej. Duke qënë i bindur se ai mund t'i shërbente më mirë kësaj kauze me penë, ai dëshironte të gjente një vend të qetë për studim dhe atje, nëpërmjet shtypit të instruktonte e të ndihmonte në ngritjen e kishave. Por paralajmërimi solemn i Farelit i erdhi si thirrje nga Qielli dhe ai nuk guxoi të refuzonte. Ai tha se iu duk sikur "dora e Zotit u zgjat që nga qielli dhe e mbërtheu, duke e vendosur përfundimisht pikërisht në vendin nga i cili ai mezi priste të largohej." - D'Aubigne, Historia e Reformacionit në Evropë gjatë kohës së Calvinit, b.6;k.17.

Gjatë kësaj kohe Kauzën e Protestanizmit e kërcënonin rreziqe të mëdha. Mbi Gjeneve gjëmonin mallkimet e Papës dhe kombet e fuqishme e kërcënonin atë me

shkatërrim. Si JYmund t'i bënte ballë ky qytet i vogel hierkarkisë së fuqishme, që i kishte detyruar kaq shpesh mbretërit dhe perandorët tëdorëzoheshin? Si mund t'i rezistonte ushtrive të pushtuesve më të mëdhenj botërore?

Në të gjitha vendet kristiane, Protestanizmi sulmohej nga armiq të fuqishëm. Pas triumfeve të para të Reformacionit Roma mblodhi forca të reja, duke shpresuar në shkatërrimin e tij. Gjatë kësaj kohe u krijua Urdhëri i Jezuiteve, kampioni më mizor, i paskrupull dhe i fuqishëm i papatit. Të shkëputur tërësisht nga lidhjet tokësore dhe interesat njerëzore, të pandjeshëm ndaj dashurisë natyrore dhe të shurdhët ndaj arsyes dhe ndërgjegjes, ata nuk njihnin asnjë rregull apo lidhje përveç atyre të Urdhërit të tyre dhe s'kishin detyrë tjetër përveç zgjerimit të fuqisë së tij.

Ungjilli i Krishtit i kishte armatosur përkrahësit e tij për ta përballuar rrezikun dhe vuajtjen të patrembur nga i ftohti, uria, puna dhe varfëria, me qëllim që të ngrinin lart flamurin e të vërtetës dhe përpara torturave, burgimeve dhe turrave të druve.

Me qëllim që të luftonte kundër ketyre forcave, Jezuizmi i frymëzonte ndjekësit e tij me fanatizëm, i cili u jepte atyre mundësinë për të përballuar të njëjtat rreziqe dhe për të kundërshtuar fuqinë e së vërtetës me armët e mashtrimit. Ata mund të kryenin çdo lloj krimi, sado i tmerrshëm të ishte ai, mund të përdornin çdo lloj mashtrimi sado i ulët të ishte ai dhe mund të merrnin përsipër çdo lloj maske sado e vështirë të ishte ajo. Devocioni në rrëzimin e Protestanizmit, rivendosja e epërsisë së papatit dhe sigurimi i pasurisë dhe fuqisë ishin qëllimit e tyre të mirëpeshuara edhe pse qenë betuar për varfëri dhe përulje të përjetshme. Sa herë që paraqiteshin si anëtarë të këtij Urdhëri ata vishnin rrobën e shenjtërimit, ndërsa vizitonin spitalet dhe 7Yburgjet, duke u kujdesur për të sëmurët dhe të varfërit, ndërsa deklaronin se kishin hequr dorë nga kjo botë dhe mbanin emrin e shenjtë të Jezusit, i cili bëri vetëm mirë. Por nën këtë mbulesë të jashtme të pafajshme shpesh fshiheshin qëllimet më të tmerrshme dhe kriminale.

Parimi kryesor i Urdhërit ishte: "Qëllimi justifikon mjetin." Sipas këtij kodi gënjeshtra, vjedhja, dëshmia e rreme, vrasja jo vetëm faleshin, por ishin akte të lavdërueshme kur i shërbenin interesave të kishës. Me manipulime të ndryshme Jezuitët arritën të depërtonin deri në zyrat e shtetit, ata u ngjitën deri tek këshilltarët e mbretërve dhe i dhanë formë politikës së kombeve. Ata u bënë shërbëtorë që të luanin rolin e spiunëve ndaj zotërinjve të tyre. Ata ngritën kolegje për fëmijët e princëve dhe fisnikëve dhe shkolla për njerëzit e thjeshtë. Kështu fëmijët e prindërve Protestantë u tërhoqën në brendësi të respektimit të riteve te papës. I gjithë demonstrimi dhe madhështia e jashtme e adhurimit roman solli konfuzion në mendje, verboi dhe robëroi imagjinatën e kështu liria për të cilin kishin punuar e derdhur gjak baballarët u tradhtua nga bijtë. Jezuitët u përhapën me shpejtësi në mbarë Evropën e kudo që shkuan u ndje ringjallja e papatit.

Për t'u dhënë atyre akoma më shumë pushtet, Papa nxorri një urdhër për rivendosjen e inkuizicionit. Pavarësisht nga neveria e përgjithshme me të cilën shihej, madje edhe në vendet katolike, ky trup gjykues përbëhej nga udhëheqës - përkrahës të Papës dhe mizoritë e tij aq të tmerrshme sa nuk mund t'i bënin ballë dritës së diellit, u përsëritën në birucat sekrete. Në shumë vende, mijëra e mijëra njerëz nga ajka e kombit, më të ndershmit dhe më fisnikët, më intelektualët dhe më të edukuarit, që nga pastorët e zellshëm dhe të devotshëm, qytetarët punëtorë e patriotë, intelektualët e shkëlqyer, artistët e talentuar e deri tek artizanët duarartë u vranë apo u 3Ydetyruan të largohen për në vende të tjera.

Të tilla ishin masat e ndërmarra nga Roma për të shuar dritën e Reformacionit, për t'ua hequr Biblën nga duart njerëzve dhe për të rivendosur injorancën dhe supersticionin e mesjetës (shekujve të errët). Por Protestanizmi nuk u shkatërrua falë bekimit të Zotit dhe punës së këtyre njerëzve fisnikë, që Ai i kishte thirrur për të zëvendësuar Luterin. Fuqinë e tij, Protestanizmi nuk ia kishte borxh as armëve dhe as simpatisë së princëve. Shtetet më të vogla, kombet më të përulura e më të pafuqishme u bënë pikat e tij të forta. Ishte Gjeneva e vogël mes armiqve të fuqishëm, që komplotonin për shkatërrimin e saj. Hollanda në brigjet me rërë të Detit të Veriut, që luftonte kundër tiranisë së Spanjës, e cila gjatë asaj kohe ishte një nga mbretërit më të fuqishme e më të pasura, Suedia e ftohtë dhe e varfër, që korrën fitore për Reformacionin.

Calvini punoi në Gjenevë pothuajse për 30 vjet. Së pari për të krijuar atje një kishë besnike ndaj moralit të Biblës dhe së dyti për ta përhapur Protestanizmin në gjithë Evropën. Rruga e tij si udhëheqës masash nuk ishte pa gabime dhe as doktrinat e tij të përsosura. Por ai ishte instrument nëshpalljen e të vërtetave, që kishin gjatë asaj kohe një rëndësi të veçantë në ruajtjen e parimeve të Protestanizmit kundër rrymës marramendëse të papatit dhe në përkrahjen e thjeshtësisë dhe pastërtisë jetësore në kishat e reformuara; këto në vend të krenarisë dhe korrupsionit që kishin marrë jetë nën mësimet e Romës.

Nga Gjeneva dolën mësues dhe botime, që përhapën doktrinat e reformuara më tej. Puna kishte arritur në pikën ku të persekutuarit e çdo vendi kërkonin udhëzim, këshillë dhe inkurajim. Qyteti i Calvinit u bë vendstrehim për të gjithë Reformatorët, që ndiqeshin të Evropës Perëndimore. Të ikurit, të larguar nga furtunat e ÛYtmershme, që vazhduan me shekuj, vinin në dyert e Gjenevës. Të uritur, të plagosur, të pastrehë dhe të vetëm ata gjenin këtu ngrohtësinë e mikpritjes dhe kujdesit. Këtu ata gjenin strehë dhe e bekonin qytetin e adoptuar me aftësinë, njohurinë dhe mëshirën e tyre. Shumë nga ata që u strehuan këtu u kthyen më pas në vendet e tyre për t'i rezistuar tiranisë së Romës. John Knox, Reformatori i guximshëm skocez, një numër jo i vogël i puritanëve anglezë, Protestantët e Hollandës dhe Spanjës dhe Huguenots e Francës morën nga Gjeneva pishtarin e së vërtetës për të ndriçuar me të errësirën e vendeve të tyre.

1. Rishikoni edhe njëherë konvertimin e Xhon Kalvinit. Si ndikoi eksperienca e tij në reformat që ndërmori?

2. A e avancuan sulmet radikale nga ekstremistët në Francë Reformën, apo e frenuan atë? Përse?

3. Franca e shtypi me forcë Reformimin. Cilat ishin rezultatet kombëtare?

4. Klavini u përdor nga Perëndia edhe pse doktrinat dhe teologjia e tij kishin të meta. Si ju ka përdorur Perëndia juve apo dikë që ju njihni, pavarësisht të metave personale dhe teologjike?

13.

Hollanda dhe Skandinavia

Ne vendet e uleta shume shpejt tirania e papatit solli si rezultat protesta te fuqishme. 700 vjet perpara epokes se Luterit dy peshkope qe ishin derguar ne nje mision ne Rome dhe kishin mesuar atje karakterin e vertete te "juridiksionit hyjnor" akuzuan papen roman: "Zoti ka krijuar mbretereshen dhe gruan e Tij, kishen, si dhe nje furnizim fisnik dhe te perjetshem per familjen e saj; me nje prike sa te lulezuar aq dhe te pakorruptueshme dhe i ka dhene asaj nje kurore dhe spekter mbreteror te perjetshem... gjithçka qe te ndalon te perfitosh si hajdut. Ti u vetvendose ne tempullin e Zotit e ne vend qe te beheshe bari u ktheve ne ujk per delet... ti do te doje qe ne te te besonim qe je nje peshkop suprem, nderkohe qe ti sillesh si tiran...Ndersa duhet qe te ishe sherbetor i sherbetoreve, si e quan veten, ti perpiqesh qe te behesh mbret i mbreterve...Ti i perçmon urdheresat e Zotit...Shpirti i Shenjte eshte ndertuesi i te gjitha kishave permbi toke...Qyteti i Zotit tone, qytetare te te cilit jemi edhe ne shtrihet ne te gjitha sferat e qiellit dhe eshte me madheshtor nga qyteti qe profetet e quajten Babilon, qe pretendonte te ishte hyjnor, qe sfidoi qiellin dhe mburrej me zgjuaresine e tij te pavdekshme; Se fundi ra pa shkak, sepse ai kurre nuk gaboi dhe s'mund te gaboje me kurre"- Gerard Brandt, Historia e Reformacionit ne Vendet e Uleta dhe perreth tyre, b.1;p.6

Shekull pas shekulli te tjere e ngriten zerin ne mbrojtje te kesaj proteste. Mesuesit e hershem, qe udhetonin ne vende te ndryshme e njiheshin me emra te ndryshem reflektonin karakterin e misionareve. Vaudoiste*, duke perhapur kudo Lajmin e Mire depertuan edhe ne vendet e uleta. Doktrinat e tyre u perhapen me shpejtesi. Ata perkthyen ne versa Biblen Waldensiane** ne hollandisht.. Ata deklaruan se nga kjo kishte shume perfitim, pa tallje, pa perralla, pa çikerrima, pa mashtrime, por me fjalet e se vertetes; qe edhe pse aty - ketu kishte ndonje kore te ashper ne te mund te zbuteshin lehtesisht thelbi dhe embelsia e asaj qe eshte e mire dhe e shenjte." - Ibid,b. 1;p.14. Keshtu shkruanin miqte e besimit te hershem ne shekullin e 12-te.

* Waldeses - mes perkthyesve te pare te Bibles. Mbrojtes te Sabatit

** Transsubstacioni - doktrine fetare, sipas se ciles vera dhe buka e ndorme perfaqesojne trupin dhe gjakun e Krishtit

Filluan tashme persekutimet e Romes, por mes turrave te druve dhe tortures, besimtaret vazhduan te shtoheshin, duke deklaruar te patundur se Bibla eshte autoriteti i vetem i pagabueshem ne fe dhe se "askush nuk duhet te detyrohet te besoje, por duhet te bindet me predikim."- Martyn,b.2;p.87

Mesimet e Luterit kishin te njejten natyre me shpirtin e paepur te banoreve te ketyre vendeve dhe prej tyre dolen njerez te vendosur e besnike per te predikuar Lajmin e Mire. Menno Simons doli nga njera prej provincave hollandeze. Duke qene i edukuar si katolik romak dhe i perkushtuar per t'u bere prift, Bibla ishte krejt e huaj per te dhe ai nuk mund ta lexonte nga frika se do te mashtrohej dhe kjo do ta çonte ne herezi.

Kur dyshimet mbi doktrinen e transsubstacionit* nuk e linin te qete, ai i konsideronte ato si tundime nga Satani dhe perpiqej kaq shume qe te çlirohej prej tyre me ane te lutjes dhe rrefimit, por me kot. Ai perpiqej te mos ia vinte veshin zerit akuzues te ndergjegjes, duke u marre me çikerrima e gjera te parendesishme, por pa dobi. Pas nje fare kohe ai filloi studimin e Dhiates se Re dhe kjo bashke me shkrimet e Luterit bene qe ai te pranonte besimin e reformuar. Ne nje fshat aty afer menjehere pas kesaj ai pa me syte e tij ekzekutimin e vendimit me vdekje ne gijotine te nje njeriu qe ishte ripagezuar. Ky fakt e beri qe te studionte Biblen, persa i perkiste pagezimit te femijeve. Ai nuk gjeti asnje prove apo deshmi per te ne Shkrimin e Shenjte, por vuri re se kudo dy ishin kushtet e kerkuara per t'u pagezuar: pendimi dhe besimi.

Menno hoqi dore nga kisha romane dhe ia kushtoi jeten e tij mesimit te te vertetave qe kishte zbuluar. Si ne Gjermani edhe ne Vendet e Uleta ishte krijuar nje klase fanatikesh, te cilet perkrahnin doktrina te dhunshme dhe absurde, cenonin rende rregullin dhe dinjitetin dhe parapelqenin dhunen dhe revolten. Menno vuri re se keto levizje do te çonin ne menyre te pashmangshme drej rezultateve te tmerrshme, prandaj ai i kundershtoi energjikisht keto mesime te gabuara si dhe skemat e papeshuara mire te fanatikeve. Sidoqofteshume vete qe me pare kishin qene te çorientuar nga fanatiket, shume shpejt i braktisen keto doktrina shkaterrimtare e keshtu kishte akoma shume pasardhes te te krishtereve te hershem, qe ishin fryte te mesimit Waldesian.

Menno punoi me zell te madh pikerisht ne gjirin e ketyre klasave dhe doli me sukses. Ai udhetoi se bashku me gruan dhe femijet e tij per 25 vjet, duke mbajtur mbi supe veshtiresi dhe mungesa te medha dhe duke e vene shpesh here jeten e tij ne rrezik. Ai udhetoi ne Vendet e Uleta dhe ne Gjermanine Veriore, duke punuar kryesisht me klasat me te perulura te shoqerise, por duke ushtruar nje ndikim te madh. Elokuent nga natyra edhe pse me nje shkollim te kufizuar ai ishte nje njeri i ndershem, me shpirt te perulur, sjellje fisnike dhe i prirur sinqerisht per te meshiruar, keshtu, duke vene ne jete parimet qe u mesonte te tjereve, ai fitoi besi-

min e njerezve. Ndjekesit e tij ishin te shperndare dhe shtypeshin. Ata vuanin nga urrejtja qe Munsteritet fanatike ushqenin per ta. E megjithate nje numer i madh njerezish u shnderruan si rezultat i punes se tij.

Ne Vendet e Uleta doktrinat e reformuara u mirepriten ne nje shkalle me te gjere se ne vendet e tjera. Perkrahesit e tyre ketu perballuan nje persekutim te tmerrshem qe vetem pak vende te tjera e kishin pare. Karli i

V-te ne Gjermani e nxorri Reformacionin jashte ligjit dhe me gezim te madh do t'i kishte shkuar ne hu te gjithe perkrahesit e tij, por ishin princet ata qe u ngriten si barriere kunder tiranise se tij.

Pushteti i tij ishte akoma dhe me i madh ne Vendet e Uleta dhe dekretet e persekutimit ndoqen shpejt njera - tjetren. Te lexoje Biblen, ta degjoje ose ta predikoje ate e madje edhe te flisje per te do te thoshte te denoheshe me vdekje ne turren e druve. T'i luteshe Zotit fshehtas, te kendoje nje psalm ishte perseri diçka qe denohej me vdekje. Madje edhe ata qe betoheshin publikisht dhe ne menyre solemne se do te hiqnin dore nga gabimet e tyre denoheshin, burrat vriteshin me shpate, ndersa grate digjeshin te gjalla. Me mijera njerez u zhduken gjate mbreterimit te Karlit dhe Filipit te Dyte.

Nje here u akuzua perpara inkuizitoreve nje familje e tere, sepse ata nuk mernin pjese ne meshe dhe adhuronin ne shtepi. Ndersa po merreshin ne pyetje mbi lutjen e tyre ne fshehtesi te plote, djali me i vogel u pergjigj: "Ne gjunjezohemi dhe i lutemi Zotit qe te na ndriçoje mendjet dhe te ne fale mekatet, lutemi per sovranin tone, qe mbreterimi i tij te perparoje dhe ai te jetoje i lumtur; ne lutemi per magjistratet, qe Zoti t'i ruaje ata."

- Wylie,b.18,k.6. Edhe pse disa nga gjykatesit u preken thellesisht, babai dhe nje nga djemte e tij u denuan me vdekje mbi turren e druve.

Besimi i martireve barazonte terbimin e persekutoreve. Jo vetem burrat por edhe grate e brishta e vajzat e reja u treguan sypatrembura dhe te guximshme. "Grate qendronin prane turres se druve ku po digjej burri i tyre e ndersa ai duronte flaket e zjarrit, ato peshperisnin fjale ngushelluese apo kendonin psalme per ta inkurajuar ate. Vajzat e reja do te shtriheshin ne varre sikur po hynin ne dhomat e tyre per te fjetur naten, apo do te shkonin drejt zjarrit ose trekembeshit, te veshura me petkat me te bukura, si te ishte dita e dasmes se tyre." _ Ibid,b.18;k.6.

Gjaku i te krishtereve u derdh perseri, tamam si ne kohen kur paganizmi perpiqej te shkaterronte Ungjillin. (Te shihet Ndjesa,Tertullian parag. 50). Ishte persekutimi ai qe e rriti numrin e deshmitareve te se vertetes.

Keshtu vit pas viti, monarku i çuditur deri ne çmenduri nga vendosmeria e paarritshme e njerezve vazhdonte punen e tij mizore, por me kot. Se fundi Revolucioni i udhehequr nga fisniku William i Orinxhit i solli Hollandes lirine e adhurimit te Zotit.

Ne malet e Piedmontit, ne rrafshinat e Frances dhe ne brigjet e Hollandes, perhapja e Lajmit te Mire u vulos me gjakun e nxenesve te tij. Por ai hyri paqesisht ne Vendet e Veriut. Studentet e Wittenbergut, ndersa ktheheshin ne shtepite e tyre, sollen ne Skandinavi (Vendet skandinave) besimin e reformuar. Botimi i shkrimeve te Luterit ndihmoi gjithashtu ne perhapjen e kesaj drite. Njerezit e thjeshte dhe te guximshem te veriut i kthyen kurrizin korrupsionit, salltaneteve dhe superstic-ioneve te Romes, duke mirepritur pastertine, thjeshtesine dhe te vertetat jetedhenese te Bibles.

Tauseni, "Reformatori i Danimarkes" ishte biri i nje fshatari. Shume shpejt ai dha prova te nje intelekti energjik, ai ishte i etur per shkollim,por kjo iu mohua nga gjendja ekonomike e prinderve te tij e keshtu ai hyri ne nje manastir. Ai fitoi simpatine e kryemurgut me ane te pastertise se jetes se tij, kjo bashke me zellin dhe besnikerine e tij. Provimi tregoi se ai zoteronte nje talent premtues per t'u perdorur ne sherbim te kishes ne te ardhmen. U vendos qe ai t'i vazhdonte studimet ne njerin nga universitetet e

Gjermanise apo te Vendeve te Uleta. Studentit te ri iu dha mundesia qe ta zgjidhte vete shkollen, me nje kusht, qe ai te mos shkonte ne Wittenberg. Shkollari i kishes nuk duhej te rrezikohej nga helmi i herezise. Keshtu thane edhe murgjit.

Tausen shkoi ne Cologne, e cila ishte gjate asaj kohe, nje pike kyçe e romanizmit. Ai e perçmoi ketu shume shpejt misticizmin e te diturve. Pothuajse ne te njejten kohe atij i rane ne duar shkrimet e Luterit. Ai i lexoi ato me çudi dhe gezim, duke gjetur kenaqesi personale nga udhezimi i Reformatorit. Po ta bente kete ai rrezikonte te ofendonte kryemurgun e manastirit te tij dhe te humbte keshtu mbeshtetjen e tij. Ai mori nje vendim dhe pa kaluar shume kohe ai u rregjistrua si student ne Wittenberg.

Me t'u kthyer ne Danimarke, ai erdhi perseri ne manastirin e tij. Askush nuk dyshonte deri ne ate moment qe ai ishte perkrahes i Luterit, ai nuk e zbuloi sekretin e tij, por u perpoq t'i udhehiqte shoket e tij pa ngacmuar paragjykimet e tyre, drejt nje besimi me te paster e nje jete me te shenjte. Ai hapi Biblen, shpjegoi kuptimin e saj te vertete dhe se fundi predikoi per Krishtin si vete drejtesia e mekatarit dhe si e vetmja shprese per shpetim. Kryemurgu qe kishte shpresuar shume se ai do te behej nje mbrojtes i guximshem i Romes u indinjua thellesisht. Ate e larguan menjehere nga manastiri i tij tek nje tjeter dhe e izoluan ne qeline e tij nen nje mbikqyrje te rrepte.

Gardianet e tij vune re me tmerr se shume shpejt disa nga murgjit u deklaruan si perkrahes te Protestanizmit. Tauseni ua kishte komunikuar shokeve te tij dijen e se vertetes nepermjet hekurave te qelise se tij. Sikur keta eter daneze te ishin te stervitur per t'u marre me herezi, zeri i Tausenit nuk do te ishte degjuar kurre, por ne vend qe t'ia besonin ndonje qelie ne ndonje burg te nendheshem ata vetem e

perjashtuan nga manastiri. Tani ata ishin te pafuqishem. Mesuesit e doktrinave te reja mbroheshin nga nje dekret mbreteror, qe sapo ishte aprovuar. Tauseni filloi te predikonte. Kishat ishin te hapura per te dhe turma te medha njerezish vinin per ta degjuar. Fjala e Zotit predikohej edhe nga te tjere. Dhiata e Re filloi te perhapej gjeresisht me t'u perkthyer ne danisht. Perpjekjet e perkrahesve te papes per te shkaterruar punen e bere rezultuan negative dhe pas pak kohe Danimarka deklaroi pranimin e besimit te reformuar.

Y Gjithashtu te rinjte suedeze, qe paten pire nga pusi i Wittenbergut, ua sollen shtetasve te tyre ujin e jetes. Dy nga udheheqesit e reformacionit suedez Olaf dhe Laurentius Petri, djemte e nje farketari, paten mesuar nga Luteri dhe Melanktoni dhe ishin te gatshem t'u mesonin te tjereve te vertetat qe dinin. Olaf i ngrinte ne kembe njerezit si Reformatori i madh me ane te zellit dhe elokuences se tij, ndersa Luarentius ishte i ditur, i mençur dhe i qete tamam si Melanktoni. Te dy ishin te zjarrte e meshireplote, me njohuri te gjera teologjike, sypatrembur e te guximshem ne perhapjen e se vertetes. Kundershtimi i Papes nuk mungonte.

Prifterinjte katolike ndikuan tek njerezit injorante dhe supersticioze. Olaf Petri u sulmua shpesh here nga turma dhe ne disa raste mezi shpetoi koken. Megjithate keta reformatore kishin fituar simpatine e mbretit dhe mbroheshin prej tij.

Nen autoritetin e kishes romane njerezit u zhyten ne varferi dhe u kerrusen nga pesha e shtypjes. Ata kishin nevoje per Shkrimet e Shenjta, por duke zoteruar nje fe qe perbehej thjesht nga shenja dhe ceremoni dhe qe nuk ia perçonte driten mendjes ata iu rikthyen besimeve supersticioze dhe praktikave pagane te paraardhesve te tyre barbare. Kombi u nda ne fraksione armike, grindja e vazhdueshme e shtoi akoma me shume mjerimin e te gjitheve. Mbreti i vendosur ne reformimin e shtetit dhe te kishes i mirepriti te gjithe keta ndihmesa te afte ne betejen kunder Romes.

Olaf Petri ne prani te monarkut dhe udheheqesve suedeze mbrojti me nje aftesi te papare doktrinat e besimit te reformuar kunder kampioneve te Romes. Ai deklaroi se mesimet e Eterve duhen pranuar vetem atehere kur perputhen meato te Shkrimeve te Shenjta, se doktrinat ÜYthemelore te besimit gjenden te shprehura ne menyre te thjeshte dhe te qarte ne Bibel, keshtu qe te gjithe njerezit mund t'i kuptojne ato. Krishti vete tha: "Kur Une nxjerr nje vendim gjyqesor ai eshte i drejte, sepse Une nuk jam i vetem ne kete pune. Ati qe me dergoi eshte me mua." (Gjoni 7:16). Pali deklaroi se do te mallkohej po te predikonte ndonje lajm te mire tjeter ne kundershtim me ate qe kishte pranuar. (Galacia 1:8). "Atehere - tha Reformatori, - si mund ta marrin te tjeret guximin per te ligjeruar dogma fetare sipas qejfit te tyre dhe per t'i imponuar ato si gjera te nevojshme per shpetim." - Wylie, b.10;k.4. Ai tregoi edhe nje here se dekretet e kishes jane te pavlefshme kur kundershtojne Urdheresat e Zotit dhe ngriti lart parimin e madh protestan se "Bibla dhe vetem Bibla" eshte rregulla e besimit dhe praktikes.

Kjo grindje edhe pse zhvillohej ne nje skene relativisht te erret sherben per te na treguar ne "se cilet ishin ata njerez qe mbushnin radhet e ushtrise se Reformatoreve. Ata nuk ishin analfabete, sektare apo grindavece, perkundrazi ata ishin njerez qe e kishin studiuar fjalen e Zotit dhe dinin t'i perdornin mire armet qe u ofronte armatura e Bibles. Ata kishin ecur shume perpara epokes se tyre persa i perkiste erudicionit (njohurive, dijeve te thella).

Kur e perqendrojme vemendjen ne qendra te tilla madheshtore si Witenbergu dhe Zyrihu dhe ne emra te tille te shquar si Luteri dhe Melanktoni, Zwingli dhe Oekolampadiusi na thuhet se ata ishin udheheqesit e kesaj levizjeje e ne natyrisht presim qe ata te kene nje fuqi shume te madhe dhe arritje te gjera, por varesit nuk ishin te tille. Keshtu i kthehemi theatrit te humbur te Suedise dhe emrave te thjeshte te Olaf dhe Laurentius Petrit -nga mesuesit tek nxenesit - çfare gjejme?... Dijetare dhe teologe, njerez qe pervetesuan thellesisht e teresisht te verteten e Ungjillit dhe qe korren fitore lehtas mÛYbi sofistet e shkollave dhe personalitetet e Romes." - Ibid,b.10;k.4.

Ky debat solli si rezultat pranimin e besimit protestant nga mbreti i Suedise e pa kaluar shume kohe edhe Asambleja Kombetare u prononcua pro saj. Olaf Petri pati perkthyer Dhiaten e Re ne suedisht dhe me deshiren e mbretit, te dy vellezerit iu futen punes per perkthimin e te gjithe Bibles. Keshtu per here te pare suedezet mund ta lexonon fjalen e Zotit ne gjuhen e tyre kombetare. Keshilli urdheroi qe misionaret ne te gjithe mbreterine te shpjegonin kuptimin e Shkrimeve te Shenjta dhe qe femijeve t'u mesohej ne shkolle qe te lexonin Biblen.

Drita e bekuar e Lajmit te Mire e shperndau gradualisht, por vendosmerisht erresiren e injorances dhe supersticionit. I çliruar nga shtypja e Romes kombi fitoi nje force e madheshti qe nuk e pati fituar kurre me pare. Suedia u be fortese e Protestantizmit. Nje shekull me vone ne nje kohe rreziqesh te medha ky vend i vogel deri atehere i dobet - i vetmi vend i Evropes qe guxoi te zgjaste doren per te ndihmuar - çliroi Gjermanine ne betejen e tmerrshme te luftes se viteve 30-te.

Dukej sikur e gjithe Evropa Veriore ishte gati duke iu nenshtruar perseri tiranise se Romes. Ishin ushtrite suedeze qe i dhane mundesi Gjermanise te zbrapste suksesin e papes dhe te fitonte liri per protestantet, qofshin keta kalviniste apo luteraniste dhe t'u ridhuronte lirine e ndergjegjes te gjitha atyre vendeve qe e kishin pranuar Reformacionin.

1. Shekuj përpara Reformimit në Gjermani, reformatorët e kishin gjetur rrugën e tyre në Hollandë dhe Skandinavi. Kush i prezantoi mësimet Biblike në këto rajone?

2. Menno Simons, Tausen i Danimarkës dhe të tjerë kishin një sukses të madh në predikimin e besimit të Reformuar. Çfarë karakteristikash i bënë ata të suksesshëm?

3. Autoritetet e Besimeve u përpoqën të intimidonin apo ti ulnin zërin Reformatorëve. Përse dështoi persekutimi të dobësonte apo të ndalonte Reformimin?

4. Studentët e Skandinavisë në Ëittenber u kthyhen me padurim në vendin e tyre me pikëpamje Reformatore. Si duhet t'i trajnojnë universitetet dhe kolegjet Adventiste të ditës së Shtatë studentët e tyre për tu bërë reformatorë dhe misionarë?

14.

Reformatorët e Mëvonshëm Anglezë

Ndersa Luteri po rizbulonte perpara gjermaneve Biblen e humbur, Tyndali, i nxitur nga shpirti i Perendise po bente ne Angli te njejten gje. Bibla e Vikliffit* ishte perkthim i bazuar mbi nje tekst latin, i cili kishte shume gabime. Kjo Bibel nuk u shtyp kurre, ndersa çmimi i doreshkrimeve ishte kaq i larte sa vetem nje grusht i vogel njerezish te pasur apo fisniket mund ta shtinin ne dore e per me teper, duke qene e ndaluar rreptesisht nga kisha, ajo pati nje qarkullim relativisht te ngushte.

Ne vitin 1516, vetem nje vit perpara shfaqjes se tezave luterane, Erasmusi pati publikuar versionin grek dhe latin te Dhiates se Re. Fjala e Zotit, per here te pare, u shtyp edhe ne gjuhen e saj origjinale. Ne kete botim u korrektuan shume gabime te versioneve te meparshme dhe u qartesua edhe me teper kuptimi i saj. Kjo i udhehoqi shume veta nga klasat me te shkolluara drejt nje njohurie me te mire rreth te vertetes dhe i dha punes se Reformes nje impuls te ri.

Por njerezit e thjeshte vazhdonin te ishin te shkeputur ne nje shkalle te madhe nga fjala e Zotit. Tyndali duke ia dhene Biblen shtetasve te tij plotesoi punen e nisur nga Vikliffi.

Ai e kishte marre Lajmin e Mire, duke qene nje student i zellshem dhe nje kerkues i etur per te verteten nga versioni greqisht i Dhiates se Re te Erasmusit. Ai i predikoi pa frike bindjet e tij, duke ngulur kembe se te gjitha doktrinat duhet te kontrollohen me Shkrimet e Shenjta. Tyndali iu pergjigj keshtu pretendimit te papatit se kisha e kishte nxjerre Biblen dhe vetem ajo mund ta shpjegonte: "a e dini ju se kush u mesoi shqiponjave te gjenin prene e tyre? E njejta Perendi u meson femijeve te saj te uritur te gjejne Atin e tyre ne Fjalen e saj. Jo vetem qe nuk na i keni dhene ju Shkrimet e Shenjta, por jeni ju qe na i keni fshehur, jeni ju qe dogjet ata qe ua mesuan te tjereve keto Shkrime dhe po te kishit mundesi do t'i digjnit

* Jorn Wikliff - lajmetar i Reformes, luftetar kunder papatit, kapelan i mbretit Eduard III,mesues ne Oksford, perkthyes i Bibles ne anglisht, ambasador ne Vendet e Uleta etj. strehe ne Gjermani. Atje ai filloi botimin e Dhiates se Re ne anglisht.

edhe vete Shkrimet e Shenjta." - D'Aubigne, Historia e Reformacionit ne shek. 16-te, b.18;k.4.

Predikimi i Tyndalit ngjalli interes te madh, shume vete e pranuan te verteten. Por prifterinjte qendronin me sy hapur dhe sapo ai u largua nga ky vend, ata u perpoqen ta shkaterronin punen e tij permes kercenimesh dhe keqperfaqesimesh. Ata ia dolen mbane shume shpesh: "Çfare duhet bere? - pyeste ai. - Ndersa une plugoj diku, armiqte shkretojne fushen nga e cila sapo jam larguar. Une s'mund te jem kudo. Oh! Sikur te krishteret t'i kishin Shkrimet e Shenjta ne gjuhen e tyre, ata vete mund t'u qendronin ketyre sofisteve. Pa Biblen eshte e pamundur te kuptohet e verteta nga masat e thjeshta." - Ibid, b.18;k.4.

Mendimet e tij u perpine nga nje qellim i ri. "Ne tempujt e Jehovajit, - tha ai, - psalmet kendoheshin ne gjuhen e Izraelit; a nuk duhet te na flase Ungjilli ne gjuhen angleze?....A mos duhet qe kisha te rrezatoje me shume drite ne agim se sa ne mesdite? Te krishteret duhet ta lexojne Dhiaten e Re ne gjuhen e nenes." Doktoret dhe mesuesit e kishes nuk bien dakort midis tyre. Njerezit mund te arrijne tek e verteta vetem permes Bibles. "Njeri mbeshtetet tek ky doktor i teologjise, tjetri tek nje i dyte...Secili prej ketyre autoreve kundershton tjetrin. Si mund ta dallojme ate qe flet drejt nga ai qe flet gabim?...Si?... Vetem permes fjales se Zotit." - Ibid,b.18;k.4.

Pa kaluar shume kohe nje doktor katolik i ditur, duke e kundershtuar ate, deklaroi: "me mire te mbetemi pa Ligjet e Zotit sesa pa ato te Papes." Tyndali iu pergjigj: "nuk e perfill as Papen dhe as ligjet e tij, e nese Zoti do te ma kurseje jeten brenda nje kohe te shkurter do te beje qe nje djale qe di te perdore vetem plugun te dije per Shkrimet e Shenjta me shume se ju." - Anderson, Kronike e Bibles angleze, fq. 19.

Qellimi qe ai kishte filluar t'ia ushqente vetes per t'ua dhene njerezve Dhiaten e Re ne gjuhen e tyre, tani u vertetua dhe ai i hyri punes menjehere. Ai shkoi ne Londer i detyruar nga persekutimi te largohej nga vendlindja, ku vazhdoi per nje fare kohe te punonte i qete. Por perseri dhuna e perkrahesve te papes e detyroi ta largohej. Dukej sikur te gjitha dyert e Anglise ishin te mbyllura per te dhe ai vendosi te kerkonte Puna iu nderpre per te dyten here, por kur botimi ndalohej ne nje qytet ai shkonte tek tjetri. Se fundi ai nisi udhetimin drejt Wormsit, ku disa vjet me pare Luteri pati mbrojtur Ungjillin perpara keshillit. Ne ate qytet te lashte kishte shume miq te Reformacionit dhe Tyndali vazhdoi atje punen e nisur pa ndonje pengese tjeter. Shume shpejt mbaroi botimi i 3 000 kopjeve te Dhiates se Re dhe keto i pasoi brenda te njejtit vit, nje botim i dyte. Ai e vazhdoi punen e tij me zell dhe kembengulje te madhe. Megjithese autoritetet angleze i ruanin portat e tyre me vigjilence te mprehte, fjala e Zotit arriti ne Londer permes rrugesh dhe menyrash sekrete dhe qe atje u perhap ne te gjithe vendin.

Perkrahesit e Papes u perpoqen qe ta shtypnin te verteten, por me kot. Peshkopi i Durhamit nje here i bleu nje librashitesi, qe ishte shok i Tyndalit te gjitha kopjet

e Biblave, me qellim qe t'i shkaterronte ato, duke menduar se kjo do ta pengonte se tepermi punen. Por perkundrazi leket, qe dolen nga kjo shitje bene te mundur blerjen e materialit per nje botim te ri edhe me te mire, i cili pa keto leke nuk do te ishte shtypur kurre. Me pas kur Tyndali u burgos atij iu ofrua liria me kusht qe te tregonte emrat e atyre qe e kishin ndihmuar per t'iu pergjigjur shpenzimeve te botimit te Biblave te tij. Ai u pergjigj se peshkopi i Durhamit kishte bere me shume se ndonje tjeter, sepse, duke paguar nje çmim te larte per librat e pashitur, ai i kishte dhene mundesi te vazhdonte punen me guxim te ri.

Tyndalin e tradhetuan dhe ai ra ne duart e armiqve te tij. Keshtu ai vuajti burgim per shume muaj me radhe. Se fundi ai deshmoi per besimin e tij nepermjet vdekjes se tij prej martiri, por armet qe ai pergatiti u kane dhene mundesi shume te tjereve te luftojne ne shekuj e madje deri ne ditet tona.

Latimeri deklaroi nga podiumi se Bibla duhet te lexohet ne gjuhen e popujve. "Autori i Shkrimit te Shenjte, - tha ai. - eshte Zoti vete, dhe ky shkrim ka pjese ne madheshtine dhe perjetesine e Autorit te tij." Nuk ka mbret, perandor, magjistrat apo udheheqes ...qe s'duhet t'i bindet ...fjales se Tij te shenjte. "Te mos ecim kuturu, por te leme fjalen e Zotit te na drejtoje, te mos ecim pas...stergjysherve tane, te mos kerkojme ate qe bene ata, por ate qe duhet te benin." - Hygh Latimer, "Sherbesa e pare, predikuar perpara mbretit Eduard VI-te."

Miqte besnike te Tyndalit, Barnesi dhe Frithi, u ngriten ne mbrojtje te se vertetes.Ata u pasuan nga Ridleysi dhe Crammer.

Keta udheheqes te Reformacionit Anglez ishin njerez te ditur dhe pjesa me e madhe e tyre ishin çmuar shume nga bashkesia e Romes per zellin dhe meshiren e tyre. Kundershtimi qe i bene papatit erdhi si rezultat i njohjes se gabimeve te "juridiksionit te shenjte". Njohja qe ata kishin per misteret e Babilonise i dha fuqi me te madhe deshmive te tyre kunder saj.

"Tani une do te bej nje pyetje te çuditshme, - tha, - Latimeri - i cili eshte peshkopi dhe prelati me i zellshem i Anglise....Shoh se po degjoni me zemer te ngrire qe t'ua tregoj emrin e tij...Do t'ua them: eshte djalli...ai nuk del kurre nga dioqeza e tij, thirreni sa here te doni, ai eshte madje ne shtepi;...eshte gjithmone prane plugut... asnjehere nuk do ta gjeni pa pune, ua garantoj une kete...Atje ku djalli eshte banues i perhershem...mirupafshim Bibla dhe ngrihen lart tespijet, mirupafshim drite e Ungjillit dhe ngrihet lart drita e qirinjve, po, ne mesdite...poshte kryqin e Krishtit, lart mashtrimet e purgatorit;...mjaft me veshjen e te zhveshurve, te varferve, te pafuqishmeve, perpara me stolisjen e imazheve dhe zbukurimin e stolisjeve te drureve dhe gureve, lart traditat dhe ligjet njerezore, poshte traditat e Zotit dhe Fjalet e tij me te Shenjta...O sikur prelatet tane te ishin aq te zellshem ne korrjen e grurit te doktrinave te mira, sa eshte Satani ne korrjen e mallkimit dhe sojeve." - Ibid, "Sherbesa e Plugimit"

Parimi themelor qe perkrahen keta Reformatore - i njejti parim i perqafuar nga Waldeses, Vikliff, John Huss, Luteri, Zwingli dhe te gjithe te tjeret qe u bashkuan me ta ishte autoriteti i pacenueshem i Shkrimeve te Shenjta si rregull i besimit dhe praktikes. Ata mohuan te drejten e papeve, keshillave, Eterve dhe mbreterve ne kontrollin e ndergjegjes, persa i perkiste çeshtjeve te fese. Bibla ishte autoriteti i tyre dhe ata testonin te gjitha doktrinat dhe te gjitha pretendimet e ndryshme me mesimet e saj.

Besimi tek Zoti dhe Fjala e Tij i perkrahte keta shenjtore, ndersa ata jepnin jeten e tyre mbi turren e druve. "Rri i qete, - i tha Latimeri, shokut te tij martir, ndersa flaket ishin gati t'i perpinin, duke i heshtur zerat e tyre, - sot ne Angli ne do te ndezim nje pishtar te tille, lavdi Zotit, qe une besoj se nuk do te shuhet kurre. - Punimet e Hugh Latimerit, Vol. I; p. XIII.

Ne Skoci farat e se vertetes, te shperndara nga Kolumba dhe bashkepunetoret e tij nuk u shkaterruan kurre teresisht. Pasi kishat e Anglise iu dorezuan Romes, ato skoceze qindra vjet me pas vazhdonin te ruanin lirine e tyre. Sidoqofte papati u vendos edhe ketu ne shek. XII-te, duke ushtruar nje ndikim me absolut se ne vendet e tjera. Askund tjeter erresira nuk ishte kaq e plote. E megjithate erresira u depertua nga rrezet e drites, te cilat premtonin per diten qe do te vinte. Lolardet, duke ardhur nga Anglia me Biblen dhe mesimet e Wikliffit, ndikuan shume ne ruajtjen e njohurive mbi Lajmin e Mire (Ungjillin) dhe çdo vend pati deshmitaret dhe martiret e vet.

Fillimi i Reformacionit te Madh solli me vete se pari shkrimet e Luterit e me pas Dhiaten e Re ne anglisht te Tyndalit. Keta lajmetare, te cilet nuk kishin rene ne sy te hierarkise, udhetonin ne qetesi permes maleve e luginave, duke e ndezur me nje zjarr te ri pishtarin e se vertetes, i cili pak kohe me pare ishte gati ne te shuar ne Skoci dhe duke shkaterruar punen qe Roma kishte kryer gjate kater shekujsh shtypjeje.

Gjaku i martireve i dha impuls te ri kesaj levizjeje. Udheheqesit e papatit, duke u bere te vetedijshem per rrezikun qe kercenonte kauzen e tyre, çuan mbi turren e druve disa nga bijte me te nderuar e me fisnike te Skocise. Ata nuk bene asgje tjeter veçse ngriten disa podiume ekzekutimi, nga ku fjalet e deshmitareve ne prag te vdekjes u degjuan ne te gjithe vendin, duke dritheruar shpirtrat e njerezve me nje qellim te pavdekshem, per te flakur tej prangat e Romes.

Hamiltoni dhe Wisharti, fisnike si nga prejardhja ashtu edhe nga karakteri, se bashku me nje varg nxenesish me te thjeshte dhane jeten mbi turren e druve. Por nga turra qe digjej e Wishartit doli dikush qe nuk heshti perpara flakeve, dikush qe me ndihmen e Zotit do t'i binte kembanes se vdekjes se papatit ne Skoci.

John Knox u ktheu kurrizin traditave dhe misticizmit te kishes, per t'u ushqyer me te vertetat e fjales se Zotit dhe mesimi i Wishartit vertetoi vendosmerine e tij

per te hequr dore nga besnikeria e Romes e per t'u bashkuar me reformatoret e persekutuar.

I nxitur nga shoket e tij per te marre mbi supe detyren e predikuesit ai u zbraps, duke u dridhur nga nje pergjegjesi e tille dhe ra dakort vetem pas disa ditesh izolimi dhe konflikti te mprehte me vetveten. Por me ta pranuar kete detyre ai eci perpara me vendosmeri te patundur dhe guxim te pashoq gjate gjithe jetes se tij. Ky reformator i vertete nuk frikesohej nga njerezit. Zjarret qe perpinin martiret, duke flakeruar perreth tij, sherbyen per te shpejtuar zellin e tij drejt nje intensiteti me te madh. Ai qendroi i forte, duke goditur i vendosur majtas dhe djathtas per te shembur idhulltarine, megjithese sepata e tiranit i qendronte kanosese mbi koke.

John Knox mbajti nje deshmi te palekundur mbi te verteten edhe kur u ballafaqua me mbretereshen e Skocise, prania e se ciles kishte lekundur zellin e shume udheheqesve protestante. Ai nuk mund te fitohej me lajka, ai nuk frikesohej nga kercenimet. Mbreteresha e akuzoi per herezi. Ai i kishte mesuar njerezit te pranonin nje fe, qe ndalohej nga shteti...deklaroi ajo...dhe kishte shkelur keshtu urdheresen e Zotit, sipas se ciles subjektet duhet t'i binden princerve te tyre. Knox u pergjigj me vendosmeri: "Ashtu si feja e vertete nuk e ka marre as fuqine origjinale dhe as autoritetin nga princat tokesore ashtu edhe subjektet nuk jane te detyruar ta ngrene fene e tyre sipas oreksit te princave te tyre. Shpesh ndodh qe princat jane me injorantet mes te tjereve persa i perket fese se vertete te Zotit... ne qofte se te gjithe pasardhesit e Abrahamit te kishin fene e faraonit, subjekte te te cilit ishin per nje kohe te gjate, te pyes ty zonje çfare feje do te kishte ne bote? Ose sikur te gjithe njerezit ne kohen e apostujve te kishin fene e perandoreve romake çfare feje do te mbizoteronte mbi faqe te dheut?...

Pra zonje, ju mund ta kuptoni se subjektet nuk jane te detyruar te kene fene e princave te tyre edhe pse ata komandohen qe t'u binden atyre."Maria tha: "Ju i interpretoni Shkrimet e Shenjta ne nje menyre dhe ata mesuesit e Kishes Katolike Romake i interpretojne ato ne nje menyre tjeter, cilin duhet te besoj, e kush do te jete gjykatesi?"

"Ju duhet te besoni Zotin, i cili flet qarte ne fjalen e Tij, - u pergjigj reformatori, - e perveç fjales qe te meson, ti nuk duhet te besosh as njerin as tjetrin. Fjala e Zotit eshte me se e qarte, e nese diku shfaqet ndonje paqartesi, Shpirti i Shenjte, i cili nuk kundershton kurre vetveten, e shpjegon te njejten gje me qarte ne vende te tjera, ne menyre qe te mos mbetet asnje dyshim perveçse tek ata qe kane vendosur me kokefortesi te qendrojne injorante." - David Laing, Punimet e Mbledhura te John Knox, vol.2,pp.281,284.

Te tilla te verteta shpalli reformatori i patrembur perpara madherise se saj, duke vene ne rrezik jeten e tij. Ai i qendroi besnik qellimit te tij me te njejtin guxim te pashoq, duke u lutur e duke luftuar ne betejat per Zotin deri sa Skocia u çlirua nga ndjekesit e Papes.

Vendosja e Protestanizmit si fe kombetare ne Angli e zvogeloi, por nuk i dha fund teresisht persekutimit. Ndersa ishte hequr dore nga shume doktrina te Romes ishin ruajtur jo pak format e saj. U mohua epersia e Papes, por ne vend te tij monarku u kurorezua si udheheqes i kishes. Gjate sherbeses ne kishe ekzistonte akoma nje shkeputje e ndjeshme nga pastertia dhe thjeshtesia e Ungjillit. Parimi i madh i lirise se besimit nuk kuptohej akoma edhe pse mizorite e tmerrshme qe Roma perdorte kunder herezise tani i drejtoheshin shume rralle udheheqesve protestante, perseri nuk njihej e drejta e çdo njeriu per ta adhuruar Zotin sipas asaj qe i thoshte ndergjegjja e vet. Te gjitheve u kerkohej qe t'i pranonin doktrinat dhe te respektonin format e adhurimit, te pershkruara nga kisha, qe tashme ishte vendosur. Deri diku opozitaret u persekutuan per qindra vjet.

Ne shek. XVII-te me mijera pastore u shkarkuan nga detyra e tyre. Njerezve iu ndalua, nepermjet gjobave te renda, burgimit dhe debimit, pjesemarrja ne takime te tjera fetare perveç atyre qe aprovoheshin nga kisha.Ato shpirtra besnike, qe nuk mund te qendronin pa u mbledhur per te adhuruar Zotin ishin te detyruar te takoheshin ne rrugica te erreta, ne çardake te strukur dhe sipas stineve edhe ne pyje ne mesnate. Keta femije te persekutuar e te çorientuar te Zotit mblidheshin ne thellesite e fshehta te pyjeve, nje tempull i krijimit te vete Zotit, per te zbrazur shpirtrat, duke iu lutur e duke lavderuar Perendine. Shume prej tyre vuajten nga besimi i tyre me gjithe masat paraprake qe ndermorren. Burgjet ishin mbushur plot. Shume familje u shperbene. Shume vete u syrgjynosen ne vende te tjera. Perseri Zoti ishte me njerezit e Tij dhe persekutimi nuk arriti ta bente te heshte zerin e deshmise se tyre. Shume prej tyre u detyruan te kalonin oqeanin drejt Amerikes dhe hodhen atje themelet e lirise civile dhe te besimit, liri qe ka qene fortesa dhe lavdia e ketij vendi.

Persekutimi, ashtu si ne ditet apostolike, perseri ndikoi ne perhapjen e Lajmit te Mire. John Bunyan thirri atmosferen e qiellit pikerisht ne nje biruce te neveritshme mbushur me plangprishes dhe kriminele dhe aty ai shkroi alegorine e tij te mrekullueshme te udhetimit te shtegtarit nga vendi i shkaterrimit drejt qytetit hyjnor. Per me shume se 200 vjet zeri nga burgu i Bedfordit u ka folur zemrave njerezore me nje fuqi dritheruese. "Progresi i Shtegtarit" dhe "Meshire me bollek per Kryemekatarin" te Bunyan kane udhehequr hapat e shume njerezve ne udhen e jetes.

Baxter, Flavel, Allune dhe shume te tjere, njerez me talent, te shkolluar dhe me nje pervoje te gjere kristiane u ngriten trimerisht ne mbrojtje te besimit, qe dikur u ishte shfaqur shenjtoreve. Puna e kryer nga keta njerez nuk mund te zhduket kurre edhe pse u ndalua dhe u shpall e jashteligjshme nga sundimtaret e kesaj bote. "Shatervani i Jetes" dhe

"Metoda e Meshires" te Flavelit u kane mesuar me mijera njerezve se si t'ia dorezojne shpirtrat e tyre Krishtit. "Pastori i Reformuar" i Baxterit ka qene bekim per shume veta, qe deshironin ringjalljen e punes se Perendise, ndersa "Pushimi i

perjetshem i Shenjtoreve" ka ndikuar ne udheheqjen e shpirtrave drejt "pushimit", qe i pret njerezit e Zotit.

Njeqind vjet me pas, ne kohen e nje erresire te plote, Whitelfieldi dhe Wesleys u shfaqen, per te sjelle driten e Perendise. Anglezet nen rregullin e kishes qe tashme ishte vendosur, rane ne nje gjendje te tille lakimi fetar qe ishte pothuajse i ngjashem me paganizmin. Feja natyrore ishte studimi i preferuar i klerit dhe ketu perfshihej edhe pjesa me e madhe e teologjise se tyre. Klasat me te larta te shoqerise perqeshnin meshiren dhe krenoheshin me vetveten se ishin mbi te ashtuquajturin fanatizem i saj. Klasat me te uleta ishin me se injorante dhe te dhena pas vesit, ndersa kisha nuk kishte me as guximin dhe as besimin e duhur per te mbeshtetur kauzen e se vertetes qe po merrte rrokullimen.

Doktrina e madhe e justifikimit me ane te besimit, shpjeguar kaq qarte nga Luteri ishte harruar dhe vendi i saj ishte zene nga parimi romak se shpetimi vjen nga veprat e mira. Whitelfield dhe Wesleys, te cilet ishin anetare te kishes, kerkonin sinqerisht simpatine dhe mbrojtjen e Perendise dhe atyre u ishte thene se keto mund te siguroheshin nepermjet nje jete te virtytshme dhe duke respektuar te gjitha urdheresat e fese (kishes).

Nje here kur Charles Wesleys ishte i semure dhe mendonte se ishte ne prag te vdekjes, ate e pyeten se ku e mbeshteste shpresen per jete te perjetshme. Kjo ishte pergjigjja e tij: "jam orvatur me sa kam mundur per t'i sherbyer Zotit." E ndersa shoku, qe e pyeti nuk dukej plotesisht i kenaqur nga pergjigjja e tij, Wesleys mendoi: "Çfare! Perpjekjet e mia nuk jane te mjaftueshme si baze shprese? Do te m'i rrembeje keto orvatje? Pa to une s'kam ku te besoj me." - John Whitehead, Jeta e Refor. Charles Wesley, fq. 102. E tille ishte erresira qe kishte mbuluar kishen, erresire, qe fshihte shlyerjen e fajeve, duke ia rrembyer lavdine Krishtit dhe duke i larguar mendjet e njerezve nga e vetmja shprese shpetimi - nga gjaku i Çliruesit te kryqezuar.

Wesley dhe shoket e tij pane se feja e vertete eshte vulosur ne zemer dhe se Ligji i Zotit perfshin jo vetem fjalet dhe veprimet, por edhe mendimet. Te bindur per nevojen e nje zemre te paster dhe te shenjte si edhe per nevojen e korrekteses ne sjelljen e jashtme, ata i hyne me nxitim nje jete te re. Ata u perpoqen t'i nenshtronin te keqijat e natyres njerezore permes orvatjeve te zellshme dhe lutjeve. Ata bene nje jete vetemohimi, bamiresie dhe peruljeje, duke i respektuar rigorozisht te gjitha ato norma qe ata mendonin se mund t'i ndihmonin per te arritur ate qe ata deshironin mbi gjithcka tjeter - hiresine qe do t'u siguronte simpatine dhe mbrojtjen e Perendise. Por nuk e arriten dot qellimin per te cilin u perpoqen aq shume. Perpjekjet e tyre per t'u çliruar nga denimi i mekatit apo per te thyer fuqine e tij shkuan kot. Ishte e njejta lufte shpirterore qe kishte perjetuar edhe Luteri ne qeline e tij ne Erfurt. Lindte e njejta pyetje qe kishte torturuar shpirtin e tij. - "Askush nuk mund te dale ne gjyq me Perendine dhe te fitoje." - Ijovi 9:2

Zjarret e se vertetes hyjnore, pothuajse te shuar prane altareve te protestanizmit, do te rindizeshin nga pishtari i zgjatur permes shekujve nga te krishteret bohemiane. Pas Reformacionit, Protestanizmi ne Bohemi u shtyp nga hordhia e Romes. Te gjithe ata qe nuk pranuan te hiqnin dore nga e verteta u detyruan te largoheshin. Disa prej tyre, duke gjetur strehe ne Saksoni, e ruajten besimin e lashte. Pikerisht drita erdhi deri tek Wesley dhe shoket e tij nga pasardhesit e ketyre kristianeve.

John dhe Charles Wesley me t'iu kushtuar ministrise u derguan me mision ne Amerike. Mbi anije ishte nje grup njerezish nga Moravia. Gjate udhetimit shperthyen stuhi te tmerrshme dhe John Wesley, duke qendruar balle per balle me vdekjen ndjeu se nuk e kishte sigurine e paqes me Zotin. Perkundrazi gjermanet manifestuan nje qetesi dhe besim, qe ishin te huaj per te. "E kisha vene re, - thote ai, - shume kohe me pare seriozitetin e sjelljes se tyre. Ata kishin dhene prova te vazhdueshme te peruljes se tyre, duke u sherbyer pasagjereve te tjere ne nje menyre te tille qe asnje anglez nuk do ta merrte persiper, gje te cilen e benin me deshire dhe pa pagese, duke thene se u bente mire zemrave te tyre krenare dhe se Shpetimtari i tyre i dashur kishte bere shume me teper per ta. Dhe çdo dite e re u jepte atyre mundesine per te shfaqur nje bindje dhe butesi te tille, qe s'mund te lekundej nga asnje fyerje. Nese dikush i shtynte, i godiste ose i hidhte tutje, ata ngriheshin dhe largoheshin, asnje ankim nuk u degjua ne buzet e tyre. Ja ku kishim nje mundesi per te provuar nese ata ishin çliruar nga shpirti i frikes, ashtu si ishin çliruar nga krenaria, zemerimi dhe hakmarrja. Furtuna shpertheu ne mes te nje psalmi me te cilin ata fillonin sherbesen e tyre, dhe uji theu velen kryesore ne mijera pjese, mbuloi anijen dhe u derdh mbi kuverte a thua se thellesia na kish gelltitur te gjitheve. Anglezet filluan te bertisnin. Gjermanet vazhduan te kendonin qetesisht. Une pyeta me pas njerin prej tyre: "Kishe frike?" Ai u pergjigj: "Falë Zotit jo." Une pyeta: "Po grate dhe femijet kishin frike?" Ai u pergjigj: "Jo, grate dhe femijet tane nuk kane frike nga vdekja." - Whitehead, Jeta e Reform. John Wesley, fq. 10.

Me te arritur ne Ravannah, Wesley qendroi per nje fare kohe me grupin nga Moravia dhe i la mbrese te thelle sjellja e tyre prej te krishteri. Ai shkroi per nje prej sherbesave te tyre fetare, duke theksuar kontrastin mes saj dhe formalizmit pa jete te kishes angleze.

"Thjeshtesia e madhe po aq sa edhe solemniteti i saj pothuajse bene qe t'i harroje 700 vjetet, qe ndodhen mes tyre dhe imagjinova vetveten ne njeren prej atyre bashkesive ku kryesonin Pali, ndertuesi i tendave dhe Pjetri peshkatar, duke shfaqur akoma Shpirtin dhe fuqine." - Ibid, fq. 11, 12.

Wesley gjate kthimit per ne Angli nen udhezimet e nje predikuesi moravian arriti ta kuptonte akoma me qarte besimin e shprehur ne Bibel. Ai u bind se duhej te hiqte dore e te mos varej nga veprat e mira per te shpetuar dhe se duhej te besonte teresisht tek "Qingji i Perendise, qe pastron mekatin nga bota". Ne nje takim te shoqerise se Moravise ne Londer u lexua nje thenie e Luterit, qe pershkruante ndry-

shimin qe puna e Shpirtit te Zotit (Shenjte) sjell ne zemren e besimtarit. Ndersa Wesley degjonte, ne shpirt iu ndez besimi. "Çuditerisht ndjeva se si m'u ngroh zemra, - thote ai, - ndjeva se une me te vertete besoja per shpetim tek Krishti, vetem tek Krishti dhe m'u dha siguria se ai i kishte pastruar mekatet e mia, po, te mijat dhe me kishte shpetuar mua nga ligji i mekatit dhe i vdekjes." - Ibid, fq. 52. Wesley i kishte qendruar besnik qellimit te tij per te kerkuar Zotin edhe permes viteve te gjata te rropatjeve te lodhshme dhe shqetesuese - viteve te vetemohimit rigoroz, te qortimeve dhe poshterimeve. Tani ai e kishte gjetur Ate, ai kuptoi se meshira, te cilen ishte munduar aq shume ta fitonte permes lutjeve dhe kreshmes, permes vetemohimit dhe duke kerkuar lemoshe ishte nje dhurate e fituar "pa leke dhe pa çmim."

Me t'u lidhur fort pas besimit tek Krishti, shpirti i tij digjej nga deshira per ta perhapur kudo lajmin e lavdishem te meshires falas te Krishtit.

"E konsideroj si famulline time boten mbare, - tha ai, - dhe kudo qe jam, deklarimi i lajmit te gezuar te shpetimit tek te gjithe ata qe duan ta degjojne, eshte per mua nje detyre e drejte dhe e ndergjegjshme." - Ibid,fq.74.

Ai vazhdoi jeten e tij strikte dhe vetemohuese, tani jo si bazen, por si rezultatin e besimit; jo si rrenjen, por si frytin e hiresise. Meshira e Perendise tek Krishti eshte themeli i shpreses se nje te krishteri dhe kjo meshire do te manifestohet ne bindje. Jeta e Wesleyt iu dedikua predikimit te te vertetave qe ai vete kishte pranuar - falje nepermjet besimit tek gjaku shlyeres i Krishtit dhe fuqi rinovuese e Shpirtit te Shenjte mbi zemrat e njerezve, duke nxjerre fryte ne jeten komfort shembullit te Krishtit.

Whitefield dhe Wesleys ishin pergatitur per punen qe do te ndermerrnin permes bindjeve te thella e te patundura te vete situates se tyre te humbur, dhe me qellim qe t'i benin balle veshtiresive si ushtare te mire te Krishtit ata iu nenshtruan proves se veshtire te perbuzjes, talljes dhe persekutimit si ne universitet, ashtu edhe ne kohen kur po fillonin punen e misionarit. Ata vete si edhe disa te tjere, qe i simpatizonin quheshin me perbuzje nga shoket e tyre keqdashes studente metodiste - emer i nderuar ne ditet tona nga pjesa me e madhe e sekteve fetare te Anglise dhe Amerikes. Ata ishin lidhur fort pas formave te adhurimit te kishes se Anglise, duke qene anetare te saj, por Zoti u paraqiti ne fjalen e Tij nje standart me te larte. Shpirti i Shenjte i nxiti ata te predikonin per Krishtin dhe kryqezimin e Tij. Fuqia e te Madherishmit ndihmoi ne punet e tyre. Me mijera njerez u binden dhe u shnderruan teresisht. Ishte e nevojshme qe te mbroheshin keto dele nga ujqit e uritur. Wesley nuk mendonte te krijonte ndonje sekt te ri fetar, por ai i organizoi ata nen te ashtuquajturen Lidhja Metodiste.

Kundershtimi qe iu desh te perballonin keta predikues ishte misterioz dhe shqetesues, por Zoti me mençurine e tij i kishte rrokullisur ngjarjet ne menyre qe Reforma te fillonte nga brenda kishes vete. Sikur kjo reforme te kishte ardhur

teresisht nga jashte, ajo nuk do te kishte depertuar kurre atje ku nevojitej aq shume. Duke qene se predikuesit e rilindur ishin njerez te kishes dhe punonin sa here qe u jepej rasti, brenda rrethojes se kishes, e verteta gjeti nje rruge kalimi edhe atje ku dyert do te kishin mbetur pergjithmone te mbyllura. Disa nga kleriket te zgjuar nga mpirja e tyre morale u bene predikues te zellshem ne famullite e tyre. Kisha qe dikur ishin ngurosur nga fanatizmi moren jete.

Ashtu si ne te gjitha periudhat e historise se kishes edhe gjate kohes se Wesleyt njerez me dhunti te ndryshme kryenin punen e tyre te caktuar. Ata nuk rane dakort me çdo doktrine, por Shpirti i Perendise ndikoi tek te gjithe, duke i bashkuar rreth qellimit mobilizues per te fituar njerez per Krishtin. Ndryshimet midis Whitelfieldit dhe Wesleyt nje here rrezikuan krijimin e perçarjeve, por shkolla e Krishtit u mesoi bindjen dhe, durimi dhe miresia reciproke çuan ne pajtimin e tyre. Ata nuk kishin kohe te polemizonin, ndersa gabimet dhe padrejtesite levronin kudo dhe mekataret po shkonin drejt rrenimit te plote.

Sherbetoret e Zotit ecen mbi nje shteg te thyer. Njerez me influence dhe te ditur perdoren te gjitha forcat kunder tyre. Pas nje fare kohe shume nga kleriket demonstruan nje armiqesi te papare dhe dyert e kishave u mbyllen per besimin e paster dhe per ata qe e shpallnin ate. Rruga qe ndoqen kleriket, duke i denoncuar ata nga podiumet e kishave, ngriti ne kembe elemente te erresires, injorances dhe padrejtesise. Here pas here John Wesley i shpetoi vdekjes fale mrekullive te meshires se Zotit. Kur terbimi i turmes drejtohej mbi te dhe dukej sikur nuk kishte rruge shpetimi, prane tij vinte nje engjell ne forme njerezore. Turma terhiqej dhe sherbetori i Krishtit largohej i sigurte nga vendi i rrezikut.

Duke folur per shpetimin e tij nga turma e xhindosur, ne nje prej ketyre rasteve Wesley tha: "Shume veta u perpoqen te me rrezonin, ndersa po zbrisnim nga kodra permes nje shtegu rreshqites drejt qytetit, duke e gjykuar mire se me te rene ne toke do ta kisha teper te veshtire per t'u ngritur perseri. Por une as nuk u pengova as nuk rreshqita, derisa isha krejtesisht jashte rrezikut...Megjithese shume veta u perpoqen te me kapnin nga kollarja apo nga rrobat, qe te me rrezonin pertoke, asnjeri nuk qe ne gjendje te mberthente diçka, vetem njeri arriti te me kapte nga cepi i jelekut, i cili i mbeti ne dore, ndersa cepi tjeter, ne xhepin e te cilit kisha nje shenim nga banka u shqep, por nuk u gris teresisht...Nje burre i fuqishem prapa meje me goditi me nje shkop prej lisi disa here me radhe, sikur te me kishte goditur vetem nje here prapa kokes me te nuk do te kishte me arsye per t'u shqetesuar. Por goditja menjanohej çdo here dhe une nuk e di se si, sepse une nuk mund te levizja as majtas as djathtas...Nje tjeter erdhi, duke shtyre permes turmes dhe ngriti krahun per te me goditur, kur papritmas e uli ate dhe vetem sa ma preku koken duke thene: "Sa floke te bute qe ka!"... Zemrat e njerezve te pare qe u shnderruan ishin ato te heronjve te qytetit, kryetaret e llumit te shoqerise, njeri prej tyre kishte qene boksier ne kopshtin e arinjve...

"Sa gradualisht na pergatit Zoti per te kryer vullnetin e Tij! Para dy vjetesh nje tulle me ra mbi shpatulla. Pas nje viti u godita me gure mes syve. Muajin e kaluar me rane nje here, kete mbremje dy here, nje perpara se te vinim ne qytet dhe nje tjeter kur po largoheshim; por te dyja ishin pa rendesi, edhe pse nje burre me goditi ne gjoks me sa fuqi kishte dhe nje i dyte me goditi ne goje me aq force sa me buçiti gjaku menjehere. Dhimbja qe ndjeva nga te dyja goditjet ishte aq e vogel sa edhe prekja me nje fije kashte." - John Wesley, Punime, Vol. 3, pp.297,298.

Metodistet e atyre diteve - si predikuesit ashtu edhe njerezit e thjeshte - duruan talljet dhe persekutimin, keto si nga anetaret e kishes ashtu edhe nga opinioni i hapur jofetar, i cili ishte ndezur flake nga keqperfaqesimi i tyre. Ata u paditen perpara gjyqeve te drejtesise - vetem emrin kishin te tille, sepse ishte e rralle te gjeje drejtesi ne gjyqet e asaj kohe. Shpesh ata duronin dhunen e persekutuesve te tyre. Turma njerezish shkuan shtepi me shtepi, duke shkaterruar mobilje e mallra, duke plaçkitur gjithcka qe donin dhe duke abuzuar brutalisht mbi burrat, grate dhe femijet. Pati disa raste kur u vendosen lajmerime publike qe u benin thirrje te gjithe atyre, qe deshironin te merrnin pjese ne thyerjen e xhamave dhe ne grabitjen e shtepive te Metodisteve, per t'u mbledhur ne nje vend te caktuar dhe ne nje ore te caktuar. Te gjitha keto shkelje te hapura si te ligjeve njerezore ashtu edhe te Ligjeve Hyjnore kaluan pa as edhe qortimin me te vogel. Nje persekutim sistematik filloi te zbatohej kunder ketyre njerezve, gabimi i vetem i te cileve ishte vetem fakti qe ata kishin kerkuar qe t'ua kthenin hapat mekatareve nga rruga e shkaterrimit drejt rruges se shenjterimit.

Duke iu referuar padive ngarkuar atij dhe shokeve te tij John Wesley tha: "Disa pohojne se doktrinat e ketyre njerezve jane te genjeshterta, te gabuara dhe entuziaste, se ato jane te reja dhe te padegjuara deri tani, se ato jane fanatizem, pro Papes dhe kuakerizem. I tere ky pretendim eshte prere nga rrenjet, sepse eshte shfaqur gjeresisht se çdo dege e kesaj doktrine eshte doktrina e qarte e Shkrimit te Shenjte, e interpretuar nga vete kisha. Duke qene se Shkrimi i Shenjte eshte i vertete ato nuk mund te jene as te genjeshterta dhe as te gabuara. "Te tjeret pohojne: Doktrina e tyre eshte teper strikte, ata e bejne teper te ngushte rrugen drejt parajses" dhe ky eshte ne te vertete kundershtimi origjinal (ashtu siç ishte i vetmi per nje fare kohe) dhe fshehtas ndodhet ne qender te mijera te tjereve, qe shfaqen ne forma te ndryshme. Por a e bejne ata rrugen drejt parajses ndopak me te ngushte seç e bene Zoti dhe apostujt e Tij? A eshte doktrina e tyre me strikte se ajo e Bibles? Le te marrim ne konsiderate vetem disa tekste te qarta: Ju duhet ta doni Zotin, Perendine tuaj me gjithe zemer, me gjithe mendje, me gjithe shpirt dhe me gjithe forcen tuaj.' 'Sepse Ai do te pergjigjet per çdo fjale te keqe qe ka dale nga goja e tij ne Diten e Gjykimit. "Hani, pini dhe beni gjithçka, duke i dhene lavdi Zotit."

"Ne qofte se doktrina e tyre eshte me strikte se kaq ata jane fajtore, por ju e dini fare mire dhe jeni te ndergjegjshem qe nuk eshte keshtu. E kush mund te jete

edhe nje grime me pak strikt pa korruptuar fjalen e Zotit? A mund te quhet besnik ai administrator i mistereve te Perendise, ne qofte se ai ka ndryshuar qofte edhe nje pjese te vogel te asaj depozite te shenjte? Jo. Ai nuk mund te anulloje asgje, ai nuk mund te zbuse asgje, ai eshte i detyruar t'u deklaroje te gjithe njerezve: "Une nuk mund t'i perpunoj Shkrimet e Shenjta sipas shijes suaj. Jeni ju ata qe duhet t'i pershtateni atyre, ose te zhdukeni pergjithmone." Te pameshirshem apo jo? Ne çfare kuptimi? A nuk veshin te zhveshurit dhe a nuk ushqehen te uriturit?

"Jo; puna nuk eshte ketu: ata nuk akuzohen per kete, por ata jane kaq te pameshirshem ne gjykim! Ata mendojne se askush nuk do te shpetohet perveç atyre te rrethit te tyre." - Ibid., vol.3.pp.152,153.

Gjendja shpirterore, qe ishte manifestuar ne Angli perpara kohes se Wesleyt vinte ne nje shkalle te madhe si rezultat i mesimit antonimian. Shume veta afirmonin faktin se Krishti e kishte anulluar ligjin moral, prandaj te krishteret nuk ishin te detyruar ta respektonin ate, se besimtaret ishin çliruar nga "zgjedha e veprave te mira."

Te tjere edhe pse pranonin perjetesine e ligjit, deklaronin se pastoret nuk kishin nevoje t'i benin thirrje njerezve per t'iu bindur koncepteve te tij, perderisa te gjithe ata qe Zoti ka zgjedhur per shpetim do te "udhehiqeshin nepermjet impulsit te pandalshem te hirit hyjnor, drejt nje praktike meshire dhe virtyti", ndersa te gjithe ata qe jane destinuar per mosaprovim te perjetshem "nuk do te kene fuqi per t'iu bindur ligjit hyjnor."

Te tjere, duke perkrahur idene se "te zgjedhurit nuk mund te largohen nga meshira dhe as mund te humbasin simpatine hyjnore", arriten ne nje konkluzion akoma me te neveritshem se "veprimet e keqija, qe kryhen prej tyre nuk jane me te vertete mekatare dhe nuk duhet te konsiderohen si shkelje te Ligjit Hyjnor, pra rrjedhimisht ata nuk kane arsye pse t'i rrefejne mekatet e tyre apo te pendohen per to." - Mc Clintock dhe Strong, Enciklopedia, art.

"Antimonianet". Keshtu ata deklaruan se madje edhe mekati me i keq, "i konsideruar boterisht si shkelje e rende e Ligjit Hyjnor, nuk perben mekat per Perendine," ne qofte se kryhet nga nje prej te zgjedhurve, "sepse eshte nje nga karakteristikat me themelore dhe me te dallueshme e te zgjedhurve, fakti se ata s'mund te bejne asgje te papelqyeshme per Zotin apo te ndaluar nga ligji."

Keto doktrina monstruoze jane ne themel te njejta me mesimet e mevonshme te edukatoreve dhe teologeve me popullore - ideja qe ligji, qe pasqyron standartin e se drejtes eshte i pandryshueshem, por standarti i moralit eshte i prirur nga vete shoqeria dhe ka qene vazhdimisht subjekt ndryshimesh. Te gjitha keto ide jane frymezuar nga i njejti shpirt i kualifikuar - nga ai, i cili edhe mes banoreve jomekatare te qiellit filloi punen e tij, duke u orvatur qe te shkaterroje kufijte e drejte te ligjit te Zotit.

Doktrina e dekreteve hyjnore, qe i jepte nje vend te fiksuar e te palevizshem karakterit njerezor i kishte udhehequr shume njerez drejt mohimit faktik te ligjit te

Zotit. Wesley i kundershtoi me vendosmeri gabimet e mesuesve antinomiane dhe tregoi se kjo doktrine, qe te çonte drejt antinomizmit bie ne kundershtim me Shkrimet e Shenjta. "Meshira e Zotit, qe sjell shpetim iu eshte shfaqur te gjithe njerezve." "Kjo eshte e mire dhe e pranueshme perpara syve te Perendise, Shpetimtarit tone; Ai do qe te gjithe njerezit te shpetohen dhe t'i drejtohen te vertetes. Sepse ka vetem nje Perendi dhe ka vetem nje ndermjetes midis Perendise dhe njerezve, njeriu Jezus, Mesia. Ai dha jeten qe te gjithe t'i çliroje nga mekatet e tyre." - 1 Timoteu 2:3-6.

Shpirti i Perendise i eshte dhene falas çdo njeriu, qe t'i jape atij mundesi per te rrokur rrugen e shpetimit. Prandaj Krishti, "eshte drite e vertete. Erdhi ne bote per t'ua dhene kete drite njerezve." - Gjoni 1:9. Njerezit e humbin shpetimin nepermjet refuzimit me kokefortesi qe i bejne dhurates se jetes.

Duke iu pergjigjur pretendimit se me vdekjen e Krishtit principet e Ligjit Hyjnor ishin anulluar per t'u zevendesuar me ligjin ceremonial, Wesley tha: "Ai nuk e anulloi ligjin moral te perfshire ne Dhjete Urdheresat dhe i perforcuar nga profetet. Shfuqizimi i ndonje pjese te tij nuk ishte perfshire ne planin e ardhjes se Tij. Ky eshte nje ligj, qe nuk mund te thyhet kurre, i cili "qendron ne kembe si deshmitar besnik ne qiell"... Kjo ishte e verteta qe me fillimin e botes, duke qene i shkruar "jo ne pllakat e gurit", por ne zemrat e te gjithe femijeve te njeriut, kur ata moren forme nga dora e Krijuesit. Sidoqofte, shkronjat e shkruara nga gishti i Zotit, tani, ne nje mase te madhe jane njollosur nga mekati, por ato nuk mund te fshihen plotesisht perderisa ne jemi te ndergjegjshem kur bejme mire dhe kur bejme keq. Çdo pjese e ketij ligji duhet te mbetet ne fuqi mbi gjithe njerezimin, gjate gjithe koherave, sepse ai nuk varet as nga koha dhe as nga vendi, madje as nga ndonje rrethane tjeter, qe mund te ndryshoje, por mbeshtetet tek natyra e Zotit, natyra e njeriut dhe marredhenia e pandryshueshme e tyre me njeri - tjetrin. "Une nuk kam ardhur te shkaterroj, por te permbush."...Padyshim, Ai me kete donte te thoshte (jo vetem ketu, por edhe me pare dhe me pas ketij pasazhi) - Kam ardhur ta permbush plotesisht, pa marre parasysh interpretimet e njerezve: Kam ardhur per te vendosur ne nje plan te plote dhe te qarte gjithçka qe ka qene e erret dhe e paqarte deri tani: Kam ardhur per te deklaruar rendesine e vertete dhe te plote te çdo pjese te tij; per te treguar gjatesine dhe gjeresine, te gjithe madheshtine e çdo urdherese, qe perfshihet ne te; lartesine dhe thellesine, pastertine dhe spiritualizmin e paimagjinueshem te tij ne çdo dege." - Wesley, sherbesa 25.

Wesley deklaroi harmonine e plote mes ligjit dhe Ungjillit. "Prandaj midis ligjit dhe Ungjillit ekziston lidhja me e ngushte, qe mund te konceptohet. Nga njera ane eshte ligji ai qe ne menyre te vazhdueshme i hap rrugen dhe na drejton ne drejt Ungjillit, nga ana tjeter Ungjilli na udheheq drejt nje permbushjeje me te plote te ligjit. Per shembull, ligji do qe ne ta duam Perendine, te duam fqinjet tane, te jemi te bindur, te perulur apo te shenjte. Ne ndiejme se s'mund t'i permbushim te gjitha

keto, por "kjo eshte e pamundur per njeriun", por ne veme re premtimin e Zotit per te na e dhene kete dashuri, per te na bere te bindur, te perulur dhe te shenjte: ne e rrokim kete lajm te mire, keto te reja te gezueshme; kjo na ndodh per shkak te besimit tone dhe "drejtesia e ligjit permbushet tek ne", nepermjet besimit qe kemi tek Jezus Krishti...

"Ne rangun e armiqve me te keqinj te Lajmit te Mire (Ungjillit) te Krishtit, - thote Wesley, - perfshihen ata qe "gjykojne haptazi vete ligjin" dhe qe "flasin keq per ligjin"; ata qe u mesojne njerezve t'i shkaterrojne, te mos respektojne, te hedhin tej detyrimin e mbajtjes, jo vetem nje, me te rendesishmen, por te gjitha urdheresat me nje goditje...

Rrethane me e çuditshme, qe shoqeron kete mashtrim te madh eshte se ata qe po heqin dore nga ligji ne fakt besojne se po nderojne Krishtin, duke rrenuar ligjin e Tij dhe se po lartesojne figuren e Tij, ndersa shkaterrojne doktrinen e Tij! Po, ata e nderojne Ate tamam si Juda kur tha: "Pershendetje, Mesuesit" dhe e puthi. E Ai mund t'i kishte thene me te drejte secilit prej tyre: "A do ta tradhetosh ti Birin e Njeriut me nje puthje?" Te flasesh per gjakun e Tij, t'i marresh kuroren, te erresosh nje pjese çfaredo te ligjit te Tij nen preteksin e perhapjes se Ungjillit eshte e njejta gje sikur ta tradhetosh me nje puthje. E njejta pergjegjesi rendon mbi supet e te gjithe atyre qe predikojne nje besim, qe ne nje fare menyre, direkt apo indirekt, perpiqet te menjanoje ndonje forme bindjeje, atyre qe predikojne mbi Jezusin ne menyre te tille qe te dobesojne apo demtojne ndonje nga urdheresat e Perendise.

Wesley iu pergjigj keshtu te gjithe atyre qe ngrinin tezen se "predikimi i Ungjillit realizon te gjitha qellimet e ligjit": "ne e mohojme kete teresisht. Ai nuk i jep pergjigje qellimit te pare te ligjit, me fjale te tjera, nuk permbush bindjet e njerezve mbi mekatin, zgjimi i atyre qe jane akoma ne gjume per rrezikun e ferrit."

Apostulli Pal deklaron se "nga ligji vjen njohja e mekatit"; "dhe vetem atehere kur njeriu bindet per mekatet e tij, ai e ndjen me te vertete nevojen per gjakun shlyeres te Krishtit...Dhe ashtu si e ka vene re edhe vete Zoti yne: "te shendoshet nuk kane nevoje per mjekun, por te semuret po." Prandaj eshte absurde t'u ofrosh te shendetshmeve ose atyre qe mendojne se jane te tille nje mjek. Me pare duhet t'i bindesh ata se jane te semure, po nuk bere keshtu ata nuk do te te falenderojne per punen tende. Po kaq absurde eshte t'u ofrosh Jezusin atyre, qe nuk kane njohur kurre ç'eshte merzitja dhe deshperimi." - Ibid, sherbesa 35.

Ndersa predikonte Lajmin e Mire te meshires se Perendise, Wesley u perpoq, ashtu si edhe Mesuesi i tij, "te lartesonte Ligjin dhe t'i jepte atij vendin e nderit." Ai e kreu me besnikeri punen qe ia besoi Zoti dhe arriti rezultate te lavdishme. Ne fund te jetes se tij te gjate - 80 vjet - pothuajse me shume se gjysem shekulli, duke punuar si misionar shetites, ai kishte bindur me shume se gjysem milioni njerez. Por numri i vertete i te gjithe atyre, qe mendonin se puna e tij ishte ngritur nga

rrenojat dhe degradimi i mekatit drejt nje jete me te paster e fisnike, i atyre qe nepermjet mesimit te tij kishin perfituar nje pervoje me te thelle e me te pasur, nuk do te merret vesh deri atehere kur e gjithe familja e te çliruarve do te mblidhet ne mbreterine e Perendise. Jeta e tij perben nje mesim te paçmuar per çdo te krishtere. U reflektofshin besimi dhe perulja, zelli i parreshtur, vetesakrifikimi dhe devocioni i ketij sherbetori te Krishtit edhe ne kishat e diteve tona!

1. Reformatorët mbështeteshin tek "autoriteti i pagabueshëm i Shkrimeve të Shenjta si rregulluesi i besimit dhe praktikimit."Cilët ishin disa nga njerëzit që mbështeteshin tek këto parime? Si ndikoi ne jetën dhe shërbesën e tyre, bindja ndaj Fjalës?

2. Edhe pse Xhon Wesley hoqi dorë nga "shpëtimi me anë të veprave", ai u zotua të vazhdonte jetën e tij strikte dhe vetëmohuese. Cila ishte baza për vendimin e tij që të vazhdonte së bëri vepra të mira?

3. Përkthimi anglisht i Tyndale i Dhjatës së Re "zgjoi interest ë madh" në Angli. Çfarë mund të rezultojë nga influenca e Biblës kur njerëzit e lexojnë dhe studiojnë atë? Shikoni Gjoni 8:32.

4. Cila ishte rëndësia e Greqishtes së Erasmusit në Dhjatën e Re? Në cilat mënyra studiuest e Biblës dhe teologët mund të ndihmojnë në përmbushjen e urdhërimit për ungjillin?

5. Sjellja e Krishterë e Moravianëve e impresionoj thellë Ësleyn dhe e drejtoi atë në shpëtim. A i jeni dorëzuar plotësiht Jezusit në mënyrë që Ai tju bëjë një dëshmi e gjallë?

15.

Bibla dhe Revolucioni Francez

Ne shek.16, Reformacioni, duke ua hapur Biblen njerezve, u perpoq qe te ishte i pranueshem ne te gjitha vendet e Evropes. Disa kombe e priten ate me gezim, tamam si lajmetarin e Qiellit. Ne disa vende te tjera papati e ndaloi me sukses hyrjen e tij dhe drita e njohurise mbi Biblen, si edhe ndikimi i saj frymezues u perjashtuan teresisht.. Ne nje vend, edhe pse drita gjeti shtegun e hyrjes, ajo nuk u kuptua nga erresira. Per shekuj me radhe e verteta dhe e genjeshterta luftuan per te mbizoteruar. Me se fundi e keqja triumfoi dhe e verteta e Qiellit u flak tej. "E ky eshte shkaku i denimit: Drita erdhi ne bote, por njerezve u pelqeu me shume erresira, sepse ata vazhdojne te veprojne keq" - Gjoni 3:19. Kombit iu desh te vilte rezultatet e rruges qe kishte zgjedhur. Kufizimi qe sjell Shpirti i Perendise i braktisi keta njerez, qe e kishin perbuzur dhuraten e meshires se Tij. E keqja u lejua qe te fitonte epersi. Dhe bota mbare pa frutin e mohimit me kokefortesi te drites.

Lufta kunder Bibles, qe kishte vazhduar per vite me radhe ne France, arriti piken kulmore gjate skenave te Revolucionit. Ai shperthim i tmerrshem ishte rezultat i ligjshem i shtypjes qe Roma u beri Shkrimeve te Shenjta. Ajo perfaqeson shembullin me te dukshem te shfaqjes se politikes se papatit qe bota ka perjetuar - ilustrim i rezultateve drejt te cilave prirej mesimi mijevjeçar i Kishes se Romes.

Profetet e kishin paralajmeruar shtypjen qe do t'u behej Shkrimeve te Shenjta gjate pushtetit suprem te papatit si dhe pikat kyçe te rezultateve te tmerrshme qe do te kishte ky zoterim "i njeriut te mekatit", veçanerisht ne France.

Engjelli i Zotit tha: "Per 42 muaj ata do ta shkretojne Jeruzalemin, qytetin e shenjte. Une do t'i dergoj dy deshmitaret e mi. Ata mbajne zi e do te shpallin, nen frymezimin e Shpirtit te Perendise, per 1260 dite ate me te cilen i ngarkoi Perendia.... Kur ta mbarojne shpalljen e lajmit te tyre, Egersira, qe del nga Humnera, do te luftoje me ta, do t'i munde dhe do t'i vrase. Kufomat e tyre do te rrine ne tregun e Jeruzalemit, qytetit te madh ku u kryqezua Zoti i tyre. Emri i figurshem i

atij qyteti do te jete Sodomi ose Egjipti. Banoret e tokes do te gezohen per vdekjen e tyre dhe do t'i ndajne dhurata njeri - tjetrit, sepse te dy keta profete u shkaktuan tortura. Por pas tri ditesh e gjysem, Perendia i gjalleroi perseri profetet me frymen e Tij dhe ata u ngriten perseri ne kembe. Te gjithe ata qe e pane kete u tremben shume." Apokalipsi 11:2-11.

Permenden ketu dy periudha - "42 muaj" dhe "1260 dite" - qe perfaqesojne saktesisht kohen gjate se ciles Roma shtypi kishen e Krishtit. Te 1260 vjetet e epersise se papatit filluan ne vitin 538 e.s. dhe keshtu duhej te perfundonin ne vitin* 1798.

Pikerisht ne ate kohe, nje ushtri franceze pushtoi Romen dhe e burgosi Papen derisa ai vdiq ne mergim. Edhe pse u zgjodh menjehere nje pape i ri, hierarkia e ushtruar nga papati s'ka qene kurre aq e fuqishme sa ajo e meparshmja.

Persekutimi i kishes nuk vazhdoi gjate gjithe kesaj periudhe 1260-te vjeçare. Perendia meshireplote e shkurtoi kohen e kesaj prove te veshtire. Duke paratreguar per "shpagimin e madh", qe do te rendonte mbi kishen, Shpetimtari tha: "Ne qofte se Zoti nuk do ta shkurtonte ate kohe te terrorit, asnjeri nuk do te shpetonte gjalle. Por Ai e shkurtoi per hir te te zgjedhurve te Tij." - Mateu 24:22. Persekutimit iu dha fund perpara vitit 1798, fale ndikimit te Reformacionit.

Duke pasur parasysh dy deshmitaret, profeti me tej deklaron: "Dy deshmitaret jane dy ullinjte dhe dy shandanet, qe qendrojne para Zotit te botes" - Apokalipsi 11:4; Psalmisti thote: "Fjala jote eshte pishtar para hapave te mi, eshte nje drite qe ndriçon rrugen time."

- Psalmi 119:105. Dy deshmitaret perfaqesojne Shkrimet e Shenjta, Dhiaten e Re dhe Dhiaten e Vjeter. Ato jane deshmi te rendesishme te origjines dhe perjetesise se Ligjit te Perendise. Ato deshmojne gjithashtu per planin e shpetimit. Simbolet, flijimet dhe profecite e Dhiates se Vjeter perqendrohen ne figuren e nje Shpetimtari qe po vinte. Ungjillet dhe letrat e Dhiates se Re tregojne per nje Shpetimtar, qe ka ardhur pikerisht ashtu siç e kishin paratreguar ardhjen e Tij simbolet dhe profecia.

"Ata do te mbajne zi per 1260 dite." Deshmitaret e Perendise gjate pjeses me te madhe te kesaj periudhe qendruan ne erresire. Fuqia e papatit u perpoq t'ua fshihte njerezve fjalen e se vertetes dhe u shpalli atyre deshmitare te rreme per ta kundershtuar deshmine e saj. Kur autoritet fetare dhe sekulare e ndaluan Biblen; kur njerezit dhe demonet u perpoqen me sa munden per t'i larguar mendjet njerezore prej saj, duke shtremberuar deshmine qe ajo perfaqesonte, kur te gjithe ata qe guxuan t'i shpallnin te vertetat e saj te shenjta u gjurmuan, u tradhetuan, u torturuan, u groposen ne qeli, u kthyen ne martire per besimin e tyre u detyruan te syrgjynoseshin ne keshtjellat e maleve apo te mbylleshin ne strofullat dhe guvat e tokes - atehere ishin ne zi edhe deshmitaret besnike. E megjithate ata vazhduan te deshmonin pa u ndalur gjate gjithe periudhes 1260 - vjeçare. Edhe ne kohet me te erreta kishte

* parimi vit - dita eshte parimi themelor ne interpretimin e kohes profetike. (te shihen Regjistrimet 14:34; Jehezkeli 4:6; Danieli 8:14; 7:25 dhe Apokalipsi 11:2; 13:5; 12:6; 11:3)

njerez besnike, qe e donin fjalen e Zotit dhe e ngriten lart nderin e Tij. Pikerisht ketyre njerezve iu dha mençuri, energji dhe autoritet per te shpallur te vertetat e Tij gjate kesaj periudhe.

"Ne qofte se ndokush kerkon t'u beje keq, nga goja do t'u dale zjarr dhe do t'i perpije armiqte e tyre. Ne kete menyre mbarojne te gjithe ata qe kerkojne t'u bejne dem." -Apokalipsi 11:5. Njerezit qe marrin neper kembe fjalen e Perendise nuk mund te mos ndeshkohen. Kuptimi i ketij denoncimi te frikshem qartesohet ne kapitullin e fundit te Apokalipsit:... "Une, Gjoni, paralajmeroj cilindo qe i degjon fjalet profetike te ketij libri: kush u shton ketyre fjaleve ndonje send, atij do t'ia shtoje Perendia plaget e pershkruara ne kete liber. Por kush i heq ndonje fjale ketij libri, atij do t'ia heqe Perendia pjesen ne pemen e jetes dhe ne qytetin e shenjte qe jane pershkruar ne kete liber." Apokalipsi 22:18,19.

Te tilla jane paralajmerimet qe ka dhene Perendia per t'i mbajtur njerezit larg nga çfaredo lloj ndryshimi qe ata mund te ndermarrin mbi ato qe ua ka zbulluar apo komanduar vete Ai. Keto denoncime solemne u drejtohen te gjithe atyre qe perdorin influencen e tyre per te udhehequr te tjeret drejt nenvleftesimit te ligjit te Perendise.

Te gjithe ata qe paturpesisht e konsiderojne bindjen apo mosbindjen ndaj ligjit te Zotit si problem pa rendesi duhet te dridhen nga frike e ketyre denoncimeve.Te gjithe ata qe lartesojne opinionet e tyre mbi zbulesen hyjnore, ata qe ndryshojne kuptimin e qarte te Shkrimit te Shenjte ne perputhje me rehatine e tyre apo per t'u pajtuar me boten, po marrin mbi supe nje pergjegjesi te frikshme. Fjala e shkruar, Ligji i Zotit do te percaktoje karakterin e çdo njeriu dhe do te denoje te gjithe ata qe e konsiderojne te paplote kete kriter te pagabueshem.

"Kur ata te kene mbaruar (te jene duke mbaruar) deshmine e tyre"...Periudha e deshmise se dy deshmitareve ne zi perfundoi ne vitin 1798-te. E ndersa ata po i afroheshin fundit te punes se tyre ne erresisre, fuqia e perfaqesuar si "Egersira qe del nga Humnera" u shpalli lufte atyre. Ne shume vende te Evropes, Satani kishte kontrolluar per shekuj me radhe, nepermjet papatit, forcat shteterore dhe fetare. Por ketu del ne pah nje manifestim i ri i fuqise satanike.

Dhenia e Bibles ne gjuhe te panjohura dhe fshehja e saj nga njerezit nen preteksin e shfaqjes se nderimit ndaj saj, kishte qene politika e Romes per nje kohe te gjate. Nen sundimin e saj deshmitaret deshmuan: "ne zi". Por u ngrit nje fuqi tjeter - Egersira e humneres - qe i shpalli lufte fjales se Perendise.

"Qyteti i madh", ne rruget e te cilit u theren deshmitaret dhe ku u derdhen trupat e tyre pa jete, eshte "shpirterisht" Egjypti. Nga te gjitha kombet qe prezantohen ne historine biblike eshte Egjypti ai qe e mohoi me kembengulje ekzistencen e Perendise qe jeton dhe i rezistoi urdheresave te Tij. Mbreti i Egjyptit ishte monarku qe guxoi me shume se te tjeret te rebelonte haptazi ndaj autoritetit te Qiellit. kur

Moisiu ne emer te Zotit i solli mesazhin ai u pergjigj me krenari: "E kush eshte Zoti? Perse ta degjoj dhe ta lejoj popullin e Izraelit te shkoje?" - Libri i Daljes 5:2 A.R.V. Ky eshte ateizem. Kombi i perfaqesuar nga Egjypti do t'i mohonte ne te njejeten menyre kerkesat e Zotit qe jeton dhe do te manifestonte te njejtin shpirt mosbesimi dhe provokimi. "Qyteti i madh" krahasohet gjithashtu "shpirterisht" me Sodomin. Korrupsioni qe thyerja e ligjit te Perendise solli ne Sodom u shpreh veçanerisht ne shthurje morale. Kombi qe do te permbushte kushtet e pershkruara ne Shkrimin e Shenjte do te karakterizohej nga i njejti mekat.

Sipas fjaleve te profetit, nje fuqi me origjine dhe karakter satanik, do te shfaqej per t'i shpallur lufte Bibles, pak perpara vitit 1798. Dhe pikerisht aty, ku deshmia e dy deshmitareve te Perendise nuk do te degjohej me, do te manifestoheshin ateizmi i faraonit dhe shthurja e Sodomit.

Kjo profeci eshte permbushur plotesisht dhe dukshem ne historine e Frances. Gjate Revolucionit, ne vitin 1793 "bota degjoi per here te pare nje asmble njerezish, te lindur e te edukuar ne qyteterim, qe kishin marre mbi vete te drejten per te qeverisur nje nga kombet me te shquar evropiane zerin se bashku per te mohuar te verteten me solemne qe pranon shpirti njerezor dhe qe unanimisht hoqen dore nga besimi dhe adhurimi i nje madherie". - Z. walter Scott; "Jeta e Napoleonit", vol.I., kap. 17. "Franca eshte i vetmi vend ne bote, ne te cilin kane mbijetuar te dhena autentike qe provojne se ajo rebeloi haptazi kunder Autorit te Universit. Kane ekzistuar e vazhdojne te ekzistojne me mijera blasfemuese, me qindra ateiste ne Angli, Gjermani, Spanje e ne vende te tjera, por Franca qendron veç ne historine e botes, si i vetmi shtet qe deklaroi me ane te nje dekreti te asamblese Kushtetuese se nuk ka Zot dhe duke degjuar kete njoftim e gjithe popullsia e kryeqytetit si edhe pjesa me e madhe e popullsise se fshatit, burra dhe gra, kenduan dhe kercyen nga gezimi." - Blackwood's Magazine, nentor 1870.

Franca misheroi gjithashtu karakteristikat qe shquan Sodomin.Gjate Revolucionit u manifestua e njejta gjendje poshterimi moral dhe korrupsioni qe kishte sjelle dikur shkaterrimin e qyteteve te rrafshines. Dhe historiani paraqet dhe ateizmin edhe shthurjen e Frances, pikerisht ashtu si jane dhene edhe ne profeci: "Lidhja e ngushte me ligjet qe preken fene ishte arsyeja e dobesimit te marteses si bashkim - lidhja me e shenjte qe formohet mes dy qeniesh njerezore, qendrueshmeria e se ciles çon ne konsolidimin me te forte te shoqerise - deri ne ate pike, saqe ajo u kthye thjesht ne nje kontrate civile me karakter kalimtar, te cilin mund ta lidhnin dy persona çfaredo dhe te zgjidhej nga kenaqesite....Ne qofte se shoket do t'i hynin punes per te zbuluar nje menyre efikase per te shkaterruar gjithçka te nderuar, te hijshme dhe te qendrueshme ne jeten familjare dhe te kishin ne te njejten kohe sigurine qe demi - krijimi i te cilit kishte qene qellimi i tyre - do te perjetonte nga brezi ne brez, ata nuk do te mund te zbulonin nje plan me efikas se shkaterrimi i marteses...

Sophie Arnoult, aktore e famshme per gjerat e mençura qe thoshte, e pershkroi martesen publike si "simbol te tradhetise bashkoshortore" - Scott, vol. I, k. 17.

"Kur u kryqezua Zoti i tyre" Franca permbushi gjithashtu edhe kete karakteristike te profecise. Ne France shpirti i armiqesive kunder Krishtit ishte shfaqur me dukshem se kudo tjeter. Ne asnje vend tjeter e verteta nuk ishte ndeshur me nje kundershtim te tille mizor dhe te ashper. Persekutimi qe ra mbi deshmitaret e lajmit te mire tregoi se Franca e kryqezoi Mesine sa here denoi nxenesit e Tij.

Gjaku i shenjtoreve u derdh per shekuj me radhe. Albigenset* e Frances deshmuan mbi te verteten ashtu si edhe vellezerit e tyre, Waldenset, qe dhane jeten ne malin Piemond "per fjalen e Perendise dhe per deshmine e Jezus Krishtit". Gjate diteve te Reformacionit, nxenesit e Tij gjeten vdekjen nga torturate tmerrshme. Mbreti dhe fisniket, grate e familjeve te larta dhe vajzat delikate, krenaria dhe fisnikeria e kombit, kishte bere feste mbi agonite e ketyre martireve te Jezusit. Huguenatsit e guximshem, duke luftuar per ato te drejta qe konsideroheshin si te shenjta nga çdo zemer njerezore, kishin derdhur gjakun mbi shume fusha betejash te veshtira. Protestanet dolen jashte ligjit, nje çmim u vu per kokat e tyre dhe ata ndiqeshin si kafshe te egra.

"Kisha e shkretetires", ai grup i vogel i pasardhesve te kristianeve te hershem, qe ekzistonte akoma ne France ne shekullin e 18-te, duke u fshehur maleve te jugut, mbajti akoma gjalle besimin e eterve te tyre. Kaloret i ndiqnin, ndersa ata udhetonin per t'u takuar naten ne male ose ne shqopishta te shkreta, duke i mbyllur ne burgje dhe ne skllaveri te perjetshme. Njerezit me te paster, me te zgjedhur e me inteligjente te Frances u vune ne zinxhire, duke u torturuar barbarisht si vjedhes dhe vrases. Te tjeret, me te cilet u sollen me me meshire, u vrane me gjakftohtesi, ndersa ata gjunjezoheshin, ta paarmatosur e te pashprese, per t'u lutur. Trupat pa jete te qindrave te moshuarve, grave te pambrojtura dhe femijeve te pafajshem, u lane ne toke prane vendeve te takimit. Ishte e zakonshme qe te gjeje "trupa pa jete, qe ndotnin lendinen ne cdo kater hapa dhe skelete qe vareshin ne peme", ndersa udhetoje ne malet dhe pyjet, qe ishin vendet ku ata e kishin bere zakon te mblidheshin. Vendi i tyre, shkaterruar nga shpata, nga sepata dhe nga turrat e druve "ishte kthyer ne nje shkretetire te erret dhe te madhe". Keto barbarizma nuk ndodhen..... ne mesjete, por ne kohen e shkelqyer te Luigjit te 14-te. Gjate asaj kohe u kultivua shkenca, shkelqeu letersia dhe teologet e oborrit mbreteror dhe te kryeqytetit ishin njerez te ditur dhe elokuent, te prekur thellesisht nga meshira per te perulurit dhe nga miresia". - Ibid.,b.22,k.7.

Por Masakra e Bartolomeut ishte me e erreta e katalogut te zi te krimeve, me e tmerrshmja nder aktet mizore te te gjithe koherave. Bota akoma mban mend me tmerr dritherues skenat e atij sulmi mizor dhe prelatet e Romes e aprovuan kete pune te tmerrshme. Kembana qe ra ne erresiren e nates ishte sinjali i therjes. Me

* Albigenses - njihen ndryshe si refugjatet e Bohemise

mijera protestante, qe flinin te qete ne shtepite e tyre duke i besuar fjales se nderit te mbretit u terhoqen zvarre dhe u vrane pa paralajmerim dhe me gjakftohtesi.

Ashtu si Mesia ishte udheheqesi i padukshem i njerezve te Tij gjate çlirimit te tyre nga Egjypti, ashtu edhe Satani ishte udheheqesi i padukshem i varesve te tij gjate punes mizore per te shtuar numrine martireve. Masakra vazhdoi ne Paris per shtate dite, tri ditet e para me nje furi te pabesueshme. Ajo madje nuk u kufizua vetem brenda qytetit, por me nje urdher te veçante te mbretit u zgjerua edhe ne provincat dhe qytetet e tjera ku jetonin protestante.Nuk u respektuan as mosha dhe as seksi. Nuk u kursye as foshnja dhe as burri me thinja te bardha ne koke. Fisniku dhe fshatari, i vjetri dhe i riu, nena dhe femija paten te njejtin fund. Kjo masaker vazhdoi ne te gjithe Francen per dy muaj. U zhduken 70 000 veta nga lulja e kombit.

"Kur lajmi i masakres arriti Romen, ngazellimi i klerit s'kishte kufi. Kardinali i Lorenes i dha lajmetarit 1 000 korona si shperblim, topi i Shen Angelos gjemoi ne nje pershendetje gezimi; rane kembanat e çdo kulle, zjarret e medha e kthyen naten ne dite dhe Gragori i 13-te, i ndjekur nga kardinale dhe autoritete te larta kishtare, shkoi ne kishen e

Shen Luizit, ku kardinali i Lorenes kendoi psalmin e Te Deum-it..... Per te perkujtuar masakren u derdh nje medalje dhe sot ne Vatikan mund te shihen tre afresket e Vasarit, qe pershruajne sulmin mbi admiralin, mbretin ne keshill, duke komplotuar masakren dhe ne te treten vete masakren. Gregori i dergoi Karlit "Trendafilin e Arte" dhe vetem kater muaj pas masakres .....ai degjoi i vetekenaqur sherbesen e nje prifti francez qe foli mbi "ate dite te mbushur me lumturi dhe gezim, kur ati i shenjte mori lajmin dhe shkoi solemnisht per te falenderuar Perendine dhe Shen Luizin". - Henry White, "Masakra e Shen Bartolomeut", k.14; parag.34

I njejti shpirt drejtues qe nxiti Masakren e Shen Bartolomeut udhehoqi gjithashtu skenat e Revolucionit. Jezu Krishti u quajt mashtrues dhe britma tallese e te pafeve franceze ishte kjo: "Shtypni te keqin2, duke pasur parasysh Krishtin. Blasfemia e marre kunder qiellit dhe e keqja e urryer punuan koke me koke dhe keshtu njerezit me te ulet, perbindeshat me te harruar te mizorise dhe veseve u ngjiten ne shkallet me te larta. Nga e gjitha kjo Satanit iu bene nderimet e rastit, ndersa Krishti u kryqezua, pavaresisht nga karakteristikat e Tij, te se vertetes, te pastertise dhe te dashurise pa kufi.

"Egersira qe del nga Humnera do te luftoje me ta, do t'i munde dhe do t'i vrase". Ne France, fuqia ateiste ne pushtet gjate Revolucionit dhe periudhes qe njihet ne histori si Mbreterimi i Terrorit, ndermori nje lufte te tille kunder Zotit dhe fjales se Tij te shenjte, qe nuk kishte pare ndonjehere me pare. Adhurimi i Keshillit* u ndalua nga Asambleja Kombetare. Urrejtja u manifestua hapur ne mbledhjen dhe djegien publike te Biblave. Ligji i Perendise u shkel me kembe. U anulluan te

gjitha institucionet qe kishin te benin me Biblen. Dita e pushimit te perjavshem u harrua dhe ne vend te saj çdo dhjete dite behej aheng dhe blasfemohej.U ndaluan si pagezimi ashtu edhe sherbesa e komunionit. Shpalljet e vena me ndergjegje ne varreza e konsideronin vdekjen si nje gjume te perjetshem.

Te kishe frike nga Zoti nuk ishte zgjuaresi, perkundrazi ishte budallallek. U ndalua çdo lloj adhurimi fetar, perveç adhurimit te lirise dhe atdheut. "Peshkopi i plotefuqishem i Parisit doli para popullit per te luajtur rolin kryesor ne farsen me te paturpshme dhe skandaloze qe ishte luajtur ndonjehere ne nje perfaqesim kombetar...Ai u shfaq i ndjekur nga nje procesion i gjate, per te deklaruar perpara Kuvendit se feja mbi te cilen ai kishte dhene mesime per kaq vjet me radhe ishte ne çdo aspekt krijim i duarve te nje prifti, qe nuk bazohej as ne histori dhe as ne te verteten e shenjte. Ai e mohoi, ne terma te sakta e solemne, ekzistencen e nje Madheshtie, adhurimit te te cilit ai i kishte perkushtuar jeten e tij dhe deklaroi se ne te ardhmen do t'i kushtohej nderimit te lirise, barazise, virtytit dhe moralit. Pas kesaj ai vendosi mbi tavoline dekoracionet e tij peshkopale dhe u perqafua vellazerisht me presidentin e Kuvendit. Shembulli i ketij prelati u ndoq nga nje numer i madh prifterinjsh femohues." - Scott, vol. I, k.17

"Banoret e tokes do te galdojne per vdekjen e tyre dhe do t'i ndajne dhurata njeri - tjetrit, sepse te dy keta profete u shkaktuan tortura". Franca e pafe ia mbylli gojen zerit akuzues te dy deshmitareve te Zotit. Fjalet e se vertetes u shtrine pa jete ne rruget e saj dhe te gjithe ata qe urrenin kufizimet dhe kerkesat e ligjit te Perendise, u ngazellyen. Njerezit sfiduan publikisht Mbretin e Qiellit. Ata bertiten ashtu si mekataret e hershem: "Perendia nuk ve re asgje. E si mund ta dije Ai lart ne qiell se çfare behet ketu poshte?" - Psalmet 73:11

Njeri nga prifterinjte e urdherit te vjeter, me nje guxim blasfemik te pabesueshem tha: "Perendi, ne qofte se ekziston hakmerru per emrin Tend te plagosur. Po! Te sfidoj! Ti qendron i heshtur; Ti nuk guxon te leshosh bubullimat e Tua. Kush do te besoje pas kesaj ne ekzistencen Tende?" - Lacretelle, Histori, vol. I,k.10. Sa e ngjashme eshte kjo me pyetjen e Faraonit: "E kush eshte Zoti? Perse ta degjoj dhe ta lejoj popullin e Izraelit te shkoje? Une nuk e njoh Zotin....."

"Jane te marre ata qe thone: Nuk ka Perendi qe t'i japim llogari!" - Psalmi 14:1. Dhe vete Zoti ka deklaruar keshtu per ata qe shtremberojne te verteten: "...do te jete e qarte per te gjithe se veprojne pa mend..." - 2 Timoteut 3:9. Pasi Franca hoqi dore nga adhurimi i Perendise qe jeton, "i te Lartit dhe Kryelartit qe jeton perjetesisht", iu desh pak kohe per te zbritur ne idhulltari, nepermjet adhurimit te Perendeshes se Arsyes, e personifikuar ne figuren e nje gruaje te çthurur. E kjo ndodhi ne asamblene perfaqesuese te kombit nga autoritetet me te larta civile dhe legjislative! Historiani thote: "Nje nga ceremonite e kesaj periudhe te çorientuar nuk mund te krahasohet me te tjerat per kombinimin e absurditetit me mungesen

* Keshilli - nje bashkesi fetare, pergjegjese per organizimin e punes se kishave.

e respektit.Dyert e Kuvendit iu hapen nje bande muzikantesh qe paraprinin hyrjen e procesionit solemn te anetareve bashkiake, duke kenduar nje himn ne lavderim te lirise dhe duke shoqeruar objektin e adhurimit te tyre te ardhshem, nje grua te mbuluar me vello, te cilen ata e quajten Perendesha e Arsyes. Me t'u futur ne salle ajo u zbulua me temena dhe u vendos ne krah te djathte te presidentit, zakonisht e meshiruar nga nje prej kercimtareve te operas.....Kuvendi Kombetar i Frances i beri ketij personi nderim publik, si perfaqesuesi me i denje i arsyes qe ata adhuronin.

"Kjo pantonime qesharake dhe fallso hyri ne mode, dhe vendosja e Perendeshes se Arsyes u rinovua dhe u imitua ne te gjithe vendin, ne ato vende, banoret e te cileve deshironin te shfaqeshin si te barabarte me te gjitha nivelet e Revolucionit".- Scott,vol.I,k.17.

Oratori qe paraqiti adhurimin e Arsyes tha: "Legjislatore! Fanatizmi i hapi rrugen arsyes. Syte e tij te mjegulluar nuk mund ta duronin shkelqimin e drites. Sot, poshte ketyre varreve gotike, eshte shfaqur nje bashkeperkim i pafund, i cili rikujton per here te pare te verteten. Atje, francezet festuan adhurimin e vetem te vertete - ate te Lirise. ate te Arsyes. Atje ne kemi uruar prosperitetin e kraheve te Republikes. Atje ne kemi braktisur idhuj te pajete per te rrokur Arsyen, imazhin e gjate, kryevepren e natyres". - M.A. Thiers. "Historia e Revolucionit francez", vol.2; fq.370,371.

Kur perendesha erdhi ne Kuvend, oratori e mori ate nga dora dhe duke iu drejtuar asamblese tha: "Mortale mos u dridhne me perpara gjemimeve te pafuqishme te nje Zoti, qe ka krijuar vetem friken tuaj. qe tani e tutje njihni vetem Arsyen, asnje hyjni tjeter. Une ju afroj imazhin me fisnik e me te paster, ne qofte se duhet te keni idhuj, flijojuni vetem nje te tilli.....Gjunjezohuni perpara Senatit madheshtor te Lirise, oh! Vellos se Arsyes".

"Perendesha pasi u perqafua nga presidenti, i hipur ne nje makine te mrekullueshme u çua permes nje turme pafund, ne katedralen e Notre Damit, per t'u vendosur ne vend te madheshtise. Atje, ajo u ngrit mbi nje altar te larte dhe u adhurua nga te gjithe te pranishmit". - Alison, vol. 1, k. 10

Pak me pas, kjo ngjarje u pasua nga djegia publike e Biblave. Ne here "Shoqeria Popullore e Muzeut" hyri ne hollin e bashkise, duke bertitur: "rrofte arsyeja!" dhe duke mbajtur ne maje te nje shkopi mbetjet gjysme te djegura te librave te ndryshem, mes te cileve libra lutjesh, meshtare dhe Dhiata te Reja e te Vjetra. "Digjni ne zjarr, - tha presidenti, - te gjitha budallalleqet qe ato ia kishin diktuar races njerezore." - Journal of Paris (Gazeta e Parisit), 1793, nr. 318. Duke iu referuar "Mbledhjes se Historise Parlamentare" ne Buckesrouse, vol. 30; faqe 200,201.

Ateizmi perfundoi punen e nisur nga papati. Politika e Romes krijoi kushtet e duhura sociale, politike dhe fetare, qe pershpejtuan rrenimin e Frances. Shkrimtaret, duke iu referuar tmerreve te revolicionit, thone se frono mbreteror dhe kisha jane perghegjese per keto mizori. Po te themi te verteten, vetem kisha eshte pergjegjese

per to. Papa dhe klika e tij helmuan mendjet e mbreterve dhe i ngriten ata kunder Reformacionit, duke e paraqitur kete te fundit si armik te fronit, molle sherri qe do te ishte fatal per paqen dhe harmonine e kombit. Gjeniu i romes frymezoi nepermjet nje mase te tille, mizorite me te tmerrshme dhe shtypjen me poshteruese qe e paten zanafillen tek froni mbreteror.

Bibla solli kudo shpirtin e lirise. Mendjet e njerezve u zgjuan, kudo ku u pranua lajmi i mire. Ata filluan te flaknin tutje prangat qe i paten kthyer ne skllever te injorances, vesit dhe supersticionit. Filluan te mendonin e te vepronin si qenie njerezore. Monarket e vune re kete dhe paten frike nga despotizmi i tyre.

Roma nxitoi ta ringjallte friken e tyre. Ne vitin 1525 Papa i tha regjentit* francez: "Kjo mani [Protestanizmi nuk do te shtremberoje dhe nuk,do te shkaterroje vetem fene, por edhe te gjitha principatat, fisnikerine, ligjet, urdherat dhe klasat e tjera poshte saj." - g. de Felice, "Historia e Protestanteve franceze", b.1, k.2, par.8. Pas disa vitesh, nje nun i papatit e paralajmeronte keshtu mbretin: "mos u mashtro! Protestantet do te trondisin si rregullin fetar, ashtu edhe ate civil..... Fronin mbreteror e kercenon i njejti rrezik si altarin..... Paraqitja e nje feje te re do te sillte padyshim vendosjen e nje qeverie te re". - D'Aubigne, "Historia e Reformacionit ne evrope gjate kohes se Calvinit, b.12; k.36. Teologet u bene thirrje paragjykimeve njerezore, duke deklaruar se doktrina Protestante" i josh njerezit drejt se rese dhe budallallekut, ajo i rremben mbretit dashurine e devotshme te shtetasve te tij dhe shkaterron si kishen ashtu edhe shtetin". Keshtu roma ia doli mbane qe ta rreshtonte Francen krah kundershtareve te Reformacionit. "Shpata e persekutimit u zhvesh ne France, se pari per te lartesuar fronin mbreteror, per te kursyer fisniket dhe per te ruajtur ligjin". - Wylie, b.13; k.4

Sundimtaret e vendit nuk i parashikuan dot rezultatet e nje politike te tille fatale. Mesimet e Bibnles do te kishin mbjelle ne mendjet dhe zemrat e njerezve ato parime te drejtesise, te rregullit, te se vertetes, te paanesise dhe te miredashjes, qe perbejne themelet e prosperitetit te nje kombi. "Drejtesia e ben popullin te madh", keshtu "sundimi i tyre forcohet me drejtesi 2 - fjalet e urta 14:34, 16:22. "Meqe te gjithe do te bejne ate qe eshte e drejte" rrjedhimisht "do te kete paqe dhe siguri pergjithmone" - Jeshaja 32:17. Ai qe i bindet ligjit hyjnor padyshim do t'u bindet dhe do t'i respektoje ligjet e vendit te tij. Ai qe respekton Perendine do te nderoje mbretin sa here ai ushtron autoritet te drejte e ligjor. Por Franca e trishtuar e ndaloi Biblen dhe i nxorri jashte ligjit nxenesit e saj. Shekuj pas shekujsh, njerez me principe dhe integritet, njerez me perpikmeri intelektuale dhe fuqi morale, qe paten guximin t'i shprehin haptazi bindjet e tyre dhe paten besimin e duhur per te vuajtur per te verteten - per shekuj me radhe njerez te tille punuan si skllever neper burgje, u zhduken mbi turrat e druve apo u kalben ne qeli. Me mijera te tjere shpetuan, duke u arratisur dehe kjo vazhdoi per 250 vjet pas fillimit te Reformacionit.

---

* regjent - anetar i keshillit

"Gjate asaj periudhe te gjate, te gjithe brezat e francezeve u bene deshmitare te largimit te nxenesve te ungjillit per shkak te terbimit te çmendur te persekutoreve, duke marre me vete inteligjencen, artin, industrine dhe rregullin, qe si rregull perbenin karakteristikat e ketyre njerezve per te pasuruar me to vendet ne te cilat gjeten strehe. E ndersa u dhuronin vendeve te tjera te tilla dhunti te mira, ata zbraznin vendin e tyre ne te njejtin raport. Ne qofte se gjithçka qe u largua do te kishte mbetur ne France, ne qofte se aftesite industriale te te merguarve gjate ketyre 300 vjeteve do te kishin kultivuar truallin e saj, ne qofte se prirjet e tyre artistike, gjate ketyre 300 vjeteve, do te kishin permiresuar manifakturat e saj, ne qofte se gjenialiteti i tyre krijues dhe fuqia e tyre analitike, gjate ketyre 300 vjeteve, do te kishte pasuruar letersine dhe do te kishte kultivuar shkencen e saj, ne qofte se mençuria e tyre do te kishte udhehequr kashillat e saj, guximi i tyre do te kishte luftuar ne betejat e saj, drejtesia e tyre do t'u kishte dhene forme ligjeve te saj dhe feja e Bibles do te kishte fuqizuar intelektin dhe do te kishte qeverisur ndergjegjen e njerezve.. çfare lavdie do te kishte qarkuar Francen! Çfare vendi madheshtor, i lulezuar dhe i lumtur - shembull per kombet e tjere - do te ishte ajo.

"Por fanatizmi i pameshirshem dhe i verber deboi nga trualli i saj çdo mesues virtyti, çdo kampion rregulli, çdo mbrojtes te ndershem te fronit mbreteror, ai i tha njerezve qe mund t'i kishin dhene vendit te tyre "fame dhe lavdi" mbi toke: "Zgjidhni çfare doni, turren e druve apo mergimin". Se fundi rrenimi i shtetit ishte teresor, nuk mbeti me ndergjegje per t'u nxjerre jashte ligji, s'meti me fe per t'u terhequrzvarre drejt turres se druve, s'meti me patriotizem per t'u syrgjynosur". - Wylie, b.13, k.20. Revolucioni me tmerret e tij ishte i vetmi rezultat mizor.

"Lufta e Huguenotesve solli nje renie te pergjithshme mbi Francen. Qytete te lulezuara manifakturash u kalben, zona pjellore u rikthyen ne shkretetira; monotonia intelektuale dhe rrenimi moral mbizoteruan nje periudhe te tille qe perjashtonte perparimin. Parisi u kthye ne nje shtepi te madhe te vobektish dhe nga te dhenat rezulton se ne fund te revolucionit 200 000 varfanjake i kerkuan lemoshe mbretit. Vetem jezuitet lulezuan ne nje komb qe po kalbej, duke sunduar mbi kishat dhe shkollat, burgjet dhe galerat me nje tirani te tmerrshme".

Ungjilli do t'i kishte sjelle Frances zgjidhjen e atyre problemevepolitike dhe sociale qe hutuan klerin, mbretin dhe legjislatoret e saj dhe qe perfundimisht e zhyten kombin ne anarki dhe rrenim. Por njerezit paten humbur nen sundimin e Romes mesimet e bekuara te Shpetimtarit mbi vetesakrifikimin dhe dashurine joegoiste. ata i kishin larguar nga ideja dhe praktika e vetemohimit per te miren e te tjereve. Te pasurit nuk qortoheshinper shtypjen qe ushtronin mbi te varferit dhe te varferit nuk ndihmoheshin per t'i shpetuar skllaverise dhe degradimit. Egoizmi i te pasurve dhe te pushtetshmeve u be me shtypes dhe me i dukshem se kurre. Per shekuj me radhe lakmia dhe plangprishja e fisnikeve, çoi ne rrembimin me force te

gjithçkaje qe i kishte mbetur fshatarit. Te pasurit shtypnin te varferit dhe te varferit urrenin te pasurit.

Ne shume provinca te fisniket ishin pronare te çifligjeve, ndersa klasat punonjese ishin vetem qiramarres,ata ishin ne meshire te pronareve te tokes dhe ishin te detyruar te plotesonin kerkesat e tyre te ekzagjeruar. Klasat e mesme dhe te uleta te shoqerise duronin mbi supe barren e dyfishte te mbajtjes se shtetit dhe kishes duke i paguar taksa te larta si autoriteteve civile, ashtu edhe klerit. "Kenaqesia e fisnikeve konsiderohej si ligj suprem; persa i perkiste ketyre shtypesve, fermeret dhe fshataret edhe mund te vdisnin urie. Njerezit shume shpejt ishin te detyruar t'u pergjigjeshin vetem interesave te pronareve te tokes. Jeta e bujqve ishte jete pune e pashtershme dhe mjerimi, qe nuk mund te tregohej. Ankesat e tyre, gjithmone nese guxonin te ankoheshin, trajtoheshin me nje perçmim fyes. Gjyqet gjithmone degjonin fisnikun edhe kur ishte bujku qe ankohej, dihej qe gjykatesit merrnin rryshfet dhe teka me e vogel e aristokracise ishte ligj sipas ketij sistemi te korrupsionit total. Me pak se gjysma e yaksave qe i vilej masave te thjeshta te popullsise nga magnatet sekulare nga njera ane dhe nga kleri nga ana tjeter, perfundonin ne buxhetin mbreteror apo peshkopal, pjesa me e madhe shkonte per te permbushur nevojat personalete ketyre njerezve te shthurur. Personat qe ne kete menyre varferonin bashkeshtetasit e tyre, perfitonin shume nga sistemi i taksave dhe ishin caktuar nga ligji apo zakonet ne ofiqet me te rendesishme te shtetit. Klasat e privilegjuara numeroheshin ne 250 000 veta, ndersa miliona te tjere per te kenaqur ata ishin denuar te jetonin nje jete te pashprese dhe degraduese.

Gjyqi u dorezua perpara luksit dhe rryshfetit. Mes popullit dhe sunduesve ekzistonte fare pak besim. Te gjitha masat e marra nga qeveria shiheshin me dyshim si te qellimta dhe egoiste. Per me shume se gjysem shekulli perpara Revolucionit froni ishte ne duart e Luigjit te 15-te, i cili edhe ne ato kohe te mbrapshta u shqua si nje monark dembel, mendjelehte dhe i dhene pas qejfit. Me nje aristokraci mizore dhe te korruptuar, me klasat e uleta te shoqerise kaq te varfera dhe injorante, me nje gjendje financiare kaq te lekundur dhe me nje popullsi kaq te zemeruar, nuk duhej syri i profetit per te parashikuar nje shperthim te afert. Mbreti ishte mesuar t'i pergjigjej paralajmerimeve te keshilltareve te tij keshtu: "Perpiquni t'i mbani gjerat ne kete nivel per aq gjate sa mendohet se do te jetoj une, pas vdekjes sime te ndodhe çfare te doje." Me kot u parashtrua nevoja e reformes. Ai i vuri re te keqijat, por s'pati as guximin as fuqine per t'u prere rrugen atyre. Fati qe e priste Francen vizohet shume qarte ne pergjigjen e tijfyese dhe egoiste: "Pas meje, le te permbytet!".

Roma, duke punuar permes xhelozise se mbreterve dhe klasave ne pushtet, kishte ndikuar qe ata t'i mbanin njerezit ne roberi, duke e ditur mire se kjo do ta dobesonte shtetin dhe duke synuar, qe nepermjet kesaj, t'i mberthente si sundimtaret, ashtu edhe popujt ne skllaverine e saj. Ajo e dinte, nga nje politike e tille larg-

pamese, se per t'i roberuar me efektivisht njerezit prangat duheshin vene ne shpirtin e tyre; e dinte se menyra me e sigurt per t'i pasur ata gjithmone ne skllaveri ishte qe t'i bente ata te paafte per te fituar lirine. Degradimi moral dhe politik ishte nje mije here me i tmerrshem se vuajtja fizike qe rezultonte nga politika e saj. Njerezit te braktisur ne mesimet e fanatizmit dhe egoizmit dhe te mbetur pa Biblen, kishin perqafuar injorancen dhe supersticionin dhe ishin zhytur ne vese, duke qene keshtu te paafte per t'u veteqeverisur.

Por rezultati i te gjithe kesaj situate ishte krejt ndryshe nga ai qe Roma kishte planifikuar. Puna e saj beri qe ne vend qe masdat t'i nenshtroheshin verberisht dogmave te saj, ata u kthyen ne revolucionare dhe jo besimtare. Romanizmi konsiderohej me perçmim prej tyre si puna e krijuar nga nje prift. Ata ia vinin klerit nje pjese te fajit per shtypjen e tyre. I vetmi Zot qe njihnin ishte Zoti i skicuar nga Roma; mesimet e saj perbenin te vetmen fe. Keshtu qe, duke menduar se lakmia dhe mizoria romane ishin fryte te ligjshme te Bibles, ata nuk donin te kishin te benin fare me te.

Roma e kishte keqperfaqesuar karakterin e Zotit dhe i kishte shtremberuar kerkesat e Tij dhe tani jjerezit i mohonin si Biblen ashtu edhe Autorin e Saj. Ajo kishte kerkuar nje besim te verber ndaj dogmave te saj, nen te ashtuquajturin shenjterim te Shkrimeve te Shenjta. Si kunderpergjigje, Voltaire*-i dhe shoket e tij hoqen dore krejtesisht nga fjala e Zotit dhe perhapen kudo helmin e pabesise. Roma i kishte gjunjezuar njerezit nen thundren e saj te hekurt dhe tashme, masat, te degraduara e te egersuara, dukwe iu zbrapsur tiranise se saj flaken tej çdo kufizim. Te terbuar nga mashtrimi shkelqyes, te cilin e kishin nderuar, ata mohuan bashke me mashtrimin edhe te verteten e ndersa keqkuptonin shthurjen si liri, skllleverit e vesit iu gezuan lirise se tyre te imagjinuar.

Ne fillim te revolucionit, njerrezve iu dha nga nje koncesion i mbetur e drejta e perfaqesimit, qe e kalonte numrin e fisnikeve dhe klerit se bashku. Edhe pse pushteti ishte ne duart e tyre ata, nuk ishin te pergatitur ta perdornin kete mundesi me zgjuarsi dhe tolerance. Te etur per te ndrequr gabimet, te cilat i kishin vuajtur mbi kurriz, ata vendosen te ndermmerrnin rikonstruksionin e shoqerise. Nje popullsi e tille e inatosur, qe ruante ne mendje per nje kohe te gjate kujtime te hidhura vuajtjesh, vendosi ta shnderronte rrenjesisht kete gjendje mjerimi, qe ishte bere e padurueshme dhe te hakmerrej ndaj atyre qe i konsideronte si autore te vuajtjeve pafund. Te shtypurit vune ne praktike mesimin qe paten mesuar nen zgjedhen e tiranise, duke u kthyer ne shtypes te atyre qe dikur i paten shtypur ata vete.

Franca e trishtuar korri me gjak ate qe pati mbjelle. Nenshtrimi i saj ndaj fuqise kontrolluese te Romes kishte sjelle rezultate te tmerrshme. Atje ku Franca, nen ndikimin e romanizmit kishte ngritur turren e pare te druve ne fillim te Reformacionit, Revolucioni ngriti gijotinen e pare. Pikerisht atje ku u dogjen martiret e

* Voltaire - kundershtar i terbuar i Kristianizmit, femohues mburravec.

pare te besimit Protestant te shek. 16-te, iu pre koka viktimave te para te shek. te 18-te. Me te larguar lajmin e mire, qe do t'i kishte sjelle sherim, Franca i hapi dyert pabesise dhe rrenimit. Me t'u flakur tej kufizimet e ligjit te Perendise, u kuptua se ligjet njerezore nuk ishin te pershtatshme per te kontrolluar rrymet e fuqishme te pasionit njerezor dhe kombi rreshqiti drejt revolres dhe anarkise. Lufta kunder Bibles inaguron nje periudhe qe njihet ne histori si Mbreterimi i Terrorit. Paqja dhe lumturia nuk kishin me vend ne shtepite dhe zemrate njerezve. ASkush nuk ndjehej i sigurt. Ai qe triumfonte sot, dyshohej dhe denohej neser. Pushteti ishte krejtesisht ne duart e dhunes dhe epshit.

Mbreti, kleri dhe fisniket u detyruan t'i nenshtroheshin barbarizmit te popullit te ngacmuar dhe te marrosur. Etja e tyre per hakmarrje vetem sa u stimulua nga ekzekutimi i mbretit dhe ata qe kishin urdheruar vdekjen e tij e ndoqen shume shpejt ne podiumin e vdekjes. U vendos vdekja ne gijotine (me therje) e te gjithe atyre qe dyshoheshin per armiqesi ndaj kauzes se Revolucionit. Burgjet u mbushen plot, madje nje here arriten edhe ne shifren 200 000 te burgosur. Qytetet e mbreterise u bene deshmitere te skenavete tmerrshme. Nje grup revolucionaresh luftonte kunder tjetrit dhe franca u kthye ne nje fushe beteje mes masave, ku sundonte terbimi i pasionit te tyre. "Ne Paris njera trazire ndiqte tjetren dhe njerezit ishin ndare ne nje perzierje fraksionesh, qellimi i vetem i te cileve ishte shfarosja reciproke." Si per t'i shtuar diçka mjerimit te pergjithshem, kombi u perfshi ne nje lufte te ghate dhe shkaterruese me fuqite me te medha te Evropes. "Vendi ishte ne prag te falimentimit, ushtrite e huaja kerkonin t'u paguheshin borxhet, parisienet po vdisnin urie, provincat po shkaterroheshin nga kusaret dhe civilizimi po shnerrohej ne anarki dhe shthurje."

Njerezit i kishin mesuar shume mire mesimet e mizorise dhe tortures qe Roma ua kishte dhene me aq zell. Dita e shpagimit me se fundi kishte ardhur. Tashme nuk ishin nxenesit e Jezusit qe rraseshin ne burgje dhe qe terhiqeshin zvarre drejt turres se druve. Ata ishin zhdukur apo kishin merguar shume kohe me pare. Roma qe nuk kursente askend, ndjeu fuqine vdekjeprurese te atyre qe ajo vete i kishte stervitur te kenaqeshin, duke kryer vepra te pergjakshme. "Shembulli i persekutimit qe ishte dhene nga kleri i Frances u kthye kunder tyre me force te madhe. Podiumet e ekzekutimit u skuqen nga gjaku i prifterinjve. Qelite dhe burgjet, dikur te mbushur me Huguenots, tani ishin mbushur me persekutoret e tyre. Te lidhur me zinxhire tek bregu apo te sfilitur, duke u dhene rremave, kleri katolik roman perjetoi te gjitha ato mallkime qe kisha e tyre ua kishte dhene heretikeve fisnike."

"Keshtu erdhi ajo dite kur gjykata me barbare nxorri kodin me barbar, kur askush s'mund te pershendeste fqinjin e tij apo te lutej.....pa pasur rrezikun se po kryente krim kapital, kur spiunet pergjonin nga çdo qoshe, kur gijotina punonte me ore te zgjatura çdo mengjes, kur burgjet ishin mbushur aq plot sa hambaret e

anijeve te sklleverve, kur rrekete derdhnin gjak ne Sene..... Ndersa çdo dite karrot e ngarkuara me viktima kalonin mes rrugeve te Parisit per te shkuar drejt fatit te tmerrshem qe i priste, lajmeteret qe kishte derguar komiteti i pavarur ne ne seksionet e tjera tregonin per nje mizori ekstravagante te papare, madje as ne kryeqytet. Thika e makines vdekjeprurese ngrihej dhe binte shume ngadale per te kryer punen e tyre te therjes. Keshtu, radhe te tera roberish kositeshin me goditje topi, duke hapur vrima ne barkat e mbushura me njerez. Lioni u kthye ne shkretetire. Ne Arras, te burgosurve iu mohohej edhe meshira mizore e nje vdekjeje te shpejte. Gjate gjithe rruges se Lorenes, nga Saumuri deri ne det, turma te tera sorrash dhe skifteresh benin feste mbi kufomat e zhveshura, duke u perdredhur me njeri - tjetrin ne perqafime te neveritshme. Nuk pati meshire as per moshen as per seksin. Numri i djemve dhe vajzave shtatembedhjete vjeçare, qe u vrane nga kjo qeveri e urryer arriti ne disa qindra. Foshnjet, hequr nga gjiri i nenave, hidheshin nga maja e njeres ure tek tjetra mes ushtareve jakobine." Vetem brenda nje periudhe dhjete vjeçare u zhduken grumbuj qeniesh njerezore.

Kjo i shkoi tamam pas shtatit Satanait. Ky ishte rezultati per sigurimin e te cilit ai kishte punuar per shekuj me radhe. Mashtrimi nga i pari tek i fundit perben politiken e tij dhe i vetmi qellim qe ka eshte qe te sjelle mallkim dhe fatkeqesi mbi njerezit, te shemtoje dhe te korruptoje mjeshterine e Zotit, te shtremberoje qellimet hyjnore te miredashjes dhe dashurise, duke shkaktuar keshtu trishtim ne qiell. Pas kesaj nepermjet artit te tij te mashtrimit i verbon mendjet e njerezve dhe i ben ata qe t'ia hedhin fajin e punes se tij Zotit, sikur i gjithe ky mjerim te ishte rtezultat i planit te Perendise. Ne te njejten menyre, kur ata qe nepermjet fuqise se tij mizore kane rene ne degradim dhe kafsheri fitojne lirine, ai i nxit drejt barbarizmit dhe veprimeve ekstremiste. Keshtu tiranet dhe shtypesit e perdornin nje gjendje te tille shthurjeje pafre si shembull i rezultateve te lirise.

Me t'u diktuar nje gabim Satani e mbeshtillta ate me nje maske tjeter dhe njerezit e pranonin genjeshtren e dyte aq me zell sa edhe te paren. Kur njerezit vune re se romanizmi ishte mashtrim dhe ai nuk mund te vazhdonte t'i udhehiqte me ata nepermjet nje agjensie te tille drejt mosbindjes ndaj ligjit te Perendise, ai i nxiti ata qe ta konsideronin fene ne teresi si mashtrim dhe Biblen si perralle; keshtu duke flakur tutje statutet hyjnore ata iu kushtuan poshtersise pafre.

Gabimi fatal qe solli nje mallkim te tille mbi shtetasit franceze ishte injorimi i kesaj te vertete te madhe, qe liria e vertete gjendet vetem brenda normave te ligjit te Perendise. "Ah, sikur t'i kishte degjuar urdherat e mia! Atehere bekimet do te kishin rrjedhur per ty, si nje perrua qe nuk thahet kurre! Fitorja do te kishte ardhur tek ti si valet qe shtrihen ne breg." "kush ngre krye kunder meje, do te humbase - thote Zoti." "por kush u kushton vemendje fjaleve te mia, ai nuk do te kete as frike dhe as halle." - Jeshaja 48:18,22 dhe Fjalet e Urta 1:33

Ateistet, jobesimtaret dhe femohuesit e kundershtuan dhe hoqen dore nga ligji i Perendise, por rezultatet e ndikimit te tyre mbi te tjeret vertetuan edhe nje here faktin, se mireqenia e njeriut, eshte e lidhur me bindjen qe ai tregon ndaj statuteve hyjnore. Ata qe nuk lexojne mesimin nga libri i Zotit jane te detyruat ta lexojne ate ne historine e kombeve.

Kur Satani perdori Kishen Katolike qe t'i udhehiqte njerezit drejt mosbindjes, agjensia e tij ishte aq e fshehte dhe puna e tij e maskuar aq mire sa mjerimi dhe degradimi qe rezultuan nga kjo nuk u konsideruan si fryte te thyerjes se ligjit te Zotit. Fuqia e tij u ndesh me punen e Shpirtit te Shenjte qe nuk e la t'i realizonte plotesisht qellimet e tij. Njerezit nuk e ndoqen efektin deri tek rrenjet e tij dhe nuk e zbulluan dot burimin e mjerimit te tyre. Por Ligji i Perendise u menjanua krejtesisht gjate Revolucionit nga Keshilli Kombetar. Ne periudhen qe pasoi gjate mbreterimit te terrorit te gjithe do ta shihnin punen e shkakut te vertete dhe efektin e tij.

Kur Franca e mohoi dhe e flaku tej publikisht biblen, njerezit e keqinj dhe shpirtrat e erresires u ngazelluan ne arritjen e qellimit qe e kishin deshiruar per nje kohe kaq te gjate - nje mbreteri te lire nga kufizimet e ligjit te Zotit. Meqenese denimi kunder krimit nuk u ekzekutua shpejt zemra e bijve te njeriut "...ben krime lirisht. Sepse krimi nuk denohet aq shpejt." Libri i Koheletit 8:11. Por mjerimi dhe rrenimi jane rezultatet e pashmangshme te thyerjes se nje ligji te drejte. Ligesia e njerezve edhe pse nuk u ndeshkua menjehere me denim, po percaktonte hap pas hapi fatin e tyre. Shekujt e mohimit te besimit dhe krimit kishin grumbulluar zemerim per diten e shpagimit, keshtu kur u mbush kupa e padrejtesive te tyre, ishte teper vone per mohuesit e Perendise per te kuptuar se t'i japesh fund durimit hyjnor, eshte diçka e frikshme. U menjanua ne nje mase te konsiderueshme Shpirti kufizues i Perendise qe kontrollon fuqine mizore te Satanit, keshtu qe ai, kenaqesia e vetme e te cilit eshte qe t'u ndjelle fatkeqesi njerezve, u la i lire te punonte. Ata qe zgjodhen rebelimin u lane te vetem te vilnin frytet e tij derisa krimet u bene aq te tmerrshme sa nuk kishte pene qe t'i pershkruante. Nje britme e tmerrshme u degjua nga provincat e shkaterruara dhe qytetet e rrenuara - britma e nje ankthi mbytes. Franca u drodh si nga nje termet. Feja, ligji, rregulli social, familja, shteti, kisha - te gjitha u shkaterruan nga dora mashtruese qe u ngrit kunder ligjit te Perendise. Bukur tha njeriu i mençur: "...keqberesit ia sjell rrenimin e keqja e tij." "Mekatari mund te beje njeqind krime e megjithate te mbetet gjalle. Po, e di çdo te me thuash: "ne qofte se e degjon Perendine, gjithçka do te shkoje mbare, por njerezve te keqinj nuk do t'u shkoje mbare." - Fjalet e Urta 11:5; Libri i Koheletit8:12,13 "Kush nuk do te haje arsye dhe nuk pranon ta nderoje Perendine me jeten e tij ..." "...ai duhet t'i duroje pasojat dhe t'i mbaje mbi kurriz telashet qe i ka hapur vetes." - Fjalet e Urta 1:29,31

Deshmitaret besnike te Zotit, qe i vrau fuqia blasfemike "qe doli nga Humnera" nuk do te heshtnin per nje kohe te gjate. "Por pas tri dite e gjysme Perendia i gjal-

leroi perseri profetet me frymen e Tij dhe ata u ngriten perseri ne kembe. Te gjithe ata qe e pane kete, u tremben shume." - Apokalipsi 11:11. Dekretet qe ndalonin fene e kkrishtere dhe mohonin Biblen u miratuan nga Asambleja Franceze ne vitin 1793. Pas tri vjetesh e gjysem e njejta Asmble me ane te nje rezolute i çfuqizoi keto dekrete, duke toleruar Shkrimet e Shenjta. Bota vuri re me tmerr fajin qe kishte rezultuar nga mohimi i Profecive te Shenjta dhe njerezit kuptuan nevojen e besimit tek Zoti dhe tek fjala e Tij, si te vetmet themele te virtytit dhe moralit, Zoti tha; "Ke mendon te fyesh dhe te vesh ne loje? Ti je sjelle me mosperfillje ndaj meje, Perendise se shenjte te Izraelit." - Jeshaja 37:23. "Prandaj kesaj here do te bej qe kombet ta provojne fuqine Time madheshtore dhe ato do te pranojne se Une jam Zoti." - Jirmija 16:21. A.K.V.

Persa i perket dy deshmitareve profeti vazhdon te deklaroje: "Pastaj te dy profetet degjuan nje ze te larte nga qielli qe i urdheroi: "Ngrihuni ketu!" Armiqte e tyre pane se si u ngriten ne qiellmbi re." - Apokalipsi 11:12. Qekur Franca u shpalli lufte, dy deshmitaret e Zotit jane nderuar si kurre me pare. Ne vitin 1804 u organizua Shoqata Angleze dhe e Huaj per Biblen. Kur u formua Shoqata Angleze, Bibla ishte shtypur dhe perhapur ne pesedhjete gjuhe te botes. Qe atehere eshte perkthyer ne disa qindra gjuhe dhe dialekte te ndryshme.

Per pesedhjete vjet pas vitit 1792, fare pak vemendje iu kushtua punes se misioneve ne vende te tjera. Nuk u formuan shoqeri te tjera dhe vetem nje numer i vogel kishash u perpoqen per ta shperndare kristianizmin edhe ne vendet pagane. Ne fumd te shek. te 18-te ndodhi nje ndryshim i madh. Njerezit ishin te pakenaqur nga rezultatet e racionalizmit dhe ndjene nevojen e zbulimit hyjnor dhe fese se rinovuar. Qe ne kete kohe, puna e misioneve njohu nje rritje te papare.

Permiresimet ne fushen e shtypjes i kane dhene nje shtytje te re punes per perhapjen e Bibles. Lehtesite e komunikimit mes vendeve te ndryshme, renia e barrierave te hershme te paragjykimeve dhe mendjemadhesive kombetare dhe humbja e pushtetit sekular te Papes se Romes i hapen rrugen fjales se Perendise. Per vite me radhe Bibla ishte shitur pa pengesa ne rruget e Romes dhe tani ajo po shkonte ne çdo pjese te populluar te globit.

Nje here Voltairi tha me mburrje: "Me ka ardhur shpirti ne maje te hundes, duke degjuar njerezit qe thone se feja kristiane u vendos nga 12 veta. Une do te provoj se nje njeri eshte mese i mjaftueshem per ta rrezuar ate." Qe nga vdekja e tij kane kaluar breza te tere. Me miliona njerez jane bashkuar ne luften kunder Bibles. Por ajo qendron shume larg shkaterrimit, sepse atje ku kishte njeqind Bibla ne kohen e Voltairit, tani ka dhjete mije, me shume, njeqind mije kopje te librit te Zotit. Fjalet e nje reformatori te hershem persa i perket kishes kristiane qe the se: "Bibla eshte nje kudher qe ka thyer shume çekiçe." Fjalet e Zotit e perforcojne. Por asnje arme nuk do te jete ne gjendje te te demtoje ty; do t'u japesh pergjigjen e duhur te gjithe atyre qe te padisin...." - Jeshaja 54:17

"Po, bari fishket dhe lulet veniten, por Fjala e Perendise sone qendron pergjithmone." "Ajo qe ben Ai eshte e besuar dhe e drejte. Urdherimet e Tij meritojne besim, pergjithmone qendrojne te patundura dhe duhen zbatuar me saktesi dhe besnikeri." - Psalmet 111:7,8. Gjithçka qe ndertohet mbi autoritetin njerezor do te rrezohet, por ajo qe hedh themelet ne shkembin e patundur te fjales se Perendise do te qendroje pergjithmone.

1. çfarë paralelesh të goditura mund të gjeni midis Francës gjatë Revolucionit dhe Egjiptit gjatë mbretërimit të Faraonit të Eksodit? Shihni Zbulesën 11:8.

2. Zbulesa 11:3 thotë: "Dy dëshmitarët do të profetizojnë 1,260 ditë, të veshur me thasë." Krahasoni vështirësitë me të cilat u përballën Reformatorët në Francë më sfidat që përballen të Krishterët e sotëm në vende ku dëshmimi është ilegal.

3. Lexoni 1 Pjetrit 5:6-8. Si mund të përgatitemi kundra sulmit final të Satanit në ditët e fundit?

16.

Etërit Pelegrin

Reformatoret angleze edhe pse kishin hequr dore nga doktrinat e Romes, kishin ruajtur akoma shume nga format e saj. Ne adhurimin e Kishes se Anglise perfshiheshin jo nje numer i vogel i zakoneve dhe ceremonive te saj, edhe pse kredoja dhe autoriteti romakishin mohuar tashme. Pretendohej se gjera te tilla nuk kishin te benin me ndergjegjen dhe meqenese nuk komandoheshin ne Shkrimin e Shenjte nuk ishin te rendesishme, por nga ana tjeter, nuk ishin te ndaluara, gje qe tregonte se ne vetvete nuk ishin te demshme. Nderimi i ketyre normave synonte te ngushtonte hendekun midis ketyre kishave te reformuara dhe Romes dhe mendohej se kjo mund te çonte ne pranimin e besimit Protestant nga Roma.

Per konservatoret dhe njerezit qe parapelqenin kompromisin, argumente te tilla ishin vendimtare. Por nje klase tjeter nuk gjykonte keshtu. Fakti qe keto zakone "synonin te kapercenin hendekun e krijuar mes Romes dher Reformacionit" (Martyn, vol.5, faqe 22) ishte sipas tyre nje arsye vendimtare per te mos i respektuar ato. Ata i konsideronin keto zakone si simbole te skllaverise, nga e cila sapo ishin çliruar dhe nuk kishin as deshiren me te vogel per t'u rikthyer. Ata arsyetonin keshtu: Ishte Zoti Ai qe kishte caktuar rregullat e adhurimit dhe se njerezit nuk kane te drejte as te shtojne dhe as te heqin gje prej tyre. Perpjekjet per te zevendesuar autoritetin e Perendiseme ate te kishes perbejne fillimet e heqjes dore nga besimi. Roma filloi duke urdheruar ate qe Zoti nuk e kishte ndaluar dhe mbaroi duke ndaluar ate qe Ai e kishte urdheruar haptazi.

Shume veta deshironin seriozisht t'u riktheheshin pastertise dhe thjeshtesise qe karakterizonin kishen primitive. Ata i konsideronin shume nga zakonet e vendosura nga Kisha angleze si monumente idhulltarie dhe nuk mund te beheshin pjese e nje adhurimi te tille ne menyre te ndergjegjshme. Por kisha, duke pasur mbeshtetjen e autoriteteve civile nuk mund te lejonte asnje mospajtim me format e saj. Pjesemarrja ne sherbesa kerkohej me ligj dhe mbledhjet e paautorizuara per adhurim

fetar ishin te ndaluara dhe pjesemarresit ne to denoheshin me burgim, mergim apo vdekje.

Ne fillim te shek. te 17-te, monarke qe sapo ishte ulur mbi fronin e anglise, shpalli publikisht vendimin e tij qe ose do t'i bente Puritanet "te bindeshin....ose do t'i sulmonte derisa ata te largoheshin ose me keq akoma." - George Bancroft, "Historia e Shteteve te bashkuara te Amerikes", pt 1, k.12,parag.6. Te ndjekur, te persekutuar dhe te burgosur ata s'mund te shquanin asnje shprese per nje te ardhme me te mire dhe ushqyen bindjen se ne qofte se do te vazhdonin t'i bindeshin ndergjegjes se tyre as Zoti s'kishte ç'tu bente dhe "Anglia do te kthehej pergjithmone ne nje vend te papopulluar." - J.G. Palfrey, "Historia e Anglise se Re", k.3, parag.43. Se fundi disa vendosen te kerkonin vendstrehim ne Hollande. Ata u ndeshen me veshtiresi, burgime dhe humbje. Planet e tyre u prishen dhe ata vete rane tradhetisht ne duart e armiqve te tyre. Por kembengulja e vendosur se fundi triumfoi, dhe ata gjeten strehe ne bregdetet miqesore te Republikes Hollandeze.

Duke u larguar nga vendi i tyre ata lane pas shtepite, te mirat materiale dhe mjetet e jeteses. Ishin te huaj ne nje vend te huaj, mes njerezve qe flisnin nje gjuhe tjeter dhe kishin zakone te tjera. Ata u detyruan te punonin ne vende te reja dhe te panjohura pune per te siguruar buken e gojes. Burra te thyer ne moshe, qe gjate gjithe jetes se tyre kishin punuar token, mesuan tashme zanate mekanike. Por ata e priten me gezim kete situate dhe nuk humben kohe me ankime apo pertaci. Edhe pse shpesh e kishin pisk nga varferia, ata perseri e falenderonin Zotin per bekimet qe u dhuronte dhe gjenin gezim ne komunionet shpirterore qe kishin mbetur te pandryshuara. "Ata e dinin se ishin mergimtare dhe nuk i vinin rendesi ketij fakti, por i ngrinin syte lart ne qiell, drejt vendit te tyre me te dashur dhe kjo ua qetesonte shpirtin" - Bancroft, pt.1, k.12,parag.15.

Dashuria dhe besimi i tyre u forcua mes veshtiresive dhe mergimit. Ata kishin besim tek premtimet e Zotit dhe Ai sa here qe kishin nevoje per Te nuk i braktisi kurre. Engjejt e Tij ishin prane tyre per t'i inkurajuar dhe mbeshtetur. Kur dora e Perendise dukej sikur tregonte pertej detin nje vend, i cili mund te behej vendi i tyre dhe ku ata mund t'u linin femijeve si trashegim te çmueshem lirine e besimit, ata nuk ngurronin por shkonin ne rrugen e pergatitur.

Zoti i kishte vene ne prove njerezit e Tij qe t'i pergatiste ata per permbushjen e qellimit te çmuar qe Ai kishte per ta. Kisha kishte rene shume poshte per t'u ngritur. Perendia ishte gati te shfaqte fuqine e Tij ne emer te saj, per te provuar edhe nje here perpara botes se Ai nuk i harron kurre ata qe e besojne. Ai i kishte permbysur ngjarjet me,qellim qe zemerimi i Satanit dhe komplotet e njerezve te ligj te sherbenin per te lartesuar lavdine e Tij dhe per t'i sjelle ne nje vend te sigurt njerezit e Tij. Persekutimi dhe mergimi po i hapnin rrugen lirise.

Kur u detyruan per here te pare qe te ndaheshin nga kisha e Anglise, puritanet

u lidhen ne nje beselidhje solemne qe si njerezit e lire te Zotit "te ecnin se bashku ne rrugen qe ai ua kishte haour apo do t'ua hapte ne te ardhmen" - J.Brown, "Eterit shtegtare 2, faqe 74. Kjo ishte fryma e vertete e reformes, parimi jetesor i Protestanizmit. Shtegtaret me kete qellim ne mendje dhe ne zemer u larguan nga Hollanda per te gjetur strehe ne Boten e Re. john Robinsoni, pastori i tyre, i cili nuk mundi t'i shoqeronte, ghate lamtumires qe iu drejtoi mergimtareve tha: "Vellezer, ne se shpejti do te ndahemi nga njeri - tjetri dhe vetem Zoti e di nese do te jetoj aq gjate sa t'iu shoh perseri me sy. Por sidoqofte une ju ngarkoj perpara Zotit dhe engjejve te Tij te bekuar, me pergjegjesine qe te me ndiqni mua po aq sq une kam ndjekur Krishtin. Ne qofte se Zoti ju zbulon permes ndonje instrumenti tjeter ndonje gje te re, qofshi te gatshem ta pranoni ate siç pranuat çdo te vertete te sherbeses time, sepse une besoj se perendia ka akoma shume te verteta dhe drite per t'ua shfaqur permes fjales se Tij te shenjte." - Martyn, vol.5, fq.70.

"Sa per mua nuk mund te ankohem aq sa duhet per gjendjen ne te cilen ndodhen kishat e reformuara, qe kane arritur ne nje periudhe te caktuar ne fe dhe tani per tani nuk do te shkojne me tej se instrumentet e reformacionit te tyre. Luteranet nuk mund te shkojne me tej asaj qe the Luteri...Calvinistet, sic e shihni jane kapur fort atje ku i la ai njeri i madh i Zotit, i cili as vete nuk i dinte te gjitha. kjo eshte nje fatkeqesi qe duhet vajtuar, se edhe pse ata ishin drite qe ndriçonin e shkelqenin ne kohen e tyre, perseri ata nuk arriten deri ne thelb te keshillave te Zotit, por po te ishin gjalle, do te ishin po aq te gatshem per te pranuar akoma me shume drite sa ç'qene kur e pranuan ate per here te pare." - D.Neal, 2Historia e Puritaneve", vol. 1; fq.269.

"Kujtoni beselidhjen e kishes suaj, me ane te se ciles rate dakort qe tye ecnit ne rruget qe Perendia ua ka hapur apo do t'ua hape ne te ardhmen. Kujtoni premtimin dhe beselidhjen me Zotin dhe me njeri - tjetrin, per te pranuar driten dhe te verteten qe do t'u jepet nga fjala e Tij e shkruar, por per me teper, ju lutem qe te jeni te vemendshem per gjithçka qe e merrni si te vertete, duke e krahasuar dhe duke e peshuar ate me te tjera tekste nga Shkrimi i se vertetes perpara se ta pranoni, sepse eshte e pamundur qe bota Kristiane te dale kaq shpejt nga erresira e dendur antikristiane dhe qe persosshmeria e dijeve te shfaqet menjehere." - Martyn, vol. 5; fq. 70,71.

Ishte deshira per liri ndergjegjeje, qe i frymezoi Shtegtaret per te mos i marre parasysh rreziqet e udhetimit te gjate permes detit, per t'u bere balle rreziqeve dhe veshtiresive te shkretetires dhe per t'u hedhur ne brigjet e Amerikes me bekimin e Zotit, themelet e nje kombi te fuqishem. Shtegtaret edhe pse ishin te ndershem dhe e respektonin Perendine nuk e kuptonin parimin e madh te lirise se besimit. Ata nuk ishin plotesisht te gatshem t'u dhuronin te tjereve lirine, per sigurimin e se ciles kishin sakrifikuar aq shume. "Nje grup shume i vogel njerezish, ku perfshiheshin

mendimtaret dhe moralistet me te shquar te shekullit te 17-te kishin vetem nje ide te atij parimi te madh, qe shtihet ne Dhiaten e Re dhe enjeh Perendine si te vetmin gjykates te besimit njerezor." - Ibid, vol. 5; fq 297. Doktrina, qe pranon se Zoti ia ka dhene kishes te drejten per te kontrolluar ndergjegjen njerezore per te percaktuar dhe denuar herezine eshte nje nga gabimet me rrenje me te thella te papatit. Ndersa Reformatoret mohonin sundimin e Romes ata nuk ishin çliruar plotesisht nga fryma e saj e ngurte.

Erresira e dendur me te cilen papati kishte mbeshtjelle gjate shekujve te gjate te sundimit te tij vendet dhe popujt e krishtere nuk ishte shperndare teresisht. Nje nga ministrat kryesore te kolonise se Gjirit te Massachusetss tha: "Tolerenca e beri boten te antikrishtere dhe denimi i heretikeve nuk e ka demtuar kurre kishen." - Ibid., vol. 5; fq.335. Kolonistet nxorren rregullin qe u jepte mundesi zgjedhjeje ne qeverine civile vetem anetareve te kishes. U formua nje lloj shtet - kishe, ku te gjithe njerezve u kerkohej qe te kontribuonin ne mbajtjen e klerit dhe magistrateve u kerkohej te shtypnin herezine. Keshtu kisha kishte ne duart e veta fuqine sekulare. Nuk kaloi shume kohe dhe keto masa çuan ne nje rezultat te pashmangshem - persekutimin.

Roger Williams erdhi ne boten e re njembedhjete vjet pas vendosjes se kolonise se pare. Ai erdhi ashtu si edhe Shtegtaret e pare per te gezuar lirine e besimit, por ndryshe nga ata ai vuri re - ate qe vetem pak njerez te kohes se tij e kishin vene re - se kjo liri eshte e drejta e pamohueshme e te gjitheve., pavaresisht se cfare besimi kane. Ai ishte kerkues i etur i se vertetes, duke mbeshtetur Robinsonin, qe besonte se ishte e pamundur qe drita e fjales se Perendise ishte pranuar teresisht. Williams2 ishte i pari qe ne kristianizmin modern e ngriti qeverine civile mbi doktrinen, qe bazohej tek liria e ndergjegjes dhe barazia e opinioneve perpara ligjit." - Bancroft, pt. 1; kap. 15, par. 16. Ai deklaroi se detyra e magjistrateve eshte te ndalojne krimin, per ata s'mund ta kontrollojne dot kurre ndergjegjen. "publiku apo magjistratet - tha aimund te vendosin se ç'eshte e pershtatshme mes njerezve, por kur ata perpiqen te paracaktojne detyrat e njeriut ndaj Perendise jane krejtesisht gabim dhe nga kjo s'ka siguri, sepse eshte e qarte se sikur magjistratet te kishin ne dore pushtetinata mund te dekretonin nje sere opinionesh dhe besimesh sot dhe nje sere tjeter neser, ashtu siç kane bere mbreterit dhe mbretereshat e Anglise, ashtu siç kane vepruar papet dhe keshillat e ndryshem te Kishes Kotolike. - rrjedhimisht, besimi do te kthehej ne nje pirg konfuzioni." - Martyn, vol. 5; fq.340.

Pjesemarrja ne sherbesat e kishes ishte e detyrueshme me ane te gjobave dhe burgimeve. "Williams e hodhi poshte kete ligj. Sipas tij statuti me i shemtuar i kodit anglez ishte ai qe e bente te detyrueshme pjesemarrjen ne kishen famulltare. T'i shtrengoje njerezit te bashkoheshin me te tjere qe nuk kishin te njejtin besim me ta ishte per te shkelje flagrante e te drejtave te tyre ligjitime, te terhiqje zvarre drejt adhurimit publik te pafete dhe ata qe nuk kishin deshire te merrnin pjese ne

te dukej sikur kerkoje me zor hipokrizi...” Askush nuk duhet te detyrohet te adhuroje - shtoi ai - ose te marre pjese ne nje adhurim qe nuk i pelqen.” “Çfare! - thirren kundershtaret e tij te cuditur nga ky parim.” - nuk ia vleka barra qirane?”. “po, - iu pergjigj ai, - ia vlen per ata qe kane caktuar qirane.” - Bancroft, pt 1, kap. 15; par. 2.

Roger Williams njihej dhe respektohej si nje minister* besnik, nje njeri me dhunti te rralla, integritet te patundur dhe miredashje te sinqerte; e megjithate, as mohimi i vendosur i pushtetit te magjistrateve civile dhe as kerkesa e tij per liri besimi nuk mund te toleroheshin. Mendohej se zbatimi i kesaj doktrine te re do te “rrezonte shtetin dhe qeverine e vendit nga themelet”. - Ibid., pt. 1; kap. 15; par. 10. Ai u denua me debim nga kolonite dhe me qellim qe te shmangte arrestimin u detyrua te syrgjynosej ne pyje te pashkelura, pavaresisht nga i ftohti dhe stuhite e dimrit.

“Per katermbedhjete jave rresht - thote ai - une u vertita i vetem ne nje stine te papershtatshme dhe ne te ftohte, pa ditur se çdo te thoshin buke dhe shtrat.” Por “korbat me ushqyen ne shkretetire” dhe shpesh nje e çare peme i sherbente si strehe. - Martyn, vol. 5; fq. 349,350. Keshtu ai vazhdoi udhetimin e tij te dhimbshem permes bores dhe pyllit te dendur derisa me se fundi u strehua ne nje fis indian, duke fituar besimin dhe dashurine e tyre, ndersa perpiqej t’u mesonte te vertetat e Ungjillit.

Pas muajsh ndryshimi dhe endjeje, ai arriti perfundimisht ne brigjet e Gjirit Narragensett, ku hodhi themelet e shtetit te pare te koheve moderne;shtet i cili njohu te drejten e lirise se besimit ne kuptimin e vertete te kesaj te drejte. Parimi themelor i kolonise se Rogerit ishte “se cdo njeri duhet te jete i lire ta adhuroje Zotin drites se ndergjegjes se tij” - Ibid., vol. 5; fq. 354. Shteti i tij i vogel, Ishulli Rhode, u kthye ne azilin e te shtypurve, duke u rritur e duke lulezuar derisa parimet e tij me te rendesishme - liria civile dhe fetare - hodhen themelet e Republikes Amerikane.

Ne ate dokument te vjeter e madheshtor qe u krijua nga stergjysherit tane si deshmi e te drejtave te tyre - ne Deklaraten e Pavaresise - thuhet: “Ne i pranojme keto te verteta si plotesisht te qarta, se njerezit u krijuan te gjithe te barabarte, se Krijuesi i tyre i ka pajisur ata me disa te drejta te pamohueshme sic jane jeta, liria dhe lufta per te arritur lumturi.” Kushtetuta garanton ne terma te qarta mbrojtjen e ndergjegjes: “Ne asnje post ne ShBA nuk do te kerkohet kriteri fetar si kualifikim”. “Kongresi nuk do te miratoje ligje persa i perket vendosjes se nje feje te caktuar, nga ku rrjedhimisht, nuk mund te ndaloje ushtrimin e lire te saj”.

“Sistemi i vendosur nga Kushtetuta njohu parimin e perjetshem sipas te cilit marredhenia e njeriut me Perendine qendron mbi legjislacionin njerezor dhe i konsideroi si te pakundershtueshme te drejten njerezore te ndergjegjes. Arsyetimi nuk eshte i nevojshem ne vendosjen e kesaj te vertete, sepse ne jemi te ndergjegjshem per

te, ne thellesi te zemrave tona. Ky ndergjegjesim, duke mos perfillur ligjet njerezore u ka dhene zemer kaq shume martireve per te duruar torturat dhe flaket. Ata ndjene se detyra e tyre ndaj Zotit qendronte me lart se dekretet njerezore dhe se njerezit nuk mund te ushtronin autoritet mbi ndergjegjet e tyre. Eshte nje parim qe ka lindur bashke me njeriun dhe asgje nuk mund ta zhduke." - Dokumenti i Kongresit (SHBA), seria nr. 200, dokumenti nr. 271.

Me t'u perhapur lajmi per nje vend ne te cilin çdo njeri mund t'i kenaqej fryteve te punes se tij dhe te ndiqte bindjet e ndergjegjes se vet, me mijera njerez nga vendet e Evropes nxituan drejt brigjeve te Botes se Re.Kolonite u shtuan me shpejtesi. "Massachusetts, me ane te nje ligji te veçanteme shpenzimet e shtetit u ofronte ndihme dhe mirepriste te krishteret e cdo kombesie qe kishin mundesine te kapercenin Atlantikun per t'u shpetuar luftrave, zise se bukes apo shtypjes se persekutoreve te tyre. "Keshtu, te shtypurit dhe te ikurit konsideroheshin nga statuti si miq te shtetit." - Martyn, vol.5; faqe 417. Njezet vjet pas zbritjes se pare ne Playmouthpo aq shtegetare ishin vendosur ne Angline e Re.

Per te arritur objektivin per te cilin luftuan "ata ishin te kenaqur nga jeta e kursyer dhe e mundimshme. Nuk i kekonin tokes asgje me teper nga frytet e arsyeshme te punes se tyre. Asnje vizion i arte nuk pati ndonje shkelqim mashtues ne rrugen e tyre. ..

Ishin te kenaqur nga progresi i ngadalte, por i palekundur i qeverimit social. Ata i perballuan me durim mungesat e shkretetires, duke e ujitur pemen e lirise me lotet e tyre dhe me djersen e ballitderisa ajo hodhi rrenje thelle ne toke".

Minister* - ne gjuhen fetare ka kuptimin e pastorit, drejtuesit te sherbeses fetare.

Bibla perbente themelin e besimit, burimin e mençurise dhe karten e lirise. Parimet e saj mesoheshin me zell ne shtepi, ne shkolle dhe ne kishe, ndersa frytet e saj manifestoheshin ne ekonomi, inteligjence, pasterti dhe rregull. Dikush mund te ishte banor per vite me radhe ne ngulimin Puritan "dhe te mos kishte pare asnje pijanec, te mos kishte degjuar asnje mallkim, te mos kishte takuar asnje lypes". - Bancroft, pt 1, kap 19, parag. 25.

U vertetua edhe nje here se parimet e Bibles jane mbrojtesit me te sigurt te madheshtise se nje kombi. Kolonite e dobeta dhe te izoluara u kthyen ne nje konfederate shtetesh te fuqishme dhe bota vuri re me habi paqen dhe lulezimin "e nje kishe pa pae dhe e nje shteti pa mbret". Por nje numer gjithnje e me i madh njerezish u terhoqen ne brigjet e Amerikes nga motive krejtesisht te ndryshme nga ato te Shtegetareve te pare.

Edhe pse besimi dhe pastertia e hershme ushtronin nje pushtet te gjere dhe shnderrues, perseri ndikimi i tyre u dobesua gjithnje e me teper me rritjen e numrit te atyre qe kerkoninnvetem perfitim tokesor.

Rregulli i ndjekur nga kolonistet e pare, sipas te cilit e drejta e votes apo emerimit ne poste te rendesishme te qeverise civile u njihej vetem anetareve te kishes çoi

ne rezultate shkaterrimtare. Kjo mase u pranua per te ruajtur pastertine e shtetit, por rezultoi ne korrupsionin e kishes.

Duke qene se feja ishte kusht per te drejten e votes dhe emerimin, shume njerez, te nisur vetem nga motive te politikes boterore, u bashkuan me kishen pa perjetuar ndryshim ne zemrat e tyre.Keshtu kishat perbenin, ne nje mase te konsiderueshme, nga persona te pashnderruar shpirterisht, e madje edhe mes pastoreve kishte nga ata qe jo vetem predikonin rreth nje doktrine te gabuar, por edhe qe nuk e njihnin fuqine rinovuese te Shpirtit te Shenjte. U manifestuan perseri rezultatet e mbrapshta, qe jane ndeshur shpesh ne historine e kishes qe nga koha e Kostandinit deri ne ditet tona, rezultate, qe kane te bejne me ndertimin e kishes me ane te ndihmes se shtetit, me mbeshtetjen nga pushteti sekular i Ungjillit te Atij qe deklaron: "Mbreteria ime nuk rrjedh nga kjo bote" - Gjoni 18:36. Bashkimi qofte ne shkalle te vogel mes kishes dhe shtetit duket sikur sjell boten me afer kishes, por ne realitet çon kishen me afer botes.

Pasardhesit e Robinsonit dhe Roger Williamsit nuk e perfillen me parimin e madh te perkrahur dikur nga eterit e tyre, qe e verteta eshte progresive dhe qe te krishteret duhet te pranojne te gjithe driten qe mund te rrezatohet nga fjala e shenjte e Perendise. Kishat Protestante te Amerikes - ashtu si ato te Evropes - paten dobi nga bekimet qe moren nga Reformacioni, por deshtuan atehere, kur duhej te çanin perpara ne rrugen e reformes. Megjithese here pas here u shfaqen njerez besnike, qe shpallen te verteta te reja dhe nxorren ne pah gabimet e se kaluares, pjesa me e madhe ashtu si çifutet e kohes se Jezusit dhe papistet e kohes se Luterit, ishin me se te lumtur qe te besonin ate, qe paten besuar baballaret e tyre dhe te jetonin ashtu, si paten jetuar ata. Keshtu feja degradoi perseri drejt formalizmit dhe gabimet dhe supersticionet qe do te ishin flakur tej sikur kisha te kishte vazhduar te ecte ne driten e fjales se Zotit, u forcuan dhe u mbajten gjalle. Gradualisht fryma e ushqyer nga Reformacioni vdiq derisa ne kishat protestante ndjehej nevoja e reformes, po ashtu siç ndjehej kjo nevoje ne Kishat Katolike te kohes se Luterit. Ekzistonte e njejta lidhje me tokesoren, e njejta pandjeshmeri shpirterore, i njejti respekt per opinionet e njerezve dhe i njejti zevendesim i mesimeve te fjales se Perendise me teorite njerezore.

Perhapja e madhe e Bibles ne fillim te shekullit te nentembedhjete dhe njekohesisht e drites qe ajo solli ne bote nuk u pasua nga i njejti perparim ne dijet mbi te vertetat e zbuluara apo te fese se rinovuar. Satani nuk mund t'i mbante me njerezit larg fjales se Zotit siç kishte bere me pare; ajo tashme ishte afer tyre, por qe te arrinte akoma qellimin e tijai i beri shume prej tyre qe te mos e merrnin Biblen seriozisht. Njerezit i mohuan Shkrimet e Shenjta dhe rrjedhimisht vazhduan te pranonin interpretime te rreme dhe te ushqenin doktrina qe s'kishin asnje baze ne Bibel.

Duke vene re deshtimin e perpjekjeve te tij per te shtypur te verteten me ane te persekutimit, Satani vuri ne zbatim planin e kompromisit, qe rezultoi ne heqjen

dore nga besimi dhe ne formimin e Kishes se Romes. Ai i nxiti te krishteret te bashkoheshin, tashme jo me paganet, por me te gjithe ata, qe nepermjet perkushtimit te tyre ndaj gjerave tokesore, provuan se ishin po aq idhulltare sa edhe adhuruesit e ketyre imazheve. Rezultatet e ketyre bashkimeve ishin po aq shkaterruese sa ato te shekujve te meparshem, mbizoteruan nen masken e fese krenaria dhe ekstravaganca dhe kishat u korruptuan. Satani vazhdoi te shtreberonte doktrinat e Bibles, ndersa traditat qe u sollen rrenim miliona njerezve, po rrenjoseshin gjithnje e me thelle. Kisha ne vend qe te ruante "besimin qe dikur ia dha shenjtoreve", ngriti lart dhe mbrojti keto tradita. Keshtu parimet per te cilat kishin punuar dhe vuajtur aq shume Reformatoret u moren neper kembe.

1. Besëlidhja e Pelegrinëve për të "ecur sëbashku në gjithçka" me mënyrat (e Zotit), mënyra të njohura apo mënyra për tu bërë të njohura, ishin një "parim jetësor për Protestantizmin." A keni bërë ndonjë besëlidhje me Perëndinë për të ndjekur Atë në të gjithë të vërtetën që Ai na zbulon?

2. "Rregullat e adoptuara nga kolonizatorët e hershëm i lejimit për të votuar apo për të mbajtur poste zyrtare në qeverisje i vetëm anëtarëve të kishës, çoi në rezultatet më të dëmshme." Cilat janë pasojat e kufizimit të pjesëmarrjes politike vetëm për një klasë njerëzish?

3. Roger Ëilliams besonte se liria e besimit ishte "e drejta e të gjithëve", çfarëdo qoftë kredoja e tyre." Si na hedh dritë mbi këtë çështje parabola e Jezusit për grurin dhe egjrën tek (Mateu 13:24-30)?

4. Pelegrinët nuk mund ta praktikonin besimin e tyre në Angli sepse "kisha e mbështetur nga autoritete civile, nuk lejonte disidentët." E megjithatë, kur ata shkuan në Botën e Re, Pelegrinët imponuan të njejtat kufizime tek të tjerët. Cili ishte qëllimi i tyre dhe cilat qenë pasojat?

17.

Lajmëtarët e Mëngjesit

Nje nga te vertetat me solemne e njekohesisht me te çmueshme, qe zbulohen ne Bibel eshte ajo e ardhjes se dyte te Krishtit per te perfunduar punen e nisur te çlirimit. Njerezve shtegtare te perendise, atyre qe qendruan per nje kohe kaq te gjate nen "mbreterimin dhe hijen e vdekjes", premtimi i Atij "qe eshte vete ringjallja dhe jeta" per "t'i rikthyer ne shtepi te gjithe mergimtaret e Tij" u jep shprese, frymezim dhe gezim. Doktrina e ardhjes se dyte eshte pika kyçe e Shkrimeve te Shenjta. Femijet e besimit kane pritur ardhjen e Te Premtuarit, qe nga dita kur çifti i pare u largua i trishtuar nga Edeni, per te mposhtur fuqine e shkaterruesit dhe per t'i çuar ata perseri drejt parajses se humbur. Shenjtoret e koheve te hershme mezi po pritnin ardhjen me lavdi te Mesise; ardhje qe do te permbushte shpresen e tyre. Henokut, pasardhes i brezit te shtate te atyre qe dikur jetonin ne Eden, i cili eci me zotin e tij per tri shekuj ne toke, iu lejua ta parashikonte kohe me pare ardhjen e Çliruesit. "Ja, - deklaroi ai, - Zoti po vjen me dhjetra - mijera engjej te Tij, per t'i gjykuar te gjithe" - Letra e Judes 14,15. Patriaku Ijov gjate nates se fatkeqesise qe i ndodhi deklaroi me besim te patundur. "Por une e di qe Shpetimtari im jeton dhe qe ne fund do te ngihet mbi toke. Mbas shkaterrimit te lekures sime, ne mishin tim do te shohe Perendine. Do ta shoh une vete, syte e mi do ta sodisin dhe jo nje tjeter. Po me shkrihet zemra". - Ijovi 19:25-27.

Ardhja e Krishtit per te shpallur mbreterine e drejtesise ka frymezuar theniet me sublime dhe te flakta te shkrimtareve te shenjte. Poetet dhe profetet e Bibles e pershkruan ate me fjale te ndezura nga zjarri qiellor. Psalmisti i kendoi keshtu fuqise dhe madheshtise se mbretit te Izraelit: "Ne Cion, ne malin me te bukur prej te gjitha maleve, Perendia shfaqet me shkelqim madheshtor. Perendia yne po vjen, nuk hesht me... Qiellin e token i thwerret per deshmitare, sepse popullit te tij do t'i kerkoje llogari" - Psalmi 50:2-4. "Te gezohet qielli, te ngazellohet toka..., sepse po vjen Zoti, Ai pi vjen per te siguruar drejtesine ne bote. Ai do te mbreteroje mbi t gjitha vendet si gjyqtar i drejte e i paanshem" - Psalmi 96:11-13.

Profeti Jeshaja tha: "Zgjohuni dhe gezohuni", o ju qe banoni ne pluhur! Sepse vesa jote eshte si vesa e nje drite qe shkelqen dhe toka do te nxjerre ne drite te vdekurit." "Do te shkaterroje pergjithnje vdekjen,Zoti. Zoti do t'i thaje lotet nga çdo fytyre, do te heqe nga tere dheu turpin e popullit te Tij, sepse Zoti ka folur. Ate dite dio te thuhet: "Ja, Ky eshte Perendia yne: tek Ai kemi shpresuar dhe Ai do te na shpetoje. Ky eshte Zoti tek i cili kemi shpresuar, te ngazellojme dhe te gezohemi ne shpetimin e Tij". - Jeshaja 26:19; 25:8,9.

Havakuku, pa ne nje nga vizionet e tij te shenjta ardhjen e Tij: "Zoti zbret nga temjani, Perendia i shenjte vjen nga mali i Paranit. Madheshtia e Tij ndriçon qiellin, shkelqimi i Tij mbush gjithe boten. Ai ndriçon perreth si drita e diellit..." "Ai ndalej dhe maste token, shikonte dhe i bente kombet te dridheshin, malet e perjetshme zhdukeshin, kodrat e lashta uleshin; rruget e Tij jane te perjetshme." "Kunder kujt del ti me kuajt e tu dhe me karron se ciles nuk mund t'i beje balle askush?" "Malet te pane dhe u drodhen...humnera ka bere te degjohet zeri i Tij dhe ka ngritur duart lart. Dielli dhe hena kane mbetur ne banesen e tyre, ne driten e shigjetave te tua levizen me te shpejte, ne vetetimen e ushtes sateflakeruese." "Ti je ngritur per te ndihmuar popullin tend, ate dhe mbretin qe ka emeruar..." - Havakuku 3:3,4,6,8,10,11,13.

Kur Shpetimtarit do t'i duhej qe te ndahej nga nxenesit e Ti, Ai i ngushelloi ata gjate kohes se trishtuar, duke i siguruar se do te vinte perseri: "Mos u trembni dhe mos kini frike!...Ne shtepine e Atit tim ka shume banesa...Po shkoj pra, per t'ju pergatitur nje vend. Pastaj do te kthehem per t'ju marre me vete, qe edhe ju te jeni atje ku do te jem une" - Gjoni 14:1-3. "Kur te vije Biri i njeriut me madheshtine e tij dhe bashke me te gjithe engjejt, atehere do te ulet mbi fronin e Tij madheshtor. Para Tij do te mblidhen njerez nga te gjithe popujt" - Mateu 25:31,32.

Engjejt qe qendruanne malin e Ullinjve pas ngritjes se Krishtit ne qiell u perseriten nxenesve premtimin e rikthimit te Tij: "Ky Jezus qe u mor ne qiell do te kthehet pikerisht keshtu sic e pate duke u larguar prej jush". - Veprat e Apostujve 1:11. Ndersa Pali i nxitur nga Shpirti i Frymezimit deshmoi: "Kur te dale urdheri i Zotit, kur te therrase kryeengjell, kur t'i bjere borise, vete zoti do te zbresenga qielli" 1 Selanikasve 4:16. Profeti i Patmosit thote: "Ja, Jezusi Mesia po vjen me re. Te gjithe do ta shohin..." - apokalipsi 1:7.

Ardhja e Tij permbledh lavdine e "rikthimit te te gjithave qe ishte parashikuar qe prej kohesh nepermjet profeteve te tij". - Veprat e Apostujve 3:21. Dhe keshtu do te shfuqizohet sundimi i gjate i se keqes "Tani sundimi mbi toke i perket Perendise tone dhe Mbretit (Mesise) qe e emeroi..." - Apokalipsi 11:15. "Atehere madheshtia e Zotit do te shfaqet dhe do ta shohe i gjithe njerezimi"....Zoti do te beje qe te mbijedrejtesia dhe lavderimi perpara tere kombeve." Ai do te jete "si nje kurore madheshtore me lule per popullin e tij qe do te mbetet gjalle". - Jeshaja 40:5; 61:11; 28:5.

Pikerisht atehere do te vendoset ne toke mbreteria paqedashese dhe e deshiruar prej kohesh e Mesise. “Do te tregoj meshire per Jerezalemin, per te gjithe ata qe banojne ne germadhat e tij. Megjithese toka e tij eshte shkretetire une do ta bej kopsht si kopshtin qe mbolla ne Eden.“ “...ajo do te jete ebukur si malet e Libanit dhe pjellore si fushat e Karmelit dhe te Sharonit” “Nuk do te te quajne me “i braktisuri”: toka jote nuk do te quhet me “gruaja e braktisur”. Do te te quajne “Kenaqesia e Perendise”, kurse token tende do ta quajne “e martuara lumturisht” “Zoti do te gezohet me ty ashtu si gezohet dhenderri per nusen e tij” - Jeshaja 51:3; 35:2; 62:4,5.

Ardhja e Zotit ka qene ne shekuj shpresa e ndjekesve te Tij te vertete. Premtimi i Shpetimtarit perpara nisjes ne Malin e Ullinjve se do te vinte pereseri i dha drite te ardhmes se nxenesve te tij, duke i mbushur zemrat e tyre me nje gezim dhe shprese te tille qe s’mund te shuheshin nga trishtimi dapo te erresoheshin nga provat. Permes vuajtjes dhe peresekutimit “shfaqja e Perendise se plotfuqishem dhe e Shpetimtarit Jezu Krisht”, perbente “shpresen e bekuar”. Kur Selanikasit e krishtere trishtoheshin sa here varrosnin te dashurit e tyre, qe kishin shpresuar ta shihnin me syte e tyre ardhjen e Zotit, Pali, mesuesi i tyre, u fliste per ringjalljen qe do te ndodhte me ardhjen e Shpetimtarit. “Me pare do te ringjallen te gjithe ata qe vdiqen (duke i besuar Zotit). Vetem atehere ne qe mbetemi gjalle do te rrembehemi bashke me ta ne takim me Zotin. Jepini zemer njeri-tjetrit me keto fjale!” - 1 Selanikasve 4:16-18.

Nxenesi i dashur, ne Patmosin e gurte degjon premtimin “Po, po vij shpejt!” dhe ne pergjigjen e tij u perfshi lutja e te gjithew kishes ne mergim, “Amen! Eja, o Zot Jezus!” - Apokalipsi 22:20.

Nga qelite e burgjeve, nga turrat e druve, nga trekembeshat, nga ku martiret dhe shenjtoret deshmuan per te verteten, vinte shprehja e qarte e besimit dhe shpreses se tyre shekullore. Nje nga keta te krishtere tha: “Ata e perçmonin vdekjen dhe qendronin mbi te duke qene te sigurt per ringjalljen e Tij personale dhe rrjedhimisht per ringjalljen e tyre qe do te ndodhte me ardhjen e Tij”. - Daniel T. Taylor, “Mbreterimi i Krishtit ne toke: ose Zeri i Kishes nder shekuj”, f. 33 Ata deshironin te shkonin ne varr qe te “ringjalleshin te lire” - Ibid.,faqe 54. Ata kerkonin “Zotin qe te vinte nga qielli mes reve me lavdine e Atit te Tij” “duke ju sjelle njerezve te drejte mbreterine e Tij”. Waldens ushqenin te njejtin besim. - Ibid.,faqe 129-132. Vikliffi mezi po priste shfaqjen e çliruesit si shpresa e kishes. - Ibid., faqet 132-, 134.

Sa here mendoj per ardhjen e Zotit - tha Bescter - ndjehem i çliruar dhe i gezuar”. - Richard Bascter, “Punime., vol. 17, faqe 555. “Eshte puna e besimit dhe karakteri i shenjtoreve te Tij, qe mezi presin shfaqjen e Tij dhe kerkojne ate shprese te bekuar”. “Ne qofte se vdekja eshte armiku i fundit q e shkaterrohet nga ringjallja, ne mund ta kuptojme sesa shume e deshirojne besimtaret dhe me sa seriozitet luten ata per ardhjen e dyte te Krishtit, kur do te realizohet fitorja e plote dhe finale”. -

Ibid., vol. 17; f.500. "Te gjithe deshmitaret duhet ta deshirojne, te shpresojne dhe ta presin kete dite si perfundimin e punes se shpetimit te tyre dhe si permbushjen e gjithe perpjekjeve dhe deshirave te shpirtrave te tyre". "O Zot pershpejtoje ardhjen e kesaj dite te bekuar!" - Ibid.,vol.17.f.182,183. E tille ishte shpresa e kishes apostolike, "kishes ne shkretetire" dhe e Reformatoreve.

Me ane te profecise nuk parashikohen vetem menyra dhe qellimi i ardhjes se Krishtit, por paraqiten edhe shenja ne baze te te cilave njerezit do te kuptojne se ardhja e Tij eshte e afert. Jezusi tha: "Ne diell, ne hene dhe ne yje do te shfaqen shenja kercenuese" - Luka 21:25. "Pak pas kesaj kohe te tmerrit, dielli do te nxihet, hena nuk do te ndrite me, trupat qiellore do te bien nga qielli dhe planetet do te lekunden. Pastaj Biri i njeriut do te vije mbi re me fuqi e madheshti te hyjnueshme, e do ta shohin te gjithe". - Marku 13:24-26. Me pas zbuluesi pershkruan shenjen e pare qe paraprin ardhjen e dyte: "...Atehere ra nje termet i madh. Dielli u erresua si veshje e zeze qe mbajne vajtuesit, kurse hena u skuq si gjaku". - Apokalipsi 6:12.

Njerezit i pane me syte e tyre keto shenja perpara fillimit te shekullit te 19-te. Ne vitin 1755 u regjistrua termeti me i tmerrshem qe kishte rene ndonjehere, i cili permbushi kete profeci. Edhe psa pergjithesisht njihet si termeti i Lisbones ai u ndje ne pjesen me te madhe te Evropes, Afrikes dhe Amerikes. ai preku Groenlanden, ishujt e Indise perendimore, ishullin Madeira, Norvegjine, Suedine, Britanine e Madhe dhe Irlanden. Ai u perhap ne nje zone jo me pak se 4 000 000 milje. Pjesa me e madhe e Algiereve u shkaterrua dhe nje fshat i vogel me tete apo dhjete mije banore afer Marokos, u zhduk. Nga tronditja pati permbytje ne bregdetin spanjoll dhe afrikan ku u permbyten qytete te tera dhe pati shkaterrime ne te tjerat.

Ne Spanje dhe Portugali tronditja e tij u manifestua ne nje dhune ekstreme. Ne Kadiz thuhej se valet ishin 60 fit[1] te larta. Malet "disa nga me te lartet ne Portugali, u drodhen vrullshem qe nga bazat e tyre dhe disa u çane ne maja, te cilat rreshqiten dhe u shkeputen ne menyre te mrekullueshme dhe masa te stermedha gurore rane ne lendinat prane tyre. tregohes se ne keto male jane ndezur zjarre". - ser charles Lyell, "Parimet e gjeologjise", f.495.

Ne Lisbone "u degjua nje gjemim nentokesor dhe menjehere pas tij nje tronditje e fuqishme rrenoi pjesen me te madhe te qytetit. Vetem brenda gjashte minutash u zhduken 60 000 njerez. Ne fillim deti u terhoq duke zbuluar bregun dhe me pas vershoi me furi 50 fit apo me shume nga niveli i zakonshem". "Thuhet se mes ngjarjeve te jashtezakonshme qe ndodhen gjare kesaj katastrofe ishe fundosja e nje moli te ri, i ndertuar i teri ne mermer dhe teper i shtrenjte. Nje grup i madh njerezish ishin grumbulluar aty per shpetim, duke qene se ky vend ishte larg forces rrenuese, por papritur, moli u zhyt bashke me njerezit dhe asnje nga trupat pa jete te tyre nuk doli ndonjehere mbi siperfaqe. - Ibid.,f.495.

[1] 1 fit = 143,7 m

"Tronditja" e termetit u pasua menjehere me renien e çdo kishe dhe manastiri e te gjitha ndertesave publike dhe te me shume se nje te katertes se shtepive. Ne lagje te ndryshme vetem dy ore pas tronditjes shpertheu zjarri, i cili pati nje force te tille saqe e izoloi qytetin teresisht brenda tri diteve. Termeti ra ne nje dite te shenjte kur te gjitha kishat dhe manastiret ishin mbushur plot me njerez, nga te cilet shpetuan vetem pak". -

Enciklopedia amerikane, art. "Lisbona" shenim (ed. 1831). "Tmerri i njerezve s'mund te pershkruhej. Askush nuk qante, tragjikja ua kishte thare lotet. Vraponin andejketej ne percartje nga tmerri dhe çudia, duke i rene kokes me grushte dhe duke bertitur "Misericordia! Botes i erdhi fundi!" Nenat harruan femijet e tyre duke vrapuar drejt imazheve te figurave te kryqezuara. Fatkeqesisht shume veta vrapuan drejt kishave per shpetim, por me kot u krye kungata, me kot perqafuan krijesat e shkreta altaret, imazhet, prifterinjte dhe njerezit u varrosen nga i njejti rrenim". Te dhenat tregojne se 90 000 mije njerez humben jeten gjate asaj dite fatale.

Shenja tjeter qe permendet ne profeci u shfaq pas 25 vjetesh - erresimi i diellit dhe henes. Fakti qe kohe e permbushjes se saj ishte treguar me pare beri kete ngjarje me emocionuese. Gjate bisedes me nxenesit e Tij mbi Malin e Ullinjve pasi pershkroi periudhen e gjate te proves per kishen - 1260 vitet e persekutimit te papatit, per te cilat Ai premtoi se kohe e kesaj fatkeqesie do te shkurtohej - Shpetimtari permendi disa ngjarje te caktuara, qe do te paraprinin ardhjen e Tijdhe percaktoi kohen kur do te ndodhte ngjarja e pare: "Pas kesaj kohe te tmerrit dielli do te nxihet dhe hena nuk do te ndrije me". - Marku 13:24. 1260 ditet apo vitet[2] perfunduan ne vitin 1798-te. Peresekutimi kishte perfunduar nje çerek shekulli me pare. Sipas fjaleve te Krishtit, erresimi i diellit duhet te pasonte kete persekutim. Kjo profeci u permbush me 19 Maj 1780.

"Dita e erret e 19 Majit te vitit 1780 qendron mes dukurive me misterioze dhe te pashpjegueshme te llojit te vet - per te mos thene e vetmja dukuri - nje erresim i paparishikuar i qiellit dhe atmosferes ne Angli". - R.M.Devens, "Shekulli yne i pare", faqe 89.

Nje deshmitar qe jetonte ne Massachusetts e pershkruan kete ngjarje si vijon: "Ne mengjes dielli lindi i qarte, por shume shpejt u mbukua, u vrenjt, rete e zeza dhe kercenuese sollen bubullima, vetetima dhe shi. Rreth ores 9, rete u holluan dhe moren ngjyre bakri apo tunxhi dhe ne kete pike toka, shkembinjte, pemet, ndertesat, uji dhe njerezit reflektuan kete drite jotokesore. Pas ca minutash, qielli u mbulua plotesisht nga nje re e zeze perveç vijes se holle te horizontit dhe u erresua sikur te ishte ora 9 e nje mbremjeje vere...

"Mendjet e njerezve, gradualisht u trazuan nga frika, ankthi dhe shqetesimi. Grate qendronin tek dera, duke pare erresiren perreth, burrat u kthyen nga puna

[2] Vitet - 1 dite ne gjuhen profetike barazon nje vit.

ne fusha, zdrukthtari la veglat e tij, farketari farken e tij, trgtari banakun. Shkollat u mbyllen dhe femijet u drejtuan per ne shtepite e tyre, duke u dridhur. Udhetaret ndaluan ne fermen me te afert. "Çfare do te ndodhe? - pyeste çdo zemer dhe çdo goje. Dukej sikur nje uragan do te perfshinte token apo sikur ishte dita qe do t'i vinte kapak gjithçkaje.

"U perdoren qirinjte, zjarret ne oxhaqe ndrinin si te ishte nje mbremje vjeshte pa hene...Shpendet pushuan ne kotecet e tyre dhe fjeten, bagetia u grumbullua ne vathe dhe filloi te pelliste, bretkosat u qetesuan, zogjte kenduan kenget e mbremjes dhe lakuriqet e nates filluan fluturimin e tyre. Por njerezit e dinin. Nara s'kishte ardhur akoma...

"Doktor Nathanael Whittaker, pastor i kishes se Rreshanjave ne Salem, organizoi sherbesa fetare ne faltore dhe mbajti nje sherbese gjate se ciles ai mbrojti idene se erresira ishte mbinatyrore. Njerezit paten grumbullime te tilla ne shume vende te tjera. Tekstet e sherbesave te improvizuara aty per aty tregonin se erresira perputhej plotasisht me profecine e Shkrimeve te Shenjta...Erresira u be me e dendur pak pas ores 11-te". - The Essex Antiquarian, Prill, 1899, vol.3,Nr.4, faqe 53,54. "Ne pjesen me te madhe te vendit erresira gjate dites ishte aq e plote sa njerezit nuk mund te shihnin as orene dores as oren e murit, nuk mund te hanin dhe as te benin punet e shtepise pa driten e qirinjve...

"Shtrirja e erresires ishte e jashtezakonshme. Ne lindje ajo u shfaq deri ne Talmouth. Ne drejtimin perendimor arriti ne piken me te larget te Connecticutit dhe ne Albany. Ne jug u vezhgua pergjate bregdeteve, ne veri perfshiu te gjitha ngulimet amerikane." - William Gordon. "Historia e ngritjes, progresit dhe vendosjes se Pavaresise se SHBA", vol. 3,f.57.

Nje apo dy ore perara mbremjes, erresira e dendur e dites u pasua nga nje qiell pjeserisht i kthellet dhe nga shfaqja e diellit edhe pse ky i fundit ishte akoma i erresuar nga veprimtaria e nje mjegulle te trashe dhe te zeze. "Pas perendimit rete u rishfaqen dhe u erresua shume shpejt". "Erresira e nates ishte po aq e jashtezakonshme dhe efrikshme sa ajo e dites. Edhe pse hena ishte e plote asnje objekt nuk mund te dallohej pa ndihmen e drites artificiale, e cila po te shihej nga shtepite fqinje apo nga nje vend i distancuar dukej permes nje lloj erresire egjiptiane e padepertueshme nga rrezet". - Isaiah Thamas, "Spiuni i Massachussets apo Profecia amerikane e Lirise" vol. 10,Nr.472 (15 Maj 1780). Nje deshmitar i skenes thote; "Ne ate kohe nuk mund te mos mendoje se edhe sikur çdo trup i ndritshem ne univers te ishte fshehur mes hijesh te padepertueshme ose te mos ekzistonte me, erresire s'mund te ishte me e plote". - Leter nga Doktor Samuel Tenney i Exeterit, hew Hampshire, Dhjetor 1785 (Ne Permbledhjet historike te Shoqerise se Massachussets, 1792, seria e pare, vol. 1, f.97). Edhe pse ne oren 9 u shfaq hena e plote "ajo nuk ndikoi aspak ne shperndarjen e hijeve qe ishin si hije vdekjeje". Erresira u zhduk ne mesnate dhe hena, me t'u shfaqur, kishte ngjyren e gjakut.

19 Maji i vitit 1780 njihet ne histori si "Dita e Erret". Qe nga koha e Mosheut nuk ka te dhena per nje periudhe erresire me te tille dendesi, gjatesi dhe shtrirje. Pershkrimi, qe deshmitaret e kohes i bene kesaj ngjarjeje eshte thjesht nje perseritje e fjaleve te Zotit, te cilat u shkruan nga profeti Joel 2 500 vjet perpara permbushjes se tyre:"

(? Bible text)

Krishti i udhezoi njerezit e Tij qe t'i vezhgonin shenjat e ardhjes dhe t'i gezoheshin, sepse ato trgonin se Zoti po vinte. "Kur te fillojne keto shenja - thote Ai - drejtohuni dhe ngrini kokat lart, sepse çlirimi juaj eshte afer." Ai u tregoi ndjekesve te Tij pemet me sythet e pare ne pranvere dhe tha: "Kur dalin gjethet e para, vetvetiu e dini se vera eshte afer. Po ashtu kur t'i shihni keto (shenja kozmike), ta dini se mbreteria e Perendise eshte afer". - Luka 21:28, 30, 31.

Meqe fryma e peruljes dhe perkushtimit ne kishe ishte zevendesuar nga krenaria dhe formalizmi, dashuria per mesine dhe besimi ne ardhjen e Tij ishin zbehur. Njerezit e shpallur te Perendise, te zhytur ne kenaqesite tokesore ishin verbuar dhe s'mund t'i shikonin udhezimet e Shpetimtarit, persa i perkista shenjave te ardhjes se Tij. Doktrina e ardhjes se dyte u mohua, keqinterpretimet i erresuan kaq shume shkrimet qe kishin te benin me te, saqe ato nuk u perfillen deri ne harrese. Kjo ndodhi veçanerisht ne kishat e Amerikes. Liria dhe rehatia qe gezonin te gjithe klasat e shoqerise, deshira ambicioze per pasuri dhe luks, lindja e nje perkushtimi shkaterrues ndaj pasurimit, nxitimi i etur per popullaritet dhe pushtet nga i cili ishin infektuar te gjithe beri qe njerezit t'i perqendronin interesat dhe shpresat e tyre ne gjerat e kesaj jete dhe ta shtynin larg ne te ardhmen ate dite solemne kur do te zhvleftesohet rregulli i tanishem i gjerave.

Kur Shpetimtari u tregoi ndjekesve te Tij shenjar e rikthimit, ai u paratregoi atyre gjendjen e kaosit qe do te ekzistonte perpara ardhjes se Tij te dyte. Do te kishte, ashtu si ne kohen e Noes aktivitet dhe levizje te biznesit tokesor dhe zhytje ne kenaqesi - shitje, blerje, mbjellje, ndertim, martese - por do te harrohej Perendia dhe jeta qe do te vinte. Paralajmerimi i Krishtit per ata qe do te jetojne ne nje kohe te tille eshte ky: "Kujdes, mos t'ju mjegullohet mendja nga dehja dhe shqetesimet e kesaj jete. Ndryshe kjo dite do t'ju zere si ne kurth." "Rrini zgjuar pra dhe mos pushoni se luturi, qe te kaloni me sukses neper te gjithe kete qe do te ndodhin dhe te paraqiteniplot besim para Birit te njeriut." - Luka 21:34,36.

Fjalet e Shpetimtarit ne Apokalips zbulojne gjendjen e kishes ne kete kohe: "Veprat e tua i di: e di edhe se mbahesh si bashkesi e gjalle, por ne te vertete je e vdekur." Atyre qe refuzojne te çlirohen nga siguria e tyre e shkujdesur u drejtohet paralajmerimi solemn: "...Ne qofte se nuk zgjohesh do te te ze ne befasi si vjedhes: nuk do te dish ne ç'ore do te vij kunder teje." - Apokalipsi 1:1,3.

Duhej qe njerezit te zgjoheshin per te kuptuar rrezikun q e i priste qe ata te ngriheshin per t'u pergatitur per ngjarjet solemne qe lidhen me fundin e proves.

Profeti i Zotit deklaron: "Eshte e tmerrshme dita kur te nderhyje Zoti: Kush do ta mbijetoje?" "Por syte e tu jane teper te paster per ta duruar te keqen, nuk mund te shikosh duarkryq, kur njerezit keqetrajtohen dhe mundohen". - Joel 2:11; Havakuk 1:19. Per ata qe thone "Zoti yne ne te njohim", por vazhdojne te thyejne beselidhjen e Tij, te vrapojne pas perendive te tjera, te fshehin poshtersi ne zemrat e tyre dhe te perqafojne rruget e padrejtesise. - per ta dita e Perendise eshte: "erresire e jo drite, ajo eshte dite e zeze, nuk do t'ju lere asnje vegim shprese". - Hoshea 8:2,1; Psalmet 16:4; Amos 5:20. "Atehere, Une - thote Zoti - do te ndriçoj çdo qoshe te Jeruzalemit per te gjurmuar njerezit e vetekenaqur, qe gezojne te qete mireqenien e tyre e thone: "Zoti nuk ben asgje, as te mira as te keqija!" - Cefanja 1:12. "Do te sjelle fatkeqesi mbi toke dhe do t'i ndeshkoje te gjithe njerezit e keqinj per makatet e tyre. Do te poshteroj cilindo qe eshte mendjemadh dhe do te ndeshkoj cilindo qe eshte kryelarte dhe mizor". - Jeshaja 13:11. "Nuk do te mund t'i shpetoje argjendi e ari i tyre..." "pasuria e tyre do te plaçkitet, shtepite e tyre do te rrafshohen me token". - Cefanja 1;18,13.

Profeti Jirmija duke pritur kete kohe te frikshme therret: "Zemra me rreh fort, pothuajse perplaset brenda ne gjoks. Nuk mund te hesht me. Degjoj briret e alarmit dhe kushtrimin e luftes". - Jirmija 4:19,20.

"Kjo dite do te jete dita e gjyqit, dite plot frike dhe rrezik, plot stuhi dhe shkretim, plot re te zeza e te frikshme, dite e erret, dite kur leshohet thirrja e betejes, kur i bihet bririt per te sulmuar..." - Cefanja 1:15,16. "Po vjen dita e Zotit... Toka do te behet si shkretetire dhe çdo mekatar do te shkaterrohet" - Jeshaja 13:9.

Duke pasur parasysh kete dite madheshtore fjala e Perendise, me gjuhe shprehese dhe solemne, u ben thirrje njerezve te Tij qe te zgjohen nga letargjia shpirterore dhe te kerkojne fytyren e Tij me pendim dhe perulje: "Bjerini bririt te alarmit ne Cion, jepni alarmin ne malin e shenjte te Zotit! Dridhuni banore te vendit! Dita kur Zoti do te beje gjyq, eshte afer!" "...Shpallni nje dite agjerimi, jepni urdher per nje sherbese pendimi. Mblidhni popullin dhe shikoni qe te paraqitet i paster para Zotit! Te mblidhen te gjithe, nga foshnjat ne gji deri tek pleqte! Edhe dhenderi me nusen duhet te dalin nga dhoma e dasmes! Prifterinjte, sherbetoret e Zotitduhet te qajne e te luten ne vendin midis shenjtores dhe altarit". "Por madje edhe tani mund te ktheheni tek une. Kthehuni tek une me gjithe zemer, agjeroni, qani e vajtoni! Grisni zemrat e jo rrobat!...Ju e dini: ai eshte plot dashuri dhe meshire. Ai ka durim, dashamiresia e Tij nuk ka kufi. Ai nuk lejon qe fatkeqesia te shkoje deri ne fund". - Joeli 2:1; 15-17;12,13.

Ne menyre qe njerezit t'i qendronin dites se Perendise duhej te zbatohej reforma. Zoti vuri re se shume nga njerezit e Tij nuk po ecnin drejt rruges se perjetesise dhe i meshirshem siç eshte Ai dergoi nje mesazh paralajmerimi per t'i zgjuar nga shtangia e tyre dhe per t'i pergatitur per ardhjen e Mesise.

Kete paralajmerim e hasim tek Apokalipsi 14-te. Ketu shfaqet nje mesazh i treqenshem perfaqesuar nga tri qenie qiellore dhe i pasuar menjehere nga ardhja e Birit te njeriut per te korrur "frytet e tokes".Paralajmerimi i pare deklaron afrimin e kohes se gjykimit. Profeti pa nje engjell ne fluturim "kishte nje mesazh qe kurre nuk do ta humbase vleren e tij.Duhej t'ua shpallte ate te gjithe banoreve te tokes dhe çdo kombi, çdo populli si dhe njerezve te te gjitha gjuheve. Ai bertiti me ze te larte: "Nderojeni Perendine dhe jepini Atij lavdi! Erdhi koha e gjyqit te Tij. Adhurojeni Krijuesin e qiellit dhe te tokes, te detit dhe te burimeve!" - Apokalipsi 14:6,7.

Ky mesazh deklarohet si pjese e "ungjillit te perjetshem". Pergjegjesia per te predikuar mbi ungjillin (Lajmin e Mire) nuk iu eshte dhene engjejve, por u eshte besuar njerezve. Engjejt e shenjte jane perfshire ne kete drejtimin e kesaj pune, ata kane pergjegjesi per levizjet e medha per shpetimin e njerezve, por jane sherbetoret e Zotit ne tokeqe e shpallin aktualisht ungjillin.

Njerezit besnike, te bindur ndaj shtytjes qe iu jepte Shpirti i Perendise dhe ndaj mesimeve te Fjales se Tij ishin ata qe ia shpallen botes kete paralajmerim. Ishin ata qe i "kishin besuar premtimet e profeteve" dhe qe i ngjanin "nje kandili qe ndrit ne erresire derisa te zbardhe dita dhe zemrat tuaja t'i ndriçoje Ylli i Mengjesit". - 2 Pjetrit 1:19. Ata kishin kerkuar me shume njohurine per Perendine sesa thesaret e fshehura, duke besuar se: "te kesh urtesi eshte me mire se te kesh argjend, eshte me i vlefshem se te kesh ar te kulluar". - Fjalet e Urta 3:14. Dhe Zoti u zbuloi atyre te fshehtat e medha te mbreterise. "Atij, qe e nderon Zotin me jeten e tij, Ai i hap mendjen dhe i tregon te fshehtat e beselidhjes se Tij". - Psalmet 25:14.

Teologet e shkolluar nuk e kuptuan te verteten dhe nuk bene asgje per t'ua shpallur kete te vertete te tjereve. Sikur ata te ishin vezhgues besnike, duke kerkuar me vullnet dhe me ane te lutjes ne Shkrimet e Shenjta, ata do ta kishin dalluar kohen e erresires; profecite dp t'ua kishin hapur syte per te shquar ngjarjet qe do te ndodhnin. Por ata nuk ishin te tille dhe mesazhi u dha nga njerez me te perulur. Jezusi tha: "...Ecni derisa keni Driten, qe te mos ju zere nata..." - Gjoni 12:35. Ata qe i kthejne kurrizin drites qe ju jep Zoti ose qe nuk e kerkojne ate kur mund ta gjejne mbeten ne erresire. Por Shpetimtari deklaron: "...Kush vjen pas meje e ka driten qe çon ne jete dhe nuk do te jetoje ne terr". - gjoni 8:12. Kushdo qe ka si qellim te vetem qe te veproje sipas vullnetit te Perendise, qe i kushton vemendje te madhe drites qe i eshte dhene tashme, do te marre akoma me shume drite, atij shpirti do t'i dergohet nje yll me shkelqim qiellor per ta udhehequr drejt se vertetes.

Gjate kohes se ardhjes se pare te Krishtit ne toke, prifterinjte dhe mesuesit e ligjit te Qytetit te Shenjte, te cileve u ishin besuar Shkrimet e Perendise, mund t'i kishin dalluar shenjat e shfaqura ne kohe dhe mund ta kishin shpallur ardhjen e te Premtuarit. Profecia e Mihajes tregonte vendlindjen e Tij, Danieli specifikonte kohen e ardhjes se Tij. - Mihaja 5:2; Danieli 9:25. Perendia ua dorezoi keto profeci

udheheqesve çifute, ata s'mund te shfaqesoheshin ne qofte se nuk e dinin dhe nuk deklaruan perpara njerezve qe ardhja e Mesise ishte kaq afer. Mohimi mekatar pati si rezultat injorancen e tyre. Çifutet po ndertonin permendore per profetet e vrare te zotit, ndersa ata, po nderonin sherbetoret e Satanit nepermjet respektit qe tregonin per njerezit e medhenj te botes. Te zhytur ne luften ambicioze per pozite dhe pushtet mes njerezve ata nuk i perfillen nderet qe u kishte ofruar Mbreti i qiellit.

Pleqesia e Izraelit duhet t'i kishte studiuar me inyeres te thelle dhe me respekt vendin, kohen, rrethanat e ngjarjes me madheshtore ne historine boterore - ardhjen e Birit te Perendise per te sjelle shpetimin e njerezimit. Te gjithe njerezit duhet te ishin ne gadishmeri dhe ne pritje, ne menyre qe te ishin mes te pareve per t'i uruar Shpetimtarit miresеardhjen. Por shikoni, dy udhetare te rraskapitur qe kane ardhur qe nga kodrat e Nazaretit pershkojne rrugen e ngushte deri ne skajin lindor te qytetit, duke kerkuar me kot nje strehe per te kaluar naten dhe nje vend per te pushuar. te gjitha dyert u mbyllen per ta. Se fundi ata gjeten strehe ne nje kasolle ndertuar per bagetine dhe pikerisht aty lindi Shpetimtari i botes.

Engjejt qiellore kishin pare lavdine qe Biri i Perendise kishte ndare me Atin perpara se te krijohej bota dhe ata e kishin pritur me interes te madh shfaqjen e Tij ne toke, si ngjarjen me te gezueshme per njerezimin. Engjejt duhej t'ia çonin lajmin e gezuar te gjithe atyre qe ishin pergatitur per ta pritur ate dhe qe njekohesisht do t'ua benin te ditur banoreve te tjere te botes. Krishti kishte pranuar te poshterohej, duke marre mbi vete natyren njerezore; ai do te duronte nje peshe te pamate mallkimi, ndersa shpirti i Tij do te behej flijim per mekatin, e megjithate engjejt deshironin qe edhe ne kete poshterimBiri i te Lartit te shfaqej perpara njerezve me dinjitetin dhe lavdine qe i pershtateshin karakterit te tij. A do te grumbulloheshin njerezit e medhenj te tokes ne kryeqytetin e Izraelit per te pershendetur ardhjen e Tij. Do ta shoqeronin turmat e engjejve perpara grupit qe e priste?

Nje engjell vizitoi token per te pare se cilet ishin pergatitur per te mirepritur Jezusin. Por Ai nuk dallon asnje shenje pritjeje. Ai nuk degjon asnje ze triumfues apo lavderues qe te tregoje se koha e ardhjes se mesise eshte afer. Engjelli sillet per nje fare kohe mbi qytetin e zgjedhur dhe mbi tempullin ne te cilin ishte manifestuar per shekuj me radhe prania hyjnore, por edhe ketu mbizoteron e njejta indiference. Prifterinjte me ate krenarine dhe pompozitetin e tyre po ofrojne flijime te ndotura ne tempull. Farisenjte po u flasin njerezve apo po luten me mburrje ne cepat e rrugeve. Ne pallatet mbreterore, ne asamblete e filozofeve, ne shkollat e rabivete[3] gjithe jane po aq te pavemendshem ndaj faktit te mrekullueshem qe kishte sjelle gezim dhe lavderime ne qiell - qe Shpetimtari i njerezve do te shpallej shpejt ne toke.

Nuk ekziston asnje prove qe te trewgoje se Krishti po pritet, dhe nuk eshte bere asnje pergatitje per Princin e jetes. Lajmetari qiellor i habitur eshte gati te rikthehet

[3] Rabi - mesues

ne qiell me lajmet e turpshme, kur ai zbulon nje grup barinjsh, qe po ruajne bagetite e tyre gjate nates dhe po shikojne qiellin me yje, qe po mendojne per profecine e ardhjes se Mesise ne toke dhe qe mezi po e presin Shpetimtarin e botes. Ja ku eshte nje grup njerezish qe jane gati per ta marre mesazhin qiellor. Dhe engjelli i Zotit shfaqet papritmas, duke u deklaruar atyre Lajmin e Mire te nje gezimi te tille. Lavdia qiellore mbulon fushen, shfaqet nje turme e panumert engjejsh dhe duke qene se gezimi ishte teper i madh per t'u shprehur nga nje lajmetar i vetem, nje kor zerash u bashkuan ne nje himn qe nje dite do ta kendojne kombet e te shpetuarve: "Lavdi Perendise ne qiell dhe paqe populliut te Tij ne toke!" - Luka 2:14.

Oh, çfare mesimi eshte per ne kjo histori e mrekullueshme e betlehemit! Çfare qortimi per mosbesimin tone, per krenarine tone, per Pavaresine tone! Na paralajmeron kaq shume qe t'i mbajme syte hapur, perndryshe nga indifwerenca jone vdekjeprurese nuk do te mund te dallojme shenjat ne kohera dhe rrjedhimisht nuk do te dime kur eshte dita e vizites.

Engjejt gjeten vezhgues te ardhjes se Mesise jo vetem ne kodrat e Judese mes barinjve te perulur. Ne vendet pagane kishte njerez qe po e prisnin Ate, njerez te mençur, te pasur dhe fisnike - filozofete Lindjes.

Magit[4], studiues nga natyra, e kishin pare Perendine ne punen e Tij te dores. Ata kishin mesuar nga Shkrimet e Shenjta per Yllin qe do te ngrihej nga Jakobi dhe po pritnin ardhjen e Tij me nje deshire te zjarrte, ardhjen e Atij qe nuk ishte vetem "shpetimi i Izraelit", por edhe "drita qe do t'u zbulohej joçifuteve", "drite per popujt e tjere" - Luka 2:25,32; veprat e Apostujve 13:47. Ata kerkonin driten dhe drita nga froni i Zotit ndriçoi rrugen ku ecen ata. Ndersa prifterinjte dhe mesuesit e Jerzalemit, te cilet ishin caktuar ne detyren e mbrojtesve dhe shpjeguesve te se vertetes ishin zhytur ne erresire, ylli i derguar nga qielli i udhehoqi keta te huaj - jocifute drejt vendlindjes se Mbretit te porsalindur.

"Kur te shfaqet heren e dyte, do te vije, jo per te shlyer mekatet, por per te persosur te gjithe ata qe e presin." - Hebrenjte 9:28. Edhe mesazhi i ardhjes se dyte, ashtu si lajmi i lindjes se Shpetimtarit nuk iu besua udheheqesve fetare. Ata nuk e kishin ruajtur lidhjen me Zotin dhe e kishin refuzuar driten e qiellit, prandaj ata nuk perfshihen ne numrin qe pershkruan apostulli Pal: "Por ju nuk jetoni ne terr, qe te mos ju zere ne befasi Dita e Zotit, ashtu siç do te zere vjedhesin, ju te gjithe jeni njerez qe i takoni drites dhe dites". - Selanikasve 5:4,5.

Vezhguesit mbi muret e Cionit duhet te ishin te paret per te rrokur lajmin e ardhjes se Shpetimtarit, te paret per te shpallur me ze te larte kohen e afert te kesaj ardhjeje, te paret per t'i paralajmeruar njerezit per t'u pergatitur per ardhjen e Tij. Por ata ishin rehgat me endeerat e tyre per paqe dhe siguri, ndersa njerezit flinin ne mekate. Jezusi e pa kishen e Tij si nje peme e zhveshur fiku, mbuluar me gjehte

[4] Magi - njerez te rangut te larte, te shkolluar dhe te pasur. Studiuan Shkrimet e Shenjta dhe qendruan ne pritje te ardhjes se Mesise

te rreme, por nevojtare per fryte te çmuara. Ekzistonte nje respektim mendjemadh i formave fetare, ndersa fryma e perulesise, pendese dhe besimit - keto dhe vetem keto mund ta bejne sherbesen te pranueshme nga Zoti - mungonte. Ne vend te fryteve te Shpirtit te Shenjte manifestoheshin krenaria, formalizmi, egoizmi, shtypja dhe mendjemadhesia. Nje kishe ne rrenim e siper mbylli syte perpara shenjave te koherave. Perendia nuk i braktisi ata e as nuk hoqi dore nga besnikeria e Tij, por ata u larguan nga Ai dhe iu menjanuan dashrise se tij. Meqe ata rwefuzuan qe t'i pergjigjeshin ketyre kushteve, premtimet e Tij nuk u permbushen tek ta.

I tille eshte rezultati i mohimit te privilegjeve qe jep Zoti. rezultati i sigurt i mosvleresimit dhe mospermiresimit nga drita e Tij eshte i tille. Feja do te degradoje ne menyre te pashmangshme ne respektim formash dhe fryma jetesore e zotit do te zhduket, ne qofte se ajo nuk do te ndjeke rrugen e hapur nga maturia e Zotit, duke pranuar çdo rreze drite dhe duke permbushur çdo detyre qe mund t'i ngarkohet. Shembuj te kesaj te vertete jane perseritur ne historine e kishes. Perendia kerkon nga njerezit e Tij vepra besimi dhe akte bindjeje, qe te korrespondojne me bekimet dhe privilegjet qe u jep Ai. Bindja kerkon sakrifice dhe perfshin nje kryq e prandaj shume nga te ashtuquajturit ndjekes te Krishtit e refuzuan driten e ardhur nga qielli dhe si çifutet e hershem nuk e kuptuan kohen e vizites se tij. - Luka 19:44. Per shkak te krenarise dhe mosbesimit te tyre Zoti i la ata te kalonin dhe ua zbuloi te verteten e Tij atyre, qe si barinjte e Betlehemit dhe Maget e Lindjes i kushtuan vemendje drites qe moren.

1. Lexoni përshkrimin e tërmetit të Lisbonës. Sa krahasohet ajo me katastrofat e fundit natyrore si ajo e tsunamit të 2004 dhe urraganit Katrina në SHBA? Përse njerëzit u frikësohen asaj që do të vijë nga lart? A është kjo një shenjë e ardhjes së afërt të Jezusit?

2. Dita e errët e 19 Majit 1780 do të ishte subjekt i kërkimeve shkencore nëse do të ndodhte sot. Si ka ndryshuar qëndrimi i botës ndaj Perëndisë në dy shekujt e fundit?

3. "Ardhja e Zotit ka qenë në të gjitha kohërat, shpresa e ndjekësve të Tij të vërtetë." A besoni se Jezusi po vjen së shpejti? Nëse po, pse?

18.

Një Reformator Amerikan

Një fermer i drejtë dhe i ndershëm që të tjerët e kishin bërë të dyshonte në autoritetin e Shkrimeve të Shenjta, por që dëshironte sinqerisht që të njihte të vërtetën u zgjodh nga Perëndia për të shpallur ardhjen e dytë të Mesisë. William Miller, si shumë reformatorë të tjerë, në fëmijëri kishte luftuar me varfërinë nga ku kishte mësuar për forcën dhe vetëmohimin. Anëtarët e familjes nga e cila rridhte edhe ai vetë karakterizoheshin nga fryma liridashëse dhe e pavarur, ishin të aftë për të duruar dhe ushqenin një patriotizëm të flaktë -tipare që shquheshin edhe në karakterin e tij. Babai i tij ishte kapiten në ushtrinë e Revolucionit dhe ndoshta kushtet e vështira të fëmijërisë së Milerit rezultonin nga sakrificat që kreu ai në betejat dhe përmes vuajtjeve të asaj periudhe të stuhishme.

Ai kishte një fizik të shëndoshë dhe që në vitet e para të jetës dha prova të një fuqie intelektuale më të madhe se e zakonshmja. Me kalimin e viteve kjo u shqua gjithnjë e më shumë. Mendja e tij ishte aktive dhe e zhvilluar dhe ai ishte i etur për dije. Edhe pse nuk pati privilegjin për të studiuar në kolegje, dashuria e tij për librat, mendimi i kujdesshëm dhe kritika e thellë e bënë një njeri me gjykim të shëndoshë dhe pikëpamje të qarta. Ai zotëronte aftësi morale të paqortueshme dhe një fame për ta pasur zili, i vlerësuar zakonisht për integritetin, ekonominë dhe mirëdashjen që tregonte. Arriti shumë shpejt kopetencën e duhur nëpërmjet energjisë dhe praktikës që përdorte, duke ruajtur njëkohësisht zakonin e të studiuarit.. Ai fitoi besimin e autoriteteve të ndryshme civile dhe ushtarake dhe dukej sikur iu hapën rrugët drejt pasurisë dhe nderimit.

Nëna e tij ishte një grua e devotshme dhe që fëmijë ai kishte krijuar përshtypjet e tij fetare. Sidoqoftë në vitet e para të rinisë ai hyri në shoqërinë e deistëve, ndikimi i të cilëve ishte i madh nga fakti se pjesa më e madhe e tyre ishin qytetatë të nderuar, njerëz me prirje mirëdashëse. Duke jetuar mes grupimeve kristiane, karakteri i tyre ishte gdhendur në një farë mase nga mjedisi që i rrethonte. Ata i ishin borxhli

Biblës për mirësitë me anë të së cilave fituan respektin dhe besimin e të tjerëve, por këto dhunti të mrekullueshme u shtrembëruan kaq shumë sa ato ushtruaan ndikim kundër fjalës së Zotit. Mileri nga shoqërimi me ta përvetësoi të njëjtat ndjenja. Interperetimet e vazhdueshme të Shkrimeve të Shenjta paraqitnin vështirësi që atij i dukeshin të pakapërcyeshme, e megjithatë ky besim i tij i ri, ndërsa flakte tej Biblën, nuk i ofronte asgjë tjetër më të mirë për të zënë vendin e saj dhe ai nuk ishte aspak i kënaqur. Sidoqoftë ai i mbrojti këto pikëpamje për pothuajse njëzet vjet. Por në moshën 34-vjeçare Shpirti i Perëndisë i nguli në mendje gjendjen e tij prej mëkatari. Ai nuk gjeti në besimin e tij të mëparshëm asnjë siguri lumturie përtej varrit. E ardhmja shfaqej e errët dhe e trishtueshme. Duke iu referuar ndjenjave të tij gjatë asaj kohe ai thoshte:

"Asgjësimi përbënte një mendim të ftohtë dhe rrënqethës, ndërsa dhënia llogari do të ishte shkatërrim i sigurt për të gjithë. Qielli ishte si prej tunxhi mbi kokën time dhe toka si prej hekuri nën këmbët e mia. Përjetësia - çfarë ishte ajo? Po vdekja - pse ndodhte vallë? Sa më shumë që arsyetoja, aq më larg isha nga praktikja. Sa më shumë që mendoja, aq më të shpërndara ishin konkluzionet që nxirrja. U përpoqa që të mos mendoja më, por nuk mund t'i kontrolloja dot mendimet e mia. Ndjehesha fatkeq pa e ditur shkakun. Qahesha dhe ankohesha pa e ditur për kë. E dija që diçka nuk shkonte, por nuk dija se ku dhe si ta gjeja të drejtën. Mbaja zi, por pa shpresë.

Ai vazhdoi të jetonte në një gjendje të tillë për disa muaj. "Në mendje-thotë ai më ngulitet papritmas karakteri i qartë i një Shpëtimtari. Dukej sikur mund të kishte një qenie kaq të mirë dhe të mëshirshme sa të ofronte vetveten si shlyerje të fajeve tona dhe kështu tëna shpëtonte ne që të mos vuanim dënimin që sjell mëkati. Ndjeva menjëherë mirësinë e një qënieje të tillë dhe imagjinova se si do të qëndroja në krahët e kësaj qenieje, se si do t'i besoja mëshirës së kësaj qenieje. Por më lindi pyetja: "Si mund të provohet se një qenie e tillë ekziston? Kuptova se nuk mund të provoja ekzistencën e një Shpëtimtari të tillë përveç se në Bibël...

"Pashë se Bibla hidhte dritë mbi Shpëtimtarin për të cilin kisha nevojë dhe u çudita se si një libër i pafrymëzuar mund të shtjellonte parime që përmbushnin kaq mirë nevojat e një bote në rrënim. U detyrova të pranoj se Shkrimet e Shenjta duhej të ishin një zbulim nga Perëndia. Ato u bënë kënaqësia ime dhe Jezusi u bë shoku im. Shpëtimtari u bë për mua më i rëndësishmi mes 10 000 njerëzve dhe Shkrimet e Shenjta që më parë ishin të errëta dhe kontradiktore u bënë tashmë pishtarë në këmbët e mia dhe dritë në rrugën time. Mendja m'u qetësua dhe ndjehesha i kënaqur. Kuptova se Zoti është një shkëmb në mes të oqeanit të jetës. Studimi i Biblës u bë parësor për mua dhe mund ta them sinqerisht se unë kërkoja në të me kënaqësi të madhe. Kuptova se nuk më kishin thënë as gjysmën. Çuditesha se si nuk e kisha vënë re më parë bukurinë dhe lavdinë e saj dhe dridhesha kur mendoja se

mund ta kisha mohuar atë. Gjeta të zbuluar në të gjithçka që më dëshironte zemra, dhe një kurë për çdo sëmundje shpirtërore. Më iku dëshira për lexime të tjera dhe dëshiroja me gjithë zemër që të merrja mençuri nga Zoti". - S. Bliss, "Kujtime të Wm. Miller", faqe 65-67.

Milleri shpalli haptazi besimin që ushqente për fenë që dikur e kishte përçmuar. Por shokët e tij nuk vonuan që të sillnin argument që ai vetë i kishte përdorur më parë kundër autoritetit hyjnor të Shkrimeve të Shenjta. Në atë kohë ai nuk ishte i përgatitur për t'iu përgjigjur atyre; por ai arsyetoi kështu: Në qoftë se Bibla është zbulim nga Perëndia, atëherë ajo duhet të jetë në përputhje me vetveten dhe në qoftë se është dhënë për të instruktuar njerëzit, atëherë duhet të jetë e kuptueshme për ta. Ai vendosi ta studionte Shkrimin e Shenjtë vetë dhe të verifikonte nëse nuk mund të harmonizohej çdo kontradiktë e supozuar.

Duke u përpjekur që t'i linte mënjanë paragjykimet dhe të mos u kushtonte vëmendje komenteve, ai krahasoi shkrimet me njëra-tjetrën me ndihmën e referencave që jepeshin në anë të faqeve dhe renditjes alfabetike. Ai vazhdoi studimin e tij rregullisht dhe në mënyrë metodike, duke filluar me Zanafillën, versë pas verse, atij iu deshën vetëm disa pasazhe me një kuptim kaq të zbuluar dhe të qartë për të mos u ndjerë më në siklet. Sa herë gjente diçka të paqartë, ai e kishte bërë zakon ta krahasonte me çdo tekst tjetër që i referohej të njëjtit problem që ai po shqyrtonte. Çdo fjalë kishte lidhjen e vet të veçantë me subjektin e tekstit dhe në qoftë se kuptimi që ai nxirrte prej saj përputhej me çdo pasazh tjetër paralel me të atëherë ajo fjalë nuk përbënte asnjë problem. Kështu sa herë që e kishte të vështirë të kuptonte ndonje pasazh ai e gjente shpjegimin në ndonjë vend tjetër të Shkrimeve të Shenjta. Ndërsa gjatë studimit ai lutej me ngulm për ndriçim hyjnor gjithçka që më parë dukej e pakuptueshme bëhej e qartë. Ai përjetoi të vërtetën e fjalëve të psalmistit: "Zbulimi i fjalës sate sjell dritë; u jep njerëzve të thjeshtë aftësi për të gjykuar drejt". - Psalme 119:130.

Ai studionte me interes të madh librat e Danielit dhe të Apokalipsit, duke përdorur të njëjtat parime interpretimi si me shkrimet e tjera dhe arriti në konkluzionin e gëzueshëm se simbolet profetike ishin të kuptueshme. Ai vuri re se profecitë që deri në atë kohë ishin realizuar qenë përmbushur fjalë për fjalë dhe se në të gjitha figurat e ndryshme metaforat, parabolat, similitudat etj ose shpjegoheshin në lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë, ose termat me të cilat shpreheshin gjenin shpjegim në shkrime të tjera (pjesë e Shkrimit të Shenjtë) dhe me t'u shpjeguar kuptoheshin fjalë për fjalë. "Isha i kënaqur - thotë ai - që Bibla është një sistem të vërtetash që zbulohen kaq qartë dhe thjesht sa edhe endacaku, edhe pse i pashkolluar, nuk mund të gabojë". - Bliss, faqe 70. Ndërsa ai skiconte hap pas hapi linjat e profecisë, përpjekjet e tij u shpërblyen, hallkë pas hallke të zinxhirit të së vërtetës. Engjejt e qiellit po udhëhiqnin mendjen e tij dhe po i hapnin Shkrimet e Shenjta që ai t'i kuptonte.

Duke marrë si kriter gjykimi mënyrën në të cilën ishin përmbushur profecitë në të shkuarën, ai u kënaq nga fakti që pikëpamja e përhapur në popull e mbretërimt shpirtëror të Krishtit - një mijëvjeçar përpara fundit të botës - nuk gjente mbështetje tek fjala e Perëndisë. Kjo doktrinë që tregonte për një periudhë drejtësie dhe paqjeje për 1 000 vjet përpara ardhjes së vetë Zotit mohonte terrorin e ditës së Zotit. Por edhe pse është e këndshme, ajo nuk përputhet me mësimet e Krishtit dhe apostujve të tij, të cilët deklaruan se egjra dhe gruri do të rriten së bashku deri në kohën e korrjeve, në fundin e botës "së mashtruesit dhe gënjeshtarët do të përparojnë - drejt rrugës së rrënimit" se "para mbarimit të kësaj kohe do të ketë kohë të vështira" dhe se mbretëria e errësirës do të vazhdojë deri në ardhjen e Zotit, i cili do ta konsumojë me urdhërin e Tij dhe do ta shkatërrojë me shkëlqimin e Tij. - Mateu 13:30; 38-41; 2 Timoteut 3:13, 1; 2 Selanikasve 2:8.

Doktrina e shndërrimit të botës dhe e mbretërimit shpirtëror të Mesisë nuk u pranua nga kisha apostolike. Nuk u pranua nga të krishterët deri në fillim të shekullit të XVIII. Rezultatet e saj ishin të gabuara ashtu si të çdo gabimi tjetër. Ajo i mësoi njerëzit që hidhnin vështrimin larg në të ardhmen për të kërkuar ardhjen e Zotit dhe bëri që ata të mos u kushtonin rëndësi shenjave që paralajmëronin afrimin e Tij. Ajo përfshinte një ndjenjë të pathemeltë besimi dhe sigurie që bëri që shumë njerëz të hiqnin dorë nga përgatitjet e nevojshme për të takuar Zotin.

Milleri e gjeti përshkrimin e qartë dhe të detajuar të ardhjes së vetë Krishtit në Bibël. Pali thotë: "Kur të dalë urdhëri i Perëndisë, kur të thërrasë kryeengjëlli, kur t'i bjerë borisë, vetë Zoti do të zbresë nga qielli." - 1 Selanikasve 4:16. Dhe Shpëtimtari deklaron: "... Të gjitha fiset e tokës do të qajnë dhe do ta shohin Birin e njeriut, duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe me madhështi të paparë." "Në të vërtetë, Biri i njeriut do të vijë papritur e në mënyrë të dukshme për të gjithë, si vetëtima që dridhet në qiell prej lindjes deri në perëndim." - Mateu 24:30,27. Të gjithë engjëjt e qiellit do ta shoqërojnë. "Kur të vijë biri i njeriut me madhështinë e tij dhe bashkë me të gjithë engjëjt, atëherë do të ulet mbi fronin e tij madhështor." - Mateu 25:31. "Kur t'i bjerë borisë, ai do t'i dërgojë engjëjt e tij nga të gjitha anët e horizontit për t'i bashkuar të zgjedhurit e tij kudo qofshin në botë." - Mateu 24:31.

Me ardhjen e Tij do të ngrihen të vdekurit - besnikë dhe do të shndërrohen të gjallët -besnikë. "Tani po ju them një të fshehtë, ne nuk do të vdesim të gjithë - thotë Pali. - Kur të bjerë boria e fundit, ne të gjithë do të shndërrohemi. Kjo do të ndodhë sa hap e mbyll sytë. Kur të bjerë boria, të vdekurit do të ringjallen për jetën e pavdekshme. Por ne që do të jemi ende gjallë, do të marrim trupin e ri. Trupi ynë i vdekshëm, që jepet pas vdekjes, duhet të shndërrohet në trupin e pavdekshëm, mbi të cilin vdekja nuk ka më asnjë pushtet." - 1 Korintasve 15;51-53. Dhe në letrën drejtuar Selanikasve, pasi përshkruan ardhjen e Zotit, ai thotë: "...Më parë do të ringjallen të gjithë ata që vdiqën (duke i besuar Zotit). Vetëm atëherë ne që

mbetemi gjallë, do të rrëmbehemi bashkë me ta në takim me Zotin që vjen në re... Kështu do të jemi përgjithmonë me Zotin." - 1 Selanikasve 4:16,17.

Nerëzit e Tij mund të bëhen pjesë e mbretërisë vetëm kur Ai personalisht të vijë përsëri. Shpëtimtari tha: "Kur të vijë biri i njeriut me madhështinë e tij dhe bashkë me të të gjithë engjëjt, atëherë do të ulet mbi fronin e tij madhështor. Para tij do të mblidhen njerëz nga të gjithë popujt dhe ai do t'i ndajë njërin prej tjetrit, si bariu që ndan delet prej cjepve. Delet do t'i vërë në të djathtën e tij, kurse cjepte në të majtën. Pastaj mbreti do t'u thotë atyre që janë në të djathtën e tij "Afrohuni, ju që Ati im ju bekoi! Merreni për pronë mbretërinë që ju caktoi Zoti që nga fillimi i botës!" - Mateu 25:31-34. Kështu ne shohim nga shkrimet që sapo na u dhanë se kur të vijë Biri i Njeriut, të vdekurit do të ringjallen dhe të gjallët do të shndërrohen. Ata përgatiten për ta marrë mbretërinë me anë të këtij shndërrimi, sepse Pali thotë:"...Njerëzit prej mishi, gjaku nukmund të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë. Një trup i vdekshëm nuk mund të bëhet i pavdekshëm vetvetiu." - 1 Korintasve 15:50. Njeriu në gjendjen në të cilën ndodhet është i vdekshëm, i korruptueshëm, por mbretëria e Perëndisë nuk mund të korruptohet, ajo do të ekzistojë përgjithmonë. Por me ardhjen e Tij Jezusi u transmeton pavdekshmëri njerëzve të Vet dhe më pas i thërret për t'u dhënë si trashëgimi mbretërinë të gjithë atyre që deri tani kanë qënë të vetmit trashëgimtarë.

Milleri u bind plotësisht nga provat që i dhanë këto si dhe shkrime të tjera (pjesë e Shkrimit të Shenjtë) se ngjarjet që priteshin të ndodhnin përpara ardhjes së Krishtit, siç ishin mbretërimi universal i paqes dhe vendosja e e mbretërisë së Perëndisë mbi tokë ishin më pas në kohë, sepse i përkisnin ardhjes së dytë. Për më tepër të gjitha shenjat e kohërave si dhe gjendja në botë përputheshin me përshkrimin profetik të ditëve të fundit. Vetëm nga studimi që i bëri Shkrimit të Shenjtë ai u detyrua të konkludonte se po i vinte fundi periudhës së ekzistencës së botës në një gjendje të tillë.

"Kronologjia e Shkrimeve të Shenjta[1], - thotë ai - ishte një provë tjetër që ndikoi shumë tek unë...Zbulova se ngjarjet e parashikuara, që ishin përmbushur në të shkuarën, ndodhnin brenda një kohe të caktuar. Njëqind e njëzet vjetët e përpara përmbytjes (Zanafilla 6:3); shtatë ditët që e paraprinë dyzetë ditët e shiut (Zanafilla 7;4), katërqind vjetët e qëndrimit të pasardhësve të Abrahamit në tokë të huaj (Zanafilla 15:19), tri ditët e ëndrrave të kryefurrtarit dhe verëtarit (Zanafilla 40:12_20), shtatë vjetët e ëndrrës së Faraonit (Zanafilla 41:28-54), dyzet vjetët në shkretëtirë (Libri i Përtërirë 14:34), tri vjetë e gjysëm të zisë së bukës (1 Mbretërve 17:1) [të shihet Luka 4:25...shtatëdhjetë vjetët e robërisë (Jeremija 25:110, shtatë vjetët e Nabukodnezarit (Danieli 4:13-16), shtatë periudhat prej shtatë vjetësh dhe

[1] autorja përdor një herë njëjësin (Shkrimet e Shenjta), duke iu referuar Biblës si njësi të vetme, dhe diku tjetër përdor shumësin (Shkrimet e Shenjta), duke iu referuar Dhiatës së Redhe Dhiatës së Vjetër edhe këto si e vetmja njësi.

gjashtëdhjetë e dy periudhat e kufizuara nga këto periudha ishin thjesht profetike, por ato u përmbushën në përputhje me këto parashikime". - Bliss, faqe 74,75.

Kështu, kur gjatë studimit që ai i bëri Biblës, gjeti në të periudha të ndryshme kronologjike, që sipas mendimit të tij, kishin të bënin me ardhjen e dytë të Krishtit, ai i konsideroi ato si "kohë të paracaktuara" që vetë Zoti ua kishte zbuluar shërbëtorëve të Tij. "Planin e tij të fshehtë - thotë Moisiu - e njeh vetëm Zoti, Perëndia ynë, por vullnetin e tij na e ka shpallur qartë neve dhe pasardhësve tanë përgjithmonë...", ndërsa Zoti me anë të profetit Amos deklaron se: "nuk bën asgjë pa njoftuar më parë lajmëtarin e Tij, profetin" -Ligji i Përtërirë 29:29; Amosi 3;7. Studiuesit e fjalës së Perëndisë vënë re se ngjarjet më të mrekullueshme të historisë njerëzore shfaqen qartë në shkrimet e Shenjta të së vërtetës.

"Duke qënë se u binda plotësisht - thotë Milleri - se Shkrimi i Shenjtë është frymëzuar nga Perëndia dhe është dobiprurës (2 Timoteut 3:160, se ai nuk u hartua nga njerëzit, por u shkrua nga profetët e mbushur me Shpirtin e Shenjtë (2 Pjetrit 1;21) dhe se u shkrua "që të mësojmë prej saj, që të na japë zemër që të qëndrojmë të patundur dhe t'ia arrijmë qëllimit që po presim" (Romakëve 15:4), s'më mbeti asgjë tjetër veçse t'i konsideroja periudhat kronologjike të Biblës si po aq të vlefshme dhe të denja për t'u kushtuar vëmendje sa çdo pjesë tjetër e Shkrimeve të Shenjta. Prandaj ndërsa përpiqesha që të kuptoja atë që Perëndia e kishte parë të arsyeshme për të na shfaqur ndjeva se nuk kisha asnjë të drejtë që të nënvleftësoja periudhat profetike." - Bliss, faqe 75.

Danieli 8:14 dukej si profecia që e zbulonte më qartë kohën e ardhjes së dytë: "Flijimi do të ndalohet 2300 herë... Vetem atehere do te rikthehet rregulli i Tempullit." Duke e bere Shkrimin e Shenjte interpretues te vetvetes, Milleri kuptoi se nje dite ne gjuhen simbolike te profecise perfaqesonte nje vit.(Regjistrimet 14:34, Ezekieli 4:6).(Shiko me kujdes, dhe korrekto po të jetë e nevojshme.)

Ai vuri re se periudha e 2300 ditëve profetike apo viteve të plota zgjatej përtej fundit të sistemit fetar çifut dhe rrjedhimisht nuk i referohej shenjtores së atij sistemi. Milleri pranoi pikëpamjen e përgjithshme se gjatë epokës kristiane toka përfaqësohej nga tempulli (shenjtorja) dhe duke u nisur nga kjo ai kuptoi se rikthimi i rregullit të tempullit, që parashikohet tek Danieli 8:14 përfaqëson pastrimin e tokës nga zjarri me ardhjen e dytë të Krishtit. Ai arriti në konkluzionin se sikur të gjendej pikënisja e 2300 ditëve do të mund të merrej vesh pa vështirësi koha e ardhjes së dytë. Kështu do të zbulohej koha e asaj përmbushjeje të madhe, koha kur gjendjes së tanishme me "krenarinë, fuqinë, pompozitetin, kotësinë, ligësinë dhe shtypjen e saj do t'i vijë fundi", kur mallkimi do të "zhvendoset nga toka, vdekja do të shkatërrohet, shërbëtorët e Perëndisë, profetët dhe shenjtorët, ata që e respektuan emrin e Tij do të shpërblehen dhe ata që rrënuan botën do të rrënohen." - Bliss, faqe 76.

Milleri vazhdoi studimin e profecisë me një zell të ri, duke iu përkushtuar me ditë dhe netë të tëra studimit të diçkaje që kishte një rëndësi të tillë të mrekul-

lueshme dhe një interes të tillë të gjithanshëm. Në kapitullin e tetë të librit të Danielit ai nuk gjeti asnjë të dhënë për kohënisjen e 2 300 ditëve, engjëlli Gabriel edhe pse u urdhërua që ta bënte Danielin të aftë për të kuptuar vizionin dha një shpjegim të pjesshëm. Duke qënë se në vizionin e profetit shpalosej persekutimi i tmerrshëm që do të rëndonte mbi kishën, ai humbi fuqinë fizike. Nuk mund të duronte më ai njeri dhe kështu engjëlli u largua për një farë kohe prej tij. "Unë Danieli isha krejt i dërrmuar dhe isha i sëmurë për ditë me radhë..." "vegimi vazhdonte të më shqetësonte - thotë ai- sepse ende nuk e kisha kuptuar."

Zoti urdhëroi përsëri lajmëtarin e Tij: "O Gavriel, shpjegoja atë që pa." Detyra duhej të përmbushej. Pas ca kohësh duke iu bindur urdhërit, engjëlli u rikthye tek Danieli duke i thënë: "O, Daniel dua të të ndihmoj ta kuptosh kuptimin e asaj fjale" "kushtoji mirë vëmendje asaj që kam për të të thënë." - Danieli 8:27,16; 9:22,23,25-27. Një pikë e rëndësishme e vizionit të kapitullit të 8-të kishte mbetur e paqartë, pikërisht ajo që kishte të bënte me kohën - me periudhën e 2300 ditëve, prandaj engjëlli ndërsa vazhdon shpjegimin e tij, ndalet kryesisht në problemin e kohës.

"...do të kalojnë 7 periudha prej 7 vjetësh dhe 62 periudha prej 7 vjetësh gjer në ardhjen e Mesisë. Jeruzalemi do të qëndrojë si qyteti rindërtuar dhe i fortifikuar edhe në qoftë se duhet të përjetojë kohë të vështira. Në fund të kësaj kohe do të vritet padrejtësisht Mesia dhe nuk do të ketë pasardhës ... Ai do të lidhë një marrëveshje të sigurt me shumicën e popullit, por në mesin e kësaj periudhe prej 7 vjetësh do të ndalohet shërbesa e flijimit në Tempull."

Danielit iu dërgua ky engjëll me të vetmin qëllim që t'i shpjegonte atij atë pikë të vizionit të kapitullit të 8-të që ai nuk kishte mundur ta kuptonte, atë thënie që lidhej me kohën.- "...2300 herë. Vetëm atëherë do të rikthehet rregulli i Tempullit." Pasi e urdhëron Danielin "kushtoji vëmendje asaj që kam për të të thënë" engjëlli fillon me këto fjalë:[2] "70 periudha prej 7 vjetësh duhet të kalojnë derisa të ndryshohet fati i popullit tënd dhe i qytetit të shenjtë." Fjala që është përkthyer në anglisht "dekretoj apo urdhëroj" fjalë për fjalë do të thotë "veçoj". Engjëlli deklaron se shtatëdhjetë periudhat që përfaqësojnë një periudhë 490 vjeçare do të veçohen sepse u përkasin çifutëve. Por nga çfarë u veçuan? Duke qënë se 2300

ditët përbëjnë të vetmen periudhë kohore që përmendet në kapitullin e 8-të kjo duhet të jetë edhe periudha nga e cila janë veçuar shtatëdhjetë periudhat prej 7 vjetësh; pra shtatëdhjetë periudhat prej 7 vjetësh duhet të bëjnë pjesë në 2300 ditët dhe këto dy periudha duhet të fillojnë njëkohësisht. Engjëlli deklaroi se shtatëdhjetë periudhat prej shtatë vjetësh fillonin me dhënien e urdhërit për të ndërtuar dhe fortifikuar Jeruzalemin. Sikur të gjendej data e këtij urdhëri rrjedhimisht do të kuptohej kohënisja e periudhës së madhe 2300 vjeçare.

[2] në versionin origjinal anglisht (Danieli 9:24) thuhet: "Janë urdhëruar (dekretuar) 70periudha prej 7 vjetësh.

Ky urdhër gjendet në kapitullin e shtatë, versat 12-26 të librit të Ezrës. Artakserksi, mbreti i Persisë, e nxori këtë dekret në vitin 457 para erës sonë. Por tek libri i Ezrës 6:14 thuhet se shtëpia e Zotit u ndërtua "sipas urdhërit të Perëndisë së Izraelit dhe perandorëve persiane, Kirit, Dariut dhe Artakserksit". Këta tre mbretër, duke e filluar, riafirmuar dhe përfunduar atë që jepej nga ky dekret, bënë që ajo t'i përmbushte kushtet e profecisë dhe të shënonte fillimin e 2300 vjetëve. Duke e konsideruar vitin 457 p.e.s. kohën e përfundimit të punës si vitin e dhënies së urdhërit, vihet re se është përmbushur çdo e dhënë e hollësishme e profecive përsa i përket shtatëdhjetë periudhave prej shtatë vjetësh.

"Që nga çasti kur doli dekreti për rindërtimin e Tempullit do të kalojnë shtatë periudha prej shatë vjetësh dhe 62 periudha prej shtatë vjetësh gjer në ardhjen e Mesisë" - me fjalë të tjera gjashtëdhjetë e nëntë javë apo 483 vjet. Dekreti i Artakserksit u zbatua në vjeshtë të vitit 457 p.e.s. Që nga kjo datë 483 vjetët shtrihen deri në vjeshtë të vitit 27 e.re[3]. Profecia u përmbush pikërisht në atë kohë. Fjala "Mesi" do të thotë "I Shuguruari". Jezusi u pagëzua nga Gjoni në vitin 27 e.re dhe u shugurua[4] ose u mbush me Shpirtin e Shenjtë. Apostulli Pal dëshmon se "Perëndia e zgjodhi Jezusin nga Nazareti dhe e mbushi me Shpirtin e me fuqinë e Tij". - Veprat 10:38. Dhe vetë Shpëtimtari deklaron: "Zoti më ka mbushur me Shpirtin e Tij. Ai më ka emëruar dhe më ka ngarkuar që t'u sjell të varfërve Lajmin e Mirë...." - Luka 4:18. Pas pagëzimit Jezusi shkoi në Galile dhe predikoi lajmin e mirë të Perëndisë: "Erdhi kohë e caktuar..." - Marku 1:14,15.

"Ai do të lidhë një marrëveshje të sigurt me shumicën e popullit për një periudhë prej 7 vjetësh". "Periudha" për të cilën flitet këtu është periudha e fundit e shtatëdhjetë periudhave, ajo përbën shtatë vjetët e fundit të periudhës që ishte paracaktuar veçanërisht për çifutët. Gjatë kësaj kohe, që nga viti 27 e.re deri në vitin 34 e.re, Krishti fillimisht personalisht e më pas nëpërmjet nxënësve të Tij, ua drejtoi veçanërisht çifutëve ftesën për të përqafuar Lajmin e Mirë. Ndërsa apostujt u nisën për të shpërndarë Lajmin e Mirë të mbretërisë, udhëzimi i Shpëtimtarit ishte ky: "Mos shkoni në vendet ku banojnë joçifutët, as mos hyni në qytetet e Samarisë, por shkoni tek kopeja e humbur, tek populli i Izraelit."- Mateu 10:4,5.

"Por në mesin e kësaj periudhe prej shtatë vjetësh do të ndalohet shërbesa e flijimit në Tempull." Zoti ynë u kryqëzua në vitin 31 e.r., tre vjet e gjysëm pas pagëzimit të Tij. Me flijimin e madhërishëm që u ofrua në Kalvar, i erdhi fundi sistemit të flijimeve që kishin pasur si pikësynim për 400 vjet Qengjin e Perëndisë. Modeli ishte kthyer në realitet dhe flijimeve dhe blatimeve të sistemit ceremonial u kishte ardhur fundi.

---

[3] sipas llogaritjes çifutë muaji i pestë i vitit të shtatë të mbretërimit të Artakserksit filloi më 23 Korrik deri më 21 Gusht 457 p.e.s. Dekreti i mbretit u zbatua pas ardhjes së Ezrës në Jeruzalem, në vjeshtë të atij viti.

[4] shugurim është një shërbesë fetare ku përdoret vaj.

Pra siç e pamë shtatëdhjetë periudhat prej shtatë vjetësh apo 490 vjetët që u ishin paracaktuar veçanërisht çifutëve përfunduan në vitin 34 e.r. Në atë kohë falë veprimtarisë së Këshillit[5] Çifut kombi vulosi mohimin e ungjillit nëpërmjet vrasjes së Shtjefnit dhe persekutimit që iu bë ndjekësve të Krishtit. Kështu mesazhi i shpëtimit nuk u kufizua më brenda kombit të zgjedhur, por iu dha të gjithë botës. Nxënësit e Mesisë, të detyruar nga persekutimi që të largoheshin nga Jeruzalemi "e përhapën gjithkund lajmin e mirë për Jezusin". "Filipi shkoi në kryeqytetin e Samarisë dhe shpalli lajmin që Jezusi është Mesia". Pjetri, i udhëhequr nga drita hyjnore, ia tregoi lajmin e mirë Komandantit[6] të Çezarit, Kornelit, që e respektonte Perëndinë; Pali i zellshëm, i rrëmbyer nga besimi tek Jezus Krishti, u autorizua që ta çonte lajmin e mirë "në popuj të huaj". - Veprat 8:4,5; 22:21.

Deri tani është përmbushur në mënyrë strikte çdo e dhënë e hollësishme e profecive dhe padyshim fillimi i shtatëdhjetë periudhave prej shtatë vjetësh i përket vitit 457 p.e.s. dhe përfundimi i tyre vitit 34 e.r. Duke u nisur nga këto të dhëna nuk është e vështirë që të gjendet fundi i 2300 ditëve. Po t'u heqim 2300 ditëve (vjetëve) shtatëdhjetë periudhat prej shtatë vjetësh - pra 490 ditë (vjet) - do të na mbesin 1810 ditë (vjet). Pas përfundimit të 490 ditëve mbeteshin edhe 1810 ditë për t'u përmbushur. 1810 vjetë po të fillojnë në vitin 34 e.s. përfundojnë në vitin 1844. Rrjedhimisht 2300 ditët e librit të Danielit 8:14 përfundojnë në vitin 1844. Në fund të kësaj periudhe të madhe profetike sipas dëshmisë së engjëllit të Zotit "do t'i rikthehet rregulli Tempullit" Kështu përfundimisht tregohej koha gjatë së cilës do t'i rikthehej rregulli Tempullit - gjë që besohej botërisht se do të ndodhte me ardhjen e dytë.

Milleri dhe shokët e tij besuan fillimisht se 2300 ditët do të përfundonin në pranverë të vitit 1844, ndërsa profecia flet për vjeshtën e atij viti. Keqkuptimi i kësaj pike bëri që ata të ishin të sigurt se ardhja e Zotit do të ndodhte më shpejt të mbeteshin të çorientuar dhe të zhgënjyer. Megjithatë kjo nuk ndikoi aspak në forcën bindëse të argumentit që tregonte se 2300 ditët do të përfundonin në vitin 1844 dhe se ngjarja e madhe që përfaqësohej nga rikthimi i rregullit të Tempullit do të ndodhte pikërisht atëherë.

Duke i hyre studimit të Shkrimeve të Shenjta në mënyrë që të provonte se ato ishin zbulime të dhëna nga Perëndia, në fillim, ai as që priste të arrinte në të tilla konkluzione. Ai vetë mezi u besoi rezultateve të kërkimeve të tij. Por të dhënat e Shkrimit të Shenjtë ishin aq të qarta dhe bindëse sa s'mund t'i lije mënjanë.

Në vitin 1818, pas dy vitesh përkushtimi ndaj studimit të Biblës ai arriti bindjen absolute se Krishti do të shfaqej pas 25 vjetësh për të çliruar njerëzit që i përkisnin. "Nuk mund t'i përshkruaj - thotë Milleri - as gëzimin që ndieja në zemër kur mendoja këtë perspektivë të mrekullueshme dhe as dëshirën e zjarrtë të shpirtit kur

[5] Këshilli Çifut ishte organi më i lartë i qeverisjes së vendit

[6] komandant i 100 ushtarëve

mendoj gëzimin e të shpëtuarve. Bibla mori tani një kuptim të ri për mua. Ishte një zbulim i zgjuar, drita që lindi nga faqet e saj të shenjta shpërndau gjithçka që për mua ishte e errët, mistike dhe e paqartë në mësimet e saj, oh sa e ndritshme dhe e lavdishme ishte shfaqja e së vërtetës! Gjithçka që më parë më dukej kontradiktore dhe e paqëndrueshme ishte zhdukur, edhe pse kishte pjesë që nuk i kuptoja tërësisht, mendja ime që më parë ishte e errët, tashmë ishte ndriçuar aq shumë nga drita që lind prej saj, sa ndieja një kënaqësi të tillë nga studimi i Shkrimit të Shenjtë që nuk ma kishte marrë mendja kurrë më parë se mund të buronte nga mësimet e tij." - Bliss, faqe 76,77.

Duke pasur bindjen absolute se ngjarjet e rëndësishme në Shkrimet e Shenjta ishin parashikuar të ndodhnin brenda një kohe kaq të shkurtër dhe duke mos marrë parasysh provën që më kishte bindur, para meje u shtrua urgjente detyra që kisha ndaj botës." - Ibid., faqe 81. Ai kuptoi se i përkiste atij që t'u jepte të tjerëve dritën që ai kishte marrë. Ai priste kundërshtim nga ana e të ligëve, por besonte se të gjithë të krishterët që e kishin shpallur dashurinë e tyre për Shpëtimtarin do të ngazëlloheshin nga shpresa e takimit të shpejtë me Të. Ai kishte frikë se të rrembyer nga gëzimi i madh i një perspektive çlirimi të lavdishëm, gëzimi që do të konsumohej shpejt, shumë prej tyre do ta pranonin këtë doktrinë pa shqyrtuar mjaftueshëm Shkrimet e Shenjta, që provonin vërtetësinë e saj. Kështu ai rianalizoi provat që mbështetnin konkluzionet e arritura prej tij dhe shqyrtoi me kujdes çdo pengesë që paraqitej para tij. Ai kuptoi se kundërshtimet zhdukeshin përpara dritës së fjalës së Perëndisë ashtu si mjegulla zhduket përpara rrezeve të diellit. Pas pesë vjetë studimi ai u bind plotësisht për saktësinë e qëndrimit të tij.

Përgjegjësia për t'ua bërë të njohur të tjerëve atë që ai besonte se jepej qartë në Shkrimet e Shenjta, i qëndronte çekan mbi kokë. "Sa herë filloja punën - thotë ai - ajo më buçiste vazhdimisht në vesh: "Shko dhe tregoi botës për rrezikun që e kanos". Mendoja gjithmonë për këtë tekst: "Kur të shpall se një njeri i caktuar duhet të vdesë për shkak të veprave të tij të këqija, atëherë ti ke përgjegjësi për këtë që ta paralajmërosh. Në qoftë se nuk e bën detyrën tënde, atëherë ai vërtet do të vdesë, ashtu siç e meriton; por ty do të të kërkoj llogari si për një vrasje. Në qoftë se ti e paralajmëron dhe ai nuk i kushton vëmendje, atëherë ai përsëri do të vdesë, ashtu siç e ka merituar, por ti ke shpëtuar jetën tënde". -Ezekieli 33:8,9. Kuptova se sikur të paralajmëroheshin njerëzit e ligj, turma të tëra mund të pendoheshin, por sikur ata të mos paralajmëroheshin, llogari do të më kërkohej mua." -Bliss, faqe 92.

Sa herë që i jepej mundësia, ai shfaqte individualisht bindjet e veta, duke u lutur që ndonjë pastor ta ndjente forcën e tyre dhe t'i përkushtohej përhapjes së tyre. Megjithatë ai s'mund të fshinte nga mendja bindjen se paralajmërimi përbënte edhe një detyrë të tijën personale. Në mendje i riktheheshin fjalët: "Shko dhe tregoji botës; llogari do të të kërkoj ty". Me një barrë që i rëndonte mbi shpirt ai priti nëntë vjet deri në vitin 1831 kur ai shpalli botërisht për herë të parë arsyet e besimit të tij.

Ashtu siç u thirr Elija, ndërsa ndiqte tufën e demave në fushë, për të veshur mantelin e përkushtimit që i përkiste detyrës profetike, ashtu Perëndia i bëri thirrje William Millerit që të linte plugun për t'u shfaqur njerëzve misteret e mbretërisë së vet. Ai i hyri punës duke u dridhur, duke i drejtuar ata që e dëgjonin, hap pas hapi, përmes periudhave profetike deri tek ardhja e dytë e Krishtit. Interesi i përgjithshëm që zgjuan fjalët e tij i dha fuqi dhe guxim.

Ai pranoi që t'i shfaqte pikëpamjet e tij publikisht falë kërkesës që i bënë miqtë e tij, në fjalët e të cilëve ai dëgjoi thirrjen e Zotit. Ai ishte gjatë asaj kohe 50 vjeç, i pamësuar për të folur përpara publikut dhe nuk ndjehej i përshtatshëm për punën që e priste. Por që në fillim puna e tij u bekua në një mënyrë të mrekullueshme që çoi deri në shpëtim shpirtrash> Fjalimi i tij i parë u pasua nga një zgjim fetar gjatë të cilit u shndërruan trembëdhjetë familje të tëra me përjashtim të dy personave. Kjo e nxiti menjëherë që të fliste në vende të tjera dhe puna e tij rezultoi kudo në ringjalljen e punës së Zotit. Mëkatarët u shndërruan shpirtërisht, të krishterët u rritën në besim, deistët dhe jobesimtarët u detyruan të njohin të vërtetën e Biblës dhe fenë kristiane. Dëshmia e njerëzve mes të cilëve punoi ai ishte kjo: "Ai arriti të depërtonte mendjet e një klase njerëzore pa ndihmën e të tjerëve". - Ibid.,faqe 138. Predikimi i tij kishte për qëllim që t'i drejtonte mendjet e dëgjuesve drejt gjërave të rëndësishme të besimit dhe që t'i vinte cak materializimit dhe imoralitetit të kohës.

Në çdo qytet kishte shumë njerëz, në disa edhe me qindra, që u shndërruan shpirtërisht si rezulatat i predikimit të tij. Në shumë vende, kishat protestante të çdo lloji i kishin dyert e hapura për të dhe ai merrte ftesa pune nga ministria (pastorë) të kongregacioneve të ndryshme. Ai e kishte si rregull që të mos punonte në vende ku nuk ishte i ftuar, por brenda një kohe të shkurtër ai nuk mund t'i përgjigjej as gjysmës së kërkesave që i drejtoheshin. Shumë njerëz edhe pse nuk i pranonin pikëpamjet e tij për kohën e saktë të ardhjes së dytë, ishin të bindur se ardhja e Krishtit ishte e sigurt dhe e afërt dhe ndjenin nevojën për t'u përgatitur. Në disa nga qytete e mëdha puna e tij la gjurmë. Pijeshitësit braktisën tregtinë dhe i kthyen dyqanet në salla mbledhjesh, qoshet e kumarit u harruan, ateistët, deistët, universalistët dhe madje edhe të shthururit më të këqinj u reformuan; disa prej tyre s'kishin shkelur në kishë për vite me radhë. Sektet e ndryshme fetare caktuan pothuajse çdo orë takime lutjeje në lagje të ndryshme, ndërsa tregtarët mblidheshin në mesditë për t'u lutur e lavdëruar Perëndinë. Mendjet e njerëzve nuk zotëroheshin nga ngacmime ekstravagante, por nga një solemnitet universal. Puna e tij, ashtu si ajo e Reformatorëve të hershëm, synonte që të thellonte kuptimin dhe të zgjonte ndërgjegjen dhe jo vetëm të ngacmonte emocionet.

Kisha Baptiste, anëtar i së cilës ishte dhe ai vetë, i dha në vitin 1899 liçensën për të predikuar. Një numër i madh pastorësh që i përkisnin sektit të tij fetar miratuan punën e nisur dhe ai vazhdoi këtë punë falë aprovimit të tyre. Ai udhëtoi

dhe predikoi pa puishim edhe pse ai i kufizoi përpjekjet e tij personale kryesisht brenda Anglisë së Re dhe..... Për vite me radhë ai i përballoi vetë shpenzimet e kësaj pune dhe më pas nuk iu dhanë kurrë të holla të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e udhëtimeve për të shkuar në vendet ku e ftonin. Kështu puna që kryente jo vetëm që nuk i sillte asnjë përfitim ekonimik, por përkundrazi i rëndonte në të ardhurat e tij, të cilët u pakësuan gradualisht gjatë kësaj periudhe të jetës së tij. Ai ishte babai i një familjeje të madhe, por duke qënë se ata ishin të gjithë të zellshëm dhe kursimtarë, ferma e tij ishte e mjaftueshme për t'i ushqyer atë dhe familjen e tij.

Dy vjet pasi Milleri kishte filluar të shfaqte publikisht provat e ardhjes së shpejtë të Krishtit, në vitin 1833, u shfaq shenja e fundit që Shpëtimtari i kishte premtuar se do ta shfaqte përpara ardhjes së Tij të dytë. Jezusi tha: "...trupat qiellorë do të bien nga qielli..." - Mateu 24:29. Dhe Gjoni pasi pa në vizion skenat që do të paraprinin ditën e Perëndisë, deklaroi kështu në Zbulesë: "Trupat qiellorë ranë mbi tokë si fiku që hedh kokrra të papjekura." - Zbulesa 6:13. Kjo profeci u përmbush në mënyrë të çuditshme në shiun meteorik të 13 Nëntorit 1833. Ai ishte manifestimi më i mrekullueshëm dhe më i madh i rënies së yjeve që është regjistruar ndonjëherë. "E gjithë kupa e qiellit mbi Shtetet e Bashkuara u trazua për orë me radhë! Në këtë vend që nga themelimi i tij, nuk kishte ndodhur asnjëherë ndonjë dukuri e tillë qiellore që të ishte vëzhguar me admirim të madh nga njëra klasë dhe me tmerr dhe alarm nga klasa tjetër." Madhështia dhe bukuria e tij ndjellëse është akoma gjallë në mendjet e shumë njerëzve....Asnjëherë s'ka rënë shi më i trashë sesa ai i meteorëve që u shkëputën drejt tokës, lindje, perëndim, veri, jug...ishte e njëjta gjë kudo. Me një fjalë, i gjithë qielli ishte në lëvizje...Rënia, siç përshkruhet në Gazetën (Journal) e Profesor Sillimanit, u vu re në gjithë territorin e Amerikës së Veriut...Në të gjithë sipërfaqen qiellore, që nga ora dy e deri në lindjen e plotë të ditës, s'kishte asnjë re, mbizotëronte kthjelltësia dhe ruhej veprimtaria e vazhdueshme e disa trupave shndritës që të verbonin." - R. M. Devens - "Përparimi amerikan apo ngjarjet e mëdha të shekullit më të madh"; kap. 28; parag. 1-5.

"S'ka gjuhë që të përshkruajë shkëlqimin e atij manifestimi të mahnitshëm... askush që nuk e ka parë me sytë e vet s'mund të formojë një ide të saktë mbi madhështinë e saj. Dukej sikur të gjithë yjet e qiellit ishin grumbulluar në një pikë afër Zenitit dhe zbrisnin poshtë me shpejtësinë e dritës njëkohësisht në drejtim të çdo ane të horizontit dhe s'kishin fund - me mijëra ndiqnin me shpejtësi shtegun e hapur nga mijëra të tjerë sikur të ishin krijuar posaçërisht për këtë rast." - T. Reed, "The Christian Advocate and Journal", 13 Dhjetor 1833. "nuk mund të shihet një pamje më e saktë e një peme fiku që hedh kokrra të papjekura, kur fryn një erë e tërbuar." - "The Old Countryman" në Evening Advertiser, Portland 26 Nëntor 1833.

Në numrin e 14 Nëntorit 1833 në Journal of Commerce (Gazeta e Tregtisë) të New York-ut u botua një artikull i gjatë që kishte të bënte me këtë dukuri të

mrekullueshme, ku përfshihej kjo thënie: "Mendoj se asnjë filozof shkencëtar nuk kishte folur apo dhënë fakte rreth një ngjarjeje si ajo e djeshmja. Në qoftë se duam të kuptojmë se yje që bien do të thotë rënie yjesh... një profet e parashikoi atë saktësisht njëmijë e tetëqind vjet më parë dhe kjo është e vetmja e vërtetë."

Kështu u shfaq shenja e fundit e ardhjes së Tij, për të cilën Jezusi u tha nxënësve të Tij: "...kur të shihni se po afrohen të gjitha këto, atëherë dijeni se ju pret menjëherë fundi." - Mateu 24:33. Gjoni pa pas këtyre shenjave ngjarjen tjetër kërcënuese, qielli u zhduk si një pergamenë që rrotullohet, asnjë mal dhe asnjë ishull nuk mbetën në vendet e tyre dhe të ligët të tmerruar u përpoqën të largoheshin nga prezenca e Birit të njeriut. - Zbulesa 6;12-17.

Shumë njerëz që panë me sytë e tyre rënien e yjeve e konsideruan atë si paralajmërim të gjykimit që po afronte, "një simbol i madh, një paralajmërues i sigurt, një shenjë mëshirplotë e asaj dite të madhërishme dhe të tmerrshme" - "The Old Countryman" në Evening Advirtiser, 26 Nëntor shumë prej tyre i vunë veshin paralajmërimit të ardhjes së dytë.

Në vitin 1840 një profeci tjetër me përmbushjen e saj të mrekullueshme ngjalli një interesim të përgjithshëm. Dy vjet më parë Josiah Litch, një nga pastorët kryesorë, ndërsa predikonte për ardhjen e dytë, botoi një artikull shtjellues mbi kapitullin e 9-të të Zbulesës ku parashikohet rënia e Perandorisë Otomane. Sipas llogaritjeve të tij kjo fuqi do të rrëzohej "dikur aty nga Gushti i vitit 1840 e.s.", dhe vetëm pak ditë përpara përmbushjes së saj ai shkroi: "Duke qënë se periudha e parë prej 150 vjetëve është përmbushur plotësisht përpara së Deacozes me lejen e turqve të ulej në fronin mbretëror dhe se 391 vjetët dhe pesëmbëdhjetë ditët që filluan në fund të periudhës së parë do të përfundojnë në 11 Gusht 1840 kur mund të pritet edhe rënia e fuqisë otomane në Kostandinopojë. Unë mendoj se do të ndodhë pikërisht kështu." - JOsiah Litch, në "Sings of the Times 2 (Shenjat e Kohërave) dhe "Expositor of Prophecy" (Parashtrues profecie); 1 Gusht 1840.

Turqia, pikërisht në kohën e paracaktuar, pranoi përmes ambasadorëve të saj mbrojtjen e forcave të bashkuara të Evropës dhe u vu kështu nën kontrollin e Shteteve kristiane.

Ngjarja vetë ishte përmbushja e plotë e parashikimit. Me t'u bërë i njohur ky fakt, një numër i madh njerëzish u bindën për saktësinë e parimeve që Milleri dhe shokët e tij përdornin për të interpretuar profecitë dhe kjo i dha një shtytje të mrekullueshme lëvizjes që përkrahte ardhjen e dytë. Me Millerin u bashkuan njerëz të ditur dhe të pushtetshëm që e ndihmuan si në predikim ashtu edhe në botimin e pikëpamjeve të tij dhe puna u përhap me shpejtësi gjatë viteve 1840-1844.

William Miller zotëronte fuqi të mëdha mendore që ishin thelluar falë studimit dhe meditimit; dhe ai u shtoi këtyre mençurinë e qiellit, duke u lidhur fort pas burimit të mençurisë. Ai ishte një njeri me dhunti të rralla dhe ngjallte respekt

kudo ku vlerësoheshin ndershmëria ekarakterit dhe pastërtia morale. Duke bashkuar mirësinë shpirtërore me përuljen kristiane dhe me aftësinë e vetëkontrollit, ai ishte i sjellshëm dhe i vëmendshëm me të gjithë, gjithmonë i gatshëm për t'u dhënë rëndësi mendimeve të të tjerëve dhe për t'i peshuar argumentet e tyre. Ai i ballafaqonte pa u ngutur të gjitha teoritë dhe doktrinat me fjalën e Perëndisë, kështu arsyetimi i shëndoshë dhe njohuria e thellë që kishte për Shkrimet e Shenjta e bënë të aftë për t'i vënë cak gabimit dhe për t'i hequr maskën gënjeshtrës.

Megjithatë gjatë punës ai u ndesh me një kundërshtim të hapur. Ashtu siç ndodhi edhe me Reformatorët e hershëm, të vërtetat që ai paraqiste nuk u mirëpritën nga mësues fetarë të njohur dhe popullorë. Duke qënë se nuk mund ta ruanin pozitën e tyre nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta, ata u drejtoheshin dhe bazoheshin tek thëniet dhe doktrinat njerëzore, tek traditat e Etërve. Por predikuesit e të vërtetës, që kishte të bënte me ardhjen pranonin fjalën e Zotit si të vetmen dëshmi. "Bibla dhe vetëm Bibla" ishte parulla e tyre. Mungesën e argumenteve nga Bibla, kundërshtarët e tyre e zëvendësonin me tallje dhe përqeshje. Kohë, mjete, talente u harxhuan vetëm që të viheshin në lojë ata, i vetmi gabim i të cilëve ishte se prisnin me gëzim rikthimin e Zotit të tyre, se orvateshin të jetonin shenjtërisht dhe se i bënin thirrje të tjerëve për t'u përgatitur për ardhjen e Tij.

U bënë përpjekje të ethshme për t'i larguar mendjet e njerëzve nga idea e ardhjes së dytë. Të studiojë profecitë që lidheshin me ardhjen e Krishtit dhe fundin e botës konsiderohej diçka e turpshme, mëkat. Kështu ky lloj predikimi i vuri shkelmin besimit tek fjala e Perëndisë. Mësimet e tyre i kthyen njerzit në të pafe dhe shumë prej tyre ndjeheshin të lirë për të ndjekur epshet e tyre të shfrenuara. Autorët e së keqes ia ngarkuan të gjitha këto mbi supe Adventistëve[7].

Edhe pse Milleri tërhiqte pas vetes turma të tëra dëgjuesish të vëmendshëm dhe inteligjentë, shtypi fetar e përmendte shumë rrallë emrin e tij dhe kjo bëhej vetëm për ta denoncuar apo për t'u tallur me të. Njerëzit moskokëçarës dhe të ligj, që morën zemër nga qëndrimi i mësuesve fetarë përdorën epitete përbuzëse, thënie të ulëta dhe fyese në mënyrë që ta poshtëronin atë dhe punën e tij. Njeriu me flokë të bardha, që kishte hequr dorë nga rehatia e shtëpisë për të udhëtuar me shpenzimet e veta nga qyteti në qytet, nga fshati në fshat, duke punuar papushim për ta paralajmëruar solemnisht botën se gjykimi ishte afër, denoncohej me përçmim si fanatik, gënjeshtar, batakçi.

Talljet, gënjeshtra dhe abuzimi që iu bë emrit të tij ngjallën indinjatën madje edhe të shtypit sekular. Njerëz të ndryshëm deklaruan se: "të trajtosh një subjekt me një madhështi të tillë të pamasë dhe me rjedhoja të tilla të frikshme", me nënvleftësim dhe përçmim "nuk do të thotë që vetëm të luash me ndjenjat e propaganduesve dhe përkrahësve të tij", por "edhe të bësh shaka me ditën e gjykimit, të

[7] njerëz që besojnë në advent-in (ardhjen) e dytë.

tallesh me vetë Madhërinë dhe të përçmosh tmerret e gjykimit të Tij". - Bliss, faqe 183.

Nxitësi i së keqes u përpoq jo vetëm që të sulmonte mesazhin e ardhjes, por edhe që të shkatërronte vetë lajmëtarin. Milleri e zbatoi praktikisht të vërtetën e Shkrimit të Shenjtë në jetën e dëgjuesve të tij, duke i qortuar për mëkatet e tyre, duke sulmuar vetëkënaqësinë e tyre, por duke ngjallur kështu me anë të fjalëve të tij të prera dhe të qarta, armiqësinë e tyre. Klasat më të ulëta të shoqërisë morën zemër nga kundërshtimi që i bënë anëtarët e kishës mesazhit të tij dhe armiqtë komplotonin për të organizuar vrasjen e tij, ndërsa do të largohej nga vendi i takimit. Por aty kishte me mijëra engjëj, dhe njëri prej tyre me formë njerëzore e kapi këtë shërbëtor të Zotit nga krahu dhe e shpëtoi nga zemërimi i turmës. Puna e tij s'kishte përfunduar ende, kështu që Satani dhe agjentët e tij nuk ia dolën në krye realizimit të qëllimit të tyre.

Interesi ndaj lëvizjes adventiste (të ardhjes) vazhdoi të rritej, pavarësisht nga kundërshtimi me të cilin u ndesh ajo. Anëtarësia e kishave nga disa qindra, u rrit në disa mijëra. Kjo rritje u vu re në kisha të ndryshme, por pas një farë kohe u manifestua shpirti i kundërshtimit edhe ndaj këtyre anëtarëve të rinj dhe kishat filluan të ndërmerrnin masa disiplinore kundër atyre që përqafuan pikëpamjet e Millerit. Një veprim i tillë nxiti përgjigjen e tij me shkrim drejtuar të krishterëve të çdo sekti fetar, duke kërkuar që t'i provohej nga Shkrimet e Shenjta nëse doktrinat e tij ishin të rreme.

"Çfare kemi besuar, - tha ai, - që nuk na është urdhëruar nga fjala e Perëndisë, të cilën ju vetë e konsideroni si udhërrëfyese, si të vetmen udhërrëfyese të besimit dhe jetës sonë? Çfarë paskemi bërë që të sulmohemi kaq ashpër si nga podiumet e kishave, ashtu edhe nga shtypi dhe të gjeni kështu shkak për të na përjashtuar ne [Adventistëve nga kishat dhe adhurimi?" "Ju lutem, nëse jemi të gabuar na tregoni ku qëndron gabimi ynë, jemi ngopur me talljet tuaja, ato s'mund të na bindin se jemi të gabuar, vetëm fjala e Perëndisë mund të ndryshojë pikëpamjet tona. Ne kemi arritur në të tilla konkluzione me ndërgjegje dhe duke u lutur falë provës që kemi gjetur në Shkrimet e Shenjta." - Ibid,faqe 250,252.

Nga shekulli në shekull, paralajmërimet që Zoti ka dërguar me anë të shërbëtorëve të Tij janë pritur me përçmim dhe mosbesim. Kur poshtërsia e njerëzve bëri që ai të përmbyste tokën, Ai fillimisht ua bëri të ditur qëllimin që kishte në mënyrë që ata të kishin mundësi që të largoheshin nga rruga e keqe. Paralajmërimi për t'u penduar u kumboi në vesh për 120 vjet me radhë, përndryshe zemërimi i Perëndisë do t'i çonte në rrënim. Por ky mesazh iu duk atyre një përrallë e kotë dhe ata nuk e besuan. Të frymëzuar nga ligësia e tyre ata u tallen me lajmëtarin e Zotit, i nënvleftësuan lutjet e Tij e madje e akuzuan për mendjemadhësi. Si mund të guxonte një njeri i vetëm që të kundërshtonte kokat e mëdha të botës? Pse nuk e vinte

re bota dhe pse nuk e besonte ajo mesazhin e Noes, në qoftë se ai ishte i vërtetë? Lajmërimi i një njeriu kundër mençurisë së botës mbarë! Ata nuk do t'i vinin veshin paralajmërimit dhe nuk do të kërkonin strehë në barkë.

Njerëzit që qeshën me të, treguan shenjat e natyrës - stinët që ia linin vendin njëra -tjetrës pa u lodhur, qielli blu nga i cili s'kishte rënë kurrë më parë shi, fushat e gjelbërta që freskoheshin nga vesa e natës - dhe britën më të madhe: "A nuk flet ai përçart?" Ata deklaruan me përbuzje se ai predikues i së vërtetës nuk ishte asgjë tjetër veçse një ëndërrues primitiv, ata vazhduan më të zellshëm se kurrë në kërkim të kënaqësive, më të prirur se kurrë drejt së keqes. Por mosbesimi i tyre nuk e pengoi përmbushjen e paralajmërimit. Perëndia e duroi gjatë ligësinë e tyre, duke u dhënë mundësi për t'u penduar, por në kohën e caktuar gjykimet e Tij ranë mbi ata që kishin mohuar mëshirën e Tij.

Krishti deklaron se i njëjti mosbesim do të manifestohet edhe përsa i përket ardhjes së Tij të dytë. Ashtu si njerëzve të kohës së Noes "nuk u shkonte nëpër mend që do t'u ndodhte gjë derisa erdhi përmbytja dhe i fshiu. Kështu do të jetë kur të vijë Biri i njeriut." -Mateu 24:39. Kur "të ashtuquajturit" njerëz të Perëndisë do të shkrihen me botën, duke jetuar siç jetojnë dhe duke u dhënë si të tjerët pas kënaqësive të ndaluara, kur luksi i botës bëhet luks i kishës, kur të bien këmbanat e dasmave dhe të gjithë të jenë duke pritur që të jetojnë vite të tëra prosperiteti tokësor - atëherë, papritur ashtu siç vetëtin qielli, do t'u vijë fundi vizioneve shumëngjyrëshe dhe shpresave të rreme.

Ashtu siç dërgoi shërbëtorin e Tij për ta paralajmëruar botën për ardhjen e Përmbytjes, Perëndia dërgoi lajmëtarë të zgjedhur për të lajmëruar afërsinë e gjykimit përfundimtar. Dhe ashtu si bashkëkohësve të Noes u pëlqente që të talleshin me parashikimet e predikuesit të së drejtës edhe në kohën e Millerit shumë njerëz, madje edhe njerëz "të shpallur" të Perëndisë, qeshën me thëniet e tij.

Por pse nuk i mirëpritën kishat doktrinën dhe predikimin mbi ardhjen e dytë tëKrishtit/ Ardhja e Zotit edhe pse u sjell të ligjve shkatërrim dhe mallkim, është për të drejtët gëzim dhe shpresë. Kjo e vërtetë e madhe kishte ngushëlluar besnikët e Perëndisë përmes vështirësive të shekujve; pse ishte kthyer, ashtu si Autori i tij në "gur pengesës dhe "shkëmb bezdie" për "të ashtuquajturit" njerëz të Tij? Ishte vetë Zoti që u premtoi nxënësve të Tij: "PO shkoj, pra, për t'iu përgatitur një vend. Pastaj do të kthehem për t'iu marrë më vete, që edhe ju të jeni atje ku do të jem unë". - Gjoni 14:3

Ishte Shpëtimtari i dhembshur i cili duke parashikuar vetminë dhe trishtimin e ndjekësve të Tij, ngarkoi engjëj, që të vinin dhe t'i ngushëllonin ata me sigurinë që Ai vetë do të vijë përsëri edhe pse shkoi në qiell. Ndërsa nxënësit qëndronin aty me sy të ngulur në lartësi që të mund të shquanin për herë të fundit Atë që e donin aq shumë, vëmendjen ua tërhoqën fjalët: "Ju galileas, - thanë ata, - përse rrini këtu e

shikoni lart? Ky Jezus, që u mor në qiell, do të kthehet pikërisht kështu, siç e patë duke u larguar prej jush" - Veprat 1;11. Mesazhi i engjëjve u ngjalli përsëri shpresën. Nxënësit "...u kthyen të gëzuar në Jeruzalem dhe vazhdimisht ishin në Tempull, duke lavdëruar Perëndinë." - Luka 24:52,53. Ata nuk u gëzuan, sepse Jezusi u largua prej tyre, duke i lënë që të luftonin me vështirësitë dhe tundimet e kësaj bote, ata u gëzuan nga siguria që u dha engjëlli se ai do të vinte sërish.

Shpallja e ardhjes së Krishtit, ashtu sikur engjëjt ua shpallën barinjve të Betlehemit, duhet të jetë edhe sot lajm i mirë gëzimi. Ata që me të vërtetë e duan Zotin e përshëndesin me gëzim thënien që bazohet në fjalën e Perëndisë se Ai, tek i cili janë përqëndruar shpresat e tyre për jetën e përjetshme, po vjen përsëri jo për t'u poshtëruar, përbuzur apo mohuar, siç ndodhi gjatë ardhjes së Tij të parë, por me pushtet dhe lavdi për të çliruar njerëzit që i përkasin.

1. Cilat ishin dy themelet e eksperiencës së besimit të William Millerit? A janë ato ende themelet dokrinale dhe frymore të Kishës Adventiste të ditës së Shtatë?

2. Milleri në mënyrë pasionante studio Biblën dhe zbuloi përmbushjet e jashtëzakonshme profetike të Danielit dhe Zbulesës. A i keni studiuar keto libra me zell të madh siç bëri edhe Miller? Rishikoni edhe njëherë aspektet kryesore të profecive paralele tek Danieli 2, 7, 8 dhe 9.

3. Fokusi i Millerit ishte në Ardhjen e Dytë të pashmangshme, fizike, të dukshme dhe personale të Jezusit. Përshkruani besimin tuaj personal, në këtë event kaq të rëndësishëm dhe pse besoni se ai do të ndodhë së shpejti.

4. Si mund ta drejtonte Perëndia Millerin nëse ky i fundit ishte gabim në lidhje me ngjarjen që parashikoi të ndodhte në 1844? A ka shembuj biblik të njerëzve të drejtuar nga Perëndia, të cilët keqkuptuan aspekte të caktuara të së vërtetës? Shihni Veprat e Apostujve 10.

19.

Drita Përmes Errësirës

Në çdo reformacion apo lëvizje të madhe fetare, nga shekulli në shekull, është vënë re se puna e Perëndisë në tokë ka paraqitur ngjashmëri mahnitëse. Parimet që Zoti përdor kur ka të bëjë me njerëzit janë të njëjta. Lëvizjet e rëndësishme të kohës sonë kanë elemente të ngjashme me ato të së shkuarës dhe eksperienca e kishës përmes shekujve na ofron mësime me vlerë të madhe.

Në Bibël ilustrohet shumë qartë e vërteta se Perëndia me anë të Shpirtit të Tij të Shenjtë i drejton shërbëtorët e Tij në tokë drejt lëvizjesh të mëdha për ta çuar përpara punën e shpëtimit. Njerëzit janë mjete në duart e Zotit që Ai i përdor për të realizuar qëllimet e Tij mëshirëplote. Secili ka pjesën e vet, gjithësecilit i është dhënë dritë sipas nevojave të kohës në të cilën jeton dhe aq sa t'i japë atij mundësi për të përmbushur detyrën që i është ngarkuar nga Zoti. Por askush sado i nderuar të ketë qënë nuk ka arritur ta kuptojë plotësisht planin e mrekullueshëm të shpëtimit, apo ta çmojë aq sa duhet qëllimin hyjnor të punës që i duhet të kryejë, për kohën në të cilën jeton. Njerëzit nuk e kuptojnë plotësisht se çfarë do të realizojë Perëndia me anë të punës që u ngarkon. Ata nuk e kuptojnë deri në hollësi mesazhin që japin ata vetë në emër të Tij.

"A mund t'i zbulosh thellësitë e Perëndisë? A e di madhështinë e të Gjithëfuqishmit?", "Mendimet e mia, - thotë Zoti, -nuk janë si të tuajat dhe udhët e mia ndryshojnë nga të tuat." ...Jam Perëndi dhe nuk ka asnjeri tjetër si unë. Që nga fillimi e parashikova përfundimin, prej kohësh parashikova se çdo të ndodhte." - Jobi 11:7; Isaja 55:8,9; 46:9,10.

Madje as profetët, të cilëve u ishte bërë një nder i madh me anë të ndriçimit të Shpirtit të Shenjtë, nuk e kuptuan plotësisht rëndësinë e zbulimeve që Perëndia u kishte bërë. Kuptimi do të zbulohej shekull pas shekulli, ndërsa njerëzve të Zotit do t'u duheshin udhëzimet që përmbante fjala e Tij. Pjetri, duke shkruar për shpëtimin që del në pah nëpërmjet ungjillit thotë: "Shpirti i Mesise tashmë vepronte në

profetët dhe i bëri të parashikonin vuajtjet që Mesia duhej t'i duronte dhe madhështinë që do t'i vinte pas. Kërkonin dhe shqyrtonin me zell që të mësonin kohën dhe mënyrën e realizimit të të gjitha këtyre. Por Perëndia i bëri të kuptonin se këto zbulime nuk i kishin marrë për veten e tyre, por për ju." - 1 Pjetrit 1:10-12.

Kështu kur profetët nuk i kuptonin plotësisht ato që u zbuloheshin, ata përpiqeshin me zell që të merrnin të gjithë dritën që vetë perëndia ua kishte shfaqur me gëzim. Ata "kërkonin dhe shqyrtonin me zell" "që të mësonin kohën dhe mënyrën e realizimit të të gjitha këtyre." Çfarë mësimi është ky për njerëzit e Zotit, për të mirën e të cilëve iu dhanë shërbëtorëve të Tij këto profeci? "Perëndia i bëri të kuptonin se këto zbulime nuk i kishin marrë për veten e tyre, por për ju." Shikoni këta njerëz të shenjtë të Perëndisë, ndërsa e kërkonin dhe shqyrtonin me zell" gjithçka që u ishte dhënë për brezat që nuk kishin lindur ende! Krahasoni zellin e tyre me moskokëçarjen me të cilën të zgjedhurit e mëvonshëm trajtuan këtë dhuratë të Qiellit. Çfarë qortimi është ky për indiferencën e njerëzve që u pëlqen rehatia dhe që tërhiqen nga dashuria për botën; e njerëzve që deklarojnë se profecitë janë të pakuptueshme!

Edhe pse mendjet njerëzore, duke pasur një cak, janë të papërshtatshme për të kuptuar këshillat e të Pafundmit apo për të marrë vesh realizimin e qëllimeve të Tij, shpesh kuptimi i mesazheve të Qiellit vjen falë gabimit apo neglizhimit nga ana e tyre. Jo rrallë mendjet e njerëzve e madje edhe të shërbëtorëve të Perëndisë janë verbuar kaq shumë nga opinionet, traditat dhe mësimet e rreme njerëzore, saqë ata nuk janë në gjendje që të kapin qoftë edhe pjesërisht, ato që ai ka zbuluar në fjalën e Vet. Kështu ndodhi edhe me nxënësit e Krishtit, madje edhe kur vetë Shpëtimtari ishte mes tyre. Në mendjet e tyre ishte ngulitur kaq shumë konceptimi popullor i Mesisë si një princi përkohshëm, i cili do ta ngrinte Izraelin drejt fronit të një perandorie universale, sa ata nuk mund t'i kuptonin fjalët me anë të të cilave, Ai u paratregoi për vuajtjet dhe vdekjen e Tij.

Vetë Krishti i kishte nisur drejt botës me mesazhin: "Erdhi koha e caktuar; u afrua mbretëria e Perëndisë - ndryshoni dhe besojini lajmit të mirë!" - Marku 1:15. Ky mesazh bazohej tek profecia e librit të Danielit, kapitulli 9. Engjëlli deklaroi se gjashtëdhjetë e nëntë periudhat prej shtatë vjetësh do të shtriheshin gjer në "ardhjen e Mesisë, Princit" dhe nxënësit po prisnin me shpresa të mëdha dhe gëzim vendosjen e mbretërisë së Mesisë në Jeruzalem, mbretëri që do të sundonte mbi botën mbarë.

Ata predikuan mbi mesazhin që u kishte dhënë Krishti pa e ditur se ata vetë e kishin keqkuptuar atë. Ndërsa thëniet e tyre bazoheshin tek kapitulli i 9-të i librit të Danielit, versa 25, ata nuk lexuan në versën tjetër të të njëjtit kapitull (9:26) se Mesia do të vritej pabesisht. Që nga lindja ata kishin pasur në zemër lavdinë e një perandori tokësor, dhe kjo bëri që të mos kuptonin as të dhënat e hollësishme të profecisë dhe as fjalët e Krishtit.

Duke paraqitur përpara kombit çifut ftesën mëshirëplotë ata përmbushën detyrën e tyre dhe pikërisht në kohën kur pritnin të shihnin Zotin e tyre të ulur në fronin e Davidit ata panë me sytë e tyre arrestimin e tij si keqbërës, fshikullimin, talljen, dënimin dhe së fundi kryqëzimin e Tij në Kalvar. Çfarë dëshpërimi dhe ankthi ndjenin në zemër ata gjatë ditëve që Zoti i tyre fjeti në varr!

Krishti kishte ardhur pikërisht në kohën dhe në mënyrën që parashikohej në profeci. Dëshmia e dhënë në Shkrimin e Shenjtë ishte përmbushur hollësisht gjatë jetës dhe misionit të Tij. Ai kishte predikuar mesazhin e shpëtimit dhe "fjala e Tij kishte fuqi." Dëgjuesit e ndjenin në zemër se ishte Qiellor. Fjala dhe Shpirti i Perëndisë vërtetuan detyrën e Birit të Tij.

Nxënësit ushqenin dashuri pakufi për Mësuesin e tyre të dashur. E përsëri dyshonin. Të mërzitur siç ishin, atyre nuk u ranë në mendje fjalët e Krishtit, që tregonin për vuajtjet dhe vdekjen e Tij. Sikur Jezusi i Nazaretit të kishte qënë Mesia i vërtetë a do të ishin zhytur vallë në një trishtim dhe zhgënjim të tillë? Kjo ishte pyetja që u rrinte çekan mbi kokë, ndërsa Shpëtimtari qëndronte shtrirë në varr gjatë orëve të Sabatit që ndanë vdekjen nga ringjallja e Tij.

Edhe pse nata e trishtimit ishte e errët pus për ndjekësit e Jezusit ata nuk harruan. Profetim tha; "ne ndodhemi në errësirë, por Zoti është drita jonë.... Ai do të na nxjerrë prej errësirës në dritë, do ta shohim se Ai do të na shpëtojë". "Për ty edhe errësira nuk është e errët edhe nata është po aq e ndritur sa dita." Perëndia foli dhe tha: "...drita ndrin për këdo që dëgjon Perëndinë..." "Do ta udhëheq popullin tim të verbër rrugëve nëpër të cilat nuk ka udhëtuar kurrë. Do ta shndërroj errësirën e tyre në dritë dhe do ta rrafshoj para tyre krahinën kodrinore. Këto janë premtimet e mia dhe unë do t'i mbaj patjetër." - Mikea 7:8,9; Psalmet 139:12; 112:4; Isaja 42:16

Lajmërimet që dhanë nxënësit në emër të Zotit ishin mëse të sakta në çdo aspekt dhe ngjarjet për të cilat flitej në to, po ndodhnin pikërisht në atë kohë. Mesazhi i tyre kishte qenë ky: "Erdhi koha e caktuar; u afrua mbretëria e Perëndisë..." Në mbarim të "kohës" - të gjashtëdhjetë e nëntë periudhave prej shtatë vjetësh që përmenden tek kapitulli 9-të i librit të Danielit, të cilat shtriheshin deri tek Mesia[1] apo: I shuguruari" - Krishti u shugurua me anë të Shpirtit pasi Gjoni e pagëzoi në lumin Jordan" Dhe nëpërmjet vdekjes së Krishtit u vendos edhe "mbretëria e Perëndisë" që ata deklaruan se ishte afër. Kjo mbretëri, ndryshe nga mësimet që ata kishin marrë, nuk ishte një perandori tokësore. Ajo nuk ishte as mbretëria e pavdekshme e të ardhmes që do të vendosej kur "Perëndia më i lartë do t'ia kalojë pushtetin mbi mbarë botën popullit të tij të shenjtë" ajo mbretëri në të cilën "të gjithë të fuqishmit do t'i shërbejnë dhe do t'i nënshtrohen Atij". -Danieli 7:27.

Shprehja "Mbretëri e Perëndisë" përdoret në Bibël për të përshkruar si mbretërinë e mëshirës ashtu edhe mbretërinë e lavdisë. Mbretëria emëshirës për-

[1] Mesi do të thotë "I shuguruar". Shugurim është një rit fetar i veçantë.

mendet në Letrën që Pali u drejton Hebrenjve. Pasi tregon Krishtin, ndërmjetësin e dhembshur "që u vu në provë në çdo drejtim", apostulli thotë: "Prandaj t'i afrohemi fronit mbi të cilin është ulur i Mëshirshmi (Perëndi). Kur të kemi nevojë për ndihmë, dashurinë dhe mëshirën e Tij do ta gjejmë gjithmone atje." - Hebrenjtë 4:15,16

Froni i të Mëshirshmit përfaqëson mbretërinë e mëshirës, sepse ekzistenca e një froni tregon ekzistencën e një mbretërie. Në shumë nga parabolat e Tij, Krishti përdor shprehjen "mbretëria e qiellit" për të treguar punën që mëshira hyjnore kryen në zemrat e njerëzve.

Kështu froni i lavdisë përfaqëson mbretërinë e lavdisë. Kësaj mbretërie i referohet Shpëtimtari kur thotë: "Kur të vijë Biri i njeriut me madhështinë e Tij dhe bashkë me të gjithë engjëjt, atëherë do të ulet mbi fronin e tij madhështor. Para Tij do të mblidhen njerëz nga të gjithë popujt..." - Mateu 25:31,32. Kjo është mbretëria e të ardhmes, që do të vendoset me ardhjen e dytë të Krishtit.

Mbretëria e mëshirës u themelua menjëherë pas dështimit të njerëzve, kur u skicua një plan shpëtimi për racën mëkatare. Gjatë asaj kohe ajo ekzistonte në qëllimin dhe premtimin e Perëndisë dhe njerëzit mund të bëheshin shtetas të saj nëpërmjet besimit të tyre. Në të vërtetë ajo u vendos praktikisht me vdekjen e Krishtit. Shpëtimtari edhe pasi iu fut misionit të Tij tokësor, i mërzitur dhe i raskapitur nga kokëfortësia dhe mosmirënjohja e njerëzve mund të kishte hequr dore nga flijimi në Kalvar.

Në Getsemani kupa e vuajtjeve i dridhej në dorë. Edhe atëherë Ai kishte mundësi ta flakte tutje këtë kupë vuajtjesh, duke mos derdhur gjakun e Tij dhe duke e lënë këtë racë mëkatare të zhdukej falë padrejtësisë së saj. Ai ta kishte bërë këtë, për njerëzimin e dështuar s'do të kishte shpëtim. Por kur Shpëtimtari dha jetën e Tij dhe thirri në frymën e fundit "Gjithçka u krye" "Ai përmbushi planin e shpëtimit. Premtimi për shpëtim që iu bë çiftit mëkatar në Eden, u mbajt.

Kështu vdekja e Krishtit - ngjarja të cilën nxënësit e kishin konsideruar si shkatërrimin përfundimtar të çdo shprese - ishte ngjarja që e bënte çdo shpresë të përjetshme. Ndërsa ishte një zhgënjim i madh për ta, në të vërtetë ajo përbënte pikën kulmore që provonte se besimi i tyre kishte qënë mëse i saktë. Ngjarja që u kishte sjellë aq dëshpërim dhe i kishte bërë të vajtonin, hapte dyert e shpresës për çdo fëmijë të Adamit dhe tek ajo përqëndroheshin jeta e përjetshme dhe lumturia e besnikëve të Perëndisë të të gjithë kohërave.

Qëllimet e mëshirës pa kufi u përmbushën pavarësisht nga zhgënjimi i nxënësve. Edhe pse fuqia dhe mëshira hyjnore e mësimeve të Atij që "fliste si askush tjetër" u fitoi zemrat, përsëri me dashurinë e pastër që ushqenin për Jezusin u bashkuan krenaria tokësore dhe ambiciet egoiste. Madja edhe në dhomën e Pashkës, pikërisht atëherë kur mësuesi i tyre ishte në prag të hijes së Getsemanit, "ndërmjet

nxënësve u hap një diskutim: kush do të ishte më i madhi prej tyre?" - Luka 22:24. Endërra e tyre përbëhej nga froni, kurora mbretërore dhe lavdia, ndërsa para syve kishin agoninë dhe turpin e kopshtit, gjyqin dhe kryqin e Kalvarit. Zemrat e tyre krenare dhe etja për lavdi tokësore i shtynë që të kapeshin aq fort pas mësimit të rremë të kohës në të cilën jetonin saqë të mos u vinin veshin fjalëve të Shpëtimtarit, që tregonin natyrën e vërtetë të mbretërisë së Tij dhe që paratregonin agoninë dhe vdekjen që e priste. Këto gabime ishin pjesë e provës - së vështirë, por të nevojshme - që do t'i bënte më të mirë. Megjithëse nxënësit e kishin keqkuptuar mesazhin dhe nuk arritën atë që prisnin, ata predikuan mbi paralajmërimin që u dha Perëndia, Ai do ta shpërblente besimin e tyre dhe do ta çmonte bindjen e tyre. Atyre iu besua puna për të përhapur në mbarë botën lajmin e lavdishëm të Zotit të ringjallur. Qëllimi i vetëm që atyre iu lejua të përjetonin një eksperiencë të tillë të hidhur ishte për t'i përgatitur për këtë detyrë.

Jezusi i ringjallur iu shfaq nxënësve të Tij në rrugën për në Emaus dhe "u tregoi ato që ishin shkruar për të, duke filluar që nga librat e Moisiut dhe duke vazhduar me librat e Profetëve e me gjithë Shkrimin". - Luka 24:27. Zemrat e nxënësve u trazuan. Besimi rilindi. Ata "shpresonin sërish" përpara shfaqjes së Jezusit. Qëllimi i Tij ishte që t'i ndriçonte mendjet e tyre drejt një kuptimi më të plotë dhe që ta bazonte besimin e tyre tek "fjala e sigurt e profecisë".

Ai dëshironte që e vërteta të lëshonte rrënjë të thella në mendjet e tyre jo vetëm falë dëshmisë së Tij personale, por edhe falë provës së padiskutueshme përfaqësuar nga simbolet dhe parabolat tipike të ligjit dhe profecive të Dhiatës së Vjetër. Duhej që ndjekësit e Krishtit të zotëronin një besim të arsyeshëm, jo vetëm për vetveten, por edhe që të kishin mundësi t'u tregonin të tjerëve për Krishtin. Dhe si hap të parë për fillimin e punës për përhapjen e këtij lajmi Jezusi i drejtoi nxënësit drejt "librave të Moisiut dhe librave të profetëve të tjerë". Kështu dëshmoi Shpëtimtari i ringjallur për vlerën dhe rëndësinë e shkrimeve të Dhiatës së vjetër.

Çfarë ndryshimi përjetuan në zemër nxënësit, ndërsa panë sërish Mësuesin e tyre të dashur! - Luka 24:32. Ata "kishin gjetur atë për të cilin kishin shkruar në ligj Moisiu dhe profetët" në një kuptim më të plotë dhe më të saktë se më parë. Pasiguria, ankthi, dëshpërimi ia lanë vendin sigurisë së plotë dhe besimit pa kufi. Çfarë mrekullie ishte që edhe pas largimit të Tij drejt qiellit "ata qëndronin vazhdimisht në Tempull, duke lavdëruar dhe duke bekuar Perëndinë". Njerëzit, që dëgjuan për vdekjen e turpshme të Shpëtimtarit, kërkuan që të shihnin të reflektuar në fytyrat e tyre trishtim, konfuzion dhe dëshpërim, por gjetën atje gëzim dhe triumf. Çfarë përgatitje u ishte bërë këtyre nxënësve për punën që i priste! Ata kishin kaluar përmes provës më të vështirë që mund të përjetonin dhe kishin kuptuar nga eksperienca e fituar, se kur sipas opinioneve njerëzore gjithçka kishte humbur, fjala e Perëndisë ishte përmbushur triumfuese. Çfarë mund ta lëkundte besimin e

tyre apo t'i priste udhën hovit të dashurisë së tyre tani e tutje? Ata kishin "siguri të dyfishtë" në dëshpërimin e madh dhe shpresë, që "është spirancë e fortë dhe e sigurt" - Hebrenjtë 6:18,19. Ata kishin qënë dëshmitarë të mençurisë dhe fuqisë së Perëndisë dhe ishin "plotësisht të bindur se asgjë nuk mund të na ndajë nga dashuria e tij; as vdekja e as jeta, as engjëjt e as fuqitë e tjera, as gjërat e tanishme as gjërat e ardhshme, as ndonjë gjë në qiell e as ndonjë gjë në ferr."

"Me anë të Jezusit,, Mesisë, Zotit tonë, - thonë ata, - Perëndia e shprehu dashurinë e vet për ne." "Në të gjitha këto ne triumfojmë me ndihmën e Tij që na ka dashur." - Rom. 8:38,39,37. "Fjala e Perëndisë vepron gjithmonë" - 1 Pjetrit 1:25. "Askush nuk mund t'i dënojë, sepse Jezusi, Mesia vdiq për ta. Jo vetëm kaq, por edhe u ringjall nga të vdekurit. Ai qëndron në vendin e plotfuqisë pranë Perëndisë dhe ndërmjetëson për dobinë tonë." - Rom. 8:34.

Zoti tha: "Kombet e tjera nuk do ta përqeshin më kurrë popullin tim" - Joeli 2:26. "Në mbrëmje mund të derdhim lot, por në mëngjes brohorasim me gëzim." - Psalmet 30:6. Kur këta nxënës e takuan Shpëtimtarin ditën që u ringjall dhe fjalët e Tij iu ngritën zemrat peshë, kur panë kokën, duart dhe këmbët që ishin mavijosur për ta, kur Jezusi përpara se të ngjitej në qiell i drejtoi në rrugën drejt Betanisë dhe duke i ngritur duart i bekoi dhe u tha: "Dilni në të gjithë botën dhe predikojuni lajmin e mirë të gjithë njerëzve!" duke shtuar: "Unë jam me ju gjithmonë deri në mbarimin e kësaj epoke." (Marku 16:15; Mateu 28:20), kur Ngushëlluesi i premtuar zbriti Ditën e Pentikostës dhe iu dha fuqi besimtarëve të ngazëllyer nga prania e Zotit të tyre - edhe pse rruga e nisur do të kalonte, ashtu si rruga e Tij, përmes sakrificash dhe vdekjesh, a do ta shkëmbenin ata vallë përhapjen e lajmit të mëshirës së Tij që do t'u dhuronte "kurorën e drejtësisë" me ardhjen e Tij, me lavdinë e një froni tokësor që kishte qënë shpresa e tyre e mëparshme? Ai që është "në gjendje të na japë shumë më tepër seç kërkojmë apo seç mendojmë" u kishte dhuruar pjesë në vuajtjet e Tij, në gëzimin që Ai dhuron -gëzimin "që u sjell lavdi shumë bijve, një gëzim që nuk shprehet dot "një lavdim të përjetshme", në krahasim me të cilën - thotë Pali -vuajtja jonë është një grimcë e vogël."

Përvoja e nxënësve që predikuan "lajmin e mirë të mbretërisë" në ardhjen e parë të Krishtit është e njëvlefshme me përvojën e atyre që shpallën mesazhin e ardhjes së Tij të dytë. Ashtu si nxënësit që predikonin "Erdhi koha e caktuar, u afrua mbretëria e Perëndisë...", ashtu edhe Milleri dhe shokët e tij shpallën lajmin së periudhës më të gjatë dhe të fundit profetike që gjendej në Bibël po i vinte fundi, se gjykimi ishte i afërt dhe se mbretëria e përjetshme do të vendosej shpejt. Predikimi i dishepujve në lidhje me kohën bazohej në shtatëdhjetë periudhat prej shtatë vjetësh që përmenden tek kapitulli 9-të i librit të Danielit. Mesazhi që shpallën Milleri dhe shokët e tij fliste për fundin e 2300 ditëve të kap. të 8-të të librit të Danielit, vargu 14, pjesë e të cilave ishin edhe shtatëdhjetë periudhat prej shtatë vjetësh. Predikimi

mbi secilën prej tyre bazohej në përmbushjen e pjesëve të ndryshme të të njëjtës periudhë të madhe profetike.

William Milleri dhe bashkëkohësit e tij, ashtu si nxënësit e parë, nuk arritën as vetë ta kuptonin plotësisht rëndësinë e mesazhit që mbartnin. Gabimet që kishin kohë që ruheshin në kishë u bënë pengesë që ata të arrinin një interpretim të saktë të një pike kaq të rëndësishme profetike. Kështu, megjithëse i shpallën botës mesazhin që Zoti ua besoi atyre, ata u zhgënjyen falë keqkuptimit që i bënë.

Duke shpjeguar Danielin 8:14 "Flijimi do të ndalohet 2300 herë... Vetëm atëherë do të rikthehet rregulli i Tempullit." Milleri siç dihet përkrahu pikëpamjen e njohur të kohës së tij, sipas së cilës, toka është tempulli dhe ai besonte se rikthimi i rregullit të Tempullit përfaqësonte pastrimin e tokës me anë të zjarrit në ardhjen e Zotit. Kështu kur kuptoi se përfundimi i 2300 ditëve ishte parashikuar përfundimisht, ai arriti në konkluzionin se kjo zbulonte kohën e ardhjes së dytë. Pranimi i pikëpamjes popullore mbi atë që përfaqësonte tempullin përbën gabimin e tij.

Sipas sistemit tipik, i cili errësonte sakrificën dhe rolin e Krishtit si prift, pastrimi i tempullit ishte shërbesa e fundit e priftit të lartë gjatë ciklit vjetor të shërbimit të tij fetar. Ishte puna përmbyllëse e shlyerjes së fajit - një zhvendosje apo flakje tutje e mëkateve të Izraelit. Ajo simbolizonte punën përmbyllëse gjatë shërbimit të priftit tonë të Lartë Qiellor, që rezultonte në zhvendosjen apo fshirjen e plotë të mëkateve të njerëzve të Tij që rregjistrohen në të dhënat qiellore. Ky shërbim përfshin veprimtarinë shqyrtuese dhe atë gjykuese; ai pason menjëherë ardhjen e Krishtit të lavdishëm e të pushtetshëm mbi retë e qiellit, sepse me ardhjen e Tij, vendoset fati i të gjithëve. Jezusi thotë: "...Do ta sjell me vete shpërblimin tuaj. Secili do ta marrë atë që u përgjigjet veprave të veta." - Zbulesa, vargu 7, shpall pikërisht veprimtarinë gjykuese që pason ardhjen e dytë: "Nderojeni Perëndinë dhe jepini Atij lavdi! Erdhi koha e gjyqit të Tij..."

Ata që shpallën këtë paralajmërim dhanë mesazhin e duhur në kohën e duhur. Por ashtu si dishepujt e parë, që ndërsa deklaronin, erdhi koha e duhur, u afrua mbretëria e Perëndisë, duke u bazuar tek kapitulli i nëntë i librit të Danielit nuk e vënë re parashikimin për vdekjen e Mesisë që përmendej në të njëjtin kapitull, ashtu edhe Milleri dhe shokët e tij predikuan mesazhin që bazohej tek kapitulli i 8-të i librit të Danielit vargu 14 i Zbulesës vargu i 7-të pa i kushtuar rëndësi mesazheve të tjera që dilnin në dritë në të njëjtin kapitull të Zbulesës vargu 7-të,pa i kushtuar rëndësi mesazheve të tjera, mesazhe që dilnin në dritë në të njëjtin kapitull të Zbulesës; mesazhe që duheshin shpallur përpara ardhjes së dytë të Zotit. Ashtu si dishepujt që gabuan kur menduan që Mbretëria do të vendosej në fund të shtatëdhjetë periudhave prej shtatë vjetësh, ashtu edhe Adventistët gabuan përsa i përket ngjarjes që do të ndodhte në përfundim të 2300 ditëve. Në të dy këto raste pranimi apo më mirë të themi, mbështetja e gabimeve popullore errësoi të vërtetën.

Në të dy këto grupe njerëzish përmbushën vullnetin e Perëndisë, duke përhapur mesazhin që Ai vetë ua kishte dhënë dhe të dy, u zhgënjyen nga keqkuptimi që ata vetë i bënë këtyre mesazheve.

Megjithatë Zoti përmbushi qëllimin e tij mirëdashës duke lejuar dhënien e paralajmërimit për gjykimin e afërt. Dita e madhe po afrohej, dhe falë kujdesit të Tij njerëzit u vunë në provë në kohën e caktuar në mënyrë që të zbulonin atë që kishin në zemër. Mesazhi synonte të provonte dhe të pastronte kishën. Njerëzve duhej t'u hapeshin sytë që të kuptonin nëse dashuria e tyre i përkiste botës apo Krishtit dhe qiellit. Ata thoshin se e donin Shpëtimtarin; kishte ardhur koha ta provonin këtë dashuri. A ishin ata të gatshëm që të hiqnin dorë nga shpresat dhe ambiciet që ushqenin dhe të mirëpritnin me gëzim ardhjen e Zotit. Mesazhi synonte që t'i bënte të aftë të shquanin gjendjen e tyre të vërtetë shpirtërore u dërgua me mëshirë që t'i ngrinte peshë zemrat e tyre, që t'i bënte ata që ta kërkonin Perëndinë me përulje dhe të penduar.

Edhe zhgënjimi, megjithëse ishte fryt i keqkuptimit që ata i bënë mesazhit që morën, do të hidhej poshtë përgjithmonë. Do të viheshin në provë zemrat e të gjithë atyre që e kishin dëgjuar këtë paralajmërim. Duke përjetuar një zhgënjim të tillë do të hiqnin ata dorë vallë nga eksperienca e krishterë dhe do t'i vinin kapak besimit tek fjala e Zotit apo do të përpiqeshin të kuptonin me anë të lutjes dhe përulësisë se kishin gabuar në interpretimin e të dhënave profetike? Sa prej tyre do të dorëzoheshin përpara frikës, impulsit apo ngacmimit? Sa do të ishin zemërthyer dhe të lëkundur në besim? Me mijëra njerëz deklaronin se e pritnin me padurim shfaqjen e Zotit. A do ta braktisnin besimin që ushqenin kur të ballafaqoheshin me talljet dhe qortimin e botës, me provën e vonesës dhe zhgënjimit? Duke mos e kuptuar menjëherë qëndrimin e Perëndisë ndaj tyre a do t'i flaknin tutje vallë, të vërtetat që dëshmoheshin qartë në fjalën e Tij?

Kjo provë do të tregonte forcën e të gjithë atyre që me besim, u ishin bindur asaj që ata besonin se ishte mësimi i fjalës dhe Shpirtit të Perëndisë. Ajo do t'u mësonte, ashtu siç mund të të mësojë vetëm një përjetim i tillë, rrezikun që sjell pranimi i teorive dhe interpretimeve njerëzore në vend që ta bësh Biblën interpretuese të vetvetes. Çoroditja dhe shqetësimi që rezultuan nga gabimi i tyre do t'u sillta fëmijëve besnikë, saktësinë që u duhej. Ata do të studionin më me vëmendje fjalën e profecisë. Do të mësonin ta shqyrtonin më me kujdes themelin e besimit të tyre dhe të mohonin gjithçka, sado e përhapur të ishte mes të krishterëve që nuk bazohej në Shkrimet e së vërtetës.

Për këta besimtarë, ashtu si për dishepujt e parë, ajo që dukej e pakuptueshme në orët e vështira të provës, më pas do të qartësohej. Me të parë "fundin e Zotit" ata do ta kuptonin se pavarësisht nga prova që erdhi si rrjedhim i gabimeve të tyre Ai u kishte falur dashuri pakufi. Ata do të mësonin nga një përvojë e tillë e bekuar se Ai

është "i dhemshur dhe i mëshirshëm" dhe se rrugët e Tij "janë mëshirëplotë dhe të drejta për të gjithë ata që respektojnë besëlidhjen e Tij dhe që dëshmojnë për Të".

1. Lexoni Danielin 9:25,26. Si i verbuan idetë e tyre të paramenduara ndaj mesazhit tek vargu 26 dishepujt, edhe pse duke shpallur përmbushjen e vargut 25?

2. Profetët "pyesnin dhe kërkonin me ngulm." Çfarë hapash të nevojiten të marrësh në mënyrë që të kërkosh me ngulmim dritën që Perëndia ka për ty?

3. Zhgënjimi i 1844 ishte një test besimi. Në eksperiencën tuaj, zakonisht, zhgënjimi jua forcon apo jua dobëson besimin?

20.

Një Zgjim i Madh Besimi

Profecia e mesazhit të engjëllit të parë, që përmëndet tek kapitulli 14[të] i Apoaklipsit, parashikon një zgjim të madh fetar për shkak të shpalljes së ardhjes së afërt të Krishtit. Shihet një engjëll që fluturon "lart në qiell. Kishte një mesazh që kkurrë nuk do ta humbasë vlerën e tij. Duhej t'ua shpallte atë të gjithë banorëve të tokës, dhe çdo kombi, çdo populli, si dhe njerëzve të të gjitha gjuhëve." "Ai bërtiti me zë të lartë; "Nderojeni Perëndinë dhe jepini Atij lavdi! Erdhi koha e gjyqit të Tij. Adhurojeni Krijuesin e qiellit dhe të tokës, të detit dhe të burimeve!" - Apokalipsi 14:6,7

Fakti që engjëlli është mbartësi i këtij paralajmërimi është kuptimplotë. Mënçuria hyjnore ka dashur të na paraqesë nëpërmjet pastërtisë, lavdisë dhe fuqisë së lajmëtarit qiellor, karakterin fisnik të punës që do të përmbushë ky mesazh, si dhe lavdinë dhe fuqinë që do të kishte. Dhe flututimi i engjëllit "lart në qiell" shqyrtimi i tij "me zë të lartë" dhe shpallja e këtij lajmi përpara të gjithë banorëve të tokës" - "Çdo kombi, çdo populli, si dhe njerëzve të të gjtitha gjuhëve" - provojeni shpejtësinë dhe përhapjen mbarëbotërore të kësaj lëvizjeje.

Vetë mesazhi hedh dritë mbi kohën e saj. Konsiderohet si pjesë "e mesazhit që kurrë s'do ta humbasi vlerën" dhe shpall ardhjen e kohës së gjykimit. Mesazhi i shpëtimit, është shpallur gjatë gjithë kohërave; por ky mesazh është pjesë e lajmit të mirë qëmund të shpallej vetëm në ditët e fundit, sepse vetëm atëhrë do të ishte e vërtë thënia se ora e gjykimit kishte ardhur. Profecitë përfaqsojnë një varg ngjarjesh që shkojnë drejt fillimit të kohës së gjykimit. Kjo është mëse e vërtetë, veçanërisht për birin e Davidit. Danieli u tha që ta shkruante dhe ta vuloste atë pjesë të profecisë që lidhej me ditët e fundit "që të hapet në kohën e fundit". Mesazhi që ka të bëjë me gjykimin, bazhar në përmbushjen e këtyre profecive, do të mund të shpallej vetëm atëherë kur të vinte kjo kohë. Profeti thotë se në kohën e fundit "shumë veta do të enden pa këshillë dhe pa ia ditur nga t'ia mbajnë, por në këtë libër do të gjejnë dituri dhe këshillë." - Danieli 12:4.

Apostulli Pal paralajmëron kishën që të mos e presë ardhjen e Krishtit gjatë kohës që ai vetë jetoi. Ai thotë: "Më parë duhet të vijë apostazia e madhe dhe të shfaqet Mesia i rremë ..." - Letra e Dytë e Selanukut 2:3. Ne mund ta presin ardhjen e Zotit vetëm pas apostazisë" "Njeriu i mëkatit" që njihet ndryshe edhe si "misteri i padrejtësisë" "biri i shkatërrimit" dhe "i ligu" përfaqëson papatin, i cili do kishte epërsi, ashtu siç thuhet edhe në profeci, për 1260 vjet. Kjo periudhë përfundoi në vitin 1788. Krishti nuk mund të vinte përpara atij viti. Pali kishte parasysh pikërisht këtë periudhë, deri në vitin 1788, kur u shkroi Selanikasve, Në këtë hohë duhej të shpallej edhe mesazhi i ardhjes së dytë të Krishtit.

Në të shkuarën nuk ishte dhënë kurrë një mesazh i tillë. Siç e vumë re, Pali nuk predikoi për të, Ai i drejtoi bashkëkohësit e Tij drejt ardhjes së Zotit në një të ardhme të largët për atë kohë. As Reformatorët nuk e përmëndën atë. Martin Luteri mendoi se gjykimi do të vinte pas treqind vjetësh nga koha në të cilënai jetoi. Por libri i Danielit është zbuluar ë nga viti 1798, profecitë kanë qënë burime më të plota dijesh dhe shumë njerëz kanë shpallur mesazhin solemn se gjykimi është afër.

Ashtu si Reformacioni i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, edhe lëvizja adventiste (e ardhjes) filloi njëkohësisht në vende të ndryshme kristiane. Në Evropë dhe në Amerikë, njerëz besnikë, duke u lutur i hynë studimit të profecisë dhe duke shqyrtuar dëshminë e frymëzuar, ata zbuluan prova bindëse se fundi i gjithshkaje ishte i afërt. Në vende të ndryshme, të krishterë që s'patën asnjë lidhje me njëri-tjetrin, vetëm me anë të studimit të Shkrimeve të Shenjta, arritën në bindjen se ardhja e Shpëtimtarit po afrohej.

Në vitin 1821, vetëm tre vjet pasi i kishte shqyrtyar imtësisht profecitë duke treguar kohën e gjykimit, Doktor Jozef Wolff "misionari i botës filloi të shpallte mesazhin e ardhjes së shpejtë të Zotit. Wolff - kishte prejardhje çifute, por kishte lindur në Gjermani. Babai i tij kishte qënë mësues çifut. Ai u bind për të vërtetën e besimit kristian që në moshë të re. Mendjemprehtë dhe kërkues, kishte qënë një dëgjues i vëmëndshëm i çifutëve të devotshëm që mblidheshin çdo ditë në shtëpinë e babait të tij për të folur rreth shpresave dhe parashkimeve të popullit të tyre, për lavdinë e Mesisë që do të vijëm për rindërtimin Izraelit. Një ditë, kur dëgjoi se u përmënd Jezusi i Nazaretit, djali pyeti se cili ishte Ai. "Një çifut nga më të talentuarit, - iu përgjigj - por duke qënë se pretendonte se ishte Mesia, gjykata çifute e dënoi me vdekje." "Pse është shkatërruar Jeruzalemi, - pyeti ai përsëri, - dhe pse jetojmë në skllavëri?" "Ah mor djalë, - iu përgjigj i ati, - sepse çifutët vranë profetët." Ndërsa atij i lindi menjëherë mendimi. "Ndoshtaedhe Jezusi ishte profet dhe çifutët e vranë edhe pse ishte i pafajshëm." - "Udhëtimet dhe aventurat e Rev. Jozef Wolff" vol 1, fq 6. Këto mendime ishin kaq shqetësuese sa ai megjithatë e kishte të ndaluar të shkonte në kishën e krishtere, shpesh ndalonte jashtë që të dëgjonte shërbesat fetare që mbaheshin atje."

Jozefi shtatë vjeçar, një ditë po i mburrej një fqinji të moshuar kristian për triummfin e ardhshëm të Izraelit kur të vinte Mesia, dhe ndërsa ai po fliste, burri plak e ndërpreu duke i thënë me dashamirësi: "O djalë, dua të të tregojj se kush ishte Mesia i vërtetë, ishte vetë Jezusi i Nazaretit ... të cilin paraardhësit e tu e kryqëzuan ashtu siç kishin vepruar me profetët e lashtësisë. Shko në shtëpi dhe lexo kapitullin pesëdhjetë e tre të librit të Jeshajës dhe do të bindesh se Jezus Krishti është biri i Perëndisë." - Ibid, vol 1, f 7. Ai dyshoi menjëherë. SHkoi në shtëpi dhe lexoi Shkrimin e Shenjtë, duke dashur të shikojë sesa plotësisht ishte përmbushur ai në figurën e Jezusit të Nazaretit. A tha vallë të vërtetën ai i krishteri? Ai i kërkoi babait që t'i shpjegonte profecinë por ndeshi në një heshtje kaq të nderë, sa s'guxoi më kurrë që ta hapte këtë temë. Sidoqoftë kjo, ai e shtoi edhe më shumë dëshirën për të mësuar për fenë kristiane.

Ajo që ai përpiqej të mësonte i fshihej qëllimisht nga familja e tij çifute; kështu që u largua nga shtëpia e babait pas njëmbëdhjetë vjetëve dhe u ballafaqua me botën, për t'u shkolluar dhe për të zgjedhur fenë dhe profesionin që pëlqente. Ai shkoi të jetonte për një farë kohe në shtëpinë e të afërmve, por ata e përzunë duke e quajtur femohues dhe aty, i vetëm dhe pa asnjë lek në xhep, iu desh të çante përpara mes të huajve. Shkoi nganjëri vend tek tjetri, duke studiuar me zell dhe duke jetuar me anë të mësimit të hebraishtes. Ai u ndikua ndjeshëm nga një mësues katolik dhe pranoi të ketë qëllim në zemër, ai shkoi për të vazhduar studimet në Kolegjin e Propagandës në Romë. Këtu ai u akuzua për herezi për shkak të mendimeve të tij të pavarura dhe shprehjes së hapur të këtyre mendimeve. Sulmoi haptazi akuzimet e kishës dhe shtroi me ngulm nevojën e një reforme. Megjithatë fillimisht autoritetet e papatit e trajtuan me dashamirësi pas një farë kohe, ai u transferua nga Roma. Shkoi nga njëri vend në tjetrin nën mbikëqyrjen e kishës, derisa u bë i qartë fakti se nuk do t'i nënshtrohej kurrë skllavërisë së Romës. Ai u konsiderua si i pakorrigjueshëm dhe u la i lirë që të shkonte ku t'i pëlqente. Në atë kohë ai u nuk drejt Anglisë dhe duke pranuar Protestianizmin, u bashkua me kishën angleze. Në vitin 1821, pas dy vjet studimi, ai hyri në misionin e tij.

Wolff-i, ndërsa pranonte të vërtetën e madhe që kishte të bënte me ardhjen e Krishtit "si njeri të vuajtjeve dhe që e njihte hidhërimin", ai vuri re që profecitë hidhnin dritë edhe mbi lavdinë dhe fuqinë e ardhjes së Tij të dytë. E ndërsa përpiqej që t'i drejtonta njerëzit tek Jezusi i Nazaretit, tek i Premtuari, dhe t'u tregonte për ardhjen e Tij të parë si flijim i përulur për mëkatet e njerëzve, ai përpiqej gjithashtu t'u tregonte atyre për ardhjen e Tij të dytë si mbret dhe çlirues.

"Jezusi i Nazaretit, Mesia i vërtetë, - ta ai, - këmbët dhe duart e të Cilit u shpuan nga gazhdët; Ai që erdhi si qengj për t'u therur, që ishte Njeriu i Vuajtjeve dhe që e njihte hidhërimin; Ai që u tradhëtua nga Juda; Ai që erdhi herën e parë, do të vijë mes reve të qiellit edhe herën e dytë i shoqëruar nga trumpeta e Kryeengjëllit." (Jozef Wolff, "Reseaches and Missionary faqe62) labours" dhe do të qëndrojë mbi

Malin e Ullinjve; dhe gjithçka që iu besua Adamit që nnga krijimi por që ai e humbi (Libri i Sanafillës 1:27, 3:17), do t'i jepet Jezusit. Ai do të mbretërojë mbi tokë. Do t'u vijë fundi rënkimeve dhe ankesave të të gjithë krijesave, dhe do të dëgjohen himne dhe fjalë lavdërrimi ... Kur Jezui të vijë i mbështjellë me lavdinë e Atit të Tij dhe me engjëjt e shenjtë, ... më parë do të ringjallen të gjithë ata që vdiqën (duke i besuar Zotit) - Letria e parë e drejtuar Selanikasve 4:16; Letra e parë e drejtuar Korintasve 13:32. Pikërisht këtë ne të krishterët e quajmë ringjallja e parë. Të gjithë kafshët e kësaj mbretërie do të ndryshojnë natyrën e tyre (Jeshaja 11:6-3) dhe do t'i nënshtrohen Jezusin. Do t'i nënshtrohen Jezusit. Do të mbizotërojë kudo në botë paqja" - "Jauwinal of Rev. Joseph Wolff", f 378, 373. "Zoti Perëndi do të hedhë përsëri shikimin mbi tokë dhe do të thotë; "Është shumë mirë" - Ibid, f 224.

Wolff-i i besonbte se ardhja e Zotit Jezus ishte shumë e afërt. Sipas premtimit të tij kjo ndodhte vetëm pas disa vjetësh nga koha e dhënë nga Milleri. Atyre që nisen nga thënia "për atë ditë dhe për atë orë askush nuk di gjë" dhe konkludonin së njerëzit nuk duhet të dinë asgjë për kohën e ardhjes, Wolff-i u përgjigj kështu; "S'ka gjë Perëndia jonë se ajo ditë dhe ajo orë nuk do të dihen kurrë. A nuk na dha Ai shenja të caktuara në kohra në mënyrë që të paktën ne të dimë afrimin e ardhjes së Tij, ashtu siç e dimë se vera është afër kur i çelin gjethet fikut? - Matey 24:32. A nuk duhet ta dimë kurrë afrimin e asaj periudhe ndërsa Ai vetë na bën thirrje që ajo jo vetën të lexojmë për të në librin e Danielit, por edhe të përpiqemi të kuptojm." Pikërisht në librin e Danielit thuhet se gjithçka do të vuloset deri nëkohën e fundit (spse ky nuk ishte problem i kohës së tij - Danielit)" se "shumë do të enden pa kështillë dhe pa ditur nga t'ia mbajnë (shprehja origjinale në hebraisht do të thotë; duke vëzhguar dhe menduar për tokën) dhe se "do të gjejmë në këtë libër kështillë dhe dituri" - Danieli 12:4. Përveç kësaj Zoti nuk ka për qëllim të nathotë se afrimi i kësaj kohe do të mbetet i panjohur, por që "ditën dhe kohën ekzakte nuk do ta dijë askush." Ai thotë se shjenjat e kohrave do të jenë të mjaftueshme për të ba shtyrë që të përjashtojmë për ardhjen e Tij, ashtu si Noa përgatiti varkën" - Wolff, "Reseaches and mossionary Labours" f 404, 405.

Wolff-i shkroi kështu përsa i përket sistemit popullor të interpretimit apo keq-interpretimit: "Pjesa më e madhe e kishës kristiane i është shmangur kuptimit të qartë të Shkrimit të Shenjtë dhe përkrahur sistemin iluminist të Budistëve, të cilët besojnë" Çifutë, duhet të kuptojnë "Të huaj" kur të lexojmë (Jeruzalem" duhet të kuptojmë "Kishë" në qoftë se thuhet "tokë" ka kuptimin "qiell" me ardhjen e Zotit ata kuptojnë progresin shoqërive misionare; dhe ngjijta drejt malit të shtëpisë së Perëndisë, nënkupton një mbledhje të madhe klasike të Metodistëve - Journal of the Rev. Joseph Wolff, f 96.

Nga viti 1821 deri në vitin 1845, për njëzet e katër vjet, Wolff-i udhëtoi kryesisht në Afrikë, ku vizitoi Egjyptin dhe Abisininë, bnë Azi ku përshkoi Palestinën, Sirinë, Persinë dhe Baharanë si dhe Indinë. Dhe ndërsa shkonte për të predikuar

në ishullin Shesi Helena, ai vizitoi Shtetet e Bashkuara. Arriti në Filadelfja dhe Baltimore dhe së fundi, vazhdoi udhëtimin e tij drejt Washingtonit. "Këtu, -thotë ai - sipas propozimit të ish-Presidentit JohnQuincy Adams, Kongresi unanimisht më dha tëdrejtën që të përdorj sallën e Kongresit për të mbajtur një nga leksionet e mia; leksionin të cilin e mbajta një të shtunë i nderuar nga prania e të gjithë anëtërve të kongresit, e peshkopit të Virrhinias, si dhe të klerikut dhe banorëve të Washingtonit. I njëjti nder m'u bë edhe nga anëtarët e qeverisë së New Jesey-it dhe, Penikanisë në prani të të cilëve, mbajta disa leksione mbi kërkimet e mia në Azi, si edhe mbi mbretërimin e vetë Jezus Krishtit." - Ibid, f 398, 399.

Doktor Wolff-i përshkoi pjesën më të madhe të vendeve barbare pa pasur mbrojtjen e autoriteteve europiane, duke u ndeshur më shumë vështirësi dhe i kërcënuar nga rreziqe të panumërta. Ai ishte i rraskapitur dhe i uritur; u shit si skllav dhe u dënua tre herë me vdekje. Grabitësit i vinin rrotull disa herë, ishte gati duke vdekur nga etja. Njëherë rrëmbyen gjithçka që ishte, dhe ai u detyrua të udhëtonte me qindra milje më këmbë në një terren malor ndërsa dëbora i rrihte fytyrën dhe këmbët e zhveshura iu mpinë nga kontakti me tokën e ngrirë.

Kur e paralajmëruan që të udhëtonte i paarmatosur përmes fiseve primitive dhe armiqësore ai deklaroi "se ishte i armatosur me lutjen, zellin për të kryer vullnetin e Perëndisë dhe besimin tek ndihma e Tij" Unë jam gjithashtu i armatosur, - tha ai, - me dashurinë për Zotin dhe të afërmin tim në zemër, dhe me Biblën në dorë." - W. N. D ADams, "en Peras oft ..., f 132. Kudo që shkonte ai merrte me vete Biblën në anglisht dhe hebraisht. Për një nga udhëtimet e tij të mëvonshme ai thotë; "E vetmja Bibël" të hapur në dorë. Ndjenja se merrja fuqi tek Biri dhe se kjo fuqi më inkurajonte të ecja përpra" - Po aty, f 201.

Kështu ai punoi me këmbëngulje derisa pjesa më e madhe e banuesvemes turqve, çifutëve, hinduve, parsisë[1], kombeve dhe raca të tjera dhe kudo, paralajmëroi afrimin w mbretërisë së Mesisë.

Ai zbuloi gjatë udhëtimeve në Barhaba se Arabët e Jemenit, një kombi i largët dhe i veçuar, besonin në dokrinën e ardhjes së shpejtë të Zotit. Ai thotë: "Ata kanë një libër me titull Seera, në të cilin gjenden të dhëna mbi ardhjen e dytë të Krishtit dhe mbretërimin e Tij të lavdishëm, dhe ata presin që në vitin 1840 të ndodhin ngjarje të mëdha." - "Jaurnal of the Rev. Joseph Wolff", f 377. "Unë ndenja gjashtë ditë me fëmijët e Rehab-it ... në Jemen. Ata nuk pinë verë, nuk merren e vreshtari, nuk mbjellin, jetojnë në tenda dhe kujtojnë Jonadabin babashan, djalin e Rehab-it. Bashkë me ta gjeta edhe izraelitë, që i përkisnin fisit të Danit, të cilët pritnin si dhe pasardhësit e Rehabit, ardhjen e shpejtë të Mesisë në retë e qiellit." - Po aty, f 383.

Një Misionar tjetër u ndesh me të njëjtin besim në Tatari. Një prift tatar e pyeti misionin se kur do të vinte Krishti pëë herë të dytë. Kur misioninari iu përgjigj se nuk dinte asgjë për këtë, prifti u çudit shumë nga padija e një personi që deklaronte

se ishte një mësues i Biblës, dhe theksoi besimin e tij të bazuar në profeci, se Krishti do të vinte rreth vitit 1844.

Mesazhi Adventis (I ardhjes) filloi filloi të predikohej në vitin 1826 më Angli. Këtu kjo lëvizje nuk mori një formë të plotë si në Amerikë; u shpallgjerësisht të vërteta e amdhërishme e ardhjes së shpejtë të Krishtit me pushtet dhe lavdi, por jo koha e saktë e kësaj ardhje. Dhe kjo nuk ndodhi vetëm mes jokonformistëve dhe sektarëve. Marin Brock një shkrimtar anglez, deklaron se rrethshtatëqind ministra të Kishës së Anglisë u përfshinë në punën për shpërndarjen "e lajmit të mirë të mbretërisë". Mrsazhi që tregonte vitin 1844 si kohë e ardhjes së Zotit u përhap edhe në Britaninë e Madhe. Qarkullonin gjithashtu edhe botime nga Shtetet e Bashkuara që kishin të bënin me ardhjen e Tij. Libra dhe gazeta u ribotuan në Angli. Dhe në vitin 1842, Robert Winter, mme origjinë angleze, rikthihet në vendlindje, pasi ishte njohur me besimin adventist në Amerikë mesazhi i gjykimit, u përhapnë vende të ndryshme të Anglisë.

Në Amerikën e Jugut, në mes të barbarizmit dhe politikës ambicioze dhe materiale të priftërinjve, Lakunza, një Jezuit spanjoll u dha pas studimit të Shkrimeve të Shenjta duke njohur këshut mesazhin e rikthimit të Krishtit. Duke dashur që t'i paralajmëronte të tjerët dhe njëkohësisht t'i shpëtonte çensurës së Romës ai botoi pikëpamjet e veta me pseudonimin "Rabi[2] Ben - Ezra", duke u prezantuar si një çifut i shndërruar shpirtërisht. Lazunra jetoi në shekullin e 18[-të], por libri i tij arriti Londrën në vitin 1825, ku edhe u përkthye ne anglisht. Botimi i tij i shërbeu thellimit të interesit tashmë të zgjuar në Angli rreth ardhjes së dytë.

Në Gjermani kjo doktrinë u përhap në shekullin e tetëmbëdhjetë nga Bengeli, ministër i Kishës Luteriane dhe një studiues dhe kritik i njohur i Biblës. Me të përfunduar studimet Rengeli "iu përkushtua studimeve teologjike, drejt të cilave ishte prirur, falë natyrës së tij serioze dhe fetare; natyrë që ishte thelluar nga disiplina e kershme. Si më parë ashtu edhe në atë kohë, atij i duhej të luftonte, si të gjithë të rinjtë e vëmendshëm, me dyshimet e vështirësitë e një natyre të tillë fetare dhe ai vetë,flet, i prekur thellësisht, për "shigjetat që i shponin zemrën dhe ia bënë vitet e rinisë të vështira dhe të padurueshme." Me t;u bërë anëtar i këshillit priftëror të Vytembergut, ai përkrahu idenë e lirisë së besimit. "Megjithëse mmbronte të drejtat e kishës, ai mbetej përkrahës i lirisë së arsyeshme që i duhej dhënë të gjithë atyre që e ndjenin veten të detyruar nga ndërgjegja e tyre, që të tërhiqeshin nga bashkësia kishtare." - Encyclopeadia Britanica, edicioni i 3[-të], art "Bengel". Rezultatet dobiprurëse të një politike të tillë ndjehen akoma në vindin e tij.

Mendja e Bengelit u ndriçua nga drita e ardhjes së dytë të Krishtit ndërsa përgatiste një shërbesë mbi kapitullin 21 të Apokalipsit për një të dielë. Profecitë e Apokalipsit u shpalosën përpara tij si kurrë më parë. I pushtuar nga ndjenja e rëndësisë së madhe dhë lavdisë së pashoqe të skenave që kishte paraqitur profeti,

ai u detyrua që ta hiqte mendjen për një farë kohe nga kjo temë. Por ndërsa fliste përpara kishës, ajo erdhi përsëri në mendje me të njëjtën forcë qartësi. Pikërisht atëherë, ai iu kushua studimit të profecive në përgjithësi dhe atyre të Apokalipsit në veçanti dhe shumë shpejt, u bind se ato e paraqitnin të afërt ardhjen e Krishtit. Sipas tij kjo ardhje do të ndodhë vetëm pas pak vjetësh nga koha e caktuar nga Milleri.

SHkrimet e Bengelit janë përhapur në të gjitha vendet dhe popujt e krishterë. Pikpamjet e tij u pranuan gjerësisht në provincën e tij, në Vyrtemberg, dhe deri diku, edhe në vendi të tjera të Gjermanisë. Kjo lëvizje vazhdoi edhe pas vdekjes së tij, dhe mesazhi adventist u dëgjua në gjermani në të njëjtën kohë, kur ai po tërhiqte vëmendjen edhe të vendeve të tjera. Në atë kohë, shumë besimtarë shkuan në Rusi dhe atje formuan kolonitë e tyre;besimi tek ardhja e shpejtë e Krishtit, është akoma i fortë në kishat gjermane të këtij vendi.

Y°Drita depërtoi gjithashtu në Francë dhe në Zvicër. Në Gjenevë, atje ku Fareli dhe Calvini kishin përhapur dikur të vërtetën e Reformimit, Gausseni predikoi mesazhin e ardhjes së dytë. Duke qënë akoma në bankat e shkollës si student, Gausseni ishte ndeshur me frymën racionalizimit që mbizotëronte në Europën e fundit të shekullit të tetëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kështu që kur filloi punë si misionar, ai jo vetëm që s'dinte se ç'do të thoshte besimi i vërtetë, por ishte i prirur drejt shpëtimit. Që në moshë të reishte interesuar në studimin e profecive. Pas leximit të "Historisë antikes të Rollin-it vëmendja e tij u përqëndrua tek kapitulli i dytë i librit të Danielit dhe ai u mahnit nga saktësia e përmbushjes së profecive duke u bazuar në të dhënat historike. Ja ku ishte një dëshmi pro frymëzimit të Shkrimeve të Shenjta, që i shërbeu atij si spirancë në mes fortunave të rrezikshme të viteve të mëvonshme. Ai s'mund të gjente qetësi në mësimet e racionalizimit, por falë studimit të Biblës dhe kërkimit të vazhdueshëm të një drite sam më të plotë, pas një farë kohe ai njohu besimin e vërtetë.

Ndërsa këmbëngulja në studimin e profecive arriti në konkluzionin se ardhja e Zotit ishte afër. I frymëzuar nga solemniteti dhe rëndësia e kësaj të vërtete të madhe, ai dëshironte t'ua shpaloste atë të tjerëve; por pengonte seriozisht bindja populore se profecitë e Danielit janë mistere dhe s'mund të kuptohen. Më së fundi ai vendosi - ashtu siç kishte bërë edhe Fareli gjatë punës së tij evangjeliste në Gjenevë - të fillonte me fëmijët, duke shpresuar që nëpërmjet tyre, do të ngjallteinteresin e prindërve.

"Dua që kjo të jetë e qartë. - tha ai më pas, duke folur WYpër qëllimin e detyrës që ndërmori. - Dëshiroja që ta filloja punën në një formë të tillë familjare sepse janë të rëndësishëm. Unë doja që të më dëgjonin dhe kisha frikë se nuk do ta arrija këtë duke iu drejtuar fillimisht të rriturve." "Prandaj vendosa që të shkoja tek më të rinjtë. Mblodha një grup fëmijësh; në qoftë se grupi zgjerohet, në qoftë se vë re se

ata dëgjojnë, janë të kënaqur dhe të interesuar, se kuptojnë dhe janë në gjendje ta shpjegojnë këtë subjekt atëherë jam i sigurtë se do të kem një grup të dytë, shumë shpejt, dhe të rriturit nga ana e tyre do ta kuptojnë që ia vlen të ulen e të studiojnë pë një farë kohe. Kur të ndodhi kjo, qëllimi është realizuar." - L. Gaussen "Daniel, të Prophet" (Danieli, profeti); Vol 2, parathënia.

Përgjigja u kurorëzua me sukses. Duke iu adresuar fëmijëve ai tërhoqi vëmendjen e më të rriturve. Dëgjues të vëmëndshëm mbushën kishën ku ai predikonte. Mes tyre gjeje njerëz të ditur dhe me pozitë apo të huaj që vizitonin Gjenevën; dhe kështu mesazhit iu hap rruga drejt vendeve të tjera.

I inkurajuar nga një sukses i tillë, Gausi botoi mësimet e tij duke shprehur që t'i8 jepte shtytje kështu, studimit të librave profetikënë kishat e gjenovezëvew që flisnin grengjisht. "Botimi i mësimit që u jepen fëmijëve, - thotë Gausseni, - është njësoj si t'u thuash të rritur, të cilët refuzojnë t'i lexojnë këto libra nën pretekstin se ato janë të paqartë: "Si mund të jenë këto libra të paqartë kur fëmijët tuaj i kuptojnë ato?" "Dëshiroja me gjithë shpirt po të ishte e mundur, - shënon ai, - që profecitë të bëheshin popullore." "Mua më duket se s'ka asnjë studim tjetër që mund t'i përgjigjet më mirë nevojave të kohës." "Nëpërmjet tij, ne do të përgatitemi për fatkeqësitë e kohës së fundit që është afër, të vëzhgojmë dhe të presim Jezu Krishtin."

HYGaussenit pas një farë kohe, iu ndalua predikimi, edhe pse ishte një nga predikuesit më të shquar dhe më të dashur të gjuhës frenge, me akuzën se i kishte udhëzuar të rinjtë duke u bazuar tek Bibla, në vënd që të bazohej tek manuali i kishës, një produkt ky i zbuluar nga racionalistët dhe pothuajse i shkëputur kryesisht nga besimi i vërtetë. Më pas, ai filloi punë si mësues në një shkollë teologjike, ndërsa të Dielave vazhdonte punën e nisur duke iu adresyar fëmijëve dhe duke i drejtuar ata drejt Shkrimeve të Shenjta. Punimet e tij mbi profecitë ngjallën gjithashtu një interes të madh. Nga katedra e profesioneve, nëpërmjet shtypit dhe falë pozitës së tij të preferuar si mësues i fëmijëve, ai vazhdoi për vite me rradhë të ushtronte një ndikim të ndjeshëm, dhe të ishte një instrument për të tërhequr vëmendjen e shumë njerëzve drejt studimit të profecive, të cilat tregonin se ardhja e Zotit ishte e afërt.

Mesazhi adventist u shpall edhe në vendet skandinave ku zgjoi një interes të gjerë. Shumë veta u shkundën nga siguria e tyre e pakujdesshme për të rrëfyer dhe hequr dorë nga mëkatet në emër të Krishtit. Por kleri i kishës dominuese e kundërshtoi këtë lëvizje dhe disa nga ata që predikuan këtë mesazh u burgosën. Në ato vende ku predikuesve të mesazhit të ardhjes së shpejtë të Zotit u mbyllej goja, Perëndia e dërgonte këtë mesazh në një mënyrë të mrekullueshme; përmes fëmijëve të vegjël. Dhe meqë ata s'e kishin mbushur ende moshën, ligji nuk mund t'i pengonte dhe kështu ishin të lirë të lisnin të qetë.

Lëvizja u përkrah kryesisht nga klasat e ulta të shoqërisë dhe pikërisht, banesat modeste të punëtorëve ishin vendtakimet enjerëzve që dëshironin të dëgjonin këtë

üYparalajmërim. Vetë fëmioredikuesit ishin në më të shumtën e rasteve fshatarë të varfër. Disa prej tyre ishin jo më shumë se gjashtë apo tetëvjeçarë; dhe zakonisht ata manifestonin inteligjencën dhe aftësinë që vihet re në fëmijët e asaj moshe edhe pse mënyra se si jetonin, dëshmonte se ata e donin Zotin dhe përpiqeshin që t'i respektonin urdhëresat e shenjta të Perëndisë. Sidoqoftë, kur qëndronin përpara njerëve dukej qartë se ata nxiteshin nga nga një forcë më e madhe se dhuntitë e tyre natyrore. Mënyra e të folurit dhe tani i zërit ndryshonin dhe ata paralajmëronin të tjerët për ditën e gjykimit me një fuqi solemne, duke përdorur fjalët e vetë Shkrimit të Shenjtë. "Nderojeni Peëndinë dhe jepini Atij lavdi! Erdhi koha e gjyqit të Tij." Ata qortuan njerëzit për mëkatet e tyre, duke dënuar jo vetëm imoralitetin dhe vesin, por edhe sjelljen e keqe materializmin dhe duke paralajmëruar dëgjuesit e tyre që të nxitonin për t'i shpëtuar valës së zemërimit që po afrohej.

Njerëzit dëgjonin të frikësuar. Shpirti i Perëndisë u foli zemrave të tyre me aftësi bindëse. Shumë prej tyre filluan t'i lexonin Shkrimet e Shenjta me një interesim të ri dhe më të madh, u transfomuan si moskokçarësit ashtu edhe imoralët, të tjerët hoqën dorë nga praktikat e pandershme të jetës dhe ky shndërrim ishte aq i dukshëm, sa edhe ministrat e kishës dominuese u detyruan të pranonin se në këtë lëvizje ndihej dora e Perëndisë.

Ishte vullneti i Zotit ë vendet skandinave ta dëgjonin lajmin e ardhjes së Shpëtimtarit; dhe kur zërat e shërbëtorëve të Tij s'u dëgjuan më, në mënyrë që të arrihej ky qëllim, Au e dërgoi Shpirtin e Tij të Shenjtë tek fëmijët. Kur Jezusi iu afrua Jeruzalemit i shoqëruar nga një turmë gjithnjë e në rritjenjerëzish, të cilët me thirrje triumfi dhe valëvitje degësh palmash lajmëronin JYardhjen e Tij si Biri i Davidit, Farisenjtë xhelozë i bënë thirrje Atij që t'i jepte fund këtij entuziazmi, por Jezusi iu përgjigj se gjithshka që po ndodhte bëhej për të përmbushur profecinë, dhe se, sikur ata të heshtnin, vetë gurët do të thërrisnin me të madhe. Njerëzit, të trembur nga kërcënimet e priftërinjve dhe sundimtarëve, i dhanë fund thirrjeve të tyre të gëzueshme ndërsa po hynin në portat e Jeruzalemit, por ishin fëmijet ata, që në oborret e tempullit më pas, ia rifilluan këtij refreni duke tundur degët e tyre të palmave dhe thirrën: "Hoshq-na, o Biri i Davidit!" - Mateu 21:8-16. Jezusi iu përgjigj "Sigurisht! A nuk e keni lexuar në Shkrimin e Shenjtë: Ti bën që të lavdërojnë foshnjet dhe të miturit." Ashtu si punoi Zoti përmes fëmijëve gjatë kohës së ardhjes së parë të Krishtit në tokë, në të njëjtën mënyrë Ai punoi përmes tyre, për të përhapur mesazhin e ardhjes së Tij të dytë. Fjala e Perëndisë duhet të përmbushet plotësisht, mesazhi i ardhjes së Shpëtimtarit duhet t'u jepet të gjithë paralajmërimin në Amerikë. Ky vend u bë pikëqëndra e lëvizjes së madhe adventiste. Këtu u përmbush në mënyrë të drejtpërdrejtë mmesazhi i engjëllit të parë. Shkrimtarë të Millerit dje bashkëkohësve të tij iu hap rruga drejt vendeve të largëta. Me depërtimin e misionerëve në vende të ndryshme të botës, depërtoi edhe lajmi i mirë i ardhjes së

shpejtë të Krishtit. Afër e larg u përhap mesazhi i ungjillit: "Nderojeni Perëndinë dhe jepini Atij lavdi! Erdhi koha e gjyqit të Tij."

Mendjet e njerëzve u përqëndruan tek dëshmitë e profecive që krijonin përshtypjen se ardhja e Krishtit do të ndodhte në pranverë të vitit 1844. Mesazhi, duke kaluar nga vendi në vend,zgjoi kudo një interesim të madh. Shumë njerëz ishin të bindur se argumentet e nxjerra nga perjudhat profetike ishin të sakta, dhe duke flijuar krenarinë e opinioneve të tyre, e pranuan të vërtetën me gëzim. Disa ÛYministra i lanë mënjanë pikpamjet dhe ndjenjat e tyre sekulare, hoqën dorë nga pagat dhe u larguan nga kishat duke u bashkuar oër të shpallur ardhjen e Jezusit. Sidoqoftë, numri i ministrave që e pranuan këtë mesazh ishte i vogël, prandaj ai përgjithsisht iu bazua vullnetarëve të përulur. Fermerët lanë pas fushat, mekanikët veglat, tregtarët mallrat, profesionistët pozitat, e përsëri numri i punëtorëve ishte i vogël në krahasim me punën që duhej të kryhej. Një gjendje e tillë, me një kishë të padenjë dhe një botë që ishte zhytur në ligësi, ishte barrë e rëndë për shpirtrat vëzhguesve të vërtetë dhe këta duruan me vullnet punën e rëndë, mungesat dhe vuajtjet me qëllimin e vetëm që t'u bënin thirrje njerëzve që të pendoheshin dhe t'u flisnin atyre për shpëtimin. Puna eci përpara ritmikisht pavarësisht nga kundërshtimi i Satanit dhe me mijëra veta e pranuan të vërtetën adventiste.

U dëgjua kudo dëshmia ngulmuese që i paralajmëronte të gjithë mëkatarët si anëtarët e kishës, ashtu edhe të tjerët, që t'i shpëtonin valës së zemërimit që po afrohej. Si Gjon Pagëzori, paralajmëruesi i Mesisë, predikuesit e ngulën sëpatën në rrënjët e pemës duke i këshilluar të gjithë të jepnin fryte pendese. Thirrjet e tyre tronditëse ndryshonin tërësisht nga mesazhet e paqës dhe sigurisë që dëgjonin nga podiumet kishëtare, dhe njerëzit gjallëroheshhin sa herë që i dëgjonin këto thirrje. Dëshmia e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë e Shkrimeve të Shenjta që u bë e njohur falë fuqisë së Shpirtit të Shenjtë, mbarste argumente kaq bindëse vetëm një numër i vogël njerëzish mund t'irefuzonte. Njerëzit e ditur të fesë u zgjuan nga ajo siguria e tyre e rreme. Atyre iu hapën sytë përpara materializmit, mosbesimit, krenarisë, egoizmit dhe padrejtësisë së tyre. Shumë prej tyre iu drejtuan Zotit të penduar dhe me përulje. Të gjithë dashurinë që deri atë kohë ua kishin kushtuar gjërave tokësore, tani ia kushtuan Perëndisë. Shpirti i Perëndisë ÜYvepronte brënda tyre dhe me zemra të lehtësuara dhe të gëzuara, ata bashkuan zërat në thirrjen: "Nderojeni Perëndinë dhe jepini Atij lavdi! Erdhi koha e gjyqit të Tij.

Mëkatarët pyesin duke qarë: "Çfarë duhet të bëj që të fitoj jetën e përjetshme?" Ata që kishin jetuar në mënyrë të pandershme ishin të gatshëm qe të ndryshonin. Të gjithë ata që gjetën tek Krishti paqen shpirtërore mezi prisnin që t'u tregonin të tjerëve për këtë bekim. Prindrit ndjeheshin të lidhur me fëmijët e tyre dhe fëmijët ndheheshin të lidhur me prindërit e tyre. Pengesat që kishin krijuar krenaria dhe rezervimi u kishte ardhur fundi. Përfitimet dilnin nga zemra dhe anëtarët e familjes

punonin së bashku për shpëtimin e njerëzve më të afërt e më të dashur. Shpesh dëgjoheshin ndërmjetësime të tilla. Kudo kishte njerëz që në ankth të madh i luteshin Zotit. Shumë prej tyre s'vinin gjumë në sy gjithë natën duke u lutur dhe që të afërmit dhe fqinjët tyre të përjetonin një shndërrim shpirtëror.

Njerëz nga të gjitha klasat e shoqërisë mernin pjesë në takimet e Adventistëve. Për arsye të ndryshme të pasurit dhe të varfrit, të pushtetshmit dhe të zakonshmit mezi prisnin që ta dëgjonin me veshët e tyre dokrinën e ardhjes së dytë. Perëndia i kontrolloi forcat kundërshtare ndërsa shërbëtorët e Tij shpjegonin arsyet e besimit të tyre. Ngandonjëherë, instrumenti që përdorej ishte i dobët; por ishte Shpirti i Perëndisë që e fuqizonte të vërtetëne Tij. Në këto grumbullime ndjehej prania e engjëjve të shenjtë dhe çdo ditë numurit të besimtarëve i shtoheshin shumë të tjerë. Ndërsa përsëriteshin provat e ardhjes së shpejtë të Krishtit, turma të mëdha njerëzish dëgjonin në qetësi të plotë njëri-tjetrit. Fuqia e Zotit ndjehej nga të rinjtë, të moshuarit dhe të gjithë të tjerët. Njerëzit ktheheshin në shtëpitë e tyre me këngë lavdërimi në gojë dhe tingÒYujt e gëzueshëm prishnin qetësinë e natës. Ata që morën pjesë në ato takime s'mund t'i harrojnë kurrë ato skena emocionuese dhe prekëse.

Dhënia e kohës së ardhjes së Krishtit ngjalli një kundërshtim të hapur nga shumë njerëz të klasave të ndryshme, që nga ministri që fliste nga podiumi kishtar, e deri tek mëkatari më i shturur dhe kokëkrisur. Fjalët e profecisë u përmëndën: "Ata do t'ju përpqeshin e do të thonë: "A mos premtoi të kthehet? E ku është ai? Që parët tanë kanë vdekur ndërkohë, por gjithshka mbetet si në krijimin e botës" - Letra e dytë e Pjetrit 3:3, 4. Kundërshtuan dokrinën e ardhjes së dytë; ata e hodhën kundër kohës së caktuar për këtë ardhje. Por syri depërtues i Zotit lexoi zemrat e tyre. Ata nuk donin të dëgjonin për një Krisht që vinte ta gjykonte drejtësisht botën. Ata nuk kishin qënë shërbëtorë besnikë, veprat e tyre nuk ishin të denja për t'i qëndruar inspektimit të Perëndisë që është në gjendje të depërtojë në zemër, dhe ata trembeshin takimit me Zotin e tyre. Ashtu si çifut gjatë kohës së ardhjes së parë të Krishtit, ata nuk ishin përgatitur për t'i uruar mirëseardhjen Jezusit. Ata jo vetëm që refuzuan që t'u vinin veshin argumenteve të qarta të Biblës, por edhe u tallën me ata që po prisnin Zotin. Satani dhe engjëjt e Tij u gëzuan dhe u tallën me Jezusin dhe ngjëjt e shenjtë duke thënë se edhe njerëzit e Tij "të shpallur" nuk e donin fare dhe nuk dëshironinqë Ai të shfaqej pësëri.

"Askush nuk e di ditën ose orën ..."; ky është argumenti që perdorej shpesh nga mohuesit e besimit adventist. Në Shkrimin e Shenjtë shkruhet; "Por askush nuk e di ditën ose orën kur do të ndodhë kjo - askush, as engjëjt në qiell, as Biri, vetëm Ati e di." - Mateu 24:36. Ata që po e pritnin me padurim Zotin dhanë një shpjegim të qartë dhe harmonik të këtij Teksti dhe kështu u duk qartë MYkeqpërdorimi i tij nga kundërshtarët e tyre. Vetë Krishti i tha këto fjalë gjatë asaj bisede të paharrueshme me nxënësit e Tij në malin e Ullinjve, pasi u largua nga tempulli për të fundit

herë. Nxënësit i kishin bërë pyetjen: "... Cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të kësaj epoke?" Jezusi u tregoi atyre shenjat dhe tha: "Kur të shihni se po afrohen të gjitha këto; atëherë dijeni se ju pret menjëherë fundi."- versat 3, 33. Nje thenie e Shpëtimtarit s'mudntë kundërshtojë tjetrën. Megjithëse askush nuk e di as ditën dhe as orën e ardhjes së Tij. Ne na janë dhënë udhëzime dhe na kërkohet që ta dimë kur kjo ardhje është afër. Më pas na është bërë e ditur se të mospërfillësh paralajmërimin e Tij, të refuzosh të njohësh apo të mohosh afërsinë e ardhjes së Tij do të jetë aq fatale për ne, sa ç'ishte për bashkëkohësit e Noas që nuk e dinin se kur do të ndodhte përmbutja. Parabola e të njëjtit kapitull, duke krahasuar shërbëtorin besnik me atë jobesnik dhe duke paraqitur fatin e atij që me vete mendonte "Zoti im do të vonohet", tregon se si do t'i konsiderojë dhe shpërblejë Krishti ata që do t'i gjejë duke e pritur dhe duke i treguar të tjerëve pë ardhjen e Tij dhe ata që e mohojnë një gjë të tillë. "Lum ai shërbëtor, - thotë Ai, - kur të kthehet i Zoti, e gjen në punë." - versat 42, 46. "Në qoftë se nuk zgjohesh do të thotë të zë në befasi si vjedhës: nukdo të dish në ç'orë do të vij kundër teje." - Apokalipsi 3:3.

Pali flet për një grup njerëzish që ardhja e Zotit do t'i gjejë të përgatitur. "Zoti do të vijë në mënyrë të parashikuar, pikërisht njëlloj siç vjen vjedhësi natën. Kur njerëzit thonë: "Gjithshka është e qetë dhe e sigurtë" papritmas do të bjerë rrënimi ... askush nuk do t'i shpëtojë." Por për ata që i kanë kushtuar vëmëndje që të mos ju zënë në befasi. Dita e Zotit ... Përkundrazi, ju të gjithë jeni njerëz që i takoni dritës dhe ditës ... nuk NYjetojmë më në natë ose në terr ..." - Letra e parë e Selanikasve 5:2-5.

Kështu duket qartë se Shkrimi i Shenjtë nuk justifikon injorancën e njerëzve në lidhje me afërsinë e ardhjes së Krishtit. Por ata që kërkonin vetëm një pretekst për ta mohuar të vërtetën i mbyllën veshët përpara këtij shpjegimi dhe fjalët, "Askush nuk e di as ditën dhe as orën ..." përsëriteshin nga tallësit kokëfortë, e madje edhe nga ministrat e Krishtit. Ndërsa në skenë dolën mësuesit fetarë duke e shtrembëruar të vërtetën dhe duke u përpjekur që ta zbusnin frikën e tyre përmes një interepretimi të gabuar të fjalës së Zotit. Vëzhgues jobesnikë u bashkuan me mashtruesin e madh duke thirrur: "Paqe, paqe" Kur Perëndia nuk kishte shpallur paqe. Ashtu si Farisenjtë në kohën e Mesisë, shumë njerëz nuk pranuan ti hynin asaj rruge. Atyre do t'u kërkohet llogari për jetët e këtyre njerëzve.

Zakonisht ishin njerëz më të thjeshtë e më të devotshëm që e pranuan të parët këtë mesazh. Ata që e studioni Biblën vetë vunë re se karakteri i pikëpamjeve populore mbi profecinë nuk bazohej në Shkrimet e Shenjta; dhe atje ku njerëzit ishin të lirë nga ndikimi i klerit, atje ku ata i drejtoheshin vetë fjalës së zotit, dokrina adventiste e krahasuar me Shrkimet e Shenjtavendoste lehtësisht autoritetin e saj hyjnor.

Shumë veta u persekutuan nga vllezërit e tyre që s'besoni. Në mënyrë që të ruanin pozitën që kishin në kishë, disa pranuan që të mos bënin zë për shpresën që ushqenin; por të tjerë ndjenin se besnikëria ndaj Zotit nuk i lejonte që t'i fshihnin

të vërtetat që Ai ua kishte besuar. Një numër jo i vogël njerëzish u shkishëruan për të vetmen arsye se besonin në ardhjen e Krishtit. Për ata që po ndjenin mbi ÔYsupe peshën e provës së besimit të tyre fjalët e profetit morën një kuptim të ri: "Meqë jeni besnikë ndaj meje, - thotë Zoti, - disa prej popullit tuaj urrejnë dhe nuk duan t'ia dinë për ju. Ata ju përqeshion duke thënë: "Le ta tregojë Zoti madhështinë e tij dhe t'ju shpëtojë, që të mund të shohim se si gëzoheni." Por ata do të turpërohen." - Jeshaja 66:5.

Engjëjt e Zotit po e vëzhgonin me interes të madh rezultatin e paralajmërimit. Më të vënë re se kishat përgjithësisht e mohuan këtë mesazh, engjejt u larguan të trishtuar. Por kishte akoma shumë njerëz që s'kishin akoma në provë përsa i përkiste të vërtetës adventiste. Ata ishin gënjyer nga burrat, gratë, prindrit apo fëmijët, dhe i kishin detyruar ta konsideronin si mëkat, edhe dëgjimin e herezive që përhapnin Adventistët. Engjëjve iu ngarkua detyra që t'i vëzhgonin vazhdimisht këta shpirtra njerëzorë sepse mbi ta nga fromi do të ndriçonte një dritë e re.

Ata që e kishin pranuar mesazhi, prisnin me një dëshirë të papërsëritshme ardhjen e Shpëtimtarit të tyre. Koha kur ata pritnin ta takonin Atë ishta afër. Ata i afroheshin asaj me një solemnitet të admirueshëm. Jetonin në një marrëdhënie të qëndrueshme me Perëndinë, në pritje të paqes që do të vinte për ta pas pak. Askush nga ata që përjetuan këtë shpresë dhe këtëbesim nuk mund t'i herrojë ato orë të çmuara pritjeje. Disa javë përpara kohës së caktuar[3]dukej sikur çdo veprimtari që trillohej nuk ngjallte më interesin e mëparshëm. Besimtarët e sinqertë kontrollonin me kujdes çdo mendim dhe çdo emocion të zemrave të tyre sikur të ishin në shtratin e vdekjes, disa orë para se të mbyllnin sytë përpara skenave tokësore. Nuk pati përgatitje "rrobash për largim"; por të gjithë ndjenin nevojën e një prove të brendshme që të tregonte se 5Yata, ishin gati për ta takuar Shpëtimtarin, rrobat e tyre të bardha përfaqësonin pastërtinë shpirtërore - karaktere të pastruara nga mëkati nëpërmjet gjakut pajtues të Krishtit. Por kjo, do të ndodhte sikur njerëzit e Zotit të zotëronin të njëjtën frymë transformuese, të njëjtin besim të frytshëm dhe të qëndrueshëm. Kështu, sikur të kishin vazhduar të qëndronin të përulur përpara Perëndisë dhe të kërkonin sinqerisht mëshirën e Tij, ata do të përjetonin një eksperiencë shumë më të pasur se aho që kanë tani. Me fjalë të tjera ata luteshin shumë pak, ishin pak të ndërgjegjshëm për mëkatet e tyre dhe mungesa e besimit të frytshëm bën që shumë njerëz të mos marrin pjesë në mëshirën e treguar kaq bujarisht nga Çliruesi ynë.

Zoti synonte t'i vinte në provë njerëzit e Tij. Dora e Tij mbuloi një gabim që u bë nga njerëz në llogaritjen e periudhave profetike. Adventistët nuk e kuptuan këtë gabim. Dhe gabimi mbeti gabim edhe për kundërshtarët më të tërbuar të tyre. Këta të fundit thonin "Llogaritja që i bëni periudhave profetike është e saktë. Një ngjarje e madhe do të ndodhë; por nuk është ngjarja që parashikon Zoti Miller; ka të bëjë me shndërimin shpirtëror të botës marë, dhe jo me ardhjen e dytë të Krishtit."

Koha që pritej me padurim kaloi, por Jezusi nuk u shfaq që të çlironte njerëzit e Tij; Ata që pritnin mme besim të vërtetë dhe dashur pakufi Shpëtimtarin e tyre, u zhgënjyen./ Megjithatë qëllimet e Zotit u realizuan; Ai po vinte në provë zemrat e atyre që deklaronin se po e pritnin me gëzim ardhjen e Tij. Mes tyre kishte shumë nga ata që shtyheshin nga një qëllim i vetëm: frika. "Besimi i tyre nuk kishte prekur zemrat e tyre dhe nuk ishte reflektuar në jetën e tyre. Me të ndodhhur një gjë e tillë, me të parë se ngjarja që pritej të ndodhte nuk ndodhi, këta njerëz deklaruan se nuk ishin zhgënjyer, ÀYsepse ata nuk kishin besuar kurrë se Krishti do të vinte. Ata ishin ndër të parët që u tallën me trishtimin e besimtarit të vërtetë.

Por Jezusi dhe të gjithë engjëjt qiellorë u qëndruan pranë besnikëve të vërtetë që ishin zhgënjyer nga një provë e tillë. Sikur shtresa që ndan dukshëm nga e padukshmja të ishte zhdukur, do të shiheshin engjëj që u afroheshin këtyre shpirtrave të papërkulur duke mbrojtur ata nga shigjetat e Satanit.

1. Kur predikuesit në Skandinavi ishin të heshtur, Perëndia përdori fëmijët për të shpallur mesazhin. Çfarë na thotë kjo për përmbushje të caktuara të planit të Perëndisë?

2. Në Gjenevë, Gausseni u mësoi ardhjen e Krishtit fëmijëve. A ka fëmijë në lagjen tuaj, të cilëvë mund tju mësoni këtë të vërtetë të madhe?

3. Përse tha Ellen White që Krishti nuk mund të vinte para 1798? Shihni 2 Selanikasve 2:3.

4. Shumë vite kanë kaluar që nga "zgjimi i besimit" Adventist dhe Krishti ende nuk ka ardhur. Cila është qëndrimi juaj për këtë vonesë?

21.

Një Paralajmërim i Refuzuar

William Milleri dhe bashkëpunëtorët e tij, ndërsa predikonin doktrinën e ardhjes së dytë, frymëzoheshin nga një qëllim i vetëm, zgjiji i njerëzve për t'u përgatitur për gëzim. Ata u përpoqën që t'i bënin të ndërgjegjshëm profesorët e fesë për të kuptuar shpresënshpresën e vërtetë të kishës dhe nevojën që ata vetë kishin për një përjetim më të plotë si të krishterë; ata punuan gjithashtu që të shtronin përpara jobesimtarëve detyrën e pendesës dhe shndërimit shpirtëror të menjëhershëm. "Ata nuk u përpoqën që t'i drejtonin njerëzit drejt një sekti apo grupimi të caktuar fetar. Ata punuan me të gjitha sektet dhe grupimet duke mos u përzier as me organizimin dhe as me disiplinën e tyre."

"Gjatë gjithë aktivitetit tim, - thotë Milleri, - as nuk kam dashur dhe as nuk më ka shkuar në mendje që mbroj ndonjë interes të ndryshëm nga ai i sekteve ekzistuese ose që përkrah njërin grupim në kurriz të tjetrit. Ideja ime ishte që përfitonin të gjithë. Mendja se nuk do të lindte nevoja e organizimit të takimeve të veçanta sepse besoja se të gjithë të krishterët do të gëzoheshin nga mesazhi i ardhjes së Krishtit dhe ata që nuk do ta konsideronin këtë ide sipas kësaj retrospektive, nuk do të kishin arsye që t'i urrenin ata që do ta përqafonin atë. Objekivi që i kisha vënë vetes ishe që t'i bëja njerëzit që ta dëgjonin Zotin, të lajmëroja botën mbarë për gjykimin që po afronte, dhe t'i nxisja bashkëkohësit që ta takonin Zotin e tyre në paqe. Pjesa më e madhe e atyre që përjetuan një shndërrim të tillë shpirtëror nga puna ime u bashkuan me kisha ekzistuese të dryshme." - Bless, f 238.

Duke qënë se ai synonte me punën e tij që të forconte kishat, puna e tij fillimisht u prit me dashamirësi. Por me kalimin e kohëspastorët dhe udhëheqësit fetarë u hodhën kundër doktrinës së ardhjes dhe dëshironin që t'i jepnin fund agjitacionit rreth këtij subjekti. Kështu që ata, jo vetëm që e luftuan atë nga podiumet kishtare, por edhe ia mohuan anëtarëe të kishave të tyre privilegjin për të dëgjuar predikime mbi ardhje e dytë ose për ta shprehur shpresën që ushqenin në takimet

e kishës. Besimtarët u gjendën në një gjendje të vështirë dhe çorientuese. Ata ishin të lidhur me kishat e tyre dhe nuk donin të ndaheshin prej tyre; por kur vunë re se po i vihej shkelmi dëshmisë së fjalës së Zotit dhe po ju mohohej e drejta për t'i studiuar personalisht profecitë, ata ndjejnë se besnikëria ndaj Perëndisë nuk i lejonte të nënshtroheshin. Ata s'mund t'i konsideronin kurrë ata që përpiqeshin që ta flaknin tej dëshminë e fjalës së Zotit, si pjesë e kishës së Krishtit, "të mbështetjes dhe bazamentit të së vërtetës." prandaj ata kishin arsye të mjaftueshme për t'i shëputur lidhjet e mëparëshme. Në verën e vitit 1844 nga kishat u larguan pothuajse pesëdhjetë mijë vetë.

Gjatë kësaj kohe u vu re një ndryshim i dukshëm në pjesën më të madhe të kishave amerikane. Për vite me rradhë ishte konsideruar një pajtim në rritje me praktikat dhe zakonet tokësore dhe një rënie po aq e madhe përsa i përkishte jetës së vërtetë shpirtërore; por gjatë atij vit u dhanë prova të një gjallërie të dukshme dhe të menjëherëshme në pothuajse të gjitha kishat e vendit. Ndërsa askush s'ishte në gjendje të merrte me mend shkakun e kësaj gjallërie, vetë ky fakt u bë i njohur dhe u komentua gjerësisht si nga shtypi, ashtu edhe nga podiumet kishtarë.

Në një mbledhje të pleësisë së kishës presbiteriane Zoti Barnes, autor i një libri shumë të njohur komentesh dhe pastor i një prej kishave kryesore të atij qyteti "deklaroi se gjatë njëzet vjetëve të punës së tij si pastor, deri në shërbesën e fundit të Komunionin, ai kishte pasur në kishë njerëz të të gjithë klasave. Por tani nuk kishte më përjetime, nuk kishte më shndërrime shpirtërore, nuk vihej më re ndonjë rritje e dukshme në besim tek pastorët dhe askush nuk merrte më pjesë në orët e studimit për të diskutuar rreth shpëtimit. Rritja e aktivitetit fitimprurës dhe prespektiva e shkëlqyer e tregtisë dhe prodhimit të manufakturave kishte shtuar interesin mbi gjërat materiale. Dhe kjo po ndodh me të gjitha sektet fetare." - "COngregational Journal", 23 Maj 1844.

Në shkurt të të njëjtit vit profesor Tinney i Kolegjit Oberlin tha: "E kemi pasur përpara syve faktin, se përgjithësisht, kishat Protestante të këtij vendi janë treguar të plogta apo armiqësore ndaj pothuajse të gjitha reformave morale të shekullit. Ekzistojnë disa përjashtime të pjesshme, por fakti i lartpërmendur është i vërtetë për pjesën më të madhe të këtyre kishave. Ballafaqimi gjithashtu me një fakt tjetër të vërtetë: mungesën e plotë të një ringjallje ndikuese në kisha. Mbizotëron kudo plogështia shpirtërore; plogështi që është kaq e plotë sa të shShtypi fetar mbarëkombëtar dëshmon për këtë ... Anëtarët e kishës po i kushtohen gjithnjë e më shumë një mënyre të caktuarjetese - janë bërë një me njerëzit e ligje duke marrë pjesë në mbrëmje vallëzimi, në festime të natyrshme të ndryshme etj ... Por s'kemi pse të zjgatemi kaq shumë në një temë të tillë. Është e mjaftueshme të themi se provat ndjekin njëra-tjetrën dhe rëndojnë mbi ne duke na treguar se kishatpërgjithësisht kanë marrë rrapëllimën në mënyrë të menjëherëshme. Ata janë larguar shumë nga Zoti dhe Ai është tërhequr prej tyre."

Një shkrimtar i "Feleskopit fetar" dëshmonte: "Nuk kemi parë kurrë më parë një degradim të tillë fetar si ky që po konstatojmë tani. Është e vërtetë që kisha duhet të zgjerohet dhe të kërkojë shkakun e kësaj fatkeqsie; sepse cilido që e do Perëndinë duhet ta konsiderojë një gjendje të tillë si fatkeqsi. Kur rikujtojmë rastet e shndërrimeve të vërteta shpirtërore që janë kaq të pakta dhe të largëta, dhe kur vëmë re vrazhdësinë dhe moskokçarjen e pakrahasueshme të mëkatarëve, pa dashur pyesim: A ka harruarvallë Zoti që të tregohet hirplotë apo mëshirës i është mbyllur dera?"

Një gjendje e tillë madje edhe brenda kishës, e ka një shkak. Errësira shpirtërore që mbulon kombe, kisha dhe individë të veçantë nuk ka të bëjë me tërheqjen arbitrare nga ana e Perëndisë apo me shmangjen e ndihmës dhe mëshirës së Tij, por me mohimin nga ana e njerëzve e dritës hyjnore. Historia e çifutëve në kohën e Krishtit na jep një shembull mahnitës të kësaj të vërtete. Të kushtuar ndaj gjërave tokësore ata harruan Zotin dhe fjalën e Tij, mendjet e tyre u errësuan dhe zemrat e tyre ishin lidhur fort pas tokësores. Kështu ata nuk ditën asgjë për ardhjen e Mesisë dhe rrjedhimisht e mohuan Atë falë krenarisë dh mosbesimit të tyre. As atëherë Zoti nuk ia mohoi kombit çifut të drejtën për te marrë pjesë dhe për të mësuar mbi bekimet dhe shpëtimin. Por ata që e flakën tutje të vërtetën, humbën bashkë me të, dëshirën për ta marrë dhuratën e Qiellit. Ata e kishin keqkuptuar "errësirën për dritë, dhe dritën për errësirë" derisa drita që kishin në vetvete u kthye në errësirë. Sa e plotë ishte ajo errësirë!

Politikës së Satanit i shkon për shtat që njerëzit t'i ruajnëdisa forma të caktuara fetare në qoftë se në to, mungon fryma jetësore e dashurisë dhe besimi tek Perëndia. çifutët vazhduan të mbanin me zell ritet e tyre të hershme, të ruanin rigorozisht të drejtën e kombit të zgjedhur edhe pas mohimit të lajmit të irë, ndërkohë që ata vetë deklaruan se prania e Zotit nuk manifestohej më mes tyre. Profecia e Danielit fliste qartë për kohën e ardhjes së Mesisë dhe parashikonte në mënyrë drejtpërdrejtë vdekjen e Tij, dhe kjo është arsyeja që ata u përpoqën të pengonin studimin e saj dhe përfundimisht, mësuesit e ligjit i mallkuan të gjitha ata që do të orvateshin që të njesonin kohën për të cilën flitet në të. Të verbuar dhe moskokëçarës, izraelitët vazhduan të tregoheshin, edhe në shekujt e mëvonshëm, indiferentë ndaj ofertave mëshirëplotë të shpëtimit, të pavëmendshëm ndaj bekimeve që sjell lajmi i mirë duke përbërë kështu një paralajmërim solemn dhe të frikshëm të rrezikut që mbart mosbesimi i dritës hyjnore.

Të gjithë ato vendi, në të cilët ekziston një gjendje e tillë, do të ndeshen me të njëjtat rrezultate. Ai që me ndërgjegje të plotë u zë frymën bindjeve, sepse ato ndikojnë në prirjet e tij, humb ndërgjegjen dhe zemra ngurtësohen dhe shpirti largohet nga Zoti. Atje ku mesazhi i të vërtetës hyjnore flaket tej me përbuzje në kishë mbizotëron errësira; besimi dhe dashuria u lënë vendin grindjeve dhe urrejtjes

Anëtarët e kishës i përqëndrojnë energjitë dhe interesat e tyre në çështje tokësore dhe kjo bën që mëkatarët të mbyllnin sytë përpara gjendjes së tyre të mjerueshme.

Mesazhi i engjëllit të parë të kapitullit 14 të Apokalipsit duke shpallur orën e gjykimit të Perëndisë dhe duke i bërë thirrje njerëzve ta respektonin e ta adhuronin Atë, synonte që t'iveçonte njerëzit e Zotit nga ndikimi korruptues i botës dhe t'i bënte ata ndërgjegjshëm për gjendjen e kaosit dhe materializimit në të cilën ndodheshin. Me këte mesazh Zoti i dërgoi kishës një paralajmërim, që po të ishte përkrahur i praniar, do t'u jepte fund gënjeshtrave që përbënën barrierën midis të dy palëve (kishës dhe Zotit). Sikur ata ta kishin përqafuar mesazhin qiellor duke qëndruar të përulur përpara Perëndisë dhe duke kërkuar me sinqeritet praninë e Tij, Shpirti dhe fuqia e Zotit do të ishin shfaqur mes mes tyre. Kisha do të kishte rifituar përsëri unitetin, besimin dhe dashurinë që ekzistonte në ditët apostolike kur të gjithë besimtarët "ishin një në zemër e në mendje" dhe "ua shpallnin të gjithëve me gëzimlajmin e Perëndisë" dhe kur "çdo ditë Perëndia çonte tek ata edhe njerëz të tjerë, të cilët donte t'i shpëtonte." - Veprat 4:32, 31; 2:47.

Sikur njerëzit e Zotit do ta kishin pranuar dritën që ndriçonte nga fjala e Tij, ata do të kishin arritur unitetin për të cilin u lut edhe Mesia, dhe të cilin apostulli e përshkruan si "njësinë që ju jep Shpirti i Perëndisë me anë të pajtimit që ju lidh me njerëi-tjetrin." "Ju të gjithë jeni një trup, - thotë ai, - në ju jeton një Shpirt; të gjithëve iu pret e njëjta e ardhme madhështore. Ka vetëm një Zot, një fe dhe një pagëzim." - Efesianët 4:3-5.

Të tilla rezultate të bekuara patën të gjithë ata pranuan mesazhin adventis (të ardhjes). Ata vinin nga sekte të ndryshme fetare, por barrierat që ngrinin këto grupime u sheshuan; kredot armiqësore u copëtuan në çikla; shpresa e babazuar në Shkrimet e Shenjta për një periudhë njëmijë vjeçare paqeje u braktis, u korrigjuan pikëpamjet e gabuara që lidheshin me ardhjen e dytë, u hoq dorë nga krenaria dhe pajtimi, me rregullat tokësore;gabimet u ndreqën; zemrat u bashkuan në një adhurim të mrekullueshëm dhe kudo mbizotëron dashuria dhe gëzimi. Meqë kjo doktrinë pati këtë ndikim tek ai numër i vogël njerëzish që e pranuan, ajo di t'i ndikonte në të gjithë, sikur të gjithë ta kishin pranuar atë.

Por kishat përgjithësisht nuk ia vunë veshin këtij paralajmërimi. Pastorët e tyre të cilët e vëzhguan "brenda shtëpisë së Izraelit" duhet të ishin të parët për të dalluar shenjat e ardhjes së Jezusit, nuk arritën ta mësonin të vërtetën as nga dëshmia e profetëve, dhe as nga të dhënat e kohërave. Duke qënë se në zemrat e tyre mbizotëronin shpresat dhe ambicjet, në to s'kishte vend për dashurinë për Perëndinë dhe besimin në fjalën e Tij. Kështu prezantimi i dokrinës mbi ardhjen e dytë zgjoi vetëm mosbesim dhe u hapi rrugën paragjykimeve. Rakti që mesazhi në një shkallë të gjerë u predikua nga njerëz të zakonshëm, u përdor si argument kundër tij. Ashtu si në të shkuarën, dëshmia e qartë e fjalës së Zotit u ndesh me pyetjen: "A e ka besuar

ndonjë nga kryefarisenjtë?" Shumë prej tyre, duke e kuptuar se sa e vështirë ishte që t'i hidhje poshtë argumentet që sillnin periudhat profetike, e penguan studimin e profecive duke deklaruar se librat profetikë ishin botuar dhe kuptimi i tyre s'mund të zbulohej. Me mijëra njerëz duke i besuar pa asnjë hezitim pastorëve të tyre, nuk i kushtuaon rëndësi këtij paralajmërimi, të tjerët megjithëse ishin të bindur për të vërtetën që mbartte ai, nuk guxonin të flisnin haptazi duke pasur frikë se "do të flakeshin jashtë sinagogës." Mesazhi që dërgoi Zoti për pastrimin dhe vënien e kishës në provë tregoi edhe një herë se sa i madh ishte numri i atyre njerëzve, që ia kishin kushtuar dashurnë e tyre botës dhe jo Krishtit. Lidhjet e tyre me letrën ishin më tëforta se ato me qiellin. Ata vendosën që t'i vinin veshin zërit tëzgjuarsisë tokësore dhe kështu i kthyen kurrizin mesazhit të së vërtetës, që synonte të depërtonte deri në zemrën e tyre.

Duke mohuar paralajmërimin e engjëllit të parë ata hoqën dorë nga mjetet që po jo jepte për përmirësimin e gjendjes në të cilën ndodheshin. Përbuzën lajmëtarin e mëshirshëm që do t'u jepte fund të këqijave që i ndanin ata nga Perëndia dhe kërkuan me zell akoma më të madh, dashamirësinë e botës. Ky ishte shkaku i asaj gjendjeje kaosi, femohimi dhe vdekjeje shpirtërore që mbizotëronte në kishat e vitit 1844.

Në kapitullin 14 të Apokalipsit engjelli i parë pasohet nga një i dytë që shpall mesazhin: "Ra, ra Babilonia e madhe që i detyroi të gjitha kombet të pinin verën e fortë të pabesisë së saj." - Apokalipsi 14:8. Termi "Babiloni" vjen nga fjala "Babel" që do të thotë konfuzion çregullim. Përdoret në Shkrimin e Shenjtë për të përcaktuar format e ndryshme të besimit të rremë. Në kapitullin 17 të Apokalipsit Babilonia paraqitet si një grua - figurë e cila përdoret në Bibël si simbolli kishës; gruaja e ndershme përfaqson kishën e pastër dhe gruaja e çthurrur kishën e rreme.

Bashkimi në martesësimbolizon në Bibël karakterin e qëndueshëm dhe të shenjtë të marrëdhënes që ekziston mes Krishtit dhe kishës së Tij. Zoti është lidhur fort me njerëzit e Tij me anë të një beslidhje, Ai duke premtuar se do të jetë Perëndia i tyre dhe ata duke u zotuar se do t'i përkasin Atij dhe askujt tjetër. Ai deklaron: "Do të martohem me ty përgjithmonë; dhe dhurata e dhëndrit do të jetë mbrojtja ime, dashura im, mëshira ime ..." - Hoshea 2:21. Tek kapitulli 3 i Librit të Profetit Jirmia, versa 14 thuhet: "Jeni të mitë si më parë." Pali përdor të njëjtënfigurë në Dhiatën e Re kur thotë: "Unë ju uroj me shumë xhelozi si vetë perëndia. Ju jeni si një vajzë që ju fejova me një djalë të vetëm, domethënë me Mesinë. Do t'ju sjell tek ai të paprekshëm." - Letra e Dytë e Korintasve 11:2

Pabesnikëria që tregoi kisha e Krishtit duke lejuar që Ai të mos përbënte më kikëqëndrën e besimit dhe dashurisë së anëtarëve të saj dhe ata të tërhiqeshin më shumë pas gjërave tokësore, përngjason me shkeljen e betimit martesor. Mëkati që bëri Izraeli duke u larguar nga Zoti paraqitet me një figurë të tillë; dhe nga ana tjetër

skicohet me ngjyra të gjalla dashuria e Tij e mrekullueshme. "Të dhashë fjalën dhe lidha për jetë beslidhjen me ty, unë, Zoti. Kështu u bëre e imja." "Ishte jashtëzakonisht e bukur dhe u bëre mbretëreshë. Mbarë bota e lavdëroi bukurinë tënde, e cila u përsos me anë të stolisë sime ... Por ti u bëre mendjemadhe dhe me bukurinë tënde joshe çdonjërin që kalonte pranë. Iu afrove të gjithëve." "Ti e ke mashtruar burrin tënd, o shtëpi e Izraelit, duke bërë imoralitet me burra të huaj;" "Por si një grua që vjen dashnori dhe bëhet e pabesë ndaj burrit të saj, ashtu ma ke shkelur besën edhe ti, o Izrael." - Jehezkeli 16:8, 23-15; Jirmija 3:20.

Me të njëjtën gjuhë u drejtohet në Dhiatën e Re apostulli Jakob të gjithë atyre të krishterëve që preferojnë më shumë miqësinë me botën sesa mbështetjen e Perëndisë. Ai thotë: "Ju jeni të pabesë ndaj Perëndisë si ata që bëjnë tradhëti bashkëshortore. Miqësia me botën do të thotë armiqësi me Perëndinë. A nuk e dini këtë? Kush pra, miqësohet me botën, armiqësohet me Perëndinë." - Letra e Jakobit 4:4.

Gruaja (Babilonia) përshkruhet në kapitullin 18 të Apokalipsit si "e veshur me një petk të purpurtë dhe të kuq të ndezur dheishte stolisur me ar, gurë të çmueshëm dhe me perla. Në dorë kishte një gotë ari. Gota ishte e mbushur me kobë dhe ndyrësi - shenja e jetës së saj të shthurrur ... Në ballë kishte të shkruar emrin që vijon: "Unë jam Babilonia, Perëndia" Profeti thotë: "Pashë sesi gruaja ishte e dehur me gjakun e popullit të Perëndisë. Kishte parë gjakun e të gjithë atyre që ishin vrarë për shkak të besnikërisë ndaj Jezusit." Më pas thuhet se Babilonia është "qyteti i madh që i ka mbretërit e botës nën pushtetin e tij". - Apokalipsi 17:4-6, 18. Roma përbën atë fuqi, për shekuj me rradhë vendosi sundimin e saj despotik mbi mbretërimin e vendeve kristiane. Veshja me petk të purpurt dhe të kuq të ndezur, ari dhe gurët e çmueshëm japin me gjyra të gjalla madhështinë dhe pompozitetin mbretëror të Papatit mendjemadh. Vetëm për atë kishë që ka persekutime gjakun e popullit të Perëndisë." Babilonia është gjithashtu fajtore për lidhjen e paligjshme me "mbretërit e botës". Kisha çifute u shturr pë shkak të aleancës së saj me paganizmin dhe largimit nga Zoti; dhe Roma e korruptuar në të njëjtën mënyrë sepse kërkoi mbështrjen e fuqisë tokësore, meriton të njëjtin dënim.

Babilonia quhet "nëna e çdo pabesie." Të bijat e saj duhet të simbolizohen të gjitha ato kisha që përqafojnë dokrinat dhe traditat e saj, që ndjekin shembullin e saj duke sakrifikuar të vërtetën dhe miratimin e Perëndisë për të siguruar një aleancë të paligjshme me botën. Mesazhi i kapitullit 14 të Apokalipsit që ka të bëjë me rënien e Babilonisë duhet t'i drejtohet atyre organizmave fetare që dikur ishin të pastra, por u korruptuan më pas. Duke pasur parasysh faktin që ky mesazh pason paralajmërimin për gjykim, ai duhet të shpallet gjatë ditëve të fundit, prandaj nuk ka sesi t'i referohet vetëm Kishës së Romës, sepse kjo kishë,për shekuj me rradhë, ka qënë në gjendje të rrënuar. Për më tepër në kapitullin 18 të Apokalipsit i bëhet thirrje popullit të Perëndisë që të dalë nga Babilonia. Duke u bazuar tek ky pasazh

i Shkrimit të Shenjtë kuptojmë se shumë njerëz nga populli i Perëndisë do të jenë akoma nën sundimin e Babilonisë. Pra, cilave organizma fetare u përkasin tani pjesa më e madhe e ndjekësve të Krishtit? Ata u përkasin padyshim kishave të ndryshme Protestante. Që në formimin e tyre këto kisha mbrojtën me vendosmëri Zotin dhe të vërtetën dhe Ai i ndihomoi duke i bekuar. Madje edhe jobesimtarët u detyruan t'i njihnin rezultatet dobiprurëse që oasuan pranimin e parimeve të ungjillit. Profeti i drejtohet dobipturëse që pasuan pranimin e parimeve të ungjillit. Profeti i drejtohet Izraelit me këti fjalë: "Mbarë bota e lavdëroi bukurinë tënde, e cila u përsos me anë të stolisë sime. - thotë Perëndia, Zoti." Por dëshira për të imituar praktikën e botës dhe për të fituar miqësinë e saj, pati sjellë mallkimin mbi Izrael dhe rrënimin e tij, çoi edhe në rënien e tyre. "Por horrove se më detyrohesh mua për lavdinë hde famën tënde. Ti u bëre mendjemadhe dhe me bukurinë tënde joshe çdonjërin që kalonte pranë. Ju ofrove të gjithëve." - Jehezkeli 16:14, 15.

Shumë kisha Protestante po ndjekin shembullin e Romës duke lidhur u padrejtësisht me mbretërit e botës" - domethënë me kisha e shtetit nëpërmjet marrëdhënieve të tyre me qeveritë sekulare; ndërsa sekte të tjera fetare, duke kërkuar dashamirësinë e botës. Kështu termi "Babiloni" - çrregullim - mund t'i vishet saktësisht këtyre organizatave, që të gjitha pa përjashtim deklarojnë se doktrinat e tyre rrjedhin nga Bibla, e në të njëjtën kohë janë grupuar në një numërtë madh sektesh, secila me teoritë dhepraktikat e veta që konrtadiktojnë tërësisht ato të të tjerëve.

Kishat që u ndanë nga Roma ruajnë, përveç aleancës mëkatprurëse me botën edhe disa nga karakteristikat e tjera të saj.

Një punim i Kishës Katolike të Romës thekson se "në qoftë se Kisha ROmane fajsohet për idhujtari përsa i përket shenjtorëve të saj, bija e saj, kisha e Anglisë që ka dhjetë kisha që i përkushtohen Marisë për një kishë që i përkushtohet Krishtit, është po aq fajtore." - Richard Challoner, "The Satholec Christian Instructed", parathëne, f 21, 22.

Dhe Doktor Hapkins në "Një rtaktat mbi njëmijëvjeçarin" deklaron; "Nuk kemi asnjë arsye që të mendojmë se fryma dhe praktikat antikristiane janë të kufizuara vetëm brenda asaj që njihet sot me emrin Kisha e ROmës, Kishat Protestante përmbajnë në vetvete shumë elemente antikristiane dhe kanë shumë për të bërë që të mund të heqin dorë nga korrupsioni dhe ligësia." - Samuel Haptuns, "Works", vol 2, f 328.

Duke shkruar rreth ndarjes së Kishës Presbiteriane nga ajo e Romës Doktor Guthri deklaron; "Përpara treqind vjetësh kisha jonë duke ngritur Biblën si flamur dhe me moton "Studioni Shkrimet e Shenjta" ai shtron pyetjen: "Po a dolë vallë krejtësisht të pastër nga Babilonia?" - Thomas Gjthri, "The Gospel isn Ezekiel", f 237.

"Duket sikur Kishën e Anglisë, - thotë spurgeoni, - e bren nga brenda krismbi i ceremonive; mospajtimi që ekziston për momentin është thurrur keqas me pabesinë

filozofike. Të gjithë ata që mbanin për njerëz të mirë po u kthejnë kurrizin njeri pas tjetrit themeleve të besimit. Besoj se lulja e kombit anglez po vyshket nga një pabesi e mallkuar që ka akoma guximin të dalë në podiumet e kishave dhe ta quaj veten të krishterë.

Cila ishte origjina e këtij mohimi të madh? Si u largua fillimisht kisha nga thjeshtësia e ungjillit? Kjo ndodhi falë përputhjes me praktikat e paganizmit në mënyrë që paganët të pranonin Kristianizmin. Që në kohën e tij apostulli Pal deklaronte kështu: "Vërtet, fuqia e padrejtësisë tashmë po punon." - 2 Selanikasve 2:7. Gjatë kohës që apostujt ishin gjallë, kisha qëndroi relativisht e pastër. Por "nga fundi i shekullit të dytë në pjesën më të madhe të kishave mbizotëronin një formë e re; humbi thjeshtësia e dikurshme dhe pa e kuptuar, ndërsa nxënësit e parë pushonin në varre, në skenë dolën pasardhësit e tyre dhe të krishterët e rinj që rimoderuan dhe rinovuan kauzën e të parëve të tyre" - Robert Robinson, "Ecclesiastical Researches", kap 6, par 17, f 51. Në mënyrë që kishat të shtoheshin me anëtarë të rinj, standarti dinjitoz i besimit kristian u mënjanua, dhe në kishë mbizotëroi një rrymë pagane që solli me vete zakonet, ceremoniale dhe idhujt e saj." - Gavazzi, "Lectures", f 278. Me të fituar simpatinë dhe përkrahjen e sunduesve sekkularë, feja kristiane u pranua nga një numër i madh njerëzish; por ndërsa pretendonin se ishin të krishterë të mirë pjesa më e madhe e tyre mbetën në vetvete paganë duke vazhduar t'i adhuronin idhujt e tyre në fshehtësi." - Po aty, f 278.

A nuk është përsëritur i njëjti proçes në pothuajse të gjitha kishat Protestante? Me të vdekur themeluesit, ata që zotëronin frymën e vërtetë të reformës, nnë skenë dilnin pasaardhësit e tyre që "rimodelonin kauzën." Ndërsa nga njëra anë të kapur verbërisht pas besimit të Baballarëve të tyre ata s'pranonin asnjë të vërtetë tjetër përveç atyre që kishin trashëguar, nga ana tjetër këta fëmijë të reformatorëve hoqën dorë nga shembulli i përuljes, vetmohimit dhe mospërfilljes ndaj botës, shembull qëdikur e ndiqnin paraardhësit e tyre. Kështu "humbi thjeshtësia e mëparëshme". Dhe rryma tokësore sjell me vete në kishë "Zakonet, ceremonitë dhe idhujt e saj."

Oh sa e rëndësishme ishte tani miqësia me botën që do të thoshte "armiqësi me Perëndinë" për "të ashtuqyajturit" ndjekës të Krishtit! Pjesa më e madhe e kishave në të gjitha vendet kristiane janë larguar kaq shumë nga standarti biblik i përulësive, vetëmohimit, thjeshtësisë dhe mirësisë! Duke folur për përdorimin e drejtë të të hollave John Westey thotë: "Mos harxhoni asnjë lek vetëm që të blinidiçka që do t'u kënaqë syrin, veshje të mrekullueshme dhe të shtrenjta, stoli të panevojshme. Mos i shpenzoni kot të hollat që ta rregulloni shtëpinë në mënyrë të habitshme, duke blerë mobilje lluksoze dhe të shtrenjta, piktura të veshura me varak dhe porttrete të kushtueshme ... Mos lësho nga dora lek për të fituar kështu admirimin dhe lëvdatat e të tjerëve dhe për të blerë krenarinë që ofron jeta ... Për aq kohë sa të bësh mirë, njerëzit do të flasin mirë për ty. Për aq kohë sa të vishesh me rroba të purpurta dhe

të bukura dhe të ushqehesh me gjithë të mirat, shumë njerëz, pa dyshim, do të duartrokasin elegancën, guston, bujarinë dhe mikëpritjen tënde.

Por mos e bli kaq shtrenjt duartrokitjen e tyre. Më mirë kënqu me nderin që të jep Perëndia." - Wesley, ""Works", Shërbesa 50, "The Use of Money". Por ne shumë kisha të ditëve tona një mësim i tillë as nuk përfillet fare.

T'i përkasësh një feje të caktuar ëhstë më se e zakonshme për botën. Sundimtare, politikane, avokatë, doktorë, tregtarë bashkohen me kishën në mënyrë që të fitojnë respektin dhe besimin e shoqërisë dhe t'u japin një shtyrje përpara interesave të tyre tokësore. Kështu, ata përpiqen që t'i mbulojnë veprimet e tyretë padrejta nën pseudobesnikërinë ndaj Kristianizmit. Organizmat e ndryshëm fetarë, të riformuar nga pasuria dhe influenca e këtyre anëtarëve të pushtetshëm, kërkojnë të kenë akoma më shumë popullaritet dhe përkrahje. Në rrugët kryesore ngrihen kisha të mrekullueshme, zbukuruar në mënyrë të ekzagjeruar. Adhuruesit vijnë të veshur me rroba të kushtueshme dhe moderne. Dhe pastori i talentuar paguhet shumë që t'i tërheqë dhe t'i zbavisë këta njerëz. Shërbesat e tyre nuk duhet të prekin problemin kritik të mëkatit, por duhet të jenë të këndshme dhe lajkatare për veshët e njerëzve modernë. Kështu, ndërsa listat e kishës shtohen me mëkatarë modernë, mëkatet moderne fshihen prej tyre nën petkun e dashurisë dhe respektit për Zotin.

Duke komentuar qëndrimin e të "të ashtuquajturve" të krishterë në lidhje me botën, një nga gazetat kryesore sekulare thotë: "Pa kuptuar, kisha i është dorëzuar frymës së kohës dhe ia kapërshtatur format e saj nevoja moderne." "Kisha përdor si instrument të sajin gjithçka që e bën fenë tërheqëse." Dhe një reporter i gazetës "New York Indipendendent" shkruan kështu përsa i përket metodizmit: "Vija e ndarjes mes besimtarëve dhe të pafeve po fshihet dhe nga të dyja anët e saj, njerëz të zellshëm, po punojnë që t'u vënë kapakun ndryshimeve mes mënyrave të tyre të veprimit dhe argëtimit." "Popullariteti i fesë synon që të rrisë në mënyrë të konsiderueshme numrin e atyre që përfitojnë prej saj duke i larë duart nga detyrat që shtrohen para tyre."

Howard Krosbi thotë: "Është shumë shqetësuese kur shikon sesi kisha e Krishtit i përmbush në një shkallë kaq të ulët synimet e Zotit të saj. Si çifutët e hershëm, që falë aleancës me kombet pagane ia mbyllën Perëndisë dyert e zemrave të tyre, ... ashtu po heq dorë tani nga metodat hyjnore të jetës së vërtetë edhekisha e Jezusit dhe po dorëzohet përpara zakoneve të rrezikshme, edhe pse shpesh, duken kaq bindëse, të një shoqërie antikristiane, duke përdorur argumente dhe duke arritur në konkluzione krejtësisht të huaja për qëllimet e Zotit dhe të dëmshme për rritjen në besim të anëtarëve të saj. Shkaku i vetëm i të gjithë kësaj gjendje - pajtimi i gabuar m e një botë të pabesë." - "The healthy Christian: An appeal to të church", f 141, 142.

Në këtë çrregullim, ku të gjithë interesohen për gjëra tokësore dhe dëshirojnë vetëm të argëtohen, nuk ka vend për vetësakrifikim dhe vetëmohim në emër të

Jezusit. "Disa nga burrat dhe gratë që tani luajnë një rol aktiv në kishat tona, kur ishin fëmijë, janë mësuar që të sakrifikojnë në mënyrë që të kenë mundësinë të japin apo të bëjnë diçka për Krishtin."Por po u deshën fonde tani, ... askush nuk mund të japë. Oh, jo! Më mirë do të ishte sikur të kishte ndonjë ngjarje intrigante apo gazmore, ndonjë drekë apo diçka për të ngrënë - domethënë diçka që të mund t'i zbavisë njerëzit."

Guvernatori Washburn i Viskonsinës deklaroi gjatë fjalimit që mbante çdo vit, më 9 Janar 1873 kështu: "Ndjehet nevoja e nje ligji që të mund të shpërndajë çerdhet nga lindin bixhozçi. Këto gjenden kudo. Madje edhe kisha (padyshim padashur) po kryen disa herë punën e djallit. Koncerte, inicioativa dhe llotari të organizuara për të nxjerrë të holla ndonjëherë shkojnë në ndihmë të qëllimeve fetare apo bamirëse, por që shpesh përdoren për të arritur synime pa vlerë. Llotaritë, çmimet, pakot etj ... përbëjnë mënyra fitimi të hollash, por jo vlerash shpirtërore. FItimi i të hollave apo pronave pa derdhur asnjë pikë djere është gjëja më demoralizuese dhe fyese veçanërisht për të rinjtë. Nukështë e çuditshme që duke parë se si njerëzit më të respektueshëm përfshihen në të tilla iniciativa të rastit ... dhe duke qënë të qetë shpirtërisht nga fakti se të hollat do të përdoren për një qëllim fisnik, të rinjtë të bien shpesh pre e entuziazmit që shkakton loja e kumarit."

Fryma e oajtimit me botën po pushton të gjitha kishat e krishtere. Atkins, në një shërbesë që mbajti në Londër, vizaton me ngjyra të errta gjendjen shpirtërore që mbizotëronte në Angli, "Njerëzit me të vërtetë të ndershëm janë të paktë mbi tokë askush s'e ka më për zemër drejtësinë. Profesorëve të sotëm të fesë, të çdo kishe, u pëlqen më shumë bota, pajtohen me të, adhurojnë rehatinë dhe duan të ngjallin respekt tek të tjerët. Atyre u është bërë thirrje që të vuajnë bashkë me Krishtin por ata mblidhen grusht dhe përpara një qëllimi ... Mohim, mohim, mohim besimi; këto fjalë janë skalitur në ballë të kishës ... e sikur ata ta dinin këtë, ta ndjenin këtë shpresa mund të ekzistonte akoma; por oh! Ata mburren: "Ne jemi të pasur, rrethar nga të mira dhe s'kemi nevojë për asgjë." - Secon Advent Library, broshura nr 39.

Babilonia ngarkohej me faj sepse ajo "i detyroi të gjitha kombet të pinin verën e fortë të pabesisë së saj." Kjo kupë helmi që ia paraqet botës ajo vetë, përfaqëson doktrinën e rreme që pranoi ajo si rezultat i lidhjes së paligjshme me më të pushtetshmit e tokës. Miqësia me botën korrupton besimin mbi botën duke përqafuar dhe përhapur doktrina që kundërshtojnë thëniet më të qarta të Shkrimit të Shenjtë.

Roma ua fshehu njerëzve Biblën dhe u kërkoi që të pranonin mësimet e sah në vend të Shkrimit të Shenjtë. Ishte Reformacioni ai ë ua riktheu popujve fjalën e Perëndisë, po a nuk është mësee vërtetë që në kishat e ditëve tona njerëzit mësohen që ta mbështesin besimin tek opinionet e tyre personale dhe mësimet e kishës dhe jo tek fjala e Zotit? Duke folur për kishat Protestante Karl Beecher thotë: "Ata dridhen nga çdo fjalë e pahijshme që drejtohet kundër qpinioneve të tyre me të njëjtën ndjeshmëri me të cilën baballarët e tyre do të ishin dridhur nga çdo fjalë e pahi-

jshme që mund të drejtohej kundër respektit ndaj martirëve dhe shenjtorëve, respekt që i kishte rrënjët ngulur thellë në zemrat e tyre ... Sektet Protestante ia lidhën duart kaq keq njëritjetrit dhe vetvetes sa, përmes kësaj thirrjeje, dikush nuk mund të bëhej kurrë predikues pa pranuar disa libra të tjerë përveç Biblës ... Gjithshka është mëse reale kur thuhet se fuqia e asaj që ata besojnë po fillon t'ia mbylli derën Biblës ashtu siç bëri Roma dikur, Beçse në një mënyrë më të zgjuar." - Shërbesa e mbajtur në Fort Wayne, Indiana më 22 Shkurt 1846 mbi temën "The Bible a Sufficient Creed" (Bibla një besim mëse i mjaftueshëm).

Kur mësues besnikë u përpoqën që ta shpjegonin fjalën e Perëndisë, në skenë u shfaqën njerëz te ditur, pastorë, që duke deklaruar se i kuptonin Shkrimet e Shenjta, u dhanë deokrinave të qarta të qarta emrin herezi dhe kështu ua prenë hovin atyre që kërkonin të vërtetën. Sikur bota të mos ishte e helmuar në këtë pikë nga vera e fortë e Babilonisë, me mijëra njerëz do të ishin bindur nga të vërtetat e qarta dhe fshikulluese të Biblës dhe do të kishin përjetuar shndërrim shpirtëror. Por besimi fetar duket kaq i ngatërruar dhe çorientues sa njerëzit nuk dinë se çfarë të besojnë si të vërtetë. Mospërputhja mëkatare po troket në dyert e kishave.

Mesazhi i engjëllit të dytë të kapitullit 14 të Apokalipsit upredikua për herë të parë në verën e vitit 1844 dhe gjatë asaj kohe, mund të zbatohej praktikisht dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë në kishat amerikane, ku paralajmërimi për gjykim ishte shpallur dhe njëkohësisht mohuar në një shkallë të gjerë dhe ku rënia morale e kishave kishte qënë nga më të shpejtat. Por mesazhi i engjëllit të dytë nuk u përmbush plotësisht në vitin 1844. Kishat ia prenë rrugën dritës që mbaartte në vetvete mesazhi i ardhjes dhe rrjedhimisht, përjetuan një rrënim moral; por edhe rrënimi nuk ishte tërësor. Ndërsa kanë vazhduar t'u presin rrugën të vërtetave të veçanta që kanë të bëjnë me kohën që jetojmë, ato janë fundosur gjithnjë e më shumë, por sidoqoftë s'mund të thuhet akoma që "Ra, ra Babilonia ... sepse i detyroi të gjitha kombet që të pinin verën e fortë të pabesisë së saj." Ajo s'i ka detyruar akoma të gjitha kombet që ta bëjnë një gjë të tillë. Fryma e pajtimit me botën dhe e mospërfilljes ndaj të vërtetave kyçe që kanë të bëjnë me kohën tonë, ekziston dhe është rimëkëmbur në kishat Protestante të të gjithë shteteve të krishtera; dhe këto kisha kanë braktisur në mënyrë të tmerrshme dhe absolute mesazhin e engjëllit të dytë. Megjithatë mohimi i besimit nuk ka arritur akoma kulmin e tij.

Bibla deklaron se përpara ardhjes së Zotit, Satani "do të bëjë gjithfarë mrekullish, shenjash dhe çudish të rreme. Do t'i mashtrojë të gjithë të humburit me anë të magjisë së tij" dhe ata që "nuk e deshën dhe nuk e pranuan të vërtetën që do t'i kishte shpëtuar," "do t'i besojnë gënjeshtrës" - Letra e dytë e Selanukasve 2:3-11. Me t'u vendosur një gjendje e tillë, ku bashkimi i kishës me botën do të mbizotërojë në të gjitha vendet kristiane, do të përfundojë edhe rënia e Babilonisë. Ndryshimi është progresiv dhe përmbushja e plotë e kapitullit 14 tëApokalipsit vera 8 dhe i përket së ardhmes.

Pavarsisht nga errësira shpirtërore dhe moskokçarja për Perëndinë që mbretërojnë në kishat që përbëjnë Babiloninë, trupi i ndjekësve të vërtetë të Krishtit është akoma i lidhur. Ka shumë prej tyre që s'i kanë vënë re kurrë të vërtetat e veçanta të kohës sonë. Jo pak prej tyre janë të pakënaqur nga gjendje në të cilën ndodhen dhe duan me shpirt akoma më shumë dritë. Ata kërkojnë më kot imazhin e Krishtit brenda kishave të cilave u përkasin. Ndërsa hendeku midis këtyre kishave dhe të vërtetëszgjerohej gjithnjë e më tepër dhe ato lidhen akoma më fort me botë, ndryshimi mes këtyre klasave do të thellohet dhe përfundimisht, kjo do të çojë në ndarjen e tyre. Do të vijë një kohë kur ata që e duan Zotin mbi gjithçka tjetër nuk do të mund të qëndrojnë më të lidhur me ata "që duan më shumë kënaqësitë sesa Perëndinë dhe megjithëse ruajnë akoma një formë besimi mohojnë fuqinë që rrjedh prej tij."

Kapitulli 18 i Apokalipsit flet pë kohën kur, për shkak të mohimit të paralajmërimit të trefishtë të Apokalipsit 14:6-18, kisha do të kishte aritur fazën që përshkruhet në mesazhin e engjëllit të dytë dhe popullit të Perëndisë që akoma ndodhej në Babiloni, do t'i jepet botës dhe ëhstë ky mesazh, që do t'i japë fund punës së nisur. Kur ato që "nuk pranuan t'i besonin së vërtetës. por që gjenin kënaqësi në atë që nuk i përgjigjet vullnetit të Perëndisë." (Letra e dytë e Salanikasve 2:12) do të zhgënjehen dhe do t'i besojnë genjeshtrës, drita e të vërtetës do të ndriçojë mbi të gjithë ata, zemrat e të cilëve janë të hapura për ta pranuar atë dhe të gjithë fëmijët e Zotit që kanë mbetur në Babiloni, do të dëgjojnë thirrjen, "Dil prej saj, populli im." (Apokalipsi 18:4).

1. Cila fuqi është e përfaqësuar nga Babilonia tek Zbulesa 17? Cilat janë "bijat" e saj?

2. çfarë lidhje ekziston ndërmjet Krishtit dhe njerëzve të Tij? Çfarë mund ta bëjë këtë lidhje që të prishet?

3. Në vitet 1844, mijëra besimtarë të Krishterë i lanë kishat e tyre. Çfarë ndryshimesh ndodhën në shumë kisha Protestante në SHBA në ato vite?

22.

Profecia e Përmbushur

Me kalimin e kohës, kur mendohej dhe pritej ardhja e dytë e Zotit - pas pranverës së vitit 1844 -ata besonin me gjithë shpirt se Ai do të vinte, kishin arsye që të ndjeheshin të çoroditur dhe të sigurtë. Ndërsa bota i konsideronte këta njerëz të dështuar dhe të zhgënjyer, fjala e Perëndisë mbeti për ta i vetmi burim ngushëllimi. Shumë prej tyre vazhduan t'i besonin me vëmendje Shkrimet e Shenjta duke shqyrtuar sërisht provat e besimit të tyre dhe duke i studiuar me kujdes profecitë për t'u ndriçuar nga drita e tyre. Dëshmitë që sillte Bibla në mbështetje të gjendjes në të cilën ndodheshin ata, ishin të qarta dje vendimtare. Shenja që edhe mund të keqkuptoheshin, tregonin se ardhja e Tij ishte e afërt. Mesazhi që mgante në të vërtetë një bekim të veçantë, që solli shndërim shpirtërortek mekatarët dhe rilindje shpirtërore mes të krishterëve, ishte qiellor. Dhe megjithëse besimtarët nuk i shpjegonin dot arsyet e zhgënjimit që përjetuan, ata ishin të sigurtë se Zoti i kishte udhëhequr përmes përvojës së shkuarës.

Me profecitë që mendohishin mendoheshin se kishin të bënin me kohën e ardhjes së dytë, ndërthureshin udhëzime që i përgjgjeshin veçanërisht gjendjes së pasigurisë dhe ankthit në të cilën ndodheshin ata. Këto profeci u rikthyen atyre guximin për të pritur me durim dhe besim, sepse gjithçka që ishte e paqartë do të bëhej mëse e kuptueshme në kohën e duhur.

Mes këtyre profecive mund të përmëndet ajo e librit të Havakukut 2:1-4. "Unë them: "Zë pozicionin tim dhe qëndroj i patundur. Me padurim pres atë që do të më thotë Zoti; dua të di se si do t'u përgjgjet Ai pyetjeve - dhe padive të mia." Dhe Zoti m'u përgjigjdhe tha: "Atë që po të tregoj tani, duhet ta shkruash hapur në rrasë, me shkrim të qartë, që ta lexojnë të gjithë! Sepse ajo që po të shpall, nuk do të realizohet menjëherë, por do të plotësohet me siguri! Për këtë të jesh i sigurtë. Prit me durim derisa të realizohet! Prandaj shkruaj: "Ai që shkel me këmbë të drejtën, do të rrëzohet; por ai që ma mban besën dhe vepron drejt, do të shpëtojë jetën e tij."

Deri në vitin 1842 porosia vepron drejt, do të shpëtojë jetën e tij "haptas në rrasë me shkrim të qartë atë që po të tregoj tani, që ta lexojnë të gjithë," i dha Charles Titch idenë për të përgatitur një kartë profetike që do të kushtonte vizionet e Danielit dhe të librit të Apokalipsit. Botimi i një karte të tillë u konsiderua si përmbushje e urdhrit të dhënë nga Havakuku. Sidoqoftë, në atë kohë, askush nuk e vuri re që në të njëjtën profeci flitej, për një farë vonese në realizimin e vizionit - "nuk do të realizohet menjëherë." Kjo pjesë e Shkrimit të Shenjtë mori një kuptim të ri pas shgënjimit që përjetuan ata që prisnin me padurim rikthimin e Tij; "Sepse ajo që po të shpall nuk do të ealizohet menjëherë, por do të plotësohet me siguri! Për këtë të jesh i sigurtë. Prit me padurim derisa të realizohet ... ai që ma mban besën dhe vepron drejt, do të shpëtojë jetën e tij."

Edhe një pjesë e profecisë së Jehezkelit ishte burim fuqie dhe ngushëllimi për besimtarët: "Ti, o njeri, çfarë flasin njerëzit tek ju në Izrael? Ata thonë: "Koha vjen dhe shkon, dhe profecitë nuk realizohen të gjitha ato me të cilat ju kanë kanosur profetët e mi ... njeri, po flas Unë, Zot; Dhe çfarë them, realizohet. Nuk vonihet." "Ti, o njeri, për t'y izraelitët për ty thonë: "Vegimet dhe profecitë nuk i përkasin së tashmes, por një të ardhmje të largët." Prandaj përgjigju: Perëndia, Zoti thotë: Ajo që kamshpallur, do të realizohet së shpejti. Ajo që them, do të plotësohet. Kështu them unë, Zoti." Jehezkeli 12-21-25, 27, 28.

Ata që pritnin u gëzuan duke besuar se Ai që di fundin që nga fillimi kishte hedhur vështrimin në shekuj dhe duke parashikuar zhgënjimin e tyre u kishte dhënë shpresë dhe guxim përmes fjalëve të tilla. Sikur të mos ishin pjesë të tilla në Shkrimin e Shenjtë, që i këshillonin ata të prisnin me durim dhe t'i besonin fjalës së Perëndisë, besimi i tyre do të ishte lëkundur gjate asaj are prove.

Edhe parabola e dhjetë vajzave që gjendet tek Kapitulli i 25-të i librit të Mateut ilustron përvojën e Adventistëve. Tek kapitulli 24 i Librit të Mateut në përgjigje të pyetjes që i drejtuan nxënësit; pyetje që kishte të bënte mme shenjat e ardhjes së Tij, Krishti foli për ngjarjet më të rëndësishme që do të ndodhin në historinë e botës dhe të kishës që nga koha e ardhjes së Tij të parë, deri në kohën e ardhjes së Tij të dytë; domethënë për shkatërrimin e Jeruzalemit, për mjerimin që dotë bjerë mbi kishën nga persekutimet pagane dhe të papatit, për errësimin e diellit dhe të hënës dhe për rënien e yjeve. Pas kësaj, Ai tregoi për ardhjen e Tij si mbret duke lidhur këtë fakt me parabolën në të cilën përshkruhen dy llojet e shërbëtorëve që dotë jenë në pritje të shfaqjes së Tij; Kapitulli 25 hapet me fjalët: "Më pas mbretëria e qiellit do të krahasohet me dhjetë vajzat e virgja. Këtu vëmendja përqëndrohet tek kisha e ditëve të fundit, tek e njëjta kishë për të cilën flitet në fund të kapitullit 24. Në këtë parabolë përvoja e kësaj kishe krahasohet me të papriturat e një martese në vendet e Lindjes.

"Më pas mbretëria e qiellit dotë krahasohet me dhjetë vajzat e virgjëra: dhejtë vajza dolën me kandilat e tyre që të pritnindhëndrin. Pesë prej tyre vepruan me

mend, kurse pesë të tjerat jo. Të fundit morën me vete vetëm kandilat, kurse të mençurat morën edhe rezervat e vajit. Meqë dhëndri u vonua, ato u lodhën të gjitha dhe i zuri gjumi. Rreth mesnatës u dha lajmi, "Po vjen dhëndri! Dilni përpara!"

Ardhja e Krishtit, ashtu si paraqitet nga mesazhi i engjëllit të parë, mendohej se përfaqësohej nga ardhja e dhëndrrit. Dalja e virgjëreshave për ta pritur përputhet me transfomimin që solli shpallja e mesazhit të ardhjes së Tij të shpejtë. Në këtë parabolë, ashtu si tek ajo e kapitullit 24 të Mateut, përfaqëson dy grupe. Të gjtha kishin marrë me vete kandilat, Biblën, dhe kishin dalë të ndihmuara nga drita e tyre për të takuar dhëndrin. Por ndërsa "ato që vepruan pa mënd morën me vete vetëm kandilat," "të mençurat morën edhe rezervat e vajit." Grupi i dytë kishte marrë me "vete hirin e Perëndisë, fuqinë rinore dhe ndriçuese të shpirtit të Shenjtë që e bën fjalën e Tij pishtar përpara hapave tanë dhe dritë që ndriçon rrugën tonë. Me respektin për Zotin në zemër, ata i kishin studiuar Shkrimet e Shenjta, për të mësuar të vërtetën dhe kishin kërkuar me zell një jetë të ndershme dhe një zemër të pastër. Ata kishin besim tek Perëndia dhe fjala e Tij dhe përvojë personale e këto, nuk mund të lëkundeshin përpara shgënjimit dhe vonesës. Të tjerët "morën me vete vetëm kandilat." Ata u treguan impulsivë, reaguan sepse u ngacmuan. Mesazhi solemn u ngjalli frikë, por ata u mbështetën tek besimi që ushqenin vëllezërit e tyre, të kënaqur nga zjarri i këtyre emocioneve të reja, por pa e kuptuar plotësisht të vërtetën dhe pa përjetuar një shndërim të vërtetë shpirtëror. Ata dolën që ta prisnin Zotin duke shpresuar se do të shpërbleheshin menjëherë, por nuk ishin gati për ta përballuar zhgënjim apo vonesë. Vështirësitë sollënfundin e besimit dhe shuarjen e dritës së tyre.

"Meqë dhëndri u vonua, ata u lodhën të gjithë dhe i zuri gjum,i. Vonesa e dhëndrit përfaqëson kalimin e kohës në të cilën pritej ardhja e Zotit, zhgenjimin. Gjatë kësaj kohe pasigurie interesi i njerëzve që kishin besuar me gjysëm zemre u lëkund, përpjekjet e tyre u pakësuanl për ata, besimi i të cilëve bazohej tek njohuritë e tyre personale mbi Biblën i kishin këmbët e ngulura mbi një shkëmb të cilin balët e zhgënjimit s'mund ta merrnin me vete. "Ata të gjithë u lodhën dhe i zuri gjumi;" një grup njerëzish po prisnin me durim, rreze të tjera drite. Megjithatë edhe këta të fundit e humbën deri diku zellin dhe përkushtimin që tregonin më parë. Ata që i kishin hyrë rrugës së besimit me gjysëm zemre, nuk mund të mbështeteshin më tek besimi i vëllezërve të tyre. Secili duhet të ecë apo të rrëzohet me këmbët e veta.

Pikërist gjatë kësaj kohe u shfaqën shenjat e para të fanatizmit. Disa prej atyre që pretendonin se e kishin besuar me gjithë shpirt mesazhin, e mohuan fjalën e Perëndisë që është e vetmja udhërrëfyese e pagabueshme, dhe duke deklaruar se ndikoheshin nga Shpirti i Shenjtë." u lanë rrugë të lirë veprimi ndjenjave, përshtypjeve dhe përfytyrimeve të tyre. Pati edhe nga ata që u verbuan nga zelli për të denoncuar të gjithë ata që nuk e përqafuan rrugën e nisur prej tyre. Idetë dhe vepri-

met e tyre fanatike nuk u panë me sy të mirë nga pjesa më e madhe e Adventistëve; por megjithatë ato e dëmtuan kauzën e së vërtetës.

Satani po përgjigjej me këtë mënyrë që ta kundërshtonte e ta shkatërronte punën e Zotit. Lëvizja e ardhjes së dytë kishte pasur një ndikim shumë të madh mbi njerëzit, mijëra mëkatarë kishin përjetuar një shndërim shpirtëror dhe njerëz besnikë iishin përkushtuar punës për ta shpallur të vërtetën edhe gjatë asaj kohe zhgënjimi dhe "vonese". Princi i errësirës po humbiste prenë e vet ... dhe që ta dëmtonte kauzën e drejtë të Zotit, ai u orvat që të mashtronte dhe të nxiste drejt veprimeve ekstremiste disa nga ata që e kishin përqafuar këtë kauzë. Më pas, agjentët e tij qëndronin të gatshëm për të shquar çdo gabim, çdo dështim, çdo veprim të parealizuar dhe për ta ngirtur atë lart përpara syve të njerëzve nën një këndvështrim të ri ... Qëllimi? Urrejtja ndaj Adventistëve dhe besimit të tyre. Kështu, sa më i madh të ishte numri i atyre që e shpallnin se besoni tek ardhja e dytë, por që ia kishin lënë kontrollin e vetvetes në dorë atij, aq më shumë do të përfitonte ai duke i quajtur ata përfaqësues "të denjë" të të gjithë besimtarëve.

Satani është "akuzuesi i vëllezërve" dhe është shpirti i gabimeve dhe të metave njerëzore të Zotit dhe i nxit ata t'u kushtojnë shumë rëndësi këtyre gabimeve, ndërsa ua mbyll sytë përpara veprave të tyre dobiprurëse. Satani bëhet aktiv sa herë që Perëndia punon për shpëtimin e njerëzve. Sa herë që vihet re ndonjë rilindje shpirtërore Ai është gati që të sjellë të gjithë të pakënaqurit dhe të paqëndrueshmit. Dhe kur këta e pranojnë deri diku të vërtetën dhe zënë një vend nderi mes besimtarëve, ai punon përmes tyre për të parashtruar teori që do të mashtrojnë njerëzit mendjelehtë. Askush s'mund të provojë se është një i krishter i vërtetë vetëm sepse shoqërohet me fëmijët e Perëndisë, madje as sepse ndodhet në kishë apo rreth tryezës së Zotit. Satani shfaqet edhe në rastet solemne, në formën e atyre që i përdor si agjentë të tij.

Princi i errësirës i pengon njerëzit e Zotit në çdo metër të udhëtimit të tyre drejt qytetit qiellor. Në historinë e kishësçdo reformacion është ndeshur me pengesa serioze. E njëjta gjë ka ndodhur në kohën e Palit. Kudo ku apostulli ngrinte një kishë të re, kishte njerëz që dukeshin sikur pranonin me gëzim të vërtetën, por që sillnin me vete herezi që po të pranoheshin nga pjesa tjetër e kishës, do t'ia kishin mbyllur derën dashurisë për të vërtetën. Edhe Luteri u çorodit dhe u qetësua nga veprimtaria e disa njerëzve fanatikë, që duke pretenduar se Perëndia kishtee folur drejtpërdrejt me ta, i vendosnin idetë dhe opinionet e tyre mbi dëshminë e Shkrimeve të Shenjta. Shumë njerëz të cilëve u mungonte besimi tek Zoti dhe përvoja, por që kishin besim në vetvete dhe u pëlqente që të dëgjonin dhe të thonin gjëra të reja, u gënjyen nga idetë e "e çmuara" të mësuesve të rinj dhe u bashkuan me agjentët e Satanin për të shkatërruar atë që Perëndia po ndërtonte me anë të Luterit. Edhë vëllezërit Wesleys që falë ndikimt dhe besimit të tyre u kthyen në bekim për botën, i ndeshën

me kruthet e Satanit në çdo hap të punës së tyre; u ndeshën me njerëz të pakënaqur, të paqëndrueshëm dhe xhelozë që ishin edhe fanatikë të tërbuar.

William Milleri i dënonte të gjithë njerëzit që i udhëhiqnin të tjerët drejt fanatizmit. Ashtu si Luteri, edhe ai deklaroi se shpirti duhej të vihej në provë nga fjala e Zotit. "Në ditët tona, - thotë Milleri, - djalli ushtron një ndikim shumë të madh mbi mendjet e disa njerëzve. Por si mund ta kuptojmë se nga cili shpirt ndikohen ata? Bibla na përgjigjet; "Do t'i njihni nga frytet" ... Në botë ka shumë lloje shpirtrash dhe është mirë që t'ia vëmë veshin urdhrit që na jepet për t'i vënë ata në provë. Shpirti që nuk na nxit drejt një jete të ndershme të drejtë dhe serioze nuk mund të jetë Shpirti i Krishtit. Çdo ditë bindem gjithnjë e më shumë se Satani ka gisht në këto lëvizje ... Shumëprej nesh, që pretendojnë një gjë të tillë." - Bless, f 236, 237. "Shpirti i së keqes do na largojë nga e vërteta; ndërsa Shpirti i Zotit do na udhëheqë drejt saj. "Por, - mund të thoni ju, - një njeri mund të gabojë, por të mendojë se po vepron drejt. Çfarë do të bëjmë në këtë rast?" Ne përgjigjemi. "Shpirti përputhet me fjalën. Në qoftë se dikush e gjykon vetveten duke u nusur nga fjala e Perëndisë dhe kupton nga kjo, se sjellja e tij përputhet me përmbajtjen e kësaj fjale, ai duhet të jetë më se i sigurtë se ka përqafuar të vërtetën dhe po vepron drejt por në qoftë se kupton se drejtohet nga një shpirt që nuk përputhet me ligjin apo Librin e Zotit, ai duhet të veprojë me kujdes se për ndryshe djalli do ta zërë në kurth", vol 8, nr 23 (15 Janar 1845). "Shpesh sytë e shpresës, faqet e njomura nga lotët, fjalët e shqiptuara me vështirësi janë prova më bindëse të një përkushtimi shpirtëror, sesa fjalët boshe të të Krishterëve." - Bless, f 282.

Armiqtë e Reformacionit quajtën fajtorë për të këqiat e fanatizmit pikërisht ata që po luftonin me vondosmëri kundër tyre. Të njëjtën rrugë ndoqën edhe kundërshtarët e lëvizjes adventiste. Zmadhimi dhe keqinterpretimi i gabimeve të ekstremistëve dhe fanatikëve nuk u kënaqi e prandaj, përhapën fjalë e thashetheme që ishin kryesisht të rreme. Këta njerëz frymëzoheshin nga urrejtja dhe paragjykimet. Ata humbën qetësinë nga mendimi që ardhja e Jezusit ishte tek pragu i derës. Kishin frikë se kjo mmmos ndodhte kështu, dhe ky konflikt, përbënte sekretin dhe arsyen e luftës së tyre kundër Adventistëve dhe besimit të tyre.

Të mendoje se kjo lëvizje nuk i përkishte Zotit vetëm sepse një numër i vogël fanatikësh mundën të depërtonin në rradhët e Adventistëve, ishte po aq qesharake, sa dënimi që iu bë punës sëPalit dhe Luterit vetëm sepse mes besimtarëvenë kisha, depërtuan edhe mashtrues. Le të ngrihen nga gjumi njerëzit e Zotit, të pendohen dhe të ndryshojnë; le t'i studiojnë Shkrimet e Shenjta që të mësojnë të vërtetën e mishëruar në personin e Jezu Krishtit; le t'i përkushtohen tërësisht Zotit dhe s'do të ketë më nevojë për të provuar se Satani është akoma aktiv dhe vigjilent. Duke thirrur në ndihmë të gjithë engjëjt mëkatarë të mbretërisë së tij, ai e shpreh fuqinë në mashtrim.

Ndarja dhe fanatizmi nuk erdhën nga shpallja e mesazhit të ardhjes së dytë. Këto të çorientuar dhe të shqetësuar përsa i përkiste gjendjes reale në të cilën ndodheshin. Predikimi i mesazhit të engjëllit të praë dhe "lajmit të mesnatës" synonte që në mënyrë të drejtpërdrejtë, t'u priste rrugën fanatizmit dhe mosmarrëveshjeve. Të gjithë ata që morën pjesë në këto lëvizje solemne jetonin në harmoni, duke ushqyer një dashuri të madhe për njëri-tjetrin dhe për Jezusin, të Cilin prisnin që ta shihnin shpejt. Besimi i njëjtë dhe e njëjta shpresë e bekuar, që ngrinin mbi kontrollin e çdo ndikimi njerëzor, ishin mburrje ndaj sulmeve të Satanit.

"Meqë dhëndri u vonua, ato u lodhën të gjitha dhe i zuri gjumi. Rreth mesnatës u dha lajmi: "Po vjen dhëndri! Dilini përpara! Të dhjetë vajzat u zgjuan dhe rregulluan kandilat e tyre." - Mateu 25:5-7. Në verën e vitit 1844, në mes të perudhës kur fillimisht mendohej se do të përfundonin 2670 vjetët dhe në vjeshtë të po atij viti, në kohën kur më pas u kuptua se do të përfundonte kjo periudhë, mesazhi u dha duke përdorur të njëjtat fjalë të Shrimit të Shenjtë: "Po vjen dhëndri!"

U zbulua sekreti i artakserksit për rindërtimin e Jeruzalemit që përbënte edhe fillimin e periudhës 2300 ditore, hyri në fuqi nëvjeshtë të vitit 437 p.e.s dhe jo në fillim të atij viti siç besohej më parë dhe ishte ky zbulim, që çoi në një lëvizje të tillë. Duke u nisur nga vjeshta e vitit 437, periudha 2300 vjeçare përfundon në vjeshtë të vitit 1844.

Simbolet e përdorura në Dhiatën e Vjetër sillnin argumente që tregonin se ngjarja që përfaqësohej nga "rikthimi i rregullit të tempullit" duhet të ndodhte në vjeshtë. Ky fakt u qartësua ndërsa iu kushtua vëmendje mënyrës sesi profecitë që kishin të bënin me ardhjen e parë të Krishtit ishin përmbushur plotësisht.

Therja e qengjit të Pashkës simbolizonte vdekjen e Krishtit. Pali thotë "Pashka jonë që është Krishti u flijua për ne" - Letra e parë e Korintasve 3:7. Vjelja e furtave të para që gjatë Pashkës iu kushtuan Perëndisë, përfaqsonte rigjalljen e Krishtit. Duke folur për ringjalljen e Zotit dhe të të gjithë popullit të Tij, Pali thotë; "Krishti fryti i parë, pastaj ata që janë të Krishtit, në ardhjen e tij." - Letra e Parë e Korintasve 15:23. Si duajt që iu kushtuan Perëndisë që ishin duajt e para të drithit që u mblodhën para të korrave, ashtu edhe Krishti është fryti i parë i atyre të korrave të pavdekshme që do të grumbullohen në hambarin e Zotit në ringjalljen që i përket së ardhmes.

Ngjarjet e përfaqësuara nga këto simbole ndodhen në kohën e paracaktuar. Në ditën e katërmbëdhjetë të muajit çifut, pikërisht në ditën dhe muajin që ishte therrur për pesëmbëdhjetë vjet me rradhë qingji i Pashkaës, Krishti me të ngrënë darkën e Pashkës i hapi rrugen festës së botës". Atë natë, duart tradhëtare e çuan Atë drejt kryqit. Zoti ynë ashtu si duajt e ngritur drejt qiellit, u ngrit nga të vdekurit në ditën e tretë si "fryti i parë i atyre që janë në gjumë", si shembull i ringjalljes së të-drejtëve "trupi i përunjur i të cilëve do të transformohet dhe "do të bëhet i ngjashëm me trupin e tij të lavdishëm" - Versa 20, Filipianët 3:21.

Simbolet që lidhen me ardhjen e dytë do të përmbushen në të njëjtën mënyrë dhe në kohën e paracaktuar në shkrimet profetike. Sipas sistemit që përdori Moisiu Dita e Madhe e Shenjtë, pastrimi i shenjtores u bë në muajin e shtatë, në ditën e dhjetë të muajit, (Kodi Priftëror 16:29-34) kur prifti pasi ofroi shlyerjen për Izraelin duke pastruar kështu shenjtoren nga mëkatet, doli përpara popullit duke pastruar kështu shenjtoren nga mëkatet, doli përpara popullit dhe e bekoi atë. Pra besohej se Krishti, si Kryeprifti ynë, do të vinte për të pastruar botën duke shkatërruar mëkatin dhe mëkatarët dhe për të bekuar njerëzit që e prisnin me dhuratën e pavdekshmërisë. 22 Tetori i vitit 1844 që përkonte me dityën e dhjetë të muajit të shtatë, me kohën e pastrimit të shenjtores ditën e madhe të Shlyerdjes - u mendua të ishte koha e ardhjes së zotit. Kjo përputhej me provat e tjera që i kemi përmendur më parë. Periudha 3200 ditëshe do të përfundonte në vjeshtë të po atij viti. Argumentet ishin bindëse, konkluzioni i pamohueshëm.

Në parabolën e kapitullit 25 të Librit të Mateut koha e pritjes dhe dremitja pasoheshin nga ardhja e dëndrit. Kjo përputhej me argumentet e nxjerra vërtetësinë e tyre; dhe mijëra besimtarë dhanë "lajmin e mesnatës".

Levizja përfshiu gjithë botën mbarë si një dallgë e fuqishme oqeani. Shkoi nga qyteti në qytet, nga krahina në krahinë deri në fshatrat më të largët, duke i zgjuar nga gjumi njerëzit e Zotit. Shpallja e këtij lajmi i dha fund fanatizmit ashtu si rrezet e diellit shkrijnë borën e parë. Besimtarët i harruandyshimet dhe çoroditjen dhe zemrat e tyre i ngrohu shpresa dhe i fisnikëroi guximi. Ata hoqën dorë nga veprimet ekstremiste që lindin sa herë që ndjenjat njerëzore dalin jashtë kontrollit dobiprurës të fjalës dhe Shpirtit të Perëndisë. Ky ndryshim ishte i ngjashëm me ato periudha përuljeje dhe rilindjeje besimi që pasonin mesazhet qortuese të shërbëtorëve të Zotit mes Izraelitëve të hershëm. Ai reflektonte karatrerin e punës së Perëndisë që manifestohen në shekuj. Nuk vihej re një shprehje e ekzagjeruar gëzimi, Por njerëzit ishin të gatshëm që të rrëfenin mëkatet e tyre, ta braktisnin botën dhe të pastronin kështu zemrat e tyre. Shpirtrat njerëzorë po orvateshin që të bëheshin gati për takimin me Zotin, duke u lutur me këmbëngulje dhe duke iu përkushtuar Atij plotësisht.

Duke përshkruar gjendjen e krijuar Milleri tha: "Gëzimi nuk shprehej plotësisht. Dukej sikur njerëzit ndryshonin atë brënda zemrave të tyre për të pritur atë çast në të ardhmen, kur qielli dhe bota do të ngazëlloheshin së bashku në një lavdi dhe gëzim të papërshkrueshëm. Askush nuk brohoret; edhe në këtë rast pritet brohoritja që dotë dëgjohet nga qielli. Këngëtarët heshtin; ata presin që të bashkojnë zërat me engjëjt, korin qiellor ... Të gjithë jetojnë në paqe duke qënë një, me zemër dhe me mendje." - Bless, f270, 271.

Një dëshmitar tjetër i kësaj lëvizje dëshmon kështu: "Ajo (lëvizja) krijoi kudo një gjendje rilindjeje dhe përuljeje përpara Perëndisë së Plotfuqishëm të qiellit. Njerëzit falë saj, hoqën dorë nga gjërat e kësaj bote, u dhanë fund armiqësive dhe

kontradiktave të vjetra, rrëfuen mëkatet e tyre dhe iu përkushtuan Zotit duke iu lutur të penduar për falje dhe pranim. Asnjëherë më parë nuk kishin parë përulje dhe thjeshtësi tëtillë. Ashtu si deklaroi Perëndia me anë të Joelit (2:12), afrimi i ditës së ardhjes së Tij do të sillte "grisje zemrash e jo rrobash dhe një rikthim tek Ai me agjërime, me lot dhe me vuajtje". Ashtu ndodhi. Ashtu si tha Zoti me anë të Zakarisë fëmijët e Tij i mbështolli fryma e mëshirës dhe lutjes; ata gjetën Atë që dikur e kishin gozhduar në kryq dhe vajtuan ... Ata që po e pritnin me padurim ia dorëzuan Atij shpirtrat e tyre të trazuar." - Bless, Në "Advent Shield and Review", Vol 1, f271 (Janar 1843).

Lëvizja e vjeshtës së vitit 1844 ka një vend të veçantë mes lëvizjeve të tjera fetare si e vetmja, që ka qënë më pak e cënuar nga gabimet njerëzore dhe nga kurthet e Satanit. Madje edhe sot e kësaj dite, pas vitesh me rradhë, të gjithë ata që morën pjesë në atë lëvizje dhe qëndruan të papërkulur në podiumin e së vërtetës, e ndjenë akoma ndikimin dobiprurës të asaj pune të bekuar dhe dëshmojnë se ajo drejtohej nga vetë Zoti.

Me të dëgjuar lajmin: "Po vjen dhëndri. Dilini përpara!", ata që po prisnin "u zgjuan dhe rregulluan kandilat e tyre"; studiuan fjalën e Perëndisë me një interes dhe një ntensitet që s'e kishin pasur më parë. Engjëj u dërguan nga qielli që t'i zgjonin ata që ishin të dekurajuar dhe t'i përgatisnin që ta pranonin këtë mesazh. Puna nuk drejtohej nga zgjuarsia dhe dituria e njerëzve, por nga fuqia e Zotit. Të parët që e dëgjuan dhe iu bindën thirrjes muk ishin njerëzit më të ditur, por më të përulurit dhe më të devotshmit. Fermerët i lanë drithrat pa korrurnë fusha, mekanikët braktisën veglat e tyre të punës dhe me lot gëzimi në sy nisën punën për të paralajmëruar botën. Ata që dikur ishin të parët në udhëheqjen e kësaj kauze, u bashkuan të të fundit me këtë lëvizje. Përgjithësisht dyert e kishave u mbyllën përparakëtij mesazhi dhe një numër i madh njerëzish që e pranuan atë, u detyruan të largoheshin prej tyre. Me ndihmën e kujdesin e Zotit shpallja e këtij mesazhi u bashkua me mesazhin e engjëllit të dytë dhe kjo e fuqizoi akoma dhe edhe më shumë punën e nisur.

Edhe pse Shkrimi i Shenjtë ishte i qartë në këtë pikë, Mesazhi "Po vjen dhëndri!" nuk u konsiderua thjesht si argument bindjeje. Ai mbante në vetvete një fuqi nxitëse që prekte shpirtin. S'kishte as dyshime dhe as mëdyshje. Me rastin e hyrjes triumfuese të Krishtit në Jeruzalem njerëz nga vende të ndryshme u bashkuan me turmën drejt Malit të Ullinjve, dhe ndërsa shoqëronin Jezusin ata ndjenë rëndësinë e momentit dhe kjo i frymëzoi që të bashkonin zërat me të tjerët që thërrisnin: "Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit!" - Mateu 21:9. Në të njëjtën mënyrë jobesimtarët që morën pjesë në takomet e Adventistëve për arsye të ndryshme - disa nga kurioziteti e disa të tjerë vetëm për t'u tallur -ndjenë fuqinë bindëse që mbante mesazhi: "Po vjen dhëndri!"

Gjatë asaj kohe ishte besimi që solli përgjgjet e lutjeve; besim që ushqente respekt për kompensimin që do t'u jepte shpërblime Shpirti i mëshirës zbriti mbi ata që po kërkonin me zell si shiu që bjen mbi tokën e thatë. Ata që prisnin me padurim të qëndronin ballë për ballë me Shpëtimtarin e tyre, përjetonin në vetvete një gëzim solemn që s'mund të përshkruhej. Ndërsa njerëzve besnikë e të devotshëm iu dhuruan bekime pafund, fuqia zbutëse dhe kontrolluese e Shpirtit të Shenjtë shkriu zemrat e tyre.

Erdhi një kohë kur të gjithë ata që e kishin dëgjuar mesazhin shpresonin që ta takonin shpejt Zotin etyre. Çdo mëngjes, ata përpiqeshin që të kishin sigurinë e plotë që Perëndia i kishte pranuar. Ndjeheshin kaq pranë njëri-tjetrit dhe luteshin tëgjithë baskë për miqtë dhe të afërmit e tyre. Shpesh takoheshin në vende të veçuara për të biseduar me Zotin dhe zëri i tyre ngrihej drej qiellit nga fushat dhe korijat. Miratimi i Perëndisë ishte për ta më i nevojshëm se ushqimi i përditshëm; dhe në qoftë se një re dyshimi errësonte mendjet e tyre, ata s'gjenin qetësi derisa ajo të largohej. Duke qënë se ata vetë ishin dëshmitarë të mëshirës dhe faljes së Tij, dëshironin me gjithë zemër që ta shoihnin me sy atë që e donin aq shumë.

Por ishin përsëri të dëshiruar të zhgënjeheshin. Kaloi edhe koha e pritjes së madhe por SHpëtimtari nuk u duke gjëkundi. Ata e kishin pritur me padurim dhe me besim të patundur ardhjen e Tij dhe tani ndjeheshn si Maria që kur erdhi tek varri i Shpëtimtarit dhe e gjeti atë bosh, thirri me lot në sy: "E kanë hequr Zotin tim, dhe nuk e di ku e kanë vënë." - Gjoni 20:13.

Një ndjenjë zilie dhe frike se mesazhi mund të ishte i vërtetë, e stepi për një farë kohe botën që s'besonte. Dhe kjo ndjenjë nuk u zhduk menjëherë pas kalimit të kohës së caktuar; fillimisht jobesimtarët nuk guxonin që të shpallnin fitore mbi të zhgënjyerit; por me të parë se s'kishte asnjë shenjë zemërimi nga ana e Perëndisë, ata e flakën tej frikën dhe ia nisën përsëri qortiv-meve dhe talljeve. Një grup i madh njerëzish, që dikur deklaronin se besonin tek ardhja e shpejtë e Zotit, hoqën dorë nga besimi që ushqenin. Krenaria e disa të tjerëve që kishin qënë të bindur për këtë gjë, ishte plagosur kaq keq, sa ata donin të fshiheshin nga bota. Filluan t'i ankohehsin Zotit dhe zgjodhën si Jona, vdekjen. Të tjerët që e kishin bazuar besimin e tyre mbi opinianet e të tjerëve dhe jo mbi fjalën e Perëndisë, ishin gati që t'i ndryshonin përsëri pikëpamjet e tyre. Ata që talleshin me zhgënjimin e të tjerëve, i bindën të dobëtit dhe frikacakët qëtë bashkoheshin me ta së bashku deklaruan se tashmë ishin të kota frika, ashtu edhe pritja. Koha e caktuar kishte kaluar, Zoti s'kishte ardhur dhe bota mund të mos ndryshonte për mijëra vjet.

Besimtarët e etur dhe të sinqertë kishin braktisur gjithçka për Krishtin dhe e kishin ndjerë praninë e Tij si kurrë më parë. Ata besonin se e kishin paralajmëruar botën për të fundit herë; dhe duke pritur që të qëndronin në shoqëri me Mësuesin dhe engjëjt hyjnorë, ishin tërhequr deri diku nga shoqëria e atyre që nuk kishin

pranuar mesazhin e ardhjes. Me një dëshirë të zjarrtë në zemër ata ishin lutur; "Eja o Zoti Jezus, eja shpejt!" Por Ai s'kishte ardhur. Dhe tani atyre do t'u duhej të mbanin përsëri barrën e rëndë të vështirësive dhe shqetësimeve të jetës dhe të duronin talljet dhe ngërdheshjet e botës dhe kjo ishte një provë e tmerrshme besimi dhe durimi.

Megithatë nxënësit e Krishtit gjatë ardhjes së Tij të parë, përjetuan një zhgënjim akoma edhe më të madh. Me të parë hyrjen e Tij triumfuese në Jeruzalem, nxënësit e tij besuan se Ai do të ulej në fronin e Davidit dhe do ta çlironte Izarelin nga armiqtë e tij. Me shpresa të mëdha dhe parandjenja të gëzueshme në zemër, ata u përpoqën kush e kush më parë ta nderonin Mretin e tyre. Shumë prej tyre ia shtruan petkat e tyre si qilim nën këmbë ose hodhën degë të lulëzuara palmash përpara Tij. U bashkua me gëzim dhe entuziazëm në thirrjen: "Hosana o Bir i Davidit!" dhe kur Farisenjtë, të shqetësuar dhe të inatosur nga kjo britmë gëzimi i thanë Jezusit që t'i qortonte nxënësit e Tij, Ai iu përgjigj: "Unë po ju them se nëse këta do të heshtin, gurët do të bërtisnin." - Luka 29:40. Profecia duhet të përmbushet. Nxënësit po realizonin qëllimin e Perëndisë, por mmegjithatë ata ishin të destinuar që të zhgënjeheshin. Vetëm pas pak ditësh, ata panë mesytë e tyre vdekjen e dhimbshme të Shpëtimtarit dhe e varrosën Atë. Parashkimet nuk u realizuan dhe shpresat e tyre vdiqën bashkë me Jezusin. Ata e kuptuan vetëm pas ngritjes triumfuese të Zotit të tyre nga varri, se gjithçka ishte parashkiuar në profeci dhe se "Krishti duhej të vuante dhe të ringjej prej të vdekurish." - Veprat e Apostujve 17:3.

Pesëqind vjet më parë Zoti nëpërmjet Zakarisë kishte deklaruar: "Ngazëllo me të madhe, o bijë e Sionit, lësho britma gëzimi, o bijë e Jeruzalemit! Ja mbreti yt po vjen; ai është i drejtë dhe sjell shpëtimin, i përulur dhe i hypur mbi një gomar, mbi një gomar të ri." Zakaria 9:9. Sikur ta dinin nxënësit se Krishti do të gjykohej dhe do të dënohej me vdekje, ata nuk do të mund ta përmbushnin dot këtë profeci. Milleri dhe bashkëkohësit e tij përmbushën në të njëjtën mënyrë një profeci dhe shpallën një mesazh që parashikohej që do t'i jepej botës falë frymëzimit të Shkrimit të Shenjtë; mesazh që s'do të mund ta shpallin kurrë sikur të kishin kuptuar plotësisht profecitë që paratregonin qartë zhgënjimin e tyre dhe parashikonin idenë e predikimit të një mesazhi të dytë përpara ardhjes së Zotit. Mesazhet e engjëllit të parë dhe të dytë iu shpallën botës në momentin e duhur, duke kryer kështu punën për të cilën Perëndia i kishte skicuar.

Bota kishte vëzhguar me kujdes, duke menduar se sistemit Adventist do t'i vinte fundi sikur të kalonte koha e caktuar dhe Krishti të mos dukej gjëkundi. Por megjithëse një numër i madh njerëzish u tunduan dhe hoqën dorë nga besimi i tyre, disa të tjerë nuj u përkulën. Frytet e kësaj lëvizje si fryma e përuljes, shndërrimi shpirtëror, braktisja e botës dhe ndryshimi i mënyrës së jetesës, dëshmonin se në drejtimin e saj ndjehej dora ePerëndisë. Ata nuk guxonin ta mohonin dëshminë e Shpirtit të Shenjtë gjatë predikimeve mbi ardhjen e dytë dhe nuk mund të shquanin

asnjë gabim në llogaritjet e periudhave profetike. Madje as më i dituri nga kundërshtarët e tyre, nuk kishte mundur ta hidhte poshtë sistemin e tyre të interpretimit profetik. Pa pasur prova biblike ata nuk mund të hiqnin dorë nga konkuzione që i kishin arritur nëpërmjet lutjeve dhe një studimi t zellshëm të Biblës, me mendje të ndriçuara nga Shpirti i Perëndisë dhe zemra që digjeshin nga fuqia e tij jetëdhënëse; konkluzione dhe qëndrime që kishin ngjallur kritikat më të ashpra dhe kundërshtimin më të rreptë të msuesve fetarë më të njohur dhe të njerëzve më të zjguar të kësaj bote, që kishin përballuar vendosmërisht forcat e bashkuara të të diturve dhe oratorëve, talljet dhe sharjet si të njerëzve të respektueshëm, ashtu edhe të njerëzve të ulët.

Ashtu është, ata dështuan në lidhje mme kohën e ngjarjes, por as ky dështim nuk e lëkundi besimin e tyre tek fjala e Perëndisë. Kur Jona shpalli në rrugët e qytetit Ninive se qytetit i kishin mbetur vetëm dyzet ditë jetë dhe Niniveasit u përulën përpara Zotit, Ai pranoi poshtërimin që ata i bënë vetes dhe ia zjgati jetëgjatësinë qytetit, megjithatë ishte vetë Perëndia që e dërgoi këtë mesazh nëpërmjet Jonës dhe qyteti i Ninivës u by në provë sipas vullnetit të Tij Adventist besonin se Zoti në të njëjtën mënyrë për të paralajmëruar botën për gjykimin e afërt. "Ky paralajmërim, - deklaruan ata" - 0 ka vënë në provë zemrat e të gjithë atyre njerëzve që e kanë dëgjuar atë dhe ka zjguar dashurinë për ardhjen e Zotit; ose i ka dhënë shkas shprehjes së një urrejtje që Perëndia e njeh mirë, në lidhje me këtë ardhje. La skicuar një vijë ... kështu që ata që do të duan të gjykojnëzemrat e tyre ta dinë se nga cila anë e kësaj vije do të kishin qenë në qoftë se Zoti do të kishte adhur në atë kohë, ta dinë nëse do të kishin thirrur "Ja! Ky është Zoti ynë, e kemi pritur dhe Ai do të na shpëtojë;" apo do t'u ishin drejtuar shkëmbinjve dhe maleve që të binin mbi ta për t'i fshehur nga prania e atij që rri ulur mbi fron nga zemërimi i Qengjit. Kështu ne jemi të bindur që Peëndia ka vënë në provë njerëzit e Tij, ka provuar besimin e tyre, ata vetë, për të parë nëse do të dridheshin frike në kohë të vështira dhe nga gjendja në cilën Ai e ka parë të arsyeshme t'i vendosë; dhe nëse do të hiqnin dorë nga kjo botë për t'u mbështetur me besim të patundur tek fjala e Perëndisë." - "The Adventist Herald and Sing of TImes Reporter", Vol 8, N 14 (13 Nëntor 1844).

Fjalët e William Millerit shprehin më së miri ndjenjat e të gjithë atyre që besonin se Perëndia i kishte udhëhequr gjatë përvojave të së kaluarës: "Sikur të kisha mundësi që ta filloja jetën nga e para duke pasur të njëjtat prova që kam tani, që të jem i sinqertë përpara Zotit dhe njerëzve, duhet të them se do të bëja përsëri gjithshka që kam bërë deri tani." "Shpresoj të mos i kem duart të lara me gjak dhe mund t'ju siguroj se brenda fuqive të mmia jam përpjekur të mos dënoj njeri." Edhe ose jam mërzitur dhe as nuk jam dekurajuar ... Shpresoj tek ardhja e Krishtit me të njëjtën forcë si më parë. Kam bërë vetëm atë që pas vietsh të gjata mendimi dhe gjykimi e ndjeja si detyrën time solemne. E në qoftë se mirësia, dashura për të

tjerët dhe kryerja e detyrës përpara Zotit quhen gabime, atëherë kam gabuar asgjë më shumë nga ajo që besoja; Zoti ka qënë me mua; puna është ndikuar nga fuqia e Tij dhe nga kjo kanë rrjedhur shumë të mira." "Siç dihet me mijëra njerëz filluan studimin e Shkrimeve tëShenjta falë predikimeve të kohës, dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet besimit dhe gjakur të Krishtit ata u ripajtuan me Perëndinë." - Bless, f 236, 255, 277, 280, 281. "Nuk kam kërkuar kurrë buzëqeshjet e njerëzve kryeneçë dhe nuk jam dridhur frike përpara pakënaqësisë së botës. Tani nuk dua të blej simpatinë e tyre, por as të mos e koloj kufirin duke ngjallur kështu urrjetjen e tyre. Nuk do t'ua dorëzoj atyre jetën time, por shpresoj gjithashtu se do të jem i gatshëm ta humb atë, nëse kështu do Zoti." - J. White, "Life of Wm. Miller", f 315.

Perëndia nuk i harroi njerëzit e Tij, Shpirti i Shenjtë vazhdoi të qëndronte me ata që nuk mohuan dritën që kishin pranuar dikur dhe nuk hoqën dorë nga lëvizja për ardhjen e dytë. Fjalët inkurajuese dhe paralajmëruese të Letrës së Hebrenjve u drejtoheshin në atë kohë krize atyre që vazhduan të pritnin edhe pas zhgënjimit që përjetuan: "Mos hidhni tej guximin tuaj, që do të ketë një shpërblim të madh. Sepse ju keni nevojë për ngulm që mbasi të bëni vullnetin e Perëndisë, të merrni gjërat e premtuara. Edhe pak kohë, edhe ai që duhet të vijë do të vijë dhe nuk ddo të vonojë. Dhe i drejti do të jetojë prej besimit; por në qoftë se ndokush tërhiqet prapa, shpirti im nuk do të gjejë pëlqim në të." Por ne nuk jemi nga ata që tërhiqen prapa për humbje, por ata që besojnë në shpëtimin e shpirtit." - Letra e Hebrenjve10:35-39.

Fjalët që kanë te bëjnë me ardhjen e shpejtë të Zotit, tregojnë qartë se ky paralajmërim i drejtohet kishës së kohës së fundit. "Edhe pak shprehet gjithashtu qartë ideja se do të duket sikur Ai do të vonohet. Përmbajtja e këtij pasazhi përputhet me përvojën e Adventistëve të parë. Besimi i njerëzve të cilëve iu drejtohej, ishte në rrezik. Ata kishin përbushur vullnetin ePerëndisë duke ndjekur dritën e fjalës dhe fuqinë e Shpirtit të Tij; e megjithatë s'mund ta kuptonin qëllimin që kishte realizuar Zoti me anë të përvojës së tyre të shkuar, ashtu si nuk mund të shquanin ndonjë shteg të hapur para tyre ... dhe kjo gjendje mund t'i shtynte ata që të dyshonin tek udhëheqja e Zotit gjatë kësaj lëvizje. Në këtë kohë fjalët: "I drejti do të jetojë prej besimit" merrnin një rëndësi të veçantë. Ata deri tani kishin ecur me anë të dritës që "lajmi i mesnatës" kishte hedhur në shtegun e hapur për ta, duke kuptuar profecitë dhe duke parë shenjat që tregonin se ardhja e Krishtit ishte e afërt. Por tani, të dërmuar dhe të zhgënjyer ata mund të gjenin ngushëllim vetëm në besimin te Perëndia dhe fjala e Tij. Bota duke i vënë në lojë ju thotë: "Jeni mashtruar. Hiqni dorë nga besimi juaj dhe pranoni që lëvizja për ardhjen e dytë u drejtua nga Satani." Por fjala e Zotit ngulmonte: "Në qoftë se dikush tërhiqet prapa, shpirti im nuk do të gjejë pëlqim në të." Heqja dorë nga besimi dhe mohimi i fuqisë së Shpirtit të Shenjtë që shoqëroi këtë mesazh, do të thoshte tërheqje dhe humbje. Ata u inkurajuan dhe

gjetën tek fjalët e palit forcën për të qëndruar të papërkulur: "Mos e hidhni tej guximin tuaj" "Keni nevojë për ngulm," "edhe pak kohë, edhe ai që duhet të vijë do të vijë dhe nuk do të vonojë." Rruga e vetme dhe e sigurtë që duhet të ndiqnin ishte që duke mbajtur gjallë dritën që u kishte dhënë Perëndia, duke u kapur fort pas premtimeve të Tij dhe duke vazhduar studimin e Shkrimeve të Shenjta, të prisnin me durim rrezet e tjera të dritës.

1. Si paralelizohet parabola e dhjetë virgjëreshave tek Mateu 25:1-20, me eksperiencën e Adventistëve Milleritë në 1844? Cila është pika kyçe e kësaj parabole?

2. Shpallja e "Klithmës së Mesnatës" nga Adventistët gjatë verës së 1844 pushtoi gjithë Amerikën e Veriut. Cili ishte efekti saj? Si u shfaq fuqia e Perëndisë?

3. Krahasoni eksperiencën e Adventistëve në vjeshtën e 1844 me eksperiencën e dishepujve të Krishtit pasi Ai u kryqëzua. Në çfarë dimensioni ngjasojnë?

4. Edhe pse Jezusi nuk u kthye në 1844, çfarë përfitimesh pasuan zhgënjimin?

23.

Çfarë është Shenjtërorja?

Thënia e kapitullit të tetë të Danielit versa 14: "Deri dymijë e treqind ditë; pastaj shenjtorja do të pastrohet", përbënte si themelin, ashtu edhe kolonën qëndrore të besimit adventist. Të gjithë ata që besonin tek ardhja e shpejtë e Zotit i dinin këto fjalë përmëndësh. Të gjithë ata mendonin se nga ngjarjet që parashikonin në të, vareshin shpresat e tyre më të zjarrta dhe ëndrrat e tyre më te bukura. Kemi treguar më sipër se këto ditë profetike mendoheshin se do të përfundonin në vitin 1844. Adventistët ishin të mendimit, ashtu si të gjithë të krishterëty e tjerë, se bota apo një pjesë e saj, përbënin shenjtore. Mendohej gjithashtu se pastrimi i shenjtores përfaqsonte pastrimin e tokës me anë të zjarreve të ditës së fundit dhe se kjo gjë, do të ndodhte gjatë ardhjes së dytë. Nga kjo u arrit në konkluzionin se Krishti do të rikthehej në tokë në vitin 1844.

Por koha e caktuar dhe Zoti nuk u duk gjikundi. Besimtarët e dinin se fjala e Perëndisë ishte e pagabueshme; gabimi duhej të qëndronte tek interpretimi duhej të qëndronte tek interpretimi që ata i kishin bërë profecisë; por ku qëndronte ky gabim vallë. Shumë njerëz e zgjidhën problemin duke deklaruar se 2300 ditët nuk përfundonin në vitin 1844. Ata s'dhanë asnjë në mbështetje të kësaj teze, përveç faktit se Krishti nuk kishte ardhur në kohën që ata e pritnin të vinte. Ata arsyetonin kështu: sikur ditët profetike të kishin përfunduar në vitin 1844, Krishti do të ishte rikthyer për ta pastruar shenjtoren me anë të zjarrit; pra, meqë Ai nuk kishte ardhur, periudha 2300 ditore (vjetroe nuk kishte përfunduar).

Pranimi i një konkluzioni të tillë do të thoshte një gabim nëllogaritjen e parë të periudhave profetike. U zbulua se 2300 ditët fillonin me dekretin e Artakserksit për restauriin dhe ndërtimin e Jeruzalemit që hyri në fuqi në vjeshtë të vitit 457 p.e.s. Duke marrë këtë datë si pikënisjen e kësaj periudhe, të gjitha ngjarjet e parashikuara në të tek Libri i Danielit 9:25-27 përputheshin me realitetin. Gjashtëdhjetë e nëntë javët, 483 vjetët e parë të periudhës 2300 vjeçare duhet të përfundonin me Mesinë,

Të Shuguruarin; dhe fakti që Krishti u pagëzua plotësisht këtë hollësi. Në mes të javës së shtatëmbëdhjetë duhej të vritej. Në pramverë të vitit 31 e.s ter vjet e gjysëm pas pagëzimit të Tij, Krishti u kryqëzua. Sidoqoftë javët apo 430 vjetët i përkisnin veçanërisht çifutëve. Në fund të kësaj periudhe ky komb vulosi mohimin e Krishtit duke persekutuar nxënësit e Tij dhe kështu në vitin 34 e.s" Me oërfundimin e 430 viteve të para të oeriudhës 2360 vjeçare mbeteshin vetëm 1810 vjet. Nga viti 34 e.s periudha 1810 vjeçare shkonte deri në vitin 1844. "Pastaj, - tha engjëlli, - shenjtorja do të pastrohet." Të gjitha hollësitë e profecitë ishin përmbushur pa asnjë dyshim në kohën e caktuar.

Duke u bazuar në një llogaritje të tillë gjithshka ishte më se e qartë dhe harmonike, përveç faktit që në vitin 1844 nuk kishte ndodhur asgjë që të korespondonte me pastrimin e shenjtores. Të hidhje poshtë konkluzionin se ditët profetike nuk përfundonin në atë kohë, do të thoshte të çrregulloje gjithçka dhe të braktisje qëndrime, që ishin arritur falë përmbysjes së plotë të profecisë.

Por ishte Zoti që i kishte udhëhequr njerëzit e Tij gjatë lëvizjes së ardhjes së dytë; fuqia dhe lavdia e Tij kishin qenë pjesë e punës së nisur dhe s'mund të lejonte që kjo përpjekje të përfundonte në errësirë dhe zhgënjim të plotë dhe konsiderohej si një lëvizje e rreme dhe fanatike. Ai s'mund të lejonte që tëdyshohej tek fjala e Tij. Megjithëse shumë njerëz hoqën dorë nga llogaritja e parë dhe mohuan sakitësinë e lëvizjes që bazohej tek ajo, të tjerët nuk donin të braktisnin pika të rëndësishme të besimit dhe përvojës së tyre që mbështeteshin gjatë studimit të profecive, dhe e quanin si detyrë ruajtjen e të vërtetave që kishin zbuluar dhe vazhdimin e kërkimeve Beblike. Ata rishikuan pozitën e tyre dhe duke u lutur studiuan Shkrimet e Shenjta për të kuptuar se ku kishin gabuar. Duke qënë se nuk gjetën asnjë gabim në llogaritjen që u kishin bërë periudhave profetike, ata u detyruan që të shqyrtonin më më kujdes problemin e shenjtores.

Falë kërkimeve të tyre ata zbuluan se nuk ekzistonte asnjë provë Biblike në mbështetje të pikëpamjes popullore sipas të cilës, shenjtorja përfaqësonte tokën; por gjetën në Bibël shpjegimin e plotë mbi temën e shenjtores, natyrën, vendosjen dhe shërbimet që mund të kryen në të; shpjegim që ishte aq i qartë dhe i mjaftueshëm, saqë ua fshehu atyre çdo dyshim. Apostulli Pal shkruan në Letrën e hebrenjve kështu; "Sigurisht edhe e para Beslidhje kishte disa rregulla për shërbesën hyjnore dhe për shenjtoren tokësore. Sepse u ndërtua për shërbesën hyjnore dhe për shenjtoren tokësore. Sepse u ndërtua një tabernakull i parë, në të cilin ishte shandani, tryeza dge bukët e paraqitjes; ai quhet "Vendi i Shenjtë". Pas vitit të dytë ishte tabernakulli i quajtur "Vendi shumë i shenjtë" (Shenjtorja e Shenjtoreve) që përmbante një tymtore prej ari edhe arkën e Beslidhjes, të mbuluar nga të gjitha anët me ar, në të cilën ishte një enë e artë me manë, shkopi i Araonit që kishte mbuluar edhe rrasat e Beslidhjes. Edhe sipër saj ishin kerubinet e lavdisë që i bënin hije pajtuesit." - Letra e Hebrenjve 9:1-5.

Pali i referohet këtu tabernakullit që Moisiu e ndërtoi sipasurdhrit të Perëndisë dhe që do të shërbente si vend qëndrimi për Të Lartin.

Ndërsa Moisiu ishte në mal me Zotin, Ai e urdhëroi; "Le të më bëjnë një shenjtore, që unë të banoj në mes tyre." (Eksodi 25:8). Në atë kohë izrelitët po e udhëtonin përmes shkretëtirës dhe tabernakulli u ndërtua në një mënyrë të tillë që të ishte e lehtë për ta zhvendosur në vende të ndryshme; e megjithatë, ishte një objekt madhështor. Muret e tij ishin të larta, të punuara me dru, të veshura me pllaka ari dhe të derdhura në zgavra argjendi, ndërsa tabernakulli përbëhej nga perde apo mbulesa; nga të cilat, perdet e jashtme ishin punuar me lesh dhie, ndërsa të brendshmet ishin të përhurta liri të veshura me herubinë të punuar artistikisht. Përveç oborrit të jashtëm në të cilin ndodhje altari ku digjeshin flijimet, vetë tabernakulli përbëhej nga dy pjesë që quheshin "Vendi i shenjtë" dhe "Vendi shumë i shenjtë" që ndaheshin nga një perde e bukur apo një vel; hyrja për tek vendi i parë mbyllet nga një vel i njëjtë.

Në jug të "vendit të Shenjtë" ndodhej shandani me shtatë llamba që ndriçonin shenjtoren ditë e natë, në veri tryeza e bukës së paraqitjes dhe përpara vitit që ndante "Vendin e Shenjtë" nga "Vendi shumë i Shenjtë" gjendej altari i artë i temjanit, nga ku çdo ditë përpara Zotit do të ngrihej akoma temjanit të parfumuar me lutjet e popullit të Izraelit.

Në "Vendin shumë të shenjtë" qëndronte arka, një sënduk i punuar me dru të çmuar dhe i larë me ar, vendmbajtja e dy rrasave të gurit mbi të cilat vetë Perëndia pati shkruar ligjin e Dhjetë Urdhëresave. Mbii arkë ndodhej pajtuesi (vendi i mëshirës) që formonte edhe mbulesën e arkës; një punim i mrekullueshëm, i rrethuar nga dy herubinë në të dy skajet e pajtuesit. Gjithçkae punuar në ar. Midis herubinëve sfaqej vetë Zoti në një re lavdie.

Me vendosjen e Çifutëve në Kanaan, vendin e tabernakullit e zuri tempulli që ndërtoi Solomoni, që edhe pse u vendos mbi shkallë më të mëdha dhe u kthye në një ndërtesë të qëndrueshme[1] ruajti të njëjtat përmasa dhe u mobilua në të njëjtën mënyrë Shenjtorja përveç gjatë kohës ekzistoi në një formë të tillë, derisa u shkatërrua nga Romakët në vitin 70 e.s.

Kjo ishte e vetmja shenjtore që përmendet në Bibël dhe që ekzistuar mbi tokë. Pali deklaroi se ajo ishte shenjtorja e beslidhjes së parë. Po beslidhja e re s'ka shenjtore?

Ata që ishin në kërkim të së vërtetës zbuluan duke iu rikthyer Letrës së Hebrenjve, se ekzistenca e nje shenjtorjeje të beslidhjes së dytë kishte gjithashtu disa rregulla përshërbesën hyjnore dhe për shenjtoren tokësore." Përdorimi i fjalës "gjithashtu" i bëri ata të mendoni se Pali e kishte përmendur më parë idenë e një shenjtorjeje. Duke iu rikthyerfillimit të një kapitulli më parë, ata lexuan: "Dhe pika kryesore e atyre gjërave që po thimi është kjo; ne kemi një kryeprift të tillë i cili qëndron në të

djathtën e fronit të Madhërisë në qiejt, shërbenjës i shenjtores dhe tabernakullit të vërtetë, të cilin e ngriti Perëndia e jo njeriu." - Letra e Hebrenjve 8:1, 2.

Këtu zbulohet shenjtorja e beslidhjes së re. shenjtorja e beslidhjes së parë u ngrit nga njerëzit, atë e ndërtoi Moisiu; kjo u ngrit nga Perëndia e jo nga njeriu. Në atë shenjtore shërbesat fetare kryheshin nga priftërinjtë tokësorë; në këtë drejton Krishti, Kryeprifti Ynë, që qëndron ne të djathtë tëfronit të Perëndisë. Një shenjtore ishte në tokë, tjetra në qiell.

Për më tepër, Moisiu e ndërtoi tabernakullin sipas një modeli. Ishte Zoti që e drejtonte: "Ju do ta bëni atë sipas tërë asaj që unë do t'u tregoj, si për modelin e tabernakullit ashtu edhe për modelin e të gjitha orendive." E ngulmohet sërisht: "Dhe shiko të bësh çdo gjë sipas modelit që t'u tregua që t'u tregua në mal." - Eksodi 25:3, 40. Pali thotë që tabernakulli i parë "ishte një shëmbëlltyrë për kohën e tanishme ku ofroheshin dhurata e flijime; "që vendet e tij të shenjta ishin modele të gjërave qiellore" që priftërinjtë që ofronin dhuratat sipas ligjit shërbenin "sipas ligjit shërbenin "sipas shembullit dhe hijes së gjërave qiellore," dhe që "Krishti nuk hyri në një shenjtore të bërë me dorë, që është vetëm shëmbëllesë e asaj të vërtetë, por në vetë qiellin për të dalë tani përpara Perëndisë për ne ..." - Letra e Hebrenjve 3:9, 23; 8:5, 3:24.

Shenjtorja e ndërtuar nga Moisiu ishte kopje, origjinali e të cilës është shenjtorja tokësore. Aftësitë artistike që u shpalosën gjatë ndërtimit të saj flisnin qartë për mençuri hyjnore. Muret dukeshin si blloqe masive ari që reflekonin në çdo drejtim dritën e shtatë llampave të shandanit të artë. Tyerza e bukës së paraqitjes dhe altari i temjanit ndriçonin siar i kulluar. Bukurisë së kësaj pamjeje i shtohej perdja e mrekullueshme që zinte vendin e çatisë (mbuesës) dhe ishte punuar me figura engjëjsh me ngjyra blu, të purpurt dhe të kuqe të ndezur. E përmbi velin e dytë, ishte Shekinahu, shfaqja në formë të dukshme e lavdisë së Perëndisë; vend në të cilin mund të hynte dhe të mbetej gjallë vetëm kryeprifti e askush tjetër.

Madhështia e pakrahasueshme e tabernakullit tokësor reflektontepërpara syve të njerëzve lavdinë e tempullit qiellor ku Krishti, paralajmëruesi ynë, shërben përpara fronit të Perëndisë për ne. Vendi i përhershëm i Mbretit të Mbretërve, ku mijëra e mijëra njerëz i shërbenin dhe mijra të tjerë qëndronin përpara Tij (Danieli 7:10); ai tempull mushur me lavdinë e fronit të përjetësisë ku engjëjt, rojtarët plot dritë, mbulonin fytyrat në shenjë adhurimi, edhe pse përbënte ovjektin më të mrekullueshën që kishin ndërtuar ndonjëherë njerëzit, ishte veçse një reflektim i dobët i lavdisë dhe madhështisë së modelit të tij. Megjithatë, shenjtorja tokësore dhe shërbesat që zhvilloheshin në të, nxorrën në pah të vërteta të rëndësishme që kishin të bënin me shenjtoren qiellore dhe me punën e madhe oër shpëtimin e njerëzve që zhvillohet në të.

Vendet e shenjta të shenjtores qiellore përfaqsohen nga dy ndarjet e shenjtores tokësore. Apostullit GJon gjatë një vizioni, iu lejua që të shihte tempullin qiellor të

Perëndisë dhe ai atje vuri re "shtatë llampa "që kishte një temianicë ari ... dhe iu dha shumë erë të këndshme që t'ua shtonte lutjeve të të gjithë shenjtorëve mbi altarin prej ari që ishte përpara fronit." - Zbulesa 8:3. Në këtë pikë të vizionit, profetit iu lejua që të shihte ndarjen e parë të shenjtores qiellore; atje ai pa "shtatë llampa të ndezura" dhe "altarin prej ari" që përfaqsohen përkatësisht na shandani i artë dhe altari i temjanit në shenjtoren tokësore. Atëherë "u hap tempulli i Perëndisë" (Zbulesa 11:13) dhe ai hodhi vështrimin përtej velit të brendshëm në "Vendin shumë të shenjtë". Atje pa "arkën e beslidhjes së Tij" që simbolizohet nga sënduku i shenjtë që ndërtoi Moisiu për të vendosur, ligjin e Perëndisë.

Kështu, ata që ishin duke studiuar këtë temë gjetën prova tëpamohueshme të ekzistencës së një shenjtoreje në qiell. Moisiu e ndërtoi shenjtoren tokësore duke u nisur nga një model i dhënë. Gjoni dëshmon se e pa në qiell atë shenjtore.

Në tempullin qiellor, vendqëndrimin e Perëndisë, nga froni i Tij vjen drejtësi dhe gjykim. Në "Vendin shumë të shenjtë" gjendet ligji i Tij, rregulli i madh i drejtësisë, në bazë të së cilit, gjykohen të gjthë njerëzit pajtuesi, përpara të cilit vetë Krishti, lutet për faljen e mëkatarëve duke përdorur gjakun e Tij. Kështu, plani i shpëtimit është gërshetim i drejtësisë me mëshirën. Këtë bashkim (gërshteim) mund ta planifikon të vetëm një mençuri pakufi dhe vetëm një fuqi po aq e pakufishme në qiell. Kerbinët e shenjtores tokësore me kokat e kthyera me respekt në drejtim të pajtuesit, përfaqësojnë inteesin që engjëjt qiellorë tregojnë për punën dhe planin e shpëtimit. Engjëjt dëshirojnë me gjithë shpirt që të zbulojnë misterin e mëshirës; - se si Perëndia tregohet i drejtë duke e falur mëkatarin e penduar dhe duke e rinovuar lidhjen e Tij me racën me dështuar; se si Jezusi poshtërohet për të shpëtuar nga rrënimi turma të panumërta njerëzish dhe për t'i veshur ata me petkat e dretjësisë së Tij, në mënyrë që ata të bashkohen me engjëjt që s'kanë mëkatuar kurrë dhe të qëndrojnë përgjithmonë në presencën e Perëndisë.

Puna e Krishtit, si ndërmjetës i njerëzve, përshkruhet shumë bukur në profecinë e Zakarisë; profeci që ka të bëjë me Atë "gurin e qoshes, mbi të cilin gjathë ndërtesa e lidhur mirë, rritet për të qënë një tempull i shenjtë në Zotin, në te cilin, - thotë ai, - edhe ju jeni bashkëndërtuar për të qënë një banesë e Perëndisë përmes Frymës." - Letra e Efesianëve 2:20-22.

"Do të mbulohet me lavdi." Krishtit i takon lavdia për shpëtimine races mëkatare. Nga shekulli në shekull, që nga fillimi ikohërave, të çliruarit me me shpërblesë do të këndojnë: "Atij që na deshi dhe na lau nga mëkatet tona në gjakun e tij, ... Atij i qoftë laavdi dhe pushtet në shekuj të shekujve." - Zbulesa 1:5, 6.

"Do të ulet e do të mbretërojë mbi fronin e tij, do të jetë prift mbi fronin e tij." Këtu nuk thuhet "mbi fronin e lavdeisë së tij", mbretëria e lavdisë nuk është krijuar akoma. "Zoti Perëndi do t'i japë fronin e Davidit, atit të tij," vetëm pasi Ai t'i ketë dhënë fund punës së Tij si ndërmjetës dhe mbretëria e Tij "nuk do të ketë kurrë të sosur." - Luka 1:32, 33. Si kryeprift, Krishti tani është ulur me Atin në

fronin e Tij. - Zbulesa 3:21. Mbi fronin e Atij që ka jetuar përjetësisht qëndron Ai "që mbante sëmundjet tona dhe kishte marrë përsipër dhembjet tona", që "u tundua në të gjithashtu si ne, por pa mëkatuar." "Në qoftë se ndokush mëkaton, kemi një avokat te Ati ..." - Isa 33:4; Letra e Hebrenjve 4:15; 2:18; Letra e parë e Gjonit 2:1. Ndërmjetësimi i tij përbëhet nga një trup i shpuar nga gozhdat dhe i thyer nga heshtat, dhe nga një jetë pa mëkat. Duart e përgjakura, brinjët e shpuar, këmbët e maviosura i bëjnë thirrje mëkatarëve, shpëtimi i të cilëve u ble me një çmim tepër të lartë.

"Midis të dyve do të jetë këshille paqjeje." Dashuria e Atit, po aq e madhe sa dashuria e Birit, është themeli i shpëtimit për racën mëkatare. Përpara se të largohej Jezusi u tha nxënësve të Tij: "Nuk po ju them se unë do t'i lutem Atit për ju; Ai vetë në fakt ju do." - Gjoni 16:26, 27. Perëndia "e ka pajtuar botën me veten në Krishtin ..." - Letra e dytë e Korintasve 5:13. Gjatë drejtimit të shenjtores atje lart "midis të dyve do të jetë një këshillë paqjeje." "Sepse Perëndia aq shumë e deshi botën sa dha Birin e tij të vetëmlindur, që, kushdo që beson në të, të moshumbasë, por të ketë jetë të përjetshme". - Gjoni 3:16.

Bibla i jep përgjigje shumë të qartë pyetjes: "Çfarë është shenjtorja?" Termi "shenjtore" që përdoret në Bibël, i referohet së pari, tabernakullit që u ndërtua nga Moisiu sipas modelit qiellor, dhe së dyti, e shenjtores së vërtetë qiellore" që pasqyrohej nga e para. Vdekja e Krishtit i dha fund shërbesës tipike. "Shenjtorja e vërtetë e qiellit përbën edhe shenjtoren e beslidhjes së re. Duke pasur parasysh se profecia e kapitullit 8 të Librit të Danielit versa 14 u realizua pas vdekjes së Mesisë, ajo i referohet shenjtores së beslidhjes së re. Në fudn të periudhës 2300 ditore (vjetore), në vitin 1844, në tokë s'kishte pasur shenjtore për shekuj me rradhë. Kështu, pa as më të voglin dyshim, profecia: "Deri dymijë e treqind ditë; pastaj shenjtorja do të pastrohet"; ka të bëjë me shenjtoren qiellore.

Por duhet gjetur përgjigja e një pyetjeje akoma më të rëndësishme: "Ç'kuptim ka pstrimi i shenjtores?" Në Dhiatën e Vjetër thksohet ekzistenca e një shërbese të tillë në shenjtoren tokësore. A mund të ketë ndonjë gjë në qiell që të ketë nevojë për t'u pastruar? Në kapitullin 3 të Letrës së Hebrenjve flitet qartë për Pastrimin si të shenjtores tokësore, ashtu edhe të asaj qiellore. "Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë. Ishte, pra, e nevojshme që format e gjërave qiellore të pastrohen me këto gjëra [gjakun e kafshëve; por vetë gjërat qiellore me flijime më të mira se këto, (Letra e Hebrenjve 9:22, 23), madje edhe gjakui çmuar i Krishtit.

Si gjatë shërbesës së vërtetë, ashtu edhe gjatë asaj imituese, pastrimi mund të kryhej vetëm me anë të gjakut; në të parën (shërbesën e vërtetë) me anë të gjakut të Krishtit, dhe në tëdytën (shërbesën imituese) me anë të gjakut të kafshëve. Sipas Palit pastrimi kryhet me anë të gjakut, sepse pa gjakderdhje, nuk ka ndjesë. Dhe pastrimi duhet të çojë në falje apo në largimin e mëkatit.

Po si mund të ekzistojë mëkati në shenjtore, sido qoftë kjo; tokësore apo qiellore? Këtë mund ta mësojmë duke iu referuar shërbesës simbolike sepse priftërinjtë që ushtronin këtë detyrë në tokë shërbenin "sipas shëmbullit dhe hijes së gjërave qiellore." - Letra e Hebrenjve 8:5.

Shërbesa e shenjtores tokësore ndahej në dy pjesë; priftërinjtë shërbenin çdo ditë në Vendin e shenjtë" dhe një herë në vit, kryeprifti kryente një shërbesë të veçantë shugurimi në "Vendin shumë të shenjtë" për të pastruar shenjtoren. Çdo ditë, mëkatari i penduar sillte përpara hyrjes së tabernakullit një kafshë për të flijuar dhe rrëfente mëkatet e tij duke vënë dorën mbi kokën e flisë duke kaluar kështu katet e tij duke vënë dorën mbi kokën e flisë duke kaluar kështu në mënyrë simbolike, mëkatet e tij tek kafsha e pafajshme. Pas kësaj, kryhej flijimi. Apostulli thotë se "pa derdhur gjak nuk ka ndjesë", Shkelja e ligjit të Perëndisë mund të shqaguhej vetëm me jetën e atij që e kishte shkelur këtë ligj. Prifti merrte gjakun, që përfaqsonte vdekjen e mëkatarit, faji i të cilit mëshirohej në figurën e kafshës së flijuar, të cilit ndodhej sënduku i ligjit që kishte shkelur ai mëkatar. Nëpërmjet kësaj ceremonie, mëkati me anë të gjakut të derdhur, kalonte në shenjtore. Kishte raste kur gjaku nuk çohej në "Vendin e shenjtë", por në këto raste priftërinjtë duhet ta hanin mishin e flisë ashtu si urdhëroi dikur Moisiu djemtë e Aaronit duke iu thënë: "Zoti ua ka dhënë me qëllim që të mbani padrejtësinë e asamblesë - Levitiku 10:17. Të dy ceremonitë simbolizonin në tënjëjtën mënyrë kalimin e mëkatit nga mëkatari i penduar, tek shenjtorja.

Kjo punë kryhej ditë për ditë gjatë gjithë vitit. Duke qënë se mëkatet e Izraelit kalinin nga populli tek shenjtorjam, lindi nevoja e kryeerjes së një shërbese të veçantë Për ta pastruar vetë shenjtoren pre tyre. Zoti urdhëroi që të shugurohehsin veças secila prej ndarjeve të shenjta. "Kështu do të bëjë shlyerjen për shenjtoren, për shkak të papastërtive të bijëve të Izraelit, të shkeljeve të tyre dhe të gjitha mëkateve të tyre. Do të veprojë në të njëjtën mënyrë për çadrën e mbledhjeve, që mbetet mes tyre, në mës te papastërtive të tyre." Edhe altari do të shugurohej me qëllim që "ta pastrojë dhe ta shenjtërojë nga papastërtitë e bijve të Izraelit." - Levitiku 16:16, 13.

Një në vit, në Ditën e madhe të Shlyerjes, kryeprifti hynte në "Vendin shumë të shenjtë" për të kryer pastrimin e shenjtores. Pastrimi ishenjtores i jepte fund shërbesës vjetore. Në ditën e Shlyerjes përpara hyrjes së tabernakullit, silleshin dy cjep dhe hidhej short për ta; "njëri prej tyre caktohej për Zotin dhe tjetri shërbente si cjap për shlyerjen e fajit." - versa 8. Cjapi i caktuar për Perëndinë do të therrej si flijim për mëkatet. Prifti e merrte gjakun e tij brënda velit dhe me një pjesë të tij spërkaste pajtuesin dhe pjesën tjetër e derdhte përpara tij. Me gjak spërkatej edhe altari i temjanit që ndodhej përpara belit.

"Aaroni do të vendosë të dyja duart e tij mbi kokën e cjapit të gjallë dhe do të rrëfejë mbi të tërë padrejtësitë e bijëve të izraelit të gjitha shkeljet e tyre, tërë mëkatet e tyre, dhe do t'i verë mbi kokën e cjapit, pastaj do ta çojë në shkretëtirë me anë

të një njeriu të zjgedhur enkas. Cjapi do të mbartë mbi vete në tokë të vetmuar të gjtha padrejtësisë e tyre." - Versat21:22. Cjapi nuk kthehej më në kampin e Izraelitëve dhe njeriu që e shoqëronte deri në shkretëtirë duhej të lahej vetë dhe të lante rrobat e tij me ujë përpara se të hynte përsëri në kamp.

Qëllimi i gjthë kësaj ceremonie ishte që t'u nguliste në mendje Izraelitëve përsosshmërinë e Perëndisë dhe urrejtjen që i ngjallte Atij mëkati; dhe për më tepër, t'u tregonte atyre se nga kontaktime mëkatin rridhte papastërti dhe asgjë tjetër dhe asgjë tjetër. Ndërsa kryhej një shërbesë e tillë, secili duhej ta pastronte shpirtin. Askush nuk punonte dhe gjthë asambleja e Izraelit mblidhej për ta kaluar ditën në përulje solemne përpara Zotit, duke u lutur, duke u rrëfyer dhe duke agjëruar.

Shërbesa imituese (tokësore) na jep të vërteta të rëndësishme përsa i përket shugurimit (shlyerjes). Në vend të mëkatitprandaj një zëvendësues; por gjaku i viktimës nuk fshihte mëkatin. Kështu u gjet një mënyrë sipas të cilës ky mëkat, i kalonte shenjtores. Nëpërmjet këtij blatimi gjaku mëkatarei njihte autoritetin e ligjit, rrëfente gabimin e tij në shkeljen e tij në shekljen e këtij ligji dhe shprehte dëshirën për të fituar falje nëpërmjet besimit tek Shpëtimtari që do të vinte; por megjithatë, ai nuk i kishte shpëtuar plotësisht dënimin që sillte ligji. Në dhiatën e Shlyerjes kryeprifti, pasi merrte flijimin e ofruar nga asambleja, hynte në "Vendin shumë të shenjtë" duke mbajtur gjakun e flisë dhe spërkaste me të pajtuesin ku ndodhej ligji, për të çuar kështu në vend, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, kërkesat e këtij ligji. Më pas, duke lejuarrolin e ndërmjetësit, ai merrte mbi vete mëkatet, duke i larguar ato nga shenjtorja. Duke vënë duart mbi kokën e cjapit, ai i rrëfente këto mëkate mbi kafshët duke u çliruar në mënyrë figurative prej tyre dhe duke ia kaluar ato cjapit. Cjapi i merrte këto mëkate vetë dhe njerëzitshkëputeshin prej tyre.

Kjo ishte shërbesa që kryhej sipas shembullit dhe hijes së gjërave qiellore. Dhe gjithçka që realizohej me anë të simboleve në shenjtoren tokësore ndodh realisht në tempullin qiellor. Me t'u rikthyer në qiell, Shpëtimtari ynë filloi punën si kryeprift. Pali thotë: "Sepse Krishti nuk hyri në një shenjtore të bërë me dorë, që është vetëm shëmbëllesë e saj të vërtetë, por në vetë qiellin për të dalë tani përpara Perëndisë për ne." - Letra e Hebrenjve 9:24.

Pjesa e parë e shërbesës së priftit që zhvillohej gjatë gjithë vitit në ndarjen e parë të shenjtores, "brënda vitit" që përbënte hyrjen dhe ndante "Vendimin e shenjtë" nga oborri i jashtëm, përfaqëson misionin që mori mbi supe Krishti me zbritjen e Tij të parë mbi tokë. Pikërisht, i përkiste priftit, që gjatë shërbimit të përditshëm t'i ofronte Perëndisë gjakun e flijimit për mëkatet dhe temjanin me lutjet e Izraelit. Në të njëjtën mënyrë, Krishti i ofroi Atit gjakun e Tij në vend të gjakut të mëkatarëve dhe paraqiti përpara Tij, bashkë me aromën e drejtësisë së Tij dhe lutjet e mëkatarëve të penduar. I tillë ishte shërbimi që kryhej në ndarjen e parë të shenjtores qiellore.

Besimi i nxënësve të Tij ishte me Të ndërsa Ai ngjitej drejt qiellit dhe largohej prej tyre. Pikërisht këtu përqëndronte shpresat e tyre. "Kjo shpresë që ne kemi, - thotë pali, - është si një spirancë e sigurtë dhe e patundur, dhe që hyn deri në brendësinë e vitit, ku ka hyrë Krishti, si pararendës për ne, pasi u bë kryeprifti."; "Hyri një herë e përgjithmonë në shenjtore, jo me gjakun e cjepve dhe të viçave por me gjakun e vet, dhe fitoi një shpëtim të amshur." - Letra e Hebrenjve 6:13,20; 3:12.

Ky shërbim vazhdoi në ndarjen e parë të shenjtores për tetëmbëdhjetë shekuj me rradhë. Gjaku i Krishtit, i ofruar në emër të besimit të penduar u siguronte atyre faljen dhe pranimin e Atit, megjithatë mëkatet e tyre mbeteshin të shkruara në shenjtoren qiellore, përpara kurorëzimit përfundimitar të punës së Krishtit për shpëtimin e njerëzve, kryhet një shugurim për të pastruar shenjtoren nga mëkatet. Kjo është shërbesa që filloi në fund të periudhës 2300 ditore. Gjatë asaj kohe, ashtu si parashikohet edhe nga profeti Daniel, Kryeprifti ynë hyri në "Vendim shumë të shenjtë" për të realizuar aktin e fundit të punës së tij solemne - pastrimin e shenjtores.

Ashtu si në kohët e hershme, kur mëkatet dhe me naë të gjakut të këtij të fundit kolonin në mënyrë figurative tek shenjtorja toësore, edhe mëkatet e të penduarve, në beslidhjet e re, nëpërmjet besimit, vendosën mbi Krishtin dhe me anë të gjakut të Tij, kalojnë tek shenjtorja qiellore. Dhe ashtu si pastrimi imitues i shenjtores tokësore realizohej duke i larguar mëkatet që sillnin papastërti në të, edhe pastrimi i vërtetë i shenjtores qiellore do të realizohet duke i larguar apo fshirë tërësisht mëkatet që janë shënuar atje. Por përpara kësaj pune, duhet të shqyrtohen me kujdes të veçantë librat e shënimeve, për të vendosur se cilët dotë përfitojnë nga kjo shlyerje falë besimit tek Krishti dhe pendesës për mëkatet e tyre. Duke u nisur nga kjo, kuptohet lehtë se pastrimi i shenjtores përfshin në vetvete një farë shqyrtimi - apo gjykim. Kjo punë duhet të paraprijnë ardhjen e dytë të Jezu Krishtit për të çliruar popullin e Tij; sepse kur të vijë Ai do të ketë shpërblime me vete, për t'ia dhënë atë gjithësecilit sipas veprave që ka bërë (Zbulesa 22:12).

Kështu, ata që i shkuan pas dritës së fjalës profetike vunë re, që në fund të periudhës 2300 ditore, në vitin 1844, në vend që të vinte në tokë (siç mendonin ata), Krishti hyri në "Vendin shumë të shenjtë" të shenjtores qiellore për të kryer aktin përfundimtar të shlyerjes, duke u përgatitur për të ardhur sërisht.

U vu re gjithashtu, që ndërsa blatimi për mëkatet simbolizonte flijimin e Krishtit hde figura e kryepriftit - Krishtin si ndërmjettës, Cjapi që lëshohej në shkretëtirë tipizonte Satanin, autorin e mëkatit, mbi të cilin do të vendosen në fund të kohës të gjitha mëkatet e të penduarve. Kur kryeprifti i largonte nga shenjtorja mëkatet me anë të gjakut të flisë, ai ia kalonte ato cjapit. Kur Krishti me anë të gjakut të Tij Ai do t'ia kalojë ato në fund të shërbimit të Tij, Satanit, i cili me dhënien e gjykimit

do të mbarsë mbi vete dënimin përfundimtar. Cjapi dërgohej në një vend të shkretë dhe të pabanuar për të mos u kthyer më kurrë në bashkësinë e Izraelit. Në të njëjtën mënyrë, edhe Satani do të dëbohet përgjithmonë larg Perëndisë dhe popullit të Tij dhe do të zhduket për të mos u shfaqur më kurrë, gjatë shkatërrimit përfundimtar të mëkatit dhe mëkatarëve. Tabernakulli (shenjtorja) - lëvizte bashkë me Izraelin gjatë udhëtimit të tyre drejt tokës së premtuar.

1. Citoni disa vargje biblike që mbështesin pikëpamjen se shenjtërorja në tokë përfaqëson shenjtëroren qiellore.

2. Lexoni Hebrenjtë 9. Çfarë na thotë ky pasazh rreth pastrimit të shenjtërores tokësore dhe asaj qiellore? Çfarë evidencash të tjera gjeni për këtë mësim të Biblës?

3. Cilat janë dallimet midis shërbesës së Krishtit nga momenti i ringjalljes dhe ngjitjes në qiell e deri në vitin 1844 dhe shërbesës së tij nga 1844 e deri në mbylljen e portës së mëshirës?

24.

Në Vendin më të Shenjtë

Ideja e shenjtores ishte çelësi që zbuloi misterin e zhgënjimit të vitit 1844. Ndërsa nga njëra anë, hidhte dritë mbi gjendjen të cilën ndodhen dhe punën që duhet të kryejnë njerzit e Zotit duke theksuar detyrën e re që dilte përpara tyre, nga ana tjetër nxirrte në pah një sistem të vërtetash harmonike dhe të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, duke e treguar edhe një herë, se lëvizja e madhe e ardhjes së dytë ishte frymëzuare drejtuar nga vetë Perëndia. Si nxënësit e parë të Jezusit që "u gëzuan kur panë Zotin" pas asaj nate të tmerrshme ankthi dhe zhgënjimi po ashtu u ngazëlluan dhe ata që kishin pritur me besim që Ai të vinte për të dytën herë. Ata kishin pritur që Ai të vinte plot lavdi për të shpërblyer shërbëtorët e Tij. E duke qënë se u zhgënjyen; ata e humbën Jezusin dhe thirrën siç thirri Maria tek varri: "E kanë hequr Zotin tim dhe nuk e di se ku e kanë vënë." E gjetën përsëri Atë në "Vendin shumë të shenjtë"; gjetënKryepriftin e tyre të dhembshur që do të vinte shpejt si mbret dhe çlirues. Drita që mbante shenjtorja ndriçoi të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ata ishin të sigurtë se Perëndia i kishte udhëhequr me maturinë e Tij të pagabueshme. Edhe pse ata vetë, ashut si nxënësit e parë, nuk e kishin kuptuar mesazhin që shpallën, ai mesazh kishte qënë më se i saktë nga çdo pikëpamje. Shpallja e tij, kishte çuar në realizimin e qëllimit të Zotit dhe puna e tyre ishte vlerësuar prej Tij. Të rilindur sërisht nga "një shpresë e mrekullueshme" ata ngazëlloheshin "me një gëzim të papërshkrueshëm dhe një lavdi të plotë."

Si Profecia e Danielit 8:14, "Deri dymijë e treqin ditë; pastaj shenjtorja do të pastrohet", ashtu edhe mesazhi i engjëllit tëparë "Duani dhe i jepni Atij lavdi, sepse ora e gjyqit të tij erdhi"; flisnin për shërbimin që do të kryente Krishti në "Vendin shumë të shenjtë", për gjykimin paraprak, dhe jo për ardhjen e Tij "Si Çlirues i popullit të Vet dhe Dërmues i ligjit. Gabimi që mendohej se do te ndodhte në fund të 2300 ditëve. Besimtarër ishin zhgënjyer falë këtij gabimi, por megjithatë, gjithçka që ishte shikuar nga profecitë dhe kishte vulën Biblike, ishte realizuar. Pikërisht në

kohën kur ata po pahehsin për zhgënjimin që kishin përjetuar ndodhi ngjarja për të cilën fliste mesazhi që ata kishin shpallur; ngjarja që duhej të ndodhte përpara ardhjes së Zotit për t'i dhënë gjithësecilit shpërblimin që i takon.

Krishti nuk kishte ardhur në tokë siç e prisnin ata, por kishte hyrë, ashtu siç skicohej në profeci me anë të simboleve, në vendin më të shenjtë të tempullit të Perendisë në qiell. Profeti Daniel e paraqit Atë duke ardhur tek i Lashti i Ditëve; "Unë Danieli shikoja disa vegime nate, - thotë ai, - dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i Ditëve dhe iu afrua atij." - Danieli 7:13.

Edhe profeti Malakia e parashikon hyrjen e Tij në tempull. Ai shkruan: "Dhe menjëherë Zoti, që ju kërkoni, do të hyjë në tempullin e Vet, engjëlli i beslidhjes që ju kërkoni me ëndje, ja, do të vijë, thotë Zoti i ushtrive." - Malakia 3:1. Njerëzit e Tij nuk e pritnin hyrjen e Tij në tempullin e Vet. Ata nuk po e kërkonin atje, por prisnin që të vinte në tokë "në një zjarr flakërues, për t'u hakmarrë kundër atyre që nuk njohin Perëndi, dhe të tyre që nuk i binden ungjillit ..." - Letra e dytë e Selanukut 1:8.

Njerëzit nuk ishin akoma gati për ta takuar Zotin e tyre. Atyreu nevojitej një punë përgatitore. FIllimish, drita do t'u ndriçonte mendjet duke i drejtuar tek tempulli i Perëndisë në qiell; e ndërsa ata, falë besimit të tyre, do ta ndiqnin kryepriftin gjatë shërbimit të Tij atje, para tyre do të shtroheshin detyra të reja. Kishës do t'i jepej një mesazh tjetër paralajmërimi dhe udhëzimi.

Profeti thotë: "Po kush do të mund të durojë ditën e ardhjes së tij? Kush do të mund të qëndrojë më këmbë ditën kur ai do të shfaqet? Ai është si zjarri i shkrirësit, si soda e larësve. Ai do të ulet si ai që shkrin dhe pastron argjendin, me qëllim që ata të mund t'i ofrojnë Zotit një blatim me drejtësi." - Malakia 3:2, 3. Ata që do të jetojnë në tokë në kohën kur ndërmjetësimi i Krishtit në shenjtore do të përfundojë, do të jenë të detyruar të qëndrojnë në praninë e një perëndie të shenjtë pa ndihmën e një ndërmjetësi. Rrobat e tyre duhet të jenë pa njolla, karakteret e tyre të pastruar nga mëkati nëpërmjet spërkatjes me anë të gjakut. Ata duhet të dalin fitimtarë në betejën më të keqe, falë mëshirës së Perëndisë dhe përpjekjeve të tyre të zellshme. Ndërsa në qiell po kryhet gjykimi zbulues, ndërsa shenjtorja po pastrohet nga mëkatet e besimtarëve të penduar, në tokë, mes njerëzve të Zotit, do të realizohet një pastrim i veçantë i mesazhet e kapitullit 14 të Zbulesës.

Me të mbaruar kjo punë, pasuesit e Krishtit do të jenë gati për ardhjen e Tij. "Atëherë oferta e Judës dhe e Jeruzalemit do të pëlqehet nga Zoti, në kohët e shkuara, si në vitet e mëparshme." - Malakia 3:4. Atëherë, kisha, që Zoti do të marrë me vete në ardhjen e Tij do të jetë" e lavdishme, pa njolla e rrudha, a ndonjë gjë të tillë ..." - Efesianët 5:27. Vetëm atëherë ajo "do të shfaqet si agimi, i bukur si hëna, e pastër si dielli, etmerrshme si një ushtri me flamuj të shpalosur." - Kënga e Solomonit 6:10.

Malakia, përveç hyrjes së Zotit në tempullin e Tij, parashikon edhe ardhjen e Tij tyë dytë për të zbatuar gjykimin me këto fjalë: "Kështu unë do t'ju afrohem për gjykim dhe do të jem një dëshmitar i gatshëm kundër magjistarëve, kundër shkelësve të kurorës, kundër atyre që bëjne betime të rreme, kundër atyre që vjedhin mëditjene punëtorit, që shtypin të venë dhe jetimin, që dëbojnë të huajin dhe nuk më kanë frikë", thotë Zoti i ushtrive." - 3:5.

Juda i referohet të njëjtës skenë kur thotë: "Ja, Zoti erdhi me mijërat e tij të shenjtë, për të bërë gjyqin kundër të gjithëve dhe për të bindur të gjithë të pabesët në mes tyre për të gjitha veprat e paudhësisë." - Letra e Judës 14, 15. Ndryshimi midis kësaj ardhjeje dhe hyrjes së Zotit në tempullin e Tij, është mëse e qartë. Këto janë dy ngjarje të ndryshme.

Ardhja e Krishtit si Kryeprifti ynë në "Vendin shumë të shenjtë" për të pastruar shenjtoren, që del në pah tek Libri i Danielit 8:4; ardhja e Birit të njeriut tek i Lashti i Ditëve që përshkruhet tek Libri i Danielit7:13; dhe ardhja e Zotit tek tempulli i Tij sipas parashikimit të Malakisë, janë përshkrime të ndryshme të të njëjtës ngjarje. Edhe ardhja e dhëndrit, që jepet shumë bukur tek parabola e dhjetë vajzave të virgjëra të Mateut 25, përfaqëson të njëjtën gjë.

Mesazhi "Ja, po vjen dhëndri!" u shpall në verë dhe në vjeshtë të vitit 1844. Në atë kohë, u fuqizuan edhe dy grupet e njerëzve tqë përfaqësoheshin nga vajzat e meçura dhe budallaqe - grupi i parë (të mençurat) përbëhej nga të gjithë ata që e pritnin me gëzim ardhjen e Zotit dhe që përgatiteshin me zell për ta takuarAtë, dhe grupi i dytë, nga të gjithë të tjerët, që duke qënë impulsivë dhe duke pasur frikë, ishin kënaqur me të vërtetën teorikisht, por nuk ndjenin nevojën e mëshirës së Perëndisë. Në parabol thuhet se me të ardhur dhëndri, "virgjëreshat që ishin gati, hynë bashkë me të në dasmë." Pra, siç vihet re, dhëndri vjen përpara dasmës. Dasma përfaqëson marrjen nga ana e Krishtit të mbretërisë së Tij. Qyteti i Shenjtë, Jeruzalemi i Ri, që është kryeqyteti dhe qyteti përfaqësues i mbretërisë quhet "nusja, gruaja e Qngjit." Engjëlli i tha Gjoni: "Eja, do të të tregoj nusen, gruan e Qengjit." "Dhe më çoi në Frymë mbi një mal të madhe dhe të lartë, dhe më tregoi qytetin e madh, Jeruzalemin e shenjtë, që zbriste nga qielli, nga Perëndia." - Zbulesa 21:9, 10. Pra, është më se e qartë se nusja përfaqëson Qytetin e Shenjtë dhe vajzat e vergjëra që dalin për të takuar dhëndrin, simbolizojnë kishën. Tek Zbulesa thuhet se njerëzit e Zotit janë të ftuarit në gostinë e dasmës së Qengjit (Zbulesa 19:9). Në qoftë se ata janë të ftuarit s'mund të përfaqësojnë në të njëjtën kohë edhe nusen. Sipas profetit Daniel, Krishti do të marrë "sundimin, lavdi dhe një mbretëri" nga i Lashti i Ditëve"; Ai do të marrë Jeruzalemin e Rij, kryeqytetin e mbretërisë së Tij "që është bërë gati si nuse e stolisur për burrin e vet." - Danieli 7:14; Zbulesa 21:2. Me të marrë në dorëzim dëtë mbretëri, Ai do të vijë plot lavdi si Mbret mbi mbretër dhe Zot mbi zotër për të çliruar njerëzit e tij që "do të ulen me Abrahamin, me Isaakun

dhe me Jakbin" në tryezën e mbretërisë së Tij për të marrë pjesë në gostinë e dasmës së qengjit (Mateu 8:11; Luka 22:30).

Shpallja e mesazhit: "Ja po vjen dhëndri!" në verë të vitit 1844, bëri që me mirëra njerëz të pritnin me padurim ardhjen e shpejtë të Krishtit. Pikërisht në atë kohë, Dhëndri erdhi, jo në tokë siçmendonin, por tek i Lashtu i Ditëve në qiell për t'u martuar, për të marrë mbretërinë që i takonte. "VIrgjëreshat që ishin gati, hynë bashkë me të në dasmë; dhe dera u mbyll." Ata nuk do të ishin personalisht të pranishëm ne dasmë, sepse ajo do të zhvillohej në qiell, ndërsa ata (të ftuarit) jetonin në tokë. Passuesit e Krishtit duhet ta "presin Zotërinë e tyre, kur të kthehet nga dasma." - Luka 12:36. Por megjithatë, ata duhet të kuptojnë punën e Tij. Dhe ta ndjekin me anë të besimit ndërsa Ai shkon përpara Perëndisë. Kjo është ideja që del kur thuhet se ata shkojnë në dasëm bashkë me Të.

Në parabolë theksohet se në dasëm, shkuan ato që kishin vaj në llampa. Me fjalë të tjera, ata që krahas njohurisë mbi të vërtetën që e kishin gjetur në Shkrimet e Shenjta, zotëronin edhe Shpirtin e Shenjtë dhe ndjenin nevojën e mëshirës së Perëndisë; ata, që kishin pritur me durim, duke përballuar natën e errët të provës dhe duke studjuar Biblën në kërkim rrezesh më të qarta drite. Ishin pikërisht këta njerëz, që kuptuan të vërtetën mbi shenjtoren qiellore dhe ndryshimin e shërbimit që do të kryente Shpëtimtari, dhe e ndoqën Atë falë besimit të tyre në punën e nisur në shenjtoren atje lart. Edhe të gjithë të tjerët, që pranojnë nëpërmjet dëshmisë së Shkrimeve ndërsa Ai del përpara Perëndisë për të përmbushur aktin e fundit të punës së Tij si ndërmjetës dhe për të marrë në përfundim të saj mbretërinë që e pret - përshkruhen si ata që shkojnë në dasëm.

Në parabolën e kapitullit 22 të Librit të Mateut përdoret e njëjta figurë = dasma - dhe duket qartë se gjykimi zbulues kryhet përpara kësaj dasme. Përpara ceremonisë, hyri mbreti, për të parë nëse të gjithë të ftuarit kishin veshur petkun e duhur për dasmë, veshjen pa njolla, karakterin e pastruar e të zbardhur nga gjakui Qengjit (Mate 22:11, Zbulesa 7:14). Perëndia pranon, duke i bërë pjesë të mbretërisë dhe duke u bërë vend pranë fronit të Tij, të gjithë ata qe pas një shqyrtimi te kujdesshëm vihet re se kanë veshur rroba dasme. Të papërshtatshmit flaken tej. Gjykimi zbulues apo puna përmbysëse që kryhet në shenjtoren qiellire përfshin pikërisht shqyrtimin e karakterit njerëzor për të vendosur në këtë mënyrë se cilët janë gati për të marrë pjesë në mbretërinë e Perëndisë.

Me të mbaruar kjo punë, me t'u shqyrtuar çështjet e të gjithë atyre që në shekuj kanë deklaruar se i përkisnin Krishtit dhe me t'u marrë vendimi për secilin prej tyre, do të përfundojë edhe periudha e gjykimit dhe me të do t'i mbyllet dera edhe mëshirës. Kështu, vetëm një fjali: "Ato që ishin gati, hynë bashkë me të në dasëm; dhe dera u mbyll."; na çon tek shërbimi i fundit i Krishtit - Shpëtimtar, tek momenti kur do të përfundojë puna e madhe për shpëtimin e njerëzve.

Gjatë shërbesës në shenjtoren tokësore, që siç e kemi vënë re ishte skicë e shërbesës qiellore, me të hyrë kryeprifti në "Vendin shumë të shenjtë" në Ditën e Shlyerjes, ndërpritej shërbimi në ndarjen tjetër të shenjtores. Zoti urdhëroi: "Në çadrën e mbledhjeve, kur ai do të hyjë në shenjtoren për të bërë shlyerjen, nuk do të ketë njeri, derisa hyri në "Vendin shumë të shenjtë" për të kryer aktin e fundit të shlyerjes, Ai i dha fund shërbimit në ndarjen e parë, filloi puna në ndarjen e dytë. Në shërbesën imituese (tokësore) kur kryepifti largohej nga "Vendi i shenjtë" në Ditën e Shlyerjes, ai dilte përpara të gjithë Izraelit që ishin penduarme të vërtetë për mëkatet e tyre. Në të njëjtën mënyrë, Krishti kishte përmbushur vetëm gjatë të cilës, Ai vazhdonte t'i ofronte Atit gjakun e Tij në emër të mëkatarëve.

Adventisët nuk e kuptuan këtë të vërtetë në vitin 1844. Edhe pse koha kur pritej ardhja e Shpëtimtarit kaloi, ata vazhdonin të besoninse Ai do të vinte shpejt; Ata ishin të mendimit se kishin arritur në një fazë të rëndësishme dhe se Krishti i kishte dhënë fund punës së Tij si ndërmjetës përpara Perëndisë. Atyre ju dukej se në Bibël thuhej se gjykimi do të përfundote pak përpara ardhjes së Zotit në retë e qiellit. Kjo dukej sikur shprehej qartë tek ato pjesë të Shkrimeve të Shenjta ku flitej për njerëz që do të kërkojnë, do të qajnë dhe do të trokasin në dyert e mëshirës, por ato dyer nuk do të hapen më për ta. Në zemrat e tyre lindi dyshimi: ndoshta data kur ata pritnin ardhjen e Krishtit shënonte fillimin e periudhës që do ta paraprinte këtë ardhje ... Ata mendonin se nga njëra anë duke e paralajmëruar botës për gjykimin e afërt e kishin kryer detyrën e tyre, dhe e kishin flakur tej barrën e rëndë të shpëtimit të mëkatarëve dhe nga ana tjetër, njerëzit e ligit që s'hiqnin dorë nga talljet dhe blasfemitë, përbënin një provë të faktit se Shpirti i Perëndisë i kishte braktisur të gjithë ata që ndjenin mevojën për mëshirën e Tij. Të gjitha këto konfitmonin bindjen e tyre se gjykimi kishte përfunduar, apo si u pëlqente ta shprehnin ata, "dera e mëshirës tashmë ishte mbyllur."

Por studimi më i detajuar i problemit të shenjtores solli rreze të reja dhe më të qarta drite. Ata vunë re, se bindja e tyre qe fundi i periudhës 2300 ditore viti 1844, shënonte fillimin e një faze të rëndësishme, ishte më se e saktë. E ndërsa, nga njëra anë, ishte i vërtetë fakti se dera e shpresës dhe mëshirës nga e cila njerëzit kishin dalë përpara Perëndisë pë një mijë e treqind vjet me rradhë ishte mbyllur, nga ana tjetër, u hap një derë e re dhe njerëzimit falë ndërmjetësimit të Krishtit në"Vendin shumë të shenjtë" iu afrua dhurata e faljes. Një pjesë e shërbimit të Tij kishte përfunduar, për t'i hapur rrugën një pjese tjetër. Akoma ekzistonte "një derë e hapur për të hyrë në shenjtoren qiellore ku vetë Krishti, shërbente si Kryeprift në emër të mëkatarëve.

Vetëm tani mund t'i kuptonin ato fjalët e Krishtit, që duke iu drejtuar kishës pikërisht në atë kohë, shprehet kështu tek Libri i Zbulesës: "Këtë thotë i Shenjti, i Vërteti, ai që ka çelësin e Davidit, ai që hap dhe skush nuk mbyll; dhe mbyll dhe askush nuk hap. UNë njoh veprat e tua; ja, të vura përpara një dere të hapur që asnjëri nuk mund ta mbyllë." - Zbulesa 3:7, 8.

Vetë mata, që me besim i shkojnë pas Krishtit në këtë detyrë të rëndësishme shlyerjeje, përfitojnë nga ndërmjetësimi i Tij; Të tjerët që i mbyllin sytë përpara dritës që nxjerr në pah këtë shërbim, nuk mund të jenë pjesë e tij Çifutët, qe hodhën poshtë dritën që ndriçonte ardhjen e parë të Krishtit dhe nuk besuan se Ai ishte Shpëtimtari i botës, nuk mund të merrnin faljen që të ofron Ai. Kur Jezusi, me t'u ngjitur sërisht në qiell, hyri me anë të gjakut të Vetnë shenjtoren qiellore për t'u dhuruar nxënësve bekimet që sjell ndërmjetësimi i Tij, çifutët u lanë në errësirë të plotë për të vazhduar me flijimet dhe blatimet e tyre pa vlerë. Shërbimit të simboleve dhe imitimeve i kishte ardhur fundi. Dera nga kishin hequr dorë nga e vetmja rrugë kërkimi që mund t'i çonte tek Ai; nga shërbimi në shenjtoren qiellore. Për këtë arsye ata nuk mund të komunikonin me Perëndinë. Për ta -dera ishte e mbyllur. Ata nuk e dinin se prandaj nuk mund të përfitonin nga ku ndërmjetësim.

Gjendja në të cilën ndodheshin çifutët ilustron gjendjen në të cilën ndodhen "të ashtuquajturit" të Krishterë të shkujdesur medëshirën e tyre, nuk duan t'ia dinë për shërbimin mëshirëplotë të shenjtë", kërkohej që i gjithë populli i Izraelit të mblidhej përredh shenjtores dhe në mënyrë solemne të përulej përpara Perëndisë, në mënyrë që t'u faleshin mëkatet dhe të vazhdonin të bënin pjesë në asambelnë fetare. Sa e rëndësishme është që ne ta kuptojmë në Ditën e vërtetë të Shlyerjes punën e Kryepriftit tonë dhe ta dimë se çfarë detyrash shtrohen përpara nesh.

Njerëzit nuk mund ta mohojnë paralajmërimin që u dërgon vetë Perëndia pa u ndëshkuar për këtë gjë. Në kohën e Noas nga qielli u dërgua një mesazh dhe shpëtimi i njerëzve varej nga mënyra me të cilën ata vetë do të reagonin ndaj këtij mesazhi. Meqënëse ata nuk ia vunë veshin paralajmërimit, Shpirti i Perëndisë e braktisi racën mëkatare, dhe ata u zhdukën në ujërat e Përmbytjes. Në kohën e Abrahamit, banorët mëkatarë të Sodomit nuk i kushtonin vëmëndje zërit të mëshirës derisa ky zë hesghit, dhe të gjithë ata, me përjashtim të Zotit, gruas dhe dy vajzave të tij, u bënë shkrumb e hi nga zjarri që zbriti nga qielli. E njëjta gjë ndodhi edhe në kohën e Krishtit. Biri i Perëndisë u drejtohet çifutëve jobesnikë duke deklaruar: "Ja, shtëpia juaj po ju lihet e shkretë." - Mateu 23:38. Duke parashikuar ngjarjet e ditëve të fundit, e njëjta Fuqi e Pafund deklaron kështu përsa u përket atyre "që nuk pranuan ta duan të vërtetën për të qënë të shpëtuar." "E prandaj Perëndia do t'u dërgojë atyre një gënjim që di t;i bëjë të gabojnë, që t'i besojnë gënjeshtrës, që të dënohen të gjithë ata që nuk i besuan të vërtetës, por përqafuan ligësinë." - Letra e dytë e Theselonikasve 2:10-12. Ndërsa ata mohojnë mësimet e fjalës së Perëndisë, Shpirti i Shenjtë tërhiqet prej tyre duke i lënë të lirë të zgjedhin gënjeshtrat dhe mashtrimet që u pëlqejnë aq shumë.

Por Krishti vazhdon të ndërmjetësojë përpara Atit në emër të njerëzve dhe atyre që kërkojnë, do t'u jepet dritë e dituri. Edhe pse fillimisht Adventistët nuk e kuptuan një gjë të tillë, më pas, ndërsa Shkrimet e Shenjta që përcaktojnë edhe qëndrimin e tyre të vërtetë, uhapërn përpara tyre, gjthçka u qartësua.

Periudha që pasoi që pasoi verën dhe vjeshtën e vitit 1844 ishte një provë e vështirë për të gjithë ata që vazhdonin të përqafëonin besimin e ardjes së dytë. Drita që i drejtonte ata për tek shenjtorja qiellore përbënte ngushëllim dhe u jepjte siguri përsa i përkiste qëndrimit që mbanin. Disa prej tyre hoqën dotë nga llogaria e mëparëshme e periudhave profetike dhe deklaronin se ndikimi i fuqishëm i Shpirtit të Shenjtë që ishte ndjerë gjatë lëvizjes për ardhjen e dytë ishte ndikim njerëzor, apo akoma më keq, satanik. Por gruupi tjetër mbretëronte me vendosmëri idenë se Zoti i kishte edhëhequr gjithmonë gjatë përvojave të së shkuarës; dhe ndërsa pritnin, vëzhgonin dhe luteshin që vullneti i Perëndisë të bëhej i njohur për ta, ata vunë re se Kryeprifti i kishte hyrë punës për fillimin e një etape të re të shërbimit të Tij, dhe duke i shkuar pas Atij me besim, atyre iu hapën sytë për të parë edhe detyrën përfundimtare që ky shërbim shtronte përpara kishës. Mesazhet e engjëllit të parë dhe të dytë morën një kuptim të ri, dhe ata u përgatitën për të marrë dhe për t'i shpallur botës mbarë paralajmërimin solemn të engjëllit të tretë; paralajmërimi që gjendet tek Kapitulli 14 i Zbulesës.

1. Në ç'mënyrë mësimi i shenjtërores ishte çelësi që ç'kyçi misterin e zhgënjimit të 1844?

2. Si e bën mesazhi i shenjtërores, të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, kuptimplote për ju?

3. Në fund të 2,300 ditëve profetike, Jezusi filloi shërbesën e Tij në vendin më të shenjtë të shenjtërores qiellore, një process i njohur si gjykimi investigative apo i para-adventit. Cilët janë disa nga vargjet biblike që e mbështesin këtë të vërtetë?

25.

Ligji i Pandryshueshëm i Perëndisë

Tempulli i Perëndisë u hap në qiell dhe atje u duk arka e beslidhjes së Tij *(Zbulesa 11:13)*. Arka e besëlidhjes së Perëndisë ndodhet në "vendin shumë të shenjtë", në ndarjen e dytë të shenjtores. Gjatë shërbesës së tabernakullit tokësor që u ndërtua "sipas shembullit dhe hijes së gjërave qiellore", në këtë ndarje të veçantë kryeprifti mund të hynte vetëm një herë në vit, në Ditën e Shlyerjes për të pastruar shenjtoren. Prandaj fakti që tempulli qiellor i Perëndisë u hap dhe në të u duk arka e beslidhjes së Tij tregon se është "vendi shumë i shenjtë" i shenjtores qiellore, që është hapur në vitin 1844 ndërsa Krishti ka hyrë në të për të kryer aktin e fundit të shlyerjes. Të gjithë ata që me besim i shkuan pas Kryepriftit të tyre gjatë shërbimit të Tij në "vendin shumë të shenjtë", panë arkën e beslidhjes së Tij. Ndërsa studionin rreth problemit të shenjtores ata kuptuan ndryshimin në shërbim të Shpëtimtarit dhe vunë re se tani Ai po shërbente përpara arkës së Perëndisë duke ofruar gjakun e tij në emër të mëkatarëve.

Në arkën e tabernakullit tokësor gjendeshin dy rrasat e gurta mbi të cilat ishin skalitur urdhëresat e ligjit të Perëndisë. Arka përbënte thjesht vendmbajtjen e rrasave të gurit dhe ishin urdhëresat e shenjta që përmbanin këto rrasa ato që i jepnin asaj vlerë dhe paprekshmëri. Me t'u hapur tempulli qiellor i Perëndisë në të u duk arka e besëlidhjes së Tij. Në vendin më të shenjtë të shenjtores qiellore ruhet me kujdes ligji i shenjtë - ligji, që e shqiptoi vetë Perëndia i shoqëruar nga gjëmimet e Malit Sinai; ligji, që Ai e shkroi me gishtin e Tij mbi rrasat e gurit.

Ligji i Perëndisë që ruhet në shenjtoren qiellore është vetë origjinali, transkriptim i pagabueshëm i të cilit ishin urdhëresat që u shkruan mbi pllakat e gurit dhe u shkruan nga Moisiu tek Pentateuch-i[1]. Të gjithë atyre që kuptuan këtë pikë kaq të rëndësishme ju hapën sytë për të parë karakterin hyjnor dhe të pandryshueshëm të ligjit të shenjtë. Ata kuptuan si kurrë më parë forcën e fjalëve të Shpëtimtarit: "Deri

[1] Pentateuch - pesë librat e parë të Biblës.

sa qielli dhe toka të kalojnë, asnjë jetë e asnjë pikë e Ligjit nuk do të kalojë para se të plotësohet gjithçka." *(Mateu 5:18).* Ligji i Perëndisë duke qënë një shfaqje e dukshme e vullntetit dhe një pasqyrim i karakterit të Tij do të ekzistojë përgjithmonë si "një dëshmitar besnik në qiell." Nuk është shfuqizuar as edhe një fjalë. Psalmisti thotë: "Gjithnjë, o Zot, fjala jote është e qëndrueshme në qiejtë." - "Të gjitha urdhërimet e tij janë të qëndrueshme, të patundura përjetë." *(Psalmi 119:89; 111:7, 8)*.

Në qendër të Dhjetë Urdhëresave, ashtu si u shpallën për të parën herë, është urdhëresa e katërt: "Mbaje mend ditën e Shtunë për ta shenjtëruar. Do të punosh gjashtë ditë dhe në ato do të bësh të gjithë punën tënde, por dita e shtatë është e shtuna e shenjtë për Zotin, Perëndinë tënd; nuk do të bësh në atë ditë asnjë punë, as ti, as biri yt, as bija jote, as shërbëtori yt, as shërbëtorja jote, as kafshët e tua, as i huaji që ndodhet brenda portave të tua; sepse në gjashtë ditë Zoti krijoi qiejt dhe tokën, detin dhe gjithçka që është në to, dhe ditën e shtatë ai pushoi; prandaj Zoti e ka bekuar ditën e Sabatit dhe e ka shenjtëruar atë." *(Eksodi 20:8-12).*

Fryma e Perëndisë punoi brenda zemrave të atyre njerëzve që studionin fjalën e Tij. Ata u bindën se e kishin shkelur, nga padia e tyre, këtë urdhëresë duke mos përfillur ditën e pushimit të Krijuesit. Ata filluan të shqyrtonin arsyet për respektimin e ditës së parë të javës në vend të ditës që e kishte bekuar vetë Perëndia. Në Shkrimet e Shenjta ata nuk mundën të gjenin asgjë që të provonte se urdhëresës së katërt i kishte ikur koha apo që Sabati kishte ndryshuar; bekimi që fillimisht e kishte shenjtëruar ditën e shkatë, kishte qënë përgjithmonë pjesë e saj. Ata ishin përpjekur sinqerisht që ta njihnin dhe ta kryenin vullnetin e Perëndisë; tani, me të vënë re se ata vetë e kishin shkelur ligjin e Tij, zemrat e tyre u trishtuan dhe ata vendosën ta shprehnin besnikërinë e tyre ndaj Zotit duke e mbajtur Sabatin e Tij të shenjtë.

Përpjekjet për ta shkelur me këmbë besimin e tyre ishin të shumta dhe të zellshme. Të gjithë mund të kuptonin që në qoftë se shenjtorja tokësore ishte ndërtuar sipas modelit të tempullit qiellor, ligji që ruhej në arkën tokësore ishte identik me ligjin që mbahej në arkën qiellore; dhe që të pranoje të vërtetën e shenjtores qiellore do të thoshte të njihje kërkesat e ligjit të Perëndisë dhe urdhëresën e katërt, Sabatin. Këtu lindi edhe kundërshtimi i hapur dhe i vendosur ndaj parashtrimit harmonik të Shkrimeve të Shenjta, parashtrim që zbulonte shërbimin e Krishtit në shenjtoren qiellore. Njerëzit u përpoqën të mbyllnin derën që e kishte hapur vetë Zoti dhe të hapnin derën që Ai e kishte mbyllur. Por "Ai është që hap dhe askush nuk mbyll; dhe mbyll dhe askush nuk hap", kishte deklaruar: "Ja, të vura përpara një dere të hapur që asnjeri nuk mund ta mbyllë" *(Zbulesa 3:7, 8)*. Krishti kishte hapur derën apo shërbimin e "vendit shumë të shenjtë"; nga kjo derë e hapur e shenjtores qiellore doli dritë dhe kjo dritë nxori në pah faktin se urdhëresa e katërt është pjesë e ligjit që ruhet atje; atë që vendos Perëndia, askush s'mund ta hedhë poshtë.

Të gjithë ata, që e pranuan dritën që sjell ndërmjetësimi i Krishtit dhe përjetësinë e ligjit të Perëndisë, vunë re se këto të vërteta shpaloseshin shumë bukur në kapitullin 14 të Zbulesës. Mesazhet e këtij kapitulli përmbajnë në vetvete një paralajmërim të trefishtë që ka për detyrë të përgatisë banorët e tokës për ardhjen e dytë të Zotit. Mesazhi "Ora e gjyqit të tij erdhi", vë në dukje aktin përfundimtar të shërbimit të Krishtit për shpëtimin e njerëzve. Ai përmban një të vërtetë që do të shpallet deri sa t'i vijë fundi ndërmjetësimit të Shpëtimtarit dhe të vijë koha e ardhjes së Tij të dytë në tokë për të marrë me vete njerëzit e Tij. Gjykimi që ka filluar në vitin 1844, do të vazhdojë deri sa të merret vendimi për të gjithë njerëzit, për të gjallët e të vdekurit. Kështu do të marrë përmasa gjithnjë në rritje deri në fund të provës njerëzore. Në mënyrë që njerëzit të jenë gati për t'i qëndruar këtij gjykimi, mesazhi i urdhëron ata "t'i druhen Perëndisë, t'i japin lavid dhe ta adhurojnë atë që bëri qiellin, dheun, detin dhe burimet e ujrave. Në Bibël jepet qartë edhe rezultati që sjell pranimi i këtyre mesazheve: "Këtu janë ata që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë dhe besimin e Jezusit." Që të jenë të përgatitur për gjykim, është e nevojshme që njerëzit ta respektojnë ligjin e Perëndisë. Ky ligj do të jetë kriteri i karakterit të gjykimit. Apostulli Pal deklaron: "Të gjithë ata që kanë mëkatuar nën ligjin do të gjykohen sipas ligjit ... ditën në të cilën Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve me anë të Jezu Krishtit" Ai thotë se "ata që e zbatojnë ligjin do të shfajësohen." *(Romakëve 2:12-16)*. Për të mbajtur ligjin e Perëndisë nevojitet besim; sepse "pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij", dhe "çdo gjë që nuk bëhet me besim, është mëkat." *(Hebrenjve 11:6, Romakëve 14:23)*.

Engjëlli i parë u bën thirrje njerëzve që "ta druajnë Perëndinë dhe t'i japin lavdi" dhe ta adhurojnë Atë si Krijuesin e qiellit dhe të tokës. Në mënyrë që ta bëjnë këtë, ata duhet t'i binden ligjit të Tij. Njeriu i mençur thotë: "Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e Tij, sepse kjo është tërësia e njeriut." *(Predikuesit 12:13)*. Adhurimi i pëlqen Perëndisë vetëm kur në të përfshihet respektimi i urdhëresave të Tij. "Kjo është dashuria e Perëndisë që ne të zbatojmë urdhërimet e Tij." "Në rast se dikush kthen veshin gjetiu për të mos dëgjuar ligjin, vetë lutja e tij do të jetë e neveritshme." *(Gjonit 5:3; Fjalët e Urta 28:9)*.

Ne ndjejmë për detyrë që ta adhurojmë Perëndinë sepse Ai është Krijuesi dhe të gjitha qeniet e tjera ndjehen borxhli karshi Tij për ekzistencën e tyre. Dhe në Bibël, kudo ku përmendet kërkesa e Tij për adhurim dhe nderim mbi perënditë pagane, theksohet prova e fuqisë së Tij krijuese. "Sepse gjithë perënditë e kombeve janë idhuj, por Zoti ka bërë qiejtë." - Psalmisti 96:5. "Me kë kërkoni, pra, të më ngjasoni që të jem baraz me të?", thotë i Shenjti. Ngrini sytë tuaj përpjet dhe shikoni: Kush i krijoi këto gjëra?" "Sepse kështu thotë Zoti që ka krijuar qiejtë, ai, Perëndia që ka formuar tokën dhe e ka bërë: ... Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër." - Isaia 40:25, 26; 45:18. Psalmisti thotë: "Pranoni që Zoti është Perëndia; na ka bërë ai

dhe jo ne vetë." "Ejani, të adhurojmë dhe të përkulemi; të gjunjëzohemi përpara Zotit që na ka bërë." - Psalm 100:3; 95:6. Ndërsa qeniet hyjnore që e adhurojnë Perëndinë në shtetin qiellor shpjegojnë kështu arsyen e nderimit që ndjejnë për Të: "Ti je i denjë, o Zot, të marrësh lavdinë, nderimin dhe fuqinë sepse ti i krijove të gjitha gjërat." *(Zbulesa 4:11).*

Në kapitullin 14 të Zbulesës u bëhet thirrje që të adhurojnë Krijuesin dhe profecia flet për një grup njerëzish që si rezultat i mesazhit të trefishtë respektojnë urdhëresat e Perëndisë. Një nga këto urdhëresa, në mënyrë të drejtpërdrejtë, i drejtohet Zotit si Krijues. Urdhëresa e katërt thekson: "Dita e shtatë është e shtuna e shenjtë për Zotin, Perëndinë tënd ... sepse në gjashtë Zoti krijoi qiejt dhe tokën, detin dhe gjithçka që është në to, dhe ditën e shtunë ai pushoi; prandaj Zoti e ka bekuar ditën e Sabatit dhe e ka shenjtëruar atë." *(Eksodi 20:10, 11)*. Më pas, përsa i përket Sabatit, vetë Zoti thotë që, "ai është një shenjë ... që ju të pranoni që unë jam Zoti, Perëndia juaj." *(Ezekieli 20:20)*. Dhe jepet edhe arsyeja: "Sepse në gjashtë ditë Zoti bëri qiellin dhe tokën, dhe ditën e shtunë pushoi dhe u shlodh." *(Eksodi 31:17).*

"Perëndia i Sabatit si përkujtimore e Krijimit qëndron në faktin se na rikujton gjithmonë arsyen nga ku ne nisemi për t'ia kushtuar adhurimin tonë Perëndisë" - sepse Ai është Krijuesi dhe ne jemi krijesat e Tij. "Prandaj Sabati përbën themelin e adhurimit hyjnor sepse ai na ngulit në mendje këtë të vërtetë të madhe në mënyrën më impresionuese. Baza e vërtetë e adhurimit hyjnor, nuk po flasim këtu vetëm për bazën e Sabatit por për adhurimin në tërësi, është ndryshimi ose dallimi midis Krijuesit dhe krijesave të Tij. Ky është një fakt që nuk mund të vjetërohet dhe nuk duhet të harrohet. Kurrë"[2] Perëndia e krijoi Sabatin në kopshtin e Eden-it për ta ruajtur në mendjet njerëzore këtë të vërtetë të madhe; dhe Sabati do të vazhdojë të jetë shenjë dhe përkujtimore e Tij për aq kohë, sa fakti që Ai është Krijuesi ynë, do të mbetet arsyeja e adhurimit tonë për Të. Sikur bota mbarë ta kishte mbajtur të shenjtë Sabatin, mendjet dhe ndjenjat e njerëzve do të ishin drejtuar tek Krijuesi si i vetmi objekt nderimi dhe adhurimi dhe s'do të kishte as idhujtarë, as ateistë dhe as të pafe. Mbajtja e Sabatit është një shenjë besnikërie ndaj Perëndisë së vërtetë, ndaj "Atij që bëri qiellin, dheun, detin dhe burimet e ujrave." Rrjedhimisht, mesazhi që i urdhëron njerëzit ta adhurojnë Perëndinë dhe t'i respektojnë urdhëresat e Tij u bën thirrje atyre që të mbajnë të shenjtë në mënyrë të veçantë urdhëresën e katërt.

Engjëlli i tretë përshkruan një grup tjetër njerëzish, kryesisht të ndryshëm nga ata që respektojnë urdhëresat e Perëndisë dhe kanë besim tek Jezu Krishti, kundër gabimeve të të cilave shpallet një paralajmërim solemn dhe i frikshëm: "Nëse ndokush adhuron bishën dhe figurën e saj dhe merr damkën mbi ballin e vet ose mbi dorën e vet, do të pijë edhe ai nga vera e zemërimit të Perëndisë." *(Zbulesa 14:9, 10).* Në mënyrë që të kuptohet domethënia e këtij mesazhi duhen interpretuar saktësisht simbolet që përdoren në të. Çfarë përfaqëson bisha, figura dhe damka?

---

[2] .J.N. Andrews, "History of Sabbath", kapitulli 27.

Linja profetike në të cilën gjenden këto simbole fillon në kapitullin 12 të Zbulesës me dragonin që u përpoq që ta zhdukte Krishtin që në lindjen e Tij. Thuhet se dragoi është Satani *(Zbulesa 12:9)*; ishte pikërisht ai (Satani) që u përpoq me anë te Herodit që ta vriste Shpëtimtarin. Por, Perandoria Romake, në të cilën mbizotëronte paganizi, ishte, gjatë shekujve të parë të Kristianizmit, agjenti kryesor i Satanit në luftën kundër Krishtit dhe njerëzve të Tij. Kështu, ai përbën një simbol edhe të Romës pagane.

Në kapitullin 13 *(versat 1-10)* përshkruhet një bishë tjetër "që i ngjante një leopardi", të cilës dragoi i dha "fuqinë e vet, fronin e vet dhe autoritet të madh." Pjesa më e madhe e Protestantëve besojnë se ky simbol përfaqëson papatin i cili pasoi dhe trashëgoi fuqinë, fronin dhe autoritetin e perandorisë së hershme Romake. Për kafshën që i ngjante leopardit thuhet: "Dhe iu dha një gojë që flet gjëra të mëdha dhe blasfemi ... Dhe ajo hapi gojën e vet për të blasfermuar kundër Perëndisë, për të blasfermuar emrin e Tij, tabernakullin e Tij dhe ata që banojnë në qiell. Dhe iu dha të bëjë luftë kundër të shenjtëve dhe t'i mundë; iu dha pushtet mbi çdo fis, gjuhë dhe komb." Kjo profeci që është pothuajse identike me përshkrimin e bririt të vogël të kapitullit 7 të librit të Danielit, pa as më të voglin dyshim nxjerr në pah papatin.

"Ju dha pushtet të veprojë për dyzet e dy muaj." Profeti thotë: "Pashë një nga krerët e saj si të plagosur për vdekje." Më pas theksohet: "Kush e çon tjetrin në robëri, në robëri do të bjerë; kush vret me shpatë, duhet edhe ai të vritet me shpatë." Të dyzet e dy muajt barazojnë "një farë kohe, disa kohë dhe gjysmën e një kohe", tre vjetët e gjysëm apo 1260 ditët e kapitullit të shtatë të Librit të Danielit, - kohën gjatë të cilës papati duke ushtruar pushtetin e vet do t'i shtypte njerëzit e Perëndisë. Kjo periudhë, siç është shpjeguar në kapitujt e mëparshëm, filloi me epërsinë e papatit në vitin 538 e.s dhe përfundoi në vitin 1798. Pikërisht në këtë kohë ushtria franceze kapi rob papën, papati u plagos për vdekje dhe profecia "Kush e çon tjetrin në robëri, në robëri do të bjerë..." u përmbush.

Me të arritur në këtë pikë përdoret një simbol tjetër. Profeti thotë: "Pastaj pashë një bishë tjetër, që ngjitet nga dheu, dhe kishte dy brirë që i ngjanin atyre të qingjit ..." *(versa 11)*. Si shfaqja e kësaj kafshe, ashtu edhe mënyra e ngjitjes së saj tregojnë qartë se ajo përfaqson një komb që nuk i ngjan kombeve që përfaqësojnë simbolet pararendëse. Profetit Daniel, mbretëritë që kanë sunduar botën, i janë shfaqur në formën e bishave; bisha që ngriheshin "kur katër erërat e qiellit tronditën Detin e Madh." *(Danieli 7:2)*. Në kapitullin 17 të Zanafillës një engjëll shpjegon se ujërat përfaqësojnë "popuj dhe turma, dhe kombe, dhe gjuhë." *(Zbulesa 17:15)*. Erërat janë simbole konfliktesh. Katër erërat e qiellit që tronditën Detin e Madh përfaqësojnë skenat e tmerrshme të revolucioneve dhe pushtimeve që shërbyen si bazë e pushtetit të këtyre mbretërive.

Por u shfaq një bishë me brirë që i ngjanin atyre të qengjit "duke u ngritur nga dheu." Në vend që të rrëzonte pushtetin e mbretërive të tjera për t'i bërë vend vetes,

kombi që përfaqësohet nga ky sibmol duhet të krijohet në një teritor të papopulluar dhe të rritet në mënyrë graduale dhe të pashoqe. Nga kjo del se ai s'mund të krijohej si komb në mes të kombeve luftënxitëse të Kontinentit të vjetër - në mes të atij deti të turbullt "popujsh dhe turmash, kombesh dhe gjuhësh." Duhet kërkuar diku në Kontinentin Perëndimor.

Cili komb i Botës së Re në vitin 1798 po fuqizohej duke pasur të gjitha premisat e një kombi të fuqishëm dhe të madh dhe duke tërhequr vëmendjen e botës mbarë? Fjalët e kësaj profecie nuk të lënë asnjë dyshim. Një komb, një komb i vetëm i përmbush, ajo flet për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Herë pas here, pa vetëdije,oratorët dhe historianët kanë përdorur në përshkrimin e lindjes dhe të rritjes së këtij kombi jo vetëm idenë e dhënë nga shkrimtarë hyjnorë, por edhe fjalët e zgjedhura prej tij. U vunë re se bisha "u ngjit nga dheu" dhe sipas përkthyesve shprehja që përdoret këtu "u ngjit", fjalë për fjalë do të thotë "të zhvillosh apo të çelësh si lule." Dhe duke iu referuar asaj që thamë më lart, ky komb duhej të lindte në një territor të populluar. Një shkrimtar i njohur, duke përshkruar krijimin e Shteteve të Bashkuara, flet për "misterin e ngjitjes së saj nga një hapsirë boshe", dhe thotë "Nga një farë e heshtur që ishim në fillim, ne u bëmë perandori."[3] Në vitin 1850, një gazetë evropiane e përshkruan Amerikën si një perandori të mrekullueshme që po "dilte", "duke fituar krenari dhe duke u fuqizuar në mes tokës së heshtur."[4] Eduard Everet, gjatë një fjalimi mbi themeluesit Shtegtarë të këtij kombi, tha: "Kërkonin ata vallë një vend të qetë e të paqshëm për shkak të izolimit të tij dhe të sigurtë për shkak të largësisë së tij ku kisha e vogël Leiden-it të mund t'i gëzohej lirisë së ndërgjegjes? Shihni zemrat madhështore që ata i kanë pushtuar paqësisht ... flamujtë e kryqit.[5]

"Ai kishte dy brirë që i ngjanin atyre të qengjit." Brirët që i ngjajnë atyre të qengjit tregojnë rini, pafajsi dhe mirësi; karakteristika që përfaqësojnë shumë mirë karakterin e këtij kombi, në vitin 1798. Shumë prej të Krishterëve, që u detyruan të mërgojnë në Amerikë dhe u përpoqën të gjejnë atje strehë për t'i shpëtuar shtypjes që ushtronin mbretërit dhe zgjedhës që u vinin priftërinjtë, ishin të vendosur për ta qeverisur vendin në bazë të parimeve të lirisë civile dhe fetare. Këto pikpamje u mishëruan tek Deklarata e Pavarësisë që nxjerr në pah të vërtetën e madhe që "të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë" dhe të pajisur me të drejtën e pamohueshme "për të jetuar për të qënë të lirë dhe të lumtur." Kushtetuta u garanton të gjithë njerëzve të drejtën e vetëqeverisjes duke theksuar ligjet e shtetit.Gjithkush gëzon lirinë e besimit dhe çdo njeriu i lejohet që ta adhuroje Perëndinë sipas ligjeve të ndërgjegjes së vet. Protestianizmi dhe Republikanizmi përbënin parimet themelore të këtij kombi. Dhe janë këto parime që përbëjnë sekretin e fuqisë dhe prosperitetit

[3] G.A. Townsend, "The New World Compared with the Old", f 462

[4] The Dublin Nation

[5] Speech delivered at Plymouth, Massachusetts, më 22 Dhjetor 1824, f 11.

të tij. Të Krishterët e shtypur dhe të persekutuar erdhën në këtë vend me shpresë dhe gëzim në zemër. Miliona njerëz kanë zbritur në brigjet e tij dhe Shtetet e Bashkuara janë sot nga kombet më të fuqishme të botës.

Por bisha me brirët si të qingjit "fliste si një dragua. Ajo ushtronte gjithë pushtetin e bishës së parë përpara saj dhe bënte që dheu dhe banorët e tij të adhurojnë bishën e parë, së cilës iu shërua plaga vdekjeprurëse; ... duke u thënë banorëve të dheut t'i bëjnë në figurë bishës që kishte plagën e shpatës dhe u kthye në jetë." *(Zbulesa 13:11-14)*.

Simboli me brirët si të qengjit dhe zërin e draguas nxjerr në pah një kontradiktë të thellë mes thënieve teorike dhe praktikës së ndjekur nga kombi i përfaqësuar prej tij. "Të falurit" e këtij kombi përfaqëson veprimtarinë e autoriteteve legjislative dhe gjyqësore. Një veprimtari e tillë do t'u vërë shkelmin parimeve liberale dhe paqedashëse që përbënin themelin e politikës kombëtare. Fakti që ai do të flasë "si një dragua" dhe do të ushtrojë "pushtetin e bishës së parë" parashikon në mënyrë të qartë se në të do të lindë e do të fuqizohet fryma e shtypjes dhe persekutimit që dikur manifestohej tek kombet që përfaqësohen nga dragoi dhe bisha që i ngjante leopardit. Thënia, sipas së cilës bisha me dy brirë "do ta bënte dheun dhe banorët e tij të adhurojnë bishën e parë" tregon se ky komb do ta ushtronte autoritetin e vet për t'i detyruar të tjerët të respektonin një rit të caktuar që do të ishte një akt nderimi ndaj papatit.

Një veprim i tillë do të binte në mënyrë të drejtpërdrejtë në kundërshtim të hapur me parimet e qeverisë, me lirinë e veprimtarisë së organizmave shtetërore, me pohimet e Deklaratës së Pavarësisë dhe me Kushtetutën e këtij vendi. Themeluesit e këtij kombi u orvatën me të gjitha forcat që t'i ruheshin ushtrimit të pushtetit sekular nga ana e kishës dhe rezultateve të pashmangshme të këtij ushtrimi - shtypjes dhe persekutimit. Në bazë të Kushtetutës "Kongresi nuk do të miratojë asnjë ligj që do të çojë në vëmendjen e një feje të caktuar apo në ndalimin e ushtrimit të lirë të besimit" dhe "nuk do të kërkohet asnjë kriter fetar për t'u punësuar a për t'u zgjedhur në organizmat e larta shtetërore të Shteteve të Bashkuara." Autoritetet civile do të mund t'i detyrojnë njerëzit që të respektojnë një formë të caktuar besimi vetëm në qoftë se do t'i shkelim në mënyrë flagrante këto masa që sigurojnë lirinë e kombit. Vetë simboli shpreh shumë qartë kontradiktën që mbart në vetvete një veprimtari e tillë. Kemi të bëjmë me një bishë me brirë si të qingjit - në dukje e pastër. e butë, që s'i bën keq askujt - që flet si dragua.

"Duke u thënë banorëve të dheut që ata duhet t'i bëjnë një figurë bishës." Këtu paraqitet shumë qartë një formë qeverisjeje në të cilën janë njerëz ata që kanë në duart e tyre pushtetin legjistlativ, një provë interesante kjo që tregon se në profeci flitet për Shtetet e Bashkuara.

Po çfarë kuptojmë me figurë të bishës? Si do të krijohet kjo figurë? Figura krijohet nga një bishë me dy brirë dhe është një figurë që i bëhet bishës. Por njihet

gjithashtu dhe si figura e bishës. Kështu, në mënyrë që të kuptojmë se si është kjo figurë dhe se si do të krijohet ajo, ne duhet të studiojmë karakteristikat e vetë bishës - papatit.

Kur kisha e hershme u korruptua sepse hoqi dorë nga thjeshtësia e ungjillit dhe pranoi rite dhe zakone pagane, ajo humbi fuqinë dhe Frymën e Perëndisë; kështu, në mënyrë që të konkretizonte ndërgjegjet e njerëzve, ajo kërkoi mbështetjen e pushtetit sekular. Si rezultat i kësaj lindi papati, një kishë që kontrollonte shtetin dhe përdorte pushtetin e këtij shteti për të arritur qëllimet e veta, veçanërisht për t'i dhënë dënimin e duhur "herezisë". Në mënyrë që Shtetet e Bashkuara të krijojnë figurën e bishës duhet që pushteti fetar të kontrollojë qeverinë civile dhe që autoriteti i kësaj të fundit të përdoret nga kisha për të arritur qëllimet e saj. Sa herë që kisha ka pasur në dorë pushtin sekular, e ka përdorur atë për të dënuar të gjithë ata që kundërshtonin doktrinat e saj. Edhe kishat Protestante që nuk kanë ecur në gjurmët e Romës duke u lidhur me fuqitë botërore kanë shfaqur të njëjtën dëshirë për t'i vënë cak lirisë së mendimit e ndërgjegjes. Persekutimi i gjatë dhe i vazhdueshëm që Kisha e Anglisë ushtroi ndaj opozitarëve të doktrinave të saj, është një shembull i qartë i këtij fakti. Gjatë shekujve të XVI-të dhe të XVII-të me mijëra ministra (jokonformistë) u detyruan të largoheshin nga kishat e tyre dhe shumë të tjerë, njerëz të thjeshtë dhe pastrehë, iu nënshtruan gjobave, burgimeve, torturave dhe vdekjes.

Për shkak të heqjes dorë nga besimi, kisha e hershme kërkoi ndihmën e qeverisë civile dhe kjo i hapi rrugë zhvillimit dhe fuqizimit të papatit - bishës. Pali thotë: "... do të vijë më parë rënia dhe do të shfaqet njeriu i mëkatit." *(2 Selanikasve 2:3)*. Pra heqja dorë nga besimi i përgatiti rrugën figurës që iu bë bishës.

Në Bibël thuhet se përpara ardhjes së Zotit, në kisha do të mbizotërojë një rrënim fetar i njëjtë me atë të shekujve të parë. "Në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira, sepse njerëzit do të jetë egoistë, lakmues parash, mburravecë, krenarë, blasfemues, të pabindur ndaj prindërve, mosmirënjohës, të paudhë, të padhembshur, të papajtueshëm, shpifës, të papërmbajtur, mizorë, që s'e duan të mirën, tradhëtarë, kokëfortë, fodullë, dëfrimdashës më fort se perëndidashës, të perëndishëm në dukje, por mohues të fuqisë së tij." *(2 Timoteut 3:1-5)*. "Dhe Fryma thotë hapur se në kohët e fundit disa do të mohojnë besimin, duke u vënë veshin shpirtrave gënjeshtarë dhe doktrinave të demonëve." *(1 Timoteut 4:1)*. Satani do të përdorë: "çudira, shenja dhe mrekulli të rreme." Dhe të gjitha ata "që nuk pranuan ta duan të vërtetën për të qënë të shpëtuar" do të përjetojnë "një gënjim që t'i besojnë gënjeshtrës." *(2 Selanikasve 2:3-11)*. Një gjendje e tillë kaosi do të pasohet nga të njëjtat rezultate që u vunë re edhe në shekujt e parë.

Shumë njerëz mendojnë se fakti që kishat Protestante besojnë në gjëra të ndryshme, provon se është e kotë përpjekja për të siguruar një farë uniteti mes tyre. Megjithatë, për vite me rradhë, kishat Protestante e kanë përkrahur idenë e unitetit ndërmjet tyre. Por gjatë bisedimeve jo të gjithë ranë dakord përsa i përket çështjeve

të rëndësisë së veçantë nga këndvështrimi Biblik, rrjedhimisht u hoq dorë nga përpjekjet për të siguruar një farë uniteti mes këtyre kishave.

Charles Beecher, gjatë një shërbese që mbajti në vitin 1846, deklaroi se të gjithë ministrat dhe pastorët e "sekteve të ndryshme Protestante, jo vetëm që janë edukuar nga i pari tek i fundit, me një ndjenjë të tmerrshme frike, por edhe jetojnë, lëvizin dhe marrin frymë në një ambjent ku gjithçka është e korruptuar dhe në mënyrë që ta fshehin të vërtetën dhe ta kenë më të lehtë të gjunjëzohen përpara fuqisë së fenomeneve, ata i bëjnë thirrje elementeve më negativë të natyrës së tyre njerëzore. A nuk ndodhi edhe me Romën kështu? A nuk po përsërisim eksperiencën e saj? Dhe çfarë na pret në të ardhmen? Një këshill tjetër i përgjithshëm! Një marrëveshje ndërkombëtare! Unitet pikpamjesh dhe një besim mbarëbotëror!"[6]. Me t'u arritur një gjë e tillë, do të shtohen përpjekjet për të siguruar një unitet të plotë veprimi dhe mendimi dhe kjo mund të arrihet vetëm në një mënyrë: me përdorimin e forcës.

Kur kishat kryesore të Amerikës, falë disa pikave të përbashkëta të doktrinave të tyre, do të ushtrojnë ndikim mbi shtetin që ky i fundit të nxjerrë ligje në përkrahje të doktrinave dhe në mbrojtje të institucioneve të tyre, Amerika Protestante do të ketë formuar figurën e hirarkisë Romake dhe kjo, në mënyrë të pashmangshme, do të çojë në ndëshkimin e të gjithë atyre që do të kundërshtojnë.

Bisha me brirë "bëri (urdhëroi) që të gjithë, të vegjël e të mëdhenj, të pasur dhe të varfër, të lirë dhe skllevër, t'u vihet një damkë mbi dorën e tyre të djathtë ose mbi ballin e tyre, që askush te mos mund të blinte ose të shiste, po të mos kishte damkën, ose emrin e bishës ose numrin e emrit të saj." *(Zbulesa 13:16,17).* Engjëlli i tretë paralajmëron kështu: "Nëse ndokush adhuron bishën dhe figurën e saj dhe merr damkën mbi ballin e vet ose mbi dorën e vet, do të pijë edhe ai nga vera e zemërimit të Perëndisë."

"Bisha" që përmendet në këtë mesazh, adhurimi i të cilës është bërë i detyrueshëm nga bisha me dy brirë, është bisha e parë që i ngjante leopardit të kapitullit 13 të Zbulesës - papati: "Figura që i bëhet bishës" përfaqëson atë formë të Protestianizmit femohues që do të zhvillohet atëherë kur kishat Protestante do t'i detyrojnë njerëzit që t'i përkrahin doktrinat e tyre me ndihmën e pushtetit civil. Tani na duhet të shpjegojmë kuptimin e "Damkës së bishës."

Profeti, me të paralajmëruar për rrezikshmërinë e adhurimit të bishës dhe figurës së saj, deklaron: "Këtu janë ata që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë dhe besimin e Jezusit." Duke qënë se ata që mbajnë urdhërimet e Perëndisë janë vënë në kontrast me ata që adhurojnë bishën dhe figurën e saj dhe kanë marrë damkën e saj, rrjedhimisht dallimi midis adhuruesve të Perëndisë dhe atyre të bishës do të bëhet në bazë të respektimit të ligjit të Perëndisë nga njëra anë, dhe shkeljes së tij nga ana tjetër.

Veçoria dalluese e bishës dhe figurës së saj është shkelja e urdhërimeve të Perëndisë. Duke folur për bririn e vogël, pra për papatin, Danieli thotë: "Ai do

[6] Shërbesë mbi "The Bible a sufficient Creed", mbajtur në Tort Wayne, Indiana më 22 Shkurt 1846

të mendojë të ndryshojë kohërat dhe ligjin." *(Danieli 7:25)*. Pali e quan të njëjtën forcë me emrin "njeriu i mëkatit" që do ta lartësonte veten e tij mbi Perëndinë. Njëra profeci plotëson tjetrën. Papati mund të lartësohej mbi Perëndinë vetëm duke ndryshuar ligjin e Perëndisë; kushdo që do ta respektonte me vetëdije ligjin e ndryshuar do t'i jepte lavdi fuqisë që kishte bërë ndryshimin. Një respektim i tillë i ligjeve të papatit do të përbënte një damkë besnikërie ndaj papës në vend të besnikërisë ndaj Perëndisë.

Papati është përpjekur që ta ndryshojë ligjin e Perëndisë. Ligjit i është hequr urdhëresa e dytë që ndalon adhurimin e idhujve dhe urdhëresa e katërt është ndryshuar deri në atë pikë sa si Sabat nuk konsiderohet dita e shtatë por dita e parë e javës. Papistët deklarojnë se duke hequr urdhëresën e dytë ata po lënë jashtë ligjit një pjesë të panevojshme dhe dhe që i përkiste të shkuarës duke i dhënë ligjit vlerën që Perëndia donte t'i jepte atij. Profeti nuk mund të ketë parashikuar këtë lloj ndryshimi. Kemi të bëjmë me një ndryshim të qëllimshëm dhe të paramenduar: "Ai do të mendojë të ndryshojë kohët dhe ligjet." Është ndryshimi që i bëhet urdhëresës së katërt që përmbush në mënyrë të saktë këtë profeci. Në lidhje me këtë urdhëresë njihet vetëm autoriteti i kishës. Këtu papati e vë haptazi veten mbi Perëndinë.

Ndërsa adhuruesit e Perëndisë do të dallohen në mënyrë të veçantë nga kujdesi që do t'i kushtojnë urdhëresës së katërt - meqënëse ajo përbën një shenjë të fuqisë së Tij krijuese dhe dëshmi të së drejtës së Tij për t'u adhuruar e nderuar nga njerëzit, -adhuruesit e bishës do të shquhen nga përpjekjet që do të bëjnë për ta rrëzuar përkujtimoren e Krijuesit dhe për të lartësuar atë të Romës. Pretendimet arrogante të papatit filluan me "të dielën"; dhe në mënyrë që e diela të konsiderohej si "dita e Zotit" ai kërkoi ndihmën e pushtetit shtetëror. Por Bibla thekson se është dita e shtatë e javës dita e Zotit, dhe jo e para. Krishti tha: "Biri i njeriut është Zot edhe i së shtunës." Në urdhëresën e katërt thuhet: "Dita e shtatë është e shtuna e shenjtë (Sabati) i Zotit." Dhe nëpërmjet profetit Isaia, Zoti e quan atë si "Ditën e Tij të shenjtë" *(Marku 2:28, Isaja 58:13)*.

Shpesh herë pretendohet se Krishti e ndryshoi Sabatin; pretendim që hidhet poshtë nga vetë fjalët e Tij. Në shërbesën që mbajti në mal, Ai tha: "Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose profetët; unë nuk erdha për t'i shfuqizuar, po për t'i plotësuar. Sepse në të vërtetë ju them: Deri sa qielli dhe toka të kalojnë, asnjë jetë e asnjë pikë e ligjit nuk do të kalojë, para se të plotësohet gjithçka. Ai pra, që do të shkelë një nga urdhërimet më të vogla dhe do t'u ketë mësuar kështu njerëzve, do të quhet më i vogli në mbretërinë e qiejve; kurse ai që do t'i vërë në praktikë dhe do t'ua mësojë të tjerëve, do të quhet i madh në mbretërinë e qiejve." *(Mateu 5:17-19).*

Përgjithësisht, Protestantët e pranojnë faktin që Shkrimet e Shenjta nuk autorizojnë ndryshimin e Sabatit. Kjo duket qartë në disa botime të American Tract

Society dhe American Sunday School Union. Në një nga këto punime theksohet se "në Dhiatën e Re nuk ka asnjë të dhënë të saktë për ndryshimin e Sabatit në të Dielë, ditën e parë të javës, dhe as për rregulla të caktuara që kanë të bëjnë me adhurimin në këtë ditë."[7]

Një tjetër thotë: "Dita nuk është ndryshuar derisa vdiq Krishti;" dhe "të dhënat tregojnë se ata (apostujt) nuk ... dhanë ndonjë urdhër të qartë që të kishte të bënte me braktisjen e Sabatit të ditës së shtatë dhe me respektimin e ditës së parë si ditë adhurimi."[8]

Katolikët Romakë pranojnë se Sabatin e ndryshoi kisha e tyre dhe deklarojnë se Protestantët, duke mbajtur të Dielën si ditë të shenjtë, njohin pushtetin e saj. Në revistën "Catholic Catechism of Christian Religion" në përgjigjen që iu dha pyetjes se cila ditë duhet të konsiderohet si e shenjtë në lidhje edhe me urdhëresën e katërt, thuhet:" Në të shkuarën e hershme, e shtuna ishte dita e shenjtë, por kisha e udhëzuar nga Jezu Krishti dhe drejtuar nga Fryma e Perëndisë ka zëvendësuar të shtunën me të dielën; pra, tani ne e konsiderojmë si të shenjtë ditën e parë dhe jo ditën e shtatë të javës. E diela tani është dita e Zotit."

Sipas shkrimtarëve papistë "vetë akti ndryshimit të Sabatit nga e shtuna në të dielë, që u pranua edhe nga Protestantët ..." përbën shenjën e autoritetit të Kishës Katolike. "Protestantët, - thonë ata, - duke mbajtur të dielën të shenjtë, njohin fuqinë e kishës për të caktuar festat fetare apo për t'i quajtur ato mëkate."[9]. Pra, ndryshimi i Sabatit s'është asgjë tjetër veçse shenja apo damka e autoritetit të Kishës Romake - damka e bishës".

Kisha Romake nuk ka hequr dorë nga pretendimi absurd për pushtet suprem; dhe kur bota e bashkë me të kishat Protestante pranojnë një sabat - krijim të saj, ndërsa i vënë shkelmin Sabatit Biblik, në fakt ata po e pranojnë një supozim të tillë. Është e vërtetë se ata mund të deklarojnë që ndryshimi ka ardhur falë traditës apo paraardhësve të tyre; por duke vepruar kështu ata po harrojnë parimin që i ndan nga Roma - parimin, sipas të cilit, Bibla dhe vetëm Bibla përbën fenë e protestantëve. Papistët e shohin që ata po mashtrojnë vetveten duke mbyllur sytë me vetëdije përpara fakteve të qarta. Ndërsa lëvizja për shenjtërimin e së dielës fuqizohet çdo ditë e më shumë, ai ngazëllohet, duke qënë i sigurtë se kjo lëvizje do të çojë rrjedhimisht kishat Protestante nën flamurin e Romës.

Katolikët deklarojnë se "fakti që Protestantët mbajnë të dielën si ditë të shenjtë është, pavarësisht nga ajo që thonë, një shenjë repsekti ndaj autoritetit të kishës (Katolike)."[10]. Respektimi i detyrueshëm i së dielës nga kishat Protestante do të thotë adhurim i detyrueshëm i papatit - domethënë i bishës. Të gjithë ata, që edhe pse e kujtojnë rëndësinë e urdhëresës së katërt, vendosin që të mbajnë Sabatin e

[7] George Elliott "The Abiding Sabbath", f 184.
[8] A. E. Waffle, "The Lord's Day", f 186-188.
[9] Henry Tuberville, "An Abridgment of the Christian Doctrine", f 58
[10] Mgr. Segur, "Plain Talk About the Protestantism of Today", f 213

rremë në vend të Atij të vërtetë, nderojnë fuqinë që urdhëroi mbajtjen e tij. Por pranimi i një ceremonie fetare të imponuar nga forcat sekulare do të thotë që vetë kishat do të krijojnë figurën e bishës; rrjedhimisht respektimi i detyrueshëm i së dielës në Shtetet e Bashkuara përbënte adhurimin e detyruar të bishës dhe figurës së saj.

Por të Krishterët e brezave të mëparshëm adhuronin në ditën e dielë duke menduar se në këtë mënyrë, po respektonin Sabatin Biblik; edhe sot e kësaj dite në çdo kishë ka shumë të Krishterë të vërtetë, që edhe pse hedhin poshtë disa pikëpamje të gabuara të Kishës së Romës, ata besojnë ndershmërisht se e Diela është Sabati i takimit hyjnor. Zoti i pranon qëllimet e tyre të sinqerta dhe ndershmërinë që ata i shprehin. Por kur respekti i së dielës do të bëhet i detyrueshëm me ligj dhe njerëzve do t'u bëhet i qartë koncepti dhe detyrimi që mbart në të vërtetë Sabati i vërtetë, atëherë kushdo që do ta shkelë urdhëresën e Perëndisë për t'iu bindur urdhrit të Romës do ta lartojnë papatin mbi vetë Zotin. Ai do të nderojë Romën dhe fuqinë që i bën të detyrueshëm vendimin e saj. Kështu, ndërsa njerëzit mohojnë atë që Zoti e ka caktuar të jetë shenjë e autoritetit të Tij dhe në vend të saj, nderojnë atë që Roma e ka zgjedhur si shenjë epërsie, ata pranojnë me fjalë të tjera shenjën e besnikërisë ndaj Romës - pranojnë "damkën e bishës." Të gjithë ata që do të vazhdojnë ta shkelin me këmbë ligjin ePerëndisë do ta marrin "damkën e bishës" vetëm atëherë kur gjithçka të jetë bërë e qartë për njerëzit dhe ata të kenë zgjedhur midis urdhëresave të Zotit dhe atyre të njerëzve.

Mesazhi i engjëllit të tretë është kërcënimi më i frikshëm që ju është drejtuar ndonjëherë njerëzve. Mëkati, që bën të derdhet kupa e papërzier me mëshirën e Perëndisë, duhet të jetë shumë i tmerrshëm. Mendjet e njerëzve do të ndriçohen përsa i përket kësaj çështjeje të rëndësishme; bota do të paralajmërohet për rrezikun e këtij mëkati përpara zbatimit të gjykimit të Zotit, në mënyrë që të gjithë ta dinë pse do të ndëshkohen dhe të kenë mundësi t'i shpëtojnë atij. Në profeci thuhet që engjëlli i parë do t'ia predikojë mesazhin e tij "çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli." Edhe mesazhi i engjëllit të tretë që është pjesë e mesazhit të trefishtë, do të ketë të njëjtën përkrahje. Thuhet se ai do të shpallet me zë të lartë nga një engjëll që do të fluturojë në mes të qiellit duke tërhequr vëmendjen e botës mbarë.

Përsa i përket këtij problemi të gjithë të Krishterët do të ndahen në dy grupe të mëdha - ata që do të mbajnë urdhëresat e Perëndisë dhe do t'i besojnë Jezu Krishtit dhe ata do të adhurojnë bishën dhe figurën e saj dhe do të marrin damkën e tyre. Megjithëse kisha dhe shteti do të bashkojnë forcat e tyre për të detyruar "të gjithë, të vegjël e të mëdhenj, të pasur dhe të varfër, të lirë dhe skllevër" *(Zbulesa 13:16)* të marrin "damkën e bishës", populli i Perëndisë nuk do ta marrë atë. Profeti i Patmosit sheh "ata që kishin mundur bishën, figurën e saj, damkën e saj dhe numrin e emrit të saj duke qëndruar mbi një det të qelqtë. Ata kishin harpat e Perëndisë" dhe këndonin këngën e Moisiut dhe të Qingjit. *(Zbulesa 15:2 3).*

1. Cilat janë disa nga karakteristikat e bishës që ka dy brirë si të qingjit? Çilën përfaqëson kjo bishë?

2. Cilat prej dy urdhërimeve preken direkt kur papati "mendon të ndryshojë kohërat dhe ligjet"?

3. Nëse do tju kërkohej nga Shkrimet që e Shtuna është ende Sabati i vërtetë, çfarë tekstesh do të përdornit?

26.

Një Punë Reformash

Fakti që reforma për Sabatin do të ndërmerrej në ditët e fundit parashkohet edhe në profecinë e Isaies: "Kështu thotë Zoti: "Respektoni të drejtën dhe zbatoni drejtësinë, sepse shpëtimi im është duke ardhur dhe drejtësia ime do të shfaqet. Lum njeriu që vepron kështu dhe biri i njeriut që i përmbahet kësaj, që respekton Sabatin pa përdhosur dhe që mban dorën nga kryerja e çfarëdo veprimi të keq." "Bijtë e të huaje që janë bashkuar me Zotin për t'i shërbyer, për të dashur emrin e Zotit dhe për të qënë shërbëtorë të tij, tërë ata që respektojnë Sabatin pa e përdosur dhe i përmbahen me vendosmëri beslidhjes sime, do t'i çoj në malin Tim të shenjtë dhe do t'i mbush me gëzimnë shtëpinë Time të lutjes." - Isaia 36:1, 2, 6, 7.

Këto fjalë i drejtohen të Krishterëve të erës sonë sipas këtij konteksti: "Zoti, Zoti që i mbledh të shpërndarët e Izraelit, thotë: "Unë do të mbledh rreth tij edhe të tjerë, përveç atyre që kam mbledhur." - Versa 8. Në këtë pasazh, parashikohet grumbullimi që do ta mbajnë Sabatin të shenjtë do të bekohen në mënyrë të veçantë. Kështu, detyrimi që mbart në vetvete urdhëresa e katërt shktrihet përtej kryqëzimit, përtej ringjalljes, përtej rikthimit të Krishtit në qiell dhe ruhet i pacënuar edhe në kohën kur shërbëtorët e Perëndisë ua predikuanmesazhin e ungjillit të gjitha kombeve.

Zoti, përmes të njëjtit profet, udhrëron: "Mbylle këtë dëshmi, vulose këtë ligj midis dishepujve të mi." - Isaia 8:16. Vula e ligjit të Perëndisë gjendet tek urdhëresa e katërt. Mes dhjetë urdhëresave, kjo është e vetmaj që nxjerr në pah si emrin, ashtu edhe të drejtën e Ligjdhënësit. Kjo urhdëresë e quan Atë, Krijuestë qiellit dhe të tokës, duke treguar në këtë mënyrë, se Ai meriton respektin dhe adhrimin tonë mbi gjithçka tjetër. Kjo është e vetmja urdhëresë në ligjin që iu dha Moisiut, që tregon majft qartë autoritetin e këtij ligji. Kur papati me autoritetin e tij ndryshoi Sabatin, këtij ligji i humbi vula. Dishepujve të Jezusit u bëhet thirrje që t'i japin vendin e duhur Sabatit, si përkujtimore e Krijuesit dhe si shenjë e autoritetit të Tij.

"Përmbajuni ligjit dhe dëshmisë." Megjithëse numri i doktrinave dhe teorive kontradikotre rritet çdo ditë, mbetet gjithmonë i vërtetë fakti, që ligji i Perëndisë është i vetmi rregull i pagabueshëm me të cilin duhet të provohet vërtetësia e të gjithë këtyre opinioneve, teorive dhe doktrinave. "Në rast se ata nuk flasin në këtë mënyrë, (duke iu përmbajtur ligjit dhe dëshmisë) kjo do të thotë se ata nuk kanë dritë." - Isaia 8:20.

Urdhëri përsëritet: "Bërtit sa të mundesh, mos u kurse; ngrije zërin tënd si një bori dhe shpalli popullit tim shkeljet e tij dhe shtëpisë së Jakobit mëkatet e saj." Për "shkeljet" nuk do të qortohet bota mëkatare, por ata që Perëndia i përshkruan si "popullin e Vet." Më pas, Ai deklaron: "Më kërkojnë çdo ditë dhe dëshirojnë të njohin rrugët e mia, si një komb që zbaton drejtësinë dhe nuk braktis ligjin e Perëndisë së Tij." - Isaia 58:1, 2. Këtu përshkruhet një grup njerëzish që mendojnë se veprojnë drejt dhe duket sikur janë të interesuar t'i shërbejnë Perëndisë; por Ai që jua njeh zemrat, i qorton sepse ata i shkelin me këmbë urdhëresat hyjnore.

Kështu, profeti thekson edhe një herë urdhëresën që është harruar: "Do të rindërtojnë rrënojat e lashta, dhe ti do të ngresh përsëri themelet e shumë brezave të shkuara; kështu do të quhesh riparuesi i të çarave, restauruesi i shtigjeve për tëbanuar aty. Në rast se përmban këmbën që të mos dhunosh Sabatin, në rast se nuk kryen punët e tua gjatë ditës sime të shenjtë, në rast se e quan Sabatin kënaqësi, ditën e shenjtë të Zotit, që meriton nder, në qoftëse e nderon duke hequr dorë nga udhëtimet e tua, nga kryerja e pnëve të tua dhe nga të folurit për problemet e tua, do ta gjesh kënaqësinë tënde tek Zoti." - (versat 12-14). Kjo profeci gjen zbatim edhe në ditët tona. Ndryshimi i Sabatit nga autoriteti i papatit, përbën të çarën në ligjin e Perëndisë. Por ka ardhur koha për ta restauruar këtë urdhëresë hyjnore. E çara duhet riparuar dhe themelet e shumë brezave, duhen ngritur.

Adami i pafajshëm e mbajti në kopshtin e shenjtë të Edenit këtë Sabat të shenjtëruar nga pushimi dhe bekimet e Krijuesit; Adami mëkatar e i penduar, vazhdoi ta respektonte atë edhe kur u largua nga vendbanimi i tij i mrekullueshëm. Të gjithë patrikët, nga Abeli tek Noa, nga Abrahami tek Jakobi, e mbajtën Sabatin të shenjtë. Kur njerëzit e zgjedhur të Zotit ishin skllevër në Egjipt, shumë prej tyre të ndikuar nga idhujtaria e egjiptianëve, e harruan ligjin e Perëndisë; por me t'i çliruar çifutët nga zgjedha egjiptiane, Zoti ua shpalli atyre me madhështi ligjin e Tij, në mënyrë që ata, ta njihnin vullnetin e Tij dhe ta respektonin dhe t'i bindeshin Atij përgjithmonë.

Njohuria mbi ligjin e Perëndisë është ruajtur pë nga ajo ditë deri në ditët tona dhe po kështu, është mbajtur edhe Sabati për të cilin flet urdhëresa e katërt. Megjithëse "njeriu i mëkatit" ia doli mbanë që për një farë periudhe ta shkelte me këmbë ditën e shenjtë të Zotit, edhe në këtë periudhë të epërsisë së tij, kishte njerëz, që në fshehtësi, e respektuan atë. Që nga koha e Reformacionit, çdo brez, ka

nxjerrë njerëz që e kanë mbajtur tëpacënuar urdhëresën e katërt. E kështu përmes persekutimeve dhe shtypjes, njerëzit dëshmuan për përjetësinë e ligjit të Perëndisë dhe respektimit të Sabatit të krijimit.

Në kapitullin 14 të Zanafillës theksohet fakti se këto të vërteta, së bashku me "ungillin e përjetshëm", do ta dallojnë kishën e Krishtit në kohën e ardhjes së Tij. Në qëndër të mesazhit të trefishtë janë "ata që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë dhe besimin e Jezusit." Ky është mesazhi i fundit që do t'i shpallet botës përpara ardhjes së dytë të Jezusit. Me t'u dhënë ky mesazh, profeti sheh Birin e njeriut duke ardhur plot lavdi, për të mbledhur të korrat e kësaj toke.

Të gjithë ata, mendjet e të cilëve u ndriçuan nga drita e së vërtetës mbi shenjtoren dhe mbi pandryshueshmërinë e ligjit të Perëndisë, u gëzuan dhe u mrekulluan kur vunë re bukurinë dhe harmoninë e këtij sistemi të vërtetash, që mori formë përpara syve të tyre. Ata dëshironin me gjithë shpirt që kjo dritë kaq e çmuar për ta, të depërtonte në zemrat e të gjithë të Krishterëve; dhe ata ishin më se të sigurtë se të tjerët, do ta pranonin me gëzim. Por të vërtetat që binin në kundërshtim me botën, nuk u panë me sy të mirë dhe nga njerëz që e quanin veten pasues të Krishtit. Pjesa më e madhe e njerëzve, i trembeshin sakrificës që mbartte në vetvete bindja ndaj urdhëresës së katërt.

Shumë njerëz, kur dëgjuan për Sabatin, arsyetuan duke u nisur nga pikpamjet botërore. Ata thanë: "Kemi mbajtur gjithmonë të dilën, baballarët tanë u rritën duke respektuar atë dhe shumë njerëz të mirë e besimtarë të devotshëm, kanë vdekur të lumtur duke mbajtur këtë ditë të shenjtë. Në se ats kanë pasur të drejtë, edhe ne të drejtë kemi. Respektimi i këtij Sabati "të ri", do ta prishiharmoninë që është vendosur mes botës dhe nesh dhe ne, nuk do të mund të ndikojmë mbi ta si më parë. Çfarë shpreson të arrijë një grup i vogël njerëzish që mbajnë të shenjtë ditën e shtatë, kundër botës mbarë, që respektuan ditën e dielë?" Edhe çifutë përdorën të njëjtat argumente për të justifikuar mohimin që i bënë Krishtit. Perëndia i kishte pranuar blatimet e flijimet e ofruara nga baballarët e tyre, atëherë, pse s'mund të shpëtonin fëmijët duke ndjekur të njëjtat rite? Kështu, në kohën e Luterit, papistët arsyetonin në të njëjtën mënyrë kur thonin se feja Katolike, ishte një faktor i majftueshëm shpëtimi duke marrë parasysh faktin se shumë të Krishterë të vërtetë, kishin qënë gjatë gjithë jetës së tyre deri në vdekje Katolikë të mirë. Një arsyetim i tillë bëhet pengesë serioze për përparime në fushën e besimit dhe praktikës së krishterë.

Shumë njerëz ngulnin këmbë se e diela ishte një doktrinë e pranuar nga mbarë bota dhe një "zakon" që kisha e ruante për shekuj me rradhë. Por u provua se Sabati dhe respektimi i tij ishin aq të vjetë sa edhe bota, domethënë shumë më të hershëm dhe më të përhapur es mbajtja e së dielës, dhe kjo ditë (Sabati), ishte miratuar si e tillë jo vetëm nga engjëjt, por edhe nga vetë Perëndia. Themelet e Sabatit u hodhën

bashkë me themelet e tokës dhe u formuan kur yjet e mëngjesit këndonin së ashku dhe bijtë e Perëndisë lëshonin britma gëzimi. (Jakobi 38:6, 7; Zanafilla 2:1-3).

Meriton respekt nga ana jonë kjo ditë, sepse nuk u krijua nga asnjë forcë tokësore dhe nuk u mbështet në traditat njerëzore; u hartua nga vetë i Lashti i DItëve dhe zuri vend në fjalën e Tij të përjetshme.

Ndërsa vëmendja e njerëzve u përqëndrua tek reforma për Sabatin,pastorë të njohur e shtrembëruan fjalën e Perëndisë, duke u përpjekur t'i qetësoni njerëzit e shqetësuar me anë të një interesimi të gabuar të saj. Dhe ata që nuk studiuan vetë Shkrimet e Shenjta, i panuan mme gëzim të gjtha ato konkluzione që përputheshin me dëshirat e tyre. Shumë njerëz u përpoqën që t'i vinin shkelmin të vërtetës duke përdorur argumentet, traditat e Etërve dhe autoritetin e kishës. Avokatët e kësaj të vërtete iu drejtuan Biblës, për t'i dhënë urdhëresës së katërt vlerën dhe rëndësinë që i takonte. Njerëz të thjeshtë, të armatosur vetëm me fjalën e së vërtetës, u bënë ballë sulmeve të njerëzve të ditur që të çuditur e të inatosur, vunë re që elokuenca e tyre e sofistikuar ishte e pafuqishme përballë arsyetimit të thjeshrë dhe drejtpërdrejtë të të parëve, që ndonse nuk kishin arsimin e tyre, ishin ekspertë të Shkrimeve të Shenjta.

Në mungesë të provave Biblike, shumë prej tyre përdornin të njëjtën arsyetim që "kishin përdorur dikur paraardhësit e tyre kundër Krishtit dhe apostujve të Tij. Ata ngulmonin" "Pse s'e kuptojnë njerëzit tanë të mëdhenj këtë punën e Sabatit? Një numër i vogël njerëzish besojnë të njëjtën gjë që ju besoni. "S'ka mundësi që ju të keni një të drejtë dhe të gjithë njerëzit e ditur të botës të jenë gabuar."

Citimi i mësimeve të Biblës dhe rikujtimi i historisë së marrëdhënieve Perëndi - njerëz në shkuj, do të ishin të mjaftueshëm për të hedhur poshtë tilla argumente. Zoti punon përmes atyre që e dëgjojnë dhe i binden zërit të Tij, përmes atyre që në rast nevoje, s'kanë frikë ta shpallin të vërtetën dhe t'i qortojnë publikisht gabimet e të tjerëve. Shpesh, si udhëheqës të lëvizjeve reformiste, Ai nuk zgjedh njerëz të ditur apo të pushtetshëm sepse ata u besojnë verbërisht aponioneve,teorive dhe sistemeve të tyre teologjike dhe nuk kanë nevojë për mësimet e Perëndisë. Vetëm ata që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe personale me Burimin e mençurisë, janë në gjendje që t'i kuptojnë e t'i shpjegojnë Shkrimet e Shenjta. Ndonjëherë, përkarahja e së vërtetës u besohet njerëzve që u mungojnë dijet që të jep shkolla, jo sepse ata janë të paditur por sepse ata dëhsirojnë të jenë nxënës të Perëndisë. Ata ulen në bankat e shkollës së Krishtit dhe duke qënë se janë nxënës të bindur e të përulur, bëhen njerëz të shquar. Duke ua zbuluar atyre të vërtetën e Tij, Zoti u bën një nder kaq të madh, sa madhëshita njerëzore dhe respekti botëror të krahasuar me të, s'kanë më asnjë vlerë.

Pjesa më e madhe e Adventistëve nuk i përfillën të vërtetën e shenjtores dhe të ligjit të Perëndisë dhe shumë prej tyre, hoqën dorë nga besimi në lëvizjen e ardhjes së dytë dhe pranuan disa pikpamje të pasakta dhe kontradiktore që kishin të bënin

me profecitë në fjalë. Disa të tjerë, vazhduan të caktojnë një datë përfundimtare për ardhyjen e Krishtit, me fjalë të tjera, vazhduan të gabojnë . Drita e shenjtores duhej t'ua kishte hapur sytë përpara faktit që asnjë periudhë profetike nuk zgjatet deri tek ardhja e dytë, sepse koha e saktë e kësaj ardhjeje, nuk është parashikuar ndonjëherë. Por, duke i kthyer kurizin dritës, ata vazhduanherë pas here të caktojnë një datë për ardhjen e Zotit dhe po aq herë, u zhgënjyen.

Kur kisha e Selanikut ndoqi disa pikëpamje të gabuara në lidhje me ardhjen e Krishtit, apostulli Pal u bëri thirrje që krahasonin me kujdes, shpresat dhe bindjet e tyre me fjalën e Perëndisë. Ai u citoi pjesë nga profecitë që kishin të bënin me ngjaarjet që duhet të ndodhnin përpara ardhjes së Krishtit, duke u treguarkështu, se shpresa e tyre për ta parë me sy ardhjen e Tij, ishte pa bazë. Ai i paralajmëroi duke u thënë: "Askush të mos ju gënjejë kurrsesi, (Letra e dytë e Selanikasve 2:3). Sikur ata të ishin dhënë tërësisht pas datave të caktuara që nuk gjenden në Shkrimin e Shenjtë, do t'i kishin hyrë një rruge të gabuar veprimi; zhgënjimi do t'i kthente në objekt talljeje për profetë, ata do të dorëzoheshin përpara dekurajimit dhe ndoshta, do të dyshonin në vërtetësinë e disa të dhënave të rëndësishme për shpëtimin e tyre.

Paralajmërimi që apostulli u bëri Selanikasve përmban një mësim të vyer për të gjithë ata që jetojnë në ditët e fundit. Shumë Adventistë mendonin se në qoftë se në qoftë se nuk do ta ndërtonin besimin e tyre mbi një datë të caktuar të ardhjes së Zotit, s'do të mund të përgatiteshin me zell për këtë ngjarje. Por ndërsa ata ushqenin shpresa që shuheshin me kalimin e kohës, besimi i tyre merrte goditje kaq shkatërrimtare, saqë ishte e pamundur që të vërtetat e mëdha të profecisë të preknin zemrat dhe mendjet e tyre.

Ishte Zoti Ai, që lejoi predikimin e një kohe të caktuar përsa i përket gjykimit, duke dhënë atë mesazhin e parë. Ky mesazh bazohej tek përllogaritja më se e saktë që ju bë periudhave profetike; përllogaritje që caktoi si fundin e periudhës 2300 ditore, vjeshtën e vitit 1844. Përpjekjet e vazhdueshme për të gjetur data të reja për fillimin dhe fundin e perdiudhave profetike dhe arsyetimi i pasaktë që i mbështet këto përpjekje, jo vetëm që i largojnë njerëzit nga e vërteta, por edhe i bëjnë ata që t'i shpjegojnë me përbuzje përpjekjet e sinqerta që bëhen për t'i shpjeguar prfofecitë. Caktimi i herëpashershëm i një date për ardhjen e dytë dge përhapja e saj në shkallë të gjerë, ushkojnë për shtat qëllimeve të Satanit. Me të kaluar koha e caktuar, ai tallet dhe i përqesh avokatët e së vërtetës, duke nxitur urrejtje ndaj lëvizjes së madhe të ardhjes së dytë të viteve 1843-1844. Ata që vazhdojnë të bëjnë të njëjtin gabim, përfundimisht, do të caktojmë një datë shumë të largët në të ardhmen dhe rrjedhimisht, do të jetojnë moskokëçarës në një gjendje sigurie të rreme dhe shumë prej tyre, di ta kuptojnë se janë mashtruar vetëm kur të jetë shumë vonë.

Përvoja e shkuar e Adventistëve ilustrohet mjaft bukur nga historia e Izraelit të herëshëm. Perëndia i udhëhoqi njerëzit e Tij drejt lëvizjes për ardhjen e dytë, ashtu

si dikur i udhëhoqi Izraelitëtjashtë Egjiptit, drejt lirisë. Besimi i tyre u vu në provë gjatë ditëve të zhgënjimit të madh, ashtu si u vu në provë besimi Çifut në brigjet e Detit të Kuq. Sikur të kishin vazhduar t'i besonin dorës që i kishte udhëhequr në të shkuarën, ata do ta kishin parë shöëtimin që vjen nga Zoti. Sikur të gjithë ata që kishin punuar si një trup i vetëm në vitin 1844, të ishin njohur me mesazhin e egjëllit të tretë dhe të nxitur nga Shpirti i Shenjtë, t'ia kishin shpallur atë botës, Zoti eo t'i kishte përdorur përpjekjet e tyre për të realizuar qëlimet e Tij dobiprurëse. Bota do të ishte paralajmëruar, punës parapërgatitore do t'i kishte ardhur fundi dhe Krishti do të kishte ardhur për t'i çliruar njerëzit e Tij vite më parë.

Nuk ishte vullneti i Perëndisë që Izraeli që sorollatej për dyzet vjet me rradhë në shkretëtirë; Ai dëshironte me gjitë zemër që t'i udhëhiqte ata drejt tokës së kanaanit dhe t'jua jepte atyre në dorëzim këtë tokë, që ata të jetonin të lumtur dhe ta donin Atë. Por "ata nuk mundën të hyjnë për shkat të mosbesimit." - Letra e Hebrenjve 3:13. Ata vdiqën në shkretëtirë për shkak tëmosbesimit dhe idhujtarisë dhe të tjerëve ju besua TOka e Premtuar. Po kështu, nuk ishte vullneti i Perëndisë që ardhja e Krishtit të vonohej kaq shumë dhe që njerëzit e Tij të jetonin kaq gjatë në një botë ku mbizotërojnë mëkatet dhe trishtimi. Por mosbesimi i largoi ata nga Zoti. Meqë ata refuzuan ta bënin punën që Ai vetë ua kishte caktuar, shpallja e mesazhit ju besua të tjerëve. Jezusi, duke u trguar mëshirëplotë ndaj botës, e vonoi ardhjen e Tij në mënyrë që t'ju jepte mundësi të gjithë mëkatarëve, që ta dëgjonin këtë paralajmërim dhe të gjenin strehë në dashurinë e Tij përpara paralajmërim dhe të gjenin strehë në dashurnë e Tij përpara se të zbrazej", zemërimi i Perëndisë.

Në ditët tona, ashtu si në të shkuarën, e vërteta që dënon gabimet dhe mëkatet e kohës ngjall kundërshtim. "Sepse kushdo që bën gjëra të mbrapshta e urren dritën dhe nuk vjen tek drita, që të mos zbulohen veprat e tij." - Gjoni 3:20. Ndërsa njerëzit e kuptojnë se nuk mund t'i mbrojnë qëndrimet që mbajnë duke përdorur Shkrimet e Shenjta, shumë prej tyre këmbëngulin duke përdorur Shkrimet e Shenjta, shumë prej tyre këmbëngulin që t'i mbrojnë ato me çdo kusht, dhe rrjedhimisht, sulmojnë me keqdashje karakterin dhe motivet e të gjithë atyre që përfaqojnë me guxim të vërtetën antipopullore. E njëjta politikë është ndjekur gjatë të gjithë kohrave. Elija konsiderohej si ngatërrestar në Izrael, Jeremia si tradhëtar dhe Pali si shkatërrues i tempullit. Që nga ajo kohë deri sot, ata që qëndronë besnikë të vërtetës konsiderohen si kryengritës, heretikë dhe elementë përçarës. Me mijëra njerëz, që nuk i zënë dot besë fjalëve të sigurta të profecive, do të bashkohen pa hezituar me të tjerët që akuzojnë të gjithë ata, që kanë guximin t'i dënojnë mëkatet "moderne". Një frymë e tillë do të përhapet gjithnjë e më shumë. Bibla naparalajmëron se po afrohet ajo kohë, kur ligjet e shtetit do të bien kaq shumë ndesh me ligjin e Perëndisë, saqë kushdo që do t'u bindet urdhëresave hyjnore, do t'i duhet të përballojë me guxim dhe dënimet që u jepen keqbërësve.

Duke pasur parasysh të gjitha këto ... cila është detyra e lajmëtarit të së vërtetës? A mos duhet vallë që ai të arrijë kunkluzionin se s'ia vlen ta përkrahësh të vërtetën duke qënë se shumë shpesh ajo bën që njerëzit t'i shmangen apo t'i rezistojnë përgjegjësisë që mbart kjo e vërtetë në vetvete? Jo; ai, ashtu si Reformatorët e parë, nuk ka asnjë arsye që t'ia fshehë botës dëshminë e fjalës së Perëndisë, edhe pse shpesh, kjo ngjall vetëm kundërshtime.Martirët dhe shenjtorët dëshmuan për besimin e tyre dhe nga kjo përfituan brezat e ardhshëm. Ata shembujt të gjallë ndershmërie dhe hirësie kanë qënë burime frymëzimi pë ata që i janë zgjedhur si dëshmitarë të Perëndisë. Atyre u janë hapur sytë përpara të vërtetës, jo vetëm për të mirën e tyre, por edhe për ta njohur boten përmes tyre me mëshirën dhe hirin e Perëndisë. Po në ditët tona, a u ka dhënë Zoti dritë dijeje shërbëtorëve të Tij? Atëherë, është detyra e tyre që ta lënë këtë dritë të ndriçojë mbarë.

Kohë më parë Zoti foli përmes një prej shërbëtorëve të Tij dhe deklaroi: "Ti do t'u njoftosh fjalët e mia edhe sikur të të dëgjojnë, edhe sikur të refuzojnë të dëgjojnë." - Ezekieli 3:7; 2:7. Ndërsa dëshmitarëve të së vërtetës në ditët tona, du drejtohen këto fjalë: "Bërtit sa të mundësh, mos u kurse; ngrije zërin tënd si një bori dhe shplli popullit tim shkeljet e tij dhe shtëpisë së Jakobit mëkatet e saj." - Isaja 38:1.

Kushdo që e pranon dritën e së vërtetës, brenda mundësive të tij, ka të njëjtën përgjegjësi solemne të profetit të Izraelit, tëcilët Zoti iu drjtua me këto fjalë: "Kështu, o bir njeriu, të kam vendosur si roje për shtëpinë e Izraelit; prandaj dëgjo fjalën e gojës simedhe i lajmëro nga ana ime. Kur i them të pabesitë: "I pabesë, ti do të vdesësh me siguri", dhe ti nuk flet për të paralajmëruartë pabesin që të largohet nga rruga e tij, si i pabesë do të vdesë për shkak të paudhësisë së tij, por për gjakun e tij do t'i kërkojë llogari dorës sate. Por në rast se ti e paralajmëron të pabesin që të largohet nga rruga e tij dhe ai nuk largohet prej saj, ai do të vdesë për shkak të paudhësisë së tij, por ti do ta shpëtosh shpirtin tënd." - Ezekieli 33:7-9.

Fakti që e vërteta ngjall pakënaqësi dhe krijon probleme, është pengesë kryesore në punën për përkrahjen dhe përfaqsimin e saj. Dhe ky është i vetmi argument që avokatët e saj nuk kanë mundur kurrë ta hedhin poshtë. Por, nga ana tjetër, ai s'i ka zbrazur kurrrë ndjekësit e vërtetë të Krishtit; njerëzit që nuk presin që e vërteta të bëhet "popullore". Me t'u bindur për detyrën që i pret, ata e pranojnë me gëzim kryqin e tyre dyke deklaruar bashkë me Palin që "trishtimi ynë i lehtë që është vetëm për një moment, prodhon për ne, një peshë të amasë e të pashoqe të amshueshme lavdie;" dhe duke çmuar "dhunën e Krishtit si pasuri më të madhe nga thesarët e Egjyptit", (Korintasit 4:17; Hebrenjtë 11:26) ata janë gati të luftojnë për të.

Paravarsisht nga ato që thonë, vetëm ata që thellë në zemrat e tyre duan t'i shërbejnë botës, i zgjedhin problemet fetare duke u nisur nga politika dhe jo nga parimet. Ne duhet të zgjedhim të vërtetën sepse është e vërtetë, dhe t'ia lëmë të tjerat në dorë Zotit. Bota u detyrohet njerëzve parimorë, besnikë dhe guximtarë

për reformat e saj më të mëdha. Dhe janë njerëz të tillë që duhet ta çojmë përpara reformën edhe në ditët tona.

Zoti tha: "Dëgjomëni, o ju që e njihni drejtësinë, o popull, që ke në zemër ligjin tim. Mos kishin frikë turpërimin nga njerëzit, as mos u trembni nga fyerjet e tyre të rënda. Sepse tenja do t'i hajë si një rrobe dhe mola do t'i brejë si leshin, por drejtësia ime do të jetë përjetë dhe shpëtimi im brez pas brezi." - Isaia 51:7, 8.

1. Cila është vula e ligjit të Perëndisë? Ku gjendet zakonisht vula?

2. Ka një rregull të pagabueshëm nga i cili duhet të testohen të gjitha opinionet, doktrinat dhe teoritë. Cili është ai rregull?

3.Cilat janë disa nga arsyet që njerëzit përdorin për të mos mbajtur Sabatin? Sa qëndrojnë këto arsyetime?

27.

Rigjallërimet Moderne

Predikimi me besim i fjalës së Perëndisë pasohej gjithmonë nga rezultate që dëshmojnë për origjinën e saj hyjnore. Shpirti i Shenjtë paraprinte mesazhin e shërbëtorëve të Tij dhe fjala merrte fuqi të reja. Ndërgjegjet e fjetura të mëkatarëve po zgjoheshin. "Drita që ndriçon çdo njeri që vjen në botë", ndriçoi edhe skutat e fshehta të shpirtit të tyre dhe nxorri në pah gjithçka që më parë i takonte errësirës. Bindja hodhi rrënjë në mendjet dhe zemrat e njerëzve. Ata ishin më se të bindur për mëkatet e tyre dhe për drejtësinë e gjykimit që po afrohej. Ata mund ta kuptonin deri diku, drejtësinë e Jehovait dhe ndjenin se nuk mund t'i dilnin përpara Atij si njerëz mëkatarë dhe të pastër. Të pushtuar nga ankthi, ata thirrën me të madhe: "Kush do më çlirojë nga ky trup që sjell vdekje?" Me të zbuluar kryqin e Kalvarit dhe flijimin që ai mbartte në vetvete, ata vunë re se vetëm Jezu Krishti mund t'i shlyente mëkatet e tyre; vetëm kjo, mund ta pajtonte njerëzimin me Perëndinë që heq mëkatet e botës." Vetëm gjaku i Jezusit mund t'u falte atyre shlyerjen e mëkateve që s'janë më."

Këta njerëz të penduar u krhyen në pemë me fryte. Ata besuan dhe u pagëzuan duke filluar një jetë të re - u bënë krijesa të reja përmes Jezu Krishtit; krijesa, që s'mund t'i përshtateshin më dëshirave të ethshme të së kaluarës, por që dëshironin ta ndiqnin me besim hap pas hpi Birin e Perëndisë, të reflektonin karakterin e Tij dhe t'i pastronin mendjet dhe zemrat e tyre në përputhje me pastërtinë e Tij. Ata donin gjithçka, që kishin urryer më parë dhe të vetëkënaqur nga jeta, u bënë të urtë dhe të përkulur. Mendjelehtët dhe supersticiozët u bënë seriozë dhe të matur.Ateistët u bënë besimtarë, pijanecët hoqën dorë nga pija, të shthururit fituan respektin e humbur. Zakonet pavlerë të botës u flakën tej. Të Krishterët nuk këkronin "stoli të jashtme: gërshetim flokësh, stolisje me ar ose veshje me rroba të bukura, por njeriun e fshehur të zemrës, me pastërtinë që nuk prishet të një shpirti të butë dhe të qetë, që ka vlerë të madhe përpara Perëndisë" - Letra e parë e Pjetrit 3:3, 4.

Përtëritje të tilla mbartnin në të vërtetët shqyrtimin e kujdesshëm të besimit dhe përulje shpirtërore. Ato karakterizoheshin nga thirrje solemne dhe të ethshme drejtuar mëkatarëve dhe nga dëshira e zjarrtë për të fituar shpëtimin e të tjerëve. Frytet e këtyre ringjalljeve shpirtërore shfaqeshin qartë tek ata njerëz, që nuk zprapseshin përpara sakrificave dhe vetëmohimit, por gëzoheshin kur qortoheshin dhe kalonin prova të vështira për hir të Jezu Krishtit. Njerëzit vinin re se si transformoheshin jetët e atyre që i përkisnin Jezusit dhe e mbronin emrin e Tij. Komuniteti ku ata jetonin përfitoi shumë nga ndikimi i tyre. Ata u bënë një me Krishtin, mbollën me ndihmën e Shpirtit të Shenjtë për të korrur jetën e përjetshme.

Për ta, mund të thuhej: "U trishtuat për pendim ... Trishtimi sipas Perëndisë në fakt, sjell pendimin për shpëtim për të cilin njeriut nuk i vjen keq, por trishtimi i botës shkakton vdekje. Në fakt, ja sa kujdes shkaktoi tek ju pikëllimi sipas Perëndisë, sa fjalë për të kërkuar ndjesë, sa zemërartë, sa druajtje, sa dëshirë të zjarrtë, sa zell, sa kënaqësi! Me çdo mënyrë ju treguat se jeni të pastër në këtë çështje" - Letra e dytë e Korintasve 7:9-11.

Këto janë rezultatet e punës së Shpirtit të Shenjtë. Pendimi i vërtetë shfaqet vetëm atëherë, kur ai sjell ndryshim. Mëkatarigjen paqe me Perëndinë vetëm atëherë, kur ao ronovon beslidhjen me Zotin, kur kthen atë që ka grabitur, kur rrëfen mëkatet dhe kur e do Zotin dhe të afërmit e Tij.

Përtëritjet fetare në të shkuarën pasoheshin nga të tilla rezultate inkurajuese. Dhe ishin pikërisht këto rezultate, që tregonin se Zoti i kishte bekuar lëvizjet fetare që kishin të bënin me shpëtimin dhe lartësimin e racës njerëzore.

Por shumë nga ringjalljet shpirtërore të kohëve moderne u mungon hiri hyjnor që pasonte punën e shërbëtorëve të Perëndisë kohë më parë. Megjithëse lind një farë interesi i përgjithshëm, megjithëse shumë njerëz pretendojnë se kanë përjetuar shndërrim shpirtëror dhe anëtarësia e kishave rritet me anëtarë të rinj, nuk rritet me anëtarë të rinj, nuk ka asnjë fakt që të na bëjë të besojmë se edhe jeta e vërtetë shpirtërore ka njohur të njëjtën shtytje përpara. Dita që ndriçon për një farë kohe, shuhet shpejt, duke e bërë errësirën të duket më efrikshme se kurrë.Shpesh këto përtëritje moderne i bëjnë thirrje imagjinatës njerëzore, nxitin emocione dhe kënaqin për të renë dhe misteriozen. Kështu "të Krishterët" e rinj, nuk kanë ndonjë dëshirë të madhe për të dëgjuar të vërtetën. Biblike dhe nuk janë të interesuar të njohur dëshmitë e profetëve dhe apostujve. Shërbesa fetare bëhet interesante për ta, vetëm në qoftë se ka karakter sensacional. Një mesazh që i bën thirrje gjykimit pasiv, nuk mund të zgjojë përgjigje aktive prej tij. Paralajmërimeve të qarta të fjalës së Perëndisë prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë interesat e tyre që lidhen ngushtë me jetën e përjetshme, s'u kushtohet vëmendje fare.

Për çdo të Krishter të vërtetë, marrëdhënia me Perëndinë dhe shpresa për jetën e përjetshme duhet të përbëjnë temën më tërëndësishme në jetë. Po ku është fryma e

përkushtimit ndaj Zotit në kishat e ditëve tona? Njerëzit që i hynë rrugës së besimit nuk heqin dorë nga krenaria dhe dashuria për botën.Ata nuk duan të sakrifikojnë, nuk duan ta marrin mbi supe kryqin dhe nuk duan t'i shkojnë pas Jezusit të përulur dhe të bindur, ashtu si nuk donin t'i bënin të gjitha këto përpara shndërrimit shpirtëror që "përjeton". Feja është kthyer në zbavitje për njerëzit skeptike dhe jobesnikë, sepse shumë prej atyre që quhen të Krishterë nuk duan t'ia dinë për parimet e saj. Fuqia e Perëndisë nuk ndjehet pothuajse fare në pjesën më të madhe të kishave. Njerëzitmendojnë vetëm për piknike, pjesë teatrale dhe tregje shitblerjeje të organizuara nga kisha, për shtëpi moderne dhe rehati personale kaq shumë pas të mirave materiale dhe pozitave shoqërore, saqë s'kanë kohë për t'u marrë me interesat e tyre që kanë të bëjnë me përjetësinë.

Në këto zbatimit të gjykimit përfundimtar të Perëndisë mes rradhëve të popullit të Zotit në tokë, do të vihet re një rilindje e tillë besimi që s'është parë që nga koha e apostujve. Shpirti dhe fuqia e Perëndisë që do të jenë me fëmijët e Tij. Gjatë kësaj kohe shumë njerëz do të largohen nga kishat ku dashuria për Zotin dhe fjalën e Tij janë zëvendësuar nga dashuia për botën. Si pastorët, ashtu edhe njerëzit e thjeshtë, do t'i pranojnë me gëzim të vërtetat e mëdha që Zoti do t'i zbulojë përpara tyre pikërisht ardhjes së dytë të Krishtit. Armiku i njerëzimit do ta pengojë këtë punë; prandaj ai do të organizojë një lëvizje të rreme - barrierë përpara kohës së duhur. Ai do të deklarojë se Perëndia i ka bekuar veçanërisht të gjitha ato kisha që ai do të ketë mashtruar; atje do të manifestohej një formë e veçantë, interesante që do të mendohet të jetë interes fetar nërritje. Me mijëra njerëz do të ngazëllehen nga fakti që Zoti po punon, po e kryen një forcë tjetër. Satani do të përpiqet që ta zgjerojë ndikimin e tij mbi të Krishterët duke përdorur, një maskë fetare.

Forcat që kanë punuar përmes pjesës më të madhe të rilindjeve shpirtërore të gjysmës së funditë të këtij shekulli, do të shfaqen pak a shumë dhe në lëvizjet më popullore të së adhmes. Mashtrimi fshihet pas ngacmimit emocional dhe përzierjes së të vërtetës me të rremen. Megjithatë, askush nuk duhet të gënjehet. Drita e fjalës së Perëndisë e lehtëson dallimin e natyrës së këtyre lëvizjeve. Njerëzit duhet ta dinë se Zoti nuk mund t'i bekojë ata që mohojnë dëshminë e Biblës duke u kthyer kurrizin atyre të tërtetave të qarta, që kërkojnë vetmohimin dhe braktisje të botës. Duke i krahasuar këto lëvizje me rregullin e vendosur nga vetë Krishti. "Ju do t'i njihni nga Shpirti i Shenjtë.

Në të vërtetat e fjalës së Tij, Perëndia u ka zbuluar njerëzve Vetveten; dhe këto të vërteta janë mburojë kundër mashtrimeve të Satanit për të gjithë ata që i pranojnë ato. Mohimi i këtyre të vërtetave i ka hapur derën së keqes, që është përhapur kaq shumë në rrethin fetar mbarëbotëror. njerëzit e kanë harruar natyrën dhe rëndësinë e ligjit të Zotit. Kuptimi i gabuar i karakterit, përjetësisë dhe detyrimit që mbart në vetvete ligji hyjnor i ka udhëhequr shumë njerëz drejt një shndërrimi dhe shen-

jtërimi shpirtëror të gabuar dhe ka çuar në uljen e nivelit të përkushtimit në kishë. Pikërisht këtu, gjendet sekreti i mungesës së fuqisë dhe Shpirtit të Perëndisë në përtëritjet shpirtërore të kohës sonë.

Në sekte të ndryshme fetare ka njerëz që shquhen për ndjenjën e tyre të përkushtimit dhe pikërisht këta njerëz janë ata, që enjohin këtë fakt dhe flasin me guxim në brojtje të tij. Profesor Edwards A. Park duke theksuar rreziqet më të përhapura të ditës në fushën e fesë, thotë: "Fakti që nga podiumet fetare nuk bëhet thirrje njerëzve për ta respektuar ligjin hyjnor, përbën një burim rreziku. Më parë podiumi i bënte jehonë zërit të ndërgjegjes ... Predikuesit tanë më të shquar u jepnin madhështi dhe bukuri shërbesave të tyre, duke ndjekur shembullin e Mësuesit dhe duke e përqëndruarvëmendjen tek ligji, urdhëresat dhe paralajmërimet e tij. Ata përsëritnin dy sentencat e mëdha: që ligji, është tejshkrim i përsosshmërisë hyjnore dhe që kushdo që nuk do ligjin, nuk mund ta dëgjojë as ungjillin; sepse ligji ashtu si ungjilli, është pasqyrë që reflekton karakterin e vërtetë të Perëndisë. Ky rrezik na udhëheq drejt një të dyti; atij të nënvlersimit të të keqes që mbart mëkati, të shtrirjes dhe dëmit që sjell ai. Drejtësia e urdhëresave dhe gabimi i mosbindjes ndaj tyre janë në përpjestim të drejtë ..."

"Në rradhën e rreziqeve të përmendura më lart është edhe ai i nënvleftësimit të drejtësisë së Perëndisë. Folësit modernë kanë prirjen që ta zhveshin drejtësinë hyjnore nga mirëdashja hyjnore, preferojnë ta paraqesin mirëdashjen më shumë si ndjenjë sesa ta lartësojnë si parim. Prizmi i ri teologjik veçon ato që Zoti i ka dhënë si bashkim unik. Ligji hyjnor është i mirë apo i keq? Është prirje për ta zbatuar ligjin. Nga zakoni i nënvleftësimit të ligjit dhe drejtësisë hyjnore, dhe të dëmit që sjell mosbindja e tyre, njerëiz mund të rrëshkasin lehtë dhe pa kuptuar në zakonin e nënvleftësimit të mëshirës dhe hirit që ka siguruar një shlyerje për këtë mëkat." Kështu, në mendjet e njerëzve, ungjilli humb vlerën dhe rëndësinë e tij dhe ata praktikisht, jnë gati ta flakin tej Biblën.

Shumë mësues fetarë pohojnë se Krishti, me anë të vdekjes së Tij, i dha fund ligjit, dhe prandaj njerëzit janë të lirë të mos i respektojnë urdhëresat e tij. Ka disa prej tyre, që e paraqesin atë si një zgjedhë të rëndë dhe përballë zgjedhjes së ligjit, ata vendosin lirinë që mbart ugjilli.

Por profetët dhe apostujt nuk e konsideruan të tillë ligjin e shenjtë të Perëndisë. Davidi tha: "Do të ec në liri, sepse kërkoj urdhërimet e tua." - Psalmi 113:45. Apostulli Jakob që shkroi pas vdekjes së Krishtit i drejtohet Decalogue-t si "ligj mbretëror dhe si "ligj i përsosur i lirisë." - Jakobi 2:8, 1:25. Dhe më pas, Gjoni një gjysën shekulli pas kryqëzimit, i bekon të gjithë ata "që i kryejnë urdhërimet e tij", duke thënë se "do të kenë të drejtën për drurin e jetës dhe për të hyrë në portat e qytetit." - Zbulesa 22:14.

Pretendimi sipas të cilit Krishti i dha fund me anë të vdekjese së Tij ligjit, është pa bazë. Sikur të ishte i mundur që ligji të ndryshohej apo të mos merrej parasysh,

atëherë Krishti s'kishte pse të vdiste për t'i shpëtuar njerëzit nga dënimi që sjell mëkati. Vdekja e Jezusit, jo vetëm që nuk i dha fund ligjit, por përkundrazi, provoi edhe një kerë pandryshueshmërinë e tij. Biri i Perëndisë erdhi "që ta bënte ligjin të madh dhtë mrekullueshëm." - Isaia 42:21. Ai tha: "Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin; "Deri sa qielli dhe toka të kalojë, asnjë jetë asnjë pikë e ligjit nuk do të kalojë." - Përsa i përket Personit të Tij, Ai deklaron: "Perëndia im, unë gëzohem kur zbatoj vullnetin tënd dhe ligji yt është në zemrën time." - Psalmi 40:8.

Ligji i Perëndisë nga natyra është i pandryshueshëm. Ai është zbulim i karakterit dhe natyrës së Autorit të tij. Zoti është dashuri dhe ligji i Tij është dashuri. Dy parimet e tijkryesorë janë: dashuri për Perëndinë dhe dashuri për të tjerët. "Dashuria pra, është përmbushja e ligjit." - Letra e Romakëve 13:10. Karakteri i Perëndisë është drejtësi dhe e vërtetë; e tillë është edhe natyra e ligjit të Tij. Psalmi thotë: "Ligji yt është i vërtetë" dhe "urdhërimet e tua janë të drejta." - Psalmi 119:142, 172. Apostullni Pal deklaron: "Kështu ligji është i shenjtë, dhe urdhërimi i shenjtë, i drejtë dhe i mirë." - Letra e Romakëve 7:12. Një ligj i tillë duke qënë shprehja e mendimit dhe vullnetit të Perëndisë, duhet të jetë i përjetshëm si Autori i Tij.

Shndërrimi shpirtëror dhe shenjtërimi kanë për detyrë që ta pajtojnë njeriun me Zotin, duke e pajtuar atë fillimisht me parimet e ligjit të Tij. Në fillim, njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Ai ishte në përputhje të plotë me natyrën dhe ligjin e Zotit; parimet e drejtësisë ishin të shkruara në zemrën e tij. Por mëkati e largoi atë nga Krijuesi i vet. Ai s'mund të reflektonte më shëmbëlltyrën hyjnore. Zemra e tij ishte në luftë me parimet e ligjit të Perëndisë "Në fakt mendja e kontrolluar nga mishi është armiqësi kundër Perëndisë, sepse nuk i nënshtrohet ligjit të Perëndisë dha as nuk mundet." - Ltera e Romakëve 8:7. Por "Perëndia kaq shumë e deshi botën, sa që dha Birin e Tij të vetëm", që njerëzit të mund të pajtoheshin me Zotin. Ata mund të rifitojnë, përmes aktit që kreu Krishti, harmoninë e dikurshme me Krijuesin e tyre. Zemrat e tyre duhet të fillojnë një jetë të re që vjen nga lart. Ky dnryshim përbën lindjen e re, pa të cilën Jezusi thotë që askush "s'mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë."

Hapi i parë në rrugën e pajtimit me Perëndinë është bindja përmëkatet tona. "Mëkati ësthë shkelja e Ligjit." "Me anë të ligjit në fakt, arrihet njohja e mëkatit." - Letra e parë e Gjonit 3:4, Letra e Romakëve 3:20. Mëkati në mënyrë që të bëhet i ndërgjegjshëm për fajsinë e tij, duhet ta krahasojë karakterin e tij me karakterin e drejtësisë së përsosur të Perëndisë. Kjo pasqyrë, që reflekton një karakter përsosshmërisht të drejtë, e bën atë të shquajë defektet e karakterit të tij.

Ligji ia hap sytë njeriut përpaa mëkateve të tij, por nuk siguron kurën e duhur për to. Ndërsa nga njëra anë ai i premton të bindurit jetën e përjetshme, nga ana tjetër deklaron se mëkatari do të marrë pagën e vet, vdekjen. Vetëm lajmi i mirë i Krishtit mund ta çlirojë atë nga dënimi apo ndotja që mbart në mëkati në vetvete. Ai duhet të pendohet përpara Perëndisë, ligji i të Cilit është shkelur me këmbë, dhe

duhet t'i besojë Krishtit si flijimi i tij shlyes. Vetëm kështu, shlyen mëkatet e tij dhe ai merr pjesë në natyrën hyjnore. Tani Ai është fëmi i Zotit, sepse ka pranuar frymën e adoptimit dhe prandaj mund të thërrasë: "Abba, o Atë!"

Po a është ai i lirë tani që ta shkelë ligjn e Zotit? Kështu mos qoftë, përkundrazi e forcojmë ligjin." Ne që jemi të vdekur për mëkatin, si do të jetojmë akoma në të?" Edhe Gjoni deklaron; "Sepse kjo është dashuria e Perëndisë që ne të zbatojmë urdhërimet e tij." dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda." - Letra e Romakëve 3:31, 6:2; Letra e parë e Gjoni 5:3. Në e re zemra gjen harmoninë e humbur me Perëndinë dhe përputhet në ligjin e Tij. Kur mëkatari përjeton një ndryshim të tillë, ai kalon nga vedekja në jetë, nga mëkati në shenjtëri, nga shkelja dhe rebelimi në besnikëri dhe bindje. Jetës së vjetër larg Perëndisë, i ka ardhur fundi; ka filluar një jetë të re pajtimi,besimi dhe dashurie. Atëherë "drejtësia e ligjit" do të "përmbushet në ne, që nuk ecim sipas mishit, por sipas Frymës." - Letra e Romakëve 8:4. Dhe ne me gjithë shpirt do të themi: "Oh, sa shumë e dua ligjin tënd! Ai është përsëritja ime gjithë ditën." - Psalmi 113:37.

"Ligji i Zotit është i përsosur, Ai përtërin shpirtin." - Psalmi 13:7. Njerëzit, pa ligjin, nuk mund ta kuptojnë drejt pastërtinë dhe shenjtërinë e Perëndisë, ashtu si nuk muund ta kuptojnë drejt papastërtinë dhe fajin e tyre. Ata nuk mund të krijojnë bindjen e plotë për mëkatet e tyre dhe nuk ndjejnë nevojën e menjëherëshme për t'u penduar. Duke mos e kuptuar gjendjen e mjerë në të cilën ndodhen, si shkelës të ligjit të Perëndisë, ata s'mund ta ndjejnë nevojën që kanë për gjakun shlyerës të Krishtit. Në këtë rast shpresa për shpëtim, pranohet ndryshim tërësor të zemrës dhe pa një transformim pozitiv të jetës së mëkatarit. Kështu, rritet numri i shndërrimeve sipërfaqësore dhe me mijëra njerëz, që s'e kanë njohur kurrëme të vërtetë Krishtin, bashkohen me kishën.

Në lëvizjet fetare të ditëve tona luajnë një rol të rëndësishëm edhe teoritë e gabuara mbi shenjtërimin që e kanë burimin tek mospërfillja apo mohimi i ligjit hyjnor. Këto teori, janë doktrina të rreme dhe praktika të rrezikshme veprimi; dhe fakti që ato shihen me sy të mirë nga një numër gjithmonë e më i madh njerëzish, kërkon një kuptim gjithmonë e më të saktë të mësimeve që na japin Shkrimet e Shenjta mbi këtë temë.

Shnjtërimi i vërtetë është një doktrinë që i ka rrënjët në Bibël. Apostulli Pal, në latrën që i drejton kishës në Selanik, deklaron: "Ky është vullneti i Perëndisë; shenjtërimi juaj." E më pas lutet: "Perëndia e paqes ju shenjtëroftë ai vetë tërësisht". - Letra e parë e Selanikasve 4:3; 5:23. Në Bibël thuhet qartë se çfarë është shenjtërimi dhe se si mund të arrihet ai. Shpëtimtari u lut kështu për nxënësit e Tij: "Shenjtëroji në të vërtetën tënde; fjala jote është e vërteta." - Gjoni 17:17. Pali na mëson se besimtarët duhet "të shenjtërohen nga Fryma e Shenjtë." - Romakët 15:16. Po çfarë pune kryen Shpirti i Shenjtë? Jezusi u tha dishepujve të Tij: "Kur të vijë ai, fryma e së vërtetës, ai do t'ju prijë në çdo të vërtetë." - Gjoni 16:13. Ndërsa

psalmisti thotë: "Ligji yt është i vërtetë." Parimet e mëdha të drejtësisë të mishëruara tek ligji i Perëndisë bëhen të kuptueshme për njerëzit me anë të fjalës dhe Shpirtit të Tij. Dhe duke qënë se ligji i Zotit është "i shenjtë, i drejtë dhe i mirë", një tejshkrim i përsosshmërisë hyjnore, rrjedhimisht, edhe një karakter që i bindet këtij ligji, do të jetë i shenjtë. Vetë Krishti është një shembull i përkryer i një karakteri të tillë. Ai thotë: "Unë i zbatova erdhërimet e Atittim." "Unë bëj vazhdimisht gjërat që i pëlqejnë." - Gjoni 13:19; 8:29. Nxënësit e Krishtit duhet t'i ngjajnë Atij - karakteret e tyre, me anë të hirit dhe mëshirës së Perëndisë, duhet të zhvillohen në përputhje me parimet e ligjit të Tij shenjtë. Ky është shenjtërimi Biblik.

Një punë e tillë mund të kryhet me sukses vetëm falë besimit tek Jezu Krishti dhe fuqisë së Shpirtit të Perëndisë. Pali i paralajmëron besimtarët me këto fjalë: "Punoni për shpëtimim tuaj me frikë e me dridhje, sepse Perëndia është ai që vepron në ju vullnetin dhe veprimtarinë, sipas pëlqimit të Tij." - Filipianët 2:12, 13. I Krishteri padyshim do ta ndjejë tundimin që mbart mëkati, por ai do ta luftojë atë vazhdimisht. Këtu ndjehet më shumë se kurrë nevoja e ndihmës që mund të na ofrojë vetëm Krishti. Dobësia njerëzore bashkohet me forcën hynore dhe nga kybashkimngrihet fuqishëm zëri i besimit: "Ta falenderojmë Perëndinë që na jep forcën me anë të Zotit tonë Jezu Krisht." - Letra e parë e Korintasve 15:57.

Shkrimet e Shenjta tregojnë qartë shenjtërimi është një proçes progresiv. Për një njeri, jeta si i Krishter fillon kur ky njeri përjeton një shndërrim shpirtëror dhe rifiton paqen me Perëndinë përmes gjakut të shlyerjes. Por ku është vetëm fillimi i një rrugë të gjatë. Tani ai duhet të "vazhdojë në rrugën e përsosmërisë:" teë rritet "sipas madhësisë dhe plotësisë së shtatit të Krishtit." Apostulli Pal thotë: "Bëj këtë: duke harruar atë që kam lënë pas dhe duke u prirur drejt atyre që kam përpara, po rend drejt synimit, drejt çmimit të thirrjes së lartme të Perëndisë në Krishtin Jezus." - Filipianët 3:13, 14. Ndërsa Pjetri flet për hapat që duhen bërë për të arritur shenjtërim të plotë shpirtëror: "Duke bërë çdo përpjekje, t'i shtoni besimit tuaj virtytin dhe virtytit diturinë, diturisë vetkontrollin, vetkontrollit qëndresën, qëndresës perëndishmërinë, mëshirës dashurinë vllazërore dhe dashurisë vllazërore dashurinë duke bërë këto gjëra, nuk do të pengoheni kurrë." - Letra e dytë e Pjetrit 1:5-10.

Ata që përjetojnë një shenjtërim të vërtetë Biblik, manifestojnë edhe një frymë të vërtetë përuljeje. Përpara tyre, ashtu si përpara Moisiut, shfaqet vetëm një pjesë e vogël e madhështisë së përkryer hyjnore dhe ata kuptojnë, se sa të pavlerë janë në krahasim me pastërtinë dhe përsosshmërinë e të Pavdekshmit.

Profeti Daniel ishte një shembull i gjallë shenjtërimi të vërtettë. Ai i shërbeu gjatë gjithë jetës me fisnikëri dhe përkushtim Zotit të tij. Ai ishte "një njeri shumë i dashur" (Danieli 10:11) i Perëndisë.

E megjithatë, ndërsa i lutej Zotit në emër të popullit të tij, ai nuk pretendonte se ishte i pastër apo i shenjtë, por e quante veten pjesë të Izraelitëve mëkatarë: "Ne nuk paraqesim përparateje lutjet tona për veprat tona të drejta, por për dhembshuritë

e tua të mëdha." "Ne kemi mëkatuar, kami kryer vepra të liga." Ai deklaron: "Unë po flisja akom, duke u lutur dhe duke rrëfyer mëkatin tim dhe mëkatin e popullit të Izraelit." Më pas, kur Danielit i shfaqet Biri i Perëndisë për ta udhëzuar, ai thotë: "Kështu mbeta vetëm të vërej këtë vegim të madh. Nuk më mbeti kurrfarë force; çehrja e bukur ndryshoi në të zbehtë dhe forcat e mia u ligështuan." Danieli 3:18, 15, 20; 10:8.

Me të dëgjuar zërin e Zotit që dilte nga furtuna, Jobi tha: "Ndjej neveri ndaj vetes dhe pendohem mbi pluhurin dhe hirin." - Jobi 42:6. Vetëm kur pa lavdinë e Zotit dhe dëgjoi njerin nga serafinët[1] të thoshte "I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zotit i ushtrive", Isaia e kuptoi gjendjen e tij të mjerë dhe tha: "I mjeri unë! Unë jam i humbur." - Isaia 6:3, 5. Pali, paso "u rrëmbye" në qiellin e tretë dhe dëgjoi gjëra që nuk mund të thuhen nga asnjë njeri, e quajti veten si "më të voglin e të gjithë shenjtorëve." - Letra e dytë e Korintasve 12:2-4; Efesianët 3:8. Gjoni i dashur pasi kishte mbështetur kokën ne gjoksin e jezusit dhe kishte parë me sy lavdinë e Tij, ra si i vdekur përpara Këmbëve të Tij. - Zbulesa 1:17.

Ata që ecin nën hijen e kryqit të Kalvarit nuk mund të mburren se kanë firuar liri ndaj mëkatit dhe nuk kanë asnjë arsye që të ngjiten në piedestal. Ata e kuptojnë se ishin mëkatet e tyre që i shkaktuan agoninë vdekjeprurëse Birit të perëndisë dhe ky mendim u bën krenaria t'i lë vendin përuljes. Ata që jetojnë mëafër Jezusit e ka shumë të lehtë që të dallojnë dhe karakterin mëkatar të racës njerëzore dhe Jezusi i kryqëzuar dhe i ringjallur përbën për ta, të vetmen shresë shpëtimi.

Shenjtërimi që po luan një rol të rëndësishëm në lëvizjet fetare të ditëve tona, mbart në vetëvete bnjë frymë vetëlavdërimi dhe mospërfilljeje ndja ligjit të Perëndisë që ësthë e huaj për shenjtërimin e vërtetë Biblik. Përkrahësit e tij, na mësojnë se shenjtërimi është një akt momental, që vetëm nëpërmjet besimit të fal përsosmërinë e duhur. "Vetëm beso, - thonë ata, - dhe do të jesh i bekuar." "I bekuari" s'ka pse të lodhet më. Nga ana tjetër, ata hedhin poshtë autoritetin e ligjit të Perëndisë duke deklaruar se të gjithë njerëzit i "kanë shpëtuar" detyrimit për t'i respektuar urdhëresat e tij. Po a ka mundësi që njreëzit të shenjtërohen sipas vullnetit dhe karakterit të Perëndisë pa rënë dakort me ato parimet e drejtësisë, që janë shprehja e natyrës dhe vullnetit të Tij dhe që tregojnë se çfarë i pëlqen Atij vetë.

Dëshira për t'iu përkushtuar një feje të thjeshtë që s'kërkon as përpjekje, as vetësakrifikim dhe as lajmërim nga budallallëqet e kësaj bote e ka kthyer doktrinën e besimit dhe vetëm besimit, në një doktrinë popullore. Po ç'thotë fjala e Perëndisë? Apostulli Jakob na thotë: "Ç'dobi ka, vëllezër të mi, nëse dikush thotë se ka besim, por nuk ka vepra? A mund ta shpëtojë atë besimi? ... Po a dëshiron të kuptosh, o njeri i kotë, se besimi pa vepra është i vdekur? Abrahami, ati ynë, a nuk u shfajsua me anë të veprave, kur ofroi birin e vet, Isakun, mbi altar? Ti e sheh se besimi vepronte bashkë me veprat e tij dhe se, nëpërmjet veprave, besimi u përsos ... Ju

shikoni, pra, se njeriu shfajsohet nga veprat dhe jo vetëm nga besimi." - Jakobi 2:14-24.

Dëshmia e fjalës së Perëndisë e kundërshton doktrinën mashtruesetë besimit pa vepra. Besimi që nuk plotëson kushtet e duhura për të fituar mëshirë, nuk mund të gjejë dashamirësi tek Zoti, sepse nuk është besim i vërtetë, por quhet pseudo-besim; sepse besimi nuk është i vërtetë bazohet tek premtimet dhe kushtet që parashtron Shkrimi i Shenjtë.

Askush të mos mashtrohet duke menduar se do të shenjtërohet ndërsa shkel me ndërgjegje, qoftë edhe njërën prej urdhëresave të Perëndisë. Pranimi dhe kryerja e një mëkati të paramenduar, e bën të heshtë Shpirtin e Shenjtë dhe e largon njeriun nga Perëndia. "Mëkati është shkelje e ligjit." Dhe "kush mëkaton [shkel ligjin nuk e ka parë dhe as nuk e ka njohur Atë." - Letra e parë e Gjonit 3:6. Edhe pse Gjoni në letrat e tij merret shumë me temën e dashurisë, ai nuk heziton që zbulojë karakterin e vërtetë të atij grupi njerëzish, që pretendojnë se kanë përjetuar shenjtërim, ndërsa jetojnë duke e shkelur me të dyja këmbët, ligjin e Perëndisë "Ai që thotë: "Unë e kam njohur atë", dhe nuk zbaton urdhërimet e tij, është gënjeshtar dhe e vërteta nuk është në të. Por kush e zbaton fjalën e tij, në të me të vërtetë dashuria e Perëndisë është përsosur." - Letra e parë e Gjonit 2:4, 5. Kjo është prova që duhet të kalojë çdo njeri. Ne nuk mund ta quajmë një njeri të hsenjtë, pa e krahasuar atë me të vetmin kriter shenjtërie që gjendet si në qiell, ashtu edhe në tokë. Në qoftë se njerëzit nuk e ndjejnë peshën morale të ligjit, në qoftë se ata nuk i japin rëndësi dhe i nënvleftësojnë urdhëresat e Perëndisë, në qoftë se shkelin ata ndërgjegje njërën prej tyre dhe i mësojnë të tjerët që të veprojnë në të njëjtën mënyrë, ata s'do të kenë asnjë vlerë në sytë e Zotit dhe ne, duhet të jemi të sigurtë, se pretendimet e tyre janë pa bazë.

Ideja se dikush është i pafajshëm, është në vetvete një provë,që tregon se ai që e ushqen një ide të tillë s'mund të jetë kurrë i shenjtë. Ky njeri, mendon se është i shenjtë sepse nuk e ka kuptuar siç duhet pastërtinë e përkryer dhe shenjtërinë e Perëndisë dhe të atyre që do të përpiqen t'i ngjajnë karakterit të Tij; ai nuk e ka kuptuar aspak, pastërtinë dhe mirësinë pa kufi të jezusit dhe ligësinë dhe keqdashjen që mishëron në vetvete mëkti. Sa më larg Krishtit të jetë ky njeri, aq më të pasakta do të jenë konceptet e tij mbi karakterin dhe urdhëresat hyjnore dhe aq më i kënaqur, do të jetë ai me vetveten.

Shenjtërimi që përshkruhet mjaft bukur në Shkrimet e Shenjta, përshin qënien si tërësi - frymën, shpirtin dhe trupin. Pali u lut që Selanikasit "me gjithë frymën, shpirtin dhe trupin e tyre të ruheshin pa të meta për ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht." - Letra e parë e Selanikasve 5:23. Ai vazhdon t'u shkruajë besimtarëve: "O vëllezër, po ju bëj thirrje, nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer tek Perëndia." - Romakët 12:1.

Shkuj më parë, në kohën e Izraelit të hershëm, çdo flijim që i ofrohej Perëndisë shqyrtohej me kujdes të veçantë. Kur në kafshën - fli vihej re ndonjë e metë, sado e vogël të ishte ajo, kafsha refuzohej; sepse Zoti kishte urdhëruar që flija të ishte "pa asnjë të metë." Në të njëjtën mënyrë, të Krishterët duhet t'i paraqesin trupat e tyre "si fli të gjalla, të shenjtëruar, të pëlqyer tek Perëndia." E që ta bëjë këtë, ata duhet të bëjnë ç'është e mundur që t'i ruajë sa më mirë forcat e tyre. Çdo zakon që ndikon negativisht në fuqinë fizike apo mendore të një njeriu, e kthen atë në një fli të papërshtatshme shërbimi ndaj Krijuesit të tij. A do t'i pëlqente vallë Perëndisë një blatim i tillë i papërshtatshëm? Jezusi tha: "Ju duhet ta doni Zotin, Perëndinëtuaj me gjithë zemër." Të gjithë ata që e duan Perëndinë me gjithë zemër, dënshirojnë t'i shërbejnë Atij me githë forcat e tyre gjatë gjithë jetës dhe përpiqen që çdo fuqi e qenies së tyre, të jetë në harmoni të plotë me urdhëresat, që do t'u hapin rrugën, aftësive të tyre për të kthyer vullntein e Tij. Ata nuk do t'i lënë as pasionet dhe as dëshirat egoiste, që ta dobësojnë apo ta fëlliqin blatimin që i përket Atit qiellor.

Pjetri thotë: "Hiqni dorë nga lakmitë e mishit që luftojnë kundër shpirtit." - Letra e parë e Pjetrit 2:11. Çdo kënaqësi mëkatare që synon të mpijë aftësitë dhe të paralizojë dhuntitë mendore dhe shpirtërore, duke bërë kështu, që fjala dhe Shpirti i Perëndisë ta kenë të vështirë që ta prekin zemrën. Pali u shkruan Korintasve duke u thënë: "Le ta pastrojmë veten nga çdo ndotje e mishit dhe frymës dh ta përfundojë shenjtërimin tonë në druajtjen e Perëndisë" - Letra e dytë e Korintasve 7:1. Dhe bashkë me frytet e Shpirtit - "dashuria, gëzimi, paqja, durimi mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia" - ai përmënd edhe "vetëkontrollin." - Galatasit 5:22, 23.

Shumë njerëz që quajnë veten të Krishterë, pavarësisht nga deklarata të tilla - frymëzime të Zotit, vazhdojnë t'i dobësojnë fuqitë e tyre në dobi të fitimeve apo të ndjekjes së modës; sa të shumtë janë ata që i flakin tej vitet e rinisë duke ngrënë gjithfarë gjërash, duke pirë dhe duke u dhënë pas kënaqësish nga më të ulëtat ... Ndërsa kisha, shumë shpesh, në vend që t'i qortojë ashpër vese të tilla, e inkurajon të keqen duke ngritur lart dëshirën pë fitim, oreksin pakufi dhe nxitjen ndaj kënaqësisve; të gjitha këto, bëhen për të rritur numrin e anëtarëve sepse dashuria për Krishtin është një flakëz në shuarje e sipër dhe s'mund të ndihmojë më në shtimin e këtij numri. SikurJezusi të hynte në kishat e ditëve tona dhe të shihte tregtinë e paligjshme dhe gostitë që organizohen atje në emër të fesë, a nuk do t'i përsinte këta "shenjtorë", ashtu si nxorri dikur jashtë tempullit tregëtarët?

Apostulli Jakob deklaron se mençuria që vjen nga lart është "fillimisht e pastër." Sikur t'i kishte takuar ky apostull, ata që e shqiptojnë emrin e çmuar të Jezusit me buzët që kanë pirë dhe duhanin, ata, fryma e të cilave mban erën e keqe të tij, ata, që të ndotin ajrin e qiellit dhe i detyrojnë të tjerët të thithin helm - sikur apostulli të ishte ballafaquar me një praktikë tërëshisht të ndryshme nga pastërtia e ungjillit, a nuk do ta kishte quajtur atë "tokësore, sensuale dhe djallëzore?" Skllevërit e

duhanit, duke pretenduar se kanë marrë bekimin e madh të shenjtërimit, mburren me shpresën që kanë për të shkuar në qiell një ditë, por fjala e Perëndisë thekson qartë se "nuk do të hyjëatje asgjë e pastër." - Zbulesa 21:27.

"A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia, dhe se nuk i përkisni vetvetes? Sepse u bletë me një çmim! Lavdëroni Perëndinë, pra, në trupin tuaj në frymën tuaj, që i përkasin Perëndisë." - Letra e parë e Korintasve 6:19, 20. Ai, trupi i të cilit është tempull i Shpirtit të Shenjtë, nuk do t'ja lejojë vetes që të bëhet shkas i një zakoni të dëmshëm. Fuqitë e tij i përkasin Krishtit që i ka blerë atë me çmimin e gjakut të Tij. Dhuntitë dhe vetotë e tij janë të Zotit. Si ka mundësi që ky njeri ta shpërdorojë kapitalin që i është besuar dhe të vazhdojë të quhet i pafajshëm? Të ashtuquajturit të Krishterë harxhojnë çdo vit shuma të mëdha të hollash për të përmbushur dëshirat e tyre të rrezikshme dhe të kota, ndërsa në të njëjtën kohë,shpirtra njerëzore kanë etje për fjalën e jetës. Duke shpenzuar mbi latarin e epshit më shumë se ç'japin për të ushqyer të varfrit dhe për të përhapur lajmin e mirë, ata e grabisin Perëndinë në të dhjetat dhe dhuratat. Sikur të gjithë ata që deklarojnë se janë ndjekës të denjë të Krishtit të ishin shenjtëruar me të vërtetë, do t'ja dhuronin thesarit të Zotit të ardhurat e tyre, në vend që t'i përdorin për plotësimin e kërkesave të panevojshme dhe të dëmshme dhe të Krishterët do të ishin kështu një shembull vetëmohimi, vetësakrifikimi dhe vetëkontrolli. Ata do të ishin dritë për mbarë botën..

Bota ësshtë pre e dëshirave egoiste, Njerëzit janë nën kontrollin e "dëshirave të ethshme të mishit, të syrit dhe krenarisë për jetën." Por pasuesit e Krishtit kanë një mision shumë më të shenjtë si ky. "Dilni ngamesi i tyre dhe ndahuni prej tyre, thotë Zoti, dhe mos prekni asgjë të ndyrë." Duke u bazuar tek drita sqaruese e fjalës së Perëndisë mund të deklarojmë se shenjtërimi i vërtetë do të thotë braktisje tërësore e dëshirave mëkatare që i përkasin kësaj bote.

Atyre që i përgjigjen thirrjes: "Dilni nga mesi i tyre dhe ndahuni prej tyre,, dhe mos prekni asgjë të ndyrë, "Zoti u ka premtuar se "do t'i pranojë, dhe do të jetë si Atë për ta dhe ata do të jenë për të si bijtë dhe bijat e Tij." - Letra e dytë e Korintasve 6:17, 18. Është detyra dhe privilegji i çdo të Kishteri që të ketë një përvojë sa më të pasur në gjërat që i përkasin Perëndisë. "Unë jam drita e botës. - tha Jezusi. - Kush nuk më ndjek do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës." - Gjoni 8:22. Shtegu i të drejtave ësthë si drita e agimit, që shkëlqen gjithnjë e mëshumë deri sa të bëhet ditë e plotë." - Fjalët e vërteta 4:18. Çdo hap besimi sa të bëhet eplotë." - Fjalët e Urta v4:18. Çdo hap besimi dhe bindje e ofron shpirtin njerëzor Dritën e botës, e sjell atë afër Atij që "nuk ka errësirë fare, por është vetëm dritë."Rrezet e shndritshme të Diellit të Drejtësisë ngrohin shërbëtorët e Perëndisë dhe u takon këtyre të fundit, detyra e reflektimit të këtyre rrezeve. Ashtu si yjet na tregojnë se ka një dritë të madhe në qiell, lavdia e të cilës u ka dhënë atyre shkëlqimin, edhe

të Krishtit duhet t'i tregojnë botës së ulur mbi fronin e universit qëndron një Zot, karakteri i të Cilit është ndenjë për t'u lëvduar e për t'u imituar. Hiret e Shpirtit të Tij, pastërtia dhe shenjtëria e karakterit të Tij duhet të shfaqen tek dëshmitarët e Tij.

Pali, në letrën drejtuar Kolosianëve, shkruan për bekimet e mëdha që i presin fëmijët e Perëndisë Ai thotë: "Ne nuk pushojmë të lutemi për ju dhe të kërkojmë që të mbusheni me njohjen e vullnetit të tij, me çdo urtësi dhe mençuri frymërore, që të ecni në mënyrë të denjë për Zotin, që t'i pëlqeni atij në çdo gjë, duke sjellë fryt në çdo vepër të mirë dhe duke u rritur në njohjen e Perëndisë; duke u forcuar me çdo fuqi, pas pushtetit të lavdisë së Tij, për çdo ngulm e durim, me gëzim duke falenderuar Perëndinë - At." - Kolosinët 1:9-11.

Ai u shkruan përsëri vëllezërve të tij në Efes për dëshirën që ka, që ata të mund ta kuptojnë rëndësinë e privilegjet që mbajnë mbi supe të Krishterët. Ai u përshkruan atyre, duke përdorur një gjuhë sa më të kuptueshme, fuqinë dhe dijen e mrekullueshme që ata, si bijë dhe bija të Zotit të Plotpushtetshëm, duhet të kenë. Fuqia e tyre "duhej të forcohej nëpërmjet Frymës së tij në njeriun e perbrendshëm", të "rrënjosej e të themelohej në dashuri", të "rrënjosej e të themelohej në dashuri", që ata të mund "të kuptonin me të gjithë shenjtorët cila është gjerësia,gjatësia, thellësia dhe lartësia; të mund ta njihnin dashurinë e Krishtit që tejkalon çnjohuri." Por lutja e apostullit arrin pikën kulmore kur ai lutet që "të mbusheni me tërë plotësinë e Perëndisë." - Efesianët 3:16-19.

Në këtë pasazh zbulon mjaft bukur përmasat e suksesit që ne mund të arrijnë nëpërmjet besimit tek premtimet e Atit tonë qiellor sa herë që u përgjigjemi kërkesave të Tij. Falë meritave të Krishtit ne mund të gjunjëzohemi përpara fronit të Fuqisë Pafund. "Ai që nuk e kurseuBirin e vet, por e dha për të gjithë ne, qysh nuk do të na dhurojë të gjitha bashkë me të? - Romakët 8:32. Ati ia dha paë kursim Birin Shpirtin e Tij, dhe rrjedhimisht, edhe ne mund të marrim pjesë në plotësinë e Tij. Jezusi thotë: "Nëse ju, pra, që jemi të këqinj, dini t'u jepni dhurata të mira bijve tuaj, aq më tepër Ati juaj qiellor do t'u dhurojë Frymën e Shenjtë atyre që ia kërkojnë." - Luka 11:13. "Në qoftë se do të kërkoni diçka në emrin tim, unë do ta bëj." "Kërkoni dhe do të merrni që gëzimi juaj të jetë i plotë." - Gjoni 14:14; 16:24.

Jeta e një të Krishtit duhet të karakterizohet nga përulja dhe jo nga trishtimi apo vetë - nenvleftësimi. Është privilegj për cilindo, që të jetë në mënyrë të tillë, që t'i pëlqejë Perëndisë dhe të marrë bekimet e Tij. Nuk ësthë vullneti i Atit tonë qiellor që ne të dënohemi apo të jetojmë në errësirë. Të ecësh me kokë ulur dhe me zemrën të trishtuar nga mendimet egoiste, nuk do të thotë të jesh i përulur. Ne mund të shkojmë e të pastrohemi tek Jezusi për të dalë përpara ligjit me kokën lart dhe me ndërgjegje të pastër. "Tani, pra, nuk ka asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus, që nuk ecin sipas mishit, por sipas Frymës." - Romakët 8:1.

Përmes Jezusit, bijtë mëkatare të Adamit u bënë "bij tëPerëndisë". "Sepse Ai që shenjtëron dhe ata shenjtërohen janë të gjitha prej një; prandaj as nuk turpërohet

që t'i quajë vëllezër." - Hebrenjtë 2:11. Jeta e një të Krishteri duhet të jetë besimi, fitorja dhe gëzimi me Perëndinë. "Çdo gjë që ka lindur nga Perëndia e mund botën; dhe kjo është fitorja që e mundi botën: besimi ynë." - Letra e parë e Gjonit 5:4. Me të drejtë, shërbëtori i Zotit, Nehemia, tha: "Gëzimi i Zotit është fuqia juaj." - Nehemia 8:10. Ndërsa Pali thotë: "Gëzohuni gjithnjë në Zotin; po jua them përsëri: Gëzohuni!" "Jeni gjithmonë të gëzuar. Lutuni pa pushim për çdo gjë falenderoni sepse i tillë është vullneti i Perëndisë në Krishtin Jezus për ju." - Filipianët 4:4; Letra e parë e Selanikasve 5:16-18.

Fryte të tilla lindin nga shndërrimi i vërtetë shpirtëror dhe shenjtërimi i vërtetë Biblik; por këto fryte shijohen kaq rrallë, sepse të Krishterët nuk i përfillin parimet e mëdha të drejtësisë që zbulon qartë në ligjin e Perëndisë. Kjo është arsyeja që ka humbur në lëvizjet fetare të kohëve moderne në dallim me ato të së shkuarës, ndikimi rrënjosur dhe i vazhdueshëm i Shpirtit të Perëndisë.

Ne ndryshojmë duke parë. Dhe kur shikon se si shkelen me këmbë urdhëresat hyjnore, në të cilat Perëndia ka shprehur përsosshmërinë dhe shenjtërinë e karakterit të Tij dhe se si mendjet e njerëzve tërhiqen pas mësimeve dhe teorive njerëzore, kupton se s'ka asnjë çudi që në kisha ka humbur fryma e dashurisë dhe mëshirosh Zoti thotë: "Populli im ka humbur fryma e dashurisë dhe mëshirosh Zoti thotë: "Populli im ka kryer dy të këqija: më ka braktisur mua, burimin e ujit që rrjedh, për të hapur sterna, sterna të prishura që nuk mbajnë ujin." - Jeremia 2:13.

"Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës së pabesëve ... por qëgjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij. Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij dhe të cilin gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi." - Psalmi 1:1 - populli i Zotit do të përjetojë një përtëritje të besimit dhe mirësisë së mëparshme. Vetëm në qoftë se ligjit të Perëndisë do t'i rikthehet vendi i duhur. Kështu thotë Zoti: "Ndaluni nëpër rrugë dhe shikoni, pyesni për shtigjet e vjetra, ku ësthë rruga e mirë, dhe ecni nëpër të; kështu do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj." - Jeremia 6:16.

1. Si mund ti krahasojmë rigjallërimet e sotme me ato të të Krishterëve të hershëm?

2. Disa mësojnë se ligji u anullua kur Jezusi vdiq në kryq. A është kjo e vërtetë sipas shkrimeve?

3. Cila është lidhja midis besimit dhe veprave? Shpjegoni se si këto të dyja bashkëveprojnë me njëra tjetrën në jetën tuaj?

28.

Duke u Përballur me Ngjarjet Jetësore

"Unë vazhdova të shikoj" - thotë profeti Daniel, - deri sa u vendosën fronet dhe i Lashti i Ditëve u ul. Vdekja e tij ishte e bardhë si bora, flokët e kokës së tij ishin si leshi i pastër, froni i tij ishte si flokët e zjarrit dhe rrotat e tij si zjarr përvëlues. Një lumë zjarri rridhte, duke dalë nga prania e tij; mijëra e mijëra njerëz i shërbenin dhe mori dhe moriqëndrimin përpara tij. Gjykimi u bë dhe librat u hapën." - Daniel 7:9, 10.

Kështu, profeti i shfaqet në vizion ajo ditë e madhe dhe solemne kur Gjykatësi i botës do të shqyrtojë me kujdes jetët dhe karakteret e të gjithë njerëzve dhe çdo njeri do të marrë "sipas veprave të tij." I Lashti i Ditëve është Perëndia - Atë. Psalmisti thotë: "Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kishte formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia." - Psalmi 90:2. Ai ësthë themeli i gjithçkaje dhe burimi i ligjit që do të zbatohet gjatë këtij gjykimi. Në këtë gjyq, do të shërbejnë si ministra dhe dëshmitarë edhe engjëjt që janë "mijëra e mijëra dhe mori dhe mori."

"Ja, mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu, ai arriti deri te i Lashti i Ditëve dhe iu afrua atij. Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që të gjithë popujt, kombet dhe gjuhët t'i shërbenin; sundimi i tij ishte një sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë." - Danieli 7:13, 14. Kështu përshkruhet një ardhje e Krishtit, por nuk është fjala për ardhjen e Tijtë dytë në tokë. Ai vjen tek I lashti i Ditëve në qiell, për të marrë sundim, lavdi dhe një mbretëri që do t'i jepen në fund të punës së Tij si ndërjemetës. Pikërisht kjo ardhje dhe jo ardhja e Tij e dytë në tokë, parashikohet se do tëndodhë në fund të periudhës 2300 ditore, në vitin 1844. Kryeprifti ynë, në praninë e engjëjve qiellorë, hyn në "vendin sumë të shenjtë" për të qëndruar përara Perëndisë dhe për të kryer aktin e fundit të shërbimit të Tij në emrin e njerëzve -pra për të përfunduar gjykimin zbulues dhe për t'i shlyer me anë të gjakut të Tij, mëkatet e të gjithë atyre që përmbaheshin kushtet për të përfituar prej Tij.

Në shërbesën imituese (tokësore) vetëm ata që ishin penduar dhe kishin rrëfuer mëkatet e tyre përpara Perëndisë; mëkate që, prmes gjakut të flisë i kalonin shenjtores, mund të merrnin pjesë në shërbimin e Ditës së Shlyerjes. Kështu, në ditën e madhe të shlyerjes përfundimtare dhe të gjykimit zbulues, shqyrtohen vetëm rastet e njerëzve të Zotit. Gjykimi i të ligjve ësthë një akt krejtësisht i veçantë dhe do të kryhet më vonë. "Erdhi koha që të fillojë gjyqi nga shtëpia e Perëndisë; dhe nëse fillon më përpara nga ne, cili do të jetë fundi i atyre që nuk i binden ungjillit të Perëndisë.?" - Letra e parë e Pjetrit 4:17.

Marrja e vendimeve gjatë këtij gjykimi do të bëhet duke u bazuar tek librat e të dhënave në të cilat janë regjisttruar të gjitha veprat e njerëzve. Profeti Daniel thotë: "Gjykimi u bë dhe librat u hapën." Gjoni, duke përshkruar të njëjtën skenë, shton: "U hap një libër tjetër, që është libri i jetës: dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre." - Zbulesa 20:12.

Libri i jetës përfshin emrat e të gjithë atyre njerëzve, që në kohëra i kanë shërbyer Perëndisë. Jezusi u tha dishepujve të Tij: "Gëzohuni më shumë se emrat tuaj janë të shkruar në qiej." - Luka 10:20. Pali flet për bashkëpunëtorët e tij besnikë "emrat e të cilëve janë në librin e jetës." - Filipianët 4:3. Danieli duke,hedhur sytë drejt "një kohe me ankthe, ashtu si nuk ka pasur kurrë", deklaron se njerëzit e Zotit, "kushdo që do t'i gjendet emri i shkruar në libër", do të çlirohen. Ndërsa Gjoni, thotë se në qytetin e Perëndisë do të hyjnë vetëm ata "që janë të shkruar në librin e jetës të Qingjit." - Danieli 12:1, Zbulesa 21:27.

"Përpara Zotit ësthë shkruar një "libër kujtimi" ku janë regjistruar veprat e mira të atyre "që kanë frikë nga Zoti dhe që e nderojnë emrin e Tij." - Malakia 3:16. Fjalët e tyre që i kishin burimin tek besimi, aktet e tyre të dashurisë janë shkruar në qiell. Nehemia i referohet pikërisht kësaj, kur thotë: "Më kujto mua, o Perëndia im dhe mos i fshij veprat e mira që kam bërë për shtëpinë e Perëndisë tim." - Nehemia 13:14. Në librin e kujtimeve të Zotit ësthë gdhendur çdo vepër drejtësie, për të mos u harruar kurrë. Atij i është bërë kronikë çdo përballimit të tundimit, mundjes së çdo të keqje, shprehjes së çdo fjale dashamirësie. Është shkruar aty gjithashtu: çdo sakrificë, çdo vuajtje dhe çdo trishtim që ka ardhur si rrjedhim i mbrojtjes së emrit të Krishtit. Psalmisti thotë: "Ti i ke numëruar hapat e bredhjes sime, vendosi lotët e mia në calikun tënd; a nuk i ke regjistruar në librin tënd?" - Psalmi 36:8.

Por ekziston dëshmi e shkruar edhe e mëkateve të njerëzve. "Sepse Perëndia do të vërë të gjykohet çdo vepër, edhe çdo gjë të fshehur, qoftë e mirë apo e keqe." "Ditën e gjyqit njerëzit do të japin llogari për çdo fjalë të kotë që kanë thënë." Shpëtimtari thotë; "Sepse në bazë të fjalëve të tua do të dënohesh." - Predikuesi 12:14; Mateu 12:36, 36. Qëllimet dhe motivet e fshehta do të zbulohen në gjërat e fshehta të errësirës dhe do të shfaqë këshillat e zemrave ..." - Letra e parë e Korintasve 4:5. "Ja, e tërë kjo është e shkruar përpara meje ...paudhësitë tuaja dhe të etërve tuaj të gjitha së bashku", thotë Zoti" - Isaia 65, 6, 7.

Veprat e të gjithë njerëzve kalojnë përpara syve të Perëndisë dhe regjistrohen si të drejta apo si të padrejta. Përkrah emrit të çdo njeriu është regjistruar në librat qiellore saktësisht, çdo fjalë e gabuar, çdo veprim egoist, çdo detyrë e lënë në mes, çdo mëkat i fshehur sadomirë i maskuar të ketë qënë ai. Engjëlli - sekretar ka mbajtur shënim çdo mospërfillje ndaj paralajmërimeve apo qortimeve qeillore, çdo çast të humbur, çdo mundësi të pashfrytëzuar, çdo vepër të mirë apo të keqe bashkë me rezultatet saj dobiprurëse apo të dëmshme.

Gjatë këtij gjykimi, jetët dhe karakteret e njerëzve do të krahasohen me ligjin e Perëndisë që është kriteri i pranimit apo mospranimit. Njeriu i mençur thotë: "Ki frikë nga Perëndia dhe respkto urdhërimet e tij, sepse kjo është detyra tërësore e njeriut dhe Perëndia do të vërë të gjykohet çdo vepër." - Predikuesit 12:13, 14. Ndërsa apostulli Jakob i paralajmëron vëllezërit e tij duke ju thënë: "Prandaj të flisni e të veproni sikurse të duhej të gjykoheshin nga ligji i lirisë." - Letra e Jakobit 2:12.

Ata që gjatë gjykimit do të "quhen të denjë" do të ngrihen në ringjalljen e parë të të drejtëve. Jezusi tha: "Ata që do të gjenden të denjë të kenë pjesë në botën tjetër dhe në ringjalljen e të vdekurve ... janë si engjëjt dhe janë bij të Perëndisë; duke qënë bij të ringjalljes." - Luka 20:35, 36. Ai deklaron edhe një herë se "ata që kanë bërë të mira do të dalin "në ringjalljen e jetës." - Gjoni 5:23.

Të vdekurit që gjatë jetës së tyre i përkisnin Jezusit, do të ngrihen nga gjumi i vdekjes vetëm pasi të jeni quajtur "të denjë"për të marrë pjesë në "ringjalljen e jetës". Kështu, ata nuk do të jenë të pranishëm gjatë seancave të gjyqit ku do të shqyrtohen karakteret e tyre dhe ku do të merret vendimi për jetët e tyre.

Jezusi do të jetë avokati i tyre mbrojtës dhe do t'i lutet Perëndisë në emër të tyre, duke i ofruar Atij gjakun e Tij. "Në qoftë se ndokush mëkatoi, kemi një avokat tek Ati, Jezu Krishtin të drejtin." - Letra e parë e Gjonit 2:1. "Sepse Krishti nuk hyri në një shenjtore të bërë me dorë, që është vetëm shembëllesë e asaj të vërtetë, por në vetë qiellin për të dalë tani përpara Perëndisë për ne." "Prandaj edhe mund të shpëtojë plotësisht ata që me anë të Tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta." - Hebrenjtë 9:24; 7:25.

Gjatë gjykimit, me t'u hapur librat e të dhënave, përpara Perëndisë shfaqen si në një film, jetët e të gjithë atyre që ishin besuar tek Jezusi. Avokati ynë mbrojtjes duke filluar me ata që ishin të parët banorë të tokës, paraqet rastet e çdo brezi pasues dhe përfundon me ata që janë akoma gjallë. Përmendet çdo emër, gjykohet me vëmendje çdo rast. Disa emra pranohen, disa emrave të tjerë Ju mohohet e drejta e pranimit. Emrat e të gjithë atyre, që kanë ende të shkruar mëkate për të cilat nuk janë penduar, do te fshihen nga libri dhe veprat e tyre të ira nuk do të jenë më të regjistruara në librin e kujtimit të Perëndisë. Zoti i tha Moisiut "Atë që ka bërë mëkat kundër meje, do ta fshijë nga librin e kujtimit të Perëndisë Zoti i tha Moisiut "Atë që ka bërë mëkat kundër meje, do ta fshijë nga libri im." - Eksodi 32:33. "Por

në rast se i drejti largohet nga drejtësia e tij dhe kryen paudhësi ... drejtësia që ka bërë nuk do të kujtojet ë." - Exekili 18:24.

Krahas emrave të gjithë atyre, që me të vëtetë janë penduar përmëkatet e tyre dhe që e kanë pranuar me anë të besimit gjakun e Krishtit si flijim shlyrës, ësthë shkruar në librat qiellor fjala "të falur"; duke qënë se ata marrim pjesë në drejtësinë e Krishtit dhe karaktere e tyre përputhen me ligjin e perëndisë, ata vetë do të quhen të denjë për të marrë dhuratën e jetës së përjetshme, pasi t'u jenë fshirë mëkatet e tyre. Zoti, nëpërmjet profetit Isaja, deklaron: "Unë, pikërisht unë, jam ai që për hir të vetvetes fshij shkeljet e tua dhe nuk do t'i mbaj mend mëkatet e tua." - Isaia 43:25. Jezusi tha: "Kush fiton do të vishet me rroba të bardha dhe unë nuk kdo ta fshijë emrin e Tij nga libri i jetës, por do të rrëfej emrin e tij përpara Atit dhe para engjëjve të Tij përpara Atit dhe para engjëjve të tij." "Kushdo që do të më rrëfejë përpara njerëzve, edhe unë d ta rrëfej përpara Atit tim që është në qiej. Por kushdo që do të më mohojë përpara Atit tim që ësthë në qiej." - Zbulesa 3:5; Mateu10:32, 22.

Interesi dhe kureshtja e njerëzve ndaj vendimeve që marrin gjykatat tokësore, përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të interesit që ngjall shqyrtimi nga Gjykatësi i tokës i emrave të librit të jetës në oborret mbretërore të qiellit. Ndërmjetësi hyjnor, paraqet lutjen e Tij që t'u kurorëzohen trashëgimtarë bashkë me Të "në sundin e lashtë" të gjithë ata që kanë fituar, falë besimit në gjakun e tij shlyrës. (Mikea 4:8). Satani, në përpjekjet e tij për të mashtuar dhe tunduar racën njerëzore, është orvatur që t'i bërë shkelmin planit hyjnor që u skicua që në krijimin e njerëzimit; por Krishti, kërkon që ky plan të vihet në zbatim i plotë sikur njerëzit të mos kenë dështuar kurrë Ai kërkon që pooulli i tij, jo vetëm të falet dhe të shfajsohet plotësisht, por edhe të marrë pjesë në lavdinë e Tij dhe të ulet pranë fronit të Tij.

Ndërsa Krishti lutet për ata që e kanë pranuar hirin e Tij, Satani i akuzon ata përpara Perëndisë si njerëz të padenjë. Mashtruesi i zgjuar është përpjekur që t'i shtyjë ata drejt rrugës së skeptizmit, t'i bëjë të humbin besimin tek Perëndia, t'i bëjë të largohen nga dashuria e Tij, t'i bëjë ta kthejnë ligjin e Tij. Dhe tani ai tregon me gisht dëshminë e shkuar të jetës së tyre, të metat e karakterit, pangjashmërinë me Krishtin që përbën një fakt fyes për Shpëtimtarin e tyre, të gjithë mëkatet drejt të cilave i ka tunduar ai vetë dhe pretendon, duke marrë parasysh të gjitha këto, se ata i përkasin atij dhe askujt tjetër.

Jezusi nuk i shkarkon ata nga faji që mbart në vetvete mëkati, por thekson besimin dhe pendesën që kanë treguar; dhe duke kërkuar faljen e tyre, Ai ngre përpara Atit dhe engjëjve të shenjtë duart e Veta me plagë dhe ju thotë: "Unë e njoh secilin prej tyre me emër. I kam gdhendur emrat e tyre në pëllëmbët e duarve të mia". "Flijimet e Perëndisë janë frymë e thyer; o Perëndi, ti nuk e përçmon zemrën e thyer dhe të penduar." - Psalmet 31:17. Ndërsa akuzuesit, i drejtohet duke i thënë: "Të qortoftë ashpër Zoti, o Satan! Po, Zoti që ka zgjedhur Jeruzalemin të qorotë ashpër!

A nuk është vallë kjo një urë zjarri e shkëputur nga zjarri?" - Zakaria 3:2. Krishti do t'i veshë njerëzit e Tij besnikë me rrobën e drejtësisë së Vet, në mënyrë që t'ia paraqesë ata Atit "të lavdishëm, pa njolla o rrudha a ndonjë gjë të tillë." - Efesianët 5:27. Emrat e tyre janë regjistruar në librin e jetës dhe për ta shkruhet: "Do të ecin me mua të veshur në të bardha, sepse janë të denjë." - Zbulesa 3:4.

Kështu do të përmbushet plotësisht premtimi i besëlidhjes së re:"Unë do ta fal paudhësinë e tyre dhe nuk do ta kujtoj më mëkatin e tyre." "Në ato ditë, në atë kohë," thotë Zoti, "do të kërkohet paudhësia e Izraelit, por nuk do të ketë fare, dhe mëkatet e Judës nuk do të gjenden." - Jeremia 31:34; 50:20. "Po atë dotë filizi i Zotit do të jetë gjithë shkëlqim dhe lavdi, dhe fryti i tokës do të jetë krenaria dhe zbukurimi i të shpëtuara të Izraelit. Dhe ka për të ndodhur që ata që do të kenë mbetur në Sion dhe ai që do të mbijetojë në Jeruzalem do të quhet i shenjtë, do-methënë kushdo që në Jeruzalem figuron i shkruar ndër të gjallët." - Isaia 4:2, 3.

Gjykimi zbulues dhe fshirja e mëkateve do të kryhen përpara ardhjes së dytë të Zotit. Meqënëse të vdekurt do të gjykohen duke u bazuar tek të dhënat e shkruara në libra, është e pamundur që fshirja e mëkateve të njerëzve të kryhet përpara gjykimit ku edhe do të shqyrtohen rastet e tyre. Por Apostull Pjetër thotë qartë, që mëkatet e besimtarëve do të fshihen "kur të vijnë kohët e flladit nga prania e Zotit dhe ai të dërgojë Jezu Krishtin." - Veprat 3:13, 20. Me të përfunduar gjykimi zbulues, do të vijë Krishti, për t'i dhënë çdo njeriu shpërblimin sipas veprave të tij.

Gjatë shërbesës imituese (tokësore), kryeprifti pasi përfundonte shlyerjen për Izraelin, dilte për të bekuar bashkësinë. Në të njëjtën mënyrë, Krishti në fund të punës së tij si mdërmjetës, do të shfaqet "pa mëkat dhe me shpëtim" (Hebrenjtë 9:29) për t'i bekuar njerëzit që po e presin me dhuratën e jetës së përjetshme. Ashtu si prifti, që me t'i larguar mëkatet nga shenjtoria, i rrëfente ato mbi tokën e cjapit, edhe Krishti do të kalojë mëkatet e të gjithëve mbi Satanin, që është autori dhe nxitësi i mëkatit. Cjapi që mbartte mbi vetë mëkatet e Izralit dërgohej"në tokë të vetmuar" (Levitiku16:22); po kështu, do të burgoset për njëmijë vjet në tokë që në atë kohë do të jetë e shkretë dhe e pabanuar edhe Satani, që do të mmbartë mbi vete fajin e të gjtha mëkateveqë ai vetë i ka detyruar njerëzit e Zotit t'i kryejnë, dhe në fund, ai do ta vuajë dënimin e plotë që sjell mëkati, duke u djegur bashkë me të gjithë njerëzit e ligjit. Kështu, me fshirjen përfundimtare të këkatit nga faqja e dheut dhe me çlirimin e të gjithë atyre që kanë qënë gati të hiqnin dorë nga e keqja, realizohet edhe plani i mrekullueshëm i shpëtimit.

Puna për shqyrtimin dhe fshirjen e mëkateve fillon në kohën e caktuar për gjykim - në vitin 1844, në fund të periudhës 2300 ditore. Të gjthë ata që kanë marrë mbi bete emrin e Krishtit duhet të ballafaqohen me një shqyrtim të tillë të hollësishëm. Ai të gjallët, ashtu edhe të vdekurit, duhet të gjykohen duke bazuar tek "ato gjëra, që sipas veprave të tyre, janë shkruar në libra."

Mëkatet, për të cilat njerëzit nuk janë penduar dhe s'i kanë harruar, nuk do të falen as nuk do të fshihen nga nfaqet e librave të të dhënave, por do të mbeten të shkruarë, për të dëshmuar kundër mëkatarit në ditën e caktuar nga Perëndia. Ai mund t'i ketë kryer këto vepra të këqija gjatë ditës me diell apo në errësirën e natës; por ato janë të dukshme dhe të hapura në sytë e Atij që ësthë zgjuar ditë e natë. Engjëjt e Perëndisë janë dëshmitarë të çdo mëkati dhe e regjistrojnë atë në librin e pagabueshëm të të dhënave. Mëkati mund të fshihet, të mohohet, të mbulohet nga babai, nëna, gruaja, fëmijët apo shokët; vetëm fajtorët mund të dyshojnë për gabimin që kanë bërë; por asgjë t'i shpëtojë zgjuarsisë si qenieve qiellore. Errësira e natës më tëerrët, fshehtësia e të gjitha mashtrimeve së bashku, nuk mjaftojnë për t'ia fshehur qoftë edhe një mendim të vetëm, Të Përjetshmit. Perëndia ka një dëshmi të shkruar mëse të saktë, të cdo mendimi dhe të çdo veprimi të gabuar. Zoti nuk mashtrohet nga përkushtimi i rremë. Ai nuk gabon kurrë në vlerësimin e karakterit njerëzor. Njerëzit mund të mashtrohen nga ata që e kanë të keqen në zemër, por Perëndia i shkatërron "muret mbrojtëse" dhe shikon brendësinë e çdo njeriu.

Sa solemn është një mendim i tillë! Ndërsa i afrohemi përjetësisë, çdo ditë është ngarkuar me peshën e të dhënave që do të shkruhen në librat qiellorë. Fjalët e thëna dikur, veprimet e kryera dikur nuk mund të kthehen kurrë mbrapsht. Engjëjt i kanë regjistruar si të mirën, dhe të keqen. Pushtuesi më i fuqishëm në botë, nuk mund të fshijnë as të dhënat e jë dite të vetme. Veprimet tona, fjalët tona, madje edhe motrave tona më të fshehta, ndikojnë në caktimin e fatit tonë: për të mirë, a për të keq. Edhe pse ne mund t'i kemi harruar, ato do të dëshmojnë për të na shfajsuar, apo për të na dënuar.

Ashtu siç riprodhohen pa as më të voglin gabim në telajat e një artisti tiparet e një njeriu, ashtu skicohen edhe në librat qiellorë karakteret njerëzore. E megjithatë, askush nuk shqetësohet për atë dëshmi të shkruar që do të lexohet nga qënie qiellore. Sikur të grissej perdja që ndan të dukshmen nga e padukshmja dhe bijtë e njeriut të mund të shihnin një engjëll të cilin do ta takonin përsëri gjatë gjykimit, duke mbajtur shënin çdo fjalë e çdo veprim; pa fjalë që i përdorim çdo ditë nuk do të shqiptoheshin më dhe sa veprime nuk do të kryheshin më kurrë?

Gjatë ketij gjykimi do të shqyrtohen me vëmendje shfrytëzimi i çdo dhuntie dhe talenti. Si e kemi përdorur kapilin që na kadhuruar Perëndia? Po Zoti, në ardhjen e Tij të dytë, do të përfitojë interes nga kapitali që ka investuar? A i kemi përdorur fuqitë që na janë besuar; fuqitë mendore, fizike e shpirtërore, për ta lavdëruar Perëndinë e për ta bekuar botën? Si e keni shfrytëzuar kohën tonë, zërin tonë, të hollat tona, ndikimin tonë? Çfarë kemi bërë për Krishtin kur Ai na është shfaqur në figurën e të varfrit, jetimit, të gruas së ve? Perëndia na ka kther në arkëtarë të fjalës së Tij të shenjtë; ç'kemi bërë me atë dritën dhe të vërtetën që na është dhuruar për t'juahapur sytë njerëzve përpara shpëtimit? Besim tek Krishti i shprehur me fjalë

të bukura, nuk ka asnjë vlerë; dashuria dhe vetëm dashuria e shprehur me anë të veprave quhet "e denjë". Në sytë e Perëndisë vetëm dashuria mund t'i japë vlerë një veprimi. Gjithshka që motivohet nga dashuria, sado e vogël t'i duhet njerëzve, pranohet dhe shpërblehet nga Zoti.

Egoizmi i fshehur zbulohet në librat e qiellit. Ata janë pasqyrë e detyrave të lëna në mes ndaj të afërmve tanë dhe e mospërfilljes ndaj qëllimeve të Shpëtimtarit. Atje do të shfaqet qartë fakti se njerëzit, i dedikojnë shpesh Satanit kohën, mendimet dhe fuqinë që i takojnë Krishtit. Engjëjt çojnë në qiell të dhëna dekurajuesve. Qënieve të zgjuara që deklarojnë me zë të lartë se janë pasuese të Jezusit, janë të dhëna kokë e këmbë pas pasurisë dhe kënaqësive tokësore.

Të hollat, koha, fuqitë, të gjitha, sakrifikohen për hir të këtyre "idealeve të larta"; por sa të pakta janë miniaturat që i kushtohen lutjes, sundimit të kujdesshëm të Shkrimmeve të Shenjta, përuljes shpirtërore dhe rrëfimit të mëkateve ...

Satani përdor intriga të panumërta për të pushtuar mendjet tona, në mënyrë që ato të mos merren më me punën e Perëndisë që duhettë jetë më e rëndësishme në jetë. Kryemashtruesi i urren të vërtetat e mëdha që hedhin dritë mbi një flijim shlyerës dhe mbi një ndërmjetës të plotfuqishëm. Ai e di se mund t;ia dalë mbanë, vetëm në qoftë se i largohen mendjet njerëzore nga Jezusi dhe e vërteta e Tij.

Ata që do të përfitonin nga të mirat e ndërmjetësimit të Shpëtimtarit, nuk do të lejonin asgjë që t'i pengonte për t'i hyrë rrugës së shenjtërimit të ndihmuar nga respekti ndaj Perëndisë. Orët e çmuara, në vend që të shkonin dëm në kënaqësira boshe, në fitime pa fun dhe në lëvdata të pabazuara, do t'i përkushtohehsin studimit të ethshëm të fjalës së të vërtetës. Njerëzit e Zotit do t'i kuptonin qartë si temën e shenjtores, ashtu edhe gjykimin zbulues. Çdo njeri duhet ta dijë qëndrimin që mban dhe punën që kryen Kryeprifti ynë, përndryshe do të jetë e pamundur për të që ta vënë në jetë gjënë më themelore të kohës, besimin, dhe ta kryjë atë detyrë që i ka besuar Perëndia. Çdo individ, ndikon pozitivisht apo negativisht në shpëtimin e të paktën njëri tjetri. Secili prej nesh përbën një rast, që pret zgjidhje nga gjyqi i Perëndisë. Çdo njeri duhet ta takojë Gjykatësin e madh ballë për ballë. Sa e rëndësishme është që çdo njeri ta përfytyrojë dhe të mendojë shpesh për atë skenë solemne, kur me fillimin e gjykimit lobrat do të hapen, dhe kur çdo njeri, në fund të kohës, duhet të qëndrojë si Danieli, mbi këmbët e veta.

Të gjithë ata që i kanë kuptuar këto tema të rëndësishme, duet t'ju dëshmojnë të tjerëve për të vërtetat e mëdha që u ka besuar Perëndia. Shenjtorja qiellore ësthë pika kulmore e punës së Krishtit në emër të njerëzimit. Ajo ka të bëjë me çdo njeri që jeton mbi këtë tokë. Ajo shpalos përpara syve tanë planin eshpëtimit, duke na treguar për fundin e kohës dhe duke na zbuluar problemin e luftës triumfuese midis drejtësisë dhe mëkatit. Është më se e rëndësishme që të gjithë njerëzit t'i shqyrtojnë me vëmendje këto subjekte dhe të jenë në gjendje që t'i përgjigjen kujtdo, që mund t'u kërkojë arsyen e shpresës që digjet në zemrat e tyre.

Ndërmjetësimi i Krishtit në emër të njerëzve në shenjtoren qiellore, është në lidhje me planin e shpëtimit, po themelor siç ishte vdekja e Tij mbi kryq. Ai filloi, me anë të vdekjes së Tij, atë punë për të cilën menjëherë pas ringjalljes, u ngjit në qiell. Nëpërmjet besiit, ne duhet të hyjmë brenda velit "ku ka hyrë Krishtisi pararendës për ne." - Hebrenjtë 6:20. Pikërisht atje reflektohet drita që vjen nga kryqi i Kalvarit. Vetëm atje, mund t'i shikojmë më në brendësi misteret e shpëtimit. Shpëtimi i njerëzve i ka kushtuar tmerrësisht shtrenjtë qiellit; flijimi i ofruar i përgjigjet kërkesave të ligjit të thyer të Perëndisë. Jezusi ka hapur rrugën për te froni i Atit dhe përmes ndërmjetësimit të Tij, mund të shrehet përpara Perëndisë dëshirat e sinqerta të të gjithë atyre që i drejtohen Atij me besim.

"Kush i fsheh shkeljet e tij nuk do të tetë mbarësi; por ai që i rrëfen dhe i braktis ato, ka për të fituar mëshirë." - Fjalët e Urta 28:13. Sikur ata që i fshehin dhe shfajësohen për mëkatet e tyre të mund të shihnin sesi gëzohet Satani nga kjo, se si tallet ai me Krishtin dhe engjëjte shenjtë nga kjo, ata do të nxitonin që t'i rrëfenin këto mëkate dhe t'i lanin duart prej tyre. Satani përpiqet që ta kontrollojë mendjen njerëzore duke përfituar nga të metat në karakterin e njeriut dhe ai e di shumë mirë, se do t'ia dalë mbanë vetm në qoftë se këto të meta do të vazhdojnë të mbahen të meta. Prandaj ai orvatet vazhdimisht që t'i mashtrojë pasuesit e Krishtit duke përdorur filozofinë e tij shkatërrimtare, sipas të cilës, këta të fundit e kanë të pamundur që të dalin fitimtarë. Por Jezusi lutet në emër të tyre duke ofruar duart e Tij të plagosura, trupin eTij të mavijosur; dhe Ai, u thotë të gjithë atyre që duan t'i shkojnë pas: "Hiri im ju mjaton." - Letra e Dytë e Korintasve 12:3. "Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përulur nga lemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë!" - Mateu 11:23, 30. Pra askush të mos i konsiderojë të metat e veta si të pakurueshme. Perëndia na jep hir dhe besim të mjaftueshëm për të fituar ndaj tyre.

Tani, ne po jetojmë në ditën e madhe të shlyerje. Gjatë shërbesës imituese (tokësore), ndërsa kryeprifti shlyente mëkatet e tyre dhe të përuleshin përpara Zoti përndryshe përpara Zotit përndryshe, do të përjashtoheshin nga populli i zjgedhur. Në të njëjtën mënyrë, të gjithë ata që duan t'i ruajnë të shkruarë emrat e tyre në librin e jetës duhet që në këto ditë të pakta prove që ju kanë mbetur, të shrehin keqardhje për mëkatet dhe një pendesëtë vërtetë përpara Perëndisë. Ata duhet ta shqyrtojnë me kujdes besimin kaq shumë të ashtuquajtur "të Krishterë". Të gjihtë ata që duan t'i nënshtrojnë përpjekjet e së keqes për të fituar epërsi, duhet të përgatiten për një luftë të ashpër. Përgatitja është një akt individual. Ne nuk dhpëtohemi në grype. Pastërtia dhe përkushtimi i njeriut nuk do të kompensojnë mungesën e këtyre viteve tek tjetri. Megjithëse do të gjykohen të gjitha kombet, Perëndia do ta shqyrtojë rastin e çdo individi me një kujdes qa të madh sikur ai të ishte i vetmi njeri mbi

faqen e tokës. Çdo njeri duhet të gjykohet dhe duhet të rezultojëpa asnjë njollë. pa asnjë rrudhë dhe pa asgjë tjetër të keqe.

Solemne janë skenat që lidhen me aktin përfundimtar të punes shlyerse. Atje përfshihen interesa nga më të rëndësishmet. Gjykimi ka filluar tashmë në shenjtoren qiellore. Kjo punë ka ecur përpara për vite me rradhë. Shpejt - ashkush nuk e di se sa shpejt - do të gjykohen të gjallët. Në praninë e madhërishme të Perëndisë do të shpalosen jetët tona. Çdo njeri duhet t'i verë veshin, pikerisht në këtë kohë, më shumë se kurrë, paralajmërimit të Shpëtimtarit: "Rrini zgjuar dhe lutuni, sepse nuk e dini kur do të jetë ai moment." - Marku 13:33. "Po të mos rrishë zgjuar, unë do të vij tek ti si vjedhës, dhe nuk do të dish ç'orë do të vijë te ti." - Zbulesa 3:3.

Me t'iu dhënë fund gjykimit zbulues, do të vendoset fati i çdo njeriut; jetë apo vdekje. Koha e provës përfundon pak përpara ardhjes së Zotit në retë e qiellit, Në librin e Zbulesës, Krishti duke folur për atë kohë, deklaron: "Kush është i padrejtë, le të vazhdojë t ëjetë i padretë, kush është i ndyrë le të vazhdojë të jetë i ndyrë, kush është i drejtë le të vazhdojë të praktikojë drejtësinë, dhe kush është i shenjtë le të vazhdojë të shenjtërohet. Dhe ja, unë vij shpejt, dhe shpërblimi im është me mua, për t'i dhënë gjithësecilit sipas veprave që ai ka bërë." - Zbulesa 22:11, 12.

Të drejtët dhe të pandershmit do të vazhdojnë të jetojnë gjendjen tyre mortale - nnjerëzit do të mbjellin dhe do të ndërtojnë, do të hanë dhe do të pinë, pa e ditur që në shenjtoren qiellore tashmë është marrë ai; vendimi i pandryshueshëm dhe përfunditar. Përpara Përmbytjes, me të hyrë Noa në varkë, Perëndia e mbylli atë brenda duke i lënë njerëzit e ligj jashtë; por për shtatë ditë me rradhë, këta njerëz, pa e ditur se fati i tyre ishtecaktuar, vazhduan të jetonin të shkujdesur e të kënaqur dhe të talleshin me paralajmërimet e një gjykimi të afërt. "Kështu do të ndodhë, - thotë Shpëtimtari, - edhe në ardhjen e Birit të njeriut." - Mateu 24:33. Ora vendimtare që do të shenojë caktimin e fatit të çdo njeriu dhe tërheqjen përfundimtare të ofertës për mëshirë drejtuar të gjithë mëkatarëve, do të vijë pa bujë dhe në heshtje, si haduti në mesnatë.

"Rrini zgjuar pra, ... që Ai të mos ju gjejë në gjumë." - Marku 13:35, 36. Të gjithë ata, që të lodhur nga pritja, do t'ju kthehen kënaqësive të kësaj bote, do ta gjejnë veten në një gjendje të rrezikshme. Ndërsa biznesmeni është i dhënë pas fitimit, ndërsa kënaqësi - dashësi po kërkon "horizonte të reja", ndërsa adhuruesja e modës po rregullon veshjet e sapoblera -pikërisht në atë moment, Gjukatësi i tokës mund të japë dënimin: "Ti peshove në peshore dhe u vu re se të mungonte diçka." - Danieli 5:27.

1. Cilët janë të parët që ekzaminohen në gjykimin investigative? Shih 1 Pjetrit 4:17.

2. Lexoni Psalin 56:8 dhe Zbulesën 20:12. Qielli mban shënim të plotë për çdo ngjarje të jetës së njerëzve.
Si mendoni përse Perëndia mban shënim të gjitha detajet e jetës njerëzore në librat e Tij?

3.Cila është ajo gjë që ne "duhet" të bëjmë gjatë kohës së gjykimit investigative?

29.

Origjina e së Keqes

Për shumë njerëz, origjina e mëkatit dhe arsyeja e ekzistencës së tij janë burime hutimi. Ata janë dëshmitarë të punës së mëkatit dhe fryteve të tij të tmerrshme - izolimit dhe mjerimit - dhe pyesin veten se si mund të ekzistojnë të gjitha këto, nën sovranitetin e Atij, që është i pafund në dashuri, mençuri dhe fuqi. Çoroditja dhe dyshimi ua mbyllin sytë atyre përpara të vërtetave të fjalës së Perëndisë; të vërtetave që janë shumë të rëndësishme për shpëtimin e tyre. Disa prej tyre, për t'u dhënë përgjigje pyetjeve që kanë të bëjnë me ekzistencën e mëkatit, përpiqen të depërtojnë në gjëra të pazbuluara nga Perëndia; rrjedhimisht, nuk gjejnë zgjidhje për problemet e tyre dhe, duke qënë se janë të prirur ndaj dyshimit, hedhin poshtë fjalët e Shkrimeve të Shenjta, duke e përdorur dyshimin si shfajësim. Sidoqoftë, të tjerët nuk arrijnë ta kuptojnë siç duhet këtë problem, sepse keqinterpretimi dhe traditat i kanë shtrembëruar mësimet e Biblës, që lidhen me karakterin e Perëndisë, me natyrën e qeverisjes së Tij dhe me parimet e veprimtarisë së Tij ndaj mëkatit.

Është e pamundur që ta shpjegosh origjinën e mëkatit dhe të parashtrosh arsyet e ekzistencës së tij. Megjithatë, me aq sa kuptojmë mbi origjinën dhe fundin që e pret mëkatin, ne mund të arrijmë në konstatimin se Perëndia është treguar i drejtë dhe mirëdashës edhe gjatë veprimtarisë së Tij kundër kësaj të keqeje të madhe. Në Bibël theksohet më shumë se çdo gjë tjetër fakti që Perëndia nuk ishte aspak përgjegjës për lindjen e mëkatit; dhe as tërheqja arbitrare e hirit hyjnor dhe as ndonjë e metë në qeverisjen qiellore nuk u bënë shkak për fillimin e një rebelimi të tillë. Mëkati është si ai mishi i huaj, prania e të cilit nuk mund të shpjegohet. Është misterioz, i pashpjegueshëm. Ta shfajësosh do të thotë ta mbrosh. Sikur të gjendej një shfajësim për të, apo të jepej qoftë edhe një arsye e vetme për ekzistencën e tij, ai nuk do të quhej më mëkat. **Ne mund të japim vetëm përkufizimin që gjendet tek fjala e Perëndisë; është "shkelja e ligjit"; është rrjedhimi i një parimi që kundërshton ligjin e madh të dashurisë; ligj, që përbën edhe themelin e qeverisjes hyjnore.**

Përpara shfaqjes së mëkatit, në univers mbizotëronte gëzimi dhe paqja. Gjithçka përputhej plotësisht me vullnetin e Krijuesit. Dashuria për Perëndinë ishte supreme, dashuria për të tjerët e paanshme. Krishti, Fjala, I Vetmi Bir i Perëndisë, ishte një me Atin e pavdekshëm - në natyrë, në karakter dhe në qëllim - ishte e vetmja qënie në të gjithë universin, që mund të merrte pjesë në të gjitha këshillat dhe mund t'i njihte të gjitha qëllimet e Perëndisë. Ati punoi përmes Krishtit, për të krijuar të gjitha qëniet qiellore. "Përmes Tij u krijuan të gjitha gjërat që janë në qiej ... frone, zotërime, principata dhe pushtete" (Kolosianët 1:16), dhe këto qënie qiellore e shprehnin besnikërinë e tyre jo vetëm ndaj Atit, por edhe ndaj Krishtit.

Ligji i dashurisë, duke qënë themeli i qeverisjes së Perëndisë dhe lumturia e të gjitha qënieve - krijesa, mbështetej tek harmonia e tyre e përsosur me parimet e madhërishme të drejtësisë. Perëndia dëshiron që të gjitha krijesat t'i shërbejnë me dashuri - Ai dëshiron që respekti të lindë nga vlerësimi i zgjuar që duhet t'i bëhet karakterit të Tij. Atij nuk i pëlqen besnikëria e detyruar dhe u ka dhuruar të gjithëve, vullnet të lirë, në mënyrë që ata t'i shërbejnë me dëshirë dhe vullnetarisht.

Por dikush vendosi që ta shpërdorojë këtë liri. Mëkati i ka rrënjët tek ai që, pas Krishtit nderohej më shumë nga Perëndia dhe që kishte më shumë lavdi dhe pushtet mes banorëve të qiellit. Luciferi, përpara rënies së tij, ishte kryeëngjëll, i shenjtë dhe i pakorruptuar. "Kështu thotë Zoti: "Ti ishe vula e përsosmërisë, tërë dituri dhe i përsosur nga bukuria. Ishe në Eden, në kopshtin e Perëndisë ishe mbuluar me lloj-lloj gurësh të çmuar ... Ti ishe një kerubin i vajosur, një mbrojtës. Unë të kisha vënë në malin e shenjtë të Perëndisë dhe ti ecje në mes gurësh zjarri. Ti ishe i përsosur në rrugët e tua, qysh nga dita që u krijove, deri sa nuk u zbulua tek ty çoroditja." (Ezekieli 28:12-15).

Luciferi mund ta kishte ruajtur dashamirësinë e Perëndisë, mund ta kishte ruajtur dashurinë dhe nderimin që tregonin engjëjt ndaj tij, duke i përdorur fuqitë e tij për të bekuar të tjerët dhe për t'i thurur lavde Krijuesit të tij. Por profeti thotë: "Zemra jote ishte ngritur prej bukurisë sate; ke korruptuar diturinë tënde për shkak të shkëlqimit tënd." (versa 17). Pak nga pak, Luciferit i lindi në zemër vetë - lavdërimi. "E ke bërë zemrën tënde si zemrën e Perëndisë." Ti thoje ... do të ngre ... do të ngjitem mbi pjesët më të larta të reve, do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin." (Versa 6, Isaia 14:13,14). Në vend që të përpiqej që Zoti të zinte vendin kryesor, përsa i përket dashurisë dhe besnikërisë së krijesave të Tij, dëshira më e madhe e Luciferit ishte që të fitonte për vete shërbimin dhe nderimin e tyre. Duke lakmuar nderin që Ati i kishte dhënë Birit, princi i engjëjve ëndërronte që të shtinte në dorë pushtetin, që i takonte vetëm Krishtit.

Qëniet qiellore ishin të lumtura që të reflektonin lavdinë e Krijuesit dhe të lavdëronin emrin e Tij. Nderimi i Perëndisë përmbante në vetvete paqe dhe gëzim. Por harmonia qiellore u prish nga një notë mosmarrëveshjeje. Vetëlavdërimi dhe vetëshërbimi, që kundërshtojnë planin e Krijuesit, hodhën hijet e para të mëkatit

në mendjet e atyre që e donin Zotin mbi gjithçka tjetër. Këshillat qiellore iu lutën Luciferit. Biri i Perëndisë i parashtroi atij madhështinë, mirësinë, drejtësinë e Krijuesit si dhe natyrën e shenjtë dhe të pandryshueshme të ligjit të Tij. Ishte Perëndia Vetë Ai, që kishte vendosur rregull në qiell; duke e prishur këtë rregull, Luciferi do të çnderonte figurën e Krijuesit dhe do të rrënohej personalisht. Por paralajmërimi që iu bë me dashuri dhe mëshirë, zgjoi vetëm qëndresë. Xhelozia e Luciferit ndaj Krishtit u thellua më shumë dhe ai u bë akoma edhe më i vendosur.

Krenaria, që lindi nga lavdia e tij, i hapi rrugën dëshirës për pushtet. Luciferi nuk i çmonte nderet që i bëheshin si dhurata nga Perëndia dhe nuk ishte mirënjohës ndaj Krijuesit për to. Ai mburrej me shkëlqimin dhe lavdinë e vet dhe dëshironte të ishte i barabartë me Perëndinë. Engjëjt qiellorë e donin dhe e nderonin Luciferin. Ata ishin të gatshëm që t'i zbatonin urdhëresat e tij, sepse ai ishte veshur me lavdi dhe mençuri shumë më të madhe se ato. Megjithatë, Biri i Perëndisë njihej si Sovrani i qiellit, një në fuqi dhe autoritet me Atin. Krishti bënte pjesë në të gjitha këshillat e Perëndisë, ndërsa Luciferit nuk i lejohej që t'i njihte qëllimet hyjnore. "Pse, pyeste ky engjëll i fuqishëm, - duhet ta ketë Krishti në dorë pushtetin? Pse të nderohet Ai më shumë se Luciferi?"

Kështu, duke iu shmangur kontaktit të drejtpërdrejtë me Perëndinë, ai filloi punën për të mbjellë në zemrat e engjëjve farën e pakënaqësisë. Për një farë kohe, ai e fshehu qëllimin e tij të vërtetë nën maskën e respektit ndaj Perëndisë dhe u përpoq që të nxiste pakënaqësi ndaj ligjeve që drejtonin jetën e qënieve qiellore, duke theksuar se ato vinin kufizime të panevojshme. Ai i nxiti engjëjt që t'u bindeshin "dekreteve" të ndergjegjeve të tyre, duke qënë se ata ishin nga natyra të shenjtë. U përpoq që të fitonte simpatinë e tyre, duke deklaruar se Perëndia, duke e nderuar Krishtin shumë më tepër, ishte treguar i padrejtë ndaj tij. Deklaronte se edhe pse donte më shumë pushtet dhe lavdi, ai nuk po kalonte në vetëlartësim, por po kërkonte një liri më të plotë për të gjithë banorët e qiellit, në mënyrë që ekzistenca e tyre të bëhej "më e lumtur".

Perëndia i Plotmëshirshëm e duroi Luciferin për një kohë të gjatë. Atij nuk iu mohuan të drejtat, që gëzonte dhe pozita e nderuar në të cilën ndodhej, as kur filloi të ushqente frymën e pakënaqësisë dhe madje, as kur filloi të parashtronte përpara engjëjve qiellorë pretendimet e tij të rreme. Ai vazhdoi të jetonte në qiell për një kohë të gjatë. Perëndia ishte gati ta falë me kusht që ai të pendohej e t'i bindej. U bë gjithçka që mund të bëhej me anë të veprimit të dashurisë dhe mençurisë së pafund për ta bindur se po gabonte. Qielli s'e kishte njohur kurrë më parë frymën e pakënaqësisë. Fillimisht, as Luciferi vetë nuk e kuptoi natyrën e vërtetë të ndjenjave të veta dhe fundin që e priste nga kjo. Por me t'u provuar se pakënaqësia e tij ishte pa bazë, Satani duhej të bindej se po vepronte gabim, se qëllimet hyjnore ishin të drejta dhe duhej t'i provonte ato si të tilla përpara gjithë banorëve qiellorë. Sikur ta

kishte bërë këtë, ai do të kishte shpëtuar vetveten dhe shumë engjëj të tjerë. Gjatë asaj kohe ai s'kishte hequr dorë plotësisht nga besnikëria ndaj Perëndisë. Edhe pse e kishte harruar pozitën e tij si kryeengjëll, po të donte të rikthehej tek Perëndia, duke e pranuar mençurinë e Krijuesit dhe duke qënë i gatshëm për të përmbushur detyrën e tij në planin e Zotit, do të kishte rifituar përsëri postin e humbur. Por krenaria nuk e la që të përulej. Ai vazhdoi t'i mbronte me këmbëngulje idetë e veta, duke menduar se s'kishte asnjë arsye që të pendohej dhe u përkushtua në luftën kundër Krijuesit të tij.

Mendja e tij e mprehtë tani thurte plane mashtruese për të fituar simpatinë e engjëjve, që vareshin prej tij. Ai përdori edhe faktin që Krishti e kishte paralajmëruar dhe këshilluar, në dobi të qëllimeve të tij prej tradhëtari. Satani u kishte thënë të gjithë atyre që ishin më të afërt me të, se e kishin gjykuar gabim, se nuk e kishin respektuar pozitën e tij dhe shpejt, do t'ia hiqnin edhe lirinë. Në mënyrë që ta poshtëronte Birin e Perëndisë përpara banorëve të qiellit, duke e akuzuar për gjëra të paqëna, ai kaloi nga keqinterpretimi i fjalëve të Krishtit, tek mashtrimi dhe gënjeshtrat e mirëfillta. Ai u orvat gjithashtu që të krijonte një pseudo - grindje mes engjëjve qiellorë, duke i akuzuar për moskokëçarje ndaj interesave të qënieve, të gjithë ata, që nuk i korruptonte dot apo që nuk i bënte dot aleatë të tij. Ai ia ngarkoi përgjegjësinë e punës së tij gjithë atyre që i qëndruan besnikë Perëndisë. Në mënyrë që të mbështeste akuzën e tij boshe për padrejtësi nga ana e Perëndisë karshi tij, ai shtrembëroi fjalët dhe veprat e Krijuesit. Argumentet mashtruese që nxori ai kundër qëllimeve mirëdashëse të Perëndisë, bënin pjesë në planin e tij për t'i çoroditur engjëjt. Ai e ktheu gjithçka të thjeshtë në mister dhe i shtrembëroi aq shumë thëniet e qarta të Jehovait sa që ato dukeshin të dyshimta. Thëniet e tij u bënë më të besueshme nga pozita e tij e lartë, nga lidhja e ngushtë që kishte me administratën hyjnore dhe shumë u tunduan që të bashkoheshin me të, në luftën kundër autoritetit qiellor.

Perëndia, duke vepruar me mençuri, e la Satanin që ta vazhdonte punën e nisur derisa fryma e urrejtjes u poq dhe u kthye në një revoltë aktive. Në mënyrë që të gjithë ta shihnin natyrën dhe tendencën e planeve të tij, ato duhet të shtjelloheshin mirë. Luciferi, duke qënë një kerubin i shuguruar, ishte lartësuar mjaft, qëniet qiellore e donin shumë dhe ai ushtronte një ndikim të madh mbi to.

Nën qeverisjen e Perëndisë nuk ishin vetëm banorët e qiellit, por edhe banorët e botëve të tjera, krijuar prej Tij; kështu, Satani mendoi se duke tërhequr në revoltë engjëjt qiellorë, do ta kishte më të lehtë që të tërhiqte pas vetes edhe banorët e botëve të tjera. Ai e parashikoi me "art" çështjen që e shqetësonte, duke përdorur mashtrime dhe gënjeshtra në mbështetje të synimeve të veta. Fuqitë e tij mashtruese ishin shumë të mëdha dhe ai fitoi epërsi, duke u maskuar nën një petk gënjeshtar. Madje as engjëjt qiellorë nuk mundën ta shquanin karakterin e tij të vërtetë dhe s'mund ta parashikonin fundin e një pune të tillë.

Satani ishte nderuar kaq shumë dhe veprimet e tij ishin veshur me një mister kaq të madh, saqë engjëjt e kishin të vështirë që të zbulonin natyrën e vërtetë të punës së tij. Mëkati nuk do të dukej kurrë një gjë e fëlliqur, në qoftë se nuk do të zhvillohej plotësisht. Deri tani, universi i Perëndisë kishte qënë i huaj për të dhe qëniet e shenjta nuk kishin as idenë më të vogël të natyrës dhe ligësisë së tij.

Ata nuk mund t'i parashikonin rezultatet e tmerrshme që do të sillte mohimi i ligjit hyjnor. Fillimisht Satani e kishte fshehur qëllimin e vet pas një shprehjeje të ethshme besnikërie ndaj Perëndisë. Ai deklaronte se po përpiqej të forconte qëndrueshmërinë e qeverisjes së Perëndisë, të lartësonte emrin e Tij dhe të mbronte interesat e banorëve të qiellit. Ndërsa nga njëra anë u nxiste engjëjve në mendje idenë e pakënaqësisë, nga ana tjetër pretendonte se "përpiqej" me mish e me shpirt që "ta largonte" këtë pakënaqësi prej tyre. Nën preteksin se për ruajtjen e harmonisë qiellore nevojiteshin ndryshime, ai i nxiti të tjerët që të transformonin rregullin dhe ligjet, që i respektonte vetë Perëndia gjatë qeverisjes së Tij.

Zoti u tregua i drejtë dhe i qëndrueshëm gjatë veprimtarisë që zhvilloi kundër mëkatit. Satani mund të përdorte ato që Perëndia s'mund t'i përdorte kurrë - lajkat dhe mashtrimet. Ai ishte përpjekur që ta fallsifikonte përpara engjëjve fjalën e Perëndisë dhe ta keqinterpretonte planin e Tij të qeverisjes, duke pretenduar se Zoti nuk tregohej i drejtë kur u shpallte banorëve qiellorë rregulla dhe ligje; dhe se Ai kërkonte bindjen dhe përuljen e krijesave të Veta, vetëm për t'u lartësuar përpara tyre. Prandaj Perëndisë i duhej që t'u demonstronte banorëve të qiellit, ashtu edhe atyre të botëve të tjera, se qeverisja e Tij ishte më se e drejtë dhe se ligji i Tij ishte më se i saktë. Satani i kishte bërë të tjerët të mendonin se ishte ai, që mbronte të mirën universale. Të gjithë duhej ta kuptonin karakterin dhe qëllimin e vërtetë të tradhëtarit. Me kalimin e kohës, karakteri i tij i vërtetë do të zbulohej përmes veprave të tij të djallëzuara.

Ai ia ngarkoi ligjit dhe qeverisjes së Perëndisë përgjegjësinë për mosmarrëveshjet, që kishte shkaktuar puna e vet dhe deklaroi se e keqja ishte fryt i administrimit hyjnor dhe se qëllimi i tij i vetëm ishte përmirësimi i ligjeve të vëna nga Jehovai. Prandaj ishte e nevojshme që ai vetë, ta paraqiste hapur natyrën e pretendimeve të tij dhe të shpaloste rrjedhimet që do të sillte ndryshimi i ligjit hyjnor. Puna e tij do të përbënte dhe dënimin e tij. Fillimisht Satani kishte deklaruar që nuk po ngrinte krye kundër Perëndisë. Mbarë universi duhet ta shikonte mashtruesin pa maskë.

Mençuria pa fund nuk e shkatërroi Satanin, madje as atëherë kur u vendos që ai të mos qëndronte më në qiell. Duke qënë se Perëndia pranon vetëm shërbim dashurie nga krijesat e Veta, besnikëria duhet të bazohet tek bindja e tyre për drejtësinë dhe dashamirësinë e Tij. Banorët e qiellit dhe të botëve të tjera, duke qënë të papërgatitur për të kuptuar natyrën e rrjedhimeve që mbart në vetvete mëkati, nuk do të mund të shquanin në atë kohë, drejtësinë dhe mëshirën e Perëndisë në shkatërrimin

e Satanit. Sikur ai të ishte eliminuar menjëherë, të tjerët do t'i shërbenin Zotit nga frika dhe jo nga dashuria. As ndikimi i mashtruesit dhe as fryma e rebelimit nuk do të ishin shkatërruar apo fshirë plotësisht. Mëkati - e keqja - duhet lejuar që të maturohet. Për të mirën e të gjithë universit, në mënyrë që të gjitha krijesat të qartësohen përsa u përket padive të tij absurde kundër qeverisjes hyjnore dhe të mos dyshojnë kurrë për drejtësinë dhe mëshirën e Perëndisë dhe për pandryshueshmërinë e ligjit të Tij, Satani, përmes shekujve, u lejua "të përsosi" parimet e veta.

Për shekuj me radhë, rebelimi i Satanit duhet të ishte mësim për të gjithë banorët e universit, një dëshmi e përhershme e natyrës dhe rezultateve të tmerrshme të mëkatit. Zbatimi i rregullave të Satanit, ndikimi i tyre si mbi njerëzit dhe mbi engjëjt, do të tregonin frutet e mohimit të autoritetit hyjnor. Ata dëshmojnë se mirëqenia e të gjitha krijesave është e lidhur ngushtë me ekzistencën e qeverisjes dhe ligjit të Perëndisë. Kështu, historia e këtij eksperimenti të tmerrshëm rebelimi do të shërbente si masë mbrojtjeje për të gjitha krijesat e zgjuara; masë, që do t'i mbronte ata, që të mos mashtroheshin nga natyra e shkeljeve të ligjit dhe t'i shpëtonte nga mëkati dhe dënimi që sjell ai.

Tradhëtari dinak vazhdoi të shfajësohej deri në fund të kontradiktës qiellore. Me t'u shpallur vendimi që ai së bashku me simpatizantët e tij duhet të dëboheshin nga vendburimi i lumturisë, udhëheqësi rebel e shprehu haptazi dhe me vendosmëri përçmimin që ndjente për ligjin e Perëndisë. Ai përsëriti idenë e vet, që engjëjt nuk kishin nevojë që të kontrolloheshin dhe duhet të ndiqnin vullnetin e tyre të lirë, që do t'i udhëhiqte gjithmonë në rrugën e drejtë. Ai e quajti ligjin hyjnor kufizim të lirisë së tyre dhe deklaroi se fundi i ligjit ishte dhe qëllimi i tij kryesor; në mënyrë që, duke qënë të çliruar nga ky kufizim, engjëjt qiellorë të kishin një ekzistencë më të lavdishme dhe më të lumtur.

Me një zë, Satani dhe përkrahësit e tij fajësuan Krishtin për rebelimin e tyre, duke deklaruar se po të mos i kishin qortuar, ata nuk do të kishin ngritur krye. Kështu, kokëfortë dhe moskokëçarës në pabesinë e tyre, duke u përpjekur më kot nga njëra anë ta rrëzonin pushtetin e Perëndisë dhe, duke pretenduar nga ana tjetër, se ishin viktima të pafajshme të një qeverisjeje shtypëse, kryerebeli dhe përkrahësit e tij u dëbuan nga qielli.

E njëjta frymë që nxiti rebelimin në qiell, vazhdon të frymëzojë rebelimin në tokë. Satani vazhdon me njerëzit, të njëjtën politikë që ndoqi dikur me engjëjt. Fryma e tij mbretëron në zemrat e të pabindurve. Si ai, ata përpiqen që t'i flakin tej kufizimet e ligjit të Perëndisë dhe u premtojnë njerëzve liri, përmes mosrespektimit të urdhëresave të tij. Ende, lind fryma e urrejtjes dhe rezistencës sa herë që qortohen njerëzit mëkatarë. Kur ndërgjegjet njerëzore zgjohen falë mesazheve paralajmëruese të Perëndisë, Satani i përgatit njerëzit që të shfajësohen dhe të kërkojnë mbështetjen dhe simpatinë e të tjerëve gjatë rrugës së tyre mëkatare. Në vend që të ndreqin gabi-

met e tyre, ata vënë në qendër të shenjestrës personin që i qorton, sikur ai të ishte i vetmi problem për ta. Që nga koha e Abelit e deri në ditët tona, ndaj atyre që guxojnë të ngrenë zërin kundër mëkatit, është manifestuar e njëjta frymë kundërshtimi.

Satani i shtyn njerëzit drejt mëkatit, duke e shtrembëruar karakterin e Perëndisë dhe duke e paraqitur Atë si të ashpër dhe tiran; gjë që e praktikoi edhe në qiell. Ai deklaron, duke qënë se ia ka dalë mbanë deri tani, se janë kufizimet e padrejta të Perëndisë, që kanë çuar në rrënimin e njerëzve ashtu si çuan dikur, në rebelimin e tij.

Por Vetë i përjetshmi e përshkruan kështu karakterin e Tij: "Zoti, Perëndia i përjetshëm, i mëshirshëm dhe i dhembshur, i ngadalshëm për zemërim, i pasur në mirësi dhe në besnikëri, që përdor mëshirën për mijëra njerëz, që fal padrejtësinë, shkeljet dhe mëkatin, por nuk e lë të pandëshkuar fajtorin." (Eksodi 34:6,7).

Duke përzënë Satanin nga qielli, Perëndia shpalli drejtësinë dhe ruajti nderin e fronit të Vet. Por kur njerëzit mëkatonin, duke iu dorëzuar mashtrimeve të shpirtit të shkatërrimit, Perëndia dha një provë dashurie, duke dorëzuar Birin e Tij të Vetëm që të vdiste për racën mëkatare. Kjo shlyerje zbuloi karakterin e vërtetë të Perëndisë. Argumenti i mahnitshëm që sjell kryqi, provon përpara gjithë universit, se rruga e mëkatit ishte një zgjedhje e Luciferit, për të cilën s'mund të fajësohet aspak, qeverisja e Zotit.

Karakteri i mashtruesit të sprovuar u zbulua qartë gjatë kontradiktës mes Krishtit dhe Satanit në vitet e shërbimit tokësor të Shpëtimtarit. Lufta mizore e Satanit kundër Çliruesit të kësaj bote, më shumë se gjithçka tjetër, ndikoi në shuarjen përfundimtare të çdo ndjenje dashurie që mund të ushqenin akoma për të engjëjt dhe banorët e tjerë të universit. Kërkesa e tij e marrë që Krishti ta nderonte e t'i përulej, guximi i tij prej mendjemadhi, kur e çoi në majën e malit dhe në pikën më të lartë të tempullit, synimi keqdashës kur e nxiste të hidhej nga ajo lartësi marramendëse, ndjenja që e linte pa gjumë dhe e çonte nga një vend tek tjetri për t'i mbushur zemrat e priftërinjve dhe të njerëzve të thjeshtë me urrejtje për Të dhe së fundi thirrja "Të Kryqëzohet! Të kryqëzohet!" - të gjitha këto ngjallën çudinë dhe indinjatën e të gjithë banorëve të universit.

Ishte Satani ai, që nxiste mohimin ndaj Jezusit. Princi i errësirës përdori të gjithë pushtetin dhe dinakërinë e vet për ta shkatërruar Krishtin; sepse ai e kuptoi se mëshira dhe dashuria e Shpëtimtarit, dhembshuria dhe dashamirësia prekëse e Tij, do t'i zbulonin botës karakterin e vërtetë të Perëndisë**.** Satani kundërshtoi çdo thënie të Birit të Perëndisë dhe përdori njerëz - agjentë të tij për t'ia "pasuruar" jetën Shpëtimtarit me vuajtje dhe trishtim. Gënjeshtrat, me anë të të cilave u orvat që të pengonte punën e Jezusit, urrejtjes, që u shpreh përmes njerëzve të pabindur, akuzat mizore ndaj Atij, jeta e të cilit ishte shembull përsosmërie; të gjitha këto frymëzoheshin nga një ndjenjë e vjetër hakmarrjeje. Kjo ndjenjë mori jetë në Kalvar, për të

djegur e bërë shkrumb e hi Birin e Perëndisë, ndërkohë që qëniet qiellore shikonin të heshtura e me tmerr skenën e kryqëzimit.

Me t'i dhënë fund këtij flijimi, Krishti u ngjit në qiell dhe, duke mos e pranuar adhurimin e engjëjve, i parashtroi Atit këtë kërkesë. "O Atë, unë dua që atje ku jam unë, të jenë me mua edhe ata që më ke dhënë." (Gjoni 17:24). Në atë çast, nga froni i Perëndisë - Atë, me fuqi dhe me dashuri të papërshkrueshme, u dëgjua përgjigja: "Le ta adhurojnë të gjithë engjëjt e Perëndisë." (Hebrenjtë 1:6). Jezusi s'kishte as edhe një njollë të vetme. I kishte ardhur fundi poshtërimit të Tij, sakrifica ishte kryer dhe Ai fitoi një emër, që lartësohet mbi çdo tjetër.

Tashmë faji i Satanit s'mund të shfajësohej më. Ai kishte zbuluar karakterin e tij të vërtetë prej gënjeshtari dhe vrasësi. Ishte më se i qartë fakti se ai do t'i kishte kontrolluar banorët e qiellit, po të kishte pasur mundësi, me të njëjtën frymë që përdorte për të ruajtur sundimin e tij mbi bijtë e njeriut. Ai kishte pohuar se mosrespektimi i ligjit të Perëndisë do të sillte liri dhe lavdi; por u vu re se degradimi dhe skllavëria ishin të vetmet rezultate, që rridhnin prej tij.

U doli boja edhe padive të rreme që Satani kishte përdorur kundër qeverisjes dhe karakterit hyjnor. Ai e kishte akuzuar Perëndinë se, duke kërkuar nga krijesat e veta përulje dhe bindje, në fakt, kërkonte thjesht vetëlartësim e ndërsa "u predikonte" të tjerëve mbi vetmohimin, Ai vetë s'ishte sakrifikuar kurrë. Por tani, të gjithë ishin dëshmitarë të faktit se Sundimtari i universit kishte bërë, për të shpëtuar një racë të padenjë dhe mëkatare,sakrificën më të madhe të dashurisë; sepse "Perëndia e ka pajtuar botën me Veten në Krishtin." (2 Korintasve 5:19). Kështu, ndërsa Luciferi i hapi rrugën mëkatit falë dëshirës së tij egoiste për lavdi e pushtet, Krishti u poshtërua dhe iu nënshtrua vdekjes për ta shkatërruar këtë mëkat.

Perëndia e shprehu hapur neverinë ndaj parimeve të rebelimit. Të gjithë banorët e panë me sytë e tyre drejtësinë e Tij, që u zbulua si tek dënimi që iu dha Satanit, ashtu edhe tek shpëtimi që iu dhurua njerëzve. Luciferi pati deklaruar se në qoftë se ligji i Perëndisë nuk mund të ndryshohej dhe, në qoftë se nuk mund të falej dënimi që mbartte ai, atëherë asnjë mëkatar (shkelës i ligjit) nuk do ta kishte kurrë të drejtën për të qëndruar në praninë e Perëndisë. Ai pretendonte se njerëzit ishin preja e tij, duke qënë se nuk mund ta shtinin kurrë në dorë dhuratën e shpëtimit. Por vdekja e Krishtit, ishte një argument pro njerëzimit, që s'mund të mohohej. Dënimi i ligjit ra mbi Atë që ishte i barabartë me Perëndinë; kështu njeriu është i lirë ta pranojë drejtësinë e Krishtit dhe të triumfit mbi fuqinë e Satanit, ashtu siç triumfoi edhe Biri i Perëndisë, përmes përuljes dhe pendimit. Pra, Perëndia që është i drejtë, i shfajëson të gjithë ata që i besojnë Jezusit.

Por Krishti nuk vuajti dhe nuk vdiq kur erdhi në tokë vetëm për të realizuar shpëtimin e njerëzve. Ai erdhi edhe "për ta lartësuar ligjin" dhe për "ta nderuar atë". Kjo ndodhi jo vetëm që banorët e tokës t'i jepnin atij ligji rëndësinë e duhur,

por edhe që banorët e botëve të tjera të universit ta kuptonin se ai ishte i pandryshueshëm. Sikur të mund të flakeshin tej parimet e tij, Biri i Perëndisë s'kishte pse ta dhuronte jetën e vet si flijim shlyerës për shkeljet që i ishin bërë këtij ligji. Vdekja e Krishtit provon qëndrueshmërinë e tij. Flijimi i dashurisë, që u sjell shpëtim mëkatarëve dhe që përfshin si Atin edhe Birin, i tregon universit mbarë atë që mund të shprehë vetëm një plan i tillë shlyerjeje, që drejtësia dhe mëshira përbëjnë themelin e ligjit dhe qeverisjes së Perëndisë.

Gjatë vënies në jetë të aktit përfundimtar të gjykimit, do të vihet re se nuk ekziston asnjë shkak për mëkatin. Kur Gjykatësi i botës do ta pyesë Satanin: "Pse je ngritur kundër meje dhe pse më ke grabitur shtetasit e mbretërisë sime?", autori i mëkatit nuk do dijë as të përgjigjet dhe as të shfajësohet. Nga goja e rebelëve s'do të dalë asnjë fjalë. Ata të gjithë do të heshtin.

Kryqi i Kalvarit, ndërsa e shpall të pandryshueshëm ligjin, pohon gjithashtu se mëkati ka pagën e vet, vdekjen. Kur Shpëtimtari shqiptoi fjalën e fundit "Mbaroi", për Satanin ra këmbana e vdekjes. Atje u mor një vendim në lidhje me kontradiktën e madhe, që kishte vazhduar për një kohë kaq të gjatë dhe u sigurua fshirja përfundimtare e së keqes nga faqja e dheut. Biri i Perëndisë kaloi përmes portave të varrit që "të shkatërronte, me anë të vdekjes, atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin." (Hebrenjtë 2:14). Dëshira për vetëlavdërim e kishte shtyrë Luciferin të thoshte: "Unë do ta ngre fronin tim përmbi yjet e Perëndisë ... do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin." Por Zoti deklaron: "Të kam katandisur në hi mbi tokë ... dhe ti nuk do të ekzistosh kurrë më." (Isaja 14:13, 14; Ezekieli 28:18, 19). "Sepse ja, dita po vjen, si një furrë; dhe të gjithë ata që veprojnë me pabesi do të jenë si kallamishtet; dita që po vjen do t'i djegë, - thotë Zoti i ushtrive, - në mënyrë të tillë që të mos u mbetet as rrënja as dega." (Malakia 4:1).

Të gjithë banorët e universit do të kthehen në dëshmitarë të natyrës dhe rezultateve të mëkatit. Kështu, eliminimi përfundimtar i tij, që në fillim do t'i kishte trembur engjëjt dhe nuk do ta kishte nderuar Perëndinë, tani, do të vërtetojë edhe një herë dashurinë e Tij dhe do të jetë provë e drejtësisë përpara një universi që kënaqen kur kryejnë vullnetin e Perëndisë dhe që e ruajnë në zemrat e tyre si thesar të çmuar ligjin e Tij. Mëkati nuk do të ekzistojë më kurrë. Fjala e Perëndisë na thotë: "Fatkeqësia nuk do të ndodhë dy herë." (Nahumi 1:9). Ligji i Perëndisë, që dikur Satani e quajti zgjedhë robërie, do të nderohet si ligj lirie. Krijesat e vëna në provë nuk do të heqin më kurrë dorë nga besnikëria ndaj Atij, karakteri i të Cilit ka dhënë prova dashurie dhe mençurie pafund.

1. Cili është përkufizimi i "mëkatit" sipas shkrimeve?

2. Përse e lejoi Perëndia Satanin që të vazhdonte rrebelimin e tij në vend që ta shfarroste atë menjëherë? Cila pasojë e mirë ka ardhur nga durimi dhe përmbajtja e Perëndisë?

3.Sipas Isaias 14, përse Luçiferi drejtoi një revolt kundra Perëndisë?

4. Jezusi e mposhti mëkatin dhe vdekjen përmes sakrificës së Tij në kryq. Si ndikon ky realitet në jetën tuaj të përditshme?

30.

Armiqësi Midis Njeriut dhe Satanit

"Unë do të shtie armiqësi midis teje dhe gruas, midis farës sate dhe farës së saj; fara e saj do të shtypë kokën tënde dhe ti do të plagosësh thembrën e farës së saj." (*Zanafilla 3:13)*. Kjo thënie hyjnore, që u shqiptua kundër Satanit, pas dështimit të njerëzimit,përbën në vetvete një profeci, që përfshin shekujt deri në fund të kohës dhe parashikon konfliktin e madh që do të jetë pjesë e jetës së të gjithë brezave njerëzorë, që do të jetojnë mbi tokë.

Perëndia deklaron: "Unë do të shtie armiqësi ...". Kjo armiqësi nuk lind vetvetiu. Kur njeriu shkeli ligjin hyjnor, natyra e tij u kthye në natyrë mëkatare dhe pikërisht në atë moment, ai përputhej plotësisht me natyrën e Satanit dhe s'kishte se si ta sulmonte atë. Natyrisht njeriu mëkatar dhe autori i mëkatit nuk mund të jenë në armiqësi me njeri-tjetrin. Të dyja palët mëkatuan, sepse hoqën dorë nga besimi. Femohuesi nuk lodhet së punuari deri sa fiton simpatinë dhe mbështetjen e të tjerëve, duke i shtyrë që të ndjekin shembullin e tij. Kjo është arsyeja e shoqërisë së pashpresë në mes engjëjve të dështuar dhe njerëzve mëkatarë. Sikur të mos kishte ndërhyrë Zoti, Satani dhe njerëzit do të kishin lidhur një aleancë kundër qiellit dhe, në vend që të ushqenin armiqësi kundër Satanit, familja e madhe njerëzore do të ishte njësuar në luftën kundër Perëndisë.

Satani i tundoi njerëzit, që këta të mëkatonin, ashtu si dikur i kishte bërë engjëjt të rebelonin në mënyrë që të siguronte bashkëpunimin e tyre në luftën kundër Qiellit. Midis Satanit dhe engjëjve të tjerë mëkatarë nuk kishte asnjë kontradiktë përsa i përket urrejtjes që ndjenin për Krishtin; ndërsa ekzistonin mosmarrëveshje në pika të tjera, ata ishin aleatë të devotshëm kur ishte fjala për të kundërshtuar autoritetin e Sundimtarit të Universit. Por me të dëgjuar se do të ekzistonte një ndjenjë armiqësie mes tij dhe gruas, mes farave të tij dhe farave të saj, Satani e kuptoi se do t'i vihej cak përpjekjeve të tij për ta korruptuar racën njerëzore dhe se njerëzit do të aftësoheshin, në një farë mënyre, për ta përballuar fuqinë e tij.

Armiqësia midis Satanit dhe racës njerëzore ka lindur tashmë, sepse përmes Krishtit, njerëzit janë kthyer në objekte të dashurisë dhe mëshirës së Perëndisë. Satani dëshiron me gjithë shpirt që ta prishë planin, duke hedhur baltë mbi krijesat e duarve të Tij. Ai sjell trishtim në qiell dhe rrënim e shkatërrim në tokë dhe, duke treguar me gisht këtë të keqe të madhe, ai deklaron se ajo është rezultat i punës së Zotit për krijimin e njeriut.

Është hiri i Krishtit që mbjell në shpirtin e njeriut armiqësi ndaj Satanit. Sikur njeriut t'i mungonte ky hir shndërrues dhe kjo dëshirë rinovuese, ai do të vazhdonte të mbetej skllav i Satanit, një shërbëtor i gatshëm për të kryer çdo urdhër të tij. Por pranimi i ri krijon një konflikt aty ku më parë mbretëronte paqja. Fuqia që vjen nga Krishti e aftëson njeriun që t'i rezistojë këtij tirani. Kushdo që e urren në vend që ta dojë mëkatin, kushdo që i reziston atij, duke dalë fitimtar mbi pasionet që ndjen përbrenda, është shembull i veprimit të një parimi qiellor.

Antagonizmi, që ekziston mes frymë së Krishtit dhe frymës së Satanit u shfaq mjaft qartë në pritjen që bota i rezervoi Jezusit. Çifutët nuk e mohuan Atë, duke u nisur vetëm nga fakti që Ai erdhi i zhveshur nga pasuria, pompoziteti apo madhështia tokësore. Ata vunë re se Ai zotëronte një fuqi të tillë, që e plotësonte mungesën e këtyre përparësive të jashtme. Por pastërtia dhe shenjtëria e Krishtit nxitën urrejtjen e njerëzve të poshtër kundër personit të Tij. Jeta e Tij, që bazohej tek vetëmohimi dhe përkushtimi i sinqertë ishte një qortim i vazhdueshëm për një popull krenar dhe të pabindur. Pikërisht kjo shkëndijë ndezi zjarrin e armiqësisë kundër Birit të Perëndisë. Satani dhe engjëjt e tij bashkuan forcat me njerëzit mëkatarë. Kampioni i së vërtetës u vu në qendër të çdo force shkatërruese.

Ndaj pasuesve të Krishtit manifestohet e njëjta armiqësi që përballoi dikur Mësuesi i tyre. Kushdo që e kupton karakterin e neveritshëm të mëkatit dhe, duke përdorur fuqi hyjnore i reziston tundimit, padyshim zgjon zemërimin e Satanit dhe agjentëve të tij. Për sa kohë që do të ketë mëkatarë, do të ekzistojë edhe urrejtja ndaj parimeve të mirëfillta të së vërtetës dhe persekutimi ndaj avokatëve të tyre mbrojtës. Pasuesit e Krishtit dhe shërbëtorët e Satanit s'mund të gjejnë kurrë një gjuhë të përbashkët. Persekutimi që filloi në kryq vazhdon akoma. "Të gjithë ata që jetojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus do të përndiqen." *(2 Timoteut 3:12).*

Agjentët e Satanit s'pushojnë kurrë së punuari nën drejtimin e tij për të vendosur autoritetin dhe për të ndërtuar mbretërinë e tij, në kundërshtim të plotë me qeverisjen e Perëndisë. Për të arritur një qëllim të tillë ata përpiqen që t'i mashtrojnë pasuesit e Krishtit dhe ta lëkundin besnikërinë e tyre. Në këtë mënyrë, ashtu si udhëheqësi i tyre, edhe ata i keqinterpretojnë dhe i shtrembërojnë Shkrimet e Shenjta. Ashtu siç u përpoq Satani që të hidhte baltë mbi figurën e Perëndisë, ashtu orvaten edhe agjentët e tij që të flasin keq për popullin e Zotit. Fryma që i solli vdekjen Krishtit i frymëzon edhe njerëzit e ligj që t'i shkatërrojnë nxënësit e Tij. Profecia

parashikon gjithçka. "Unë do të shtie armiqësi midis teje dhe gruas, midis farës sate dhe farës së saj." Kjo do të vazhdojë deri në fund të kohës.

Satani grumbullon të gjitha forcat dhe përdor të gjithë pushtetin që ka për ta fituar këtë betejë. Pse nuk i bëhet atëherë një qëndresë edhe më e madhe? Pse janë ushtarët e Krishtit kaq të tulatur dhe indiferente? ... Sepse kanë një lidhje të dobët me Krishtin, sepse u mungon Fryma e Tij. Mëkati nuk përfaqëson për ta ndryshim me Mësuesin e tyre, nuk përfaqëson një gjë të neveritshme dhe të urryer. Ata nuk i përgjigjen atij, ashtu siç bëri Krishti, me një qëndresë të vendosur dhe të papërkulur. Ata nuk e kuptojnë të keqen dhe rrënimin që mbart mëkati dhe janë të verbuar përpara karakterit dhe fuqisë së princit të errësirës. Satani dhe veprat e tij sulmohen pak, sepse njerëzit nuk e njohin fuqinë dhe keqdashjen e tij dhe nuk e kuptojnë plotësisht përhapjen e gjerë që ka marrë lufta e tij kundër Krishtit dhe kishës së Tij. Me mijëra njerëz zhgënjehen në këtë pikë.Ata nuk e dinë që armiku i tyre është një gjeneral i fuqishëm, që kontrollon mendjet e një numri të madh engjëjsh mëkatarë dhe që lufton kundër Krishtit për të penguar shpëtimin e njerëzve, duke përdorur plane dhe veprime të menduara mirë. Emri i Satanit përmendet pak në mes të Krishterëve të thjeshtë madje edhe pastorët e ungjillit i referohen atij rrallë gjatë shërbesave të tyre. Ata nuk i përfillin provat e veprimtarisë dhe suksesit të tij të vazhdueshëm; ata nuk i marrin parasysh paralajmërimet e shumta të dinakërisë së tij dhe duket sikur nuk pranojnë edhe vetë ekzistencën e tij.

Ndërsa njerëzit nuk dinë asgjë për planet e tij, ky armik vigjilent nuk u ndahet hap pas hapi. Ky mik i padëshiruar hyn në çdo dhomë të shtëpisë, në çdo rrugë të qytetit, në kisha, në këshillin kombëtar, në sallat e gjyqeve, duke çoroditur, tunduar, mashtruar, duke rrënuar kudo trupat dhe shpirtrat e burrave, grave dhe fëmijëve, duke shpërbërë familje, duke mbjellë urrejtje, cmirë, grindje, kryengritje dhe vrasje. Ndërsa të Krishterët i shikojnë këto ngjarje të paracaktuara nga Zoti që thjesht duhet të ekzistojnë.

Satani po përpiqet vazhdimisht që t'i shkelë me këmbë njerëzit e Zotit, duke rrafshuar barrierat që i ndajnë ata nga pjesa tjetër e botës. Izraeli i hershëm u josh nga mëkati kur filloi "miqësinë" e ngushtë me popujt paganë. Në të njëjtën mënyrë gabojnë edhe Izraelitët modernë. "Por Perëndia e kësaj bote ua verboi mendjet atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit, që është shembëllimi i Perëndisë, të mos ndriçojë tek ata." *(2 Korintasve 4:4)*. Të gjithë ata, që nuk janë pasues besnikë të Krishtit, janë shërbëtorë të Satanit. Në një zemër të papërtërirë mbizotëron dashuria për mëkatin dhe dashuria për ta ushqyer dhe shfajësuar atë. Në një zemër të rinovuar mbretëron urrejtja për mëkatin dhe qëndresa e vendosur kundër tij. Kur të Krishterët zgjedhin shoqërinë e të pafeve, ata zbulohen përpara tundimit. Satani s'duket gjëkundi në horizont, por mengadalë ai ua vesh sytë me petkun e tij mashtrues. Ata s'mund ta kuptojnë që një shoqëri e tillë është llogaritur

që t'i dëmtojë; e ndërsa përputhen me botën në karakter, fjalë e veprime, ata verbohen çdo ditë e më shumë.

Përshtatja me zakonet tokësore e kthen kishën tek bota, por nuk e kthen kurrë botën tek Krishti. Mëkati na duket më pak i dëmshëm sa herë që mësohemi me të. Ai që vendos që të shoqërohet me shërbëtorët e Satanit, nuk do ta ketë më frikë zotin e tyre. Kur gjatë detyrës që kryejmë vihemi në provë si Danieli në oborrin mbretëror, Zoti do të na mbrojë, por në qoftë se i zbulohemi qëllimisht tundimit, herët a vonë do ta pësojmë.

Puna e tundimit është më e suksesshme me ata që nuk dyshojnë se janë nën kontrollin e tij. Njerëzit e talentuar dhe të edukuar shpesh admirohen dhe nderohen thua se këto veti mund të zëvendësojnë respektin ndaj Perëndisë apo t'i japin njeriut të drejtën për të fituar dashurinë e Tij. Talenti dhe kultura janë në vetvete dhurata të Perëndisë; por kur këto, zënë vendin e mëshirës dhe në vend që ta afrojnë njeriun me Zotin, e drejtojnë atë në rrugë të gabuar, kthehen në kurth dhe mallkim. Shumë njerëz janë të mendimit që mirësjellja dhe delikatesa i përkasin në një farë mënyre, Krishtit. Ky është gabimi më i madh. Këto veti duhet që ta zbukurojnë karakterin e çdo të Krishteri, sepse janë forcë e madhe në mbështetje të besimit të vërtetë; por ato duhet t'i përkushtohen Perëndisë, ndryshe do të jenë pre e së keqes. Shumë njerëz të ditur dhe të sjellshëm, që nuk do të përuleshin përpara të ashtuquajturave akte imoraliteti janë thjesht instrumente të përpunuara mirë në duart e Satanit. Karakteri tinzar dhe mashtrues i ndikimit dhe shembullit të tyre i bën ata armiq më të rrezikshëm se injorantët dhe të padituri, ndaj kauzës së Krishtit.

Duke iu lutur dhe duke u mbështetur tek Perëndia, Solomoni fitoi një mençuri kaq të madhe sa që e çudiste botën mbarë. Por me t'u larguar nga Burimi i fuqisë së tij, duke u mbështetur tek forcat e veta, ai ra pre e tundimit. Kështu, fuqitë e mrekullueshme që iu dhuruan këtij mbreti të zgjuar e kthyen atë në një agjent efektiv të armikut të njerëzimit.

Ndërsa Satani përpiqet vazhdimisht që t'i çorodisë dhe t'i hutojë, të Krishterët nuk duhet kurrë të harrojnë se "beteja e tyre nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të botës së errësirës të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrapshta në vendet e larta." *(Efesianët 6:12)*. Paralajmërimi, përmes shekujve, arrin deri në ditët tona: "Jini të përmbajtur, rrini zgjuar; sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar se cilin mund të përpijë." *(1 Pjetrit 5:8)*. "Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni kundër djallit." *(Efesianët 6:11).*

Që nga koha e Adamit deri në ditët tona, armiku ynë e ka përdorur fuqinë e vet për të shtypur e për të shkatërruar. Tani ai po përgatitet për fushatën e tij të fundit kundër kishës. Të gjithë ata, që përpiqen ta ndjekin Jezusin do të jenë në konflikt me këtë armik dinak. Sa më afër Shembullit hyjnor të jetë i Krishteri, aq më shumë

mundësi do të ketë ai për t'u kthyer në shenjestër për sulmet e Satanit. Të gjithë ata që do të përfshihen në mënyrë aktive në punën e Perëndisë, duke u përpjekur që t'i çjerrin maskën mashtrimeve të kryemëkatarit dhe ta zbulojnë Krishtin përpara njerëzve, do të bashkohen me Palin në dëshminë e tij, ku flitet për shërbim ndaj Perëndisë me përulje, me lot e tundime pafund.

Satani e tundoi Krishtin me dinakëri, por humbi çdo betejë. Ato beteja u luftuan në emrin tonë; ato fitore na bënë edhe ne fitimtarë. Krishti do t'u japë fuqi të gjithë atyre që do t'ia kërkojnë atë. Satani mund të sundojë vetëm atë që s'do të fitojë. Tunduesi nuk mund ta kontrollojë vullnetin e lirë apo ta detyrojë njeriun që të mëkatojë. Ai mund të na bezdisë, por nuk mund të na infektojë. Ai mund të na trishtojë, por nuk mund të na korruptojë. Fitorja e Krishtit duhet të jetë burim frymëzimi dhe forcë për pasuesit e Tij, në luftën kundër mëkatit dhe Satanit.

1. Përse Satani e urren rracën njerëzore?

2. Kur mbolli Jezusi armiqësi midis njeriut dhe Satanit në zemrën njerëzore? Në çmënyrë na jep ne avantazh "vakumi i formësuar nga Perëndia" në zemrat tona, në prezantimin e ungjillit?
3. çfarë qasje na bën neve të jemi në shënjestër të sulmeve të Satanit?

4. Nëse tunduesi nuk mund të kontrollojë dot vullnetin tonë apo nuk mund të na detyrojë ne të mëkatojmë, atëherë përse çdo njeri ka mëkatuar? Në çfarë mënyre na frymëzon Jezusi në betejën tonë kundra mëkatit?

31.

Agjensitë e Frymërave të Liga

Në Shkrimet e Shenjta zbulohet qartë lidhja mes të dukshmes dhe të padukshmes,shërbimi që kryejnë engjëjt e Perëndisë, agjentura e frymërave të së keqes dhe ndërthurja e tyre me historinë njerëzore. Një numër gjithnjë e më i madh njerëzish nuk besojnë në ekzistencën e frymërave të së keqes, ndërsa engjëjt e shenjtë që "shërbejnë në të mirën e atyre që kanë për të trashëguar shpëtimin" *(Hebrenjtë 1:14)* konsiderohen si shpirtëra të vdekurish. Por Shkrimet e Shenjta jo vetëm që flasin si për engjëj të mirë, ashtu dhe për engjëj mëkatarë, por na japin prova bindëse për të vërtetuar se ata nuk janë shpirtëra të zhveshur nga trupat e të vdekurve.

Engjëjt kanë ekzistuar edhe përpara krijimit të njerëzve të parë, sepse, kur u hodhën themelet e tokës "Yjet e mëngjesit kënduan së bashku dhe tërë bijtë e Perëndisë lëshuan britma gëzimi" *(Jobi 38:7).*

Menjëherë pas dështimit të njerëzve ishin engjëjt ata, që u dërguan për të ruajtur pemën e jetës dhe kjo ka ndodhur në një kohë kur asnjë qënie njerëzore nuk kishte vdekur ende. Engjëjt nga natyra janë më lart se njerëzit, sepse psalmisti thotë që njerëzit u "bënë pak më të ulët se engjëjt". *(Psalmet 8:5)*.

Shkrimet e Shenjta na japin të dhëna përsa i përket numrit, fuqisë dhe lavdisë së qënieve qiellore, lidhjes së tyre me qeverisjen e Perëndisë dhe me planin e shpëtimit. Zoti e ka vendosur fronin e tij në qiejtë dhe mbretërimi i tij sundon mbi gjithçka. Profeti thotë: "dëgjova zërin e shumë engjëjve përqark fronit". Në dhomën e mbretit të mbretërve presin ata "engjëjt e pushtetshëm dhe të fortë", "ministrat e Tij që ia zbatojnë vullnetin" dhe që "i binden zërit të fjalës së Tij". *(Psalmet 103:19-21)*; *(Zbulesa 5:11)*. Profeti Daniel pa mijëra e mijëra e mori e mori lajmëtarësh qiellorë. Apostulli Pal deklaron se ata përbëjnë "një mori të panumërt". *(Danieli 7:10)*, *(Hebrenjtë 12:22)*. Ndërsa lajmëtarët e Perëndisë lëvizin nga njëri vend tek tjetri ata "duken si rrufe" *(Ezekieli 1:14)*, kaq verbuese është lavdia e tyre dhe kaq i shpejtë

fluturimi. Engjëlli, që u shfaq tek varri i Shpëtimtarit "me pamje si vetëtimë dhe veshje të bardhë si bora" i bëri rojet të dridheshin nga frika dhe ata "mbetën si të vdekur" *(Mateu 28:3,4)*. Kur Senakeribi, Asiri mendjemadh u tall me Zotin, blasfemoi kundër Tij dhe i kërcënoi izraelitët, duke u thënë se do ta kthente Izraelin në gërmadha, "ndodhi që engjëlli i Zotit atë natë doli dhe vrau në kampin e Asirëve 185 njerëz". Atje gjetën vdekjen "burrat e fortë dhe trima, princat dhe komandantët "e ushtrisë së Senakeribit. Kështu "ky u kthye në vendin e tij i mbuluar me turp." *(2 Mbretërve 19:35)*; *(2 Kronikave 32:21)*

Engjëjt dërgohen me misione të veçanta mëshire për fëmijët e Zotit, tek Abrahami, me premtime bekimesh; tek portat e Sodomit, për të shpëtuar Lotin e ndershëm nga rreziku që i kanosej; tek Elija, ndërsa ai ishte gati duke vdekur nga uria dhe lodhja në shkretëtirë; tek Elisha për të rrethuar me karroca dhe kuaj zjarri qytetin ku e kishin burgosur armiqtë e tij, tek Danieli ndërsa ai kishte nevojë për mençuri në oborrin e një mbreti pagan, apo kur mund të kthehej në pre për luanët e uritur; tek Pjetri kur ky u dënua me vdekje në burgjet e Herodit; tek të burgosurit në Filipi; tek Pali dhe miqtë e tij atë natë stuhie në det për t'ia hapur Korneljusit dyert dhe zemrat ndaj lajmit të mirë; për ta nisur Pjetrin me misionin e përhapjes së Mesazhit të shpëtimit edhe tek popujt joçifutë-pra engjëjt e shenjtë u kanë shërbyer gjatë gjithë kohërave njerëzve të Perëndisë.

Çdo pasuesi të Krishtit i është caktuar një engjëll mbrojtës. Këto roje qiellore e mbrojnë të drejtin nga fuqia e së keqes. Edhe Satani vetë e pranon këtë fakt kur thotë: "Vallë më kot Jobi ka frikë nga Perëndia? A nuk ke vënë Ti një mbrojtje rreth Tij, rreth shtëpisë së tij dhe të gjitha gjërave që ai zotëron?" *(Jobi-1:9,10)*

Fjalët e psalmistit e përshkruajnë shumë bukur mënyrën sipas së cilës Perëndia i mbron njerëzit e Tij. "Engjëlli i Zotit zë vend rreth atyre që kanë frikë prej Tij dhe i çliron**".** *(Psalmet 34:7)*.

Duke folur për ata që i besojnë Shpëtimtari tha **"**Ruhuni se përbuzni ndonjë nga këta të vegjël, sepse unë po ju them se engjëjt e tyre në qiell shohin vazhdimisht fytyrën e Atit tim" *(Mateu 18:10)*. Engjëjt, detyra e të cilëve është të kujdesen për fëmijët e Perëndisë, kanë gjithmonë të drejtën që të qëndrojnë në praninë e Perëndisë.

Kështu njerëzit e Zotit që janë në shënjestër të fuqisë mashtruese dhe keqdashjes së vazhdueshme të princit të errësirës dhe që luftojnë me të gjitha forcat e së keqes, kanë mbështetjen e plotë të engjëjve qiellore. Ata kanë nevojë për një mbështetje të tillë. Zoti u ka premtuar fëmijëve të Tij mëshirë dhe mbrojtje, sepse ata duhet të përballojnë agjentura të fuqishme të së keqes-agjentë të panumërt të vendosur e të palodhur që me fuqinë dhe keqdashjen e tyre mund t'i rrënojnë të gjithë ata, që janë të paditur dhe nuk i kushtojnë rëndësi ekzistencës së tyre.

Shpirtërat mëkatarë, që fillimisht u krijuan të përsosur kishin të njëjtën natyrë, fuqi dhe lavdi me qeniet hyjnore, që tani janë lajmëtarët e Perëndisë. Por të dësh-

tuar, falë mëkatit ata kanë lidhur "besën", për ta çnderuar Zotin dhe për t'i shkatërruar njerëzit. Aleatët e Satanit gjatë rebelimit të tij patën të njëjtin fat me të: u përzunë nga qielli dhe që atëherë kanë bashkëpunuar me udhëheqësit e tyre për të luftuar kundër autoritetit hyjnor. Shkrimet e Shenjta na tregojnë për komplotet dhe Qeverisjen e tyre, për qëllimet, zgjuarsinë dhe dinakërinë e tyre, për projektet e tyre keqdashëse kundër paqes dhe lumturisë njerëzore.

Në historinë e Dhiatës së Vjetër ekzistenca dhe veprimtaria e tyre përmenden rrallë, sepse shpirtrat e së keqes e manifestuan fuqinë e tyre veçanërisht gjatë kohës kur Krishti jetoi në tokë. Krishti erdhi për të vënë në jetë pjesën e parë të planit për shpëtimin e njerëzve, por edhe Satani vendosi që ta shpallte haptazi të drejtën e tij për të kontrolluar botën. Ai kishte mbjellë idhujtari në çdo anë të botës përveç Palestinës. Puna i kishte ecur mbarë, por Krishti erdhi për t'u falur njerëzve dritë qiellore, pikërisht në atë vend, që nuk i ishte dorëzuar plotësisht dhunës së tunduesit. Të drejtën për ta qeverisur tokën e kërkonin njëkohësisht dy forca rivale. Jezusi po i hapte me dashuri krahët e tij dhe po i ftonte që të vinin tek Ai të gjithë ata, që kërkonin falje dhe paqe shpirtërore. Shpirtërat mëkatarë të errësirës vunë re se nuk mund të ushtronin mbi njerëzit një kontroll pa kufi dhe e kuptuan se në qoftë se Krishti do t'ia dilte mbanë gjatë misionit të Tij, sundimit të tyre do t'i vinte shpejt fundi. Satani i tërbuar si një luan në kafaz e shprehu fuqinë e vet si mbi trupat, ashtu dhe mbi shpirtërat njerëzorë.

Në Dhiatën e Re hidhet dritë mbi faktin që demonët pushtuan shumë njerëz. Këta njerëz, që ndikoheshin prej tyre nuk vuanin thjesht vetëm nga sëmundje fizike. Krishti po merrej me diçka, që ishte e njohur për Të dhe Ai e kuptoi menjëherë praninë e drejtpërdrejtë dhe veprimtarinë e shpirtërave të së keqes.

Historia e shërimit të njeriut të pushtuar nga demonët në Gadara është një shembull mahnitës i numrit, fuqisë dhe keqdashjes së tyre, por edhe i fuqisë dhe mëshirës së Krishtit. Ata maniakë të dërrmuar, duke hequr dore nga çdo formë vetkontrolli, duke u përpëlitur, duke shkumbëzuar me tërbim, duke dëmtuar vetveten dhe duke i vënë në rrezik të gjithë ata që guxonin t'u afroheshin u prishnin qetësinë të tjerëve me britmat e tyre. Trupat e tyre të gjakosur dhe të rraskapitur, mendjet e tyre të mpira përbënin një spektakël të këndshëm për princin e errësirës. Një nga demonët, që kontrollonin këta njerëz të shumëvuajtur deklaronte: "unë quhem Legjion, sepse jemi shumë ." *(Marku 5:9)*. Në ushtrinë romake një legjion përbëhej nga 3000-5000 ushtarë. Edhe moria satanike është e grupuar në kompani dhe vetëm kompania e këtyre demonëve kishte po aq "ushtarë", sa edhe një legjion.

Me urdhërin e Jezusit shpirtërat e së keqes u larguan nga ish viktimat e tyre dhe këta të fundit qëndronin të qetë, të urtë, të sjellshëm dhe të mençur, të ulur tek këmbët e Shpëtimtarit. Por demonëve iu lejua që të kaptonin një tufë derrash, që falë veprimit të tyre shkatërrues përfunduan në det dhe për banorët e Gadares humbja e kësaj tufe peshonte më shumë se bekimet që u kishte falur Krishti, prandaj ata

iu lutën me ngulm Mësuesit Hyjnor që të largohej. Një rezultat i tillë përmbushte plotësisht qëllimin e Satanit. Duke e quajtur Krishtin fajtor për këtë humbje të "madhe", ai zgjoi në zemrat e njerëzve frikë dhe hutim, duke mos i lënë ata që të dëgjonin fjalën e Tij. Satani i quan vazhdimisht të krishterët shkakun e vetëm të humbjeve, fatkeqësive dhe vuajtjeve, sepse nuk do që faji të bjerë mbi supet e fajtorëve të vërtetë-të atij vetë dhe të agjentëve të tij.

Por Krishti kishte qëllimet e veta dhe këto qëllime s'mund të hidheshin poshtë. Ai lejoi shpirtërat e së keqes që ta shkatërronin tufën e derrave, për të qortuar në këtë mënyrë të gjithë ata çifutë që po i rrisnin këto kafshë të papastra vetëm për hir të fitimit. Sikur Krishti të mos u kishte vënë fre Demonëve ata do të kishin fundosur në thellësitë e detit jo vetëm tufën e derrave, por edhe barinjtë e pronarët e tyre. Mbrojtja e barinjve dhe e pronarëve i dedikohet vetëm ushtrimit të mëshirshëm të fuqisë së Tij**.** E për më tepër kjo ngjarje ndodhi në mënyrë që dishepujt të mund të shihnin me sytë e tyre fuqinë mizore të Satanit jo vetëm mbi njerëzit, por edhe mbi kafshët. Shpëtimtari dëshironte që pasuesit e Tij ta njihnin armikun që kishin përpara që të mos mashtroheshin e as të mos i nënshtroheshin marifeteve të tij. Ai veproi në atë mënyrë që, duke përmbushur vullnetin e Tij njerëzit e asaj zone të dëshmonin për fuqinë e Tij, që ishte aq e madhe sa mund të flakte tej zgjedhën satanike e mund t'u rikthente lirinë robërve të saj. Edhe pse Jezusi vetë u largua Ai la prapa njerëzit, që i çliroi falë fuqisë së Tij, njerëz, që shpallën kudo mëshirën e mirëbërësit të tyre.

Në Shkrimet e Shenjta jepen të dhëna mbi ngjarje të tjera të ngjashme me këtë. Vajza e një gruaje sirofenikase ishte pushtuar nga një demon, të cilin Jezusi e urdhëroi të largohej nga fëmija falë fuqisë së fjalës së Tij *(Marku 7:26-30)*. "Një i demonizuar që ishte i verbër e memec." *(Mateu 12;22)*; një i ri që ishte pushtuar nga një frymë memece që shpesh "e hidhte në zjarr dhe në ujë për ta shkatërruar". *(Marku 5:17-27)*. Maniaku, që i ngacmuar nga "fryma e një demoni të ndyrë" *(Luka 4:33-36)*, prishi qetësinë e sinagogës në Kapernaun atë ditë Sabati - të gjithë këta njerëz gjetën shërim dhe qetësi shpirtërore tek Shpëtimtari i dhemshur. Në çdo rast Krishti u drejtohej demonëve si qenie reale, duke i urdhëruar që të largoheshin nga viktimat e tyre dhe të mos i shqetësonin më kurrë ata. Të gjithë njerëzit që ishin në Kapernaun, duke qënë dëshmitarë të fuqisë së Tij të mrekullueshme "i pushtoi habia dhe i thonin njeri-tjetrit: "Ç'fjalë është kjo vallë? Ai urdhëron me autoritet dhe pushtet frymët e ndyra dhe ata dalin!" *(Luka 4;;36)*.

Zakonisht njerëzit e pushtuar nga demonët (frymërat e së keqes), paraqiten si qenie, që vuajnë parreshtur; por edhe ky rregull ka përjashtimet e veta. Disa njerëz e mirëpresin ndikimin satanik, sepse mendojnë se kështu mund të fitojnë një farë fuqie mbinatyrore. Pa dyshim këta të fundit jetojnë me demonët. Njerëzit, që zotërojnë shpirtin e magjisë si Simon Magusi, Elimas magjistari dhe vajza e re,

që ndoqi Balin dhe Silën në udhëtimin për në Filipi, i përkasin kësaj kategorie "të pushtuarish".

Ata, që pavarësisht nga dëshmia e drejtpërdrejt e Shkrimeve të Shenjta e mohojnë ekzistencën edhe veprimtarinë e djallit dhe engjëjve të tij, rrezikojnë më shumë se të tjerët që të bien pre e ndikimit të shpirtrave të së keqes. Ata do të kenë avantazh mbi ne për aq kohë sa ne nuk do t'i njohim kurthet e tyre mashtruese; shumë njerëz u vënë veshin sugjerimeve të tyre, duke menduar se ju flet zëri i ndërgjegjes dhe zgjuarsisë së brendshme. Prandaj në afrimin e fundit të kohës; periudhë gjatë së cilës satani do t'i shtojë përpjekjet e tij për të mashtruar e shkatërruar njerëzit, ai do të përhapë kudo besimin se nuk ekziston. Maskimi është politika dhe mënyra e tij e veprimit.

Mashtruesin e "madh" e tmerron fakti që ne mund të njihemi me truket e tij. Në mënyra që ta fshehë sa më mirë karakterin dhe qëllimet e tij të vërteta, ai e paraqet veten si një qenie që ngjall vetëm tallje dhe përçmim. Ai kënaqet shumë kur të tjerët e përfytyrojnë si një qenie qesharake dhe të neveritshme, një objekt pa formë, gjysëm kafshë dhe gjysëm njeri. Atij i bëhet qejfi kur dëgjon se njerëzit që e quajnë veten inteligjentë dhe të mirëinformuar, e përdorin emrin e tij në pantonima dhe shaka.

Duke qenë se maskimi i tij është më se i përsosur shpesh njerëzit i bëjnë vetes pyetjen: "Ekziston vallë me të vërtetë një qenie e tillë?" Fakti që bota fetare pranon si të vërteta teori që, përgënjeshtrojnë haptazi dëshminë e qartë të Shkrimeve të Shenjta është provë e pamohueshme e suksesit të tij. Fjala e Perëndisë, duke marrë parasysh faktin që Satani është gati t'i vërë nën kontrollin e tij të gjithë ata që nuk e kuptojnë fuqinë e tij, na jep kaq shumë shembuj të punës së tij keqdashëse, duke zbuluar para nesh forcat e tij të fshehta e duke na paralajmëruar ndaj sulmeve të tij.

Fuqia dhe keqdashja e Satanit dhe agjentëve të tij duhej të na alarmonin me të drejtë në qoftë se nuk do të mund të gjenin strehë dhe mbrojtje tek fuqia e pafund e Shpëtimtarit tonë. I sigurojmë shtëpitë tona me shul dhe dry për t'u mbrojtur dhe për të ruajtur pasurinë tonë nga lakmia e njerëzve të liq; por nuk mendojmë pothuaj asnjëherë për engjëjt mëkatarë, që përpiqen vazhdimisht të na sulmojnë; kundër sulmeve të të cilëve ne me forcat tona nuk mund të mbrohemi kurrë. Po t'u jepet mundësia ata mund të çorodisin mendjet tona, të çorientojnë trupat tanë, të shkatërrojnë jetët tona dhe gjithçka tjetër që na përket. Ata kënaqen vetëm kur rrënojnë e shkatërrojnë gjithçka që iu bie në dorë. E mjerueshme është gjendja e atyre që i rezistojnë mbrojtjes hyjnore dhe i dorëzohen tundimeve të Satanait. Por ata që i besojnë dhe e ndjekin Krishtin janë gjithmonë të sigurt nën mbrojtjen dhe kujdesin e Tij. Në mbrojtje të tyre dërgohen engjëj, që shquhen për forcë e guxim. E keqja nuk mund ta shpartallojë murin mbrojtës që Perëndia ka ngritur rreth njerëzve të Tij.

1. Në disa pjesë të botës, veçanërisht në ato më pak të zhvilluara, shërbesa e engjëjve është më e shfaqur zakonisht. Përse ndodh kjo?

2. Cila është diferenca midis një fryme të ligë dhe Frymës së Perëndisë?

3. Lexoni Psalmin 34:7. Nëse ja kemi dhënë jetët tona Jezusit, a mund të na dëmtojë Satani apo frymërat e liga? A duhet të kemi frikë nga frymërat e liga?

32.

Kurthet e Satanit

Kontradiktës së madhe midis Krishtit dhe Satanit, e cila ka vazhduar pothuajse gjashtëmijë vjet, po i vjen fundi dhe Satani i dyfishon përpjekjet e tij për ta penguar punën e Krishtit në të mirë të njerëzimit dhe për t'i mbërthyer shpirtrat njerëzore në kurthet e tij. Qëllimi i tij i vetëm është që t'i mbajë njerëzit në errësirë dhe padije deri sa të përfundojë periudha e ndërmjetësimit të Shpëtimtarit pas së cilës, mëkatin nuk do të mund ta shlyejë më asnjë flijim tjetër.

Kur në kishë dhe në botë mbizotëron moskokëçaria dhe nuk bëhet asnjë përpjekje për t'i bërë ballë fuqisë së Tij, satani është i qetë, sepse nuk rrezikon që t'i humbasë ata që po i transformon në robër të vullnetit të vet. Por kur vëmendja e njerëzve përqëndrohet tek gjërat e përjetshme dhe ata pyesin veten: "Çfarë duhet të bëj që të shpëtoj!", Atij i rrëshket toka nën këmbë, sepse i duhet që të krahasohet me fuqinë e Krishtit dhe t'i kundërpërgjigjet ndikimit të Frymës së Shenjtë.

Në Shkrimet e Shenjta thuhet se një ditë, kur engjëjt e Perëndisë u paraqitën para Tij, bashkë me ta erdhi dhe Satani: *(Jobi 1:6)*; jo që të përulej përpara Mbretit të Pavdekshëm, por që të thellonte akoma dhe më shumë përpjekjet e tij keqdashëse kundër njerëzve të drejtë. Të njëjtën gjë ka në mendje ai dhe kur pret të mblidhen njerëzit, që duan të adhurojnë Perëndinë. Megjithëse nuk duket asgjëkundi, fshehur diku, ai punon me zell që të vihet në kontroll të mendjeve të atyre që adhurojnë. Si një gjeneral i zoti, përgatit fillimisht planin e veprimit. Ndërsa ndjek me kujdes se si lajmëtari i Perëndisë shqyrton me kujdes Shkrimet e Shenjta, ai mban shënim temën që do t'u parashtrohet njerëzve. Pas kësaj, ai përdor të gjithë dinakërinë dhe zgjuarsinë e tij, duke krijuar rrethana të tilla që mesazhin të mos e dëgjojnë njerëzit, që ai po i mashtron pikërisht në atë pikë. Njeriu që ka më shumë nevojë për këtë paralajmërim, do të përfshihet në disa procedura pune, që kërkojnë praninë e tij, apo në një farë mënyre, do t'i paraqiten pengesa që të mos t'i dëgjojë fjalët që mund t'i shpëtojnë jetën.

Satani shikon shërbëtorët e Zotit të shqetësuar për shkak të errësirës shpirtërore që ka mbërthyer njerëzimin. Ai dëgjon lutjet e tyre të ethshme që hiri dhe fuqia hyjnore t'i japin fund periudhës së indiferencës, pakujdesisë dhe plogështisë. Më pas, me zell të ri, ai fillon punën për vënien në jetë të planeve të veta. Ai i tundon njerëzit që t'i kushtojnë vëmendje oreksit të tyre apo plotësimit të ndonjë forme tjetër vetëkënaqësie, duke i paralizuar kështu ndjenjat e tyre në atë pikë, sa që ata refuzojnë të dëgjojnë pikërisht ato gjëra, për të cilat kanë më shumë nevojë.

Satani e di mirë që pre e sulmeve të tij do të bëhen të gjithë ata, që do të heqin dorë nga lutjet dhe studimi i Shkrimeve të Shenjta, prandaj ai përdor çdo lloj mjeti të mundshëm për të tërhequr vëmendjen e njerëzve. Gjithmonë ka ekzistuar një grup njerëzish që, duke u hequr "të shenjtë", në vend që të studionin për të gjetur të vërtetën, kërkonin gabime dhe të meta në karakterin dhe besimin e atyre, që nuk binin dakord me ta. Njerëz të tillë janë krahu i djathtë i Satanit. Akuzuesit e të tjerëve nuk janë të paktë dhe sa herë që Perëndia nderohet në të vërtetën nga shërbëtorët e Tij, ata bëhen më aktivë. Ata do të hedhin një vështrim të gabuar në fjalët dhe veprat e atyre që e duan dhe i binden të vërtetës. Ata i skicojnë shërbëtorët më të zellshëm, më të ethshëm dhe më të vendosur të Krishtit, si të mashtruar apo mashtrues. Detyra e tyre është që të keqinterpretojnë motivet e çdo besimtari të vërtetë dhe fisnik, që të përhapin thashetheme dhe të mbjellin dyshim në mendjet e njerëzve pa përvojë. Me gjithfarë mënyrash ata do të përpiqen që ta paraqesin gjithçka të pastër dhe të drejtë, si çmenduri dhe mashtrim.

Por askush nuk duhet të mashtrohet prej tyre. Eshtë e lehtë të kuptosh se fëmijët e kujt janë ata, shembullin e kujt ndjekin dhe punën e kujt kryejnë. "Ju do t'i njihni nga frytet e tyre" *(Mateu 7;16)*. Rruga e tyre ngjason me rrugën e Satanit, shpifësit të mallkuar, e paditësit të vëllezërve tanë". *(Zbulesa 12:10)*

Mashtruesit të madh i shërbejnë shumë agjentë, që janë të gatshëm të mbrojnë me vendosmëri çdo lloj gabimi - grackë njerëzore, gabime, që përbëjnë herezi të përgatitura me kujdes për të kënaqur shijet dhe për t'iu përgjigjur aftësive të atyre njerëzve që ai do të rrënojë. Plani i tij është që të sjellë në kishë elementë të pasinqertë dhe përçarës, që do të përhapnin dyshim dhe mosbesim dhe do t'ia fshehin punën e Perëndisë të gjithë atyre, që duan të jenë pjesë e saj. Shumë njerëz, që nuk besojnë me të vërtetë tek Perëndia dhe tek Fjala e tij, pranojnë disa parime të së vërtetës dhe vetëquhen të Krishterë, gjë që jua lehtëson paraqitjen e gabimeve si doktrina biblike.

Ideja sipas së cilës nuk ka asnjë rëndësi ajo që besojnë njerëzit, është një nga mashtrimet më të suksesshmet të Satanit. Ai e di mjaft mirë se e vërteta e pranuar me dashuri e shenjtëron njeriun, prandaj përpiqet që ta zëvendësojë atë me teori të rreme, me përralla të bukura dhe me një ungjill tjetër. Që në fillim të kohës, shërbëtorët e Perëndisë janë ngritur kundër mësuesve të rremë, duke i konsideruar

ata jo vetëm si njerëz me vese, por edhe si mbartës gënjeshtrash fatale për shpirtin njerëzor. Elija, Jeremia, Pali, i kundërshtuan me vendosmëri ata që po i largonin njerëzit nga fjala e Zotit. Këta mbrojtës të shenjtë të së vërtetës nuk e përkrahën atë lloj liberalizmi, që e quante të parëndësishëm besimin e saktë fetar.

Interpretimet e pasakta dhe imagjinare të Shkrimeve të Shenjta dhe teoritë kontradiktore, që kanë të bëjnë me besimin fetar dhe që janë pranuar nga të krishterët përbëjnë themelin e punës së armikut tonë të rrezikshëm për të çorientuar mendjet e njerëzve, në mënyrë që ata të mos të mund ta shquajnë më të vërtetën. Mosmarrëveshjet dhe ndarjet, që ekzistojnë mes kishave të krishtera vijnë në një shkallë të madhe si rrjedhim i luftës që i bëhet Shkrimeve të Shenjta për të mbështetur një teori "interesante". Shumë njerëz në vend që ta studiojnë fjalën e Perëndisë me kujdes dhe me përulje, që të njihen kështu me vullnetin e Tij, përpiqen vetëm që të zbulojnë diçka të veçantë dhe origjinale.

Disa të tjerë me qëllim që të mbështesin doktrinat e tyre të gabuara dhe veprimet antikristiane, kapen fort pas disa pasazheve të Shkrimit të Shenjtë, që i zhveshin nga kuptimi, duke cituar ndoshta në mbrojtje të "doktrinave" të tyre një gjysëm verse ndërkohë që gjysma e dytë e kundërshton tërësisht kuptimin e dhënë nga gjysma e parë. Duke përdorur dinakërinë e gjarpërit ata fshihen pas disa thënieve të shkëputura, thënie që i rindërtojnë për t'ju përshtatur dëshirave të tyre trupore. Në këtë mënyrë shumë njerëz "të aftë" i shtrembërojnë fjalët e librit të Perëndisë.

Të tjerët që kanë një imagjinatë të zhvilluar shfrytëzojnë simbolet dhe figurat e Shkrimit të Shenjtë, i interpretojnë ato sipas dëshirës së tyre pa marrë parasysh dëshminë biblike dhe më pas u vënë trilleve të tyre titullin: "Mësime të Biblës".

Sa herë që Shkrimet e Shenjta studiohen me mospërfillje, mendjemadhësi, pa dëshirë, si pasazhet e qarta dhe të thjeshta ashtu edhe versat më të vështira, do të zhvishen nga kuptimi i tyre i vërtetë. Drejtuesit e papatit zgjedhin ato pjesë të Shkrimeve të Shenjta që iu përgjigjen më mirë qëllimeve të tyre, i interpretojnë ato në përputhje me doktrinat e tyre e më pas ua paraqesin ato të zbukuruara njerëzve, duke u mohuar atyre privilegjin e studimit të Biblës dhe të kuptuarit të së vërtetave të shenjta. Njerëzit duhet ta lexojnë Biblën ashtu siç është shkruar; fjalë për fjalë; versë për versë, kapitull për kapitull. Do të ishte shumë më mirë që njerëzit të mos merrnin fare mësime biblike se sa të dëgjonin keqinterpretime të përmasave të tilla.

Bibla u shkrua me qëllim që të ishte udhëzuese për të gjithë ata, që dëshirojnë të njohin vullnetin e Krijuesit të tyre. Perëndia iu dha njerëzve fjalën e sigurtë profetike; engjëjt e madje Vetë Krishti erdhën tek Danieli dhe Gjoni për t'u shpallur atyre ngjarjet, që do të ndodhnin në të ardhmen e afërt dhe të largët.

Çështjet e rëndësishme, që lidhen ngushtë me shpëtimin tonë nuk mbetën mistere. Ato nuk dolën nga errësira në dritë që të çorientonin dhe keqdrejtonin studiuesit e sinqertë të së vërtetës. Zoti përmes profetit Habakuk tha: "Shkruaje vegimin dhe gdhende mbi rrasa, që të mund të lexohet shpejt". *(Habakuku 2:2)*

Fjala e Perëndisë qartësohet përpara syve të atyre që e studiojnë atë, duke u lutur. Drita e së vërtetës do të depërtojë në zemrën e çdo njeriu me të vërtetë të ndershëm. "Drita ka dalë për të drejtin" *(Psalmet 97:11).* Dhe një kishë mund të përparojë në rrugën e shenjtërisë vetëm kur anëtarët e saj ta kërkojnë të vërtetën me zell si të ishte një thesar i fshehur.

Liberalizmi i ka verbuar njerëzit përpara planeve keqdashëse të armikut të tyre, ndërsa ata duhet ta dinë se ai punon me kujdes gjatë gjithë kohës për të arritur qëllimin e tij. Ndërsa ai e zëvendëson me sukses Biblën me spekulimet njerëzore. Ligji i Perëndisë del jashtë "mode" dhe kisha bie nën zgjedhën e mëkatit, duke pretenduar në të njëjtën kohë se është e lirë.

Shumë njerëz i quajnë kërkimet shkencore mallkime. Perëndia përmes zbulimeve në shkencë dhe art i ka falur botës një lumë drite, por edhe kokat më të mëdha, në qoftë se nuk drejtohen gjatë këtyre zbulimeve nga fjala e Zotit çuditen dhe çorientohen, kur përpiqen të gjejnë lidhjet mes shkencës dhe zbulesës.

Dijet njerëzore mbi problemet materiale dhe shpirtërore janë të pjesshme dhe të pasakta, prandaj shumë njerëz nuk janë në gjendje që të gjejnë një gjuhë të përbashkët mes pikëpamjeve shkencore dhe thënieve Biblike. Disa prej tyre i pranojnë teoritë dhe spekulimet e thjeshta si fakte shkencore dhe janë të mendimit se fjala e Perëndisë duhet të kontrollohet nga të dhënat "e asaj që quhet në mënyrë të rreme, shkencë" *(1 Timoteut 6:20)*. Ata s'mund ta kuptojnë Krijuesin dhe Veprat e Tij, dhe, duke qënë se nuk i shpjegojnë dot këto ligje të natyrës e quajnë historinë e Biblës - përrallë. Të gjithë ata që dyshojnë tek vërtetësia e të dhënave të Dhiatës së Re dhe të Vjetër shpesh nuk mjaftohen me kaq, por dyshojnë tek vetë ekzistenca e Perëndisë dhe e veshin natyrën me fuqi të pafund. Me të prerë litarin e spirancës ata lihen në mëshirën e valëve, që i përplasin tek shkëmbinjtë e tradhëtisë.

Kështu ata heqin dorë nga besimi, duke u kthyer në objekte të tundimit satanik. Njerëzit përpiqen që të tregohen më të zgjuar se Krijuesi i tyre, filozofia njerëzore është orvatur që të prekë dhe t'u japë shpjegim mistereve, që nuk do të mund të zbulohen kurrë deri në fund të kohës. Sikur njerëzit të studionin dhe të kuptonin ato gjëra, që Perëndia ka zbuluar mbi Personin e Tij dhe qëllimet që ka për zemër ata do të përfitonin një ide të tillë të lavdisë, madhështisë dhe fuqisë së Jehovait, që do t'i ndihmonte të kuptonin se sa të vegjël janë përpara Tij dhe se sa të kënaqur duhet të jenë për gjithçka që ka dalë në dritë jo vetëm për ta, por edhe për fëmijët e tyre.

Mendjet njerëzore kërkojnë të dinë dhe të marrin me mend gjëra, që Perëndia i ka kthyer në mistere dhe nuk dëshiron që të bëhen të njohura për ta dhe ky fakt, përbën mashtrimin-kryevepër të Satanit. Pikërisht kështu e humbi Luciferi postin e tij në qiell. Ai ishte i pakënaqur, sepse nuk ishte në dijeni të të gjitha qëllimeve të Perëndisë dhe nuk donte t'ia dinte për postin e lartë që i ishte besuar. Ai rrënoi edhe

një pjesë të engjëjve, duke mbjellë në zemrat e tyre ndjenjën e pakënaqësisë. Në të njëjtën mënyrë përpiqet që t'i frymëzojë njerëzit me këtë frymë shkatërruese, që ata t'u kthejnë shpinën urdhëresave të drejtpërdrejta të Perëndisë.

Të gjithë ata, që nuk duan t'i pranojnë të vërtetat e qarta dhe të prera të Biblës janë të etur që të dëgjojnë përralla të bukura për të qetësuar ndërgjegjen e tyre kondradiktore. Sa më bindëse, të vërteta dhe vetëmohuese të jenë doktrinat e parashtruara përpara njerëzve, aq me më pak entusiazëm do të priten ato. Këta njerëz u vënë shkelmin aftësive të tyre intelektuale në dobi të dëshirave të tyre fizike. Duke menduar se janë tepër të ditur për t'i studiuar Shkrimet e Shenjta përmes lutjeve dhe lotëve të pendimit, ata humbin mburojën e çeliktë, duke mbetur të zhveshur përpara zhgënjimit. Satani është gati t'i përmbushë menjëherë dëshirat njerëzore dhe për këtë arsye, në vend të së vërtetës paraqet mashtrimin. Në të njëjtën mënyrë papati mundi të siguronte kontrollin mbi mendjet njerëzore, por edhe protestantët, duke mohuar të vërtetën sepse kjo mbart në vetvete një kryq Kalvari, i kanë hyrë të njëjtës rrugë. Të gjithë ata që e mohojnë fjalën e Perëndisë për të studiuar diplomaci dhe për të përqafuar atë që i shkon për shtat botës, do ta keqkuptojnë herezinë e mallkuar për të vërtetë fetare. Ata që e mohojnë me vetëdije të vërtetën janë të gatshëm që të pranojnë çdo formë gabimi. Ai që e sheh me tmerr një mashtrim të vetëm do të bëhet sakaq viktimë e një të dyti. Apostulli Pal, duke folur për një grup njerëzish "që nuk pranuan ta duan të vërtetën për të qënë të shpëtuar" deklaron: "E prandaj Perëndia do t'u dërgojë atyre një zhgënjim që do t'i bëjë të gabojnë, që t'i besojnë gënjeshtrës, që të dënohen të gjithë ata, që nuk i besuan të vërtetës, por përqafuan ligësinë!". *(2 Selanikasve 2:10-12)*. Me një paralajmërim të tillë në mendje, ne duhet të tregohemi të kujdesshëm në zgjedhjen e doktrinave që pranojmë.

Mësimet e rreme dhe çuditë e gënjeshtërta të spiritualizmit përbëjnë dy nga veprimtaritë më të suksesshme të mashtruesit të madh. I maskuar si një engjëll drite, ai i hedh rrjetat atje ku nuk pritet. Sikur njerëzit të luteshin që Fryma e Shenjtë t'u hapte sytë që ata ta kuptonin Librin e Perëndisë gjatë studimit të tij, ata nuk do të liheshin në errësirë dhe nuk do të pranonin doktrina të rreme të asnjë lloji. Por me të mohuar të vërtetën ata kthehen në pre të mashtrimit.

Doktrina sipas të cilës mohohet hyjniteti i Krishtit, duke pretenduar se Ai nuk ka ekzistuar përpara ardhjes së Tij në tokë, është një përgënjeshtrim i rrezikshëm. Kjo teori është mirëpritur nga një grup i madh njerëzish, që deklarojnë se i besojnë Biblës e, megjithatë, ata kundërshtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë thëniet më të qarta të Shpëtimtarit në lidhje me marrëdhëniet e Tij me Atin, karakterin e Tij hyjnor dhe ekzistencën e Tij të përjetshme. Një teori e tillë mund të përkrahet vetëm në qoftë se nuk merret aspak parasysh dëshmia e Shkrimeve të Shenjta. Ajo jo vetëm që u vë shkelmin koncepteve njerëzore mbi aktin e shpëtimit, por edhe

minon besimin se Bibla është një libër i frymëzuar nga Perëndia. Kjo jo vetëm që e bën çështjen të rrezikshme, por edhe më të komplikuar. Në qoftë se njerëzit e hedhin poshtë dëshminë e frymëzuar të Shkrimeve të Shenjta në lidhje me Hyjnitetin e Krishtit është e kotë që të përpiqesh t'ua shpjegosh këtë pikë, sepse asnjë argument, sado i pamohueshëm të jetë ai, nuk do të jetë bindës për ta. "Njeriu natyror nuk i rrok gjërat që janë të Shpirtit të Shenjtë, sepse për të janë marrëzi dhe nuk mund t'i njohë, sepse ato gjykohen frymërisht". *(1 Korintasve 2:14)*. Ai që e përqafon një gabim të tillë nuk do të mund ta kuptojë kurrë karakterin e vërtetë të misionit të Krishtit apo planin e madh të Perëndisë për shpëtimin e njerëzimit.

Besimi që po përhapet shpejt, sipas të cilit Satani nuk ka ekzistuar kurrë ndonjëherë si qënie, si individ dhe se emri i tij përdoret në Shkrimin e Shenjtë për të përfaqësuar mendimet dhe dëshirat mëkatare të njerëzve, është një gabim tjetër i dëmshëm dhe shkatërrues.

Ideja që dëgjohet shpesh nga podiumet kishtare, sipas së cilës ardhja e dytë e Krishtit përfaqësohet nga vizita që Ai "do t'i bëjë" çdo njeriu të vdekur është një mjet, që përdoret për t'i larguar mendjet njerëzore nga ardhja e Tij e vërtetë mes reve të qiellit. Satani, për vite me radhë ka thënë: "Ja është në dhomat e fshehta" *(Mateu 24:23-26);* dhe shumë njerëz kanë humbur, sepse e kanë pranuar si të vërtetë këtë mashtrim.

Megjithatë, mençuria tokësore vazhdon të na thotë se lutja nuk është themelore. Shkencëtarët pretendojnë se lutjeve nuk u jepet asnjëherë një përgjigje e vërtetë, se kjo do të përbënte një shkelje të ligjeve të natyrës, do të ishte një mrekulli dhe mrekullitë, thonë ata, nuk ekzistojnë. Ata janë të mendimit se në themel të ekzistencës së universit janë ligjet dhe se edhe vetë Perëndia i respekton këto ligje. Kështu ata e paraqesin Perëndinë të mbërthyer nga ligjet e Veta - sikur në veprimtarinë e ligjeve hyjnore të mos ketë vend për liri hyjnore. Dëshmia e Shkrimeve të Shenjta e kundërshton një ide të tillë. A nuk kreu Krishti dhe apostujt e Tij mrekulli? Shpëtimtari i dhembshur jeton edhe sot e kësaj dite dhe është aq i gatshëm t'u vërë veshin lutjeve të besimit sa ç'ishte kur jetoi personalisht mes njerëzve. E natyrshmja bashkëvepron me të mbinatyrshmen. Eshtë vullneti i Perëndisë që të na dhurojë, në përgjigje të lutjeve të bëra me besim, atë që nuk do të na e jepte po të mos ia kishim kërkuar.

Kishat e krishtera po përqafojnë një numër të madh doktrinash të gabuara dhe idesh fantastike. Eshtë e pamundur që të llogariten rezultatet shkatërruese që mbart në vetvete zhvendosja e vetëm njërës prej shenjave orientuese të fjalës së Perëndisë.

Të paktë janë ata njerëz, që pas mohimit të një të vërtete të vetme kanë guximin të heqin dorë nga kjo rrugë. Pjesa më e madhe e tyre vazhdojnë t'i flakin tej njëri pas tjetrit parimet e së vërtetës deri sa kthehen në jobesimtarë.

Gabimet e teologjisë popullore i kanë çuar shumë njerëz drejt rrugës së skepticizmit, njerëz që shumë mirë mund të besonin në Shkrimet e Shenjta. Eshtë e

pamundur që një njeri të pranojë doktrina, që dhunojnë ndjenjën e tij të drejtësisë, mëshirës dhe dashamirësisë dhe kur këto doktrina paraqiten si mësime Biblike ai nuk mund të besojë se ajo është Fjala e Perëndisë.

Dhe pikërisht ky është qëllimi që përpiqet të arrijë Satani. Ai dëshiron me gjithë shpirt që ta shkatërrojë besimin e njerëzve tek Perëndia dhe Fjala e Tij. Satani është kryekomandant i ushtrisë së madhe të njerëzve, që dyshojnë dhe ai përdor çdo armë që i bie në dorë për t'i shtuar radhët e kësaj ushtrie me elementë të rinj. Dyshimi ka hyrë në modë. Një grup i madh njerëzish e shikojnë Fjalën e Perëndisë dhe Perëndinë Vetë me dyshim, vetëm sepse ajo e qorton dhe e dënon mëkatin. Ata që nuk duan t'i binden urdhëresave të saj (të Biblës), përpiqen ta hedhin poshtë edhe autoritetin që mbart ajo. Ata e lexojnë Biblën apo i dëgjojnë mësimet e saj të parashtruara nga podiumet kishtare vetëm që të mbajnë shënim gabimet e Shkrimeve të Shenjta apo paqartësitë e shërbesave fetare. Të shumtë janë ata, që për të justifikuar apo shfajësuar vetveten për moskryerjen e detyrave të tyre, heqin dorë nga besimi. Të tjerët përqafojnë parime skeptike falë krenarisë apo përtacisë së tyre. Tepër të dobët për të fituar lavdi përmes ndonjë vepre nderi, që kërkon përpjekje të ethshme dhe vetësakrifikim, qëllimi i tyre është që, duke kritikuar Biblën të shquhen për zgjuarësi dhe guxim. Mendja njerëzore e zhveshur nga mençuria hyjnore është e pafuqishme që të kuptojë një numër të madh gjërash. Kështu këta njerëz shfrytëzojnë këtë rast të veçantë për të kritikuar. Ka shumë njerëz, që mendojnë që të qëndrosh nga ana e mosbesimit, skepticizmit dhe pabesisë është meritë. Por nën maskën e sinqeritetit dhe çiltërsisë fshihen vetëbesimi dhe krenaria. Një numër i madh njerëzish kënaqen kur gjejnë diçka në Shkrimet e Shenjta, që është mister për të tjerët. Fillimisht disa kritikojnë dhe arsyetojnë gabim, vetëm sepse u pëlqen që t'i kundërshtojnë të tjerët. Ata nuk e kuptojnë se në këtë mënyrë herët a vonë do të bien pre e kurtheve të Satanit. Me të shprehur haptazi mosbesimin e tyre ata mendojnë se tashmë u duhet ta mbrojnë këtë ide. Pra ata bashkohen me njerëzit e padenjë dhe ia mbyllin vetvetes dyert e parajsës.

Perëndia na ka dhënë në fjalën e Tij prova të mjaftueshme pro karakterit të Tij hyjnor. Aty parashtrohen qartë të vërtetat e mëdha, që kanë të bëjnë me shpëtimin tonë. Çdo njeri me ndihmën e Frymës së Shenjtë, që u është premtuar të gjithë atyre që do ta kërkojnë me zemër të hapur, mund t'i kuptojë këto të vërteta. Perëndia ka hedhur për njerëzit themele të forta, që ata të ndërtojnë të sigurt mbi to besimin e tyre.

Megjithatë, mendjet njerëzore që kanë një cak arsyetimi, nuk mund t'i kuptojnë plotësisht qëllimet dhe planet e të Pafundmit. Kërkimet nuk do të na zbulojnë kurrë Perëndinë. Ne nuk duhet që të përpiqemi që ta ngremë me dorën e vetbesimit perden prapa së cilës Ai ka fshehur madhështinë e Tij. Apostulli thotë: "Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e Tij dhe sa të pashtershme janë udhët e Tij." *(Romakët 11:33)*. Ai na ka zbuluar marrëdhëniet e Tij me ne dhe motivet që e

frymëzojnë që ne të mund të shquajmë shkrirjen e dashurisë dhe mëshirës pakufi me fuqinë pafund. Ati ynë qiellor e kryen gjithçka me mençuri dhe drejtësi dhe ne s'jemi më të pakënaqur dhe dyshues, por të përulemi përpara Tij me respekt dhe nënshtrim. Ai do të nxjerrë në dritë atë pjesë të qëllimeve të Tij që është mirë që ne ta njohim, më pas, ne duhet t'i besojmë Dorës së plotfuqishme dhe zemrës, që ushqen vetëm dashuri.

Edhe pse Perëndia na ka dhënë prova pafund besimi, Ai nuk do t'i fshijë të gjitha shkaqet e mosbesimit. Ata që kërkojnë grepa për të varur dyshimet e tyre, do t'i gjejnë ato. Ndërsa ata, që nuk pranojnë t'i binden dhe ta pranojnë fjalën e Perëndisë edhe pse çdo kundërshtim është hedhur poshtë dhe çdo dyshim është fshirë, do të mbeten në errësirë.

Mosbesimi tek Perëndia është fryt i natyrshëm i një zemre mëkatare, që është në armiqësi me Të. Besimi frymëzohet nga Fryma e Shenjtë dhe lulëzon vetëm atëherë kur fara e mbjellë bie në tokë të mirë. Askush nuk mund të forcohet në besim pa u përpjekur me vendosmëri. Mosbesimi fuqizohet sa herë që gjen mbështetje inkurajuese dhe në qoftë se njerëzit i lejojnë vetes që të dyshojnë dhe të ankohen vazhdimisht për hiçgjë në vend që të kapen fort pas provave që Perëndia u ka dhënë në mbrojtje të besimit të tyre ata do të vënë re se dyshimet e tyre do të përforcohen vazhdimisht.

Por ata që dyshojnë tek premtimet e Zotit dhe nuk i besojnë fjalës së Tij në lidhje me mëshirën dhe hirin, që Ai u ka falur, e çnderojnë Atë dhe ata në vend që t'i tërheqin të tjerët tek Krishti, ndikojnë negativisht, duke i larguar prej Tij. Ata u ngjajnë pemëve pa fruta, që me degët e tyre të gjata e të errëta nuk e lejojnë dritën e diellit të depërtojë tek bimët e tjera, duke i bërë ato të fishken dhe të thahen nën veprimtarinë e ngricës. Jeta e këtyre njerëzve, që nga fillimi deri në fund, do të jetë një dëshmi e pamohueshme kundër tyre. Ata po mbjellin fara dyshimi dhe skepticizmi, që nuk do të japin të korra të mbara.

Për ata që me të vërtetë dëshirojnë të çlirohen nga dyshimet ka vetëm një rrugë; në vend që të bëjnë pyetje dhe të ankohen për gjërat që nuk i kuptojnë, le t'i kushtojnë vëmendje dritës, që tashmë e kanë përpara tyre dhe, duke bërë këtë do t'u falet një dritë akoma dhe më e madhe. Le të kryejnë çdo detyrë që është e qartë për ta dhe më pas do të jenë në gjendje që të kuptojnë edhe përgjegjësitë, që dikur u ngjallnin dyshim dhe frikë.

Satani mund të krijojë një kopje të fallsifikuar kaq të ngjashme me të vërtetën saqë mund t'i mashtrojë të gjithë ata që duan të mashtrohen, ata që dëshirojnë t'i largohen vetëmohimit dhe sakrificës që mbart në vetvete e vërteta, por ai e ka të pamundur që të kontrollojë qoftë edhe një njeri të vetëm, që dëshiron me çdo kusht, ta njohë të vërtetën. Krishti është e vërteta dhe "Drita, që ndriçon çdo njeri që vjen në botë" *(Gjoni 1:3)*. Njerëzve u është dërguar Fryma e së vërtetës, që t'i udhëheqë

drejt vërtetësisë. Dhe përsa i përket autoritetit të Birit të Perëndisë thuhet: "Lypni dhe do t'u jepet" "Në qoftë se dikush do të bëjë vullnetin e Tij, do ta njohë nëse doktrina vjen nga Perëndia" *(Mateu 7:7)*; *(Gjoni7:17)*.

Pasuesit e Krishtit nuk dinë shumë për komplotet që Satani dhe agjentët e tij po thurin kundër tyre. Por Ai që ulet mbi fronin qiellor do t'i vërë kufi këtyre planeve keqdashëse për të përmbushur qëllimet e Tij mirëdashëse. Zoti lejon që populli i Tij të ballafaqohet me provat e vështira të tundimit, jo sepse i pëlqen t'i shohë të brengosur e të mërzitur, por sepse ky proçes, është pjesë themelore e fitores së tyre përfundimtare. Ai nuk mund t'i mbrojë ata vazhdimisht me lavdinë e Tij nga tundimi, sepse qëllimi i kësaj prove është që t'i përgatisë ata të përballojnë ngasjet e mëkatit.

Në qoftë se njerëzit do t'i rrëfejnë mëkatet e tyre me zemër të penduar e të përulur dhe do të bëhen pjesë e premtimeve të Tij përmes besimit që ushqejnë, as njerëzit dhe as djalli s'mund ta fshehin punën e Perëndisë apo ta fshijnë praninë e Tij prej tyre. Çdo tundimi, çdo ndikimi negativ të hapur apo të fshehur, mund t'i bëhet ballë me sukses "jo me anë të fuqisë, as me anë të forcës, por me anë të Shpirtit Tim, thotë Zoti i ushtrive" *(Zakaria 4:6)*

"Sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e Tij janë në lutjet e tyre..." *(1 Pjetrit 3:12,13)*. Kur Balaami, i joshur nga premtimi i një shpërblimi të majmë, bëri magji kundër Izraelit dhe u përpoq që nëpërmjet flijimeve që i ofroi Zotit të ndillte një mallkim mbi popullin e Tij, Fryma e Perëndisë ia preu rrugën të keqes që ai donte të krijonte dhe Balaami u detyrua të thoshte: "Si mund të mallkoj atë që Zoti nuk e ka mallkuar? Si mund të padis atë që Zoti nuk e ka paditur?" "Vdeksha unë si njerëzit e drejtë dhe qoftë fundi im i njëllojtë me atë të tyren!" Kur u afrua një flijim tjetër, profeti i padenjë deklaroi: "Ja, unë mora urdhërin që të bekoj, po, ai ka bekuar dhe unë nuk mund ta heq bekimin e tij. Ai nuk ka vërejtur paudhësi tek Jakobi dhe nuk ka parë përdhosje tek Izraeli. Zoti, Perëndia i tij, është me të dhe klithma e një mbreti është mes tyre." "Nuk ka magji kundër Jakobit, nuk ka shortari kundër Izraelit. Tani duhet të themi ç'ka bërë Perëndia me Jakobin dhe Izraelin!" Me t'u ngritur altari i tretë, Balaami u përpoq sërish që të shtinte në dorë një mallkim. Por përmes gojës së profetit, Fryma e Perëndisë shpalli prosperitetin e njerëzve të Tij të zgjedhur dhe qortoi ashpër keqdashjen dhe marrëzinë e armiqve të tyre: "qoftë i bekuar ai që të bekon dhe qoftë i mallkuar ai që të mallkon!" (Numrat 23:8,10,20,21,23; 24:9

Gjatë asaj kohe, izraelitët ishin besnikë ndaj Perëndisë dhe për aq kohë sa ata vazhduan t'i bindeshin ligjit të Tij, s'kishte asnjë forcë në tokë a në ferr që të mund t'i gjunjëzonte.

Por Balaami arriti t'i mallkonte ata vetë, duke i joshur drejt "kënaqësive" të mëkatit. Me të shkelur urdhëresat e Perëndisë, ata u larguan prej tij dhe ndjenë mbi supe barrën e rëndë të fuqisë së shkatërruesit.

Satani e di mirë se edhe njeriu më i dobët që i qëndron besnik Krishtit, është më i fortë se ushtria e tij e errësirës dhe se ai nuk ka asnjë mundësi fitoreje po të shfaqet haptazi. Prandaj përpiqet që t'i largojë ushtarët e kryqit nga fortifikata e tyre e qëndrueshme, ndërsa ai bashkë me forcat e tij qëndrojnë në pritë, të gatshëm për të rrënuar këdo, që guxon të hyjë në territorin e tij. Ne jemi të sigurt vetëm kur i qëndrojmë besnikë Perëndisë dhe i bindemi urdhëresave të Tij.

Askush nuk gjen qetësi dhe siguri pa u lutur çdo ditë e çdo orë. Ne duhet t'i lutemi Zotit që të na falë veçanërisht mençuri për të kuptuar fjalën e Tij. Këtu (në Bibël) zbulohen kurthet e tunduesit dhe armët me të cilat mund t'i bëjmë ballë atij me sukses. Satani është ekspert në citimin e Shkrimit të Shenjtë dhe shpreson që të na pengojë, duke i veshur pasazhet hyjnore me interpretimin e vet. Ne duhet ta studiojmë Biblën zemërpërulur, duke pasur gjithmonë në mendje faktin që ne jemi të lidhur me Perëndinë. Ndërsa nga njëra anë duhet t'i ruhemi vazhdimisht kurtheve të Satanit, nga ana tjetër duhet të lutemi gjithmonë me besim: "O Atë, mos lejo të biem në tundim."

1. Një nga kurthet e Satanit është që të "pushtojë mendjen" me shpërqëndrime. Çfarë shpërqëndrime ju mbajnë larg nga përkushtimi ndaj studimeve biblike dhe lutjes?

2. Qëllimet e Satanit janë që ne të mendojmë se ajo çka ne besojmë "nuk ka asnjë pasojë". Si e reflekton këtë mashtrim të kundërshtarit, sot, mendimi post-modernist?

3. Ndërsa Perëndia na jep evidence për të besuar mjaftueshëm, Ai nuk na i heq plotësisht shkaqet për dyshime. Cila është rrënja e dyshimit? A mund ta përjetojmë ne punën e Frymës së Shenjtë në jetët tona, edhe nëse nuk mund ti japim përgjigje apo shpjegim çdo pyetjeje?

4. Asnjëra nga kurthet e Satanit nuk mund ta pengojë prezencën e Perëndisë nga njerëzit e Tij. Mbani mend premtimin e mëposhtëm: "Çdo tundim, çdo influencë kundërshtuese, qoftë e hapur apo sekrete, mund të rezistohet" "Jo nga fuqia dhe as nga forca, por nga Fryma ime, thotë Zoti i ushtrive" (Zakaria 4:6).

33.

Mashtrimi i Parë i Madh

Satani u përpoq që ta mashtronte racën njerëzore që në fillim të kohës. Ai që kishte nxitur rebelim në qiell dëshironte që banorët e tokës të bëheshin aleatë të tij në luftën kundër qeverisjes së Perëndisë. Adami dhe Eva ishin më se të lumtur aq kohë sa iu bindën ligjit të Zotit dhe ky fakt dëshmonte kundër pretendimit absurd që Satani shprehu ndërsa ishte në qiell, sipas të cilit ligji i Perëndisë i shtypte dhe cënonte lumturinë e krijesave të Tij. E për më tepër, Satani u bë më cmirëzi kur pa shtëpinë e mrekullueshme që ishte bërë gati për çiftin e pafajshëm. Ai vendosi që t'i rrënonte ata në mënyrë që, duke i larguar ata nga Perëndia dhe duke i vënë nën kontroll, të shtinte në dorë tokën dhe të vendoste atje mbretërinë e tij në kundërshtim me të Plotfuqishmin.

Sikur Satani t'u kishte zbuluar Adamit dhe Evës karakterin e tij të vërtetë, ata do ta kishin hedhur poshtë menjëherë kërkesën e tij, sepse ishin paralajmëruar për ekzistencën e këtij armiku të rrezikshëm, por ai punoi në errësirë, duke e fshehur qëllimin e tij të vërtetë, që të arrinte me sukses objektivin e vet. Duke përdorur si mjet të vetin gjarpërin, që në atë kohë ishte një krijesë që ngjallte interes, iu drejtua Evës me fjalët: "A ka thënë me të vërtetë Perëndia: Mos hani nga të gjitha pemët e kopshtit?" *(Zanafilla 3:1)*. Sikur Eva të mos kishte filluar të diskutonte me tunduesin ajo do të ishte e sigurt, por ajo mori guximin që të bisedonte me të dhe u kthye kështu në viktimë të trukeve të tij. Shumë njerëz vazhdojnë të mashtrohen në të njëjtën mënyrë. Ata i vënë në dyshim urdhërimet e Perëndisë dhe në vend që t'i binden kërkesave hyjnore, pranojnë teoritë njerëzore që s'janë asgjë tjetër veçse veshje të jashtme të mashtrimeve satanike.

"Dhe gruaja iu përgjigj gjarprit: Nga frytet e pemëve të kopshtit mund të hamë, por nga fryti i pemës që është në mes të kopshtit Perëndia ka thënë: Mos hani dhe mos e prekni, ndryshe do të vdisni." Atëherë gjarpri i tha gruas: "Ju s'keni për të vdekur aspak, por Perëndia e di që ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe

do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen.*" (Versat 2-5)*. Ai deklaroi pra, se ata do të bëheshin si Perëndia, më të mençur se më parë dhe do të lartësoheshin drejt një forme më të ndritur ekzistence. Eva iu dorëzua tundimit dhe Adami falë ndikimit të saj i hyri gjithashtu rrugës së mëkatit. Ata i pranuan si të vërteta fjalët e gjarprit, sipas të cilave Perëndia nuk i kishte me gjithë mend ato që u kishte thënë, ata nuk patën besim tek Krijuesi i tyre dhe menduan se në një farë mënyre Ai e kishte cënuar lirinë e tyre dhe se, duke shkelur ligjin e tij ata do të lartësoheshin dhe do të fitonin më shumë mençuri.

Menjëherë pas mëkatit të tij Adami e gjeti domethënien e fjalëve "të gjarprit". Cili ishte kuptimi i vërtetë i fjalisë "Ju s'keni për të vdekur aspak?" A përputhej kuptimi i tyre me fjalët e satanit që tha se ata do të përjetonin një formë më të lartë ekzistence? Ata mund të "përfitonin" shumë nga shkelja e ligjit dhe Satani do të quhej bamirësi i madh. Por Adami e kuptoi se kjo nuk ishte domethënia e saktë e fjalisë hyjnore. Perëndia deklaroi se si dënim për mëkatin që kryen ata duhet të riktheheshin atje nga kishin ardhur, në tokë.

"Do të rikthehesh në dhe, sepse nga ai ke ardhur" *(Versa 19)*. Kuptimi i vetëm i fjalëve të Satanit "Sytë tuaj do të hapen" ishte ky: Sytë e Adamit dhe të Evës u hapën që ata të shihnin marrëzinë e tyre, ata njohën mëkatin dhe provuan shijen e hidhur të frytit të shkeljes së ligjit dhe mosbindjes ndaj Perëndisë.

Në mes të kopshtit të Edenit rritej pema e jetës, frytet e të cilës kishin fuqinë e jetës së përjetshme. Sikur Adami t'i kishte qëndruar besnik Perëndisë, ai do të kishte vazhduar të gëzonte të drejtën për të shijuar frytet e kësaj peme dhe do të kishte jetuar përjetësisht. Por me të mëkatuar, atij iu hoq e drejta e pjesëmarrjes në prodhimtarinë e pemës së jetës dhe ai u kthye në viktimë të vdekjes. Fjalia hyjnore, "Do të rikthehesh në dhe, sepse nga ai ke ardhur", tregon shuarjen e plotë të jetës". Shkelja, mosbindja e hodhi poshtë premtimin për pavdekësi që iu bë njerëzve me kusht që ata të tregoheshin të bindur. Adami nuk mund t'u jepte brezave pasardhës diçka që nuk e kishte të vetën; edhe për racën mëkatare nuk do të kishte asnjë shpresë, sikur Perëndia të mos iu dhuronte përsëri pavdekësinë përmes flijimit të Birit të Vet. Ndërsa "vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan", Krishti "nxori në dritë jetën dhe pavdekësinë me anë të ungjillit." (*Romakët 5:12; 2 Timoteu 1:10)*. Pavdekësia mund të fitohet vetëm përmes Krishtit. Jezusi tha: "Kush beson në Birin ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet Birit nuk do të shohë jetë." *(Gjoni 3:36)*. Çdo njeri që i përmbush këto kushte, mund ta fitojë këtë bekim të çmuar. Të gjithë ata që "kërkojnë lavdi, nder e pavdekësi, duke ngulmuar në veprat e mira", do të marrin "jetë të përjetshme" *(Romakët 2:7)*.

Vetëm mashtruesi i premtoi Adamit jetë të përjetshme edhe përmes mosbindjes. Deklarata që gjarpri i bëri Evës në Eden: "Ju s'keni për të vdekur aspak" -ishte shërbesa e parë që është predikuar ndonjëherë mbi pavdekësinë e shpirtit. Megjithëse

kjo deklaratë mban firmën e vet Satanit, vazhdon të përsëritet nga podiumet e kishave të Krishtera dhe të pranohet nga pjesa më e madhe e njerëzve me po atë lehtësi, sa u pranuan edhe nga prindërit tanë të parë. Pra fjalisë së Shkrimit të Shenjtë, "Shpirti që mëkaton do të vdesë" *(Ezekieli 18:20)* i është dhënë një kuptim i ri "shpirti që mëkaton nuk do të vdesë, por do të jetojë përjetësisht". Kështu nuk na mbetet asgjë tjetër veçse të çuditemi me budallallëkun, që i bëri njerëzit të besojnë tek fjalët e Satanit dhe të mos i përfillin fjalët e Zotit.

Sikur njeriut dhe pas dështimit të tij t'i lejohej ngrënia e frutave të pemës së jetës, ai do të kishte jetuar përgjithmonë dhe rrjedhimisht mëkati do të përjetësohej. Por kerubinët me shpatën flakëruese "ruajtën rrugën e pemës së jetës" *(Zanafilla 3:24)*, duke mos lejuar asnjë anëtar të familjes së Adamit që ta kapërcente këtë pengesë dhe të shtinte në dorë frytin jetëdhënës. Prandaj të gjithë mëkatarët i pret vdekja.

Por Satani menjëherë pas dështimit të njerëzve i urdhëroi engjëjt e tij që të bënin ç'ishte e mundur për të përhapur idenë se njeriu ishte nga natyra i pavdekshëm; dhe pasi t'i drejtonte njerëzit në këtë rrugë të gabuar, ata (engjëjt mëkatarë) do t'i nxisin më tej drejt konkluzionit shkatërrimtar se mëkatari është i dënuar të jetojë në mjerim të përjetshëm. Kështu princi i errësirës, duke punuar përmes agjentëve të tij e paraqet Perëndinë si një tiran hakmarrës, duke deklaruar se ai i flak në ferr, duke i bërë që të ndiejnë mallkimin e tij të gjithë ata, që nuk i pëlqejnë; e për më tepër, ndërsa ata përpëliten dhe vuajnë nga dhembjet dhe ankthi i flakëve në përjetësi, Krijuesi i tyre i shikon i kënaqur nga froni i vet.

Pra, djalli e vesh Krijuesin dhe Mirëbërësin e njerëzimit me tiparet e veta. Mizoria është satanike. Perëndia është dashuri; gjithçka e krijuar nga dora e tij ishte e pastër, e shenjtë dhe e bukur deri sa Kryerebeli "na dhuroi mëkatin". Vetë Satani është armiku, që i tundon njerëzit drejt mëkatit e më pas i shkatërron përfundimisht dhe, me t'u siguruar se viktimën e ka në dorë ai ngazëllehet triumfues mbi rrënjët e punës së tij. Sikur të kishte mundësi ai do të përfshinte në rrjetën e tij të gjithë racën njerëzore. Pa ndërhyrjen dhe fuqinë hyjnore të gjithë bijtë dhe bijat e Adamit do të ishin të humbur, përjetësisht të humbur.

Satani përpiqet të mashtrojë njerëzit sot, ashtu siç mashtroi prindërit tanë të parë, duke lëkundur besimin e tyre tek Krijuesi, duke i bërë të dyshojnë tek zgjuarsia e Qeverisjes dhe drejtësia e ligjeve të tij. Në mënyrë që të justifikojnë keqdashjen dhe rebelimin e tyre Satani dhe "misionarët" e tij e paraqesin Zotin më të keq se ata vetë. Kryemashtruesi përpiqet që ta veshë Atin tonë qiellor me karakterin dhe mizorinë e tij të paskajshme në mënyrë që ai me dëbimin e tij nga qielli, të luajë rolin e viktimës që s'mund t'i nënshtrohej një Qeveritari të tillë të padrejtë. Ai i shpalos botës lirinë që mund të gëzojë nën sundimin e tij të paanshëm, duke e krahasuar atë me zgjedhën që mbartin në vetvete dekretet e ngurta të Jehovait. Në këtë mënyrë ai i bind njerëzit që të heqin dorë nga besnikëria ndaj Perëndisë.

Sa e papranueshme është për çdo zemër të mbushur me dashuri e dëshirë, për çdo shpirt që ushqen ndjenjën e drejtësisë, doktrina sipas së cilës të vdekurit mëkatarë torturohen me zjarr dhe squfur në një ferr të ndezur përjetësisht, e ju duhet të vuajnë për mëkatet e një jete të shkurtër tokësore aq gjatë sa do të jetojë Perëndia. Megjithatë kjo doktrinë është përhapur shumë dhe përbën një nga besimet e pjesës më të madhe të të krishterëve. Një doktor i ditur teologjie ka thënë: "Vuajtjet e ferrit do t'i japin një ngjyrë të re lumturisë së shenjtorëve. Kur këta të fundit të shikojnë se si të tjerët, që kanë lindur në të njëjtat rrethana dhe kanë të njëjtën natyrë janë zhytur në një mjerim të tillë, ata do të bëhen të ndërgjegjshëm për lumturinë e tyre". Një tjetër përdor këto fjalë: "Ndërsa dekreti i mosaprovimit zbatohet përjetësisht mbi nenet e zemërimit, tymi i vuajtjeve të tyre do të ngjitet përjetësisht përpara neneve të mëshirës, që në vend që t'i përkrahin ato qënie të mjerueshme do të thonë: "Amen! Haleluja! Lëvduar qoftë Zoti!

Në cilat faqe të fjalës së Perëndisë gjendet një mësim i tillë? Do t'i humbin vallë shenjtorët në qiell të gjitha ndjenjat e keqardhjes dhe mëshirës e madje edhe idenë e humanizmit të zakonshëm? A do të shndërrohen këto në moskokëçarjen e njeriut stoik dhe në mizorinë e njeriut të egër? Jo, jo; në librin e Perëndisë nuk gjendet një mësim i tillë. Ata që na prezantojnë pikëpamje si këto që cituam më lart mund të jenë njerëz të ditur e madje edhe të ndershëm, por janë viktima të mashtrimit të sofistikuar të Satanit. Ai i bën ata që t'i keqinterpretojnë disa shprehje Biblike, duke i dhënë atyre ngjyrën e keqdashjes dhe egërsisë, që janë tipike për të, por të huaja për krijuesin tonë. "Ashtu siç është e vërtetë që unë jetoj", thotë Zoti Perëndi, "unë nuk kënaqem me vdekjen e të pabesit, por që i pabesi të ndryshojë rrugën e tij dhe të jetojë; konvertohuni, konvertohuni nga rrugët tuaja të këqija. Pse vallë duhet të vdisni?" *(Ezekieli 33:11).*

Çfarë do të mendohej për Perëndinë, sikur ne të pranonim që Ai kënaqet kur sheh me sy tortura pa fund, se ngazëllehet nga britmat dhe mallkimet e krijesave të shumëvuajtura që ai i ka dënuar në flakët e ferrit? A mund të jenë këta tinguj të tmerrshëm nota muzike për veshët e dashurisë pafund? Thuhet se Perëndia i dënon njerëzit mëkatarë përjetësisht, për të treguar urrejtjen që ushqen për mëkatin, që është shkatërrimtar, për paqen dhe rregullin e universit. Çfarë blasfemie e ndyrë! Sikur urrejtja e Zotit për mëkatin të jetë arsyeja e përjetësimit të tij! Sepse sipas mësimeve të këtyre teologëve, tortura e vazhdueshme pa shpresë mëshire i verbon këto viktima fatkeqe dhe ata e shprehin zemërimin e tyre në mallkim dhe blasfemi, duke shtuar kështu përjetësisht fajin e tyre. Mendja njerëzore nuk mund ta kuptojë të keqen që mbart në vetvete herezia e vuajtjes së përjetshme.

Besimi i Biblës, besimi i dashurisë, mirësisë, dhe i dhembshurisë errësohet nga supersticionet dhe vishet me tmerr. Kur shohim se me çfarë ngjyrash të rreme e pikturon Satani karakterin e Perëndisë, a mund të çuditemi nga fakti që njerëzit e

kanë frikë, madje dhe e urrejnë Krijuesin tonë mëshirëplotë? Pikëpamjet e frikshme rreth Zotit, pikëpamje që nga podiumet kishëtare janë përhapur nëpër botë i kanë kthyer në skeptikë dhe jobesimtarë me mijëra, po, me miliona njerëz.

Teoria e vuajtjes së përjetshme është një nga doktrinat e rreme që formojnë verën e fortë të zemërimit të Babilonisë, nga e cila do të pijnë të gjithë kombet. *(Zbulesa 14:8; 17:2)*

Fakti që ministrat e Krishtit e kanë pranuar këtë herezi dhe e shpallin atë si të vërtetë nga podiumet e shenjtë është me të vërtetë një mister. Ata e morën atë ashtu siç morën edhe Sabatin e rremë, nga Roma. E vërtetë është, njerëz të mirë e të mëdhenj e kanë përqafuar këtë ide, por drita e një subjekti të tillë ka ardhur në ditët tona më e plotë. Ata ishin përgjegjës vetëm për dritën që u zbulua në kohën e tyre, për rrezet e reja të kohës sonë përgjegjësia bie mbi ne. Në qoftë se i kthejmë krahët dëshmisë së fjalës së Perëndisë dhe pranojmë doktrina të rreme vetëm sepse na i mësuan baballarët tanë, mbi ne do të bjerë dënimi që iu dha Babilonisë; ne do të pijmë verën e fortë të pabesisë së saj.

Një grup i madh njerëzish që nuk e pranojnë doktrinën e vuajtjes së përjetshme përqafojnë gabimin e kundërt. Ata e kuptojnë se Shkrimet e Shenjta e paraqesin Perëndinë si një qënie dashurie dhe mëshire dhe nuk mund ta besojnë se ai do t'i dorëzojë krijesat e Veta në flakët e përjetshme të ferrit. Kështu, duke mbështetur tezën se shpirti është i pavdekshëm ata arrijnë në konkluzionin "e vetëm" se i gjithë njerëzimi do të shpëtojë një ditë. Shumë njerëz janë të mendimit se kërcënimet dhe paralajmërimet Biblike synojnë t'i shtyjnë njerëzit drejt bindjes, duke i frikësuar ata, por nuk do të bëhen realitet ndonjëherë. Pra, mëkatari mund t'ia bëjë qejfin vetes, duke i shkelur me këmbë urdhëresat e Perëndisë e megjithatë të presë në fund një shpërblim dashamirësie. Një doktrinë e tillë, që "ngre lart" mëshirën e Zotit, por që nuk e përfill drejtësinë e Tij, i shkon pas shtatit dëshirave të një zemre njerëzore dhe e inkurajon njeriun mëkatar drejt paudhësive të tjera.

Që të tregojmë se si njerëzit, që besojnë tek shpëtimi mbarëbotëror i shtrembërojnë Shkrimet e Shenjta në mbështetje të dogmave të tyre shkatërruese, na duhet të citojmë thëniet e tyre. Gjatë varrimit të një të riu të pafe, që kishte gjetur vdekjen në një aksident, një pastor universialist zgjodhi si tekst referimi thënien që gjendet në Shkrimin e Shenjtë dhe lidhet me Davidin: "Ishte ngushëlluar tashmë nga vdekja e Amnonit" *(2 Samuelit 13:39)*.

"Shpesh më pyesin, - tha folësi, - se ç'i pret ata që largohen nga kjo botë të zhytyr në mëkat, që vdesin ndoshta të dehur, që vdesin me njollat e kuqe të krimit mbi petkat e tyre apo që vdesin siç vdiq ky djalë i ri, pa pasur asnjë përjetim besimi, pa pranuar të vërtetën e madhe. Ne i drejtohemi Shkrimeve të Shenjta; përgjigjja e tyre i jep zgjidhje këtij problemi të vështirë. Amnoni ishte një njeri mëkatar, s'pendohej kurrë derisa një ditë e dehën dhe e vranë, ashtu, të dehur. Davidi ishte profet i Zotit,

ai duhet ta dinte nëse Amnoni do të gjendej mirë në botën tjetër. Çfarë tha ai? "Mbreti David dëshironte të shkonte te Absalomi, sepse ishte ngushëlluar tanimë nga vdekja e Amnonit" *(versa 39)*.

"Çfarë përfundimi nxjerrim nga një thënie e tillë? A nuk arrijmë vallë në konkluzionin se vuajtjet e përjetshme nuk ishin pjesë e besimit të tij fetar? Ky është i vetmi konkluzion, dhe këtu zbulojmë një provë triumfuese në mbështetje të hipotezës më të këndshme dhe më mëshirëplote, asaj të pastërtisë dhe paqes së pacënueshme mbarëbotërore. Ai ishte ngushëlluar nga vdekja e birit të tij. Pse vallë? Sepse me syrin e profecisë ai mund të depërtonte në të ardhmen e lavdishme dhe të shihte birin e vet larg tundimeve, të çliruar nga zgjedha dhe të pastruar nga kalbëzimi i mëkatit për t'u pranuar, pasi të kthehej në shenjtor, në radhët e shpirtërave ngazëllues. Ngushëllimi i tij i vetëm ishte fakti, që duke u larguar nga gjendja e tanishme e mëkatit dhe vuajtjes, biri i tij i dashur ishte ngjitur në atë vend, ku shpirti i tij i errët do të ndriçohej nga frymëmarrja e plotë e Frymës së Shenjtë, ku mendja e tij do të rrokte mençurinë qiellore dhe dashurinë pafund, duke u përgatitur kështu për të shijuar, falë kësaj natyre të shenjtëruar, pushimin dhe shoqërinë e qiellit.

"Nga kjo ne kuptojmë se shpëtimi qiellor nuk varet aspak as nga qëndrimi ynë në këtë jetë, as nga ndryshimi që përjetojmë në zemër, as nga besimi i tanishëm dhe as nga ndjekja e mundshme e një feje të caktuar".

Kështu i ashtuquajturi pastor i Krishtit përsërit gënjeshtrën që e shqiptoi i pari gjarpri në kopshtin e Edenit: "Ju s'keni për të vdekur aspak". "Ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jenë si Perëndia". Ai deklaron se mëkatarët më të këqinj - vrasësi - hajduti, tradhëtari - do të bëhen gati që pas vdekjes të bëhen pjesë e lumturisë së përjetshme.

Nga i nxjerr këto konkluzione ky shtrembërues i Shkrimeve të Shenjta? Nga një fjali e vetme që shpreh përuljen e Davidit ndaj vullnetit të Perëndisë. Me shpirt "ai dëshironte të shkonte te Absalomi, sepse ishte ngushëlluar tanimë nga vdekja e Amnonit". Therja e plagës së trishtimit ishte zbutur me kalimin e kohës, mendimet tashmë përqëndroheshin tek djali i gjallë, duke u larguar gradualisht nga biri i vdekur dhe ai kishte filluar ta harronte frikën që i shkaktonte dënimi më se i drejtë i krimit të tij. E kjo na qenka prova që Amnoni i dehur dhe gjaknxehtë menjëherë pas vdekjes na paska shkuar në shtëpinë e lumturisë pafund për t'u pastruar shpirtërisht dhe për t'u përgatitur për të shijuar shoqërinë e engjëjve të pamëkatë! Me të vërtetë një përrallë e këndshme kjo, që i realizon kaq mirë dëshirat e zemrës njerëzore! Kjo është doktrinë satanike dhe e kryen punën e vet me sukses të plotë. A duhet të çuditemi që me udhëzime të kësaj natyre e keqja sa vjen e shtohet?

Rruga që ndjek ky mësues - mashtrues shërben si shembull për të treguar rrugët që ndjekin me qindra të tjerë. Disa fjalë të Shkrimeve të Shenjta shkëputen nga konteksti, që në pjesën më të madhe të rasteve është i veshur me një kuptim krejtë-

sisht të kundërt nga ai i pari dhe këtyre pasazheve të shkëputura u mohohet kuptimi i mirëfilltë dhe përdoren si prova në mbështetje të disa doktrinave të caktuara, që nuk bazohen aspak te fjala e Perëndisë. Dëshmia që sillet si provë e faktit që Amnoni i dehur është në qiell është një konkluzion që hidhet poshtë nga thëniet e qarta të Shkrimeve të Shenjta sipas të cilave asnjë pijanec nuk do ta trashëgojë mbretërinë e Perëndisë. *(1 Korintasve 6:10)*

Pikërisht kështu e kthejnë të vërtetën në gënjeshtër njerëzit e pabesë, skeptikë dhe jo besimtarë. Teoria e tyre ka mashtruar dhe ka vënë në gjumë në djepin e sigurisë së rreme me mijëra e mijëra njerëz.

Sikur të jetë e vërtetë që shpirtrat e të gjithë njerëzve pa përjashtim shkojnë drejt e në parajsë në momentin e vdekjes, atëherë më mirë të lakmojmë vdekjen sesa jetën. Shumë njerëz, të shtyrë nga një besim i tillë, i kanë dhënë fund jetës me duart e veta. Kur dikush është i trishtuar, i çorientuar dhe i zhgënjyer është shumë e lehtë që ta presë fillin e hollë të jetës për të fluturuar drejt haresë së botës së përjetshme.

Perëndia na ka dhënë në fjalën e Tij prova vendimtare që Ai do t'i dënojë të gjithë ata që e shkelin ligjin e Tij. Ata që i bëjnë qefin vetes, duke menduar se Ai është tepër i mëshirshëm për të ushtruar drejtësi mbi mëkatarin, duhet të kujtohen për kryqin e Kalvarit. Vdekja e Birit të panjollosur të Perëndisë dëshmon se "mëkati ka pagën e vet: vdekjen" dhe se çdo shkelje e ligjit të Perëndisë duhet shpaguar. Krishti i pafajshëm u kthye në mëkat për njerëzit. Ai mbajti mbi supe fajin e shkeljes dhe s'mundi ta shihte më fytyrën e Atit të Tij derisa iu thye zemra dhe vdiq. Ai sakrifikoi dhe u flijua, që mëkatarët të shpëtonin. Kjo ishte e vetmja mënyrë shpëtimi ndaj dënimit të mëkatit për njerëzimin. Dhe çdo njeri që nuk pranon të marrë pjesë në shlyerjen me një çmim të tillë, duhet ta mbajë mbi supet e veta peshën e fajit dhe dënimit që sjell shkelja e ligjit.

Le të shikojmë se ç'na mëson më tej Bibla për njerëzit mëkatarë dhe të pabindur që ai universialisti i vendos në parajsë bashkë me engjëjt e shenjtë.

"Atij që ka etje unë do t'i jap si dhuratë nga burimi i ujit të jetës" *(Zbulesa 21:6)*. Ky premtim i drejtohet vetëm atyre që kanë etje. Vetem ata që ndiejnë nevojën e ujit të jetës dhe e kërkojnë atë, duke harruar gjithçka tjetër, do ta shuajnë etjen. "Kush fiton do t'i trashëgojë të gjitha gjërat dhe do të jem për të Perëndi dhe ai do të jetë për mua bir" *(versa 7)*. Edhe këtu kushtet janë të qarta. Në mënyrë që të bëhemi trashëgimtarë të gjithçkaje ne duhet t'i bëjmë ballë dhe të fitojmë mbi mëkatin.

Përmes profetit Isaja, Zoti deklaron: "I thoni të drejtit se do t'i dalë mirë. Mjerë i pabesi! Do t'i bjerë mbi kokë fatkeqësia, sepse do t'i jepet ajo që duart e tij kanë përgatitur" *(Isaja 3:10,11)*. "Edhe në qoftë se mëkatari bën njëqind herë të keqen - thotë njeriu i urtë - dhe i zgjaten ditët e tij, unë e di që të mirën do ta kenë ata që kanë frikë nga Perëndia, që kanë frikë përpara Tij." *(Predikuesi 8:12,13)*. Ndërsa Pali dëshmon se mëkatari po mbledh rreth vetes "zemërim për ditën e zemërimit dhe të

zbulesës së gjykimit të drejtë të Perëndisë, që do ta shpaguajë secilin sipas veprave të tij;" "mundim dhe ankth mbi çdo shpirt njeriu që bën të ligën" - Romakët 2:5,6,9.

"Asnjë nga imoralët, kopracët apo të ndyrët, të cilët janë idhujtarë nuk kanë ndonjë trashëgim në mbretërinë e Krishtit dhe të Perëndisë" *(Efesianët 5;5)*. "Kërkoni paqe me të gjithë dhe shenjtërim, pa të cilin askush nuk ka për të parë Perëndinë" *(Hebrenjtë 12:14)*. "Lum ata që i kryejnë urdhërimet e Tij, që të kenë të drejtën për drurin e jetës dhe për të hyrë në portat e qytetit. Jashtë janë qentë, magjistarët, imoralët, vrasësit, idhujtarët dhe kushdo që do dhe zbaton gënjeshtrën" *(Zbulesa 22:14,15)*. Perëndia i ka dorëzuar njerëzimit një deklaratë të karakterit dhe mënyrës së Tij të veprimit kundër mëkatit. "Zoti, Perëndia i përjetshëm, i mëshirshëm dhe i dhembshur, i pasur në mirësi dhe në besnikëri, që përdor mëshirën për mijëra njerëz, që fal padrejtësinë, shkeljet dhe mëkatin, por nuk e lë pa ndëshkuar fajtorin." *(Eksodi 34:6,7)*. "Ai do të shkatërrojë të gjithë të pabesët". "Shkelësit do të shkatërrohen të gjithë, në fund të pabesët do të dërrmohen." *(Psalmet 145:20; 37:38)*. Qeveria hyjnore do ta përdorë fuqinë dhe autoritetin e vet për t'i dhënë fund rebelimit, megjithatë zbatimi i kësaj drejtësie do të përputhet plotësisht me karakterin e Perëndisë si qënie mirëdashëse dhe mëshirëplotë.

Perëndia i ka dhënë gjithësecilit një vullnet dhe një gjykim të lirë. Atij nuk i pëlqen aspak bindja e një skllavi. Ai dëshiron që krijesat e duarve të Tij ta duan, sepse Ai e meriton dashurinë e tyre. Ai do të donte që ata t'i bindeshin falë vlerësimit të tyre të zgjuar të mençurisë, drejtësisë dhe mirëdashjes së Tij. Të gjithë ata që i kuptojnë drejt këto cilësi do t'i falin Atij dashurinë e tyre, sepse Ai do t'i tërheqë drejt vetes, duke mbjellë në zemrat e tyre farën e adhurimit ndaj vetive të Tij të çmuara.

Parimet e mirësisë, mëshirës dhe dashurisë që u mëshiruan në figurën e Shpëtimtarit, përbëjnë një kopje të transkriptuar të vullnetit dhe karakterit të Perëndisë. Krishti deklaroi se u mësoi njerëzve vetëm ato që kishte marrë nga Ati i Tij. Parimet e qeverisjes hyjnore përputhen plotësisht me porosinë e Shpëtimtarit: "Duajini armiqtë tuaj". Perëndia zbaton drejtësinë mbi të pabesët jo vetëm për të mirën e universit mbarë, por edhe për të mirën e vetë këtyre njerëzve. Ai do t'i bënte ata të lumtur në rast se do të kishte mundësi të bënte këtë, duke iu përmbajtur ligjeve të qeverisjes së Tij dhe u ofron mëshirë, por ata e përçmojnë dashurinë, e quajnë të pavlerë ligjin dhe e hedhin poshtë mëshirën. Edhe pse marrin dhurata prej Tij vazhdimisht, ata e çnderojnë Dhuruesin, ata e urrejnë Perëndinë, sepse e dinë që Ai nuk i honeps dot mëkatet e tyre. Zoti i duron për një kohë të gjatë paudhësitë e tyre, por ora vendimtare do të vijë dhe një ditë do të vuloset edhe fati i tyre. Do t'i lidhë vallë me zinxhirë Ai këta rebelë që ata të qëndrojnë përkrah Tij? Do t'i detyrojë me forcë që të kryejnë vullnetin e Tij?

Ata që kanë zgjedhur Satanin udhëheqës dhe që janë vënë nën kontrollin e tij

nuk janë përgatitur për të qëndruar në praninë e Perëndisë. Krenaria, mashtrimi, imoraliteti, mizoria janë gdhendur tashmë në karakterin e tyre. A mund të shkojnë ata në parajsë për të jetuar përjetësisht me ata që i kanë përçmuar dhe urryer mbi tokë? Një gënjeshtar nuk ka për të rënë kurrë dakort me të vërtetën, bindja nuk do të mund ta kënaqë kurrë krenarinë dhe vetëkënaqësinë, i korruptuari s'mund ta pranojë kurrë pastërtinë, për egoistin dashuria pa interes nuk është interesante. Çfarë burimi kënaqësie mund t'i ofrojë parajsa atyre njerëzve që janë të dhënë kokë e këmbë pas interesave tokësore e egoiste?

A mund të shkojnë në parajsë sa hap e mbyll sytë ata që gjatë gjithë jetës së tyre kanë ngritur krye ndaj Perëndisë? A mund të dëshmojnë këta njerëz shkallën e lartë dhe të shenjtë të përsosmërisë, që ekziston atje - ku çdo shpirt është i mbushur me dashuri, ku çdo fytyrë rrezaton gëzim, ku për nder të Perëndisë dhe Qingjit dëgjohen melodi të mrekullueshme dhe ku fytyra e Atij që rri ulur mbi fron lëshon rreze pafund drite mbi të shpëtuarit - a mund të bëhen pjesë e turmës qiellore dhe a mund ta ngrenë zërin në këngë lavdërimi ata, zemrat e të cilëve janë mbushur me urrejtje për Perëndinë, të vërtetën dhe shenjtërinë e Tij? A mund t'i bëjnë ballë ata lavdisë së Perëndisë dhe të Qingjit? Jo, jo, atyre ju janë falur vite prove dhe stazhi, që ata të krijonin karaktere të përshtatshme parajse, por ata s'e mësuan kurrë zemrën e tyre me pastërtinë, ata nuk e mësuan kurrë gjuhën e qiellit dhe tani është tepër vonë. Rebelimi kundër Perëndisë i ka kthyer në qytetarë të papërshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë. Pastërtia, shenjtëria dhe paqja e këtij vendi do të ishte torturë për ta, lavdia e Zotit do të ishte një zjarr shkatërrues. Ata do të dëshironin me gjithë shpirt që të largoheshin me të katra nga ai vend i shenjtë. Ata do të parapëlqenin shkatërrimin që do t'i fshihte nga fytyra e Atij që vdiq për t'i shpëtuar. Të pabesët e caktojnë fatin e tyre nga zgjedhja e vet. Ata përjashtohen vullnetarisht nga qielli dhe Perëndia tregohet i drejtë dhe i mëshirshëm me ta.

Zjarret e ditës së madhe, ashtu si ujërat e Përmbytjes, tregojnë vendimin gjyqësor të Perëndisë që e keqja është e pashërueshme. Ata as nuk kanë ndërmend që t'i nënshtrohen autoritetit hyjnor. Ata e kanë shprehur vullnetin e tyre në revoltë dhe, kur jetës së tyre i ka ardhur fundi është tepër vonë për ta kthyer rrjedhën e mendimeve të tyre në drejtim të kundërt, tepër vonë për t'u kthyer nga shkeljet në bindje, nga urrejtja në dashuri.

Duke i falur jetën Kainit, vrasësit, Perëndia i dha botës një shembull të asaj, që do të ishte rezultati i dhënies mundësi një mëkatari për të vazhduar jetën, duke vazhduar në të njëjtën kohë edhe rrugën e paudhësisë pa cak. Mijëra pasardhës të Kainit, falë ndikimit të mësimeve dhe shembullit të tij, i hynë rrugës së mëkatit derisa "ligësia e njerëzve ishte e madhe mbi tokë" dhe "synimet e zemrave të tyre nuk ishin gjë tjetër veçse e keqja në çdo kohë". "Toka ishte e korruptuar përpara Perëndisë dhe plot me dhunë". *(Zanafilla 6:5,11)*.

Vetëm për të treguar mëshirë ndaj botës, Zoti i fshiu nga faqja e dheut bash-

këkohësit mëkatarë të Noes. I mëshirshëm u tregua Ai edhe kur shkatërroi banorët e Sodomit. Përkrahësit e paudhësisë, përmes fuqisë mashtruese të Satanit, fitojnë simpati dhe admirim, duke i udhëhequr kështu të tjerët drejt rebelimit. Kështu ndodhi në kohën e Kainit dhe të Noes, kështu ndodhi në kohën e Abrahamit dhe të Lotit, kështu ndodh edhe në ditët tona. Perëndia do t'i shkatërrojë përfundimisht mohuesit e hirit të Tij, për të treguar mëshirë ndaj mbarë universit.

"Paga e mëkatit është vdekja, por dhurata e Perëndisë është jeta e përjetshme në Jezu Krishtin, Zotin tonë". *(Romakët 6:23).*

Ndërsa të drejtët marrin si trashëgimi jetën, të padrejtët trashëgojnë vdekjen. Moisiu i deklaroi Izraelit; "Shiko, unë vë sot para teje jetën dhe të mirën, vdekjen dhe të keqen*" (Ligji i Përtërirë 30:15)*. Në këto versa të Shkrimit të Shenjtë nuk flitet për vdekjen që iu shpall për herë të parë Adamit, sepse të gjithë njerëzit duhet ta vuajnë dënimin e shkeljeve të tyre. Këtu i referohemi "vdekjes së dytë", që krahasohet me jetën e përjetshme.

Vdekja, si rezultat i mëkatit të Adamit, kaloi tek të gjithë njerëzit pa përjashtim. Të gjithë shkojnë në varr. Dhe të gjithë duhet të dalin një ditë nga varri falë planit të shpëtimit. "Do të ketë një ringjallje të të vdekurve, qoftë të të drejtëve, qoftë të të padrejtëve" "Sepse, ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin.*" (Veprat e Apostujve 24:15; 1 Korintasve 15:22)*. Por klasat njerëzore që do të ringjallen dallojnë nga njëra-tjetra. "Të gjithë ata që janë në varre do ta dëgjojnë zërin e Tij dhe do të dalin prej tyre; ata që kanë bërë të mira, në ringjallje të jetës, dhe ata që kanë bërë të liga, në ringjalljen e dënimit" *(Gjoni 5:28,29)*. Ata që kanë qënë "të denjë" për të fituar ringjalljen e jetës janë "të bekuar dhe të shenjtë". "Mbi ta vdekja e dytë nuk ka pushtet" *(Zbulesa 20:6)*. Por ata që nuk janë falur, sepse nuk e kanë fituar atë me anë të pendimit dhe besimit, duhet të durojnë dënimin e fajit të tyre - "pagën e mëkatit". Dënimi që ata vuajnë ndryshon në kohëzgjatje dhe intensitet "sipas veprave të tyre", por përfundimisht do të marrë fund me vdekjen e dytë. Duke qënë se Perëndia e ka të pamundur ta shpëtojë mëkatarin që nuk pendohet për mëkatet e tij, sepse Ai duhet t'i qëndrojë besnik parimeve të drejtësisë dhe mëshirës, Ai ia heq atij të drejtën e ekzistencës për të cilën ai s'e ka treguar veten të denjë. Një shkrimtar i frymëzuar nga Fryma e Shenjtë thotë: "Edhe pak dhe i pabesi nuk do të jetë më". Një tjetër deklaron: "do të jenë si të mos kenë qënë kurrë" *(Psalmet 37:10)*; *(Abdia 16)*. Të mbuluar me turp ata lihen në një harresë të përjetshme dhe të pashpresë.

Kështu do t'i jepet fund mëkatit bashkë me trishtimin dhe rrënimin që mbart ai. Psalmisti thotë: "Ke shkatërruar të pabesin, ke fshirë emrat e tyre përgjithnjë. Armiku është zhdukur, i kapur nga një pikëllim i përjetshëm!" *(Psalmet 9:5,6)*. Gjoni në librin e Zbulesës, ndërsa shikon në të ardhmen drejt përjetësisë, dëgjon një himn universal lavdërimi që nuk prishet nga asnjë notë e keqintonuar. Ai dëgjoi

të gjitha krijesat e qiellit dhe tokës se si i thurnin lavde Perëndisë. *(Zbulesa 5:13)*. Atje nuk do të ketë shpirtra të humbur që të blasfemojnë kundër Zotit, ndërsa vuajnë dhimbjet e një torture të vazhdueshme, me këngët e të shpëtuarve nuk do të përzihen britmat e qënieve të harruara të ferrit.

Gabimit themelor të pavdekshmërisë natyrore i shtohet doktrina e ndërgjegjes gjatë vdekjes. - një doktrinë, që ashtu si teoria e vuajtjes së përjetshme, bie ndesh me mësimet e Shkrimeve të Shenjta, me arsyen dhe ndjenjat tona humane. Sipas këtij besimi kaq popullor, të shpëtuarit në parajsë njihen me gjithçka që ndodh në tokë dhe dinë gjithçka për miqtë dhe të afërmit që kanë lënë pas. Po si mund të jenë të lumtur këta të vdekur kur dinë shqetësimet e njerëzve të gjallë, kur shohin me sytë e tyre mëkatet që kryejnë të dashurit e tyre, kur shohin se si i durojnë ata trishtimet, zhgënjimet dhe ankthet e jetës? Sa shumë nga lumturia qiellore do të shijonin ata që u vijnë rrotull miqve të tyre mbi tokë? Sa acarues është besimi sipas të cilit me t'u larguar fryma nga trupi, shpirti i njeriut të pabindur i dorëzohet flakëve të ferrit! Çfarë ankthi duhet të përjetojnë ata që shohin shokët e tyre t'i japin fund jetës të papërgatitur për të hyrë në një gjendje përjetësie të mbushur me mjerim dhe vuajtje! Shumë njerëz janë çmendur nga ky mendim i frikshëm.

Po Shkrimet e Shenjta çfarë na thonë në lidhje me këto çështje? Davidi deklaron se i vdekuri është i pandërgjegjshëm. "Kur fryma e tij ikën, ai kthehet përsëri në tokë dhe po atë ditë planet e tij zhduken" *(Psalmet 146:4)*. Solomoni dëshmon të njëjtën gjë: "të gjallët në fakt e dinë se kanë për të vdekur, por të vdekurit nuk dinë asgjë" "Edhe dashuria e tyre, urrejtja e tyre dhe cmira e tyre janë zhdukur tashmë dhe ata nuk do të kenë asnjë pjesë në të gjitha ato që bëhen nën diell". "Në Sheol ku po shkon nuk ka më as punë, as mendim, as njohuri dhe as dituri" *(Predikuesi 9:5,6,10)*.

Kur, në përgjigje të lutjes së tij, jeta e Ezekielit u zgjat edhe 15 vjet mbreti mirënjohës i thuri Perëndisë lavde për mëshirën e Tij. Ai përmend në këngën e tij arsyet e gëzimit që ndjen: "Varri nuk mund të të lëvdojë, vdekja nuk mund të të kremtojë, ata që zbresin në gropë nuk mund të shpresojnë më në besnikërinë tënde. I gjalli, i gjalli është ai që të lëvdon siç po bëj unë sot." *(Isaja 38:18,19)*. Teologjia e ditëve tona na thotë se të vdekurit besimtarë janë në parajsë duke shijuar harenë qiellore dhe duke e lavdëruar Perëndinë me këngë pafund, por Ezekieli nuk mundi të shquante një perspektive kaq të lavdishme në vdekje. Edhe dëshmia e psalmistit përputhet me fjalët e tij "Në vdekje nuk do të kujtoj njeri, kush do të të kremtoj në varr?" Nuk janë të vdekurit ata që lëvdojnë Zotin, as ata që zbresin në vendin e heshtjes" *(Psalmet 6:5; 115:17)* Në ditën e Rrëshajave Pjetri deklaroi se patriarku David është "i vdekur dhe i varrosur dhe varri i tij është nder deri në ditën e sotme" "Sepse Davidi nuk është ngritur në qiell." *(Veprat e Apostujve 2:29,34)*. Fakti që Davidi qëndron në varr deri në ditën e ringjalljes provon se të drejtët nuk shkojnë

në qiell në momentin e vdekjes së tyre. Vetëm nëpërmjet ringjalljes dhe faktit që Krishti u ngrit nga varri, Davidi mund të ulet në anën e djathtë të Perëndisë.

Ndërsa Pali thotë: "Në qoftë se të vdekurit nuk ringjallen, as Krishti nuk është ringjallur, por në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, i kotë është besimi juaj, ju jeni ende në mëkatet tuaja dhe ata që fjetën në Krishtin janë të humbur". *(1 Korintasve 15:16-18)*. Në qoftë se për katër mijë vjet me radhë të drejtët kanë shkuar menjëherë në parajsë në ditën e vdekjes së tyre si mund të thoshte Pali se në qoftë se nuk do të ketë ringjallje "ata që fjetën në Krishtin janë të humbur?" Ringjallja e ditës së fundit nuk do të ishte e nevojshme.

Martiri Tyndal, duke iu referuar gjendjes së të vdekurit, deklaroi: "E pranoj haptazi që nuk më bind ideja që ata janë tashmë pjesë e lavdisë së plotë që gëzon Krishti apo engjëjt e zgjedhur të Perëndisë. Kjo nuk mund të jetë një pikë e besimit tim, sepse po të ndodhte kështu, predikimi mbi ringjalljen e njerëzve do të ishte diçka e kotë"[1].

Eshtë një fakt i pamohueshëm që shpresa tek lumturia e përjetshme ka çuar në mohimin e doktrinës Biblike të ringjalljes.Kjo tendencë u vu në dukje nga doktor Adam Clarke që tha: "të Krishterët e hershëm e konsideronin doktrinën e ringjalljes si të veshur me një rëndësi shumë më të madhe se të Krishterët e ditëve tona. Si ndodhi kjo? Apostujt ngulnin këmbë vazhdimisht në këtë pikë, duke i shtyrë ndjekësit e Perëndisë që të bindeshin, të pendoheshin dhe të ngazëlloheshin përmes saj. Ndërsa pasardhësit e tyre në ditët tona e përmendin ringjalljen shumë rrallë! Apostujt e predikonin një gjë të tillë dhe të krishterët e hershëm besonin në të; ne nuk e përmendim dhe dëgjuesit tanë nuk besojnë në të. Kjo është doktrina që theksohet më shumë në Bibël dhe kjo është gjithashtu doktrina që shkelet më shumë me këmbë në sistemin e sotëm të predikimit"[2]

Kjo gjë ka vazhduar për shekuj me radhë, derisa bota e krishterë e ka harruar krejtësisht të vërtetën e lavdishme të ringjalljes. Kështu një shkrimtar i shquar fetar, duke komentuar fjalët e Palit tek 1 Selanikasve 4:13-18 thotë: "Doktrina e pavdekshmërisë së bekuar të të drejtëve na jepet me qëllim ngushëllimi dhe zë vendin e të gjithë doktrinave të tjera të dyshimta që lidhen me ardhjen e dytë të Zotit. Zoti vjen për ne në ditën e vdekjes sonë. Këtë duhet të presim me besim. Të vdekurit kanë kaluar tashmë në lavdi. Ata s'kanë pse të presin trumpetën për të marrë gjykimin dhe shpërblimin e lumturisë".

Por kur largimi i Tij po afrohej, Jezusi nuk u tha dishepujve se ata do të shkonin shumë shpejt pranë Tij. "Unë po shkoj t'ju përgatis një vend." E më pas Ai tha: "Dhe kur të shkoj t'ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t'ju marr pranë meje" *(Gjoni 14:2,3)*. Ndërsa më poshtë Pali na thotë se: "Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeëngjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në

[1] William Tyndal "Preface to New Testament(ed. 1534)" rishtypur në British Reformers - Tindal, Frith, Barnes, faqe 349

[2] Comentary, të dhëna mbi 1 Korintasit 15, paragrafi 3.

Krishtin do të ringjallen të parët, pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi re, për të dalë përpara Zotit në ajër dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin". Dhe ai shton: "Ngushëlloni pra, njëri-tjetrin me këto fjalë." *(1 Selanikasve 4:16-18)*. Sa ndryshojnë këto fjalë ngushëllimi nga ato të pastorit universialist që cituam më lart! Ky i fundit i ngushëlloi miqtë e lënë pas, duke u dhënë atyre sigurinë se sado mëkatarë të ketë qënë i vdekuri gjatë jetës së tij në momentin që jep frymën e fundit ai fluturon mes engjëjve. Pali e përqëndron vëmendjen e vëllezërve të tij tek ardhja e Zotit, kur prangat e varrit do të thyhen dhe "të vdekurit në Krisht" do të ringjallen për të fituar jetën e përjetshme.

Perëndia do t'i shqyrtojë me kujdes rastet e të gjithë njerëzve dhe do t'i gjykojë me drejtësi karakteret dhe veprat e tyre përpara se ata të marrin në dorëzim dhomat e rezervuara për të bekuarit. Të gjithë do të gjykohen në bazë të gjërave që janë shkruar në libra dhe do të shpërblehen në bazë të veprave të tyre. Ky gjykim nuk ndodh në momentin e vdekjes. Vini re fjalët e Palit: "Ai ka caktuar një ditë në të cilën do të gjykojë me drejtësi botën me anë të Atij Njeriu, të cilin Ai e ka caktuar dhe për këtë u ka dhënë të gjithëve një provë të sigurt, duke e ringjallur nga të vdekurit" *(Veprat e Apostujve 17:31)*. Këtu apostulli e thekson qartë se është caktuar një kohë e veçantë për gjykimin e botës.

Juda i referohet të njëjtës periudhë kur thotë: "Ai i ruajti me pranga të përjetshme në errësirë për gjyqin e ditës së madhe edhe engjëjt, që nuk e ruajtën gjendjen e tyre të parë, po e lanë banimin e tyre". Më pas ai citon fjalët e enokut: "Ja, Zoti erdhi me mijërat e Tij të shenjtë, për të bërë gjyqin kundër të gjithëve." *(Juda 6,14,15)*. Gjoni deklaron se pa "të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë dhe librat u hapën ... dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra". *(Zbulesa 20:12)*.

Por në qoftë se të vdekurit janë duke shijuar tashmë lumturinë qiellore apo janë duke u përpëlitur në flakët e ferrit kujt i duhet gjykimi i ardhshëm? Mësimet që na jep fjala e Perëndisë në lidhje me këto çështje të rëndësishme janë të qarta dhe të thjeshta, njerëzit e zakonshëm e kanë të lehtë t'i kuptojnë ato. Po a ka ndonjë njeri të zgjuar që të shquajë mençuri apo drejtësi në teorinë e ditës? A do t'u thuhet të drejtëve pas inspektimit të rasteve të tyre ditën e gjykimit. "Ju lumtë o shërbëtorë të mirë dhe besnikë, hyni në gëzimin e Zotit", kur ata kanë jetuar në praninë e Tij ndoshta për shekuj me radhë? A do të grumbullohen të pabesët nga vendi i torturës për të dëgjuar nga gjykatësi i botës dënimin: "Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm?" *(Mateu 25:21,41)*. Oh, shaka makabre! Akuzë e turpshme ndaj mençurisë dhe drejtësisë së Perëndisë!

Teoria e pavdekshmërisë së shpirtit ishte një nga doktrinat e rreme që Roma e mori borxh nga paganizmi për ta përzier me kristianizmin. Martin Luteri e kla-

sifikon atë me "përrallat e tmerrshme, që formojnë dekretet - plehra të Romës"[3]. Duke komentuar fjalët e Solomonit tek Predikuesi ku ai thotë se të vdekurit nuk dinë asgjë, Reformatori thotë: "Ky është një libër tjetër që provon se të vdekurit... nuk ndiejnë asgjë. Ai (Solomoni) thotë se në vdekje nuk ka as shkencë, as detyrë, as dije dhe as mençuri. Solomoni deklaron se të vdekurit flenë dhe nuk kanë ndjenja. Pra, të vdekurit shtrihen në varre, të pandërgjegjshëm për ditët dhe vitet që kalojnë, por kur të zgjohen do t'u duket se kanë fjetur vetëm një minutë".[4]

Në Shkrimet e Shenjta nuk gjendet asnjë thënie në mbështetje të doktrinës sipas së cilës të drejtët e marrin shpërblimin dhe të pabesët dënimin e tyre ditën e vdekjes. As patriarkët dhe as profetët nuk na kanë lënë një "siguri" të tillë. Krishti dhe apostujt e Tij nuk aluduan për një gjë të tillë. Bibla na thotë qartë se të vdekurit nuk shkojnë menjëherë në qiell. Ata paraqiten si të vënë në gjumë deri në ditën e ringjalljes. *(1 Selanikasve 4:14; Jobi 14:10-12)*. Pikërisht atë ditë kur këputet kordoni prej argjendi dhe kur thyhet vazoja prej ari *(Predikuesi 12:6)*, zhduken edhe mendimet e njeriut. Ata që zbresin në varr mbështillen nga heshtja. Ata nuk e dinë se çfarë ndodh nën diell *(Jobi 14:21)*. Paçin një pushim të bekuar të drejtët e lodhur! Koha, qoftë e gjatë apo e shkurtër, për ta përbën një moment të vetëm. Ata flenë, boria e Perëndisë i zgjon për në pavdekësi. "Sepse do të bjerë boria, të vdekurit do të ringjallen të paprishur...dhe kur ky trup që prishet duhet të veshë mosprishjen, edhe ky i vdekshëm kur të veshë pavdekësinë, atëherë do të realizohet fjala që është shkruar: "Vdekja u përpi në fitore*" (1 Korintasve 15:52-54)*. Me t'u zgjuar nga gjumi i tyre i thellë, ata fillojnë të mendojnë për momentet e fundit.se po i dorëzoheshin fuqisë së varrit. Me t'u ngritur nga varri, britma triumfuese do t'i bëjë jehonë mendimit të tyre të parë të gëzueshëm: "O vdekje, ku është gjëma jote? O ferr, ku është fitorja jote?" *(Versa 55)*

1. Në të gjithë universin, vetëm bota jonë ran ë mëkat. Cila ishte gënjeshtra që Satani i tha Evës, dhe që ngeli një nga mashtrimet e tij më të suksesshme?

2. A na mëson Bibla që njerëzit kanë pavdekshmëri natyrale? Mbështetini përgjigjet tuaja nga Bibla.

3. Lexoni Ezekielin 18:20, 33:11, Malakia 4:1, Mateu 10:28, Zbulesa 20:11-15. Ideja e "mundimit të përjetshëm në ferr" ka çuar shumë njerëz që ta rrefuzojnë Zotin. Cili është mësimi korrekt i Biblës për ferrin dhe shkatërrimin e të padrejtëve?

4. Universalizmi mëson se çdo njeri do të shpëtohet në fund. A është kjo e vërtetë? A ka kushte për tu shpëtuar?

---

[3] E. Petavel "The problem of immortality", faqe 255

[4] Martin Luther, "Exposition of Solomon's booke called Ecclesiastes", faqe 152.

34.

A Mund të na Flasin të Vdekurit?

Shërbimi i engjëjve të shenjtë, ashtu si na përshkruhet edhe në faqet e Shkrimit të Shenjtë, është një e vërtetë ngushëlluese dhe e çmuar për çdo të krishterë. Por teologjia "moderne" i ka errësuar dhe shtrembëruar mësimet Biblike në lidhje me këtë pikë. Doktrina e pavdekshmërisë, që fillimisht u mor borxh nga filozofia pagane për t'u bërë pjesë gjatë viteve të errëta të apostazisë së madhe e besimit kristian, i ka zënë vendin të vërtetës sipas së cilës "të vdekurit nuk dinë asgjë". Me mijëra njerëz besojnë, se janë shpirtrat e të vdekurve ata "që janë dërguar për t'i shërbyer të gjithë atyre, që do të trashëgojnë shpëtimin." Dhe ky besim është përhapur pa marrë parasysh dëshminë e Shkrimit të Shenjtë për ekzistencën e engjëjve qiellorë dhe lidhjes së tyre me historinë njerëzore përpara vdekjes së të parës qënie njerëzore.

Doktrina e ndërgjegjes gjatë vdekjes e veçanërisht besimi, se shpirtrat e të vdekurve kthehen për t'i shërbyer të gjallëve i kanë hapur rrugën spiritualizmit modern. Në qoftë se të vdekurit jetojnë në praninë e Perëndisë dhe të engjëjve të shenjtë dhe kanë privilegjin që të dinë më shumë se më parë pse të mos kthehen në tokë për të ndriçuar mendjet dhe për të udhëzuar njerëzit e gjallë? Në qoftë se, siç na thonë "teologët e njohur", shpirtrat e të vdekurve fluturojnë rreth miqve të tyre mbi tokë, pse nuk u lejohet atyre që të komunikojnë me ta, t'i paralajmërojnë ndaj të keqes dhe t'i ngushëllojnë në kohë të vështira? Si mund ta hedhin poshtë ata që besojnë në ndërgjegjen gjatë vdekjes dritën hyjnore që u komunikohet përmes shpirtrave të lavdishëm?!

Kjo rrugë konsiderohet e shenjtë, përmes së cilës Satani punon për të arritur qëllimet e tij. Engjëjt mëkatarë që iu përgjigjen urdhrave të tij shfaqen si lajmëtarë të botës së shpirtrave. Ndërsa në dukje të gjallët komunikojnë me të vdekurit, është princi i të keqes ai, që përfiton për të ndikuar negativisht mendjet e tyre. Ai ka fuqi që të sjellë përpara njerëzve një formë qënieje të ngjashme me miqtë apo të afërmit e vdekur. Fotokopja e rreme është e përsosur; pamja e jashtme, fjalët, toni riprod-

hohen pa më të voglin ndryshim. Shumë njerëz i ngushëllon siguria, se të dashurit e tyre po shijojnë lumturinë qiellore dhe pa as më të voglin dyshim ata i vënë veshin "shpirtrave joshës dhe doktrinave të djallit".

Kur ata fillojnë të besojnë se të vdekurit mund të kthehen për të komunikuar me ta, Satani i ballafaqon me ata njerëz që u larguan nga kjo botë të papërgatitur. Këta të fundit pretendojnë se jetojnë në qiell të lumtur e madje se janë të veshur me pozitë të lartë, kështu hidhen themelet e atij gabimi popullor që nuk njeh asnjë ndryshim mes të drejtëve dhe të pabesëve. Të ashtuquajturit vizitorë nga bota e shpirtrave ndonjëherë i paralajmërojnë të afërmit e tyre mbi baza të sakta. Kështu me të fituar besimin e tyre ata paraqesin doktrina që minojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë besimin tek Shkrimet e Shenjta. Në dukje të interesuar për mirëqënien e miqve të tyre në tokë, ata mbartin në vetvete shumë gabime të rrezikshme. Fakti që ndonjëherë ata thonë të vërtetën dhe janë në gjendje të parashikojnë disa ngjarje të së ardhmes, i jep thënieve të tyre një farë besueshmërie; dhe me mijëra njerëz i pranojnë dhe u besojnë mësimeve të tyre me zemër të hapur dhe me sy mbyllur thua se ato janë disa nga të vërtetat më të shenjta të Biblës. Ligji i Perëndisë flaket tutje, Fryma e Shenjtë përçmohet dhe gjaku i besëlidhjes shihet si diçka pa vlerë. Shpirtrat e mohojnë origjinën hyjnore të Krishtit dhe e vënë veten në të njëjtin nivel me vetë Krijuesin. Kështu, rebeli i madh, duke përdorur një maskë të re, vazhdon luftën kundër Perëndisë; luftë që filloi në qiell dhe që vazhdoi në tokë për më se gjashtë mijë vjet.

Shumë njerëz përpiqen që t'i shpjegojnë këto "shfaqje shpirtërore" duke i quajtur mashtrime të arrira apo marifete të suksesshme të magjistarëve. Por, megjithëse është e vërtetë që shumë nga këto "shfaqje shpirtërore" janë provuar që janë thjesht dredhi e asgjë tjetër, disa prej tyre mbajnë vulën e fuqisë mbinatyrore. Fillimi misterioz i spiritualizmit modern nuk erdhi si rezultat i dredhive dhe dinakërisë njerëzore, por ishte fryt i punës së engjëjve të errësirës që i paraqitën kështu botës një nga iluzionet më të suksesshme dhe më shkatërruese. Shumë njerëz që ushqejnë besimin se spiritualizmi përbën thjesht një mashtrim njerëzor, do të bien shpejt në kurthin e tij, sepse me t'u ballafaquar me shfaqje i vetmi shpjegim i të cilave është fuqia mbinatyrore, ata do të mashtrohen dhe do t'i pranojnë ato si manifestime të fuqisë së Perëndisë.

Këta njerëz nuk i kushtojnë rëndësi dëshmisë së Shkrimeve të Shenjta, që ka të bëjë me çuditë që është në gjendje të kryejë Satani dhe agjentët e tij. Magjistarët e Faraonit mundën ta fallsifikonin punën e Perëndisë të ndihmuar nga fuqia Satanike. Pali dëshmon se përpara ardhjes së dytë të Krishtit do të manifestohet e njëjta fuqi djallëzore. Ardhja e Zotit do të paraprihet nga "veprimi i Satanit, bashkë me çudira, shenja dhe mrekulli të rreme dhe nga çdo mashtrim ligësie." *(2 Selanikasve 2:9,10)*. Ndërsa apostulli Gjon, duke përshkruar fuqinë çudibërëse që do të

shfaqet në ditët e fundit, deklaron:"Ai bënte shenja të mëdha, saqë edhe zjarr bënte të zbresë nga qielli mbi dhe në prani të njerëzve dhe i mashtronte banorët e dheut me anë të këtyre shenjave..." *(Zbulesa 13:13,14)*. Këtu nuk flitet për mashtrime të thjeshta. Njerëzit mashtrohen nga mrekullitë që bëjnë agjentët e Satanit dhe jo nga të ashtuquajturat "mrekulli".

Princi i errësirës, që i ka përqëndruar përpjekjet e tij për një kohë të gjatë në zanatin e të mashtruarit, fut me mençuri në kurthet e tij tunduese njerëz të të gjitha klasave dhe shtresave shoqërore. Njerëzve të shkolluar dhe të kulturuar ai u paraqit aspektet më intelektuale dhe më të stërholluara të spiritualizmit, duke i tërhequr kështu drejt greminave shkatërruese. Spiritualizmi mishëron në vetvete mençurinë që apostulli Jakob e përshkruan si "dituri që nuk zbret nga lart, por është tokësore, shtazore, djallëzore." *(Jakobi 3:15)*. Megjithatë mashtruesi i madh edhe mund të fshihet kur kjo është rruga më e mirë për të arritur qëllimet e tij. Ai që mundi t'i shfaqej Krishtit në shkretëtirën e tundimit i veshur me shkëlqimin e një engjëlli qiellor, vjen përpara njerëzve në formën më tërheqëse për syrin njerëzor; në formën e një engjëlli drite. Ai i bën thirrje arsyes, duke paraqitur tema të mëdha; ai e kënaq fantazinë me skena të paimagjinueshme; dhe fiton simpati falë "shprehjes elokuente" të dashurisë dhe mëshirës. Ai i jep krahë imagjinatës, duke i bërë njerëzit që të krenohen kaq shumë me zgjuarsinë e tyre, saqë në zemrat e tyre të hidhet fara e përçmimit ndaj të Përjetshmit. Ajo qënie e fuqishme që mundi ta çonte Shpëtimtarin e botës në majën e malit për t'i afruar Atij mbretëritë e botës dhe lavdinë e tyre, do t'iu japë njerëzve mbi një pjatë argjendi, tundimet e tij në mënyrë që t'ua mpijë ndjenjat të gjithë atyre, që nuk kanë veshur mburojat hyjnore.

Satani i mashtron njerëzit sot ashtu siç bëri edhe me Evën në Eden, me anë të lajkave, duke zgjuar në mendjet e tyre dëshirën për dije të ndaluara dhe duke nxitur ambicien për vetëlavdërim. Këta faktorë sollën dështimin e tij dhe ai synon t'i rrëzojë njerëzit përmes tyre. "Do të jeni si Perëndia- deklaroi ai- do të mund të njihni të mirën dhe të keqen." *(Zanafilla 3:5)*. Spiritualizmi na mëson se "njeriu është krijesë e progresit, që në lindje ai është destinuar që të përparojë, madje edhe në përjetësi, drejt Perëndisë." Më pas na thuhet:"Çdo mendje do të gjykojë vetveten dhe askënd tjetër. Ky gjykim do të jetë i drejtë, sepse do të jetë gjykimi i vetvetes.... Froni është brenda jush." Një mësues spiritualist ndërsa brenda tij u zgjua "ndërgjegja shpirtërore", tha: "Miqtë e mi, të gjithë ishin gjysmëperëndi të pagabueshëm." Ndërsa një tjetër deklaron:"Çdo qënie e drejtë dhe e përsosur është Krisht."

Kështu, Satani ka kthyer në objekt adhurimi, në vend të dejtësisë dhe përsosmërisë së Perëndisë pafund, në vend të drejtësisë së pacënueshme të ligjit të Tij, që është kriteri i vërtetë i çdo arritjeje njerëzore, natyrën mëkatare njerëzore. Pra, ai e ka quajtur këtë natyrë të kalbur të vetmin objekt adhurimi, të vetmin rregull

gjykimi, të vetmin kriter karakteri. Ky është progres; po, po; ky është *progres*, por jo përpara, prapa.

Ekziston një ligj i një natyre intelektuale dhe shpirtërore sipas të cilit, duke parë ne ndryshojmë. Mendja, gradualisht, përshtatet me subjekte mbi të cilat i lejohet të përqëndrohet. Ajo tërhiqet pas diçkaje që është mësuar me dashuri dhe respekt. Një njeri nuk mund të shkojë më larg se kriteri i tij i pastërtisë, mirësisë apo së vërtetës. Në qoftë se vetvetja përbën idealin e tij më të lartë ai nuk do të mund të arrijë asgjë tjetër më fisnike se kjo. Përkundrazi, do të vazhdojë të fundoset gjithnjë e më shumë. Njeriun mund ta lartësojë dhe ta fisnikërojë vetëm hiri i Perëndisë. Sikur gjithçka të mbetej në duart e tij njeriu do të zgjidhte atë rrugë që, pa as më të voglin dyshim, do ta çonte në rrënim.

Në format madhështore të spiritualizmit njerëzit e shkolluar dhe të edukuar gjejnë atë që përputhet me pirjet e tyre, por pjesës tjetër; njerëzve të vetkënaqur, imoral dhe të shkujdesur, spiritualizmi i shfaq një fytyrë me një maskë më të thjeshtë. Satani studion çdo pirje apo dobësi të natyrës njerëzore, ai shquan mëkatet, që kryen më shpesh çdo individ i caktuar dhe më pas kujdeset që këtij njeriu të mos i mungojnë rastet për të shfaqur pirjet drejt të keqes. Ai i tundon njerëzit vazhdimisht në lidhje me diçka që në vetvete është më se e ligjshme, duke i bërë ata që t'i dobësojnë përmes teprisë, fuqitë e tyre fizike, morale dhe mendore. Ai ka shkatërruar dhe vazhdon të shkatërrojë me mijëra njerëz përmes dëshirës për të lënë të lira pasionet, duke rrënuar kështu natyrën njerëzore. Dhe në mënyrë që t'i vërë kapakun punës së nisur ai deklaron përmes këtyre shpirtrave që "njohuria e vërtetë e vë njeriun mbi ligjin;" që "gjithçka që ekziston është e drejtë," që "Perëndia nuk dënon", dhe që "të gjitha mëkatet, që kryhen nga njerëzit janë në vetvete të pafajshme." Kështu kur njerëzit binden dhe besojnë se dëshira egoiste është ligji më i lartë, liria është e lejuar dhe se njeriu është përgjegjës vetë për vetveten, si mund të çuditemi që korrupsioni dhe shthurja janë në lulëzim e sipër? Me mijëra njerëz pranojnë me etje të madhe si të vërteta mësime të rreme që u japin atyre dorë të lirë për t'iu bindur pirjeve të një zemre mëkatare. Kapistalli i vetkontrollit është hedhur mbi qafën e epshit, fuqitë mendore dhe shpirtërore janë kthyer në pre të parimeve shtazarake dhe kështu Satani tërheq me gëzim në rrjetën e tij me mijëra njerëz, që vetëquhen ndjekës të Krishtit.

Por askush nuk duhet të mashtrohet nga pretendimet e gënjeshtërta të spiritualizmit. Perëndia i ka falur botës dritë të mjaftueshme për t'i aftësuar njerëzit që t'i zbulojnë këto kurthe të rrezikshme. Siç është shpjeguar deri tani, teoria që përbën themelin e spiritualizmit kundërshton haptazi thëniet më të qarta të Shkrimeve të Shenjta. Bibla deklaron se të vdekurit nuk dinë asgjë dhe se mendimet e tyre janë zhdukur; ata s'dinë asgjë nga ato që ndodhin ditën me diell; ata nuk dinë asgjë për gëzimet dhe shqetësimet e njerëzve të tyre të dashur.

Për më tepër, Perëndia e ka ndaluar haptazi të ashtuquajturën "komunikim" me shpirtrat e të vdekurve. Në kohën e çifutëve ekzistonte një grup njerëzish që, ashtu si spiritualistët e sotëm, pretendonin se mund të komunikonin me të vdekurit. Por Bibla thotë se "shpirtrat e njohur" siç quhen vizitorët e botëve të tjera, s'janë asgjë tjetër veçse "shpirtra demonësh". (Të krahasohen *Numrat 25:1-3 Psalmet 106:28; 1 Korintasve 10:20; Zbulesa 16:14*). Zoti e quante komunikimin me shpirtrat e njohur diçka të pështirë dhe komunikimi vetë dënohej solemnisht me vdekje. *(Levitiku 19:31; 20:27)*. Në ditët tona magjia në vetvete përçmohet. Ideja se njerëzit mund të bashkëbisedojnë me shpirtrat e këqinj konsiderohet si përrallë e mesjetës. Por spiritualizmi që numëron në radhët e veta me qindra, mijëra e madje me miliona njerëz, që ka depërtuar në rrethet shkencore dhe përkrahet nga organet legjislative dhe nga pallatet mbretërore - ky mamuth mashtrimi s'është asgjë tjetër veçse rilindja nën një maskë të re të magjisë, që është dënuar e ndaluar në të shkuarën.

Fakti që shpirtrat nuk shohin asnjë dallim mes drejtësisë dhe mëkatit, mes apostujve më fisnikë dhe më të devotshëm të Krishtit dhe shërbëtorëve më të korruptuar të Satanit, do të ishte për çdo të krishterë provë e mjaftueshme e karakterit të vërtetë të spiritualizmit.

Duke bërë sikur njerëzit më të ulët nderohen në një mënyrë të veçantë në qiell, Satani po i thotë botës:"S'ka rëndësi se sa të ligj jeni; s'ka rëndësi nëse i besoni apo jo Zotit dhe Biblës. Jetoni si të doni..., parajsa është shtëpia juaj." Mësuesit spiritualistë deklarojnë me besim:"Kushdo që vepron keq pëlqehet nga Zoti, i cili kënaqet me të." ose "Ku është Perëndia e drejtësisë?" *(Malakia 2:17)*.

Fjala e Perëndisë na thotë:"Mjerë ata që e quajnë të mirë të keqen dhe të keqe të mirën, që ndërrojnë terrin në dritë dhe dritën në terr." *(Isaja 5:20)*. Apostujt, të mishëruar nga këta shpirtra të rremë, kundërshtojnë atë që kanë shkruar vetë nën ndikimin e Frymës së Shenjtë, ndërsa ishin ende gjallë në tokë. Ata mohojnë origjinën hyjnore të Biblës, duke mbuluar kështu me baltë themelin e shpresës së çdo të Krishteri dhe, duke fikur dritën, që zbulon rrugën drejt parajsës. Satani po e bën botën të besojë se Bibla është thjesht një trillim apo një libër, që i përshtatej miturisë ose fillimeve të ekzistencës së kësaj race, por që tani nuk duhet t'i kushtohet shumë rëndësi apo më mirë akoma duhet të flaket tej si diçka e vjetëruar. Dhe në vend të fjalës së Perëndisë, ai ngre lart shfaqjet shpirtërore. Pra, kemi të bëjmë me një rrugë, që kontrollohet plotësisht prej tij, përmes kësaj rruge ai mund ta bëjë botën të besojë gjithçka që nxjerr nga goja. Ai e fsheh diku nën shkurre, pikërisht ashtu si ia do zemra atë, librin, që e gjykon atë dhe pasuesit e tij; ai e paraqit Shpëtimtarin e botës si një njeri të zakonshëm. Dhe ashtu si rojet romake, që kur panë varrin bosh të Jezusit hapën fjalë të gënjeshtërta, që priftërinjtë dhe anëtarët e pleqësisë ua kishin mësuar, mbi ringjalljen e Tij, ashtu edhe ata që u besojnë manifestimeve spirituale përpiqen të na bindin se nuk ka pasur asgjë të mrekullueshme apo mbinatyrore në

jetën e Shpëtimtarit. Kështu, pasi përpiqen të hedhin poshtë Jezusin, ata tërheqin mendjen e njerëzve tek mrekullitë e tyre, duke deklaruar me mburrje se këto të fundit ua kalojnë ku e ku veprave të Krishtit.

Eshtë e vërtetë se spiritualizmi sot po ndryshon formë dhe, duke i fshehur disa nga aspektet e tij më të papëlqyeshme po vesh një petk deri diku Kristian. Por të mos harrojmë se thëniet e tij nga podiume të ndryshme dhe nga faqet e shtypit e kanë çuditur botën për vite me radhë dhe pikërisht aty (tek thëniet), zbulohet karakteri i tij i vërtetë. Këto mësime as nuk mund të mohohen dhe as nuk mund të fshihen.

Madje në formën e tanishme edhe pse ka fituar një farë liberalizmi më të madh se në të shkuarën, mashtrimi që ai mban në vetvete është më i rrezikshëm, sepse është më i zgjuar. Ndërsa fillimisht i mohonte si Krishtin, ashtu edhe Biblën, tani shprehet se i pranon të dyja. Por Bibla interpretohet në një mënyrë të tillë që t'ia bëjë qejfin një zemre të patransformuar, ndërsa të vërtetat e saj solemne dhe jetësore humbin vlerën e tyre. Dashuria mendohet si tipari kryesor i Perëndisë, por degradohet në një ndjenjë të dobët sentimentalizmi, duke mos bërë dallim mes të mirës dhe të keqes. Drejtësia e Perëndisë, urrejtja e Tij ndaj mëkatit, urdhëresat e ligjit të Tij hyjnor nuk përmenden fare. Ligji i Moisiut konsiderohet si diçka e shkruar e asgjë më shumë. Njerëzit bien rob të përrallave të bukura dhe magjiplote, duke harruar se Bibla duhet të jetë themeli i besimit të tyre. Krishti mohohet njësoj si më parë; por Satani i ka verbuar njerëzit në atë pikë sa ata nuk mund ta dallojnë më mashtrimin. Të paktë janë ata që e kanë një koncept të drejtë të fuqisë mashtruese të spiritualizmit dhe të rrezikut që sjell ndikimi i tij. Disa luajnë me të për të kënaqur kuriozitetin e tyre. Ata nuk i besojnë me të vërtetë atij dhe do t'i tmerronte mendimi se mund t'i dorëzohen kontrollit të shpirtrave. Por ata enden në një zonë të ndaluar dhe shkatërruesi i fuqishëm ushtron pushtetin e tij mbi ta edhe pse kjo ndodh kundër vullnetit të tyre. Le t'i nënshtrohen për një çast të vetëm mendjet e këtyre njerëzve kontrollit të tij dhe ai do t'i kthejë në robër. Me forcat e tyre ata e kanë të pamundur që t'i thyejnë prangat e magjishme dhe joshëse. Këta shpirtra të ngecur në kurth mund t'i çlirojë vetëm fuqia e Perëndisë, që vjen si përgjigje e lutjeve të ethshme të besimit.

Të gjithë ata që mbajnë gjallë disa veçori të caktuara karakteri apo që me vullnet të lirë ushqejnë një mëkat të njohur, po u hapin derën tundimeve të Satanit. Ata largohen nga Zoti dhe nga kujdesi i engjëjve të Tij; e ndërsa i ligu përpiqet t'i mashtrojë, ata janë të pambrojtur dhe bien lehtas pre e tij. Kështu, ata që i nënshtrohen pushtetit të tij nuk arrijnë ta kuptojnë se ku do t'i çojë kjo rrugë. Me t'i shtënë në dorë ata vetë, tunduesi do t'i përdorë si agjentë për të joshur të tjerë drejt rrënimit të plotë.

Profeti Isaja thotë:"Në rast se ju thuhet "Këshillohuni me mediumet dhe me magjistarët, që murmurisin dhe pëshpërisin, përgjigjuni:"A nuk duhet një popull

të konsultojë Perëndinë e tij? A duhet vallë, t'u drejtohet të vdekurve për llogari të të gjallëve? Përmbajuni ligjit dhe dëshmisë! Në rast se një popull nuk flet në këtë mënyrë, kjo do të thotë se ai nuk ka dritë." *(Isaja 8:19,20)*. Në qoftë se njerëzit do të ishin të gatshëm për të pranuar të vërtetat, që shprehen kaq qartë në Shkrimet e Shenjta në lidhje me natyrën njerëzore dhe gjendjen e të vdekurit, ata do të mund të shquanin në pretendimet dhe manifestimet spiritualiste dorën dhe punën e Satanit me shenja dhe çudi të rreme. Por në vend që të heqin dorë nga liria e tepruar, që i shkon kaq shumë pas shtati zemrës mëkatare dhe të braktisin mëkatet, që i duan aq shumë, me mijëra njerëz mbyllin sytë përpara dritës dhe ecin kuturu pa marrë parasysh asnjë nga paralajmërimet e dhëna, ndërsa Satani thur përreth tyre kurthet e tij dhe ata kthehen në pre. "Sepse nuk pranuan ta duan të vërtetën për të qënë të shpëtuar... Perëndia do t'u dërgojë atyre një gënjim... që ata t'i besojnë gënjeshtrës." *(2 Selanikasve 2:10,11)*.

Ata, që kundërshtojnë mësimet e spiritualizmit nuk po sulmojnë vetëm disa njerëz të caktuar, por vetë Satanin dhe agjentët e tij. Ata i kanë hyrë betejës kundër principatash, fuqish dhe shpirtrash të këqinj, të një rëndësie të veçantë. Satani nuk do të lëshonte as edhe një centimetër tokë, në qoftë se nuk do të zbrapsej përpara fuqisë së lajmëtarëve qiellorë. Njerëzit e Perëndisë duhet të jenë në gjendje t'i bëjnë ballë ashtu siç i bëri ballë Shpëtimtari, duke përdorur fjalët:"Eshtë e shkruar". Satani ashtu si bëri edhe në kohën e Krishtit, mund të citojë pjesë të Shkrimeve të Shenjta, por për të arritur zhgënjimet e tij "të famshme", do t'i shtrembërojë ato. Ata që duan të dalin fitimtarë në këto kohëra vështirësish, duhet të kuptojnë individualisht dëshminë e Shkrimeve të Shenjta.

Shumë njerëz do të ballafaqohen me shpirtrat e demonëve, që do të simbolizojnë miqtë apo të afërmit e vdekur dhe që do të deklarojnë disa nga herezitë më të rrezikshme. Këta vizitorë do të prekin pikat tona më të dobëta dhe do të kryejnë mrekulli për të mbështetur pretendimet e tyre. Ne duhet t'i zbrapsim sulmet e tyre, duke përdorur të vërtetën e Biblës, që na tregon qartë se të vdekurit nuk dinë asgjë dhe ata, që shfaqen në këtë mënyrë kaq të mistershme s'janë asgjë tjetër veçse shpirtrat e demonëve.

Përpara nesh gjendet "ora e shpresës, që do të vijë mbi gjithë botën, për të provuar ata që banojnë mbi dhe." *(Zbulesa 3:10)*. Të gjithë ata, besimi i të cilëve nuk është ngritur me themelin e fjalës së Perëndisë, do të mashtrohen dhe do të munden me turp. Satani "Vepron duke përdorur çdo mashtrim ligësie" për të fituar kontroll mbi fëmijët e njeriut dhe mashtrimet e tij do të shtohen nga dita në ditë. Por ai mund të arrijë qëllimin e tij vetëm, në qoftë se njerëzit i dorëzohen tundimeve të tij. Ata, që po kërkojnë me zell të vërtetën dhe që po përpiqen që të pastrojnë shpirtrat e tyre përmes bindjes, duke u përgatitur kështu për këtë konflikt të madh do të gjejnë tek Perëndia e së vërtetës një mbrojtje të sigurt. Shpëtimtari na premton, duke na thënë:"Unë do të të ruaj ty sepse e ruajte fjalën e durimit tim" *(Versa 10)*.

Ai do të preferonte më mirë të dërgonte edhe engjëllin e fundit qiellor në mbrojtje të popullit të tij se sa të linte qoftë edhe një njeri të vetëm, që ka besim tek Ai të mundej nga Satani.

Profeti Isaja na kujton mashtrimin e frikshëm që do të përjetojnë të pabesët; mashtrimin që do t'i bëjë të mendojnë se i kanë shpëtuar gjykimit të Perëndisë. "Kemi përfunduar një besëlidhje me vdekjen, kemi bërë një alencë me Sheolin, kur rrebeshi përmbytës do të kalojë nuk do të arrijë deri tek ne, sepse gënjeshtrën e kemi bërë strehën tonë dhe jemi fshehur prapa falsitetit." *(Isaja 28:15)*. Këtu përshkruhet ai grup njerëzish që, duke qënë kokëfortë dhe të pabesë, vetngushëllohen me sigurinë që mëkatari nuk do të dënohet; dhe se që të gjithë njerëzit, pavarësisht nga korruptimi i tyre, do të lartësohen drejt parajsës për t'u bërë si engjëjt e Perëndisë. Por akoma më shumë theksohen ata njerëz, që kanë përfunduar një besëlidhje me vdekjen dhe një aleancë me ferrin, që kanë hequr dorë nga të vërtetat që Perëndia i ka skicuar për të mbrojtur të drejtët në ditët e vështirësive për të pranuar strehën e gënjeshtrave ofruar "me bujari" nga Satani - me fjalë të tjera për të pranuar pretendimet zhgënjyese të spiritualizmit.

S'ka fjalë që mund ta përshkruajë verbërinë e këtij brezi njerëzish. Me mijëra njerëz e flakin tej me përbuzje fjalën e Perëndisë dhe pranojnë të etur mashtrimin e Satanit. Skeptikët tallen me "fanatizmin" e atyre, që përqafojnë besimin e profetëve dhe apostujve dhe kënaqen duke hedhur baltë mbi deklaratat solemne të Shkrimeve të Shenjta në lidhje me Krishtin, planin e shpëtimit dhe shpagimin, që do të bjerë mbi të gjithë ata, që e kanë mohuar të vërtetën. Atyre u vjen kaq keq për ata të shkretët, që janë njerëz kaq të dobët, injorantë dhe supersticiozë sa e njohin Perëndinë dhe i binden ligjit të Tij. Duken kaq të sigurt sa thua e kanë lidhur me të vërtetë një besëlidhje me vdekjen dhe një aleancë me ferrin - sikur të kenë ngritur me të vërtetë një barrierë të padepërtueshme dhe të pakapërcyeshme mes vetes së tyre dhe gjykimit hakmarrës të Perëndisë. Ata s'kanë frikë nga asgjë. Kaq plotësisht i janë dorëzuar tunduesit, kaq pazgjidhshmërisht janë bashkuar me të dhe kaq tërësisht janë mbrujtur me shpirtin e tij, saqë nuk kanë as fuqi dhe as dëshirë për t'i shpëtuar kurthit të tij.

Satani ka kohë që është përgatitur për përpjekjen e tij përfundimtare për të mashtruar botën. Siguria që iu dha Evës në Eden përbën edhe themelin e punës së tij:"Ju s'keni për të vdekur aspak". "Ditën që do t'i hani, sytë tuaj do të hapen dhe do të jeni në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen." *(Zanafilla 3:4,5)*. Hap pas hapi ai i ka hapur rrugën kryeveprës së tij mashtruese - lulëzimit të spiritualizmit. Ai nuk e ka arritur akoma plotësisht qëllimin e tij, por do t'ia dalë mbanë në fundin e kohës. Profeti thotë:"Dhe pashë... tri frymë të ndyra, që u ngjanin bretkosave... ato janë fryma të demonëve që bëjnë mrekulli, që shkojnë te mbretërit e dheut dhe të gjithë botës, që t'i mbledhin për luftën e ditës së madhe të Perëndisë."

(Zbulesa 16:13,14). E gjithë bota, me përjashtim të atyre, që falë besimit në fjalën e Tij do të marrin fuqi nga Perëndia, do të thithet nga forca përpirëse e këtij zhgënjimi. Njerëzit ndillen drejt një sigurie fatale, për t'u zgjuar nga shprehja e zemërimit të Perëndisë.

Zoti Perëndi thotë:"Unë do të vendos të drejtën si masë dhe drejtësinë si plumçe: breshëri do të pastrojë strehën e gënjeshtrës dhe ujërat do të përmbysin strehën tuaj. Besëlidhja juaj me vdekjen do të anullohet dhe aleanca juaj me Sheolin nuk do të qëndrojë; kur rrebeshi i përmbytjes do të kalojë, ju do të shkeleni prej tij." *(Isaja 28:17,18)*.

1. Lexoni Psalmin 146:3,4; Predikuesi 9:5,6; Gjoni 11:11, 14. Bibla na mëson se të vdekurit janë të pandërgjegjshëm dhe nuk mund të komunikojnë me të gjallët. Nëse dikush që ngjan me një të afërmin tuaj të dashur apo mikun tuaj që ka vdekur, cilin jeni duke parë në të vërtetë?

2. Lexoni 2 Selanikasve 2:9,10 dhe Zbulesën 13:13. Bibla thotë se shfaqja e Satanit në ditët e fundit do të jetë reale dhe do të mashtrojë shumë njerëz. Si mund të jesh i mbrojtur nga mashtrimi nëse ndodh kjo gjë?

3. A jeni vizituar nga frymëra që pretendonin se ishte njëri nga të afërmit tuaj të vdekur? A jeni ngatërruar ndonjëherë me tavolinat e Ouijës, letrat tarot, horoskopet apo ekstrasensët? Si ju ndihmon ky kapitull të përballeni me këto situata me supernaturorët?

35.

Kërcënimi i Lirisë së Ndërgjegjes

Protestantët e ditëve tona e shikojnë romanizmin me sy më të mirë se para-ardhësit e tyre. Në ato vende ku katolicizmi ka marrë rrokullimën dhe përkrahësit e Papës, në mënyrë që të rifitojnë rëndësinë e dikurshme, i kanë hyrë rrugës "së pajtimit", vihet re një indiferencë gjithmonë e në rritje përsa u përket doktrinave, që veçojnë kishat e reformuara nga hierarkia e papatit; tashmë po përkrahet ideja se në fund të fundit nuk ndryshojnë aq shumë sa mendohej në çështjet e rëndësisë së veçantë dhe se po të tregohemi ca më dorëlëshuar do të fitojmë një marrëdhënie më të mirë me Romën. Një herë e një kohë liria e ndërgjegjes, që ishte fituar me djersë e gjak kishte një vlerë të veçantë për protestantët. Ata i mësonin fëmijët që të mos ta përfillin papatin dhe ishin të mendimit se të kërkojë paqe me Romën do të thoshte të mos i bindeshe Perëndisë. Po sa shumë ndryshojnë idetë e shprehura sot!

Mbrojtësit e papatit deklarojnë se për kishën është folur keq dhe Protestantët janë të prirur që ta pranojnë një thënie të tillë. Shumë prej tyre janë të idesë se nuk është e drejtë që ta gjykosh kishën e sotme, duke u nisur nga urrejtja dhe absurditeti, që ishin në qendër të politikës së saj gjatë shekujve të injorancës dhe errësirës. Ata e shfajësojnë mizorinë e saj të tmerrshme, duke e quajtur "barbarizëm të kohës" dhe thonë se ndikimi i qytetërimit modern i ka ndryshuar doktrinat e saj.

E kanë harruar vallë këta njerëz pretendimin që kjo fuqi mendjemadhe e ka ruajtur për 800 vjet me radhë, sipas të cilit kisha është e pagabueshme? Jo vetëm që nuk është hequr dorë nga ky pretendim absurd, por përkundrazi ai është riafirmuar me një forcë të paparë në shekullin e *IXX-të*. Ndërsa Roma pohon se "kisha nuk ka gabuar kurrë; dhe sipas Shkrimeve të Shenjta nuk do të gabojë kurrë,"[1] si mund t'i braktisë ajo parimet që kanë qeverisur politikën e saj në të shkuarën?

Kisha e papës nuk do të heqë kurrë dorë nga pretendimi i pagabueshmërisë. Ajo e quan të drejtë gjithçka që ka bërë gjatë persekutimit të të gjithë atyre, që mohuan

[1] (John L. von Mosheim, "Enstitutes of Ecclesiastical History" libri 3, shek. II, pjesa 2, kap. 2, seksioni 9, shënimi 17)

dogmat e saj; sikur t'i jepet prapë kjo mundësi a nuk do të bëjë vallë përsëri të njëjtën gjë? Sikur të mos ekzistonin më ligjet e vendosura nga qeveritë sekulare dhe Romës t'i rikthehej pushteti i dikurshëm, të gjithë do të ishim dëshmitarë të një ringjalljeje të shpejtë të tiranisë dhe persekutimit të saj.

Një shkrimtar i mirënjohur, duke shqyrtuar lirinë e ndërgjegjes dhe rreziqet, që iu kanosën veçanërisht Shteteve të Bashkuara nga suksesi i politikës romake, e përshkruan kështu hierarkinë e papatit "Shumë njerëz në Shtetet e Bashkuara janë të prirur ta quajnë frikën ndaj katolicizmit të Romës fanatizëm apo kalamallëk. Njerëz të tillë nuk janë në gjendje që të shquajnë armiqësoren në karakterin dhe qëndrimin e Romës ndaj institucioneve të pavarura dhe nuk shohin asgjë ogurzezë në shtrirjen e saj. Le të krahasojmë pra disa nga parimet themelore të qeverisë sonë me ato të kishës Katolike.

Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara siguron lirinë e ndërgjegjes. Asgjë nuk është më e rëndësishme apo më e shtrenjtë se kjo. Papa Piu IX-të në letrën e tij drejtuar peshkopëve shkruan "doktrinat apo përçartjet e gabuara dhe absurde në mbrojtje të lirisë së ndërgjegjes përbëjnë një të metë shqetësuese - një sëmundje që duhet të na trembë më shumë se gjithçka tjetër". I njëjti papë në letrën e tij drejtuar peshkopëve në 8 Dhjetor 1864 mallkon "të gjithë ata, që ushtrojnë lirinë e ndërgjegjes dhe të adhurimit fetar" si dhe "ata, që janë të mendimit se kisha nuk duhet të përdorë forcën".

"Toni paqësor" i Romës në Shtetet e Bashkuara nuk nënkupton një ndryshim në zemër. Ajo bëhet dorëlëshuar atëherë kur nuk ka asnjë rrugëzgjidhje tjetër. Peshkopi O'Connor thotë: "Lirisë së besimit do t'i jepet dorë e lirë veprimi deri atëherë kur ushtrimi i të kundërtës së saj nuk do ta rrezikojë botën Katolike..." Kryepeshkopi i Shën Louis një herë tha: "Herezia dhe mosbesimi janë krime dhe në vendet e krishtera si në Itali dhe Spanjë psh kur të gjithë shtetasit janë Katolikë dhe ku feja Katolike është një tërësi e rëndësishme e ligjit kombëtar ato duhet të dënohen si çdo krim tjetër..."

"Çdo kardinal, kryepeshkop dhe peshkop i Kishës Katolike i betohet Papës për besnikëri. Në mes të tjerave në tekstin e këtij betimi gjenden fjalët: "Unë do të bëj ç'është e mundur për të kundërshtuar dhe persekutuar çdo heretik, përçarës apo rebel, që ngrihet kundër Zotit (papës) të tanishëm apo pasardhësve të tij."[2]

Eshtë e vërtetë që në bashkësinë katolike romane ka shumë të Krishterë të vërtetë. Me mijëra njerëz të asaj kishe i shërbejnë Perëndisë sipas asaj njohurie që kanë. Atyre nuk iu lejohet studimi i Fjalës së Tij e prandaj nuk mund ta dallojnë të vërtetën[3]*. Ata nuk e kanë parë kurrë ndryshimin midis një shërbimi me gjithë shpirt dhe një manifestimi ritesh dhe ceremonish. Zoti i shikon me dhembshuri dhe keqardhje këta njerëz, që janë brumosur në një besim zhgënjyes që lë shumë

[2] Josiah Strong, "Our Country", kap. 5, parag. 2-4.

[3] *botuar në vitet 1888 dhe 1911

për të dëshiruar. Ai do të dërgojë rreze drite mes errësirës së dendur që i rrethon ata. Ai do t'u zbulojë atyre të vërtetën e mëshiruar në personin e Jezusit dhe shumë prej tyre do të bashkohen me popullin e Tij.

Por Romanizmi si sistem ashtu si gjatë periudhave të shkuara të historisë së saj, nuk përputhet me Ungjillin e Krishtit. Kishat Protestante duhet të jenë zhytur në një errësirë të madhe, ndryshe do t'i kishin shquar qartë shenjat e kohërave. Kisha e Romës po i shtrin planet dhe mënyrat e veprimit të saj. Ajo po përdor gjithçka që ka në dorë për të përhapur influencën dhe për të shtuar pushtetin e saj, duke u përgatitur kështu për një konflikt të ashpër dhe të vendosur për të rifituar kontrollin mbi botën, për të riushtruar persekutimet dhe për të shkatërruar gjithçka që ka ndërtuar Protestanizmi. Katolicizmi po fiton pikë në çdo drejtim. Shihni numrin në rritje të kishave të saj në shtetet protestante. Vini re popullaritetin e kolegjeve dhe seminareve të saj në Amerikë, kolegje dhe seminare që shihen me sy të mirë nga protestantët. Kushtojini rëndësi rritjes së ritualizmit në Angli dhe përçarjeve të shpeshta mes radhëve të katolikëve. Të gjitha këto duhet të zgjojnë shqetësim në zemrat e atyre, që vlerësojnë parimet e pastra të ungjillit.

Protestantët i kanë lëshuar pe dhe e kanë mbrojtur papatin; ata kanë lidhur kompromise dhe kanë bërë kaq shumë lëshime sa edhe vetë papistët nuk mund t'i kuptojnë e janë të çuditur. Njerëzit po mbyllin sytë përpara karakterit të vërtetë të Romanizmit dhe përpara rreziqeve që mbart në vetvete epërsia e tij. Njerëzit duhet të ngrihen në këmbë që t'i bëjnë ballë progresit të këtij armiku të rrezikshëm të lirisë fetare dhe civile.

Shumë protestantë mendojnë që feja katolike nuk është aspak tërheqëse dhe se adhurimi i tyre është një tërësi e mërzitshme dhe e pakuptimtë ceremonish. Këtu janë gabim. Megjithëse Romanizmi bazohet në mashtrim, ky mashtrim në vetvete nuk është i rëndomtë dhe bosh. Shërbesa fetare e kishës romake është një ritual mahnitës. Shfaqjet e saj të mrekullueshme dhe ritet solemne i magjepsin njerëzit dhe e mbysin zërin e arsyes dhe ndërgjegjes njerëzore.

Syri kënaqet. Kishat e mrekullueshme, procesionet mbresëlënëse, altarët e artë, faltoret e gdhendura me xhevahire, pikturat e zgjedhura me kujdes dhe skulpturat e përkryera e kënaqin dashurinë për të bukurën. Edhe veshi zihet rob. Muzika është e pakrahasueshme me gjithçka tjetër. Notat mahnitëse të organos së akorduar bukur ndërthurur me melodinë e qindra zërave, që përplasen përmes kubeve të larta dhe korridoreve me kolona të katedraleve madhështore lë përshtypje të papërshkrueshme nderimi dhe frikë në mendjen njerëzore.

Ky shkëlqim, ky pompozitet dhe ky ritualitet i jashtëm, që vetëm i vë në lojë dëshirat e zjarrta të shpirtit të gërryer nga krimbi i mëkatit, është një provë e korrupsionit të brendshëm. Feja e Krishtit nuk ka nevojë për zbukurime të tilla që të duket tërheqëse. Në dritën, që ndriçon nga kryqi, Kristianizmi i vërtetë shfaqet kaq

i pastër dhe i këndshëm sa që asnjë dekorim i jashtëm nuk mund t'ia shtojë vlerën që ka në vetvete. Bukuria e shenjtërisë dhe shpirti i qetë dhe i përulur janë me vlerë në sy të Perëndisë.

Nuk është e thënë që bukuria e stilit të jetë tregues mendimesh të pastra dhe hyjnore. Idetë e përpunuara, vlerësimi i drejtë i artit dhe shija e hollë për të bukurën shpesh ekzistojnë në mendjet e njerëzve të dhënë pas kësaj bote dhe epshit. Satani i përdor ata shpesh që t'i bëjnë të tjerët t'i harrojnë nevojat e shpirtit, të mos i kushtojnë vëmendje të ardhmes dhe jetës së përjetshme, t'i kthejnë kurrizin Ndihmësit të palodhur dhe të jetojnë për këtë botë dhe vetëm për këtë botë.

Vetëm zemra e patransformuar tërhiqet nga një fe bukurish të jashtme. Shumë njerëz janë mashtruar nga fuqia joshëse dhe marramendëse e pompozitetit dhe ceremonive të adhurimit Katolik, e madje këta njerëz e konsiderojnë kishën e Romës si të ishte porta e parajsës. Vetëm ata, zemrat e të cilëve janë ripërtërirë nga Fryma e Shenjtë dhe që janë kapur fort pas themelit të së vërtetës kanë mburojën e duhur për t'i bërë ballë ndikimit të saj. Me mijëra të tjerë, që nuk e kanë njohur personalisht Krishtin do t'i pranojnë këto forma të perëndishme, por të zhveshura nga fuqia transformuese. Njerëzimit i pëlqen një fe e tillë.

Pretendimi i kishës, sipas të cilit ajo ka të drejtën e faljes, bën që shumë besimtarë të ndjehen të lirë të mëkatojnë, madje edhe rrëfimi, pa të cilin nuk ka falje, synon t'i hapë rrugën të keqes. Ai njeri që gjunjëzohet përpara një njeriu tjetër mëkatar dhe rrëfen mendimet dhe qëllimet e fshehta të zemrës së tij, hedh baltë mbi burrërinë e tij dhe shkel me këmbë çdo instikt fisnik të shpirtit të vet. Duke shpalosur mëkatet e jetës së tij përpara një prifti - një njeri me gabime dhe mëkatar, që shpesh është edhe i korruptuar në të pira dhe shthurje - ai përbuz standartin e karakterit të tij dhe rrjedhimisht ndjehet i poshtëruar. Ideja e tij për Zotin ndërthuret apo ngjan me njeriun mëkatar, sepse prifti në vetvete përfaqëson Perëndinë. Ky rrëfim degradues i njeriut tek njeriu është burimi i fshehur, nga ku ka rrjedhur një pjesë e madhe e së keqes, që po ndyn botën, duke e përgatitur atë për shkatërrimin përfundimtar. Megjithatë për njeriun që ia bën qejfin vetes është më e lehtë që t'i rrëfehet një bashkëmëkatari tjetër se sa t'ia hapi zemrën Zotit. Për natyrën njerëzore është më i pranueshëm vetndëshkimi sesa braktisja e mëkatit, është më e lehtë që të vetposhtërohet, duke përdorur thasë me rërë, hithra dhe zinxhirë se sa të kryqëzojë epshet trupore. Zemra mëkatare është e gatshme më mirë të durojë një zgjedhë të tillë të rëndë se sa t'i përulet zgjedhës së Krishtit.

Ekziston një ngjashmëri e dukshme mes Kishës së Romës dhe Kishës Çifute në kohën e ardhjes së parë të Krishtit. Ndërsa çifutët po i merrnin fshehtas nëpër këmbë parimet e ligjit të Perëndisë, në pamje të jashtme ata dukeshin sikur po zbatonin me rigorozitet çdo urdhëresë të Tij, duke i bashkangjitur atyre tradita dhe kërkesa të reja, që e kthyen respektimin e tyre në diçka të dhimbshme dhe të

vështirë. Ashtu si çifutët pretendonin se e respektonin ligjin, në të njëjtën mënyrë papistët pretendojnë se e respektojnë kryqin. Ata e lartësojnë simbolin e vuajtjeve të Krishtit, ndërkohë që në jetët e tyre e mohojnë Atë, që përfaqëson ky simbol.

Papistët vendosin kryqe mbi kishat, altarët dhe veshjet e tyre. Kudo shihet shenja e kryqit. Në pamje të parë duket sikur kudo nderohet dhe lartësohet Ai. Megjithatë mësimet e Krishtit janë varrosur nën një meshë mbushur me tradita pa kuptim, interpretime të rreme dhe kërkesa strikte. Fjalët e Shpëtimtarit në lidhje me çifutët fanatikë i drejtohen me forcë akoma më të madhe udhëheqësve të Kishës Katolike Romane. "Ata lidhin barrë të rënda, që mbarten me vështirësi dhe ua vënë mbi kurriz njerëzve. Por ata nuk duan ta luajnë vetë as me gisht" *(Mateu 23:4)*. Me mijëra njerëz të ndërgjegjshëm, duke pasur frikë nga një i ofenduar mbahen nën një tmerr të vazhdueshëm, ndërsa shumë nga funksionarët e lartë të kishës jetojnë në luks dhe epsh.

Adhurimi i idhujve dhe relikteve, lutjet drejtuar shenjtorëve dhe lartësimi i papës nuk janë asgjë tjetër veçse mënyra që përdor Satani për t'i larguar mendjet njerëzore nga Zoti dhe Biri i Tij. Në mënyrë që t'i rrënojë ata plotësisht ai përpiqet që t'i largojë ata nga Ai që është i vetmi që mund t'ju sjellë shpëtim. Ai do t'i drejtojë ata drejt çdo objekti, që mund të zëvendësojë Atë që tha: "Ejani tek Unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar dhe Unë do t'ju jap çlodhje" *(Mateu 11:28)*

Satani përpiqet vazhdimisht që ta keqinterpretojë karakterin e Perëndisë, natyrën e mëkatit dhe çështjet e rëndësisë së veçantë në kontradiktën e madhe. Me mendjemprehtësinë e tij ai orvatet që ta minojë detyrimin që mbart ligji hyjnor dhe u jep njerëzve të drejtën për të mëkatuar. Në të njëjtën kohë ai i bën ata që të kenë një koncept të gabuar për Perëndinë në mënyrë që ta shohin Atë me frikë dhe urrejtje dhe jo me dashuri. Mizoria, që është pjesë përbërëse e karakterit të tij i vishet Krijuesit, ajo ndërthuret në sistemet fetare dhe shprehet në mënyrat e adhurimit. Kështu mendjet e njerëzve mpihen dhe Satani i kthen ata në agjentë të tij në luftën kundër Perëndisë. Kombet pagane,duke shtrembëruar të vërtetën e cilësive hyjnore besonin se për të fituar simpatinë e Perëndisë nevojiteshin flijime njerëzore dhe këtu e kanë zanafillën mizoritë e tmerrshme, që janë kryer nën forma të ndryshme idhujtarie.

Kisha Katolike Romane, duke ndërthurur paganizmin me Kristianizmin dhe ashtu si paganët, duke keqinterpretuar karakterin e Perëndisë, ka përdorur praktika po aq mizore dhe revoltuese. Roma përdorte në ditët e pushtetit të saj suprem mjete torture për t'i detyruar njerëzit që t'i miratonin doktrinat e saj. Ata që nuk i nënshtroheshin pretendimeve të saj i priste turra e druve. Masakrat ishin të një shkalle të tillë që do të na zbulohen vetëm në ditën e gjykimit. Kokat e mëdha të kishës studiuan nën drejtimin e Satanit - mësuesit të tyre, për të shpikur mjetin që do të mund të sillte dhimbjen më therëse të mundshme pa i dhënë fund jetës së viktimës.

Në pjesën më të madhe të rasteve ky proçes skëterre përsëritej derisa arrihej caku përfundimtar i durimit njerëzor, natyra pushonte së luftuari dhe njeriu - viktimë arrinte deri aty sa e priste vdekjen si një çlirim të ëmbël.

Një fat të tillë patën kundërshtarët e Romës. Ajo u rezervoi pasuesve të saj disiplinën e kamxhikut, të urisë dhe të vuajtjeve trupore në formën e tyre më të ashpër dhe më mizore. Në mënyrë që të fitonin dashamirësinë e Perëndisë besimtarët shkelnin me këmbë ligjet e Tij, duke përbaltur ligjet e natyrës. Ata ishin edukuar me dëshirën për të këputur ato lidhje, që Zoti i kishte krijuar për ta bekuar e për ta bërë më të lumtur qëndrimin e përkohshëm të njerëzve në tokë. Oborret e kishave janë dëshmitare të mijëra viktimave, që gjatë gjithë jetës së tyre u përpoqën më kot që të nënshtronin çdo ndjenjë të natyrshme dashurie, që të shtypnin si diçka fyese ndaj Perëndisë çdo mendim dhe ndjenjë simpatie për bashkëkohësit e tyre.

Në qoftë se duam ta kuptojmë mizorinë pakufi të Satanit, të shfaqur për qindra vjet me radhë jo në radhët e atyre njerëzve, që nuk kanë dëgjuar kurrë për Zotin, por pikërisht në qendër të Kristianizmit, duhet t'i hedhim një sy historisë së Kishës së Romës. Princi i errësirës arrin përmes këtij sistemi të stërmadh mashtrimi qëllimin e tij; përdhosjen e figurës së Zotit dhe rrënimin e njerëzve. E ndërsa shohim se sa i suksesshëm është ai në maskimin e vetvetes dhe në arritjen e qëllimeve të tij përmes udhëheqësve të kishës, ne arrijmë të kuptojmë më mirë arsyet e antipatisë që ai ushqen për Biblën. Në rast se do të lexohej ai Libër në të do të shfaqeshin qartë dashuria dhe mëshira e Perëndisë, do të vihej re se Ai nuk i ngarkon njerëzit me të tilla barra të rënda. Ai kërkon gjëra të thjeshta, një zemër të penduar e të lënduar dhe një shpirt të përulur e të bindur.

Gjatë jetës së Tij Krishti nuk dha asnjë shembull që të inkurajonte burrat dhe gratë të mbylleshin në manastire, në mënyrë që të bëheshin të denjë për të shkuar në parajsë. Ai nuk na ka mësuar kurrë që të mos i përfillim ndjenjat e dashurisë dhe simpatisë. Në zemrën e Shpëtimtarit kishte vetëm dashuri. Sa më shumë t'i afrohet njeriu përkryerjes morale aq më të mprehta bëhen ndjenjat e tij, aq më i saktë është koncepti i tij mbi mëkatin dhe aq më e thellë është simpatia që ndjen ai për njerëzit e mjerë. Papa pretendon se është famullitar i Krishtit, po a mund të krahasohet karakteri i tij me atë të Shpëtimtarit tonë?

A i dërgoi ndonjëherë Krishti njerëzit në burg apo në rrënim të plotë vetëm sepse ata nuk e nderuan si Mbret i Qiellit që ishte? A u dëgjua ndonjëherë zëri i Tij, duke i dënuar me vdekje ata që nuk e pranuan? Kur banorët e një fshati samaritan nuk e përfillën aspak Jezusin, apostulli Gjon i indinjuar e pyeti: "Zot, a do të thuash të zbresë zjarr nga qielli dhe t'i përvëlojë, ashtu si bëri Elija?" Krishti e pa me keqardhje dishepullin e Tij dhe e qortoi për ashpërsinë e tij, duke thënë: "Biri i njeriut nuk erdhi për të shkatërruar shpirtrat e njerëzve, por për t'i shpëtuar ata" *(Luka 9:54,56)*. Fryma, që manifestoi Krishti ndryshon kaq shumë nga ajo e të ashtuquajturit famullitar të Tij!

Kisha e Romës tani i paraqet botës një pamje të lavdërueshme, duke i mbuluar me shpjegime të dhënat e mizorisë së saj të paparë. Ajo është veshur me petka të prera sipas kallëpit të Krishtit, por thelbi ka mbetur i njëjtë. Çdo parim i të shkuarës ekziston edhe sot e kësaj dite. Doktrinat, që u përpunuan në vitet e mesjetës mbahen akoma të gjalla. Askush të mos mashtrohet...Papati, që protestantët janë kaq të gatshëm ta nderojnë, është i njëjti që sundonte botën gjatë viteve të Reformacionit, kur njerëzit e Zotit ngritën zërin, duke vënë në rrezik jetën e tyre, për t'i çjerrë maskën paudhësisë së saj. Ai zotëron të njëjtën krenari dhe vetbesim që i dha atij mundësinë të sundonte mbi mbretër e princër e të kërkonte të nderohej si të ishte Perëndi. Fryma që ajo shfaq sot është po aq mizore dhe despotike sa ajo e shekujve më parë kur kjo fuqi i vuri shkelmin lirisë njerëzore dhe i shkoi në hell shenjtorët e më të lartit.

Papati është pikërisht ashtu siç e përshkruan profecia: apostazia e kohëve të vona *(2 Selanikasve 2:3,4)*. Ndërrimi i karakterit sipas nevojës dhe qëllimit që do të arrijë bën pjesë në politikën e saj; por nën pamjen e paqëndrueshme të kameleonit fshihet helmi i pandryshueshëm i gjarprit. Ajo deklaron: "Besimi nuk duhet mbajtur me heretikë dhe as me persona që dyshohen për herezi".[4] A mund të njihet kjo fuqi, ditari i së cilës është shkruar për mijëra vjet në gjakun e shenjtorëve, si pjesë e Kishës së Krishtit?

Pretendimi që ka lindur në vendet Protestante, sipas të cilit Katolicizmi nuk ndryshon aq shumë sa në të shkuarën me Protestanizmin nuk është pa bazë. Diçka ka ndryshuar, por ky ndryshim nuk vihet re tek papati. Në të vërtetë sot Katolicizmi i ngjan më shumë protestanizmit ekzistues dhe kjo ndodh, sepse protestanizmi ka degjeneruar shumë që nga koha e Reformatorëve.

Ndërsa kishat protestante janë përpjekur që të fitojnë simpatinë e botës, sytë e tyre i ka verbuar mirësia e rreme. Ata kanë harruar gjithçka tjetër dhe vetëm besojnë se duhet të gjejnë të mirën në diçka të keqe dhe si rrjedhim do të vijë një moment kur ata do të besojnë të keqen në diçka të mirë. Në vend që të mbrojnë besimin, që ua lanë trashëgim shenjtorët, ata po i kërkojnë falje Romës për opinionin e pamëshirshëm që kishin për të dhe për fanatizmin e tyre absurd.

Një grup i madh njerëzish, madje edhe ata, që nuk e shohin me sy të mirë kishën e Romës, nuk e kuptojnë aq sa duhet rrezikun që mbart pushteti dhe influenca e saj. Shumë prej tyre janë të mendimit se errësira morale dhe intelektuale, që mbizotëronte në Mesjetë e favorizoi përhapjen e dogmave, bestytnive dhe shtypjes së saj dhe se inteligjenca e kohëve moderne, përhapja më e madhe e dijeve dhe rritja e liberalizmit në lidhje me çështjet fetare do t'i vërë kufi rilindjes së tiranisë dhe robërisë. Vetëm mendimi që në këtë periudhë kaq të sofistikuar gjërat mund të kthehen në origjinën e tyre i bën njerëzit të qeshin. Eshtë e vërtetë që ky brez

[4] Lenfant, vëll. I, faqe 516

është dëshmitar i një drite më të plotë intelektuale, morale dhe fetare. Nga faqet e hapura të Fjalës së Shenjtë të Zotit lumenj drite nga qielli kanë zbritur mbi tokë. Por mos harroni, sa më e madhe të jetë drita e fituar, aq më e madhe është errësira, që mbulon ata që e shtrembërojnë dhe e mohojnë.

Lutja dhe studimi i vëmendshëm i Biblës duhet t'u tregojë Protestantëve karakterin e vërtetë të papatit dhe duhet t'i bëjë ata të mos ta përfillin dhe t'i ruhen atij, por shumë prej tyre mendojnë se janë kaq të zgjuar sa nuk kanë nevojë t'i kërkojnë me përulje Zotit përgjigje, në mënyrë që Ai t'i drejtojë hapat e tyre drejt së vërtetës. Megjithëse krenohen me këtë zgjuarësi të madhe, ata janë të paditur përsa u përket si Shkrimeve të Shenjta ashtu edhe fuqisë së Perëndisë. Atyre u duhet diçka që t'i qetësojë ndërgjegjet e tyre dhe ata kërkojnë atë rrugë, që është më pak shpirtërore dhe fyese. Ata duan të gjejnë një mënyrë që ta harrojnë Zotin, por që në të njëjtën kohë, të duket si një metodë që do t'i ndihmojë ata "ta kujtojnë" Atë. Papati është i pajisur mirë me gjithçka që mund t'i plotësojë nevojat e të gjithë këtyre njerëzve. Eshtë një tërësi e përgatitur për t'iu përgjigjur dy klasave njerëzore ose me fjalë të tjera, pothuajse të gjithë botës - atyre, që duan të shpëtohen nga meritat e tyre dhe atyre, që duan të shpëtohen në mëkatet e tyre. Ky është sekreti i fuqisë së tij.

Eshtë provuar se një ditë errësirë e madhe intelektuale ndihmon në suksesin e papatit. Do të provohet se edhe një ditë dritë e madhe intelektuale është po aq e favorshme për arritjen e suksesit të tij. Në shekujt e mëparshëm, kur njerëzve u ishte mohuar fjala e Perëndisë dhe njohuria e të vërtetës, sytë e tyre ishin të mbyllur dhe me mijëra njerëz, duke mos e parë rrjetën e shpalosur përpara këmbëve të tyre, binin në kurth. Në ditët tona sytë e shumë njerëzve verbohen nga shkëlqimi i spekulimit njerëzor, që gabimisht quhet "shkencë", as këta të fundit nuk e shquajnë dot rrjetën dhe shkojnë tek ajo me këmbët e tyre thua se janë me sy të mbyllur. Sipas planit të Zotit fuqia intelektuale e njeriut duhet të ruhet si dhuratë nga Krijuesi dhe duhet të përdoret në shërbim të së vërtetës dhe të drejtës, por kur krenaria dhe ambicia marrin jetë dhe njerëzit i ngrenë teoritë e tyre mbi fjalën e Perëndisë, atëherë inteligjenca është shumë më e dëmshme se injoranca. Kështu, shkenca e rreme e ditëve tona, që shkatërron besimin tek Bibla, do të jetë po aq e suksesshme në përgatitjen e rrugës për pranimin e papatit dhe formave të tij joshëse sa ç'ishte dikur mohimi i dijeve në hapjen e rrugës për lulëzimin e tij në Mesjetë.

Me lëvizjet që po zhvillohen tani në Shtetet e Bashkuara për të siguruar mbështetjen e shtetit për institucionet dhe veprimtaritë e kishës, protestantët po ndjekin rrugën e papistëve. E për më tepër ata po i hapin derën papatit që të rifitojë në Amerikën Protestante pushtetin suprem që ka humbur në Botën e Vjetër[5]. "Kjo lëvizje bëhet më domethënëse nga fakti se qëllimi kryesor i saj është përforcimi i ritit të adhurimit ditën e Dielë - një zakon ky që e ka zanafillën në Romë dhe që kjo

[5] Bota e vjetër përfshin Evropën, Azinë, Afrikën.

e fundit e quan shenjë të auroritetit të saj. Fryma a papatit - fryma e shkrirjes me zakonet e botës dhe lartësimit të traditave njerëzore mbi urdhëresat e Perëndisë - po përhapet në kishat protestante dhe po i detyron ato të nderojnë të Dielën, duke çuar kështu përpara punën që papati e ka nisur kohë më parë.

Në rast se lexuesi do t'i kuptonte forcat që do të ballafaqohen në mosmarrëveshjen e afërt, atij s'do t'i mbetej asgjë tjetër veçse të studionte mënyrat që ka përdorur Roma në të shkuarën për të njëjtin qëllim. Ah, sikur ta dinte se si papistët dhe Protestantët me forca të bashkuara do t'i trajtojnë ata, që mohojnë dogmat e tyre! Le të vëmë re me kujdes frymën që manifestoi Roma në lidhje me Sabatin dhe përkrahësit e tij.

Dekrete mbretërorë, këshilla të përgjithshme dhe urdhëresa kishëtare të përkrahura këto edhe nga pushtete sekulare i dhanë festivalit pagan vendin e nderit në botën e Krishterë. Masa e parë publike, që çoi në respektimin e detyrueshëm të së Dielës ishte ligji i nxjerrë dhe dekretuar nga Kostandini (321 e.s.). Në bazë të këtij dekreti banorët e qyteteve duhet të pushonin "në ditën e diellit", ndërsa fshatarët mund ta vazhdonin punën e tyre. Edhe pse ky s'ishte asgjë tjetër veçse një rit pagan, ky rit u bë ligj menjëherë, pasi perandori e pranoi zyrtarisht Kristianizmin.

Duke qënë se mandati mbretëror nuk mund ta zëvendësonte plotësisht autoritetin hyjnor, Eusebius, një peshkop, që kërkonte simpatinë e princërve dhe që ishte mik i ngushtë dhe lajkatar i Kostandinit nxori pretendimin se ishte Krishti, Ai që e kishte "transferuar" Sabatin nga e Shtuna tek e Diela. Në Shkrimet e Shenjta nuk u gjet as edhe një dëshmi e vetme në mbrojtje të kësaj doktrine të re. Vetë Eusebius pa dashje e pranon fallsitetin e kësaj ideje dhe na tregon autorët e vërtetë të këtij ndryshimi. "Gjithçka - thotë ai - që duhet bërë në Sabat, ne e kemi transferuar në Ditën e Zotit".[6] Por megjithëse ideja e të Dielës është krejtësisht pa bazë, ajo u dha zemër njerëzve që ta flaknin tej Sabatin e Zotit. Të gjithë ata, që donin të fitonin respektin e botës pranuan këtë festë popullore.

Me të marrë pushtetin në dorë papati, puna për lartësimin e të Dielës mori përpjestime gjithnjë e më të mëdha. Për një farë kohe njerëzit, që merreshin me bujqësi nuk shkuan në kishë dhe dita e shtatë vazhdoi të konsiderohej si Sabat. Por dalëngadalë diçka ndryshoi. Atyre që punonin në zyrën e shenjtë (gjykatë) iu ndalua gjykimi i civilëve të Dielën. Pak pas kësaj mase, të gjithë njerëzit çfarëdo lloj pozite, u urdhëruan të mos punonin të Dielën, në rast të kundërt njerëzve të lirë do t'u duhej të paguanin gjobë, ndërsa shërbëtorët do të rriheshin me thupër. Më vonë doli një dekret tjetër sipas të cilit të pasurit do të dënoheshin me humbjen e gjysmës së pasurisë së tyre dhe së fundi nëse ata vazhdonin të tregoheshin kokëfortë do të humbisnin lirinë, duke u kthyer në skllevër. Klasat e ulëta të shoqërisë do të dënoheshin me dëbim të përjetshëm.

---

[6] Robert Cox, "Sabbath Laws and Sabbath Duties", faqe 538

Më pas u kërkua raportimi me shkrim i çdo mrekullie. Mes të tjerave u raportua një mrekulli e tillë: ndërsa një kryefamiljar, që po bëhej gati të plugonte tokën e tij të Dielën dhe pastroi plugun me një hekur, hekuri iu ngjit në dorë dhe ai vazhdoi ta mbante atë me vete për dy vjet rresht i turpëruar, duke duruar një dhimbje therrëse."[7]

Më vonë papa urdhëroi që priftërinjtë e famullive duhet t'i paralajmëronin të gjithë njerëzit që nuk e respektonin të Dielën, t'i nxisnin ata të shkonin në kishë dhe të luteshin për ta, përndryshe si ata ashtu edhe fqinjët e tyre do të përjetonin fatkeqësi të mëdha. Një këshillë kishtare hodhi idenë e përkrahur, që nga ajo kohë edhe nga Protestantët. Duke qënë se njerëzve të ndryshëm u kishte rënë rrufeja, ndërsa po punonin të Dielën kjo ditë duhet të jetë Sabati.

"Duket qartë - thanë prelatët - se Perëndia ishte i pakënaqur nga fakti që ata e kishin lënë pas dore këtë ditë". Më pas iu bë thirrje priftërinjve dhe pastorëve, mbretërve dhe princërve dhe të gjithë besimtarëve "që të bënin gjithçka që kishin në dorë që kësaj dite t'i rikthehej nderi i humbur dhe të respektohej me devotshmëri edhe në të ardhmen."[8]

Duke qënë se dekretet e këtyre këshillave fetare nuk gjetën përgjigjen e duhur, u nxitën autoritetet sekulare, të cilat nxorën një ligj, që ngjalli tmerr dhe frikë në zemrat e njerëzve dhe që i detyroi ata të hiqnin dorë nga puna ditën e Dielë. Në një sinod të mbajtur në Romë u riafirmuan me një forcë dhe solemnitet akoma më të madh të gjitha vendimet e mëparshme. Ato u përfshinë gjithashtu në ligjin kishëtar dhe u përforcuan nga ligjet e nxjerra nga autoritetet civile të pothuajse të gjitha vendeve të krishtera. (Të shihet Heylyn "History of Sabbath", pjesa 2, kap. 5, seksioni 7[9])

Megjithatë, mungesa e dëshmive Biblike në mbrojtje të adhurimit ditën e Dielë vazhdonte t'i vinte në siklet autorët e këtij ndryshimi. Njerëzit vazhdonin të vinin në dyshim të drejtën e mësuesve të tyre për të mos e përfillur deklaratën e Jehovait "Dita e shtatë është Sabati i Zotit, Perëndisë suaj", për të mbajtur të shenjtë ditën e diellit. Për të zëvendësuar thëniet biblike duheshin gjetur të dhëna të tjera bindëse. Nga fundi i shekullit të XII-të një avokat mbrojtës i zellshëm i së Dielës vizitoi kishat e Anglisë ku iu desh të përballonte shumë dëshmitarë besnikë të së vërtetës. Kaq të pasuksesshme ishin fillimisht përpjekjet e tij saqë ai u detyrua të largohej nga vendi për një farë kohe dhe të kërkonte "fakte" të reja në mbështetje të mësimeve të tij. Kur u kthye përsëri gjërat kishin ndryshuar dhe puna e tij e mëvonshme njohu deri diku disa rezultate inkurajuese. Ai solli me vete një cilindër, që mendohej se ishte dërguar nga Zoti vetë. Cilindri përmbante edhe urdhëresën e shumëdëshiruar të adhurimit ditën e Dielë, urdhëresë e cila shoqërohej me kërcënime të tmerrshme

---

[7] Francis West, "Historical and Practical discourse on the Lord's Day", faqe 174

[8] Thomas Morer "Discourse in Six Dialogues on the Name, Notion and Observation of the Lord's Day" faqe 271

[9] Të shihet Heylyn "History of Sabbath", pjesa 2, kap. 5, seksioni 7

për të pabindurit. Thuhej se ky dokument i çmuar - një mashtrim ky po aq i ulët sa edhe ideja që mbështeste - kishte rënë nga qielli dhe ishte gjetur në Jeruzalem mbi altarin e Shën Simonit në Golgota. Por në fakt ishte pallati i papës në Romë burimi i vërtetë nga ku doli ai. Që të fitonte pushtet e prosperitet kisha, hierarkia e papës i ka quajtur të ligjshme të gjitha mashtrimet dhe fallsifikimet që i është dashur të kryejë në shekuj.

Cilindri ndalonte punën nga ora e nëntë d.m.th. nga ora 3.00 pasdite të Shtunën deri në lindjen e diellit të Hënën dhe thuhej që vërtetësia e tij ishte konfirmuar nga një numër i madh mrekullish. U raportua se njerëzit, që kishin kryer punë gjatë orëve të pushimit ishin paralizuar. Një mullixhi, që u përpoq të bluante grurë, pa të dilte në vend të miellit një rrjedhë gjaku dhe vuri re se guri i mullirit nuk lëvizte, pavarësisht nga lëvizja e vrullshme e ujit. Një grua që vuri brumë në furrë e gjeti atë të papjekur kur e nxori nga furra edhe pse vetë furra ishte shumë e nxehtë. Një grua tjetër që e kishte bërë gati brumin për ta pjekur në orën e nëntë (orën 3.00) dhe që vendosi të mos e gatuante deri të Hënën vuri re se të nesërmen brumi ishte ndarë në copa dhe ishte pjekur nga fuqia hyjnore. Një burrë, që poqi bukë pas orës së nëntë të së Shtunës, kur e ndau për ta ngrënë të nesërmen, pa të dilte gjak nga buka. Avokatët mbrojtës të së Dielës u përpoqën ta ligjëronin shenjtërinë e saj me ndihmën e këtyre trillimeve superstticioze dhe absurde [10]

Në Skoci, ashtu si në Angli, respektimi i së Dielës u sigurua, duke i bashkangjitur asaj një pjesë të Sabatit të dikurshëm. Por koha, që kërkohej të mbahej e shenjtë ndryshonte. Në një vendim të mbretit të Skocisë thuhej se "e Shtuna nga ora 12.00 e mesditës duhet të konsiderohet e shenjtë" dhe se askush nuk duhej të punonte nga ajo orë deri të Hënën në mëngjes."[11].

Por, pavarësisht nga përpjekjet e bëra për ta veshur të Dielën me një petk shenjtërie vetë papistët kanë deklaruar publikisht autoritetin hyjnor të Sabatit dhe origjinën njerëzore të atij riti që e ka zëvendësuar atë. Në shekullin e XVI-të një këshill i kishës së papës deklaroi qartë: "Të mos harrojnë të Krishterët se dita e shtatë është shenjtëruar nga vetë Perëndia dhe është pranuar dhe respektuar si e tillë jo vetëm nga çifutët, por nga të gjithë ata, që pretendojnë se e adhurojnë Zotin, edhe pse ne të Krishterët e kemi ndryshuar Sabatin e tyre në ditën e Zotit."[12] Ata, që po hidhnin baltë mbi ligjin hyjnor ishin më se të ndërgjegjshëm për karakterin e punës së tyre. Ata po vetëvendoseshin me vetëdije të plotë mbi Perëndinë.

Një shembull i qartë i politikës së Romës në lidhje me të gjithë ata, që nuk bien dakort me të është edhe persekutimi i gjatë dhe i përgjakshëm që i bëri ajo Waldenasve, disa prej të cilëve mbanin Sabatin e vërtetë. Edhe shumë të tjerë kanë vuajtur në të njëjtën mënyrë për shkak të besnikërisë që kanë treguar ndaj urdhëresës së

[10] Të shihet "Annals" i Roger de Hoveden, vol. 2, faqe 528-530).
[11] Morer, faqe 290-291
[12] Ibid., faqe 281, 282

katërt. Historia e kishave të Etiopisë dhe Abisinisë është veçanërisht domethënëse. Mes errësirës së mesjetës, të Krishterët e Afrikës Qendrore u harruan nga pjesa tjetër e botës dhe për shekuj me radhë ata qenë në gjendje ta ushtronin të lirë besimin e tyre. Por më së fundi Roma dëgjoi për ekzistencën e tyre dhe perandori i Abisinisë u detyrua ta njihte papën si famullitar të Krishtit. Këtë e pasuan ndryshime të tjera. U miratua një dekret që ndalonte respektimin e Sabatit nën dënimet më të ashpra e mizore."[13] Por tirania e papatit shumë shpejt u kthye në një zgjedhë kaq mbytëse sa që banorët e Abisinisë vendosën ta heqin qafe atë. Pas përpjekjesh të vazhdueshme papistët u dëbuan nga qendrat e tyre dhe ata iu rikthyen përsëri besimit të mëparshëm. Kishat iu gëzuan lirisë së fituar dhe nuk e harruan kurrë mësimin që morën në lidhje me mashtrimin, fanatizmin dhe fuqinë despotike të Romës. Brenda territoreve të tyre të veçuara ata ishin të lumtur që jetonin larg pjesës tjetër të të Krishterëve.

Kishat e Afrikës e mbanin Sabatin ashtu si mbahej edhe nga kisha e papës përpara apostazisë së saj të plotë. Ndërsa mbanin ditën e shtatë të shenjtë, duke iu bindur kështu urdhëresës së katërt të Perëndisë, ata nuk punonin të Dielën në përputhje me zakonin e kishës. Me të fituar pushtet suprem Roma e shkeli me këmbë Sabatin e Zotit për të lartësuar Sabatin e vet, por kishat afrikane të fshehura për më se 1000 vjet nga bota nuk patën gisht dhe as nuk morën pjesë në këtë apostazi. Por me të rënë rob të Romës ata u detyruan ta flaknin tej Sabatin e vërtetë e të përqafonin të rremin, por sapo rifituan pavarësinë e dikurshme ata iu rikthyen zakonit të vjetër të bindjes ndaj urdhëresës së katërt.

Këto të dhëna të së shkuarës shprehin qartë armiqësinë e Romës ndaj Sabatit të vërtetë dhe mbrojtësve të tij, si dhe rrugët që përdori ajo për të nderuar "krijimin" e vet. Fjala e Perëndisë na mëson se të gjitha këto skena do të përsëriten atëherë kur katolikët dhe protestantët do të bashkohen në lartësimin e të Dielës.

Profecia tek Zbulesa 13 na tregon se fuqia, që përfaqësohet nga bisha me dy brirë të cilët i ngjajnë atyre të qingjit do të bëjë që "dheu dhe banorët e tij" të adhurojnë papatin - që këtu simbolizohet nga bisha "që i ngjante leopardit". Bisha me dy brirë do t'u thotë: "banorëve të dheut t'i bëjnë një figurë bishës" e për më tepër ajo do t'i urdhërojë të gjithë "të vegjël e të mëdhenj, të pasur e të varfër, të lirë dhe skllevër" të pranojnë damkën e bishës. *(Zbulesa 13:11-16)*. Është vërtetuar që bisha me dy brirë, që i ngjajnë atyre të qengjit është Amerika dhe që profecia do të përmbushet kur Shtetet e Bashkuara do ta bëjnë respektimin e së Dielës, që me fjalë të tjera do të thotë njohje e pushtetit suprem të Romës, të detyrueshëm. Por Shtetet e Bashkuara nuk do të jenë të vetmet që do t'i përulen papatit. Ndikimi i Romës në vendet që dikur e njihnin sundimin e saj nuk është zhdukur aspak. Profecia parashikon një rilindje të fuqisë së saj. "Pashë një nga krerët e saj si të plagosur për vdekje,

[13] Të shihet "Church History of Ethiopia" Michael Geddes, faqe 311,312

por plaga e saj vdekjeprurëse u shërua dhe gjithë dheu u mrekullua pas bishës" *(versa 3)*. Përmendja e plagës vdekjeprurëse tregon rrapëllimën që mori papati në vitin 1798. Pas kësaj thotë profeti "plaga e saj vdekjeprurëse u shërua dhe gjithë dheu u mrekullua pas bishës". Pali thekson se "njeriu i mëkatit" do ta vazhdojë punën e tij deri në ardhjen e dytë." *(2 Selanikasve 2:3-8)*. Në fund të kohës ai do t'i drejtojë të gjitha energjitë e tij në detyrën e vështirë të mashtrimit. Duke iu referuar papatit Gjoni deklaron: "Dhe do ta adhurojnë të gjithë banorët e dheut, emrat e të cilëve nuk janë shkruar në librin e jetës" *(Zbulesa 13:8)*. Papati do të nderohet si nga Bota e re, ashtu edhe nga Bota e Vjetër falë respektimit që do t'i bëhet të Dielës, këtij riti që e ka zanafillën tek kisha e Romës.

Që nga mesi i shekullit të XIX-të studiuesit e profecisë në Shtetet e Bashkuara i kanë parashtruar botës të njëjtën dëshmi. Ngjarjet, që po ndodhin sot në botë po çojnë në përmbushjen e profecive. Mësuesit protestantë mbrojnë pretendimin absurd se respektimi i së Dielës ka themele hyjnore dhe besojnë të njëjtën mungesë provash biblike, duke u bërë kështu një trup i vetëm me mësuesit e papatit që "shpikën" mrekulli për të zëvendësuar urdhëresën e Perëndisë që mungonte. Ideja se Perëndia do t'i dënojë njerëzit që nuk do ta respektojnë të Dielën - Sabat do të përsëritet dhe në fakt është duke hedhur rrënjë në mendjet e njerëzve. Madje po gjen përkrahje edhe një lëvizje, qëllimi i vetëm i të cilës do të jetë kthimi i të Dielës në ditë adhurimi të detyrueshëm.

Kisha e Romës të mahnit me dhelpërinë dhe zgjuarsinë e saj. Ajo mund ta parashikojë deri diku të ardhmen. Duke vënë re se kishat Protestante po e respektojnë atë vetë, duke pranuar sabatin e rremë dhe po bëjnë përgatitjet e duhura për ta bërë këtë rit të detyrueshëm, duke përdorur të njëjtat forma që ajo vetë përdorte dikur. Ajo po pret rastin e volitshëm. Ata që e mohojnë dritën e së vërtetës do të vazhdojnë të kërkojnë ndihmën e kësaj fuqie të vetëkrijuar dhe "të pagabueshme" për të lartësuar një rit që e ka zanafillën tek ajo vetë. Dhe nuk është e vështirë të imagjinosh se sa e gatshme do të jetë ajo për të ndihmuar protestantët në realizimin e këtij qëllimi. Kush di më mirë se udhëheqësit e papatit si t'i trajtojë të gjithë ata që nuk i binden kishës?

Kisha Katolike romake si edhe degët e saj në të gjithë botën formojnë një organizatë të madhe, që është nën kontroll dhe i shërben nevojave të papatit. Përfaqësuesit e saj në çdo vend të globit, që janë me miliona, i betohen për besnikëri papës. Pavarësisht nga kombësia apo forma e qeverisjes atyre u kërkohet që ta konsiderojnë autoritetin e kishës mbi gjithçka tjetër. Megjithëse ata mund të betohen për t'i qëndruar besnikë shtetit para kësaj qëndron besimi për bindje ndaj Romës që ka forcën ta zhvleftësojë çdo lloj lidhje tjetër, që mund të cënojë interesat e kishës.

Historia është dëshmitare e përpjekjeve të saj të vazhdueshme dhe të zgjuara për të ndërhyrë në punët e kombeve të ndryshme; dhe me të fituar pikët e para për t'i

çuar deri në fund qëllimet e saj edhe sikur kjo të kërkojë rrënimin e princëve dhe popujve. Në vitin 1204 Papa Innocent i tretë arriti ta bënte Pjetrin e Dytë mbretin e Arragonit t'i betohej atij në këtë mënyrë: "Unë, Pjetri, mbret i arragonasve, shpall publikisht dhe premtoj që do të jem besnik dhe i bindur ndaj Zotit tim, Papës Innocent, ndaj pasuesve të tij Katolikë si edhe ndaj kishës së Romës. Betohem se mbretëria ime do t'i bindet me besnikëri atij, duke mbrojtur besimin katolik dhe duke persekutuar heretikët."[14] Kjo përputhet me pretendimet, që kanë të bëjnë me pushtetin e ushtruar nga papa i Romës, sipas të cilave "është më se e ligjshme që ai të rrëzojë nga pushteti perandorët" dhe "të çlirojë popujt nga betimet që kanë bërë për t'i qëndruar besnik sundimtarëve të padenjë."[15]

Mos harroni, Roma mburret me faktin që ajo nuk ndryshon kurrë. Parimet e Gregorit të Shtatë dhe Innocentit të Tretë vazhdojnë të jenë parimet e Kishës Katolike të Romës. E sikur të kishte fuqinë e duhur ajo do t'i zbatonte ato me po atë zell që ka treguar në të shkuarën. Protestantët nuk dinë se ç'po bëjnë kur pranojnë ndihmën që u afron Roma në përpjekjet e përbashkëta për ta lartësuar të Dielën. Ndërsa ata janë të dhënë pas realizimit të qëllimit të tyre, Roma po synon të rifitojë pushtetin e duhur dhe të rizbulojë epërsinë e humbur. Me t'u pranuar në Shtetet e Bashkuara parimi që kisha mund të përdorë apo të kontrollojë pushtetin shtetëror, që ligjet sekulare mund t'i bëjnë të detyrueshme ligjet fetare, shkurt, që autoriteti i kishës dhe i shtetit mund të mbizotërojë ndërgjegjen, Roma do të triumfojë në këtë vend.

Fjala e Perëndisë na ka paralajmëruar për këtë rrezik që po na vjen rrotull; sikur të mos i vihet veshi këtij paralajmërimi bota Protestante do t'i mësojë se cilat janë qëllimet e vërteta të Romës vetëm kur të jetë tepër vonë për t'i shpëtuar kurthit të saj. Ajo po ngjit në heshtje shkallët e pushtetit. Doktrinave të saj po u vihet veshi në sallat e mbledhjeve, në kisha dhe në zemrat e njerëzve. Ajo po i grumbullon strukturat e saj kryeneçe dhe masive në skutat e fshehta ku do të përsëriten persekutimet e mëparshme. Ajo po mbledh forcat me ngadalë dhe pa ngjallur dyshime për të realizuar, me te ardhur momenti i duhur, qëllimet e saj. Asaj i duhet vetëm terreni i favorshëm dhe ky po i jepet pa kursim. Shumë shpejt do ta shohim dhe do të ndiejmë se cili është qëllimi i elementeve të Romës. Këdo që do t'i besojë dhe do t'i bindet fjalës së Perëndisë do ta presin qortime dhe persekutime.

1. Çështja e Sabatit do të jetë në qendër të konfliktit final. Përse është kaq i shqetësuar Perëndia për diçka që shumë veta mendijnë se është një detaj i vogël?

[14] "The History of Romanism" John Dowling, libri 5, kap. 6, seksioni 55

[15] Mosheim, libri 3, pjesa 2, kap. 2, seksioni 9, shënimi 17

2. Cila është lidhja midis lirisë së ndërgjegjes dhe Sabatit të vërtetë të ditës së shtatë? A po ndodhin ngjarje në vendin tuaj që mund të kërcënojnë lirinë e ndërgjegjes?

3. Në cilat mënyra po bashkohen Katolikët me Protestantët sot? Në çmënyrë kjo është një përmbushje e profecisë?

4. Ka shumë të Krishterë të dedikuar Brenda komunitetit Katoliko-Roman. Cilat janë karakteristikat shpirtërore të këtyre bijëve të Perëndisë? Çfarë do bëjë Perëndia për t'i ndihmuar dhe drejtuar ata tek e vërteta siç është në Jezusin?

5. Papati ka përzierë praktikat pagane me Krishtërimin. A ka ndonjë mënyrë se si mund të përziejmë praktikat e kësaj bote me adhurimin ndaj Perëndisë sonë?

36.

Konflikti i Pashmangshëm

Qëllimi i Satanit, që në fillim të kontradiktës së madhe qiellore, ka qënë ai i shkatërrimit të ligjit të Perëndisë. Ai rebeloi kundër Perëndisë për të arritur pikërisht këtë qëllim dhe megjithëse u dëbua nga qielli ai vazhdoi në tokë të njëjtën luftë absurde. Ai i ka hyrë punës për të mashtruar njerëzit, duke i bërë ata ta shkelin me këmbë ligjin hyjnor. S'ka rëndësi në se kjo do të arrihet duke e fshirë tërësisht ligjin apo duke "harruar" një nga urdhëresat e tij, rezultati do të jetë i njëjtë. Kush e shkel ligjin "në një pikë" tregon mospërfillje për ligjin në tërësi ai bëhet "fajtor në të gjitha pikat". *(Jakobi 2:10)*

Duke u përpjekur që të ngjallë urrejtje për urdhëresat hyjnore Satani shtrembëron doktrinat Biblike dhe besimi i mijëra njerëzve, që mendojnë se kanë si udhërrëfyese Shkrimet e Shenjta vishet me gabime. Konflikti i fundit mes së vërtetës dhe të rremes nuk është asgjë tjetër veçse beteja përfundimtare e kontradiktës, që ka vazhduar për një kohë të gjatë në lidhje me ligjin e Perëndisë. Ne po e fillojmë këtë betejë - betejën mes ligjeve njerëzore dhe urdhëresave të Jehovait, mes besimit të Biblës dhe besimit të përrallave dhe traditës.

Forcat, që do të bashkohen kundër të vërtetës dhe drejtësisë tani janë më se aktive. Fjala hyjnore e Perëndisë, e cila ka kaluar nga brezi në brez me gjak dhe sakrifica e ka humbur vlerën e saj. Biblën mund ta lexojnë të gjithë, por të paktë janë ata që me të vërtetë e pranojnë atë si udhërrëfyese në jetë. Pabesnikëria mbizotëron frikshëm jo vetëm në botë, por edhe në kishë. Shumë njerëz kanë arritur deri aty sa të mohojnë doktrina, të cilat përbëjnë shtyllat e besimit Kristian.

Pjesa më e madhe e botës së krishterë i kanë mohuar plotësisht apo pjesërisht faktet e mëdha të krijimit, mëkatin e parë të njeriut, dhuratën shlyese të kryqëzimit dhe natyrën e pandryshueshme dhe të përhershme të ligjit të Perëndisë. Me mijëra njerëz, që krenohen me mençurinë dhe pavarësinë e tyre e quajnë shenjë dobësie besimin e plotë dhe të patundur tek Bibla. Ata janë të mendimit se t'i sulmosh

Shkrimet e Shenjta, t'i pastrosh apo t'i zhveshësh nga kuptimi të vërtetat e tyre të mëdha është shenjë dije dhe talenti. Shumë pastorë po i mësojnë anëtarët e kishave të tyre, shumë profesorë dhe mësues po u thonë studentëve të tyre që ligji i Perëndisë ka ndryshuar apo është shfuqizuar dhe ata që i konsiderojnë urdhëresat e tij akoma në fuqi apo me fjalë të tjera që u binden atyre fjalë për fjalë meritojnë të tallen dhe të përbuzen.

Duke mohuar të vërtetën njerëzit mohojnë Autorin e saj. Duke shkelur me këmbë ligjin e Zotit ata mohojnë autoritetin e Ligjdhënësit. Të krijosh një idhull doktrinash dhe teorish të rreme është po aq e lehtë sa të gdhendësh një idhull druri apo guri. Duke i shtrembëruar vetitë e Perëndisë, Satani i bën njerëzit të krijojnë një mendim të gabuar mbi karakterin e tij. Për shumë njerëz në fronin e Jehovait është ulur një idhull i sofistikuar, ndërkohë që të paktë janë ata që adhurojnë Perëndinë që jeton, ashtu siç është përshkruar Ai në fjalën e Vet, në figurën e Krishtit dhe në mrekullitë e krijimit. Me mijëra njerëz hyjnizojnë natyrën, ndërsa mohojnë Zotin e natyrës. Idhujtaria ekziston sot në botën e Krishterë edhe pse në një formë të re po ashtu siç ekzistonte mes Izraelitëve të hershëm në kohën e Elijas. Zoti i shumë njerëzve të ashtuquajtur "të mençur", i filozofëve, poetëve, politikanëve, gazetarëve - zoti i rretheve "të llastuara" të shoqërisë, të shumë kolegjeve, universiteteve e madje të disa institucioneve fetare - nuk është aspak më i mirë se Baali, Perëndia - diell i Phoenicia-s.

Doktrina moderne, që po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha sipas së cilës njerëzit nuk janë të detyruar t'i binden më ligjit të Perëndisë, është gabimi më i madh i pranuar nga bota e krishterë, që cënon autoritetin qiellor, që i vë kufi zërit të arsyes dhe e rrezikon lirinë e besimit. Çdo komb ka ligjet e veta, që duhen respektuar dhe iu duhet bindur, asnjë qeveri nuk do të mbijetonte pa këto ligje, si mund të mendohet atëherë që Krijuesi i qiellit dhe i tokës nuk ka ligje për të qeverisur krijesat e veta? Mendoni çdo të ndodhë sikur ministra të mirënjohur t'u mësonin publikisht njerëzve se respektimi i ligjeve që qeverisin vendin dhe që mbrojnë të drejtat e shtetasve nuk është i detyrueshëm - se ato (ligjet) kufizojnë liritë e njerëzve e prandaj nuk duhen zbatuar, për sa kohë do t'u jepej e drejta e fjalës këtyre njerëzve? Çfarë është më e rëndë: mosrespektimi i ligjeve shtetërore dhe kombëtare apo shkelja me këmbë e urdhëresave hyjnore, që përbëjnë themelet e çdo lloj qeverisjeje?

Do të ishte më e pranueshme që kombet t'i shfuqizonin ligjet e tyre dhe t'i lejonin popujt të bënin çfarë të donin se sa Sundimtari i universit të anullonte ligjin e Tij dhe ta linte botën pa një standart gjykimi për fajtorin dhe shfajësimi për të bindurin. A i dimë ne vallë rezultatet që do të sillte mohimi i ligjit të Perëndisë? Një eksperiment i tillë është kryer. Franca u bë dëshmitare e skenave të tmerrshme kur ateizmi mori në dorë pushtetin. Pikërisht atëherë bota mësoi se të flakësh tej caqet e

vendosura nga Zoti do të thotë të pranosh sundimin e tiranëve më të pacipë. Me t'u mohuar standarti i drejtësisë, princit të errësirës i hapet rruga për të sunduar botën.

Aty ku nuk përfillen urdhëresat hyjnore, mëkati nuk duket më diçka e keqe dhe drejtësinë nuk e pëlqen askush. Ata që refuzojnë t'i nënshtrohen qeverisjes së Perëndisë, nuk janë në gjendje që të qeverisin as veten e tyre. Përmes mësimeve të tilla të rrezikshme në zemrat e fëmijëve dhe të rinjve, që nga natyra nuk e parapëlqejnë kontrollin, hidhet fara e mosbindjes dhe nga kjo rezulton një shoqëri e shthurur dhe pa ligje. Me mijëra njerëz, ndërsa tallen me besimin e atyre që iu binden urdhëresave të Perëndisë, pranojnë me etje të madhe zhgënjimet që iu ofron Satani. Në jetët e tyre mbretëron epshi dhe ata janë të dhënë pas atyre mëkateve, që çuan në gjykimin e paganëve.

Të gjithë ata, që i mësojnë njerëzit t'i marrin me shaka urdhëresat e Perëndisë, mbjellin mosbindje për të korrur mosbindje. Me t'u flakur tutje njëherë e përgjithmonë ligji hyjnor, ligjet njerëzore shumë shpejt do të shihen me mospërfillje. Duke qënë se Zoti ndalon praktikat e shthurura, lakminë, gënjeshtrën dhe mashtrimin, njerëzit janë të gatshëm të hedhin baltë mbi ligjin e Tij, sepse ai iu bëhet pengesë në rrugën "e përparimit" tokësor. Por groposja e këtyre urdhëresave do të sjellë rezultate të paparashikuara. Në qoftë se ligji nuk është i detyrueshëm pse duhet të kemi frikë ta shkelim atë? Pronat nuk do të ishin më të sigurta. Njerëzit do t'i vidhnin pasuritë e fqinjëve të tyre me dhunë dhe më të fortët do të ishin edhe me të pasurit. Do të humbiste edhe respekti për jetën vetë. Betimi martesor nuk do të ishte më një fortesë mbrojtëse për familjen. Ai që kishte fuqi e pushtet do të mund po të donte ta merrte gruan e tjetrit me dhunë.

Urdhëresa e pestë do të shkonte bashkë me të katërtën në kosh të plehrave. Fëmijët do t'i vrisnin pa frikë prindërit e tyre në qoftë se, duke bërë këtë do t'i bënin qejfin zemrës së tyre të korruptuar. Bota e qytetëruar do të kthehej në një hordhi grabitësish dhe vrasësish dhe paqja, qetësia dhe lumturia do të zhdukeshin nga faqja e dheut.

Doktrina, sipas së cilës njerëzit nuk janë të detyruar t'u binden urdhëresave të Perëndisë, ka filluar tashmë ta dobësojë forcën e detyrimit moral dhe i ka hapur derën paudhësisë. Paligjshmëria, shthurja dhe korrupsioni janë duke na përmbytur në formën e një rryme të helmët. Satani po punon edhe në familje. Flamuri i tij valëvitet edhe në të ashtuquajturat familje të Krishtera. Ekzistojnë në to zilia, hipokrizia, mendimet e liga, ftohja, sfida, grindjet, tradhëtia e të vërtetave hyjnore dhe dëshira për çthurje. I gjithë sistemi i parimeve dhe doktrinave fetare, që duhej të formonte themelin dhe strukturën e jetës sociale, s'është asgjë tjetër veçse një masë lëkundëse gati për t'u thyer në mijëra copëra. Kriminelët më të ulët, kur futen në burg për krimet që kanë kryer shpesh trajtohen me përkujdesje të veçanta a thua se janë veçuar nga të tjerët për t'u nderuar. Karakterit dhe krimeve të tyre i bëhet një

reklamim i paparë. Shtypi boton hollësitë revoltuese të krimit, duke i nxitur kështu të tjerët drejt mashtrimit, vjedhjes dhe vrasjes, ndërsa Satani ngazëllohet nga suksesi i skemave të tij djallëzore. Shtrirja e së keqes, vrasjet e kota, rritja e tmershme e padrejtësive të çdo klase dhe rangu duhet t'i bëjë të gjithë ata që e nderojnë Perëndinë të pyesin veten se çfarë mund të bëjnë për t'i bërë ballë kësaj rryme mëkati?

Gjykatësit janë të korruptuar. Sundimtarët nxiten vetëm nga dëshira për të fituar dhe nga dashuria për kënaqësi seksuale. Shumë njerëz janë verbuar nga bollëku që i rrethon, ndaj iu pëlqejnë bakshishet, u pëlqejnë shumë. Ligjvënësit janë mbartës të veseve të tilla si pija, çthurja, pasioni, zilia dhe shpërdhosja. "Drejtësia ka mbetur larg, sepse e vërteta ndodhet në shesh dhe paanësia nuk mund të hyjë në të" *(Isaia 59:14)*

Paudhësia dhe errësira shpirtërore, që mbizotëronin në vitet e pushtetit suprem të Romës ishin rezultatet e pashmangshme që solli shtypja që u bëri ajo Shkrimeve të Shenjta. Po cila është arsyeja e mohimit të ligjit të Perëndisë dhe e korruptimit që pasoi nën shkëlqimin e plotë të dritës së ungjillit në një kohë lirie fetare? Tani që Satani nuk mund ta mbajë më botën nën kontroll duke i fshehur asaj Shkrimet e Shenjta ai përdor mjete dhe rrugë të tjera për të arritur qëllimet e tij. Të shkatërrosh besimin në Bibël do të thotë shkatërrim i vetë Biblës dhe ky është qëllimi i tij. Duke hedhur idenë se ligji i Perëndisë nuk është i detyrueshëm ai i bën njerëzit që ta shkelin me këmbë atë në të njëjtën mënyrë që do ta shkelnin edhe sikur të mos dinin asgjë për urdhëresat e tij. Në ditët tona ashtu si në shkuarën ai përdor kishën për t'i thelluar e zgjeruar planet e tij. Sektet fetare të kohës sonë nuk ia kanë vënë veshin të vërtetave, që shfaqen qartë në Bibël, por që nuk gëzojnë simpatinë e njerëzve dhe në mënyrë që t'i luftojnë ato kanë bërë të vetat disa interpretime dhe ide, që kanë mbjellë kudo farat e skepticizmit. Duke përqafuar gabimin e Kishës së papës mbi pavdekshmërinë e natyrshme dhe ndërgjegjen në vdekje, ata kanë flakur tej të vetmet armë që kishin kundër përrallave të spiritualizmit. Doktrina e vuajtjeve pafund në ferr i ka bërë shumë njerëz që të heqin dorë nga besimi tek Bibla. E ndërsa përpara njerëzve shfaqet urdhëresa e katërt, e cila mban në vetvete respektimin e Sabatit, ditës së shtatë, shumë mësues "të mirënjohur" shohin si të vetmen rrugë për t'i bërë bisht një detyre, që nuk duan ta kryejnë, idenë se ligji i Perëndisë nuk është më në fuqi. Kështu ata hedhin poshtë si Sabatin ashtu edhe ligjin. Me zgjerimin e reformës së Sabatit ky mohim i ligjit hyjnor për të shmangur përgjegjësinë që mbart në vetvete urdhëresa e katërt do të bëhet pothuajse mbarëbotëror. Mësimet e disa udhëheqësve fetarë i kanë hapur rrugën mosbesimit, spiritualizmit dhe përçmimit për ligjin e shenjtë të Zotit; dhe këta udhëheqës fetarë mbajnë mbi supe një përgjegjësi të frikshme për paudhësinë, që ekziston në botën e krishterë.

Megjithatë është pikërisht ky grup njerëzish, që pretendon se fajin për përhapjen e shpejtë të korrupsionit e ka keqinterpretimi i të ashtuquajturit "sabat i

të Krishterëve" dhe se respektimi i detyrueshëm i të Dielës do ta përmirësojë shumë moralin e shoqërisë. Ky pretendim ka gjetur shtrirje të madhe në Amerikë, ku është predikuar shumë edhe doktrina e Sabatit të vërtetë. Këtu puna për ndalimin e pijeve alkoolike, një nga reformat më të njohura dhe më të rëndësishme morale, shoqëron shpesh lëvizjen pro të së Dielës dhe avokatët mbrojtës të kësaj të fundit hiqen sikur po përkrahin interesat më të larta shoqërore, ndërsa ata, që nuk pranojnë të bashkohen me ta quhen armiq të reformës. Por fakti që, një lëvizje me synim që të ligjërojë një gabim, bashkohet me një lëvizje të dytë që është në vetvete diçka e mirë, nuk është një provë në favor të këtij gabimi. Ne mund ta fshehim helmin, duke e përzier me ushqim të shëndetshëm, por nuk mund t'ia ndryshojmë natyrën atij. Përkundrazi kjo përzierje e bën atë më të rrezikshëm, sepse ndodh shumë më lehtë e kundërta. Ndërthurja e gënjeshtrës me një dozë fare më të vogël të së vërtetës që do ta bëjë të parën të besueshme është një nga mjetet e punës së Satanit. Udhëheqësit e lëvizjes në mbrojtje të së Dielës mund të përkrahin reforma, për të cilat njerëzit kanë nevojë dhe parime, që janë në përputhje me Biblën, por nëse me to përzihet diçka që është në kundërshtim me ligjin e Perëndisë, shërbëtorët e Tij nuk mund të bashkohen me ta. Asgjë nuk mund t'i shfajësojë ata, që mohojnë urdhëresat e Zotit për të përqafuar udhëzimet e njerëzve.

Përmes këtyre dy gabimeve të mëdha siç janë pavdekshmëria e shpirtit dhe natyra e shenjtë e të Dielës, Satani do të arrijë t'i mashtrojë njerëzit. Ndërsa e para hedh themelet e spiritualizmit, e dyta krijon një lidhje simpatie me Romën. Protestantët e Shteteve të Bashkuara do të jenë të parët që do të zgjasin duart mbi hendek për të rrokur dorën e spiritualizmit, ata do të zgjaten mbi humnerë për të përplasur duart me Romën dhe ky vend nën ndikimin e këtij bashkimi të trefishtë, do të ndjekë rrugën e Romës, duke shkelur me këmbë të drejtat e ndërgjegjes.

Meqënëse spiritualizmi po imiton gjithnjë e më shumë Kristianizmin e ditëve tona ai mban në vetvete një fuqi të madhe mashtrimi dhe dredhie. Vetë Satani është shndërruar për t'iu përshtatur rjedhës moderne të ngjarjeve. Ai do të shfaqet në formën e një engjëlli drite. Me anë të kësaj agjencie -spiritualizmit - do të kryhen mrekulli, do të shërohen të sëmurët dhe do të ndodhin çudira të papara ndonjëherë. Dhe duke qënë se shpirtrat do të deklarojnë se i besojnë Biblës dhe do të shfaqin respekt për institucionet kishëtare, punës së tyre do t'i vihet emri "fuqi hyjnore".

Dallimi midis të krishterëve dhe të pafeve sot e kësaj dite është shumë i vogël. Anëtarëve të kishës u pëlqen ajo që i pëlqen botës dhe janë gati të bashkohen me të tjerët, ndërsa Satani i ka bërë përgatitjet e duhura për t'i kthyer ata në një trup të vetëm dhe për të forcuar kështu, duke i hedhur ata në rrjetat e spiritualizmit, kauzën e tij. Papistët, që mburren me mrekullitë, duke i quajtur ato shenja të kishës së vërtetë do të mashtrohen shpejt nga kjo fuqi çudibërëse. Edhe Protestantët do të gënjehen, sepse e kanë hedhur me kohë mburojën e së vërtetës. Si papistët

dhe protestantët, ashtu edhe të pafetë do ta pranojnë krahëhapur këtë formë të perëndishme, por të zhveshur nga fuqia transformuese dhe të tre palët do të shohin në këtë bashkim lëvizjen e madhe të shndërrimit mbarëbotëror dhe fillimin e mijëvjeçarit të shumëpritur.

Përmes spiritualizmit, duke shëruar të sëmurët dhe duke "paraqitur" një sistem të ri dhe më të zhvilluar besimi fetar Satani merr rolin e mirëbërësit të racës njerëzore, por në të njëjtën kohë ai mbetet shkatërruesi i vjetër. Tundimet, që e kanë burimin tek ai vetë po rrënojnë me mijëra njerëz. Tepria e rrëzon nga froni arsyen, shthurja, mosmarrëveshjet dhe gjakderdhja i shkojnë pas. Satanit i bëhet zemra mal kur shikon luftra, sepse lufta nxit pasionet më të egra të shpirtit dhe më pas i fshin përjetësisht viktimat e këtyre luftrave, që përfshihen dashje pa dashje në krime e gjakderdhjeje. Qëllimi i tij është që t'i shtyjë kombet të luftojnë kundër njëri - tjetrit, sepse kështu ai i largon mendjet e njerëzve nga përgatitjet për të qënë gati në ditën e fundit.

Satani përdor të njëjtat elemente edhe për të futur në hambar të korrat e shpirtrave të papërgatitur. Ai i ka studiuar të gjitha sekretet e laboratorëve të natyrës dhe përdor të gjithë fuqinë që ka, për t'i kontrolluar këto elemente aq sa i lejon Perëndia. Kur iu lejua që të sulmonte Jobin, bagëti, shërbëtorë, shtëpi, fëmijë u zhdukën nga faqja e dheut sa hap e mbyll sytë; fatkeqësitë ndoqën njëra - tjetrën në një të dhjetën e minutit. Eshtë Zoti Ai që i mbron krijesat e Tij nga fuqia shkatërruese e Satanit. Por bota e krishterë ka filluar ta përçmojë ligjin e Jehovait dhe ka ardhur koha që Zoti të bëjë pikërisht atë që ka thënë se do të bëjë - ai nuk do ta bekojë më botën dhe nuk do t'i mbrojë më ata që po rebelojnë kundër ligjit të tij dhe më keq akoma që po mësojnë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Satani kontrollon të gjithë ata që nuk mbrohen në mënyrë të veçantë nga Perëndia. Që të arrijë qëllimet e veta ai do të tregohet dashamirës dhe do t'i ndihmojë disa njerëz, ndërsa të tjerëve do t'ju sjellë vetëm shqetësime dhe probleme, duke i bërë që të mendojnë se Zoti është përgjegjës për të gjitha këto.

Ndërsa nga njëra anë u shfaqet fëmijëve të njeriut si një mjek i madh që është në gjendje t'i shërojë të gjitha sëmundjet e tyre, nga ana tjetër ai është burimi i çdo sëmundjeje dhe katastrofeje që ka izoluar dhe shfarosur popullsinë e qyteteve të tëra. Ai po punon edhe sot e kësaj dite, duke ushtruar fuqinë e tij në aksidente e fatkeqësi tokësore e detare, në zjarre e uraganë të fuqishëm, në rrebeshe e fortuna, në përmbytje, ciklone e tërmete dora e tij vepron në çdo vend e në mijëra forma të ndryshme. Ai fshin nga faqja e dheut të korrat, duke sjellë kështu zi buke dhe shkatërrim. Ai infekton ajrin dhe me mijëra njerëz zhduken nga sëmundjet ngjitëse. Mos harroni! Këto shenja do të bëhen më të shpeshta e më të rrezikshme. Shkatërrimi do të bjerë si mbi njerëzit, ashtu edhe mbi kafshët. "Toka është në zi dhe vuan" "Populli i dheut ligështohet. Toka është përdhosur nga banorët e saj, sepse këta kanë

shkelur ligjet, kanë ndryshuar statutin dhe kanë marrë nëpër këmbë besëlidhjen e përjetshme." *(Isaia 24:4,5)*.

Më pas mashtruesi i madh do t'i bindë njerëzit se të gjithë këto të këqija vijnë nga ata që i shërbejnë Perëndisë. Ata njerëz, që kanë provokuar Zotin me veprimet e tyre do të fajësojnë, për të gjitha fatkeqësitë dhe shqetësimet që kanë rënë mbi ta, të gjithë të tjerët, që falë bindjes së tyre ndaj urdhëresave të Perëndisë, qëndrojnë të patundur përballë shkelësve të ligjit hyjnor. Do të thuhet se njerëzit, duke shkelur me këmbë të Dielën - Sabat ofendojnë Perëndinë dhe ky mëkat do të vazhdojë të jetë mbartës fatkeqësish derisa respektimi i së Dielës të bëhet i detyrueshëm dhe se të gjithë ata, që mbrojnë dhe quajnë të vërtetë urdhëresën e katërt, duke i vënë kështu kazmën respektit për të Dielën, janë hala në syrin e njerëzimit që po pengojnë rikthimin e dashamirësisë hyjnore dhe të përparimit të përkohshëm. Kështu do të përsëritet edhe një herë akuza që në të shkuarën u bëhej shërbëtorëve të Perëndisë e për më tepër edhe rrethanat do të jenë të njëjta: "Ashabi i doli përpara Elias dhe me ta parë Elian i tha: "Ti je pikërisht ai, që e bën rrëmujë Izraelin? Elia u përgjigj: "Nuk jam unë që e bëj rrëmujë Izraelin, por ti dhe shtëpia e atit tënd, sepse keni braktisur urdhërimet e Zotit dhe ti ke shkuar pas Baalëve" *(1 Mbretërve 18:17,18)*. Me t'u nxitur zemërimi i njerëzve nga këto akuza të rreme, ata do t'i trajtojnë ambasadorët e Perëndisë në të njëjtën mënyrë që Izraeli femohues trajtoi Elinë.

Fuqia çudibërëse e spiritualizmit do të drejtohet kundër atyre që do të vendosin t'i binden Zotit dhe jo njerëzve. Shpirtrat transmetues do të deklarojnë se i ka dërguar Perëndia për t'i bindur ata që nuk e njohin të Dielën si ditë të shenjtë se e kanë gabim, duke theksuar se ligjet e vendit duhet të respektohen si të ishin ligji i Zotit. Ata do të ankohen për mëkatin, që ekziston sot në botë dhe do të përsërisin dëshminë e mësuesve fetarë se kjo gjendje e dëshpëruar morale e ka zanafillën tek mosrespektimi i të Dielës. E madhe do të jetë indinjata, që do të nxitet kundër të gjithë atyre, që nuk do ta pranojnë këtë dëshmi të tyren.

Satani do të ndjekë në konfliktin përfundimtar me popullin e Perëndisë, të njëjtën politikë që ka përdorur që në fillim të kontradiktës së madhe qiellore. Ai deklaronte se po përpiqej që të siguronte qëndrueshmërinë e qeverisjes hyjnore, kur në të njëjtën kohë po bënte ç'ishte e mundur që ta rrëzonte këtë qeveri. Dhe quajti engjëjt hyjnorë fajtorë për punën që ai vetë po përpiqej të kryente. E njëjta politikë mashtrimi e ka vulën e vet edhe në historinë e Kishës së Romës. Ndërsa deklaron se vepron si zëdhënëse qiellore, kjo fuqi përpiqet që të vetëlartësohet mbi Perëndinë dhe të ndryshojë ligjin e Tij. Nën sundimin e Romës, të gjithë atyre, të cilët vdiqën për shkak të besnikërisë së tyre ndaj ungjillit iu vu emri "keqbërës" dhe "bashkëpunëtorë të Satanit" për të ngjallur pakënaqësinë e njerëzve dhe për t'i bërë ata të shfaqeshin në sytë e të tjerëve si kriminelët më të ndyrë, u përdor çdo rrugë e mjet i mundshëm. E njëjta gjë do të ndodhë në ditët tona. Meqenëse Satani

po përpiqet që të rrënojë ata, që e nderojnë ligjin e Perëndisë ai do të bëjë ç'është e mundur që ata të akuzohen si shkelës të ligjit dhe si persona që, duke çnderuar Zotin po i sjellin fatkeqësi botës.

Perëndia nuk i vë kurrë cak vullnetit të lirë apo ndërgjegjes, por Satani, në mënyrë që t'i kontrollojë ata që nuk mund t'i zërë në grackë përmes ndonjë rruge tjetër e përdor detyrimin me anë të mizorisë. Ai përpiqet që të sundojë mbi ndërgjegjet njerëzore dhe të sigurojë respekt për veten, vetëm përmes frikës apo forcës. Që ta arrijë këtë ai punon me anë të autoriteteve fetare dhe sekulare, duke i bërë ata që të fuqizojnë me ligj disa ligje të caktuara shtetërore, që e kundërshtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin e Perëndisë.

Të gjithë ata që e respektojnë Sabatin Biblik do të quhen armiq të ligjit dhe të rregullit, si njerëz që, duke flakur tej kufizimet morale të shoqërisë po sjellin anarki dhe korrupsion dhe po nxisin zemërimin e Zotit lart në qiell. Rezistenca e tyre e ndërgjegjshme do të merret si kokëfortësi, kryeneçësi dhe përçmim ndaj autoriteteve. Ata do të akuzohen se nuk ju pëlqen qeveria kombëtare. Pastorët dhe ministrat që e hedhin poshtë detyrimin që përfaqëson ligji hyjnor do të theksojnë nga podiumet kishëtare se duhet t'i bindemi autoriteteve civile, se këto të fundit na qenkan emëruar nga vetë Zoti (?!). Mbajtësit e urdhëresave do të keqprezantohen dhe do të dënohen nga trupat gjykues dhe autoritetet legjislative. Fjalëve të tyre do t'u jepet një ngjyrë e rreme, qëllimet e tyre do të vishen me domethënie nga më absurdet.

Ndërsa kishat protestante do të mohojnë argumentet e qarta Biblike në mbrojtje të ligjit të Perëndisë, ata mezi do të presin që t'ua mbyllin gojën atyre njerëzve, besimin e të cilëve nuk mund ta hedhin poshtë me asnjë të dhënë nga Shkrimet e Shenjta. Edhe pse nuk arrijnë ta kuptojnë një gjë të tillë ata i kanë hyrë në fakt një rruge që do t'i çojë në persekutimin e atyre që refuzojnë me ndërgjegje të bëjnë atë që po bëjnë të gjithë të krishterët e tjerë, refuzojnë të njohin pretendimet pa vend të Sabatit të Kishës së papës.

Autoritet e kishës dhe të shtetit do të bashkohen që t'i blejnë, t'i binden apo t'i detyrojnë të gjithë njerëzit që ta nderojnë të Dielën.

Mungesa e autoritetit hyjnor do të zëvendësohet nga disa ligje shtypëse. Korrupsioni politik po i vë shkelmin dashurisë për drejtësi dhe respektit për të vërtetën, e madje edhe në Amerikën e lirë, sunduesit dhe ligjvënësit, në mënyrë që të fitojnë përkrahjen e popullit, do t'i dorëzohen kërkesës popullore për ta bërë respektimin e të Dielës të detyrueshëm me ligj. Liria e ndërgjegjes, që është arritur me sakrifica të mëdha, do të groposet. Në konfliktin e së ardhmes së afërt ne do të përjetojmë përmbushjen e fjalëve të profetit: "Dhe dragoi u zemërua me gruan dhe shkoi të bëjë luftë me të tjerët, pasardhësit e saj, me ata që i ruajnë urdhëresat e Perëndisë dhe që kanë dëshminë e Jezu Krishtit" *(Zbulesa 12:17)*.

1. Në çmënyrë mund ta bëjmë ligjin e Perëndisë tërheqës për njerëzit në mënhyrë që ata ta zbatojnë atë?

2. Kur na vijnë problemet, ne shpesh herë fajësojmë Zotin; por cili është fajtori në të vërtetë?

3. Spiritizmi do të infiltrohet deri në kishë në ditët e fundit. Në çmënyra po ndodh kjo gjë sot?

4. Para se Jezusi të vijë, pothuajse e gjithë bota do të jetë rreshtuar kundra Perëndisë dhe ligjit të Tij. Ku qëndroni ju në mes të këtyre ngjarjeve?

37.

Shkrimet si Mburojë

"Përmbajuni ligjit dhe dëshmisë! Në rast se një popull nuk flet në këtë mënyrë, kjo do të thotë se ai nuk ka dritë". *(Isaja 8:20)*. Populli i Perëndisë duhet t'i drejtohet Shkrimeve të Shenjta si të vetmet masa mbrojtëse kundër ndikimit të mësuesve të rremë dhe fuqisë joshëse e mashtruese të shpirtrave të errësirës. Satani bën ç'është e mundur, që t'i pengojë njerëzit që këta të mos e studiojnë Biblën, sepse thëniet e saj të qarta nxjerrin në dritë mashtrimet e tij. Sa herë puna e Perëndisë merr një shtysë përpara, princi i mëkatit vepron më aktivisht; tani ai po bën gjithçka që është brenda fuqive të tij për t'u përgatitur për betejën përfundimtare kundër Krishtit dhe pasuesve të Tij. Ne shumë shpejt do të jemi dëshmitarë të mashtrimit të fundit të madh. Antikrishti do na "mrekullojë" me çuditë e tij të fundit. E vërteta dhe fotokopja do të jenë kaq të ngjashme sa që do të jetë e pamundur ta veçosh njërën nga tjetra pa ndihmën e Shkrimeve të Shenjta. Çdo thënie dhe çdo mrekulli duhet të krahasohet me dëshminë e këtyre të fundit.

Ata që përpiqen t'u binden të gjitha urdhërimeve të Perëndisë do të ndeshen me kundërshtime e përqeshje. Ata mund t'i bëjnë ballë gjithçkaje vetëm duke u kapur fort pas Shkëmbit të Shekujve. Në mënyrë që ta kalojnë me sukses provën që i pret ata duhet të kuptojnë vullnetin e Perëndisë, që zbulohet në faqet e fjalës së Tij; ata mund ta nderojnë Atin e tyre vetëm atëherë kur të kenë krijuar një ide të qartë mbi karakterin, qeverisjen dhe qëllimet e Tij dhe vetëm atëherë mund të jetojnë në përputhje me to. Ata që janë të fortifikuar me të vërtetat Biblike janë të vetmit që do t'i bëjnë ballë konfliktit të fundit të kohërave. Çdo shpirti njerëzor do t'i duhet të kalojë testin: "T'i besoj dhe t'i bindem Zotit apo njerëzve?" Ora vendimtare po afron. A i kemi vendosur këmbët mirë mbi shkëmbin e palëvizshëm të fjalës së Perëndisë? A jemi gati që t'i mbrojmë pa u përkulur urdhëresat e Zotit dhe besimin tek Jezusi?

Përpara ditës së kryqëzimit, Shpëtimtari iu shpjegoi dishepujve se Atij do t'i duhej të vdiste, por do të ngrihej përsëri nga varri dhe ishin engjëjt qiellorë ata që

zbritën mbi tokë dhe i bënë mendjet dhe zemrat e këtyre qenieve njerëzore të vëmendshme ndaj këtyre fjalëve. Por dishepujt po kërkonin një çlirim të përkohshëm nga zgjedha romake dhe ata as nuk mund ta mendonin që Ai, që përbënte epiqendrën e shpresave të tyre do të përjetonte një vdekje aq të turpshme sa ç'ishte kryqëzimi. Ata i kishin fshirë nga kujtesa fjalët që duhet t'i kujtonin dhe koha e provës i gjeti të papërgatitur. Vdekja e Jezusit i shkatërroi plotësisht shpresat e tyre a thua se Ai Vetë nuk i pati paralajmëruar kurrë. Në të njëjtën mënyrë, profecitë na zbulojnë të ardhmen po aq qartë sa fjalët e Krishtit e zbuluan atë për dishepujt e dikurshëm. Ngjarjet që lidhen me fundin e kohës së provës dhe me punën përgatitore për fillimin e periudhës së vështirësive të mëdha, na janë përshkruar me hollësi. Por me mijëra njerëz nuk kanë kuptuar ende asnjë nga këto të vërteta të rëndësishme a thua se për to nuk është folur kurrë. Satani qëndron në pritë për të fshirë çdo përshtypje që do t'i bënte ata që të kuptonin rëndësinë e dhuratës së shpëtimit dhe periudha e vështirësive do t'i gjejë ata të papërgatitur.

Kur Perëndia u dërgon njerëzve paralajmërime që janë aq të rëndësishme sa simbolizohen si të shpallura nga engjëj hyjnorë që fluturojnë në qiell ai kërkon që çdo njeri i arsyeshëm t'u vërë veshin këtyre mesazheve. Gjykimi i frikshëm, që është dhënë kundër adhurimit të bishës dhe figurës së saj *(Zbulesa 14:9-11)*, duhet t'i nxisë të gjithë njerëzit drejt një studimi të zellshëm të profecive, për të mësuar kështu se çfarë është shenja e bishës dhe si mund t'i shmangen asaj. Por masat e njerëzve i kthejnë kurrizin të vërtetës dhe përqafojnë vetëm përrallat e bukura. Duke parashikuar ngjarjet e ditëve të fundit apostulli Pal deklaroi se: "do të vijë koha kur njerëzit nuk do ta durojnë doktrinën e shëndoshë" *(2 Timoteut 4:3)*. Kjo kohë ka ardhur tashmë. Njerëzit nuk e duan më të vërtetën Biblike, sepse ajo i pret rrugën dëshirave mëkatare dhe botëdashëse të zemrës dhe në vend të saj Satani nxiton t'u servirë mashtrimet, që ata i duan kaq shumë.

Por Perëndia do të ketë popullin e Vet në tokë që do ta ruajnë Biblën dhe vetëm Biblën si standart të çdo doktrine dhe si bazë të çdo reforme. As opinionet e njerëzve të ditur, as konkluzionet shkencore, as besimet apo vendimet e këshillave fetare, pavarësisht se kishat që ata përfaqësojnë janë të shumta dhe të rëndësishme, as mendimi i shumicës nuk duhet konsideruar si provë në favor apo kundra ndonjë pike të besimit fetar. Përpara se të pranojmë ndonjë doktrinë apo urdhëresë të re ne duhet të kërkojmë vetëm një fjalë të thjeshtë si "kështu tha Zoti" në mbështetje të saj.

Satani po përpiqet vazhdimisht që ta tërheqë vëmendjen e njerëzve tek njerëzit dhe jo tek Perëndia. Ai i shtyn njerëzit që, në vend që t'i studiojnë vetë Shkrimet e Shenjta për ta kuptuar me forcat e tyre detyrën që i pret, të quajnë udhërrëfyes peshkopët, pastorët dhe profesorët e teologjisë. Më pas, me të vënë nën kontroll mendjet e këtyre udhëheqësve, ai mund t'i bëjë njerëzit të kryejnë vullnetin e tij.

Kur Krishti erdhi për t'u thënë fjalë jete, njerëzit e thjeshtë e dëgjuan Atë me gëzim dhe shumë prej tyre, mes të cilëve edhe priftërinj e sundimtarë i besuan Atij. Por kryeprifti dhe udhëheqësit e kombit ishin më se të vendosur që t'i mohonin mësimet e Tij e ta dënonin. Megjithëse përpjekjet e tyre për ta akuzuar Atë s'ishin asgjë tjetër veçse flluska sapuni dhe megjithëse edhe ata vetë e ndjenin ndikimin e fuqisë hyjnore dhe mençurinë që shoqëronin fjalët e Tij, ata nuk mund të hiqnin dorë nga paragjykimet dhe mohuan kështu provën më të qartë të faktit se Ai ishte vetë Mesia, ndryshe do t'u duhej të bëheshin dishepujt e Tij. Këta kundërshtarë të Jezusit ishin ata njerëz që të tjerët ishin mësuar t'i nderonin që nga fëmijëria dhe t'i përuleshin pa fjalë.

"Si shpjegohet - pyesnin ata - që mësuesit dhe udhëheqësit tanë të ditur nuk i besojnë Jezusit? A nuk do ta prisnin këta njerëz të shquar Atë krahëhapur sikur të ishte Krishti?"

Ndikimi i këtyre mësuesve bëri që kombi çifut ta mohonte Shpëtimtarin e Vet.

Fryma, që frymëzonte këta priftërinj dhe udhëheqës fetarë manifestohet edhe sot e kësaj dite nga shumë njerëz, të cilët hiqen shumë të mëshirshëm. Ata nuk pranojnë ta zbulojnë dëshminë e Shkrimeve të Shenjta që ka të bëjë me të vërtetat e kohës sonë. Ata mburren me anëtarësinë e madhe, me pasurinë dhe popullaritetin e tyre dhe i përçmojnë avokatët mbrojtës të së vërtetës si të pakët në numër, të varfër dhe jo popullorë, si mbrojtës të një besimi që i ndan ata nga pjesa tjetër e botës.

Krishti e parashikoi që vetveshja me autoritet, e cila filloi me farisenjtë dhe mësuesit e ligjit do të vazhdonte edhe pas shpërndarjes së çifutëve. Ai kishte një ide të qartë profetike të punës për lartësimin e autoritetit njerëzor mbi ndërgjegjen, punë që është kthyer në një mallkim për kishën për shekuj me radhë. Ai u çorri maskën Farisenjve dhe mësuesve të ligjit dhe i paralajmëroi njerëzit për rrezikun që mbart ndjekja e këtyre udhëheqësve të verbër e për më tepër të gjitha këto u regjistruan për të qëndruar si dëshmi për brezat e ardhshëm.

Kisha e Romës u ka dhënë klerikëve të saj të drejtën për të interpretuar Shkrimet e Shenjta. Duke mbështetur mendimin se vetëm kleri është në gjendje që ta shpjegojë fjalën e Zotit, kjo e fundit u mohohet njerëzve të thjeshtë, megjithëse Reformacioni i hapi Shkrimet e Shenjta për të gjithë, parimi i ruajtur me kujdes nga Roma vazhdon të ndikojë mijëra njerëz në kishat protestante që këta të mos e studiojnë vetë Biblën. Atyre u thuhet se duhet t'i pranojnë mësimet Biblike siç i interpreton Kisha dhe ka me qindra njerëz që nuk guxojnë të pranojnë asnjë pavarësisht se ajo mund të jetë zbuluar qartë në Shkrimet e Shenjta që bien ndesh me besimin apo mësimet e Kishës së tyre.

Pavarësisht nga fakti që Bibla na paralajmëron disa herë ndaj mësuesve të rremë, shumë njerëz janë gati që t'ia u besojnë shpirtërat e tyre, klerikëve dhe autoriteteve kishëtare. Sot ka me mijëra profesorë teologjie, që parashtrojnë si arsye besimi mbi

pika të ndryshme të fesë së tyre faktin që ata janë udhëzuar nga udhëheqësit e tyre fetarë. Ata pothuajse nuk ua vënë veshin fare mësimeve të Shpëtimtarit, por u besojnë pa as më të voglin dyshim fjalëve të pastorëve.Po... a janë pastorët te pagabueshëm? Si mund t'ua besojmë atyre shpirtërat tanë pa e ditur nga fjala e Perëndisë se ata janë mbartës drite? Mungesa e guximit moral për t'iu shmangur rrugës së botës i bën shumë njerëz që t'u shkojnë pas udhëheqësve të ditur dhe duke mos ushqyer as dëshirën më të vogël për të studiuar vetë, ata mbetën të mbërthyer keq në zinxhirët e gabimit. Ata e shohin se Bibla e nxjerr në pah shumë haptazi të vërtetën e kohës sonë, e ndiejnë fuqinë e Frymës së Shenjtë që i shoqëron thëniet e saj e megjithatë i kthejnë kurrizin dritës vetëm sepse Klerit i vriten sytë prej saj dhe lufton me ç'të mundet. Edhe pse ndërgjegjja dhe arsyeja u thonë të mos binden, këta njerëz të mashtruar as nuk guxojnë të mendojnë ndryshe nga pastorët e tyre dhe kështu gjykimi i tyre personal dhe interesat e tyre mbi përjetësinë bëhen fli e mosbesimit, krenarisë dhe paragjykimeve të të tjerëve.

Satani për të zënë rob viktimat e veta punon duke përdorur mënyra të ndryshme përmes ndikimit njerëzor. Ai bën për vete me mijëra njerëz, duke i tërhequr ata me fijet e mëndafshta të "dashurisë", së atyre që janë armiq të Kryqit të Krishtit. Nuk ka rëndësi se çfarë lidhjeje është kjo, prindërore, martesore apo sociale, rezultati është i njëjtë: Kundërshtarët e së vërtetës ushtrojnë fuqinë e tyre për të kontrolluar ndërgjegjen njerëzore dhe shpirtërat, që ndodhen nën zgjedhën e tyre nuk kanë as guximin e duhur dhe as pavarësinë e duhur për t'iu bindur bindjeve të tyre.

E vërteta dhe lavdia e Perëndisë janë të pandara, duke pasur Biblën në dorë ne e kemi të pamundur ta nderojmë Zotin me anë të disa opionioneve të gabuara. Shumë njerëz pretendojnë se nuk ka rëndësi se çfarë beson një njeri në se jeta e tij është e drejtë. Por mos harroni! Jeta gdhendet sipas besimit. Në qoftë se drita dhe e vërteta janë afër nesh dhe ne nuk pranojmë ta bëjmë tonin privilegjin e dëgjimit dhe vështrimit të tyre, me fjalë të tjera ne i mohojmë ato, pra ne zgjedhim errësirën dhe hedhim poshtë dritën.

"Ka një rrugë që njeriut i duket e drejtë, por në fund ajo të nxjerr në udhët e vdekjes" *(Fjalët e Urta 16:25)*. Aty ku ekziston mundësia për ta njohur vullnetin e Perëndisë injoranca nuk është shfajësim për gabimet apo mëkatet. Një njeri, duke udhëtuar arrin në një vend ku rruga degëzohet në një numër rrugësh të tjera dhe pikërisht aty gjendet një tabelë ku tregohet qartë se ku të çon secila prej këtyre rrugëve. Në rast se ai nuk i kushton rëndësi tabelës dhe i hyn rrugës që atij i duket e drejtë, ai mund të jetë mëse i sinqertë dhe pa asnjë paragjykim,por ai ka shumë mundësi që ti ketë hyrë rrugës së gabuar.

Perëndia na ka dhënë fjalën e Tij në mënyrë që ne të njihemi me mësimet e Tij dhe të zbulojmë vetë se çfarë pret Ai prej nesh. Kur gjykatësi erdhi tek Jezusi dhe e pyeti: "Çfarë duhet të bëj që të fitoj jetën e përjetshme?" - Shpëtimtari e drejtoi drejt

Shkrimeve të Shenjta dhe i tha: "Çfarë shkruhet në ligj? Si e lexon ti atë? - Meqënëse në duart e të moshuarve dhe të rinjve gjendet një prezantim i saktë i këtij ligji, i parimeve dhe detyrave që mbart ai, injoranca dhe padia nuk do t'i shfajësojë apo çlirojë ata nga dënimi që sjell shkelja e ligjit të Perëndisë. Nuk është e mjaftueshme që të kesh qëllime të mira, nuk është e mjaftueshme të bësh atë që *ti* mendon se është e drejtë apo që *pastori* të thotë se është e drejtë. Shpëtimi yt është në rrezik e ti duhet t'i studiosh Shkrimet e Shenjta vetë. Sado të forta të jenë bindjet e tua, sado besim të kesh që pastori e di mirë të vërtetën, asnjë nga këto nuk është themelore. Përpara ka një tabelë që të tregon çdo kthesë në rrugën drejt parajsës dhe s'do të të duhet t'i marrësh gjërat me mend.

Eshtë detyra e parë dhe më e lartë e çdo qenieje të arsyeshme njerëzore që të mësojë se ç'është e vërteta në faqet e Shkrimeve të Shenjta e më pas të ecë në dritë e t'i inkurajojë të tjerët që të ndjekin shembullin e Tij. Ne duhet ta studiojmë Biblën me zell çdo ditë, duke peshuar çdo mendim e duke krahasuar tekste me tekste. Ne duhet të krijojmë me ndihmën hyjnore opinionet tona personale ashtu siç duhet t'i përgjigjemi Zotit personalisht.

Njerëzit e ditur që, duke u hequr si të mençur e mësojnë të tjerët se Shkrimet e Shenjta kanë një kuptim mistik të fshehtë e shpirtëror që nuk shprehet drejtpërdrejt nga gjuha e përdorur, kanë përgënjeshtruar e kredhur në errësirë të vërtetat më të rëndësishme Biblike. Këta janë mësues të rremë. Këtij grupi njerëzish i drejtohet Jezusi kur thotë: "nuk i njihni as shkrimet e as pushtetin e Perëndisë." Gjuha Biblike duhet shpjeguar sipas kuptimit të saj të drejtpërdrejtë, atëherë kur nuk përdoret një figurë apo simbol. Krishti na ka premtuar: "në qoftë se dikush bën vullnetin e Tij do të njohë doktrinën" *(Gjoni 7;17)*. Në qoftë se njerëzit do ta kuptonin Biblën ashtu siç është, në qoftë se nuk do të kishte mësues të rremë, që do t'i keqdrejtonin e do t'i ngatërronin mendjet njerëzore do të kryhej një punë e tillë që do t'i gëzonte engjëjt e do të mblidhte rreth Krishtit mijëra e mijëra njerëz, që tani enden në gabim.

Ne duhet të vëmë në punë të gjitha fuqitë tona mendore në studimin e Shkrimeve të Shenjta e duhet të përpiqemi me aq sa kemi mundësi si qënie njerëzore që jemi të kuptojmë gjërat e mëdha të Perëndisë, megjithatë nuk duhet të harrojmë se bindja e nënshtrimi i një fëmije përbëjnë frymën e një nxënësi të zellshëm. Vështirësitë, që hasen në studimin Biblik nuk mund të kapërxehen kurrë me anë të të njëjtave metoda që përdoren në zgjidhjen e problemeve filozofike. Ne nuk duhet t'i hyjmë studimit të Biblës me vetbesim siç bëjnë shumica e njerëzve kur studiojnë degët e ndryshme të shkencës, por duke iu lutur, duke u mbështetur tek Perëndia dhe me një dëshirë të sinqertë për të mësuar vullnetin e Tij. Ne duhet të na karakterizojë një frymë përulësie që të fitojmë dijen nga i madhi Unë Jam. Ndryshe engjëjt mëkatarë do të na i verbojnë mendjet e do të na i ftohin zemrat aq shumë sa e vërteta nuk do të na bëjë më përshtypje. Shumë tekste të Shkrimit të Shenjtë,

që njerëzit e shkolluar i quajnë të mistershme apo që nuk i kushtojnë vëmendje mbajnë në vetvete ngushëllim dhe udhëzime për atë njeri që është ulur në bankat e shkollës së Krishtit. Shumë teologë nuk arrijnë të kuptojnë dot fjalën e Perëndisë, sepse ata i mbyllin sytë para të vërtetave, që nuk duan t'i vënë në jetë. Kuptimi i të vërtetës Biblike nuk varet aq shumë nga fuqia e intelektit, sa nga rëndësia e qëllimit dhe dëshira e ethshme për drejtësi.

Bibla nuk duhet të studiohet kurrë pa u lutur më parë. Vetëm Fryma e Shenjtë mund të na bëjë ta kuptojmë lehtë rëndësinë e këtyre të vërtetave dhe të na pengojë që të mundohemi me disa të dhëna të tjera, që janë të vështira për ne. Engjëjt qiellorë kanë për detyrë që ta përgatisin zemrën që ta kuptojë fjalën e Perëndisë e ne të kemi privilegjin që të mrekullohemi me bukurinë e saj, t'u kushtojmë rëndësi paralajmërimeve të saj dhe të frymëzohemi, dhe të marrim fuqi nga premtimet e saj. Peticioni i psalmistit duhet të bëhet edhe i yni: "Hapi sytë e mi dhe unë do të shikoj mrekullitë e ligjit Tënd" *(Psalmi 119:18)*. Shpesh tundimet duken të papërballueshme, sepse duke mos u lutur dhe duke mos e studiuar Biblën, njeriu që tundohet nuk është në gjendje që t'i kujtojë premtimet e Perëndisë dhe t'i bëjë ballë Satanit me armët e Shkrimeve të Shenjta. Por engjëjt janë afër atyre që duan t'i dinë gjërat hyjnore dhe në rast nevoje ata do t'i kujtojnë këta njerëz për të vërtetat që iu duhen. Kështu "kur kundërshtari do të vijë si një lumë i furishëm, shpirti i Zotit do të lartojë kundër Tij një flamur". *(Isaja 59:19)*

Jezusi i premtoi dishepujve të tij: "Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim do t'u mësojë çdo gjë dhe do t'iu kujtojë të gjitha këto që ju thashë" *(Gjoni 14:26)*. Por mësimet e Krishtit duhet të jenë ngulitur në mendje më parë, në mënyrë që Fryma e Perëndisë të na i kujtojë ato në kohë rreziku. "E kam ruajtur fjalën tënde në zemrën time, - thotë Davidi - që të mos mëkatoj kundër teje" *(Psalmi 119:11)*.

Të gjithë ata, që i vlerësojnë interesat që lidhen me përjetësinë duhet t'i ruhen sulmit të skepticizmit. Vetë shtyllat e të vërtetës do të sulmohen. Eshtë e pamundur që t'i mbash larg sofizmës dhe sarkazmës mësimet djallëzore dhe infektuese të mosbesimit modern. Satani ua përshtat tundimet e tij të gjitha grupeve njerëzore. Ai e sulmon të padituri, duke qeshur dhe duke u tallur, ndërsa të diturin me ide shkencore e arsyetim filozofik, por tek të dy ai synon të ngjallë mosbesim dhe përçmim ndaj Shkrimeve të Shenjta. Madje edhe të rinjtë e pa përvojë shprehin dyshim në lidhje me parimet themelore të kristianizmit. Dhe ky mosbesim i të rinjve, pavarësisht se është i përciptë ushtron ndikimin e tij. Shumë njerëz sillen kështu me besimin e baballarëve të tyre dhe e përçmojnë Frymën Mëshirëplotë *(Hebrejtë 10:29)* Shumë jetë njerëzore, që duhej të nderonin Perëndinë e të bekonin botën janë infektuar nga fryma e ndyrë e mosbesimit. Të gjithë ata që i besojnë vendimeve të arsyes dhe imagjinatës njerëzore për të shpjeguar pa ndihmën e zgjuar të Perëndisë misteret e të vërtetat hyjnore, bien rob të kurthit satanik.

Ne po jetojmë në periudhën më solemne të historisë botërore. Shpejt do të vendoset edhe fati i banorëve të shumtë të kësaj bote. Mirëqënia jonë e së ardhmes, shpëtimi ynë dhe i të tjerëve varet shumë nga rruga që po ndjekim sot. Ne duhet t'i lëmë fushë të lirë veprimi fuqisë udhëheqëse të Frymës së Shenjtë. Çdo pasues i Krishtit duhet të pyesë me ngulm: "O Zot, çfarë do që të bëj unë?" Ne duhet t'i përulemi Zotit me lutje dhe agjërim dhe duhet të meditojmë për fjalën e Tij e veçanërisht për skenat e gjykimit.Tani ka ardhur koha që ne të kërkojmë një përvojë të plotë dhe të gjallë në gjërat e Perëndisë. Nuk kemi kohë për të humbur, as edhe një minutë. Rreth nesh po ndodhin ngjarje të një rëndësie jetësore, ne jetojmë mbi tokën e magjepsur nga Satani. Mos flini roje të Perëndisë; armiku po vërtitet aty afër i gatshëm, në rast se ju jeni të pavëmendshëm dhe të përgjumur për t'iu gllabëruar e kthyer në pre të tij.

Shumë njerëz janë mashtruar në lidhje me pozitën e tyre të vërtetë para Perëndisë. Ata vetëlavdërohen për veprimet e gabuara që nuk kanë kryer, por harrojnë t'i numërojnë veprat e mira e fisnike që Zoti kërkon prej tyre, por që ata kanë haruar t'i kryejnë. Nuk është e mjaftueshme që ata të jenë pemë në kopshtin e Perëndisë. Ata duhet t'i përgjigjen asaj që Ai pret prej tyre, duhet të lidhin fruta. Ai i quan ata fajtorë për mungesën e veprave të mira që ata do të kishin kryer me ndihmën e hirit të Tij forcues. Në librat qiellorë ata janë regjistruar si njerëz mëkatarë, megjithatë as çështja e këtij grupi njerëzish nuk është fare e pashpresë. Zemra e dashurisë së shumëvuajtur vazhdon t'i lutet edhe atyre që e kanë shpërfillur mëshirën e Perëndisë dhe kanë abuzuar me hirin e Tij. Prandaj Ai thotë: "Zgjohu ti që fle dhe ringjallu prej të vdekurish dhe Krishti do të shndrisë mbi ty. Kujdesuni pra, që të ecni me kujdes ... duke e shfrytëzuar kohën, sepse ditët janë të mbrapshta" *(Efesianët 5: 14-16)*.

Kur të vijë koha e provës do të dalin në pah edhe të gjithë ata që e kanë bërë fjalën e Perëndisë udhërrëfyese në jetë. Gjatë verës pemët, që janë gjithmonë të gjelbra nuk ndryshojnë shumë nga pemët e tjera, por me të ardhur erërat e ftohta të dimrit, pemët e tjera zhvishen nga gjethet, por pemët, që janë gjithmonë të gjelbra nuk ndryshojnë. Kështu, profesori i rremë tani nuk ndryshon shumë nga i krishteri i vërtetë, por koha është e afërt, kur ky ndryshim do të bëhet më se i dallueshëm. Me të lindur kundërshtimi, me të marrë rrugë fanatizmi dhe mosbesimi, me të lulëzuar persekutimi, hipokritët dhe të ashtuquajturit "të Krishterë" me gjysëm zemre do të dridhen e do të dorëzohen, por i Krishteri i vërtetë do të qëndrojë i fortë si një shkëmb, me një besim akoma më të madh e me një shpresë akoma më të shndritshme se në kohë paqeje.

Psalmisti thotë: "urdhërimet e tua janë përsiatja ime". "Me anë të urdhërimeve të tua unë përfitoj zgjuarsinë, prandaj urrej çdo shteg falsiteti" *(Psalmi 119:99, 104)*.

"Lum ai njeri që ka gjetur diturinë". "Ai do të jetë si një pemë e mbjellë pranë ujit, që i shtrin rrënjët e tij gjatë lumit. Nuk do ta ndiejë kur vjen vapa dhe gjethet

e saj do të mbeten të gjelbra, në vitin e thatësirës nuk do të ketë asnjë shqetësim dhe do të vazhdojë të mbajë fryte" *(Fjalët e Urta 3;19); (Jeremia 17:8).*

1. Perëndia do të rrisë ndërgjegjësimin frymor përpara Ardhjes së Dytë. Sipas Zbulesës 14:9-11, cili do të jetë rezultati për ata që nuk ia vënë veshin mesazhit??

2. Cili është vendi që zë arsyeja dhe intelekti në studimin e Biblës?

3. Si mund të rrisni dashurinë tuaj për Shkrimet dhe studimin e Biblës?

4. Shumë të Krishterë thjesht shohin nga klerikët për t'i interpretuar Biblën. A nënkupton kjo se ne nuk duhet të kërkojmë kurrë këshilla nga një njeri tjetër për sa i përket interpretimit të Biblës? Jepni shpjegime.

38.

Paralajmërimi i Fundit

"Pashë një engjëll tjetër që zbriste nga qielli, që kishte pushtet të madh dhe dheu u ndriçua nga lavdia e tij. Ai bërtiti me forcë dhe me zë të madh, duke thënë: "Ra, ra Babilonia e madhe dhe u bë vendbanimi i demonëve dhe streha e çdo fryme të ndyrë dhe streha e çdo shpendi të ndyrë dhe të neveritshëm". "Pastaj dëgjova një zë tjetër nga qielli duke thënë: "Dilni prej saj, o populli im, që të mos bëheni pjesëtarë të mëkateve të saj dhe të mos merrni nga plagët e saj" *(Zbulesa 18:1,2,4).*

Ky tekst flet për një periudhë të caktuar kohe në të ardhmen, kur shpallja e rënies së Babilonisë, që bëhet nga engjëlli i dytë në kapitullin *14 (versa 8)* të Zbulesës do të përsëritet, duke i shtuar kësaj edhe përmendjen e korrupsionit që ka mbërthyer organizatat e ndryshme, që formojnë Babiloninë që nga koha e dhënies së mesazhit të parë në verën e vitit 1844. Këtu përshkruhet situata e nderë që po përjeton bota fetare. Duke mohuar të vërtetën, mendjet e njerëzve do të mpihen gjithnjë e më shumë dhe zemrat e tyre do të bëhen akoma dhe më të pavarura deri sa ata do të mbeten të mbërthyer në kurthin e paturpësisë femohuese. Duke mos iu vënë veshin paralajmërimeve të Perëndisë ata do të vazhdojnë ta shkelin me këmbë një nga urdhëresat e ligjit të Tij, derisa kjo, do t'i bëjë që t'i persekutojnë ata që e ruajnë atë urdhëresë të paprekur e të shenjtë. Krishti e ka humbur rëndësinë e Vet nga përçmimi që ka rënë mbi fjalën dhe njerëzit e Tij. Pranimi nga ana e kishave e mësimeve të spiritualizmit e ka flakur tej murin mbrojtës, ndërtuar rreth zemrës njerëzore dhe me kalimin e kohës feja do të kthehet në një petk për të mbuluar padrejtësitë më të mëdha. Besimi në shfaqjet e manifestimet e spiritualizmit i hap derën doktrinave të demonëve dhe shpirtërave joshës dhe kështu ndikimi i engjëjve mëkatarë do të ndjehet edhe në kisha.

Në lidhje me kohën, që nxjerr në pah profecia për Babiloninë deklarohet: "Mëkatet e saj janë grumbulluar dhe kanë arritur deri në qiell dhe Perëndia i kujtoi paudhësitë e saj". *(Zbulesa 18:5)*. Ajo e ka mbushur kupën e fajit dhe mbi të shpejt

do të bjerë rrënimi i plotë. Por Zoti ka akoma njerëzit e Tij në Babiloni dhe këtyre njerëzve besnikë u bëhet thirrje që të largohen prej saj përpara gjykimit të Tij, në mënyrë që të mos marrin pjesë në mëkatet dhe "të mos marrin nga plagët e saj". Që këtu fillon edhe lëvizja e simbolizuar nga engjëlli që zbret nga qielli, duke e ndriçuar tokën me lavdinë e Tij dhe, duke shpallur me një zë të lartë e kumbues mëkatet e Babilonisë. Mesazhi i Tij ka si pikë kulmore thirrjen: "Dilni prej saj, o populli im". Këto njoftime së bashku me mesazhin e engjëllit të tretë përbëjnë paralajmërimin e fundit drejtuar banorëve të tokës.

Botës do t'i duhet të ballafaqohet me një problem të madh. Fuqitë mbarëbotërore, të bashkuara në luftë kundër urdhëresave të Perëndisë, do të nxjerrin dekretin, sipas të cilit "të gjithë, të vegjël e të mëdhenj, të pasur e të varfër, të lirë dhe skllevër" *(Zbulesa 13:16)* duhet t'u binden zakoneve të kishës, duke respektuar sabatin e rremë. Atyre që nuk do të binden do t'u vihen gjoba dhe së fundi, do të përkrahet ideja se ata meritojnë të vdesin. Nga ana tjetër, ligji i Perëndisë, pjesë e të cilit është dhe dita e pushimit të Krijuesit, kërkon bindje dhe ngjall zemërimin e Perëndisë ndaj atyre që e shkelin atë.

Duke i pasur të qarta të gjitha këto, kushdo që e shkel me këmbë ligjin e Zotit për t'iu bindur "ligjeve" njerëzore do të marrë damkën e bishës, me fjalë të tjera ai pranon shenjën e besnikërisë së asaj fuqie që ai vetë zgjedh t'i bindet në vend të fuqisë së Perëndisë. Por Zoti na ka paralajmëruar kështu: "Nëse ndokush adhuron bishën dhe figurën e saj dhe merr damkën mbi ballin e vet ose mbi dorën e vet, do të pijë edhe ai nga vera e zemërimit të Perëndisë, që është derdhur e papërzier në kupën e zemërimit të tij" *(Zbulesa 14:9,10).*

Por askush nuk do ta përjetojë zemërimin e Perëndisë në rast se e vërteta është e panjohur për mendjen dhe ndërgjegjen e tij dhe në rast se ai nuk e ka mohuar me vetëdije këtë të vërtetë. Ka shumë njerëz, të cilët nuk e kanë pasur mundësinë për t'i dëgjuar të vërtetat e veçanta të kohës sonë.

Detyrimi që mbart në vetvete urdhëresa e katërt nuk iu është bërë kurrë i qartë. Ai, që lexon çdo zemër e zbulon çdo qëllim, nuk do të lërë asnjë, që dëshiron të njihet me të vërtetën, të mashtrohet në lidhje me çështjet e rëndësishme të kontradiktës së madhe. Dekreti nuk do t'i gjejë njerëzit me sy mbyllur. Gjithëkujt do t'i falet dritë e mjaftueshme për të marrë vendime të mençura.

Sabati do të jetë prova e madhe e besnikërisë, sepse është ajo pikë e së vërtetës që është shtrembëruar më shumë se të tjerat. Me t'u vënë në provë njerëzit, do të hiqet edhe viza e dallimit mes atyre që i shërbejnë Perëndisë dhe të tjerëve që nuk e bëjnë një gjë të tillë. Ndërsa respektimi i sabatit të rremë në përputhje me ligjin e shtetit do të jetë një shprehje e besnikërisë ndaj fuqisë që kundërshton Perëndinë. Mbajtja e Sabatit të vërtetë si ditë e shenjtë në përputhje me ligjin e Zotit është një provë besnike ndaj Krijuesit. Ndërsa një grup njerëzish, që pranojnë t'i nënshtrohen

fuqive tokësore marrin damkën e bishës, të tjerët që zgjedhin shenjën e besnikërisë ndaj autoritetit hyjnor marrin vulën e Perëndisë.

Më parë, lajmëtarët e të vërtetave të mesazhit të engjëllit të tretë janë quajtur shpesh alarmistë. Parashikimet e tyre, sipas të cilave liria e besimit nuk do të mbijetonte gjatë në Shtetet e Bashkuara dhe kisha e shteti do të bashkoheshin për të persekutuar ata që iu bindën urdhëresave të Perëndisë u quajtën të pabazuara dhe absurde. Gjithmonë është deklaruar me mendjemadhësi që ky vend nuk mund të ndryshojë - ai do të mbetet gjithmonë mbrojtës i lirisë fetare. Por me lindjen e problemit të kthimit të respektimit të së Dielës në diçka të detyrueshme, po vihet re se ngjarja, për të cilën ka pasur dyshime dhe diskutime të zjarrta, po afrohet dhe mesazhi i engjëllit të tretë do të ketë një ndikim të paparë ndonjëherë.

Në çdo kohë e brez të historisë njerëzore, Perëndia ka dërguar shërbëtorët e Tij për ta sulmuar mëkatin si në botë ashtu edhe në kishë. Por njerëzit duan që t'u thonë fjalë të bukura dhe e vërteta e pandryshuar dhe e pazbukuruar është e papranueshme për ta. Shumë reformatorë kur i hynë punës së tyre ishin të vendosur që ta trajtonin mëkatin në kishë dhe në botë me kujdes e tolerancë. Ata shpresonin që t'i kthenin njerëzit tek doktrinat biblike nëpërmjet shembullit të një jete të pastër Kristiane. Por ata i pushtoi Fryma e Perëndisë siç kishte pushtuar dikur Elijan, duke i shtyrë ata që t'i sulmonin ashpër mëkatet e një mbreti të lig apo të një populli femohues, ata nuk mund të hiqnin dorë nga predikimi i thënieve të qarta Biblike - i doktrinave që ata nuk kishin dashur t'i trajtonin. Ata u nxitën që të deklaronin më fort të vërtetën dhe rrezikun, që i kërcënonte njerëzit. Ata përdorën pa pasur frikë nga pasojat fjalët që i vuri në gojë Perëndia dhe njerëzit u detyruan ta dëgjonin paralajmërimin e tyre.

Kështu do të shpallet edhe mesazhi i engjëllit të tretë. Me të ardhur koha për zbulimin e tij, Zoti do t'i drejtojë mendjet e atyre që i janë përkushtuar shërbimit të Tij drejt tij, duke punuar përmes disa instrumenteve të përulura. Këta njerëz do të kualifikohen më shumë nga veprimi i Frymës së Shenjtë se sa nga institucionet shkollore. Njerëz besimtarë dhe të përulur do të nxiten që të punojnë me zell hyjnor për të shpallur fjalët që do t'ju besojë Perëndia. Mëkateve të Babilonisë do t'iu çirret maska. Rezultatet e frikshme të kthimit të riteve fetare në ligje të detyrueshme shtetërore, sulmet e spiritualizmit, përparimi i kujdesshëm, por i shpejtë i fuqisë së papës - të gjitha këto do të shohin më së fundi dritën e diellit. Njerëzit do të fillojnë të zgjohen nën veprimin e këtyre paralajmërimeve solemne. Mijëra e mijëra njerëz, që nuk kanë dëgjuar kurrë fjalë të tilla do t'u vënë veshin atyre. Ata do të magjepsen nga dëshmia, që thotë se Babilonia është kisha, e rrënuar falë mëkateve dhe gabimeve të veta, për shkak të mohimit të së vërtetës qiellore. Dhe ndërsa njerëzit iu drejtohen mësuesve të tyre të mëparshëm në pyetjen: "Kjo është e vërteta?", pastorët do të tregojnë përralla të tjera të bukura, dhe do të paraqesin disa

pika të parëndësishme profecish për të qetësuar njerëzit e trembur dhe ndërgjegjen e tyre të zgjuar. Por, duke qënë se shumë prej tyre nuk kënaqen me autoritetin e njerëzve dhe kërkojnë të dëgjojnë fjalinë e famshme "kështu tha Zoti", kleri, ashti si Farisenjtë e së shkuarës, i inatosur nga fakti që autoriteti i tij po lëkundet nga themelet, do ta quajë mesazhin Satan ik dhe do t'i nxisë njerëzit mëkatarë që t'i përçmojnë e persekutojnë të gjithë ata që e mbrojnë këtë mesazh. Ndërsa kontradikta e madhe zgjerohet drejt horizonteve të reja dhe mendjet e njerëzve tërhiqen drejt ligjit të marrë nëpër këmbë të Perëndisë, Satan i rri zgjuar. Fuqia që do të shoqërojë përhapjen e këtij mesazhi do të inatosë vetëm ata që e kundërshtojnë atë. Kleri do të bëjë ç'është e mundur për ta fikur këtë dritë se përndryshe ajo do të ndriçojë edhe turmat e tyre. Ata do të përpiqen me çdo mjet e mundësi që ta mbyllin diskutimin e këtyre çështjeve jetësore. Kisha i bën thirrje grushtit të fuqishëm të fuqisë civile dhe në kryerjen e kësaj "detyre' papistët dhe Protestantët bëhen një. Me t'u përforcuar e përhapur lëvizja për ta bërë adhurimin e së Dielës të detyrueshëm, do të miratohet edhe një ligj kundër mbajtësve të urdhëresave hyjnore. Disa prej tyre do të kërcënohen me gjoba e burgime, ndërsa të tjerëve do t'u ofrohen pozita të rëndësishme, shpërblime apo të mira të tjera vetëm e vetëm për t'i bërë ata që ta braktisin besimin e tyre. Por përgjigjja e tyre e vendosur është: "na tregoni gabimin tonë në ballafaqim me fjalën e Perëndisë" - e njëjta përgjigje kjo që përdori edhe Luteri në rrethana të ngjashme.

Ata që dalin përpara trupit gjykues e mbrojnë me guxim besimin e tyre dhe disa prej njerëzve, që i dëgjojnë ata frymëzohen që t'iu kushtojnë rëndësi e t'i respektojnë urdhëresat e Perëndisë. Kështu sytë e mijëra njerëzve, që ndryshe nuk do të njiheshin kurrë me këto të vërteta, do të shohin dritën e tyre.

Bindja e ndërgjegjshme ndaj fjalës së Perëndisë do të quhet rebelim. Verbuar nga Satani, prindi do ta trajtojë keq dhe ashpër fëmijën e vet që beson, pronari apo pronarja do ta shtypin shërbëtorin urdhëresëmbajtës. Ndjenjat e dashurisë do të ngurtësohen, fëmijëve do t'u hiqet e drejta e trashëgimisë dhe do të dëbohen nga shtëpia. Fjalët e Palit do të përmbushen pikë më pikë. "Të gjithë ata që duan të rrojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus, do të përndiqen" *(2 Timoteut 3:12)*. Disa nga mbrojtësit e së vërtetës që nuk pranojnë ta nderojnë të Dielën - Sabat do të burgosen, të tjerët do të dëbohen nga vendi, ndërsa ata që do të mbeten do të trajtohen si skllevër. Tani për tani të gjitha këto duken si të pamundura për mendjen njerëzore, por kur Fryma e Shenjtë do t'i braktisë njerëzit dhe ata do të mbeten të vetëm nën kontrollin e Satanit, që i urren urdhëresat e shenjta, do të ndodhin disa ngjarje shumë të çuditshme. Një zemër e zhveshur nga dashuria dhe respekti ndaj Perëndisë, mund të jetë shumë mizore.

Me t'u afruar stuhia, një numër i madh njerëzish nga ata që pretendonin se i besonin mesazhit të engjëllit të tretë, por që nuk janë shenjtëruar përmes bindjes ndaj

së vërtetës, do të heqin dorë nga bindje të tyre të mëparshme dhe do të bashkohen me radhët e kundërshtarëve. Duke u bashkuar me botën dhe duke marrë pjesë në atmosferën e saj, ata fillojnë t'i shohin gjërat përmes të njëjtave lente e kur vjen koha e provës, ata janë të prirur që të zgjedhin rrugën e lehtë të botës. Njerëz të talentuar e të ditur, që dikur ngazëlloheshin nga e vërteta, përdorin të gjitha dijet e tyre për të mashtruar e keqtrajtuar të tjerët. Ata kthehen në armiqtë më të këqinj të vëllezërve të tyre të dikurshëm. Kur mbajtësit e Sabatit dalin përpara trupave gjykues për të dhënë llogari për besimin e tyre, këta femohues janë agjentët më të mirë të Satanit që i keqpërfaqësojnë, akuzojnë dhe ngjallin pakënaqësinë e sundimtarëve ndaj tyre falë të dhënave të rreme dhe trillimeve fantastike.

Besimi i shërbëtorëve të Perëndisë do të vihet në provë pikërisht në këtë kohë persekutimi. Duke pasur si udhërrëfyes Zotin dhe fjalën e tij, ata i kanë paralajmëruar të tjerët pa frikë. Fryma e Shenjtë, duke punuar brenda zemrave të tyre, i ka nxitur që të flasin. Të frymëzuar nga ky zell hyjnor dhe me këtë impuls të shenjtë brenda tyre ata i hynë rrugës së kryerjes së detyrës së tyre pa i llogaritur fare pasojat që kishte shpallja haptazi e fjalëve të Perëndisë. Ata nuk duan t'ia dinë për interesat e tyre të përkohshme e as për të ruajtur emrin e tyre të mirë apo vetë jetën e tyre. E megjithatë kur disa prej tyre ndiejnë stuhinë e kundërshtimit e talljes, të pushtuar nga frika janë gati të thonë: "sikur t'i dinim pasojat e fjalëve tona nuk do ta kishim hapur fare gojën". Ata bëhen robër të vështirësive. Satani i sulmon, duke i ofruar tundime nga më të ndryshmet. Puna që kanë marrë mbi supe duket shumë më e vështirë nga aftësitë e tyre realizuese. Atyre iu kërcënohet shkatërrimi. Entuziazmi, që i frymëzonte dikur nuk ekziston më, por megjithatë çuditërisht nuk kthehen dot pas. Më pas duke kuptuar se nuk kanë asnjë rrugë tjetër shpëtimi, ata i drejtohen të Fuqishmit për fuqi. Atyre iu kujtohet se fjalët që kanë thënë nuk iu përkisnin atyre, por Atij që iu besoi paralajmërimin. Perëndia ua shkroi të vërtetën në zemër e ata nuk mund të mos ta shpallnin atë.

Edhe shërbëtorët e Perëndisë në të shkuarën kanë përjetuar e përballuar prova të tilla Wycliffe, Huss, Luter, Tyndale, Baxter, Wesley e të tjerë, ishin të mendimit se të gjitha doktrinat duhet të kalojnë provën e Biblës dhe deklaronin se ata do të hiqnin dorë nga çdo argument që i dështonte kësaj prove. Këta njerëz u vunë në epiqendrën e një persekutimi të tërbuar, por nuk pushuan kurrë së deklaruari të vërtetën. Çdo periudhë e veçantë e historisë së kishës ka vulën e shpalljes së një të vërtete të re, që i përgjigjej nevojave të njerëzve të Zotit në atë kohë të caktuar.

Çdo e vërtetë e re e çan rrugën drejt suksesit përmes urrejtjes dhe kundërshtimit, ata që bekohen nga drita e saj vihen në provë e tundohen. Zoti u zbulon njerëzve një të vërtetë të veçantë në rast nevoje. Kush guxon të mos pranojë ta shpallë atë? Ai i urdhëron shërbëtorët e Tij që t'i ofrojnë botës ftesën e fundit të mëshirës. Ata nuk mund të heshtin edhe pse kjo rrezikon vetë jetën e tyre. Ambasadorët e Krishtit

nuk duan t'ia dinë për pasojat. Ata kryejnë detyrën e tyre dhe ia lënë rezultatet në dorë Perëndisë.

Me t'u shtuar shtypja e kundërshtimi, shërbëtorët e Zotit shqetësohen, sepse ju duket sikur e kanë krijuar ata vetë këtë gjendje të vështirë e kritike. Por ndërgjegjja dhe fjala e Perëndisë i sigurojnë se rruga që kanë ndjekur është e drejtë dhe megjithëse provat e vështira vazhdojnë, ata gjejnë forcën e duhur për t'u bërë ballë atyre. Kontradiktat shtohen e mprehen gjithnjë e më shumë, por besimi dhe guximi i tyre marrin përmasa të reja. Dëshmia e tyre është kjo: "Ne nuk guxojmë ta shkelim me këmbë fjalën e Perëndisë, duke e copëzuar ligjin e Tij hyjnor; duke e cilësuar një pjesë të tij si të rëndësishme dhe pjesën tjetër si të parëndësishme, sepse kjo e fundit cënon dashamirësinë e botës ndaj nesh. Zoti, që i shërbejmë është në gjendje që të na çlirojë. Krishti i ka mundur fuqitë e tokës; a duhet të kemi frikë nga një botë e mundur tashmë?"

Persekutimi dhe format e tij të ndryshme përbëjnë zhvillimin e një parimi, që do të ekzistojë për aq kohë sa do të mbijetojë Satan i dhe sa Kristianizmi do të ruajë forcën e tij jetësore. Askush nuk mund t'i shërbejë Zotit pa nxitur kundër vetes kundërshtimin e turmave të errësirës. Engjëjt mëkatarë, të frikësuar se me ndikimin e tij ai po iu heq prenë nga duart, do ta sulmojnë atë. Njerëzit mëkatarë, të trondi-tur nga shembulli i tij, do të bashkohen për të ngritur falë tundimeve joshëse, një mur ndarës mes tij dhe Perëndisë. Kur të gjitha këto përpjekje nuk kanë sukses, i hyn punës një fuqi, që kërkon t'i vërë caqe kufizuese ndërgjegjes njerëzore.

Por për aq kohë sa Jezusi mbetet ndërmjetësues i këtij njeriu në shenjtoren qiellore, sundimtarët dhe njerëzit e thjeshtë do të ndiejnë ndikimin kontrollues të Frymës së Shenjtë. Ai akoma vazhdon të kontrollojë deri-diku ligjet kombëtare. Sikur të mos ishin këto ligje, bota do të ndodhej në një pozitë shumë më të keqe nga ç'është tani. Megjithëse shumë nga sundimtarët tanë janë agjentë aktive të Satan it, mes tyre ka edhe agjentë të Perëndisë. Armiku i frymëzon shërbëtorët e tij që të propozojnë masa të tilla "mbrojtëse", që do ta pengojnë mjaft punën e Perëndisë, por qeveritarët që e nderojnë Zotin frymëzohen nga engjëj hyjnorë për t'i kundërshtuar propozime të tilla me argumente bindëse. Kështu, një numër i vogël njerëzish do të kontrollojnë një rrymë të fuqishme të keqeje. Kundërshtimit të armiqve të së vërtetës do t'i vihet kufi, në mënyrë që mesazhi i engjëllit të tretë të bëjë punën e vet. Me t'u dhënë paralajmërimi i fundit, ai do të tërheqë vëmendjen e udhëheqësve, që po punojnë tani për Zotin dhe disa prej tyre do ta pranojnë atë dhe do të bashkohen me popullin e Perëndisë në periudhën e vështirësive të mëdha.

Engjëlli, që bashkohet me shpalljen e mesazhit të tretë do ta ndriçojë botën mbarë me lavdinë e Tij. Këtu kemi të bëjmë me një punë mbarëbotërore dhe një fuqi mbinjerëzore. Lëvizja adventiste (e ardhjes) e viteve 1840-1844 ishte një mani-festim i lavdishëm i fuqisë së Perëndisë; mesazhi i engjëllit të parë u përhap në çdo

qendër misionare të botës dhe në disa vende ai zgjoi interesin më të madh fetar që është parë ndonjëherë që nga reformacioni i shekullit të XVI, por lëvizja e fuqishme e frymëzuar nga paralajmërimi i fundit i engjëllit të tretë do të ketë fryte akoma dhe më të shumta.

Puna do t'i ngjajë asaj të Ditës së Rrëshajave. Ashtu si "shiu i parë", që u dha me dërgimin e Frymës së Shenjtë në fillim të punës për përhapjen e Lajmit të Mirë, që të bënte të mundur lulëzimin e farës së çmuar, ashtu do të ndodhë edhe me "shiun e dytë" që do të bjerë në fund të kohës për të bërë të mundur korrjen e të mbjellave. "E njohim Zotin, do të përpiqemi ta njohim më mirë, ardhja e Tij është e sigurt si agimi. Ai do të na vijë si shiu, si shiu i fundit dhe i parë mbi tokë." *(Osea 6;3)*. "Prandaj gëzohuni, o bij të Sionit dhe kënaquni, ngazëllohuni tek Zoti, Perëndia juaj, sepse ju ka dhënë shiun e parë me drejtësi dhe do të bëjë të bjerë për ju shiun e fundit." *(Joeli 2;23)*. "Dhe në ditët e fundit do të ndodhë - thotë Perëndia - që Unë do të derdh Shpirtin Tim mbi çdo mish." "Dhe do të ndodhë që kush ta ketë thirrur emrin e Zotit do të shpëtohet" *(Veprat e Apostujve 2:17,21)*.

Puna e mrekullueshme e përhapjes së ungjillit nuk do të përfundojë me një shfaqje më të vogël të fuqisë së Perëndisë nga ç'filloi. Profecitë, që u përmbushën me rënien e shiut të parë të hapjes së ungjillit do të vazhdojnë të përmbushen edhe me shiun e dytë e të fundit. Këto janë edhe "kohët e flladit që apostulli Pjetër mezi po i priste kur tha: "Pendohuni, pra dhe kthehuni, që të shlyhen mëkatet tuaja dhe që të vijnë kohët e flladit nga prania e Zotit dhe Ai të dërgojë Jezu Krishtin" *(Veprat e Apostujve 3:19,20).*

Shërbëtorët e Perëndisë, me fytyra të ndriçuara nga përkushtimi hyjnor, do të nxitojnë nga vendi në vend për të shpallur mesazhin qiellor. Paralajmërimi do t'i përcillet botës nga cepi në cep nga jehona e mijëra zërave. Do të kryhen mrekulli, do të shërohen të sëmurët dhe fjalët e besimtarëve do t'i shoqërojnë shenja e çudi. Por edhe Satani do të punojë përmes shenjash të mëdha e madje do të bëjë të zbresë zjarr nga qielli. *(Zbulesa 13:13)*. Kështu, banorëve të tokës do t'iu duhet të zgjedhin se kujt duan t'i shërbejnë.

Mesazhin do ta shoqërojë më shumë fuqia bindëse e Frymës së Shenjtë, se sa argumentet pro tij. Të dhënat janë paraqitur një nga një. Fara është mbjellë dhe tani do të çelë e do të lidhë fryte. Botimet e shpërndara nga misionarët kanë ushtruar ndikimin e tyre, por megjithatë mendjet e shumë njerëzve, që janë prekur prej tij janë penguar disi që ta kuptonin plotësisht të vërtetën apo që t'i dorëzoheshin bindjes. Tani rrezet e dritës depërtojnë kudo, e vërteta shfaqet me gjithë bukurinë e saj dhe fëmijët e sinqertë të Perëndisë i thyejnë prangat e robërisë së tyre. Lidhjet familjare apo kishëtare nuk janë më të fuqishme që t'i mbajnë ata të lidhur pas tyre. E vërteta është më e çmuar se gjithçka tjetër përreth. Pavarësisht nga forcat e bashkuara kundër së vërtetës, një numër i madh njerëzish bashkohen me radhët e popullit të Perëndisë.

1. Krahasoni dhe vini në contrast vulën e Perëndisë me damkën e bishës.

2. Cila është Babilonia Frymore? Lexoni ngjarjen biblike të rënies së Babilonisë së asaj kohe tek Danieli 5. Si mund ta krahasojmë këtë me rënien e Babilonisë frymore?

3. Mbajtësit e Sabatit të vërtetë do të persekutohen. Si mund të jemi të përgatitur shpirtërisht për këtë ngjarje?

4. Lexoni Kolosianët 4:6. Si ju ndihmon ky tekst që të dini se sa "larg" duhet të shkojmë kur vjen puna për të "sulmuar mëkatet e kishës dhe kombeve"?

39.

Koha e Trazirave

Në atë kohë do të dalë Mikaeli, princi i madh, mbrojtësi i bijve të popullit tënd; dhe do të jetë një kohë me ankthe, ashtu si nuk ka pasur kurrë, që kurse ekzistojnë kombet e deri në atë kohë, e pikërisht në atë kohë do të çlirohen, edhe njerëzit e tu, të gjithë, emrat e të cilëve do të gjenden të shkruar në libër." *(Danieli 12:1)*

Me t'u dhënë edhe mesazhi i engjëllit të tretë, nuk ka më mëshirë për banorët mëkatarë të botës. Njerëzit e Perëndisë e kanë kryer detyrën e tyre. Ata e kanë pranuar "shiun e fundit", kohën e flladit të pranisë së Zotit dhe janë gati për t'i bërë ballë orës së provës së madhe. Engjëjt nxitojnë nga njëri vend tek tjetri. Një engjëll, duke u kthyer nga toka deklaron se e ka kryer punën e tij; bota është ballafaquar me provën përfundimtare dhe të gjithë ata, që janë treguar besnikë ndaj urdhëresave hyjnore kanë marrë vulën e Perëndisë që jeton. Në këtë moment Jezusi nuk është më ndërmjetës në shenjtoren qiellore. Ai ngre duart lart dhe me zë të lartë thotë: "U krye" dhe më pas engjëjt heqin kurorat e tyre mbretërore, ndërsa Ai thotë solemnisht: "Kush është i padrejtë, le të vazhdojë të jetë i padrejtë, kush është i ndyrë le të vazhdojë të jetë i ndyrë, kush është i drejtë le të vazhdojë të praktikojë drejtësinë dhe kush është i shenjtë le të vazhdojë të shenjtërohet." *(Zbulesa 22:11)*. Eshtë marrë çdo vendim jete a vdekjeje. Krishti ka kryer shlyerjen dhe fshirjen e mëkateve të popullit të Tij. Numri i shtetasve të Tij është bërë i njohur; mbretëria, sundimi dhe madhështia e më të madhes mbretëri nën qiell, është bërë gati për t'iu dhënë trashëgimtarëve të shpëtimit dhe Jezusi do të mbretërojë që nga ky moment Mbret i mbretërve dhe Zot i zotërve.

Me t'u larguar Ai nga shenjtorja, banorët e tokës i mbulon errësira. Gjatë asaj kohe të frikshme të drejtët duhet të ballafaqohen me Perëndinë pa ndihmën e një ndërmjetësi. Kufiri mbrojtës i vendosur edhe mbi njerëzit e ligj nuk ekziston më dhe Satani i ka ata plotësisht nën kontroll. Vuajtjes së gjatë të Perëndisë i ka ardhur fundi. Bota e ka mohuar mëshirën e Tij, e ka përçmuar dashurinë e Tij dhe e ka

shkelur me këmbë ligjin e Tij. Të padenjët e kanë kaluar kufirin e provës së tyre, Fryma e Shenjtë, së Cilës i kanë bërë ballë për një kohë kaq të gjatë, i ka braktisur më në fund. Të pastrehuar në hirin hyjnor, ata janë të pambrojtur përpara të Ligut. Pikërisht atëherë Satani do t'i zhysë banorët e tokës në një trazim të madh të fundit. Ndërsa engjëjt e Perëndisë nuk i kontrollojnë më erërat e pasionit njerëzor, të gjithë elementët e kontradiktave do të lirohen nga zinxhirët. Bota mbarë do të rrënohet më keq se Jeruzalemi i dikurshëm.

Një engjëll i vetëm solli vdekjen e të gjithë të parëlindurve egjiptianë dhe e mbushi vendin me lot e vaj. Kur Davidi e ofendoi Perëndinë, duke numëruar popullin, një engjëll ishte ai që shkaktoi shkatërrimin- dënim të këtij mëkati. E njëjta fuqi shkatërruese, që ushtrohet nga engjëjt e shenjtë, kur urdhëron Perëndia, do të vihet në punë edhe nga engjëjt mëkatarë, kur lejon Perëndia. Përreth nesh ka forca të gatshme që nuk presin asgjë tjetër veçse lejen hyjnore për të shkatërruar gjithçka.

Ata që e nderojnë ligjin e Zotit janë akuzuar si shkaktarë të fatkeqësive botërore dhe do të konsiderohen si mbartës të ndryshimeve të frikshme të natyrës, të mosmarrëveshjeve dhe gjakderdhjes mes njerëzve dhe do të mendohet se janë ata që po i sjellin mallkim këtij planeti. Fuqia që shoqëron paralajmërimin e fundit i ka tërbuar njerëzit zemërligj; zemërimi i tyre drejtohet kundër atyre që e kanë pranuar këtë mesazh dhe Satani do ta nxisë akoma dhe më shumë frymën e urrejtjes dhe persekutimit.

Kur Perëndia e fshehu fytyrën e Tij përpara kombit çifut, as priftërinjtë dhe as populli nuk e kuptuan një gjë të tillë. Edhe pse ishin nën kontrollin e Satanit dhe të pushtuar nga pasionet më të tmerrshme dhe keqdashëse, ata vazhdonin të mendonin se ishin populli i zgjedhur i Zotit. Shërbesat vazhdonin në tempull, në altarët e tij të ndotur vazhdonin të ofroheshin flijime dhe çdo ditë kërkohej bekimi hyjnor për një popull, që përpiqej të zhdukte pastorët dhe apostujt e Perëndisë dhe që ishte fajtor për gjakun e Birit të dashur të Perëndisë. Në të njëjtën mënyrë kur në shenjtoren qiellore të jetë marrë vendimi përfundimtar dhe të jetë përcaktuar fati i pandryshueshëm i kësaj bote, banorët e tokës nuk do ta dinë një gjë të tillë. Format e fesë do të mbahen gjallë nga njerëz, që nuk udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë. Zelli satanik, me të cilin princi i errësirës do t'i frymëzojë këta njerëz, që t'i zbatojnë në praktikë skemat e tij të pamëshirshme, do t'i ngjajë zellit që vjen nga Perëndia.

Duke qenë se Sabati është kthyer në pikën kyçe të kontradiktës së madhe në vendet e Krishtera dhe autoritetet fetare dhe sekulare janë bërë një për ta bërë adhurimin e së dielës të detyrueshëm, mosdorëzimi këmbëngulës i një pakice të vogël ndaj kërkesave njerëzore do t'i vërë ata në qendër të urrejtjes mbarëbotërore. Do të theksohet se ata të paktë njerëz, që e kundërshtojnë këtë rit fetar dhe këtë ligj shtetëror nuk duhen lënë të lirë të bëjnë çfarë të duan dhe se është më mirë që të vuajnë ata se sa të gjitha kombet t'i përfshijë rrëmuja dhe çrregullimi. Një mijë

e tetëqind vjet më parë sunduesit e kombeve përdorën të njëjtën argument kundër Krishtit. Eshtë e leverdisshme për ne, - tha Kajafa dinak, - që të vdesë vetëm një njeri për popullin dhe të mos humbasë gjithë kombi. *(Gjoni 11:50)*. Një argument i tillë do të jetë vendimtar dhe së fundi do të miratohet një dekret kundër të gjithë atyre, që e nderojnë Sabatin e urdhëresës së katërt, duke deklaruar se ata meritojnë dënimin më të ashpër dhe, duke u dhënë njerëzve, pas një farë kohe, dorë të lirë për t'i vrarë ata. Romanizmi në Botën e Vjetër dhe Protestanizmi femohues në Botën e Re do të ndjekin të njëjtën rrugë në lidhje me ata, që i respektojnë të gjitha urdhëresat hyjnore.

Njerëzit e Perëndisë do të përjetojnë shqetësimet dhe ankthin që përshkruhen nga profeti në kohën e vështirësive të mëdha të Jakobit: "Kështu thotë Zoti: Ne kemi dëgiuar një britmë tmerri, frike dhe jo paqeje... Pse tërë fytyrat janë bërë të zbehta? Medet, sepse ajo ditë është e madhe; nuk pati kurrë ndonjë të ngjashme me të; do të jetë një kohë ankthi për Jakobin, por ai do të shpëtojë prej tij." *(Jeremia 30:5-7)*.

Nata e ankthit të Jakobit kur ai lutej me ngulm që të shpëtonte nga dora hakmarrëse e Esaut *(Zanafilla 32:24-30),* përfaqëson përvojën e popullit të Perëndisë në orën e vështirësive të mëdha. Duke qenë se kishte mashtruar për të fituar bekimin e të atit, që i takonte në fakt Esaut, Jakobi u largua nga shtëpia për të ruajtur kokën i tmerruar nga kërcënimet vdekjeprurëse të të vëllait. Pasi qëndroi për vite me radhë në mërgim ai, duke iu përgjigiur urdhërit të Perëndisë, filloi udhëtimin bashkë me gratë, fëmijët dhe bagëtitë e tij drejt vendlindjes së vet. Me të arritur në kufijtë e vendit ai u frikësua nga lajmi që Esau në krye të një skuadre luftëtarësh po afrohej padyshim i gatshëm për t'u hakmarrë. Shoqëruesit e Jakobit, të paarmatosur e të pambrojtur, dukeshin sikur do të binin viktima të dhunës dhe urrejtjes. E për më tepër, barrës së ankthit dhe frikës iu shtua edhe pesha mbytëse e vetëqortimit, sepse ishte mëkati i tij (Jakobit) që i kishte vënë në një rrezik të madh.

Shpresa e tij e vetme ishte mëshira e Perëndisë; mbrojtja e tij e vetme, lutja. Megjithatë ai bëri gjithçka që ka në dorë për ta shlyer të keqen që i ka bërë të vëllait dhe për ta shmangur rrezikun kërcënues. Kështu duhet të veprojnë edhe pasuesit e Krishtit: ndërsa i afrohen orës së vështirësive të mëdha ata duhet të bëjnë gjithçka që kanë në dorë për t'iu shfaqur njerëzve në dritëhijen e duhur, për ta çarmatosur paragjykimin dhe për ta shmangur kështu rrezikun, që i kanoset lirisë së ndërgjegjes.

Duke e larguar familjen, në mënyrë që ata të mos ishin dëshmitarë të shqetësimit të tij, Jakobi qëndron vetëm, i gatshëm për të hyrë në bisedime me Perëndinë. Ai rrëfen mëkatin e tij dhe e pranon me mirënjohje mëshirën që Zoti ka treguar ndaj tij, ndërsa lutet i përulur; duke kujtuar besëlidhjen e Perëndisë me etërit e tij dhe premtimet që iu bënë atij vetë gjatë natës së vizionit në Bethel dhe gjatë viteve të mërgimit. Jeta e tij është në krizë; gjithçka është në rrezik. Në errësirë e në vetmi

ai vazhdon t'i lutet i përulur Perëndisë. Pa pritur ndjen një dorë mbi sup. Mendon se është një armik që do ta vrasë dhe me gjithë energjinë e dëshpërimit që ndjen lufton me sulmuesin e tij. Me të zbardhur dita, i huaji përdor fuqinë e tij të mbinatyrshme dhe vetëm prekja e tij duket sikur e paralizon njeriun e fuqishëm dhe ai i lutet i përlotur dhe i pashpresë armikut të tij misterioz. Jakobi e kupton tashmë se ai është përleshur me vetë engjëllin e besëlidhjes. Edhe pse ndjehet i pafuqishëm dhe i trishtuar, ai nuk heq dorë nga qëllimi i tij. Ai ka përjetuar për një kohë të gjatë ankth, dhimbje dhe keqardhje për atë që ka bërë dikur e tani duhet të sigurohet se është i falur. Vizitori hyjnor bëhet gati për t'u larguar, por Jakobi kapet fort pas tij, duke iu lutur për një bekim. Engjëlli i tha: "Lermë të shkoj, se po lind agimi." Por Jakobi iu përgjigj:Nuk do të lë të shkosh, në rast se nuk më bekon më parë. Çfarë besimi, qëndrueshmërie dhe këmbëngulje vihet re në këto fjalë! Sikur ky të kishte qenë një pretendim arrogant dhe i hamendshëm, Jakobi do të ishte shkatërruar në moment; por ai ishte thjesht një njeri, që rrëfen dobësitë dhe parëndësinë e vet dhe vazhdon t'i besojë mëshirës së një Perëndie që ruan besëlidhjen.

Me forcën e vet luftoi me Engjëllin dhe fitoi. *(Osea 12:6)*. Përmes përuljes, pendesës dhe vetëdorëzimit, ky njeri mëkatar dhe i padenjë fitoi ndaj Engjëllit qiellor. Ai u kap fort me duart që i dridheshin tek premtimet e Perëndisë dhe zemra e Dashurisë Pafund nuk mund të mos e pranonte lutjen e këtij mëkatari. Si provë triumfi dhe si shenjë inkurajimi për të tjerët, emri i tij ndryshoi nga një emër- kujtimi mëkati në një emër- përkujtim fitoreje. Fakti që Jakobi fitoi me Perëndinë ishte garanci, që provonte se ai do të fitonte edhe me njerëzit. Ai nuk kishte më frikë që të ballafaqohej me inatin e të vëllait, sepse Zoti ishte mburoja e tij.

Satani e kishte akuzuar Jakobin përpara engjëjve të Perëndisë, duke pretenduar se ai duhej zhdukur për shkak të mëkatit të tij. Ai e kishte frymëzuar Esaun që të marshonte kundër tij dhe ai u përpoq që gjatë natës së gjatë të agonisë së patriarkut ta bënte atë të ndjehej fajtor e të dekurajohej deri në atë pikë sa ta harronte Perëndinë. Jakobi ishte me të vërtetë i dëshpëruar, por e dinte që pa ndihmën qiellore do të ishte i humbur me gjithçka. Ai ishte penduar me sinqeritet për mëkatin e tij dhe me zemër të pastër i bëri thirrje mëshirës së Perëndise. Asgjë nuk do ta zbrapste përpara qëllimit që i kishte vënë vetes, prandaj e rroku fort engjëllin, duke qarë me lot e duke iu lutur me zë të dridhur derisa ia doli mbanë.

Ashtu si e nxiti Esaun që të marshonte kundër Jakobit, ashtu do t'i frymëzojë Satani edhe njerëzit e ligj që të shkatërrojnë në orët e vështirësive të mëdha, popullin e Perëndisë. Dhe ashtu si akuzoi Jakobin, ai do të ngrerë akuzat e tij kundër popullit të Perëndisë. Ai konsideron banorët e tokës si skllevër të tij dhe nuk i pëlqen ai grupi i vogël që, duke respektuar urdhëresat e Perëndisë i bëjnë ballë pushtetit të tij suprem. Sikur të mund t'i zhdukte ata nga faqja e dheut, triumfi i tij do të ishte i plotë. Ai shikon engjëjt e shenjtë që i mbrojnë ata dhe arrin në konkluzionin që

mëkatet e tyre janë falur, por në të vërtetë ai nuk e di se gjithçka është vendosur në shenjtoren qiellore. Ai i di mirë të gjitha mëkatet që kanë kryer ata, duke rënë pre e tundimeve të tij dhe i paraqet ata përpara Perëndisë më të fryrë se kurrë, duke i vizatuar ata si njerëz, që si ai vetë e meritojnë urrejtjen e Perëndisë. Ai deklaron se Perëndia i drejtë nuk mund t'i fali mëkatet e popullit të tij dhe njëkohësisht të shkatërrojë Satanin dhe engjëjt e tij. Ai i quan ata prenë e tij dhe kërkon që t'i lihet rrugë e lirë veprimi për t'i shkatërruar ata njëherë e përgjithmonë.

Ndërsa Satani i akuzon njerëzit e Perëndisë për mëkatet e tyre, Zoti e lejon që t'i vërë ata në provë deri në pikën e fundit. Besimi tek Perëndia dhe qëndrueshmëria e tyre do të vihen në një provë të vështirë. Ndërsa shqyrtojnë të shkuarën ata dekurajohen, sepse në jetën e tyre vënë re shumë pak elemente të së mirës. Ata janë më se të ndërgjegjshëm për dobësinë dhe parëndësinë e tyre. Satani përpiqet që t'i frikësojë ata me anë të mendimit se nuk kanë as më të voglën shpresë dhe se njolla e padrejtësisë së tyre nuk do të mund të lahet kurrë. Duke bërë këtë ai shpreson që ta groposë besimin e tyre, që ata t'i dorëzohen tundimeve të tij dhe të heqin dorë nga besnikëria ndaj Perëndisë.

Megjithëse njerëzit e Zotit do të rrethohen nga armiq, qëllimi i vetëm i të cilëve është shkatërrimi i tyre, ankthi që ata përjetojnë nuk vjen si rrjedhim i persekutimit për hir të së vërtetës, por për shkak të frikës që ata ndiejnë se mund të mos jenë penduar për çdo mëkat dhe se nuk do të mund ta përmbushin për fajin e tyre premtimin e Shpëtimtarit: Unë do të ruaj ty nga ora e sprovës që do të vij mbi të gjithë botën. *(Zbulesa 3:10)*. Sikur të ishin të sigurt se iu ishin falur mëkatet ata nuk do të dridheshin përpara torturave apo vdekjes, po sikur të jenë të padenjë dhe të humbin jetën e tyre falë të metave të karakterit, atëherë emri i shenjtë i Perëndisë do të përbaltej.

Nga çdo anë ata dëgjojnë komplote tradhëtie dhe shohin punën aktive të rebelimit e brenda tyre lind një dëshirë e zjarrtë dhe e ethshme që kjo lëvizje femohuese të përfundojë shpejt dhe ligësisë së njerëzve t'i vijë fundi. Por ndërsa i luten Perëndisë që t'i bëjnë ballë punës së rebelimit, ata vetë, duke përjetuar një ndjenjë të fortë vetëqortimi nuk kanë forcën e duhur që t'i qëndrojnë apo ta zprapsin valën e fuqishme të mëkatit. Ata mendojnë se, sikur t'i kishin përdorur të gjitha aftësitë e tyre në shërbim të Krishtit, duke fituar çdo ditë fuqi të reja, forcat e Satanit nuk do të ishin aq të mëdha sa të fitonin mbi ta.

Ata përulen përpara Perëndisë dhe, duke kujtuar se sa të penduar janë treguar për mëkatet e tyre të së shkuarës i luten Shpëtimtarit, duke përdorur fjalët e premtimit të Tij: "Do të ishte me Mua, po, për të bërë paqe me Mua." *(Isaja 27:5)*. Ata nuk heqin dorë nga besimi edhe pse lutjet e tyre nuk marrin një përgjigje të menjëhershme. Megjithëse përjetojnë një ankth, një shqetësim dhe një çrregullim të madh ata nuk pushojnë së luturi. Ata kapen fort pas fuqisë së Perëndisë ashtu siç

u kap edhe Jakobi fort pas Engjëllit dhe zemrat e tyre shqiptojnë fjalët: "Nuk do të të lë të shkosh, në rast se nuk më bekon më parë."

Sikur Jakobi të mos ishte penduar më parë që e fitoi të drejtën e të parëlindurit me mashtrim, Perëndia nuk do ta kishte dëgiuar lutjen e tij dhe nuk do t'ia kishte kursyer me mëshirë jetën. Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se populli i Perëndisë, gjatë orës së vështirësive të mëdha, do të ketë mëkate të parrëfyera edhe pse ata do të përjetojnë frikë e ankth, do të jenë të humbur; dëshpërimi do t'ia priste rrugën besimit dhe ata nuk do të kishin as sy, as faqe për t'iu lutur Perëndisë për shpëtim. Por ndërsa e ndiejnë thellë në zemër se nuk janë të denjë për t'i dalë përpara Zotit, nuk kanë fshehur asgjë të keqe nga sytë e Tij. Mëkatet e tyre janë gjykuar dhe fshirë plotësisht e ata i kanë harruar fare ato.

Satani i bën shumë njerëz të besojnë se Perëndia nuk do t'i kushtojë rëndësi "gabimeve" të tyre në çështjet e vogla të jetës, por Zoti na tregon nëpërmjet trajtimit që i bën Jakobit se Ai as nuk do ta miratojë e as nuk do ta tolerojë ndonjëherë të keqen. Të gjithë ata, që përpiqen t'i shfajësojnë apo fshehin mëkatet e tyre, duke i lënë ato të parrëfyera e të pafalura në faqet e librave qiellorë do të bien në kurthin e Satanit. Sa më fisnik të jetë profesioni i tyre dhe sa më e nderuar pozita që kanë, aq më e mjerë është në sytë e Zotit rruga që ata zgjedhin dhe aq më i sigurt triumfi i kundërshtarit të tyre të madh. Ata që vonohen në përgatitjet e tyre për ditën e fundit nuk mund ta rregullojnë atë as në orën e vështirësive të mëdha dhe as më pas. Rasti i këtyre njerëzve është i pashpresë.

Ata, të ashtuquajturit të Krishterë, që ballafaqohen me konfliktin e fundit të frikshëm të paarmatosur, do t'i rrëfejnë të dëshpëruar e në ankth mëkatet e tyre, ndërsa njerëzit e ligj do të gëzohen nga shqetësimi i tyre. Rrëfime të tilla janë të së njëjtës natyrë me ato të Esaut dhe Iudës. Ata që janë autorët e tyre ankohen për rezultatin e mëkatit dhe jo për fajin që mbart ai. Ata as nuk pendohen me të vërtetë dhe as nuk urrejnë me të vërtetë mëkatin. Ata i pranojnë mëkatet e tyre falë frikës së dënimit, por si Farisenjtë e dikurshëm, do të vazhdonin ta përçmonin Perëndinë sikur të mos ekzistonte më gjykimi.

Historia e Jakobit na siguron se Zoti nuk do t'i braktisë ata që janë mashtruar, tunduar e gënjyer në mëkat, por që janë rikthyer tek Ai të penduar. Ndërsa Satani përpiqet që ta rrënojë këtë grup njerëzish, Perëndia do të dërgojë engjëjt e Tij për t'i mbrojtur ata në rast rreziku. Sulmet e Satanit janë të vendosura dhe të ashpra; mashtrimet e tij të tmerrshme, i dëgjon të qarat e tyre. Ankthi i tyre është i madh dhe zjarri i furnaltës duket sikur do t'i bëjë shkrumb e hi, por Rafinatori do t'i nxjerrë nga furra si ar i provuar mes flakësh. Dashuria e Perëndisë për fëmijët e Tij gjatë periudhës së provave të tyre më të vështira është po aq e zjarrtë dhe e madhe sa në ditët e përparimit të tyre më të suksesshëm, por atyre iu duhet të futen në furrnaltën e zjarrtë, në mënyrë që të digjet dashuria e tyre për botën dhe ata të mundin ta reflektojnë imazhin e Krishtit të pacënuar.

Periudha e dëshpërimit dhe ankthit që na pret do të kërkojë nga ne një besim, që mund t'i bëjë ballë rraskapitjes, vonesës dhe urisë- një besim që edhe pse vihet në një provë të vështirë, pikërisht për një kohë të tillë. Jakobi fitoi, sepse ai ishte i vendosur e këmbëngulës. Fitorja e tij është provë e fuqisë së lutjes së vazhdueshme. Të gjithë ata që do të mbështeten tek premtimet e Perëndisë si bëri ai do të triumfojnë si triumfoi ai. Ata që nuk janë të gatshëm për vetëmohim, për t'u giunjëzuar përpara Perëndisë dhe për t'u lutur vazhdimisht dhe ethshëm për bekimin e Tij, nuk do ta fitojnë atë kurrë. Të luftosh me Perëndinë- sa pak veta e dinë se çfarë do të thotë kjo! Sa të paktë janë ata që i janë drejtuar Perëndisë me një dëshirë kaq të zjarrtë saqë çdo forcë e tyre është vënë në lëvizje. Kur njeriun që lutet e pushtojnë valë të tilla dëshpërimi që nuk ka giuhë që t'i përshkruajë, sa të paktë janë ata që mbështeten me besim të patundur tek premtimet e Perëndisë.

Atyre që ushtrojnë besim të pamjaftueshëm, iu kërcënohet rreziku i madh i rënies rob të zhgënjimeve satanike dhe të dekretit ndërgjegje- kontrollues. E madje edhe në rast se i bëjnë ballë provës, ata do të përjetojnë një ankth dhe shqetësim akoma më të madh gjatë orëve të vështirësive, sepse nuk e kanë zakon t'i besojnë Perëndisë. Ata do të detyrohen t'i mësojnë leksionet e besimit që i kanë flakur tutje dikur, nën një trysni të tmerrshme dekurajimi.

Ne tani duhet të njihemi me Zotin, duke i vënë në provën e të së vërtetës premtimet e Tij. Engjëjt mbajnë shënim çdo lutje të ethshme dhe të sinqertë. Më mirë të braktisim kënaqësitë egoiste se sa ta lëmë pas dore komunikimin me Perëndinë. Varfëria më e madhe dhe vetësakrifikimi më i plotë me miratimin e Tij, janë më shumë se pasuritë, nderet, rehatllëku dhe shoqëria e zhveshur nga bekimi i Tij. Ne duhet të kalojmë kohë duke u lutur. Nëse i lëmë mendjet tona që të jepen pas interesave botërore, Zoti mund të na krijojë "kohë të lirë", duke iu vënë shkelmin idhujve tanë të arit, shtëpive apo tokave pjellore.

Të rinjtë nuk do të josheshin drejt mëkatit sikur të mos pranonin t'i hynin një rruge tjetër, përveç asaj që ka vulën e bekimit të Perëndisë. Në rast se lajmëtarët e paralajmërimit të fundit solemn do t'i luteshin Perëndisë për t'i bekuar me zell dhe me besim si Jakobi e jo me përtaci, plogështi e ftohtësi ata do të kishin mundësi të dëshmonin shpesh. "E pashë Perëndinë ballë për ballë dhe jeta ime u kursye." - Zanafilla 32:30. Ata do të quheshin më se të denjë, duke pasur fuqi që të fitojnë me Perëndinë kundër njerëzve.

"Ora e vështirësive të mëdha, që nuk janë parë kurrë më parë" është afër dhe ne do të na duhet një përvojë shpirtërore që tani nuk e kemi dhe që shumë njerëz nuk bëjnë as përpjekjen më të vogël për ta fituar. Shpesh mendohet se problemet janë më të vështira në mendje se sa në realitet, por kjo teori nuk vlen në lidhje me krizën që na pret. Edhe përshkrimi më i gjallë nuk mund t'i skicojë përmasat e kësaj prove të vështirë. Në atë kohë ankthi, çdo njeriut do t'i duhet të paraqitet vetë para Perëndisë. "Edhe sikur mes tyre të ishin Noe, Danieli dhe Jobi, ashtu siç është e

vërtetë që unë rroj, - thotë Zoti, - ata nuk do të shpëtonin as bijtë as bijat e tyre sepse drejtësia e tyre do të shpëtonte vetëm ata vetë." *(Ezekieli 14:20)*.

Tani, ndërsa Kryeprifti ynë po ndërhyn për ne, ne vetë duhet të përpiqemi që të përsosemi në Krisht. As nuk duhet të na shkojë nëpër mendje se Shpëtimtari ynë mund t'i dorëzohet fuqisë së tundimit. Satani gjen në zemrën njerëzore diçka që i shërben si pikënisje, nxiten disa dëshira mëkatare në shpirt dhe falë tyre i hapet rruga tundimeve të tij. Por Krishti ka thënë për Veten e Tij: "Princi i kësaj bote nuk ka asgjë në Mua." *(Gjoni 14:30)*. Satani nuk gjeti asgjë në personin e Birit të Perëndisë që t'i jepte atij mundësi për të triumfuar. Ai i kishte respektuar urdhëresat e të Atit me përpikmëri dhe Ai i qëndronte larg mëkatit, në mënyrë që Satani të mos kishte asgjë në dorë kundër Tij. Të kësaj natyre duhet të jenë edhe ata që duan t'i bëjnë ballë orës së provës së madhe.

Përmes besimit në gjakun shlyerës të Krishtit, ne duhet të veçohemi nga mëkati në këtë jetë. Shpëtimtari ynë i çmuar na fton që të bashkohemi me Të, të bashkojmë dobësinë tonë me forcën e Tij, padijen tonë me mençurinë e Tij, parëndësinë tonë me aftësitë e Tij. Zemërgjerësia e Perëndisë është shkolla ku ne duhet të mësojmë bindjen dhe thjeshtësinë e Krishtit. Zoti madje po na parashtron jo rrugën që do të zgjidhnim ne, që është rruga më e lehtë dhe më e këndshme, por qëllimet e vërteta në jetë. Na takon ne që të bashkëpunojmë me forcat që përdor Perëndia në punën për t'i rigdhendur karakteret tona sipas modelit hyjnor. Askush nuk mund ta lërë pas dore apo ta mënjanojë këtë detyrë pa vënë në rrezik shpirtin e tij.

Apostulli Gjon në vizionin e tij dëgjoi një zë të lartë nga qielli, duke thirrur: "Mjerë iu banorë të tokës e të detit. sepse zbriti djalli drejt jush, duke pasur zemërim të madh, duke ditur se ka pak kohë." *(Zbulesa 12:12)*. Skenat që e bëjnë të thërrasë me të madhe zërin qiellor, janë të frikshme. Zemërimi i Satanit vjen duke u rritur ndërsa epokës sonë po i vjen fundi dhe mashtrimet e shkatërrimet do të arrijnë kulmin kur të trokasë ora e ankthit të madh.

Shpejt do të shfaqen në qiej shenja të frikshme të karakterit mbinatyror; prova këto të fuqisë çudibërëse të demonëve. Shpirtrat e demonëve do të shkojnë tek sundimtarët e kombeve dhe në çdo cep të tokës për t'i zënë ata në grackën e mashtrimit dhe për t'i nxitur kështu që të bashkohen me Satanin në përpjekjen e tij të fundit kundër qeverisjes qiellore. Këto forca do të mashtrojnë si sundimtarët, ashtu edhe njerëzit e thjeshtë. Do të shfaqen njerëz, që do të deklarojnë se janë Vetë Krishti, duke pretenduar si të tyren titullin dhe adhurimin që i takojnë Shpëtimtarit të kësaj bote. Ata do të kryejnë mrekulli të papara shërimi dhe do të shpallin se kanë vizione nga qielli që pa as më të voglin dyshim, do të bien ndesh me dëshminë e Shkrimeve të Shenjta.

Në dramën e madhe të mashtrimit aktin kurorëzues do ta luajë vetë Satani-personifikim i Krishtit. Kisha ka kohë që ka deklaruar se ardhja e Shpëtimtarit do të përbëjë edhe fundin e shpresave të saj. Mashtruesi i madh do të krijojë idenë se

Krishti është mes nesh. Në pjesë të ndryshme të botës Satani do të shfaqet mes njerëzve si një qënie madhështore me një shkëlqim marramendës, që i ngjan përshkrimit të Birit të Perëndisë që na jep Gjoni në librin e Zbulesës. *(Zbulesa 1:13- 15)*. Lavdia që e rrethon ia kalon çdo gjëje tjetër që kanë parë ndonjëherë sytë e njerëzve. Kudo dëgjohet britma triumfuese: "Ka ardhur Krishti! Ka ardhur Krishti!" Njerëzit i përulen atij në shenjë adhurimi, ndërsa ai ngre duart lart dhe i bekon ata ashtu siç i bekoi edhe Krishti dishepujt e Tij në tokë. Zëri i tij është i ulët dhe i qetë, por melodioz. Me një ton të këndshëm e të mëshirshëm ai shqipton disa nga të vërtetat e lavdishme qiellore që dikur i ka shpallur edhe Shpëtimtari; ai shëron të sëmurët e më pas, në këmbë të Krishtit, ai pretendon se e ka ndryshuar Sabatin në të Dielën dhe i urdhëron të gjithë që ta shenjtërojnë ditën që ai vetë e ka bekuar. Ai deklaron se ata që ngulin këmbë në respektimin e ditës së shtatë po blasfemojnë, duke mos pranuar t'u vënë veshin engjëjve, që dërgohen të mbarsur me dritë e të vërtetë, kundër emrit të Tij. Ky është mashtrimi më i madh, pothuajse i përsosur. Ashtu siç u mashtruan Samaritanët nga Simon Magusi, do të mashtrohen edhe mijëra njerëz, nga më i vogli tek më i madhi, nga këto fuqi absurde dhe këta të fundit do të thonë: "Kjo është fuqia e madhe e Perëndisë." *(Veprat e Apostujve 8:10)*.

Por populli i Perëndisë nuk do të gënjehet. Mësimet e këtij krishti të rremë nuk përputhen me Shkrimet e Shenjta. Bekimet e tij iu drejtohen adhuruesve të bishës dhe të figurës së saj, pikërisht atij grupi njerëzish mbi të cilët na thotë Bibla do të derdhet vera e papërzier e zemërimit të Perëndisë.

E për më tepër Satanit nuk i lejohet që të kopjojë mënyrën e ardhjes së Krishtit. Shpëtimtari i ka paralajmëruar njerëzit e Tij që të mos mashtrohen në këtë pikë dhe e ka paratreguar qartë mënyrën e ardhjes së Tij të dytë. "Sepse do të dalin krishtër të rremë dhe profetë të rremë dhe do të bëjnë shenja të mëdha dhe mrekulli të tilla aq sa t'i mashtrojnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit... Pra, në qoftë se iu thonë: "Ja, është në shkretëtirë", mos shkoni atje: "Ja është në dhomat e fshehta", mos u besoni. Sepse si vetëtima që del nga lindja dhe flakëron deri në perëndim, kështu do të jetë ardhja e Birit të njeriut." *(Mateu 24:24- 27, 31; 25:31)*; *(Zbulesa 1:7; 1) (Selanikasve 4:16,17)*. Është e pamundur që ta kopjosh këtë ardhje. Do të njihet nga bota mbarë- do të shihet nga të gjithë banorët e saj.

Vetëm ata, të cilët kanë qenë studentë të zellshëm të Shkrimeve të Shenjta dhe e kanë pranuar me zemër të hapur dashurinë për të vërtetën, do të mbrohen nga forca shkatërruese e këtij mashtrimi që do ta zërë rob botën. Këta njerëz do të mund t'ia çjerrin maskën mashtruesit falë dëshmive Biblike. Koha e provës është për të gjithë. Nga shoshitja e tundimit do të zbulohet i Krishteri i vërtetë. Janë vallë njerëzit e Zotit të lidhur kaq fort me fjalën e Tij saqë nuk i dorëzohen provës së ndjenjave të tyre? A do të kapen ata fort në këtë kohë kritike tek Bibla dhe vetëm tek Bibla? Satani, në qoftë se do të ketë mundësi, do t'i pengojë ata në përgatitjet për t'i bërë ballë orës së provës. Ai do t'i rregullojë gjërat në atë mënyrë që t'u zërë

rrugën atyre, duke i bërë ata që të magjepsen pas thesareve tokësore ose të jenë ngarkuar me një peshë kaq të rëndë dhe rraskapitëse sa që zemrat e tyre të jenë aq të dhëna pas problemeve dhe shqetësimeve të kësaj jete sa dita e provës së madhe t'u afrohet si hajdut nate.

Me t'u miratuar nga qeveritarët e vendeve Kristiane, dekreti kundër të gjithë atyre që i respektojnë urdhëresat dhe me t'u hequr kështu prej tyre mbrojtja e qeverisë, duke i lënë ata në duart e atyre që duan t'i shohin të vdekur, njerëzit e Perëndisë do të largohen nga qytetet e fshatrat dhe do të shoqërohen së bashku në grupe të vogla, duke jetuar në vendet më të shkreta e të izoluara. Shumë prej tyre do të gjejnë strehë në fortesat malore. Ashtu si të Krishterët e lëndinave të Piedmontit, edhe ata do t'i kthejnë vendet e larta në shenjtore e do ta falenderojnë Perëndinë për "shkëmbinjtë e fortifikuar." *(Isaja 33:16)*. Por shumë njerëz nga kombe e klasa të ndryshme, të rëndësishëm e të parëndësishëm, të pasur e të varfër, të zinj e të bardhë do të bien rob të një skllavërie të padrejtë e mizore. Të dashurit e Zotit kalojnë ditë rraskapitëse, të lidhur në zinxhirë e të mbyllur në burgje, të dënuar me varje në litar a të harruar në qelitë e errëta e të neveritshme, ku vdesin nga uria. Nuk ka asnjë vesh njerëzor që t'i dëgjojë të qarat e tyre dhe nuk ka dorë njerëzore që t'i ndihmojë.

Po Zoti a do ta harrojë popullin e Tij në një orë prove të tillë? A e harroi Ai Noan besnik kur e gjykoi botën përpara përmbytjes? A e harroi Ai vallë Zotin, kur zjarri zbriti nga qielli për t'i bërë shkrumb e hi qytetet e luginës? E harroi vallë Ai Jozefin kur ky jetonte i rrethuar nga idhulltarët egjyptianë? E harroi Ai vallë Elian kur betimi i Izabelës e kërcënonte atë me të njëjtin fat të profetëve të Baalit? E harroi Ai vallë Jereminë në gropën e errët dhe të mërzitshme të shtëpisë - burg? A i harroi Ai vallë të tre izraelitët trima në furrnaltën përvëluese apo Danielin në kafazin e luanëve?

"Por Sioni ka thënë: "Zoti më ka braktisur, Zoti më ka harruar." A mundet një grua që ta harrojë foshnjen e gjirit dhe të mos t'i vijë keq për fëmijën e barkut të saj? Edhe sikur ato të të harrojnë unë nuk do të harroj. Ja unë të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia." *(Isaja 49:14- 16)*. Zoti i ushtrive ka thënë: "Ai që iu prek, prek beben e syrit të Tij." *(Zakaria 2:8)*.

Edhe pse armiqtë mund t'i burgosin, muret e qelive nuk mund ta ndërpresin komunikimin e këtyre shpirtrave njerëzorë me Krishtin. Ai që sheh çdo dobësi të tyren, që njeh çdo provë që ata kalojnë, është mbi çdo fuqi tokësore; dhe çelitë e tyre të vetmuara do të presin engjëj si mysafirë; engjëj që do të sjellin dritë e paqe qiellore. Burgu do t'i ngjajë një pallati, sepse i pasuri në besim qëndron aty dhe muret e errëta do të ndriçohen nga shkëlqimi hyjnor si atëherë kur Pali dhe Sila u lutën dhe i thurën lavde Perëndisë në mesnatë në qelitë e burgut filipian.

Ndëshkimi i Perëndisë do të bjerë mbi ata që përpiqen t'i kundërshtojnë e t'i shkatërrojnë njerëzit e Tij. Durimi i Tij i madh me të ligjtë u ka dhënë zemër njerëzve që ta përqafojnë pa frikë padrejtësinë, por megjithatë dënimi i tyre është

i sigurt dhe i tmerrshëm, sepse është vonuar ca si shumë. "Zoti do të ngrihet si në malin e Peratsimit, do të zemërohet si në luginën e Gabaonit, për të plotësuar veprën e Tij, veprën e tij të padëgiuar, për të plotësuar punën e Tij të pazakontë." *(Isaja 28:21)*. Për Zotin tonë të mëshirshëm akti i dënimit është një akt i pazakontë. "Ashtu siç është e vërtetë që unë jetoj, - thotë Zoti, - unë kënaqem me vdekjen e të pabesit." *(Ezekieli 33:11)*. Zoti është "i mëshirshëm dhe i dhembshur, i ngadalshëm në zemërim, i pasur në mirësi dhe në besnikëri... që fal padrejtësinë, shkeljet dhe mëkatin." Megjithatë Ai "pa asnjë dyshim do ta zhdukë fajtorin." "Zoti është i ngadalshëm në zemërim dhe pushtetmadh, por nuk e lë pa e ndëshkuar aspak të ligun." *(Eksodi 34:6,7)*; *(Nahumi 1:3)*. Ai do të hakmerret për autoritetin e ligjit të Tij të përbaltur nëpërmjet gjërash të tmerrshme. Një ide e ashpërsisë së hakmarrjes që e pret të padenjin mund të krijohen nga mosdashja e Perëndisë për të ushtruar drejtësi në këtë rast. Kombi, të cilin Ai e ka duruar për një kohë të gjatë dhe që nuk do ta shpartallojë pa e mbushur kupën e padrejtësive sipas gjykimit të Perëndisë, do ta pijë më në fund kupën e zemërimit të papërzier me mëshirë të Zotit.

Me të pushuar së qëni Krishti ndërmjetësi ynë në shenjtoren qiellore, zemërimit "të papërzier" që iu kanoset atyre që e adhurojnë bishën dhe figurën e saj dhe që marrin damkën e saj mbi ballë, do t'i lihet rrugë e lirë. *(Zbulesa 14:9,10)* Plagët që përjetoi Egjipti kur Perëndia ishte gati për të çliruar Izraelitët ishin të ngjashme në karakter me ndëshkimet më të tmerrshme dhe më të mëdha që do të përjetojë bota përpara çlirimit përfundimtar të popullit të Perëndisë. Duke përshkruar këto dënime të llahtarshme zbuluesi thotë: "Një ulçer e ligë dhe e dhimbshme goditi njerëzit që kishin damkën e bishës dhe ata që e adhurojnë figurën e saj." Deti "u bë si gjaku i një të vdekuri dhe çdo qënie e gjallë në det vdiq." Dhe "lumenjtë dhe burimet e ujërave u bënë gjak." Megjithatë të gjitha këto fatkeqësi janë të tmerrshme, drejtësia e Perëndisë ka arsye për hakmarrje. Engjëlli i Zotit deklaron: "Ti je i drejtë o Zot... që i gjykove këto gjëra. Sepse ata kanë derdhur gjakun e shenjtorëve dhe profetëve dhe ti u dhe atyre të pijnë gjak, sepse është shpërblimi që ata meritojnë." *(Zbulesa 16:2- 6)*. Duke i dënuar njerëzit e Zotit me vdekje, ata e kanë dënuar edhe vetveten me vdekje, me derdhje gjaku. Në të njëjtën mënyrë Krishti në kohën e Tij, i deklaroi çifutët fajtorë për gjakun e derdhur të të gjithë shenjtorëve që nga ditët e Abelit, sepse ata frymëzoheshin nga e njëjta frymë dhe përpiqeshin të bënin të njëjtën gjë me vrasësit modernë.

Gjatë plagës që pason, fuqi i jepet diellit, në mënyrë që ai t'i djegë njerëzit me zjarr. Dhe njerëzit u dogjën nga një nxehtësi e madhe. *(versat 8,9)*. Më pas, profetët përshkruajnë gjendjen e tokës gjatë kësaj periudhe të frikshme. Fusha është shkretuar, vendi është në zi... tërë drurët e fushës u thanë sepse nuk ka gëzim midis bijve të njerëzve. Farat po thahen nën plisa, depot janë katandisur të shkreta... Sa vuajnë kafshët! Kopetë e gjedhëve sillen kot, sepse nuk ka kullotë për ta... Rrjedhat e ujit

janë tharë dhe zjarri ka gllabëruar tokat për kullotë. Atë ditë këngët e tempullit do të bëhen vajtime, - thotë Zoti, - Do të ketë kudo kufoma që do t'i hedhin jashtë në heshtje. *(Joeli 1:10-12, 17-20)*; *(Amosi 8:3)*.

Këto nuk janë plagë mbarëbotërore se përndryshe banorët e tokës do të zhdukeshin pa nam e pa nishan. Megjithatë, ato do të përbëjnë ndëshkimet më të tmerrshme që kanë njohur ndonjëherë qëniet njerëzore. Çdo dënim që iu është bërë njerëzve përpara periudhës së provës së madhe, ka qenë i përzier me mëshirë. Gjaku shlyerës i Krishtit e ka mbrojtur mëkatarin nga shpërblimi i plotë i fajit të tij, por gjatë ndëshkimit përfundimtar zemërimi do të shprehet i papërzier me mëshirë.

Gjatë asaj ore prove me mijëra njerëz do ta duan me shpirt mëshirën e Perëndisë, që e kanë përçmuar për një kohë të gjatë. "Ja, do të vijnë ditët, - thotë Zoti, - gjatë të cilave unë do të dërgoj urinë në vend, jo uri për bukë dhe etje për ujë, por më tepër për të dëgiuar fjalët e Zotit. Ata do të shkojnë duke u endur nga një det në tjetrin, nga veriu në lindje, do të rendin sa andej këtej në kërkim të fjalës së Zotit, por nuk do ta gjejnë." *(Amosi 8:11,12)*.

Edhe njerëzit e Perëndisë do të vuajnë, por ndërsa do të përndiqen e do të trishtohen, ndërsa do të vuajnë urie dhe nuk do të kenë me bollëk, atyre do t'u kursehet jeta. Ai Zot, që u kujdes për Elijan, nuk do ta lërë pas dore asnjërin nga fëmijët e Tij vetëmohues. Ai, që numëron flokët e tyre do të kujdeset për ta e në kohë zie buke ata do të jenë të ngopur. Ndërsa njerëzit e ligj do të vdesin nga uria dhe sëmundjet epidemike, engjëjt do t'i mbrojnë të drejtët dhe do t'ua plotësojnë nevojat atyre. Atij, që ecën me drejtësi i është premtuar: "Buka do t'i jepet atij dhe uji do t'i sigurohet. Të mjerët dhe të varfërit kërkojnë ujë, por mungon; giuha e tyre u është tharë nga etja; unë, Zoti do t'ua plotësoj dëshirën; unë, Perëndia i Izraelit, nuk do t'i braktis." *(Isaja 33:15,16; 41:17)*.

Ndonëse fiku nuk do të lulëzojë dhe nuk do të ketë asnjë fryt tek hardhitë, ndonëse punimi i ullirit do të jetë zhgënjyes dhe arat nuk do të japin më ushqim, ndonëse kopetë do të zhduken nga vathat dhe nuk do të ketë më qe në stalla, ata që e nderojnë Perëndinë do të ngazëllohen tek Zoti dhe do të gëzohen tek Perëndia i shpëtimit të tyre. *(Habakuku 3:17,18)*.

Zoti është Ai që të mbron, Zoti është hija jote, ai ndodhet në të djathtën tënde. Dielli nuk ka për të të goditur ditën, as hëna natën. Zoti do të të ruajë nga çdo e keqe; ai do të të ruaj jetën tënde. Me siguri ai do të të çlirojë nga laku i gjuetarit të shpendëve dhe nga murtaja vdekjeprurëse. Ai do të të mbulojë me pendët e tij dhe do të gjesh strehë nën krahët e tij; besnikëria e tij do të të shërbejë si mburojë dhe parzmore. Ti nuk do të kesh frikë nga terri i natës, as nga shigjeta që fluturon ditën, as nga murtaja që endet në terr, as nga shfarosja që bën kërdinë në mesditë. Njëmijë do të bien në krahun tënd dhe dhjetëmijë në të djathtën tënde, por ty nuk do të të afrohet. Mjafton që ti të këqyrësh me sytë e tu dhe të shikosh shpërblimin

e të pabesëve. Duke qenë se ke thënë: O Zot, ti je streha ime dhe e ke bërë Shumë të Lartin strehën tënde, nuk do të të gjejë asgjë e keqe, asnjë plagë nuk do t'i afrohet çadrës tënde. *(Psalmet 121:5-7; 91:3-10)*.

Megjithatë në sytë e njerëzve, do të duket sikur popullit të Perëndisë do t'i duhet ta vulosë dëshminë me gjak siç bënë edhe martirët përpara tyre. Edhe ata vetë fillojnë të kenë frikë e të mendojnë se Zoti i ka lënë pre në duart e armiqve të tyre. Eshtë një periudhë agonie e frikshme. Ata i luten Perëndisë ditë e natë për shpëtim. Njerëzit e pabesë gëzojnë dhe kudo dëgjohet britma e tyre tallëse: Ku e keni besimin tani? Pse nuk iu shpëton Perëndia nga hakmarrja jonë me që jeni me të vërtetë populli i Tij? Por besimtarëve të durueshëm iu kujtohet Jezusi që, ndërsa po vdiste në kryq dëgjoi të tallurat dhe shpotitjet e kryepriftërinjve dhe sundimtarëve: "Ai i shpëtoi të tjerët dhe nuk mund të shpëtojë vetveten; në qoftë se është mbreti i Izraelit, le të zbresë tani nga kryqi dhe ne do të besojmë në të." *(Mateu 27:42)*. Si Jakobi, edhe ata luftojnë me Zotin. Shprehjet e fytyrave të tyre rreflektojnë betejën e brendshme. Ata janë të zbehtë. Megjithatë nuk heqin dorë nga ndërmjetësimi.

Sikur njerëzit të ishin në gjendje që të shihnin vizione hyjnore ata do të vinin re një numër të madh engjëjsh që i rrethojnë me mure mbrojtës të gjithë ata që e kanë ndjekur me besim e durim fjalën e Krishtit. Me një ndjenjë të sinqertë simpatie, engjëjt kanë qenë dëshmitarë të ankthit dhe i kanë dëgiuar me veshët e tyre lutjet e këtyre njerëzve. Ata po presin urdhërin e Komandantit të tyre që t'i shpëtojë nga ky rrezik i madh. Por duhet të presin edhe pak. Njerëzit e Perëndisë duhet të pijnë nga kupa dhe të pagëzohen. Vetë kjo vonesë, që për ta është e dhimbshme, përbën përgjigjen më të mirë të peticioneve të tyre. Ndërsa përpiqen që të presin me besim që Zoti të veprojë, ata detyrohen që të ushtrojnë besim, shpresë dhe durim, që i kanë ushtruar kaq pak gjatë përvojës së tyre fetare. Megjithatë, për hir të të zgjedhurve, kjo kohë prove do të shkurtohet: "Vallë Perëndia nuk do të marrë hak për të zgjedhurit e tij që i këlthasin Atij ditë e natë?... Po, unë po iu them se ai do t'iua marrë hakun shpejt." *(Luka 18:7,8)*. Fundi do të vijë shumë më shpejt nga ç'presin njerëzit. Gruri do të grumbullohet e do të lidhet në duaj për hambarët e Perëndisë; egjra do të lidhet në krah shkarpash për zjarrin e shkatërrimit.

Rojet qiellore e kryejnë me besnikëri detyrën që u është besuar, vazhdojnë patrullimin. Edhe pse një dekret i miratuar e ka caktuar kohën kur jeta e njerëzve që nderojnë urdhëresat mund të vihet në rrezik, armiqtë e tyre në disa raste do ta paraprijnë këtë dekret e do të përpiqen t'i bëjnë gropën atyre përpara kohës së caktuar. Por askush nuk mund t'u shpëtojë rojeve të këtyre njerëzve besnikë. Disa prej tyre sulmohen, ndërsa largohen nga fshatrat dhe qytetet, por shpatat e ngritura kundër tyre thyhen e bien në tokë si të ishin fije kashte. Të tjerët i mbrojnë engjëj në formë luftëtarësh.

Gjatë gjithë kohërave Zoti e ka ndihmuar e çliruar popullin e Tij me anë të engjëjve hyjnorë. Qëniet qiellore kanë luajtur një rol aktiv në jetën e njerëzve. Ata

janë shfaqur të veshur me dritë apo si njerëz të thjeshtë, veshur si udhëtarë. Engjëjt u janë shfaqur shërbëtorëve të Perëndisë në formë njerëzore. Ata kanë pushuar kur janë lodhur, nën hijen e lisave. Kanë pranuar bujarinë e shtëpive tokësore. Janë kthyer në udhërrëfyes për udhëtarët që i ka zënë nata rrugës. Ata kanë ndezur me duart e tyre zjarret mbi altare. Kanë hapur dyer burgjesh e iu kanë falur liri shërbëtorëve të Zotit. Të armatosur me armaturën qiellore ata erdhën për të lëvizur madje edhe gurin e varrit të Shpëtimtarit.

Në formë njerëzore engjëjt janë ndërthurur me njerëzit e drejtë, por kanë vizituar edhe grumbullimet e të padrejtëve siç bënë me Sodomin, për të mbajtur shënim veprat e tyre dhe për të vendosur nëse ata e kanë kaluar kufirin e durimit të Perëndisë. Zotit i pëlqen shumë mëshira; dhe për hir të një numri të vogël njerëzish që me të vërtetë i shërbejnë Atij, ai nuk i dërgon fatkeqësi dhe e zgjat periudhën paqësore për mijëra të tjerë. Blasfemuesit e Perëndisë nuk e kuptojnë aspak se iu janë borxhli për jetët e tyre atyre të paktëve besnikë, të cilët i tallin e i shtypin.

Edhe pse sundimtarët e botës nuk e dinë, ata kanë pasur shpesh në këshillat e tyre engjëj si zëdhënës. Sy njerëzorë i kanë parë ata, veshë njerëzorë i kanë dëgjuar thirrjet e tyre, buzë njerëzore i kanë hedhur poshtë sugjerimet e tyre dhe janë tallur me këshillat që kanë dhënë ata, duar njerëzore i kanë përbuzur e kanë abuzuar me ta. Në salla mbledhjesh e gjyqesh këta lajmëtarë qiellorë kanë treguar se mund ta mbrojnë një të pafajshëm, shumë më mirë se më të aftët e më elokuentët avokatë mbrojtës. Ata kanë hedhur poshtë qëllime dhe kanë arrestuar elemente keqbërës, që do ta kishin vonuar shumë punën e Zotit dhe do t'u kishte shkaktuar shqetësime njerëzve të Tij. Në orë rreziku e ankthi "engjëlli i Perëndisë zë vend rreth atyre që kanë frikë prej Tij dhe i çliron." *(Psalmi 34:7)*.

Me një dëshirë të zjarrtë, populli i Perëndisë pret shenjat e ardhjes së dytë të Mbretit. Ndërsa rojeve u bëhet pyetja "Në ç'pikë ka arritur nata?", përgjigjja vjen shpejt "vjen mëngjesi e pastaj edhe nata." *(Isaja 21:11,12)*. Drita po depërton mes reve mbi majat e maleve. Shpejt do të shfaqet edhe lavdia e Tij. Dielli i Drejtësisë është në të dalë. Si mëngjesi dhe nata janë fare afër- mëngjesi: fillimi i periudhës së përjetësisë për të drejtët dhe nata: ardhja e fundit të përjetshëm për të padrejtët.

Ndërsa besimtarët i drejtojnë peticione Perëndisë, perdja që ndan të dukshmen nga e padukshmja duket sikur nuk ekziston më. Qiejtë ndriçohen nga lindja e ditës së përjetësisë dhe si melodi këngësh engjëllore dëgjohen fjalët: "Qëndroni të patundur në besnikëri. Ndihma po vjen." Krishti, Fitimtari i plotfuqishëm, u jep ushtarëve të Tij të rraskapitur një kurorë lavdie të përjetshme dhe zëri i Tij dëgjohet nga dyert pak të hapura qiellore: "Ja, Unë jam me iu. Mos kini frikë. Unë i di të gjitha ankthet tuaja, unë i kam mbajtur mbi supe trishtimet tuaja. Nuk po luftoni kundër një armiku të panjohur. E kam luftuar unë këtë betejë në emrin tuaj dhe në emrin Tim iu jeni më shumë se fitimtarë."

Shpëtimtari i çmuar do të na ndihmojë kur kemi më shumë nevojë. Rruga drejt parajsës është shenjtëruar nga giurmët e Tij. Çdo gjemb, që na ngulet në këmbë, i është ngulur Atij më parë. Çdo kryq që na duhet të mbajmë mbi supe, është mbajtur nga Ai më parë. Zoti lejon konflikte që ta përgatisë shpirtin për paqe. Ora e vështirësive të mëdha është një provë e fuqishme për njerëzit e Perëndisë, por është edhe momenti i duhur, kur çdo besimtar i vërtetë duhet të ngrejë sytë lart dhe me besim të shohë ylberin e premtimit që e rrethon.

"Të shpenguarit nga Zoti do të kthehen, do të vijnë në Sion me klithma gëzimi dhe një hare e përjetshme do të kurorëzojë kokën e tyre; do të marrin gëzim dhe hare e dhimbja e rënkimi do të zhduken. Unë, unë vetë, jam Ai, që iu ngushëllon; kush je ti që i trembesh njeriut që po vdes dhe birit të njeriut të caktuar të jetë bari? Ti ke harruar Zotin që të ka bërë... dhe kishe gjithnjë frikë, tërë ditën përpara tërbimit të shtypësit; kur ai përgatitej të të shkatërronte. Po ku është tani tërbimi i shtypësit? I mërguari në robëri do të çlirohet së shpejti, nuk do të vdesë në gropë e as nuk do t'i mungojë buka. Sepse Unë jam Zoti, Perëndia yt, që tund detin dhe bën të gjëmojnë valët; emri i Tij është Zoti i ushtrive. Unë i vura fjalët e Mia në gojën tënde dhe të mbulova me hijen e dorës Sime." *(Isaja 51:11-16)*.

"Prandaj tani dëgjo këtë, o e pikëlluar dhe e dehur, por jo nga vera. Kështu thotë Zoti yt, Perëndia yt, që mbron çështjen e popullit të Tij: "Ja, unë po të heq nga dora kupën e hutimit, llumin e kupës së zemërimit Tim; ti nuk do ta pish më. Do ta vë përkundrazi në duart e atyre që të hidhëronin dhe të thonin: "Shtrihu përtokë, që të kalojmë mbi ty" dhe ti bëje kurrizin tënd një vend, një rrugë për kalimtarët." *(versat 21-23)*.

Syri i Perëndisë, duke hedhur vështrimin në shekuj, u ndal tek kriza që do t'u duhej të përballonin njerëzit e Tij, pikërisht atëherë kur fuqitë tokësore do të bashkohen kundër tyre. Si të mërguarit- robër, ata do t'i tremben vdekjes nga uria apo dhuna. Por, I Shenjti që e ndau në dy pjesë Detin e Kuq përpara Izraelitëve, do ta manifestojë fuqinë e Tij pafund dhe t'i shpëtojë ata nga skllavëria. "Ata do të jenë të Mitë, - thotë Zoti i ushtrive,- ditën kur unë përgatis thesarin Tim të veçantë dhe Unë do t'i fal ashtu si e fal njeriu birin që i shërben Atij." - Malakia 3:17. Po të derdhej gjaku i këtyre dëshmitarëve besnikë të Krishtit në këtë rast ai nuk do të shërbente si gjaku i martirëve, si farë për të dhënë të mbjella të mbara për Perëndinë. Besnikëria e tyre nuk do të ishte dëshmi për t'i bindur të tjerët për të vërtetën, sepse zemra e ngurtë njerëzore i ka kthyer mbrapsht valët e mëshirës derisa ato nuk vijnë më. Në rast se të drejtët do të liheshin që të binin pre në duart e armiqve të tyre, princi i errësirës do të triumfonte. Psalmisti thotë: "Ditën e fatkeqësisë Ai do të më fshehë në çadrën e Tij, do të më fshehë në një vend sekret të banesës së Tij." *(Psalmi 27:5)*. Krishti tha: "Shko, o populli Im, hyr në dhomat e Tua, mbylli portat e tua prapa teje; fshihu për një çast, derisa të kalojë zemërimi. Sepse, ja, Zoti del

nga banesa e Tij për të ndëshkuar paudhësitë e banorëve të tokës." *(Isaja 26:20,21)*. I lavdishëm do të jetë çlirimi i atyre, që e kanë pritur me durim ardhjen e Tij dhe i kanë emrat të shkruar në librin e jetës.

1. Në çmënyrë do jetë ndryshe periudha e fundit e trazirave nga të gjitha sprovat e tjera të historisë njerëzore?

2. Satani do të improvizojë Ardhjen e Dytë të Jezusit. Si mund të përgatiteni për këtë mashtrim?

3. Çfarë hiri special do t'u jepet njerëzve të Perëndisë në mënyrë që të qëndrojnë besnik ndaj Tij gjatë kësaj kohe? Shikoni Danielin 12:1.

40.

Njerëzit e Perëndisë të Çliruar

Me t'u tërhequr mbrojtja e ligjeve kombëtare nga ata, që nderojnë ligjin e Perëndisë, në vende të ndryshme të botës do të fillojë një lëvizje e njëkohshme për shkatërrimin e tyre. Ndërsa koha e caktuar nga dekreti afrohet gjithnjë e më shumë, njerëzit do të fillojnë të konspirojnë për t'i zhdukur nga rrënjët të zgjedhurit e urryer. Do të merret vendimi që vetëm brenda një nate të organizohet një goditje e tillë e befasueshme që do t'ia mbyllë gojën të pabindurve dhe njerëzve "kokëfortë".

Populli i Perëndisë - disa nëpër qelitë e burgjeve e të tjerët në vende të fshehta në pyje e në male - vazhdon të lutet për mbrojtjen nga qielli, ndërsa nga çdo anë, grupe të armatosura njerëzish, të nxitur nga turma engjëjsh mëkatarë, përgatiten për t'iu bërë gropën. Pikërisht në atë kohë rreziku të madh, Perëndia i Izraelit do të ndërhyjë për çlirimin e të zgjedhurve të Tij. Zoti thotë: "atëherë do t'ia merrni këngës si natën kur kremtoni një festë dhe do të keni gëzim në zemër, ashtu si ai që shkon... në malin e Zotit, në kështjellën e Izraelit. Pastaj Zoti do të bëjë të dëgjohet zëri i Tij madhështor dhe do të të tregojë si godet me krahun e Tij, kur tërbohet nga zemërimi i Tij, në flakën e një zjarri gllabërues, në mes shpërthimesh të furishme uraganesh dhe breshëri gurësh". *(Isaia 30;29,30)*.

Me britma triumfi, talljeje dhe mallkimi, turma njerëzish të ligj përgatiten për t'iu sulur presë së tyre kur, oh, një errësirë e dendur dhe më e zezë se nata mbulon tokën. Më pas një ylber, duke ndriçuar me lavdi nga froni i Perëndisë, i jep dritë qiellit dhe duket sikur rrethon grupet e njerëzve, që luten. Turmat e njerëzve të inatosur çuditen. Britmat e tyre tallëse meken. Me parandjenja të frikshme në zemër, ata shikojnë simbolin e besëlidhjes së Zotit dhe dëshirojnë me gjithë shpirt që t'i fshihen shkëlqimit të Tij të mbinatyrshëm.

Nga mesi i radhëve të njerëzve të Perëndisë dëgjohet një zë i qartë dhe melodioz që thotë: "Shihni lart" dhe, ndërsa ngrenë sytë drejt qiellit, ata shohin harkun e premtimit. Retë e zeza e kërcënuese, që mbulonin kupën e qiellit janë larguar dhe

si Stefani edhe ata shohin me vëmendje qiellin dhe vënë re lavdinë e Perëndisë dhe Birin e njeriut ulur mbi fronin e Tij. Në formën e tij hyjnore ata akoma mund të shquajnë shenjat e poshtërimit të Tij të dikurshëm dhe nga buzët e Tij dëgjojnë kërkesën që Ai i parashtron të Atit përpara engjëjve hyjnorë: "O Atë, Unë dua që atje ku jam Unë, të jenë me Mua edhe ata që më ke dhënë" *(Gjoni 17;24)*. Dëgjohet përsëri një zë triumfues e melodioz që thotë: "Ata vijnë! Ata vijnë! Të shenjtë, të pastër e të padëmtuar. Ata e kanë mbajtur fjalën e durimit Tim, ata do të ecin mes engjëjve" dhe nga buzët e zbehta dhe që dridhen, të atyre, që e kanë ruajtur të pacënuar besimin, del një britmë fitoreje.

Perëndia e shfaq fuqinë e tij në çlirimin e popullit të Vet në mesnatë. Megjithatë del dielli, duke ndriçuar si të ishte mesditë. Shenja e çudi ndjekin njëra-tjetrën brenda një kohë te shkurtër. Të padenjët e shohin me tmerr e me çudi këtë skenë, ndërsa të denjët i shohin me gëzim solemn shenjat e çlirimit të tyre. Duket sikur çdo element i natyrës ka ndryshuar zakonet. Rrymat e ujit nuk rrjedhin më. Shfaqen re të zeza e të dendura që përplasen me njëra-tjetrën. Në mes të qiejve të vrenjtur ekziston një hapësirë e kaltër, e pastër e një lavdie të papërshkruar, nga ku vjen edhe zëri i Perëndisë si fërshëllima e ujërave të ujëvarave dhe thotë: "U krye" *(Zbulesa 16:17)*

Ai zë tund qiellin dhe tokën. Më pas ndodh një tërmet i madh "që i tillë nuk ishte bërë qëkurse u bënë njerëzit mbi tokë, një tërmet kaq fort i madh" *(versat 17,18)*. Kupa e qiellit duket sikur hapet e mbyllet, përmes saj ndriçon lavdia, që vjen nga froni i Perëndisë. Malet dridhen si një kallam nga era dhe shkëmbinjtë shpërndahen në të katër anët. Dëgjohet një oshëtimë si ajo e një furtune, që afrohet me shpejtësi. Deti është i kreshpëzuar. Ndihet si një klithmë uragani, që i ngjan zërit të demonëve, kur i hyjnë një misioni shkatërrimi. Toka gulçon e lëkundet si valët e detit. Sipërfaqja e saj fillon të plasaritet. Vetë themelet e saj duken sikur nuk mbajnë më. Vargmalet po shpërbëhen. Ishujt e papopulluar zhduken. Portat detare që i ngjajnë Sodomit për nga ligësia i përpijnë dallgët e inatosura. "Babilonia e madhe u kujtua përpara Perëndisë që t'i japë kupën e verës së zemërimit të Tij të tërbuar". Një breshër i madh "me peshë prej një talenti" shkatërron gjithçka që i del përpara. *(versat 19,21)*.

Qytetet më krenare të botës janë bërë rrafsh me tokën. Pallatet mbretërore për ndërtimin e të cilave, njerëzit e mëdhenj të botës kanë harxhuar pa kursim pasurinë e tyre dhe ku janë vetëlavdëruar sa kanë dashur, rrënohen përpara syve të tyre. Muret e burgjeve kthehen në gërmadha dhe njerëzve të Perëndisë, që janë burgosur për shkak të besimit të tyre, iu rifalet liria.

Varret hapen dhe "shumë nga ata që flenë në pluhurin e tokës zgjohen, disa në një jetë të përjetshme, të tjerë në turpin dhe në poshtërsi të përjetshme" *(Danieli 12:2)*. Të gjithë ata që kanë vdekur, duke i besuar mesazhit të engjëllit të tretë ringjallen të nderuar për të dëgjuar besëlidhjen e paqes së Perëndisë me ata që e kanë

respektuar deri në fund ligjin e tij. "edhe ata që e tejshpuan" *(Zbulesa 1:7)*, ata që u tallën dhe i përçmuan agonitë vdekjeprurëse të Krishtit si dhe kundërshtarët më të dhunshëm të së vërtetës dhe të popullit të tij ngrihen nga varret për ta parë me sytë e tyre lavdinë e tij dhe nderin që iu bëhet njerëzve besnikë e të bindur.

Re të dendura vazhdojnë ta mbulojnë qiellin, por herë pas here depërtojnë edhe disa rreze, që i ngjajnë shkëlqimit të syve hakmarrës të Jehovait. Vetëtima të shpeshta, që e kanë burimin në qiej e mbështjellin tokën me një perde të zjarrtë. Mes ushtimës së tmerrshme të furtunës dëgjohen zëra të llahtarshëm e misteriozë, që deklarojnë fatin e njerëzve të padrejtë e të ligj. Jo të gjithë i kuptojnë këto fjalë, por pa as më të voglin dyshim janë mëse të qarta për mësuesit e rremë. Ata që pak më parë ishin kaq aktivë, mendjemëdhenj, provokues dhe mospërfillës në mizorinë e tyre ndaj popullit urdhëresëmbajtës të Perëndisë, janë tani të pushtuar nga një tmerr dhe frikë mbytëse. Vajtimet e tyre dëgjohen mbi çdo zhurmë apo tingull tjetër. Demonët e njohin karakterin hyjnor të Krishtit dhe dridhen përpara forcës së tij, ndërsa njerëzit luten për mëshirë dhe shtrihen përtokë të llahtarisur.

Profetët e lashtësisë, ndërsa panë vizione të ditës së Perëndisë, e përshkruan atë kështu: "Bërtisni, sepse dita e Zotit është e afërt, ajo po vjen si një shkatërrim nga ana e të Plotëfuqishmit" *(Isaia 13:6)* "Hyr në shkëmb dhe fshihu në pluhurin përpara tmerrit të Zotit dhe përpara shkëlqimit të madhërisë së tij. Vështrimi krenar i njeriut do të ulet dhe krenaria e vdekatarëve do të përulet; vetëm Zoti do të lartësohet atë ditë. Sepse dita e Zotit të ushtrive do të vijë kundër çdo gjëje krenare dhe kryelartë dhe kundër çdo gjëje, që ngrihet për ta ulur." "Në këtë ditë njerëzit do t'ua hedhin minjve dhe lakuriqëve të natës idhujt e tyre prej argjendi dhe idhujt e tyre prej ari, që i kanë prodhuar për t'i adhuruar, për t'u futur në të çarat e shkëmbinjve dhe në greminat e kreshpave para tmerrit të Zotit dhe shkëlqimit të madhërisë së Tij, kur do të ngrihet për ta bërë tokën të dridhet" *(Isaia 2:10-12; 20,21)*.

Përmes një të çare mes reve rrezaton një yll, shkëlqimi i të cilit është katër herë më i madh në kontrast me errësirën e dendur. Ai iu jep shpresë e gëzim besnikëve, por iu flet për zemërim e ashpërsi shkelësve të ligjit të Perëndisë. Ata, që kanë flijuar gjithçka për Krishtin tani janë të sigurt, të fshehur si në dhomat sekrete të tendës së Zotit. Ata janë vënë në provë dhe i kanë treguar botës dhe përçmuesve të së vërtetës se ata do t'i qëndrojnë besnikë deri në fund Atij që vdiq për ta. Ata që janë treguar të qëndrueshëm në besim edhe përpara vdekjes kanë përjetuar një ndryshim të mrekullueshëm. Papritur ata janë çliruar nga tirania e tmerrshme dhe e zymtë e njerëzve të transformuar në demonë. Fytyrat e tyre, më parë të zbehta, të shqetësuara dhe të dërrmuara, ndriçojnë tani me çudi, besim e dashuri. Zërat e tyre ngrihen në një këngë triumfi: "Perëndia është për ne një strehë dhe një forcë, një ndihmë gjithnjë e gatshme në fatkeqësi. Prandaj ne nuk kemi frikë edhe sikur toka të luajë dhe malet të hidhen në mes të detit dhe ujërat e tij të tërbohen e të shkumbojnë dhe malet të dridhen nga fryrjet e tyre" *(Psalmi 46:1-3)*.

Ndërsa këto fjalë besimi të shenjtë ngjiten fluturimthi tek Perëndia, retë zhduken dhe shfaqen qartë qiejtë me yje që janë të një lavdie të papërshkrueshme krahasuar me kupën e zezë dhe të zymtë të qiellit në dy krahët e tyre. Lavdia e qytetit qiellor derdhet e pacënuar përmes portave të hapura të tij. Më pas në mes të qiejve shfaqet një dorë, që mban dy pllaka guri të lidhura së bashku. Profeti thotë: "qiejtë do të shpallin drejtësinë e tij, sepse vetë Perëndia është gjykatësi". *(Psalmi 50:6)*. Ai ligj hyjnor, drejtësia e Perëndisë, që u shpall përmes furtunës e flakëve nga mali i Sinait si udhërrëfyes jetësh, u zbulohet tani njerëzve si rregull gjykimi.Dora hap pllakat e gurta dhe aty shihen të shkruara si me penë zjarri urdhëresat e ligjit të shenjtë që iu dha Moisiut. Fjalët janë aq të qarta sa mund t'i besojnë të gjithë. Kujtesa zgjohet, errësira e supersticionit dhe herezisë zhduket nga çdo mendje dhe 10 urdhëresat e shkurtëra, të kuptueshme e autoritare janë në qendër të vëmendjes së të gjithë banorëve të tokës.

Eshtë e pamundur që të përshkruhet terrori dhe dëshpërimi i atyre që i kanë shkelur me këmbë kërkesat e shenjta të Perëndisë. Zoti u dha atyre ligjin; ata mund t'i kishin krahasuar karakteret e tyre me të dhe t'i kishin mësuar të metat e tyre, ndërsa kishin akoma mundësi për t'u penduar e për të ndryshuar, por në mënyrë që të fitonin dashamirësinë e botës, ata nuk i përfillën urdhëresat e Tij dhe i mësuan edhe të tjerët që t'i shkelnin ato me të dy këmbët. Ata u përpoqën që t'i detyronin njerëzit e Perëndisë që ta përdhosnin Sabatin e Tij. Tani ata dënohen nga ai ligj, që e përçmuan dikur. Ata e shikojnë qartë se nuk kanë asgjë që mund t'i shfajësojë. Ata e zgjodhën vetë se kë do të adhuronin dhe kujt do t'i shërbenin. "Atëherë do të shikoni përsëri ndryshimin ndërmjet të drejtit dhe të pabesit, ndërmjet atij që i shërben Perëndisë dhe atij që nuk i shërben Atij" *(Malakia 3:18)*.

Armiqtë e ligjit të Zotit, që nga pastorët e deri tek më i thjeshti, krijojnë mes tyre një ide të re mbi të vërtetën dhe detyrën që mbart ai në vetvete. Ata e kuptojnë tepër vonë se Sabati i urdhëresës së katërt përbën vulën e Perëndisë që jeton. Tepër vonë e kuptojnë edhe natyrën e vërtetë të Sabatit të tyre të rremë dhe të themelit prej rëre ku janë mbështetur. Ata kuptojnë se kanë qënë duke luftuar kundër Perëndisë. Mësuesit fetarë i kanë çuar njerëzit në greminën e humbjes, ndërsa thonin se po i udhëhiqnin drejt portave të Parajsës. Vetem në ditën e fundit të larjes së hesapeve do të shihet se sa e madhe do të jetë përgjegjësia e zyrtarëve të lartë të Kishës dhe sa të tmerrshme janë rezultatet e pabesnikërisë së tyre. Vetëm në përjetësi do të mund ta llogarisim me saktësi humbjen edhe të një njeriu të vetëm. I frikshëm do të jetë fati i atij të cilit Perëndia do t'i thotë: "Largohu, ti shërbëtor i lig!".

Zëri i Zotit dëgjohet nga qielli, duke deklaruar ditën dhe orën e ardhjes së Jezusit dhe duke u dhënë edhe një herë njerëzve besëlidhjen e përjetshme. Fjalët e Tij zbresin drejt tokës si kumbim i bubullimës më të fuqishme. Izraeli i Perëndisë dëgjon i heshtur me sytë lart. Fytyrat e tyre janë ndriçuar nga lavdia e Tij dhe shkëlqejnë si fytyra e Moisiut kur zbriti nga mali Sinai. Njerëzit e padenjë nuk i

shohin dot. Me t'u bekuar ata, që e kanë nderuar Perëndinë, duke mbajtur të Shenjtë Sabatin e Tij; dëgjohet një britmë fitoreje.

Papritmas nga lindja shfaqet një re e vogël e zezë, pothuajse sa gjysma e madhësisë së dorës së njeriut. Eshtë reja, që rrethon Shpëtimtarin e që duket në largësi si e mbështjellë në errësirë. Njerëzit e Zotit e dinë se kjo është shenja e ardhjes së Birit të njeriut. Ata e shikojnë në heshtje, ndërsa i afrohet tokës, duke u ndriçuar e duke u bërë gjithnjë e më i lavdishëm derisa shfaqet tërësisht, një re e bardhë e madhe, baza e së cilës i ngjan një lavdie si zjarr, që digjet dhe me të qëndron ylberi i besëlidhjes. Jezusi marshon përpara si një fitimtar i plotfuqishëm. Ka ardhur, jo më si "Njeriu i Vuajtjeve "për të pirë kupën e hidhur të turpit e zemërimit, por si fitimtar i qiellit dhe i tokës për të gjykuar si të gjallët, ashtu edhe të vdekurit." Besniku dhe i vërteti gjykon e lufton me drejtësi "dhe" ushtritë që janë në qiell" *(Zbulesa 19:11,14)* e ndjekin pas. Me himne melodish qiellore, një turmë e madhe dhe e panumërt engjëjsh të shenjtë, e shoqëron në këtë udhëtim. Kupa e qiellit mbushet me forma të shndritshme-" dhjetë mijë mbi dhjetë mijë, e mijëra e mijëra të tjerë. "Nuk ka penë njerëzore, që mund ta përshkruajë këtë skenë; nuk ka asnjë mendje aq të mprehtë njerëzore që ta kuptojë lavdinë e saj." Lavdia e Tij mbulonte qiejt dhe toka ishte plot me lëvdimin e Tij. Shkëlqimi i tij ishte si drita." *(Habakuku 3:3,4)*. Ndërsa reja afrohet gjithnjë e më shumë, çdo sy sheh Princin e jetës. S'ka më kurorë gjembash mbi kokën e tij, por një diademë. Lavdia i ka ndaluar mbi vetullën hyjnore.Shprehja e fytyrës së Tij reflekton shkëlqimin marramendës të diellit të mesditës." Dhe mbi rrobën e kafshën e Tij ishte shkruar një emër: "**Mbreti i mbretërve dhe Zoti i zotërve.**" *(Zbulesa 19:16)*.

Përpara Tij "të gjitha fytyrat bëhen të zbehta" dhe mohuesit e mëshirës së Perëndisë i zë tmerri i dëshpërimit të përjetshëm. "Zemra ligështohet, gjunjët dridhen ... dhe tërë fytyrat e tyre zverdhen." *(Jeremia 30:6); (Nahumi 2:10)*.Të drejtët thonë, duke u dridhur: "Kush do të jetë në gjendje që të qëndrojë? "Kënga e engjëjve pushon dhe kudo mbizotëron një periudhë qetësie e plotë. Më pas dëgjohet zëri i Jezusit që thotë: "Hiri im është i mjaftueshëm për ju". Fytyrat e njerëzve besnikë shkëlqejnë dhe çdo zemër mbushet me gëzim. Dhe engjëjt ia marrin një kënge të re, ndërsa i afrohen edhe më shumë tokës.

Mbreti i mbretërve ulet mbi re i mbështjellë si me një zjarr përvëlues.Qiejtë mbështillen si një pergamen, toka dridhet përpara Tij dhe çdo mal e ishull lëviz nga vendi i vet. "Perëndia ynë do të vijë dhe nuk do të rrijë në heshtje; do të paraprihet nga një zjarr shkatërrimtar dhe rreth tij do ketë një furtunë të madhe. Ai do të thërresë qiejtë nga lart dhe tokën për të gjykuar popullin e Tij." *(Psalmi 50:3,4)*.

"Dhe mbretërit e dheut, të mëdhenjtë, të pasurit, komandantët, të fuqishmit, çdo skllav e çdo i lirë, u fshehën nëpër shpella dhe nëpër krepat e maleve dhe u thoshin maleve dhe shkëmbenjve: "Bini mbi ne dhe na fshihni nga fytyra e Atij që rri mbi fron dhe nga zemërimi i qengjit." *(Zbulesa 6:15-17)*.

Të qeshurat tallëse nuk dëgjohen më. Buzët gënjeshtare nuk gjejnë dot më fjalët e shumëdëshiruara. Përplasja e armëve, çoroditja e betejës dhe "çdo mantel i rrëkëllyer me gjak "nuk do të ekzistojë më. Tani dëgjohen vetëm lutje, vajtime e ankime. Nga buzët, që deri tani vonë po talleshin del thirrja: "Dita e madhe e zemërimit të Tij ka ardhur. Kush do të jetë në gjendje t'i bëjë ballë?" Të padenjët luten që më mirë t'i vënë përfund shkëmbenjtë dhe malet se sa të takohen ballë për ballë me Atë, që e kanë mohuar e përçmuar.

Ata e njohin atë zë, që depërton deri tek veshët e të vdekurve. Sa shpesh u kanë bërë thirrje për t'u penduar tonet e tij të qeta. Sa shpesh është dëgjuar në përpjekjet mirëdashëse të një miku, të një vëllai, të një Shpëtimtari. Për mohuesit e hirit të Tij nuk ka asnjë tjetër, që mbart aq shumë dënim dhe që është ngarkuar me aq shumë qortim sa ai zë që u është lutur gjatë: "Konvertohuni, konvertohuni nga rrugët tuaja të këqija. Pse vallë duhet të vdisni, o shtëpi e Izraelit? *(Ezekieli 33:11)*. Oh ai ishte për ta zëri i një të panjohuri! Jezusi thotë: "unë thirra dhe ju nuk keni dashur, shtriva dorën Time, askush prej jush nuk i kushtoi vëmendje, përkundrazi hodhët poshtë të gjitha këshillat e Mia dhe nuk pranuat ndreqjen Time*." (Fjalët e Urta 1:24, 25)*

Ai zë zgjon kujtime që ata do të donin t'i fshihnin fare -paralajmërime të përçmuara, ftesa të refuzuara, privilegje të braktisura.

Këta janë ata që e tallën Krishtin e përulur. Me një fuqi tronditëse atyre u vjen në mendje Vuajtësi që kur e pyeti kryeprifti, deklaroi solemnisht: "Unë po ju them, se në të ardhmen ju do ta shihni Birin e njeriut duke ndenjur në të djathtën e Pushtetit dhe duke ardhur mbi retë e qiellit". *(Mateu 26:64)*. Tani ata e shohin me sytë e tyre lavdinë e tij dhe do ta shohin pas pak edhe të ulur në të djathtë të pushtetit.

Atyre, që e hodhën poshtë pretendimin e Tij se ishte Biri i Perëndisë u kanë humbur fjalët tani. Ja ku është edhe Herodi mistrec, që qeshi me titullin e Tij mbretëror dhe i urdhëroi ushtarët tallës që ta kurorëzonin Mbret. Janë edhe ata ushtarët, që me duart e fëlliqura i veshën rrobën e kuqërremtë, i vunë në ballë kurorën e gjembave, i dhanë në duar skeptrin e rremë dhe që u përulën përpara Tij në mënyrë tallëse e blasfemuese. Njerëzit, që e goditën dhe e pështynë Princin e jetës, i kthejnë kurrizin shikimit të Tij depërtues dhe përpiqen t'i shpëtojnë e t'i largohen lavdisë së mbinatyrshme të pranisë së tij. Ata, që i shpuan me gozhdë duart e këmbët, ushtari, që i shpoi brinjën, i shikojnë këto shenja me tmerr e mbytje ndërgjegjeje.

Priftërinjtë dhe sunduesit i kujtojnë ngjarjet e Kalvarit deri në imtësitë më të vogla. Atyre iu kujtohet sesi duke tundur kokat me gëzim satanik i thirrën Atij me të madhe: "Ai i shpëtoi të tjerët dhe nuk mund të shpëtojë Vetveten; në qoftë se është Mbreti i Izraelit le të zbresë tani nga kryqi dhe ne do t'i besojmë Atij, Ai ka besuar në Perëndinë; le ta lirojë tani në qoftë se e do me të vërtetë, sepse ka thënë: "unë jam Biri i Perëndisë." *(Mateu, 27:42,43).*

Kujtojnë me përpikmëri ata tani parabolën e vreshtarëve, që nuk pranuan t'i jepnin Zotit të Vreshtit frytet që i takonin, por i rrahën shërbëtorët e Tij dhe ia

vranë birin e vetëm. Atyre iu kujtohet gjithashtu dënimi, që ata e dhanë me gojën e tyre ku thanë "Zoti i vreshtit do të vijë e do t'i shfarosë vreshtarët". Njerëzit e padrejtë, priftërinjtë dhe anëtarët e pleqësisë shohin tek mëkati dhe dënimi i këtyre vreshtarëve rrugën, që ata vetë kanë ndjekur dhe fatin e afërt që i pret. E nga mesi i tyre ngrihet një klithmë, që i ngjan një agonie vdekjeprurëse. Akoma më therëse se britma "Kryqëzojeni, kryqëzojeni!", që u ndje dikur në rrugët e Jeruzalemit, dëgjohet kudo një zë vajtues dhe i dëshpëruar që thotë: "Ai është Biri i Perëndisë! Ai është Mesia i vërtetë!" Ata përpiqen që t'i largohen prezencës së mbretit të mbretërve. Ata më kot orvaten që të fshihen në shpellat e thella tokësore, të cilat janë bërë gërmadha nga veprimtaria e elementeve natyrore.

Vjen një moment në jetën e të gjithë atyre, të cilët e mohojnë të vërtetën, kur ndërgjegjja zgjohet, kur në mendje rikthehen kujtime të një jete hipokrite dhe kur shpirtin e bren keqardhja. Por çfarë janë të gjitha këto krahasuar me brejtjen e ndërgjegjes në atë ditë "kur frika vjen si një furtunë" dhe "kur fatkeqësia vjen si një stuhi" *(Fjalët e urta 1:27)*. Ata, që donin aq shumë që ta shkatërronin Krishtin dhe popullin e Tij janë tani dëshmimtarë të lavdisë që i mbulon ata. Të tmerruar siç janë ata dëgjojnë zërat e Shenjtorëve me nota të gëzuara që këndojnë: "Ja ky është Perëndia ynë; tek Ai kemi shpresuar dhe ai do të na shpëtojë." *(Isaja 25:9)*.

Në mes lëkundjes së tokës, vetëtimave dhe gjëmimit të bubullimave dëgjohet zëri i Birit të Perëndisë, që zgjon shenjtorët, që flenë. Ai shikon varret e të drejtëve dhe më pas, duke ngritur duart drejt qiellit thërret; "zgjohuni, zgjohuni, zgjohuni, ju që flini në pluhur dhe ngrihuni!"

Në të katër anët e botës të vdekurit do ta dëgjojnë atë zë dhe ata që do ta dëgjojnë do të ringjallen. Dhe bota mbarë do ta dëgjojë hapin e asaj ushtrie tejet të madhe të çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli. Ata dalin nga shtëpia- burg e vdekjes të veshur me lavdi të përjetshme, duke thirur: "O vdekje ku është gjëma jote? O ferr ku është fitorja jote? *(1 Korintasve 15:55)*. Shenjtorët e ringjallur dhe të gjallët e drejtë bashkojnë zërat në një britmë të gjatë dhe të gëzuar fitoreje.

Të gjithë dalin nga varret me të njëjtin fizik që kishin kur hynë në to. Adami, që qëndron në mes të turmës së të ringjallurve është tepër i gjatë dhe madhështor, pak më i shkurtër se biri i Perëndisë. Ai dallohet qartë, i krahasuar me njerëzit e brezave të mëvonshëm, në këtë aspekt duket qartë korruptimi i madh që breu racën tonë. Megjithatë të gjithë ringjallen me freskinë dhe zellin e një rinie të përjetshme. Në fillim njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, jo vetëm në karakter, por edhe në formë. Mëkati e shpërfytyroi dhe pothuajse e fshiu fare imazhin hyjnor, por Krishti erdhi për të restauruar atë që kishte humbur. Ai do të ndryshojë trupat tanë të fishkur për t'i gdhendur sipas modelit të trupit të Tij të lavdishëm. Forma e korruptuar, që mbante në vetvete vdekjen, pa hijeshi dhe e ndotur nga mëkati, kthehet në diçka të përsosur të bukur dhe të pavdekshme. Të gjitha të metat dhe

deformimet "Harrohen" në varr. Të shpëtuarit, të ripranuar në pemën e jetës, në Edenin e shumëhumbur, "do të fitojnë" *(Malakija 4:2)* formën e plotë të një lavdie të pacënuar. Shenjat e fundit të veprimit infektues të mëkatit do të fshihen dhe besnikët e Krishtit do të shfaqen të veshur me "bukurinë e Zotit", me mendje, shpirtra e trupa, që reflektojnë imazhin e përsosur të Zotit të tyre. Oh shpëtimi i mrekullueshëm! Sa gjatë është folur për të, sa shumë është pritur me padurim, por asnjëherë nuk është kuptuar plotësisht .

Të drejtët e gjallë transformohen "në një moment sa hap e mbyll sytë." Me të dëgjuar zërin e Perëndisë ata fitojnë lavdi, ndërsa tani u falet pavdekësia dhe bashkohen me shenjtorët e ringjallur për të takuar Zotin e tyre në ajër. Engjëjt "i mbledhin bashkë të zgjedhurit e Tij nga të katër anët, nga një cep i qiellit tek tjetri." Engjëjt hyjnorë u sjellin nënave fëmijët e tyre të vegjël. Ritakohen miq, që kanë kohë pa u parë për të mos u ndarë më kurrë dhe të gjithë së bashku, me këngë gëzimi në gojë, ngjiten drejt qytetit të Perëndisë.

Në të dyja anët e karrocës-re ka krahë dhe poshtë saj rrota, që lëvizin e, ndërsa karroca ngjitet gjithnjë e më lart duket sikur zhurma e rrotave thotë "I shenjtë" duket sikur lëvizja e krahëve thotë "I shenjtë" dhe suita e engjëjve thërret "I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë është Zoti, Perëndia i plotfuqishëm." Ndërsa karroca merr rrugën drejt Jeruzalemit të Ri të shpëtuarit brohorasin "Haleluja".

Përpara se të hyjnë në qytetin e madh të Perëndisë, Shpëtimtari i jep pasuesve të Tij emblemat e fitores dhe u fal atyre shenjat dalluese të mbretërisë së Tij. Radhët e shndritshme të shenjtorëve formojnë një katror me qendër bosh përreth mbretit të tyre, i cili ngrihet madhështor mbi njerëz dhe engjëj, duke rrezatuar nga të gjitha poret dashuri dhe mirësi. E gjithë turma e panumërt e të shpëtuarve është përqëndruar tek Ai, çdo sy sheh lavdinë e Atij fytyra e të Cilit rrezaton më shumë se e çdo njeriu dhe forma e të Cilit është më madhështore se ajo e bijve të njeriut.

Jezusi vendos me dorën e tij të djathtë, mbi kokat e fitimtarëve, kurorën e lavdisë. Secilit i takon një kurorë, mbi të cilën është shkruar "emri i tij i ri" *(Zbulesa 2:17)* dhe mbishkrimi "Lavdi Zotit". Çdo dorë rrok palmën e fitimtarit dhe harpën shndritëse. Më pas me t'i rënë engjëjt udhëheqës notës së parë çdo dorë i prek telat e harpës me zotësi artisti duke krijuar një melodi të bukur dhe origjinale. Një entuziazëm i papërshkruar pushton çdo zemër dhe të gjithë ngrenë zërat e tyre në një këngë lavdërimi: "Atij që na deshi dhe na lau nga mëkatet tona në gjakun e Tij dhe na bëri mbretër dhe priftërinj për Perëndinë dhe Atin e Tij, Atij i qoftë lavdi dhe pushtet në shekuj të shekujve." *(Zbulesa 1:5.6).*

Përpara turmës së shenjtë gjendet qyteti hyjnor. Jezusi i hap katërkanatëshe portat - perla dhe kombet, që e kanë ruajtur të vërtetën hyjnë brenda. Atje ata shohin parajsën e Perëndisë, shtëpinë e Adamit në virgjërinë e saj. Më pas dëgjohet përsëri ai zë që është më i pasur në melodi se çdo muzike që ka dëgjuar ndonjëherë

veshi njerëzor, duke thënë: "konfliktit tuaj i ka ardhur fundi," "Ejani ju o të bekuar të Atit tim dhe merrni si trashëgim mbretërinë, që është përgatitur për ju që nga krijimi i botës!"

Lutja e Shpëtimtarit për dishepujt e Tij është bërë realitet "Atje ku jam Unë do të jenë me mua edhe ata që më ke dhënë." *(Juda 24)* Krishti paraqet "të paqortueshëm dhe me gëzim para lavdisë së Atit", çmimin e gjakut të Tij, duke deklaruar: "Ja ku jam Unë dhe fëmijët që më dhe", "Ata që më ke dhënë i kam ruajtur." Oh sa të mëdha janë çuditë e dashurisë shlyerëse! Sa i madh është ngazëllimi i atij çasti kur Ati i Përjetshëm, duke vëzhguar të shpëtuarit, do të shohë në ta imazhin e Tij, ku gjurma dhe e keqja e mëkatit i janë fshirë dhe njerëzorja përputhet përsëri me hyjnoren!

Me një dashuri të papërshkrueshme Jezusi iu uron mirseardhjen besnikëve të Tij në gëzimin e Zotit. Shpëtimtari gëzon kur sheh në mbretërinë e lavdisë njerëzit, që janë shpëtuar falë agonisë dhe poshtërimit të Tij, ndërsa të shpëtuarit do të marrin pjesë në gëzimin e Tij kur të shohin mes shenjtorëve ata që i kanë besuar Krishtit përmes lutjeve, punës dhe sakrificave të tyre. Ndërsa i afrohen fronit të bardhë ata përjetojnë një lumturi të papërshkrueshme, kur shohin ata që i ka bërë ata vetë miq me Krishtin dhe kur vënë re se një ka sjellë të tjerë dhe të tjerët të tjerë akoma, që të gjithë të shijojnë parajsën e pushimit për t'i vënë kurorat e tyre tek këmbët e Jezusit dhe për t'i thurur lavde Atij çdo ditë përjetësie.

Me t'u uruar të shpaguarve mirseardhjen në qytetin e Perëndisë dëgjohet kudo një këngë adhurimi. Të dy Adamët bëhen gati për t'u takuar. Biri i Perëndisë qëndron në këmbë me krahë hapur për të pritur babain e racës sonë- qënien që e krijoi Ai vetë, që mëkatoi kundër Krijuesit të Tij, i Cili mban akoma në trup shenjat e kryqëzimit, që iu desh të përballonte për shkak të mëkatit të tij. Ndërsa Adami shquan me sy gjurmët e gozhdëve mizore ai nuk e përqafon Zotin e Tij, por bie në gjunjë para këmbëve të Tij, duke thënë: "I denjë, i denjë është qengji që u ther!" Shpëtimtari e ngre atë përsëri në këmbë me dashuri dhe e nxit që ta shikojë edhe një herë shtëpinë e tij në Eden, nga e cila ka kohë që është larguar.

Pas dëbimit të tij nga Edeni, jeta e Adamit në tokë u mbush me trishtim e probleme. Çdo gjethe e vyshkur, çdo viktimë flijimi, çdo e metë mbi fytyrën e qeshur të natyrës dhe çdo njollë mbi pastërtinë njerëzore e kujtonte atë për mëkatin e tij. Ndërgjegjja e brende tmerrësisht, ndërsa shikonte përhapjen e shpejtë të padrejtësisë dhe ndërsa merrte si përgjigje të paralajmërimeve të tij vetëm qortime, a thua se ai vetë ishte shkaku i kësaj të keqeje që quhej "mëkat". Ai duroi me përulje për pothuajse mbi 1000 vjet dënimin e shkeljes - mëkat. Ai u pendua me të vërtetë për mëkatin e tij, besoi në meritat e Shpëtimtarit të premtuar dhe vdiq me shpresën e një ringjalljeje në zemër. Biri i Perëndisë e vuri në vend rënien dhe dështimin njerëzor dhe tani përmes gjakut shlyerës, Adami e sheh veten në pronat e tij të dikurshme.

I mbushur me lumturi ai sheh pemët, që dikur ishin krenaria e tij-pikërisht ato pemë, frutat e të cilave i kishte mbledhur vetë me duart e tij në ato ditë gëzimi dhe pafajësie. Ai sheh vreshtat, që i ka punuar vetë dhe lulet, për të cilat kujdesej aq shumë. Mendja e tij fillon të kuptojë realitetin e kësaj skene. Ai e kupton që ky është me të vërtetë Edeni i restauruar, madje akoma dhe më i bukur nga ç'kishte qënë në ditën e mërgimit të tij. Shpëtimtari e drejton për tek pema e jetës, këput frytin e lavdisë dhe i thotë ta hajë. Ai hedh një vështrim përreth dhe shikon një turmë të madhe të shpëtuarish nga familja e tij, që janë miq në parajsën e Perëndisë. Pastaj ai e vendos kurorën e tij vezulluese tek këmbët e Jezusit dhe, duke e rrokur Shpëtimtarin e përqafon atë. Ai prek harpën e tij të artë dhe kupa e qiellit përcjell këngën e triumfit: "I denjë, i denjë është Qengji që u ther dhe jeton përsëri!" Anëtarët e familjes së Adamit bashkohen me këtë melodi, vendosin kurorat e tyre tek këmbët e Shpëtimtarit dhe përulen para Tij në adhurim.

Engjëjt, që vajtuan për rënien e Adamit dhe u ngazëlluan kur Jezusi pas ringjalljes, me anë të së cilës hapi dyert e varreve për të gjithë ata, që do t'i besonin emrit të Tij, u ngjit në qiell, ishin dëshmitarë të këtij ribashkimi. Tani ata panë me sytë e tyre realizimin e planit të shpëtimit dhe bashkuan zërat e tyre në këtë këngë lëvdimi.

Pranë detit të qelqtë, përpara fronit të Perëndisë, pranë atij deti që duket i përzier me zjarr, aq e shndritshme është lavdia e Zotit, janë grumbulluar ata "që kanë mundur bishën, figurën dhe damkën e saj dhe numrin e emrit të saj." Ata qëndrojnë në këmbë me qingjin mbi malin Sion "me harpa në duar," ata 144 mijë njerëzit, që ishin çliruar mes gjithë të tjerëve. Më pas dëgjohet një zë nga qielli, që i ngjan ushtimës së ujërave dhe gjëmimit të rrufeve. Eshtë zëri i harpistëve që u bien veglave të tyre. Ata këndojnë përpara fronit një "këngë të re," që s'mund ta mësojë askush, asnjë tjetër përveç të 144 mijëve. Eshtë kënga e Moisiut dhe e qengjit - një këngë çlirimi. Askush përveç 144 mijëve nuk mund ta mësojë atë këngë, sepse është kënga e përvojës së tyre- e një përvoje që nuk e ka përjetuar asnjë njeri tjetër. "Këta janë ata, që ndjekin Qengjin kudo që të shkojë Ai". Këta, duke u larguar nga toka dhe duke u shpenguar ndër njerëzit quhen "të parat fruta të Perëndisë dhe të Qengjit." *(Zbulesa 15:2.3; 14:1-5)*. "Këta janë ata që kanë ardhur nga shtrëngimi i madh. Ata kanë përballuar një provë të tillë të madhe, që nuk është parë ndonjëherë. Ata kanë përjetuar ankthin e orëve të vështirësive të mëdha të Jakobit, ata kanë qëndruar pa ndihmën e ndonjë ndërmjetësi përmes derdhjes përfundimtare të kupës së dënimeve të Perëndisë, por janë çliruar, sepse "i kanë larë dhe i kanë zbardhur rrobat e tyre në gjakun e Qengjit." "Në gojë të tyre nuk u gjet gënjeshtër, sepse janë të paqortueshëm para fronit të Perëndisë." "Prandaj edhe janë përpara fronit të Perëndisë dhe i shërbejnë Atij ditë e natë në tempullin e Tij dhe ai që rri ulur mbi fron do të banojë mes tyre." Ata e kanë parë tokën të zhuritur nga zitë e bukës dhe sëmundjet epidemike, kanë parë diellin me një fuqi të tillë përvëluese sa i ka

përzhitur njerëzit dhe ata vetë kanë duruar vuajtje, uri dhe etje. Por "ata nuk do të kenë më uri, as nuk do të kenë etje, as nuk do t'i godasë më dielli, as nuk do të kenë vapë, sepse Qengji, që është në mes të fronit do t'i kullosë e do t'i çojë te burimet e gjalla të ujërave dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre" *(Zbulesa 7:14-17)*.

Gjatë gjithë kohërave njerëzit e zgjedhur të Shpëtimtarit janë edukuar e disiplinuar në shkollën e provës. Ata ecën në tokë në rrugica të ngushta dhe u pastruan në furrnaltën e vuajtjeve. Ata duruan për hir të Jezusit, kundërshtim, urrejtje dhe shpifje.Ata e ndoqën Atë përmes konfliktesh, ata përballuan vetmohimin dhe përjetuan zhgënjime të hidhura. Ata e kuptuan të keqen, fuqinë, fajin dhe mallkimin, që mbart në vetvete mëkati falë përvojës së tyre të dhimbshme dhe mësuan kështu ta urrejnë atë. Ideja e sakrificës së madhe, që është dashur të bëhet për ta kuruar atë nuk i lejon ata që të krenohen dhe ua mbush zemrat me mirënjohje dhe lavde, ndjenja këto që ata që nuk kanë dështuar kurrë nuk mund t'i njohin. Ata duan shumë, sepse edhe janë falur shumë. Duke qënë se kanë marrë pjesë në vuajtjet e Krishtit ata janë të përshtatshëm për t'u bërë pjesë edhe e lavdisë së tij.

Trashëgimtarët e Perëndisë vijnë nga çardakë, nga kolibe, nga burgje, nga male, nga shkretëtira, nga shpellat tokësore dhe nga fundi i detit. Ndërsa jetonin në tokë "ata vuajtën", u persekutuan dhe ishin të varfër. Me miliona vetë u varrosën të mbuluar me turp, vetëm e vetëm, sepse nuk pranuan t'i dorëzoheshin pretendimeve mashtruese të Satanit. Gjykatat njerëzore i gjykuan si kriminelët më të këqinj. Por tani "vetë Perëndia është gjykatësi" *(Psalmi 50:6)*. Tani vendimeve njerëzore u ka ardhur fundi. "Zoti do të heqë nga tërë dheu turpin e popullit të Tij." *(Isaja 28:8)* "Do t'i quajnë populli i Shenjtë", "të çliruarit e Zotit". Ai ka vendosur që "t'u jap atyre një diademë në vend të hirit, vajin e gëzimit në vend të zisë, mantelin e lavdërimit në vend të një fryme të ligështuar." *(Isaja 62:12; 61:3)*. Ata nuk janë më të dobët, të vuajtur, të përçarë dhe të shtypur. Që tani e tutje ata do të jetojnë përgjithmonë me Zotin. Ata qëndrojnë para fronit të veshur me petka më të çmuara se të gjithë njerëzit më të nderuar të botës. Ata janë nderuar me Diadema më madhështore, se ato të monarkëve tokësore. Ditëve të dhimbjes dhe vajit u ka ardhur fundi. Mbreti i lavdisë i ka fshirë lotët nga sytë e të gjithëve, nuk ekzistojnë më shkaqe trishtimi. Në mes valëvitjes së degëve të palmave ata këndojnë një këngë të qartë, melodioze dhe të gëzuar lëvddimi; të gjithë këndojnë me gjithë zemër notat e kësaj kënge, derisa vetë kupa e qiellit e përcjell himnin: "Shpëtimi është i Perëndisë sonë, që është ulur mbi fron dhe i Qengjit." Të gjithë banorët e qiellit përgjigjen me fjalët: "Amen, Bekimi, Lavdia, Dituria, Falenderimi, Nderimi, Fuqia dhe Forca janë të Perëndisë sonë në shekuj të shekujve." *(Zbulesa 7:10;12)*.

Në këtë jetë ne vetëm sa mund të fillojmë ta kuptojmë temën e mrekullueshme të shpëtimit. Me mendjet tona të kufizuara ne mund të mendojmë me zell të madh për turpin dhe lavdinë, jetën dhe vdekjen, drejtësinë e mëshirën që reflekton kryqi,

megjithatë edhe pse mund t'i vëmë në punë të gjitha fuqitë tona mendore nuk arrjmë ta kuptojmë domethënien e Tij të plotë. Gjatësia e gjerësia, thellësia e lartësia e dashurisë shlyerëse vetëm sa merren me mend. Plani i shpëtimit nuk do të kuptohet imtësisht as atëherë kur të çliruarit të shohin se si janë parë dhe të njohin se si janë njohur. Vetëm me kalimin e shekujve të përjetësisë, mendja njerëzore do të mrekullohet e do të çuditet nga e vërteta që do t'i zbulohet vazhdimisht nga viti në vit, nga shekulli në shekull. Megjithëse trishtimeve, dhimbjeve e tundimeve tokësore do t'u vijë fundi dhe mëkati në vetvete do të shkatërrohet përfundimisht, populli i Perëndisë nuk do të arrijë ta krijojë kurrë një ide të qartë dhe intelektuale të çmimit të vërtetë të shpëtimit të tyre.

Kryqi i Krishtit do të jetë shkenca dhe kënga e të shpëtuarve gjatë gjithë përjetësisë. Në figurën e Krishtit të lëvduar ata do të shohin Krishtin e kryqëzuar. Nuk do të harrohet kurrë që ai krijoi dhe koordinoi me anë të fuqisë së Tij botët e panumërta të hapësirës pa anë e cak, I Dashuri i Perëndisë, Madhëria qiellore, Ai, që kerubini dhe serafini (engjëlli), shndërrues e adhuronin me gjithë shpirt u përul për të lartësuar njerëzimin mëkatar; Ai që duroi fajin e turpin e mëkatit si dhe fshehjen e fytyrës së të Atit, deri sa mallkimet e një bote të humbur ia thyen zemrën dhe e copëzuan jetën e Tij mbi atë kryq në Kalvar. Fakti që krijuesi i të gjitha botëve pa përjashtim dhe Gjyqtari i çdo fati hoqi dorë nga lavdia e Tij dhe u poshtërua nga dashuria për njeriun do të ngjalli gjithmonë çudinë e adhurimin e një universi mbarë. Ndërsa armatat e të shpëtuarve hedhin vështrimin tek Shpëtimtari i tyre dhe shohin të shkëlqejë mbi fytyrën e Tij, lavdia e përjetshme e të Atit, ndërsa shohin fronin e Tij, që ekziston nga përjetësia në përjetësi dhe kuptojnë se mbretërisë së Tij nuk do t'i vijë kurrë fundi ata shpërthejnë në një këngë të gëzueshme: "I denjë, i denjë është Qengji që u ther dhe na ka shpëtuar e pajtuar ne me Perëndinë me anë të gjakut të Tij të çmuar!"

Misteri i kryqit shpjegon të gjitha misteret e tjera. Në dritën e Kalvarit, vetitë e Perëndisë që na kanë ngjallur respekt e nderim duken kaq të bukura e tërheqëse. Vihet re se si mëshira, butësia dhe dashuria prindërore ndërthuren me shenjtërinë, drejtësinë dhe fuqinë. Ndërsa jemi dëshmitarë të madhështisë së fronit të Tij të lartësuar e të shenjtëruar ne shohim të shprehur me lavdi karakterin e Tij dhe e kuptojmë si asnjëherë më parë domethënien e atij emri të dashur "Ati Ynë".

Do të vihet re se Ai, që është i pafund në mençuri nuk mund të hartonte një plan tjetër për shpëtimin tonë, përveç flijimit të të Birit. Shpërblimi i një sakrifice të tillë është gëzimi që sjell popullimi i tokës me qenie të shenjta, të lumtura, të pavdekshme e të shpaguara. Konflikti i Shpëtimtarit me fuqitë e errësirës rezulton në gëzim për të shpëtuarit, që ia dedikojnë gjithçka sa të jetë përjetësia lavdisë së Perëndisë. Dhe Ati është i kënaqur kur çmimi i paguar i ka dhënë një vlerë të tillë shpirtit, dhe Krishti Vetë, duke parë frytet e flijimit të Tij, është i kënaqur.

1. Perëndia i Izraelit do të ndërhyjë në "orën e ekstremitetit maksimal." A mund të sillni ndërmend një eksperiencë jetësore në të cilën Perëndia ndërhyri për t'ju çliruar nga një moment kritik?

2. Lexoni Zbulesën 14:1-5. Çfarë i bën 144,000 njerëzit një grup special? Përse ata janë të vetmit që mund të këndojnë këngën e Moisiut dhe të Qengjit?

3. Ndërsa Dhjetë Urdhërimet zbresin nga qielli, armiqtë e ligjit kuptojnë se "Sabati i urdhërimit të katërt është vula e Perëndisë së gjallë." Çfarë mund të bëni ju që të ndihmoni njerëzit të kuptojnë dhe ta pranojnë të vërtetën e Sabatit?

4. Të shpëtuarit do të ftohen në "gëzimin e Zotit." Reflektoni për gjërat e mrekullueshme që do të shikoni dhe që do të përjetoni përgjatë gjithë përjetësisë.

41.

Shkretimi i Tokës

"Mëkatet e saj kanë arritur deri në qiell dhe Perëndia kujtoi paudhësitë e saj... Në kupën që ajo derdhi derdhini dyfish. Në masën që u vetëlavdërua ajo dhe shfreu në epshe, në atë masë i jepni asaj mundim dhe brenga, sepse ajo në zemër të saj thotë: "Unë rri posi mbretëreshë, e ve nuk jam dhe brengë nuk do të njoh." Prandaj në një ditë të vetme do të vijnë plagët e saj: vdekja, vaji dhe zija e bukës; edhe do të digjet krejt në zjarr, sepse i fuqishëm është Zoti Perëndia, Ai që e gjykon atë. Dhe do të qajnë atë dhe do të vajtojnë për të mbretërit e dheut, ata që u kurvëruan me të dhe u dhanë pas epsheve të saj... duke thënë: "Mjerë, mjerë Babilonia, qyteti i madh, qyteti i fuqishëm, sepse në një moment erdhi gjyqi yt!" *(Zbulesa 18:5-10)*.

"Edhe tregëtarët e dheut" që "u pasuruan për shkak të luksit të saj të tepruar" "do të rrijnë larg për shkak të frikës së mundimit të saj dhe do të qajnë e do të vajtojnë, duke thënë: "Ah! Ah! Qyteti i madh që ishte veshur me li të hollë, me të purpurta e të kuqe të ndezur dhe i stolisur me ar, me gurë të çmuar e me margaritarë! Sepse në një moment u shkatërrua një pasuri kaq e madhe!" *(Zbulesa 19;11,3, 15-17)*

Të tilla fatkeqësi do të përjetojë Babilonia në ditën e zemërimit të Perëndisë. Ajo e ka mbushur kupën e paudhësive të saj, koha ka ardhur, ajo është pjekur për t'u korrur me drapërin e shkatërrimit.

Kur zëri i Perëndisë i jep fund robërisë së popullit të Tij, ata që kanë humbur gjithçka në konfliktin e jetës fillojnë të zgjohen nga ky gjumë letargjik. Gjatë periudhës së provës ata ishin verbuar nga mashtrimet e Satanit dhe e shfajësonin veten për këtë rrugë mëkatare që ndiqnin. Të pasurit vetëlavdëroheshin për epërsinë e tyre mbi ata që kishin më pak, por harruan që e kishin vënë pasurinë e tyre, duke e shkelur me këmbë ligjin e Zotit. Ata nuk e kishin çuar në vend detyrën e tyre për të ushqyer të uriturit, për të veshur të zhveshurit, për të vepruar me drejtësi dhe për ta përqafuar mëshirën. Ata ishin përpjekur që të vetëlartësoheshin për të fituar kështu nderimin e bashkëkrijesave të tyre. Tani ata janë zhveshur nga gjithçka që i

bënte të rëndësishëm e janë lënë në mëshirë të fatit, nevojtarë e të pambrojtur. Ata shikojnë me sy të zgurdulluar shkatërrimin e idhujve, që i zinin vendin krijuesit në zemrat e tyre. Ata ia kanë shitur shpirtin pasurive dhe kënaqësive tokësore dhe nuk kanë bërë asgjë për t'u pasuruar në sytë e Perëndisë. Si rrjedhim jetët e tyre janë një dështim i plotë, kënaqësitë e tyre janë kthyer në hidhërim dhe thesaret e tyre janë korruptuar nga i pari tek i fundit. Fitimi i një jete zhduket sa hap e mbyll sytë. Të pasurit vajtojnë shkatërrimin e shtëpive të tyre të stërmëdha dhe groposjen e arit dhe argjendit të dikurshëm, por këto vaje fashiten nga frika se ata vetë do të zhduken së bashku me idhujt e tyre.

Të padrejtët i bren ndërgjegjja, jo sepse e kanë mohuar me paturpësi Perëndinë dhe i kanë përçmuar të tjerët, por sepse Zoti ka dalë fitimtar. Ata vajtojnë një rezultat të tillë, por nuk pendohen për ligësinë e tyre. Po t'u jepej rasti, ata nuk do të linin gjë pa bërë për të fituar.

Bota vë re se ai grup njerëzish, që ata e kanë tallur e përçmuar dhe kanë dashur ta zhduknin nga faqja e dheut, nuk pëson asgjë nga sëmundjet epidemike, nga furtunat a tërmetet. Ai që përbën për shkelësit e ligjit të Tij një zjarr përvëlues, është për popullsinë e Tij një strehë e sigurt.

Pastori që i ka bërë varrin të vërtetës për të fituar dashamirësinë e botës, sheh tani karakterin dhe ndikimin e mësimeve të tij. Duket qartë se syri i kudondodhshëm e ka ndjekur atë, ndërsa qëndronte në podiumet kishëtare, ndërsa ecte në rrugë e ndërsa komunikonte me njerëzit në skena të ndryshme të jetës. Çdo emocion i zemrës, çdo rresht i shkruar, çdo fjalë e thënë, çdo veprim që i ka shtyrë njerëzit të pushojnë në një strehë gënjeshtrash, ka qënë një farë që është përhapur me shpejtësi dhe në njerëzit e ligj e të pashpresë që ka përreth ai shquan të korrat e farës.

Zoti thotë: "Ata mjekojnë shkel e shko plagën e bijës së popullit të Tij, duke thënë "Paqe, paqe", kur nuk ekziston paqja." "Në fakt e keni brengosur zemrën e të drejtit me gënjeshtra, kur Unë nuk e brengosa dhe keni forcuar duart e të pabesit, që të mos shmanget nga rruga e tij e keqe për të mos mbetur në jetë." *(Jeremia 8:11; Ezekiel 19:22)*.

"Mjerë barinjtë, që prishin dhe shpërndajnë kopenë e kullotës sime! ... Ja, Unë do t'ju dënoj për ligësinë e veprimeve tuaja." "Bërtisni, o barinj, klithni: Rrotullohuni në pluhur, o drejtues të kopesë, sepse ditët e therjes suaj janë plotësuar... Barinjtë nuk do të kenë asnjë mundësi të ikin dhe rojet e kopesë asnjë rrugë shpëtimi." *(Jeremia 23:1,2; 25:34,35)*.

Pastorët dhe njerëzit e tjerë e kuptojnë se nuk kanë krijuar një lidhje të qëndrueshme me Perëndinë. Ata e kuptojnë se kanë rebeluar kundër Autorit të ligjit të drejtësisë dhe shpresës. Duke hedhur baltë mbi urdhëresat hyjnore, ata i kanë hapur rrugën me mijëra rrjedhave të mëkatit, mosmarrëveshjeve, urrejtjes dhe padrejtësisë derisa toka u kthye në një fushë të pamasë beteje dhe në një kosh plehrash. Pikër-

isht kjo është pamja që iu shfaqet përpara syve atyre që kanë mohuar të vërtetën dhe kanë përqafuar gënjeshtrën. Nuk ka gjuhë që të mund të shprehë dëshirën që ndiejnë të pabindurit dhe të pabesët për të pasur atë që e kanë humbur përgjithmonë - jetën e përjetshme. Njerëzit, të cilët bota i ka adhuruar për talentin dhe elokuencën e tyre, i shohin të gjitha këto në dritën e tyre të vërtetë. Ata e kuptojnë se kanë humbur për shkak të shkeljeve që kanë kryer dhe bien në këmbët e atyre, besnikërinë e të cilëve e kanë përçmuar dhe u rrëfejnë se Perëndia i ka dashur me të vërtetë.

Njerëzit e kuptojnë se i kanë mashtruar. Ata akuzojnë njëri-tjetrin për rrënimin që i pret, por të gjithë janë të mendimit se pastorët janë ata që kanë fajin më të madh. Pastorët femohues kanë profetizuar vetëm gjëra të bukura dhe i kanë bërë dëgjuesit e tyre që ta shumëzojnë me zero ligjin e Perëndisë dhe t'i përndjekin të gjithë ata që e kanë respektuar atë si të shenjtë. Tani, mësuesit e dëshpëruar i rrëfejnë botës punën e tyre mashtruese. Turmat e njerëzve tërbohen. "Ne jemi të humbur -bërtasin ata - dhe ju jeni arsyeja e rrënimit tonë" dhe akuzojnë me këto fjalë barinjtë e rremë. Madje pikërisht ata, që dikur i çmonin më shumë se të tjerët, do t'i mallkojnë me gjithë zemër. Duart, që dikur u kurorëzuan me dafina, do të ngrihen për t'i shkatërruar. Shpatat që duhej të përdoreshin për të therur njerëzit e Perëndisë, përdoren tani për t'u shkurtuar jetën armiqve të tyre. Kudo mbizotërojnë mosmarrëveshjet dhe gjakderdhjet.

"Zhurma do të arrijë deri në skajet e tokës, sepse Zoti ka një mosmarrëveshje me kombet, do të hyjë në gjyq me çdo mish të gjallë dhe do t'i lërë të pabesët në mëshirë të shpatës." *(Jeremia 25;31).* Mosmarrëveshja ka vazhduar për 6.000 vjet me radhë; Biri i Perëndisë dhe lajmëtarët e Tij qiellorë kanë qenë në një konflikt të vazhdueshëm me fuqitë e mëkatarit të madh, për të paralajmëruar, ndriçuar e shpëtuar fëmijët e njeriut. Tani gjithësecili e ka marrë vendimin e vet, të pabesët janë bashkuar plotësisht me Satanin në luftën e tij kundër Perëndisë. Ka ardhur koha që Zoti të hakmerret për autoritetin e shkelur me këmbë të ligjit të Tij. Tani mosmarrëveshja nuk ka të bëjë vetëm me Satanin, por edhe me njerëzit - bashkëluftëtarë të tij: "Zoti ka një mosmarrëveshje me kombet." "Ai do t'i lërë të pabesët në mëshirë të shpatës."

Vula e shpëtimit iu është dhënë atyre "që rënkojnë e qajnë për çdo të keqe që ka ndodhur" Tani engjëlli i vdekjes, që përfaqësohet nga njerëzit me armë në vizionin e Ezekielit, nis udhëtimin pasi merr urdhërin: "Vrisni deri në shfarosje pleq, të rinj, virgjëresha, fëmijë dhe gra, por mos iu afroni asnjërit mbi të cilin është shenja, filloni nga shenjtorja ime." Profeti vazhdon: "Kështu ata filluan me pleqtë që ishin para tempullit." *(Ezekieli 9:1-6).*

Shkatërrimi fillon me ata që vetëquhen: "udhëheqës shpirtërorë" të njerëzve. Rojet e rremë janë të parët që rrëzohen. Askush nuk do të shpëtojë, për asnjë nuk do të ketë keqardhje. Burra, gra, shërbëtorë e fëmijë të vegjël zhduken pa nam e nishan.

"Ja, Zoti del nga banesa e Tij për të ndëshkuar paudhësitë e banorëve të tokës; toka do të nxjerrë në shesh gjakun e derdhur dhe nuk do t'i fshehë më të vrarët e saj." *(Isaia 26:21)*. "Kjo do të jetë plaga me të cilën Zoti do të godasë të gjithë popujt, që kanë luftuar kundër Jeruzalemit: Ai do të bëjë që mishi i tyre të konsumohet, ndërsa ata qëndrojnë në këmbë, sytë e tyre do të konsumohen në zgavrat e tyre dhe gjuha e tyre do të konsumohet në gojën e tyre. Atë ditë do të ndodhë që për shkak të veprimit të Zotit, midis tyre do të jetë një çoroditje e madhe, secili prej tyre do të zërë dorën e fqinjit të vet dhe do ta ngrerë dorën kundër dorës së fqinjit të vet." *(Zakaria 14:12,13)*. Banorët e ligj të tokës - priftërinj, sundimtarë dhe njerëz të pasur dhe të varfër, të respektuar e të thjeshtë - do të bien pre e mosmarrëveshjeve të çmendura të pasioneve të tyre të egra dhe e zbrazjes së gotës së zemërimit të papërzier të Perëndisë." Atë ditë ata që janë vrarë nga Zoti do të jenë kudo, nga njëri skaj i tokës tek tjetri; nuk do të qahen, nuk do të mblidhen dhe as nuk do të varrosen." *(Jeremia 25:33)*

Me ardhjen e Jezusit, njerëzit e ligj zhduken nga faqja e dheut - të konsumuar nga fryma e gojës së Tij dhe të shkatërruar nga ndriçimi i lavdisë së Tij. Krishti e merr popullin e Tij në Qytetin e Perëndisë dhe toka zbrazet nga banorët e saj. "Ja, Zoti zbraz tokën dhe e bën të shkretë, prish faqen e saj dhe shpërndan banorët e saj." "Toka do të zbrazet plotësisht dhe do të plaçkitet plotësisht, sepse Zoti ka thënë këto fjalë: "Sepse banorët e saj kanë shkelur ligjet, kanë ndryshuar statutin, kanë marrë nëpër këmbë besëlidhjen e përjetshme. Prandaj një mallkim e ka përpirë tokën dhe banorët e saj janë të dëshpëruar, prandaj banorët e tokës po digjen." *(Isaia 24:1,3,5,6)*.

Toka i ngjan një shkretëtire të vërtetë. Rrënojat e qyteteve dhe të fshatrave shkatërruar nga tërmetet, pemët e shkulura nga rrënjët, shkëmbinjtë e nxjerrë nga deti apo të shkëputur nga toka, gjenden gjatë gjithë sipërfaqes së saj, ndërsa gropat e mëdha tregojnë vendin ku malet janë rrëzuar që nga themelet e tyre.

Ndërsa më pas ndodh ngjarja, që paraprofetizohet në shërbesën solemne të Ditës së Shlyerjes. Me të përfunduar shërbimi në Vendin shumë të shenjtë dhe me t'u pastruar shenjtorja nga mëkatet e Izraelit me anë të aftësisë shpaguese të gjakut të flijimit për mëkatin, cjapi paraqitet i gjallë përpara Perëndisë dhe në prani të bashkësisë kryeprifti rrëfen mbi të tërë paudhësitë e bijve të Izraelit, të gjitha shkeljet e tyre, tërë mëkatet e tyre për t'i vënë mbi kokën e cjapit." *(Levitiku 16:21)*. Në të njëjtën mënyrë, kur të ketë përfunduar puna shlyerëse në shenjtoren qiellore, në prani të Perëndisë, të engjëjve qiellorë dhe të turmave të të shpëtuarve, mbi kokën e Satanit do të rrëfehen të gjithë mëkatet e popullit të Perëndisë; ai do të deklarohet fajtor për të gjitha të këqijat që i ka detyruar ata t'i kryejnë. Dhe ashtu si cjapi, që u dërgua në një vend të shkretë, edhe Satani do të "mërgojë" në një tokë të shkretë, në një vend të pabanuar e të frikshëm.

Gjoni tek Zbulesa na paratregon për dëbimin e Satanit dhe gjendjen e kaosit dhe shkretimit që do të mbizotërojë mbi planetin tonë dhe deklaron që, një gjendje e tillë do të vazhdojë për 1.000 vjet. Pas përshkrimit të skenave të ardhjes së dytë të Zotit dhe shkatërrimit të mëkatarëve, profecia vazhdon kështu: "Pashë një engjëll që zbriste nga qielli, duke pasur çelësin e humnerës dhe një zinxhir të madh në dorë. Ai e kapi dragoin, gjarpërin e lashtë, që është djalli dhe satani dhe e lidhi për 1.000 vjet dhe e hodhi atë në humnerë, dhe e mbylli atë dhe vulosi mbi të, që të mos i mashtrojë më kombet, derisa të mbushen 1.000 vjet dhe pas kësaj ai duhet zgjidhur për pak kohë." *(Zbulesa 20;1-3)*.

Shprehja "humnerë" simbolizon botën në një gjendje çrregullimi dhe errësire dhe kjo qartësohet nga tekste të tjera të Shkrimeve të Shenjta. Duke përshkruar gjendjen e tokës "në fillim" të dhënat Biblike na thonë se: "ajo ishte pa trajtë, e zbrazët dhe errësira mbulonte sipërfaqen e humnerës". *(Zanafilla 1;2)*. Profecia na tregon se ajo do të kthehet, të paktën pjesërisht, në këtë gjendje të mëparshme. Duke e pritur me padurim ditën e madhe të Perëndisë, profeti Jeremia deklaron: "Pashë tokën dhe ja, dridheshin dhe tërë kodrat lëkundeshin. Pashë dhe ja, nuk kishte asnjë njeri dhe tërë zogjtë e qiellit kishin ikur. Pashë dhe ja, toka pjellore ishte një shkretëtirë dhe të gjitha qytetet e saj ishin shembur." *(Jeremia 4;23-26)*.

Kjo do të jetë edhe shtëpia e Satanit dhe e engjëjve të tij mëkatarë për 1.000 vjet. Duke qenë i mbërthyer në tokë, atij nuk do t'i lejohet hyrja në botët e tjera për të tunduar e bezdisur ata, që nuk kanë dështuar kurrë. Në këtë kuptim thuhet se ai lidhet: ai s'mund ta ushtrojë fuqinë e tij, sepse nuk ka mbetur askush që mund të bëhet pre e tij. Ai i ka larë duart njëherë e përgjithmonë nga puna e mashtrimit dhe rrënimit që ka qenë për shekuj me radhë e vetmja kënaqësi e tij.

Profeti Isaja, duke parashikuar kohën e rrëzimit të Satanit, thotë: "Vallë, si ke rënë nga qielli o Lucifer, bir i agimit? Vallë si të hodhën përtokë ty që i hidhje poshtë kombet? Ti thoje në zemrën tënde "Unë do të ngjitem në qiell, do të ngre fronin tim përmbi yjet e Perëndisë... do të jem i ngjashëm me shumë të Lartin. Po përkundrazi, do të hidhesh në Sheol, në thellësitë e gropës. Ata që do të të shikojnë, të ngulin sytë, të vërejnë me kujdes dhe thonë: "Ky është njeriu që e bënte tokën të dridhej, që i trondiste mbretëritë, që e katandisi botën në shkretëtirë, që shkatërron qytetet e saj dhe nuk i la kurrë të shkojnë të lirë robërit e tij? *(Isaia 14;12-17)*.

Për 6.000 vjet rebelimi satanik e "ka bërë tokën të dridhet". Ai "e katandisi botën në shkretëtirë dhe i shkatërroi qytetet e saj" dhe "nuk i la kurrë të lirë robërit e tij". Për 6.000 vjet ai ka mbajtur rob njerëzit e Perëndisë e po të mundte do të vazhdonte t'i mbante ata në zinxhira; por Krishti i theu zinxhirët dhe u fali të burgosurve lirinë.

Madje as të pabesët nuk janë më nën komandën e tij dhe ai mbetet vetëm me engjëjt e tij të zinj për të kuptuar se ç'do të thotë mallkim mëkati. "Të gjithë

mbretërit e kombeve, tërë ata prehen në lavdi, secili në varrin e tij, ty përkundrazi, të hodhën larg varrit tënd si një farë e neveritshme... Ti nuk do të bashkohesh me ta në varr, sepse ke shkatërruar vendin tënd dhe ke vrarë popullin tënd." *(Isaja 14;18-20)*.

Për 1.000 vjet, Satani do t'i vijë rrotull tokës së shkretë për të parë me sytë e vet frytet e rebelimit të tij kundër ligjit të Perëndisë. Gjatë kësaj kohe ai do të vuajë shumë. Që nga dëbimi i tij nga qielli, në jetën e tij prej aktivisti të palodhur nuk ka pasur vend për mendime, por tani ai nuk ka asgjë në dorë dhe është braktisur për të kuptuar rolin që ka luajtur që nga momenti kur rebeloi kundër qeverisjes qiellore dhe për të pritur me tmerr dhe drithëm të ardhmen e tmerrshme që do të mbajë mbi supe për të keqen që ka bërë, kur do të dënohet gjithashtu për mëkatet që i ka shtyrë të tjerët të kryejnë. Popullit të Perëndisë, robëria e Satanit do t'i sjellë gëzim dhe ngazëllim. Profeti thotë: "Kështu që ditën në të cilën Zoti do t'i japë prehje lodhjes sate, shqetësimit tënd nga skllavëria e rëndë, së cilës i ishe nënshtruar, ti do të shqiptosh këtë sentencë mbi mbretin e Babilonisë [që përfaqëson Satanin në këtë rast] dhe do të thuash: "Ashtu si mbaroi shtypësi!...Zoti e ka thyer shkopin e të pabesëve, skeptrin e tiranëve. Ai që në tërbim e sipër godiste popujt me goditje të pandërprera, ai që sundonte me zemërim mbi kombet, tani përndiqet pa mëshirë" *(Versat 3-6)*.

Në periudhën 1.000-vjecare nga ringjallja e parë në të dytën, bëhet gjykimi i të pabesëve. Apostulli Pal e përshkruan këtë gjykim si një ngjarje, që pason ardhjen e dytë: "Mos gjykoni asnjë para kohe derisa të vijë Zoti, që do të nxjerrë në dritë gjërat e fshehta të errësirës dhe do të shfaqë këshillat e zemrave." *(1 Korintasve 4:5)*.

Danieli deklaron: "se iu dha e drejta shenjtorëve të Shumë të Lartit", vetëm kur arriti i Lashti i Ditëve." *(Danieli 7:22)*. Gjatë kësaj kohe të drejtët mbretërojnë si princër dhe priftërinj në Perëndi. Gjoni tek Zbulesa thotë: "Pashë frone dhe ata u ulën mbi to dhe atyre iu dha pushteti që të gjykojnë." "Ata do të jenë priftërinj të Perëndisë dhe të Krishtit dhe do të mbretërojnë me të 1.000 vjet. *(Zbulesa 20:4,6)*. Pikërisht kjo është koha kur Pali na parathotë se: "shenjtorët do të gjykojnë botën" *(1 Korintasve. 6:2)*. Ata gjykojnë së bashku me Krishtin, njerëzit e ligj, duke i krahasuar veprat e tyre me librin - statut, Biblën e duke e mbyllur çdo rast me një vendim të bazuar në aktet e kryera prej tyre. Më pas caktohet dënimi që duhet të vuajë çdo njeri i pabesë dhe ky shënohet përbri emrit të tij në librin e vdekjes.

Krishti dhe të besuarit e Tij do të gjykojnë edhe Satanin dhe engjëjt e tij mëkatarë. Pali thotë: "A nuk e dini ju se ne do të gjykojmë engjëjt? *(versa 3)*. Ndërsa Juda deklaron se: "Ai ruajti me pranga të përjetshme në errësirë për gjyqin e ditës së madhe edhe engjëjt, që nuk e ruajtën gjendjen e tyre të parë, po e lanë banimin e tyre" *(Juda 6)*

Në fund të periudhës 1.000-vjeçare do të ndodhë edhe ringjallja e dytë. Kështu, të vdekurit femohues do të ringjallen për t'u paraqitur përpara Perëndisë për t'u

zbatuar "gjykimi i shkruar". Gjoni tek Zbulesa, pas përshkrimit të ringjalljes së të drejtëve thotë: "Por të vdekurit e tjerë nuk u kthyen në jetë derisa të mbusheshin të 1.000 vjetët" *(Zbulesa 20:5)*. Isaja, duke iu referuar të pabesëve deklaron: "Ata do të mblidhen bashkë si të burgosur në një burg të nëndheshëm; do të mbyllen në një burg dhe *pas shumë ditësh do të ndëshkohen*." *(Isaja 24:22)*.

1. Kur të padrejtët të shohin që janë të humbur, ata do të "mbushen me keqardhje". Nëse është vërtetë kështu, atëherë përse atyre sërisht nuk u kursehet shkatërrimi?

2. Lexoni Levetikun 16:18-22. Çfarë bënin priftërinjtë me dhinë-që arratisej përgjatë Shlyerjes? Si krahasohet kjo me atë që i ndodh Satanit dhe engjëjve të tij përgjatë 1,000 vjetëve?

3. Njerëzit e Perëndisë do të jenë në qiell për 1,000 vjet me Perëndinë. Çfarë do të bëjnë ata gjatë kësaj kohe?

42.

Konflikti Merr Fund

Në fund të periudhës 1.000-vjeçare, Krishti vjen sërish në tokë. Ai shoqërohet nga turmat e të shpëtuarve dhe mbështetet nga ushtritë e engjëjve. Ndërsa zbret me një madhështi të papërshkrueshme Ai i urdhëron të vdekurit e pabesë që të ringjallen për të marrë dënimin e tyre. Ata dalin nga varret, një turmë e stërmadhe dhe e panumërt si rëra e detit. Sa ndryshojnë nga ata që janë zgjuar në ringjalljen e parë! Të drejtët u veshën me rini dhe bukuri të përjetshme. Të padrejtët mbajnë në vetvete gjurmë sëmundjesh dhe vdekjeje.

Çdo sy në atë tërësi sysh është përqëndruar tek lavdia e Birit të Perëndisë. Turma e njerëzve të ligj thërret me një zë: "I bekuar është Ai që vjen në emër të Zotit!" Kjo thënie nuk frymëzohet nga dashuria për Jezusin. Eshtë forca e së vërtetës që i bën buzët të shqiptojnë pa dashur këto fjalë. Njerëzit e pafe dalin nga varri me atë armiqësi dhe frymë rebelimi ndaj Krishtit me të cilën shkuan në varr. Atyre nuk do t'u jepet një kohë tjetër prove për të ndrequr të metat e jetës së tyre të shkuar. Asgjë nuk do të fitohej prej kësaj. Një jetë e tërë shkeljesh nuk i ka zbutur zemrat e tyre. Po t'u afrohej një kohë e dytë prove, ajo do të kalohej si edhe e para, duke përbaltur urdhëresat e Perëndisë dhe duke nxitur rebelimin kundër Tij.

Krishti zbret mbi Malin e Ullinjve, nga ku edhe u ngrit lart në qiell pas ringjalljes dhe ku engjëjt u kujtuan dishepujve premtimin e rikthimit të Tij. Profeti thotë: "Perëndia im do të vijë dhe të gjithë shenjtët e Tij do të jenë me Të." "Atë ditë këmbët e Tij do të ndalen sipër Malit të Ullinjve, që ndodhet përballë Jeruzalemit në lindje dhe Mali i Ullinjve do të çahet në mes... duke krijuar kështu një luginë të madhe". "Zoti do të jetë mbret mbi të gjithë dheun; atë ditë do të jetë vetëm Zoti dhe vetëm emri i tij." *(Zakaria 14:5,4,9)*. Ndërsa Jeruzalemi i Ri me shkëlqimin e tij verbues zbret nga qielli, ai ndalet në vendin e pastruar dhe bërë gati për të. Krishti me popullin dhe engjëjt e Tij hyjnë në Qytetin e Shenjtë.

Tani Satani përgatitet për t'i hyrë betejës së tij të fundit për të fituar epërsi. Për sa kohë që princi i mëkatit nuk mund ta ushtronte pushtetin e tij dhe nuk mund

të kryente veprimtari mashtruese, ndjehej i harruar dhe i mjerë, por me të parë të vdekurit femohues të ringjallur dhe me të vënë re turmat e tyre të mëdha, shpresat e tij rilindin dhe ai vendos të mos dorëzohet.

Ai do t'i mobilizojë të gjitha ushtritë e të humburve nën flamurin e tij dhe do të përpiqet që të zbatojë përmes tyre, planet e veta. Të pabesët janë robër të Satanit. Duke mohuar Krishtin, ata kanë pranuar sundimin e këtij udhëheqësi rebel. Ata janë gati që t'i përqafojnë sugjerimet e tij dhe t'i binden urdhërave të tij. Megjithatë, dinak siç është, ai nuk paraqitet si Satani. Përkundrazi, pretendon të jetë princi që është pronari me të drejta të plota i kësaj bote, të cilit i kanë marrë trashëgiminë në mënyrë të paligjshme. Ai u shfaqet shtetasve të tij të gënjyer si çlirimtar, duke i siguruar ata se ka qënë fuqia e tij që u ka hapur atyre dyert e varreve dhe që do t'i shpëtojë nga një tirani mizore. Me t'u larguar Krishti, Satani bën çudi për të mbështetur pretendimet e tij. Ai i forcon të dobëtit dhe i frymëzon të gjithë pa përjashtim me frymën dhe energjinë e tij. Ai propozon që ata të marshojnë kundër kampit të shenjtorëve për të pushtuar Qytetin e Perëndisë. Me entuziazëm djallëzor ai sheh milionat e panumërt të atyre, që janë ringjallur dhe deklaron se si udhëheqësi i tyre është në gjendje që ta rrëzojë qytetin dhe të rifitojë fronin dhe mbretërinë e tij.

Në atë turmë të madhe, ka me mijëra njerëz që i përkisnin asaj race që jetoi përpara Përmbytjes, njerëz me një fizik madhështor dhe një intelekt të admirueshëm, që duke iu dorëzuar kontrollit të engjëjve mëkatarë, ia përkushtuan të gjitha aftësitë dhe dijet e tyre lartësimit të vetvetes; njerëz, veprat e mrekullueshme artistike të të cilëve, e bënë botën që ta idealizojë gjenialitetin e tyre, por mizoria dhe shpikjet e liga të të cilëve, duke e ndotur tokën dhe duke e shtrembëruar imazhin e Perëndisë, e detyruan Atë që t'i fshinte nga faqja e krijimit të Tij. Mes tyre ka mbretër e gjeneralë, që pushtuan kombe të tëra, burra trima që nuk humbën asnjë betejë dhe luftëtarë krenarë dhe ambiciozë që i bënë mbretërit të dridheshin nga afrimi i tyre. Vdekja nuk i ka ndryshuar këta njerëz. Ndërsa dalin nga varri filli i mendimeve të tyre rifillon atje ku u këput dikur. Ata frymëzohen nga e njëjta dëshirë për të sunduar si dikur.

Satani konsultohet si me engjëjt e tij, ashtu edhe me këta mbretër, pushtues dhe njerëz të mëdhenj. Ata llogarisin forcën dhe madhësinë e ushtrisë së tyre dhe deklarojnë se ushtria që ndodhet brenda mureve është e vogël në krahasim me të tyren e mund të mundet lehtësisht. Ata hartojnë plane për t'i shtënë në dorë pasuritë dhe lavdinë e Jeruzalemit të Ri. Të gjithë fillojnë pa humbur kohë përgatitjet për betejë. Artizanë të zotë ndërtojnë armë lufte. Udhëheqës ushtarakë, të mirënjohur për suksesin e tyre, drejtojnë kompanitë dhe togat e luftëtarëve të sprovuar.

Më së fundi jepet urdhëri për të sulmuar dhe turma e panumërt marshon përpara - një ushtri kjo që as pushtuesit tokësorë nuk kanë qënë kurrë në gjendje ta organizojnë dhe as forcat e bashkuara të të gjitha kohërave që nga fillimi i luftërave në tokë nuk mund ta barazojnë. Satani, më i madhi mes luftëtarëve, udhëheq tri-

mat dhe engjëjt e tij bashkojnë forcat e tyre për betejën përfundimtare. Mbretërit e luftëtarët udhëtojnë në trenin e tij, ndërsa togat e panumërta i shkojnë pas, secili i prirë nga udhëheqësi i vet. Radhët e shtrënguara përparojnë me saktësi ushtarake mbi sipërfaqen e plasaritur dhe të çrregullt të tokës drejt Qytetit të Perëndisë. Portat e Jeruzalemit të Ri mbyllen me urdhërin e Jezusit dhe ushtritë e Satanit rrethojnë qytetin, të gatshëm për sulm.

Tani Krishti shfaqet përsëri përpara armiqve të Tij. Larg, në një pikë të lartë të qytetit, mbi një themel të artë, ngrihet një fron. Mbi këtë fron ulet Biri i Perëndisë, i rrethuar nga nënshtetasit e mbretërisë së Tij. Fuqinë dhe madhështinë e Krishtit nuk mund ta përshkruajë asnjë gjuhë e botës dhe nuk mund ta skicojë asnjë piktor. Lavdia e Atit të Përjetshëm mbulon Birin. Shkëlqimi i prezencës së Tij ndriçon Qytetin e Perëndisë, i kapërcen portat dhe mbulon botën mbarë. Më afër fronit rrinë ata që dikur punonin me zell për kauzën satanike, por që si ura zjarri të shkëputura nga djegia, kanë ndjekur më pas Shpëtimtarin me një përkushtim të plotë dhe të ethshëm. Më pas, vijnë ata që kanë formuar karaktere kristianësh në mes gënjeshtrash e mosbesimi, ata që e kanë respektuar ligjin e Perëndisë në një kohë kur bota e Krishterë e kishte quajtur atë të kotë dhe mijëra njerëz, që u martirizuan në kohëra për besimin e tyre. Dhe akoma më tutje "turma e madhe, të cilën askush nuk mund ta numëronte, prej të gjitha kombeve, fiseve, popujve dhe gjuhëve; që qëndronin përpara fronit dhe përpara Qengjit, të veshur me rroba të bardha dhe me palma në duart e tyre." *(Zbulesa 7:9)*. Lufta e tyre ka përfunduar, fitorja është e siguruar për ta. Ata e kanë përfunduar garën dhe e kanë marrë çmimin. Dega e palmës në duart e tyre është një simbol triumfi, ndërsa rroba e bardhë është emblema e drejtësisë së panjollë të Krishtit, që tani është e tyrja.

Të çliruarit këndojnë një këngë lëvdimi, që kumbon e rikumbon përmes kupës qiellore. "Shpëtimi është i Perëndisë tonë, që është ulur mbi fron dhe i Qengjit." *(Versa 10)*. Edhe engjëjt dhe serafinët bashkojnë zërat e tyre në adhurim. Ndërsa të shpëtuarit kanë parë fuqinë dhe keqdashjen e Satanit, ata e kanë kuptuar më saktë se kurrë më parë, që vetëm fuqia e Krishtit mund t'i bënte ata fitimtarë. Në atë turmë rrezatuese nuk ka asnjë që ta quajë shpëtimin të vetin a thua se kanë triumfuar falë fuqisë apo mirësisë së tyre. Nuk thuhet asnjë fjalë mbi veprat apo vuajtjet e tyre; por ritmi i çdo kënge dhe nota e çdo himni është: "Shpëtimi është i Perëndisë sonë dhe i Qengjit."

Në prani të banorëve të tokës e qiellit, bëhet edhe kurorëzimi përfundimtar i Birit të Perëndisë. I veshur me madhështi dhe pushtet suprem, Mbreti i mbretërve dënon rebelët e qeverisjes së Tij dhe zbaton drejtësi mbi ata që e kanë shkelur ligjin e Tij dhe që i kanë shtypur njerëzit e Tij. Profeti i Perëndisë thotë: "Pashë një fron të madh të bardhë dhe Atë që ulej mbi të, nga prania e të Cilit iku dheu dhe qielli dhe nuk u gjet vend për ta. Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin

në këmbë përpara Perëndisë, edhe librat u hapën dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës, dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre." *(Zbulesa 20;11,12)*.

Me t'u hapur librat e të dhënave dhe me të ndjerë shikimin e Jezusit, të pabesët janë më se të ndërgjegjshëm për çdo mëkat që kanë kryer. Ata e shikojnë se si këmbët e tyre i janë larguar shtegut të shenjtërisë dhe pastërtisë dhe se si krenaria dhe rebelimi i kanë shtyrë larg në rrugën e shkeljes së ligjit të Perëndisë.

Tundimet joshëse që ata vetë i kishin mirëpritur, duke përqafuar mëkatin, bekimet e hedhura poshtë, përçmimi i lajmëtarëve të Perëndisë, paralajmërimet e shkelura me këmbë, valët e mëshirës të kthyera pas nga zemra kokëfortë e krenare -të gjitha këto dukeshin si të shkruara me shkronja zjarri.

Mbi fron zbulohet kryqi dhe si në film shfaqen njëra pas tjetrës, duke filluar nga tundimi dhe dështimi i Adamit, skenat e planit të madh të shpëtimit. Lindja e thjeshtë e Shpëtimtarit, jeta e Tij e thjeshtë dhe e bindur, pagëzimi i Tij në lumin Jordan, agjërimi dhe tundimet në shkretëtirë, shërbimi i Tij publik, që shpalosi përpara njerëzve bekimet më të çmuara qiellore, ditët e mbushura me vepra dashurie dhe mëshire, netët e lutjeve dhe meditimeve ndër male; komplotet e urryera dhe keqdashëse që ishin shenja e "mirënjohjes" për mirësitë e Tij, agonia misterioze e Gjetsemanit që e kishte zanafillën tek pesha shtypëse e mëkateve të të gjithë botës, rënia e Tij pre, me anë të tradhëtisë, në duart e turmës gjakdashëse, ngjarjet e frikshme të asaj nate tmerri - i burgosuri i qetë, që ishte harruar edhe nga dishepujt e Tij të dashur dhe që u tërhoq zvarrë rrugëve të Jeruzalemit, Biri i Perëndisë që del krenar përpara Anasit, që gjykohet në pallatin e kryepriftit dhe më pas hyn në dhomën e këshillit të Pilatit, akoma më pas paraqitet edhe përpara Herodit frikacak e mizor, që tallet, fyhet, torturohet dhe dënohet me vdekje - gjithçka skicohet me imtësi dhe kujdes.

E tani turmat e njerëzve janë dëshmitarë të skenave të fundit - Jezusi i durueshëm, duke u drejtuar për në Kalvar, Princi qiellor i varur në kryq; priftërinjtë zemërkëqinj dhe llumi i shoqërisë, që tallen me agoninë e Tij vdekjeprurëse, errësira e mbinatyrshme; tundja e tokës, shkëputja e shkëmbinjve, hapja e varreve - të gjitha këto shenja treguan se Shpëtimtari i botës dha jetën e Tij për ne.

Ky spektakël i tmerrshëm është më se realist. Satani, engjëjt dhe shërbëtorët e tij nuk mund t'i kthejnë krahët pikturës që ka dalë nga duart e tyre. Çdo aktori i kujtohet pjesa që ka luajtur Herodi, që theri fëmijët e pafajshëm të Betlehemit, në mënyrë që ta zhdukte nga faqja e dheut Mbretin e Izraelit, shërbëtorët e ulët të Herodit mbi të cilët bie faji i gjakut të Gjon Pagëzorit, Pilati i dobët dhe lajkatar, ushtarët shakaxhinj, priftërinjtë, sundimtarët dhe turma e çmendur e njerëzve që kishin thirrur: "Le të jetë gjaku i Tij mbi ne dhe mbi fëmijët tanë!" - të gjithë pa përjashtim e kuptojnë madhësinë e fajit të tyre. Ndërsa të shpëtuarit vënë kurorat e tyre

tek këmbët e Shpëtimtarit duke thënë: "Ai vdiq për mua!", të tjerët përpiqen më kot t'i fshihen madhështisë hyjnore të pamjes së Tij dhe reflekton lavdinë e diellit vetë.

Në mes të turmës së të çliruarve janë apostujt e Krishtit, Pali heroik, Pjetri trim, Gjoni i dashur si dhe vëllezërit e tyre zemërmirë dhe me ta numri i pamasë i martirëve, ndërsa jashtë mureve ndodhen të gjithë ata që i persekutuan, burgosën dhe vranë ata. Atje është edhe Nero, ai mostër mizorish dhe vesesh, që shikon tani gëzimin dhe lartësimin e atyre që i torturonte dikur dhe që gëzohej pamasë nga ankthi i tyre i papërshkrueshëm. Edhe nëna e tij është atje jashtë për të parë me sytë e saj rezultatin e punës së vet, për të parë se si vula mëkatare e karakterit, që iu kalua të birit, pasionet, që u nxitën dhe morën përmasa të mëdha falë ndikimit dhe shembullit të saj, kanë lidhur fryte krimesh, që e bëjnë botën të dridhet.

Ka mes tyre prelatë e priftërinj të papës, që pretendonin se ishin ambasadorë të Krishtit, por që përdorën burgjet, turrën e druve dhe gijotinën për ta bërë zap ndërgjegjen e popullit të Tij. Janë aty edhe kryepriftërinjtë krenarë, që u vetëlartësuan mbi Perëndinë dhe morën në dorë ndryshimin e ligjit të Perëndisë. Këta etër të rremë të kishës duhet t'i japin llogari Perëndisë dhe zor që të shfajësohen. Ata e kanë kuptuar tepër vonë se I Gjithëpushtetshmi është xheloz për ligjin e Tij dhe nuk mund t'ua falë një gabim të tillë. Ata e mësojnë tepër vonë se interesat e Krishtit ishin vetë interesat e njerëzve të Tij të vuajtur dhe e ndiejnë deri në palcë forcën e fjalëve të Tij "Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të Mi të vegjël, këtë ma bëtë Mua" *(Mateu 25:40)*.

Të gjithë banorët e ligj të tokës do të dalin përpara trupit gjykues të Perëndisë si mbajtës të padisë së tradhëtisë së lartë kundër qeverisjes qiellore. Ata s'kanë askënd që t'i mbrojë, nuk mund të shfajësohen dhe kështu dënohen me vdekje të përhershme.

Tani, të gjithë e kanë të qartë se paga e mëkatit nuk është as pavarësia e fisshme dhe as jeta e përjetshme, por skllavëria, rrënimi dhe vdekja. Të padenjët e kuptojnë se çfarë kanë kopjuar falë jetës së tyre prej rebelësh. Ata e përçmuan lavdinë e madhe të përjetësisë kur iu afrua, por sa shumë do të donin ta kishin të tyren tani! "Mund t'i kisha të miat të gjitha këto - thotë shpirti i humbur - por vendosa t'i largoj larg meje. Oh, çmenduri! I kam flakur tutje paqen, lumturinë dhe nderin për të përqafuar ligësinë, turpin dhe dëshpërimin." Të gjithë e kuptojnë se përjashtimi i tyre nga parajsa është më se i drejtë. Me anë të jetës së tyre, ata kanë deklaruar: "Nuk duam që ky Njeri [Jezusi] të mbretërojë mbi ne."

Me gojë hapur, njerëzit e padenjë kanë parë me sytë e tyre kurorëzimin e Birit të Perëndisë. Ata shquajnë rrasat e gurta të ligjit hyjnor, urdhëresat e të cilit ata vetë i kanë përçmuar e shkelur me këmbë, në duart e Tij. Ata janë dëshmitarë të shprehjes së çudisë, mrekullisë dhe adhurimit nga ana e të shpëtuarve dhe të valës melodioze që pushton turmën që thërret: "Të mëdha dhe të mrekullueshme janë veprat e Tua,

O Zot, Perëndi i plotfuqishëm; të drejta dhe të vërteta janë udhët e Tua o Mbret i të shenjtëve!" dhe të gjunjëzuar e adhurojnë edhe ata Princin e jetës.

Satani duket si i paralizuar nga lavdia dhe madhështia e Krishtit. Atij, që dikur ishte një engjëll për të pasur zili, i kujtohet rënia e vet. Një engjëll shndritës "bir i mëngjesit" ... sa ka ndryshuar, sa është degraduar! Ai është përjashtuar nga këshilli që dikur e kishte pranuar si anëtar i nderuar. Ai shikon një engjëll tjetër tani, që qëndron pranë Atit, i mbuluar me lavdinë e Tij. Ai e ka parë me sytë e tij engjëllin me pamje madhështore dhe fizik të lartë, që i vuri kurorën mbi kokë Krishtit dhe e ka më se të qartë se mund ta kishte pasur ai vetë këtë nder të madh.

Atij i rikthehet në mendje shtëpia e pastërtisë dhe pafajësisë së tij, paqja dhe gëzimi që përjetonte deri kur filloi të mërmëriste kundër Perëndisë dhe të kishte zili Krishtin.

Akuzat, rebelimi, mashtrimet për të fituar dashamirësinë dhe mbështetjen e engjëjve, këmbëngulja e tij e krisur për të mos u penduar kur Perëndia do ta kishte falur - të gjitha këto i shfaqen si të gjalla përpara syve. Ai rillogarit rezulatet e punës së tij mes njerëzve - armiqësinë e njeriut ndaj njeriut, shkatërrimin e tmerrshëm të jetës, rënien dhe rimëkëmbjen e mbretërive, rrëzimin e froneve dhe vargun e gjatë të konflikteve, çrregullimeve dhe revolucioneve. Atij i kujtohen përpjekjet e vazhdueshme që ka bërë për ta kundërshtuar punën e Krishtit e për ta zhytur njeriun gjithnjë e më thellë. Ai e kupton se kurthet e tij djallëzore nuk kanë mundur t'i shkatërrojnë ata, që i kanë besuar Jezusit gjatë gjithë jetës së tyre. Ndërsa hedh vështrimin tek mbretëria - fryt i punës së tij, Satani sheh vetëm dështim dhe rrënim në të. Ai i ka bërë turmat e njerëzve që të mendojnë se qyteti i Perëndisë është një pre e kapur lehtë, por vetë e di mirë se kjo nuk është e vërtetë. Gjatë shekujve të kontradiktës së madhe ai është detyruar të dorëzohet dhe të tërhiqet i mundur shumë herë. Ai e njeh shumë mirë fuqinë dhe madhështinë e të Përjetshmit.

Qëllimi i kryerebelit ka qënë gjithmonë shfajësimi i vetvetes dhe ngarkimi i qeverisë hyjnore me fajin e rebelimit. Ai ka përdorur për arritjen e këtij qëllimi të gjitha fuqitë e intelektit të tij mahnitës. Ka punuar me ndërgjegje e në mënyrë sistematike për t'i nxitur njerëzit që ta pranojnë pa fjalë versionin e tij në lidhje me kontradiktën e madhe që ka vazhduar për një kohë kaq të gjatë. Për mijëra vjet me radhë, ky mjeshtër konspiracioni e ka vulosur gënjeshtrën me vulën e së vërtetës. Por tani ka ardhur koha që t'i jepet fund rebelimit dhe t'i çirret maska historisë dhe karakterit të Satanit. Përpjekja e fundit për ta rrëzuar nga froni Krishtin, për të shkatërruar popullin e Tij dhe për të shtënë në dorë qytetin e Zotit, ia ka nxjerrë të palarat në shesh kryemashtruesit. Ata që janë bashkuar me të, e kuptojnë se kauza e tij ka dështuar plotësisht. Ndjekësit e Krishtit dhe engjëjt hyjnorë shohin makinacionet e tij kundër qeverisjes së Perëndisë bardhë e zi. Ai është në qendër të urrejtjes mbarëbotërore.

Satani e kupton se rebelimi i projektuar dhe zbatuar prej tij e ka bërë të papërshtatshëm për të jetuar në qiell. Ai është stërvitur për vite me radhë për ta luftuar Zotin, pastërtia, paqja dhe harmonia qiellore do të përbënin për të një torturë të papërshkueshme. Akuzat e tij kundër mëshirës dhe drejtësisë së Perëndisë nuk dëgjohen më. Urrejtja që është përpjekur të ngjallë për Jehovain i ka rënë mbi kokë. Tani Satani përulet dhe shpall kështu drejtësinë që mbart në vetvete dënimi i tij.

"Kush nuk do të të druajë, O Zot, dhe nuk do lëvdojë emrin Tënd? Sepse vetëm Ti je i Shenjti; sepse të gjitha kombet do të vijnë dhe do të adhurojnë përpara Teje, sepse gjykimet e tua u shfaqën." *(versa 4)*. Çdo pyetjeje për të vërtetën dhe gënjeshtrën, që ka lindur gjatë kësaj kontradikte të stërgjatë, i është dhënë përgjigje. Sytë e të gjitha krijesave u hapën për të parë rezultatet e rebelimit dhe frytet e mohimit të urdhëresave hyjnore. Universit mbarë i është parashtruar ndryshimi mes sundimit të Satanit dhe qeverisjes së Perëndisë. Satanin e kanë dënuar veprat e duarve të tij. Mençuria, drejtësia dhe mirësia e Zotit qëndrojnë të patundura në vend nderi. Duket qartë se çdo veprim i Tij gjatë shekujve të kontradiktës së madhe është frymëzuar vetëm nga dëshira për t'i bërë mirë popullit të Tij dhe botëve që ka krijuar. "Tërë veprat e tua do të të kremtojnë, O Zot, dhe shenjtorët e Tu do të të bekojnë." *(Psalmi 145:10).* Historia e mëkatit do të mbetet sa të jetë përjetësia dëshmi, që tregon se lumturia e të gjitha krijesave është e lidhur ngushtë me ekzistencën e Ligjit të Perëndisë. Duke pasur në mendje faktet e kontradiktës së madhe, i gjithë universi, si njerëzit besnikë, ashtu edhe ata jobesnikë deklarojnë me një zë: "Të drejta e të vërteta janë udhët e Tua, o Mbret i kombeve".

Përpara universit mbarë shfaqet edhe një herë sakrifica e madhe që ka bërë Ati dhe Biri në emër të njerëzimit. Ka ardhur ora që Krishti të lëvdohet e të zërë vendin e Tij mbi të gjitha principatat, fuqitë dhe mbi çdo emër tjetër. Për gëzimin që e priste - që të mund të vishte me lavdi shumë njerëz - ai duroi kryqin dhe përçmoi turpin e Tij përpara botës. Gëzimi dhe lavdia janë akoma më të mëdha se trishtimi dhe turpi. Ai sheh të çliruarit, të rinovuar sipas shëmbëlltyrës së Tij me gjurmë të pagabueshme shenjtërie, çdo fytyrë - pasqyrë ngjashmërie me vetë Mbretin; shquan në to frutet e punës së Tij rraskapitëse dhe kënaqet. Më pas, me një zë të fuqishëm që depërton deri tek turmat si të të denjëve ashtu edhe të të padenjëve, ai deklaron: "Shikoni vlerën e gjakut Tim! Për këta vuajta, për këta vdiqa që ata të qëndrojnë në prezencën Time gjatë gjithë shekujve të përjetësisë." Ndërsa ata, që janë veshur me të bardha pranë fronit, i këndojnë lavde: "I denjë është Qengji që u ther të marrë fuqinë, pasurinë, diturinë, forcën, nderin, lavdinë dhe bekimin." *(Zbulesa 5:12)*.

Megjithëse Satani është detyruar që të njohë drejtësinë e Perëndisë dhe t'i përulet epërsisë së Krishtit, karakteri i tij ka mbetur po ai. Fryma e rebelimit si një rrymë e fuqishme, vazhdon të lëvrojë. I verbuar nga budallallëku ai vendos të mos i japë fund kështu kësaj kontradikte. Ka ardhur koha për t'u ndeshur për të fundit herë

me Mbretin qiellor. Ai turfullon në mes të radhëve të ushtarëve të tij dhe përpiqet që t'i frymëzojë ata me tërbimin e tij e t'i bëjë t'i hyjnë betejës me vrull. Por nga ata mijëra njerëz që i ka magjepsur deri në rebelim nuk ka asnjë që t'i besojë epërsisë së tij. Njerëzit e ligj përjetojnë të njëjtën urrejtje, që frymëzon edhe Satanin, por e kuptojnë se kauzës së tyre i ka ardhur fundi e se nuk mund ta mundin Jehovain. Tërbimi i tyre drejtohet kundër Satanit dhe bashkëpunëtorëve të tij në mashtrim dhe me zemërim demonësh ata i sulen atyre.

Zoti thotë: "Me qënë se e ke bërë zemrën tënde si zemrën e Perëndisë, prandaj ja, Unë do të sjell kundër teje kombet më të tmerrshme, këta do të zhveshin shpatat e tyre kundër shkëlqimit të diturisë sate dhe do të ndotin bukurinë tënde. Ti do të zbresësh në gropë." "Të kam shkatërruar, o kerubin mbrojtës në mes gurësh zjarri... Unë po të hedh përtokë, po të vë përpara mbretërve, me qëllim që të të shohin... Je bërë objekt tmerri dhe nuk do të ekzistosh kurrë më." *(Ezekiel 28:6-8; 16-19)*. "Çdo betejë luftëtarësh është e zhurmshme dhe me petka të zhytura në gjak, por kjo do të jetë me djegie dhe zjarr" "Zoti është zemëruar me të gjitha kombet, është indinjuar me të gjitha ushtritë e tyre: ai ka vendosur shkatërrimin e tyre, i braktis në masakër" "Ai do të bëjë që të bien mbi të pabesët leqe, zjarr, squfur dhe erëra zhuritëse; kjo do të jetë pjesa nga kupa e tyre." *(Isaia 34;2)*; *(Psalmi 11:6)*. Zjarri zbret nga qielli. Toka plasaritet. Armët e fshehura në thellësitë e saj dalin në pah. Nga çdo e çarë dalin flakë përvëluese. Edhe shkëmbinjtë marrin flakë. Toka digjet si furrë. Elementët shkrijnë nga nxehtësia marramendëse, veprat dhe toka vetë zhuriten deri në zhdukje. *(Malakia 4:1); (2Pjetrit 3;10)*. Sipërfaqja e tokës i ngjan një mase që zien - një liqeni të madh zjarri. Eshtë ora e gjykimit dhe zhdukjes së njerëzve të padenjë - "dita e hakmarrjes së Zotit, viti i shpërblimit për çështjen e Sionit*" (Isaia 34).*

Të padrejtët e marrin shpërblimin në tokë. *(Fjalët e Urta 11:31)* Ata "do të veprojnë me pabesi; dita që po vjen do t'i djegë - thotë Zoti i ushtrive." *(Malakia 4:1)*. Disa shkatërrohen në moment, ndërsa disa të tjerë vuajnë disa ditë. Të gjithë dënohen "sipas veprave të tyre" Mëkatet e njerëzve të drejtë i kalohen Satanit, ai do të vuajë jo vetëm për rebelimin e tij, por edhe për mëkatet që i ka shtyrë të kryejnë njerëzit e Perëndisë. Dënimi i tij do të jetë shumë më i rëndë se i atyre që ai ka mashtruar. Ai do të vazhdojë të jetojë e të vuajë edhe pas zhdukjes së të gjithë preve të tij mëkatare. Femohuesit do të shkatërrohen nga flakët që nga rrënjët e deri në degë - Satani rrënja, pasuesit e tij degët. Eshtë dhënë edhe dënimi përfundimtar, kërkesat e drejtësisë janë përmbushur dhe qielli e toka - dëshmitarë - deklarojnë drejtësinë e Jehovait.

Punës shkatërruese të Satanit i ka ardhur fundi përgjithmonë. Ai ka bërë çfarë ka dashur, duke i sjellë mallkim tokës dhe trishtim mbarë universit për më se 6 000 vjet. I gjithë krijimi është ankuar e ka vuajtur në heshtje. Tani, krijesat e Perëndisë

marrin frymë të lira nga tundimet dhe larg pranisë së tij. "Mbarë dheu pushon i qetë, njerëzit [e drejtë] shpërthejnë në britma gëzimi." *(Isaia 14:7)*. Një britmë triumfi dhe lëvdimi del nga zemra e universit mbarë.

"Zëri i një turme të madhe" si "zë shumë ujërash dhe si zë bubullimash të forta" dëgjohet tek thotë: "Haleluja, sepse filloi të mbretërojë Zoti, Perëndia ynë i Plotfuqishmi!" *(Zbulesa 19:6)*.

Ndërsa tokën e kishte përfshirë zjarri i shkatërrimit, të drejtët qëndronin të sigurt në Qytetin e Shenjtë. Vdekja nuk ka ç'u bën atyre që morën pjesë në ringjalljen e parë. Ndërsa për të padenjët Perëndia u bë zjarr përvëlues, Ai është diell dhe mburojë për popullin e tij. *(Zbulesa 20:6)*; *(Psalmi 84:11).*

"Pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar" *(Zbulesa 21:1)*. Zjarri që bën shkrumb e hi të pabesët, pastron njëkohësisht edhe tokën. Fshihet çdo gjurmë mallkimi. Të shpëtuarve nuk do t'ia kujtojë pasojat e frikshme të mëkatit ndonjë ferr, që digjet në përjetësi.

Mbetet një kujtim i vetëm: Shpëtimtari ynë do të ketë gjithmonë në duar shenjat e kryqëzimit. Në kokën e Tij të plagosur, në ije, mbi duart dhe këmbët e Tij gjenden të vetmet gjurmë të punës mizore, që ka kryer mëkati. Duke parë në vizion Krishtin dhe lavdinë e Tij, profeti thotë: "rreze si shkëndija dilnin nga ija e Tij dhe aty fshihej fuqia e tij." *(Habakuku 3:4)*. Ajo ije e shpuar nga ku rodhi rrëkeja e kuqe, që pajtoi njeriun me Perëndinë, është edhe vendfuqia e Shpëtimtarit, vendi ku fshihet lavdia e Tij.

"I plotfuqishëm për të çliruar" përmes flijimit shlyerës, Ai ishte edhe i gatshëm që të ushtronte drejtësi mbi të gjithë ata që e përçmuan mëshirën e Perëndisë. Shenjat e poshtërimit përbëjnë edhe nderin e Tij më të madh; përmes dekadave të përjetësisë, plagët e Kalvarit do të nxjerrin në pah lavdërimin dhe do të deklarojnë fuqinë e Tij.

"Ti kullë e kopesë, kala e bijës së Sionit, Ty do të vijë sundimi i lashtë." *(Mikea 4:8)*. Ka ardhur koha, që shenjtorët e kanë pritur me padurim që nga momenti që shpata shndritëse ua bllokoi hyrjen në Eden çiftit të parë, koha "për shpengimin e plotë të zotërimit të blerë." *(Efesianët 1:14)*. Toka, që fillimisht iu dha njeriut si mbretëri e tij e që më pas kaloi tradhëtisht në duart e Satanit, pushtuar për një kohë të gjatë nga armiku i fuqishëm, është çliruar tashmë nga plani i shpëtimit.

Është rifituar gjithçka që humbi nga mëkati. "Kështu thotë Zoti...që ka formuar tokën dhe e ka bërë; Ai e ka vendosur, nuk e ka krijuar pa trajtë, por e ka formuar që të banohej." *(Isaia 45:18)*. Qëllimi fillestar i Perëndisë në krijimin e tokës, dhuratën e jetës së përjetshme të të shpëtuarve, është realizuar. "Të drejtët do të trashëgojnë tokën dhe do të banojnë gjithnjë mbi të." *(Psalmi 37:29).*

Frika, që po ta përmendnim shumë do bënim të duket trashëgimia jonë e së ardhmes si diçka tepër materiale, i ka shtyrë shumë njerëz të mos mendojnë për të

vërtetat, që na bëjnë ta shohim atë si shtëpinë tonë. Krishti i siguroi dishepujt e Tij që po largohej për të përgatitur dhoma për ta në shtëpinë e Atit. Ata, që i pranojnë si të vërteta mësimet e fjalës së Perëndisë nuk do të jenë tërësisht të paditur përsa i përket vendbanimit të tyre qiellor. Megjithatë, "syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan." *(1 Korintasve 2:9)*. Gjuha njerëzore nuk është në gjendje që ta përshkruajë shpërblimin e të drejtëve. Do t'u shfaqet vetëm atyre që do të shohin me sy. Nuk ka mendje njerëzore që ta mund të kuptojë lavdinë e Parajsës së Perëndisë.

Në Bibël trashëgimia e të shpëtuarve quhet "atdhe" *(Hebrenjtë 11:14-16)*. Atje Bariu qiellor e drejton tufën e Tij për tek burimet e ujërave të jetës. Pema e jetës jep fryte çdo muaj dhe madje edhe gjethet e saj do t'u duhen kombeve. Aty-këtu ka rrjedha të pashtershme, të pastra si kristal dhe përbri tyre shelgjet lotuese hedhin hije mbi rrugët e përgatitura për të çliruarit e Zotit. Atje lëndinat, njëra pas tjetrës, takojnë kodrat e gjelbra dhe malet e Perëndisë "krenohen" me majat e tyre vigane. Populli i Perëndisë, që është endur dhe ka migruar për një kohë të gjatë, do të gjejë tek këto lëndina paqedashëse dhe përbri këtyre rrëkeve jetëdhënëse, shtëpinë e vet të vërtetë.

"Populli im do të banojë në një vend paqeje, në banesa të sigurta dhe në vende të qeta pushimi." "Nuk do të dëgjohet të flitet më për dhunë në vendin tënd, as për shkatërrime dhe rrënoja brenda kufijve të tu; por do t'i quash muret e tua "Shpëtim" dhe portat e tua "Lavdërim." "Do të ndërtojnë shtëpi dhe do të banojnë në to, do të mbjellin vreshta dhe do të hanë frytin. Nuk do të mbjellin më që të hajë një tjetër...Të zgjedhurit e mi do të gëzojnë për një kohë të gjatë veprat e duarve të tyre." *(Isaia 32:18; 60:18; 65:21,22)*.

Atje, "shkretëtira dhe toka e thatë do të gëzohen, vetmia do të gëzohet dhe do të lulëzojë si trëndafili." "Në vend të ferrave do të rritet selvia, në vend të hithrave do të rritet mersina." "Ujku do të banojë bashkë me qengjin dhe leopardi do të rrijë me kecin...dhe do të udhëhiqen nga një fëmijë." "Nuk do të bëhet asgjë e keqe, asnjë shkatërrim mbi malin Tim të shenjtë. - thotë Zoti." *(Isaia 35:1; 55:13; 11:6,9).*

Nuk mund të ketë dhimbje në atmosferën qiellore. Nuk do të derdhen më lot, nuk do të ketë më vargje varrimi dhe as shenja vajtimesh. "Vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma ...sepse gjërat e mëparshme shkuan." "Asnjë banor i qytetit nuk do të thotë: "unë jam i sëmurë." Populli që banon aty do të përfitojë faljen për paudhësinë e tij." *(Zbulesa 21:4; Isaia 33:24).*

Ja ku është Jeruzalemi i Ri, kryeqyteti i tokës së re të lëvduar, "kurora e shkëlqyer në dorën e Perëndisë tënd." "Shkëlqimi i tij i ngjante një guri shumë të çmuar, si gur diaspri kristalor." "Dhe kombet e të shpëtuarve do të ecin në dritën e tij dhe mbretërit e dheut do të sjellin lavdinë dhe nderin e tyre në të." "Zoti thotë: "Do të kënaqem me Jeruzalemin dhe do të gëzohem me popullin tim." "Ja tab-

ernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe Ai do të banojë me ta dhe ata do të jenë populli i Tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre." *(Isaia 62:3)*; *(Zbulesa 21:11,24)*; *(Isaia 65:19)*; *(Zbulesa 21:3)*.

"Nuk do të bjerë kurrë nata" në Qytetin e Perëndisë. Askush nuk do të dojë dhe as nuk do të ketë nevojë për pushim. Askush nuk do të lodhet, duke kryer vullnetin e Perëndisë dhe duke i thurur lavde emrit të Tij. Ne do të ndiejmë përgjithmonë freskinë e mëngjesit që nuk do të kalojë kurrë. "Ata nuk kanë nevojë për llambë, as për dritë dielli, sepse Zoti Perëndi i ndriçon." *(Zbulesa 22:5)*. Dritën e diellit do ta mbysë një shkëlqim që nuk është tmerrësisht rrezatues, por që megjithatë ia kalon pa masë dritës së mesditës. Lavdia e Perëndisë dhe e Qengjit e pushtojnë Qytetin Hyjnor me një dritë që nuk shuhet kurrë. Të çliruarit ecin në lavdinë, që nuk ka nevojë për ndriçimin diellor, të ditës së përjetshme.

"Nuk pashë asnjë tempull në të, sepse Zoti Perëndi i plotfuqishëm dhe Qengji janë tempulli i Tij." *(Zbulesa 21;22)*. Populli i Perëndisë ka nderin e madh që të komunikojë haptazi me Atin dhe Birin. "Tani në fakt, ne shohim si në pasqyrë në mënyrë të errët." *(1 Korintasve 13:12)*. Ne e shohim imazhin e Perëndisë të reflektuar si në pasqyrë, në veprat e natyrës dhe në marrëdhëniet me njerëzit; por atëherë, atje do ta shohim Atë ballë për ballë pa pasur në mes një perde zbehëse. Ne do të qëndrojmë në praninë e Tij dhe do ta shikojmë me sytë tanë lavdinë e fytyrës së Tij.

Atje, të shpëtuarit do të njohin ashtu siç edhe do të njihen. Dashuria dhe dashamirësia, që vetë Perëndia i ka mbjellë në shpirtin e gjithësecilit, do të marrin atje formën e tyre më të vërtetë e më të plotë. Bashkësia e mirëfilltë me qëniet hyjnore, jeta harmonike me engjëjt e bekuar dhe me besnikët e të gjitha kohërave, që i kanë larë e bërë të bardha borë rrobët e tyre në gjakun e Qengjit, lidhjet e shenjta, që bashkojnë "familjen në qiej e në tokë" *(Efesianët 9:15)* - të gjitha këto, ndërtojnë gurë pas guri lumturinë e të shpëtuarve.

Atje, mendjet e njerëzve të pavdekshëm do të shqyrtojnë me një kënaqësi të pafund çuditë e fuqisë krijuese, misteret e dashurisë çliruese. Nuk do të ketë më asnjë armik mashtrues dhe mizor që të na joshë derisa ta harrojmë Perëndinë. Çdo aftësi do të zhvillohet më tej, çdo cilësi do të përsoset akoma edhe më shumë. Njohuritë e reja nuk do ta lodhin mendjen e as nuk do t'i shterojnë energjitë. Atje mund të realizohen ëndrrat më të mëdha, mund të arrihen aspiratat më të bukura, mund të bëhen realitet synimet më të guximshme e megjithatë do të shfaqen lartësi të reja që duhen kaluar, çudi të reja që duhen admiruar, të vërteta të reja, që duhen kuptuar dhe qëllime të reja, që kërkojnë përkushtim mendjeje, shpirti dhe trupi.

Thesaret e universit do të zbulohen përpara të zgjedhurve të Perëndisë. Të paprekur nga vdekja, ata hapin krahët për të fluturuar pa u lodhur drejt botëve të largëta, - drejt botëve, që i trishtoi pamja e rrënimit njerëzor, por që këndu an himne gëzimi kur dëgjuan lajmin e shpirtrave të shpëtuar. Fëmijët tokësorë hyjnë, duke

përjetuar një çudi të papërshkrueshme, në gëzimin dhe mençurinë e qenieve të pafajshme. Ata marrin pjesë në thesaret e njohurisë dhe dijes së fituar nga shekulli në shekull, në planin e duarve të Perëndisë. Sytë e tyre shquajnë pa as më të voglën pengesë, lavdinë e krijimit - diejt, yjet dhe sistemet qiellore, që në rregullin e duhur, qarkojnë fronin e Perëndisë. Të gjitha gjërat, nga më e vogla tek më e madhja, mbajnë vulën e emrit të Krijuesit dhe tregojnë thellësitë e fuqisë së Tij.

Ndërsa vitet e përjetësisë ia lënë vendin njëri-tjetrit, ata do të zbulojnë më mirë, më lavdishëm, karakterin e Perëndisë dhe të Krishtit. Dashuria, respekti dhe lumturia do të shtohen me rritjen e njohurive. Sa më shumë do të mësojnë për Perëndinë, aq më shumë do ta adhurojnë ata karakterin e Tij. Ndërsa Jezusi zbulon përpara tyre pasuritë e shpëtimit dhe arritjet e mrekullueshme gjatë kontradiktës me Satanin, zemrat e të shpëtuarve drithërohen me një përkushtim të zjarrtë dhe me një gëzim entuziazmues dhe ata i bien harpave të arta, ndërsa dhjetë mijë shumëzuar me dhjetë mijë e mijëra e mijëra zëra të tjerë bashkohen për t'i dhënë jetë korit të fuqishëm të lëvdimit.

"Çdo krijesë që është në qiell, mbi dhe, nën dhe dhe ato që janë në det dhe gjithë gjërat sa janë në to, thonin: "Atij që rri ulur mbi fron dhe Qengjit i qofshin bekimi, nderi, lavdia dhe forca në shekuj të shekujve." *(Zbulesa 5:13)*.

Konfliktit të Madh i ka ardhur fundi. Mëkati dhe mëkatarët janë zhdukur pa gjurmë. Universi mbarë është i pastër. Një impuls i vetëm harmonie dhe gëzimi ndjehet në të gjithë krijimin e pafund. Ai që krijoi gjithçka i fal jetë, dritë dhe gëzim gjithë skajeve të hapësirës së pamasë. Nga atomi pa peshë deri tek bota e madhe, të gjitha gjërat me jetë dhe pa jetë, me bukurinë e tyre të pacënuar dhe me gëzimin e tyre të përsosur deklarojnë se Perëndia është dashuri!

1. Çfarë nënkupton për universin e Perëndisë fundi i Konfliktit të Madh midis Krishtit dhe Satanit?

2. Karakteri i Satanit qëndron i pandryshuar që nga koha kur ran ë mëkat e deri tani. Lexoni Isaian 14:13,14. Si do të sillet Satani kur të zbresë Jeruzalemi i Ri?

3. Malakia 4:1 thotë se "të padrejtët do të jenë si kallmishtet: dhe dita që po vjen do t'i djegë ata." Si mundet një Perëndi i dashur dhe i mëshirshëm të shkatërrojë këtë tokë dhe banorët e saj?

4. Seria e Konfliktit të Kohërave përfundon ashtu siç filloi tek Patriarkët dhe Profetët me universin e pastruar nga mëkati dhe gjithë krijesat deklarojnë se Perëndia është dashuri. Si e keni kuptuar edhe më mirë dashurinë e Perëndisë nëpërmjet leximit të këtyre serive?